VENDIME

TË GJYKATËS KUSHTETUESE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

2025

Volumi II

VENDIMET PËRFUNDIMTARE
TË GJYKATËS KUSHTETUESE 2025

II

VENDIME
TË GJYKATËS KUSHTETUESE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
2025

Vendime 27-54

Volumi II

© Botim i Gjykatës Kushtetuese
Tiranë, 2026

ISBN 9789928861580 (Set)
ISBN 9789928861603 (v. 2)

PRINTED AND BOUND IN ALBANIA BY ONUFRI

Rr. “Konferenca e Pezës”, Nr. 71, Kodi Postar 1027, Tiranë;
Tel & Fax 00355 42 220 017 / 270 399
www.onufri.com; E-mail: info@onufri.com

Përmbajtja

Vendim nr. 27, datë 29.04.2025 (V-27/25) 659
Vendim nr. 28, datë 30.04.2025 (V-28/25) 676
Vendim nr. 29, datë 30.04.2025 (V-29/25) 693
Vendim nr. 30, datë 02.05.2025 (V-30/25) 709
Vendim nr. 31, datë 02.05.2025 (V-31/25) 726
Vendim nr. 32, datë 19.05.2025 (V-32/25) 748
Vendim nr. 33, datë 20.05.2025 (V-33/25) 766
Vendim nr. 34, datë 27.05.2025 (V-34/25) 807
Vendim nr. 35, datë 27.05.2025 (V-35/25) 828
Vendim nr. 36, datë 04.06.2025 (V-36/25) 853
Vendim nr. 37, datë 04.06.2025 (V-37/25) 869
Vendim nr. 38, datë 10.06.2025 (V-38/25) 879
Vendim nr. 39, datë 17.06.2025 (V-39/25) 897
Vendim nr. 40, datë 17.06.2025 (V-40/25) 913
Vendim nr. 41, datë 24.06.2025 (V-41/25) 932
Vendim nr. 42, datë 01.07.2025 (V-42/25) 942
Vendim nr. 43, datë 24.07.2025 (V-43/25) 997
Vendim nr. 44, datë 29.07.2025 (V-44/25) 1014
Vendim nr. 45, datë 31.07.2025 (V-45/25) 1077
Vendim nr. 46, datë 18.09.2025 (V-46/25) 1127
Vendim nr. 47, datë 18.09.2025 (V-47/25) 1149
Vendim nr. 48, datë 22.09.2025 (V-48/25) 1158
Vendim nr. 49, datë 24.09.2025 (V-49/25) 1196
Vendim nr. 50, datë 25.09.2025 (V-50/25) 1221
Vendim nr. 51, datë 25.09.2025 (V-51/25) 1237
Vendim nr. 52, datë 07.10.2025 (V-52/25) 1245
Vendim nr. 53, datë 09.10.2025 (V-53/25) 1264
Vendim nr. 54, datë 09.10.2025 (V-54/25) 1282

Indeks i vendimeve të vitit 2025 1295

Vendim nr. 27, datë 29.04.2025
(V-27/25)

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Holta Zaçaj, Kryetare, Marsida Xhaferllari, Fiona Papajorgji, Sandër Beci, Ilir Toska, Marjana Semini, Genti Ibrahimi, Sonila Bejtja, anëtarë, me sekretare Belma Lleshi, në datën 29.04.2025 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 28 (E) 2024 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: **EDMOND MAMUSHI**

SUBJEKT I INTERESUAR:
PROKURORIA E PËRGJITHSHME, përfaqësuar nga prokuror Arqile Koca, me autorizim.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimeve nr. 22/22-2018-127, datë 17.04.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr. 20-2018-830/104, datë 17.10.2018 të Gjykatës së Apelit Gjirokastër; nr. 00-2024-1285, datë 11.07.2024 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

BAZA LIGJORE: **Nenet 4, 42, 131, pika 1, shkronja "f", 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2 dhe 142 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); nenet 27, 31, 31/a, 71 dhe 71/a të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).**

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Sonila Bejtja, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuesit Edmond Mamushi (*kërkuesi*), i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar, Prokurorisë së Përgjithshme, që ka kërkuar pranimin pjesërisht të kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I
Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi është akuzuar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet për kryerjen e veprave penale "Vrasja me paramendim", të mbetur në tentativë dhe "Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe e municionit", të parashikuara nga nenet 78, paragrafi i dytë dhe 22, si dhe 278, paragrafi i dytë, të Kodit Penal (*KP*).

2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Përmet, me vendimin nr. 22/22-2018-127, datë 17.04.2018, ndër të tjera, ka vendosur ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale në ngarkim të kërkuesit, nga "Vrasja me paramendim", të mbetur në tentativë, të parashikuar nga nenet 78, paragrafi i dytë dhe 22 të KP-së, në "Vrasja me paramendim", të mbetur në tentativë, të parashikuar nga nenet 78, paragrafi i parë dhe 22 të KP-së, duke e deklaruar atë fajtor për kryerjen e kësaj vepre, si dhe duke e dënuar me 15 (pesëmbëdhjetë) vjet burgim. Po kështu, ajo gjykatë ka vendosur edhe ndryshimin e cilësimit juridik të veprës tjetër penale në ngarkim të kërkuesit, nga "Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyese dhe i municionit", të parashikuar nga neni 278, paragrafi i dytë, i KP-së, në veprën penale "Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyese dhe i municionit", të parashikuar nga neni 278, paragrafi i parë, i KP-së, duke e deklaruar atë fajtor për këtë vepër, duke e dënuar me 3 (tre) vjet burgim. Në aplikim të neneve 55 dhe 56 të KP-së, në bashkim të dënimeve, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Përmet e ka dënuar kërkuesin përfundimisht me 15 (pesëmbëdhjetë) vjet burgim. Ndaj këtij vendimi ka bërë ankim kërkuesi.

3. Gjykata e Apelit Gjirokastër, me vendimin nr. 20-2018-830/104, datë 17.10.2018, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 22/22-2018-127, datë 17.04.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet. Ndaj këtij

vendimi, në datën 18.11.2018, ka paraqitur rekurs kërkuesi. Gjithashtu, rezulton se në datat 06.03.2023 dhe 05.07.2024 kërkuesi ka paraqitur edhe dy akte të tjera në Gjykatën e Lartë, nëpërmjet të cilave ka parashtruar pretendimet e tij për kundërshtimin e vendimit të gjykatës së apelit.

4. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-1285, datë 11.07.2024, ka vendosur mospranimin e rekursit, për shkak se nuk përmbante asnjë prej shkaqeve të parashikuara në nenin 432, pika 1, të Kodit të Procedurës Penale (*KPP*). Në vlerësimin e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, Gjykata e Apelit Gjirokastër, e cila ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë, ka bërë një analizë të hollësishme të dinamikës së fakteve dhe provave të marra e të administruara në këtë gjykim dhe se pretendimet e kërkuesit për moskryerjen e ekspertimit teknik të armës, eksperimentit hetimor për këtë armë dhe fishekëve të saj nuk e cenojnë vendimmarrjen e gjykatave të faktit, të cilat, bazuar në nenin 152 të KPP-së, i kanë çmuar provat në tërësi në përputhje me njëra-tjetrën, duke mos mbivlerësuar asnjërën nga ato. Po sipas Kolegjit Penal, nuk konstatohet që gjykatat e faktit nuk kanë respektuar parimin e prezumimit të pafajësisë ose që ndaj kërkuesit të jetë zhvilluar një proces jo i rregullt ligjor, referuar nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së.

5. Në datën 30.10.2024 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*), me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij, i cili është regjistruar në të njëjtën datë.

II
Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

6. ***Kërkuesi,*** në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar e drejta për proces të rregullt në drejtim të:

6.1. *Së drejtës së aksesit substancial të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor,* pasi gjykata e apelit nuk ka marrë në shqyrtim dhe nuk ka arsyetuar pretendimet me natyrë kushtetuese të ngritura në ankim nga kërkuesi, të cilat lidheshin me cenimin e parimeve të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit, prezumimit të pafajësisë dhe standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor. Gjithashtu, rezulton se edhe Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë nuk i ka marrë në shqyrtim, nuk ka arsyetuar dhe nuk u ka dhënë përgjigje pretendimeve me natyrë kushtetuese të ngritura në rekurs, si dhe aktet e tjera të paraqitura nga ai, që kishin të bënin

me cenimin e parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit, prezumimit të pafajësisë dhe të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, jo vetëm që nuk i ka shqyrtuar dhe arsyetuar pretendimet me natyrë kushtetuese të ngritura në aktet e tjera të paraqitura nga kërkuesi, por as nuk i ka pasqyruar ato në pjesën e vendimit ku parashtrohen pretendimet e rekursuesit, në kundërshtim me jurisprudencën e Gjykatës, konkretisht me vendimin nr. 19, datë 07.07.2022.

6.2. *Parimit të barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit,* pasi gjykata e shkallës së parë dhe gjykata e apelit, në vlerësimin e tyre, u janë referuar vetëm dëshmive dhe provave të paraqitura nga organi i akuzës dhe në asnjë moment nuk u janë referuar dëshmitarëve ose provave të paraqitura nga kërkuesi. Dëshmitë e marra në shqyrtim nga gjykatat nuk janë të mjaftueshme për të formuar bindjen e tyre për fajësinë e kërkuesit dhe ato nuk kanë administruar asnjë provë për të mbështetur vendimmarrjen e tyre. Mënyra sesi kanë vepruar ato gjykata, vë në dyshim respektimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të garantimit të parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit, si dhe së drejtës së mbrojtjes.

7. ***Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme***, në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar si vijon:

7.1. Pretendimi i kërkuesit për cenimin e *së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor* është i pabazuar, pasi bazuar në nenin 415, pika 2, të KPP-së, ai që ka bërë ankim ka të drejtë të paraqesë në sekretarinë e gjykatës që do të shqyrtojë çështjen, parashtrime me shkrim për shkaqet e ngritura në ankim, ndërkohë, në rastin konkret, kërkuesi nuk ka paraqitur parashtrime, por ka paraqitur shtesë rekursi. Gjithashtu, parashtrimet e ngritura nga kërkuesi në rekurs kanë të bëjnë me çështje provash dhe nuk paraqitet asnjë argument, fakt ose provë e re që është kërkuar apo pretenduar nga kërkuesi, e cila nuk është shqyrtuar ose analizuar nga gjykatat më të ulëta.

7.2. I pabazuar është edhe pretendimi tjetër i kërkuesit për cenimin e *parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit*, pasi referuar vendimmarrjes së gjykatës së shkallës së parë është pasqyruar marrja e dëshmive të një sërë dëshmitarësh, dëshmitë e të cilëve ishin në harmoni më ngjarjen e pasqyruar. Gjithashtu, është

shqyrtuar pretendimi i kërkuesit se ishte i pafajshëm dhe se ai nuk kishte kryer veprën penale, duke analizuar harmonizimin e të gjitha provave. Madje gjykata e shkallës së parë, në përfundim, ka bërë një rikualifikim të veprës penale në ngarkim të kërkuesit në favor të tij. Vendimi i gjykatës së shkallës së parë është lënë në fuqi nga gjykata e apelit, duke marrë kjo e fundit në analizë të gjitha provat e gjykimit, të cilat, të vlerësuara në harmoni me njëra-tjetrën, vërtetonin tej çdo dyshimi të arsyeshëm se kërkuesi ka kryer veprën penale.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkuesit

8. Çështja e legjitimimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

9. Në këtë këndvështrim, kërkuesi, si individ, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të shkronjës "f" të pikës 1 të nenit 131 dhe shkronjës "i" të pikës 1 të nenit 134 të Kushtetutës, pasi është palë në çështjen objekt të ankimit kushtetues individual, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të këtij gjykimi.

10. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës, Gjykata vëren se kërkuesi i është drejtuar asaj me ankim kushtetues individual pas përfundimit të procesit gjyqësor në të tria shkallët e gjyqësorit të zakonshëm dhe pasi ka shteruar në formë e substancë mjetet e zakonshme të ankimit ndaj vendimeve të gjykatave më të ulëta. Për rrjedhojë, ai nuk ka mjet tjetër

juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të tij kushtetuese përveç paraqitjes së ankimit kushtetues individual.

11. Kërkuesi legjitimohet edhe *ratione temporis*, në kuptim të përmbajtjes së nenit 71/a, pika 1, shkronja "b", të ligjit nr. 8577/2000, pasi vendimi më i fundit në kohë i kundërshtuar, ai i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, mban datën 11.07.2024, ndërsa kërkesa është paraqitur në këtë Gjykatë në datën 30.10.2024, pra brenda afatit ligjor 4-mujor.

12. Në lidhje me legjitimimin *ratione materiae*, Gjykata vëren se pretendimet e kërkuesit lidhen me cenimin e së drejtës së aksesit substancial të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor, si dhe me cenimin e parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit, si elemente të procesit të rregullt ligjor.

13. Për sa i përket pretendimit për cenimin e *parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit*, kërkuesi ka argumentuar se gjykata e shkallës së parë dhe gjykata e apelit, në vlerësimin e tyre, u janë referuar vetëm dëshmive dhe provave të paraqitura nga organi i akuzës dhe në asnjë moment nuk u janë referuar dëshmitarëve ose provave të paraqitura nga ai. Sipas kërkuesit, dëshmitë e marra në shqyrtim nga ato gjykata nuk janë të mjaftueshme për të formuar bindjen e tyre për fajësinë e tij dhe ato nuk kanë administruar asnjë provë për të mbështetur vendimmarrjen e tyre. Po kështu, kërkuesi ka pretenduar se nuk rezulton që nga gjykatat të jetë hetuar se kujt i përkiste arma, e cila është përdorur në krim.

14. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se në procesin penal mbrojtja e të pandehurit lidhet ngushtë me parimin e barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit, të cilat së bashku përbëjnë në vetvete elementet më të qenësishme e thelbësore të procesit të rregullt ligjor në kuptimin kushtetues. Prandaj, për respektimin e tyre, gjykata duhet të përmbushë me rigorozitet një sërë detyrimesh, me synimin kryesor realizimin e një debati real ndërmjet akuzës dhe mbrojtjes, gjë që ndikon pozitivisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë në zbulimin e së vërtetës dhe dhënien e drejtësisë nga gjykata me objektivitet e paanësi. Këto kërkesa kushtetuese e ligjore janë në funksion të mbrojtjes sa më efektive të të pandehurit, pasi përballë tij qëndron vetë shteti i përfaqësuar në procesin penal nga prokurori që paraqet dhe mbron akuzën kundër tij (*shih vendimet nr. 34, datë 17.11.2022; nr. 71, datë 30.11.2016 të Gjykatës Kushtetuese*). Parimi i barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit në gjykimin penal, i garantuar nga neni 31 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së, kërkon që argumentet e mbrojtjes të paraqiten dhe të dëgjohen njëlloj si ato të prokurorit. Ky parim

prezupozon që secilës palë duhet t'u ofrohen mundësi të arsyeshme për të paraqitur pretendimet për çështjen, në kushte të tilla që të mos e vënë në disavantazh me palën tjetër (*shih vendimet nr. 13, datë 24.04.2018; nr. 16, datë 27.03.2012; nr. 5, datë 17.02.2003 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Në këndvështrim të standardeve të mësipërme kushtetuese, për sa u përket pretendimeve të kërkuesit për cenimin e parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit, Gjykata vëren se kërkuesi nuk ka argumentuar se cilave provave ose dëshmitarëve nuk u janë referuar gjykatat, të cilat ishin në favor të tij. Gjithashtu, bazuar në arsyetimin e gjykatave të shkallës së parë dhe asaj të apelit, Gjykata konstaton se nuk rezulton që kërkuesi të jetë vënë në pozita të pabarabarta me organin e akuzës. Atij i është dhënë mundësia që gjatë procesit të zhvilluar në gjykatën e shkallës së parë dhe gjykatën e apelit të kundërshtojë akuzat e ngritura ndaj tij, provat mbi të cilat janë ngritur këto akuza, të debatojë për to, si dhe të paraqesë argumente dhe prova në mbështetje të pretendimeve të tij. Për këto arsye, Gjykata çmon se pretendimi i kërkuesit për cenimin e *parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit* është haptazi i pabazuar.

16. Për sa i përket pretendimit tjetër të parashtruar në ankimin kushtetues individual për cenimin e *së drejtës së aksesit substancial të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor*, Gjykata vëren se argumentet e kërkuesit kanë të bëjnë me qëndrimin që kanë mbajtur Gjykata e Apelit Gjirokastër dhe Gjykata e Lartë për pretendimet e tij me natyrë kushtetuese, të parashtruara përpara atyre gjykatave, të cilat kanë të bëjnë me parimet e prezumimit të pafajësisë dhe të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit, si dhe me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor. Edhe pse kërkuesi i ka ngritur këto pretendime edhe në këndvështrim të vendimmarrjes së gjykatës së apelit, duke pasur parasysh jo vetëm natyrën e tyre, por edhe pozicionin e Gjykatës së Lartë në drejtim të verifikimit të respektimit dhe të standardeve kushtetuese, për shkak të natyrës subsidiare të kontrollit kushtetues, si dhe referuar akteve të paraqitura nga kërkuesi në Gjykatën e Lartë (rekurs dhe aktet e tjera), ku në thelb ai ka pretenduar cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë, Gjykata çmon të shqyrtojë në vijim, në themel, nëse Gjykata e Lartë ka marrë në shqyrtim pretendimet e kërkuesit dhe nëse, në këndvështrim të së drejtës së aksesit dhe të standardit të arsyetimit, i ka dhënë përgjigje përfundimtare të arsyetuar pretendimit për cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor, në drejtim të parimit të prezumimit të pafajësisë

17. Kërkuesi ka pretenduar se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë nuk i ka marrë në shqyrtim, nuk i ka dhënë përgjigje dhe nuk ka arsyetuar për pretendimet me natyrë kushtetuese të ngritura në rekurs dhe në aktet e tjera të paraqitura prej tij. Po kështu, kërkuesi ka pretenduar se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, jo vetëm që nuk i ka shqyrtuar dhe arsyetuar pretendimet me natyrë kushtetuese të ngritura në aktet e tjera të paraqitura nga ai, por as nuk i ka pasqyruar ato në pjesën e vendimit ku parashtrohen pretendimet e rekursuesit, në kundërshtim me jurisprudencën e Gjykatës, konkretisht me vendimin nr. 19, datë 07.07.2022.

18. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme, ka prapësuar, duke argumentuar se ky pretendim i kërkuesit është i pabazuar, pasi, bazuar në nenin 415, pika 2, të KPP-së, ai që ka bërë ankim ka të drejtë të paraqesë në sekretarinë e gjykatës që do të shqyrtojë çështjen parashtrime me shkrim për shkaqet e ngritura në ankim, ndërkohë, në rastin konkret, kërkuesi nuk ka paraqitur parashtrime, por ka paraqitur shtesë rekursi. Gjithashtu, sipas Prokurorisë së Përgjithshme, parashtrimet e ngritura nga kërkuesi në rekurs kanë të bëjnë me çështje provash dhe nuk paraqitet asnjë argument, fakt ose provë e re që është kërkuar ose pretenduar nga kërkuesi dhe nuk është shqyrtuar ose analizuar nga gjykatat më të ulëta.

19. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se e drejta për të pasur akses në gjykatë i garanton individit të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës dhe për të marrë një përgjigje përfundimtare prej saj, të arsyetuar, për pretendimet e ngritura (*shih vendimet nr. 5, datë 29.01.2025; nr. 11, datë 21.04.2022; nr.17, datë 24.03.2014 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjithashtu, Gjykata ka pohuar se kur në rekurs janë ngritur pretendime të natyrës kushtetuese, Gjykata e Lartë, bazuar në natyrën e gjykimit kushtetues të kërkesave individuale, si dhe në parimin e subsidiaritetit që udhëheq raportet ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme, duhet të investohet në ekzaminimin e tyre dhe të mbajë një qëndrim të shprehur për to (*shih vendimet nr. 5, datë 29.01.2025; nr. 47, datë 11.06.2024; nr. 11, datë 16.04.2018 të Gjykatës Kushtetuese*). Për rrjedhojë, në rastet kur pretendimet me natyrë kushtetuese të paraqitura në rekurs nuk gjejnë pasqyrim në vendimin e Gjykatës së Lartë dhe atyre nuk u jepet përgjigje, arsyetimi i vendimit të asaj gjykate nuk ka përmbushur

një ndër funksionet e tij, konkretisht të drejtën e individit për t'u dëgjuar për të gjitha pretendimet e ngritura (*shih vendimet nr. 5, datë 29.01.2025; nr. 28, datë 11.04.2024; nr. 19, datë 07.07.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Po kështu, Gjykata ka theksuar se parimi i prezumimit të pafajësisë kërkon që deklarimi i fajësisë të të pandehurit të bëhet nga gjykata vetëm pas një shqyrtimi të plotë të çështjes. Sipas këtij parimi, asnjë masë që barazohet me dënimin nuk mund të jepet ndaj një të pandehuri pa u provuar fajësia e tij përtej çdo dyshimi të arsyeshëm (*shih vendimet nr. 20, datë 03.04.2024; nr. 4, datë 21.02.2022; nr. 68, datë 14.11.2016 të Gjykatës Kushtetuese*). Garancitë kushtetuese të parimit të prezumimit të pafajësisë janë konkretizuar në rregullat e KPP-së, duke i krijuar në këtë mënyrë të gjitha mundësitë organit që procedon me ndjekjen penale (prokurorisë dhe gjykatave) për të përmbushur detyrën kushtetuese të respektimit të këtij parimi. Kështu, parimi i prezumimit të pafajësisë parashikohet në nenin 4 të këtij kodi, sipas të cilit i pandehuri prezumohet i pafajshëm gjersa nuk vërtetohet fajësia e tij me vendim gjyqësor të formës së prerë dhe se çdo dyshim për akuzën çmohet në favor të tij (*shih vendimet nr. 20, datë 03.04.2024; nr. 63, datë 20.11.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Në kuptim të sa më sipër, në këndvështrim të këtyre standardeve kushtetuese, Gjykata do të verifikojë, në vijim nëse Gjykata e Lartë ka pasqyruar në vendimin e saj pretendimet e ngritura nga kërkuesi në rekurs dhe në aktet e tjera të paraqitura përpara asaj gjykate, të cilat kanë të bëjnë me parimin e prezumimit të pafajësisë dhe, më tej, do të vlerësojë nëse ajo gjykatë, në këndvështrim të së drejtës së aksesit dhe të standardit të arsyetimit, i ka marrë në shqyrtim këto pretendime dhe nëse u ka dhënë atyre përgjigje përfundimtare të arsyetuar.

22. Në rastin konkret, në vendimet e tyre gjykatat e faktit pranojnë se kërkuesi ka përdorur në vendin e ngjarjes një armë zjarri, me qëllim për të vrarë shtetasin J.H., por arma nuk ka realizuar qitje. Sipas tyre, arma e krimit nuk është gjetur as në vendin e ngjarjes dhe as i është sekuestruar kërkuesit. Nga ana tjetër, pranohet se arma e krimit është dorëzuar në ambientet e Komisariatit të Policisë Përmet, bashkë me disa fishekë, pas ndodhjes së ngjarjes, nga viktima e veprës penale J.H. dhe shtetasi E.Ç., i cili ka qenë në shoqërinë e të parit në vendin e ngjarjes. Te kjo armë nuk janë gjetur gjurmë papilare të kërkuesit. Arma dhe fishekët e dorëzuar në këto rrethana i janë nënshtruar ekspertimit teknik nga Instituti i Policisë Shkencore Tiranë duke u përpiluar akti nr. 12080, datë 07.11.2016, i cili, në vijim, është përdorur si prova e vetme shkencore për fajësinë e kërkuesit.

Po ashtu, për veprimin e lëvizjes nga vendi i ngjarjes të armës së krimit, prokuroria ka ushtruar ndjekjen penale të shtetasit E.Ç. për veprën penale "Veprime që pengojnë zbulimin e të vërtetës", të parashikuar nga neni 301 i KP-së, por që më pas hetimet për këtë shtetas janë pushuar me argumentin se veprimi i tij nuk ka pasur për qëllim të ndihmojë të pandehurin/kërkuesin për t'iu shmangur përgjegjësisë penale ose për të penguar zbulimin e së vërtetës, por për shkak se ka pasur frikë se arma mund të përdorej nga persona të tjerë kundër të pandehurit. Ndërkohë, kërkuesi gjatë gjithë procesit penal ka mohuar kryerjen e veprave penale për të cilat akuzohej dhe, në veçanti, faktin e mbajtjes dhe përdorimit të armës të dorëzuar nga viktima e veprës penale J.H. dhe shtetasi E.Ç.

23. Referuar këtyre fakteve si dhe akteve të dosjes gjyqësore të administruar për qëllime të këtij gjykimi kushtetues, Gjykata konstaton se Gjykata e Lartë është vënë në lëvizje mbi bazën e rekursit të paraqitur nga kërkuesi, i cili, në vijim, ka paraqitur në Gjykatën e Lartë edhe dy akte të tjera, në të cilat ka parashtruar pretendimet e tij ndaj vendimit të gjykatës së apelit. Ato janë depozituar në Gjykatën e Lartë në datat 06.03.2023 dhe 05.07.2024. Referuar përmbajtjes së rekursit, rezulton se kërkuesi ka parashtruar si shkaqe se vendimi i gjykatës së apelit është rrjedhojë e një procesi të parregullt ligjor, në shkelje të neneve 42 e vijues të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së, duke dënuar një person të pafajshëm, si dhe duke e prezumuar atë të fajshëm, në një kohë që pafajësia e tij është provuar në të dyja shkallët e gjykimit. Po në mbështetje të parimit të prezumimit të pafajësisë, kërkuesi ka argumentuar në rekurs se gjykimi ndaj tij ka nxjerrë në pah faktin se organi i akuzës dhe gjykatat e kanë deformuar këtë parim dhe kanë deformuar edhe përgjegjësinë dhe përgjegjshmërinë e organit prokurorisë për të provuar fajësinë e tij. Sipas kërkuesit, ky parim është cenuar prej gjykatave për shkak se arma me të cilën pretendohet se është kryer vepra penale nuk ka qenë e tij, por e viktimës. Gjykata konstaton se në aktin e datës 05.07.2024 drejtuar Gjykatës së Lartë, kërkuesi, ndër të tjera, ka ngritur pretendime për mënyrën e marrjes së provave, duke argumentuar se prokuroria ka sekuestruar një armë tip pistoletë me tre fishekë, të dorëzuar nga shtetasi J.H., viktima e veprës penale dhe shtetasi E.Ç. dhe fishekët kanë dalë nga xhepi i këtyre të fundit. Këto shkaqe në thelbin e tyre lidhen gjithashtu me parimin e prezumimit të pafajësisë.

24. Referuar përmbajtjes së vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, Gjykata konstaton se në pjesën hyrëse të tij, ku parashtrohen pretendimet e rekursuesit, ai kolegj ka pasqyruar si pretendimet e

parashtruara në rekurs, ashtu edhe ato të parashtruara në aktin e datës 06.03.2023. Ndërkohë, nuk rezulton që të jenë pasqyruar në vendim pretendimet e kërkuesit të paraqitura në aktin e datës 05.07.2024. Në këtë drejtim, Gjykata konstaton, fillimisht, se pretendimet e kërkuesit të paraqitura në Gjykatën e Lartë me aktin e datës 05.07.2024 nuk rezulton të jenë pretendime të reja, por janë argumente në mbështetje të pretendimeve të ngritura më parë prej tij në rekurs, në drejtim të pretendimit për cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë. Në këtë kuptim, Gjykata vlerëson se mospasqyrimi i tyre në vendimin e Gjykatës së Lartë nuk përbën shkelje të natyrës kushtetuese[1].

25. Për sa i përket përmbajtjes dhe thelbit të pretendimeve të parashtruara në rekurs dhe në aktet e tjera të paraqitura përpara Gjykatës së Lartë, kërkuesi ka pretenduar cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë në drejtim të provueshmërisë së fajësisë të tij tej çdo dyshimi të arsyeshëm, për sa i përket mbajtjes dhe përdorimit nga ai të armës e cila, sipas kërkuesit, i përkiste viktimës së veprës penale dhe është dorëzuar prej këtij të fundit *(shih paragrafin 23 më sipër).* Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, pasi ka marrë në shqyrtim shkaqet e parashtruara nga kërkuesi, për pretendimin për cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë ka vlerësuar se nuk konstatohet që gjykatat e faktit të mos e kenë respektuar atë ose që ndaj kërkuesit të jetë zhvilluar një proces jo i rregullt dhe nuk evidentohet zbatimi i gabuar i ligjit penal material i lidhur me kualifikimin ligjor të veprës penale dhe caktimin e dënimit ndaj të gjykuarit (neni 47 i KP-së), si dhe i ligjit procedural penal për çmuarjen dhe vlerësimin e provave, sipas nenit 152 të KPP-së. Sipas Kolegjit Penal, Gjykata e Apelit Gjirokastër ka bërë një analizë të hollësishme të dinamikës së fakteve dhe provave të marra e të administruara në këtë gjykim dhe pretendimet e kërkuesit për moskryerjen e ekspertimit teknik të armës dhe eksperimentit hetimor për këtë armë dhe fishekëve të saj nuk e cenojnë vendimmarrjen e gjykatave të faktit, të cilat i kanë çmuar provat në tërësi, në përputhje me njëra-tjetrën, duke mos mbivlerësuar asnjërën prej tyre (*shih paragrafët 23-25 të vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë*).

[1] Gjyqtarët Fiona Papajorgji, Sonila Bejtja dhe Sandër Beci, bazuar edhe në jurisprudencën kushtetuese sipas së cilës mospasqyrimi në pjesën hyrëse të vendimit të Gjykatës së Lartë i shkaqeve të parashtruara në shtesën e rekursit përbën cenim të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor (*shih vendimet nr. 77, datë 05.11.2024; nr. 19, datë 07.07.2022 të Gjykatës Kushtetuese*), mbajtën qëndrimin se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë duhet të pasqyronte në pjesën hyrëse të vendimit të tij edhe pretendimet e parashtruara nga kërkuesi në aktet e paraqitura përpara Gjykatës së Lartë në datën 05.07.2024 për kundërshtimin e vendimeve të gjykatave më të ulëta.

26. Duke iu referuar natyrës së këtij pretendimi, në këndvështrim të standardeve të mësipërme kushtetuese, të cilat janë të zbatueshme edhe gjatë gjykimit në Gjykatën e Lartë, duke pasur parasysh rolin dhe funksionin e asaj gjykate për kontrollin edhe të kushtetutshmërisë së procesit gjyqësor dhe parimin e subsidiaritetit, Gjykata vlerëson se Gjykata e Lartë duhej të ishte ndalur në vlerësimin e këtij pretendimi, duke mbajtur një qëndrim të shprehur për të dhe duke dhënë arsyetim për bazueshmërinë e tij. Me fjalë të tjera, Gjykata e Lartë duhej t'i kishte dhënë përgjigje pretendimit të kërkuesit për zbatimin e gabuar të ligjit procedural sa i takon çmuarjes së provave nga ana e gjykatave të faktit në lidhje me mbajtjen dhe përdorimin nga ai në vendin e ngjarjes të armës të dorëzuar, në një distancë kohore pas ngjarjes, nga viktima e veprës penale dhe personi që shoqërohej me të, në raport me përfundimin e arritur nga ato për të provuarin tej çdo dyshimi të arsyeshëm të kryerjes nga ai të veprave penale për të cilat është gjetur fajtor.

27. Duke mbajtur një qasje formale në drejtim të vlerësimit të shkaqeve të rekursit në tërësinë e tyre, pa u ndalur në aspekte të veçanta të procesit gjyqësor që mbartin natyrë kushtetuese, për shkak të natyrës së pretendimeve, Gjykata vlerëson se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë nuk ka arsyetuar për pretendimin e kërkuesit për cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë dhe arsyetimi i kufizuar i atij kolegji, në këtë rast konkret, nuk përmbush detyrimin kushtetues për arsyetimin e vendimit gjyqësor, si element i së drejtës për proces të rregullt ligjor. Edhe pse pretendimi i ngritur nga kërkuesi, për sa i përket armës me të cilën është kryer vepra penale, përbën një nga aspektet më të rëndësishme të të provuarit të fajësisë së tij përtej çdo dyshimi të arsyeshëm, ky pretendim nuk ka marrë përgjigje përfundimtare të arsyetuar. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se arsyetimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë është haptazi i paarsyeshëm dhe i pamjaftueshëm në këndvështrimin kushtetues.

28. Nën këtë optikë, Gjykata çmon se Gjykata e Lartë, duke mos i dhënë përgjigje të arsyetuar kërkuesit për pretendimin e tij për cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë, ka vënë në dyshim respektimin e së drejtës së tij për të marrë përgjigje të arsyetuar për të gjitha pretendimet e ngritura përpara asaj gjykate, në këndvështrim të së drejtës së aksesit substancial në gjykatë dhe standardit të arsyetimit të vendimeve gjyqësore. Për këtë arsye, Gjykata çmon se pretendimet e kërkuesit në drejtim të së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor, në drejtim të parimit të prezumimit të pafajësisë, janë të bazuara.

29. Në përfundim, Gjykata çmon se pretendimi i kërkuesit për cenimin e së drejtës së aksesit i lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor është i bazuar, sipas arsyetimit të mësipërm të këtij vendimi, ndaj kërkesa pranohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, si dhe neneve 71 dhe 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, shumicë votash,

V E N D O S I:

1. Pranimin pjesërisht të kërkesës.

2. Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2024-1285, datë 11.07.2024 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën.

3. Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 29.04.2025
Shpallur më 28.05.2025

MENDIM PAKICE

1. Në gjykimin kushtetues të çështjes që i përket kërkuesit Edmond Mamushi, me objekt: "*Shfuqizimi i vendimeve nr. 22/22-2018-127, datë 17.04.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr. 20-2018-830/104, datë 17.10.2018 të Gjykatës së Apelit Gjirokastër; nr. 00-2024-1285, datë 11.07.2024 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë*", jemi kundër qëndrimit të shumicës për pranimin pjesërisht të kërkesës, pasi vlerësojmë se kërkesa duhej të ishte rrëzuar në tërësinë e saj. Në mbështetje të nenit 132, pika 3, të Kushtetutës dhe nenit 72, pika 8, të ligjit nr. 8577/2000, që parashikojnë publikimin e mendimit të pakicës së bashku me vendimin përfundimtar të Gjykatës, parashtrojmë, në vijim, argumentet që mbështesin qëndrimin tonë kundër.

2. Në mënyrë të përmbledhur, rezulton se kërkuesi është dënuar me 15 vjet burgim nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Përmet për veprat penale të vrasjes me paramendim në tentativë dhe të mbajtjes pa leje të armëve luftarake. Ndonëse, ai ka paraqitur ankim, vendimi është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Gjirokastër, ndërsa Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuesit.

3. Kërkuesi ka paraqitur ankim kushtetues individual, duke pretenduar se Gjykata e Lartë ka cenuar të drejtën për proces të rregullt ligjor në aspekt të së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor, si dhe parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit, të garantuara nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës.

4. Shumica i ka vlerësuar pretendimet e kërkuesit në këndvështrim të së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor në drejtim të parimit të prezumimit të pafajësisë (*shih paragrafin 16 të vendimit*). Ajo ka arritur në përfundimin se vendimi i Gjykatës së Lartë duhet shfuqizuar, pasi Gjykata e Lartë ka mbajtur qasje formale në drejtim të vlerësimit të shkaqeve të rekursit në tërësinë e tyre, pa u ndalur në aspekte të veçanta të procesit gjyqësor që mbartin natyrë kushtetuese për shkak të natyrës së pretendimeve, duke dhënë një arsyetim të kufizuar për rastin, i cili bie ndesh me standardin kushtetues. Sipas shumicës, edhe pse pretendimi i ngritur nga kërkuesi që lidhej me armën luftarake, me të cilën është kryer vepra penale, përbën një nga aspektet më të rëndësishme të të

provuarit të fajësisë së tij përtej çdo dyshimi të arsyeshëm, ky pretendim nuk ka marrë përgjigje përfundimtare të arsyetuar, ndaj arsyetimi i Gjykatës së Lartë është haptazi i paarsyeshëm dhe i pamjaftueshëm në këndvështrimin kushtetues (*shih paragrafin 25 të vendimit*).

5. Nuk pajtohemi me këtë vlerësim të shumicës, pasi çmojmë se vendimi i Gjykatës së Lartë përmbush standardin kushtetues të arsyetimit, duke i treguar kërkuesit që është dëgjuar, duke i dhënë mundësinë atij ta kundërshtojë atë (*shih vendimet nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 10, datë 04.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Arsyetimi i kufizuar i vendimit të marrë nga Gjykata e Lartë në dhomën e këshillimit nuk e ka cenuar procesin e rregullt ligjor, pasi ai është tregues i faktit se kërkuesi nuk ka ngritur asnjë nga argumentet ligjore të përcaktuara në dispozitën përkatëse të legjislacionit të brendshëm, që është kusht për pranimin e kërkesës (*shih vendimet nr. 29, datë 01.11.2022; nr. 14, datë 21.06.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

6. Çështja themelore që na ndan me shumicën lidhet me faktin nëse arsyetimi i kufizuar i Gjykatës së Lartë konsiderohet përgjigje për pretendimin e kërkuesit lidhur me parimin e prezumimit të pafajësisë. Ashtu siç ka pohuar shumica, parimi i prezumimit të pafajësisë kërkon që deklarimi i fajësisë të të pandehurit të bëhet nga gjykata vetëm pas një shqyrtimi të plotë të çështjes dhe se, sipas këtij parimi, asnjë masë që barazohet me dënimin nuk mund të jepet ndaj një të pandehuri pa u provuar fajësia e tij përtej çdo dyshimi të arsyeshëm (*shih vendimet nr. 20, datë 03.04.2024; nr. 4, datë 21.02.2022; nr. 68, datë 14.11.2016 të Gjykatës Kushtetuese*). Duke mbajtur në konsideratë se garancitë kushtetuese të parimit të prezumimit të pafajësisë konkretizohen në rregullat e KPP-së, duke i krijuar në këtë mënyrë të gjitha mundësitë organit procedues për të përmbushur detyrën kushtetuese të respektimit të këtij parimi (*shih vendimin nr. 63, datë 20.11.2023 të Gjykatës Kushtetuese*), theksojmë se parimi i prezumimit të pafajësisë në thelb është garanci procedurale në procesin penal, që lidhet, ndër të tjera, me barrën e provës, prezumimet ligjore dhe të faktit, të drejtën e individit për të mos dëshmuar kundër vetes, si dhe shprehjet paragjykuese nga gjykata ose zyrtarë të tjerë publikë rreth fajësisë së tij.

7. Nën këtë optikë, ne, gjyqtarët në pakicë, *së pari,* evidentojmë se gjykatat e faktit kanë përcaktuar faktet dhe ligjin e zbatueshëm që e kanë çuar në vendimmarrjen e tyre. Në ndryshim nga sa pretendon kërkuesi, se për fajësinë e tij nuk ekzistonte asnjë provë, gjykatat e faktit kanë

arritur në përfundimin e fajësisë, duke shqyrtuar dhe vlerësuar një sërë provash, siç janë pyetja e rreth tetë dëshmitarëve, një pjesë e të cilëve kanë qenë të pranishëm në vendngjarje, akti i ekspertimit, rezultatet e përgjimit të kërkuesit me një shtetas të tretë. Lidhur me sekuestrimin e armës luftarake të dorëzuar nga viktima në organet e policisë dhe jo në vendngjarje, gjykatat kanë arsyetuar se ky fakt provohet jo vetëm nga dëshmitë e viktimës dhe të të pranishmëve në vendngjarje, por edhe nga procesverbali i Policisë Gjyqësore, sikundër kanë vënë në dukje se alibia e ngritur nga kërkuesi nuk mbështetej në prova, duke dhënë arsyet përse. Këto prova janë analizuar prej gjykatave, duke treguar përmbajtjen e tyre, pa i dhënë ndonjë prove fuqi provuese të paracaktuar dhe në harmoni me njëra-tjetrën, duke respektuar në këtë mënyrë rregullat për barrën e provës dhe prezumimet e faktit, për rrjedhojë edhe parimin e prezumimit të pafajësisë. Në këtë mënyrë, vlerësimi i shumicës se arma nuk është sekuestruar në vendngjarje, por është dorëzuar nga viktima dhe shtetas të tjerë, në thelb nuk është gjë tjetër veçse vlerësim i fuqisë provuese të provave, që nuk i nënshtrohet juridiksionit kushtetues.

8. *Së dyti*, evidentojmë se Gjykata e Lartë ka arsyetuar në mënyrë të mjaftueshme se vendimmarrja e gjykatave të faktit nuk është e cenueshme, për sa kohë që rekursi i paraqitur nga i gjykuari nuk përmban shkaqet e parashikuara nga neni 432, pika 1, i KPP-së dhe se gjykatat e shkallëve më të ulëta, në unison kanë disponuar për fajësinë e tij, ku gjykata e apelit ka bërë një analizë të hollësishme të dinamikës së fakteve dhe të provave të marra e të administruara në këtë gjykim. Po kështu, Gjykata e Lartë ka marrë në shqyrtim edhe pretendimin e kërkuesit për cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë, duke arsyetuar shprehimisht se gjykatat e faktit i kanë çmuar provat në tërësi, në përputhje me njëra-tjetrën, duke mos mbivlerësuar asnjërën prej tyre, ndaj nuk konstatohet që ato gjykata të mos kenë respektuar parimin e prezumimit të pafajësisë ose që ndaj kërkuesit të jetë zhvilluar një proces jo i rregullt ligjor, referuar nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së. Në këtë mënyrë, kërkuesi ka marrë përgjigje të arsyetuar, ndërsa Gjykata e Lartë ka ushtruar plotësisht dhe në mënyrë korrekte funksionin e saj si gjykatë e ligjit, sikundër edhe funksionin për kontrollin edhe të kushtetutshmërisë së procesit gjyqësor, bazuar në rolin e saj subsidiar.

9. Nga ana tjetër, ne, gjyqtarët në pakicë, vlerësojmë se nuk është detyrë e Gjykatës të analizojë provat dhe faktet ku janë bazuar gjykatat e juridiksionit të zakonshëm për zgjidhjen në themel të çështjes së kërkuesit,

pasi kjo mbetet detyrë funksionale e atyre gjykatave. Në aspektin e kontrollit kushtetues, Gjykata verifikon në drejtim të së drejtës së aksesit nëse gjykatat u kanë dhënë përgjigje të arsyetuar pretendimeve të parashtruara përpara tyre dhe nëse arsyetimi i vendimit gjyqësor i ka plotësuar ose jo kriteret kushtetuese, të cilat garantojnë të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, gjë që, në rastin konkret, rezulton të jetë përmbushur si nga gjykata e apelit, ashtu edhe nga Gjykata e Lartë. Në këtë drejtim, ritheksojmë se vlerësimi kushtetues i Gjykatës nuk mund të zëvendësojë prerogativat/rolin/funksionin e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, duke e kthyer atë në një shkallë të katër gjykimi.

10. Në përfundim, ne, gjyqtarët në pakicë, çmojmë se pretendimi i kërkuesit për cenimin e së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor në drejtim të prezumimit të pafajësisë, është i pabazuar, prandaj duhej të ishte vendosur rrëzimi i kërkesës.

Anëtarë: Marsida Xhaferllari, Genti Ibrahimi, Marjana Semini

Vendim nr. 28, datë 30.04.2025
(V-28/25)

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Holta Zaçaj, Kryetare, Marsida Xhaferllari, Fiona Papajorgji, Sonila Bejtja, Sandër Beci, Genti Ibrahimi, Marjana Semini, anëtarë, me sekretare Belma Lleshi, në datën 30.04.2025 mori në shqyrtim në seancë mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 13 (T) 2024, që u përket:

KËRKUES: **TUNXH VATNIKAJ**

SUBJEKT I INTERESUAR:
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR, përfaqësuar nga kryetari Ilir Rusi.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimeve nr. 243, datë 29.10.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor; nr. 42, datë 28.02.2020 të Gjykatës Administrative të Apelit nr. 00-2024-3030 (310), datë 11.07.2024 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

BAZA LIGJORE: **Nenet 42, 43, 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 6 dhe 7 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar *(ligji nr. 8577/2000)*.**

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Marjana Semini, mori në shqyrtim pretendimet e kërkuesit Tunxh Vatnikaj (*kërkuesi*), i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, parashtrimet e subjektit të interesuar, Këshillit të

Lartë Gjyqësor (*KLGJ*), që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I
Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi është emëruar gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër me dekretin e Presidentit të Republikës nr. 2526, datë 14.02.2000. Me kërkesën e tij, me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 627, datë 21.05.2008, kërkuesi është emëruar drejtor i përgjithshëm i Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (*AKKP*), bazuar në nenin 28 të ligjit nr. 9877, datë 18.02.2008 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë" (*ligji nr. 9877/2008*). Sipas kësaj dispozite, gjyqtarëve u lindte e drejta që me kërkesë të institucioneve dhe me pëlqimin e tyre, si dhe me vendim të Këshillit të Lartë të Drejtësisë (*KLD*) të shërbenin për një afat deri në tre vjet në pozicione të tjera dhe në përfundim të këtij afati të ktheheshin në vendin e mëparshëm të punës.

2. Me vendimin nr. 54, datë 21.01.2009 të Këshillit të Ministrave kërkuesi është shkarkuar nga detyra e drejtorit të AKKP-së për shkelje disiplinore. Po kështu, për kërkuesin është regjistruar procedimi penal nr. 4908 i vitit 2008 për veprën penale "Shpërdorimi i detyrës", të kryer në bashkëpunim, të parashikuar nga nenet 248 e 25 të Kodit Penal. Në përfundim të hetimeve paraprake, në datën 24.04.2009 prokuroria ka vendosur dërgimin në gjyq të çështjes penale në ngarkim të kërkuesit. Pas shqyrtimit gjyqësor të çështjes penale ndaj kërkuesit Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 718, datë 07.05.2012, ka vendosur deklarimin të pafajshëm të tij, vendim i cili është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr. 1280, datë 13.02.2013.

3. Pasi vendimi i pafajësisë së tij ka marrë formë të prerë, me kërkesën e datës 18.02.2013 kërkuesi i është drejtuar KLD-së për rikthimin në detyrën e gjyqtarit, kërkesë për të cilën ai nuk ka marrë përgjigje. Në këtë situatë, në datën 17.03.2015 ai i është drejtuar me kërkesëpadi Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, me objekt detyrimin e palës së paditur, KLD-së, që të marrë në shqyrtim kërkesën për rikthimin e tij në detyrën e gjyqtarit, si dhe detyrimin e atij organi për t`i paguar pagën e gjyqtarit nga data 21.02.2009 deri në fillimin e detyrës.

4. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 2839, datë 25.05.2015, ka vendosur, ndër të tjera, pranimin e pjesshëm të kërkesëpadisë, detyrimin e palës së paditur, KLD-së, që të marrë në shqyrtim kërkesën e kërkuesit të depozituar në datën 18.02.2013. Ky vendim është lënë në fuqi me vendimin nr. 121, datë 28.01.2016 të Gjykatës Administrative të Apelit, kurse Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 1057, datë 16.10.2018, ka vendosur mospranimin e rekursit të KLD-së.

5. Për shkak se vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit, si më sipër, nuk është ekzekutuar, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*GJEDNJ*) me aplikimin nr. 42612/19, datë 08.08.2019 për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor, sipas nenit 6, paragrafi 1, të KEDNJ-së, për shkak të mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë. Me vendimin e datës 04.07.2024, GJEDNJ-ja ka vendosur nxjerrjen e këtij aplikimi nga lista, në përputhje me nenin 37, pika, 1, shkronja "c", të KEDNJ-së, për shkak të zgjidhjes së çështjes me marrëveshje, pasi shteti shqiptar ka pranuar t`i paguajë kërkuesit dëmshpërblim për shkak të mosekzekutimit të vendimit gjyqësor brenda një afati të arsyeshëm.

6. Në vijim, kërkuesi i është drejtuar me kërkesë KLGJ-së, organi që sipas nenit 147/a të Kushtetutës, pas ndryshimeve të vitit 2016, ka kompetencën për të vendosur për emërimin, vlerësimin, transferimin, masat disiplinore të gjyqtarëve të të gjitha niveleve etj. Me vendimin nr. 243, datë 29.10.2019 (*vendimi nr. 243/2019*), KLGJ-ja ka vendosur refuzimin e kësaj kërkese. Sipas saj, kërkuesi nuk ka paraqitur kërkesë për t'u rikthyer në funksionin e tij në përfundim të afatit 3-vjeçar të komandimit, ndaj KLD-ja nuk mund të vijonte ruajtjen e vendit të punës si gjyqtar, pasi kërkuesi nuk ka kërkuar rikthimin me veprime konkludente; nuk i është nënshtruar rivlerësimit kalimtar e nuk ka plotësuar dhe dorëzuar formularët përkatës për këtë qëllim; nuk ka paraqitur kërkesë për pavlefshmëri të akteve të procedimit penal dhe nuk ka qenë i pezulluar nga detyra e gjyqtarit; nuk ka kundërshtuar aktin e shkarkimit nga detyra të drejtorit të AKKP-së; masa disiplinore e shkarkimit nga detyra përbën kriter ndalues për rekrutimin e gjyqtarit, si dhe është shkak për mbarimin e statusit të magjistratit.

7. Duke mos qenë dakord me këtë vendim, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Administrative të Apelit, bazuar në parashikimet e ligjit nr. 115/2016, datë 03.11.2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë" (*ligji nr. 115/2016*), me kërkesëpadi me objekt shfuqizimin e aktit administrativ, vendimit të KLGJ-së, detyrimin e kësaj të fundit ta

kthejë në funksionin e gjyqtarit, si dhe rregullimin e pasojave për pagesën e pagës nga data 21.02.2009 deri në rikthimin e tij në funksionin e gjyqtarit.

8. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 42, datë 28.02.2020, ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë me arsyetimin se mosparaqitja në kohë e kërkesës për rikthimin në detyrë është ekuivalente me dorëheqjen. Po kështu, sipas asaj gjykate, për sa kohë nuk është provuar dhënia e autorizimit nga KLD-ja për fillimin e procedimit penal, kërkuesi nuk ka qenë i pezulluar nga funksioni i tij, prandaj, pavarësisht se me vendim të formës së prerë është deklaruar i pafajshëm, nuk kishte më të drejtë të kthehej në detyrën e mëparshme. Kundër këtij vendimi kërkuesi ka paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë. Gjatë kohës që rekursi ishte ende në shqyrtim kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me kërkesë për konstatimin e cenimit të së drejtës për proces të rregullt ligjor si pasojë e mosekzekutimit brenda një afati të arsyeshëm të vendimit gjyqësor të formës së prerë që kishte vendosur detyrimin e palës së paditur, KLD-së, që të merrte në shqyrtim kërkesën e kërkuesit. Në datën 12.02.2021, pasi kërkesa kishte kaluar për shqyrtim në seancë plenare, kërkuesi ka paraqitur kërkesë për heqjen dorë nga gjykimi i atij ankimi kushtetues. Për rrjedhojë, bazuar në nenin 31/b të ligjit nr. 8577/2000, me vendimin nr. 5, datë 16.02.2021, Gjykata ka vendosur pushimin e gjykimit të çështjes.

9. Për sa i përket shqyrtimit të rekursit, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-3030 (310), datë 11.07.2024, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 42, datë 28.02.2020 të Gjykatës Administrative të Apelit, me arsyetimin se ai vendim është i drejtë, ndërsa vendimi i KLGJ-së, me të cilin është refuzuar kërkesa e kërkuesit për kthimin e tij në funksionin e gjyqtarit, është një akt administrativ i mbështetur në prova dhe në ligj.

10. Në datën 09.10.2024 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij, i cili, pasi është plotësuar sipas kërkesave të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 16.10.2024. Me vendimin e datës 26.12.2024, Kolegji i Gjykatës ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

11. Pas kalimit të çështjes për shqyrtim në seancë plenare, në datën 01.04.2025, një gjyqtar i Gjykatës ka paraqitur kërkesë për heqjen dorë nga shqyrtimi i çështjes, e cila është pranuar nga Mbledhja e Gjyqtarëve me vendimin nr. 7, datë 03.04.2025. Në datën 02.04.2025 kërkuesi ka paraqitur kërkesë për përjashtimin e të njëjtit gjyqtar nga shqyrtimi i çështjes së tij, për të cilën Mbledhja e Gjyqtarëve, me vendimin nr. 8,

datë 03.04.2025, ka vendosur pushimin e shqyrtimit të saj, pasi kërkesa ka mbetur pa objekt.

II
Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

12. ***Kërkuesi,*** në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se vendimet objekt kundërshtimi i kanë cenuar:

12.1. *Të drejtën për proces të rregullt ligjor*, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të:

12.1.1. *Së drejtës së aksesit efektiv*, pasi gjatë procesit administrativ, as kërkuesi, as përfaqësuesi i tij nuk kanë pasur mundësi të paraqesin argumentet e tyre, ndërsa gjykatat nuk e kanë thirrur asnjëherë për të parashtruar pretendimet e tij. Po kështu, Gjykata e Lartë e ka shqyrtuar rekursin në dhomën e këshillimit, ndonëse çështja e kërkuesit është gjykuar në shkallë të parë në Gjykatën Administrative të Apelit, e cila ka pasur juridiksion fillestar.

12.1.2. *Standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor*, pasi megjithëse Gjykata e Lartë ka pasqyruar faktin se kërkuesi është shpallur i pafajshëm me vendim të formës së prerë, sërish ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së apelit, duke mos e rikthyer në detyrë atë. Pavarësisht se kërkesa për të përfituar të drejtat që njeh statusi i gjyqtarit është paraqitur nga kërkuesi menjëherë pas marrjes së vendimit të pafajësisë, KLD-ja nuk e ka marrë asnjëherë në shqyrtim atë. Gjykatat kanë arritur në përfundimin se statusi i gjyqtarit ka mbaruar "në heshtje", ndonëse ky term nuk gjendet në ligj dhe vendimet e tyre janë kontradiktore në lidhje me faktet dhe provat. Argumenti se nuk janë paraqitur dokumentet për t'iu nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar nuk qëndron, pasi kërkuesi nuk ishte pjesë e listës së gjyqtarëve. Gjithashtu, Gjykata e Lartë nuk ka pasqyruar në vendimin e saj vendimin e GJEDNJ-së për çështjen e kërkuesit.

12.2. *Të drejtën për të fituar mjetet e jetesës me punë të ligjshme*, të garantuar nga neni 49 i Kushtetutës, pasi për shkak të vendimeve gjyqësore të cilat kanë lejuar shkelje të procesit të rregullt, kërkuesit i kanë ardhur pasoja për ushtrimin e profesionit të tij.

Gjatë gjithë periudhës pas shkarkimit kërkuesi nuk ka ushtruar asnjë funksion tjetër, duke respektuar statusin e gjyqtarit.

13. ***Subjekti i interesuar, KLGJ-ja,*** ka prapësuar si vijon:

13.1. Pretendimi për cenimin e *së drejtës së aksesit efektiv* është i pabazuar, pasi për sa i përket procesit administrativ të zhvilluar nga KLGJ-ja, referuar dispozitave ligjore administrative, e drejta e palës për t'u dëgjuar ushtrohet në çdo formë të përshtatshme, përfshirë rastin kur pala ka paraqitur paraprakisht mendimet, komentet dhe shpjegimet në formë shkresore. Në procedurat administrative nuk kërkohet detyrimisht zhvillimi i një seance dëgjimore. Edhe Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vepruar brenda kompetencave të tij ligjore për sa i përket shqyrtimit të rekursit mbi bazë të dokumenteve në dhomën e këshillimit, sipas nenit 61, pika 1, të ligjit nr. 49/2012, datë 03.05.2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", të ndryshuar (*ligji nr. 49/2012*). Ky kolegj ka krijuar bindjen se shkaqet e ngritura në rekurs nuk gjejnë mbështetje në aktet e administruara në dosjen gjyqësore, për rrjedhojë është në kompetencën e tij të vendosë mospranimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore.

13.2. Edhe pretendimi për cenimin e *standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor* është i pabazuar. *Së pari,* për sa i përket pretendimit se Gjykata e Lartë nuk ka pasqyruar në vendim procesin e zhvilluar në GJEDNJ, rezulton se kërkuesi ka pretenduar atje mosekzekutimin e një vendimi gjyqësor për shkak të procedurave të gjata dhe mungesën e një mjeti efektiv. Pra, objekti i vendimit të GJEDNJ-së nuk është shfuqizimi i vendimit nr. 243/2019 të KLGJ-së, i lënë në fuqi nga gjykata e apelit. *Së dyti*, Gjykata e Lartë u ka kthyer përgjigje shteruese pretendimeve të parashtruara në rekurs dhe vendimi i saj është i qartë, logjik dhe nuk ka kundërthënie. Madje në rastin konkret nuk është ndryshuar vendimmarrja, por është lënë në fuqi vendimi i gjykatës së apelit.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkuesit

14. Çështja e legjitimimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore

që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

15. Në këtë këndvështrim, Gjykata çmon se kërkuesi, si individ, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të shkronjës "f" të pikës 1 të nenit 131 dhe shkronjës "i" të pikës 1 të nenit 134 të Kushtetutës, pasi është palë në çështjen objekt të ankimit kushtetues individual, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

16. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se sipas nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës, ajo vendos për gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese, që individi pretendon se i janë cenuar nga akti i pushtetit publik. Kriteri për shterimin e mjeteve juridike efektive kërkon që, përpara se t'i drejtohet Gjykatës, kërkuesi duhet të vërtetojë se ka përdorur në formë dhe substancë të gjitha mjetet ligjore të njohura nga ligji dhe të mjaftueshme për të rivendosur të drejtat e shkelura *(shih vendimet nr. 18, datë 19.03.2024; nr. 38, datë 12.07.2023 të Gjykatës Kushtetuese)*.

17. Gjykata vëren se në ankimin kushtetues individual kërkuesi ka pretenduar, ndër të tjera, cenimin e së drejtës së aksesit efektiv si element i së drejtës për proces të rregullt, të parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës, si për sa i përket procesit administrativ të zhvilluar në KLGJ, ashtu edhe procesit gjyqësor në gjykatën e apelit dhe Gjykatën e Lartë. Për sa u përket pretendimeve për cenimin e së drejtës së aksesit në procesin administrativ dhe procesin gjyqësor në gjykatën e apelit, Gjykata, bazuar në aktet bashkëlidhur kërkesës, konstaton se këto pretendime nuk janë ngritur më parë nga kërkuesi, në formë dhe përmbajtje, as në kërkesëpadinë me të cilën ka vënë në lëvizje procesin gjyqësor të kundërshtuar, as në rekursin drejtuar Gjykatës së Lartë, por janë parashtruar për herë të parë në ankimin

kushtetues individual. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se për këto pretendime kërkuesi nuk ka shteruar mjetet juridike në dispozicion, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës. Për sa u përket pretendimeve të tjera, kërkuesi i ka ngritur ato më parë në formë dhe substancë përpara gjykatave të zakonshme, ndaj ai nuk ka mjete të tjera juridike në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të tij kushtetuese përveç ankimit kushtetues individual.

18. Gjykata vlerëson se kërkuesi legjitimohet edhe *ratione temporis*, në kuptim të përmbajtjes së nenit 71/a, pika 1, shkronja "b", të ligjit nr. 8577/2000, pasi vendimi më i fundit në kohë i kundërshtuar, ai i Gjykatës së Lartë, mban datën 11.07.2024, ndërsa kërkesa është paraqitur në këtë Gjykatë në datën 09.10.2024, pra brenda afatit 4-mujor.

19. Në lidhje me legjitimimin *ratione materiae,* Gjykata vëren se kërkuesi ka pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të *së drejtës së aksesit efektiv* në procesin gjyqësor në Gjykatën e Lartë dhe *standardit të arsyetimit të vendimit*, si dhe cenimin e *së drejtës për të fituar mjetet e jetesës me punë të ligjshme*, të parashikuara në nenet 42 dhe 49 të Kushtetutës. Për sa i përket së drejtës së aksesit efektiv, kërkuesi ka pretenduar se Gjykata e Lartë e ka shqyrtuar rekursin e tij në dhomën e këshillimit, ndonëse kjo çështje është gjykuar nga Gjykata Administrative e Apelit si gjykatë e shkallës së parë, e cila ka pasur juridiksion fillestar për këto lloj çështjesh. Gjykata, bazuar në natyrën dhe thelbin e këtij pretendimi, vlerëson ta analizojë atë në drejtim të së drejtës për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur.

20. Gjykata ka theksuar se e drejta për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur, në kontekstin kushtetues të procesit të rregullt, nuk nënkupton vetëm atë për t`u dëgjuar personalisht përpara gjykatës, por ajo realizohet edhe përmes shqyrtimit të dokumenteve, pra mbi komentet dhe shpjegimet e dhëna me shkrim nga palët ndërgjyqëse *(shih vendimet nr. 43, datë 27.12.2022; nr. 41, datë 22.12.2022; nr. 38, datë 02.12.2021 të Gjykatës Kushtetuese)*. Nga ana tjetër, Gjykata ka pohuar se procesi gjyqësor konsiderohet i rregullt, për sa kohë që në një shkallë gjykimi është zhvilluar në seancë gjyqësore publike, gjatë së cilës kërkuesit i është dhënë mundësia për t'u dëgjuar dhe mbrojtur *(shih vendimet nr. 27 datë 18.05.2023; nr. 28, datë 01.11.2022 të Gjykatës Kushtetuese)*.

21. Gjykata vëren se referuar nenit 100 të ligjit nr. 115/2016, kërkuesi ka ankimuar aktin administrativ individual, vendimin nr. 243/2019 të KLGJ-së, në Gjykatën Administrative të Apelit. Në përfundim të atij gjykimi

kërkuesi ka vënë në lëvizje Gjykatën e Lartë me rekurs dhe çështja e tij është shqyrtuar nga ajo gjykatë në dhomën e këshillimit. Për sa i përket rregullave të shqyrtimit të rekursit, neni 61, pika 1, i ligjit nr. 49/2012 ka parashikuar se shqyrtimi i tij në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë, si rregull, bëhet mbi bazë të dokumenteve në dhomën e këshillimit dhe sipas nenit 62 të këtij ligji vetëm në raste të veçanta të parashikuara nga ligji, Gjykata e Lartë vendos kalimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve.

22. Për sa më sipër, Gjykata vëren se gjykata e apelit dhe Gjykata e Lartë janë vënë në lëvizje nga kërkuesi përmes mjeteve të ankimit dhe rekursit, në përmbajtje të të cilave ai ka parashtruar të gjitha shkaqet kundër vendimit të KLGJ-së dhe vendimit të gjykatës së apelit. Kërkuesi është njoftuar rregullisht për gjykimin në gjykatën e apelit, ku ka qenë i pranishëm në seancat gjyqësore të zhvilluara, proces që është zhvilluar me praninë e palëve dhe ku kërkuesit i është garantuar e drejta të parashtrojë pretendimet e tij dhe të kundërshtojë ato të palës tjetër në proces. Për sa i përket gjykimit në Gjykatën e Lartë kërkuesi ka pasur të gjitha mundësitë të parashtrojë pretendimet e tij për vendimet e kundërshtuara dhe ajo gjykatë ka vepruar në përputhje me parashikimet procedurale që rregullojnë atë lloj gjykimi. Në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë rezultojnë të pasqyruara të dhëna të plota për njoftimet për datën e seancës së planifikuar nga ajo gjykatë për shqyrtimin e rekursit.

23. Në analizë të sa më sipër, Gjykata vlerëson se kërkuesi nuk ka arritur të argumentojë në këndvështrimin kushtetues pasojat në të drejtën për t`u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur për shkak të mënyrës sesi është zhvilluar procesi gjyqësor i kundërshtuar, ndaj vetëm fakti që gjykimi në Gjykatën e Lartë është zhvilluar në dhomën e këshillimit nuk e bën procesin të parregullt nga pikëpamja kushtetuese dhe nuk vë në dyshim të drejtën për proces të rregullt, për më tepër në situatën që ajo gjykatë është vënë në lëvizje me rekursin e paraqitur nga kërkuesi, të cilin e ka marrë në shqyrtim, duke u dhënë përgjigje pretendimeve të tij. Për rrjedhojë, pretendimi i kërkuesit për cenimin e së drejtës për t'u dëgjuar dhe për t`u mbrojtur është haptazi i pabazuar.

24. Për sa i përket pretendimit për cenimin e së *drejtës për të fituar mjetet e jetesës me punë të ligjshme,* kërkuesi ka parashtruar se mënyra si gjykatat kanë vlerësuar dhe interpretuar ligjin për situatën e tij faktike ka sjellë pasoja në lidhje me ushtrimin e profesionit të tij dhe ai është detyruar të mos ushtrojë asnjë funksion tjetër, duke respektuar statusin e gjyqtarit.

25. Sipas nenit 49, pika 1, të Kushtetutës, secili ka të drejtë të fitojë mjetet e jetesës së tij me punë të ligjshme, që ka zgjedhur ose pranuar vetë dhe ai është i lirë të zgjedhë profesionin, vendin e punës, si dhe sistemin e kualifikimit të vet profesional. Në këtë drejtim, Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se kjo e drejtë përfshin zgjedhjen e profesionit, vendit të punës, si dhe sistemit të kualifikimit profesional, me qëllim sigurimin e mjeteve të jetesës në mënyrë të ligjshme. Zgjedhja e profesionit, siç parashikohet nga dispozita kushtetuese, është një e drejtë e individit, në kuptimin që ai i përkushtohet një veprimtarie për të siguruar mjetet e jetesës. Kjo e drejtë për të përfituar me punë të ligjshme fiton rëndësi edhe nga pikëpamja sociale, pasi puna si profesion është një vlerë edhe për kontributin që i sjell shoqërisë në tërësi *(shih vendimet nr. 1 datë 25.01.2024; nr. 17, datë 23.03.2023; nr. 9, datë 23.03.2010 të Gjykatës Kushtetuese)*.

26. Në referim të këtij standardi, Gjykata çmon se kërkuesi nuk ka argumentuar se në çfarë mënyre refuzimi i KLGJ-së për ta rikthyer atë në detyrën e gjyqtarit përfshihet në fushën e veprimit të kësaj të drejte kushtetuese. Për rrjedhojë, për sa kohë që kërkuesi nuk ka arritur ta argumentojë këtë pretendim në aspektin kushtetues, ai nuk mund të merret në shqyrtim.

27. Kërkuesi ka pretenduar edhe cenimin e *standardit të arsyetimit të vendimit* mbi argumentet se Gjykata e Lartë ka interpretuar në mënyrë kontradiktore faktet e provat dhe nuk ka marrë parasysh vendimin e pafajësisë së tij, duke bërë një interpretim të gabuar të kuadrit ligjor për zgjidhjen e mosmarrëveshjes. Gjykata, në kuptim të ndarjes së juridiksionit të gjykatave të zakonshme nga ai kushtetues, ka theksuar se vendimet e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm nuk vihen në dyshim prej saj, përveç rasteve kur gjetjet e tyre mund të konsiderohen si arbitrare ose haptazi të paarsyeshme. Në këtë kuptim, kjo Gjykatë vepron në rastin kur gabimi ligjor ose faktik nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është aq i dukshëm, sa një gjykatë e arsyeshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose i tillë që gjykimin e bën të padrejtë (*shih vendimin nr. 30, datë 29.05.2023 të Gjykatës Kushtetuese*). Për rrjedhojë, edhe në rastin konkret, Gjykata do t`i analizojë në themel këto pretendime të kërkuesit në kuptim të së drejtës për gjykim të drejtë, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e së drejtës për gjykim të drejtë

28. Kërkuesi ka pretenduar se megjithëse Gjykata e Lartë ka pasqyruar

faktin se ai është shpallur i pafajshëm me vendim të formës së prerë, sërish ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së apelit, duke mos e rikthyer në detyrë. Sipas tij, pavarësisht se kërkesa për të përfituar të drejtat që njeh statusi i gjyqtarit është paraqitur nga kërkuesi menjëherë pas marrjes së vendimit të pafajësisë, KLD-ja nuk e ka marrë asnjëherë në shqyrtim atë. Po kështu, kërkuesi ka pretenduar se gjykatat kanë arritur në përfundimin se statusi i gjyqtarit ka mbaruar "në heshtje", ndonëse ky term nuk gjendet në ligj dhe vendimet e tyre janë kontradiktore në lidhje me faktet dhe provat. Edhe argumenti se nuk janë paraqitur dokumentet për t'iu nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar nuk qëndron, pasi kërkuesi nuk ishte pjesë e listës së gjyqtarëve. Gjithashtu, sipas tij, Gjykata e Lartë nuk ka pasqyruar në vendimin e saj vendimin e GJEDNJ-së dhe nuk ka respektuar vendimet e Gjykatës, të cilat kanë fuqi detyruese.

29. Subjekti i interesuar, KLGJ-ja, ka prapësuar se pretendimi për cenimin e standardit të arsyetimit është i pabazuar. Sipas këtij subjekti, për sa i përket argumentit se Gjykata e Lartë nuk ka pasqyruar në vendimin e saj procesin e zhvilluar nga kërkuesi në GJEDNJ, rezulton se ai ka të bëjë me mosekzekutimin e një vendimi gjyqësor për shkak të procedurave të gjata dhe mungesën e një mjeti efektiv. Pra, objekti i vendimit të GJEDNJ-së nuk është shfuqizimi i aktit administrativ nr. 243/2019 të KLGJ-së i lënë në fuqi nga gjykata e apelit. Po kështu, sipas subjektit të interesuar, Gjykata e Lartë u ka kthyer përgjigje shteruese pretendimeve të kërkuesit të parashtruara në rekurs dhe vendimi i kundërshtuar është i qartë, logjik dhe nuk ka kundërthënie. Për më tepër në rastin konkret nuk është ndryshuar vendimmarrja, por është lënë në fuqi vendimi i gjykatës së apelit.

30. Neni 42, pika 2, i Kushtetutës, ndër të tjera, parashikon se kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë. Gjykata në jurisprudencën e saj ka pohuar se detyra e saj është të vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës (*shih vendimet nr. 67, datë 06.12.2023; nr. 59, datë 14.11.2023; nr. 30, datë 29.05.2023 të Gjykatës Kushtetuese)*.

31. Për sa më lart, Gjykata vëren se thelbi i çështjes në shqyrtim është mënyra sesi gjykatat e zakonshme kanë zbatuar kuadrin ligjor në fuqi që rregullon rastet e kthimit në funksionin e gjyqtarit, ndaj ajo do të verifikojë nëse gjykatat kanë zbatuar standardin e mësipërm dhe nëse interpretimi i

ligjit të zbatueshëm për zgjidhjen e mosmarrëveshjes konkrete është apo jo haptazi i paarsyeshëm, në kuptimin që të ketë sjellë një përfundim arbitrar për kërkuesin në drejtim të garantimit të të drejtave që ai ka kërkuar të mbrojë përmes procesit gjyqësor të kundërshtuar.

32. Gjykata vëren se kërkuesi, gjatë kohës që ushtronte funksionin e gjyqtarit të zakonshëm, është lejuar me vendim të KLD-së të ushtrojë detyrën e drejtorit të përgjithshëm të AKKP-së për një periudhë 3-vjeçare. Gjatë kësaj periudhe kërkuesi është akuzuar dhe është gjykuar për kryerjen e veprës penale "Shpërdorimi i detyrës". Pas përfundimit të procesit penal dhe deklarimit të tij të pafajshëm me vendim të formës së prerë të gjykatës së apelit, kërkuesi ka kërkuar nga KLD-ja rikthimin në detyrë. Për shkak se nuk ka marrë përgjigje nga ai organ, kërkuesi ka vënë në lëvizje një proces gjyqësor, përmes të cilit gjykatat kanë detyruar KLD-në që të shqyrtojë kërkesën e tij. Megjithatë edhe ky vendim ka mbetur i paekzekutuar dhe kërkesa e kërkuesit nuk është shqyrtuar asnjëherë nga KLD-ja (organi kompetent në atë kohë). Pas reformës kushtetuese të vitit 2016, e cila solli edhe ristrukturimin e disa organeve të sistemit të drejtësisë, kërkuesi i është drejtuar KLGJ-së me kërkesë për rikthimin në funksionin e gjyqtarit, kërkesë e cila është refuzuar. Ky vendim është kundërshtuar në Gjykatën Administrative të Apelit, në përputhje me kompetencën e saj, e cila ka rrëzuar padinë me arsyetimin se kërkesa për rikthimin në funksionin e gjyqtarit nuk është paraqitur brenda afatit 3-vjeçar sipas ligjit nr. 9877/2008 dhe se heshtja e kërkuesit përgjatë kësaj periudhe përbën, në thelb, heqje dorë nga e drejta. Sipas asaj gjykate, mosparaqitja në kohë e kërkesës për rikthim në detyrë është ekuivalente me dorëheqjen sipas pikës "a" të nenit 20 të ligjit nr. 9877/2008. Gjykata e apelit ka vlerësuar se për sa kohë nuk është provuar dhënia e autorizimit nga KLD-ja për fillimin e procedimit penal, kërkuesi nuk ka qenë i pezulluar nga funksioni i tij, prandaj, pavarësisht se me vendim të formës së prerë është deklaruar i pafajshëm, nuk kishte më të drejtë të kthehej në detyrën e tij të mëparshme (*shih faqet 27-29 të vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit*).

33. Vendimi i gjykatës së apelit është lënë në fuqi nga Gjykata e Lartë, me arsyetimin se kërkuesi ka humbur statusin e gjyqtarit, për shkak se ai nuk ka paraqitur kërkesë për rikthim as kur u shkarkua nga Këshilli i Ministrave si drejtor i AKKP-së, as në përfundim të afatit 3-vjeçar të komandimit, i cili ka përfunduar në vitin 2011. Sipas Gjykatës së Lartë, kërkuesi nuk ka paraqitur as kërkesë për t'iu nënshtruar vullnetarisht procesit të rivlerësimit kalimtar sipas ligjit nr. 84/2016, datë 30.08.2016

"Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" (*ligji nr. 84/2016*), ndonëse mendonte se ishte në kushtet kur ai duhej të rikthehej në detyrë. Për më tepër, sipas asaj gjykate, masa disiplinore e shkarkimit nga detyra si drejtor i AKKP-së përbënte, sipas nenit 28, shkronja "dh", të ligjit nr. 96/2016, ndalim për KLGJ-në që të rikthente kërkuesin në detyrën e gjyqtarit (*shih paragrafët 20,21 dhe23 të vendimit të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë*).

34. Gjykata, bazuar në arsyetimin e gjykatave të zakonshme vëren se argumentet e tyre kryesore për rrëzimin e padisë kanë qenë: i) kërkuesi nuk ka paraqitur kërkesë në përfundim të afatit 3-vjeçar dhe nuk ka qenë i pezulluar nga funksioni i gjyqtarit, për rrjedhojë statusi i gjyqtarit ka mbaruar në heshtje; ii) ndaj tij ka një masë disiplinore të shkarkimit nga detyra; iii) ai nuk i është nënshtruar rivlerësimit kalimtar. Për rrjedhojë, ajo do të verifikojë mënyrën sesi ato gjykata kanë zbatuar dhe interpretuar ligjin e zbatueshëm për secilin shkak.

35. *Së pari,* për sa i përket argumentit se statusi i gjyqtarit ka mbaruar në heshtje, pasi kërkuesi nuk ka paraqitur kërkesë për rikthimin në detyrën e gjyqtarit në përfundim të afatit 3-vjeçar sipas nenit 28 të ligjit nr. 9877/2008, në fuqi në kohën e përfundimit të periudhës së komandimit, Gjykata vëren se kjo dispozitë parashikonte të drejtën e gjyqtarëve që me kërkesë të institucioneve e me pëlqimin e tyre dhe me vendim të KLD-së të shërbenin për një afat deri në tre vjet në strukturat e Ministrisë së Drejtësisë, si dhe në institucione të tjera, dhe në përfundim të këtij afati të ktheheshin në vendin e mëparshëm të punës. Po kështu, neni 4, pika 6, i ligjit nr. 8678, datë 14.05.2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë", sipas parashikimeve në fuqi në atë kohë, parashikonte se gjyqtarët/prokurorët që shërbenin në nivelet drejtuese a ekzekutive të strukturave juridiko-profesionale të Ministrisë së Drejtësisë, me kërkesë të tyre, riemëroheshin gjyqtarë/prokurorë pa konkurs. Referuar nenit 20, pika 1, shkronja "c", të ligjit nr. 9877/2008, në fuqi në kohën kur kërkuesi ka paraqitur kërkesën në KLD për rikthimin në detyrë, gjyqtari nuk mund të lëvizej nga detyra përveç rasteve kur dënohej me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi. Në rastin kur ndaj një gjyqtari jepej autorizimi për fillimin e procedimit penal, ai pezullohej nga detyra derisa të merrej vendim gjyqësor i formës së prerë dhe në rastet kur fajësia nuk provohej me vendim të formës së prerë, gjyqtari kishte të drejtën të kthehej në punën e tij të mëparshme dhe të përfitonte pagën e plotë që nga koha e pezullimit (neni 29). Kurse sipas pikës 2 të nenit 32 të

po këtij ligji, shkelje shumë të rënda konsideroheshin aktet dhe sjelljet që diskreditonin rëndë pozitën dhe figurën e gjyqtarit që lidheshin me shkaqe që kryheshin gjatë ushtrimit të funksionit gjyqësor.

36. Bazuar në aktet e çështjes në shqyrtim, Gjykata konstaton se kërkuesi është emëruar drejtor i AKKP-së në datën 21.05.2008, ndërsa në datën 21.01.2009 ai është shkarkuar nga kjo detyrë dhe ndaj tij ka nisur procedimi penal. Në datën 13.02.2013 është dhënë vendimi i formës së prerë i pafajësisë së tij. Ndërsa në datën 18.02.2013 është paraqitur kërkesa në KLD për rikthim në detyrë, e cila nuk u shqyrtua asnjëherë nga ky organ. Vetëm pas ankimit të kërkuesit në GJEDNJ, kërkesa e tij u mor në shqyrtim nga KLGJ-ja, e cila me vendimin e datës 29.10.2019 vendosi refuzimin e saj, duke e konsideruar se është paraqitur tej afatit 3-vjeçar të komandimit. Sipas KLGJ-së, ky afat ka filluar në datën e emërimit të tij si drejtor i përgjithshëm i AKKP-së (datë 21.05.2008) dhe ka përfunduar në datën 21.05.2011.

37. Gjykata vëren se ky qëndrim i KLGJ-së është gjetur i drejtë nga gjykata e apelit dhe Gjykata e Lartë, por asnjë nga këto gjykata nuk kanë analizuar në aspektin e përmbajtjes së ligjit material të zbatueshëm (ligji i kohës), në kuptim të parashikimeve të nenit 29 të ligjit nr. 9877/2008 dhe të pretendimeve të kërkuesit në këtë drejtim, nëse paraqitja e një kërkese të tillë, në kushtet kur kërkuesi gjatë periudhës së komandimit është marrë në cilësinë e të pandehurit dhe në vijim është gjykuar për kryerjen e veprave penale, do të kishte perspektivë suksesi dhe do të rezultonte një mjet efektiv që do të mundësonte kthimin e tij në detyrë brenda kohës së komandimit. Edhe për sa i përket argumentit të përdorur në vendimet objekt kundërshtimi se ndaj kërkuesit nuk është vendosur masa e pezullimit nga detyra e gjyqtarit, Gjykata çmon se gjykatat nuk kanë arsyetuar sesi neni 29 i ligjit nr. 9877/2008, që përcakton pezullimin nga detyra të gjyqtarit në rastin e ndjekjes penale ndaj tij, përbënte ose jo pengesë për kërkuesin (i cili ishte në ndjekje penale), për të paraqitur kërkesë për rikthimin në detyrë, ndërkohë kur KLD-ja as nuk e kishte pezulluar atë nga pikëpamja formale juridike me një vendim, as nuk e rikthente në detyrë, situata këto që duket se përjashtojnë njëra-tjetrën.

38. Nga ana tjetër, edhe pse kanë vlerësuar se statusi i gjyqtarit ka mbaruar në heshtje për kërkuesin, gjykatat e zakonshme nuk kanë analizuar faktet që kanë rezultuar gjatë gjykimit, të cilat janë përcaktuese të sjelljes së kërkuesit në drejtim të shprehjes së vullnetit për vijimin ose përfundimin e statusit të tij si gjyqtar dhe pasojat që vijnë nga veprimet e tij. Ndërkohë që rezulton se

kërkuesi ka paraqitur kërkesë për kthim në detyrë përpara KLD-së vetëm 5 ditë pas vendimit të formës së prerë të gjykatës së apelit që e ka deklaruar atë të pafajshëm për veprën penale për të cilën akuzohej, bazuar në interpretimin që ai i ka bërë përmbajtjes së nenit 29 të ligjit nr. 9877/2008 në rastin e tij. Gjykata evidenton se gjykatat nuk kanë analizuar dhe as pasqyruar se kërkuesi në mënyrë të vazhdueshme ka shfaqur interes, në përputhje me interpretimin që ai u ka bërë dispozitave ligjore të zbatueshme dhe se ai ka përdorur çdo mjet që në dukje mund të rezultonte i suksesshëm për mbrojtjen e të drejtave të tij, siç ishte edhe kërkesa në GJEDNJ për konstatimin e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë që kishte vendosur detyrimin e KLD-së për t`u shprehur për kërkesën e tij për kthimin në funksionin e gjyqtarit. Ndonëse ky vendim nuk shprehet për themelin e çështjes së kërkuesit dhe ai ka marrë shpërblim të drejtë për shkeljen e konstatuar, një fakt i tillë nuk mund të shmangej nga Gjykata e Lartë, për sa kohë ai është tregues i sjelljes së kërkuesit në drejtim të kërkimit kryesor të padisë së tij, që është kthimi në funksionin e gjyqtarit dhe provon faktin se kërkuesi nuk ka pranuar në heshtje mbarimin e statusit të gjyqtarit.

39. Nga ana tjetër, gjykatat e zakonshme nuk kanë analizuar dhe nuk janë shprehur për sjelljen e organeve kompetente, konkretisht të KLD-së së kohës, e cila nuk e ka marrë në shqyrtim kërkesën e kërkuesit për një periudhë disavjeçare (kërkesa është paraqitur më 18.02.2013 dhe deri më 12.12.2018, kur ka pushuar funksionet ky institucion, nuk është shqyrtuar), ndonëse prej saj nuk ka pasur më parë një vendim për pezullimin e kërkuesit nga ushtrimi i funksionit të gjyqtarit. Gjykata evidenton faktin se edhe pse kërkuesi ka vënë në lëvizje procesin gjyqësor për detyrimin e KLD-së për të marrë në shqyrtim kërkesën e tij, padi që është pranuar, sërish KLD-ja nuk ka vepruar për të përmbushur detyrimin e saj për t`i dhënë përgjigje kërkuesit.

40. *Së dyti*, për argumentin se ndaj kërkuesit ka një masë disiplinore të shkarkimit nga detyra, Gjykata evidenton se neni 20 i ligjit nr. 9877/2008 parashikonte si shkak për mbarimin e statusit të gjyqtarit, ndër të tjera, shkarkimin nga detyra, ndërsa kjo masë, referuar nenit 32, pika 2, të këtij ligji, jepej për shkaqe që lidheshin drejtpërdrejt me ushtrimin e funksionit të gjyqtarit. Në këtë drejtim, Gjykata konstaton se masa e shkarkimit nga detyra është marrë gjatë ushtrimit të një funksioni administrativ, atij të drejtorit të AKKP-së, ndërsa gjykatat nuk kanë arsyetuar nëse një masë e tillë parashikohej edhe në ligjin e posaçëm, përkatësisht në nenin 32, pika 2, të ligjit nr. 9877/2008.

41. *Së treti*, për sa i përket argumentit të gjykatave se kërkuesi nuk i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar, Gjykata vëren se sipas nenit 179/b të Kushtetutës (i shtuar me ndryshimet kushtetuese të vitit 2016), procesit të rivlerësimit u nënshtrohen edhe të gjithë gjyqtarët të cilët kanë punuar në këto pozicione të paktën tre vjet. Sipas parashikimeve kushtetuese, nëse subjekti i rivlerësimit nuk e dorëzon deklaratën e pasurisë në kohë sipas ligjit (neni D, pika 5, i Kushtetutës) ose deklaratën për figurën në kohë (neni DH, pika 4, i Kushtetutës), ai shkarkohet nga detyra. Procesi i rivlerësimit është detajuar më tej në parashikimet e ligjit nr. 84/2016.

42. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se gjykatat e zakonshme, mbi vlerësimin se kërkuesi nuk gëzonte statusin e gjyqtarit pas periudhës së komandimit, kanë pohuar se ai nuk ka depozituar as formularin e deklarimit të pasurisë pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që është një shkak tjetër që sjell pamundësinë e tij për t'u rikthyer në detyrë. Kjo do të thotë se gjykatat nuk kanë analizuar dhe interpretuar në mënyrë të plotë mënyrën e zbatimit të dispozitave kushtetuese dhe ligjore për rivlerësimin kalimtar në atë kohë, pra në momentin e hyrjes në fuqi të tyre, përfshirë detyrimin e gjyqtarëve në detyrë ose të ish-gjyqtarëve për të dorëzuar formularët e vetëdeklarimit, në kushtet kur kërkuesi nuk kishte asnjë vendim të organit administrativ për statusin e tij, edhe pse ai vetë kishte kërkuar prej tyre të shpreheshin në këtë drejtim. Thënë ndryshe, gjykatat nuk kanë marrë në analizë efektet që do të kishte në rastin e kërkuesit një kërkesë drejtuar institucioneve të rivlerësimit paraprak sipas parashikimeve kushtetuese dhe ligjore që normonin procesin e rivlerësimit, në mungesë të vendimit të organit kompetent (KLD/KLGJ) në atë kohë në lidhje me (mos)pasjen e statusit të gjyqtarit dhe në situatën që vetë kërkuesi, bazuar në qasjen e tij, ka mbajtur një qëndrim të ndryshëm për interpretimin dhe zbatimin e dispozitave ligjore që rregullojnë statusin e gjyqtarit dhe vetë sistemin e rivlerësimit kalimtar. Për më tepër, sikurse rezulton nga rrethanat konkrete dhe faktet me natyrë kushtetuese të konstatuara gjatë këtij gjykimi, mosveprimi i kërkuesit edhe për paraqitjen e një kërkese të tillë është diktuar në radhë të parë nga mosveprimi i institucioneve kompetente për të përcaktuar statusin e tij.

43. Për sa më lart, Gjykata vë në dukje se Gjykata e Lartë nuk ka marrë në konsideratë të gjitha faktet dhe rrethanat e çështjes së kërkuesit, duke bërë një interpretim abstrakt të ligjit, i cili nuk pajtohet me gjykimin konkret, duke mos zgjidhur mosmarrëveshjen në fjalë. Në këtë kuptim, pjesa arsyetuese e vendimmarrjes së Gjykatës së Lartë rezulton të jetë

formaliste, duke e larguar qëllimin e procesit nga vetë thelbi i së drejtës kushtetuese të individit. Për rrjedhojë, interpretimit të ligjit nga Gjykata e Lartë, në rastin në fjalë, i mungon analiza nga pikëpamja e faktit dhe e së drejtës, duke e bërë atë haptazi të paarsyeshëm.

44. Në përfundim, Gjykata çmon se pretendimi i kërkuesit për cenimin e së drejtës për gjykim të drejtë është i bazuar, sipas arsyetimit të mësipërm të këtij vendimi, ndaj kërkesa pranohet pjesërisht.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, si dhe neneve 71 dhe 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, njëzëri,

V E N D O S I:

1. Pranimin pjesërisht të kërkesës.

2. Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2024-3030 (310), datë 11.07.2024 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën.

3. Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 30.04.2025
Shpallur më 17.06.2025

Vendim nr. 29, datë 30.04.2025
(V-29/25)

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Holta Zaçaj, Kryetare, Fiona Papajorgji, Sonila Bejtja, Sandër Beci, Ilir Toska, Genti Ibrahimi, Marjana Semini, Marsida Xhaferllari, anëtarë, me sekretare Belma Lleshi, në datën 30.04.2025 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve kërkesën nr. 10 (R) 2024 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: **RAFET DOKOLLARI**

SUBJEKTE TË INTERESUARA:
KËSHILLI I MINISTRAVE, përfaqësuar nga Herald Jonuzaj, drejtor i departamentit.
PËRMBARUESI GJYQËSOR PRIVAT RIGELS DIKELLARI

OBJEKTI: **Konstatimi i shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimi i procedurave të ekzekutimit të vendimit gjyqësor nr. 413, datë 08.06.2017, titull ekzekutiv.**
Detyrimi i Këshillit të Ministrave të shpërblejë dëmin financiar për vonesën e pagesës dhe fitimin e munguar.

BAZA LIGJORE: **Neni 42, pika 2, i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë *(Kushtetuta)*; nenet 6, pika 1 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).**

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Marsida Xhaferllari, mori në shqyrtim parashtrimet me shkrim të kërkuesit Rafet Dokollari *(kërkuesi)*, i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet e subjektit të interesuar, Këshillit të Ministrave, që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës dhe informacionin e përmbaruesit gjyqësor Rigels Dikellari për pushimin e ekzekutimit, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I
Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi ka pasur në pronësi një ndërtesë me sipërfaqe 140 m^2 dhe truall me sipërfaqe 1000 m^2, në fshatin Udenisht, Pogradec. Këshilli i Ministrave, me vendimin nr. 909 datë 22.12.2014 "Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private që preken nga realizimi i projektit "Rehabilitimi i bregut të Liqenit të Ohrit dhe gjelbërimi përgjatë rrugës Lin-Pogradec"" *(VKM nr. 909/2014)* ka vendosur, ndër të tjera, shpronësimin e kërkuesit për pronën në fjalë (truall dhe ndërtesë) kundrejt vlerës 18.489.423 lekë, duke përcaktuar se shpronësimi fillonte prej datës 24.12.2014.

2. Kërkuesi, duke mos qenë dakord me vlerën e shpronësimit, në datën 11.07.2016 ka paraqitur padi në gjykatë. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Korçë, me vendimin nr. 971(413), datë 08.06.2017, ka vendosur pranimin e padisë, ndryshimin e pjesshëm të VKM-së nr. 909/2014, për sa i përket vlerës së kompensimit për efekt shpronësimi për kërkuesin, duke detyruar Këshillin e Ministrave ta kompensojë atë për pasurinë e shpronësuar (truall dhe ndërtesë) në vlerën 58.640.000 lekë. Vendimi ka marrë formë të prerë në datën 08.08.2017, pa u ankimuar nga asnjë prej palëve.

3. Në fillim të vitit 2020 kërkuesi ka vënë në lëvizje procedurën e ekzekutimit të detyrueshëm të vendimit gjyqësor, duke iu drejtuar përmbaruesit gjyqësor privat. Ky i fundit në datën 10.02.2020 ka njoftuar subjektin e interesuar, Këshillin e Ministrave, për ekzekutimin vullnetar, ndërsa në datën 04.03.2020 ka vendosur sekuestron konservative për llogaritë e tij. Në datën 06.07.2020 Dega e Thesarit Tiranë ka njoftuar përmbaruesin gjyqësor se nuk mund ta ekzekutonte vendimin gjyqësor, pasi subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave, nuk dispononte fonde buxhetore

ose artikuj të posaçëm në sistemin informatik financiar të qeverisë dhe as kodin shtatëshifror për kryerjen e procedurave financiare në sistemin e thesarit. Në vijim, përmbaruesi gjyqësor i është drejtuar disa herë Këshillit të Ministrave dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit, duke kërkuar ekzekutimin e vendimit gjyqësor, por pa sukses. Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit i është përgjigjur se duhet të komunikonte drejtpërdrejt me Këshillin e Ministrave dhe se vendimi gjyqësor nuk përcaktonte qartë nëse institucioni debitor ishte njësi varësie e Këshillit të Ministrave ose vetë aparati i tij.

4. Në këto rrethana, në datën 16.03.2022, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë, me kërkesë për konstatimin e cenimit të afatit të arsyeshëm të ekzekutimit të vendimit gjyqësor, bazuar në nenet 399/2 dhe 399/5 të Kodit të Procedurës Civile (*KPC*). Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Korçë, me vendimin nr. 900(770), datë 13.04.2022, ka vendosur rrëzimin e kërkesës, me arsyetimin se ekzekutimi i vendimit gjyqësor është penguar nga arsye objektive, që kanë të bëjnë me mungesën e fondeve buxhetore të debitorit në sistemin informatik financiar të qeverisë dhe të kodit shtatëshifror për realizimin e procedurave financiare në thesar. Në vijim, kërkuesi ka paraqitur në të njëjtën gjykatë kërkesën për sqarimin e vendimit gjyqësor, e cila nuk po ekzekutohej. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Korçë, me vendimin nr. 301(259), datë 09.02.2023, ka vendosur rrëzimin e kërkesës me arsyetimin se ishte e pabazuar në ligj dhe se në atë lloj gjykimi nuk mund të ndryshohej ndërgjyqësia.

5. Në datën 20.03.2023 përmbaruesi gjyqësor i është drejtuar sërish Këshillit të Ministrave për ekzekutimin e vendimit gjyqësor nga një njësi varësie e tij, ndërsa në datën 19.04.2023 ka paraqitur kërkesë në gjykatë për marrjen e masave të nevojshme për ekzekutimin e vendimit, bazuar në nenin 65 e vijues të ligjit nr. 49, datë 03.05.2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", të ndryshuar. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Korçë, me vendimin nr. 1, datë 12.05.2023, ka vendosur mospranimin e kërkesës me arsyetimin se përmbaruesi nuk kishte shteruar mjetet ligjore në dispozicion, pasi nuk kishte aplikuar paraprakisht sanksionet e parashikuara nga ligji.

6. Më tej, përmbaruesi gjyqësor ka vijuar t'i drejtohet Këshillit të Ministrave me disa shkresa, duke kërkuar ekzekutimin e detyrimit. Subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave, në datën 25.09.2023 i është përgjigjur se detyrimi do të shlyhej nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë *(MIE),*

duke qenë se vendimi i shpronësimit i përkiste fushës së përgjegjësisë së saj. Në datën 20.05.2024 MIE-ja ka njoftuar përmbaruesin gjyqësor se ekzekutimi do të kryhej nga viti 2024 e në vijim, sipas mundësive buxhetore të saj.

7. Në datën 09.09.2024 përmbaruesi gjyqësor ka kërkuar informacion nga Dega e Thesarit Tiranë nëse kërkuesi ishte përfshirë në listën për likuidimin e detyrimeve nga MIE-ja, për të cilën ka marrë përgjigje negative. Pas marrjes së këtij informacioni përmbaruesi gjyqësor ka paraqitur dy kërkesa të tjera (në datat 25.09.2024 dhe 08.11.2024) për ekzekutimin e detyrimit nga MIE-ja, duke vënë në dijeni edhe Këshillin e Ministrave, por pa sukses.

8. Në datën 05.12.2024 kërkuesi, nëpërmjet shërbimit postar, ka paraqitur në Gjykatën Kushtetuese *(Gjykata)* ankim kushtetues individual, sipas objektit. Në datën 22.01.2025 Kolegji i Gjykatës ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II
Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

9. ***Kërkuesi***, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar *e drejta për gjykim brenda afatit të arsyeshëm,* pasi vendimi gjyqësor nuk është ekzekutuar për 6 vjet. Megjithëse MIE-ja, për llogari të debitorit, Këshillit të Ministrave, në datën 21.01.2025 e ka shlyer detyrimin financiar, atij i është shkaktuar dëm nga mosekzekutimi i vendimit në afat, dëm i cili duhet t'i paguhej sipas nenit 399/6 të KPC, së bashku me fitimin e munguar.

10. ***Subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave***, në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar se kërkesa është paraqitur jashtë afatit ligjor 4-mujor, që ka filluar të ecë në datën 13.04.2022, kur gjykata e shkallës së parë ka rrëzuar kërkesën për konstatimin e shkeljes. Kërkimi për shpërblimin e dëmit, sipas nenit 399/6 të KPC-së, është jashtë juridiksionit kushtetues, ndërsa kërkimi për konstatimin e cenimit të së drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm tashmë ka mbetur pa objekt, pasi detyrimi është shlyer në datën 21.01.2025. Vonesa në ekzekutim është shkaktuar nga pamundësia objektive e Këshillit të Ministrave, e cila lidhet me mungesën e fondeve dhe të procedurave financiare në emër të tij.

11. ***Subjekti i interesuar, përmbaruesi gjyqësor privat Rigels Dikellari,*** ka informuar se ka vendosur pushimin e procedurës së ekzekutimit të detyrueshëm në kushtet kur titulli ekzekutiv është ekzekutuar tërësisht nga MIE-ja.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkuesit

12. Çështja e legjitimimit *(locus standi)* është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, shterimin e mjeteve juridike efektive, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

13. Kërkuesi, në ankimin kushtetues individual, ka kërkuar, ndër të tjera, edhe shpërblimin e dëmit nga Këshilli i Ministrave, referuar neneve 399/6 dhe 399/10 të KPC-së, si dhe fitimin e munguar si pasojë e vonesës në ekzekutim. Subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave, ka prapësuar se ky kërkim është jashtë juridiksionit kushtetues, pasi kjo lloj padie ngrihet në gjykatën civile të shkallës së parë ku ka qendrën organi, ndaj të cilit është konstatuar shkelja, me kushtin që shkelja të jetë konstatuar në një gjykim të mëvetshëm.

14. Gjykata, bazuar në nenin 131 të Kushtetutës, ka pohuar se pretendimet për të drejtën për dëmshpërblim, sipas neneve 399/6 dhe 399/10 të KPC-së, si rrjedhojë e shkeljes së afatit të arsyeshëm të gjykimit në gjykatat e zakonshme, nuk përfshihen në juridiksionin kushtetues *(shih vendimin nr. 31, datë 29.05.2023 të Gjykatës Kushtetuese)*. Për këtë arsye, kërkimi për shpërblimin e dëmit nga vonesa në ekzekutim dhe fitimin e munguar nuk mund të merret në shqyrtim.

15. Për sa i takon kriterit të legjitimimit *ratione personae*, Gjykata ka pohuar se, në parim, statusi i "*viktimës*" përjashtohet vetëm nëse organet publike kanë njohur shkeljen, në mënyrë të shprehur ose në substancë, dhe më pas e kanë riparuar atë. Në rastin e kohëzgjatjes së procedurave të gjykimit, korrigjim të mjaftueshëm përbën caktimi i shpërblimit të drejtë me vendim gjyqësor dhe, në një rast të tillë, kërkuesi nuk mund të pretendojë më se është viktimë e shkeljes *(shih vendimin nr. 44, datë 26.09.2023 të*

Gjykatës Kushtetuese). Po kështu, Gjykata ka theksuar se vetëm fakti që autoritetet shtetërore kanë zbatuar vendimin, pas një vonese thelbësore, nuk mund të konsiderohet se i heq automatikisht kërkuesit statusin e viktimës, në kuptimin kushtetues *(shih vendimin nr. 8, datë 23.03.2010 të Gjykatës Kushtetuese)*.

16. Mbi bazën e standardeve të mësipërme, Gjykata vëren se vendimi gjyqësor në favor të kërkuesit është bërë i ekzekutueshëm në datën 18.08.2017. Pas paraqitjes së ankimit kushtetues individual, konkretisht në datën 21.01.2025, subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave, ka shlyer tërësisht vlerën e detyrimit sipas vendimit gjyqësor. Megjithatë, duke mbajtur në konsideratë vonesën thelbësore të ekzekutimit, faktet se kjo shkelje nuk është njohur si e tillë nga autoritetet shtetërore dhe se kërkuesi nuk është kompensuar për vonesën, Gjykata arrin në përfundimin se ai e ruan statusin e viktimës së shkeljes, ndaj legjitimohet *ratione personae.*

17. Një kriter tjetër është *shterimi i mjeteve juridike efektive*, i parashikuar nga neni 131, pika 1, shkronja "f", i Kushtetutës dhe neni 71/a, pika 1, shkronja "a", i ligjit nr. 8577/2000, që kërkon shfrytëzimin në rrugë normale të mjeteve juridike efektive, të cilat janë të përshtatshme, të disponueshme dhe të frytshme për një çështje konkrete. Lidhur me kërkesat për konstatimin e cenimit të së drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm, Gjykata, pas ndryshimeve që iu bënë KPC-së me ligjin nr. 38/2017, ka mbajtur qëndrimin se individi duhet t'u drejtohet paraprakisht gjykatave të zakonshme, në përputhje me nenet 399/1 e vijues të KPC-së, dhe vetëm pasi të ketë shteruar garancitë e mbrojtjes që i ofrohen nga juridiksioni i zakonshëm gjyqësor, ai mund të vërë në lëvizje gjykimin kushtetues *(shih vendimet nr. 68, datë 07.12.2023; nr. 46, datë 03.10.2023; nr. 44, datë 26.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese)*.

18. Në rastin konkret, Gjykata vëren se kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual, pasi ka paraqitur kërkesë në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Korçë për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm në ekzekutimin e vendimit gjyqësor dhe përshpejtimin e ekzekutimit të tij, kërkesë e cila është rrëzuar nga gjykata e shkallës së parë në datën 13.04.2022. Në vijim, ai ka paraqitur edhe kërkesë për interpretimin e vendimit gjyqësor që kërkohej të ekzekutohej, e cila gjithashtu i është rrëzuar nga gjykata e shkallës së parë në datën 09.02.2023. Pavarësisht se vendimi i formës së prerë është ekzekutuar tashmë, i vetmi mjet në dispozicion të kërkuesit për rivendosjen e së drejtës së cenuar, atë të ekzekutimit të vendimit brenda afatit të arsyeshëm, është ankimi kushtetues

individual. Në këto rrethana, Gjykata çmon se kërkuesi e ka përmbushur kriterin e shterimit të mjeteve juridike efektive në dispozicion.

19. Për sa i përket legjitimimit *ratione temporis*, bazuar në nenin 71/a, pika 1, shkronja "b", të ligjit nr. 8577/2000, afati për paraqitjen e ankimit kushtetues individual është 4 muaj nga konstatimi i cenimit të së drejtës. Në rastet e ankimeve kushtetuese individuale që lidhen me kohëzgjatjen e arsyeshme të gjykimit, Gjykata ka vënë në dukje se bëhet fjalë për situata të shkeljes vazhduese, në të cilat rregulli i afatit ligjor 4-mujor nuk është i zbatueshëm në mënyrë strikte. Megjithatë, një situatë e vazhdueshme nuk mund të shtyjë për një kohë të pacaktuar zbatimin e afatit të paraqitjes së kërkesës, pasi individi ka edhe detyrimin për të treguar kujdesin e duhur dhe të ndërmarrë nismën e ankimit për dështimin e vazhdueshëm të organeve të pushtetit publik për të përmbushur disa nga detyrimet e tij (*shih vendimet nr. 64, datë 30.11.2023; nr. 44, datë 26.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Mbi bazën e standardit të mësipërm dhe duke mbajtur në konsideratë se debitori nuk e ka përmbushur detyrimin deri në paraqitjen e ankimit kushtetues individual, ndërsa kërkuesi ka bërë disa përpjekje procedurale për ekzekutimin e vendimit, jo vetëm duke vënë në lëvizje vazhdimisht përmbaruesin gjyqësor, por edhe duke iu drejtuar dy herë gjykatës së shkallës së parë me kërkesa të veçanta, Gjykata çmon se shkelja e pretenduar ka natyrë vazhduese dhe kërkuesi ka treguar kujdesin e duhur për të ndërmarrë nismën e ankimit. Për këtë arsye, ai legjitimohet *ratione temporis*, ndaj prapësimi i subjektit të interesuar, Këshillit të Ministrave, për mosrespektimin e afatit, nuk qëndron.

21. Në drejtim të legjitimimit *ratione materiae*, kërkuesi në ankimin kushtetues individual ka kundërshtuar vonesën në ekzekutimin e vendimit gjyqësor. Ky pretendim lidhet me të drejtën e procesit të rregullt ligjor, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe, si i tillë, hyn në juridiksionin kushtetues. Gjykata, duke u bazuar edhe në mënyrën se si është parashtruar pretendimi i kërkuesit, vlerëson ta shqyrtojë atë në këndvështrim të së drejtës për ekzekutimin e vendimit gjyqësor brenda një afati të arsyeshëm.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për konstatimin e cenimit të së drejtës për ekzekutimin e vendimit gjyqësor brenda një afati të arsyeshëm

22. Kërkuesi ka pretenduar konstatimin e cenimit të së drejtës për ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë brenda një afati të arsyeshëm, pasi debitori, Këshilli i Ministrave, ka marrë dijeni për

detyrimin që në vitin 2019 dhe vazhdimisht i është kërkuar ekzekutimi i tij. Edhe pse në datën 21.01.2025, MIE-ja e ka shlyer detyrimin financiar, sipas kërkuesit, pagesa nuk shlyen dëmin e shkaktuar nga vonesa, ndaj Gjykata duhet të konstatojë cenimin e së drejtës kushtetuese të tij.

23. Subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave, ka prapësuar se vendimi gjyqësor në favor të kërkuesit është ekzekutuar me vonesë për shkak të pamundësisë objektive që lidhej me mungesën e fondeve buxhetore dhe të procedurave financiare në emër të vet Këshillit të Ministrave pranë degës së thesarit.

24. Neni 42 i Kushtetutës parashikon, ndër të tjera, se kushdo për mbrojtjen e të drejtave të tij kushtetuese dhe ligjore, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë, ndërsa neni 142, pika 3, i Kushtetutës detyron organet e shtetit të ekzekutojnë vendimet gjyqësore.

25. Gjykata ka theksuar se parimet kushtetuese të lidhura me procesin e rregullt ligjor, për të cilin bën fjalë neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së, si dhe detyrimi për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore, të parashikuara në nenin 142, pika 3, të Kushtetutës, nënvizojnë faktin se çdo qytetar, i cili i drejtohet një gjykate kompetente për realizimin e një të drejte, nuk mund të presë pa kufij për realizimin e saj *(shih vendimet nr. 4, datë 20.02.2013; nr. 6, datë 06.03.2009; nr. 1, datë 19.01.2009 të Gjykatës Kushtetuese)*. Ekzekutimi brenda një afati të arsyeshëm i një vendimi të formës së prerë të gjykatës duhet konsideruar si pjesë përbërëse e së drejtës për një proces të rregullt ligjor. Ai përbën një element thelbësor të shtetit të së drejtës e të vet nocionit të gjykimit të drejtë. Asnjë organ shtetëror nuk mund të vërë në diskutim drejtësinë e vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Çdo organ shtetëror detyrohet të marrë masat përkatëse për zbatimin e tyre (*shih vendimet nr. 25, datë 27.03.2017; nr. 1, datë 21.01.2016; nr. 35, datë 27.10.2010 të Gjykatës Kushtetuese)*.

26. Ekzekutimi i vendimit të formës së prerë të gjykatës përbën fazën përfundimtare të realizimit të një të drejte të fituar gjyqësisht. Vetëm pas realizimit të kësaj faze mund të konsiderohet se individi e ka vendosur plotësisht në vend të drejtën e tij të fituar. Procesi i vendosjes në vend të një të drejte të shkelur përfshin jo vetëm vendimmarrjen e gjykatave, por edhe veprimet konkrete të organeve përgjegjëse të ngarkuara me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Në një çështje që përfshin përcaktimin e një të drejte civile, kohëzgjatja e procedurave normalisht llogaritet nga momenti i fillimit të procedurës gjyqësore deri

në momentin kur jepet vendimi dhe ekzekutohet ai. Faza ekzekutive konsiderohet si fazë e mëtejshme e të njëjtit proces *(shih vendimet nr. 14, datë 15.04.2010; nr. 8, datë 23.03.2010; nr. 9, datë 01.04.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

27. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut *(GJEDNJ)* është shprehur se një individi, i cili ka qenë palë fituese në një proces gjyqësor me një autoritet publik, mund t'i kërkohet të ndërmarrë disa hapa proceduralë për të lejuar ose përshpejtuar zbatimin e një vendimi. Megjithatë, kërkesa për bashkëpunimin e kreditorit nuk duhet të shkojë përtej asaj që është rreptësisht e nevojshme dhe nuk i liron autoritetet nga detyrimet e tyre *(shih Burdov kundër Rusisë (nr. 2), datë 15.01.2009, § 69)*. Barra e provës për të siguruar zbatimin e një vendimi kundër shtetit u takon autoriteteve shtetërore *(shih Yavorivskaya kundër Rusisë, datë 21.07.2005, § 25)*. GJEDNJ-ja ka theksuar se një vonesë në ekzekutimin e një vendimi mund të justifikohet në rrethana të veçanta, por vonesa nuk duhet të jetë e tillë që të cenojë thelbin e së drejtës së mbrojtur sipas nenit 6, paragrafi 1 të KEDNJ-së *(shih Burdov kundër Rusisë, datë 07.05.2002, § 35; Androsov kundër Rusisë, datë 06.10.2005, § 52)*.

28. Gjykata konstaton se, referuar nenit 399/2, pika 1, shkronja "c", të KPC-së, ligjvënësi ka përcaktuar që afati i arsyeshëm i ekzekutimit të një vendimi gjyqësor civil ose administrativ, si rregull, është një vit, afat i cili llogaritet nga dita e paraqitjes së kërkesës për vënien në ekzekutim. Ndërsa në pikën 2 të këtij neni parashikohet se palët në proces mund të kërkojnë konstatimin e tejzgjatjes së procedurës së ekzekutimit edhe pa kaluar afati njëvjeçar, duke pasur parasysh kompleksitetin e çështjes, objektin e mosmarrëveshjes, të procedimit ose të gjykimit, sjelljen e organit që po kryen procedurat, si dhe të çdo personi tjetër të lidhur me çështjen, kur pretendojnë zvarritje të ekzekutimit të vendimit.

29. Duke iu kthyer çështjes konkrete, Gjykata vëren se procesi gjyqësor i vënë në lëvizje nga kërkuesi për masën e shpërblimit nga shpronësimi i pasurisë së tij ka përfunduar me vendimin nr. 971(413), datë 08.06.2017 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë, i cili nuk është ankimuar nga asnjë prej palëve dhe është bërë përfundimtar në datën 08.08.2017. Në fillim të vitit 2020 kërkuesi ka vënë në lëvizje procedurën e ekzekutimit të detyrueshëm, e cila ka zgjatur pothuajse 5 vjet, nga dita kur përmbaruesi gjyqësor ka lajmëruar Këshillin e Ministrave për ekzekutimin vullnetar (10.02.2020), deri në ekzekutimin e detyrimit (21.01.2025).

30. Në këto rrethana, për të vlerësuar nëse kohëzgjatja e ekzekutimit ka qenë e paarsyeshme, pra nëse kërkuesit i është cenuar e drejta kushtetuese për proces të rregullt ligjor në këtë aspekt, Gjykata do të analizojë rrethanat e veçanta të çështjes konkrete dhe kriteret e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese që lidhen me: (i) kompleksitetin e çështjes; (ii) sjelljen e kërkuesit; (iii) sjelljen e autoriteteve; (iv) rëndësinë e asaj çfarë rrezikon kërkuesi (*shih vendimet nr. 39, datë 14.05.2024; nr. 57, datë 25.07.2017; nr. 59, datë 16.09.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

31. Në lidhje me *kompleksitetin e çështjes*, Gjykata vëren se vendimi gjyqësor në ekzekutim ka pasur në objektin e tij detyrimin e Këshillit të Ministrave për t'i paguar kërkuesit një shumë parash si pasojë e shpronësimit të pasurisë së tij për interes publik, çështje e cila *prima facie* nuk duket komplekse. Megjithatë, Gjykata evidenton se Këshilli i Ministrave sipas ligjeve nr. 9000, datë 30.01.2003 "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave" dhe nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, nuk ka personalitet juridik, ndaj nuk është njësi shpenzuese dhe nuk ka fonde buxhetore. Ky fakt konfirmohet edhe nga komunikimi i vazhdueshëm që përmbaruesi ka kryer, jo vetëm me Këshillin e Ministrave, por edhe me Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit, si dhe nga fakti që vendimi është ekzekutuar në fakt nga MIE-ja, që është person juridik publik dhe njësi shpenzuese.

32. Për sa më lart, Gjykata çmon se përcaktimi si debitor i Këshillit të Ministrave, në kontekstin e procedurave buxhetore, ku ai subjekt identifikohet si aparat, duke vepruar përmes njësive përbërëse në varësi të tij është një rrethanë që ka ndërlikuar në njëfarë shkalle ekzekutimin e vendimit gjyqësor, por që gjithsesi nuk e justifikon kohëzgjatjen prej pothuajse 5 vjetësh. Për këtë arsye, vlerësimi i kritereve të tjera merr rëndësi përcaktuese për të vlerësuar nëse kërkuesit i është shkelur e drejta kushtetuese.

33. Lidhur me *sjelljen e kërkuesit*, në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se kohëzgjatja e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë lidhet edhe me veprimet ose mosveprimet e individit, të cilat mund të kenë çuar në mosekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë nga autoritetet e caktuara nga ligji (*shih vendimet nr. 64, datë 30.11.2023; nr. 25, datë 27.03.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Në çështjen konkrete, Gjykata vëren se kërkuesi është sjellë në përputhje

me të drejtat e tij procedurale për të realizuar të drejtën e tij. Ai nuk e ka humbur interesin për ekzekutimin e vendimit, madje e ka shfaqur atë në mënyrë të pandërprerë, duke kërkuar vazhdimisht me mjete të ndryshme procedurale, duke filluar nga kërkesa për ekzekutimin e detyrueshëm, paditë drejtuar gjykatave të zakonshme dhe deri tek ankimi kushtetues individual. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se vetë kërkuesi nuk është bërë shkak për vonesën në ekzekutimin e vendimit.

34. Lidhur me *sjelljen e autoriteteve*, Gjykata ka pohuar se, nga njëra anë, i takon debitorit të gjejë mundësi zgjidhjeje sa më të përshtatshme, me qëllim vënien në vend të së drejtës së kreditorit. Nga ana tjetër, autoritetet shtetërore nuk mund të justifikohen me pamundësinë për të mos respektuar një detyrim që vjen nga një vendim gjyqësor, por duhet të përpiqen me të gjitha mjetet dhe mundësitë që kanë në dispozicion për ta zbatuar atë (*shih vendimet nr. 4, datë 20.02.2013; nr. 10, datë 01.03.2012; nr. 2, datë 01.02.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

35. Gjykata konstaton se nga koha kur ka filluar procedura e ekzekutimit të detyrueshëm ka pasur një korrespondencë të gjatë midis kërkuesit, përmbaruesit gjyqësor privat dhe autoriteteve shtetërore. Kështu, përmbaruesi gjyqësor, me shkresën e datës 20.02.2020, ka lajmëruar debitorin për ekzekutimin vullnetar, ka komunikuar vazhdimisht me Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit, me MIE-në, si dhe ka paraqitur edhe në gjykatë kërkesë për kryerjen e veprimeve të posaçme dhe marrjen e masave të tjera të nevojshme. Për sa i takon sjelljes së vetë debitorit, Këshillit të Ministrave, Gjykata vëren se ai është vënë në lëvizje për përmbushjen e detyrimit me vonesë. Kështu, pas 6 vjetësh nga marrja e formës së prerë të vendimit dhe pothuajse 3 vjet nga fillimi i procedurës së ekzekutimit të detyrueshëm (25.09.2023), Këshilli i Ministrave i ka deleguar MIE-së, në cilësinë e ministrisë së linjës, ndjekjen dhe ekzekutimin e vendimit të formës së prerë. Ndërkohë, edhe ky organ shtetëror nuk ka vepruar menjëherë, madje as nuk e ka planifikuar në buxhetin vjetor të radhës përmbushjen e detyrimit, por është vënë në lëvizje pas më shumë se një viti (21.01.2025), vetëm kur kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual.

36. Subjekti i interesuar ka argumentuar se shkaku i vonesës lidhej me krijimin e pasaktë të ndërgjyqësisë në gjykimin, ku është dhënë vendimi për shpërblimin nga shpronësimi, pasi gjykata e zakonshme duket t'ia kishte ngarkuar detyrimin ministrisë përgjegjëse për shpronësimin. Duke

u caktuar si debitor Këshilli i Ministrave, procedurat buxhetore të thesarit të shtetit pamundësonin kryerjen e veprimeve financiare.

37. Pa mohuar faktin që kjo rrethanë ka ndikuar në vonesën në ekzekutim, Gjykata thekson se ajo nuk e shkarkon subjektin e interesuar nga detyrimi kushtetues që kanë të gjitha organet e shtetit për të ekzekutuar vendimet gjyqësore, sipas nenit 142, pika 3, të Kushtetutës. Për më tepër, Gjykata evidenton se subjekti i interesuar i ka pasur në dispozicion të gjitha mjetet procedurale për të kundërshtuar ndërgjyqësinë në gjykim, madje edhe për t'u ankuar në një gjykatë më të lartë, mjete të cilat nuk rezulton t'i ketë përdorur.

38. Për sa më lart, Gjykata çmon se sjellja e autoriteteve shtetërore nuk ka qenë në nivelin e duhur të efikasitetit, duke çuar në zvarritje të pajustifikuar të ekzekutimit të vendimit gjyqësor.

39. Në lidhje me rëndësinë e asaj çfarë rrezikon kërkuesi, Gjykata vëren se, në rastin konkret, pretendimet e kërkuesit, në thelb, lidhen me shpërblimin e drejtë nga shpronësimi, që përbën një të drejtë të mbrojtur në mënyrë të posaçme nga Kushtetuta në nenin 41, pika 4. Për rrjedhojë, çështja konkrete është e një natyre të tillë që interesi i kërkuesit është rrezikuar në shkallë të konsiderueshme nga vonesa e ekzekutimit të vendimit gjyqësor.

40. Në përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuesit për konstatimin e cenimit të së drejtës për proces të rregullt ligjor, si pasojë e mosekzekutimit të vendimit të formës së prerë të gjykatës brenda një afati të arsyeshëm, është i bazuar, sipas arsyetimit të mësipërm të këtij vendimi, ndaj kërkesa pranohet pjesërisht.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, si dhe neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me shumicë votash,

V E N D O S I:

1. Pranimin e pjesshëm të kërkesës.

2. Konstatimin e cenimit të së drejtës për proces të rregullt ligjor në aspektin e së drejtës për ekzekutimin e vendimit të gjykatës brenda afatit të arsyeshëm.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 30.04.2025
Shpallur më 27.05.2025

MENDIM PAKICE

1. Në gjykimin kushtetues të çështjes që i përket kërkuesit Rafet Dokollari, me objekt: "*Konstatimi i shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimi i procedurave të ekzekutimit të vendimit gjyqësor nr. 413, datë 08.06.2017, titull ekzekutiv. Detyrimi i Këshillit të Ministrave të shpërblejë dëmin financiar për vonesën e pagesës dhe fitimin e munguar",* jam kundër qëndrimit të shumicës për pranimin e kërkesës dhe vlerësoj se kërkesa duhej të ishte rrëzuar, për shkak se në drejtim të vlerësimit të kohëzgjatjes së arsyeshme të procesit të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të kundërshtuar nuk janë plotësuar kriteret e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese dhe për këtë arsye çmoj të shprehem me mendim pakice.

2. Duke iu referuar rrethanave të çështjes konkrete në shqyrtim, siç ka konstatuar edhe shumica, procesi i ekzekutimit të vendimit gjyqësor ka vijuar për një periudhë prej rreth 5 vjetësh dhe është në tejkalim të afatit të arsyeshëm, të parashikuar nga KPC-ja për ekzekutimin e vendimeve. Megjithatë, kjo, në vetvete, nuk përbën argument për të deklaruar kohëzgjatjen e paarsyeshme të procesit, për sa kohë që për të arritur në një vlerësim të tillë nevojitet të vlerësohen kriteret e përcaktuara në jurisprudencën kushtetuese, konkretisht ato që kanë të bëjnë me: (i) sjelljen e kërkuesit; (ii) kompleksitetin e çështjes; (iii) sjelljen e autoriteteve; (iv) rëndësinë e asaj çfarë rrezikon kërkuesi.

3. Sipas shumicës, objekt i çështjes konkrete është ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formë së prerë, me të cilin debitori duhet t'i paguante kërkuesit një shumë parash si pasojë e shpronësimit për interes publik. Nisur nga kjo, duke referuar në jurisprudencën e Gjykatës, shumica ka arritur në përfundimin se çështja është e një natyre të tillë që interesi i kërkuesit është rrezikuar në shkallë të konsiderueshme nga kohëzgjatja e tepruar e procedurës së ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë me rreth 5 vjet, nga të cilat 4 vjet për afatin e arsyeshëm të përcaktuar në KPC, edhe pse nga ana e debitorit është shlyer detyrimi, ndërkohë që çështja pritej të shqyrtohej nga Gjykata në seancë.

4. Në lidhje me të katra kriteret që merren në vlerësim për konstatimin e cenimit të afatit të arsyeshëm për ekzekutimin e vendimit të formës së prerë, bashkohem me shumicën në vlerësimin që ajo i ka bërë *kompleksitetit*

të çështjes, ndërkohë që për sa u takon tre kritereve të tjera ndahem nga qëndrimi i shumicës.

5. Konkretisht për sa i takon kriterit që lidhet me *sjelljen e kërkuesit,* ky i fundit, pavarësisht se ka shfrytëzuar mjetet procedurale në dispozicion të tij, në kushtet kur nga momenti i disponimit me vendim nga ana e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë, për konstatimin e cenimit të afatit të arsyeshëm për ekzekutimin e vendimit e deri në paraqitjen e ankimit kushtetues individual, pavarësisht se shkelja është vazhduese, nuk ka përmbushur detyrimin për të treguar kujdesin e nevojshëm dhe nismën për t'u ankuar në kohën e duhur në këtë Gjykatë për dështimin e vazhdueshëm të ekzekutimit të vendimit të tij brenda një afati të arsyeshëm kohor. Ndërkohë për sa i takon përmbaruesit gjyqësor, ky i fundit, në trajtimin e çështjes, nuk i ka shteruar të gjitha mjetet juridike që parashikon legjislacioni për ekzekutimin e vendimit, fakt ky që provohet me vendimin e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë, që ka rrëzuar kërkesën për kryerjen e veprimeve të posaçme dhe marrjen e masave të tjera të nevojshme nga ana e asaj gjykate.

6. Duke marrë në analizë *sjelljen e autoriteteve,* pavarësisht se është tejkaluar afati i arsyeshëm me 4 vjet, ekzekutimi i vendimit të formës së prerë të kërkuesit, siç me të drejtë konstaton edhe Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Korçë me vendimin nr. 900 (770), datë 13.04.2022, rezulton se ekzekutimi i vendimit gjyqësor është penguar nga arsye objektive, të cilat lidhen me ndërtimin e ndërgjyqësisë, si dhe me faktin se Këshilli i Ministrave nuk disponon llogari në degën e thesarit, duke bërë që vonesa në ekzekutim në këtë rast të justifikohet nga rrethana të veçanta. Në analizën e këtij kriteri gjithashtu duhet të mbahet parasysh edhe fakti që Këshilli i Ministrave, me gjithë pamundësinë e ekzekutimit, ka deleguar një nga organet e varësisë dhe ky i fundit ka ekzekutuar vendimin e formës së prerë të kërkuesit.

7. Për sa i takon kriterit të katërt dhe të fundit*, rëndësinë e asaj çfarë rrezikon kërkuesi* nga kohëzgjatja e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, në vlerësimin tim kërkuesi është kompensuar fillimisht për shumën e llogaritur për shpronësim nëpërmjet VKM-së nr. 909/2014, ndërkohë që shuma e ekzekutuar tashmë me vendim gjykate është plotësimi i vlerës sipas kërkesëpadisë së tij. I marrë në analizë ky kriter i lidhur edhe me kriteret e tjera, si dhe me faktin që kërkuesi është likuiduar për shumën e pretenduar, vlerësoj se ai nuk ka argumentuar dhe provuar rrezikun për interesat e tij pas ekzekutimit tërësor të vendimit. Nisur nga kjo, mbaj qëndrimin se nuk

ka cenim të së drejtës për proces të rregullt ligjor në aspekt të kohëzgjatjes së arsyeshme të ekzekutimit të vendimit, ndaj, për rrjedhojë, kërkesa duhej të ishte rrëzuar.

Anëtar: Genti Ibrahimi

Vendim nr. 30, datë 02.05.2025
(V-30/25)

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Holta Zaçaj, Kryetare, Fiona Papajorgji, Sonila Bejtja, Sandër Beci, Ilir Toska, Genti Ibrahimi, Marjana Semini, Marsida Xhaferllari, anëtarë, me sekretare Belma Lleshi, në datën 22.04.2025 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 12 (G) 2024 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: **GEG NDOCI, AGE NDOCI,** përfaqësuar nga avokat Konstandin Tradafili, me prokurë.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:
SHOQËRIA E SIGURIMEVE "ATLANTIK" SH.A., përfaqësuar nga avokat Envi Hicka, me prokurë.
SHOQËRIA "JAPAN SERVIS" SH.P.K., në mungesë.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimeve nr. 12276, datë 22.12.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr. 548, datë 10.03.2016 të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr. 00-2024-1095, datë 20.03.2024 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

BAZA LIGJORE: **Nenet 41, 42, 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i" dhe 142 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6, pika 1, i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); nenet 27, pikat 1 dhe 2, 71, pika 1, 71/a dhe 71/b të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin**

e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Marsida Xhaferllari, mori në shqyrtim pretendimet e kërkuesve Geg Ndoci dhe Age Ndoci (*kërkuesit*), të cilët kërkuan pranimin e kërkesës, parashtrimet me shkrim të subjektit të interesuar, Shoqërisë së Sigurimeve "Atlantik" sh.a. (*shoqëria e sigurimeve*), që kërkoi rrëzimin e kërkesës, konstatoi mungesën e prapësimeve me shkrim të subjektit tjetër të interesuar, shoqërisë "Japan Servis" sh.p.k., si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I
Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesit janë bashkëshortë ndërmjet tyre. Në datën 04.11.2011, në fshatin Gojan të Pukës ka ndodhur një aksident automobilistik në të cilin ka humbur jetën fëmija i tyre i mitur i moshës 2 vjeç dhe ka mbetur e dëmtuar rëndë kërkuesja Age Ndoci.

2. Pas kryerjes së veprimeve hetimore, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë (*Prokuroria e Pukës*) ka konkluduar se shkaktar i aksidentit ka qenë drejtuesi i mjetit motorik, të cilin e ka proceduar penalisht për veprën penale "Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor", të parashikuar nga neni 290, paragrafi i parë, i Kodit Penal dhe e ka dërguar çështjen në gjyq. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pukë, në përfundim të gjykimit të shkurtuar të çështjes, me vendimin nr. 16, datë 15.05.2012, e ka deklaruar drejtuesin e mjetit motorik fajtor sipas akuzës dhe e ka dënuar me 1 vit e 4 muaj burgim. Vendimi është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Shkodër me vendimin nr. 182, datë 20.09.2012.

3. Drejtuesi i mjetit motorik shkaktues i dëmit ka qenë i siguruar me policë sigurimi pranë shoqërisë së sigurimeve për periudhën 30.07.2011 – 29.07.2012. Pas përfundimit të procesit penal dhe shpalljes fajtor të drejtuesit, në datën 04.09.2013 kërkuesit i janë drejtuar me kërkesë shoqërisë së sigurimeve për shpërblimin e dëmit shëndetësor të shkaktuar nga aksidenti. Me shkresën e datës 12.09.2013, shoqëria e sigurimeve u ka bërë të ditur kërkuesve se dokumentacioni i paraqitur kishte mangësi që

e bënin të pamundur përllogaritjen e dëmshpërblimit sipas rregullores nr. 53, datë 25.06.2009 "Për trajtimin e dëmeve që mbulohen nga kontrata e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit", të ndryshuar (*rregullorja nr. 53/2009*), të miratuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (*AMF*), duke u kërkuar vendimin gjyqësor penal të formës së prerë për fajësinë e autorit të ngjarjes, dëshminë e trashëgimisë dhe akte të tjera shkresore.

4. Kërkuesit, duke mos qenë dakord me përgjigjen e shoqërisë së sigurimeve, kanë paraqitur padi në gjykatë me objekt shpërblimin e dëmit të plotë pasuror dhe jopasuror, si dhe pagesën e shpenzimeve, gjithsej në vlerën 7.986.458 lekë (4.809.729 lekë për viktimën e mitur dhe 3.176.729 lekë për kërkuesen Age Ndoci). Po kështu, ata kanë kërkuar edhe pagesën e interesave sipas normave deri në ekzekutimin e vendimit.

5. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 12276, datë 22.12.2014, ka vendosur pranimin pjesërisht të padisë, duke detyruar shoqërinë e sigurimeve të shpërblejë kërkuesit për dëmin e shkaktuar në vlerën gjithsej 4.079.944 lekë (2.500.000 lekë për viktimën e mitur dhe 1.579.944 lekë për kërkuesen Age Ndoci) dhe rrëzimin e padisë për kërkimet e tjera. Ndonëse kërkuesit kanë paraqitur ankim, vendimi është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr. 548, datë 10.03.2016, ndërsa Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-1095, datë 20.03.2024, ka vendosur mospranimin e rekursit.

6. Në datën 24.10.2024 kërkuesit i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit, i cili pasi është plotësuar në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 8577/2000 me aktet e kërkuara, është regjistruar në datën 31.10.2024. Kolegji i Gjykatës në datën 03.01.2025 ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II
Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

7. ***Kërkuesit,*** në mënyrë të përmbledhur, kanë pretenduar se gjykatat e zakonshme u kanë cenuar:

7.1. *Parimin e barazisë përpara ligjit dhe mosdiskriminimit*, të garantuar nga neni 18 i Kushtetutës, për llogaritjen e vlerës së shpërblimit për dëmin pasuror të akorduar në shumën fikse 1.000.000 lekë, për sa kohë nuk ka kritere ligjore specifike për pagesën referencë. Gjykatat duhet t'u referoheshin nenit 646

të Kodit Civil dhe pagës minimale zyrtare në shkallë vendi për kohën kur ka ndodhur aksidenti. Gjykatat e kanë përllogaritur dëmshpërblimin bazuar në rregulloren nr. 53/2009, ndonëse ajo nuk kishte hyrë ende në fuqi, duke mos respektuar qëndrimin e konsoliduar të Gjykatës së Lartë, e cila ka vënë në dukje se rregullorja është botuar më vonë në Fletoren Zyrtare. Rregullorja bie ndesh me nenin 646 të Kodit Civil. Gjithashtu, gjykatat e zakonshme, në ndryshim nga rastet e tjera, u kanë mohuar kërkuesve të drejtën e kamatave ligjore që ua njeh ligji.

7.2. *Të drejtën e pronës*, të garantuar nga neni 41 i Kushtetutës, pasi dëmshpërblimi sipas ligjit nr. 10076, datë 12.02.2009 "Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit", të ndryshuar (*ligji nr. 10076/2009*) përbën interes pasuror. Gjykatat e zakonshme kanë interpretuar gabim ligjin për përllogaritjen e dëmit pasuror, duke zbatuar rregulloren nr. 53/2009 dhe kanë cenuar situatën sociale dhe ekonomike të kërkuesve.

7.3. *Të drejtën për proces të rregullt ligjor*, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në aspektet e mëposhtme:

7.3.1. *Së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj,* pasi Gjykata e Lartë ka dështuar të realizojë funksionin e saj rishikues dhe kontrollues mbi vendimet e gjykatave më të ulëta, duke ligjëruar shkeljet e lejuara, si ndaj parashikimeve ligjore, ashtu edhe ndaj vet praktikës gjyqësore. Rekursi është paraqitur më 21.03.2016, megjithatë vendimi është marrë nga Gjykata e Lartë bazuar në parashikimet ligjore të miratuara në vitin 2017. Për pasojë, kërkuesve u është cenuar edhe *e drejta e aksesit,* pasi u është kufizuar shqyrtimi i të gjitha shkaqeve të paraqitura në rekurs, përfshirë edhe shkeljet e ligjit material nga gjykatat e faktit. Megjithëse pretendimet e kërkuesve ishin lehtësisht të verifikueshme, Gjykata e Lartë nuk ka bërë një analizë të tyre, por vetëm ka vlerësuar se shkaqet ishin të ndryshme nga ato të parashikuara nga neni 472 i Kodit të Procedurës Civile (*KPC*).

7.3.2. *Parimit të sigurisë juridike dhe pritshmërive të ligjshme*, pasi dëmshpërblimi i kërkuesve duhej llogaritur sipas vendimit unifikues nr. 12, datë 14.09.2007 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë (*vendimi unifikues nr. 12/2007*) dhe parashikimeve të Kodit Civil, duke qenë se në kohën e ngjarjes

rregullorja nr. 53/2009 nuk kishte hyrë ende në fuqi. Zbatimi i rregullores ka cenuar rregullat kushtetuese për hyrjen në fuqi të akteve normative të përcaktuara në nenin 117 të Kushtetutës. Si pasojë, kërkuesve u janë cenuar interesat, pasi masa e dëmshpërblimit është zvogëluar.

7.3.3. *Së drejtës për t'u dëgjuar,* pasi Gjykata e Lartë e ka shqyrtuar çështjen në dhomën e këshillimit, megjithëse çështja ishte komplekse dhe në procedura gjyqësore prej 12 vjetësh, çka e bënte të nevojshëm shqyrtimin e saj në seancë gjyqësore me praninë e palëve, për më tepër që shkaqet e rekursit vinin në diskutim çështje të ligjit dhe uniformitetin e praktikës gjyqësore. Për pasojë, kërkuesve u është mohuar edhe *e drejta për t'u mbrojtur* në kuptimin e paraqitjes së argumenteve në seancë, si dhe aksesi në gjykatë.

7.3.4. *Standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor*, pasi Gjykata e Lartë nuk ka arsyetuar se përse nuk i ka marrë parasysh pretendimet e ngritura në rekurs nga kërkuesit, nuk ka dhënë argumente të hollësishme se përse nga gjykatat nuk ka shkelje të ligjit material ose praktikës gjyqësore të Gjykatës së Lartë. Ajo i shmanget dhënies së argumenteve, ndërsa ka dhënë konkluzione kategorike dhe të rrumbullakosura, duke keqinterpretuar faktet dhe ligjin.

8. ***Subjekti i interesuar, shoqëria e sigurimeve,*** në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar se:

8.1. Pretendimi për cenimin e *parimit të barazisë përpara ligjit* nuk qëndron, pasi fakti që gjykatat nuk kanë zbatuar në mënyrë uniforme ligjin nuk është çështje kushtetuese. Mënyra e zgjidhjes së çështjes dhe e zbatimit të ligjit është e drejtë e çdo gjykate brenda funksionit gjyqësor, ndaj pretendimi i kërkuesve është thjesht një sforcim juridik për të shprehur një rëndesë që çështja efektivisht nuk e ka.

8.2. Pretendimi për cenimin e *së drejtës së pronës* është i pabazuar, pasi rasti i kërkuesve qëndron jashtë konceptit të pritshmërive të ligjshme në kontekstin e kësaj të drejte, madje është qartazi i përjashtuar nga jurisprudenca evropiane. Gjykatat nuk u kanë mohuar kërkuesve të drejtën për dëmshpërblim, por ato kanë caktuar masën e dëmshpërblimit në interpretim të legjislacionit të brendshëm. Ndonëse kërkuesit kanë përfshirë brenda nocionit

të së drejtës së pronës edhe parimin e sigurisë juridike, pretendimi i tyre është i pavend. Fakti që në momentin e ngjarjes ishte në fuqi vendimi unifikues i Gjykatës së Lartë nuk ka asnjë kuptim juridik, sepse në atë kohë vepronte ligji nr. 10076/2009.

8.3. Pretendimi për cenimin e *së drejtës për proces të rregullt ligjor,* në aspektet e *gjykimit nga një gjykatë e paanshme dhe pavarur, e caktuar me ligj, së drejtës për t'u dëgjuar dhe standardit të arsyetimit gjyqësor,* është i pabazuar, pasi kërkuesit nuk kanë paraqitur asnjë argument me vlerë në mbështetje të tij. Kërkuesit janë të pakënaqur për vlerësimin që gjykatat e zakonshme i kanë bërë zgjidhjes së mosmarrëveshjes së tyre, duke kërkuar që pretendimet e tyre të shqyrtohen në instancë të katërt. Argumentet e tyre ndaj (mos)zbatimit të rregullores nr. 53/2009 janë shqyrtuar në substancë nga gjykatat e faktit dhe Gjykata e Lartë nuk ka gjetur shkak për të pranuar rekursin. Mospranimi i rekursit nga Gjykata e Lartë nuk e ka kufizuar aksesin e kërkuesve, pasi ky disponim është brenda funksionit të saj. Çështja e kërkuesve ka qenë në proces trajtimi nga shoqëria e sigurimeve kur rregullorja ka hyrë në fuqi dhe dëmshpërblimi është caktuar sipas saj, ndaj nuk qëndrojnë argumentet për cenimin e *rregullave kushtetuese për hyrjen në fuqi të akteve normative*. Për rrjedhojë, nuk është cenuar standardi i gjykimit të drejtë.

9. ***Subjekti i interesuar, shoqëria "Japan Servis" sh.p.k.,*** nuk ka paraqitur prapësime me shkrim, megjithëse është njoftuar me shpallje nga Gjykata.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkuesve

10. Çështja e legjitimimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike,

afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

11. Për sa i përket legjitimimit *ratione personae*, Gjykata vëren se kërkuesit, në cilësinë e trashëgimtarëve ligjorë të fëmijës së tyre të mitur (prindërit) që ka humbur jetën në aksidentin automobilistik, madje njëri prej tyre edhe në cilësinë e të dëmtuarit (kërkuesja Age Ndoci), kanë ngritur padi në gjykatat e zakonshme për të kërkuar dëmshpërblim nga aksidenti, proces i cili ka përfunduar me mospranimin e rekursit të tyre nga Gjykata e Lartë. Për rrjedhojë, ata justifikojnë interesin në çështjen kushtetuese të parashtruar në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës.

12. Në lidhje me *shterimin e mjeteve juridike efektive*, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës, Gjykata vëren se kërkuesit i janë drejtuar asaj me ankim kushtetues individual pas përfundimit të procesit gjyqësor në të tria shkallët e gjyqësorit të zakonshëm, ku i kanë ngritur edhe në substancë pretendimet e tyre kushtetuese. Për rrjedhojë, ata nuk kanë mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese përveç paraqitjes së ankimit kushtetues individual.

13. Për sa i takon legjitimimit *ratione temporis*, bazuar në nenin 71/a, pika 1, shkronja "b", të ligjit nr. 8577/2000, afati për paraqitjen e ankimit kushtetues individual është 4 muaj nga konstatimi i cenimit të së drejtës. Gjykata është shprehur se në rastin kur ankimi ka të bëjë me një vendim të Gjykatës së Lartë, data e marrjes dijeni konsiderohet data në të cilën vendimi i arsyetuar bëhet i disponueshëm për palët përmes depozitimit të tij në sekretarinë gjyqësore dhe publikimit në faqen zyrtare (*shih vendimin nr. 42, datë 19.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Gjykata konstaton se vendimi i Gjykatës së Lartë mban datën 20.03.2024, ndërsa kërkesa është paraqitur në datën 24.10.2024. Gjykata e Lartë, me shkresën nr. 3729/1 prot., datë 17.07.2024, ka informuar përfaqësuesin ligjor të kërkuesve se vendimi është publikuar në faqen zyrtare të saj në datën 25.06.2024. Duke iu referuar kësaj date si momenti i konstatimit të cenimit të të drejtave themelore, rezulton se ankimi kushtetues individual është paraqitur brenda afatit 4-mujor, rrjedhimisht kërkuesit legjitimohen edhe *ratione temporis*.

15. Në drejtim të legjitimimit *ratione materiae*, kërkuesit kanë pretenduar cenimin e parimit të barazisë përpara ligjit, së drejtës për proces të rregullt ligjor në disa aspekte (gjykimi nga një gjykatë e caktuar me ligj, parimi i sigurisë juridike, e drejta për t'u dëgjuar dhe mbrojtur, si dhe standardi i

arsyetimit të vendimit gjyqësor) dhe së drejtës së pronës, të garantuar nga nenet 18, 41 dhe 42 të Kushtetutës.

16. Pretendimin për cenimin e *parimit të barazisë përpara ligjit*, kërkuesit e kanë mbështetur në disa argumente, një pjesë e të cilave lidhet me mënyrën e përllogaritjes së masës së dëmshpërblimit, ndërsa pjesa tjetër e argumenteve lidhet me faktin se gjykatat kanë vepruar në mënyrë të ndryshme nga rastet e tjera. Subjekti i interesuar, shoqëria e sigurimeve, ka prapësuar se pretendimi nuk qëndron, pasi zbatimi i ligjit nuk është çështje kushtetuese dhe mënyra e zgjidhjes së rastit konkret është e drejtë e çdo gjykate brenda funksionit gjyqësor, ndaj kërkimi i kërkuesve është thjesht një sforcim juridik për të shprehur një rëndesë që çështja efektivisht nuk e ka.

17. Gjykata thekson se mënyra e zbatimit të ligjit është një çështje që përfshihet brenda juridiksionit të gjykatave të zakonshme, të cilat kanë detyrën e interpretimit të ligjit për qëllim të procesit gjyqësor që ato zhvillojnë (*shih vendimet nr. 33, datë 14.11.2022; nr. 3, datë 23.02.2016; nr. 42, datë 07.07.2014 të Gjykatës Kushtetuese*). Nga ana tjetër, Gjykata konstaton se kërkuesit nuk kanë konkretizuar se cilat janë rastet e ngjashme në të cilat gjykatat e zakonshme megjithëse gjendeshin përpara rrethanave dhe fakteve të njëjta kanë mbajtur qëndrime të ndryshme. Në këtë pikë, Gjykata vë në dukje se edhe nëse prezumohet se gjykatat e zakonshme kanë vendosur ndryshe në një rast të ngjashëm, kjo në vetvete nuk mund të mbështesë *a priori* pretendimin për shkeljen e parimit të barazisë përpara ligjit, pasi mënyra e zgjidhjes së çështjes dhe e zbatimit të ligjit është e drejtë e çdo gjykate, për sa kohë çdo çështje konkrete është specifike dhe ka individualitetin e saj, harmonizuar edhe me rrethana, faktorë, motive ose prova gjyqësore, të cilat nuk mund të jenë të njëjta (*shih vendimet nr. 19, datë 21.03.2024; nr. 17, datë 23.03.2023 të Gjykatës Kushtetuese*). Nën këtë analizë, Gjykata vlerëson se argumentet e kërkuesve në mbështetje të pretendimit për cenimin e *parimit të barazisë përpara ligjit* nuk qëndrojnë, ndaj ky pretendim nuk mund të merret në shqyrtim.

18. Lidhur me pretendimin për cenimin e së drejtës *për t'u dëgjuar dhe mbrojtur,* për shkak të formës së gjykimit të çështjes së kërkuesve nga Gjykata e Lartë në dhomën e këshillimit, Gjykata ka theksuar se faza e shqyrtimit paraprak është procedurë e cila zhvillohet gjithnjë në dhomën e këshillimit dhe kompetencat e kolegjit të Gjykatës së Lartë ushtrohen *de plano*, pasi lidhen me seleksionimin e rekurseve që plotësojnë kriteret ligjore, ndërsa për rekurset që nuk plotësojnë kriteret e nenit 472 të KPC-së

vendoset mospranimi i tyre bazuar në nenin 480 të po këtij kodi. Shqyrtimi paraprak vlerësues është kompetencë vetëm e trupës së gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë në dhomën e këshillimit *(shih vendimet nr. 67, datë 06.12.2023; nr. 31, datë 29.05.2023 të Gjykatës Kushtetuese).* Në rastin konkret, Gjykata konstaton se Gjykata e Lartë ka vepruar në përputhje me parashikimet procedurale të nenit 480 të KPC-së, sipas të cilave mospranimi i rekursit vendoset në dhomën e këshillimit, pra pa praninë e palëve, kur janë rastet e parashikuara nga kjo dispozitë. Po kështu, Gjykata evidenton se kërkuesit, edhe pse kanë barrën e provës në këtë drejtim, nuk kanë arritur të provojnë në aspektin kushtetues cenimin e së drejtës për proces të rregullt për shkak të shqyrtimit të rekursit në dhomën e këshillimit. Ndaj pretendimi i tyre për cenimin e së drejtës për t'u dëgjuar dhe mbrojtur është haptazi i pabazuar.

19. Për sa i takon pretendimit për cenimin e *së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj*, kërkuesit kanë argumentuar se ndonëse rekursi është paraqitur më 21.03.2016, Gjykata e Lartë e ka marrë vendimin bazuar në parashikimet ligjore të miratuara në vitin 2017, çka ka sjellë edhe cenimin e së drejtës së aksesit, pasi shkaqet e rekursit janë shqyrtuar në mënyrë të kufizuar. Subjekti i interesuar ka prapësuar se Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit brenda funksionit të saj, ndaj pretendimi është i pabazuar.

20. Gjykata vëren se në thelb ky pretendim lidhet me mënyrën e zbatimit të ligjit procedural për shqyrtimin e rekursit nga Gjykata e Lartë. Kjo e fundit ka arsyetuar se, për sa i takon formimit të trupit gjykues, procedurës së gjykimit, si dhe mënyrës sesi disponon, kolegji civil i Gjykatës së Lartë u referohet dispozitave që janë aktualisht në fuqi (*shih paragrafët 16 – 17 të vendimit të Gjykatës së Lartë*). Në këto rrethana, Gjykata çmon se Gjykata e Lartë ka vepruar bazuar në parimin *tempus regit processum*, sipas të cilit ligji i ri procedural ka fuqi edhe për çështjet që janë në gjykim, me përjashtim të rastit kur vetë ai shprehet ndryshe *(shih vendimet nr. 3, datë 11.02.2021; nr. 106, datë 27.05.2002 të Gjykatës Kushtetuese)*. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se pretendimi i kërkuesve për cenimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj është haptazi i pabazuar.

21. Gjithashtu, kërkuesit kanë pretenduar edhe cenimin e *parimit të sigurisë juridike,* me argumentin se gjykatat duhet ta kishin përllogaritur vlerën e dëmshpërblimit sipas vendimit unifikues nr. 12/2007 dhe parashikimeve të Kodit Civil, duke qenë se rregullorja nr. 53/2009, e cila ka zvogëluar vlerat e dëmshpërblimit, ende nuk kishte fituar fuqi ligjore. Sipas

tyre, gjykatat e zakonshme nuk kanë respektuar rregullat kushtetuese për hyrjen në fuqi të akteve normative, pasi rregullorja është botuar më vonë në Fletoren Zyrtare dhe nuk mund të ketë fuqi ligjore prapavepruese për ngjarjen e ndodhur në datën 04.11.2011. Këto argumente janë kundërshtuar nga subjekti i interesuar, shoqëria e sigurimeve, që ka prapësuar se ato nuk kanë asnjë rëndësi për çështjen objekt shqyrtimi, pasi rasti ka qenë në proces trajtimi nga shoqëria e sigurimeve kur rregullorja ka hyrë në fuqi, ndaj trajtimi i dëmshpërblimit është bërë sipas këtij akti.

22. Gjykata vëren se këto argumente, nga njëra anë, kanë të bëjnë me përmbushjen e kërkesave të cilësisë së akteve normative, për të cilat ajo është shprehur se akti duhet të jetë i aksesueshëm për të interesuarin (në kuptim të marrjes dijeni) dhe i parashikueshëm për efektet e tij, si dhe mjaftueshmërisht i qartë, me qëllim që t'u japë qytetarëve sigurinë juridike (*shih vendimet nr. 39, datë 15.12.2022; nr. 30, datë 02.11.2022; nr. 30, datë 05.07.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Nga ana tjetër, argumentet e kërkuesve kanë të bëjnë edhe me qëndrimin e mbajtur nga gjykatat e zakonshme në drejtim të mënyrës se si ato kanë zgjidhur çështjen objekt shqyrtimi, pra arsyet që ato kanë përdorur për të identifikuar ligjin e zbatueshëm për zgjidhjen e mosmarrëveshjes konkrete. Nisur nga kjo, këto pretendime të kërkuesve do të analizohen në këndvështrim *të së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor*.

23. Për pretendimin e cenimit *të së drejtës së pronës*, kërkuesit kanë argumentuar se çështja mbart interes pasuror, në kushtet kur ata kanë pësuar dëm nga aksidenti dhe ligji nr. 10076/2009 u jep të drejtën e dëmshpërblimit, që sipas tyre është llogaritur gabim nga gjykatat e zakonshme dhe në shkelje të parimit të sigurisë juridike për shkak të zbatimit të rregullores nr. 53/2009, e cila nuk kishte hyrë në fuqi në rastin e tyre. Subjekti i interesuar, shoqëria e sigurimeve, ka prapësuar se kërkuesit nuk kanë pasur pritshmëri të ligjshme për vlerën e dëmshpërblimit, pasi rasti i tyre është trajtuar nga gjykatat e zakonshme sipas legjislacionit në fuqi, ndaj pretendimi për cenimin e së drejtës së pronës është haptazi i pabazuar.

24. Neni 41 i Kushtetutës garanton të drejtën e pronës private, si dhe përcakton kritere për kufizimin me ligj në ushtrimin e kësaj të drejte. Kjo e drejtë garantohet edhe nga neni 1 i Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, që në thelb u referohet vetëm pasurive ekzistuese të individit.

25. Sipas Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*GJEDNJ*), "pasuritë" mund të jenë "pasuri ekzistuese" ose asete, duke përfshirë edhe pretendimet nëpërmjet të cilave një kërkues mund të argumentojë se ka

të paktën "një pritshmëri legjitime" (e cila duhet të jetë më konkrete se sa thjesht një shpresë) se ato do të realizohen, domethënë se do të fitojë gëzim efektiv të një të drejte pronësie *(shih Bici kundër Shqipërisë, datë 03.12.2015, § 49).* Që një pretendim të konsiderohet si "pasuri" që përfshihet brenda fushës së zbatimit të nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, kërkuesi duhet të vërtetojë se ka një bazë të mjaftueshme në ligjin kombëtar, për shembull kur ekziston një praktikë gjyqësore e gjykatave vendase që e konfirmojnë atë ose nëse ka një vendim gjyqësor të formës së prerë në favor të kërkuesit. Nëse rasti është i tillë, atëherë koncepti i "pritshmërisë së ligjshme" mund të hyjë në veprim *(shih Draon kundër Francës, datë 06.10.2005, § 68; Driza kundër Shqipërisë, datë 13.11.2017, § 102*). Po kështu, sipas GJEDNJ-së, individi nuk mund të pretendojë se ka një pritshmëri të ligjshme në rastin kur është vënë në diskutim interpretimi dhe zbatimi i saktë i së drejtës kombëtare dhe pretendimet e tij janë rrëzuar nga gjykatat vendase (*shih Anheuser-Busch Inc. kundër Portugalisë, datë 11.01.2007, § 65; Béláné Nagy kundër Hungarisë, datë 13.12.2016, § 75*).

26. Mbi bazën e standardeve të mësipërme, Gjykata konstaton se argumentet e kërkuesve kanë të bëjnë me të drejtën për dëmshpërblim nga aksidenti, që njihet nga ligji nr. 10076/2009, lidhur me vlerën e ulët të dëmshpërblimit të caktuar nga gjykatat e zakonshme, që, sipas tyre, i janë referuar metodologjisë së rregullores nr. 53/2009 që nuk kishte fuqi juridike. Në këtë kuptim, Gjykata çmon se kërkuesit kanë treguar se ka një bazë ligjore të mjaftueshme që konfirmon në dukje pritshmëritë e ligjshme të tyre për të pasur një dëmshpërblim monetar, ndaj në ndryshim nga sa prapëson subjekti i interesuar, pretendimi i tyre konsiderohet se ka të bëjë me të drejtën e pronës.

27. Për sa më lart, duke qenë se pretendimi për cenimin e së drejtës së pronës, në thelb, lidhet me vlerësimin që gjykatat e zakonshme i kanë bërë çështjes në fjalë, Gjykata çmon ta analizojë atë në këndvështrim të nenit 42 të Kushtetutës, sipas të cilit prona nuk mund të cenohet pa një proces të rregullt ligjor dhe se kushdo, për mbrojtjen e saj, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë nga një gjykatë.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor

28. Kërkuesit kanë pretenduar se Gjykata e Lartë nuk ka arsyetuar se përse nuk i ka marrë parasysh pretendimet e ngritura në rekurs nga kërkuesit

dhe nuk ka dhënë argumente të hollësishme se përse nga gjykatat nuk ka shkelje të ligjit material ose praktikës gjyqësore të Gjykatës së Lartë. Ajo i shmanget dhënies së argumenteve, ndërsa ka dhënë konkluzione kategorike dhe të rrumbullakosura, duke keqinterpretuar faktet dhe ligjin. Sipas kërkuesve, dëmshpërblimi duhej llogaritur sipas vendimit unifikues nr. 12/2007 dhe parashikimeve të Kodit Civil, duke qenë se në kohën e ngjarjes rregullorja nr. 53/2009 nuk kishte hyrë ende në fuqi. Zbatimi i rregullores, shprehen kërkuesit, ka cenuar rregullat kushtetuese për hyrjen në fuqi të akteve normative të përcaktuara në nenin 117 të Kushtetutës. Si pasojë, atyre u janë cenuar interesat, pasi masa e dëmshpërblimit është zvogëluar.

29. Subjekti i interesuar, shoqëria e sigurimeve, ka prapësuar se nuk është cenuar standardi i gjykimit të drejtë dhe se kërkuesit nuk kanë paraqitur asnjë argument me vlerë në mbështetje të pretendimit të tyre. Kërkuesit janë të pakënaqur për vlerësimin që gjykatat e zakonshme i kanë bërë zgjidhjes së mosmarrëveshjes, duke kërkuar që pretendimet të shqyrtohen në instancë të katërt. Argumentet e tyre janë shqyrtuar në substancë nga gjykatat e faktit dhe Gjykata e Lartë nuk ka gjetur shkaqe për të pranuar rekursin. Po sipas subjektit të interesuar, çështja e kërkuesve ka qenë në proces trajtimi nga shoqëria e sigurimeve kur rregullorja ka hyrë në fuqi dhe dëmshpërblimi është caktuar sipas saj, ndaj argumentet për cenimin e rregullave kushtetuese për hyrjen në fuqi të akteve normative nuk qëndrojnë.

30. Gjykata ka theksuar se e drejta e aksesit nuk përfshin vetëm të drejtën për të filluar një proces, por edhe të drejtën për të pasur, nga ana e gjykatës, një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pasi aksesi në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal (*shih vendimet nr. 32, datë 03.11.2022; nr. 5, datë 22.02.2022; nr. 22, datë 29.04.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

31. Po kështu, sipas Gjykatës, funksioni i një vendimi gjyqësor të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë (*shih vendimet nr. 33, datë 30.05.2023; nr. 11, datë 10.03.2023 të Gjykatës Kushtetuese*). Po në këtë drejtim, Gjykata është shprehur se vendimet e mospranimit të rekursit të Gjykatës së Lartë mund të arsyetohen në mënyrë të kufizuar, me kusht që në pjesën hyrëse të listohen shkaqet e rekursit. Arsyetimi i kufizuar nuk cenon standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor, përderisa në thelb shpreh shkaqet e mospranimit të rekursit (*shih vendimet nr. 10, datë 07.03.2023; nr. 21, datë*

16.04.2015; nr. 37, datë 19.09.2011 të Gjykatës Kushtetuese). Megjithatë, kur në rekurs janë ngritur pretendime të natyrës kushtetuese, Gjykata e Lartë, bazuar në natyrën e gjykimit kushtetues të kërkesave individuale, si dhe në parimin e subsidiaritetit që udhëheq raportet ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme, duhet të mbajë një qëndrim të shprehur për to *(shih vendimet nr. 16, datë 12.03.2024; nr. 29, datë 01.11.2022; nr. 19, datë 07.07.2022 të Gjykatës Kushtetuese)*.

32. Nga ana tjetër, Gjykata ripohon se është detyra e saj të shqyrtojë dhe vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës (*shih vendimin nr. 33, datë 14.11.2022 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata nuk vepron si shkallë e katërt gjykimi, por ajo ndërhyn atëherë kur gabimi ligjor ose faktik nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është aq i dukshëm, sa një gjykatë e arsyeshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose është i tillë që gjykimin e bën të padrejtë *(shih vendimet nr. 3, datë 21.01.2025; nr. 59, datë 14.11.2023; nr. 29, datë 01.11.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

33. Mbi bazën e standardeve të mësipërme, Gjykata do të verifikojë nëse kërkuesit kanë marrë përgjigje përfundimtare për pretendimin lidhur me ligjin e zbatueshëm në llogaritjen e shpërblimit të dëmit dhe nëse gjykatat e zakonshme kanë identifikuar ligjin e zbatueshëm pa gabime ligjore të dukshme, duke shqyrtuar më pas nëse rekursi i tyre përmban pretendime me natyrë kushtetuese dhe nëse vendimi i mospranimit të rekursit të Gjykatës së Lartë është në përputhje me standardet kushtetuese të arsyetimit.

34. Gjykata vëren se kërkuesit e kanë nisur procesin gjyqësor për shpërblimin e dëmit nga aksidenti, duke ngritur në të gjitha aktet procedurale (padi, apel dhe rekurs) pretendimin për moszbatimin e rregullores nr. 53/2009, me argumentin se ai ishte një akt që në momentin e ndodhjes së aksidentit nuk kishte hyrë në fuqi. Lidhur me këtë, gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar se aksidenti ka ndodhur në datën 04.11.2011, kohë në të cilën ligji nr. 10076/2009 kishte qenë në fuqi dhe në zbatim të tij ishte miratuar edhe rregullorja nr. 53/2009. Kjo e fundit i ka shërbyer gjykatës së shkallës së parë si referencë për figurën konkrete të dëmit që kanë pësuar kërkuesit për pasojë edhe të vlerës së dëmshpërblimit. Po sipas asaj gjykate, vendimi unifikues nr. 12/2007 që nuk vendoste kufij në caktimin e vlerës tavan të dëmshpërblimit, nuk ishte i zbatueshëm, pasi ai vendim jepte orientime për llogaritjen e dëmit në kushtet e mungesës së

akteve ligjore dhe nënligjore përkatëse. Sipas gjykatës së shkallës së parë, situata e mungesës së akteve ligjore dhe nënligjore nuk ekzistonte më, pasi kishin hyrë në fuqi ligji nr. 10076/2009 dhe rregullorja nr. 53/2009. Kjo e fundit ishte e detyrueshme të zbatohej nga shoqëritë e sigurimeve dhe nga vlerësuesit e dëmeve, ndaj momenti i botimit ose jo i saj në Fletoren Zyrtare tashmë është i ezauruar. Rregullorja është vetëm e natyrës metodologjike për trajtimin e dëmeve sipas parashikimeve të bëra në ligj. Sipas gjykatës, nëse do të pranohej fakti që kjo rregullore nuk ka hyrë në fuqi, do të thotë të mbetet pa zbatuar ligji nr. 10076/2009 për një periudhë 2-vjeçare dhe në këto kushte, pretendimi i kërkuesve se rregullorja nuk zbatohet në rastin e tyre është i pabazuar (*shih faqet 10 – 12 të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë*).

35. Vendimi i gjykatës së shkallës së parë për këtë çështje është gjetur i drejtë nga Gjykata e Apelit Tiranë, e cila ka vlerësuar se përllogaritja e dëmit që rrjedh nga rasti i sigurimit u referohet kërkesave të ligjit nr. 10076/2009 dhe rregullores nr. 53/2009 të AMF-së, pasi ngjarja ka ndodhur në datën 04.11.2011, kohë në të cilën këto akte kanë qenë në fuqi. Ndonëse sipas nenit 117 të Kushtetutës, një akt ligjor ose nënligjor prodhon efekte vetëm pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe rregullorja nr. 53/2009 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 180 të muajit dhjetor në vitin 2011, rasti i kërkuesve ka qenë në proces trajtimi nga shoqëria e sigurimeve në datën e hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, ndaj ai do të trajtohet sipas parashikimeve të rregullores (*shih faqen 11 të vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë*).

36. Ndonëse kërkuesit kanë ushtruar rekurs, duke parashtruar edhe shkakun që lidhej me (mos)hyrjen në fuqi të rregullores, Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e tij, duke vlerësuar se shkaqet e parashtruara nuk parashikoheshin në nenin 472 të KPC-së dhe se nuk rezultonte të kishte shkelje të rënda të normave procedurale që ta bënin të pavlefshëm vendimin dhe procedurat e gjykimit. Gjykata e Lartë ka arsyetuar edhe se gjykata e apelit ka respektuar ligjin material, duke e interpretuar dhe zbatuar drejt atë, ndërsa vendimi i saj nuk është në kundërshtim me ndonjë vendim të Kolegjit Civil ose të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë (*shih paragrafin 19 të vendimit të Gjykatës së Lartë*).

37. Gjykata konstaton se kërkuesit e kanë ngritur në rekurs pretendimin se gjykatat e faktit kanë identifikuar gabim ligjin e zbatueshëm, duke caktuar për pasojë një vlerë të ulët dëmshpërblimi. Sipas tyre, rregullorja nr. 53/2009 nuk ishte e zbatueshme sipas nenit 117 të Kushtetutës, pasi mosmarrëveshja ka lindur në ditën e aksidentit, më 04.11.2011, ndërsa

rregullorja ishte botuar më vonë në Fletoren Zyrtare. Këto pretendime, në thelb, kanë të bëjnë me parimet e sigurisë juridike dhe të hierarkisë së akteve, ashtu sikundër edhe me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor, të cilat kanë natyrë kushtetuese. Megjithatë, Gjykata e Lartë, bazuar në nenet 472 dhe 480 të KPC-së, ka vendosur mospranimin e rekursit, me arsyetim të kufizuar, pa mbajtur qëndrim të shprehur. Ndërkohë që edhe përgjigjja e dhënë nga gjykatat e faktit lidhur me fuqinë juridike të rregullores nuk rezulton shteruese dhe e qartë në drejtim të pretendimit kyç të kërkuesve.

38. Konkretisht, gjykatat e faktit kanë paraqitur arsye të ndryshme për zbatimin e rregullores nr. 53/2009, por pa u shprehur qartë nëse rregullorja ka natyrë normative dhe kur ka marrë fuqi juridike. Kështu, gjykata e shkallës së parë arsyeton se ligji i zbatueshëm përcaktohet nga data e aksidentit, por rregullorja, edhe pse është botuar pas aksidentit, gjen zbatim në rastin e kërkuesve, pasi në të kundërt ligji mbetet i pazbatueshëm. Kurse gjykata e apelit, ndërsa shprehet se vendimi i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë, arsyeton se ligji i zbatueshëm përcaktohet nga data që ka filluar procesi administrativ në shoqërinë e sigurimeve, kur rregullorja ishte në fuqi. Kjo situatë e vlerësimit të ndryshëm ligjor të çështjes kërkonte që Gjykata e Lartë të ushtronte rolin e saj si gjykatë e ligjit, për të verifikuar identifikimin e ligjit të zbatuar dhe fuqinë juridike të tij nën dritën e parimit të sigurisë juridike, sipas të cilit individi duhet të marrë dijeni rregullisht për aktet ligjore, të cilat duhet të jenë të parashikueshme për efektet e tyre dhe mjaftueshmërisht të qarta. Në këtë mënyrë, Gjykata e Lartë nuk ka arsyetuar nëse rregullorja kishte natyrë normative dhe nëse po kur kishte hyrë në fuqi dhe përse zbatohej në rastin e tyre, që do thotë se kur kërkuesit mund ta aksesonin atë, pra të merrnin dijeni dhe rrjedhimisht të parashikonin efektet e rregullores, me qëllim që ata të ishin mjaftueshmërisht të qartë për masën e dëmshpërblimit që u takonte si pasojë e një ngjarjeje shumë të rëndë që kishte sjellë edhe humbjen e jetës së fëmijës së tyre të mitur 2 vjeç.

39. Gjykata ka vënë në dukje edhe më parë se në rastet e shpërblimit të dëmit nga aksidentet, çështjet e veprimit të ligjit në kohë ose të vendosjes respektive hierarkike të normave në konflikt, hyjnë në sferën e kompetencës së gjykatave të zakonshme. Dyshimet në lidhje me veprimin në kohë të normave juridike duhet të zgjidhen nga gjykatat e zakonshme, bazuar në parashikimet kushtetuese që përcaktojnë momentin e hyrjes në fuqi të tyre (neni 117 i Kushtetutës), si edhe bazuar në parimin kushtetues të hierarkisë së akteve ligjore (nenet 4 dhe 116 të Kushtetutës), nga të cilat burojnë edhe parimet ku bazohen gjykatat për përcaktimin e ligjit të zbatueshëm në rast

të përplasjeve mes normave me fuqi të njëjtë ose të ndryshme juridike (*shih vendimin nr. 82, datë 26.11.2024 të Gjykatës Kushtetuese*).

40. Po kështu, Gjykata risjell në vëmendje se vetëm një vendim i arsyetuar i jep asaj mundësinë të vlerësojë nëse gjykatat e zakonshme kanë marrë në shqyrtim pretendimet kryesore të palëve dhe mënyrën se si i kanë trajtuar ato. Veçanërisht kur bëhet fjalë për pretendime me natyrë kushtetuese, në kuadër të parimit të subsidiaritetit që udhëheq raportet ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të zakonshëm gjyqësor, mungesa e arsyetimit të Gjykatës së Lartë e vë në vështirësi/pamundësi Gjykatën për të vlerësuar nëse ajo i ka marrë në shqyrtim dhe nëse i ka vlerësuar ato pretendime (*shih vendimin nr. 82, datë 26.11.2024 të Gjykatës Kushtetuese*).

41. Nisur nga sa më lart, Gjykata çmon se Gjykata e Lartë, në ushtrim të funksionit të saj, duhej të kishte mbajtur një qëndrim të shprehur në drejtim të ligjit të zbatueshëm, në përputhje edhe me parimet kushtetuese dhe praktikën e kësaj Gjykate, ashtu edhe në drejtim të bazueshmërisë në themel të shkaqeve të rekursit që kishin të bënin me aspekte kushtetuese të procesit gjyqësor. Kjo me qëllim që kërkuesit të merrnin një përgjigje për sa i takon zbatueshmërisë së ligjit në zgjidhjen e mosmarrëveshjes së tyre objekt shqyrtimi. Në këto kushte, në kontekst të rrethanave të rastit konkret, mospranimi i rekursit të kërkuesve nga Gjykata e Lartë, duke u mjaftuar vetëm me parashtrimin në vendim të shkaqeve të rekursit dhe me arsyetimin *de plano* se këto shkaqe nuk janë nga ato të parashikuara nga ligji, pa u dhënë përgjigje të arsyetuar pretendimeve me natyrë kushtetuese, të çon në përfundimin se zbatimi i ligjit nga ajo është haptazi i paarsyeshëm dhe vë në dyshim të drejtën e procesit të rregullt ligjor në aspektin e arsyetimit të vendimit gjyqësor.

42. Në përmbledhje të argumenteve të mësipërme, Gjykata çmon se pretendimi i kërkuesve për cenimin e së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor nga Gjykata e Lartë është i bazuar, ndaj ky vendim duhet të shfuqizohet dhe çështja të dërgohet për rishqyrtim.[1]

[1] Gjyqtarja Fiona Papajorgji është shprehur kundër qëndrimit të shumicës për pranimin e kërkesës, pasi ka vlerësuar se kërkesa duhej të ishte rrëzuar, mbështetur në të njëjtat argumente të shprehura në mendimin e saj të pakicës bashkëlidhur vendimit nr. 82, datë 26.11.2024 të Gjykatës. Sipas gjyqtares në pakicë, kërkuesit kanë ushtruar të drejtën e tyre të paraqitjes së padisë/ankimit/rekursit, ku përmes një procesi gjyqësor, që ka analizuar themelin e çështjes, me vendim përfundimtar kanë marrë përgjigje të arsyetuar për të

43. Në përfundim, Gjykata vlerëson se kërkesa e kërkuesve duhet të pranohet sipas arsyetimit të mësipërm të këtij vendimi.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, si dhe nenit 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me shumicë votash,

V E N D O S I:

1. Pranimin e pjesshëm të kërkesës.

2. Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2024-1095, datë 20.03.2024 të Gjykatës së Lartë.

3. Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 02.05.2025
Shpallur më 28.05. 2025

gjitha pretendimet e tyre, në veçanti për masën e dëmshpërblimit që u takonte sipas ligjit të zbatueshëm për zgjidhjen e mosmarrëveshjes konkrete. Po kështu, Gjykata e Lartë ka vepruar brenda rolit dhe funksionit të saj kushtetues për interpretimin e ligjit. Në këto rrethana, pretendimi i kërkuesve për cenimin e së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsyetimit është i pabazuar.

Vendim nr. 31, datë 02.05.2025
(V-31/25)

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Holta Zaçaj, Kryetare, Marsida Xhaferllari, Fiona Papajorgji, Sandër Beci, Genti Ibrahimi, Marjana Semini, Sonila Bejtja, anëtarë, me sekretare Belma Lleshi, në datën 22.04.2025 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 18 (F) 2024 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: **FESTIM ELEZAJ, EGLANTINA ELEZAJ, FABIOLA BEGAJ (ELEZAJ),** përfaqësuar nga avokate Anila Veliaj, me prokurë.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

BYROJA SHQIPTARE E SIGURIMIT, përfaqësuar nga drejtoresha ekzekutive, Anila Hoxha.

AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE, përfaqësuar nga drejtoresha ekzekutive, Mimoza Kaçi.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i Rregullores së Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare "Për trajtimin e dëmeve që mbulohen nga kontrata e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit", krerët III, IV, V, VI "Metodologjia e përllogaritjes së dëmit shëndetësor", "Vlerësimi i dëmeve" dhe neni 14, pika 1, shkronja "e", miratuar me vendimin e bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare nr. 53, datë 25.06.2009, ndryshuar me vendimet e këtij bordi nr. 168, datë 13.12.2011, nr. 72, datë 04.04.2018 dhe nr. 91, datë 31.05.2019, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**
Shfuqizimi i vendimeve nr. 7522, datë 30.06.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr. 970,

datë 25.04.2016 të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr. 00-2024-2568, datë 05.06.2024 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 17, 18, 118, 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 27, 49, pika 3, shkronja "e", 71 dhe 71/a të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Sonila Bejtja, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuesve, të cilët kanë kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjekteve të interesuara, Byrosë Shqiptare të Sigurimit (*BSHS*) dhe Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (*AMF*), të cilat kanë kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I
Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesit janë trashëgimtarë ligjorë të së ndjerës E.E. (prindërit dhe motra e viktimës të mitur), e cila ka humbur jetën në datën 28.03.2011, si pasojë e dëmtimeve të rënda të shëndetit të shkaktuara nga aksidenti automobilistik i ndodhur në datën 13.03.2011.

2. Në lidhje me këtë ngjarje ka filluar procedimi penal ndaj shtetasit A.K., i cili ishte duke drejtuar automjetin që ka shkaktuar dëmtimet e viktimës, i papajisur me dëshmi aftësie për drejtim të mjeteve motorike. Në lidhje me këtë procedim penal, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 1367, datë 06.10.2011, e ka deklaruar atë fajtor dhe e ka dënuar për kryerjen e veprave penale "Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor" dhe "Drejtimi i mjetit pa dëshmi", të parashikuara nga nenet 290,

pika 1 dhe 291 të Kodit Penal. Ky vendim është lënë në fuqi me vendimin nr. 435, datë 20.04.2012 të Gjykatës së Apelit Tiranë.

3. Trashëgimtarët e viktimës, kërkuesit, si dhe vëllai i saj D.E., i janë drejtuar BSHS-së për kërkimin e dëmit pasuror dhe jopasuror të shkaktuar nga përdorimi i mjetit motorik, i cili ka qenë me regjistrim të huaj dhe pronari i tij nuk ishte i mbuluar nga sigurimi i përgjegjësisë ndaj palës së tretë (nuk ka pasur dokument të sigurimit ndërkombëtar të vlefshëm dhe as kontratë të sigurimit kufitar). Kërkesa është mbështetur në nenin 29 të ligjit nr. 10076, datë 12.02.2009 "Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit" (*ligji nr. 10076/2009*), si dhe dispozitat e neneve 419 e vijues, 476 e vijues, 608 e vijues, 625, 640 e vijues të Kodit Civil (*KC*).

4. Duke qenë se nuk kanë marrë përgjigje nga BSHS-ja në lidhje me kërkesën e tyre, trashëgimtarët e viktimës, në datën 07.10.2013 kanë paraqitur kërkesëpadi në gjykatën e shkallës së parë, me objekt detyrimin e palës së paditur, BSHS-së, të paguajë në favor të paditësve dëmin real pasuror dhe jopasuror, shpenzimet e varrimit dhe të ceremonive mortore, si dhe kamatëvonesat, për shkak të dëmit të shkaktuar nga aksidenti rrugor i datës 13.03.2011 ku ka humbur jetën viktima e mitur E.E.

5. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 7522, datë 30.06.2014, ka vendosur pranimin e pjesshëm të padisë, duke detyruar palën e paditur, BSHS-në, t`i dëmshpërblejë ata për dëmin pasuror dhe jopasuror në shumën 3.250.000 lekë dhe me interesin e pagueshëm ligjor për çdo ditë vonesë në shlyerjen e dëmshpërblimit, duke filluar nga data 12.03.2013. Sipas asaj gjykate, ajo i referohet rregullores nr. 53, datë 25.06.2009 "Për trajtimin e dëmeve që mbulohen nga kontrata e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit" (*rregullorja nr. 53/2009*), të miratuar nga AMF-ja, që gjen zbatim për trajtimin e dëmit në këtë rast. Sipas parashikimeve të këtij akti lidhur me formulën e llogaritjes së dëmshpërblimeve, gjykata ka vlerësuar fillimisht dëmin pasuror, duke iu referuar kreut III të saj dhe në vijim neneve 12 dhe 14, pika 1/e, si parashikime të posaçme në raport me parashikimin e bërë në nenin 646 të KC-së. Edhe për përcaktimin e dëmit jopasuror, gjykata ka përllogaritur dëmin biologjik, moral dhe atë ekzistencial bazuar në rregulloren nr. 53/2009 (*shih faqet 8-10 të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë*). Kundër këtij vendimi kanë bërë ankim paditësit.

6. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 970, datë 25.04.2016, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, duke

vlerësuar se zgjidhja e çështjes në themel në lidhje me dëmin pasuror dhe jopasuror është në përputhje me ligjin. Gjykata e apelit e ka gjetur të drejtë arsyetimin e gjykatës së shkallës së parë për ligjin e zbatueshëm dhe për pabazueshmërinë e pretendimeve të paditësve në lidhje me llogaritjen e dëmit pasuror dhe jopasuror, duke vlerësuar se ligji nr. 10076/2009, si legjislacioni i posaçëm që rregullon në mënyrë specifike rastet e sigurimit të detyrueshëm në fushën e transportit, lidhur me metodën për përllogaritjen e vlerave të dëmshpërblimit për secilën figurë dëmi, ka autorizuar AMF-në për të miratuar rregulla për trajtimin e dëmeve, e cila, për këtë qëllim, ka miratuar rregulloren nr. 53/2009 të botuar në Fletoren Zyrtare nr. 180, datë 25.01.2012. Sipas gjykatës së apelit, në nenin 51/1 të kësaj rregulloreje përcaktohet se dosjet e dëmeve, ngjarja e të cilave ka ndodhur pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 10076/2009 dhe janë në proces trajtimi nga shoqëria e sigurimit dhe BSHS-ja në datën e hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, trajtohen sipas parashikimeve të saj, ndaj ka vlerësuar se gjykata e shkallës së parë, me të drejtë, ka pranuar vlerat e dëmit të llogaritura nga eksperti vlerësues sipas rregullores, përderisa ajo përbën një rregullim të posaçëm të dëmeve në fushën e transportit, duke pasur përparësi në zbatim në raport me rregullimet e legjislacionit të përgjithshëm (*shih faqet 8 dhe 9 të vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë*). Kundër këtij vendimi kanë paraqitur rekurs paditësit.

7. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-2568, datë 05.06.2024, ka vendosur mospranimin e rekursit, pasi nuk përmban shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 472 të Kodit të Procedurës Civile (*KPC*), ndërsa shkaqet e parashtruara në rekurs që ngrenë çështje të vlerësimit të provave dhe fakteve, dalin jashtë juridiksionit rishikues dhe ligjor të asaj gjykate. Sipas Kolegjit Civil, gjykata e apelit ka interpretuar dhe zbatuar drejt ligjin material dhe atë procedural që kanë shërbyer për zgjidhjen e mosmarrëveshjes, ka arsyetuar në mënyrë ezauruese shkakun e vendimmarrjes, nuk ka shkelur dispozitat për juridiksionin dhe kompetencën lëndore, funksionale dhe as tokësore ekskluzive, përbërja e trupit gjykues ka qenë në rregull dhe nuk ka pasur shkaqe papajtueshmërie, nuk ka vendosur pushimin e çështjes në rastin konkret, çështja është shqyrtuar në prani të palëve ndërgjyqëse dhe nuk konstatohen shkelje lidhur me procesin e njoftimit të tyre, hetimi gjyqësor është shtrirë mbi të gjitha objektet e kërkimit e pa i tejkaluar ato, si edhe nuk konstatohen akte të pavlefshme procedurale, të një rëndësie të atillë që të kenë ndikuar në dhënien e vendimit (*shih paragrafët 17 - 19 të vendimit të Kolegjit Civil*).

8. Në datën 05.11.2024 kërkuesit i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*), me ankim kushtetues individual sipas objektit të tij, i cili, pasi është plotësuar sipas kërkesave të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 06.11.2024. Kolegji i Gjykatës në datën 14.01.2025 ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë dokumentesh.

II
Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

9. ***Kërkuesit,*** në mënyrë të përmbledhur, kanë pretenduar:

9.1. *Për rregulloren nr. 53/2009:*

9.1.1. Kërkuesit plotësojnë në mënyrë kumulative kriteret e legjitimimit: *i) legjitimimin ratione personae*, pasi janë bartës të së drejtës kushtetuese të pretenduar të cenuar (pabarazia përpara ligjit, diskriminimi për shkak të moshës), si dhe provojnë interesin në lidhje me çështjen, pra cenimin e drejtpërdrejtë dhe real të së drejtës kushtetuese; *ii) kanë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive,* pasi çështja ka përfunduar së gjykuari në të tria shkallët e gjykimit; *iii) legjitimimin ratione temporis*, pasi kanë paraqitur ankim kushtetues individual brenda afatit 4-mujor nga momenti i shpalljes së arsyetuar të vendimit të Gjykatës së Lartë; *iv) legjitimimin ratione materiae*, pasi pretendimet e ngritura bëjnë pjesë në juridiksionin kushtetues. Pavarësisht se rregullorja nr. 53/2009 është shfuqizuar aktualisht me ndryshimet ligjore (ligji nr. 32/2021, datë 16.03.2021 "Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit") normat e saj bëjnë pjesë në të drejtën pozitive, pasi ajo aktualisht zgjat në kohë dhe zbatohet ndaj marrëdhënieve juridike të krijuara në kohën që ka qenë në fuqi.

9.1.2. *Gjykata e Lartë nuk ka pranuar kërkesën për njësimin e praktikës gjyqësore* edhe pse rregullorja nr. 53/2009, duke parashikuar metodologjinë e vlerësimit të dëmit ka zvogëluar dëmet shumë herë më tepër se kufiri minimal i parashikuar nga neni 26 i ligjit nr. 10076/2009 dhe pavarësisht se praktika gjyqësore vijon të jetë e ndryshme dhe në lidhje me këto raste ka vetëm një vendim unifikues (vendimi nr. 12, datë 14.09.2007 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë

(*vendimi unifikues nr. 12/2007*). Në lidhje me kërkesën për njësim ajo nuk citohet në vendimin e Kolegjit Civil dhe madje nga verifikimi i dosjes gjyqësore rezulton se kjo kërkesë nuk është administruar në fashikullin gjyqësor. Kjo përbën një shkelje procedurale, pasi gjykata duhej të ishte shprehur me vendim në lidhje me të.

9.1.3. *Është cenuar parimi i sigurisë juridike dhe i pritshmërive të ligjshme*, pasi në vendimet e gjykatave të faktit dëmi i llogaritur është bazuar në variantin e parashikimeve të rregullores nr. 53/2009, e cila nuk ka qenë e botuar në Fletoren Zyrtare në momentin e shkaktimit të dëmit. Por edhe nëse ajo do të ishte në fuqi, ky akt ka zvogëluar hapësirat e përcaktuara nga vetë ligji nr. 10076/2009.

9.1.4. *Është cenuar parimi i barazisë përpara ligjit,* pasi në raste analoge Gjykata e Lartë nuk ka zbatuar parashikimet e rregullores nr. 53/2009, me arsyetimin se ajo nuk mund të gjejë zbatim, pasi nuk ka qenë e botuar në Fletoren Zyrtare në momentin e shkaktimit të dëmit dhe këto raste janë referuar edhe në kërkesën për njësim të praktikës dhe në rekurs. Madje në një rast tërësisht analog Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të palës së paditur (INSIG), që ngrinte si shkak të tij moszbatimin e parashikimeve të rregullores, duke marrë zgjidhje diametralisht të kundërt në të tria shkallët e gjykimit. Për rrjedhojë, duke qenë se praktika gjyqësore ishte e ndryshme, kishte nevojë për njësim, pasi këto qëndrime të gjykatave i kanë vendosur palët në kushtet e pabarazisë përpara ligjit.

9.1.5. *Rregullorja nr. 53/2009 nuk respekton parimin e hierarkisë së akteve,* sipas nenit 116 të Kushtetutës dhe *rezervën ligjore*, sipas nenit 118 të Kushtetutës. Kjo sepse krerët e saj për vlerësimin e dëmit kanë dalë tej kufijve të përcaktuar në ligj edhe pse rregullorja duhet të dalë në bazë dhe për zbatim të ligjit dhe nuk mund të zvogëlojë hapësirat e dhëna në ligj. Në lidhje me mënyrën e parashikuar për llogaritjen e dëmit pasuror (duke parashikuar një shumë fikse dëmshpërblimi për të miturit), rregullorja bie ndesh jo vetëm me ligjin nr. 10076/2009 (neni 3, pika 7), por edhe me vetë KC-në, nenet 643 e vijues të saj, të interpretuara me vendimin unifikues

të Kolegjeve të Bashkuara, që kanë të bëjnë me dëmin e shkaktuar nga vdekja e të miturit. Rregullorja nr. 53/2009 ka tejkaluar tagrin e dhënë nga ligji nr. 10076/2009, duke parashikuar krerët vlerësimi i dëmeve, autorizim që neni 13 i ligjit nuk ia ka dhënë. Ky nen ka parashikuar se rregullat për trajtimin e dëmeve që mbulohen nga kontrata e sigurimit të detyrueshëm, sipas pikës 1 të nenit 2 të këtij ligji, miratohen me vendim të autoritetit (AMF), ndërkohë që termi "trajtim" është krejtësisht i ndryshëm nga termi "vlerësim", edhe po t`i referohemi kuptimit gjuhësor të këtyre fjalëve. Në këto kushte, rregullorja nr. 53/3009 ka tejkaluar kompetencat që ligji i ka deleguar AMF-së.

9.1.6. *Rregullorja nr. 53/2009* është nxjerrë nga një organ jokushtetues, siç është AMF-ja. Aktet normative nxirren vetëm nga organet e parashikuara në Kushtetutë dhe jo nga ato që nuk parashikohen në të, siç është AMF-ja, e cila është një organ i krijuar me ligj dhe ka pasur tagrin të nxjerrë rregullore për trajtimin e dëmeve, por jo udhëzim për vlerësimin e tyre. Organet e krijuara me ligj, siç është AMF-ja mund të nxjerrin vetëm rregullore me karakter të brendshëm. AMF-ja e ka mbajtur rregulloren nr. 53/2009 të pabotuar në Fletoren Zyrtare për 2 vjet e 7 muaj, që nga data 25.06.2009 deri në datën 25.01.2012. Kjo vërteton faktin se rregullorja nuk është një akt normativ, por një akt i brendshëm i cili nuk duhet të gjente pasqyrim nga gjykatat. Dëmi që u ka ardhur kërkuesve ka ndodhur një vit përpara daljes së rregullores.

9.1.7. *Rregullorja nr. 53/2009* ka zvogëluar hapësirat e dhëna nga ligji nr. 10076/2009, sipas nenit 26, pika 2, shkronja "c", të të cilit kufiri minimal i përgjegjësisë për çdo person të dëmtuar, i parashikuar në shkronjat "a" dhe "b" të kësaj pike, është 2.000.000 lekë. Kjo vlerë nuk rezulton në asnjë prej parashikimeve të rregullores nr. 53/2009.

9.1.8. *Është cenuar neni 17 i Kushtetutës,* pasi kjo dispozitë i ka rezervuar ligjit kufizimin e lirive dhe të drejtave kushtetuese, ndaj zbatimi i rregullores përbën një kufizim të ri tej atyre të parashikuara në ligjin nr. 10076/2009, duke mos u respektuar kështu kriteri i kufizimit me ligj.

9.1.9. *Është cenuar neni 18 i Kushtetutës,* pasi vendosja e një çmimi fiks si dëm pasuror për të miturin cenon parimin e mosdiskriminimit për shkak të moshës. Në dy raste të tjera identike, ku personat të cilët kanë gjetur vdekjen në të njëjtën periudhë kohore (përpara botimit të rregullores nr. 53/2009) dhe kanë pasur edhe të njëjtën moshë, Gjykata e Lartë i ka zgjidhur në mënyrë diametralisht të kundërt. Janë me dhjetëra vendime të Gjykatës së Lartë që kanë mbajtur qëndrim duke mos e njohur zbatimin e rregullores nr. 53/2009, por i janë referuar drejtpërdrejt ligjit.

9.2. *Për vendimet gjyqësore*:

9.2.1. *Është cenuar parimi i barazisë përpara ligjit,* i parashikuar në nenin 18 të Kushtetutës për shkak të zbatimit të rregullores nr. 53/2009 dhe jo vendimit unifikues të Gjykatës së Lartë, duke iu njohur familjarëve të të miturve që humbin jetën në aksident vlera fikse dëmi. Vendimet gjyqësore, për sa i përket dëmit pasuror, e kanë konsideruar të miturën si të papunë dhe në pamundësi për të fituar të ardhura, duke u njohur familjarëve të saj shumën fikse të dëmit në masën 1,000,000 lekë, sipas parashikimeve të nenit 14, pika 1, shkronja "e", të rregullores. Ndërkohë, vendimi unifikues i Gjykatës së Lartë ka interpretuar gjerësisht dëmin që u shkaktohet familjarëve kur nga aksidenti ndërron jetë një i/e mitur, duke arritur në përfundimin unifikues se, në mbështetje të neneve 608 dhe 643/a të KC-së, anëtarët pasjetues të familjes, në lidhje të afërt dhe të qëndrueshme me të ndjerin e mitur që ka humbur jetën për shkak të një fakti të paligjshëm, kanë të drejtën e dëmshpërblimit në lidhje me dëmin pasuror të pësuar në formën e fitimit të munguar, si një pamundësi për të përfituar, në rrjedhën normale të jetës, solidaritetin dhe kontributin reciprok të të ndjerit të mitur, jo vetëm si përkujdesje në tërësi, por edhe si mbështetje ekonomike e tij për familjen në të ardhmen. Sipas atij vendimi, nuk ka rëndësi rrethana që në kohën e vdekjes së të miturit, prindërit dhe anëtarët e tjerë të familjes gëzojnë ose jo të ardhura të mjaftueshme për ushqim dhe jetesë. Gjykatat, që kanë pasur detyrimin të zbatojnë këtë vendim unifikues, kanë njohur dhe zbatuar parashikimet e nenit 14, pika 1, shkronja "e", të rregullores,

duke sanksionuar pabarazinë dhe diskriminimin për shkak të moshës. Kjo pasi nëse e ndjera do të ishte 16 vjeç në çastin e aksidentit, pavarësisht se po njëlloj nuk gjeneronte të ardhura, llogaritja e dëmit pasuror për të do të ishte disa herë më e lartë.

9.2.2. Në lidhje me dëmin jopasuror, paditësve (babai, nëna, motra dhe vëllai i së ndjerës) u është njohur së bashku, sipas rregullores nr. 53/2009, dëmi moral në shumën 1,000,000 lekë dhe po aq dëm ekzistencial. Kjo citohet në vendime se është parashikuar në nenin 26 të ligjit nr. 10076/2009 dhe në rregullore, nen ky që ka pasur nevojë për një interpretim të zgjeruar, pasi në një interpretim shterues do të rezultonte që dëmi jopasuror është tërësisht pa lidhje me dëmin pasuror. Nëse dëmi pasuror ndahet mes paditësve (trashëgimtarë ose familjarë të të ndjerit) dëmi jopasuror është vetjak dhe i përket individualisht gjithsecilit, që do të thotë se nëse ligji parashikon në nenin 26 të tij si kufi mbulimi për dëmin jopasuror me pasojë vdekjen shumën 1,000,000 lekë, ky kufi i përket individualisht secilit prej paditësve dhe nuk ndahet mes tyre si trashëgimi. Dëmi jopasuror për sa është interpretuar edhe në vendimin unifikues (biologjik, moral, ekzistencial) shfaqet në tri forma dhe para gjykatës duhet provuar secila prej tyre. Në rastin konkret paditësit nuk mundën të provonin dot dëmin biologjik të pësuar dhe kërkuan të dëmshpërbleheshin për dy figurat e tjera autonome të dëmit jopasuror (atë moral dhe ekzistencial). Ndërkohë që dëmi moral (që është interpretuar në vendimin unifikues nr. 12/2007 si prezumim ligjor) dhe ekzistencial (që është provuar me akt psikologjik) janë gjetur të provuar nga gjykatat. Mënyra sesi është interpretuar në rastin konkret dëmi jopasuror sanksionon pabarazinë përpara ligjit, pasi të dëmtuarit e ndryshëm do të trajtoheshin në mënyra të ndryshme në varësi të anëtarëve të familjes dhe për të njëjtën pasojë.

10. ***Subjekti i interesuar, BSHS-ja***, në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar si vijon:

10.1. *Për rregulloren nr. 53/2009:*

10.1.1. Gjykata nuk mund të shqyrtojë kërkimin për shfuqizimin e rregullores nr. 53/2009, pasi ai është një akt nënligjor i

shfuqizuar dhe nuk është më në fuqi. Sipas BSHS-së, ky akt nuk ka më asnjë efekt dhe bazuar në nenin 51, pika 2, të ligjit nr. 8577/2000, gjykimi për rregulloren nr. 53/2009 duhet të pushohet nga Gjykata.

10.1.2. Kërkuesit nuk legjitimohen për këtë pjesë të objektit të ankimit kushtetues, pasi akti nënligjor i kundërshtuar nuk cenon ndonjë të drejtë të tyre kushtetuese, si edhe ata nuk kanë argumentuar se cila është kjo e drejtë kushtetuese që u cenohet nga ai akt. Pretendimet e kërkuesve në lidhje me rregulloren nr. 53/2009 kanë të bëjnë me çështje të terminologjisë së përdorur në të ("trajtim" apo vlerësim"), që në këtë rast nuk ngre asnjë pretendim kushtetues. Pra, problematika e ngritur nga kërkuesit në lidhje me rregulloren nr. 53/2009, nëse është ose jo në përputhje me Kushtetutën, nuk është çështje kushtetuese. Në këtë rast, pretendimet e kërkuesve kanë të bëjnë me çështje të interpretimit të ligjit, veprimit në kohë të rregullores, që për nga natyra janë në juridiksionin e gjykatave të zakonshme dhe që në fakt janë zgjidhur nga Gjykata e Lartë në çështje të ngjashme. Rregullorja nr. 53/2009 nuk është kundërshtuar brenda afateve ligjore.

10.1.3. Rregullorja nr. 53/2009 është nxjerrë në përputhje dhe në zbatim të ligjit nr. 10076/2009, duke respektuar edhe nenin 116 të Kushtetutës. Gjykata nuk mund të shqyrtojë një kërkesë për kundërshtimin e akteve të cilat janë në përputhje me legjislacionin dhe me Kushtetutën.

10.2. *Për vendimet gjyqësore*:

10.2.1. Pretendimi i kërkuesve për cenimin e *parimit të barazisë përpara ligjit* nuk është i bazuar, pasi nuk mund të pretendohet cenimi i këtij parimi për mënyrën e ndryshme të interpretimit të ligjit nga gjykatat për çështje të ngjashme. Pabarazia përpara ligjit ndodh vetëm nëse individët që janë në kushte të ngjashme trajtohen në mënyra të ndryshme. Ndërkohë, kërkuesit pretendojnë se pabarazia ka ardhur për shkak të interpretimit të ligjit nga gjykatat për çështje të ngjashme. Çdo çështje gjyqësore ka karakteristika të veçanta dhe gjykatat kanë lirinë për të interpretuar ligjin në përputhje me faktet dhe argumentet që paraqiten për secilin rast.

10.2.2. Pavarësisht se rregullorja nr. 53/2009 nuk ka qenë e botuar në Fletoren Zyrtare në kohën e ndodhjes së aksidentit (13.03.2011), në momentin që kjo çështje i është nënshtruar hetimit gjyqësor në shkallë të parë, kjo rregullore rezulton të ketë hyrë në fuqi (botuar në Fletoren Zyrtare nr. 180, dhjetor 2011) dhe ka pasur fuqi të plotë për t'u zbatuar nga gjykata si akt nënligjor. Fakti i mosbotimit të kësaj rregulloreje në Fletoren Zyrtare në kohën e aksidentit, nuk e ndalon gjykatën ta zbatojë atë, si një akt nënligjor i dalë në zbatim të ligjit nr. 10076/2009 (*shih vendimin nr. 6, datë 17.02.2002 të Gjykatës Kushtetuese*). I njëjti qëndrim është mbajtur edhe nga praktika e Gjykatës së Lartë.

10.2.3. Rregullorja nr. 53/2009 nuk përcakton apriori vlerën që përfiton i dëmtuari, por përcakton mënyrën se si duhet të kryhet trajtimi dhe përllogaritja e dëmit, e cila është e ndryshme në varësi të kritereve përkatëse të përmendura objektive, siç mund të jenë të ardhurat, përbërja familjare etj. dhe ky fakt nuk përbën tejkalim të tagrave të dhëna nga ligji, për sa kohë është miratuar nga vetë organi kompetent (AMF-ja) për të garantuar mbrojtjen e palës së dëmtuar. Për sa i takon pretendimit se cenohet barazia përpara ligjit për shkak të dëmshpërblimeve të ndryshme që përfitojnë të dëmtuar të ndryshëm, në rastin konkret nuk jemi përpara dy subjekteve të barabarta prej nga rrjedh normimi i ndryshëm. Rregullorja përcakton kriteret dhe metodologjinë, ndaj dëmshpërblimet mund të ndryshojnë në varësi të disa kritereve (lloji i dëmit, pasojat shëndetësore, mosha etj.) dhe si pasojë individë që ndodhen në situata të ngjashme mund të marrin dëmshpërblime të ndryshme.

10.2.4. Parashikimi ligjor i rregullores nr. 53/2009, si legjislacion i posaçëm, ka përparësi në raport me legjislacionin e përgjithshëm. Për rrjedhojë, edhe gjykatat i janë referuar në mënyrë të drejtë nenit 14, pikës 1, shkronjës "e", të rregullores nr. 53/2009. Kjo për arsye se i mituri (e ndjera në rastin konkret), për shkak të moshës e ndalimit ligjor për të punuar, pra pamundësisë për të krijuar të ardhura të ligjshme, nuk mund të ngarkohej me detyrime për ushqim kundrejt të afërmve të saj. Shuma fikse e përcaktuar tek rregullorja

është një mekanizëm që siguron mbrojtje dhe mbështetje për prindërit që kanë humbur jetën e fëmijës së tyre, duke marrë parasysh faktin se i mituri nuk ka mundësi të krijojë të ardhura.

10.2.5. Pretendimi i kërkuesve se rregullorja nr. 53/2009 është në kundërshtim me praktikën unifikuese të Gjykatës së Lartë, ka të bëjë me çështje të interpretimit të ligjit dhe nuk hyn në juridiksionin kushtetues, por në atë të gjykatave të zakonshme dhe është zgjidhur nga shumë vendime të ngjashme të Gjykatës së Lartë.

11. ***Subjekti i interesuar, AMF-ja***, në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar si vijon:

11.1. *Për rregulloren nr. 53/2009:*

11.1.1. Si bazë juridike për nxjerrjen e rregullores nr. 53/2009 ka shërbyer neni 13, pika 1, i ligjit nr. 10076/2009. Ky i fundit është shfuqizuar me ligjin nr. 32/2021, në bazë të të cilit ka dalë edhe rregullorja "Për përcaktimin e rregullave dhe metodologjisë së llogaritjes së dëmshpërblimit që mbulohet nga kontrata e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit", miratuar me vendimin e Bordit të AMF-së nr. 125, datë 28.07.2021. Në këto kushte, neni 13, pika 1, i ligjit nr. 10076 dhe rregullorja nr. 53/2009 nuk mund të zbatohen më nga subjektet e së drejtës të cilave u drejtohen dhe nuk janë më pjesë e rendit juridik, për rrjedhojë nuk mund t'i nënshtrohen kontrollit kushtetues. Kërkuesit kanë pretenduar se rregullorja nr. 53/2009 është në tejkalim të përcaktimeve ligjore, duke pretenduar mospërputhje ndërmjet rregullores dhe ligjit dhe në asnjë moment nuk argumentojnë se me cilin nen të Kushtetutës bie ndesh rregullorja ose dhe vetë ligji. Për rrjedhojë, kjo çështje hyn në juridiksionin e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm.

11.2. Rregullorja nr. 53/2009 është botuar në Fletoren Zyrtare dhe referuar jurisprudencës kushtetuese ky akt nënligjor në bazë të Kushtetutës ka marrë fuqi juridike. Rregullorja nr. 53/2009 ka dalë në bazë dhe për zbatim të nenit 13, pika 1, të ligjit nr. 10076/2009. Vetë ligji nr. 10076/2009 ka autorizuar miratimin e këtij akti nënligjor, duke përcaktuar organin kompetent që ngarkohet për nxjerrjen e tij, si dhe çështjet që do trajtohen në të. Rregullorja nr.

53/2009 në asnjë moment nuk i ka tejkaluar tagrat e dhëna nga ligji nr. 10076/2009. Efektet juridike të nenit 13, pikës 1, të ligjit nr. 10076/2009 kanë përfunduar me nxjerrjen e rregullores nr. 53/2009. Po ashtu, rregullorja nr. 53/2009 nuk përcakton apriori vlerën që përfiton i dëmtuari, por përcakton mënyrën sesi duhet të kryhet trajtimi dhe përllogaritja e dëmit, e cila është e ndryshme në varësi të faktorëve, siç janë të ardhurat personale, të ardhurat për vetë nevojat e personit, përbërja familjare etj. Termi "trajtim" i përdorur në rregullore përfshin edhe termin "vlerësim". Kjo bazuar edhe në Fjalorin e Gjuhës Shqipe, sipas të cilit "trajtim" do të thotë shtjellim i një çështjeje në mënyrë të caktuar, duke i dhënë një zgjidhje të caktuar.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkuesve

12. Çështja e legjitimimit (*locus standi*) është vlerësuar nga Gjykata si një ndër aspektet kryesore që lidhen me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas nenit 131, pika 1, shkronja "f", nenit 134, pika 1, shkronja "i" dhe nenit 134, pika 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, shterimin e mjeteve juridike, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

13. Për sa i përket legjitimimit *ratione personae*, Gjykata vëren se kërkuesit, në cilësinë e trashëgimtarëve ligjorë të së ndjerës E.E. (prindërit dhe motra e viktimës të mitur) që ka humbur jetën në aksidentin automobilistik, kanë ngritur padi në gjykatat e zakonshme për të kërkuar dëmshpërblim nga aksidenti, proces i cili ka përfunduar me mospranimin e rekursit të tyre nga Gjykata e Lartë. Për rrjedhojë, ata justifikojnë interesin në çështjen kushtetuese të parashtruar në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës.

14. Në lidhje me *shterimin e mjeteve juridike efektive*, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës, Gjykata vëren se kërkuesit i janë drejtuar asaj me ankim kushtetues individual pas përfundimit të procesit gjyqësor në të tria shkallët e gjyqësorit të zakonshëm dhe pasi kanë shteruar në formë e substancë mjetet e zakonshme të ankimit ndaj vendimeve të gjykatave më të ulëta. Për rrjedhojë, ata nuk kanë mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese përveç paraqitjes së ankimit kushtetues individual.

15. Për sa i takon legjitimimit *ratione temporis*, bazuar në nenin 71/a, pika 1, shkronja "b", të ligjit nr. 8577/2000, afati për paraqitjen e ankimit kushtetues individual është 4 muaj nga konstatimi i cenimit të së drejtës. Gjykata është shprehur se në rastin kur ankimi ka të bëjë me një vendim të Gjykatës së Lartë, data e marrjes dijeni konsiderohet data në të cilën vendimi i arsyetuar bëhet i disponueshëm për palët përmes depozitimit të tij në sekretarinë gjyqësore dhe publikimit në faqen zyrtare (*shih vendimin nr. 42, datë 19.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Gjykata konstaton se vendimi i Gjykatës së Lartë mban datën 05.06.2024, ndërsa kërkesa është paraqitur në datën 05.11.2024. Gjykata e Lartë, me shkresën nr. 4550/1 prot., datë 24.09.2024, ka informuar përfaqësuesin ligjor të kërkuesve se vendimi është publikuar në faqen zyrtare të saj në datën 08.07.2024. Duke iu referuar kësaj date si momenti i konstatimit të cenimit të të drejtave themelore, rezulton se ankimi kushtetues individual është paraqitur brenda afatit 4-mujor, rrjedhimisht kërkuesit legjitimohen edhe *ratione temporis*.

17. Në drejtim të legjitimimit *ratione materiae*, kërkuesit kanë pretenduar se Gjykata e Lartë nuk e ka pranuar kërkesën e tyre për njësim të praktikës gjyqësore dhe se u janë cenuar parimet e sigurisë juridike dhe pritshmërive të ligjshme, barazisë përpara ligjit dhe mosdiskriminimit, hierarkisë së akteve dhe rezervës ligjore, si dhe neni 17 i Kushtetutës.

18. Për sa i përket pretendimit për cenimin e *parimit të barazisë para ligjit dhe mosdiskriminimit*, kërkuesit e kanë atë mbështetur në disa argumente, një pjesë e të cilave lidhet me mënyrën e përllogaritjes së masës së dëmshpërblimit, ndërsa pjesa tjetër e argumenteve lidhet me faktin se gjykatat kanë vepruar në mënyra të ndryshme nga rastet e tjera. Subjektet e interesuara kanë prapësuar se këto pretendime të kërkuesve nuk qëndrojnë, pasi nuk mund të pretendohet cenimi i parimit të barazisë përpara ligjit, për mënyrën e ndryshme të interpretimit të ligjit nga gjykatat për çështje të ngjashme. Sipas subjekteve të interesuara,

pretendimet e kërkuesve në këtë drejtim kanë të bëjnë me çështje të interpretimit të ligjit, të cilat nuk hyjnë në juridiksionin kushtetues, por në atë të gjykatave të zakonshme.

19. Gjykata thekson se mënyra e zbatimit të ligjit është një çështje që përfshihet brenda juridiksionit të gjykatave të zakonshme, të cilat kanë detyrën e interpretimit të ligjit për qëllim të procesit gjyqësor që ato zhvillojnë (*shih vendimet nr. 33, datë 14.11.2022; nr. 3, datë 23.02.2016; nr. 42, datë 07.07.2014 të Gjykatës Kushtetuese*). Nga ana tjetër, Gjykata konstaton se kërkuesit nuk kanë konkretizuar se cilat janë rastet e ngjashme në të cilat gjykatat e zakonshme megjithëse gjendeshin përpara rrethanave dhe fakteve të njëjta kanë mbajtur qëndrime të ndryshme. Në këtë pikë, Gjykata vë në dukje se edhe nëse prezumohet se gjykatat e zakonshme kanë vendosur ndryshe në një rast të ngjashëm, kjo në vetvete nuk mund të mbështesë *a priori* pretendimin për shkeljen e parimit të barazisë para ligjit, pasi mënyra e zgjidhjes së çështjes dhe e zbatimit të ligjit është e drejtë e çdo gjykate, për sa kohë çdo çështje konkrete është specifike dhe ka individualitetin e saj, harmonizuar edhe me rrethana, faktorë, motive ose prova gjyqësore, të cilat nuk mund të jenë të njëjta (*shih vendimet nr. 19, datë 21.03.2024; nr. 17, datë 23.03.2023 të Gjykatës Kushtetuese*). Nën këtë analizë, Gjykata vlerëson se argumentet e kërkuesve në mbështetje të pretendimit për cenimin e *parimit të barazisë para ligjit dhe mosdiskriminimit* nuk qëndrojnë, ndaj ky pretendim nuk mund të merret në shqyrtim.

20. Po në drejtim të legjitimimit *ratione materiae*, Gjykata konstaton se pavarësisht se kërkuesit kanë dy kërkime në objektin e kërkesës (shfuqizimin e vendimeve gjyqësore dhe rregullores nr. 53/2009), në thelb, argumentet e tyre të sjella për kundërshtimin e rregullores nr. 53/2009 lidhen me vendimmarrjen e gjykatave të zakonshme që kanë zbatuar atë akt për zgjidhjen e mosmarrëveshjes konkrete, edhe pse sipas kërkuesve ai akt jo vetëm që nuk është i zbatueshëm, pasi nuk ishte botuar në Fletoren Zyrtare në momentin e ngjarjes, por madje bie ndesh me parashikimet e ligjit nr. 10076/2009 dhe dispozitat e KC-së të interpretuara me vendimin unifikues nr. 12 të vitit 2007 nga Gjykata e Lartë. Për rrjedhojë, duke qenë të ndërlidhura këto kërkime, fillimisht ato do të trajtohen në drejtim të mënyrës sesi kanë vepruar gjykatat e zakonshme në rastin konkret në drejtim të identifikimit të ligjit të zbatueshëm në përputhje me parimet e së drejtës dhe në drejtim të mënyrës sesi kanë argumentuar dhe arsyetuar çështjen konkrete në shqyrtim. Në varësi të përfundimit të këtij vlerësimi, Gjykata

më pas do të vlerësojë edhe pretendimet e kërkuesve për kundërshtimin e rregullores nr. 53/2009.

21. Për sa më lart, Gjykata në vijim do ta analizojë çështjen në drejtim të së drejtës së aksesit substancial lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor. Po kështu, pavarësisht se kërkuesit kanë kundërshtuar për shkaqet e mësipërme edhe vendimet e gjykatës së shkallës së parë dhe gjykatës së apelit, duke pasur parasysh jo vetëm natyrën e pretendimeve, por edhe pozicionin e Gjykatës së Lartë dhe funksionin e saj si gjykatë ligji, në ushtrimin e të cilit ajo kontrollon jo vetëm mënyrën e zbatimit të ligjit material dhe procedural nga ana e gjykatave më të ulëta, por edhe respektimin e standardeve kushtetuese për proces të rregullt, për shkak të natyrës subsidiare të kontrollit kushtetues, Gjykata vlerëson të analizojë çështjen në këndvështrim të mënyrës si Gjykata e Lartë ka vepruar në rastin konkret në drejtim të së drejtës së kërkuesve për proces të rregullt, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e së drejtës së aksesit substancial të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor

22. Kërkuesit kanë pretenduar, në thelb, se kërkesa e tyre për njësimin e praktikës gjyqësore nuk citohet në vendimin e Kolegjit Civil dhe as është marrë parasysh prej tij, madje nga verifikimi i dosjes gjyqësore rezulton se kjo kërkesë nuk është administruar në fashikullin gjyqësor. Sipas kërkuesve, kjo përbën shkelje procedurale, pasi Gjykata e Lartë duhej të ishte shprehur me vendim në lidhje me këtë kërkesë. Po ashtu, kërkuesit kanë pretenduar se gjykatat e kanë llogaritur dëmin e shkaktuar atyre bazuar në përcaktimet e rregullores nr. 53/2009, e cila nuk ka qenë e botuar në Fletoren Zyrtare në momentin e shkaktimit të tij. Sipas kërkuesve, dëmshpërblimi duhej llogaritur sipas vendimit unifikues nr. 12/2007 të Gjykatës së Lartë dhe parashikimeve të KC-së, duke qenë se në kohën e ngjarjes rregullorja nr. 53/2009 nuk kishte hyrë ende në fuqi. Si pasojë, kërkuesit kanë pretenduar se atyre u janë cenuar interesat, pasi masa e dëmshpërblimit është zvogëluar.

23. Subjekti i interesuar, BSHS-ja, ka prapësuar se pavarësisht se rregullorja nr. 53/2009 nuk ka qenë e botuar në Fletoren Zyrtare në kohën e ndodhjes së aksidentit (13.03.2011), në momentin që kjo çështje i është nënshtruar hetimit gjyqësor në shkallë të parë, ky akt rezulton të ketë hyrë në fuqi (botuar në Fletoren Zyrtare nr. 180, dhjetor 2011) dhe ka pasur fuqi të plotë për t'u zbatuar nga gjykata si akt nënligjor. Fakti i

mosbotimit të kësaj rregulloreje në Fletoren Zyrtare në kohën e aksidentit, nuk e ndalon gjykatën ta zbatojë atë, si një akt nënligjor i dalë në zbatim të ligjit nr. 10076/2009, qëndrim i mbajtur edhe nga Gjykata me vendimin nr. 6, datë 17.02.2002. Sipas BSHS-së, parashikimi ligjor i rregullores nr. 53/2009, si legjislacion i posaçëm, ka përparësi në raport me legjislacionin e përgjithshëm, ndaj edhe gjykatat i janë referuar në mënyrë të drejtë nenit 14, pikës 1, shkronjës "e", të saj.

24. Gjykata ka theksuar se e drejta e aksesit nuk përfshin vetëm të drejtën për të filluar një proces, por edhe të drejtën për të pasur, nga ana e gjykatës, një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pasi aksesi në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal (*shih vendimet nr. 32, datë 03.11.2022; nr. 5, datë 22.02.2022; nr. 22, datë 29.04.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

25. Po ashtu, Gjykata ka theksuar se e drejta për proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, funksioni i të cilit është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë (*shih vendimet nr. 33, datë 30.05.2023; nr. 11, datë 10.03.2023 të Gjykatës Kushtetuese*). Po në këtë drejtim, Gjykata është shprehur se vendimet e mospranimit të rekursit të Gjykatës së Lartë mund të arsyetohen në mënyrë të kufizuar, me kusht që në pjesën hyrëse të listohen shkaqet e rekursit. Arsyetimi i kufizuar nuk cenon standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor, përderisa në thelb shpreh shkaqet e mospranimit të rekursit (*shih vendimet nr. 10, datë 07.03.2023; nr. 21, datë 16.04.2015; nr. 37, datë 19.09.2011 të Gjykatës Kushtetuese*). Megjithatë, kur në rekurs janë ngritur pretendime të natyrës kushtetuese, Gjykata e Lartë, bazuar në natyrën e gjykimit kushtetues të kërkesave individuale, si dhe në parimin e subsidiaritetit që udhëheq raportet ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme, duhet të mbajë një qëndrim të shprehur lidhur me to *(shih vendimet nr. 16, datë 12.03.2024; nr. 29, datë 01.11.2022; nr. 19, datë 07.07.2022 të Gjykatës Kushtetuese)*.

26. Nga ana tjetër, Gjykata ripohon se është detyra e saj të shqyrtojë dhe vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës (*shih vendimin nr. 33, datë 14.11.2022 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata nuk vepron si shkallë e katërt gjykimi, por ajo ndërhyn atëherë kur gabimi ligjor ose faktik nga gjykatat e

juridiksionit të zakonshëm është aq i dukshëm, sa një gjykatë e arsyeshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose është i tillë që gjykimin e bën të padrejtë *(shih vendimet nr. 3, datë 21.01.2025; nr. 59, datë 14.11.2023; nr. 29, datë 01.11.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

27. Mbi bazën e standardeve të mësipërme, Gjykata do të verifikojë nëse kërkuesit kanë marrë përgjigje përfundimtare për pretendimin lidhur me ligjin e zbatueshëm në llogaritjen e shpërblimit të dëmit dhe nëse gjykatat e zakonshme kanë identifikuar ligjin e zbatueshëm pa gabime ligjore të dukshme, duke shqyrtuar më pas nëse rekursi i kërkuesve përmban pretendime me natyrë kushtetuese dhe nëse vendimi i mospranimit të rekursit të Gjykatës së Lartë është në përputhje me standardet kushtetuese të arsyetimit.

28. Gjykata vëren se kërkuesit e kanë nisur procesin gjyqësor për shpërblimin e dëmit nga aksidenti, duke ngritur në të gjitha aktet procedurale (padi, apel dhe rekurs) pretendimin për moszbatimin e rregullores nr. 53/2009, me argumentin se ai ishte një akt që në momentin e ndodhjes së aksidentit nuk kishte hyrë në fuqi, pasi nuk ishte botuar në Fletoren Zyrtare. Lidhur me këtë, gjykata e shkallës së parë ka argumentuar se ngjarja ka ndodhur në datën 13.03.2011, kohë në të cilën ligji nr. 10076/2009 ka qenë në fuqi dhe në zbatim të tij është miratuar edhe rregullorja nr. 53/2009. Kjo e fundit, krahas parashikimeve të përgjithshme të ligjit, i ka shërbyer gjykatës për detajimin e hollësishëm të figurave të dëmit të pësuar në këtë gjykim. Pra, si referim ligjor krahas rregullimeve të përcaktuara në mënyrë eksplicite në ligjin nr. 10076/2009, gjykata e shkallës së parë i referohet për interpretim edhe rregullores nr. 53/2009 të AMF-së, për aq sa ky akt rregullon kriteret e figurave konkrete të dëmit, në mungesë të rregullimeve të bëra nga ligji organik. Në këtë kuptim, lidhur me formulën e llogaritjes së dëmshpërblimeve sipas parashikimeve të këtij akti (rregullores nr. 53/2009), gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar fillimisht dëmin pasuror, duke iu referuar kreut III të saj dhe në vijim neneve 12 dhe 14, pika 1/e, si parashikime të posaçme në raport me parashikimin e bërë në nenin 646 të KC-së. Edhe lidhur me përcaktimin e dëmit jopasuror, gjykata e shkallës së parë ka përllogaritur dëmin biologjik, moral dhe atë ekzistencial bazuar në rregulloren nr. 53/2009 (*shih faqet 6-10 të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë*).

29. Arsyetimi i gjykatës së shkallës së parë për këtë çështje është gjetur i drejtë nga Gjykata e Apelit Tiranë, e cila ka vlerësuar se gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se ligji nr. 10076/2009, si legjislacioni i posaçëm që rregullon në mënyrë specifike rastet e sigurimit të detyrueshëm

në fushën e transportit, lidhur me metodën për përllogaritjen e vlerave të dëmshpërblimit për secilën figurë dëmi, ka autorizuar AMF-në për të miratuar rregulla për trajtimin e dëmeve, e cila, për këtë qëllim, ka miratuar rregulloren nr. 53/2009, të botuar në Fletoren Zyrtare nr. 180, datë 25.01.2012. Sipas gjykatës së apelit, në nenin 51/1 të kësaj rregulloreje përcaktohet se dosjet e dëmeve, ngjarja e të cilave ka ndodhur pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 10076/2009 dhe janë në proces trajtimi nga shoqëria e sigurimit dhe BSHS-ja në datën e hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, trajtohen sipas parashikimeve të saj, ndaj ka vlerësuar se gjykata e shkallës së parë, me të drejtë, ka pranuar vlerat e dëmit të llogaritura nga eksperti vlerësues sipas rregullores, përderisa ajo përbën një rregullim të posaçëm të dëmeve në fushën e transportit, duke pasur përparësi në zbatim në raport me rregullimet e legjislacionit të përgjithshëm (*shih faqet 8 dhe 9 të vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë*).

30. Ndonëse kërkuesit kanë ushtruar rekurs, duke parashtruar edhe shkakun që lidhej me (mos)hyrjen në fuqi të rregullores nr. 53/2009, Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e tij, duke vlerësuar se shkaqet e parashtruara në të nuk bënin pjesë në ato të parashikuara në nenin 472 të KPC-së. Sipas Kolegjit Civil gjykata e apelit ka interpretuar dhe zbatuar drejt ligjin (material dhe atë procedural) që ka shërbyer për zgjidhjen e mosmarrëveshjes; ka arsyetuar në mënyrë ezauruese shkakun e vendimmarrjes; nuk ka shkelur dispozitat për juridiksionin dhe kompetencën lëndore, funksionale dhe as tokësore ekskluzive; përbërja e trupit gjykues ka qenë në rregull dhe nuk ka pasur shkaqe papajtueshmërie; nuk ka vendosur pushimin e çështjes në rastin konkret; çështja është shqyrtuar në prani të palëve ndërgjyqëse dhe nuk konstatohen shkelje lidhur me procesin e njoftimit të tyre; hetimi gjyqësor është shtrirë në të gjitha objektet e kërkimit e pa i tejkaluar ato; nuk konstatohen akte të pavlefshme procedurale të një rëndësie të atillë që të kenë ndikuar në dhënien e vendimit (*shih paragrafët 17-19 të vendimit të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë*)

31. Gjykata konstaton se në rekursin e tyre kërkuesit kanë ngritur pretendime për sa i përket identifikimit dhe zbatimit nga gjykata e apelit të ligjit të zbatueshëm të lidhur me momentin e lindjes së marrëdhënies juridiko-civile për shkak të së cilës është krijuar mosmarrëveshja mes palëve, si dhe me momentin e hyrjes në fuqi të aktit nënligjor dhe efektet juridike të tij, konkretisht për zbatimin me fuqi prapavepruese të rregullores nr. 53/2009 të AMF-së, pretendime të cilat, në thelb, kanë të bëjnë me parimet e sigurisë juridike dhe të hierarkisë së akteve, ashtu sikundër edhe

me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor, që kanë natyrë kushtetuese. Megjithatë, Gjykata e Lartë, duke vendosur mospranimin e rekursit, nuk u ka dhënë përgjigje këtyre pretendimeve të kërkuesve, për më tepër kur ajo është ndodhur përpara vendimit të gjykatës së apelit, e cila duket se nuk i ka dhënë përgjigje shteruese pretendimit të ngritur në gjykim nga kërkuesit në këtë drejtim dhe të pranuar nga gjykata e shkallës së parë. Edhe pse kjo, në vlerësimin e Gjykatës, nuk sjell *a priori* cenim të së drejtës për proces të rregullt, mënyra se si kanë vepruar gjykatat, në rastin konkret, ka sjellë edhe një mënyrë të ndryshme analize dhe vlerësimi ligjor të çështjes nga ana e tyre, çka impononte për Gjykatën e Lartë ushtrimin e rolit të saj si gjykatë e ligjit për të verifikuar pikërisht mënyrën e zbatimit të ligjit nga gjykatat më të ulëta. Ajo gjykatë ka disponuar sipas nenit 480 (shkronja "a") të KPC-së, që përcakton se mospranimi i rekursit bëhet për shkaqe të ndryshme nga ato që lejon ligji, por pa treguar se përse shkaqet e ngritura në rekursin e kërkuesve nuk përfshihen në ato të parashikuara nga neni 472 i KPC-së, sipas përmbajtjes së tij në kohën e depozitimit të rekursit ose përse ato shkaqe nuk gjejnë mbështetje në aktet e dosjes gjyqësore, duke qenë kështu haptazi të pabazuara. Po kështu, Gjykata e Lartë ka vlerësuar edhe se gjykata e apelit ka respektuar ligjin material, duke e interpretuar dhe zbatuar drejt atë, megjithëse si ajo, ashtu edhe gjykata e shkallës së parë duket se kanë mbajtur një qëndrim formalist dhe pa shteruar në substancë qartësisht pretendimin kyç të kërkuesve që lidhej me zbatueshmërinë e një akti që sipas tyre nuk ishte në fuqi në kohën e ngjarjes.

32. Gjykata ka vënë në dukje edhe më parë se në rastet e shpërblimit të dëmit nga aksidentet, çështjet e veprimit të ligjit në kohë ose të vendosjes respektive hierarkike të normave në konflikt hyjnë në sferën e kompetencës së gjykatave të zakonshme. Dyshimet në lidhje me veprimin në kohë të normave juridike duhet të zgjidhen nga gjykatat e zakonshme, bazuar në parashikimet kushtetuese që përcaktojnë momentin e hyrjes në fuqi të tyre (neni 117 i Kushtetutës), si edhe bazuar në parimin kushtetues të hierarkisë së akteve ligjore (nenet 4 dhe 116 të Kushtetutës), nga të cilat burojnë edhe parimet ku bazohen gjykatat për përcaktimin e ligjit të zbatueshëm në rast të përplasjeve mes normave me fuqi të njëjtë ose të ndryshme juridike (*shih vendimin nr. 82, datë 26.11.2024 të Gjykatës Kushtetuese*).

33. Po kështu, Gjykata risjell në vëmendje se vetëm një vendim i arsyetuar i jep asaj mundësinë të vlerësojë nëse gjykatat e zakonshme kanë marrë në shqyrtim pretendimet kryesore të palëve dhe mënyrën se si i kanë trajtuar ato. Veçanërisht kur bëhet fjalë për pretendime me natyrë kushtetuese, në

kuadër të parimit të subsidiaritetit që udhëheq raportet ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të zakonshëm gjyqësor, mungesa e arsyetimit të Gjykatës së Lartë e vë në vështirësi/pamundësi Gjykatën për të vlerësuar nëse ajo i ka marrë në shqyrtim dhe nëse i ka vlerësuar ato pretendime (*shih vendimin nr. 82, datë 26.11.2024 të Gjykatës Kushtetuese*).

34. Nisur nga sa më lart, Gjykata çmon se Gjykata e Lartë, në ushtrim të funksionit të saj, duhej të kishte mbajtur një qëndrim të shprehur në drejtim të ligjit të zbatueshëm, në përputhje edhe me parimet kushtetuese dhe praktikën e kësaj Gjykate, ashtu edhe në drejtim të bazueshmërisë në themel të shkaqeve të rekursit që kishin të bënin me aspekte kushtetuese të procesit gjyqësor. Kjo me qëllim që kërkuesit të merrnin një përgjigje për sa i takon zbatueshmërisë së ligjit në zgjidhjen e mosmarrëveshjes së tyre objekt shqyrtimi. Në këto kushte, në kontekst të rrethanave të rastit konkret, mospranimi i rekursit të kërkuesve nga Gjykata e Lartë, duke u mjaftuar vetëm me parashtrimin në vendim të shkaqeve të rekursit dhe me arsyetimin *de plano* se këto shkaqe nuk janë nga ato të parashikuara nga ligji, pa u dhënë përgjigje të arsyetuar pretendimeve me natyrë kushtetuese, të çon në përfundimin se zbatimi i ligjit nga ajo është haptazi i paarsyeshëm dhe vë në dyshim të drejtën e procesit të rregullt ligjor në aspektin e arsyetimit të vendimit gjyqësor.

35. Në përmbledhje të argumenteve të mësipërme, Gjykata çmon se pretendimi i kërkuesve për cenimin e të drejtës së aksesit lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor nga Gjykata e Lartë është i bazuar, ndaj ky vendim duhet të shfuqizohet dhe çështja të dërgohet për rishqyrtim[1].

36. Në përfundim, Gjykata vlerëson se kërkesa e kërkuesve duhet të pranohet sipas arsyetimit të mësipërm të këtij vendimi.

37. Ndërsa për sa i përket kërkimit tjetër të kërkuesve për shfuqizimin e Rregullores nr. 53/2009, duke qenë se çështja e tyre do rigjykohet nga

[1] Gjyqtarja Fiona Papajorgji është shprehur kundër qëndrimit të shumicës për pranimin e kërkesës, pasi ka vlerësuar se kërkesa duhej të ishte rrëzuar, mbështetur në të njëjtat argumente të shprehura në mendimin e saj të pakicës bashkëlidhur vendimit nr. 82, datë 26.11.2024 të Gjykatës. Sipas gjyqtares në pakicë, kërkuesit kanë ushtruar të drejtën e tyre të paraqitjes së padisë/ankimit/rekursit, ku përmes një procesi gjyqësor, që ka analizuar themelin e çështjes, me vendim përfundimtar kanë marrë përgjigje të arsyetuar për të gjitha pretendimet e tyre, në veçanti për masën e dëmshpërblimit që u takonte sipas ligjit të zbatueshëm për zgjidhjen e mosmarrëveshjes konkrete. Po kështu, Gjykata e Lartë ka vepruar brenda rolit dhe funksionit të saj kushtetues për interpretimin e ligjit. Në këto rrethana, pretendimi i kërkuesve për cenimin e së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsyetimit është i pabazuar.

Gjykata e Lartë, e cila do të vendosë edhe për ligjin e zbatueshëm në zgjidhjen e mosmarrëveshjes së tyre objekt shqyrtimi dhe, për rrjedhojë nëse ai akt, që është objekt i këtij ankimi kushtetues, zbatohet në rastin e kërkuesve, Gjykata vlerëson të mos ndalet në shqyrtimin e këtij kërkimi, i cili duhet të shqyrtohet nga Gjykata e Lartë[2].

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, si dhe neneve 71 dhe 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me shumicë votash,

V E N D O S I:

1. Pranimin pjesërisht të kërkesës.

2. Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2024-2568, datë 05.06.2024 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

3. Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 02.05.2025
Shpallur më 03.06.2025

[2] Gjyqtarët Genti Ibrahimi dhe Marjana Semini, duke mbajtur parasysh natyrën e rregullores nr. 53/2009 si një akt me karakter normativ, si dhe pretendimet e kërkuesve që kanë të bëjnë me parimin e zbatimit në kohë të këtij akti, si përcaktues i ligjit të zbatueshëm për zgjidhjen e çështjes konkrete, që, si të tilla, përbëjnë pretendime me natyrë kushtetuese, mbajtën qëndrimin se Gjykata duhet të shprehej për zbatueshmërinë e këtij akti në çështjen e kërkuesve, për rrjedhojë, nëse arrinte në një përfundim të tillë, do të duhej të shqyrtonte edhe vetë kushtetutshmërinë e rregullores nr. 53/2009.

Ndërsa, gjyqtarja Fiona Papajorgji mbajti qëndrimin se rregullorja e AMF-së nr. 53/2009 ka gjetur zbatim në rastin konkret, çka përligj interesin e kërkuesit për të kërkuar shfuqizimin e saj. Gjithsesi, përderisa gjyqtarja në pakicë nuk gjeti shkelje të të drejtave kushtetuese në procesin gjyqësor të kundërshtuar nuk vlerëson të ndalet më tej në analizën e pretendimeve për kushtetutshmërinë e rregullores.

Vendim nr. 32, datë 19.05.2025
(V-32/25)

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Holta Zaçaj, Kryetare, Marsida Xhaferllari, Fiona Papajorgji, Sonila Bejtja, Sandër Beci, Ilir Toska, Genti Ibrahimi, Marjana Semini, anëtarë, me sekretare Belma Lleshi, në datën 13.05.2025 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 10 (L) 2024 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: **LUAN MUMAJESI, ISUF MUMAJESI, MAJLINDA MUMAJESI, ENVER MUMAJESI, PULLUMB MUMAJESI,** të përfaqësuar nga avokatët Virtyt Sokoli dhe Erjon Syziu, me prokurë të posaçme.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:
AVOKATURA E SHTETIT, përfaqësuar nga avokatet e shtetit Irma Qosja dhe Valbona Legisi
AGJENCIA E TRAJTIMIT TË PRONAVE, në mungesë,
PETRIT MUMAJESI, BESNIK MUMAJESI, FATBARDHA MUMAJESI, ARBEN MUMAJESI, në mungesë.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2024-1060 (115), datë 13.03.2024 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**
Kthimi i çështjes për rigjykim në Kolegjin Civil të Gjykatës së Lartë, me tjetër trup gjykues.

BAZA LIGJORE: **Nenet 4, 41, 42, 131, pika 1, shkronja "f", 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë *(Kushtetuta)*; nenet 6 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat**

e Njeriut dhe neni 1 i Protokollit nr. 1 të saj; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar *(ligji nr. 8577/2000)*.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Marjana Semini, mori në shqyrtim parashtrimet me shkrim të kërkuesve *(kërkuesit)* të cilët kanë kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar, Avokaturës së Shtetit, i cili ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, konstatoi mungesën e prapësimeve me shkrim nga subjektet e interesuara, Agjencia e Trajtimit të Pronave *(ATP)*, Petrit Mumajesi, Besnik Mumajesi, Fatbardha Mumajesi dhe Arben Mumajesi, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I
Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesit dhe subjektet e interesuara Petrit Mumajesi, Besnik Mumajesi, Fatbardha Mumajesi dhe Arben Mumajesi janë trashëgimtarët ligjorë të subjektit të shpronësuar I.B. Bazuar në parashikimet e ligjit nr. 9235, datë 27.09.2004 "Për kthimin dhe kompensimin e pronës", të ndryshuar *(ligji nr. 9235/2004),* kërkuesi Luan Mumajesi, në cilësinë e përfaqësuesit ligjor të trashëgimtarëve subjektit të shpronësuar, i është drejtuar organit shtetëror të ngarkuar nga ligji me një kërkesë për njohjen e së drejtës së pronës dhe kthimin e pronës së paluajtshme, tokë "truall", me sipërfaqe 12,450 m^2, të ndodhur në lagjen "Xhami Sherif" (10 Korriku), Tiranë, të shpronësuar në mënyrë të padrejtë nga shteti.

2. Me vendimin nr. 365, datë 19.12.2008 *(vendimi nr. 365/2008)*, Zyra Rajonale e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave *(ZRKKP)*, qarku Tiranë, ka njohur të drejtën e pronësisë së trashëgimtarëve ligjorë të subjektit të shpronësuar për pronën tokë "truall" 8.000 m^2, të drejtën e tyre të kompensimit për këtë sipërfaqe në një nga format e parashikuara nga neni 11 i ligjit nr. 9235/2004, si dhe të drejtën e parablerjes së objekteve brenda sipërfaqes së pronës, konkretisht të 5 bujtinave me sipërfaqet respektive.

3. Kundër vendimit të ZRKKP-së, Tiranë ka ushtruar ankim administrativ Avokatura e Shtetit (zyra vendore Tiranë), ndërsa kërkuesi Luan Mumajesi ka paraqitur kundërankim administrativ. Në zbatim të vendimit nr. 27, datë 26.05.2010 *(vendimi nr. 27/2010)* dhe në vijim edhe të vendimit nr. 43, datë 06.10.2011 *(vendimi nr. 43/2011)* të Gjykatës Kushtetuese *(Gjykata),* me të cilët u shfuqizuan ato dispozita të ligjit nr. 9235/2004, të cilat njihnin kompetencën e drejtorit të përgjithshëm të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave *(AKKP)* për shqyrtimin e ankimeve të Avokaturës së Shtetit ndaj vendimeve të zyrave rajonale në qarqe, me vendimin nr. 1492, datë 30.12.2011, drejtori i përgjithshëm i AKKP-së ka deklaruar mungesën e juridiksionit administrativ dhe të kompetencës së AKKP-së për shqyrtimin e ankimit të Avokaturës së Shtetit ndaj vendimit nr. 365/2008 të ZRKKP-së, Tiranë.

4. Në vijim, në mbështetje të nenit 5 të ligjit nr. 10018, datë 13.11.2008 "Për Avokaturën e Shtetit" *(ligji nr. 10018/2008)*, që njihte të drejtën e këtij institucioni për të përfaqësuar dhe mbrojtur interesat pasurorë të shtetit shqiptar përpara gjykatave vendase, si dhe të nenit 18 të ligjit nr. 9235/2004, që i njihte të drejtën për të bërë ankim në mbrojtje të këtyre interesave, Avokatura e Shtetit i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me kërkesëpadi ndaj AKKP-së dhe trashëgimtarëve të subjektit të shpronësuar, duke kërkuar anulimin e vendimit të ZRKKP-së, Tiranë, me pretendimin se ky vendim ishte në kundërshtim me ligjin, pasi nuk provohej që subjekti i shpronësuar të ketë pasur të drejtën e pronësisë deri në datën 29.11.1944 dhe që prona t'i jetë marrë padrejtësisht nga shteti pas kësaj date. Gjatë gjykimit të çështjes së regjistruar për këtë padi, kërkuesit së bashku me trashëgimtarët e tjerë të subjektit të shpronësuar kanë paraqitur kundërpadi ndaj Avokaturës së Shtetit dhe AKKP-së, duke kërkuar ndryshimin e të njëjtit vendim të ZRKKP-së, Tiranë dhe njohjen e së drejtës së pronësisë për sipërfaqen e përgjithshme të truallit prej 12.450 m^2, kthimin fizik të truallit të lirë dhe njohjen e së drejtës së parablerjes të objekteve shtetërore që ndodhen brenda kësaj sipërfaqeje kur ato të privatizohen, me pretendimin se e drejta e pronësisë së subjektit të shpronësuar shtrihej në një sipërfaqe me të madhe se ajo e njohur nga ZRKKP-ja, Tiranë.

5. Në përfundim të gjykimit, me vendimin nr. 5743, datë 12.05.2014, gjykata e rrethit ka vendosur rrëzimin e padisë së Avokaturës së Shtetit, pranimin e kundërpadisë të trashëgimtarëve të subjektit të shpronësuar, ndryshimin e vendimit të ZRKKP-së, Tiranë, njohjen pronarë të trashëgimtarëve të subjektit të shpronësuar I.B. për sipërfaqen "truall" prej 13.200 m^2, sipas kufizimeve përkatëse; kthimin atyre të sipërfaqeve 4.900

m^2 dhe 4.750 m^2, sipas aktit të ekspertimit dhe shtesës së tij; kompensimin e sipërfaqes 810 m^2 të zënë me rrugë kalimi; njohjen e së drejtës së parablerjes ose kompensimit në një nga format e parashikuara nga ligji nr. 9235/2004 për bujtinat me sipërfaqet respektive. Kundër këtij vendimi ka ushtruar ankim Avokatura e Shtetit, duke pretenduar, ndër të tjera, se kërkimi i kundërpadisë nuk kishte lidhje me atë të padisë e midis tyre nuk mund të bëhej kompensimi dhe se kundërpadia nuk mund të drejtohej ndaj saj, si subjekt procedural, pasi vendimi i kundërshtuar nuk ishte nxjerrë nga ajo.

6. Me vendimin nr. 1036, datë 05.05.2015, Gjykata e Apelit Tiranë ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së rrethit, duke e vlerësuar atë të drejtë dhe të bazuar në ligj. Ndaj këtij vendimi ka ushtruar rekurs Avokatura e Shtetit, duke parashtruar, krahas shqyrtimit nga gjykatat e ulëta të kundërpadisë së bashku me padinë, edhe se ajo nuk kishte asnjë tagër ligjor për t'u njohur dhe kthyer pronën kërkuesve, pasi këtë tagër e kishte vetëm AKKP-ja, ndaj kundërpadia nuk duhej të ishte drejtuar ndaj saj. Nga ana tjetër, trashëgimtarët e subjektit të shpronësuar kanë paraqitur kundërrekurs.

7. Me vendimin nr. 00-2024-1060 (115), datë 13.03.2024, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, bazuar në nenet 160, 299 dhe 485, pika 1, shkronja "a" dhe "dh", të Kodit të Procedurës Civile *(KPC)*, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së apelit për pjesën e rrëzimit të padisë së Avokaturës së Shtetit dhe prishjen e vendimeve të gjykatës së rrethit e të gjykatës së apelit, si dhe pushimin e gjykimit për kundërpadinë e trashëgimtarëve të subjektit të shpronësuar, me arsyetimin se gjykatat më të ulëta kanë gabuar kur kanë pranuar për shqyrtim kundërpadinë së bashku me padinë, në rrethanat kur nuk plotësohen kushtet dhe kriteret e nenit 160, pika 1, të KPC-së për marrjen në shqyrtim të kundërpadisë, e cila nuk mund të ngrihej në kuptim të nenit 299 të KPC-së, pasi nga pikëpamja formale nuk plotëson elementet përbërëse të një kundërpadie në kuptim të nenit 160 të KPC-së. Konkretisht, sipas saj, akti kundërpadi nuk i plotëson kushtet për të qenë i tillë si në drejtim të mungesës së legjitimimit formal procedural të Avokaturës së Shtetit, ashtu edhe të mungesës së kritereve lidhëse të objektit të padisë me atë të kundërpadisë, ndërkohë që mungesa e legjitimimit procedural formal të Avokaturës së Shtetit e bënte të pamundur ekzistencën e gjykimin si një padi më vete të kundërpadisë, e cila, për shkak të të metave të karakterit formal procedural të ndërtimit të ndërgjyqësisë fillestare, nuk plotëson as kushtet e një padie të pavarur.

8. Në datën 12.07.2024 kërkuesit i janë drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual, i cili pas plotësimit, sipas parashikimeve të nenit 27 të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 30.10.2024. Në datën 18.12.2024 Kolegji i Gjykatës ka vendosur kalimin e çështjes për diskutim në Mbledhjen e Gjyqtarëve. Kjo e fundit, në datën 27.01.2025, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

9. Gjykata vë në dukje se, në përputhje me nenin 32 të ligjit nr. 133/2015, datë 05.12.2015 "Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave", AKKP-ja është transformuar në ATP. Për këtë shkak, në tekstin e këtij vendimi, emërtimet e këtij institucioni janë përdorur në përkëmbim respektiv të njëri-tjetrit, duke iu referuar kohës kur janë kryer veprimet dhe janë marrë vendimet përkatëse.

II
Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

10. ***Kërkuesit***, në mënyrë të përmbledhur, kanë pretenduar se u janë cenuar:

10.1. *E drejta për proces të rregullt ligjor*, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të:

10.1.1. *Së drejtës së aksesit substancial*, si rrjedhojë e pushimit nga Gjykata e Lartë të gjykimit për kundërpadinë, ndonëse përdorimi i këtij mjeti juridik njihet nga ligji. Po kështu, Gjykata e Lartë nuk i ka dhënë përgjigje pretendimit kryesor të tyre që lidhet me të drejtën substanciale të pronës dhe nuk ka arsyetuar për ndërhyrjen në këtë të drejtë, në cenim të së drejtës së tyre për akses në këtë gjykatë.

10.1.2. *Standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor*, pasi: (i) Interpretimi që Gjykata e Lartë i ka bërë nenit 160 të KPC-së për ushtrimin e së drejtës së padisë në formën e kundërpadisë është arbitrar në këndvështrimin kushtetues. Paraqitja e kundërpadisë përbën një mjet të lejuar si nga dispozita ligjore, ashtu edhe nga praktika gjyqësore. Arsyetimi i Gjykatës së Lartë është kontradiktor, pasi pranon që kundërpadia mund të paraqitet si padi e veçantë, ndërkohë që në praktikë ajo do të ishte bashkuar gjithsesi në të njëjtin proces. Në kundërshtim nga sa Gjykata e Lartë arsyeton, Avokatura e Shtetit nuk është paraqitur në gjykim në cilësinë e përfaqësuesit të

AKKP-së, por si palë paditëse. Për këtë shkak, kundërpadia nuk i është drejtuar vetëm këtij organi, por edhe AKKP-së. Gjykata e Lartë duhet të kishte analizuar rolin e këtij organi si subjekt formal i së drejtës dhe si palë në një proces civil. (ii) Arsyetimi i Gjykatës së Lartë është i mangët, pasi ajo nuk është shprehur për shkakun kryesor të kundërpadisë dhe kundërrekursit, që lidhej me të drejtën substanciale të pronës. Ai është kontradiktor, pasi, nga njëra anë, pranon se kërkuesit kanë paraqitur kundërpadi ndaj AKKP-së, ndërsa, nga ana tjetër, shprehet se ata duhej të paraqisnin padi ndaj këtij organi dhe jo Avokaturës së Shtetit, çka e bën këtë vendim arbitrar në këndvështrimin kushtetues.

10.2. *E drejta e pronës,* e garantuar nga neni 41 i Kushtetutës, pasi duke disponuar për pushimin e gjykimit të kundërpadisë Gjykata e Lartë ka zhbërë një proces gjyqësor 12-vjeçar lidhur me të drejtën e tyre për të gëzuar dhe disponuar pronën e trashëguar dhe të drejtat reale në të, në cenim të *parimit të sigurisë juridike*. Përmes procesit administrativ e më pas atij gjyqësor ata kanë synuar rivendikimin e së drejtës së tyre të pronës, të fituar në një nga format e njohura nga Kushtetuta dhe ligji, konkretisht përmes vendimit të ZRKKP-së, Tiranë dhe vendimeve të gjykatave të shkallës së parë dhe të apelit. Gjykata e Lartë nuk është shprehur për pasojat e vendimmarrjes së saj në të drejtën substanciale të pronës dhe vendimi i kësaj gjykate e ka bërë të pamundur ushtrimin e plotë të tagrave të pronësisë, duke krijuar pasiguri juridike. Mënyra sesi Gjykata e Lartë ka interpretuar dispozitat procedurale që lidhen me kundërpadinë nuk përputhet me konceptin kushtetues të së drejtës së pronës. Qëndrimi i saj bie ndesh me vendimin unifikues nr. 24, datë 13.03.2002 të Kolegjeve të Bashkuara të saj *(vendimi unifikues nr. 24/2002)*.

11. ***Subjekti i interesuar*, Avokatura e Shtetit**, ka prapësuar:

A. Për juridiksionin

11.1. Gjykata nuk ka juridiksion për shqyrtimin e çështjes, pasi pretendimet e kërkuesve kanë të bëjnë me interpretimin dhe zbatimin e ligjit, çka nuk përfshihet në juridiksionin kushtetues.

B. Për themelin

11.2. Pretendimet për cenimin e *së drejtës së aksesit* janë të pabazuara, pasi kërkuesit nuk kanë parashtruar argumente konkrete në

mbështetje të tyre. Vendimi i Gjykatës së Lartë është marrë në bazë të parimeve të së drejtës civile dhe në respektim të dispozitave ligjore përkatëse. Padia është ngritur nga Avokatura e Shtetit bazuar në ligjin nr. 9235/2004, i cili njihte të drejtën e këtij institucioni për kundërshtimin e vendimeve të ZRKKP-ve në mbrojtje të interesave shtetërorë. Ushtrimi i së drejtës për ngritjen e padisë nuk e legjitimon atë si palë në proces, pasi Avokatura e Shtetit nuk është mbajtëse e ndonjë të drejte subjektive. Në padi AKKP-ja është thirrur prej saj në pozitë të kundërt procedurale.

11.3. Pretendimet për cenimin e *standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor* janë të pabazuara, pasi analiza dhe arsyetimi i Gjykatës së Lartë për vlerësimin e objektit të kundërpadisë janë ezaurues dhe të plotë, duke u dhënë përgjigje në mënyrë të argumentuar e me referenca ligjore pretendimeve të ngritura në kërkesë.

11.4. Edhe pretendimet për cenimin e *së drejtës së pronës* janë të pabazuara, pasi padia e Avokaturës së Shtetit për kundërshtimin e vendimit të ZRKKP-së është bërë në mbrojtje të së drejtës së pronës, sipas ligjit të posaçëm nr. 9235/2004 dhe jo në mbrojtje të së drejtës së saj të pronësisë ose si përfaqësuese e ZRKKP-së. Jurisprudenca kushtetuese ka pranuar se Avokatura e Shtetit gëzon vetëm të drejtën e përfaqësimit. Në rastin konkret, Avokatura e Shtetit nuk gëzon pozitën procedurale të bashkëndërgjyqësisë me AKKP-në. Interpretimi që Gjykata e Lartë i ka bërë ligjit në drejtim të dallimit që ekziston mes rolit të Avokaturës së Shtetit si mbrojtëse e interesit pasuror të shtetit dhe interesit të një institucioni shtetëror, palë në gjykim, është i drejtë.

12. ***Subjektet e interesuara, ATP-ja, Petrit Mumajesi, Besnik Mumajesi, Fatbardha Mumajesi dhe Arben Mumajesi,*** nuk kanë paraqitur prapësime me shkrim, edhe pse janë njoftuar rregullisht.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkuesve

13. Çështja e legjitimimit *(locus standi)* është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për

gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

14. Kërkuesit, si individë, legjitimohen *ratione personae,* bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, pasi kanë qenë palë në procesin gjyqësor ndaj të cilit kanë ngritur pretendime në këtë Gjykatë dhe kanë interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

15. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës, Gjykata vëren se kërkuesit i janë drejtuar asaj me ankim kushtetues individual, duke ngritur pretendime për procesin gjyqësor të zhvilluar në Gjykatën e Lartë, për të cilin nuk kanë mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të tyre kushtetuese përveç ankimit kushtetues individual.

16. Për sa i takon legjitimimit *ratione temporis,* bazuar në nenin 71/a, pika 1, shkronja "b", të ligjit nr. 8577/2000, afati për paraqitjen e ankimit kushtetues individual është 4 muaj nga konstatimi i cenimit të së drejtës. Në rastin konkret, Gjykata vëren se kërkuesit kanë kundërshtuar vendimin e Gjykatës së Lartë të datës 13.03.2024, ndërsa ankimin kushtetues individual, në të cilin kanë parashtruar pretendime për cenimin e *së drejtës për proces të rregullt ligjor* në drejtim të *së drejtës së aksesit substancial* e *standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor*, si dhe *së drejtës së pronës të lidhur me parimin e sigurisë juridike,* e kanë paraqitur në datën 12.07.2024. Për rrjedhojë, ata legjitimohen *ratione temporis* për këto pretendime, pasi i kanë paraqitur brenda afatit ligjor 4-mujor.

17. Gjykata konstaton se në parashtrimet e datës 05.03.2025 dhe ato të datës 13.03.2025 ndaj prapësimeve të Avokaturës së Shtetit, kërkuesit kanë pretenduar cenimin e *së drejtës për proces të rregullt ligjor* edhe në drejtim të *së drejtës për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur,* si rrjedhojë e shqyrtimit të çështjes në dhomën e këshillimit nga Gjykata Lartë, si dhe të *parimit të barazisë së armëve*, për shkak të favorizimit të Avokaturës së Shtetit në procesin e zhvilluar, pretendime të cilat nuk i kanë ngritur në ankimin fillestar. Referuar nenit 1, pika 2, të ligjit nr. 8577/2000 dhe nenit 185 të KPC-së, Gjykata vë në dukje se shkaqet e ankimit kushtetues individual mund të ndryshohen (shtohen ose pakësohen) deri në momentin

që vendoset kalimi i çështjes për shqyrtim në seancë plenare. Bazuar në këto parashikime, Gjykata çmon se këto pretendime të reja, të cilat përbëjnë shtesë të shkaqeve të ankimit kushtetues individual, nuk mund të merren në shqyrtim, pasi ato janë paraqitur nga kërkuesit pas vendimit të Mbledhjes së Gjyqtarëve për kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.

18. Për sa i takon legjitimimit *ratione materiae*, Gjykata evidenton se kërkuesit kanë pretenduar se vendimi i Gjykatës së Lartë u ka cenuar të drejtën për proces të rregullt ligjor në drejtim të së drejtës së aksesit substancial e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, si dhe të drejtën e pronës të lidhur me parimin e sigurisë juridike. Sipas subjektit të interesuar, Avokaturës së Shtetit, Gjykata nuk ka juridiksion për shqyrtimin e këtyre pretendimeve, pasi ato kanë të bëjnë me interpretimin dhe zbatimin e ligjit, çka nuk përfshihet në juridiksionin e saj. Kërkuesit e kanë vlerësuar të pabazuar prapësimin e Avokaturës së Shtetit, me argumentin se pretendimet e tyre janë parashtruar në kuadër të cenimit të të drejtave kushtetuese dhe vlerësimit të gabuar të ligjit nga Gjykata e Lartë, çka sipas jurisprudencës kushtetuese përfshihet në juridiksionin e Gjykatës.

19. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se kontrolli kushtetues që ajo ushtron ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes të të drejtave kushtetuese të individit dhe problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit për zgjidhjen e çështjeve konkrete nuk përbëjnë juridiksion kushtetues, nëse ato nuk shoqërohen me cenimin e këtyre të drejtave *(shih vendimet nr. 3, datë 26.01.2015; nr. 31, datë 05.07.2011 të Gjykatës Kushtetuese)*. Në këndvështrim të kësaj jurisprudence, në rastin konkret, Gjykata vëren se kërkuesit kanë pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor dhe së drejtës së pronës private, të garantuara nga nenet 42 e 41 të Kushtetutës. Në kushtet kur këto pretendime kanë të bëjnë me cenimin e të drejtave themelore kushtetuese, Gjykata vlerëson se, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës, ato përfshihen në juridiksionin e saj, ndaj i çmon të pabazuara prapësimet e Avokaturës së Shtetit për mungesën e juridiksionit të saj në shqyrtimin e çështjes.

20. Për sa i takon thelbit të pretendimeve të kërkuesve, duke qenë se argumentet për të cilat ata kanë bazuar pretendimin për cenimin e së drejtës së pronës private të lidhur me parimin e sigurisë juridike janë të ndërvarura me ato për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor, Gjykata çmon të analizojë çështjen në këndvështrim të nenit 42 të Kushtetutës, sipas të

cilit prona private nuk mund të cenohet pa një proces të rregullt ligjor dhe se kushdo, për mbrojtjen e së drejtës kushtetuese të pronës private, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë. Duke mbajtur në konsideratë se kërkuesit parashtrojnë se si rrjedhojë e interpretimit të gabuar të ligjit vendimi i Gjykatës së Lartë për pushimin e kundërpadisë u ka cenuar të drejtën për akses substancial përpara asaj gjykate, Gjykata vlerëson të analizojë në vijim bazueshmërinë në themel të pretendimeve të tyre në drejtim të aksesit substancial dhe të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor të lidhur me të drejtën e pronës.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e aksesit substancial dhe të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor të lidhur me të drejtën e pronës

21. Kërkuesit kanë pretenduar se Gjykata e Lartë ka interpretuar dhe zbatuar në mënyrë arbitrare nenin 160 të KPC-së për ushtrimin e kundërpadisë, në cenim të së drejtës së tyre për akses substancial në atë gjykatë. Ajo nuk ka marrë parasysh se Avokatura e Shtetit është paraqitur si palë paditëse dhe jo si përfaqësuese e AKKP-së, shkak për të cilin kundërpadia u është drejtuar të dyja institucioneve. Arsyetimi i saj është kontradiktor, pasi ndërsa pranon se kundërpadia është paraqitur ndaj AKKP-së, shprehet se ajo duhej paraqitur ndaj këtij organi dhe jo ndaj Avokaturës së Shtetit. Gjykata e Lartë ka ripërsëritur në mënyrë abuzive shkaqet e parashtruara në rekurs nga Avokatura e Shtetit, ndërkohë që duhej të kishte analizuar rolin e këtij organi si subjekt formal i së drejtës dhe si palë në procesin civil. Po sipas kërkuesve, Gjykata e Lartë nuk i ka dhënë përgjigje pretendimit kryesor të tyre që lidhej me të drejtën substanciale të pronës. Duke disponuar për pushimin e gjykimit të kundërpadisë kjo gjykatë ka zhbërë një proces gjyqësor 12-vjeçar lidhur me të drejtën e tyre për të gëzuar dhe disponuar pronën e trashëguar dhe të drejtat reale në të, në cenim të *parimit të sigurisë juridike*. Qëndrimi i saj bie ndesh edhe me vendimin unifikues nr. 24/2002.

22. Subjekti i interesuar, Avokatura e Shtetit, ka prapësuar se pretendimet e kërkuesve janë të pabazuara, pasi vendimi i Gjykatës së Lartë është marrë në përputhje me parimet e së drejtës civile e dispozitat ligjore përkatëse dhe interpretimi që ajo i ka bërë ligjit, në drejtim të dallimit që ekziston mes rolit të Avokaturës së Shtetit si mbrojtëse e interesit pasuror të shtetit dhe interesit të një institucioni shtetëror, palë në gjykim, është i drejtë. Avokatura e Shtetit ka vepruar në bazë të ligjit nr. 9235/2004, pa qenë

mbajtëse e ndonjë të drejte subjektive ose përfaqësuese e ZRKKP-së, Tiranë. Po sipas këtij subjekti, Gjykata e Lartë ka bërë një arsyetim të plotë të çështjes, duke u dhënë përgjigje pretendimeve të kërkuesve. Në interpretim të drejtë të ligjit ajo ka dalluar drejt rolin e Avokaturës së Shtetit si mbrojtëse e interesit shtetëror nga ai i një institucioni palë në gjykim.

23. Neni 42, pika 1, i Kushtetutës parashikon se prona nuk mund të cenohet pa një proces të rregullt ligjor. Kjo dispozitë sanksionon të drejtën për gjykim, ku e drejta e aksesit, që është e drejta për të vënë në lëvizje gjykatën, përbën një aspekt të saj. E drejta e aksesit u garanton subjekteve të cenuara të drejtën t'i drejtohen një gjykate, e cila do t'i dëgjojë pretendimet e tyre dhe do të shpallë një vendim pas një gjykimi të drejtë dhe publik. Kjo e drejtë e individit nuk përfshin vetëm të drejtën për të vënë në lëvizje gjykatën, por edhe të drejtën për të pasur nga ajo një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pasi aksesi në gjykatë duhet të jetë substancial dhe jo thjesht formal. Në rast se mohohet kjo e drejtë procesi konsiderohet i parregullt, sepse aksesi në gjykatë është, përpara së gjithash, një kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tjera të individit *(shih vendimet nr. 41, datë 29.05.2024; nr. 22, datë 29.04.2021; nr. 3, datë 23.02.2016 të Gjykatës Kushtetuese)*.

24. E drejta për proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka pohuar se arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funksioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Vendimi gjyqësor në çdo rast duhet të jetë i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje dhe në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre dhe formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie, kontradiksion të hapur ose të fshehtë. Po sipas Gjykatës, detyra e saj është të shqyrtojë dhe të vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës *(shih vendimet nr. 3, datë 21.01.2025; nr. 50, datë 20.06.2024 të Gjykatës Kushtetuese)*. Në këtë drejtim, Gjykata ka theksuar se respektimi i të drejtave kushtetuese është funksion edhe i gjykatave të zakonshme, për më tepër i Gjykatës së Lartë, e cila i ka të gjitha mjetet dhe kompetencat për të kryer një rol që shkon

përtej ligjit dhe synon të drejtën (*shih vendimet nr. 10, datë 04.03.2021; nr. 3, datë 23.02.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

25. Për sa i përket së drejtës për pronë private, të parashikuar nga neni 41 i Kushtetutës, Gjykata ka theksuar se ajo përbën një ndër aspektet më thelbësore të shoqërisë demokratike. Sipas Gjykatës, si e drejtë universale e njeriut, e drejta e pronës përfshin çdo posedim të sendeve ose të të drejtave të tjera materiale pasurore dhe në një shtet demokratik individit duhet t'i garantohet gëzimi i qetë dhe pa pengesa të paarsyeshme i kësaj të drejte. Në çdo rast, kjo e drejtë shtrihet ndaj sendeve, pronësia e të cilave është fituar në përputhje me ligjin *(shih vendimet nr. 31, datë 18.04.2024; nr. 53, datë 31.10.2023; nr. 36, datë 21.04.2017 të Gjykatës Kushtetuese)*.

26. Në lidhje me procesin e kthimit dhe të kompensimit të pronës, Gjykata është shprehur se ai lindi si një nevojë për të vendosur drejtësinë sociale, për arsye se individët ishin zhveshur nga prona në përputhje me legjislacionin e kohës, por në kundërshtim me elementet bazë të së drejtës të shteteve demokratike, në të cilat e drejta e pronës private njihet dhe mbrohet nga rendi juridik dhe se, në këto kushte, individëve të ndryshëm, të cilët ishin privuar nga e drejta e pronës gjatë regjimeve totalitare, u lindi e drejta që të kërkonin të viheshin në të njëjtat pozita juridike për pronën, siç kishin qenë përpara shtetëzimit. Sipas saj, kërkesa e një personi përpara organeve të kthimit dhe të kompensimit të pronave synon njohjen e së drejtës së pronës për një send të caktuar, e cila është një e drejtë subjektive dhe jo një interes i ligjshëm i tij, në kuptim të nenit 32 të KPC-së, ndërsa ajo rregullohet nga Kodi Civil, duke qenë jashtë fushës së veprimit të së drejtës publike. Gjykata ka theksuar se vendimet e organeve administrative, që kanë pasur si kompetencë kthimin dhe kompensimin e pronave, në vite, nuk trajtohen dhe nuk goditen në gjykatë si akte administrative, por, përkundrazi, shtetasi në gjykatë, në një gjykim të zakonshëm kërkon të drejtën e pronës, duke paraqitur prova në mbështetje të kësaj të drejte dhe se shqyrtimi i saj mund të bëhet vetëm nga gjykata e zakonshme, në përputhje me KC-në *(shih vendimin nr. 27, datë 26.05.2010 të Gjykatës Kushtetuese).*

27. Gjykata vëren se pushimi i gjykimit rregullohet posaçërisht nga ligji procedural civil. Sipas nenit 299 të KPC-së, gjykata vendos pushimin e gjykimit edhe kur konstaton se padia nuk mund të ngrihej dhe kur ky shkak konstatohej nga gjykatat më të larta, ato prishin vendimin e gjykatave më të ulëta dhe vendosin pushimin e gjykimit (shkronja "c"). Ndërkohë, kundërpadia rregullohet nga neni 160, paragrafi i parë, i KPC-së, sipas të

cilit i padituri ka të drejtë të paraqesë kundërpadi kur kërkimi i kundërpadisë ka lidhje me atë të padisë ose kur midis tyre mund të bëhet kompensimi. Në jurisprudencën e saj unfikuese, Gjykata e Lartë ka pohuar se që padia e të padituri kundër paditësit të cilësohet si kundërpadi dhe të pranohet të gjykohet së bashku me padinë në gjykimin e filluar duhet të plotësojë të paktën një nga dy elementet substanciale të kërkuara nga neni 160, paragrafi i parë, i KPC-së, lidhjen (koneksitetin) midis kërkimeve dhe/ose mundësinë e kompensimit (ndërshlyerjes) të detyrimeve të ndërsjella *(shih vendimin unifikues nr. 901, datë 14.07.2000 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë)*. Kundërpadia ka të bëjë me kërkimet e të padituri në një gjykim të filluar, ku ai jo vetëm që kundërshton padinë, duke kërkuar rrëzimin e saj, por ngre edhe kërkime të tjera që tejkalojnë objektin e padisë, duke pretenduar mbrojtjen e të drejtave të tij subjektive nëpërmjet gjykatës. Këto kërkime në kundërpadi kanë si qëllim, nga njëra anë, realizimin e mbrojtjes të të padituri ndaj padisë, por, nga ana tjetër, ato parashtrojnë dhe pretendime që qëndrojnë më vete si padi e veçantë *(shih vendimin unifikues nr. 3, datë 28.04.2014 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë)*.

28. Në këndvështrim të standardeve të mësipërme, Gjykata çmon të analizojë në vijim vendimmarrjen e Gjykatës së Lartë, në pjesën që ka vendosur pushimin e gjykimit të kundërpadisë edhe të kërkuesve, për të vlerësuar nëse interpretimi që ajo i ka bërë institutit të pushimit të gjykimit në kontekstin e nenit 299 të KPC-së të lidhur me nenin 160 të këtij kodi ka cenuar të drejtën e tyre për akses substancial në atë gjykatë e, për rrjedhojë, nëse ky interpretim dhe procesi i zhvilluar nga ajo gjykatë kanë çuar në cenimin e së drejtës së pronës private të kërkuesve. Po kështu, Gjykata do të analizojë nëse qasja e mbajtur në vendimin e kundërshtuar të Gjykatës së Lartë respekton standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor, konkretisht nëse në vendim janë shpjeguar qartë arsyet për pushimin e gjykimit të kundërpadisë.

29. Në rastin konkret, referuar akteve të dosjes gjyqësore të administruar për qëllime të gjykimit kushtetues, Gjykata vëren se kërkuesit i janë drejtuar organit shtetëror të ngarkuar nga ligji për kthimin e pronës së trashëgimlënësit të tyre, kërkesë e cila është pranuar vetëm pjesërisht, duke u njohur atyre të drejtën e pronësisë dhe të kompensimit për një pjesë të sipërfaqes së saj, si dhe të drejtën e parablerjes së objekteve të ndodhura në të. Vendimi është kundërshtuar në rrugë administrative dhe pas konstatimit të mungesës së juridiksionit administrativ, si dhe kompetencës së AKKP-së për shqyrtimin e ankimit, Avokatura e Shtetit

i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me kërkesëpadi ndaj AKKP-së dhe trashëgimtarëve të subjektit të shpronësuar, duke kërkuar anulimin e vendimit të ZRKKP-së, Tiranë, sa i përket njohjes të së drejtës së pronës, kthimit e kompensimit të saj, ndërsa kërkuesit kanë paraqitur kundërpadi ndaj Avokaturës së Shtetit dhe AKKP-së, duke kërkuar ndryshimin e vendimit të ZRKKP-së, Tiranë dhe njohjen atyre të së drejtës së pronësisë për një sipërfaqe më të madhe, kthimin fizik të saj dhe njohjen e së drejtës së parablerjes të objekteve shtetërore të ndodhura në të në momentin e privatizimit të tyre.

30. Si gjykata e rrethit, ashtu edhe gjykata e apelit kanë pranuar shqyrtimin e kundërpadisë së kërkuesve (dhe trashëgimtarëve të tjerë) së bashku me padinë, duke e gjetur atë në përputhje me kërkesat e nenit 160 të KPC-së. Ndërsa Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vlerësuar se shqyrtimi i kundërpadisë duhej të pushohej si padi që nuk mund të ngrihej, sipas nenit 299, shkronja "c", të KPC-së, për shkak se ajo nuk plotësonte nga pikëpamja formale elementet përbërëse të një kundërpadie në kuptim të nenit 160 të KPC-së, si në drejtim të mungesës së legjitimimit formal procedural të Avokaturës së Shtetit, ashtu edhe në drejtim të mungesës së kritereve lidhëse të objektit të padisë me atë të kundërpadisë, duke mos u plotësuar kështu kushtet dhe kriteret e përcaktuara nga kjo dispozitë për shqyrtim e saj së bashku me padinë. Sipas Kolegjit Civil, edhe pse sipas ligjit, Avokatura e Shtetit gëzonte të drejtën e ngritjes së padisë, ajo nuk mund të ishte palë e paditur në padi ose kundërpadi, pasi nuk gëzon legjitimitet procedural pasiv, për sa kohë nuk është pronare e pasurisë shtet dhe as administron këtë pasuri, nuk ka kompetencë të shprehet për kërkimet e subjekteve të shpronësuara për njohjen dhe kthimin e pasurisë dhe nuk është ajo subjekti që ka shkelur, cenuar ose mohuar të drejtat subjektive që trashëgimtarët e subjektit të shpronësuar synonin të realizonin përmes kundërpadisë. Për rrjedhojë, në kuptim të nenit 160 të KPC-së, mes objektit të padisë dhe atij të kundërpadisë mungonte lidhja e nevojshme, çka sillte, për pasojë, mungesën e kushtit të ngritjes së kundërpadisë si mjet mbrojtës procedural i të padituri në gjykim. Ky i fundit mund të realizonte pretendimet për pasurinë dhe për kundërshtimin e vendimit të ZRKKP-së, Tiranë përmes ngritjes së një padie, duke thirrur në gjykim si të paditur AKKP-në, si organi që me mosveprim nuk ishte shprehur për të gjithë sipërfaqen e pronës së pretenduar prej tyre në rrugë administrative, dhe jo përmes kundërpadisë së ngritur edhe ndaj Avokaturës së Shtetit, e cila është përfaqësuese ligjore e organeve shtetërore mbajtës të së drejtës së

pronësisë. Kur gjykohen se bashku një padi dhe një kundërpadi, si rregull, nuk mund të thirren si paditës ose të paditur edhe persona të tjerë, me kërkime të pavarura nga ato të përcaktuara në objektin e padisë dhe të kundërpadisë, përveç rasteve të bashkëndërgjyqësisë sipas neneve 161-162 të KPC-së, ndërkohë që, në rastin konkret, nuk janë kushtet për bashkimin proceduralisht të Avokaturës së Shtetit me të padituri AKKP. Në këtë situatë, në kushtet e të metave të karakterit formal procedural të ndërtimit të ndërgjyqësisë fillestare, kundërpadia nuk plotësonte as kushtet e një padie të pavarur, ndaj çështja nuk mund të kthehej për rigjykim *(shih, paragrafët 31, 34, 41 dhe 42, faqet 12-15, të vendimit të Gjykatës së Lartë)*.

31. Nga sa më lart, Gjykata vëren se trashëgimtarët e subjektit të shpronësuar i janë drejtuar organit shtetëror të ngarkuar nga ligji për rivendosjen e së drejtës së pronësisë përmes njohjes së saj, kthimit dhe kompensimit të pronës sipas ligjit të posaçëm. Kjo kërkesë është pranuar pjesërisht nga ZRKKP-ja, Tiranë dhe Avokatura e Shtetit, në cilësinë e institucionit të ngarkuar nga ligji edhe për mbrojtjen e interesave pasurorë të shtetit pranë gjykatave kombëtare, ka kundërshtuar vendimin, duke paraqitur padi në gjykatë, me të cilën ka thirrur si të paditur AKKP-në dhe trashëgimtarët e subjektit të shpronësuar. Në paraqitjen e padisë Avokatura e Shtetit ka vepruar në bazë të nenit 5 të ligjit nr. 10018/2008, duke u shfaqur në proces në cilësinë e paditësit dhe jo të përfaqësuesit ligjor të ndonjë institucioni shtetëror. Përmes padisë Avokatura e Shtetit ka synuar marrjen nga gjykata të një vendimi për ndryshimin e vendimit të ZRKKP-së, Tiranë për atë pjesë të tij, me të cilin ishte disponuar për njohjen e së drejtës së pronës, kthimin dhe kompensimin e saj, pra të një vendimi që zhbënte efektet e vendimit të ZRKKP-së, Tiranë dhe, në thelb, mosnjohjen e së drejtës së pronësisë për trashëgimtarët e subjektit të shpronësuar të së drejtës së pronësisë, duke mbetur në këtë mënyrë prona në pronësi të shtetit.

32. Nga ana tjetër, edhe trashëgimtarët e subjektit të shpronësuar kanë kundërshtuar të njëjtin vendim të ZRKKP-së, Tiranë, por për atë pjesë të tij me të cilin, për një pjesë të pretenduar të pronës, nuk ishte njohur e drejta e pronësisë, kthimi ose kompensimi i saj. Këtë kundërshtim ata e kanë paraqitur gjatë procesit gjyqësor, duke përdorur për këtë mjetin ligjor të kundërpadisë, me të cilin kanë thirrur si të paditur, krahas AKKP-së, edhe Avokaturën e Shtetit, e cila kishte paraqitur padinë kundër tyre në funksion të mbrojtjes së interesave pasurorë të shtetit. Me fjalë të tjera, kërkuesit me anë të kundërpadisë jo vetëm kanë kundërshtuar padinë e

Avokaturës së Shtetit, duke kërkuar rrëzimin e saj, por kanë ngritur edhe kërkime të tjera që tejkalojnë objektin e padisë, duke pretenduar mbrojtjen e së drejtës subjektive të pronës nëpërmjet gjykatës. Kërkimet e tyre në kundërpadi kanë pasur si qëllim, nga njëra anë, realizimin e mbrojtjes së tyre ndaj padisë, por, nga ana tjetër, ato kanë parashtruar edhe pretendime që qëndrojnë më vete si padi e veçantë.

33. Gjykata konstaton se mosmarrëveshja e parashtruar përpara gjykatave të zakonshme lidhet me të drejtën e pronës, ndërsa (kundër)padia edhe e kërkuesve për njohjen e kësaj të drejte është pushuar nga Gjykata e Lartë. Kjo e fundit, ndonëse ka pranuar se trashëgimtarët e subjektit të shpronësuar mund të ngrinin padi kundër AKKP-së për rivendosjen e së drejtës së pronës, ka arritur në përfundimin se kundërpadia e paraqitur nga ata në rastin konkret ishte një padi që nuk mund të ngrihej për shkak se ajo ishte ngritur edhe kundër Avokaturës së Shtetit, e cila, sipas asaj gjykate, nuk gëzonte legjitimim procedural pasiv. Një arsyetim i tillë, në vlerësim të Gjykatës, nuk është në përputhje me standardet kushtetuese, për dy shkaqet e mëposhtme.

34. *Së pari*, vendimi i Gjykatës së Lartë është kontradiktor dhe i paarsyeshëm lidhur me vlerësimin se kundërpadia e trashëgimtarëve të subjektit të shpronësuar ndaj AKKP-së është një padi që nuk mund të ngrihej. Sikurse edhe vetë Gjykata e Lartë ka pranuar, por referuar edhe jurisprudencës kushtetuese, sikundër edhe praktikës gjyqësore ndër vite, subjektet e shpronësuara mund të kundërshtojnë vendimet e organit shtetëror të ngarkuar nga ligji për kthimin dhe kompensimin e pronës, vendime të cilat nuk trajtohen dhe nuk goditen në gjykatë si akte administrative, por, përkundrazi, shtetasi në gjykatë, në një gjykim të zakonshëm, kërkon të drejtën e pronës, duke paraqitur prova në mbështetje të kësaj të drejte. Në këtë kuptim, përfundimi i Gjykatës së Lartë se ishte para një padie që nuk mund të ngrihej dhe gjykimi i saj duhej të pushohej, është haptazi i paarsyeshëm, duke sjellë, si pasojë, kufizimin e aksesit substancial të kërkuesve në atë gjykatë, si dhe cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, në shkelje të së drejtës për proces të rregullt ligjor.

35. Po kështu, Gjykata vëren se Gjykata e Lartë ka vënë në diskutim edhe nëse mjeti i përdorur nga trashëgimtarët e subjektit të shpronësuar plotëson kërkesat e nenit 160 të KPC-së për t'u konsideruar si kundërpadi, duke rezultuar se ato kërkesa nuk plotësohen, çka, sipas asaj gjykate, pengonte shqyrtimin e saj së bashku me padinë e Avokaturës së Shtetit. Në

vlerësim të Gjykatës, pavarësisht bazueshmërisë ose jo të këtij përfundimi të Gjykatës së Lartë, vetëm fakti i bashkimit të gabuar të dy padive dhe i shqyrtimit të tyre në të njëjtin gjykim, nuk përbën shkak sipas ligjit procedural për pushimin e gjykimit të padisë së dytë. I vetmi rast kur ligji procedural parashikon pushimin e gjykimit të padisë së dytë është ai sipas nenit 58 të KPC-së, sipas të cilit kur në të njëjtën gjykatë ose gjykata të ndryshme shqyrtohen në të njëjtën kohë mosmarrëveshje midis të njëjtave palë dhe kanë të njëjtin shkak e të njëjtin objekt, vendoset pushimi i gjykimit të mosmarrëveshjeve të paraqitura pas asaj të regjistruar më parë, çka nuk evidentohet në rastin konkret. Për rrjedhojë, edhe në këtë kuptim, përfundimi i Gjykatës së Lartë për pushimin e (kundër)padisë së trashëgimtarëve të subjektit të shpronësuar është i haptazi i paarsyeshëm dhe në cenim të së drejtës së kërkuesve për akses substancial.

36. *Së dyti*, arsyetimi i Gjykatës së Lartë është i paqartë dhe i pamjaftueshëm lidhur me vlerësimin se përse Avokaturës së Shtetit i mungon legjitimimi pasiv, pasi ajo vepron si përfaqësuese e organeve shtetërore. Në këtë pikë, Gjykata vëren se në rastin konkret bëhet fjalë për një proces gjyqësor të hapur nga Avokatura e Shtetit, në cilësinë e paditësit, me legjitimitet aktiv të fituar për shkak të ligjit, që do të thotë se ajo nuk ka vepruar në cilësinë e përfaqësuesit të organit shtetëror. Për rrjedhojë, edhe në këtë kuptim, përfundimi i Gjykatës së Lartë për pushimin e (kundër)padisë së trashëgimtarëve të subjektit të shpronësuar nuk është i arsyetuar, duke passjellë cenimin e së drejtës së kërkuesve për akses substancial.

37. Në përfundim, Gjykata çmon se pretendimet e kërkuesve për cenimin e së drejtës së aksesit substancial dhe të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor të lidhur me të drejtën e pronës janë të bazuara, sipas arsyetimit të këtij vendimi, ndaj kërkesa duhet të pranohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, si dhe neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, njëzëri,

V E N D O S I:

1. Pranimin e kërkesës.
2. Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2024-1060 (115), datë 13.03.2024 të

Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, për sa i përket kundërpadisë.

3. Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 19.05.2025
Shpallur më 26.06.2025

Vendim nr. 33, datë 20.05.2025
(V-33/25)

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Holta Zaçaj, Kryetare, Marsida Xhaferllari, Fiona Papajorgji, Sonila Bejtja, Sandër Beci, Genti Ibrahimi, Marjana Semini, Ilir Toska, anëtarë, me sekretare Belma Lleshi, në datën 20.05.2025 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 23 (P) 2024 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: **PËLLUMB GJOKA, SHOQËRIA "IMPERIAL GROUP" SH.A., KOLË GJOKA,** përfaqësuar nga avokat Gurali Brahimllari, me prokurë.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:
PROKURORIA E POSAÇME KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR, përfaqësuar nga prokurorët Altin Dumani dhe Arben Kraja.
SHOQËRIA "XHENIS-SH" SH.P.K., përfaqësuar nga avokatët Maksim Haxhia dhe Dritan Jahaj, me prokurë.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimeve nr. 422, datë 23.10.2023 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 167 (87-2023-270), datë 27.11.2023 të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 00-2024-423, datë 07.03.2024 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

BAZA LIGJORE: **Nenet 11, 17, 41, 42, 43, 131, pika 1, shkronja "f", 134, pika 1, shkronja "i" dhe 142 të Kushtetutës**

së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 6, 7 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*) dhe neni 1 i Protokollit nr. 1 të saj; nenet 27, 43/b, 71 dhe 71/a të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Ilir Toska, mori në shqyrtim parashtrimet me shkrim të kërkuesve, të cilët kanë kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar, Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (*Prokuroria e Posaçme*), që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, parashtrimet me shkrim të subjektit të interesuar, shoqërisë "Xhenis-Sh" sh.p.k., i cili ka kërkuar shfuqizimin e vendimeve objekt kërkese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I
Rrethanat e çështjes

1. Çështja në shqyrtim lidhet me ankimin kushtetues individual të shtetasit Pëllumb Gjoka *(kërkuesi i parë),* shoqërisë "Imperial Group" sh.a. *(kërkuesi i dytë)* dhe shtetasit Kolë Gjoka *(kërkuesi i tretë),* ndaj vendimeve të dhëna në një proces gjyqësor për vendosjen e masës së sigurimit pasuror të sekuestros preventive, në kuadër të një procedimi penal të regjistruar nga Prokuroria e Posaçme.

Procedimi penal

2. Në datën 16.01.2023 Prokuroria e Posaçme ka regjistruar procedimin penal nr. 9 të vitit 2023 (*procedimi penal nr. 9/2023*) për veprat penale "Falsifikimi i dokumenteve", "Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale", të kryera në bashkëpunim në formën e "Grupit të strukturuar kriminal", të parashikuara nga nenet 186, 287 dhe 333/a të Kodit Penal (*KP*). Procedimi penal është regjistruar në bazë të kallëzimit të shtetasve L.Z. dhe D.Z. (nënë e bir), sipas të cilëve, kërkuesi i parë në bashkëpunim me disa persona të tjerë, kanë kryer një sërë veprimesh në

mashtrim të ligjit, deri te tjetërsimi i një sipërfaqeje toke prej 39 hektarësh, e ndodhur në fshatin Pulaj-Velipojë, Shkodër, në pronësi të trashëgimlënëses së tyre D.H.(Gj.), duke përdorur për këtë një prokurë të posaçme (e datës 17.01.2012), e cila nuk ishte lëshuar nga trashëgimlënësja e tyre, por ishte e falsifikuar, pasi ajo nuk ka ditur të lexojë, shkruajë ose të nënshkruajë. Po sipas kallëzuesve, pasuria është poseduar vazhdimisht nga kërkuesi i parë.

3. Në vijim, në datën 13.03.2023, Prokuroria e Posaçme ka regjistruar edhe procedimin penal nr. 41 të vitit 2023 *(procedimi penal nr. 41/2023),* për veprat penale "Vrasja me paramendim", "Korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë", "Korrupsioni aktiv i gjyqtarit, prokurorit dhe i funksionarëve të tjerë të drejtësisë", "Heqja e paligjshme e lirisë", "Shpërdorimi i detyrës", "Ekspertimi i rremë", "Trafikimi i narkotikëve", "Mbajta pa leje e armëve dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyese dhe municionit", në bashkëpunim, në formën e "Grupit të strukturuar kriminal", "Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal", të parashikuara nga nenet 78, 319/ç, 319, 110, 248, 309, 283/a, 278, 333/a dhe 334 të KP-së. Në datën 18.07.2023, në regjistrin e njoftimit të veprave penale, Prokuroria e Posaçme ka regjistruar emrat e personave nën hetim, ndër të tjerë, edhe të kërkuesit të parë.

4. Procedimet penale si më lart, në datën 19.07.2023, janë bashkuar në një procedim të vetëm, atë me nr. 9/2023, në kushtet kur provat e njërit procedim ndikonin në provueshmërinë e fakteve/rrethanave të procedimit tjetër. Për nevoja të hetimit, për sa u përket fakteve në lidhje me fitimin e pronësisë nga shtetasja D.H.(Gj.) dhe tjetërsimin e saj në vijim, Prokuroria e Posaçme ka administruar edhe aktet e procedimit penal nr. 751 të vitit 2020 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër *(Prokuroria Shkodër),* i regjistruar për veprën penale "Falsifikimi i dokumenteve", të parashikuar nga neni 186 i KP-së. Sipas materialeve të këtij procedimi penal, ai është regjistruar në bazë të informacioneve të organeve ligjzbatuese, mbi dyshimin se shtetasja D.H.(Gj.) ka përfituar në mënyrë të paligjshme një sipërfaqe toke prej 39 hektarësh përmes përdorimit të dokumenteve të falsifikuara, konkretisht të një vërtetimi pronësie të datës 17.01.1997, lëshuar nga Zyra e Hipotekës Shkodër, sipas të cilit prona ka qenë e regjistruar në emër të asaj shtetaseje në radhorët e pronësisë së vitit 1938. Në vijim është paraqitur kallëzim edhe nga shtetasja L.Z., sipas së cilës, në emër të trashëgimlënëses së saj D.H.(Gj.) është lëshuar një prokurë e posaçme e falsifikuar, e cila është përdorur për realizimin e të gjithë

procedurës së fitimit të pronësisë dhe, më pas, për përvetësimin e pasurisë përmes tjetërsimit të saj. Po kështu, ka paraqitur kallëzim edhe shtetasi D.M., sipas të cilit, gjatë procesit të njohjes dhe kthimit të pronës në favor të shtetases D.H.(Gj.) janë përdorur dokumente arkivore të falsifikuara dhe se asaj shtetaseje i është njohur dhe kthyer edhe një sipërfaqe toke që është pasuri e tij.

5. Nga hetimi ka rezultuar se shtetasja D.H.(Gj.) ka lëshuar një prokurë të posaçme në datën 17.01.2012, përmes së cilës ka caktuar si përfaqësues të saj shtetasin A.B., duke i dhënë atij tagra për të paraqitur kërkesë në Agjencinë për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave (*AKKP*) Tiranë për njohjen dhe kthimin e një sipërfaqeje prone prej 390 dynymësh, të ndodhur në fshatin Pulaj-Velipojë, Shkodër. Në bazë të kësaj prokure, shtetasi A.B. ka vënë në lëvizje një proces gjyqësor në emër të shtetases D.H.(Gj.) për vërtetim fakti juridik, ku është paraqitur si provë edhe vërtetimi i pronësisë i datës 17.01.1997, në përfundim të të cilit kërkesa është pranuar me vendimin nr. 1648, datë 21.06.2012 të Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër. Në vijim, në datën 10.09.2012, ai shtetas i është drejtuar AKKP-së për njohjen dhe kthimin e pronës në favor të të përfaqësuarës prej tij, shtetases D.H.(Gj.), ku janë paraqitur si prova edhe disa dokumente të vitit 1935, të dala nga Arkivi Qendror i Shtetit (*AQSH*). Me vendimin nr. 608, datë 26.11.2012, AKKP-ja e ka rrëzuar kërkesën me arsyetimin se binte ndesh me ligjin nr. 9235, datë 29.07.2004 "Për kthimin dhe kompensimin e pronës", të ndryshuar dhe se dokumentacioni nuk ishte i plotë. Shtetasi A.B., po si përfaqësues i shtetases D.H.(Gj.), e ka kundërshtuar këtë vendim në gjykatë. Në vijim, në datën 10.01.2013, ai ka lëshuar një prokurë të posaçme me të cilën ka caktuar si përfaqësuese shtetasen S.B. për ta përfaqësuar për të gjitha problemet ligjore lidhur me shqyrtimin e mosmarrëveshjes civile dhe mbrojtjen e të drejtave pasurore të të përfaqësuarës prej tij D.H.(Gj.). Me vendimin nr. 8821, datë 29.07.2013, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur pranimin e kërkesës, anulimin e vendimit të AKKP-së, njohjen e së drejtës së pronësisë të shtetases D.H.(Gj.) për sipërfaqen 390 dynymë, kthimin të lirë të sipërfaqes 30 dynymë dhe kompensimin për sipërfaqen 360 dynymë. Mbi ankimin edhe të përfaqësueses S.B., Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 2935, datë 09.07.2014, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së parë me ndryshimin se shtetases D.H.(Gj.) i kthehet në natyrë e gjithë sipërfaqja prej 390 dynymësh. Ky vendim në vijim është lënë në fuqi nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë me vendimin nr. 59, datë 18.05.2017.

6. Po kështu, nga hetimi ka rezultuar se pas vendimit të gjykatës së apelit dhe regjistrimit të pasurisë në favor të shtetases D.H.(Gj.), në vijim janë kryer disa veprime juridike për tjetërsimin dhe regjistrimin e saj tek të tretët, konkretisht: i) pasuria nr. 1083/4, zona kadastrale 3072, e llojit "pyll", me sipërfaqe 113500 m^2, e ndodhur në Pulaj-Plazh, Velipojë, Shkodër, është regjistruar në volumin 10, faqe 86, në emër të kërkuesit të dytë (shoqëria "Imperial Group" sh.a.). Kjo pasuri fillimisht është fituar nga shoqëria "Imperial C. Construction" sh.p.k. me kontratën e shitblerjes të datës 17.11.2016, përkundrejt çmimit 17,000,000 lekë, në të cilën pala shitëse D.H.(Gj.) është përfaqësuar me prokurë nga shtetasi A.B. Më pas, me kontratën e datës 12.12.2018, shoqëria "Imperial C. Construction" sh.p.k., me ortak të vetëm kërkuesin e parë, ia ka shitur aktivitetin tregtar, ku përfshihet edhe kjo pasuri e paluajtshme, shoqërisë "SHB" sh.a., me aksionarë po kërkuesin e parë, si dhe kërkuesin e tretë (Kolë Gjoka), babai i tij, ndërsa kjo shoqëri, me vendimin e asamblesë së aksionarëve të datës 18.12.2018, ka ndryshuar emrin në "Imperial Group" sh.a.; ii) pasuria nr. 1083/5, zona kadastrale 3072, e llojit "pyll", me sipërfaqe 61470 m^2, e ndodhur në Pulaj-Plazh, Velipojë, Shkodër, është regjistruar në volumin 10, faqe 87, në emër të shoqërisë "Xhenis-Sh" sh.p.k., fituar me kontratën e shitblerjes së datës 18.03.2015, përkundrejt çmimit 9,281,970 lekë, në të cilën pala shitëse D.H.(Gj.) është përfaqësuar përsëri me prokurë nga shtetasi A.B.; iii) pasuria nr. 1083/6, zona kadastrale 3072, e llojit "pyll", me sipërfaqe 215030 m^2, e ndodhur në Pulaj-Plazh, Velipojë, Shkodër, është regjistruar në volumin 10, faqe 88, në emër të kërkuesit të tretë, fituar me kontratën e dhurimit të datës 29.08.2017, me palë dhuruese shtetasen D.H.(Gj.), motra e tij.

7. Gjatë hetimit të atij procedimi penal, për sa u përket dokumenteve të përdorura në procesin e njohjes dhe të kthimit të pronës në favor të shtetases D.H.(Gj.), Prokuroria Shkodër ka administruar edhe tre akte ekspertimi grafik, konkretisht ato të datave 19.02.2021, 27.01.2022 dhe 06.05.2022. Në përfundim të hetimeve paraprake, në korrik 2022, ajo prokurori i ka kërkuar gjykatës pushimin e procedimit penal për shkakun se, pavarësisht të dhënave që ngrinin dyshime për origjinalitetin e dokumenteve të përdorura gjatë procesit të njohjes dhe kthimit të pronës, ndjekja penale për veprën penale "Falsifikimi i dokumenteve" nuk mund të vazhdonte për shkak të parashkrimit të saj referuar kohës kur ato dokumente ishin përdorur, në vitin 2012. Për këtë kërkesë, Gjykata e Shkallës së Parë Shkodër, me vendimin nr. 1402(4731), datë 14.11.2022, ka vendosur pranimin e saj

dhe pushimin e procedimit penal. Për statusin e këtij vendimi nuk jepen të dhëna.

8. Ndërkohë, në kuadër të procedimit penal të regjistruar nga Prokuroria e Posaçme, kjo e fundit ka evidentuar se shtetasi A.B., i cili ka vepruar si përfaqësues i shtetases D.H.(Gj.) në procesin e njohjes dhe kthimit të pronës, si dhe për tjetërsimin e saj në vijim, ka deklaruar më herët se kërkuesin e parë e ka kushëri dhe ka marrëdhënie të afërta me të. Për sa i përket shtetases S.B., e cila ka vepruar si përfaqësuese e shtetases D.H.(Gj.) gjatë procesit gjyqësor për njohjen dhe kthimin e pronës, nga këqyrja e sistemit C@ts të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve ka rezultuar se ajo ka qenë e punësuar pranë shoqërisë, kërkueses së dytë, me aksionar mazhoritar kërkuesin e parë. Gjithashtu, nga këqyrja e komunikimeve në *chat*-in e aplikacionit "SkyEcc" midis kërkuesit të parë dhe shtetasit Xh.L. (ish-drejtues i Prokurorisë Shkodër) ka rezultuar se ata kanë pasur komunikim në datat 16 dhe 18 shkurt 2021, pak ditë përpara përpilimit të aktit të ekspertimit grafik të datës 19.02.2021. Në një prej komunikimeve gjenden katër fotografi të një dokumenti që ngjason shumë me atë të atij akti ekspertimi, përveçse është konstatuar edhe përfshirja dhe angazhimi i atyre shtetasve për kompromet imin e konkluzioneve të këtij akti. Në këtë akt ekspertimi është arritur në konkluzionin se dokumentet arkivore të përdorura gjatë procesit të njohjes dhe kthimit të pronës nuk konstatohen të jenë të falsifikuara, ndërkohë që në dy aktet e tjera të realizuara në vijim është arritur në një konkluzion të kundërt, pra se ato dokumente janë të falsifikuara. Gjatë hetimit, në datën 03.10.2023, është realizuar edhe këqyrja e pasurisë, ku është konstatuar se në të nuk kishte asnjë ndërtim.

Procesi gjyqësor për masën e sekuestros preventive

9. Prokuroria e Posaçme, duke vlerësuar se të tria pasuritë e paluajtshme në fjalë *(shih paragrafin 6 të vendimit)* janë në pronësi të personave subjekte të hetimit dhe se ka dyshime të arsyeshme të bazuara në prova se ato janë përfituar përmes falsifikimit të dokumenteve të realizuar nga kërkuesi i parë në bashkëpunim me persona të tjerë, si dhe se ekziston rreziku që këto pasuri, të cilat janë produkte të veprës penale, të tjetërsohen te persona të tretë, ka paraqitur në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (*GJKKO-ja e Shkallës së Parë*) kërkesë për vendosjen e sekuestros preventive për ato pasuri.

10. GJKKO-ja e Shkallës së Parë, në dhomën e këshillimit, me vendimin nr. 422, datë 23.10.2023, ka pranuar kërkesën e Prokurorisë së Posaçme, duke vendosur masën e sigurimit pasuror "Sekuestro preventive" mbi

pasuritë e paluajtshme objekt kërkese. Sipas dispozitivit të vendimit, për administrimin e pasurisë ngarkohet administratori i Agjencisë për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara (*AAPSK*) pranë Ministrisë së Financave. Ajo gjykatë ka vlerësuar, në kuptim të përmbajtjes së nenit 274 të Kodit të Procedurës Penale (*KPP*), praninë e elementeve *fumus delicti* dhe *periculum in mora,* si kushte për vendosjen e masës së sekuestros preventive, duke evidentuar në vijim parashikimet e pikës 2 të kësaj dispozite. Në këtë kuadër, sipas saj, evidentohej prania e elementit *fumus commissis delicti* dhe atij të lidhjes së posaçme, funksionale dhe jo të rastësishme mes sendit dhe veprimit penal të kundërligjshëm. Sipas gjykatës, ka dyshime të arsyeshme se kërkuesi i parë ka kryer veprat penale të atribuara në kuadër të procedimit penal nr. 9/2023, i regjistruar edhe për veprat penale "Falsifikimi i dokumenteve" dhe "Ekspertimi i rremë" dhe se ekziston dyshimi se pasuritë e paluajtshme objekt kërkimi për sekuestrim janë përfituar si rezultat i veprimtarisë kriminale. Po kështu, sipas saj, ka dyshime të arsyeshme se pasuritë objekt kërkese janë produkte të veprës penale të disa shtetasve, hetimi i së cilës është në dinamikën e tij dhe se kërkuesi i parë ka marrë pjesë në aktivitetin e kundërligjshëm të përvetësimit të atyre pasurive. Ajo gjykatë ka evidentuar se në procesin e njohjes dhe kthimit të pasurisë dhe në veprimet juridike për tjetërsimin e saj janë përfshirë shtetasit A.B. dhe S.B., të cilët rezultojnë lidhje e afërt e kërkuesit të parë, ndërkohë që nga të dhënat e marra nga aplikacioni SkyEcc rezulton edhe përfshirja e këtij shtetasi në kryerjen e ekspertimit grafik të rremë në funksion të procesit penal të lidhur me falsifikimin. Në vijim, gjykata ka vlerësuar se disponimi i lirë i pasurive mund të sjellë tjetërsimin e tyre tek të tretët, ligjërimin e tyre në qarkullimin civil dhe, për rrjedhojë, do të vështirësonte konfiskimin e tyre në përfundim të procesit penal.

11. Të tre kërkuesit, pasi kanë ardhur në dijeni të vendimit të GJKKO-së së Shkallës së Parë, si më lart, kanë paraqitur ankim për masën e sekuestros të vendosur ndaj dy prej pasurive. Po kështu, ndaj këtij vendimi ka paraqitur ankim edhe shoqëria "Xhenis-Sh" sh.p.k., për sa i përket masës së sekuestros ndaj pasurisë së regjistruar në pronësi të saj. Në kushtet kur përmes tyre kundërshtohej i njëjti vendim gjyqësor, ankimet janë shqyrtuar në një gjykim të vetëm dhe në përfundim, Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e organizuar (*GJKKO-ja e Apelit*), me vendimin nr. 167(87-2023-270), datë 27.11.2023, ka vendosur miratimin e vendimit të GJKKO-së së Shkallës së Parë. Edhe sipas asaj gjykate, ekzistojnë

kriteret ligjore që masa synon, nëpërmjet shmangies së disponimit të lirë të sendit që lidhet me veprën penale ose të sendit produkt i veprës penale, në ndalimin e rëndimit ose të zgjatjes së pasojave të veprës penale tashmë të konsumuar dhe eliminimin e lehtësirave të kryerjes së veprave të tjera penale. Ajo gjykatë ka vlerësuar se për vendosjen e masës së sigurimit pasuror, sikurse dhe sekuestroja preventive, kërkohet ekzistenca e dyshimit, prova e krimit *(fumus delicti),* duke qenë të parëndësishme njohja e autorit të krimit apo fajësia e tij, sikundër edhe përkatësia e pronësisë së sendit. Sipas saj, në rastin konkret krijohet dyshimi i arsyeshëm se përmes falsifikimit të dokumenteve nga kërkuesi i parë është arritur në përfitimin e parregullt të pronësisë mbi pasuritë e sekuestruara, të cilat në vijim u kanë kaluar të tretëve (ankuesve). Po sipas gjykatës, referuar llojit të sendit, disponimi i të cilit shkakton rrezik/dëm nga vonesa apo *periculum in mora*, formohen dy lloje të sekuestros preventive, ajo e detyrueshme dhe ajo e mundshme funksionale. Në rastin konkret, ka vlerësuar ajo gjykatë, disponimi i lirë i sendeve (pasurive) të lidhura ngushtësisht me veprat penale të falsifikimit të dokumenteve në kuadër të krimit të organizuar, jo vetëm ka rënduar dhe zgjatur pasojat e saj ose ka krijuar lehtësira për kryerjen e veprës tjetër penale "Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale", por dhe mund të vazhdojë të rëndojë, zgjasë pasojat e këtij krimi dhe të krijojë lehtësira për vepra të tjera penale, nëpërmjet, së paku, pastrimit të produkteve të veprës penale ose të veprimtarisë kriminale, duke u plotësuar kështu kërkesat sipas nenit 274, pika 1, të KPP-së, për vendosjen e sekuestros së detyrueshme. Po sipas saj, pasuritë e fituara nëpërmjet falsifikimit të dokumenteve në kuadër të krimit të organizuar krijojnë lidhjen ndërmjet veprave penale dhe sendit, duke qenë ato produkte të veprës penale (neni 36, pika 1, shkronja "b", i KP-së), situatë e cila përputhet me kërkesat e nenit 274, pika 2, të KPP-së, për vendosjen e sekuestros së mundshme funksionale.

12. Për rekursin e paraqitur nga tre kërkuesit dhe nga shoqëria "Xhenis-Sh." sh.p.k., Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, me vendimin nr. 00-2024-423, datë 07.03.2024, ka vendosur mospranimin e tyre. Për sa i përket rekursit të kërkuesve, ai kolegj ka arritur në përfundimin se shkaqet e parashtruara nuk referojnë në përcaktimet e nenit 432, pika 1, të KPP-së, pasi nuk janë të tilla që të paraqesin rëndësi për njësimin apo zhvillimin e praktikës gjyqësore, nuk sjellin pasojë në vlefshmërinë e vendimit, si dhe nuk evidentohet që vendimi i kundërshtuar të jetë në kundërshtim me praktikën e Kolegjit Penal ose të Kolegjeve të Bashkuara.

Ai kolegj ka vërejtur se sekuestroja preventive vendoset në prani të nevojave të sigurimit që lidhen me praninë e dyshimit për ekzistencën e veprës penale dhe me rrezikshmërinë e sendit, sipas dy situatave: kur sendi është i lidhur me veprën penale dhe disponimi i lirë i tij mund të rëndojë apo të zgjasë pasojat e veprës penale, ose të lehtësojë kryerjen e veprave penale të tjera; kur sendi është produkt i veprës penale ose çdo pasuri tjetër që mund të konfiskohet. Për sa i përket rastit konkret, ai kolegj e ka gjetur të drejtë, në kuptim të nenit 274 të KPP-së, qëndrimin e gjykatave më të ulëta për vendosjen e sekuestros preventive me qëllim që të pengohet çdo transferim i mundshëm i pasurive të paluajtshme, të dyshuara si produkte të veprës penale, ndërsa disponimi i lirë i tyre mund të sillte tjetërsimin tek të tretët, ligjërimin në qarkullimin civil, për rrjedhojë, do të vështirësonte në përfundim konfiskimin e tyre. Po sipas atij kolegji, në rastin konkret jemi para sekuestrimit si masë e përkohshme që kufizon të drejtën e disponimit të lirë të pronës kur përmbushen kushtet e parashikuara në ligj, ndaj, ndryshe nga sa pretendohet në rekurs, edhe sipas nenit 7 të Direktivës 42/2014 të Bashkimit Evropian (*BE*) (pavarësisht faktit nëse ajo është e zbatueshme në Republikën e Shqipërisë), një masë e tillë është e lejueshme edhe për pasuritë/sendet që disponohen nga të tretët kur ndaj tyre lejohet konfiskimi. Së fundi, Kolegji Penal ka vlerësuar se vendosja e masës së sigurimit pasuror është e domosdoshme dhe proporcionale në raport me faktet penale, për të cilat po hetohen të hetuarit, për të cilët ka dyshime të bazuara se kanë vepruar apo bashkëvepruar në kuadrin e një grupi të strukturuar kriminal dhe ndërhyrja ka qenë në përputhje me gjendjen që e ka diktuar atë dhe në proporcion të drejtë me qëllimin për të cilin është marrë.

13. Në datën 26.04.2024 Prokuroria e Posaçme ka paraqitur kërkesën për dërgimin në gjyq të procedimit penal nr. 9/2023 në ngarkim edhe të kërkuesit të parë, e cila është pranuar nga GJKKO-ja e Shkallës së Parë (gjyqtari i seancës paraprake) dhe çështja penale aktualisht është në gjykim. Nga ana tjetër, Prokuroria e Posaçme referon se materialet e procedimit penal nr. 9/2023, në lidhje me faktet penale që kanë të bëjnë me pasuritë e vendosura në sekuestro preventive, janë ndarë si procedim më vete, hetimi paraprak për të cilin është në vijim.

14. Në datën 25.10.2024, përmes shërbimit postar, të tre kërkuesit i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*), me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij, i cili është regjistruar në datën 28.10.2024.

15. Me vendimin e datës 27.12.2024 Kolegji i Gjykatës ka vendosur

kalimin e çështjes për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve dhe kjo e fundit, me vendimin e datës 20.01.2025, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve dhe thirrjen si subjekte të interesuara të palëve në procesin gjyqësor të kundërshtuar, të cilat në vijim janë njoftuar rregullisht. Subjekti i interesuar, shoqëria "Xhenis-Sh" sh.p.k., në parashtrimet e datës 20.02.2025, ka kundërshtuar procesin gjyqësor objekt i ankimit kushtetues, duke ngritur pretendime për cenimin e të drejtave të saj kushtetuese për shkak të masës së sekuestros preventive mbi pasurinë e regjistruar në pronësi të këtij subjekti. Gjykata, duke pasur parasysh se subjektet e interesuara thirren në gjykim në mënyrë që të kontribuojnë në shqyrtimin e çështjes që po gjykohet, në rastin konkret në lidhje me ankimin kushtetues individual të kërkuesve, si dhe në situatën kur ky subjekt i interesuar edhe pse ka qenë palë në procesin gjyqësor objekt të këtij gjykimi, nuk i është drejtuar në formë dhe në përmbajtje Gjykatës për kundërshtimin e tij me ankim kushtetues individual për sa masa e sekuestros ka prekur interesat e tij, kërkimet ngushtësisht personale të paraqitura nga ky subjekt, për sa kohë nuk lidhen dhe as kontribuojnë për çështjen në këtë gjykim, nuk u morën në konsideratë.

16. Në datën 06.03.2025 kërkuesi i parë dhe kërkuesi i dytë i janë drejtuar Gjykatës me kërkesë për përjashtimin e një gjyqtari nga shqyrtimi i kësaj çështjeje, për të cilën Mbledhja e Gjyqtarëve, me vendimin e datës 26.03.2025, ka vendosur rrëzimin e saj si të pabazuar.

II
Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

17. ***Kërkuesit,*** në mënyrë të përmbledhur, kanë pretenduar se u është cenuar:

17.1. *E drejta e pronës private,* për shkak të shkeljes së normave kushtetuese dhe konventore që lejojnë masat e sigurimit pasuror në procedurën penale, pasi:

17.1.1. Ndërhyrja në të drejtën e pronës private *nuk është bazuar në ligj*, sepse legjislacioni penal material dhe procedural lejon kufizimet e kësaj të drejte vetëm ndaj personave që dyshohet se kanë kryer veprën penale dhe në kushtet kur në përfundim të gjykimit për ata mund të jepet edhe dënimi plotësues i parashikuar në nenet 32, pika 2 dhe 36 të KP-së. Vendimet gjyqësore kanë interpretuar në mënyrë të zgjeruar

përmbajtjen e neneve 274-276 të KPP-së, pasi kërkuesi i dytë dhe i tretë nuk kanë kryer ndonjë veprim të paligjshëm dhe as dyshohen se mund të kenë kryer ndonjë prej veprave penale të procedimit penal në kuadër të të cilit u vendos masa e sekuestros. Gjykatat kanë neglizhuar mirëbesimin e këtyre kërkuesve në kohën kur janë bërë titullarë të ligjshëm të pasurive të vendosura në sekuestro. Konfiskimi është një nga llojet e dënimeve plotësuese, që paraprihet nga sekuestro preventive, por ka të njëjtën natyrë, bie mbi personin dhe jo mbi pasurinë. Prokuroria, edhe pse ka barrën e provës, nuk ka provuar se ekziston "dyshimi i arsyeshëm" për përgjegjësinë personale të kërkuesit të dytë dhe të tretë në kryerjen e veprës penale, kohën e përfshirjes në veprimtari kriminale në raport me kohën e krijimit të pasurisë që kërkohet të sekuestrohet, madje edhe lidhjen e krimit me atë pasuri. Ndërkohë që neni 190, pika 1, shkronja "a", i KPP-së parashikon përjashtimin nga konfiskimi të sendeve të personave që nuk kanë marrë pjesë në kryerjen e veprës penale.

17.1.2. Ndonëse legjislacioni penal nuk e njeh *konceptin e "konfiskimit të zgjeruar" në procesin penal,* edhe nëse supozohet aplikimi i Direktivës 42/2014 të BE-së, nuk do të kishte qenë e mundur vendosja e sekuestros preventive, pasi direktiva mbron interesat pasurorë të palëve të treta në mirëbesim. Nga vendimet gjyqësore nuk rezulton që kontratat e lidhura mes shtetases D.H.(Gj.) dhe kërkuesve të kenë qenë fiktive ose me qëllim mashtrimin e ligjit, përkundrazi, palët kanë përmbushur detyrimet e tyre, duke paguar kërkuesi i dytë shumën e parave të blerjes përmes bankës. Konfiskimi i zgjeruar sipas direktivës lejon ndjekjen e produkteve të krimit te personat e tretë me kushtin që të jenë në keqbesim, ndërkohë që masat pasurore nuk mund të cenojnë pasuri të personit të tretë të fituar në mirëbesim.

17.1.3. Masa e sekuestros preventive *nuk respekton parimin e proporcionalitetit të ndërhyrjes.* Ajo përbën një masë ekstreme, për sa kohë që pronarët e ligjshëm janë zhveshur *de facto* nga çdo e drejtë reale mbi pasuritë e tyre, ndërkohë që kërkuesi i dytë është penguar që të zhvillojë pronën sipas lejes së marrë nga organi kompetent shtetëror. Dëmi i

shkaktuar këtij kërkuesi është joproporcional, ndaj masa nuk është e përshtatshme me nevojat e sigurimit, pasi mund të urdhërohej kryerja e shënimeve në kartelat e pasurisë për të garantuar mostjetërsimin e pronës tek të tretët. Masa është e ashpër dhe disproporcionale në raport me pasojat ekonomike të pronarit dhe interesin publik për zhvillimin e turizmit në atë zonë. Kërkuesi i dytë nuk ka qenë palë në kontratën e shitblerjes fillestare prej pronares dhe ka qenë në mirëbesim. Ai ka kryer studimin gjeoteknik të terrenit dhe ka përgatitur projektin për ndërtimin e kompleksit turistik, duke ndjekur procedurën administrative deri te miratimi i lejes. Përpara se të jepej leja nga Këshilli Kombëtar i Territorit, ai ka kërkuar të konfirmohen të drejtat e pronësisë, çka rezulton nga shkresa e ASHK-së. Kur u caktua masa e kundërshtuar kishin filluar punimet ndërtimore, të cilat u ndërprenë, duke pësuar kështu kërkuesi i dytë një dëm të konsiderueshëm ekonomiko-financiar. Masa e sekuestros ka prekur edhe interesat publikë për zhvillimin e zonës, duke qenë se projekti është pjesë e investimeve strategjike. Masa më e përshtatshme do të ishte vendosja e kufizimeve në regjistrat e ASHK-së, ndërkohë që marrja në administrim nga AAPSK-ja e ka zhveshur tërësisht kërkuesin e dytë nga çdo tagër dhe nga e drejta për zhvillimin e pronës.

17.1.4. Në fashikullin gjyqësor nuk gjendet asnjë provë që të lidhë në mënyrë direkte ose indirekte kërkuesin e parë me pasuritë e sekuestruara, edhe pse gjykatat e kanë pranuar *apriori* këtë. Edhe pse është nipi i së ndjerës D.H.(GJ.), ai nuk provohet të jetë angazhuar në veprimet administrative të kryera për kthimin e pasurisë, ndërsa pas regjistrimit të pronës me vendim gjyqësor civil të formës së prerë, shoqëria "Imperial C. Construction" sh.p.k. e ka blerë sipas kontratës noteriale dhe është depozituar çmimi në llogarinë e noteres. Edhe pse kjo shoqëri është përthithur nga shoqëria kërkuese e dytë, ku kërkuesi i parë ka shumicën e aksioneve, në kohën e transaksionit ndaj këtij të fundit nuk kishte asnjë procedim penal. Kërkuesi i tretë është vëllai i së ndjerës D.H.(Gj.), ndaj është e pranueshme dhe e ligjshme kontrata e dhurimit të pasurisë nr. 1083/6. Në datat e kryerjes së këtyre transaksioneve ndaj kërkuesit të parë

nuk ka pasur ndonjë proces penal, ndaj edhe në këndvështrim të konfiskimit të zgjeruar (pavarësisht se nuk aplikohet në Shqipëri), pasuritë e kërkuesit të dytë dhe të tretë nuk mund të ishin objekt sekuestrimi. Në lidhje me problematikat që kanë dalë në vitin 2021, kërkuesi i parë nuk ka pasur mundësi të dinte dyshimet për origjinalitetin e dokumenteve në favor të ish-pronares të dala nga AQSH-ja në datën 07.06.2013. Përgjigja e AQSH-së është shoqëruar me fotokopje të dokumenteve përkatëse, përmbajtja e të cilave është verifikuar nga shumë institucione dhe nga ekzaminimet grafike ka rezultuar se në to nuk ka pasur ndërhyrje. Dokumentet e dala nga ky institucion janë dorëzuar në të njëjtën gjendje në gjykatë, duke u bërë pjesë e dosjes gjyqësore.

17.1.5. Lidhja e kërkuesit të parë me dyshimet për falsifikim të dokumenteve bazohet vetëm në të dhënat e komunikimeve në platformën SkyEcc, të dërguara nga autoritetet franceze, të cilat pretendohet se i përkasin muajit shkurt 2021, kurse shtetasja D.H.(Gj.) e ka fituar të drejtën e pronësisë me vendim gjyqësor të formës së prerë në vitin 2014 dhe kalimet e pronësisë janë bërë në vitet 2016 e 2017. Të dhënat e komunikimeve në platformën SkyEcc janë të papërdorshme, pasi janë prova të mbledhura në kundërshtim me ligjin. Gjithsesi, ato nuk vërtetojnë përfshirjen e kërkuesit të parë në falsifikimin e dokumenteve brenda AQSH-së përpara vitit 2013. Për më tepër, GJKKO-ja e Apelit nuk ka arsyetuar për shkakun e ankimit që lidhet me papërdoshmërinë e të dhënave të marra me letërporosi nga autoritetet franceze, si të mbledhura në kundërshtim me legjislacionin shqiptar, për sa kohë ato janë rezultat i përgjimeve masive, duke qenë për këtë shkak të papërdorshme edhe në këtë gjykim. Procesi i identifikimit të kërkuesit të parë si përdorues i një kodi Pin ka qenë i paligjshëm dhe shkel edhe standardet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*GJEDNJ*) për domosdoshmërinë që ndërhyrja në të drejtat e mbrojtura nga neni 8, pika 2, i KEDNJ-së duhet të jetë e bazuar në legjislacionin e brendshëm. Në kuptim të nenit 32, pika 2, të Kushtetutës ato duhet të përjashtohen si provë, pasi përbëjnë të dhëna të mbledhura në mënyrë të paligjshme.

17.2. *E drejta për proces të rregullt* në drejtim të:

17.2.1. *Së drejtës së aksesit,* pasi gjykimi në GJKKO-në e Shkallës së Parë është zhvilluar pa u njoftuar, thirrur dhe dëgjuar palët e treta që janë prekur në të drejtën e pronës nga sekuestrimi arbitrar i pasurive të tyre. Referuar dispozitave procedurale që rregullojnë sekuestron preventive, përpara dhe pas ndryshimeve të vitit 2017, ato nuk parashikojnë një mënyrë të veçantë gjykimi, sikurse është ai kameral (në dhomë këshillimi). Ligjvënësi, duke heshtur, ka pranuar se gjykimi i këtyre kërkesave duhet të bëhet me urgjencë, por me njoftimin e palëve, prandaj konfondimi i kësaj procedure me atë për caktimin e masave të sigurimit personal, sipas nenit 244 të KPP-së, është e gabuar dhe në shkelje të vullnetit të ligjvënësit. Ndërsa në procedura të tjera ligjvënësi ka shprehur vullnetin për shqyrtimin e kërkesave të tilla në dhomën e këshillimit (ligji nr. 10192/2009), në përmbajtjen e neneve 274 dhe 275 të KPP-së, ai ka konfirmuar vullnetin për gjykimin e tyre në seancë gjyqësore me prani të palëve. Kjo shkelje nuk u riparua nga gjykatat më të larta.

17.2.2. *Parimit të barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit*, pasi për shkak të zhvillimit të seancës në dhomën e këshillimit, GJKKO-ja e Shkallës së Parë nuk ka lejuar debatin për provat mbi të cilat është kërkuar masa e sekuestros. Kjo shkelje u thellua nga gjykata e apelit, e cila zhvilloi një seancë gjyqësore formale ku vetëm dëgjoi parashtrimet e ankuesve, por nuk lejoi debatin gjyqësor, as shqyrtimin dhe verifikimin në seancë gjyqësore të përmbajtjes së akteve e të dokumenteve të paraqitura nga prokuroria. Gjykata e Lartë nuk e pranoi këtë shkak rekursi duke dhënë një arsyetim të përgjithshëm. Gjykata e Lartë nuk i dëgjoi kërkuesit edhe pse ata kishin parashtruar çështje të ligjit dhe të faktit, për sa kohë pretendimet kishin të bënin edhe me parimin e ligjshmërisë në caktimin e masës.

17.2.3. *Standardit të arsyetimit*, pasi gjykatat nuk kanë respektuar përmbajtjen e nenit 274, pika 1, të KPP-së, por i kanë arsyetuar vendimet në mënyrë të përgjithshme, duke ndërhyrë në të drejtën e pronës së kërkuesit të dytë dhe të tretë, të cilët nuk janë nën hetim, ndaj tyre nuk ka pasur procedim

penal apo ndonjë indicie ose dyshim se kanë kryer ndonjë vepër penale. Gjykatat kanë zbatuar në mënyrë të gabuar nenin 274, pika 2, të KPP-së në lidhje me nenin 36 të KP-së, i cili zbatohet vetëm për pasuritë e personit nën hetim. Masa është në shkelje të nenit 7 të KEDNJ-së dhe praktikës së GJEDNJ-së. Kërkuesit në fjalë kanë qenë në mirëbesim kur kanë fituar pasuritë. Po kështu, direktiva e re e BE-së 2024/1260, datë 24.04.2024 përcakton paprekshmërinë e pronës private të personave të tretë/të interesuar/të dëmtuar/viktimave etj., të cilët jo vetëm nuk kanë marrë pjesë në kryerjen e veprave penale, por e kanë fituar pasurinë në mirëbesim. Gjykatat u kanë dhënë vlerë të dhënave të marra në mënyrë të paligjshme dhe kanë zhvendosur efektin e tyre disa vite më parë (2013-2017), kur aplikacioni SkyEcc nuk ishte në përdorim. Gjykatat kanë zhbërë vendimet gjyqësore të formës së prerë në lidhje me tagrat e pronësisë së shtetases D.H.(Gj.), por edhe të dhënat e akteve shkresore dhe provave të tjera, duke shkelur detyrimin për të verifikuar praninë e *fumus commissi delicti.* Ato kanë pranuar *apriori* kërkesën e prokurorisë, pa analizuar veprimtarinë konkrete të kërkuesit të tretë ose të administratorit të kërkuesit të dytë në raport me tërësinë e provave, në kundërshtim me procesin e drejtë. Masat e sigurimit pasuror kushtëzohen nga disa faktorë, për të cilat barrën e provës e ka prokuroria, që lidhen me fajësinë për veprën penale, vërtetimin e përgjegjësisë personale të pronarit në kryerjen e veprës penale në kohën e përfshirjes së tij në veprimtarinë kriminale, lidhjen mes veprës penale dhe pasurisë që sekuestrohet.

17.2.4. *Parimit të paanshmërisë,* pasi gjykatat kanë qenë të prirura të pranojnë *apriori* kërkesën e prokurorisë edhe sepse janë nën "presionin" e organit procedues për shkak të përgjimeve të komunikimeve të tyre dhe familjarëve nga struktura e Byrosë Kombëtare të Hetimit *(BKH)*, që varet nga ai (Prokuroria e Posaçme).

17.2.5. *Parimit të sigurisë juridike*, pasi kërkuesi i dytë dhe i tretë e kanë fituar titullin e pronësisë shumë vite përpara se të regjistrohej procedimi penal nr. 9/2023, ndërsa shitësja D.H.(Gj.) i kishte fituar tagrat e pronësisë në bazë të vendimeve gjyqësore të

formës së prerë. Ata janë bërë pronarë të ligjshëm të pasurive të sekuestruara në kushtet kur pala shitëse/dhuruese gëzonte titull të ligjshëm pronësie të regjistruar rregullisht. Vendimi gjyqësor i formës së prerë përbën mënyrë origjinale të fitimit të pronës dhe sipas nenit 451/a të Kodit të Procedurës Civile (*KPC*) është i detyrueshëm, ndërsa efektet e tij nuk mund të vihen në diskutim, përveçse sipas institutit të rishikimit të rregulluar nga nenet 494 e vijues i këtij kodi. Nuk rezulton të jetë dhënë ndonjë vendim penal i formës së prerë për falsifikimin e dokumenteve me të cilat është bërë pronare e ndjera D.H.(Gj.) dhe as të jetë paraqitur ndonjë kërkesë për rishikimin e vendimit civil të formës së prerë, ndaj ndërhyrja në të drejtat e pronësisë të kërkuesve në fjalë është në shkelje të parimeve të ligjshmërisë dhe të sigurisë juridike. Po kështu, këta kërkues kanë qenë në mirëbesim kur kanë fituar pasuritë. Procedura e kalimit të pronësisë është bërë disa vite përpara hyrjes në fuqi të ligjit nr. 20/2020. Ky parim është cenuar edhe sepse gjykatat nuk kanë marrë në konsideratë as përfundimet në vendimin për pushimin e hetimeve të vitit 2022.

18. ***Subjekti i interesuar, Prokuroria e Posaçme**,* ka prapësuar si vijon:

18.1. Pretendimi për mungesën e lidhjes të të hetuarit, kërkuesit të parë, me pasuritë objekt sekuestro, si dhe se gjykatat kanë pranuar *apriori* versionin hipotetik të Prokurorisë së Posaçme se pasuritë e sekuestruara janë pronë e këtij shtetasi është i gabuar dhe anashkalon provat e administruara në hetim. Ndryshe nga sa pretendohet, në hetim janë grumbulluar prova që sjellin të dhëna në këtë drejtim dhe konkretisht:

18.1.1. E pyetur në datën 13.01.2021 për prokurën e nënës së saj D.H.(Gj.) për shtetasin A.B., kallëzuesja L.Z. ka deklaruar se nëna e saj nuk dinte të shkruante, të lexonte ose të nënshkruante dhe maksimumi që mund të bënte ishte të vendoste gishtin në letër. Ajo ka deklaruar se bëhet fjalë për një pronë në Velipojë që ndodhet afër një resorti të madh, me sipërfaqe 365 dynymë, për të cilën nëna nuk u ka folur kurrë, por në regjistrin e vitit 1935 rezultonte pronare. Këtë pronë e ka poseduar vazhdimisht kërkuesi i parë, i cili ka bërë edhe veprimet për ta bërë të vetën. Vetëm diku rreth vitit 2015 ajo ka marrë vesh për herë të parë se nëna e saj ka prona.

18.1.2. Shtetasi A.B., përfaqësuesi me prokurë i D.H.(Gj.), i pyetur si person që ka dijeni për veprën penale, ka deklaruar se kërkuesin e parë e ka kushëri dhe ka marrëdhënie të afërta me të. Nga këqyrja e sistemit C@ts të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, rezulton se shtetasja S.B. ka qenë e punësuar pranë shoqërisë, kërkueses së dytë, me aksionar me 56% të kuotave kërkuesin e parë. Nga këqyrja e datës 03.10.2023, për vendndodhjen e pasurive të mësipërme, rezulton se ato kufizohen nga ana perëndimore me muret kufizuese të objektit "Grand Hotel Evropa Resort", nga ana veriore me rrugën e asfaltuar, nga ana lindore me plazhin e Velipojës dhe nga ana jugore me bregdetin. Në këtë sipërfaqe trualli nuk u konstatua asnjë ndërtim brenda tij.

18.1.3. Komunikimet në aplikacionin SkyEcc mes përdoruesit me kodin pin xxxxxx (kërkuesi i parë) dhe përdoruesit me kodin pin xxxxxx (prokurori Xh.L.) tregojnë përfshirjen dhe angazhimin e tyre me veprime konkrete për kompromet imin e konkluzioneve të aktit të ekspertimit grafik nr. 1802, datë 19.02.2021, i cili nuk ka konstatuar falsifikime. Ky akt është në mbështetje të vërtetësisë së dokumenteve, të cilat kanë shërbyer për fitimin e pronës nga shtetasja D.H.(Gj.) (emta e kërkuesit të parë). Ky komunikim është zhvilluar në periudhën 16-18 shkurt 2021, pra tre deri në një ditë përpara se të kryhej akti i ekspertimit grafik, i cili, nga ana tjetër, bie në kundërshtim me përfundimet e akteve të ekspertimit grafik nr. 639, datë 27.01.2022 dhe nr. 5398, datë 06.05.2022, të kryera në kuadër të hetimeve të të njëjtit procedim penal. Dokumentet e konstatuara të falsifikuara sipas këtyre të fundit (aktet e ekspertimit) janë përdorur në procesin e njohjes së pronësisë të shtetases D.H.(Gj.) nga përfaqësuesit me prokurë A.B. dhe S.B. Në kushtet kur ka dyshime të arsyeshme, të bazuara në prova, se pasuritë janë fituar nëpërmjet falsifikimit të dokumenteve të kryer edhe nga kërkuesi i parë, ekziston rreziku që këto pasuri, të cilat janë produkte të veprës penale, të tjetërsohen te persona të tretë.

18.2. Pretendimi i kërkuesve për cenimin e së drejtës së aksesit bazuar në argumentin se nuk janë njoftuar, thirrur dhe dëgjuar palët që preken rëndë në të drejtat e tyre pronësore nga sekuestrimi, është

i pabazuar. Neni 244, pika 1, i KPP-së parashikon se vendimi i gjykatës për kërkesën e prokurorit për caktimin e masave të sigurimit merret në dhomën e këshillimit, duke mos lënë kjo dispozitë ligjore asnjë hapësirë paqartësie në këtë drejtim. Të njëjtin arsyetim ka përdorur edhe gjykata e apelit dhe Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë kur kanë shqyrtuar dhe rrëzuar ankimin dhe rekursin e palës kërkuese për këtë pretendim.

18.3. I pabazuar është edhe pretendimi për cenimin e parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit, për shkak të shqyrtimit të kërkesës së Prokurorisë së Posaçme në dhomën e këshillimit. Kërkuesit e kanë ankimuar vendimin e gjykatës së shkallës së parë dhe përpara gjykatës së apelit kanë pasur mundësinë të paraqesin të gjitha provat dhe pretendimet e tyre, ndërkohë që ajo gjykatë në përfundim të shqyrtimit u ka dhënë përgjigje të arsyetuar të gjitha pretendimeve të ngritura. Ky pretendim është shqyrtuar edhe nga Gjykata e Lartë, e cila e ka gjetur të pabazuar.

18.4. I pabazuar është edhe pretendimi për cenimin e parimit të sigurisë juridike. Sipas kërkuesve, ata e kanë fituar titullin e pronësisë shumë vite përpara se të regjistrohej procedimi penal nr. 9/2023 dhe se shitësja D.H.(Gj.) i kishte fituar tagrat e pronësisë në bazë të vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Ndërkohë, neni 451/a i KPC-së zbatohet në çështje civile dhe parashikon se vendimi gjyqësor i formës së prerë ka fuqi vetëm për çka është vendosur midis po atyre palëve, për të njëjtin objekt dhe për të njëjtin shkak ligjor të padisë. Në rastin konkret, jemi përpara një mase sigurimi pasuror në kuadër të një procedimi penal, e cila vendoset në kushtet e parashikuara nga KPP-ja. Kjo është një masë e përkohshme dhe e verifikueshme në raport me kushtet e zbatimit të saj. Ndërkohë, efektet e procedimit civil dhe administrativ në atë penal, janë parashikuar shprehimisht në nenin 71 të KPP-së, për rrjedhojë ky pretendim haptazi nuk ka lidhje me parimin e sigurisë juridike.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkuesve

19. Çështja e legjitimimit *(locus standi)* është vlerësuar si një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të

Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, shterimin e mjeteve juridike, si dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

20. Lidhur me legjitimimin *ratione personae*, Gjykata ka pohuar se sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, individi mund të paraqesë ankim kushtetues individual vetëm për çështje që lidhen me interesat e tij, duke provuar se është cenuar në të drejtat e tij kushtetuese, pra se është viktimë e një shkeljeje dhe se pasojat nga akti i kundërshtuar janë të drejtpërdrejta dhe reale për të. Kjo do të thotë se kërkuesi duhet të provojë legjitimimin e tij si në aspektin procedural, ashtu edhe në atë substancial (*shih vendimin nr. 16.04.2024 të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Për sa u përket kërkuesve të dytë (shoqëria "Imperial Group" sh.a.) dhe të tretë (Kolë Gjoka), ata kanë qenë pala ankuese që ka vënë në lëvizje gjykatat më të larta për kundërshtimin e vendimit të GJKKO-së së Shkallës së Parë që ka pranuar kërkesën e Prokurorisë së Posaçme, duke vendosur masën e sigurimit pasuror "Sekuestro preventive" mbi pasuritë e tyre. Për rrjedhojë, ata provojnë interesin e tyre në aspektin procedural dhe atë substancial në drejtim të pasojave reale dhe të drejtpërdrejta në të drejtat kushtetuese të pretenduara të cenuara nga vendimet e kundërshtuara. Po kështu, në lidhje me legjitimimin e kërkuesit të dytë, në kuptim të nenit 16 të Kushtetutës, të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë vlejnë edhe për personat juridikë, për aq sa përputhen me qëllimet e përgjithshme të tyre dhe me thelbin e këtyre të drejtave e lirive. Ky kërkues është person juridik i krijuar sipas legjislacionit shqiptar dhe ka vënë në lëvizje gjykimin kushtetues për mbrojtjen e të drejtave të tij kushtetuese të pretenduara të cenuara, për të cilat Kushtetuta ofron të njëjtën mbrojtje si për personat fizikë.

22. Për sa i përket kërkuesit të parë (Pëllumb Gjoka), edhe pse ai ka qenë gjithashtu pala ankuese në procesin gjyqësor të kundërshtuar, në fakt rezulton që ai të jetë aksionar në shoqërinë kërkuese të dytë, por nuk rezulton që masa e sekuestros të jetë vendosur mbi pasuri që janë

të regjistruara në emër të tij, pra nuk rezulton që ai *de jure* të mbartë të drejta pasurore për pasuritë e paluajtshme objekt sekuestro. Sipas GJEDNJ-së, në lidhje me ankesat e shoqërive (*shih Agrotexim etj. kundër Greqisë, 1995, §§ 64-71*), një person nuk mund të ankohet për shkeljen e të drejtave të tij në procedura në të cilat nuk është palë edhe nëse është aksionar dhe/ose drejtor i një shoqërie që ishte palë në ato procedura (*shih Centro Evropa 7 S.r.l. dhe Di Stefano kundër Italisë [DhM], 2012, §§ 92-93*). Po kështu, kërkuesi në fjalë nuk rezulton të ketë vepruar në rastin konkret as në cilësinë e përfaqësuesit të shoqërisë kërkuese. Interesat e tij si aksionar i kësaj shoqërie përthithen nga kjo e fundit, duke qenë ajo subjekti i së drejtës që mbart interesa për pasuritë e regjistruara në emër të saj dhe që mund të ankohet për shkelje të të drejtave të lidhura me ato pasuri, gjë të cilën ajo për më tepër në rastin konkret e ka bërë. Për rrjedhojë, kërkuesi Pëllumb Gjoka nuk legjitimohet *ratione personae* në aspektin substancial për t`iu drejtuar Gjykatës.[1]

23. Për sa më lart, Gjykata vlerëson të vijojë shqyrtimin e çështjes vetëm për sa u përket kërkuesve të dytë dhe të tretë.

24. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, Gjykata ka pohuar se në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës, mbrojtja kushtetuese ka një funksion *subsidiar*, që do të thotë se ajo mund të kërkohet vetëm për një vendim përfundimtar, të çfarëdolloj forme që përmbyll procesin gjyqësor, pasi individi ka shteruar mjetet dhe rrugët e tjera ligjore. Cenimi i të drejtave themelore, përfshirë atë për një proces të rregullt ligjor, mund të pretendohet në këtë Gjykatë vetëm pasi të shterohen të gjitha mundësitë e ofruara nga sistemi i apelimeve. Në rastin konkret, objekt kundërshtimi janë vendimet gjyqësore të të tria shkallëve të gjykimit me të cilat është lejuar vendosja e sekuestros preventive mbi pasuritë e paluajtshme të kërkuesve. Nisur nga fakti se Gjykata i ka

[1] Gjyqtaret Holta Zaçaj, Marsida Xhaferllari dhe Sonila Bejtja mbajtën qëndrimin se kërkuesi Pëllumb Gjoka legjitimohet *ratione personae* për t`iu drejtuar Gjykatës. Në vlerësimin e këtyre gjyqtareve kërkuesi i parë justifikon interesin në çështjen e parashtruar, në kushtet kur ai, ashtu siç kanë evidentuar edhe gjykatat e zakonshme, përfshihet në rrethin e personave të interesuar për sekuestrimin, të cilët kanë të drejtën e ankimit sipas dispozitave të KPP-së, si dhe në kushtet kur ai është subjekt i procedimit penal gjatë të cilit është vendosur sekuestrimi i pasurisë me argumentin se disponimi i lirë i sendeve rëndon pasojat dhe lehtëson kryerjen e veprave penale, për të cilat vetë kërkuesi i parë është person i dyshuar. Për më tepër, vlerësimi i shumicës për moslegjitimimin e kërkuesit të parë nuk sjell ndonjë pasojë praktike në zgjidhjen e çështjes, në kushtet kur të tre kërkuesit paraqesin të njëjtat kërkime, me të njëjtin objekt dhe shkaqe.

përfshirë në juridiksionin e saj këto vendime, të cilat ndonëse me karakter të përkohshëm dhe që nuk vendosin për themelin e çështjes, ndërhyjnë në të drejtat kushtetuese individuale (*shih vendimet nr. 29, datë 16.04.2024; nr. 18, datë 19.03.2024 të Gjykatës Kushtetuese*), konsiderohet se ato përfshihen në juridiksionin kushtetues.

25. Për sa u përket pretendimeve të parashtruara në ankimin kushtetues individual rezulton se pretendimin për cenimin e *parimit të paanshmërisë,* pasi gjykata e shkallës së parë dhe ajo e apelit kanë qenë të prirura të pranojnë *apriori* kërkesën e prokurorisë edhe sepse janë nën "presionin" e organit procedues për shkak të përgjimeve të komunikimeve të tyre dhe të familjarëve nga struktura e BKH-së, që varet nga ai (Prokuroria e Posaçme), kërkuesit nuk e kanë ngritur më parë në formë e substancë në ankimet në gjykatat më të larta të juridiksionit të zakonshëm, por e kanë parashtruar për herë të parë përpara kësaj Gjykate. Për rrjedhojë, kërkuesit nuk kanë shteruar mjetet juridike për këtë pretendim. Kurse për sa u përket pretendimeve të tjera të parashtruara në ankimin kushtetues, rezulton se kërkuesit kanë përmbushur kriterin e shterimit të mjeteve juridike.

26. Kërkuesit legjitimohen edhe *ratione temporis*, në kuptim të përmbajtjes së nenit 71/a, pika 1, shkronja "b", të ligjit nr. 8577/2000, pasi vendimi gjyqësor më i fundit në kohë i kundërshtuar, ai i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, mban datën 07.03.2024, i cili, sipas informacionit të dërguar nga Gjykata e Lartë, është publikuar në faqen e saj zyrtare më 27.06.2024, ndërsa kërkesa është dërguar në Gjykatë përmes shërbimit postar në datën 25.10.2024, pra brenda afatit 4-mujor.

27. Gjykata konstaton se pas njoftimit të palëve për kalimin e çështjes për shqyrtim në seance plenare, kërkuesit, në parashtrimet shtesë drejtuar Gjykatës, kanë pretenduar, mes të tjerash, cenim të: nenit 7 të KEDNJ-së, që parashikon se askush nuk mund të dënohet për një veprim ose një mosveprim që në momentin kur është kryer nuk përbënte vepër penale sipas së drejtës së brendshme ose ndërkombëtare, e lidhur me kjo me mirëbesimin e palëve që nuk janë objekt i procedimit penal; së drejtës së aksesit dhe asaj për t`u dëgjuar për çështje të ligjit dhe faktit, si dhe parimit të barazisë së armëve në gjykatat e zakonshme; të drejtave në këndvështrim të Direktivës së re të BE 2024/1260 të datës 24.04.2024 për rikuperimin dhe konfiskimin e pasurive. Nga sa konstatohet, Gjykata, në të njëjtën linjë qëndrimi që ka mbajtur edhe në çështje të ngjashme (*shih vendimet nr. 4, datë 21.01.2025; nr. 21, datë 22.04.2025 të Gjykatës Kushtetuese*), çmon se pretendimet e parashtruara pas kalimit të çështjes për shqyrtim në

seancë plenare, përmes të cilave ngrihen shkaqe të reja ankimi, nuk mund të merren në shqyrtim, sepse duhet të respektojnë kriteret e përgjithshme të formës dhe të afateve të paraqitjes, të cilat i nënshtrohen fillimisht procedurës së shqyrtimit paraprak.

28. Në lidhje me legjitimimin *ratione materiae* kërkuesit kanë pretenduar si cenimin e *së drejtës për proces të rregullt,* ashtu edhe të *normave kushtetuese dhe konventore që lejojnë masat e sigurimit pasuror në procedurën penale* në drejtim të *së drejtës së pronës private dhe kritereve që lejojnë kufizimin e saj*.

29. Në drejtim të së drejtës për proces të rregullt kërkuesit kanë pretenduar cenimin e *së drejtës së aksesit* dhe të *parimit të barazisë së armëve e kontradiktoritetit* për shkak të formës së gjykimit në shkallë të parë në dhomën e këshillimit dhe moslejimit të debatit për provat as në gjykatën e apelit, shkelje që, sipas tyre, nuk janë marrë parasysh nga Gjykata e Lartë. Sipas kërkuesve, në rastin e masave të sigurimit me karakter pasuror, nuk mund të gjejnë zbatim parashikimet e nenit 244 të KPP-së, të cilat zbatohen për masat e sigurimit personal dhe për sa kohë që ligjvënësi nuk ka parashikuar në mënyrë të shprehur gjykimin në dhomën e këshillimit për këto kërkesa, duhet të zbatohen rregullat e përgjithshme të gjykimit. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Posaçme, ka prapësuar se këto pretendime janë të pabazuara, pasi parashikimi i nenit 244, pika 1, të KPP-së nuk lë asnjë hapësirë paqartësie se vendimi merret në dhomën e këshillimit dhe se kërkuesit e kanë ankimuar vendimin e gjykatës së shkallës së parë dhe përpara gjykatës së apelit ata kanë pasur mundësinë të paraqesin të gjitha provat dhe pretendimet e tyre, për të cilat kanë marrë përgjigje të arsyetuar.

30. Referuar përmbajtjes së nenit 274 të KPP-së, që rregullon masën e sigurimit pasuror të sekuestros preventive, kur ka rrezik që disponimi i lirë i një sendi që lidhet me veprën penale mund të rëndojë ose të zgjasë pasojat e saj ose të lehtësojë kryerjen e veprave penale të tjera, me kërkesën e prokurorit, gjykata kompetente urdhëron sekuestrimin e tij me vendim të arsyetuar dhe sipas nenit 276 të KPP-së, kundër vendimit për vënien ose mosvënien e sekuestros, cilido që ka interes mund të bëjë ankim, duke mos parashikuar këto dispozita një formë të caktuar shqyrtimi në këtë shkallë gjykimi. Gjykatat e zakonshme kanë arsyetuar në vendimet e tyre edhe në lidhje me procedurën që ndiqet për vlerësimin e kërkesës së prokurorit, duke konsideruar se debati kontradiktor mes palëve zhvillohet në gjykimin në apel, në rast ankimi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë (*shih*

faqen 3 të vendimit të GJKKO-së së Shkallës së Parë) dhe se dispozitat procedurale, për sa i përket formës së gjykimit, nuk kanë bërë dallim midis masave të sigurimit në personale ose pasurore, duke mos lënë hapësirë për paqartësi në drejtim të shqyrtimit të këtyre masave në dhomën e këshillimit, vetëm në bazë të dokumenteve të paraqitura nga prokurori (*shih faqet 5 dhe 6 të GJKKO-së së Apelit*). Edhe Kolegji Penal i ka marrë në shqyrtim këto pretendime dhe ka vlerësuar se neni 244 i KPP-së ka një rregullim të përgjithshëm dhe në këtë rast kontradiktoriteti është siguruar në gjykatën e apelit, ku palëve u është dhënë mundësia që të parashtrojnë pretendimet e tyre dhe të dëgjohen për to (*shih paragrafin 24 të vendimit të Kolegjit Penal*).

31. Gjykata ka pohuar se procedurat gjyqësore që vendosin për kërkesat e prokurorit gjatë hetimit paraprak, të cilat ndërhyjnë në të drejtat themelore, si rregull, duhet të sigurojnë garancitë e duhura të procesit të rregullt për individin. Megjithatë, ligji i ka kufizuar disa prej garancive të procesit të rregullt në këtë fazë në raport me ato të gjykimit të themelit. Kështu, kur liria personale kufizohet nga caktimi i masës së sigurimit të arrestit, ligji ka kufizuar parimin e barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit (në drejtim të thirrjes së dëshmitarëve ose marrjes së provave), i cili nuk zbatohet në të njëjtën masë dhe mënyrë si në gjykimin e themelit (*shih vendimin nr. 86, datë 30.12.2024 të Gjykatës Kushtetuese*). Nga ky këndvështrim, Gjykata vlerëson se ligjvënësi në këto raste, duke mos parashikuar dëgjimin e individit dhe një debat kontradiktor përpara gjyqtarit të hetimit paraprak, si dhe duke mos i dhënë efekt pezullues ankimit, ka synuar që masa të tilla hetimore, sikurse janë edhe ato të sekuestros, të mos pengohen nga individi me anë të taktikave të ndryshme përmes fshehjes, zhdukjes ose tjetërsimit të sendit objekt sekuestroje. Në këtë mënyrë sigurohet efektiviteti i masës, për rrjedhojë edhe rezultati i procedimit penal në tërësinë e tij. Për këtë arsye, disa nga garancitë e procesit të rregullt realizohen në gjykimin në shkallë të dytë, ku gjykata e apelit, e cila ka edhe kompetencën e marrjes dhe të shqyrtimit të provave, krahas zbatimit të ligjit, i jep mundësinë individit që ai vetë ose avokati i tij të dëgjohet për çdo kundërshtim në lidhje me kushtet në të cilat janë caktuar ose zbatuar masat hetimore (*shih vendimin nr. 21, datë 22.04.2025 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë pikëpamje, Gjykata vlerëson se edhe në këndvështrim të së drejtës për t`u dëgjuar dhe parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit, kërkuesit e kanë ushtruar lirisht të drejtën e ankimit në gjykatën e apelit, ku janë dëgjuar nëpërmjet përfaqësuesit të tyre, sikundër të drejtën për të paraqitur

rekurs në Gjykatën e Lartë, duke marrë në përfundim edhe përgjigje nga gjykatat për pretendimet e tyre. Për rrjedhojë, pretendimet për cenimin e së drejtës së aksesit dhe të parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit janë haptazi të pabazuara.

32. Kërkuesit kanë pretenduar edhe cenimin e *parimit të sigurisë juridike*, pasi ata e kanë fituar titullin e pronësisë në mënyrë të ligjshme, shumë vite përpara se të regjistrohej procedimi penal nr. 9/2023 nga shtetasja D.H.(Gj.), e cila i kishte fituar tagrat e pronësisë në bazë të vendimit gjyqësor të formës së prerë, që sipas nenit 451/a të KPC-së është i detyrueshëm për zbatim dhe efektet e tij nuk mund të vihen në diskutim përveçse me institutin e rishikimit, sipas neneve 494 e vijues të po këtij kodi. Gjykata vëren se ky pretendim i kërkuesve duket se ka të bëjë me faktin që organi procedues dhe gjykatat e zakonshme nuk kanë marrë parasysh fuqinë e vendimit gjyqësor civil që ka njohur pronësinë e shtetases D.H.(Gj.) mbi pasuritë e sekuestruara, pronësi të cilën ajo, në vijim, përmes veprimeve juridike, ua ka kaluar atyre. Sipas kërkuesve, për sa kohë që vendimi gjyqësor vijon të jetë në fuqi dhe veprimet juridike nuk janë konstatuar të pavlefshme nga një gjykatë, pasuritë e tyre nuk mund të sekuestrohen. Pra, sipas tyre, për sa kohë në procese gjyqësore civile nuk është provuar ndryshe, pronësia është fituar në mënyrë të ligjshme dhe për këtë shkak pasuritë e tyre nuk mund të jenë objekt sekuestrimi. Në lidhje me këtë pretendim subjekti i interesuar, Prokuroria e Posaçme, ka prapësuar se neni 451/a i KPC-së zbatohet në çështje civile kurse në rastin konkret, jemi përpara një mase sigurimi pasuror në kuadër të një procedimi penal, e cila vendoset në kushtet e parashikuara nga KPP-ja. Sipas tij, efektet e procedimit civil dhe administrativ në atë penal, janë parashikuar shprehimisht në nenin 71 të KPP-së, për rrjedhojë ky pretendim nuk ka lidhje me parimin e sigurisë juridike.

33. Gjykata ka theksuar se sekuestro preventive synon të ndërpresë pasojat e veprës penale në pikëpamje të rëndimit ose të zgjatjes së tyre, ose të parandalojë kryerjen e veprave penale të rejave, si dhe të garantojë efektivitetin e një konfiskimi të mundshëm të mëvonshëm, duke bërë paraprakisht të padisponueshme, në një fazë që i paraprin dënimit, sendet që kanë shërbyer ose kanë qenë të destinuara për të kryer veprën penale, produktet e saj ose të ardhurat, apo sendet, prodhimi, përdorimi, mbajtja ose tjetërsimi i të cilave përbën vepër penale (*shih vendimin nr. 20, datë 11.04.2025 të Gjykatës Kushtetuese*). Për rrjedhojë, kjo masë, prek edhe të drejtën e pronës mbi sende që kanë lidhje me veprën penale apo janë

produkte të saj, për të cilat ka dyshime për ligjshmërinë e fitimit të tyre, ndërhyrje kjo në këtë të drejtë që mund të vijojë deri në përfundim të procesit penal në të cilin përcaktohet edhe (pa)ligjshmëria e fitimit të pasurisë së dyshuar si e lidhur me veprën penale apo si produkt i saj. Megjithatë, masa e sekuestros në vetvete nuk vendos për përkatësinë e vet së drejtës së pronës, pra, sikundër edhe në rastin konkret, as nuk ua ka njohur, as nuk i ka zhveshur kërkuesit nga kjo e drejtë. Përkundrazi, duke pranuar pronësinë *de jure* të kërkuesve mbi pasuritë e sekuestruara, masa e kundërshtuar ka vendosur kufizimin e përkohshëm të së drejtës së pronës, me qëllim, ndër të tjera, sigurimin e një konfiskimi të mundshëm, i cili mund të vendoset si rezultat i procedurës penale në përfundim të procesit penal. Në këtë kuptim, ndërsa ligji lejon një kufizim të tillë të së drejtës së pronës, pretendimi për cenimin e parimit të sigurisë juridike në këtë kontekst është i paqartë dhe i paargumentuar në aspektin kushtetues.

34. Po në këndvështrim të parimit të sigurisë juridike, Gjykata vlerëson të theksojë se e drejta e pronës, që përfshin çdo posedim të sendeve ose të të drejtave të tjera materiale pasurore, shtrihet ndaj sendeve, pronësia e të cilave është fituar në përputhje me ligjin. Me gjithë mbrojtjen që ajo gëzon, e drejta e pronës mund t'u nënshtrohet kufizimeve, të cilat duhen bërë sipas disa kritereve të përcaktuara në mënyrë shteruese në nenet 17 dhe 41 të Kushtetutës (*shih vendimet nr. 18, datë 19.03.2024; nr. 53, datë 31.10.2023; nr. 36, datë 21.04.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Për rrjedhojë, Kushtetuta, së pari, nuk mbron një të drejtë pronësie të fituar në mënyrë të kundërligjshme dhe, së dyti, lejon kufizimin e saj me ligj për një interes publik. Duke pasur parasysh rrethanat e rastit konkret, për sa kohë që pronësia e sendeve të sekuestruara në origjinë është fituar me një vendim gjyqësor, i cili dyshohet të jetë marrë mbi prova dokumentare të falsifikuara, pra si rrjedhojë e një vepre penale, ligji procedural penal ka parashikuar mundësinë e kufizimit të së drejtës së pronës përmes masës së sekuestros preventive, me qëllim parandalimin e rrezikut që vjen nga disponimi i lirë i sendit që lidhet me veprën penale në aspektin e rëndimit ose të zgjatjes së pasojave të saj ose të lehtësimit të kryerjes së veprave penale të tjera, apo me qëllim konfiskimin, ndër të tjera, edhe të produkteve të veprimtarisë kriminale në përfundim të procesit penal. Në këtë kuptim, qoftë shmangia e rrezikut të rëndimit ose zgjatjes së pasojave të veprës penale apo lehtësimi i kryerjes së veprave penale të tjera nga disponimi i lirë i sendit që lidhet me veprën penale, ashtu edhe konfiskimi i produkteve të veprimtarisë kriminale përbëjnë interes publik, për sa kohë synojnë

parandalimin dhe luftën kundër krimit apo parandalimin dhe nxjerrjen nga qarkullimi civil të pasurive të fituara në mënyrë të kundërligjshme. Duke mbajtur parasysh se funksioni shoqëror i pronës private mund të përmbushet vetëm me kushtin e pandryshueshëm që fitimi i saj të jetë në përputhje me rregullat e sistemit ligjor, fitimi i pronësisë në mënyrë të kundërligjshme nuk mund të konsiderohet i pajtueshëm me atë funksion. Për rrjedhojë, e parë edhe në këtë këndvështrim, kërkuesit nuk kanë argumentuar në aspektin kushtetues pretendimin për cenimin e parimit të sigurisë juridike në kontekst të rrethanave të rastit konkret, ndaj ai nuk mund të merret në shqyrtim nga Gjykata.

35. Në këndvështrim të *së drejtës së pronës*, kërkuesit kanë argumentuar se kjo ndërhyrje nuk është bazuar në ligj, pasi gjykatat kanë interpretuar në mënyrë të zgjeruar përmbajtjen e neneve 274-276 të KPP-së, për sa kohë personat e tretë as nuk kanë kryer ndonjë veprim të paligjshëm dhe as dyshohen se mund të kenë kryer ndonjë prej veprave penale të procedimit penal në kuadër të të cilit është vendosur masa e sekuestros preventive, ashtu edhe cenimin e parimit të proporcionalitetit të ndërhyrjes, pasi masa e sekuestros e vendosur përbën një masë ekstreme dhe dëmi i shkaktuar shoqërisë është joproporcional.

36. Gjykata ka theksuar se në rastin përjashtimor të kontrollit të vendimeve që vendosin masa me karakter të ndërmjetëm, ajo i trajton pretendimet e parashtruara në ankimin kushtetues individual në drejtim të të drejtave substanciale, ndërsa pretendimet që kanë të bëjnë me të drejtën për proces të rregullt ligjor trajtohen si aspekte procedurale të së drejtës substanciale të pretenduar të cenuar, ndaj, në këtë kuptim, ajo ndalet në aspekte të veçanta të së drejtës për proces të rregullt ligjor, për sa ato mund të ndikojnë drejtpërdrejt në të drejtën substanciale në vetvete (*shih vendimet nr. 74, datë 22.10.2024; nr. 29, datë 16.04.2024; nr. 18, datë 19.03.2024 të Gjykatës Kushtetuese*). Për rrjedhojë, bazuar në natyrën dhe thelbin e pretendimeve të mësipërme, për sa kohë që ato kanë të bëjnë me të drejtën e pronës private, Gjykata vlerëson t`i shqyrtojë në këndvështrim të së drejtës substanciale të pronës private të parashikuar nga neni 41 i Kushtetutës dhe kritereve kushtetuese që lejojnë kufizimin e saj. Për këtë qëllim, Gjykata do t'i referohet edhe arsyetimit të gjykatave të zakonshme, pra nëse ato, në vendimet për caktimin e masës së sekuestros, kanë arsyetuar në mënyrë të mjaftueshme dhe të qartë, si për lidhjen e kësaj mase me objektivin e saj, që është parandalimi i pasojave të mëtejshme të veprës penale, ashtu edhe për respektimin e kritereve që lejojnë ndërhyrjen në të drejtën kushtetuese të

pronës private. Sikurse ka pohuar në jurisprudencën e saj, për të vlerësuar nëse ka pasur ose jo cenim të të drejtave substanciale, Gjykata bazohet në arsyetimin e vendimeve të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, për sa kohë që në bazë të parimit të subsidiaritetit u takon atyre gjykatave që përveç zbatimit të ligjit material dhe procedural penal, të mbajnë parasysh edhe jurisprudencën e Gjykatës dhe të GJEDNJ-së në lidhje me parimin e proporcionalitetit, duke qenë kjo Gjykatë mjeti i fundit për mbrojtjen e këtyre të drejtave (*shih vendimet nr. 79, datë 12.11.2024; nr. 29, datë 16.04.2024 të Gjykatës Kushtetuese*).

37. Gjykata vëren, gjithashtu, se kërkuesit kanë pretenduar cenimin e nenit 32, pika 2, të Kushtetutës, lidhur me përdorimin e të dhënave të marra nga autoritetet franceze, që kanë të bëjnë me komunikimet në platformën SkyEcc. Ky pretendim duket se lidhet edhe me provueshmërinë e autorit të dyshuar të veprës penale që supozohet të ketë ndodhur, pra me autorësinë e kërkuesit të parë, ashtu edhe me mirëbesimin e kërkuesve të dytë dhe të tretë në rrethanat kur, sipas tyre, ata nuk janë nën hetim dhe as nuk ka indicie a dyshim se kanë kryer ndonjë vepër penale. Për sa u përket pretendimeve për autorësinë në krim të kërkuesit të parë, Gjykata vlerëson se ato, nga njëra anë, mund të ngrihen vetëm nga ky i fundit, i cili nuk është palë në këtë gjykim për sa kohë që u vlerësua se i mungon interesi i ligjshëm dhe, nga ana tjetër, lidhen me çështje të të provuarit të (pa)fajësisë së tij, çka i përket gjykimit në themel të çështjes penale. Për rrjedhojë, këto pretendime nuk mund të merren në shqyrtim. Për sa u përket pretendimeve të tjera të kërkuesve, Gjykata vlerëson se ato, pavarësisht mënyrës sesi janë ngritur në ankimin kushtetues, në thelb, kanë të bëjnë me arsyetimin e gjykatave të zakonshme në lidhje me kushtet e vendosjes së masës së sekuestros preventive sipas nenit 274 të KPP-së, për sa i përket ekzistencës së dyshimit për veprën penale që supozohet të jetë kryer dhe lidhjes së saj me pasuritë e sekuestruara apo qenies së këtyre të fundit produkte të veprimtarisë kriminale. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson t`i shqyrtojë edhe këto pretendime në këndvështrim të së drejtës së pronës në aspektin substancial të saj.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e së drejtës së pronës

38. Sipas kërkuesve, gjykatat nuk kanë respektuar përmbajtjen e nenit 274, pika 1, të KPP-së, por i kanë arsyetuar vendimet në mënyrë të përgjithshme, duke ndërhyrë në të drejtën e pronës të personave të tretë,

të cilët nuk janë nën hetim dhe ndaj tyre nuk ka pasur procedim penal apo ndonjë indicie a dyshim se kanë kryer ndonjë vepër penale, ndërkohë që kjo dispozitë, e parë së bashku me nenin 36 të KP-së, zbatohet vetëm për pasuritë e personit nën hetim. Kërkuesit kanë pretenduar se ndërhyrja në të drejtën e pronës private *nuk është bazuar në ligj,* pasi vendimet gjyqësore kanë interpretuar në mënyrë të zgjeruar përmbajtjen e neneve 274-276 të KPP-së, sepse personat e tretë nuk kanë kryer ndonjë veprim të paligjshëm dhe as dyshohet se mund të kenë kryer ndonjë prej veprave penale të procedimit penal në kuadër të të cilit është vendosur masa e sekuestros. Sipas kërkuesve prokuroria, edhe pse ka barrën e provës, nuk ka provuar se ekziston "dyshimi i arsyeshëm" për përgjegjësinë personale të palëve të treta në kryerjen e veprës penale, kohën e përfshirjes në veprimtari kriminale në raport me kohën e krijimit të pasurisë që kërkohet të sekuestrohet, madje edhe lidhjen e krimit me atë pasuri. Ndërkohë që neni 190, pika 1, shkronja "a", i KPP-së parashikon përjashtimin nga konfiskimi të sendeve të personave që nuk kanë marrë pjesë në kryerjen e veprës penale. Sipas tyre, ndonëse legjislacioni penal nuk e njeh konceptin e "konfiskimit të zgjeruar" në procesin penal, edhe nëse do të supozohej aplikimi i Direktivës 42/2014 të BE-së, nuk do të kishte qenë e mundur vendosja e sekuestros preventive, pasi direktiva mbron interesat pasurorë të palëve të treta në mirëbesim. Kërkuesit kanë pretenduar edhe se masa *nuk respekton parimin e proporcionalitetit të ndërhyrjes.* Ajo përbën një masë ekstreme për sa kohë që pronarët e ligjshëm janë zhveshur *de facto* nga çdo e drejtë reale mbi pasuritë e tyre, ndërkohë që shoqëria "Imperial Group" sh.a. është penguar të zhvillojë pronën sipas lejes së marrë nga organi kompetent shtetëror. Po sipas tyre, dëmi i shkaktuar shoqërisë është joproporcional dhe masa është e ashpër dhe joproporcionale në raport me pasojat ekonomike të pronarit dhe interesit publik për zhvillimin e turizmit në atë zonë.

39. *Subjekti i interesuar, Prokuroria e Posaçme,* ka prapësuar se në rastin konkret jemi para një mase sigurimi pasuror, me natyrë të përkohshme, të verifikueshme në raport me kushtet e zbatimit të saj. Sipas tij, pretendimi për mungesën e lidhjes të të hetuarit Pëllumb Gjoka me pasuritë objekt sekuestroje është i gabuar dhe anashkalon provat e administruara nga Prokuroria e Posaçme për këtë fakt, të paraqitura edhe në gjykimin kushtetues. E pyetur në datën 13.01.2021, kallëzuesja L.Z. lidhur me prokurën e nënës së saj D.H. për shtetasin A.B. ka deklaruar se ajo nuk dinte të shkruante, të lexonte ose të nënshkruante dhe maksimumi që mund

të bënte ishte të vendoste gishtin në letër. Kjo shtetase ka deklaruar se bëhet fjalë për një pronë në Velipojë që ndodhet afër një resorti të madh, me sipërfaqe 365 dynymë, për të cilën nëna nuk u ka folur kurrë, por në regjistrin e vitit 1935 rezultonte pronare. Këtë pronë e ka poseduar vazhdimisht Pëllumb Gjoka, pasi ai ka bërë edhe veprimet për ta bërë të vetën dhe diku rreth vitit 2015 ajo ka marrë vesh për herë të parë së nëna e saj kishte prona. Po kështu, sipas subjektit të interesuar, shtetasja S.B., që ka kryer veprimet sipas tagrave të shtetasit A.B., ka qenë e punësuar në shoqërinë "Imperial Group" sh.a., me aksioner me 56% të kuotave shtetasin Pëllumb Gjoka. Shtetasi A.B., përfaqësuesi me prokurë i D.H.(Gj.), i pyetur si person që ka dijeni për veprën penale, ka deklaruar se shtetasin Pëllumb Gjoka e ka kushëri dhe ka marrëdhënie të afërta me të. Po sipas subjektit të interesuar, komunikimet në aplikacionin SkyEcc mes kodit që i përkiste kërkuesit Pëllumb Gjoka dhe atij që i përkiste prokurorit Xh.L. tregojnë përfshirjen dhe angazhimin me veprime konkrete të këtyre shtetasve për kompromet imin e konkluzioneve të aktit të ekspertimit grafik nr. 1802, datë 19.02.2021, i cili nuk ka konstatuar falsifikime, komunikime që janë kryer në periudhën 16.02.2021-18.02.2021, që është tre deri në një ditë përpara se të kryhej ky akt ekspertimi, i cili bie në kundërshtim me përfundimet e akteve të ekspertimit grafik nr. 639 dhe nr. 5398 të kryera në kuadër të hetimeve të të njëjtit procedim penal. Sipas Prokurorisë së Posaçme, në kushtet kur pasuritë ka dyshime të arsyeshme, të bazuara në prova, se janë fituar nëpërmjet falsifikimit të dokumenteve, të kryer nga Pëllumb Gjoka në bashkëpunim me persona të tjerë, ekziston rreziku që këto pasuri, të cilat janë produkte të veprës penale, të tjetërsohen te persona të tretë.

40. Gjykata ka theksuar se e drejta e pronës, e sanksionuar në nenin 41 të Kushtetutës, përfshin tre garanci që duhet të zbatohen në shqyrtimin e pretendimeve për cenimin e saj: *garancia e parë* ka të bëjë me parimin e gëzimit të qetë të pronës, e cila ka natyrë të përgjithshme; *garancia e dytë* ka të bëjë me kufizimet e lejueshme për të drejtën e pronës; *garancia e tretë* ka të bëjë me të drejtën e autoriteteve publike për të kontrolluar përdorimin e pronës në përputhje me interesin e përgjithshëm (*shih vendimet nr. 18, datë 19.03.2024; nr. 53, datë 31.10.2023; nr. 25, datë 13.10.2022 të Gjykatës Kushtetuese*). Për sa i përket ndërhyrjes që vendimi i sekuestrimit bën tek e drejta e pronës, Gjykata ka theksuar se: ai duhet të jetë i ligjshëm, në kuptimin që të jetë vendosur me ligj dhe të ndjekë një qëllim të ligjshëm, në kuptim të interesit publik; ndërhyrja duhet të vendosë një "ekuilibër të drejtë" midis kërkesave të interesit të përgjithshëm dhe garancive për

mbrojtjen e së drejtës së pronës; midis mjeteve të përdorura dhe qëllimit të ndjekur duhet të ketë një marrëdhënie të arsyeshme proporcionaliteti. Ekziston një hapësirë e gjerë vlerësimi për autoritetet publike në lidhje me zgjedhjen e mjeteve dhe atë çfarë konsiderohet në interes të përgjithshëm, me përjashtim të rasteve kur vendimi është haptazi i paarsyeshëm. Ndërsa pranohet dyshimi i arsyeshëm në fillim të hetimeve penale si bazë për ndërhyrje në të drejtën e pronës, hetimet duhet të jenë të shpejta, në mënyrë që ndërhyrja të zgjasë për një kohë të kufizuar. Masat e përkohshme të vendosura në kuadër të procedurave gjyqësore, të cilat i paraprijnë një konfiskimi të mundshëm, mund të shkaktojnë dëmtim të pronës, por në mënyrë që dëmi të jetë në përputhje me garancitë e lartpërmendura, ai nuk duhet të jetë përtej asaj që është e pashmangshme (*shih vendimet nr. 29, datë 16.04.2024; nr. 18, datë 19.03.2024 të Gjykatës Kushtetuese*).

41. Gjykata, bazuar në natyrën e pretendimeve të parashtruara nga kërkuesit, vlerëson se ato përfshihen në fushën e veprimit të së drejtës së pronës, sipas nenit 41 të Kushtetutës dhe nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së. Thënë kjo, duke pasur parasysh përmbajtjen e këtyre dispozitave, ashtu edhe të nenit 17 të Kushtetutës, që lejon kufizimin e të drejtave kushtetuese sipas kritereve të përcaktuara prej tij, Gjykata do të ndalet, në vijim, në analizën nëse në rastin konkret ndërhyrja e bërë për shkak të caktimit të masës së sigurimit pasuror "Sekuestro preventive" ndaj pasurive të paluajtshme në pronësi të kërkuesve respekton kriteret kushtetuese të kufizimit.

42. Për sa i përket ligjshmërisë së ndërhyrjes, Gjykata vëren se masa e kundërshtuar është bazuar në parashikimet e ligjit procedural penal, sipas të cilit sekuestroja, si masë preventive e marrë gjatë procesit penal, kufizon të drejtën e disponimit të pasurisë së mbajtësit të saj. Për të garantuar këtë të drejtë (të pronës private) nga veprimet abuzive të organit procedues, ligji parashikon se ajo masë vendoset nga gjykata, e cila kontrollon edhe zbatimin e saj, ndërkohë që vendimet e gjykatës më të ulët i nënshtrohen kontrollit gjyqësor nga gjykatat më të larta. Konkretisht, masa e sekuestros preventive kërkohet nga prokurori dhe vendoset nga gjyqtari, dhe sipas nenit 274 të KPP-së ajo urdhërohet kur ka rrezik që disponimi i lirë i një sendi që lidhet me veprën penale mund të rëndojë ose të zgjasë pasojat e saj ose të lehtësojë kryerjen e veprave penale të tjera (pika 1). Kurse sipas pikës 2 të këtij neni, sekuestroja mund të vendoset edhe për sendet, produktet e veprës penale dhe çdo lloj pasurie tjetër që lejohet të konfiskohet, sipas nenit 36 të KP-së, i cili parashikon rastet e konfiskimit të mjeteve të

kryerjes së veprës penale dhe produkteve të veprës penale dhe ka të bëjë me marrjen dhe kalimin në favor të shtetit, ndër të tjera, të produkteve të veprës penale, ku përfshihet çdo lloj pasurie, si dhe dokumentet ose instrumentet ligjore që vërtetojnë tituj ose interesa të tjerë në pasurinë që rrjedh ose fitohet drejtpërdrejt ose tërthorazi nga kryerja e veprës penale (pika 1, shkronja "b").

43. Në kuptim të sa më sipër, në rastin konkret masa është vendosur nga gjyqtari i hetimeve paraprake mbi kërkesën e prokurorit, ndërsa vendimi i tij dhe zbatimi i masës në vijim i është nënshtruar kontrollit nga gjykatat më të larta. Vendimet gjyqësore të kundërshtuara përmbajnë informacionin e nevojshëm në lidhje me arsyet e vendosjes dhe të zbatimit të masës së sekuestrimit, përkatësisht *periculum in mora* dhe *fumus delicti*. Gjykatat e zakonshme kanë arsyetuar se ka ekzistuar një *periculum in mora* (rrezik vonese) në mosdhënien e një vendimi sekuestrimi, pasi pasojat e veprës penale mund të rëndoheshin ose të zgjateshin, ose mund të lehtësohej kryerja e veprave penale të tjera. Në të vërtetë, për shkak të zbulimit të veprimeve në lidhje me falsifikimin e dokumenteve në rastin e njohjes së pronësisë fillimisht dhe ushtrimit të ndjekjes penale në vijim, ndërsa pasuritë edhe më parë ishin tjetërsuar, ka ekzistuar rreziku që ato të mund të tjetërsoheshin sërish ose të zhvilloheshin në mënyrë të atillë, çka do të pengonte ose vështirësonte konfiskimin e tyre në përfundim të procesit penal. Për sa i përket çështjes së *fumus delicti*, gjykatat e zakonshme kanë pranuar se ky kusht përmbushej duke qenë se vendimi i sekuestros po merrej në fazën e hetimit dhe se dyshimet për veprat penale që supozohej të kishin ndodhur ishin të besueshme. Në lidhje me këtë, ato kanë evidentuar detaje rreth përdorimit të dokumenteve të dyshuara si të falsifikuara në procesin e njohjes dhe të kthimit të pronës, sikundër edhe për sa i përket tjetërsimit të saj në vijim, referuar të cilave ngrihej dyshimi për veprat penale të falsifikimit të dokumenteve dhe pastrimit të produkteve të veprimtarisë kriminale, në kuadër të grupit të strukturuar kriminal. Po kështu, ato kanë evidentuar edhe të dhëna faktike për lidhjen e pasurive me veprat penale të dyshuara, lidhjen mes tyre të personave të dyshuar të veprave penale, sikundër edhe lidhjen e këtyre të fundit me personat që mbanin *de jure* pasuritë, pra me kërkuesit e dytë dhe të tretë.

44. Gjykata vëren se edhe pse në dukje veprimet për kalimin e pasurive në pronësi të kërkuesve në fjalë janë bërë përmes veprimeve të ligjshme, objekti i procedimit penal në kuadër të të cilit është vendosur masa e kundërshtuar ka të bëjë me mënyrën e fitimit të kësaj prone në origjinë përmes veprimeve të

dyshuara si të paligjshme. Në këtë kuptim, duke pasur parasysh arsyetimin e gjykatave të zakonshme, në drejtim të mënyrës së interpretimit dhe zbatimit të nenit 274 të KPP-së, si baza ligjore e zbatueshme edhe në rastin konkret, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuesve për paligjshmëri të masës së sekuestros me argumentet se kanë vepruar në mirëbesim për fitimin e pasurisë dhe se nuk janë persona nën hetim ose të dyshuar për veprën penale, nuk është i rëndësishëm për sa kohë masa e kundërshtuar është vendosur në kuadër të një procedimi penal dhe në funksion të mbarëvajtjes së tij. Nga ana tjetër, këta kërkues nuk kanë parashtruar ndonjë arsye të qenësishme në lidhje me ligjshmërinë e fitimit të pronës në origjinë në kuptim të kushtit të *fumus delicti* për vendosjen e masës së kundërshtuar.

45. Për sa i përket qëllimit të ligjshëm të ndërhyrjes, të masës së kundërshtuar në kuptim të interesit publik, Gjykata, siç u theksua edhe më sipër, e ka konsideruar të prezumuar për sa kohë ka vlerësuar se rregullat procedurale penale që lejojnë sekuestrimin e pasurisë i shërbejnë mbarëvajtjes së procedimit penal, në kuptimin e ruajtjes së rendit dhe të sigurisë publike nga veprimtaria kriminale (*shih vendimet nr. 79, datë 12.11.2024; nr. 29, datë 16.04.2024 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, zbatimi i masave të përkohshme në kontekstin e procedurave gjyqësore që synojnë edhe një konfiskim të mundshëm të pronës në përfundim të procesit penal, është në interesin e përgjithshëm të shoqërisë, prandaj ndërhyrja në rastin konkret konsiderohet se është bërë për një qëllim legjitim. Për më tepër, ndërhyrja në këtë rast ka ndjekur edhe një qëllim tjetër legjitim, sikurse është ai i luftës kundër pastrimit të produkteve të veprimtarisë kriminale në kuadër të krimit të organizuar.

46. Gjykata ka theksuar se kur kontrollohen aktet e pushtetit publik, sa herë që vihet në diskutim një e drejtë kushtetuese ose liri themelore, është me rëndësi të verifikohen edhe parimet që lidhen me cilësinë e ligjit e parashikueshmërinë e tij, pasi janë pikërisht ato që mbrojnë individin nga arbitrariteti, veçanërisht në marrëdhëniet ndërmjet tij dhe shtetit (*shih vendimet nr. 39, datë 15.12.2022; nr. 30, datë 02.11.2022 të Gjykatës Kushtetuese*). Kur bëhet fjalë për mundësinë e individit për të parashikuar pasojat e veprimeve të tij, nuk është e thënë që të nënkuptohet një qartësi absolute. Ligji duhet të jetë në gjendje të ndjekë rrethanat e ndryshme dhe, për këtë arsye, një standard i një parashikueshmërie të arsyeshme është i mjaftueshëm (*shih vendimin nr. 16, datë 15.06.2009 të Gjykatës Kushtetuese).* Edhe sipas GJEDNJ-së, nocioni "ligj" nënkupton disa kushte cilësore, sidomos ato të mundësisë së qasjes, qartësisë dhe të

parashikueshmërisë (shih Cantoni k. Francës, § 29; Kafkaris k. Qipros [DhM], § 140; Del Río Prada k. Spanjës [DhM], § 91).

47. Duke pasur parasysh se masa e sekuestros preventive ka natyrë parandaluese, ndërsa synon të kufizojë, për një periudhë të përkohshme, disponimin e lirë të një sendi të lidhur me veprën penale, me qëllim për të penguar rëndimin ose zgjatjen e pasojave të veprës penale ose lehtësimin e kryerjes së veprave penale të tjera apo edhe të një sendi produkt të veprës penale, me qëllim konfiskimin e tij në përfundim të procesit penal, edhe në vlerësim të Gjykatës ajo vendoset gjatë procedimit penal dhe rëndon mbi pasurinë kur plotësohen kushtet ligjore. Në këtë kuptim, dispozitat penale materiale dhe procedurale në lidhje me sekuestron preventive, jo vetëm janë të aksesueshme, por janë edhe mjaftueshmërisht të qarta në drejtim të sendeve mbi të cilat mund të veprojnë ato.

48. Për sa më lart, Gjykata vlerëson se masa e sekuestros preventive në çështjen në fjalë është vendosur sipas ligjit dhe në përputhje me interesin e përgjithshëm për të siguruar që përdorimi i pronës në fjalë të mos sjellë përfitime në dëm të shoqërisë. Për rrjedhojë, kufizimi i disponimit të lirë të pasurive të paluajtshme të sekuestruara është bërë me ligj dhe ka ndjekur një qëllim të ligjshëm.

49. Gjykata ka theksuar se ndërhyrja duhet të vendosë një "ekuilibër të drejtë" midis kërkesave të interesit të përgjithshëm dhe garancive për mbrojtjen e së drejtës së pronës dhe midis mjeteve të përdorura dhe qëllimit të ndjekur duhet të ketë një marrëdhënie të arsyeshme proporcionaliteti. Për sa i përket kriterit të proporcionalitetit të ndërhyrjes, Gjykata merr në analizë, në linjë me praktikën e saj, disa elemente që lidhen drejtpërdrejt me natyrën e pasojave që prodhon vendimi për vendosjen e masës së sekuestros, në kuptim të balancimit të të drejtave ndërmjet interesit të përgjithshëm dhe mbrojtjes të të drejtave themelore të individit, kërkuesve. Edhe sipas GJEDNJ-së, në kuptim të nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, çdo ndërhyrje në gëzimin paqësor të pasurisë së një individi duhet të gjejë një ekuilibër të drejtë midis kërkesave të interesave të përgjithshëm të shoqërisë dhe kërkesave të mbrojtjes të të drejtave themelore të individit. Ekuilibri i nevojshëm nuk do të gjendet nëse personave të përfshirë u është dashur të mbajnë një barrë individuale dhe të tepërt *(shih East West Alliance Limited kundër Ukrainës, datë 23.01.2014, § 168; Piras kundër San Marinos, datë 20.07.2017, § 55).* Ndërsa një sekuestrim i pronës nuk është në vetvete i hapur për kritika, duke pasur parasysh në veçanti kufirin e vlerësimit të lejuar sipas paragrafit të dytë të nenit 1 të Protokollit nr. 1

të KEDNJ-së, ai mbart me vete rrezikun e vendosjes së një barre të tepërt në aspektin e aftësisë së individit të prekur për të disponuar pronën dhe në përputhje me rrethanat duhet të ofrojë disa mbrojtje procedurale në mënyrë që të sigurojë që funksionimi i sistemit dhe ndikimi i tij në të drejtat pronësore të mos jenë as arbitrare, as të paparashikueshme. Ndërsa çdo sekuestrim ose konfiskim sjell dëm, ai aktual i pësuar nuk duhet të jetë më i madh sesa ajo që është e pashmangshme (*shih Džinić kundër Kroacisë, datë 17.05.2016, § 68; Piras kundër San Marino, datë 20.07.2017, § 55*). Për më tepër, një hapësirë e gjerë vlerësimi u lejohet shteteve kur bëhet fjalë për masa të përgjithshme të strategjisë politike, ekonomike ose sociale dhe GJEDNJ-ja në përgjithësi respekton zgjedhjen e politikave të ligjvënësit, përveçse nëse është "qartazi pa bazë të arsyeshme" (*shih Azienda Agricola Silverfunghi dhe të tjerë kundër Italisë, nr. 48357/07, 52677/07, 52687/07 dhe 52701/07, § 103, datë 24 qershor 2014*).

50. Për këtë qëllim, për të vlerësuar nëse procedurat e sekuestrimit janë arbitrare, Gjykata ndalet në vlerësimin e nevojës, përshtatshmërisë dhe ashpërsisë së masës së sekuestros, duke mbajtur në konsideratë edhe shpejtësinë e procedurave, pra që ndërhyrja në njërin prej tagrave të së drejtës së pronës (në rastin konkret gëzimi dhe disponimi i saj) të zgjasë për një kohë të kufizuar, si dhe dëmin që vjen nga cenimi, i cili nuk duhet të jetë përtej asaj që është e pashmangshme (*shih vendimin nr. 29, datë 16.04.2024 të Gjykatës Kushtetuese*). Po në vijim të këtij kontrolli, Gjykata verifikon edhe nëse kërkuesve në procedurat gjyqësore të kundërshtuara u është dhënë një mundësi e arsyeshme për të paraqitur argumentet e tyre përpara gjykatave të zakonshme dhe nëse gjetjet e atyre gjykatave janë të tilla që mund të konsiderohen arbitrare dhe në kundërshtim me kërkesat e një gjykimi të drejtë.

51. Për sa u përket aspekteve të nevojës, përshtatshmërisë dhe ashpërsisë së ndërhyrjes, Gjykata ka theksuar se ajo analizon nëse masa e marrë është e aftë të realizojë pasojën që ajo synon, pra të sigurojë mbarëvajtjen e procedimit penal në kuadër të të cilit është marrë (*shih vendimin nr. 29, datë 16.04.2024 të Gjykatës Kushtetuese*). Në lidhje me këtë aspekt të ndërhyrjes, Gjykata vëren se për pasuritë e paluajtshme objekt i sekuestros preventive, edhe pse *de jure* janë në pronësi të kërkuesve të dytë dhe të tretë, të cilët nuk janë thirrur si persona nën hetim në atë procedim penal (nr. 9/2023) të regjistruar nga Prokuroria e Posaçme, ndërsa është evidentuar se ato kanë lidhje me veprat penale që po hetohen, përveçse edhe mundësia që ato të jenë produkte të veprimtarisë kriminale, ka ekzistuar rreziku se disponimi i lirë i tyre mund të lehtësojë apo zgjasë pasojat e veprës penale ose të

lehtësojë kryerjen e veprave të tjera penale, ndaj masa parandalon rrezikun e tjetërsimit apo të humbjes së këtyre pasurive, ose të kryerjes së veprave të tjera penale deri në përfundim të procedurave penale, sikundër garanton edhe një konfiskim të mundshëm në përfundim të atyre procedurave.

52. Lidhur me përshtatshmërinë e ndërhyrjes, në vlerësimin e Gjykatës masa e sekuestros duhet të jetë e arsyeshme, duke balancuar qëllimin e procedimit penal me interesat e individit të përfshirë, në kuptimin që ajo nuk duhet të caktohet përtej asaj që është e pashmangshme (*shih vendimin nr. 29, datë 16.04.2024 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata, referuar përmbajtjes së vendimeve gjyqësore të kundërshtuara, vëren se masa e sekuestrimit është marrë në kontekst të një hetimi penal në lidhje edhe me veprat penale të falsifikimit të dokumenteve dhe të pastrimit të produkteve të veprimtarisë kriminale në kuadër të krimit të organizuar, duke pasur për qëllim parandalimin e tjetërsimit ose të shndërrimit të pasurive që mund të ishin subjekt i konfiskimit, shmangien e një përkeqësimi ose zgjatjeje të veprës penale ose lehtësimit të kryerjes së veprave të tjera penale. Pasuritë e sekuestruara kërkuesve janë të konsiderueshme, por megjithatë Gjykata vëren se ato janë të lidhura me veprimtarinë e paligjshme të falsifikimit të dokumenteve në rastin e njohjes së pronësisë në burim dhe që përbënin pastrimin e supozuar të tyre si produkte të veprimtarisë kriminale, arsye për të cilën pasuritë e sekuestruara korrespondojnë me kërkesën e mundshme për konfiskim.

53. Lidhur me ashpërsinë e ndërhyrjes, Gjykata vëren se përmes masës së sekuestros gjykatat e zakonshme kanë vendosur kufizimin e të gjitha tagrave të pronësisë mbi pasuritë në fjalë. Ndërkohë kërkuesi i dytë ka pretenduar se kjo masë është e ashpër në raport me pasojat ekonomike të këtij subjekti dhe interesin publik për zhvillimin e turizmit në atë zonë, duke qenë se projekti është pjesë e investimeve strategjike. Sipas këtij kërkuesi, shoqëria ka kryer studimin gjeoteknik të terrenit dhe ka përgatitur projektin për ndërtimin e kompleksit turistik, duke ndjekur procedurën administrative deri te miratimi i lejes dhe se përpara dhënies së lejes KKT-ja ka kërkuar të konfirmohen të drejtat e pronësisë. Po sipas tij, projekti do të shkojë në vlerën afërsisht 52 milionë euro dhe do të punësohen 80 persona, ndërkohë që në kohën kur u vendos masa e sekuestros kishin filluar punimet ndërtimore të cilat u ndërprenë, duke pësuar shoqëria dëm të konsiderueshëm ekonomik financiar.

54. Gjykata ka theksuar se në lidhje me nënkriterin e ashpërsisë së masës, ai analizohet në raport me të tre tagrat e së drejtës së pronës, përkatësisht: posedimin, gëzimin (ku përfshihet edhe gëzimi i fryteve të pronës ose

zhvillimi i saj) dhe disponimin. Në çdo rast vendimet për caktimin e masës së sekuestros duhet të përcaktojnë se cilin tagër të së drejtës së pronësisë do të prekin përtej disponimit të lirë të sendit, rreziku për ndodhinë e të cilit duket të jetë synimi kryesor dhe i shprehur i nenit 274 të KPP-së. Në këtë drejtim, masa e sekuestros është e lidhur me objektivin që konsiston në parandalimin e pasojave të mëtejshme të veprës penale (*shih vendimin nr. 29, datë 16.04.2024 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë këndvështrim, Gjykata thekson se gjykatat e zakonshme, në çdo rast, duke pasur në vëmendje si mbrojtjen e të drejtave kushtetuese të individit, si dhe standardet e evidentuara në jurisprudencën kushtetuese, me qëllim garantimin e së drejtës për një gjykim të drejtë, duhet të bëjnë kujdes për të arsyetuar në mënyrë të plotë dhe shteruese respektimin e këtij kriteri në drejtim të secilit prej tagrave të së drejtës së pronës së individit ndaj të cilit vendoset kufizimi i pasurisë.

55. Gjykata, edhe pse një analizë e tillë mungon në vendimet gjyqësore objekt gjykimi, bazuar në rrethanat e çështjes konkrete dhe referuar qëllimit dhe pasojave të masës së sekuestros, sikundër ato janë pranuar nga gjykatat e zakonshme, vlerëson se masa në rastin konkret nuk tejkalon kriterin e ashpërsisë, duke mbajtur në konsideratë pasojat e saj në drejtim të interesit të përgjithshëm publik që synon të mbrojë, përveçse edhe natyrën paraprake të masës dhe lidhjen midis pasurive të sekuestruara dhe kryerjes së veprave të rënda penale, ndërsa ato në origjinë dyshohet se janë përfituar nga një veprimtari kriminale, për fshehjen e së cilës dhe ligjërimin në qarkullim civil janë ndërmarrë në vijim veprime për tjetërsimin e tyre, por duke ruajtur kontrollin mbi to autori i dyshuar i veprave penale. Edhe pse kufizimi ka prekur të gjitha tagrat e pronësisë, duke qenë se dyshohet se këto pasuri janë produkte të veprës penale, por edhe objektivi i synuar i veprave penale që po hetohen në kuadër të procedimit penal nr. 9/2023, konsiderohet se midis vendimit të sekuestros dhe qëllimit të ndjekur duket se ka një marrëdhënie të arsyeshme proporcionaliteti, prandaj kufizimi i së drejtës së pronës është në raport të drejtë me gjendjen që e ka diktuar atë. Për më tepër, nisur edhe nga fakti se kërkuesi i dytë është pajisur me autorizimet ligjore dhe synon zhvillimin e pronës, është e qartë se ky zhvillim i saj do të bëjë të vështirë një konfiskim të mundshëm të pasurisë, tokës që dyshohet të jetë produkt i veprës penale, për shkak të lidhjes së qëndrueshme që do të krijohet mes saj dhe ndërtimit që ai kërkues synon të realizojë. Në këtë kuptim, në këtë situatë reale dhe faktike, masa e kundërshtuar, e cila ka kufizuar jo vetëm tagrin e disponimit, por edhe atë të gëzimit, konsiderohet se është proporcionale në drejtim të ashpërsisë së saj.

56. Për sa më sipër, Gjykata, duke mbajtur në konsideratë edhe hapësirën

e gjerë të vlerësimit të autoriteteve në ndjekjen e politikave penale në luftën kundër kriminalitetit, veçanërisht kur bëhet fjalë për vepra të tilla penale të rënda, vlerëson se procedurat, në tërësinë e tyre, kanë respektuar ekuilibrin e drejtë të kërkuar.

57. Po kështu, Gjykata vëren se kërkuesve u është dhënë një mundësi e arsyeshme për të paraqitur argumentet e tyre përpara gjykatave të zakonshme dhe ata kanë pasur akses në dy nivele juridiksioni, duke pasur edhe një seancë dëgjimore në gjykatën e apelit, ndërsa janë përfaqësuar nga avokatë të zgjedhur. Në këtë mënyrë, kërkuesve u është dhënë mundësia për të paraqitur çështjen e tyre në procedura kontradiktore përpara gjykatave të zakonshme, të cilat u kanë dhënë përgjigje pretendimeve të tyre për caktimin e masës së kundërshtuar, arsyetim ky që nuk duket të jetë arbitrar apo të mos plotësojë kërkesat e një gjykimi të drejtë.

58. Nën dritën e konsideratave të mësipërme, duke pasur parasysh rëndësinë e qëllimeve të ndjekura, si dhe kufirin e vlerësimit të autoriteteve publike në këtë fushë, Gjykata vlerëson se në rrethanat e rastit aktual masa e kundërshtuar e sekuestrimit nuk përbën një ndërhyrje disproporcionale në të drejtën e kërkuesve për gëzimin paqësor të pronës.

59. Në përfundim, Gjykata çmon se pretendimet e kërkuesve në drejtim të së drejtës së pronës private janë të pabazuara, sipas arsyetimit të mësipërm të vendimit, ndaj kërkesa rrëzohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, si dhe neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me shumicë votash,

V E N D O S I:

1. Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 20.05.2025
Shpallur më 23.06.2025

MENDIM PAKICE

1. Në gjykimin kushtetues të çështjes që u përket kërkuesve Pëllumb Gjoka, shoqëria "Imperial Group" sh.a. dhe Kolë Gjoka, me objekt: "*Shfuqizimi i vendimeve 422, datë 23.10.2023 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 167 (87-2023-270), datë 27.11.2023 të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 00-2024-423, datë 07.03.2024 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë*", jam kundër qëndrimit të shumicës që ka vendosur rrëzimin e kërkesës, ndaj, në vijim, do të parashtroj argumentet që mbështesin qëndrimin tim në këtë çështje.

2. *Së pari,* theksoj se nuk jam dakord me qëndrimin e shumicës për moslegjitimimin e kërkuesit Pëllumb Gjoka, qasje që është shprehur në footnotën e paragrafit 22 të vendimit. Ritheksoj, në mënyrë të përmbledhur, se vetë gjykatat e zakonshme e kanë legjitimuar kërkuesin e parë, duke e pranuar si palë në gjykimin e kundërshtuar në të cilin ai vetë ka ngritur pretendime për kundërshtimin e masës së sekuestros. Në asnjë shkallë të gjykimit të zakonshëm nuk ka pasur pretendime nga palët, veçanërisht prokuroria dhe nuk është vënë në diskutim kryesisht nga gjykatat legjitimimi i këtij kërkuesi për të qenë pjesë e gjykimit në fjalë. Vetë fakti që ai kundërshton vendimet gjyqësore për mënyrën sesi kanë trajtuar pretendimet e tij të ngritura në ankim dhe rekurs e bën edhe kërkuesin e parë palë të gjykimit kushtetues. Në këtë pikë vlerësoj të theksoj edhe se kjo Gjykatë, në ushtrim të funksionit të saj edhe si gjykatë e të drejtave të njeriut, nuk mund të mbajë qasje të tilla formaliste, përkundrazi është ajo që duhet të synojë të shmangë formalizmin e tepruar duke zgjeruar mbrojtjen kushtetuese të të drejtave të individit.

3. *Së dyti,* jam kundër qëndrimit të shumicës pasi në vlerësimin tim masa e kundërshtuar nuk respekton kriterin e proporcionalitetit, pikërisht për shkak të mirëbesimit të kërkuesve të dytë dhe të tretë në fitimin e së drejtës së pronës mbi pasuritë e sekuestruara dhe për shkak se vetë personi nga i cili është fituar ajo, shtetasja D.H.(Gj.) e ka fituar përmes vendimeve gjyqësore të formës së prerë, të cilat nuk janë vënë në diskutim, nuk janë shfuqizuar dhe as rishikuar. Shumica e ka trajtuar këtë pretendim në këndvështrim të ligjshmërisë së masës së sekuestros, duke vlerësuar

se "*pretendimi i kërkuesve për paligjshmëri të masës së sekuestros me argumentet se kanë vepruar në mirëbesim për fitimin e pasurisë dhe se nuk janë persona nën hetim ose të dyshuar për veprën penale, nuk është i rëndësishëm për sa kohë masa e kundërshtuar është vendosur në kuadër të një procedimi penal dhe në funksion të mbarëvajtjes së tij. Nga ana tjetër, këta kërkues nuk kanë parashtruar ndonjë arsye të qenësishme në lidhje me ligjshmërinë e fitimit të pronës në origjinë në kuptim të kushtit të fumus delicti për vendosjen e masës së kundërshtuar*" (*shih paragrafin 44 të vendimit*). Ndërkohë që referuar pretendimeve të kërkuesve, natyrës dhe thelbit të tyre, ai haptazi ka të bëjë me ashpërsinë e masës së sekuestros si element i parimit të proporcionalitetit të ndërhyrjes në të drejtën e tyre të pronës private.

4. Edhe në rastin konkret qasja ime është në linjë me atë të mbajtur në qëndrimet në çështjet me kërkues Elda Dinaj (vendimi nr. 29, datë 16.04.2024) dhe Marina Bay (vendimi nr. 79, datë 12.11.2024).

5. Sipas GJEDNJ-së në rastin e vendimeve të caktimit të masave të sekuestros ose konfiskimit për pasurinë e personave të tretë, të cilët nuk janë pjesë e procedimit penal, përcaktimi i ekuilibrit të drejtës midis qëllimit të ligjshëm dhe të drejtave themelore të kërkuesit varet nga shumë faktorë, ndër të cilët edhe sjellja e individit që ka të drejtën e pronës. Prandaj, gjykatave u lind detyrimi për të përcaktuar shkallën e fajit ose kujdesit që ka pasur kërkuesi ose, të paktën, marrëdhënien midis sjelljes së tij dhe veprave penale të kryera (*shih Agosi kundër Mbretërisë së Bashkuar, datë 24.10.1986, § 54; Silickiene kundër Lituanisë, datë 10.04.2012, § 66*).

6. Ashtu siç ka pranuar edhe shumica, kërkuesit e parë dhe të dytë as janë palë në procedimin penal, as nuk ka ndonjë të dhënë se ata janë të lidhur ose të dyshuar, pra se janë, në çfarëdo lloj forme, të lidhur me veprimtarinë kriminale që dyshohet se lidhet me pasuritë në fjalë apo se i kanë fituar ato përmes veprimeve të paligjshme për të cilat duhet të mbahen përgjegjës. Unë i bashkohem qëndrimit të shumicës se masa të tilla me natyrë pasurore synojnë luftën kundër krimit ose parandalimin dhe nxjerrjen nga qarkullimi civil të pasurive të fituara në mënyrë të kundërligjshme dhe se rregullat procedurale penale që lejojnë sekuestrimin e pasurisë i shërbejnë mbarëvajtjes së procedimit penal, në kuptimin e ruajtjes së rendit dhe sigurisë publike nga veprimtaria kriminale (*shih paragrafët 34 dhe 45 të vendimit*). Ndonëse është me rëndësi thelbësore lufta kundër krimit dhe në rastin konkret edhe ajo kundër pastrimit të produkteve të veprimtarisë kriminale, ky qëllim nuk mund të justifikojë çdo ndërhyrje në të drejtat

kushtetuese, pasi kjo jo vetëm do të lejonte arbitraritetin në veprimet e autoriteteve publike, por dhe do të zhvishte vetë kontrollin kushtetues nga qëllimi, natyra e rëndësia e tij.

7. Në vlerësimin tim, referuar përmbajtjes së vendimeve gjyqësore objekt kërkese, masa e sekuestros e tejkalon kriterin e ashpërsisë, pasi kërkuesve të dytë dhe të tretë u është vendosur një barrë e tepruar, për sa kohë që fitimi i pronës prej tyre është e provuar se është bazuar në procedura të ligjshme, sipas legjislacionit në fuqi për qarkullimin civil të sendeve, çka ka bërë që ata të kishin pritshmëri të ligjshme në drejtim të gëzimit të të drejtave dhe interesave që burojnë nga kjo marrëdhënie kontraktore dhe që lidhen (për kërkuesin e dytë) edhe me zhvillimin e pronës dhe ushtrimin e veprimtarisë ekonomike në pasurinë në pronësi të tyre. Gjykatat e zakonshme dhe shumica nuk kanë verifikuar situatën reale dhe faktike dhe as pretendimet e kërkuesve në këtë drejtim, duke mos arsyetuar në drejtim të cenimit të të drejtave substanciale të personave të tretë në procesin penal (kërkuesit e dytë dhe të tretë), të cilët jo vetëm që nuk janë të përfshirë në veprimtari të paligjshme, por është provuar se kanë vepruar në në *bona fide* (mirëbesim), duke hyrë në marrëdhënie për blerjen e pasurive të fituara përmes vendimeve gjyqësore të formës së prerë, të regjistruara në përputhje me ligjin dhe për të cilat kanë kryer veprimet po në përputhje me ligjin.

8. Nga ana tjetër, masa shtrënguese e sekuestros tejkalon kriterin e ashpërsisë edhe për shkak të ndalimit tërësor të tagrave të pasurisë, pra të disponimit dhe gëzimit të sendeve. Edhe parashikimi i nenit 274 të KPP-së kërkon ndalimin e disponimit të lirë të një sendi në rast se ai mund të rëndojë ose të zgjasë pasojat e veprës penale, ose të lehtësojë kryerjen e veprave penale të tjera. As gjykatat e zakonshme, as shumica në vendimin e saj nuk kanë arsyetuar se përse masa e sekuestros në këtë formë, pra duke vendosur kufizim mbi të gjitha tagrat e së drejtës së pronës, çka në thelb përbën zhveshje *de facto* të pronarit nga prona, konsiderohet si masa e vetme për mbarëvajtjen e procesit penal, në kushtet kur ekzistojnë edhe masa të tjera më të lehta, të cilat do t'u mundësonin kërkuesve ushtrimin e disa tagrave të pronës dhe gëzimin e sendit, duke siguruar njëkohësisht edhe zhvillimin e procesit penal të themelit. Në kundërshtim me detyrimin për të arsyetuar vendimet e tyre në drejtim të analizës së verifikimit të kritereve të proporcionalitetit të ndërhyrjes, gjykatat janë mjaftuar vetëm me një arsyetim formal të kushteve dhe kritereve për vendosjen e masës së sekuestros. Ndërkohë që edhe shumica, në këndvështrim të kriterit

të proporcionalitetit, nuk ka arsyetuar se përse një kufizim tjetër, siç do të ishte ai për urdhërimin e bllokimit të të gjitha veprimeve juridike për pasuritë e sekuestruara, nuk do të arrinte në të njëjtën mënyrë qëllimin e procedimit penal.

9. Nën dritën e argumenteve të mësipërme, vlerësoj se masa e sekuestros preventive mbi pasuritë e kërkuesve të dytë dhe të tretë nuk përmbush kriterin e proporcionalitetit, pasi ajo është një masë e ashpër dhe gjykatat nuk kanë arritur të arsyetojnë se përse në rastin konkret është arritur ekuilibri i drejtës mes kërkesave të përgjithshme të interesit publik dhe atyre individuale të kërkuesve për mbrojtjen e pronës së tyre dhe se përse asnjë masë tjetër kufizuese në tagrat e pronësisë nuk do të ishte e aftë të garantonte në të njëjtën mënyrë qëllimin për të cilin është vendosur masa e kundërshtuar.

10. Në përfundim, unë, gjyqtarja në pakicë, çmoj se pretendimet e kërkuesve në drejtim të mosrespektimit të parimit të proporcionalitetit të ndërhyrjes në të drejtën e pronës private, në kundërshtim me nenet 17 dhe 41 të Kushtetutës, janë të bazuara, prandaj duhej të ishte vendosur pranimi i kërkesës.

Anëtare: Sonila Bejtja

Vendim nr. 34, datë 27.05.2025
(V-34/25)

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Holta Zaçaj, Kryetare, Marsida Xhaferllari, Fiona Papajorgji, Sonila Bejtja, Sandër Beci, Ilir Toska, Genti Ibrahimi, Marjana Semini, anëtarë, me sekretare Belma Lleshi, në datën 27.05.2025 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 11 (H) 2024 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: **HYSNI MULLALLI**

SUBJEKT I INTERESUAR:
DREJTORIA RAJONALE E SIGURIMEVE SHOQËRORE, TIRANË

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimeve nr. 1983, datë 20.07.2012 të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr. 00-2017-454 (107), datë 01.03.2017 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë; nr. 67 (86-2024-82), datë 29.01.2024 të Gjykatës Administrative të Apelit, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**
Konstatimi i cenimit të së drejtës për proces të rregullt ligjor, si rrjedhojë e mosgjykimit të çështjes brenda një afati të arsyeshëm.

BAZA LIGJORE: **Nenet 17, pikat 1 dhe 2, 41, 42, pika 2, 131, pika 1, shkronja "f", 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, si dhe 142 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë *(Kushtetuta)*; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut *(KEDNJ)* dhe neni 1 i Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së; nenet 71 dhe 71/a të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës**

Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar *(ligji nr. 8577/2000)*.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Marjana Semini, mori në shqyrtim pretendimet e kërkuesit Hysni Mullalli *(kërkuesi)*, që ka kërkuar pranimin e kërkesës, konstatoi mungesën e prapësimeve me shkrim të subjektit të interesuar, Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore *(DRSSH)*, Tiranë, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I
Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi ka qenë oficer aktiv i Forcave të Armatosura nga data 01.06.1976. Ai ka dalë në rezervë në datën 01.09.2006, ndërsa mbante gradën "Kolonel" dhe me një vjetërsi shërbimi si ushtarak aktiv prej 30 vjetësh e 3 muajsh.

2. Pas përfundimit të periudhës 2-vjeçare të trajtimit me pagesë kalimtare, kërkuesi ka paraqitur kërkesë për t'u trajtuar me pension të parakohshëm për vjetërsi shërbimi (*pension i parakohshëm*). DRSSH-ja, Tiranë, me vendimin nr. 35, datë 24.02.2009 *(vendimi nr. 35/2009),* pasi ka verifikuar plotësimin e kushteve të përfitimit, e ka trajtuar kërkuesin me pension të parakohshëm në masën 19.030 lekë në muaj, me të drejtë përfitimi nga data 01.09.2008. Caktimi i pensionit të parakohshëm për kërkuesin është bazuar në ligjin nr. 8087, datë 13.03.1996 "Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë...", të ndryshuar *(ligji nr. 8087/1996)* dhe është llogaritur sipas nenit 11 të tij, në masën 50% të pagës referuese mbi të cilën është derdhur kontributi për 15 vite pune, e shtuar kjo me 2% të pagës referuese, mbi 15 vite pune, por jo më shumë se masa e pensionit maksimal në shkallë vendi. Në përgjigje të ankesës së kërkuesit për masën e caktuar të pensionit të parakohshëm, me shkresën nr. 2147 prot., datë 29.03.2011, DRSSH-ja, Tiranë e ka informuar atë se llogaritja e pensionit është bërë në përputhje me nenin 11 të ligjit nr. 8087/1996, të ndryshuar, në vlerën maksimale të pensionit të pleqërisë në shkallë vendi.

3. Në datën 13.04.2011 kërkuesi i është drejtuar gjykatës me padi, objekti

i së cilës në vijim të gjykimit është përcaktuar përfundimisht në kërkimet për: (i) prishjen e vendimit të DRSSH-së dhe ricaktimin e pensionit të parakohshëm, duke e rillogaritur sa herë që ndryshon paga referuese dhe indeksohen pensionet që nga data 01.09.2008 e në vazhdim; (ii) pagesën e diferencave mes masës së pensionit që i takon dhe pensionit të dhënë, që rezultojnë nga caktimi i gabuar i masës së pensionit dhe mosllogaritja e tij sa herë ka ndryshuar paga referuese dhe nga mosindeksimi i pensionit. Sipas kërkuesit, në caktimin e masës së pensionit të tij të parakohshëm DRSSH-ja, Tiranë nuk kishte marrë parasysh parashikimin e nenit 35 të ligjit nr. 9210, datë 23.03.2004 "Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë" *(ligji nr. 9210/2004),* si dhe se me nenin 49 të këtij ligji ishte shfuqizuar kufizimi "jo më shumë se pensioni maksimal i pleqërisë në shkallë vendi", i parashikuar në shkronjën "b" të nenit 11 të ligjit nr. 8087/1996. Po sipas tij, nuk ishte mbajtur parasysh as neni 33 i ligjit nr. 9418, datë 20.05.2005 "Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura", të ndryshuar *(ligji nr. 9418/2005),* sipas të cilit, pas hyrjes në fuqi të tij, ligji nr. 8087/1996 me ndryshimet që kishte pësuar dhe aktet e dala në zbatim të tij nuk do të zbatoheshin për ushtarakët e Forcave të Armatosura që përfitonin sipas këtij ligji.

4. Në përfundim të gjykimit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 10268, datë 15.12.2011, ka vendosur pranimin pjesërisht të padisë, duke: (1) detyruar DRSSH-në, Tiranë t'i rillogarisë paditësit (kërkuesit) pensionin e parakohshëm në përputhje me përcaktimet e nenit 35, pika 1, të ligjit nr. 9210/2004 dhe neneve 13 e 14 të ligjit nr. 9418/2005 në këtë mënyrë: a) 50 % të pagës referuese mbi të cilën është derdhur kontributi; b) për çdo vit tjetër të vjetërsisë në shërbim mbi përcaktimin e mësipërm masa e pensionit të shtohet me 2% të pagës referuese; (2) detyruar DRSSH-në, Tiranë t'i paguajë paditësit (kërkuesit) diferencat e dala si rezultat i rillogaritjes së pensionit të parakohshëm për periudhën 01.09.2008 - 30.06.2009 në shumën 562.565 lekë; (3) rrëzuar padinë për pjesën e kërkimit për pagimin e diferencave të pensionit të parakohshëm nga data 01.07.2009 e në vazhdim. Ajo gjykatë ka arsyetuar se DRSSH-ja, Tiranë në caktimin e pensionit të parakohshëm për kërkuesin nuk ka zbatuar ligjin në fuqi në momentin e lindjes të së drejtës, ndërkohë që kërkimi në padi për pagimin e diferencave të pensionit ishte i bazuar vetëm për periudhën 01.09.2008 deri 30.06.2009 të hyrjes në fuqi të ligjit nr. 10142, datë 15.05.2009 "Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së

Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, të Policisë së Burgjeve, të Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi e të punonjësve të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore në Republikën e Shqipërisë" *(ligji nr. 10142/2009),* ndërsa neni 29 i tij përcakton rillogaritjen e përfitimeve sipas rregullave të përcaktuara në këtë ligj, rillogaritje e cila nuk ishte bërë ende. Kundër këtij vendimi, për pjesën e rrëzuar të padisë, ka ushtruar ankim kërkuesi. Po ashtu, ka ushtruar ankim edhe DRSSH-ja, Tiranë, për pjesën e pranuar të padisë.

5. Gjatë kohës që çështja ndodhej në pritje për t'u shqyrtuar nga gjykata e apelit, DRSSH-ja, Tiranë ka bërë rillogaritjen e pensionit të parakohshëm të kërkuesit në zbatim të nenit 29 të ligjit nr. 10142/2009. Në përgjigje të një ankese të kërkuesit, me shkresën nr. 2594/1, datë 11.05.2012, DRSSH-ja, Tiranë e ka informuar atë për rillogaritjen e pensionit të parakohshëm duke filluar nga data 01.07.2009, e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 10142/2009, shkresë të cilën kërkuesi e ka paraqitur si provë në gjykimin në apel.

6. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 1983, datë 20.07.2012, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me të njëjtën linjë arsyetimi. Ndërkohë, mbi rekursin e ushtruar vetëm nga i padituri, DRSSH-ja, Tiranë dhe kundërrekursin e kërkuesit, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2017-454 (107), datë 01.03.2017, ka prishur vendimin e Gjykatës së Apelit Tiranë dhe e ka dërguar çështjen për rishqyrtim në Gjykatën Administrative të Apelit, me arsyetimin se gjykatat e faktit kanë zbatuar gabim ligjin material dhe në rigjykim duhet të mbajnë në konsideratë vendimin nr. 2, datë 18.02.2013 *(vendimi nr. 2/2013)* të Gjykatës Kushtetuese *(Gjykata)* dhe orientimet e vendimit unifikues nr. 3, datë 24.11.2016 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë *(vendimi unifikues nr. 3/2016).*

7. Në datën 29.06.2017 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës, duke kërkuar shfuqizimin si antikushtetues të vendimit të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë. Me vendimin nr. 215, datë 29.09.2017 *(vendimi nr. 215/2017)*, Kolegji i Gjykatës ka vendosur moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare, për shkak të mosshterimit nga kërkuesi të mjeteve ligjore në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës.

8. Në rigjykimin e çështjes, me vendimin nr. 67 (86-2024-82), datë 29.01.2024, Gjykata Administrative e Apelit ka vendosur ndryshimin e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe rrëzimin e padisë së kërkuesit. Kundër këtij vendimi kërkuesi ka ushtruar rekurs dhe Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-2861, datë

21.06.2024, ka vendosur mospranimin e tij, duke vlerësuar se në rekurs nuk ngriheshin shkaqe nga ato të parashikuara nga neni 58 i ligjit nr. 49/2012, datë 03.05.2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", të ndryshuar *(ligji nr. 49/2012)*.

9. Në datën 21.10.2024 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual, i cili, pasi është plotësuar sipas parashikimeve të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 04.11.2024, ndërsa në datën 18.12.2024 Kolegji i Gjykatës ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II
Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

10. ***Kërkuesi***, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i janë cenuar:

10.1. *E drejta për proces të rregullt ligjor*, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të:

10.1.1. *Standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor*, pasi Gjykata e Apelit Tiranë nuk ka marrë parasysh argumentet e tij se sipas shkresës nr. 2594/1 prot., datë 11.05.2012 të DRSSH-së pensioni i parakohshëm i ishte rillogritur në masën 28.332 lekë në muaj, si dhe pretendimet për shkeljen e së drejtës së pronës, të parashtruara në argumentet shtesë të datës 21.05.2012. Po kështu, Gjykata Administrative e Apelit ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë, duke u mbështetur kryesisht në përfundimin e vendimit unifikues nr. 3/2016, pa marrë parasysh pretendimet e kërkuesit, përfshirë ato për zgjatjen pa arsye të procedurave gjyqësore, si dhe rekomandimet e vendimit nr. 215/2017 të Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese. Si Gjykata Administrative e Apelit, ashtu edhe Gjykata e Lartë i kanë mbështetur vendimmarrjet e tyre vetëm në pikat që lidheshin me zbatimin e përgjithshëm të ligjit në fuqi, pa marrë në shqyrtim pretendimet e tij për shkeljen e të drejtave kushtetuese.

10.1.2. *Së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm*, pasi procesi gjyqësor për çështjen e kërkuesit ka zgjatur më shumë se 13 vjet. Kështu, vendimi i Gjykatës së Lartë për kthimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën Administrative të Apelit është marrë 52 muaj pas depozitimit të rekursit. Po

kështu, çështja është gjykuar nga Gjykata Administrative e Apelit 7 vjet e gjysmë pas regjistrimit të saj në atë gjykatë. Vonesat në gjykim janë rrjedhojë e sjelljes së gjykatave, pasi çështja nuk është komplekse ose e veçantë dhe sjellja e kërkuesit nuk është bërë shkak për shqyrtimin e saj tej afateve të arsyeshme. Kështu, në datën 15.07.2016 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës së Lartë me kërkesë për rifillimin e gjykimit të çështjes, pas pezullimit të saj për qëllime të marrjes së vendimit unifikues nr. 3/2016.

10.2. *E drejta e pronës,* e garantuar nga neni 41 i Kushtetutës dhe neni 1 i Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, *e lidhur me parimin e proporcionalitetit*, pasi vendimet e kundërshtuara e kanë penguar kërkuesin në gëzimin e qetë të pensionit të tij. Si rezultat i tyre masa e pensionit të parakohshëm i është ulur me 75%. Bazuar në parashikimet e ligjit nr. 9210/2004 dhe vendimit nr. 33, datë 24.06.2010 *(vendimi nr. 33/2010*) të Gjykatës, ai kishte pritshmëri të ligjshme për përfitimin e këtij pensioni në shumën 74.840 lekë në muaj, duke filluar nga data 01.09.2008 deri në datën 24.02.2018 të daljes në pension pleqërie. Ndërhyrja e DRSSH-së dhe gjykatave në këtë pritshmëri është e pajustifikuar. Në mënyrë joproporcionale vendimet gjyqësore i kanë reduktuar kërkuesit me 75% masën e pensionit të parakohshëm, duke e vendosur potencialisht në pozitën e debitorit, pasi mund t'i kërkohet të kthejë pjesën e shumave të marra që tejkalojnë kufirin mujor 19.030 lekë.

11. ***Subjekti i interesuar, DRSSH-ja, Tiranë,*** nuk ka paraqitur prapësime me shkrim edhe pse është njoftuar zyrtarisht nga Gjykata.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkuesit

12. Çështja e legjitimimit *(locus standi)* është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në

Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

13. Kërkuesi, në ankimin kushtetues në shqyrtim, ka kundërshtuar edhe vendimet e Gjykatës së Apelit Tiranë dhe të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë të dhëna në përfundim të procesit gjyqësor fillestar. Gjykata vëren se këto vendime janë kundërshtuar edhe më parë para saj dhe Kolegji i Gjykatës, me vendimin nr. 215/2017, ka vlerësuar se ato nuk mund të bëhen objekt i kontrollit kushtetues, pasi kërkuesi ka mjete juridike në dispozicion gjatë procesit të rigjykimit të çështjes së tij. Për rrjedhojë, në kuptim të nenit 31/a, pika 2, shkronja "dh", të ligjit nr. 8577/2000 kërkimi në lidhje me ato vendime gjyqësore nuk mund të merret në shqyrtim për sa kohë ka qenë objekt i një vendimi të mëparshëm të kësaj Gjykate.

14. Për pjesën tjetër të ankimit kushtetues individual, në lidhje me vendimet gjyqësore të dhëna në rigjykimin e çështjes, kërkuesi, si individ, legjitimohet *ratione personae,* bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor ndaj të cilit ka ngritur pretendime në këtë Gjykatë dhe ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

15. Për sa i takon kriterit të *shterimit të mjeteve juridike efektive*, sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, individi mund t'i drejtohet Gjykatës me ankim kushtetues individual vetëm pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese që ai pretendon se i janë cenuar. Shterimi i mjeteve juridike ka të bëjë me kontrollin subsidiar që ushtron Gjykata, përfshirë edhe rastet e shkeljes së të drejtave të individit. Mjetet ligjore konsiderohen të shteruara kur, në varësi të rrethanave të çështjes, rregullat procedurale nuk parashikojnë mjete të tjera ankimi *(shih vendimet nr. 59, datë 14.11.2023; nr. 12, datë 09.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese)*.

16. Në rastin konkret, Gjykata vëren se kërkuesi ka pretenduar edhe cenimin e së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm nga Gjykata e Lartë dhe Gjykata Administrative e Apelit. Sipas tij, shqyrtimi i çështjes për herë të parë nga Gjykata e Lartë është bërë pas 52 muajsh, ndërsa pas kthimit të saj për rigjykim me vendimin nr. 00-2017-454 (107), datë 01.03.2017 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, çështja është shqyrtuar nga Gjykata Administrative e Apelit pas 7 vjetësh e gjysmë.

17. Për sa u përket këtyre pretendimeve, Gjykata evidenton se me ndryshimet që i janë bërë Kodit të Procedurës Civile *(KPC)* me ligjin nr. 38/2017 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8116, datë 29.03.1996 "Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar", të hyra në fuqi më 05.11.2017, legjislacioni i brendshëm ka parashikuar mjete juridike (nenet 399/1 e vijues të KPC-së), që i ofrojnë individit rezultate konkrete për rivendosjen e së drejtës kushtetuese për gjykim brenda një afati të arsyeshëm. Në rastin konkret, nga materialet e dosjes gjyqësore të administruar për qëllime të gjykimit kushtetues, Gjykata konstaton se kërkuesi nuk rezulton të ketë përdorur këto mjete të parashikuara nga dispozitat në fjalë, duke mos shteruar në këtë mënyrë mjetet juridike efektive në dispozicion përpara se t'i drejtohet Gjykatës për pretendimet për tejzgjatje të afatit të gjykimit.

18. Në lidhje me pretendimet e tjera për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor dhe së drejtës së pronës të lidhur me parimin e proporcionalitetit, të cilat janë parashtruar në thelb në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, Gjykata çmon se kërkuesi nuk ka më mjete të tjera në dispozicion përveçse ankimit kushtetues individual, ndaj në lidhje me to vlerëson se i ka shteruar mjetet juridike efektive në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës.

19. Kërkuesi legjitimohet edhe *ratione temporis*, bazuar në nenin 71/a, pika 1, shkronja "b", të ligjit nr. 8577/2000, pasi vendimi më i fundit në kohë që ka përmbyllur procesin gjyqësor është ai i Gjykatës së Lartë, i datës 21.06.2024, ndërsa ankimi kushtetues individual është paraqitur në Gjykatë në datën 21.10.2024, pra brenda afatit 4-mujor.

20. Në kuadër të legjitimimit *ratione materiae*, Gjykata evidenton se edhe pse në objektin e ankimit kushtetues individual kërkuesi nuk ka kundërshtuar shprehimisht vendimin nr. 00-2024-2861, datë 21.06.2024, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, në përmbajtje ai ka parashtruar pretendime edhe ndaj këtij vendimi. Konkretisht, kërkuesi ka pretenduar se vendimet e gjykatave të zakonshme i kanë cenuar *të drejtën për proces të rregullt ligjor*, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të *standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor*, si dhe *të drejtën e pronës,* të garantuar nga neni 41 i Kushtetutës, në drejtim të *pritshmërive të ligjshme* për përfitimin e pensionit të parakohshëm nga data 01.09.2008 deri në datën e daljes në pension pleqërie dhe *parimit të proporcionalitetit*, si rrjedhojë e uljes me 75 % të masës së këtij pensioni. Për sa u përket këtyre pretendimeve, duke pasur parasysh se ato parashtrohen në thelb në

drejtim të interpretimit nga gjykatat e zakonshme të parashikimeve ligjore për përfitimin e pensionit të parakohshëm, Gjykata çmon t'i analizojë në vijim në drejtim të së drejtës për gjykim të drejtë, të parashikuar në nenin 42 të Kushtetutës, të lidhur me parimin e sigurisë juridike në drejtim të pritshmërive të ligjshme.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e parimit të gjykimit të drejtë të lidhur me parimin e sigurisë juridike në drejtim të pritshmërive të ligjshme

21. Kërkuesi ka pretenduar se vendimet e kundërshtuara i kanë reduktuar me 75% masën e pensionit të parakohshëm, në kundërshtim me parashikimet e ligjit nr. 9210/2004 dhe vendimin nr. 33/2010 të Gjykatës. Ai kishte pritshmëri të ligjshme për përfitimin e këtij pensioni në shumën 74.840 lekë në muaj, duke filluar nga data 01.09.2008 deri në datën 24.02.2018 të daljes në pension pleqërie. Po sipas kërkuesit, në mënyrë të pajustifikuar DRSSH-ja, Tiranë dhe gjykatat e kanë penguar në gëzimin e qetë të pensionit të parakohshëm.

22. Neni 42, pika 2, i Kushtetutës, ndër të tjera, parashikon se kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë. Gjykata në jurisprudencën e saj ka pohuar se detyra e saj është të vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës. Ajo nuk vepron si gjykatë e shkallës së katërt dhe për këtë arsye vendimet e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm nuk vihen në dyshim, përveç rasteve kur gjetjet e tyre mund të konsiderohen si arbitrare ose haptazi të paarsyeshme. E thënë ndryshe, Gjykata vepron në rastin kur gabimi ligjor ose faktik nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është aq i dukshëm, sa një gjykatë e arsyeshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose i tillë që gjykimin e bën të padrejtë (*shih vendimet nr. 25, datë 23.04.2025; nr. 67, datë 06.12.2023; nr. 59, datë 14.11.2023 të Gjykatës Kushtetuese)*.

23. Për sa i përket parimit të sigurisë juridike, Gjykata ka pohuar se ai nënkupton, ndërmjet të tjerash, garantimin e besueshmërisë së individit te shteti, institucionet e tij dhe tek aktet që ato nxjerrin. Besueshmëria ka të bëjë me bindjen e individit se nuk duhet të shqetësohet vazhdimisht ose të jetojë me frikë për ndryshueshmërinë dhe pasojat negative të akteve juridike, të cilat mund të cenojnë jetën e tij private ose profesionale dhe të

përkeqësojnë një gjendje të vendosur me akte të mëparshme. Nëse masat e marra shpien në përkeqësimin në mënyrë të paarsyeshme të gjendjes ligjore të personave të tjerë, mohojnë të drejtat e fituara ose injorojnë interesat legjitimë të këtyre, atëherë do të rrezikohet arritja e qëllimit madhor të ndërtimit të shtetit të së drejtës. Në këtë kuptim, parimi i sigurisë juridike nuk shfaqet asnjëherë si i tillë në vetvete, por shoqërohet me mbrojtjen e të drejtave të fituara, vazhdimësinë ligjore, qartësinë dhe përcaktueshmërinë në normimin e marrëdhënieve juridike, si dhe respektimin e pritshmërive legjitime *(shih vendimet nr. 9, datë 27.02.2024; nr. 11, datë 21.04.2022; nr. 10, datë 29.02.2016 të Gjykatës Kushtetuese)*.

24. Po në drejtim të parimit të sigurisë juridike, Gjykata është shprehur se ai përfshin edhe ndalimin e fuqisë prapavepruese të normave juridike, i cili nënkupton se është e pamundur të gjykohen, sipas normave ligjore në fuqi, sjellje njerëzore, fakte ligjore ose marrëdhënie ligjore që kanë ndodhur përpara se këto norma të hynin në fuqi. Si rregull, ligjet i shtrijnë efektet e tyre në kohën e ardhme dhe fuqia prapavepruese zbatohet në raste përjashtimore, sepse, në të kundërt, mund të krijohen situata me pasoja të paparashikuara (*shih vendimin nr. 78, datë 06.11.2024 të Gjykatës Kushtetuese)*. Fuqia prapavepruese zbatohet si përjashtim në ligjet penale favorizuese, në ligjet që ndërhyjnë për të rregulluar me ligj situata të paligjshme të krijuara më parë, në ligjet që interpretojnë anët e errëta ose të paqarta të një ligji të mëparshëm apo në ndonjë rast tjetër ku paraqitet domosdoshmëria për të shmangur pasoja të rënda, negative ose të pandreqshme (*shih vendimin nr. 9, datë 26.02.2007 të Gjykatës Kushtetuese*). Nocioni i fuqisë prapavepruese është i pranishëm në rastet kur një normë ligjore aplikohet për gjëra tashmë të vendosura në të kaluarën. Në aspektin kushtetues, ligji me fuqi prapavepruese është i kundërshtueshëm në qoftë se cenon të drejtat e fituara me ligjet ekzistuese ose krijon një detyrim të ri për sa u përket transaksioneve të shkuara (*shih vendimin nr. 1, datë 31.01.2003 të Gjykatës Kushtetuese*).

25. Gjykata, po kështu, është shprehur edhe se pensioni i parakohshëm për vjetërsi shërbimi jepet në konsideratë të natyrës së punës të ushtarakëve ose punonjësve të Policisë së Shtetit, të cilët pas ndërprerjes së karrierës, me ose pa dëshirën e tyre, e kanë të vështirë të gjejnë një vend pune të një niveli të krahasueshëm me funksionet që ushtronin. Për këtë arsye, ligjvënësi ka parashikuar krijimin e një sistemi përfitimesh suplementare që të garantohet ruajtja e një niveli të krahasueshëm jetese dhe ekonomik për ushtarakët e Forcave të Armatosura dhe punonjësit e Policisë së Shtetit, të

cilëve u ndërpriteshin marrëdhëniet e punës. Në këtë këndvështrim pensioni i parakohshëm për vjetërsi shërbimi mbrohet nga parimi i sigurisë juridike *(shih vendimet nr. 25, datë 23.04.2025; nr. 33, datë 24.06.2010 të Gjykatës Kushtetuese).*

26. Nisur nga standardi i mësipërm kushtetues, Gjykata çmon të ndalet fillimisht në rregullimin ligjor ndër vite të pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi për ushtarakët e Forcave të Armatosura. Konkretisht, ky pension fillimisht është njohur me ligjin nr. 8087/1996. Në nenin 11 të këtij ligji, i ndryshuar në vijim me ligjin nr. 8521/1999, parashikoheshin kushtet dhe masa e përfitimit të pensionit të parakohshëm. Sipas tij, ushtarakët e shërbimit aktiv të përhershëm, që kishin dalë në rezervë e në lirim pas datës 03.07.1991 deri në plotësimin e kushteve për pension pleqërie, sipas ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", përfitonin pension të parakohshëm për vjetërsi shërbimi, kur plotësonin vjetërsinë e shërbimit si ushtarak në masën 12 vjet për gratë dhe 15 vjet për burrat dhe të kishin mbushur moshën: gratë 42 vjeç dhe burrat 47 vjeç. Masa e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi u parashikua të ishte: a) 50 për qind e pagës referuese mbi të cilën ishte derdhur kontributi, b) për çdo vit tjetër të vjetërsisë së shërbimit mbi përcaktimin e mësipërm, masa e pensionit shtohej me 2 për qind të pagës referuese, por jo më shumë se masa e pensionit maksimal të pleqërisë në shkallë vendi. Gjithashtu, neni 10 i ligjit nr. 8251/1999 parashikoi se efektet e zbatimit të tij do të shtriheshin nga data 01.01.1999.

27. Shprehja "*por jo më shumë se masa e pensionit maksimal të pleqërisë në shkallë vendi"* në shkronjën "b" të nenit 11 të ligjit nr. 8087/1996 u shfuqizua me ligjin nr. 9210/2004 (neni 49). Gjithashtu, neni 35 i ligjit nr. 9210/2004 rregulloi të drejtën e pensionit të parakohshëm për ushtarakët aktivë të Forcave të Armatosura, duke parashikuar kushtet dhe masën e përfitimit të këtij pensioni. Në pikën 1 të këtij neni u përcaktua se "*oficerët, nënoficerët dhe ushtarët me pagesë/profesionistë, me vjetërsi shërbimi në Forcat e Armatosura 15 vjet për burrat dhe 12 vjet për gratë, gëzojnë të drejtën e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi në masën 50 për qind të pagës mujore deri në plotësimin e kushteve për përfitimin e pensionit të pleqërisë. Për çdo vit tjetër shërbimi mbi kufirin e mësipërm ushtarakut i jepet një shtesë pensioni në masën 2 për qind të pagës mujore"*. Kurse pika 3 e tij përcaktoi se kriteret dhe kushtet e përfitimit të pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi përcaktohen në ligjin për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave

të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, të ushtarakëve të Ministrisë së Rendit Publik dhe të Shërbimit Informativ Shtetëror, të ndryshuar. Ndërkohë, në dispozitat e fundit, në nenin 48 të ligjit, për sa i përkiste zbatimit të nenit 35 të tij, ngarkoi Këshillin e Ministrave që brenda 24 muajve nga hyrja në fuqi e ligjit, të paraqiste ndryshimet përkatëse në ligjin nr. 8087/1996.

28. Në vijim u miratua ligji nr. 9418/2005, i cili në nenin 13 përcaktoi kushtet e përfitimit të pensionit të parakohshëm, të njëjta si ato në ligjin nr. 8087/1996 dhe ligjin nr. 9210/2004. Ndërsa neni 14 rregulloi masën e pensionit të parakohshëm, duke përcaktuar të njëjtën masë pensioni të parakohshëm sikurse dhe neni 35 i ligjit nr. 9210/2004, por me kufizimin se *"masa e pensionit të parakohshëm nuk mund të jetë më e madhe se katërfishi i pensionit bazë"*. Neni 32 i tij ngarkoi Këshillin e Ministrave që, brenda 3 muajve nga data e hyrjes në fuqi, të nxirrte aktet nënligjore në zbatim të neneve 3, 4 dhe 14 të këtij ligji. Ndërkohë, neni 33 i dispozitave kalimtare, parashikoi se ligji nr. 8087/1996 dhe aktet e dala në zbatim të tij, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, nuk do të zbatoheshin për ushtarakët e Forcave të Armatosura, që përfitonin sipas këtij ligji. Ligji hyri në fuqi në datën 01.01.2006.

29. Më pas, ligji nr. 9418/2005 u ndryshua me ligjin nr. 9481/2006, i cili ndryshoi dispozitat në lidhje me kushtet dhe masën e përfitimit të pensionit të parakohshëm (nenet 13 dhe 14). Për kushtet e përfitimit të pensionit të parakohshëm, neni 1 i ligjit ndryshues përcaktoi të njëjtat kushte, por identifikoi dy kategori ushtarakësh përfitues: (i) ata që dilnin në rezervë/lirim pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 9210/2004 deri në plotësimin e kushteve për pension të plotë pleqërie sipas ligjit nr. 7703/1993, për të cilët masa e përfitimit përcaktohej në nenin 14 të ligjit; (ii) ata që kishin dalë në rezervë/lirim nga data 1 janar 1991 deri në datën e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 9210/2004, pavarësisht nga çasti i lindjes të së drejtës për përfitimin e pensionit të parakohshëm, të cilët do të vazhdonin ta përfitonin sipas ligjit nr. 8087/1996. Kurse për masën e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi, neni 2 i ligjit ndryshues, ndërsa përcaktoi të njëjtën masë pensioni të parakohshëm, sikurse dhe neni 35 i ligjit nr. 9210/2004, vendosi kufizime sipas gradave të ushtarakëve, të cilat varionin deri në 6-fishin e pensionit bazë për ushtarakët me gradën "gjeneral", deri në 3-fishin e pensionit bazë për ushtarakët e tjerë, ku për sa u përket ushtarakëve me gradën "kolonel" (gradë që e ka pasur edhe kërkuesi Hysni Mullalli), kufizimi i masës së pensionit shkonte deri në 5-fishin e pensionit bazë. Neni 9 i ligjit

nr. 9481/2006 ndryshoi edhe dispozitën për hyrjen në fuqi të ligjit (nenin 34), duke parashikuar se hynte në fuqi në datën 16.04.2006.

30. Ndërkohë, neni 1 i ligjit nr. 9481/2006, i cili ndryshoi nenin 13 të ligjit nr. 9418/2005 për kushtet e përfitimit të pensionit të parakohshëm, u shfuqizua nga Gjykata me vendimin nr. 9, datë 26.02.2007, me arsyetimin se ai cenonte parimin e sigurisë juridike, për shkak të paqartësisë dhe kontradiktave midis dispozitave të ligjit (në lidhje me nenin 33 të pandryshuar të ligjit nr. 9418/2005), por edhe parimin e barazisë përpara ligjit. Gjykata konstatoi se kjo dispozitë i ndante ushtarakët në dy kategori për efekt të përfitimit të pensionit të parakohshëm, ndërsa me ligjin e mëparshëm pagesa e pensionit shkonte deri në 4-fishin e pensionit bazë në shkallë vendi, me ligjin e ri u ul pagesa e pensionit të parakohshëm për ushtarakët e dalë në pension deri në datën e hyrjes në fuqi të ligjit për statusin (ligji nr. 9210/2004), për të cilët kjo masë shkonte deri në masën e pensionit maksimal në shkallë vendi, e barabartë me 2-fishin e pensionit bazë, kur për ushtarakët e dalë në pension të parakohshëm, pas hyrjes në fuqi të ligjit për statusin, maksimumi i pagesës jepej i diferencuar sipas gradës dhe shumë më i favorshëm nga ajo që u jepej ushtarakëve që kishin dalë në pension përpara ligjit për statusin. Po kështu, Gjykata konstatoi se neni 1 i ligjit të kundërshtuar i bënte referencë ligjit të vitit 1996 (nr. 8087/1996) për përfitimet e një kategorie ushtarakësh, ndërkohë që neni 33 i pandryshuar i ligjit të vitit 2005 (nr. 9418/2005) ndalonte zbatimin e atyre dispozitave, duke krijuar kështu paqartësi në kuptimin e ligjit dhe në zbatimin e tij. Me të njëjtin arsyetim u shfuqizua edhe neni 7, pika 1, shkronjat "a" dhe "b", të ligjit nr. 9481/2006, i cili shtoi nenin 31/1 në ligjin nr. 9418/2005, në lidhje me njohjen e periudhës së sigurimit për efekt të pensionit të pleqërisë. Me këtë vendim Gjykata shfuqizoi edhe nenin 9 të ligjit nr. 9481/2006, përmes të cilit ishte shtyrë hyrja në fuqi e ligjit nr. 9418/2005, duke konstatuar edhe në këtë rast cenimin e parimit të sigurisë juridike. Në vendimin e saj, duke vlerësuar se me shfuqizimin e këtyre dispozitave të ligjit krijoheshin boshllëqe edhe lidhur me pensionet e parakohshme për vjetërsi shërbimi të ushtarakëve, Gjykata i rekomandoi Këshillit të Ministrave dhe Kuvendit të Shqipërisë të merrnin masa për të bërë rishikimin në tërësi të ligjit në përputhje me vendimin e saj.

31. Në vijim u miratua një ligj tjetër për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, ligji nr. 10142/2009, i cili hyri në fuqi në datën 27.06.2009. Ky ligj shfuqizoi si ligjin nr. 8087/1996, ashtu edhe ligjin nr. 9418/2005, përveçse edhe pikat 1 dhe 2 të nenit 35 të

ligjit nr. 9210/2004. Në nenin 29 ligji parashikoi rillogaritjen e të drejtave të njohura, sipas të cilit dispozitat e ligjit nr. 8087/1996 zbatohen deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji (pika 1). Pensionet e parakohshme të caktuara në përputhje me ligjin nr. 8087/1996, si edhe ato të caktuara me vendime të gjykatave, pavarësisht nga mosha e vjetërsia në punë, në çastin e fillimit të së drejtës, do të rillogariten, rillogaritje e cila bëhet sipas rregullave të përcaktuara në këtë ligj dhe në bazë të pagave referuese, në çastin që i ka lindur e drejta për përfitim, masë përfitimi të rivlerësuar mbi të cilën zbatohen koeficientet e rritjes apo të indeksimit të pensionit, sipas vendimeve të veçanta të Këshillit të Ministrave, nga çasti i lindjes të së drejtës dhe deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji. Masa e pensionit, e rivlerësuar si më lart, në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, vlerësohet si shumë përfundimtare e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi ose e pensionit suplementar (pika 2). Pensionet për vjetërsi shërbimi, kur plotësohen kriteret e nenit 11 të ligjit nr. 8087/1996 dhe kur e drejta për përfitim ka lindur në harkun kohor 0l.01.1999 deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, por nuk është caktuar, llogariten sipas kritereve të këtij ligji (pika 3).

32. Dispozita të këtij ligji, përfshirë edhe nenin 29 të tij, janë bërë objekt kontrolli kushtetues dhe Gjykata, me vendimin nr. 33/2010, ndërsa ka shfuqizuar pikën 2 të nenit 14 dhe nenin 27 të ligjit nr. 10142/2009, nuk ka pranuar kërkesat në lidhje me nenin 29 të ligjit. Lidhur me këtë të fundit, Gjykata ka vërejtur se ajo mund të ulte/pakësonte ose rriste të drejtat e fituara. Duke mos mohuar interesat dhe pritshmëritë e ligjshme të qytetarëve nga ndryshimet në legjislacion dhe synimin e shtetit për të ndryshuar një situatë të rregulluar më parë vetëm nëse ai sjell pasoja pozitive, Gjykata ka vlerësuar se mund të zbatohet një interpretim pajtues i kësaj dispozite dhe konkretisht se rillogaritja e të drejtave të fituara në zbatim të ligjeve të mëparshme ose dhe të vendimeve të gjykatave të bëhet vetëm në rast se ndryshon pozitivisht, pra përmirëson situatën e përfituesve, pasi në të kundërt do të ishim përpara cenimit të parimit të sigurisë juridike, cenim për justifikimin e të cilit për një interes të rëndësishëm publik subjektet e interesuara nuk dhanë argumente.

33. Këshilli i Ministrave në vijim miratoi aktin normativ nr. 5, datë 10.11.2010 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10142, datë 15.5.2009 ...", akt normativ i cili bënte disa ndryshime në masën dhe mënyrën e përllogaritjes së pensionit suplementar të ushtarakëve të liruar. Ky akt normativ me fuqinë e ligjit u miratua me ligjin nr. 10367, datë 23.12.2010.

Këto akte normative u bënë objekt i kontrollit kushtetues dhe Gjykata, me vendimin nr. 2/2013 rrëzoi kërkesën për shfuqizimin e tyre. Gjykata vlerësoi se përmes akteve të kundërshtuara masa e përfitimit të sigurimit suplementar është zvogëluar si pasojë e vendosjes si pagë referuese pagën mujore neto, por pavarësisht se parimi i sigurisë juridike është prekur nga rregullimi i ri, ndërhyrja në këtë rast është bërë duke respektuar kriteret kushtetuese të parashikuara nga neni 17, pika 1, i Kushtetutës, konkretisht mbrojtjen e interesit publik, vendosjen e një raporti të drejtë midis së drejtës së cenuar dhe qëllimit që synohet të arrihet nëpërmjet ndërhyrjes legjislative, si dhe ruajtjen e thelbit të së drejtës për sigurim shoqëror.

34. Në lidhje me zbatimin në kohë dhe efektin prapaveprues të legjislacionit për pensionin e parakohshëm, si dhe skemën e zbatueshme për llogaritjen e masës së këtij pensioni, për shkak të qëndrimeve të ndryshme të gjykatave, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 3/2016, kanë arritur në përfundimin njësues se, në referim të nenit 29, pika 1, të ligjit nr. 10142/2009, në gjykimin e mosmarrëveshjeve për pensionet e parakohshme për vjetërsi shërbimi, për periudhën nga data 01.01.1999 deri në hyrjen në fuqi të ligjit nr. 10142/2009, pensioni i parakohshëm për vjetërsi shërbimi do të përllogaritej sipas ligjit nr. 8087/1996 (të ndryshuar me ligjin nr. 8521/1999). Sipas atyre kolegjeve, zbatimi në këtë mënyrë i nenit 29 të ligjit nr. 10142/2009 bën që të mos zbatohet ligji nr. 9418/2005 (i ndryshuar me ligjin nr. 9481/2006), për përfituesit që u ka lindur e drejta për pension të parakohshëm për vjetërsi shërbim në kohën kur ky ligj ka qenë në fuqi dhe se cenimi i parimit të sigurisë juridike në këtë rast diktohej nga interesi publik, mbrojtja e të cilit ka përparësi sikurse Gjykata ka pranuar në vendimet e saj nr. 33/2010 dhe nr. 2/2013. Po sipas tyre, zbatimi me fuqi prapavepruese i nenit 29 të ligjit është në përputhje me Kushtetutën, sikurse është vlerësuar edhe në vendimet në fjalë të Gjykatës.

35. Gjithashtu, sipas Kolegjeve të Bashkuara, ligji nr. 9210/2004 kishte hequr kufizimin në masën e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi të parashikuar, por zbatimi i parashikimit ligjor të këtij ligji ishte i kushtëzuar me nxjerrjen e rregullimeve ligjore në fushën e sigurimeve shoqërore suplementare të ushtarakëve në zbatim të këtij ndryshimi. Caktimi i pensionit të parakohshëm, sipas nenit 11 të ligjit nr. 8087/1996 (i ndryshuar me ligjin nr. 8521/1999), bëhej duke u llogaritur sipas skemës: a) 50% e pagës referuese mbi të cilën ishte derdhur kontributi; b) për çdo vit tjetër të vjetërsisë së shërbimit mbi 12 vjet për gratë dhe 15 vjet për burrat masa e pensionit shtohej me 2% të pagës referuese. Por masa

e përgjithshme e pensionit të parakohshëm nuk mund të kalonte masën e pensionit maksimal të pleqërisë në shkallë vendi. Tavani i vendosur në lidhje me masën e pensionit të parakohshëm në nenin 11 të ligjit nr. 8087/1996, të ndryshuar, duhet të zbatohej për të gjithë masën e pensionit të parakohshëm.

36. Për sa më lart, në rastin në shqyrtim, nisur nga thelbi i parashtrimeve të kërkuesit, si dhe bazuar në standardet kushtetuese të sipërcituara, Gjykata do të analizojë nëse interpretimi që Gjykata Administrative e Apelit dhe Gjykata e Lartë i kanë bërë ligjit material të zbatueshëm në mosmarrëveshjen objekt gjykimi i ka cenuar kërkuesit të drejtën për pension të parakohshëm për vjetërsi shërbimi, të përfituar për shkak të parashikimeve ligjore, pra nëse në interpretimin që ato gjykata i kanë bërë ligjit të zbatueshëm në rastin e kërkuesit ka ose jo elemente të arbitraritetit.

37. Në çështjen në shqyrtim, Gjykata vëren se kërkuesit, si ushtarak i dalë në rezervë, e drejta për pension të parakohshëm i ka lindur në datën 01.09.2008. Trajtimi i tij me këtë pension është bazuar në ligjin nr. 8087/1996, të ndryshuar me ligjin nr. 8521/1999 dhe është caktuar në masën 19.030 lekë në muaj, sipas aktit administrativ nr. 35/2009 të DRSSH-së, Tiranë, cili është kundërshtuar gjyqësisht nga kërkuesi. Me vendimin nr. 10268, datë 15.12.2011, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vlerësuar se pensioni i parakohshëm i kërkuesit është në masën e 50 % të pagës referuese mbi të cilën është derdhur kontributi dhe për çdo vit tjetër të vjetërsisë në shërbim mbi këtë masë shtohej 2% e pagës referuese, në përputhje me pikën 1 të nenit 35 të ligjit nr. 9210/2004 dhe nenet 13 e 14 të ligjit nr. 9418/2005. Sipas saj, këto dispozita ligjore nuk parashikonin kufizimin e zbatuar nga DRSSH-ja, Tiranë, bazuar në nenin 11 të ligjit nr. 8087/1996 (të ndryshuar me ligjin nr. 8521/1999), sipas të cilit masa e pensionit të parakohshëm nuk duhet të kalojë masën e pensionit maksimal të pleqërisë në shkallë vendi, përveçse ky kufizim ishte shfuqizuar nga neni 49 i ligjit nr. 9210/2004. Po sipas gjykatës, rillogaritja e pensionit të parakohshëm për kërkuesin dhe pagimi i diferencave të tij shtrihej deri në datën 30.06.2009, e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 10142/2009, datë pas së cilës pensioni i tij i nënshtrohej rillogaritjes sipas nenit 29 të këtij ligji, rillogaritje e cila nuk ishte bërë ende nga DRSSH-ja, Tiranë.

38. Gjykata e Apelit Tiranë ka vlerësuar të drejtë qëndrimin e gjykatës së rrethit për sa i përket legjislacionit të zbatueshëm, duke arsyetuar se DRSSH-ja duhej t'i paguante kërkuesit diferencën e pensionit të parakohshëm deri në momentin e zbatimit të ligjit nr. 10142/2009 e t'i rillogariste këtë pension

në zbatim të këtij ligji e VKM-së nr. 793/1010, të ndryshuar me VKM-në nr. 252, datë 09.02.2011. Ndërsa, për sa i përket përfitimit të pensionit të parakohshëm pas datës 30.06.2009, gjykata e apelit ka vënë në dukje se rillogaritja e tij, sipas nenit 29 të ligjit nr. 10142/2009, nuk ishte bërë konflikt gjykimi, ndaj nuk mund të gjykohej një konflikt që nuk kishte ekzistuar vetëm mbi pretendimin e kërkuesit se ai nuk duhej të ndodhte.

39. Vendimi i mësipërm i gjykatës së apelit është prishur nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë. Sipas këtij kolegji, gjykatat e faktit kanë zbatuar gabim ligjin material dhe në rigjykim duhet të mbajnë në konsideratë vendimin e Gjykatës nr. 2/2013 dhe orientimet e vendimit unifikues nr. 3/2016 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

40. Në rigjykim, me vendimin nr. 67 (86-2024-82), datë 29.01.2024, Gjykata Administrative e Apelit ka vendosur ndryshimin e vendimit të gjykatës së rrethit dhe rrëzimin e padisë së kërkuesit. Sipas asaj gjykate, pavarësisht se në kohën e caktimit të pensionit të parakohshëm të kërkuesit kanë qenë në fuqi ligji nr. 8087/1996, i ndryshuar me ligjin nr. 8521/1999 dhe me ligjin nr. 9210/2004, si dhe ligji nr. 9418/2005, i ndryshuar me ligjin nr. 9481/2006, referuar përfundimeve të arritura në vendimin unifikues nr. 3/2016 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, për periudhën 01.09.2008 - 30.06.2009, ligji i zbatueshëm në rastin konkret nuk është ligji nr. 9418/2005, i ndryshuar me ligjin nr. 9481/2006, por ligji nr. 8087/1999, i ndryshuar me ligjin nr. 8521/1999, i cili është zbatuar edhe në rastin konkret. Për rrjedhojë, gjykata e apelit ka vlerësuar se gjykata e rrethit nuk ka zbatuar drejt ligjin material, ndërkohë që llogaritja e pensionit të parakohshëm të kërkuesit nga DRSSH-ja, Tiranë është bërë në përputhje me formulën e nenit 11 të ligjit nr. 8087/1996, të ndryshuar. Kurse për periudhën në vijim, pra nga data 01.07.2009, sipas gjykatës së apelit, pensioni i parakohshëm i kërkuesit është rillogaritur sipas nenit 29 të ligjit nr. 10142/2009, në përputhje me formulën e parashikuar në nenin 14 të tij, dispozitë e cila i ishte nënshtruar kontrollit kushtetues, duke mos u gjetur ajo antikushtetuese nga Gjykata në vendimin nr. 2/2013.

41. Çështja në vijim i është nënshtruar kontrollit nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë i cili, me vendimin nr. 00-2024-2861, datë 21.06.2024, ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuesit, me arsyetimin se shkaqet e tij nuk mbështeteshin në asnjë prej rasteve të parashikuara në nenin 58 të ligjit nr. 49/2012.

42. Bazuar në standardet e mësipërme dhe duke pasur në konsideratë rrethanat e rastit konkret, Gjykata vëren se kërkuesit i ka lindur e drejta

për pension të parakohshëm në datën 01.09.2008, moment në të cilin kjo e drejtë rregullohej nga nenet 13 dhe 14 të ligjit nr. 9418/2005, të ndryshuar me ligjin nr. 9481/2006, të cilat përcaktonin kushtet dhe kriteret për përfitimin e pensionit të parakohshëm dhe masën e tij, për të cilën përcaktohej se ajo ishte 50% e pagës referuese dhe për çdo vit tjetër të vjetërsisë së shërbimit mbi përcaktimin e mësipërm, masa e pensionit shtohej me 2% të pagës referuese, por masa e pensionit të parakohshëm nuk mund të ishte më e madhe se 5-fishi i pensionit bazë për ushtarakët që mbanin gradën "Kolonel". Ndërkohë, sikurse u theksua më lart (*shih paragrafët 27 e 28 të vendimit*), për shkak të shfuqizimit me ligjin nr. 9210/2004 të tavanit të masës së pensionit maksimal të pleqërisë, si dhe parashikimeve të nenit 33 të ligjit nr. 9418/2005, sipas të cilit, me hyrjen e tij në fuqi, ligji nr. 8087/1996 dhe aktet e dala në zbatim të tij nuk do të zbatoheshin për ushtarakët e Forcave të Armatosura që përfitonin sipas këtij ligji, kërkuesi kishte pritshmëri të ligjshme se ai do të përfitonte nga këto dispozita, pra se ndaj atij nuk do të zbatohej tavan/kufizim në masën e pensionit të parakohshëm (referuar ligjit nr. 9210/2004) apo se ky kufizim do të ishte deri në 5-fishin e pensionit bazë (referuar ligjit nr. 9418/2005, të ndryshuar me ligjin nr. 9481/2006).

43. Megjithatë, Gjykata konstaton se pavarësisht momentit kur kërkuesit i ka lindur e drejta për pension të parakohshëm dhe ligjit në fuqi në atë moment, konkretisht të ligjit nr. 9418/2005, të ndryshuar me ligjin nr. 9481/2006, Gjykata Administrative e Apelit ka arritur në përfundimin se ky ligj nuk zbatohej, por zbatohej ligji nr. 8087/1996, i ndryshuar me ligjin nr. 8521/1999, megjithëse neni 33 i ligjit të parë parashikonte shprehimisht se ky i dyti nuk do të zbatohej për ushtarakët e Forcave të Armatosura, që përfitonin sipas këtij ligji (ligjit të parë) (*shih paragrafin 29 të këtij vendimi*). Për këtë ajo gjykatë i është referuar përfundimit të arritur në vendimin unifikues nr. 3/2016 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, sipas të cilave, referuar nenit 29, pika 1, të ligjit nr. 10142/2009, për periudhën nga data 01.01.1999 dhe deri në hyrjen në fuqi të ligjit nr. 10142/2009, pensioni i parakohshëm për vjetërsi shërbimi do të përllogaritej sipas ligjit nr. 8087/1996 (të ndryshuar me ligjin nr. 8521/1999), përfshirë edhe për përfituesit që u ka lindur e drejta për pension të parakohshëm për vjetërsi shërbim në kohën kur në fuqi ka qenë ligji nr. 9418/2005 (i ndryshuar me ligjin nr. 9481/2006), ligj i cili nuk zbatohej. Po sipas atyre kolegjeve, zbatimi me fuqi prapavepruese i nenit 29 të ligjit është në përputhje me Kushtetutën, sikurse është vlerësuar edhe në vendimet e Gjykatës nr.

33/2010 dhe nr. 2/2013 *(shih paragrafin 35 të këtij vendimi)*. Megjithatë, objekt rregullimi i nenit 29 të ligjit nr. 10142/2009 është rillogaritja e të drejtave të njohura, ku pika 1 e tij përcakton zbatimin e dispozitave të ligjit nr. 8087/1996 deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji (nr. 10142/2009), duke mos u shprehur për ndonjë efekt prapaveprues të ligjit në fjalë, por as për (pa)zbatueshmërinë e ligjit nr. 9418/2005 apo rregullimin ndryshe të pasojave të ardhura nga zbatimi i tij. Po ashtu, edhe në vendimet e referuara në Gjykatës nuk ka ndonjë vlerësim në lidhje me (pa)zbatueshmërinë e ligjit nr. 9418/2005 për periudhën që ai ka qenë në fuqi dhe as për zbatimin në mënyrë përjashtimore me efekt prapaveprues të ligjit nr. 10142/2009, pra me qëllim rregullimin e ndonjë prej atyre situatave të cilat, në aspektin kushtetues, në këndvështrim të parimit të sigurisë juridike, do të lejonin, përjashtimisht, zbatimin me efekt prapaveprues të këtij ligji ndaj situatave apo marrëdhënieve të lindura përpara hyrjes së tij në fuqi *(shih paragrafët 33 dhe 34 të këtij vendimi*).

44. Gjithashtu, përtej kësaj, Gjykata konstaton se ndonëse me ligjin nr. 9210/2004 tavani i masës së pensionit maksimal të pleqërisë ishte shfuqizuar, Gjykata Administrative e Apelit për pensionin e parakohshëm të kërkuesit për periudhën 01.09.2008 - 30.06.2009, duke u bazuar në nenin 11 të ligjit nr. 8087/1996, të ndryshuar me ligjin nr. 8521/1999, ka përcaktuar se masa e përgjithshme e pensionit të parakohshëm nuk mund të kalonte masën e pensionit maksimal të pleqërisë në shkallë vendi, duke vlerësuar edhe ajo se ligji nr. 9210/2004 nuk mund të zbatohej, pasi nuk kishin dalë aktet nënligjore në zbatim të tij.

45. Duke arsyetuar si më lart, Gjykata Administrative e Apelit duket se nuk ka mbajtur parasysh rregullimet e nenit 37, pika 1, të ligjit nr. 49/2012, sipas të cilit gjykata e shqyrton ligjshmërinë e veprimit administrativ që kundërshtohet në bazë të situatës ligjore dhe faktike që ekzistonte në kohën e kryerjes së veprimit konkret administrativ, si dhe nuk e ka llogaritur masën e pensionit sipas kushteve e kritereve të parashikimeve ligjore në fuqi për atë periudhë. Prandaj, në vlerësimin e Gjykatës vendimi i gjykatës së apelit nuk duket se ka përmbushur konceptin e një gjykimi të drejtë në kuptim të parashikimit të nenit 42 të Kushtetutës.

46. Nga ana tjetër, Gjykata vëren se përmbajtja e ligjit nr. 9210/2004 dhe e nenit 29 të ligjit nr. 10142/2009, si dhe mënyra e interpretimit të tyre nga gjykata e apelit nuk rezultojnë të jenë analizuar nga Gjykata e Lartë. Gjithashtu, ajo nuk shprehet përse ligji nr. 9418/2005 i ndryshuar me ligjin nr. 9481/2006, i identifikuar nga gjykata e rrethit si i zbatueshëm

për periudhën 01.09.2008 - 30.06.2009, është i pazbatueshëm në rastin konkret dhe se i tillë është ligji nr. 8087/1996, i ndryshuar me ligjin nr. 8521/1999, si dhe pse në rastin në shqyrtim kishte vend për zbatimin e vendimit unifikues për këtë periudhë dhe përse ligji i identifikuar si i zbatueshëm nga gjykata e apelit vijon të përmbajë kufizim të masës së pensionit të parakohshëm (jo më shumë se masa e pensionit maksimal të pleqërisë në shkallë vendi), në një kohë kur ky kufizim është shfuqizuar. Në këtë drejtim, nuk duket se Gjykata e Lartë u ka dhënë përgjigje shkaqeve të paraqitura në rekurs në lidhje me ligjin e zbatueshëm në rastin konkret, sikundër edhe për sa i përket zbatimit të kritereve ligjore të parashikuara nga ligji nr. 8087/1996, i ndryshuar me ligjin nr. 8521/1999, për periudhën 01.09.2008 - 30.06.2009, si pasojë e shfuqizimit me ligjin nr. 9210/2004 të masës së tavanit të pensionit të parakohshëm.

47. Nisur nga sa më lart, Gjykata vlerëson se Gjykata e Lartë si gjykatë ligji duhet t'u kthente përgjigje pretendimeve të kërkuesit për ligjin e zbatueshëm dhe kriteret e përcaktimit të masës së pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi. Për sa i përket këtij të fundit, ajo gjykatë nuk mund të mjaftohej me një arsyetim të kufizuar, por duhet të mbante qëndrim dhe të arsyetonte qoftë për sa i përket ligjit të zbatueshëm, ashtu edhe në veçanti në drejtim të masës së kufizimit të pensionit të parakohshëm të kërkuesit për periudhën 01.09.2008 - 30.06.2009. Prandaj, vendimi i saj nuk plotëson kërkesat për një gjykim të drejtë në drejtim të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, duke i cenuar kërkuesit edhe parimin e sigurisë juridike në drejtim të së drejtës për pension të parakohshëm të fituar prej tij nga ligji.

48. Për arsyet e lartpërmendura, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuesit për cenimin e së drejtës së pensionit të parakohshëm për shkak të interpretimit të paarsyeshëm të ligjit është i bazuar. Megjithatë, Gjykata, duke mbajtur në konsideratë edhe rolin subsidiar të saj në respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, vlerëson se i përket Gjykatës së Lartë të kontrollojë ligjshmërinë e vendimmarrjes së gjykatave të faktit për interpretimin e ligjit material prej tyre, prandaj duhet të shfuqizohet vetëm vendimi i saj.

49. Në përfundim, Gjykata çmon se sipas arsyetimit të mësipërm të këtij vendimi, kërkesa është e bazuar, ndaj ajo pranohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, si dhe neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, njëzëri,

V E N D O S I:

1. Pranimin pjesërisht të kërkesës.

2. Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2024-2861, datë 21.06.2024 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

3. Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 27.05.2025
Shpallur më 01.08.2025

Vendim nr. 35, datë 27.05.2025
(V-35/25)

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Holta Zaçaj, Kryetare, Marsida Xhaferllari, Sonila Bejtja, Sandër Beci, Ilir Toska, Genti Ibrahimi, Marjana Semini, Fiona Papajorgji, anëtarë, me sekretare Belma Lleshi, në datën 27.05.2025 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 1 (Nj) 2025 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: **JO MË PAK SE NJË E DHJETA E DEPUTETËVE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**, përfaqësuar nga kryetari i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, Gazment Bardhi dhe avokati Marash Logu, me autorizim.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, përfaqësuar nga Genci Gjonçaj, sekretar i përgjithshëm.

DEPUTETI VULLNET SINAJ, përfaqësuar nga avokate Romina Zano, me prokurë.

OBJEKTI: **Zgjidhja e konfliktit të kompetencave ndërmjet Kuvendit të Shqipërisë dhe subjektit kushtetues në konflikt, jo më pak se një e dhjeta e deputetëve.**

Deklarimi si i papajtueshëm me Kushtetutën i vendimit nr. 5, datë 30.01.2025 "Për mosdërgimin e mocionit në Gjykatën Kushtetuese" për konstatimin e papajtueshmërisë së mandatit të deputetit Vullnet Sinaj.

Detyrimi i Kuvendit të Shqipërisë për dërgimin në Gjykatën Kushtetuese të mocionit për

konstatimin e papajtueshmërisë së mandatit të deputetit Vullnet Sinaj.

BAZA LIGJORE: Nenet 70, 71, 131, shkronja "ç", të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 27, 54 dhe 66/a të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar *(ligji nr. 8577/2000)*.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Fiona Papajorgji, mori në shqyrtim parashtrimet me shkrim të jo më pak se një të dhjetës së deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë *(kërkuesi)*, që ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet e subjekteve të interesuara, Kuvendit të Republikës së Shqipërisë *(Kuvendi)* dhe deputetit Vullnet Sinaj, të cilat kanë kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I
Rrethanat e çështjes

1. Me shkresën nr. 3160, datë 08.08.2024, 14 deputetë të Kuvendit, anëtarë të Partisë Demokratike, i janë drejtuar Kuvendit me mocion për ndjekjen e procedurës parlamentare për konstatimin e papajtueshmërisë dhe mbarimit të mandatit të deputetit të Kuvendit Vullnet Sinaj dhe dërgimin e mocionit në Gjykatën Kushtetuese (*Gjykata*), për shkak se gjatë periudhës 2017-2024, që ka ushtruar mandatin e deputetit, ka përfituar nëpërmjet shoqërive të tij të ardhura nga buxheti i shtetit, në kundërshtim me nenin 70, pika 3, të Kushtetutës.

2. Në datën 04.09.2024 është zhvilluar mbledhja e parë e Këshillit për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin (Këshilli për Rregulloren), në të cilën janë paraqitur faktet dhe provat nga deputeti përfaqësues i deputetëve nënshkrues të mocionit, Gazment Bardhi, si dhe deputeti Vullnet Sinaj. Për shkak të kërkesës së këtij të fundit për t'u përfaqësuar me një avokat, mbledhja është shtyrë në datën 18.09.2024. Në këtë datë është zhvilluar mbledhja e dytë e Këshillit për Rregulloren, e cila është ndërprerë. Në

kushtet kur nga Kryetarja e Kuvendit nuk është thirrur mbledhja e radhës, me shkresën nr. 3160/3 prot., datë 01.11.2024, deputeti Gazment Bardhi ka kërkuar mbledhjen e Këshillit për Rregulloren për vijimin e shqyrtimit të mocionit. Në datën 20.11.2024 është zhvilluar mbledhja e tretë e Këshillit për Rregulloren, në të cilën deputeti Vullnet Sinaj dhe përfaqësuesja e tij kanë mbajtur qëndrimin e tyre për mocionin.

3. Me shkresën nr. 4721 prot., datë 13.12.2024, deputeti Gazment Bardhi ka kërkuar mbledhjen e Këshillit për Rregulloren, duke i bashkëlidhur edhe raportin e relatorit të deputetëve të opozitës, në përmbajtje të të cilit është konkluduar se mocioni plotëson kriteret e nenit 70, pika 3, të Kushtetutës, ai është nënshkruar nga jo më pak se një e dhjeta e deputetëve, shoqërohet me dokumentacion dhe prova shoqëruese që mbështesin mocionin, deputeti e ka marrë mandatin përpara në kohë nga momenti i transaksioneve dhe bëhet fjalë për veprimtari fitimprurëse që buron nga pasuria e shtetit.

4. Në datën 17.01.2025 shumica parlamentare ka paraqitur raportin e saj për mocionin e paraqitur nga një e dhjeta e deputetëve, në të cilin është konkluduar se kërkesa për mocion i plotëson kërkesat formale të parashikuara në nenin 70, pika 4, të Kushtetutës dhe kërkesës i janë bashkëlidhur provat dhe dokumentet e nevojshme. Për verifikimin e kritereve të parashikuara në pikën 3 të nenit 70 të Kushtetutës, shumica ka rekomanduar t'i kalojë seancës plenare për votim projektvendimin "Për dërgimin e mocionit në Gjykatën Kushtetuese për konstatimin e papajtueshmërisë dhe mbarimit të mandatit të deputetit Vullnet Sinaj".

5. Në datën 17.01.2025 është zhvilluar mbledhja e katërt e Këshillit për Rregulloren, gjatë së cilës janë prezantuar raportet e shumicës dhe pakicës parlamentare. Me vendimin nr. 5, datë 30.01.2025, Kuvendi ka vendosur: "*Mosdërgimin në Gjykatën Kushtetuese të mocionit të jo më pak se 1/10-ës së deputetëve për konstatimin e papajtueshmërisë së mandatit të deputetit Vullnet Sinaj*" (*vendimi nr. 5/2025*).

6. Në datën 05.03.2025 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me kërkesë, sipas objektit, duke kërkuar zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencës të krijuar mes tij dhe Kuvendit, si rrjedhojë e marrjes së vendimit nr. 5/2025, deklarimin e këtij vendimi si të papajtueshëm me Kushtetutën dhe detyrimin e Kuvendit për dërgimin në Gjykatë të mocionit për konstatimin e papajtueshmërisë së mandatit të deputetit Vullnet Sinaj.

7. Në datën 06.03.2025 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me kërkesë për përshpejtimin e shqyrtimit të çështjes ose në alternativë për shqyrtimin në themel të papajtueshmërisë dhe mbarimit të mandatit të deputetit.

8. Në datën 12.03.2025 Kolegji i Gjykatës ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve, e cila në datën 18.03.2025 ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve. Po në këtë datë, Mbledhja e Gjyqtarëve ka vendosur edhe pranimin e kërkesës për përshpejtim.

II
Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

9. ***Kërkuesi,*** në mënyrë të përmbledhur, ka paraqitur pretendimet, si vijon:

9.1. *Për themelin e pretendimeve*

9.1.1. Deputeti ka papajtueshmëri me detyrën, për shkak se në cilësinë e pronarit ose bashkëpronarit të nëntë shoqërive ka përfituar të ardhura të vazhdueshme nga buxheti i shtetit edhe pas fitimit të mandatit të deputetit. Këto shoqëri kanë vazhduar të jenë në pronësi të tij, pasi përmes disa marrëveshjeve është bërë vetëm transferimi i kuotave dhe jo tjetërsimi i tyre, duke kaluar nga zotërues aktiv i aksioneve në zotërues pasiv. Caktimi i personave të besuar për drejtimin e tyre nuk nënkupton se deputeti ka humbur pronësinë ose të drejtën për të marrë përfitime. Neni 70, pika 3, i Kushtetutës ndalon në mënyrë të qartë ushtrimin e aktivitetit fitimprurës nga deputeti kur të ardhurat burojnë nga buxheti i shtetit dhe ka qëllim eliminimin e shkaqeve për ta konsideruar këtë funksion si një mundësi për të shtuar burimin e të ardhurave për shkak të pozitës së privilegjuar. Ky ndalim kushtetues nuk mund të shmanget nëpërmjet delegimit të vendimmarrjes te një person i besuar. Për më tepër, fakti që fitimet e këtyre shoqërive kanë shkuar si divident për deputetin vërtetohet edhe nga deklaratat vjetore të deklarimit të pasurisë. Gjithashtu, deputeti ka paraqitur si prova dy dokumente që vërtetojnë kthimin e vlerave të transaksioneve në buxhetin e shtetit ose te shoqëritë, çka provon se ai ka përfituar fonde publike. Jurisprudenca kushtetuese nuk ka bërë dallimin midis personit fizik dhe juridik dhe midis veprimtarisë së kryer veçmas nga këto subjekte të së drejtës, si dhe nuk e ka lidhur ndalimin me përfitimin e drejtpërdrejtë të deputetit nga veprimtaria e kryer. Kontratat e lidhura nga shoqëritë ku

ai është aksionar kanë sjellë të ardhura në mënyrë indirekte për të, duke rritur kapitalin e shoqërisë dhe vlerën e aksioneve që ai zotëronte.

9.1.2. Neni 70, pika 3, i Kushtetutës nuk mund të lexohet i shkëputur nga përmbajtja e nenit 70 në tërësinë e tij, i cili edhe pse, në thelb, ka për qëllim shmangien e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike, referon te ligji nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", i ndryshuar. Sipas këtij ligji, deputeti nuk mund të jetë drejtues ose anëtar i organeve drejtuese të organizatave fitimprurëse dhe as mund të ushtrojë veprimtari private që krijojnë të ardhura në formën e personit fizik tregtar. Është detyrë e deputetit të marrë masa me qëllim shmangien e situatave të papajtueshmërisë përpara marrjes së mandatit parlamentar.

9.1.3. Për të gjitha arsyet e mësipërme, Kuvendi, në mbështetje të nenit 70, pika 4, të Kushtetutës dhe nenit 119/1, pika 2, të Rregullores së Kuvendit, ka detyrimin për dërgimin e mocionit në Gjykatë për të konstatuar papajtueshmërinë dhe mbarimin e mandatit të deputetit. Kuvendi nuk mund të vlerësojë nëse veprimet konkrete janë të papajtueshme me mandatin e deputetit, pasi kjo është çështje ekskluzive e Gjykatës. Për më tepër, raportet e shumicës dhe pakicës parlamentare kanë konkluduar se mocioni përmbush kërkesat formalo-juridike, pasi është nënshkruar nga 14 deputetë, është i shoqëruar me prova, si dhe plotëson kriteret kushtetuese të nenit 70, pika 3, të Kushtetutës.

10. ***Subjekti i interesuar, Kuvendi,*** në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar:

10.1. *Për legjitimimin e kërkuesit:*

10.1.1. Kërkuesi nuk legjitimohet, pasi nuk ekziston një mosmarrëveshje kompetencash mes tij dhe Kuvendit. Referuar dispozitës kushtetuese dhe ligjore, për të pasur një mosmarrëveshje të tillë nevojitet ndërhyrja me akt normativ në kompetencat e një organi kushtetues, duke sjellë si pasojë pakësimin ose shtimin e kompetencave të tij; kur një ose disa organe nxjerrin akte që cenojnë sferën e kompetencave të organit tjetër ose kur një organ nuk e kërkon për vete

kompetencën për të përmbushur një akt të caktuar, por pretendon se sjellja mosvepruese e një organi tjetër ose një akt i tij ka zvogëluar kompetencat e tij ose e ka penguar në ushtrimin e tyre. Në rastin konkret nuk ekziston asnjë prej këtyre kritereve.

10.1.2. Asnjë nga deputetët kërkues nuk ka qenë i pranishëm në momentin e votimit për dërgimin e mocionit të deputetit Vullnet Sinaj në Gjykatë, duke bojkotuar në mënyrë të qëllimshme dhe me vullnet të plotë votimin. Në këtë mënyrë kërkuesit i hiqet mundësia për të shfrytëzuar një të drejtë kushtetuese, për sa kohë nuk ka përmbushur detyrimin e ushtrimit efektivisht të mandatit përfaqësues dhe kompetencës së pretenduar të cenuar nga Kuvendi. Duke mos qenë prezent në votimin e mocionit, kërkuesi nuk ka interes legjitim për t'iu drejtuar Gjykatës për të kundërshtuar vendimin e Kuvendit për mosmiratimin e këtij mocioni, i cili është votuar me 61 vota "kundër", 12 "abstenim" dhe asnjë votë "pro". Nuk mund të ketë cenim të një kompetence kushtetuese kur vetë subjekti nuk ka ndërmarrë asnjë hap konkret për ta ushtruar atë kompetencë dhe nuk ka qenë pjesë e procesit institucional ku ajo kompetencë merr kuptim praktik. Po kështu, kërkuesi nuk është penguar të marrë pjesë në këtë proces. Mosprania fizike në votim përbën shprehje të qartë të mungesës së interesit për të vijuar me nismën e tij dhe është interpretuar e tillë nga deputetët e tjerë të pranishëm. Vetëm nëpërmjet votimit për dërgimin e mocionit në Gjykatë aktivizohet kompetenca që pretendohet se është cenuar. Kërkuesi nuk ka arritur të identifikojë kompetencën kushtetuese që i është cenuar, pasi e drejta për të kërkuar papajtueshmërinë e mandatit të deputetit i përket vetëm Kuvendit.

10.2. *Për themelin e pretendimeve*

10.2.1. Kërkuesi nuk ka plotësuar kriteret formale që duhet të plotësojë mocioni, pasi provat e paraqitura në Kuvend nuk plotësojnë kriterin minimal në drejtim të provueshmërisë së papajtueshmërisë së deputetit, kryerjes të ndonjë veprimi që sjell si pasojë shkeljen e dispozitës kushtetuese ose mosveprimi nga ana e deputetit. Pesë nga transaksionet objekt mocioni nuk janë përfitime nga buxheti i shtetit, pasi

i përkasin rimbursimit të tepricave për tatimin mbi të ardhurat të paguar paraprakisht nga shoqëritë dhe të kthyera për shkak të likuidimit të tyre. Katër prej transaksioneve nuk i përkasin periudhës së mandatit aktual të deputetit. Tetëmbëdhjetë transaksione janë kundërshtuar përtej afatit 3-mujor të parashikuar në nenin 66/a të ligjit nr. 8577/2000, ndërsa kërkuesi nuk ka arritur të identifikojë momentin e marrjes dijeni të konstatimit. Në këtë kuptim, mocionit i mungon kriteri juridiko-formal, duke e bërë atë të paplotësuar nga ana e përmbajtjes dhe të pavlefshëm për qëllimin e synuar.

10.2.2. Transaksionet e evidentuara janë të rastësishme, të kryera në kushte tregtare të zakonshme, në vlera minimale dhe të papërfillshme dhe përjashtojnë ekzistencën e një përfitimi ekonomik nga ana e deputetit. Për të gjitha transaksionet në vlera të vogla mungon dijenia, ndikimi dhe vullneti i deputetit. Disa prej transaksioneve janë bërë në markete të ndodhura në afërsi me institucionet shtetërore nga stafi i zakonshëm, çka tregon mungesën e përzgjedhjes së qëllimshme në funksion të interesit të deputetit. Që prej vitit 2017 deputeti nuk zotëron asnjë kuotë aktive në shoqëritë ku ishte aksionar, duke caktuar persona të besuar, ndërsa përmes vendimeve të asamblesë së ortakëve është ndaluar shprehimisht kryerja e veprimtarive që burojnë nga pasuria e shtetit. Deputeti, si zotërues pasiv i aksioneve, nuk mund të urdhërojë personin e besuar. Transaksionet e pretenduara nuk janë përfshirë në asnjë procedurë tenderimi dhe nuk janë prerë fatura në zbatim të kontratave publike. Deputeti ka ndërmarrë të gjitha veprimet konkrete/masat për të shmangur papajtueshmërinë me detyrën dhe ai nuk mund të penalizohet për veprimet e të tretëve ose kur ka qenë në mirëbesim. Kërkuesi nuk arriti të paraqiste prova se deputeti ka përdorur detyrën zyrtare për të përfituar nga buxheti i shtetit apo se ndërprerja e mandatit është proporcionale.

11. ***Subjekti i interesuar, deputeti Vullnet Sinaj,*** në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar:

11.1. *Për legjitimimin:*

11.1.1. Kërkuesi nuk legjitimohet, pasi në rastin konkret nuk ekziston një konflikt kompetencash në kuptim të nenit 131, pika 1,

shkronja "ç", të Kushtetutës. Gjykata mund të zgjidhë konflikte kompetencash vetëm në rastet kur dy ose më shumë pushtete bien në kundërshtim për ushtrimin e një funksioni kushtetues konkret, me anë të aktit zyrtar të secilit prej tyre. Kuvendi ka ushtruar kompetencën e tij për të shqyrtuar dhe vlerësuar mocionin dhe ka vendosur mospranimin e tij sipas nenit 70 të Kushtetutës. Deputetët të cilët kanë paraqitur mocionin me vullnet nuk kanë ushtruar të drejtën e tyre, pasi asnjë nuk ka qenë i pranishëm gjatë votimit. Nuk mund të ngrihet pretendimi për konflikt kompetencash kur nuk ka pasur kërkesë për të ushtruar një kompetencë dhe mungesa e pjesëmarrjes nuk mund të ngrihet në nivelin e një konflikti institucional. Pjesëmarrja në procesin e votimit nuk është një formalitet.

11.2. *Për themelin e pretendimeve*

11.2.1. Kërkesa për mocion nuk përmbush kushtet juridiko-formale të kërkuara nga Kushtetuta, pasi, së pari, nuk mbështetet në fakte të qarta dhe të provuara që lidhen me ndonjë veprim ose mosveprim të vet deputetit, së dyti, provat nuk identifikojnë asnjë marrëdhënie kontraktuale të lidhur me ndonjë subjekt publik dhe asnjë formë të ndërhyrjes apo përfitimit të deputetit dhe, së treti, përmbajtja e dokumenteve të paraqitura është interpretuar në mënyrë të gabuar ose të njëanshme për të krijuar idenë e një situate papajtueshmërie, e cila nuk qëndron në fakt dhe në ligj.

11.2.2. Transaksionet nuk përfaqësojnë përfitime nga fondet publike të buxhetit të shtetit; katër transaksione i përkasin periudhës përpara fillimit të mandatit të deputetit; tetëmbëdhjetë transaksione janë kundërshtuar përtej afateve procedurale; disa prej tyre janë të rastësishme dhe në vlera minimale, të cilat janë rikthyer në buxhetin e shtetit në momentin e marrjes dijeni; deputeti ka marrë të gjitha masat për respektimin e ndalimit të konfliktit të interesit përpara marrjes së mandatit, çka është konfirmuar edhe nga institucioni përgjegjës i ngarkuar për të kontrolluar rastet e konfliktit.

11.2.3. Gjykata duhet të tregojë vetëpërmbajtje dhe të mos përfshihet në debatet politike në kushtet kur po zhvillohen zgjedhjet e përgjithshme parlamentare.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për juridiksionin e Gjykatës

12. Kërkuesi i është drejtuar Gjykatës bazuar në nenin 131, pika 1, shkronja "ç", të Kushtetutës dhe nenet 27, 54 dhe 66/a të ligjit nr. 8577/2000, duke kërkuar: (i) zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencave ndërmjet tij, si subjekt i veçantë, i parashikuar në nenin 70, pika 4, të Kushtetutës dhe Kuvendit; (ii) shfuqizimin si antikushtetues të vendimit nr. 5/2025 të Kuvendit, i cili është bërë shkak për lindjen e mosmarrëveshjes së kompetencave.

13. Subjekti i interesuar, Kuvendi, ka prapësuar se nuk ekziston një mosmarrëveshje kompetencash mes tij dhe kërkuesit. Sipas tij, referuar dispozitave kushtetuese dhe ligjore, për të pasur një mosmarrëveshje të tillë nevojitet ndërhyrja me akt normativ në kompetencat e një organi kushtetues, duke sjellë si pasojë pakësimin ose shtimin e kompetencave të tij ose nxjerrja, nga një ose disa organe, e akteve që cenojnë sferën e kompetencave të organit tjetër ose kur një organ nuk e kërkon për vete kompetencën për të përmbushur një akt të caktuar, por pretendon se sjellja mosvepruese e një organi tjetër ose një akt i tij kanë zvogëluar kompetencat e tij ose e kanë penguar në ushtrimin e tyre. Në rastin konkret, sipas këtij subjekti, nuk ekziston asnjë prej këtyre kritereve.

14. Subjekti i interesuar, deputeti Vullnet Sinaj, ka prapësuar se nuk ekziston një konflikt kompetencash në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja "ç", të Kushtetutës. Sipas tij, Gjykata mund të zgjidhë konflikte kompetencash vetëm në rastet kur dy ose më shumë pushtete bien në kundërshtim për ushtrimin e një funksioni kushtetues konkret, me anë të aktit zyrtar të secilit prej tyre. Kuvendi, ka prapësuar ky subjekt, ka ushtruar kompetencën e tij për të shqyrtuar dhe vlerësuar mocionin dhe ka vendosur mospranimin e tij sipas nenit 70 të Kushtetutës.

15. Gjykata ka pohuar se natyra dhe kufijtë e juridiksionit kushtetues përcaktohen drejtpërdrejt nga neni 124 i Kushtetutës, sipas të cilit: *"1. Gjykata Kushtetuese zgjidh mosmarrëveshjet kushtetuese dhe bën interpretimin përfundimtar të saj."*. Kurse sipas nenit 131, pika 1, shkronja "ç", të Kushtetutës, Gjykata vendos, ndër të tjera, edhe për mosmarrëveshjet e kompetencës ndërmjet pushteteve. Kjo dispozitë kushtetuese përfshin jo vetëm mosmarrëveshjet që lindin në sferën e ndarjes klasike të pushteteve (ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor, si dhe pushtet qendror e qeverisje

vendore), por edhe ato që mund të lindin midis organesh a subjektesh që nuk bëjnë pjesë, në mënyrë të përcaktuar e kategorike, në secilin prej tyre. Sipas Gjykatës, çdo organ juridiksional, qoftë si institucion ose organ pushteti, në kuptimin klasik administrativ të tij, ose dhe si subjekt që ushtron funksionet në një situatë pavarësie të plotë të garantuar nga Kushtetuta, mund të jetë palë në mosmarrëveshje kompetencash *(shih vendimet nr. 1, datë 23.01.2023; nr. 29, datë 21.10.2009; nr. 20, datë 04.05.2007 të Gjykatës Kushtetuese)*.

16. Një mosmarrëveshje kompetence që paraqitet për zgjidhje përpara Gjykatës duhet të ketë natyrë kushtetuese, në kuptimin që subjektet e përfshira në konflikt të jenë nga ato që i njeh Kushtetuta dhe që kompetenca e pretenduar të parashikohet si e tillë në Kushtetutë. Në këtë mënyrë, gjykimi kushtetues përqendrohet pikësëpari në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të kompetencës për sa u takon funksioneve të nivelit kushtetues, duke gjetur dhe cilësuar si të papajtueshëm me Kushtetutën shkakun vendimtar që ka sjellë lindjen e mosmarrëveshjes. Në përfundim, Gjykata vendos se cilit organ të pushtetit i përket kompetenca për të cilën ka lindur mosmarrëveshja. Në këto raste është e domosdoshme të ketë një mosmarrëveshje konkrete, pasi zgjidhja e çështjeve të kësaj natyre nuk mund të bëhet me kontroll kushtetues *in abstracto (shih vendimet nr. 26, datë 25.05.2021; nr. 36, datë 01.06.2015; nr. 4, datë 01.02.2015 të Gjykatës Kushtetuese)*.

17. Sipas Gjykatës, mosmarrëveshja e kompetencave lind në dy raste: i) kur një organ ndërhyn me akt normativ në kompetencat e një organi kushtetues, duke sjellë si pasojë pakësimin ose shtimin e kompetencave të tij. Në këtë rast objekt i gjykimit kushtetues është vlerësimi *in abstracto* nëse ky ndryshim i kompetencave ka cenuar parimin kushtetues të ndarjes së pushteteve; ii) kur një ose disa organe nxjerrin akte që cenojnë sferën e kompetencave të organit tjetër. Në këtë rast objekt i gjykimit kushtetues është vlerësimi *in concreto* nëse akti ka prekur kompetencat e një organi tjetër *(shih vendimin nr. 26, datë 25.05.2021 të Gjykatës Kushtetuese)*.

18. Në rastin konkret, kërkuesi (një e dhjeta e deputetëve) ka pretenduar se ka lindur një mosmarrëveshje kompetencash mes tij dhe Kuvendit, për shkak se ky i fundit ka detyrimin për dërgimin e mocionit në Gjykatë për konstatimin e papajtueshmërisë dhe mbarimin e mandatit të deputetit dhe nuk mund të vlerësojë vetë nëse veprimet konkrete janë të papajtueshme me mandatin e deputetit, pasi kjo është çështje ekskluzive e Gjykatës. Nga ana tjetër, subjektet e interesuara kanë prapësuar se nuk ekziston një

konflikt kompetencash në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja "ç", të Kushtetutës, sepse kërkuesi nuk ka arritur të identifikojë kompetencën kushtetuese që i është cenuar, pasi e drejta për të kërkuar papajtueshmërinë e mandatit të deputetit i përket vetëm Kuvendit, i cili në rastin konkret ka ushtruar kompetencën për të shqyrtuar dhe vlerësuar mocionin dhe ka vendosur mospranimin e tij sipas nenit 70 të Kushtetutës.

19. Gjykata, fillimisht, sjell në vëmendje se referuar nenit 131, pika 1, shkronja "e", të Kushtetutës, ndërmjet të tjerave, ajo vendos edhe për çështjet që lidhen me papajtueshmëritë në ushtrimin e funksioneve të deputetëve. Megjithatë, kjo kompetencë, në kuptim të përmbajtjes së pikës 3 të nenit 70 të Kushtetutës, ushtrohet vetëm në ato raste kur deputetët kryejnë veprimtari fitimprurëse që buron nga pasuria e shtetit ose e pushtetit vendor apo fitojnë pasuri të këtyre. Sipas pikës 4 të këtij neni, Kryetari i Kuvendit ose një e dhjeta e anëtarëve të tij janë subjektet që nisin procedurat parlamentare dhe Kuvendi është subjekti i posaçëm që vë në lëvizje gjykimin kushtetues në këto raste për shqyrtimin në themel të papajtueshmërisë së mandatit të deputetit. Referuar dispozitave të ligjit organik të Gjykatës deri në vitin 2016, neni 66 i tij parashikonte si subjekt të posaçëm që mund të vinte në lëvizje Gjykatën për këtë qëllim vetëm Kuvendin. Me ndryshimet që iu bënë këtij ligji me ligjin nr. 99/2016, në nenin 66, pika 2, u parashikua si subjekt i posaçëm, përveç Kuvendit, edhe një e pesta e deputetëve, që është një nga subjektet me legjitimitet të pakushtëzuar që mund t'i drejtohet Gjykatës sipas nenit 134, pika 1, shkronja "c", të Kushtetutës. Gjykata vëren se qëllimi për miratimin e kësaj dispozite ka qenë përshtatja me ndryshimet kushtetuese dhe synimi për ta bërë atë më efektive në vendimmarrje, më specifikisht duke detajuar subjekte kërkuese në disa procedura gjykimi që kanë qenë të parregulluara ose të rregulluara jo mjaftueshëm, të tilla si shqyrtimi i papajtueshmërisë së mandatit të deputetit (*shih faqet 2 dhe 7 të raportit të Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën në Sistemin e Drejtësisë*).

20. Gjykata vëren se në praktikën e saj, në zbatim të nenit 70, pika 4, të Kushtetutës, ajo është vënë në lëvizje si nga Kuvendi, ashtu edhe nga një e dhjeta e deputetëve dhe pas ndryshimeve ligjore të vitit 2016 edhe nga jo më pak se një e pesta e deputetëve *(shih vendimet nr. 55, datë 10.07.2024; nr. 2, datë 23.01.2023; nr. 1, datë 23.01.2023; nr. 32 datë 03.06.2016; nr. 7, datë 24.02.2016; nr. 44, datë 07.10.2011; nr. 29, datë 30.06.2011 të Gjykatës Kushtetuese).* Megjithatë, ndërsa Kuvendi dhe jo më pak se një e pesta e deputetëve kanë vënë në lëvizje gjykimin kushtetues për

ushtrimin e kompetencës sipas neneve 131, pika 1, shkronja "e" dhe 70, pika 3, të Kushtetutës, subjekti kushtetues, një e dhjeta e deputetëve, duke mos pasur të drejtë të vërë drejtpërdrejt në lëvizje Gjykatën për ushtrimin e kësaj kompetence, e ka vënë në lëvizje gjykimin kushtetues për zgjidhjen e konfliktit të kompetencave mes tij dhe Kuvendit gjatë procedurave parlamentare të zhvilluara për këtë qëllim, por duke synuar, përmes kësaj lloj kërkese, detyrimin e Kuvendit për të dërguar në Gjykatë çështjen e papajtueshmërisë së mandatit të deputetit, duke qenë se kjo e fundit është organi i vetëm që mund të vendosë për themelin e saj.

21. Gjykata rithekson se vënia në lëvizje e saj në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja "e" dhe 70, pikat 3 dhe 4, të Kushtetutës ka për qëllim final kontrollin e kushtetutshmërisë së veprimtarisë së Kuvendit dhe vetë anëtarëve të tij, duke synuar që të shmangë çdo vendimmarrje politike nga ana e Kuvendit, në diskrecion të shumicës parlamentare. Në kuptim të këtij qëllimi, Gjykata ka interpretuar normat kushtetuese, duke njohur mbrojtjen kushtetuese të së drejtës së pakicës parlamentare dhe duke pranuar vënien e saj në lëvizje edhe me kërkesë të një të dhjetës së deputetëve për zgjidhjen e konfliktit të kompetencave me Kuvendin në rastet kur ky i fundit nuk ka pranuar mocionin e këtij subjekti për dërgimin në Gjykatë të çështjes së papajtueshmërisë së mandatit të deputetit. Megjithatë, Gjykata vëren se një e dhjeta e deputetëve është subjekti që vë në lëvizje Kuvendin nëpërmjet mocionit dhe është ky i fundit i cili vë në lëvizje Gjykatën për shqyrtimin në themel të papajtueshmërisë së mandatit të deputetit në kuptim të nenit 70, pika 3, të Kushtetutës.

22. Gjykata vlerëson të theksojë se ndalimi i deputetëve për të ushtruar veprimtari fitimprurëse që buron nga pasuria e shtetit, i parashikuar në nenin 70, pika 3, të Kushtetutës, ka për qëllim të mbrojë integritetin e funksionit publik të deputetit, i cili duhet të ushtrojë funksionin jetik të përfaqësimit politik të zgjedhësve i pandikuar nga interesat personalë ose të grupeve të ngushta. Në këtë mënyrë garantohet besimi i publikut në procesin e përfaqësimit demokratik dhe parandalohen fenomene të tilla si konflikti i interesave.

23. Po kështu, Gjykata thekson se qëllimi i kompetencës kushtetuese për kontrollin e papajtueshmërisë së mandatit të deputetit nënkupton një gjykim në themel prej saj, në të cilin ajo vlerëson nëse veprimet konkrete të kryera nga deputeti janë të papajtueshme me mandatin e tij dhe në përfundim konstaton këtë papajtueshmëri, nëse është rasti. Në funksion të realizimit të këtij qëllimi, kushtetutëbërësi ka parashikuar edhe një të

dhjetën e deputetëve si subjekt që vë në lëvizje procedurën parlamentare për dërgimin e çështjes së papajtueshmërisë së dyshuar të deputetit për shqyrtim në themel në Gjykatë. Në këto kushte, në rastet kur Kuvendi vihet në lëvizje me mocion të një të dhjetës së deputetëve ose të Kryetarit të tij, ai (Kuvendi) ka detyrimin kushtetues për të filluar procedurën parlamentare për shqyrtimin e mocionit për dërgimin e çështjes së papajtueshmërisë së mandatit në Gjykatë. Në rast të rrëzimit të mocionit të një të dhjetës së deputetëve të Kuvendit ose Kryetarit të tij, për rrjedhojë në rast të mosvënies në lëvizje të Gjykatës nga Kuvendi, në kuptim të bërjes efektiv të këtij mekanizmi të kontrollit kushtetues të parashikuar nga shkronja "e" e pikës 1 të nenit 131 të Kushtetutës, paraqitja e kërkesës nga jo më pak se një e pesta e deputetëve, në kuptim të së drejtës së saj sipas shkronjës "c" të pikës 1 të nenit 134 të Kushtetutës, të reflektuar tashmë edhe në përmbajtjen e pikës 2 të nenit 66 të ligjit nr. 8577/2000, përbën mjetin alternativ për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues për kontrollin e papajtueshmërisë së mandatit të deputetit.

24. Referuar rregullimit që i është bërë në ligjin organik së drejtës së jo më pak se një të pestës së deputetëve për të vënë në lëvizje Gjykatën për shqyrtimin e papajtueshmërisë së mandatit të deputetit, ajo vlerëson të theksojë se ky subjekt kushtetues nuk zëvendëson Kuvendin në ushtrimin e kompetencës së tij për dërgimin në Gjykatë të çështjes sipas nenit 70, pika 4, të Kushtetutës. E drejta e një të pestës së deputetëve sipas nenit 66, pika 2, të ligjit nr. 8577/2000 lidhet me vënien në lëvizje të Gjykatës në ato raste kur vetë Kuvendi, pas shqyrtimit të mocionit të Kryetarit të tij ose një të dhjetës së deputetëve, vendos të rrëzojë mocionin në seancë plenare, për rrjedhojë të mos pranojë dërgimin e çështjes në Gjykatë. Vetëm në këtë mënyrë bëhet i zbatueshëm neni 70, pika 4, i Kushtetutës dhe merr vlerë e drejta e pakicës parlamentare, jo më pak se një të pestës së deputetëve, për të kërkuar nga Gjykata shqyrtimin përfundimtar në themel të çështjes së papajtueshmërisë së mandatit të deputetit.

25. Gjykata, bazuar në jurisprudencën e saj për interpretimin e nenit 70, pikat 3 dhe 4, të Kushtetutës, si dhe bazuar në përmbajtjen e dispozitave kushtetuese që përcaktojnë subjektet që e vënë atë në lëvizje, ashtu edhe në parashikimet e reja ligjore që kanë përcaktuar në mënyrë të shprehur të drejtën e jo më pak se një të pestës së deputetëve për të kërkuar shqyrtimin e papajtueshmërisë së mandatit të deputetit, vëren se mocioni i një të dhjetës së deputetëve që i paraqitet Kuvendit synon në thelb vënien në lëvizje të saj përmes organit ku ky subjekt bën pjesë, Kuvendit, për gjykimin në

themel të çështjes së papajtueshmërisë së mandatit të deputetit, çka përbën edhe objektin e vetë mocionit të një të dhjetës së deputetëve. Nisur nga kjo, mosmarrëveshja që i kërkohet Gjykatës të zgjidhë në çështje të kësaj natyre, është verifikimi nëse deputeti ka kryer veprimtari nga ato që ndalon pika 3 e nenit 70 të Kushtetutës, për pasojë, konstatimin e papajtueshmërisë së mandatit të deputetit, proces që, si rregull, duhet të vihet në lëvizje nga Kuvendi. Në këtë kuptim, Gjykata, sikurse është shprehur në jurisprudencën e saj, rithekson se Kuvendi është i detyruar ta dërgojë çështjen në Gjykatë për shqyrtimin në themel të saj, në rastet kur mocioni i paraqitur plotëson kriteret juridiko-formale (*shih vendimin nr. 7, datë 24.02.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

26. Për sa më lart, për t'i dhënë kuptim dhe vlerë normave kushtetuese në lidhje me mbrojtjen e integritetit të funksionit publik të deputetit, garantimin e ushtrimit nga Gjykata të kompetencës së saj dhe të drejtës së pakicës parlamentare në përmbushje të misionit dhe funksioneve të saj, duke marrë shkas edhe nga fakti se interpretimi i Kushtetutës duhet të garantojë efektivitetin e mjeteve në drejtim të qëllimit të çështjes kushtetuese të synuar, Gjykata vlerëson të zhvillojë qasjen e saj në këtë drejtim jo vetëm për të bërë efektive kompetencën e saj, por edhe të drejtën e pakicës parlamentare. Gjykata i përmbahet konceptit se Kushtetuta duhet interpretuar si një "instrument i gjallë" dhe në mënyrë që të ketë kuptimin më të arsyeshëm dhe më efikas të mundshëm, që do të thotë se ajo i përshtatet evolucionit që bëjnë vlerat në vendin tonë (*shih vendimet nr. 20, datë 01.06.2011; nr. 26, datë 02.11.2006 të Gjykatës Kushtetuese*).

27. Për sa më sipër, në rastin konkret, pavarësisht se në objektin e kërkesës një e dhjeta e deputetëve ka kërkuar zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencave midis saj dhe Kuvendit, në thelb ajo çka synohet është papajtueshmëria e mandatit të deputetit Vullnet Sinaj, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja "e", të Kushtetutës. Pra, në këtë rast përpara Gjykatës nuk ka një mosmarrëveshje kompetencash në kuptim të standardeve kushtetuese të përmendura më lart (*shih paragrafët 15-17 të vendimit*), por përpara saj është shtruar një mosmarrëveshje kushtetuese që lidhet pikërisht me papajtueshmërinë e mandatit të deputetit. Kjo passjell, për rrjedhojë, mungesën e legjitimimit të kërkuesit, një të dhjetës së deputetëve të Kuvendit, për të vënë në lëvizje Gjykatën për zgjidhjen e kësaj mosmarrëveshjeje kushtetuese, pra për konstatimin e deklarimit të papajtueshmërisë së mandatit të deputetit Vullnet Sinaj.

28. Në përfundim, Gjykata rithekson se në çdo rast një e dhjeta e

deputetëve ka të drejtën të kërkojë nga Kuvendi me mocion që të dërgojë në Gjykatë çështjen e papajtueshmërisë së deputetit në ushtrimin e mandatit dhe në rast të rrëzimit të një mocioni të tillë, aktivizohet e drejta e jo më pak se një të pestës së deputetëve për të vënë drejtpërdrejt në lëvizje gjykimin kushtetues për shqyrtimin në themel të çështjes së papajtueshmërisë dhe deklarimin e mbarimit të mandatit të deputetit.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 70, pikat 3 e 4, 124, 131, shkronja "e" dhe 134, pika 1, shkronja "c", të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe neneve 66 dhe 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me shumicë votash,

V E N D O S I:

1. Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 27.05.2025
Shpallur më 10.07.2025

MENDIM PAKICE

1. Në gjykimin kushtetues të çështjes, që i përket kërkuesit një e dhjeta e deputetëve të Kuvendit, me objekt: "*Zgjidhja e konfliktit të kompetencave ndërmjet Kuvendit të Shqipërisë dhe subjektit kushtetues në konflikt, jo më pak se një e dhjeta e deputetëve. Deklarimi si i papajtueshëm me Kushtetutën i vendimit nr. 5, datë 30.01.2025 "Për mosdërgimin e mocionit në Gjykatën Kushtetuese" për konstatimin e papajtueshmërisë të mandatit të deputetit Vullnet Sinaj. Detyrimi i Kuvendit të Shqipërisë për dërgimin në Gjykatën Kushtetuese të mocionit për konstatimin e papajtueshmërisë së mandatit të deputetit Vullnet Sinaj*", jemi kundër qëndrimit të shumicës për rrëzimin e kërkesës, pasi vlerësojmë se kërkesa duhej të ishte pranuar. Në mbështetje të neneve 132, pika 3, të Kushtetutës dhe 72, pika 8, të ligjit nr. 8577/2000, që parashikojnë publikimin e mendimit të pakicës së bashku me vendimin përfundimtar të Gjykatës, parashtrojmë në vijim argumentet që mbështesin qëndrimin kundër.

2. Nga rrethanat e çështjes rezulton se kërkuesi i është drejtuar fillimisht Kuvendit me mocion për ndjekjen e procedurës parlamentare për konstatimin e papajtueshmërisë dhe mbarimit të mandatit të deputetit Vullnet Sinaj, me argumentin se gjatë kohës së ushtrimit të mandatit ka përfituar nga buxheti i shtetit nëpërmjet shoqërive tregtare të tij. Pas kalimit të mocionit për votim në seancë plenare, Kuvendi ka vendosur mosdërgimin në Gjykatë të mocionit. Në vijim, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me kërkesë, sipas objektit të lartpërmendur, duke pretenduar se në mbështetje të nenit 70, pika 4, të Kushtetutës Kuvendi ka detyrimin për dërgimin e mocionit në Gjykatë për të konstatuar papajtueshmërinë dhe mbarimin e mandatit të deputetit, pasi nuk është në kompetencën e tij vlerësimi në themel i mocionit.

3. Shumica ka arritur në përfundimin se kërkuesi, një e dhjeta e deputetëve, nuk legjitimohet për të vënë në lëvizje Gjykatën. Në funksion të përcaktimit të juridiksionit të Gjykatës, bazuar në nenin 131, pika 1, shkronja "e", të Kushtetutës, shumica ka evidentuar kompetencën e saj (Gjykatës) për çështjet që lidhen me papajtueshmërinë e mandatit të deputetëve, duke theksuar se nga përmbajtja e nenit 70, pika 4, të Kushtetutës, subjektet që nisin procedurat parlamentare janë Kryetari i Kuvendit ose një e dhjeta e anëtarëve të tij, ndërsa subjekti që vë në

lëvizje gjykimin kushtetues është Kuvendi. Gjithashtu, ajo ka konstatuar se ndryshimet e ligjit nr. 8577/2000 kanë parashikuar në nenin 66, pika 2 edhe jo më pak se një të pestën e deputetëve si subjekt me legjitimitet të pakushtëzuar që mund t'i drejtohet Gjykatës edhe për çështje të kësaj natyre (*shih paragrafin 19 të vendimit).*

4. Shumica ka evidentuar po ashtu se Gjykata është vënë në lëvizje më parë për ushtrimin e kësaj kompetence si nga Kuvendi ashtu edhe nga jo më pak se një e pesta e deputetëve. Ajo ka vërejtur se Gjykatës i është drejtuar edhe një e dhjeta e deputetëve, por ky subjekt, duke mos pasur të drejtën ta vërë drejtpërdrejt në lëvizje për kontrollin e papajtueshmërisë së mandatit të deputetit, ka kërkuar zgjidhjen e konfliktit të kompetencave mes tij dhe Kuvendit. Në vijim, shumica ka konsideruar si qëllim final për vënien në lëvizje të Gjykatës kontrollin e kushtetutshmërisë së veprimtarisë së Kuvendit dhe vetë anëtarëve të tij, duke arsyetuar se në kuptim të këtij qëllimi Gjykata ka njohur mbrojtjen kushtetuese të së drejtës së pakicës parlamentare, duke pranuar vënien e saj në lëvizje edhe me kërkesë të një të dhjetës së deputetëve për zgjidhjen e konfliktit të kompetencave me Kuvendin në rastet kur ky i fundit nuk ka pranuar mocionin e këtij subjekti për dërgimin në Gjykatë të çështjes së papajtueshmërisë së mandatit të deputetit (*shih paragrafët 20-21 të vendimit*).

5. Gjithashtu, shumica, duke vendosur theksin te ndryshimet ligjore në nenin 66 të ligjit nr. 8577/2000, si dhe duke pranuar detyrimin e Kuvendit për dërgimin në Gjykatë të çështjes së papajtueshmërisë së mandatit, shprehet se paraqitja e kërkesës po për papajtueshmërinë e mandatit të deputetit nga jo më pak se një e pesta e deputetëve përbën mjetin alternativ për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues, si dhe bën efektiv mekanizmin e kontrollit kushtetues për këtë çështje. Ajo pohon gjithsesi se jo më pak se një e pesta e deputetëve nuk zëvendëson Kuvendin në ushtrimin e kompetencës së tij sipas nenit 70, pika 4, të Kushtetutës, por e drejta e këtij subjekti aktivizohet në rastin e rrëzimit të mocionit të Kryetarit të Kuvendit ose të një të dhjetës së deputetëve. Në këtë kuptim, shumica ka deklaruar se po zhvillon qasjen e saj, duke arritur në përfundim se pavarësisht se në objektin e kërkesës një e dhjeta ka kërkuar zgjidhjen e një mosmarrëveshjeje kompetence, qëllimi i saj lidhet me zgjidhjen e çështjes së papajtueshmërisë së mandatit të deputetit, çka passjell mungesën e legjitimimit të kërkuesit, një e dhjeta e deputetëve të Kuvendit, për të vënë në lëvizje Gjykatën për këtë qëllim (*shih paragrafët 23-28 të vendimit*).

6. Ne, gjyqtaret në pakicë, nuk pajtohemi me këtë vlerësim të shumicës,

pasi gjykojmë, *së pari,* se analiza e vendimit dhe përfundimi i arritur nuk marrin në konsideratë jurisprudencën e Gjykatës për çështje të kësaj natyre. Për të mbështetur qëndrimin tonë po ndalemi te jurisprudenca kushtetuese në rastet e konfliktit të kompetencave të një të dhjetës së deputetëve me Kuvendin, e cila mendojmë se duhet të ishte analizuar nga shumica. Kështu, në rastin e deputetit I.B. një e dhjeta e deputetëve filloi procedurën për deklarimin e papajtueshmërisë së mandatit të këtij deputeti, mocion i cili u miratua nga Kuvendi. Ky i fundit, më pas, iu drejtua Gjykatës me kërkesë për konstatimin e papajtueshmërisë së mandatit të deputetit, e cila vendosi konstatimin e papajtueshmërisë (*shih vendimin nr. 44, datë 07.10.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

7. Ndërsa në rastin e deputetit K.K., një grup deputetësh paraqitën kërkesë në Kuvend për fillimin e procedurave parlamentare për konstatimin e pavlefshmërisë dhe mbarimin e mandatit të këtij deputeti. Kuvendi vendosi mosdërgimin e çështjes në Gjykatë. Jo më pak se një e pesta e deputetëve iu drejtua Gjykatës me kërkesë për papajtueshmërinë e mandatit të deputetit dhe interpretimin e nenit 70, pika 4, të Kushtetutës. Gjykata vlerësoi se jo më pak se një e pesta e deputetëve, si një nga subjektet e parashikuara në nenin 134 të Kushtetutës, nuk legjitimohej t`i drejtohej drejtpërdrejt Gjykatës për të kërkuar konstatimin e papajtueshmërisë të mandatit të deputetit. Ajo u shpreh se në rast se Kuvendi vihet në lëvizje me mocion të Kryetarit të Kuvendit ose një të dhjetës së anëtarëve të tij, në kuptim të paragrafit 3 të nenit 70 të Kushtetutës, ai duhet të vendosë dërgimin e çështjes në Gjykatë, që është organi i vetëm që ka kompetencën të shqyrtojë në themel çështjen dhe të vendosë për papajtueshmërinë e mandatit të deputetit. E drejta e një të dhjetës së deputetëve për të kërkuar vënien në lëvizje të Gjykatës është ngritur në nivel kushtetues, duke i dhënë mbrojtje kushtetuese, me qëllim evitimin e ndërhyrjes së shumicës në ushtrimin e kësaj të drejte dhe diskrecionin e shumicës në interpretimin dhe vlerësimin e saj rast pas rasti. Duke ritheksuar se Kuvendi është i detyruar ta dërgojë çështjen në Gjykatë, ajo vlerësoi se hapësira e vlerësimit të Kuvendit lidhet vetëm me verifikimin e kritereve juridiko-formale, duke respektuar procedurat parlamentare të parashikuara në Rregulloren e këtij organi (*shih vendimin nr. 7, datë 24.02.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

8. Në zbatim të vendimit të mësipërm të Gjykatës, Kuvendi, pasi ka marrë sërish në shqyrtim kërkesën e një grupi deputetësh, ka vendosur dërgimin e çështjes në Gjykatë, e cila pasi shqyrtoi çështjen në themel,

ka vendosur konstatimin e papajtueshmërisë së mandatit të deputetit (*shih vendimin nr. 32, datë 03.06.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

9. Në një rast të ngjashëm, një grup prej 20 deputetësh të Kuvendit ka paraqitur mocionin për konstatimin e papajtueshmërisë së mandatit të një deputeti (rasti R.S.). Kuvendi ka vendosur mosdërgimin në Gjykatë të kërkesës për konstatim. Në këto kushte, një e dhjeta e deputetëve i ka kërkuar Kuvendit dërgimin e çështjes në Gjykatë, i cili ka vendosur pranimin e kësaj kërkese. Gjykata, pasi evidentoi se konstatimi i papajtueshmërisë së mandatit i referohej paragrafit 2 të nenit 70 të Kushtetutës, vendosi rrëzimin e kërkesës me arsyetimin se konstatimi i papajtueshmërisë së mandatit të deputetit është në juridiksionin e Gjykatës vetëm në rastet e parashikuara nga neni 70, pika 3, të Kushtetutës, kurse për të gjitha rastet e tjera legjislatori ka parashikuar vetë Kuvendin si institucionin i cili vendos për heqjen ose jo të mandatit të deputetit (*shih vendimin nr. 72, datë 07.12.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

10. Pas ndryshimeve kushtetuese dhe ligjore me reformën e vitit 2016, Gjykata u vu në lëvizje nga një e dhjeta e deputetëve për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencës ndërmjet këtij subjekti dhe Kuvendit dhe shfuqizimin e vendimeve të tij për mosdërgimin e çështjes së papajtueshmërisë së mandatit të deputetes O.Xh. në Gjykatë. Kjo e fundit, bazuar në jurisprudencën e saj të mëparshme, vendosi pranimin e kërkesës me arsyetimin se Kuvendi duhet të kishte pranuar mocionin e kërkuesit dhe t'ia dërgonte asaj çështjen për shqyrtim, në mënyrë që aspektet e pretenduara si papajtueshmëri të mandatit të deputetes t'i nënshtroheshin vlerësimit kushtetues (*shih vendimin nr. 1, datë 23.01.2023 të Gjykatës Kushtetuese*). Ndërsa me vendimin nr. 2, datë 23.01.2023 Gjykata vendosi pushimin e gjykimit për kërkesën e jo më pak se një të pestës së deputetëve, të cilët i ishin drejtuar asaj me të njëjtin objekt, duke theksuar se juridiksioni i saj ende nuk ishte aktivizuar për sa kohë Kuvendi nuk ia kishte dërguar çështjen asaj.

11. Nisur nga fakti se këto dy vendime nuk u zbatuan nga Kuvendi, i cili vendosi përsëri mosdërgimin e mocionit në Gjykatë, kjo e fundit, e vënë në lëvizje nga një e dhjeta e deputetëve dhe një e pesta e deputetëve, me vendimin nr. 55, datë 10.07.2024 legjitimoi subjektin një e dhjeta e deputetëve për zgjidhjen e konfliktit të kompetencave ndërmjet tij dhe Kuvendit, duke theksuar se Kuvendi nuk ka respektuar vendimmarrjen kushtetuese, në kundërshtim me detyrimin kushtetues që buron nga neni 132 i Kushtetutës, duke shkaktuar një mosmarrëveshje të re kushtetuese,

pasi përmes vendimmarrjes së tij ka cenuar të drejtën kushtetuese të jo më pak se një të dhjetës së deputetëve për t'iu drejtuar Gjykatës për konstatimin e papajtueshmërisë së mandatit të deputetes.

12. Në analizë të sa më lart, konstatojmë se roli i veçantë kushtetues që një e dhjeta e deputetëve gëzon në procedurat parlamentare që lidhen me mocionet për papajtueshmërinë e mandatit të deputetëve është afirmuar nga jurisprudenca kushtetuese. Megjithëse fillimisht kjo pakicë parlamentare nuk i është drejtuar drejtpërdrejt Gjykatës, kërkesat e saj për çështje të kësaj natyre janë respektuar nga Kuvendi, i cili ka ndërmarrë veprimet e nevojshme për ta vënë në lëvizje Gjykatën. Më tej, rëndësia e rolit të një të dhjetës së deputetëve është konfirmuar edhe nga jurisprudenca më e fundit, ajo e viteve 2023-2024, ku Gjykata e ka njohur shprehimisht këtë grupim si subjekt legjitim kushtetues në një mosmarrëveshje kompetencash dhe ka urdhëruar Kuvendin të marrë në shqyrtim mocionin, duke e detyruar atë të dërgojë çështjen e papajtueshmërisë së mandatit të deputetit në Gjykatë.

13. Në këtë kuptim ne gjyqtaret në pakicë vlerësojmë se qëndrimi i shumicës që nuk ka legjitimuar një të dhjetën e deputetëve për paraqitjen e kërkesës për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencave, bie ndesh me jurisprudencën e lartpërmendur të Gjykatës. Duke vepruar në këtë mënyrë shumica, me një arsyetim të sforcuar, ka ndryshuar thelbin e objektit të kërkesës së paraqitur nga ky subjekt, duke prezumuar se në fakt qëllimi i tij ka qenë çështja e papajtueshmërisë së mandatit të deputetit.

14. *Së dyti*, duke arsyetuar në këtë mënyrë, shumica edhe pse deklaron se po zhvillon qasjen e Gjykatës për çështjet e papajtueshmërisë së mandatit, në fakt qartësisht ka bërë ndryshim të jurisprudencës kushtetuese, pa dhënë argumente për nevojën dhe domosdoshmërinë e këtij ndryshimi. Në këtë pikë sjellim në vëmendje rregullin e vazhdimësisë së jurisprudencës si element të parimit të shtetit të së drejtës, të sanksionuar në nenin 4 të Kushtetutës. Ky rregull është elaboruar nga Gjykata, e cila ka theksuar se në aspektin kushtetues, është e palejueshme që doktrina kushtetuese zyrtare të riinterpretohet në një mënyrë të tillë që ndryshon sistemin e vlerave të sanksionuara në Kushtetutë, që mohon pajtueshmërinë e vlerave me njëra-tjetrën, që redukton garancitë mbrojtëse të epërsisë së saj në sistemin juridik, që mohon konceptimin e Kushtetutës si një akt i vetëm dhe sistem harmonik, që redukton garancitë e të drejtave dhe lirive të sanksionuara dhe që ndryshon modelin e ndarjes së pushteteve, të rregulluara në Kushtetutë. Çdo ndryshim i precedentëve të Gjykatës ose korrigjim i doktrinës kushtetuese zyrtare nuk mund të bëhet mbi bazën e faktorëve të rastit,

siç mund të jetë edhe ndryshimi i përbërjes së saj. Ndonëse ka pranuar se jurisprudenca kushtuese mund të evoluojë, Gjykata ka pohuar se një ndryshim i praktikës mund të realizohet nëse ekzistojnë arsye të forta që do ta justifikojnë një ndërmarrje të tillë dhe vetëm në rastet kur kjo është e paevitueshme, objektivisht e domosdoshme, si dhe kushtetutshmërisht e bazuar dhe e arsyetuar (*shih vendimet nr. 30, datë 17.06.2010; nr. 21, datë 29.04.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Ndërkohë që, sikurse është shprehur edhe Gjykata, Kushtetuta në nenet 124, 132 dhe 145, pika 2, shprehet qartësisht në lidhje me forcën detyruese të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese për të gjitha organet kushtetuese, autoritetet publike dhe gjykatat. Nga standardi i detyrimit të zbatimit të vendimmarrjes kushtetuese nuk mund të bëjë përjashtim as vetë Gjykata (*shih vendimet nr. 55 datë 10.07.2024; nr. 11, datë 16.04.2018; nr. 78, datë 12.12.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Bazuar në këto standarde, Gjykata në jurisprudencën e saj ka pranuar ndryshimin e qasjes së saj në raste për të cilat kanë ekzistuar arsye të rëndësishme, sidomos për ta harmonizuar atë me praktikën e GJEDNJ-së, siç janë rastet e gjykimit penal në mungesë ose vendimet për caktimin e masës penale të sekuestrimit të pasurisë (*shih vendimet nr.30, datë 17.06.2010; nr. 18 datë 19.03.2024 të Gjykatës Kushtetuese*). Ndërkohë në rastin në shqyrtim, ndonëse shumica nuk ka paraqitur asnjë shkak për ndryshimin e jurisprudencës, mund të identifikohen në mënyrë të nënkuptuar se tre janë faktorët që kanë ndikuar në këtë drejtim: (i) ndryshimi i përbërjes në trupin gjykues të Gjykatës, (ii) moszbatimi i vendimeve të Gjykatës në lidhje me detyrimin e Kuvendit për t'i dërguar asaj çështjen për shqyrtimin në themel të papajtueshmërisë së mandatit të deputetit; (iii) ndryshimet në ligjin organik të Gjykatës.

17. Në vlerësimin tonë asnjë prej këtyre faktorëve nuk përbën argument të mjaftueshëm për ndryshimin e jurisprudencës. Në këtë kuptim, vetë rregulli i përtëritjes periodike të gjyqtarëve ka qëllim ruajtjen e vazhdimësisë së jurisprudencës kushtetuese (*shih vendimin nr. 24, datë 09.06.2011 të Gjykatës Kushtetuese*), ndaj, ashtu siç Gjykata e ka deklaruar në mënyrë të shprehur, nuk mund të përbëjë shkak për ndryshimin e jurisprudencës (*shih vendimet nr. 30, datë 17.06.2010; nr. 21, datë 29.04.2010 të Gjykatës Kushtetuese*). Ndërsa për sa i përket moszbatimit të vendimit të Gjykatës, jo vetëm ai përbën një rast të izoluar (*shih vendimin nr. 55, datë 10.07.2024 të Gjykatës Kushtetuese)*, por nuk mund të përbëjë shkak për ndryshimin e jurisprudencës, pasi bie ndesh me parimin e forcës detyruese të vendimeve

të saj të sanksionuar në nenin 132 të Kushtetutës dhe cenon drejtpërdrejt autoritetin e Gjykatës. Edhe ndryshimi në ligjin organik të Gjykatës, të cilin shumica e ka përdorur si argument për të deklaruar se tashmë një e pesta e deputetëve mund t'i drejtohet Gjykatës për konstatimin e papajtueshmërisë së mandatit të deputetit, nuk mund të evidentohet si shkak, për sa kohë ai ka qenë i njohur në vendimmarrjen e vitit 2023 për çështje të ngjashme dhe nuk përbën risi e cila do e detyronte Gjykatën t'ia përshtaste qëndrimin e saj këtij ndryshimi ligjor. Prandaj, në referim të standardeve kushtetuese të lartpërmendura, theksojmë se, në thelb, rrëzimi i kërkesës së një të dhjetës së deputetëve në rastin konkret përbën ndryshim të jurisprudencës, i cili është i pajustifikuar dhe i pandikuar nga asnjë prej faktorëve për të cilët mund të bëhet ky ndryshim.

18. *Së treti*, në ndryshim nga shumica, jemi të mendimit se subjekti një e dhjeta e deputetëve është një subjekt kushtetues të cilit kompetenca i është njohur nga Kushtetuta. Shumica, edhe pse arsyeton se një e dhjeta e deputetëve ka të drejtë të paraqesë në Kuvend mocion për konstatimin e papajtueshmërisë së mandatit të një deputeti, nuk e konsideron këtë kompetencë në përputhje me jurisprudencën e Gjykatës, sipas së cilës mocioni përbën një instrument parlamentar që ka për qëllim të nxisë një diskutim në Kuvend për një çështje të caktuar dhe për të cilën duhet të ketë një vendimmarrje nga ky i fundit (*shih vendimin nr. 1, datë 23.01.2023 të Gjykatës Kushtetuese*). Kjo do të thotë se mocioni përbën në vetvete një kompetencë kushtetuese, që në rast të rrëzimit të tij nga Kuvendi passjell një konflikt kompetencash midis një të dhjetës së deputetëve, nga njëra anë, dhe Kuvendit, nga ana tjetër. Me fjalë të tjera, kompetenca e parashikuar në nenin 70, pika 4, të Kushtetutës për paraqitjen e mocionit nga ana e një të dhjetës së deputetëve, legjitimimon këtë subjekt që në rast të rrëzimit të kërkesës të tij nga Kuvendi t'i drejtohet Gjykatës për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencave.

19. *Së katërti*, jemi të mendimit se shumica duke mos legjitimuar një të dhjetën e deputetëve për t'iu drejtuar asaj me kërkesë për zgjidhjen e konfliktit të kompetencave me Kuvendin, në rastin kur ky i fundit vendos të mos dërgojë çështjen e papajtueshmërisë së mandatit të deputetit në Gjykatë, në thelb i ka kufizuar Kuvendit kompetencën për t'u shprehur në lidhje me mocionin për konstatimin e papajtueshmërisë së deputetëve, duke zvogëluar në këtë mënyrë sferën e autonomisë parlamentare.

20. Fillimisht, sjellim në vëmendje se Gjykata ka theksuar se domosdoshmëria e vendimmarrjes paraprake nga Kuvendi për mocionin

e papajtueshmërisë së një deputeti në kuptim të nenit 70, pika 4, të Kushtetutës, duhet kuptuar edhe si një shfaqje e parimit të gjithëpranuar të autonomisë parlamentare, i cili nënkupton se Kuvendi ka autoritet fillestar për të shqyrtuar dhe gjykuar kërkesat për shkelje të nenit 70, pika 3, të Kushtetutës. Megjithatë, Kuvendi në këto raste nuk mund t'i hyjë themelit të çështjes, pra vlerësimit nëse veprimet konkrete të pretenduara të kryera nga deputeti janë të papajtueshme me mandatin e tij, sepse, në të kundërt, do të ndërhynte në kompetencat që kushtetutëbërësi ia ka njohur vetëm Gjykatës (*shih vendimet nr. 55, datë 10.07.2024; nr. 1, datë 23.01.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Sipas mendimit tonë, zgjidhja e shumicës që e lidh të drejtën për të vënë në lëvizje Gjykatën vetëm me kërkesën e jo më pak se një të pestës së deputetëve përbën ndërhyrje në autonominë funksionale të Kuvendit, duke i mohuar këtij të fundit kompetencën për t'u shprehur për mocionin e paraqitur nga një e dhjeta e deputetëve. Me fjalë të tjera, edhe në rastet kur Kuvendi do të refuzojë mocionin për një arsye procedurale (të tillë si mosplotësimi i numrit të deputetëve që kanë nënshkruar mocionin) dhe pa shqyrtuar *de plano* shkaqet e mocionit, subjekti jo më pak se një e pesta e deputetëve përsëri do të mund të vërë në lëvizje Gjykatën për çështjen e papajtueshmërisë së mandatit të deputetit. Në këtë mënyrë, pa shqyrtim të mocionit nga Kuvendi, Gjykata do të shqyrtonte çështjen në të gjitha aspektet e saj sipas nenit 70, pika 3, të Kushtetutës.

22. Kjo zgjidhje e dhënë nga shumica jo vetëm që në dukje kufizon qartësisht autonominë parlamentare, por në thelb e shndërron në instrument pa vlerë rolin kushtetues të pakicës parlamentare (një të dhjetës të deputetëve) në inicimin e shqyrtimit të papajtueshmërisë së mandatit të një deputeti, sepse e lë në vullnetin e një subjekti tjetër (jo më pak se një të pestës së deputetëve) vlerësimin për adresimin e çështjes në Gjykatë në rast të mosveprimit ose rrëzimit të kërkesës nga Kuvendi. Në këtë mënyrë, shumica është larguar nga qëllimi i kushtetutëbërësit, i cili, referuar Debatit Kushtetues, ka përcaktuar dy organe për procedurën e heqjes së mandatit të deputetit për shkak të konstatimit të papajtueshmërisë me detyrën – Kuvendin që merr vendim për dërgimin në Gjykatë të çështjes dhe Gjykatën. Megjithatë, pyetjes së ngritur në diskutim se kush vendos përfundimisht për mandatin e deputetit, përgjigja ka qenë "Parlamenti" (*shih Debati Kushtetues, volumi I, faqe 262*), çka thekson rëndësinë e parimit të autonomisë së Kuvendit në këtë procedurë. Nuk është e rastit që Kushtetuta këtë procedurë ia ka besuar Kuvendit, sepse ai është organ

politik që fiton legjitimitetin demokratik drejtpërdrejt nga populli nëpërmjet zgjedhjeve të përgjithshme, ndaj për shkak të legjitimitetit demokratik, verifikimi i mandatit nuk mund të shndërrohet në një çështje të thjeshtë gjyqësore.

23. *Së pesti*, legjitimimin e subjektit jo më pak se një e pesta e deputetëve shumica e ka bazuar në ndryshimet e ligjit organik të Gjykatës. Pavarësisht se ky subjekt është i parashikuar edhe në nenin 134, pika 1, shkronja "c", të Kushtetutës, si një ndër subjektet që kanë të drejtë të vënë në lëvizje gjykimin kushtetues në mënyrë të pakushtëzuar, Kushtetuta në normat që lidhen drejtpërdrejt me çështjet për konstatimin e papajtueshmërisë së mandatit të deputetit, nuk e përcakton si subjekt me ndonjë kompetencë në këtë procedurë. Në lidhje me raportin ndërmjet normave të ndryshme kushtetuese në shqyrtim, gjatë interpretimit të nenit 70, pika 4, të Kushtetutës, Gjykata ka pohuar parimin se norma e posaçme ka përparësi mbi normën e përgjithshme. Sipas saj, në rastet e procedurave për inicimin e kontrollit kushtetues të papajtueshmërisë me detyrën dhe vlerësimit të mandatit të deputetit, dispozita e pikës 4 të nenit 70 të Kushtetutës përbën normën e posaçme, për rrjedhojë ajo prevalon mbi parashikimin e përgjithshëm të neneve 131 dhe 134 të Kushtetutës *(shih vendimet nr. 1, datë 23.02.2023; nr. 72, datë 07.12.2016; nr. 7, datë 24.02.2016 të Gjykatës Kushtetuese)*. Në të njëjtën mënyrë, bazuar edhe në parimin e hierarkisë së akteve normative (neni 116 i Kushtetutës), ajo prevalon edhe mbi parashikimet e ligjit nr. 8577/2000. Për më tepër, ky argument i shumicës ka edhe kontradiktë logjike, sepse në thelb pranon që teksti kushtetues mund të interpretohet ose ndryshohet nga Kuvendi me anë të ligjeve, duke anashkaluar në këtë mënyrë jurisprudencën kushtetuese dhe rolin e Gjykatës për interpretimin përfundimtar të Kushtetutës.

24. Në këtë kuptim jemi të mendimit se nëse qëllimi i kushtetutëbërësit do të ishte legjitimimi i jo më pak se një të pestës së deputetëve për konstatimin e papajtueshmërisë së mandatit të deputetit, ai do të ishte shprehur përmes ndryshimeve kushtetuese të vitit 2016, duke e njohur shprehimisht si subjekt kushtetues për inicimin e çështjes së papajtueshmërisë së mandatit të deputetit, situatë e cila nuk ka ndodhur. Prandaj vlerësojmë se nëpërmjet legjitimimit të subjektit jo më pak se një e pesta e deputetëve, shumica ka tejkaluar Kushtetutën, duke krijuar normë të re kushtetuese. Kjo bie ndesh me jurisprudencën e Gjykatës edhe nën një aspekt tjetër, pasi, sikurse Gjykata ka theksuar, interpretimi përfundimtar që bën Gjykata nuk ka si qëllim shtimin e normave të reja, por deklarimin ose pohimin e përmbajtjes

së këtyre normave. Ajo (Gjykata) u jep jetë normave kushtetuese përmes kuptimit të drejtë të përmbajtjes dhe qëllimit të tyre *(shih vendimin nr.29, datë 30.06.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

25. Nisur nga sa më lart, vlerësojmë se kërkesa e një të dhjetës së deputetëve përbënte një premisë për zhvillimin e jurisprudencës në rastin kur Kuvendi, në kundërshtim me detyrimin që rrjedh nga një vendim i Gjykatës, refuzon përsëri ta sjellë çështjen për shqyrtim, pas të cilit mund të aktivizohet e drejta e jo më pak se një të pestës së deputetëve për t'iu drejtuar Gjykatës jo më për një konflikt kompetencash, por për shqyrtimin e papajtueshmërisë së mandatit të deputetit, por kurrsesi nuk mund të përbënte shkak për moslegjitimimin e një të dhjetës për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencës.

26. Për të gjitha argumentet e mësipërme, ne, gjyqtaret në pakicë, vlerësojmë se Gjykata, bazuar në jurisprudencën e saj të mëparshme dhe parashikimet e nenit 70, pika 4 të Kushtetutës, duhej të vendoste pranimin e kërkesës, zgjidhjen e konfliktit të kompetencës ndërmjet Kuvendit dhe kërkuesit një e dhjeta e deputetëve, shfuqizimin e vendimit të Kuvendit dhe detyrimin e tij për dërgimin në Gjykatë të mocionit për papajtueshmërinë e mandatit të deputetit Vullnet Sinaj.

Anëtare: Marsida Xhaferllari, Fiona Papajorgji, Marjana Semini

Vendim nr. 36, datë 04.06.2025
(V-36/25)

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Holta Zaçaj, Kryetare, Marsida Xhaferllari, Fiona Papajorgji, Sonila Bejtja, Ilir Toska, Genti Ibrahimi, Marjana Semini, Sandër Beci, anëtarë, me sekretare Belma Lleshi, në datën 21.05.2025 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 32 (Sh) 2024, që u përket:

KËRKUESE: **SHOQËRIA "MARLEN" SH.P.K.,** e përfaqësuar nga administratori Muharrem Shutina.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:
BASHKIA TIRANË, e përfaqësuar nga sekretari i përgjithshëm Alban Dokushi.
AVOKATURA E SHTETIT, në mungesë.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2024-1166 (117), datë 25.03.2024 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**
Dërgimi i çështjes për rigjykim në Gjykatën e Lartë.

BAZA LIGJORE: **Nenet 42, 43, 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë *(Kushtetuta)*; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut *(KEDNJ)*; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar *(ligji nr. 8577/2000).***

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sandër Beci, mori në shqyrtim pretendimet e kërkueses, shoqërisë "Marlen" sh.p.k. *(kërkuesja)*, e cila ka kërkuar

pranimin e kërkesës, prapësimet e subjektit të interesuar, Bashkisë Tiranë që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, konstatoi mungesën e parashtrimeve të subjektit të interesuar, Avokaturës së Shtetit, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I
Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesja është person juridik, me objekt veprimtarie importin, eksportin e të gjitha mallrave dhe ndërtimin në të gjitha fushat.

2. Këshilli i Rregullimit të Territorit të Bashkisë Tiranë *(KRRT-ja),* me vendimin nr. 235, datë 28.05.2004, ka miratuar kërkesën për shesh ndërtimi për subjektin ndërtues, shoqërinë "Iliada" sh.p.k., në pronën e familjes Kika në qytetin e Tiranës. Me vendimin nr. 297, datë 05.07.2004, KRRT-ja ka miratuar lejen e ndërtimit po për këtë subjekt ndërtues për një godinë banimi 2, 6 dhe 8 kate në rrugën "Muhamet Gjollesha", Tiranë.

3. Midis kërkueses, në cilësinë e investitorit, dhe shoqërisë "Iliada" sh.p.k., në cilësinë e sipërmarrëses, është lidhur kontrata e sipërmarrjes nr.15621 rep., nr.3270 kol., datë 11.12.2004, për kalimin e investimit, si dhe kontrata nr.7289 rep., nr.1807 kol., datë 10.06.2006, për kalimin e sipërmarrjes në favor të kërkueses. Sipas kontratës së fundit, kërkuesja ka marrë përsipër të gjitha detyrimet financiare ndaj shtetit, individëve dhe pronarëve të truallit ku do të kryhej ndërtimi.

4. Në zbatim të lejes së ndërtimit është nxjerrë autorizimi nr. 5161 prot., datë 10.06.2005 nga drejtoria e përgjithshme e urbanistikës në Bashkinë Tiranë, për pagesën e taksës 5% të ndikimit në infrastrukturë, e cila është paguar me mandat bankar nr. 000TRFRO51640010, datë 13.06.2005, në shumën 7.200.000 lekë. Pas pagesës së taksës prej 5% është miratuar leja për prishje ndërtimi nr. 4236 prot., datë 17.05.2005 dhe është zbardhur formulari nr. 4 për lejen e ndërtimit nr. 4236/ 1 prot., datë 17.05.2005.

5. Pas kërkesës së shoqërisë "Marlen" sh.p.k., KRRT-ja, me vendimin nr. 229, datë 12.10.2008, ka miratuar shtyrjen e afatit të lejes së ndërtimit edhe për 36 muaj, deri në datën 12.10.2011.

6. Disa prej pronarëve të truallit, ku do të realizohej ndërtimi, kanë paraqitur padi për pavlefshmërinë absolute të vendimit nr. 297, datë 05.07.2004 të KRRT-së "Për lejen e ndërtimit", si dhe të vendimit nr. 229,

datë 12.10.2008 të KRRT-së "Për zgjatjen e afatit të lejes së ndërtimit", me pretendimin se leja e ndërtimit ishte marrë në kundërshtim me ligjin. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 9731, datë 01.12.2011, ka vendosur pranimin e padisë. Vendimi i gjykatës së shkallës së parë është lënë në fuqi me vendimin nr. 722, datë 26.03.2013 të Gjykatës së Apelit Tiranë. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, pasi ka shqyrtuar rekursin e ushtruar nga kërkuesja dhe kundërrekursin e paditësve/pronarëve të truallit, me vendimin nr. 00-2017-389 (203), datë 04.04.2017, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë.

7. Në rrethanat kur së bashku me dokumentacionin e nevojshëm për shtyrjen e afatit të lejes së ndërtimi nuk ishte depozituar kopja e formularit nr. 4 të lejes së ndërtimit, KRRT-ja ka marrë vendimin nr. 4236 prot., datë 17.05.2005 "Për prishjen e ndërtimit". Në vijim, kërkuesja i është drejtuar Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik Vendor *(INUV)* në Bashkinë Tiranë për të ndërhyrë për lirimin e sheshit të ndërtimit. INUV-i, me shkresat nr. 2001 prot., datë 27.02.2009 dhe nr. 5231 prot., datë 05.06.2009, ka lajmëruar për prishjen e objektit. Në datën 15.06.2009 është kryer prishja e banesave vetëm të personave që kishin nënshkruar kontratën e sipërmarrjes përfundimtare, të cilët kishin rënë dakord për prishjen e banesave të tyre, duke lënë pa prishur banesat e tjera, pronarët e të cilave nuk kishin nënshkruar ende kontratat përfundimtare të sipërmarrjes.

8. Kërkuesja ka pretenduar se drejtoria e urbanistikës në Bashkinë Tiranë nuk i ka vendosur në dispozicion formularin nr. 4 të lejes së ndërtimit në mënyrë që të fillonte punimet. Për këtë arsye, kërkuesja/paditëse i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për të detyruar Bashkinë Tiranë për ta pajisur me formularin nr. 4 për zbardhjen e lejes së ndërtimit, nr. 4236/1 prot., datë 17.05.2005, për të filluar punimet. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 3642, datë 16.04.2012, ka vendosur pranimin e pjesshëm të padisë dhe detyrimin e Bashkisë Tiranë për të pajisur kërkuesen me formularin nr. 4 për zbardhjen e lejes së ndërtimit nr. 4236/1 prot., datë 17.05.2005. Gjykata e shkallës së parë e ka rrëzuar kërkimin për rivendosjen në afat të lejes së ndërtimit. Vendimi ka marrë formë të prerë në datën 30.05.2012, por Bashkia Tiranë nuk e ka ekzekutuar edhe pas realizimit të procedurave të ekzekutimit nga një shoqëri përmbarimore private.

9. Kërkuesja i është drejtuar disa herë drejtorisë së urbanistikës në Bashkinë Tiranë për t'u pajisur me formularin nr. 4 të zbardhjes së lejes së ndërtimit, por nuk ka marrë përgjigje. Formulari nr. 4 duhej të ishte pjesë

e kontratave përfundimtare të sipërmarrjes, me anë të të cilave pronarët e truallit do të firmosnin për pjesën takuese në ndërtimin e ri.

10. Në datën 17.09.2020 kërkuesja i është drejtuar drejtorisë së përgjithshme të taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Tiranë, duke kërkuar kthimin e shumës 7.200.000 lekë, që përfaqësonte taksën e ndikimit në infrastrukturë për lejen e ndërtimit nr. 297, datë 05.07.2004 të KRRT-së. Drejtoria e përgjithshme e taksave dhe tarifave vendore, me shkresën nr.7271/1 prot., datë 06.10.2020 të sektorit të kontabilitetit *(shkresa nr. 7271/1 prot., datë 06.10.2020 e Bashkisë Tiranë),* e cila i është njoftuar kërkueses në datën 10.10.2020, i ka kthyer përgjigje se referuar shkresës nr. 35625/1, datë 07.11.2019 të drejtorisë së ankimeve pranë drejtorisë së përgjithshme juridike të aseteve dhe licencimit të Bashkisë Tiranë është refuzuar kërkesa për kthimin e shumës së paguar për nxjerrjen e lejes së ndërtimit për arsye se me vendimin nr. 9731, datë 01.12.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është konstatuar pavlefshmëria absolute e lejes së ndërtimit dhe gjykata nuk është shprehur për rregullimin e pasojave *(shih paragrafin 6 të këtij vendimi).*

11. Kërkuesja ka pretenduar se duke mos iu kthyer shuma e paguar për taksën e ndikimin në infrastrukturë i është shkaktuar dëm efektiv. Në datën 17.11.2020 kërkuesja i është drejtuar gjykatës së shkallës së parë me padi për detyrimin e Bashkisë Tiranë/palë e paditur për kthimin e shumës së paguar për taksën 5% të ndikimit në infrastrukturë të paguar për lejen e ndërtimit nr. 297, datë 05.07.2004, për godinën e banimit me 2, 6 dhe 8 kate në rrugën "Muhamet Gjollesha", Tiranë dhe shpërblimin e dëmit efektiv të shkaktuar për të gjitha shpenzimet e kryera në respektim të lejes së ndërtimit dhe të kontratave të sipërmarrjes dhe të porosive me pronarët e truallit, në shumën totale 50.427.766 lekë. Detyrimin e Bashkisë Tiranë që t'i paguajë kërkueses kamatëvonesat ligjore për dëmin efektiv në shumën totale 17.945.553 lekë dhe pagesat mujore të qirave në shumat 50.000 lekë në muaj, si dhe 1.200 USD në muaj nga data 17.06.2021 deri në ekzekutimin e vendimit gjyqësor.

12. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 3207 (80-2021-3261), datë 16.11.2021, ka vendosur pranimin e pjesshëm të padisë dhe detyrimin Bashkisë Tiranë që të dëmshpërblejë kërkuesen/palë paditëse në vlerën e dëmit pasuror, si dhe fitimin e munguar për të gjitha shpenzimet e kryera në respektim të lejes së ndërtimit nr. 297, datë 05.07.2004 dhe kontratave të sipërmarrjes dhe porosive me pronarët e truallit në vlerën totale të dëmit 68.373.319 (gjashtëdhjetë e tetë milionë e

treqind e shtatëdhjetë e tre mijë e treqind e nëntëmbëdhjetë) lekë. Rrëzimin e padisë për sa i përket pjesës tjetër të kërkimit, si të pabazuar në ligj dhe në prova. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka arsyetuar se e drejta e padisë në rastin konkret ka lindur në zbatim të nenit 18/1 të ligjit nr. 49, datë 03.05.2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", të ndryshuar *(ligji nr. 49/2012),* pra brenda 45 ditëve nga dita kur ka marrë përgjigjen përfundimtare nga Bashkia Tiranë për moskthimin e shumës së taksës së paguar me shkresën e njoftuar në datën 10.10.2020, për rrjedhojë padia e datës 17.11.2020 është depozituar brenda afatit ligjor 45-ditor në gjykatë. Gjykata e shkallës së parë ka vendosur rrëzimin e kërkimit për kamatëvonesat që buronin nga dëmi i shkaktuar.

13. Pas ankimit të subjektit të interesuar, Bashkisë Tiranë, Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 435 (86-2023-626), datë 30.05.2023, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë. Gjykata e apelit ka arsyetuar se padia në këtë rast nuk parashkruhet, pasi është aksesore me padinë për pavlefshmërinë absolute të lejes së ndërtimit, të zgjidhur me vendim gjyqësor që e ka pranuar atë padi. Gjykata Administrative e Apelit ka arsyetuar se, në rastin konkret, pala e paditur detyrohet të kthejë shumën e përfituar prej saj dhe të paguar nga pala paditëse/kërkuesja për dhënien e lejes së ndërtimit bazuar në parimin e rivendosjes së palëve në gjendjen e mëparshme. Sipas gjykatës së apelit, pala paditëse/kërkuesja ka humbur të drejtën për ndërtim, prandaj duhet t'i kthehen shumat që ka paguar, si dhe kamatëvonesat përkatëse*(shih faqen 12 të vendimit të gjykatës së apelit).*

14. Ndaj vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit ka ushtruar rekurs Avokatura e Shtetit bazuar në nenin 5, pika 1/1, të ligjit nr. 10018, datë 13.11.2008 "Për Avokaturën e Shtetit". Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-1166 (117), datë 25.03.2024, ka ndryshuar vendimin nr. 435 (86-2023-626), datë 30.05.2023 të Gjykatës Administrative të Apelit dhe vendimin nr. 3207 (80-2021-3261), datë 16.11.2021 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, duke vendosur rrëzimin e padisë. Gjykata e Lartë ka arsyetuar se nga data 12.10.2011, kohë kur ka përfunduar afati për shtyrjen e lejes së ndërtimit, pala paditëse/kërkuesja nuk mund të vazhdonte me ndërtimin dhe e ka pasur të mundur identifikimin dhe dokumentimin e dëmit të shkaktuar nga pamundësia e realizimit të ndërtimit dhe të organit përgjegjës që ka shkaktuar dëmin e pretenduar, që lidhet me mosdorëzimin e formularit nr.

4, për të cilin pretendon se ishte në pritje. Nga momenti që Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 722, datë 26.03.2013, ka konstatuar pavlefshmërinë absolute të lejes, pala paditëse nuk ka pasur më dyshime për pamundësinë e vazhdimit të këtij ndërtimi. Në këtë kuptim, pala paditëse ka qenë në dijeni të dëmit të shkaktuar dhe se cili ishte organi publik që duhet të vepronte, por që nuk ka vepruar, sipas pretendimit të saj, në mënyrë të paligjshme dhe, për pasojë pala paditëse nuk ka paraqitur padinë brenda afatit ligjor 3-vjeçar të parashikuar nga Kodi Civil *(KC)* dhe ligji nr. 49/2012.

15. Në datën 31.10.2024 kërkuesja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese *(Gjykata)* me ankim kushtetues individual, i cili është plotësuar në datën 04.11.2024. Në datën 15.01.2025 Kolegji i Gjykatës ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve, e cila, me vendimin e datës 29.01.2025, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II
Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

16. ***Kërkuesja*****,** në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar:

16.1. *E drejta e aksesit,* pasi Gjykata e Lartë, duke vendosur rrëzimin e padisë, ka mohuar të drejtën për të marrë përgjigje për pretendimet e parashtruara. Kërkimi i Bashkisë Tiranë se padia është parashkruar, është ngritur vetëm në konkluzionet përfundimtare gjatë gjykimit në shkallë të parë, duke argumentuar se padia është depozituar jashtë afatit ligjor 45-ditor të parashikuar në ligjin nr. 49/2012 dhe nuk është i referuar në asnjë moment afatit ligjor 3-vjeçar të parashikuar nga ligji nr. 8510, datë 15.07.1999 "Për përgjegjësinë jashtëkontraktore të organeve të administratës shtetërore" *(ligji nr. 8510/1999).* Referuar nenit 158, pika 7, të Kodit të Procedurës Civile *(KPC),* Gjykata e Lartë e ka anashkaluar dhe nuk është shprehur për këtë dispozitë, pasi, në rastin konkret, prapësimet dhe provat nuk janë paraqitur së bashku me deklaratën e mbrojtjes, për rrjedhojë nuk duhet të ishin pranuar nga gjykata në pretendimet përfundimtare. Mosshqyrtimi i nenit 158 të KPC-së nga gjykatat më të ulëta duhej të konsiderohej nga Gjykata e Lartë si shkelje procedurale, për rrjedhojë rekursi nuk duhej të pranohej. Gjykata e Lartë për parashkrimin i është

referuar vendimit nr. 722, datë 26.03.2013 të Gjykatës së Apelit Tiranë, i cili është i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm, por nga ana tjetër ndaj këtij vendimi është ushtruar rekurs, për të cilin Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 00-2017-389 (203), datë 04.04.2017, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së apelit (vendimi i Gjykatës së Lartë është bërë i aksesueshëm në datën 04.12.2017). Nëse Gjykata e Lartë do t'i referohej këtij vendimi, kërkuesja përsëri do të ishte brenda afatit ligjor 3-vjeçar për paraqitjen e padisë. Komunikimi i shkresës nr. 7271/1 prot., datë 06.10.2020 të Bashkisë Tiranë pas më shumë se 1 viti nuk i ka hequr kërkueses të drejtën për të ngritur padi dhe kërkimi është bërë brenda afatit ligjor 3-vjeçar. Kërkuesja nuk mund të kërkonte gjyqësisht kthimin e shumës, pa marrë më parë përgjigje përfundimtare nga Bashkia Tiranë. Gjithashtu, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 3642, datë 16.04.2012, ka vendosur detyrimin e Bashkisë Tiranë për të pajisur kërkuesen me formularin nr. 4 për zbardhjen e lejes së ndërtimit, vendim që kjo bashki pa asnjë shkak nuk e ka ekzekutuar. Pavarësisht të gjitha vendimeve, ka qenë vendimi nr. 200, datë 15.06.2020 i gjykatës së apelit (që ka vendosur pranimin e padisë të disa prej pronarëve të truallit për kundërshtimin e procedurave të ekzekutimit në zbatim të vendimit gjyqësor që i detyronte ata për të paguar detyrimet sipas kontratave të sipërmarrjes), që i ka shuar kërkueses shpresat për të zhvilluar lejen e ndërtimit dhe për këtë arsye Gjykata e Lartë duhet të kishte marrë në konsideratë edhe këtë datë për llogaritjen e afatit ligjor 3-vjeçar, sipas ligjit nr. 8510/1999, për padinë e datës 17.11.2020.

16.2. *E drejta për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj*, *e drejta e pronës, siguria juridike dhe pritshmëritë e ligjshme,* pasi është cenuar e drejta e pronës e garantuar në nenin 41 të Kushtetutës dhe nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së. Gjykata e Lartë, duke vepruar tej kompetencave të saj, ka cenuar të drejtën e pronës, pra vlerën monetare që kërkuesja priste të kompensohej (dëmshpërblehej), duke humbur mjetet monetare dhe të ardhurat nga leja e ndërtimit.

17. ***Subjekti i interesuar, Bashkia Tiranë, ka prapësuar, si vijon:***

17.1. *Pretendimet e kërkueses janë të pabazuara*, pasi nga data 12.10.2011, kohë kur ka përfunduar afati i shtyrë i lejes së

ndërtimit, kërkuesja nuk mund të vazhdonte me ndërtimin. Ajo ka pasur të mundur identifikimin dhe dokumentimin e dëmit të shkaktuar nga pamundësia e realizimit të ndërtimit dhe të organit përgjegjës që ka shkaktuar dëmin e pretenduar, që lidhet me mosdorëzimin e formularit nr.4. Nga momenti që Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 722, datë 26.03.2013, ka konstatuar pavlefshmërinë absolute të lejes së ndërtimit, kërkuesja ka qenë në pamundësi për vazhdimin e ndërtimit. Shkresa nr. 7271/1 prot., datë 06.10.2020 e Bashkisë Tiranë, me anë të së cilës kërkueses i është komunikuar shkresa e drejtorisë së përgjithshme juridike e aseteve dhe licencimit se është refuzuar kërkesa për kthimin e shumës, nuk e pezullon dhe as nuk e ndërpret afatin e parashkrimit. Shkresa nr. 7271/1 prot., datë 06.10.2020 e Bashkisë Tiranë nuk është akt administrativ që mund të kundërshtohet në gjykatë brenda afatit ligjor 45-ditor. Marrëdhënia juridike mes palëve për shpërblimin e dëmit ka lindur nga momenti që pala e paditur/ Bashkia Tiranë ka kryer veprime ose mosveprime të paligjshme në vitin 2011. Nisur nga ky vit, kur ka mbaruar afati i lejes së ndërtimit, por edhe nga viti 2013, kur gjykata e ka konstatuar të pavlefshme lejen e ndërtimit deri në datën 17.11.2020, kur është paraqitur padia, kanë kaluar më shumë se 3 vjet, pra dukshëm më shumë se afati ligjor për paraqitjen e padisë.

18. ***Subjekti i interesuar, Avokatura e Shtetit,*** nuk ka paraqitur parashtrime me shkrim, megjithëse është njoftuar rregullisht.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkueses

19. Çështja e legjitimimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me

shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

20. Në këtë këndvështrim, Gjykata vlerëson se kërkuesja legjitimohet *ratione personae* në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, sepse është palë në çështjen objekt të ankimit kushtetues individual, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të këtij gjykimi.

21. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës, kërkuesja i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual pas përfundimit të procesit gjyqësor në të tria shkallët e gjyqësorit të zakonshëm, duke kundërshtuar vendimin e Gjykatës së Lartë që ka disponuar për vendimmarrjet e gjykatave më të ulëta që kanë pranuar padinë e kërkueses, duke vendosur ndryshimin e këtyre vendimeve dhe rrëzimin e padisë, ndaj Gjykata çmon se kërkuesja i ka shteruar mjetet juridike efektive dhe se nuk ka mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese përveç paraqitjes së ankimit kushtetues individual.

22. Në lidhje me legjitimimin *ratione temporis*, bazuar në nenin 71/a, pika 1, shkronja "b", të ligjit nr. 8577/2000, afati për paraqitjen e ankimit kushtetues individual është 4 muaj nga konstatimi i cenimit të së drejtës. Në çështjen në shqyrtim, Gjykata konstaton se vendimi i Gjykatës së Lartë, objekt kundërshtimi, mban datën 25.03.2024, ndërsa kërkesa është paraqitur në këtë Gjykatë në datën 31.10.2024. Nga informacioni i dërguar nga Gjykata e Lartë rezulton se vendimi është publikuar në faqen zyrtare të saj në datën 02.07.2024, për rrjedhojë Gjykata vlerëson se ankimi kushtetues individual është paraqitur brenda afatit ligjor 4-mujor.

23. Në drejtim të legjitimimit *ratione materiae,* Gjykata vëren se kërkuesja ka parashtruar pretendime për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor, të garantuar në nenin 42 të Kushtetutës, në drejtim të së drejtës së aksesit, gjykatës së caktuar me ligj, sigurisë juridike e pritshmërive të ligjshme, si dhe të së drejtës së pronësisë, të parashikuar nga neni 41 i Kushtetutës dhe neni 1 i Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së. Kërkuesja, në mënyrë të përmbledhur, ka parashtruar se Gjykata e Lartë ka mohuar të drejtën për të marrë përgjigje për kërkimin për kthimin e shumës së paguar për taksën e ndikimit në infrastrukturë dhe se interpretimi i ligjit nga Gjykata e Lartë për afatet e parashkrimit të padisë ka qenë i gabuar, duke cenuar të drejtën e kthimit të taksës dhe të shpërblimit të dëmit të pësuar.

24. Për sa më lart, Gjykata vlerëson ta analizojë çështjen e paraqitur në këndvështrim të nenit 42 të Kushtetutës, sipas të cilit prona nuk mund të cenohet pa një proces të rregullt ligjor dhe se kushdo, për mbrojtjen e së drejtës kushtetuese të pronës, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë. Në vlerësimin e së drejtës së pronës së kërkueses, Gjykata evidenton se taksa është pjesë e konceptit kushtetues të pronës, pasi pagesa e një sasie të caktuar të hollash, e barasvlershme me masën e detyrimit, është një shumë e cila merret nga pasuria e individit tatimpagues, që vetë atij i buron nga ligji për të paguar detyrimet financiare *(shih vendimin nr.16, datë 25.07.2008 të Gjykatës Kushtetuese).*

25. Për sa më lart, për të përcaktuar nëse kërkueses i është cenuar e drejta e pronës, është e rëndësishme të analizohet në themel nëse procesi gjyqësor i zhvilluar nga Gjykata e Lartë, që ka dhënë vendimin e kundërshtuar, ka përmbushur standardet e procesit të rregullt ligjor në këndvështrim të së drejtës së aksesit substancial të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e së drejtës së aksesit substancial të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor

26. Kërkuesja ka pretenduar se nga Bashkia Tiranë, si palë e paditur në gjykim, nuk është parashtruar kërkimi për paraqitjen e padisë tej afatit ligjor 3-vjeçar të parashikuar nga ligji nr. 8510/1999. Për më tepër, paraqitja e këtij kërkimi tej parashtrimeve të deklaratës së mbrojtjes është në kundërshtim me nenin 158 të KPC-së dhe nga Gjykata e Lartë duhej të konsiderohej si shkelje e rëndë procedurale. Gjykata e Lartë nuk u ka dhënë përgjigje pretendimeve të parashtruara nga kërkuesja dhe komunikimi i shkresës nr. 7271/1 prot., datë 06.10.2020 të Bashkisë Tiranë, pas më shumë se 1 viti, nuk i ka hequr të drejtën për të ngritur padi brenda afatit ligjor 3-vjeçar. Në drejtim të plotësimit të afatit ligjor, Gjykata e Lartë duhej të merrte parasysh edhe vendimin nr. 200, datë 15.06.2020 të Gjykatës së Apelit Tiranë.

27. Subjekti i interesuar, Bashkia Tiranë, ka prapësuar se nga data 12.10.2011, kohë kur ka përfunduar afati i shtyrjes së lejes së ndërtimit, kërkuesja nuk mund të vazhdonte më ndërtimin. Ajo e ka pasur të mundur identifikimin dhe dokumentimin e dëmit të shkaktuar nga pamundësia e realizimit të ndërtimit, si dhe të organit përgjegjës për shkaktimin e dëmit të pretenduar, që lidhet me mosdorëzimin e formularit nr. 4 për zbardhjen e

lejes së ndërtimit. Bashkia Tiranë ka parashtruar se shkresa nr. 7271/1 prot., datë 06.10.2020, e lëshuar nga ai institucion nuk është akt administrativ që mund të kundërshtohet në gjykatë brenda afatit ligjor 45-ditor.

28. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se e drejta për të pasur akses në gjykatë i garanton individit të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës dhe për të marrë një përgjigje përfundimtare prej saj, të arsyetuar, për pretendimet e ngritura (*shih vendimet nr. 11, datë 21.04.2022; nr.17, datë 24.03.2014 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata ka theksuar se e drejta për një proces të rregullt ligjor, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142/1 të Kushtetutës, si dhe neni 6 i KEDNJ-së, përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar. Funksioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve se ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Vendimi mund të kontrollohet nga një gjykatë më e lartë sipas procedurave përkatëse dhe që kjo të jetë e mundur duhet bërë arsyetimi i vendimit, në të cilin gjyqtari tregon me qartësi faktet dhe ligjin e zbatueshëm që e kanë çuar në bërjen e një zgjedhjeje ndërmjet disa mundësive. Përveç kësaj, duke dhënë një vendim të arsyetuar, mund të realizohet edhe vëzhgimi publik i administrimit të drejtësisë *(shih vendimin nr. 18, datë 15.03.2016 të Gjykatës Kushtetuese)*.

29. Në këndvështrim të standardeve të mësipërme kushtetuese, Gjykata do të vlerësojë nëse kërkuesja ka marrë përgjigje për pretendimet e parashtruara nga ajo gjatë gjykimit të çështjes, si dhe nëse ato janë vlerësuar nga Gjykata e Lartë në kuadër të garancive që ofron neni 42 i Kushtetutës për procesin e rregullt ligjor në drejtim të së drejtës së aksesit substancial të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor.

30. Në rastin konkret, Gjykata vëren se kërkuesja në datën 13.06.2005 ka paguar shumën 7.200.000 lekë për taksën e ndikimit në infrastrukturë, që përfaqësonte vlerën 5 % të investimit. Kjo taksë është paguar bazuar në ligjin nr. 8405, datë 17.09.1998 "Për urbanistikën", të ndryshuar dhe vendimin nr. 7, datë 07.03.2003 "Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Tiranës" të këshillit bashkiak Tiranë. Sipas këtyre akteve, taksa e ndikimit në infrastrukturë synon të balancojë dëmin që vjen në infrastrukturë nga ndërtimet e reja. Ajo paguhet nga personi juridik përpara marrjes së dokumentit të lejes së ndërtimit. Si bazë e kësaj takse është vlera e investimit të ri që kërkohet të kryhet dhe vlera e taksës shprehet si përqindje ndaj vlerës së investimit. Mbi bazën e këtij kuadri ligjor, Gjykata konstaton se vlera e paguar nga kërkuesja për taksën e ndikimit në infrastrukturë ka qenë e kushtëzuar me marrjen e lejes së ndërtimit dhe vlerën e investimit.

Megjithatë, kërkuesja nuk është pajisur nga Bashkia Tiranë me dokumentin e lejes së ndërtimit dhe kjo e fundit në vitin 2011 me vendim gjyqësor është shpallur si akt absolutisht i pavlefshëm. Në këto rrethana, në muajin shtator të vitit 2020 kërkuesja i ka kërkuar Bashkisë Tiranë kthimin e shumës së paguar për atë taksë, por kjo bashki e ka refuzuar kërkesën me argumentin se vendimi gjyqësor për pavlefshmërinë absolute të lejes së ndërtimit nuk është shprehur për rregullimin e pasojave.

31. Në nëntor të vitit 2020 kërkuesja u është drejtuar gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, të cilat gjatë procesit gjyqësor kanë marrë në shqyrtim padinë, me objekt kthimin e shumës së paguar për taksën e ndikimit në infrastrukturë dhe shpërblimin e dëmit jashtëkontraktor. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 3207 (80-2021-3261), datë 16.11.2021, ka vendosur pranimin pjesërisht të padisë dhe detyrimin e Bashkisë Tiranë/palë e paditur për të dëmshpërblyer kërkuesen në vlerën e dëmit pasuror, si dhe fitimit të munguar për të gjitha shpenzimet e kryera në respektim të lejes së ndërtimit nr. 297, datë 05.07.2004 dhe kontratave të sipërmarrjes dhe porosive me pronarët e truallit në vlerën totale të dëmit 68.373.319 lekë, si dhe rrëzimin e padisë për pjesën tjetër të kërkimit për kamatëvonesat, si të pabazuar në ligj dhe në prova. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka vlerësuar se në rastin konkret plotësohen kushtet për ekzistencën e shpërblimit të dëmit të shkaktuar nga veprimi i paligjshëm dhe me faj i të tretit sipas neneve 608 dhe 609 të KC-së dhe vendimit unifikues nr. 12, datë 14.09.2007 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Në lidhje me afatin e paraqitjes së padisë, gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar se në rastin konkret, në referim të nenit 18, pika 1, të ligjit nr. 49/2012, padia kundër veprimit administrativ paraqitet në gjykatë brenda 45 ditëve nga dita kur ka marrë përgjigje përfundimtare nga Bashkia Tiranë për moskthimin e taksës me shkresën e kësaj bashkie, e cila është komunikuar në datën 10.10.2020.

32. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 435 (86-2023-626), datë 30.05.2023, pas ankimit të subjektit të interesuar, Bashkisë Tiranë, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, duke arsyetuar se, në rastin konkret, pala e paditur detyrohet të kthejë shumën e përfituar prej saj dhe të paguar nga pala paditëse/kërkuesja për lëshimin e lejes së ndërtimit. Për afatin e parashkrimit, gjykata e apelit ka arsyetuar se padia nuk parashkruhet, pasi është e lidhur me padinë për pavlefshmërinë absolute të lejes së ndërtimit Sipas gjykatës së apelit, pala paditëse/kërkuesja ka humbur të drejtën për ndërtim, por kjo nuk i shuan

të drejtën për të kërkuar kthimin e asaj që ka paguar *(shih paragrafin 13 të këtij vendimi).*

33. Ndaj vendimit ka ushtruar rekurs Avokatura e Shtetit dhe Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-1166 (117), datë 25.03.2024, ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. 435 (86-2023-626), datë 30.05.2023 të Gjykatës Administrative të Apelit dhe vendimit nr. 3207, datë 16.11.2021 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, si dhe rrëzimin e padisë. Në vendim, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka arsyetuar se në rastin konkret janë përpara padisë për shpërblimin e dëmit jashtëkontraktor, padi civile, e cila duhet të paraqitet brenda afatit ligjor 3-vjeçar të parashikuar nga ligji i posaçëm nr. 8510/1999. Sipas Kolegjit Administrativ, edhe në nenin 115, shkronja "dh", të KC-së parashikohet afati ligjor 3-vjeçar për parashkrimin e padisë për shpërblimin e dëmit jashtëkontraktor.

34. Gjykata e Lartë ka arsyetuar se momenti i lindjes të së drejtës së padisë përcaktohet si momenti i fillimit të ecjes së afatit të parashkrimit, pasi vetëm me lindjen e kësaj të drejte mund të flitet për mosveprim të titullarit dhe vetëm kur cenohet e drejta subjektive lind e drejta e padisë për mbrojtjen e saj. Kolegji Administrativ ka vlerësuar se momenti kur kërkueses i ka lindur e drejta për të paraqitur padi ka qenë data 12.10.2011, kur ka përfunduar afati për shtyrjen e lejes së ndërtimit. Në vijim, pala paditëse/kërkuesja nuk mund të vazhdonte me ndërtimin dhe se ajo e ka pasur të mundur identifikimin dhe dokumentimin e dëmit të shkaktuar nga pamundësia e realizimit të ndërtimit dhe të organit përgjegjës që ka shkaktuar dëmin e pretenduar dhe jo nga data 10.10.2020 kur i është komunikuar shkresa e Bashkisë Tiranë. Gjithashtu, sipas Kolegjit Administrativ, kjo shkresë nuk përbën akt administrativ, që mund të kundërshtohet në gjykatë brenda 45 ditëve dhe se nuk përbën shkak për të pezulluar ose ndërprerë ecjen e afatit të parashkrimit. Kolegji Administrativ ka vlerësuar se, në rastin konkret, për të ngritur padinë e kërkimit të shpërblimit të dëmit, si në ligjin e posaçëm, ashtu edhe në KC, parashikohet afati ligjor 3-vjeçar, i cili pranohet edhe nga referimi që bëhet në nenin 18, pika 4, të ligjit nr. 49/2012. Nga ana tjetër, specifika e gjykimit administrativ është se në pikën 7 të kësaj dispozite gjendet rregullimi se afatet e parashkrimit janë të prera dhe shkelja e tyre shkakton humbjen e së drejtës së padisë, si dhe *"këto afate shqyrtohen nga gjykata edhe kryesisht"*. Pra, sipas Gjykatës së Lartë, ligji i posaçëm nr. 49/2012, në nenin 18, pika 7, të tij, ka vendosur një rregull të ndryshëm nga ai i parashikuar në nenin 125 të KC-së, dhe se gjen

zbatim ekskluzivisht për gjykimet administrative dhe lidhet me mundësinë dhe detyrimin e gjykatës administrative që të marrë parasysh vetë afatin e parashkrimit, edhe pa u ngritur kjo çështje nga palët, duke vlerësuar se në rastin konkret padia është paraqitur jashtë afatit ligjor.

35. Duke analizuar përmbajtjen e vendimeve gjyqësore në raport me rrethanat e çështjes, Gjykata konstaton se padia e paraqitur nga kërkuesja ka pasur dy kërkime të ndryshme, me objekte dhe shkaqe të ndryshme, konkretisht: 1) kthimin e shumës 7.200.000 lekë të paguar për taksën 5 % të ndikimit në infrastrukturë për lejen e ndërtimit nr. 297, datë 05.07.2004, për godinën 2, 6 dhe 8 kate në rrugën "Muhamet Gjollesha", Tiranë, për shkak se ndërtimi nuk ishte realizuar; 2) shpërblimin e dëmit të shkaktuar për të gjitha shpenzimet e kryera në respektim të lejes së ndërtimit dhe të kontratave të sipërmarrjes, si dhe porosive me pronarët e truallit dhe fitimin e munguar. Pas shqyrtimit të padisë nga gjykata e shkallës së parë, e cila ka çmuar se padia ishte paraqitur brenda afatit ligjor, duke përcaktuar vlerën 68.373.319 lekë për shpërblimin e dëmit pasuror dhe fitimin e munguar për të gjitha shpenzimet e kryera në respektim të lejes së ndërtimit dhe të kontratave të sipërmarrjes, gjykata e apelit dhe, në vijim, Gjykata e Lartë kanë shqyrtuar ankimin dhe rekursin e paraqitur nga subjekti i interesuar, duke i vlerësuar pretendimet dhe duke mbajtur qëndrime diametralisht të kundërta. Konkretisht, gjykata e apelit ka vlerësuar se kërkimi për kthimin e taksës ishte kërkim aksesor i padisë për pavlefshmërinë absolute të lejes së ndërtimit, e cila nuk parashkruhet, ndaj edhe për kthimin e taksës nuk zbatohej ndonjë afat parashkrimi. Ndërsa për detyrimin e Bashkisë Tiranë për të dëmshpërblyer kërkuesen, gjykata e apelit ka arsyetuar se në interpretim të nenit 450 të KC-së shpërblimi për dëmin duhet të rrjedhë nga vonesa e debitorit, pra lind nga momenti kur detyrimi është bërë i kërkueshëm për debitorin dhe ai nuk e ka përmbushur atë *(shih faqen 12 të vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë).*

36. Ndërsa Gjykata e Lartë i ka vlerësuar të dyja kërkimet e padisë si një të vetme në drejtim të shpërblimit të dëmit jashtëkontraktor dhe ka marrë në shqyrtim kryesisht parashkrimin e padisë sipas afatit ligjor 3-vjeçar të parashikuar nga ligji nr. 8510/1999 për shpërblimin e dëmit. Lidhur me marrjen në shqyrtim të parashkrimit me nismën e saj, Gjykata e Lartë ka arsyetuar se ligji nr. 49/2012 ka përparësi ndaj parashikimit të nenit 125 të KC-së, sipas të cilit parashkrimi i plotësuar nuk mund të merret parasysh nga gjykata ose organi tjetër kompetent me nismën e vet, por vetëm me kërkesën e palës së interesuar. Në vijim, Kolegji Administrativ i Gjykatës

së Lartë, duke përdorur metodën e interpretimit *strictu sensu* të ligjit nr. 49/2012, ka arsyetuar se kërkuesja ka qenë në dijeni të dëmit të pësuar dhe të subjektit (organit publik) që e ka shkaktuar atë, duke plotësuar në mënyrë kumulative kriteret e nenit 120 të KC-së *(shih paragrafin 24 të vendimit të Gjykatës së Lartë)*. Nuk rezulton që Gjykata e Lartë të jetë shprehur për kërkimin për kthimin e taksës së paguar dhe as se përse nuk qëndronte arsyetimi i gjykatës së apelit se ky kërkim nuk i nënshtrohej parashkrimit, pasi ishte kërkim aksesor i padisë për pavlefshmërinë absolute të lejes së ndërtimit, që sipas ligjit nuk parashkruhet. Si pasojë e këtij interpretimi/zbatimi të ligjit, Gjykata e Lartë ka arritur në përfundimin se padia është paraqitur jashtë afatit ligjor dhe, për këtë shkak, ka ndryshuar vendimet e gjykatave më të ulëta, duke vendosur rrëzimin e padisë.

37. Gjykata vëren se Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, duke marrë kryesisht në shqyrtim çështjen e parashkrimit të padisë, ka vlerësuar se kërkuesja ka kërkuar dëmshpërblim tej afatit ligjor 3-vjeçar, duke rrëzuar në tërësi padinë e saj. Edhe pse gjykata e apelit ishte shprehur se kërkimi për kthimin e taksës së infrastrukturës nuk parashkruhej, duke mbajtur në konsideratë se ishte kërkim aksesor i lidhur me procesin gjyqësor për deklarimin e pavlefshmërisë absolute të lejes së ndërtimit, Gjykata e Lartë nuk ka arsyetuar se përse ky arsyetim ishte i pabazuar, por ka zgjedhur të mos shprehet fare për këtë kërkim, ndonëse kërkuesja kishte paguar taksën në favor të bashkisë për një ndërtim, i cili *de facto* nuk u realizua. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se Gjykata e Lartë ka mbajtur qëndrim vetëm për njërin nga kërkimet e parashtruara në padi, për shpërblimin e dëmit të shkaktuar për shpenzimet e kryera nga kërkuesja dhe nuk ka dhënë asnjë përgjigje për kërkimin tjetër të saj për kthimin e shumës së paguar për taksën 5% të ndikimit në infrastrukturë. Në këtë mënyrë, pretendimi i kërkueses për kthimin e shumës 7.200.000 lekë nuk ka marrë përgjigje përfundimtare nga gjykatat, që do të thotë se Gjykata e Lartë, në ushtrim të funksionit të saj si gjykatë ligji, duke mos mbajtur qëndrim të shprehur për kërkimin për kthimin e shumës së taksës së ndikimit në infrastrukturë, sipas objektit të padisë të kërkueses, ka cenuar të drejtën e aksesit substancial të lidhur me standardin kushtetues të arsyetimit të vendimit gjyqësor, për rrjedhojë pretendimi në këtë drejtim është i bazuar. Në kushtet kur procesi i zhvilluar nga Gjykata e Lartë, për pjesën për kërkimin për kthimin e taksës të ndikimit në infrastrukturë, nuk ka përmbushur standardet e procesit të rregullt ligjor, Gjykata çmon se është vënë në dyshim edhe e drejta e pronës së kërkueses.

38. Në përfundim, Gjykata çmon se kërkesa e kërkueses është e pjesërisht e bazuar, sipas arsyetimit të mësipërm të këtij vendimi.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, si dhe nenit 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, njëzëri,

V E N D O S I:

1. Pranimin pjesërisht të kërkesës.

2. Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2024-1166 (117), datë 25.03.2024 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë vetëm për kërkimin për kthimin e shumës së paguar si taksë e ndikimit në infrastrukturë.

3. Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 04.06.2025
Shpallur më 31.07.2025

Vendim nr. 37, datë 04.06.2025
(V-37/25)

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Holta Zaçaj, Kryetare, Marsida Xhaferllari, Fiona Papajorgji, Sonila Bejtja, Sandër Beci, Ilir Toska, Genti Ibrahimi, Marjana Semini, anëtarë, me sekretare Belma Lleshi, në datën 04.06.2025 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 3 (K) 2025 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: **KRISTOFOR ROBO**, përfaqësuar nga avokat Ylli Kameri, me prokurë.
ANDONIS LINA, ANASTASIA LINA

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2024-3542, datë 26.06.2024 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**
Konstatimi i shkeljes së afatit të arsyeshëm në gjykimin e çështjes civile nr. 7363 regj., nr. 112016-00206-30-2022 në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.
Rregullimi i pasojave duke detyruar gjykatën për gjykimin e çështjes menjëherë.

BAZA LIGJORE: **Nenet 42, 131, pika 1, shkronja "f", 134, pika 1, shkronja "i" dhe 142, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë *(Kushtetuta)*; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut *(KEDNJ)*; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar *(ligji nr. 8577/2000).***

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Marjana Semini, mori në shqyrtim pretendimet e kërkuesve Kristofor Robo, Andonis Lina dhe Anastasia Lina *(kërkuesit)*, të cilët kanë kërkuar pranimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I
Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesit Kristofor Robo dhe Arba Lina kanë qenë bashkëpronarë të një mjedisi me sipërfaqe prej 87.20 m^2, të ndodhur në Tiranë, që është përshtatur për bar, si dhe të një pasurie ngjitur me të me sipërfaqe 12.50 m^2, të regjistruar si "godinë" në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme *(ZVRPP),* Tiranë. Kërkuesit kanë lidhur kontratën e qirasë nr. 1937 rep., nr. 838 kol, datë 09.08.2017, me afat 5-vjeçar, me shtetasin E.S. për posedimin dhe gëzimin e dy pasurive të sipërcituara. Në rrethanat kur qiramarrësi nuk ka paguar vlerën e qirasë, sipas kontratës, kërkuesit i janë drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me padi për zgjidhjen e kontratës së qirasë, dorëzimin e pasurisë, pasi posedohej në mënyrë të paligjshme dhe pagimin e vlerës së qirasë për muajt e papaguar deri në zgjidhjen e kontratës në mënyrë të njëanshme nga paditësit/kërkuesit, si dhe sigurimin e padisë. Gjithashtu, shtetasi E.S. ka paraqitur kundërpadi për kthimin e shpenzimeve të nevojshme dhe të dobishme të kryera nga ai.

2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 7727, datë 26.11.2021, ka vendosur pranimin e padisë, zgjidhjen e kontratës noteriale të qirasë dhe detyrimin e shtetasit E.S. t'u dorëzojë kërkuesve mjedisin objekt të kontratës së qirasë dhe shumën 330.000 lekë, që përbën vlerat e papaguara të qirasë për tre muaj, si dhe detyrimin për të paguar shumën 110.000 lekë në muaj nga data 15.10.2018 deri në ditën e ekzekutimit të vendimit. Gjithashtu, gjykata e shkallës së parë ka vendosur pranimin e pjesshëm të kundërpadisë, duke detyruar paditësit/kërkuesit që t'i paguajnë palës së paditur shumën 4.141.171 lekë, që përbën shpenzimet e nevojshme të kryera nga ai në objekt dhe rrëzimin e kundërpadisë për pjesën tjetër.

3. Kundër vendimit nr. 7727, datë 26.11.2021 të Gjykatës së Rrethit

Gjyqësor Tiranë kanë paraqitur ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë (sot Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm) kërkuesit/paditësit dhe shtetasi E.S. Në datën 28.01.2022 çështja është regjistruar në atë gjykatë.

4. Kërkuesit, duke pretenduar shkeljen e afatit të arsyeshëm në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, i janë drejtuar po kësaj gjykate në datën 08.01.2023 me kërkesë për përshpejtimin e gjykimit edhe zhvillimin e gjykimit në afat të arsyeshëm. Ata e kanë përsëritur kërkesën në datat 02.03.2023 dhe 08.09.2023.

5. Në datën 29.01.2024, pasi ka kaluar afati ligjor 2-vjeçar për gjykimin e çështjes në gjykatën e apelit, sipas nenit 399/2, pika 1, shkronja "b", të Kodit të Procedurës Civile *(KPC),* kërkuesit i janë drejtuar me kërkesë Gjykatës së Lartë. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-3542, datë 26.06.2024, ka vendosur rrëzimin e kërkesës, duke arsyetuar, në mënyrë të përmbledhur, se nuk vërehej pakujdesi në veprimtarinë e gjykatës së apelit dhe se aktualisht ajo gjykatë është në pamundësi objektive për urdhëruar marrjen e masave për përshpejtimin e kësaj çështjeje të regjistruar në vitin 2022, pasi ajo gjykatë është e ngarkuar me shumë çështje të tjera më të vjetra, konkretisht të vitit 2017, madje me të njëjtën ose shkallë më të lartë përparësie *(shih paragrafin 24 të vendimit të Gjykatës së Lartë).*

6. Kërkuesit në datën 17.01.2025 *(data e shërbimit postar)* i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese *(Gjykata)* me ankim kushtetues individual sipas objektit. Kolegji i Gjykatës në datën 25.03.2025 ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtimin paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve, e cila, me vendimin e datës 01.04.2025, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

7. Gjatë kohës që çështja ishte në pritje për shqyrtim në Gjykatë, ka rezultuar se kërkuesja Arba Lina ka ndërruar jetë në datën 22.03.2025, sipas certifikatës së vdekjes të datës 08.04.2025. Për këtë qëllim, bazuar në nenin 1, pika 2, të ligjit nr. 8577/2000 dhe nenin 199 të KPC-së është bërë kalimi procedural duke vijuar gjykimi nga fëmijët Andonis Lina dhe Anastasia Lina, si trashëgimtarë të radhës së parë, sipas dëshmisë së trashëgimisë nr. 2084 rep., 529 kol., datë 05.05.2025.

II
Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

8. ***Kërkuesit*****,** në mënyrë të përmbledhur, kanë parashtruar pretendime për cenimin e së *drejtës për proces të rregullt ligjor,* të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në aspektin e së *drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm,* pasi gjykimi i çështjes në gjykatën e apelit është në tejkalim të afatit ligjor dhe ajo gjykatë nuk ka marrë masa për përshpejtimin e shqyrtimit të çështjes. Çështja nuk është komplekse dhe duhet të përfundonte menjëherë, si në shkallë të parë edhe në apel. Vonesat në gjykim kanë çuar edhe në shpronësimin e kërkuesve, që nuk mund të gëzojnë pronën e tyre, duke cenuar edhe të drejtën e pronësisë. Vonesa në gjykim është një element që rrit vlerën e konfliktit, duke bërë që objekti të shfrytëzohet dhe menaxhohet për përfitime nga personi që e posedon. Gjykimi i çështjes duhet të përshpejtohet, pasi kërkuesit janë respektivisht të moshave 75 dhe 77 vjeç, vuajnë nga sëmundje dhe të ardhurat nga objekti përbëjnë për ta mjete jetese. Gjykimi i çështjes duhet të përshpejtohet, duke marrë parasysh sjelljen e palëve, të gjykatës dhe kompleksitetin e çështjes, si dhe të drejtën absolute të pronësisë.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkuesve

9. Çështja e legjitimimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Referuar neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

10. Gjykata vlerëson se kërkuesit legjitimohen *ratione personae*,

bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, pasi janë palë ndërgjyqëse në procesin gjyqësor ndaj të cilit kanë ngritur pretendime në drejtim të gjykimit brenda një afati të arsyeshëm, ndaj justifikojnë interesin në çështjen e parashtruar.

11. Për sa i takon shterimit të mjeteve juridike efektive, Gjykata vëren se kërkuesit, bazuar në nenet 399/1 e vijues të KPC-së, i janë drejtuar Gjykatës së Lartë me kërkesë për konstatimin e shkeljes së afatit në shqyrtimin e çështjes dhe përshpejtimin e procedurave të gjykimit nga Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm, kërkesë e cila është rrëzuar. Për rrjedhojë, i vetmi mjet në dispozicion të tyre për rivendosjen e së drejtës së cenuar është ankimi kushtetues individual.

12. Në lidhje me afatin e paraqitjes së ankimit kushtetues individual, Gjykata konstaton se vendimi i Gjykatës së Lartë mban datën 26.06.2024, ndërsa kërkesa është paraqitur në Gjykatë në datën 17.01.2025. Referuar shkresës nr. 5987/1 prot., datë 06.12.2024 të Gjykatës së Lartë, vendimi është publikuar në faqen zyrtare të saj në datën 20.09.2024, për rrjedhojë Gjykata vlerëson se kërkuesit legjitimohen edhe *ratione temporis,* sepse jo vetëm që shkelja është vazhduese, por edhe ankimi kushtetues individual është paraqitur brenda afatit ligjor 4-mujor.

13. Në drejtim të legjitimimit *ratione materiae*, kërkuesit kanë pretenduar se u është cenuar e drejta për gjykim brenda një afati të arsyeshëm, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se pretendimi bën pjesë në juridiksionin kushtetues, ndaj do ta analizojë atë në themel.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm

14. Kërkuesit kanë pretenduar se gjykimi i çështjes në gjykatën e apelit është në tejkalimit të afatit ligjor dhe ajo gjykatë nuk ka marrë asnjë masë për përshpejtimin e çështjes. Çështja nuk është komplekse dhe duhet të përfundonte menjëherë edhe për shkak të moshës së kërkuesve dhe faktit që ata vuajnë nga disa sëmundje.

15. Neni 42 i Kushtetutës parashikon, ndër të tjera, se kushdo, për mbrojtjen e të drejtave ligjore, ka të drejtën e një gjykimi brenda një afati të arsyeshëm. Në jurisprudencën kushtetuese është pohuar se kohëzgjatja e gjykimit, normalisht, llogaritet nga momenti i fillimit të procesit gjyqësor deri në dhënien e vendimit dhe se në kohëzgjatjen e përgjithshme të gjykimit nuk përjashtohen vonesat e shkaktuara nga zbatimi i reformës në drejtësi,

pasi barra e këtyre vonesave nuk duhet të zhvendoset te palët ndërgjyqëse *(shih vendimet nr. 15, datë 03.04.2025; nr. 57, datë 17.09.2024; nr. 2, datë 17.02.2022 të Gjykatës Kushtetuese)*.

16. Duke iu referuar nenit 399/2, pika 1, shkronja "b", të KPC-së, Gjykata vë në dukje se kohëzgjatja e gjykimit të çështjes konkrete ka tejkaluar afatin 2-vjeçar të përcaktuar nga ligji si i arsyeshëm për përfundimin e gjykimit civil në apel. Në këto rrethana, për të vlerësuar nëse kërkuesve u është cenuar e drejta kushtetuese për gjykim brenda afatit të arsyeshëm, Gjykata do të analizojë rrethanat e veçanta të çështjes konkrete dhe kriteret e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese që lidhen me: (i) sjelljen e kërkuesit; (ii) kompleksitetin e çështjes; (iii) sjelljen e autoriteteve; (iv) rëndësinë e asaj çfarë rrezikon kërkuesi (*shih vendimet nr. 46, datë 03.10.2023; nr. 6, datë 16.02.2023; nr. 13, datë 26.05.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. *Për sjelljen e kërkuesve,* sipas jurisprudencës kushtetuese vlerësimi i sjelljes së kërkuesit është një element përcaktues i kohëzgjatjes së arsyeshme të procedimeve, duke u analizuar rrethanat nëse ai ka vepruar në përputhje me të drejtat procedurale, duke shfaqur ose jo interes të vazhdueshëm për gjykimin e çështjes brenda një afati sa më të përshtatshëm për të, dhe nëse është bërë shkak ose ka shkaktuar vonesa në këtë drejtim *(shih vendimet nr. 6, datë 16.02.2023; nr. 37, datë 05.11.2021; nr. 35, datë 01.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Gjykata konstaton se pasi çështja/ankimi është regjistruar në datën 28.01.2022 në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, kërkuesit kanë shfaqur interes për ecurinë e shpejtë të gjykimit të çështjes. Ata i janë drejtuar Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm tri herë, në datat 08.01.2023, 02.03.2023 dhe 08.09.2023. Në vijim, ata i janë drejtuar Gjykatës së Lartë me kërkesë për përshpejtimin e gjykimit të çështjes. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se kërkuesit i kanë përdorur të gjitha mjetet ligjore për mbrojtjen e të drejtave të tyre dhe nuk rezulton të jenë bërë shkak ose të kenë shkaktuar vonesa në gjykimin e çështjes gjyqësore.

19. Për sa i takon *kompleksitetit të çështjes,* Gjykata ka theksuar se në vlerësimin e kompleksitetit të çështjes marrin rëndësi të gjitha aspektet e saj, përfshirë objektin, faktet e kundërshtuara, volumin dhe natyrën e provave, llojin dhe ndërthurjen e ligjeve të zbatueshme, si dhe numrin e palëve pjesëmarrëse në proces *(shih vendimet nr. 6, datë 16.02.2023; nr. 13, datë 26.05.2022; nr. 35, datë 01.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese).*

20. Gjykata vëren se çështja ka natyrë civile, me objekt rregullimin e

pasojave për shkak të zgjidhjes së njëanshme nga kërkuesit të kontratës së qirasë të lidhur me të padituri/qiramarrës. Duke iu referuar rrethanave, çështja e kërkuesve nuk paraqitet komplekse, e tillë që të justifikojë kohëzgjatjen prej 3 vjetësh e 4 muaj në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

21. Për sa i përket *sjelljes së autoriteteve*, Gjykata konstaton se çështja e kërkuesve është në pritje për shqyrtim në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm prej më shumë se 3 vjetësh, ndonëse ligjvënësi ka parashikuar afate procedurale konkrete në KPC. Duke analizuar gjendjen e Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, Gjykata konstaton se çështja konkrete është regjistruar në atë gjykatë në datën 28.01.2022, në një kohë kur reforma në drejtësi kishte filluar të zbatohej. Gjyqtarja relatore, së cilës i është caktuar çështja e kërkuesve, deri në muajin maj 2024 ka për shqyrtim 1894 çështje gjyqësore, të regjistruara në periudhën 2016-2024 dhe nuk rezulton të ketë kryer veprime me çështjen konkrete.

22. Edhe Gjykata e Lartë e ka rrëzuar kërkesën për konstatimin e shkeljes dhe përshpejtimin e procedurave, duke arsyetuar se Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm është në pamundësi objektive të urdhërojë marrjen e masave për përshpejtimin e kësaj çështjeje, pasi kjo gjykatë është e ngarkuar me shumë çështje të tjera më të vjetra se ajo objekt gjykimi dhe me shkallë më të lartë përparësie *(shih paragrafin 24 të vendimit të Gjykatës së Lartë).* Sipas Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, askujt nuk mund t'i kërkohet të bëjë të pamundurën dhe për më tepër nuk mund të mbahet përgjegjësi për pamundësinë objektive absolute për evadimin e çështjeve, në kushtet e një numri të kufizuar burimesh njerëzore dhe një numri tepër të lartë të stokut të çështjeve *(shih paragrafin 17 të vendimit të Gjykatës së Lartë)*. Në jurisprudencën kushtetuese është përcaktuar se gjykimi përtej afatit të arsyeshëm nuk mund të përligjë cenimin e të drejtave kushtetuese të individëve, në kushtet kur mbingarkesa në gjykata tashmë është një situatë e njohur dhe e zgjatur në kohë, e cila nuk varet nga individët *(shih vendimin nr. 57, datë 17.09.2024 të Gjykatës Kushtetuese).*

23. Në lidhje me *atë çfarë rrezikojnë kërkuesit* në procesin gjyqësor, Gjykata ka vlerësuar se disa çështje që lidhen me interesa "vetjakë e jetësorë " nevojitet të trajtohen me shpejtësi e përparësi, të tilla si ato që kërkojnë "kujdes të veçantë" ose "kujdes të jashtëzakonshëm" dhe që lidhen me statusin civil, kujdestarinë e fëmijëve, marrëdhëniet e punësimit, sëmundjet e pashërueshme dhe pensionin. Lista e këtyre çështjeve nuk mund të jetë shteruese dhe kriteri i interesit të kërkuesit në proces verifikohet nga

Gjykata rast pas rasti *(shih vendimet nr. 43, datë 04.06.2024; nr. 21, datë 04.04.2024; nr. 6, datë 16.02.2023 të Gjykatës Kushtetuese*). Edhe Këshilli i Lartë Gjyqësor *(KLGJ)* në vendimin nr. 78, datë 30.05.2019, të ndryshuar me vendimin nr. 254, datë 09.05.2024, ka vlerësuar se pala mund të kërkojë përshpejtimin e gjykimit për shkaqe që përcaktojnë ose kushtëzojnë ecurinë e zgjidhjes së mosmarrëveshjes kryesore të palëve ndërgjyqëse, shkaqe këto, ekzistenca e të cilave motivon shqyrtimin e përshpejtuar të çështjes. Si shkak veçanërisht i rëndë është edhe gjendja shëndetësore e palës ose mosha, e tillë që mund të vërë në dyshim pritshmërinë për një vendim gjyqësor që lidhet me një të drejtë personale (*shih kreun II, pika 5 dhe pika 6, shkronja "b", të vendimit nr. 78, datë 30.05.2019 të KLGJ-së "Për kalendarin e shqyrtimit të çështjeve në gjykatën e apelit"*). Gjykata vëren se në drejtim të plotësimit të këtij kriteri, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka arsyetuar se nuk rezulton që kërkuesit të kenë prezantuar e provuar para gjykatës shkaqe veçanërisht të rënda, që justifikojnë përshpejtimin e çështjes në raport me çështjet pararendëse dhe se mosha nuk mund të përbëjë apriori një rrethanë veçanërisht të rëndë për përshpejtim, me përjashtim të rasteve kur diskutohet e drejta e pensionit e lidhur ngushtësisht me të ardhurat jetike për jetesë. Ndërkohë, çështja konkrete nuk ka një natyrë të tillë *(shih paragrafin 28 të vendimit të Gjykatës së Lartë)*. Gjykata vëren se kërkuesit në kërkesat e drejtuara gjykatës së apelit për afrimin e datës së gjykimit të çështjes, po ashtu edhe në kërkesën drejtuar Gjykatës së Lartë e kanë parashtruar situatën e tyre të veçantë lidhur me moshën dhe gjendjen shëndetësore. Në këtë situatë, Gjykata thekson edhe faktin se kërkuesja Arba Lina ka ndërruar jetë në datën 22.03.2025, për shkak të gjendjes së rënduar shëndetësore.

24. Për sa më lart, Gjykata, referuar objektit të çështjes gjyqësore dhe thelbit të pretendimeve të parashtruara në ankimin kushtetues individual, vlerëson se kërkuesit kanë arritur të parashtrojnë shkaqe objektive, specifike dhe të mjaftueshme për të provuar se çështja është e një natyre të tillë që interesi i tyre rrezikohet në shkallë të konsiderueshme nga kohëzgjatja e procedurave gjyqësore. Për rëndësinë e asaj çfarë rrezikojnë kërkuesit, për shkak të vonesës në shqyrtimin e çështjes në gjykatën e apelit, Gjykata konstaton, nga rrethanat e rastit konkret, se sendi në pronësi të tyre nuk iu është dorëzuar, pra nuk iu është kthyer, edhe pasi ka mbaruar afati i kontratës për të pasur mundësi për të lidhur një të re me një tjetër qiramarrës, në kushtet kur kontrata e qirasë me shtetasin E.S. kishte mbaruar. Në situatën aktuale, pasi kërkuesja Arba Lina ka ndërruar

jetë, kërkuesit Kristofor Robo, si pensionist dhe me gjendje të rënduar shëndetësore, vazhdon t'i vihet në dyshim pritshmëria për të gëzuar të ardhurat civile që vijnë nga kontrata e qirasë. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se në rastin konkret kërkuesit kanë argumentuar dhe provuar rrezikun për interesat e tyre, natyra dhe rëndësia e të cilave justifikon trajtimin me përparësi dhe shpejtësi të veçantë të çështjes nga Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm.

25. Në përfundim, Gjykata çmon se në kontekstin e situatës së përgjithshme të sistemit gjyqësor, duke mbajtur në konsideratë burimet njerëzore, kushtet e punës dhe numrin e lartë të çështjeve, kohëzgjatja e gjykimit në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm të çështjes së kërkuesve përbën shkak të mjaftueshëm për të konstatuar tejzgjatje të procedurave. Për më tepër, duke e ndërlidhur kohëzgjatjen e gjykimit të çështjes me rrethanat e tjera, si mungesa e komplek

sitetit të saj dhe interesat vetjakë që kanë rëndësi për kërkuesit në lidhje me moshën, gjendjen shëndetësore dhe atë ekonomike, Gjykata çmon se kërkuesve u është cenuar e drejta kushtetuese për gjykim brenda një afati të arsyeshëm, për rrjedhojë kërkesa e tyre pranohet.

26. Gjithashtu, Gjykata, duke marrë në konsideratë veçoritë e çështjes së kërkuesve dhe mundësitë aktuale të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, çmon se bazuar në nenin 81, pika 3, të ligjit nr. 8577/2000 duhet urdhëruar detyrimi i kësaj gjykate që të shqyrtojë çështjen brenda 3 (tre) muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, si dhe nenit 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, njëzëri,

V E N D O S I:

1. Pranimin e kërkesës.

2. Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2024-3542, datë 26.06.2024 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën.

3. Konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm në gjykimin e çështjes civile nr. 7363, regjistri nr. 112016-00206-30-2022 në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

4. Detyrimin e gjykimit të çështjes në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm brenda tre (3) muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 04.06.2025
Shpallur më 26.06.2025

Vendim nr. 38, datë 10.06.2025
(V-38/25)

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Holta Zaçaj, Kryetare, Marsida Xhaferllari, Fiona Papajorgji, Sandër Beci, Genti Ibrahimi, Marjana Semini, Sonila Bejtja, anëtarë, me sekretare Belma Lleshi, në datën 10.06.2025 mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë të dokumenteve, çështjen nr. 34 (Sh) 2024 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUESE: **SHOQËRIA "ERDA" SH.P.K.**, përfaqësuar nga avokat Artan Zeneli, me prokurë.

SUBJEKT I INTERESUAR:
SHOQËRIA "ALB-ITALIA COSTRUZIONI" SH.P.K., përfaqësuar nga administratori Adrian Prifti.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2023-1328 (173), datë 04.04.2024 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**
Dërgimi i çështjes për rigjykim në Gjykatën e Lartë, me tjetër trup gjykues.

BAZA LIGJORE: **Nenet 4, 41, 42, 43, 44, 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).**

GJYKATA KUSHTETUESE

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Sonila Bejtja, mori në shqyrtim parashtrimet me shkrim të kërkueses "Erda" sh.p.k. (*kërkuesja*), e cila ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar, shoqërisë "Alb-Italia Costruzioni" sh.p.k. (*shoqëria Alb-Italia*), që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I
Rrethanat e çështjes

1. "Erda" sh.p.k. është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e cila ka objekt veprimtarie shërbime të ruajtjes së sigurisë fizike. Në datën 01.01.2001 kërkuesja, në cilësinë e ofrueses së shërbimeve, ka nënshkruar një kontratë shërbimi (*kontrata*) me afat 1 vjeçar me shoqërinë Alb-Italia, e cila fillimisht ka pasur ortak shtetin shqiptar dhe një shoqëri të së drejtës italiane, në cilësinë e përfitueses së shërbimeve. Palët kanë nënshkruar edhe procesverbalin e marrjes në dorëzim të mjediseve për ruajtje. Në datën 01.01.2002 palët kanë rinovuar kontratën për një periudhë të mëtejshme 1-vjeçare, me të njëjtat kushte. Sipas kontratës, kërkuesja merrte përsipër të ruante territorin e shoqërisë Alb-Italia, ndërsa kjo e fundit detyrohej të paguante shpenzimet për ruajtjen e objekteve, të cilat konsistonin në pagën mujore të 6 rojeve, në një vlerë totale prej 90.000 lekësh. Sipas kontratës, shoqëria Alb-Italia do ta bënte pagesën për shërbimet në datën 10 të çdo muaji, ndërsa parashikohej një kamatë prej 2% të shumës së papaguar për çdo ditë vonese. Duke pretenduar se shoqëria Alb-Italia nuk i kishte përmbushur detyrimet kontraktore kërkuesja i është drejtuar gjykatës me padi me objekt detyrimin e saj për të paguar detyrimin sipas kontratës, përfshirë kamatëvonesat.

2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 3331, datë 16.07.2003 (*vendimi nr. 3331/2003*), ka vendosur pranimin e kërkesëpadisë dhe detyrimin e shoqërisë Alb-Italia t'i paguajë kërkueses shumën 24.814.800 lekë, të përbërë nga pagat e punonjësve në shumën 2.160.000 lekë dhe kamatëvonesat në shumën 22.654.800 lekë. Gjatë gjykimit të çështjes në gjykatën e shkallës së parë ka rezultuar se pala e paditur, shoqëria Alb-Italia, ka qenë në mungesë. Ky vendim ka marrë formë të prerë për shkak se ndaj tij nuk është paraqitur ankim. Referuar parashtrimeve

dhe prapësimeve të palëve të paraqitura në gjykimin kushtetues, detyrimi financiar sipas këtij vendimi është ekzekutuar tërësisht nëpërmjet shërbimit përmbarimor gjyqësor, ndërkohë që në dosjen gjyqësore të administruar për qëllime të këtij gjykimi, nuk gjendet urdhri i ekzekutimit i lëshuar nga gjykata.

3. Pas rreth 5 vjetësh nga vendimi i gjykatës së shkallës së parë, me pretendimin se nuk ka pasur dijeni për zhvillimin e atij gjykimi dhe as për vendimin e asaj gjykate, subjekti i interesuar, shoqëria Alb-Italia i është drejtuar gjykatës me kërkesë për rivendosjen në afat të së drejtës së ankimit kundër atij vendimi. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin e datës 09.10.2008, ka vendosur pushimin e gjykimit për shkak të heqjes dorë nga kërkesa. Në vijim, në datën 19.06.2009, shoqëria Alb-Italia ka riparaqitur kërkesë për rivendosjen në afat dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 342 akti, datë 05.10.2009, ka vendosur rrëzimin e saj. Mbi ankimin e këtij subjekti, Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 382, datë 16.07.2010 (*vendimi nr. 382/2010*), ka vendosur ndryshimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë, duke rivendosur në afat shoqërinë Alb-Italia për t'u ankuar ndaj vendimit nr. 3331/2003, me arsyetimin se ajo palë nuk ka pasur dijeni për procesin gjyqësor të zhvilluar kundër saj për shkak të pavlefshmërisë së njoftimeve. Ky vendim është lënë në fuqi me vendimin nr. 116, datë 03.04.2014 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (*vendimi nr. 116/2014*).

4. Pas rivendosjes në afat, shoqëria Alb-Italia ka paraqitur ankim kundër vendimit nr. 3331/2003, ku ka ngritur pretendime si në drejtim të padijenisë për zhvillimin e procesit gjyqësor në gjykatën e shkallës së parë, ashtu edhe në drejtim të themelit të mosmarrëveshjes, duke argumentuar se ajo gjykatë nuk ka shqyrtuar vlefshmërinë e veprimeve juridike edhe pse kontratat e lidhura mes palëve ndërgjyqëse janë nënshkruar nga një person që nuk ka pasur të drejtë të përfaqësonte shoqërinë dhe, rrjedhimisht, asaj nuk i lind asnjë detyrim prej tyre. Gjithashtu, ajo ka kërkuar nga gjykata e apelit kthimin e çështjes për rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

5. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 113, datë 22.01.2016 ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 3331/2003 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Ajo gjykatë nuk ka pranuar kërkesën e shoqërisë Alb-Italia për kthimin e çështjes për rigjykim në gjykatën e shkallës së parë dhe ka vendosur ta shqyrtojë atë brenda kufijve të shqyrtimit të çështjes në apel, në bazë të nenit 465 të Kodit të Procedurës Civile (*KPC*), në përputhje me funksionin e saj si gjykatë fakti dhe ligji dhe, në përfundim, ka lënë në

fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë, pasi e ka gjetur atë të bazuar. Kundër atij vendimi ka paraqitur rekurs shoqëria Alb-Italia.

6. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë me vendimin nr. 00-2023-1328 (173), datë 04.04.2024, ka vendosur prishjen e vendimit nr. 113, datë 22.01.2016 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, me tjetër trup gjykues. Kolegji Civil ka arsyetuar se fakti i padijenisë së palës rekursuese ishte tashmë i provuar me vendim të formës së prerë (vendimi nr. 116/2014, që ka lënë në fuqi vendimin nr. 382/2010) dhe se gjykata e apelit mjaftonte thjesht ta konstatonte këtë fakt pa e vënë në diskutim atë, përndryshe cenohet parimi i gjësë së gjykuar. Për këtë arsye, sipas atij kolegji, gjykata e apelit duhet të vendoste prishjen e vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe dërgimin e çështjes për rigjykim po aty, me qëllim riparimin e shkeljeve procedurale, pa i hyrë analizës së shkaqeve të themelit të çështjes, sikundër dhe ka vepruar. Në përfundim, Kolegji Civil ka sqaruar se vetë Gjykata e Lartë nuk e ka mundësinë e dërgimit të çështjes për rigjykim drejtpërdrejt në gjykatën e shkallës së parë, pasi këtë të drejtë e ka vetëm për vendimet jo përfundimtare, ndaj i ka lënë detyrë gjykatës së apelit ta bëjë këtë.

7. Në datën 18.11.2024 kërkuesja, nëpërmjet shërbimit postar, i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij. Në datën 19.05.2025 Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës ka vendosur pranimin e dorëheqjes së një gjyqtari nga gjykimi i çështjes. Kolegji i Gjykatës, në datën 14.01.2025 ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II
Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

8. ***Kërkuesja,*** në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar *e drejta e pronës private* përmes një *procesi jo të rregullt ligjor*, në drejtim të:

8.1. *Së drejtës së aksesit*, e cila përfshin edhe të drejtën për një zgjidhje gjyqësore të mosmarrëveshjes, pasi Gjykata e Lartë e ka diktuar vendimmarrjen e gjykatës së apelit, duke e bërë procesin e rigjykimit jo të plotë, por të cekët dhe formal. Në rastin konkret, shkaku i rivendosjes në afat të së drejtës së ankimit ka qenë pavlefshmëria e njoftimeve gjatë gjykimit në gjykatën e shkallës së parë. Referuar nenit 123 të KPC-së, pavlefshmëria e vendimeve

të gjykatës që mund të shqyrtohen në gjykatën e apelit ose për të cilat mund të bëhet kërkesë në Gjykatën e Lartë, vlerësohet brenda kufijve dhe rregullave të caktuara për këto mjete kundërshtimi. Vendimi i Gjykatës së Lartë për prishjen e vendimit të gjykatës së apelit, e cila e kishte zgjidhur tashmë çështjen në themel, në raport me rregullin procedural të përdorur nga ajo, përbën një formalizëm të tepruar.

8.2. *Së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e pavarur, e paanshme dhe e caktuar me ligj,* për shkak se Gjykata e Lartë, në tejkalim të kompetencave të saj dhe në kundërshtim me parashikimet e nenit 123 të KPC-së, ka urdhëruar gjykatën e apelit që ta dërgojë çështjen për shqyrtim në gjykatën e shkallës së parë. Kthimi i çështjes në gjykatën e shkallës së parë është i panevojshëm, duke pasur parasysh se, gjykata e apelit, që ka kompetencë të shqyrtojë si çështjet e faktit, ashtu edhe çështjet e ligjit ka mundësinë që i jep neni 123 i KPC-së për të konvertuar shkakun e pavlefshmërisë (pavlefshmëria e njoftimeve) në mjetin e ankimit; gjatë shqyrtimit të ankimit të rivendosur në afat ka përmbushur standardet e gjykimit të drejtë, pasi i ka shqyrtuar të gjitha pretendimet e palëve dhe ka marrë një vendim të arsyetuar, të bazuar në prova, duke adresuar të gjitha aspektet e themelit të çështjes. Për pasojë, çështja është rikthyer në mënyrë të panevojshme në fazat fillestare të procesit, duke krijuar një rreth procedural të panevojshëm, në cenim edhe të parimit të sigurisë juridike. Mënyra e disponimit të Gjykatës së Lartë nuk i ka lënë mënyrë tjetër gjykimi gjykatës së apelit, veçse të prishë vendimin e gjykatës së shkallës së parë, duke e bërë të pakuptimtë rigjykimin e çështjes. Rrjedhimisht, ajo gjykatë nuk ka më autonomi në rigjykim, duke e bërë vendimmarrjen e saj formale, të paragjykuar dhe të diktuar nga Gjykata e Lartë.

8.3. *Së drejtës së mbrojtjes*, pasi vendimi i gjykatës së apelit në rigjykim është i paragjykuar, jo efektiv dhe tërësisht formal, pasi ajo gjykatë është e detyruar të vendosë në një mënyrë të caktuar, pavarësisht parashtrimeve të palëve në procesin gjyqësor.

8.4. *Standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor,* pasi Gjykata e Lartë ka arsyetuar se jurisprudenca kushtetuese e kufizon gjënë e gjykuar me thelbin e mosmarrëveshjes dhe nuk e shtrin atë edhe në vendime procedurale, që nuk adresojnë thelbin e mosmarrëveshjes, siç është vendimi i Gjykatës së Lartë që lë në fuqi vendimin e

gjykatës së apelit për rivendosjen në afat. Vendimi i Gjykatës së Lartë nuk adreson në mënyrë të mjaftueshme dhe bindëse sesi çështjet procedurale të pavlefshmërisë së njoftimeve ndikojnë në thelbin e mosmarrëveshjes, e cila tashmë është trajtuar dhe zgjidhur nga gjykata e apelit, si dhe nuk shpjegon se përse nuk është konsideruar shqyrtimi dhe zgjidhja e çështjes nga gjykata e apelit si e mjaftueshme për të garantuar të drejtën për një proces të drejtë dhe efektiv. Rikthimi i çështjes për rigjykim në gjykatën e shkallës së parë nuk adreson asnjë të drejtë të mohuar, por vetëm krijon zvarritje të pajustifikuar të procesit.

8.5. *Së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm të lidhur me të drejtën për një mjet juridik efektiv dhe parimin e ekonomisë gjyqësore*, pasi rikthimi i çështjes në fazën fillestare përbën një hap procedural të panevojshëm. Zgjatja e procesit përtej 21 vjetëve dhe perspektiva e shtyrjeve të mëtejshme, është në kundërshtim me garancitë e ofruara nga Kushtetuta dhe KEDNJ-ja, të cilat kërkojnë që konfliktet të zgjidhen në mënyrë të shpejtë dhe efektive, duke shmangur rikthimin e panevojshëm të çështjeve.

9. ***Subjekti i interesuar, shoqëria Alb-Italia,*** ka prapësuar si vijon:

9.1. Kërkuesja nuk legjitimohet, pasi nuk plotësohet kriteri i *shterimit të mjeteve juridike efektive*, për sa kohë që vendimi objekt ankimi nuk është as përfundimtar, as i formës së prerë, sepse e dërgon çështjen për rigjykim në gjykatën e apelit.

9.2. Pretendimi për cenimin e së *drejtës së aksesit në gjykatë* është i pabazuar pasi paradoksalisht kërkuesja e ka lidhur këtë pretendim me cenimin e mbrojtjes efektive, ndërkohë që shoqërisë Alb-Italia i është cenuar kjo e drejtë, duke u gjykuar në mungesë në gjykatën e shkallës së parë.

9.3. Pretendimi për cenimin e së *drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj* është i pabazuar, pasi Gjykata e Lartë ka ushtruar funksionin e saj si gjykatë ligji dhe mbështetur në përcaktimet e shkronjës "c" të nenit 485 të KPC-së ka udhëzuar, nëpërmjet konkluzioneve të saj, për mënyrën sesi duhet të ndreqen në rigjykim të metat e konstatuara në gjykimin e çështjes.

9.4. I pabazuar është edhe pretendimi për cenimin e *standardit të arsyetimit të vendimit*, pasi Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë e ka dërguar çështjen për rigjykim në gjykatën e apelit me qëllim për të korrigjuar cenimin e parimit të barazisë së armëve dhe

kontradiktoritetit të konstatuar me vendim të formës së prerë. Shoqëria Alb-Italia nuk ka qenë në dijeni të zhvillimit të procesit gjyqësor në gjykatën e shkallës së parë dhe gjykata e apelit nuk mund ta vinte në diskutim një fakt të tillë.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkueses

10. Çështja e legjitimimit *(locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

11. Në rastin në shqyrtim, Gjykata çmon se kërkuesja legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, pasi është palë në procesin gjyqësor ndaj të cilit ka ngritur pretendime në këtë Gjykatë dhe ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

12. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, Gjykata ka pohuar se në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës, mbrojtja kushtetuese ka një funksion *subsidiar*, që do të thotë se ajo mund të kërkohet vetëm për një vendim përfundimtar, të çfarëdolloj forme që përmbyll procesin gjyqësor, pasi individi ka shteruar mjetet dhe rrugët e tjera ligjore. Cenimi i të drejtave themelore, përfshirë atë për një proces të rregullt ligjor, mund të pretendohet në këtë Gjykatë vetëm pasi të shterohen të gjitha mundësitë e ofruara nga sistemi i apelimeve (*shih vendimet nr. 24, datë 27.04.2023; nr. 19, datë 07.07.2022; nr. 14, datë 11.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Megjithatë, Gjykata në jurisprudencën e saj ka pohuar se në rastin e vendimeve që kanë kthyer çështjen për rishqyrtim në një gjykatë më të ulët, përjashtimisht nga rregulli i parashikuar në nenin 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës, kontrollit kushtetues mund t'i nënshtrohen edhe vendime të tjera me natyrë jo përfundimtare që jepen

gjatë një procesi gjyqësor, për shkak të pasojave të drejtpërdrejta në të drejtën kushtetuese të individit dhe pamundësisë së riparimit të shkeljes së pretenduar gjatë procesit të themelit, pra në procesin gjyqësor që është duke u zhvilluar në juridiksionin e zakonshëm (*shih vendimin nr. 59, datë 14.11.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Gjykata vëren se në rastin në shqyrtim objekt i ankimit kushtetues individual është vendimi i Gjykatës së Lartë që ka kthyer çështjen për rigjykim në gjykatën e apelit, duke përcaktuar edhe detyrimin për këtë të fundit që ta kthejë çështjen për rigjykim në gjykatën e shkallës së parë, prandaj, në këndvështrim të jurisprudencës së mësipërme, Gjykata do të analizojë nëse në këtë rast përmbushen standardet/kriteret e lartpërmendura. Gjykata vëren, së pari, se e drejta kushtetuese e pretenduar e cenuar është ajo e pronës private, në formën e detyrimit financiar që qëndron në bazë të procesit gjyqësor të themelit. Kërkuesja ka pretenduar se mënyra e disponimit të Gjykatës së Lartë cenon, ndër të tjera, të drejtën kushtetuese për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj për shkak të tejkalimit të kompetencave nga Gjykata e Lartë, e cila ndikon edhe në të drejtën e saj të pronës private. Në këtë kuptim, Gjykata do të verifikojë nëse vendimi i kundërshtuar ka sjellë pasoja në të drejtën kushtetuese të pronës private dhe nëse është e mundur që ato të riparohen gjatë procesit të themelit në rigjykimin e çështjes.

14. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se ajo ndalet në aspekte të veçanta të së drejtës për proces të rregullt ligjor, për sa kohë ato mund të ndikojnë drejtpërdrejt në të drejtën substanciale në vetvete (*shih vendimet nr. 86, datë 30.12.2024; nr. 81, datë 21.11.2024; nr. 29, datë 16.04.2024 të Gjykatës Kushtetuese*). Edhe në rastin në shqyrtim, Gjykata vëren se pretendimi i kërkueses ka të bëjë me aspektin procedural të së drejtës substanciale të pronës private, dhe se gjykata e apelit gjatë rigjykimit është e detyruar të zbatojë detyrat e lëna nga Gjykata e Lartë, pra të kthejë çështjen në gjykatën e shkallës së parë. Kjo do të thotë se e drejta për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj nuk mund të riparohet gjatë rigjykimit të çështjes dhe, në këtë mënyrë, së bashku me kohëzgjatjen e procesit, ndikojnë në të drejtën substanciale të pronës.

15. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se në rastin konkret plotësohen të dyja kriteret e përcaktuara nga jurisprudenca kushtetuese si lidhur me pasojat e drejtpërdrejta në të drejtat kushtetuese, ashtu edhe me pamundësinë e riparimit të shkeljeve të pretenduara gjatë procesit të themelit. Për këtë arsye, Gjykata vlerëson se vendimi i kundërshtuar, përjashtimisht, ka

natyrë përfundimtare për qëllime të gjykimit kushtetues, ndaj përfshihet në juridiksionin e Gjykatës.

16. Kërkuesja legjitimohet *ratione temporis*, në kuptim të përmbajtjes së nenit 71/a, pika 1, shkronja "b", të ligjit nr. 8577/2000, pasi vendimi objekt kërkese, ai i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, mban datën 04.04.2024, i cili, sipas informacionit të asaj gjykate, është publikuar në faqen e saj zyrtare më 19.07.2024, ndërsa kërkesa është paraqitur në Gjykatë në datën 18.11.2024, pra brenda afatit ligjor 4-mujor.

17. Në drejtim të legjitimimit *ratione materiae,* Gjykata vëren se kërkuesja ka pretenduar cenimin e së *drejtës së pronës private, së drejtës së aksesit, asaj për t'u gjykuar nga një gjykatë e pavarur, e paanshme dhe e caktuar me ligj, së drejtës së mbrojtjes, standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor dhe së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm të lidhur me të drejtën për një mjet juridik efektiv*. Për sa i përket pretendimit për cenimin e së *drejtës për t`u gjykuar nga një gjykatë e pavarur, e paanshme dhe e caktuar me ligj*, Gjykata verën se kërkuesja e ka lidhur me mënyrën e disponimit të Gjykatës së Lartë, e cila, sipas kërkueses, në tejkalim të kompetencave të saj, e ka urdhëruar gjykatën e apelit që ta dërgojë çështjen për shqyrtim në gjykatën e shkallës së parë. Për rrjedhojë, pavarësisht mënyrës sesi kërkuesja e ka ngritur këtë pretendim, në thelb, ka të bëjë vetëm me *të drejtën për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj,* ndaj Gjykata do ta shqyrtojë në drejtim të këtij standardi. Ndërsa pretendimet e tjera të kërkueses janë më natyrë kushtetuese dhe, si të tilla, hyjnë në juridiksionin e Gjykatës, prandaj do të shqyrtohen në vijim për bazueshmërinë e tyre në themel. Në këtë pikë, Gjykata, siç ka theksuar edhe në paragrafin 14 të këtij vendimi, vlerëson që t'i analizojë pretendimet e kërkueses të lidhura me procesin e rregullt ligjor, si aspekte procedurale të së drejtës substanciale të pronës private. [1]

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e së drejtës së pronës private në aspektin procedural

B.1. 1. Për cenimin e së drejtës për t`u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj

[1] Gjyqtarja Marjana Semini votoi për shqyrtimin në themel edhe të pretendimit për cenimin e parimit të sigurisë juridike. Sipas saj, qasja e Gjykatës së Lartë në vendimin objekt të ankimi kushtetues individual, vë në dyshim garantimin e parimit të sigurisë juridike dhe të së drejtës së pronës të kërkueses, të njohur me vendim të formës së prerë dhe të ekzekutuar rreth 22 vjet më parë.

18. Kërkuesja ka pretenduar se mënyra e disponimit të Gjykatës së Lartë shkon përtej kompetencave që ka parashikuar ligji, duke diktuar vendimmarrjen e gjykatës së apelit, së cilës ajo nuk i ka lënë mënyrë tjetër vendimmarrjeje përveç kthimit të çështjes për rigjykim në gjykatën e shkallës së parë. Sipas saj, rigjykimi në gjykatën e apelit për këtë shkak do të jetë i pakuptimtë dhe vendimmarrja e asaj gjykate do të jetë formale, e paracaktuar dhe e paragjykuar.

19. Subjekti i interesuar, shoqëria Alb-Italia, ka prapësuar se pretendimet e kërkueses janë të pabazuara, pasi Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë e ka dërguar çështjen për rigjykim në gjykatën e apelit me qëllim për të korrigjuar cenimin e parimit të barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit të konstatuar me vendim të formës së prerë. Për sa kohë që ajo nuk ka qenë në dijeni të zhvillimit të procesit gjyqësor në gjykatën e shkallës së parë, gjykata e apelit nuk mund ta vinte në diskutim një fakt të tillë.

20. Neni 42 i Kushtetutës parashikon se e drejta e pronës private nuk mund të cenohet pa një proces të rregullt ligjor dhe se kushdo, për mbrojtjen e tyre, ka të drejtën e një gjykimi nga një gjykatë e caktuar me ligj. Në kuptim të këtij standardi, Gjykata është shprehur se përcaktimi i saktë i kompetencës është detyrim që rrjedh nga parimi i shtetit të së drejtës, i sanksionuar në nenin 4 të Kushtetutës, sipas të cilit, e drejta përbën bazën dhe kufijtë e veprimtarisë së shtetit. Fjala "ligj", sipas nenit 42 të Kushtetutës, përfshin edhe legjislacionin për krijimin dhe kompetencën e gjykatave (*shih vendimet nr. 14, datë 25.03.2025; nr. 16, datë 27.06.2022; nr. 62, datë 04.11.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Shqyrtimi i çështjes nga një *"gjykatë e caktuar me ligj"* është një nga elementet e procesit të rregullt, sipas nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së. Ky element, në sensin material, karakterizohet nga funksioni i saj gjyqësor, që ka të bëjë me zgjidhjen e çështjeve nga organe të ngarkuara me ligj për të dhënë drejtësi. Përveç këtij kushti, këto organe duhet të shqyrtojnë dhe të vendosin për çështje që janë në kompetencë të tyre gjatë një procesi të zhvilluar për një procedurë ligjërisht të përcaktuar dhe në pajtim me rendin juridik. E drejta e çdo pale për t'u dëgjuar në seancë përpara një gjykate kompetente dhe të caktuar me ligj nënkupton që gjykata të ketë juridiksion për të gjykuar çështjen dhe që kompetenca për të vendosur për të t'i jetë njohur nëpërmjet ligjit (*shih vendimet nr. 7, datë 20.02.2024; nr. 3, datë 07.02.2023; nr. 7, datë 23.02.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Gjykata ka vërejtur se bazuar në nenin 141 të Kushtetutës dhe

interpretimi i dispozitave që lidhen me procedurën e shqyrtimit të rekurseve është detyrë funksionale e Gjykatës së Lartë, megjithatë ajo ka pohuar se ky interpretim i nënshtrohet kontrollit kushtetues kur vihet në diskutim parimi i gjykatës së caktuar me ligj, në kuptimin që Gjykata analizon nëse Gjykata e Lartë u është përmbajtur kompetencave të saj të dhëna nga ligji (*shih vendimin nr. 14, datë 25.03.2025 të Gjykatës Kushtetuese)*.

23. Lidhur me kompetencën e Gjykatës së Lartë, Gjykata vëren se neni 485 i KPC-së ka përcaktuar mënyrat e disponimit të asaj gjykate, ku për rastet që vlerësohet se rekursi është bërë për shkaqe të parashikuara nga neni 472 i KPC-së, ka të drejtë të prishë vendimin e gjykatës së apelit dhe lënien në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë (*shkronja "b"*); të prishë vendimin e gjykatës së apelit dhe të dërgojë çështjen për rishqyrtim në atë gjykatë, me tjetër trup gjykues (*shkronja "c"*); të prishë vendimet e gjykatës së shkallës së parë dhe të gjykatës së apelit dhe të dërgojë çështjen për rigjykim në shkallë të parë kur vendimi jopërfundimtar i gjykatës së shkallës së parë është marrë në kundërshtim me ligjin dhe kjo shkelje nuk është konstatuar nga gjykata e apelit (*shkronja "ç"*); të prishë vendimet e gjykatës së shkallës së parë dhe të gjykatës së apelit dhe të pushojë çështjen (*shkronja "d"*); të ndryshojë vendimet e gjykatës së shkallës së parë dhe të gjykatës së apelit dhe të zgjidhë përfundimisht çështjen kur zbatimi i ligjit procedural ose material nuk diktohet nga nevoja për rishqyrtimin dhe rivlerësimin e fakteve ose të provave të çështjes (*shkronja "dh"*), si dhe të lërë në fuqi të vendimin e gjykatës së apelit (*shkronja "e"*).

24. Nën dritën e garancive të parashikuara nga neni 42 i Kushtetutës, duke pasur parasysh standardet kushtetuese të mësipërme dhe në referim të përmbajtjes së pretendimeve të kërkueses, Gjykata, në vijim, vlerëson që të analizojë vendimmarrjen e Gjykatës së Lartë në raport me dispozitat e KPC-së, të cilat përcaktojnë kompetencat e asaj gjykate, me qëllimin për të përcaktuar nëse ajo ka vepruar ose jo brenda këtyre kompetencave dhe, nëse kjo mënyrë e të vepruarit i ka sjellë pasoja edhe në drejtim të cenimit të të drejtave kushtetuese të kërkueses.

25. Gjykata konstaton fillimisht se Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë e ka vendosur dërgimin e çështjes për rigjykim, duke e justifikuar me nevojën e riparimit të një shkeljeje procedurale të gjykatës së shkallës së parë, duke referuar në nenin 467 të KPC-së, sipas të cilit gjykata e apelit prish vendimin e gjykatës së shkallës së parë dhe e dërgon çështjen për rigjykim kur çështja është gjykuar në mungesë të pjesëmarrësve në proces, pa pasur dijeni për gjykimin (shkronja ç"). Pavarësisht se në aspektin formal Kolegji

Civil e ka mbështetur vendimmarrjen në parashikimin e kësaj dispozite procedurale, ai nuk ka arsyetuar se përse riparimi i shkeljeve procedurale nga ana e gjykatës së apelit gjatë shqyrtimit të çështjes së themelit pas rivendosjes në afat të subjektit të interesuar nuk ishte e mjaftueshme, në kushtet kur ajo gjykatë nuk rezulton të ketë vënë në diskutim padijeninë e shoqërisë Alb-Italia për zhvillimin e gjykimit në gjykatën e shkallës së parë dhe pavlefshmërinë e njoftimeve, të ketë konstatuar me vendimin e rivendosjes në afat të gjykatës së apelit, duke i garantuar asaj pale të gjitha të drejtat procedurale që garanton procesi i drejtë, ku përfshihen parimi i barazisë së armëve dhe i kontradiktoritetit dhe e drejta e mbrojtjes. Thënë kjo, Kolegji Civil, pa dhënë ndonjë arsyetim, nuk ka konsideruar përfundimet e gjykatës së apelit dhe arsyetimin e saj se kthimi i çështjes në gjykatën e shkallës e parë do të zvarriste procesin tej afateve të arsyeshme për shkak se nga fillimi i atij gjykimi kishte kaluar një kohë shumë e gjatë, për më tepër që shoqëria është rivendosur në afat pas 6 vjetësh. Po kështu, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në pamundësi për ta dërguar vetë çështjen për rigjykim në shkallën e parë pasi ligji nuk e parashikon një kompetencë të tillë, ia ka lënë këtë detyrë gjykatës së apelit të rigjykimit.

26. Referuar kuadrit ligjor që përcakton kompetencat e Gjykatës së Lartë dhe në analizë të vendimit të Kolegjit Civil të asaj gjykate, në rastin konkret, Gjykata vlerëson se Kolegji Civil, duke vendosur kthimin e çështjes për rigjykim në gjykatën e apelit, por, në thelb, duke e detyruar atë gjykatë që ajo ta dërgojë çështjen për rigjykim në gjykatën e shkallës së parë, ka kapërcyer kompetencat e parashikuara nga neni 485 i KPC-së, sipas të cilit Gjykata e Lartë ose vendos mospranimin e rekursit kur ai është bërë për shkaqe të ndryshme nga ato që parashikohen në nenin 472 të KPC-së, ose, në të kundërt, vendos në një nga mënyrat e përcaktuara në shkronjat "b", "c", "d", "dh" ose "e" të nenit 485 të KPC-së për vendimet përfundimtare. Gjithashtu, me vendimmarrjen e tij, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, duke arritur në përfundimin se duhet prishur një vendim gjyqësor, i cili e ka zgjidhur çështjen në themel, pasi ka zhvilluar një proces gjyqësor në respektim të parimit të kontradiktoritetit, me praninë e palëve, të cilat kanë pasur mundësinë të paraqesin prova, të ngrenë pretendime dhe prapësime, të kundërshtojnë provat dhe pretendimet e palës tjetër, e ka kthyer rregullin garantues procedural në një mjet pengues për kërkuesen, si pala paditëse në atë gjykim, për të pasur një përgjigje përfundimtare me vendim të formës së prerë për themelin e çështjes së saj që, jo vetëm ka të bëjë me të drejtën e pronës, por, e ka zgjatur edhe tej çdo afati të arsyeshëm. Rrjedhimisht,

Gjykata vlerëson se nëpërmjet kësaj vendimmarrjeje Kolegji Civil ka disponuar përtej asaj që parashikon neni 485 i KPC-së, që përcakton mënyrat e disponimit të Gjykatës së Lartë, duke e bërë vendimin objekt ankimi të pambështetur në kompetencat e përcaktuara në ligj.

27. Bazuar në këto konsiderata, Gjykata ka arritur në konkluzionin se Gjykata e Lartë, duke paracaktuar vendimmarrjen e gjykatës së apelit, e cila qartazi ka vetëm mundësinë e kthimit të çështjes për shqyrtim në gjykatën e shkallës së parë, ka tejkaluar kompetencat e saj të përcaktuara në ligj. Në situatën që vendimi i Gjykatës së Lartë është produkt i një procesi jo të rregullt ligjor, për shkak të gjykimit të çështjes nga ajo gjykatë në kundërshtim me parimin e gjykatës së caktuar me ligj, kërkueses i cenohet edhe e drejta e pronës private, për rrjedhojë, pretendimi i saj për cenimin e *drejtës së pronës private* për shkak të cenimit të procesit të rregullt ligjor, në drejtim të *së drejtës për tu gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj*, është i bazuar.

28. Për sa më sipër, sipas Gjykatës, kjo mënyrë e të vepruarit të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë në rastin konkret, duke paracaktuar vendimmarrjen e gjykatës së apelit, duket se praktikisht asgjëson një shkallë gjykimi, duke e bërë ankimin në gjykatën e apelit një mjet jo efektiv, në cenim edhe të së drejtës së aksesit në gjykatë. Po kështu, kjo mënyrë disponimi duket se e ka bërë edhe të drejtën e mbrojtjes së kërkueses jo reale, por iluzive pasi, pavarësisht pretendimeve dhe prapësimeve të palëve gjatë rigjykimit në apel, gjykata e apelit është e detyruar të vendosë në një mënyrë të caktuar. Po kështu, duke mos e arsyetuar mjaftueshëm disponimin e saj, duket se vendimi i Gjykatës së Lartë është edhe në cenim të standardeve kushtetuese për arsyetimin e vendimit gjyqësor.

29. Gjykata, duke mbajtur në konsideratë se në zbatim të parimit të *subsidiaritetit* kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese është funksion edhe i Gjykatës së Lartë, çmon të mos ndalet në analizimin e pretendimeve të tjera të kërkueses që kanë të bëjnë me të drejtën e aksesit në gjykatë, të drejtën e mbrojtjes, standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor dhe të drejtën për gjykim brenda një afati të arsyeshëm, për sa kohë që çështja do të merret sërish në shqyrtim nga Gjykata e Lartë dhe kjo e fundit duhet t'u japë përgjigje të arsyetuar këtyre pretendimeve.

30. Në përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkueses për cenimin e së drejtës së pronës private në aspektin procedural janë të bazuara, sipas arsyetimit të mësipërm të këtij vendimi, ndaj kërkesa pranohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, si dhe neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me shumicë votash,

V E N D O S I:

1. Pranimin e kërkesës.

2. Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2023-1328 (173), datë 04.04.2024 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

3. Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 10.06.2025
Shpallur më 14.07.2025

MENDIM PAKICE

1. Në gjykimin kushtetues të çështjes që i përket kërkueses shoqëria "ERDA" sh.p.k., me objekt: "*Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2023-1328 (173), datë 04.04.2024 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe dërgimi i çështjes për rigjykim në të njëjtën gjykatë me tjetër trup gjykues",* jam kundër qëndrimit të shumicës për pranimin e kërkesës, pasi vlerësoj se kërkuesja nuk ka shteruar mjetet juridike në dispozicion. Në mbështetje të nenit 132, pika 3, të Kushtetutës dhe nenit 72, pika 8, të ligjit nr. 8577/2000, që parashikojnë publikimin e mendimit të pakicës së bashku me vendimin përfundimtar të Gjykatës, parashtroj në vijim argumentet që mbështesin qëndrimin kundër.

2. Çështja konkrete ka të bëjë me një mosmarrëveshje gjyqësore civile, me objekt mospërmbushjen e detyrimeve kontraktore midis dy shoqërive tregtare. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë në vitin 2003 ka vendosur pranimin e padisë së kërkueses, duke detyruar shoqërinë Alb-Italia t'i paguajë kërkueses shumën 24.814.800 lekë, nga të cilat 2.160.000 lekë detyrim kontraktor i pashlyer dhe 22.654.800 lekë kamatëvonesa. Gjykimi është zhvilluar në mungesë të shoqërisë Alb-Italia dhe vendimi ka marrë formë të prerë pa u ankimuar. Në vitin 2010 gjykata e apelit ka vendosur rivendosjen në afat të apelit të shoqërisë Alb-Italia, me arsyetimin se njoftimet e realizuara nga gjykata e shkallës së parë ishin të pavlefshme. Në vijim, gjykata e apelit ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të themelit të gjykatës së shkallës së parë. Mbi bazën e rekursit të shoqërisë Alb-Italia, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në shkallë të dytë, me arsyetimin se duheshin riparuar shkeljet procedurale të njoftimit të lejuara nga gjykata e shkallës së parë.

3. Në këto rrethana, kërkuesja ka paraqitur ankim kushtetues individual, me pretendimin se kthimi i çështjes për rigjykim i ka cenuar të drejtat e pronës dhe të procesit të rregullt ligjor (në aspektet e së drejtës së aksesit në gjykatë, asaj për t'u gjykuar nga një gjykatë e pavarur, e paanshme dhe e caktuar me ligj, asaj për t'u mbrojtur, standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor dhe së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm të lidhur me të drejtën për një mjet juridik efektiv dhe parimin e ekonomisë gjyqësore), të garantuara nga nenet 41 dhe 42 të Kushtetutës.

4. Në analizë të kritereve të legjitimimit, shumica ka arritur në përfundimin se kërkuesja ka shteruar mjetet juridike në dispozicion, duke evidentuar se vendimi i Gjykatës së Lartë, që ka kthyer çështjen për rigjykim, konsiderohet përfundimtar për qëllime të kontrollit kushtetues, pasi pretendimet e kërkueses kanë natyrë kushtetuese dhe se e drejta për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, që pretendohet se është shkelur nga Gjykata e Lartë, nuk mund të riparohet në rigjykimin e çështjes nga gjykatat e faktit (*shih paragrafët 12 dhe 13 të vendimit*).

5. Nuk pajtohem me këtë vlerësim të shumicës, pasi çmoj se vendimi objekt kundërshtimi nuk është vendim përfundimtar sipas nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës, as nga pikëpamja formale, as nga ajo substanciale. Kështu, në referim të kësaj dispozite kushtetuese, Gjykata vendos për gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve kundër çdo vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e këtyre të drejtave, përveçse kur parashikohet ndryshe në Kushtetutë.

6. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se mbrojtja kushtetuese ka një funksion *subsidiar*, që do të thotë se ajo mund të kërkohet vetëm për një vendim përfundimtar, të çfarëdolloj forme që përmbyll procesin gjyqësor, pasi individi ka shteruar mjetet dhe rrugët e tjera ligjore. Cenimi i të drejtave themelore, përfshirë atë për proces të rregullt ligjor, mund të pretendohet në këtë Gjykatë vetëm pasi të shterohen të gjitha mundësitë e ofruara nga sistemi i apelimeve dhe kjo vlen edhe në rastet kur procedurat gjyqësore paraprake çojnë në një rëndim të mëtejshëm ose në tejzgjatjen e cenimit të kësaj të drejte (*shih vendimet nr. 29, datë 16.04.2024; nr. 25, datë 13.10.2022; nr. 14, datë 11.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

7. Mbi bazën e këtij standardi, kolegjet e Gjykatës dhe Mbledhja e Gjyqtarëve kanë një praktikë konstante të zhvilluar ndër vite, sipas së cilës kërkesa të tilla nuk janë kaluar për shqyrtim në seancë plenare, me arsyetimin uniform se vendimi gjyqësor, me të cilin është vendosur kthimi i çështjes për rigjykim, nuk është përfundimtar për qëllime të kontrollit kushtetues. Sikurse shumica ka referuar në vendim, Gjykata në jurisprudencën e saj e ka kontrolluar vetëm një herë një vendim të tillë, pa përfunduar gjykimi i themelit të çështjes, përjashtim i cili lidhej me parimin e sigurisë juridike, në kushtet kur gjykatat e zakonshme kishin marrë në shqyrtim një ankim të paraqitur dukshëm jashtë afatit ligjor (*shih vendimin nr. 59, datë 14.11.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

8. Në këtë situatë, vlerësoj, *së pari*, se nga pikëpamja formale në rastin konkret vendimi i Gjykatës së Lartë që ka kthyer çështjen për rigjykim nuk është përfundimtar për qëllime të kontrollit kushtetues dhe nuk përbën as rast përjashtimor, sipas kuptimit që i ka dhënë Gjykata në jurisprudencën e saj. Duke vepruar në këtë mënyrë, shumica nuk i është përmbajtur kufirit që duhet të ekzistojë midis juridiksionit kushtetues dhe atij gjyqësor të zakonshëm dhe as parimit të subsidiaritetit që përshkon raportin midis gjykatave të zakonshme dhe vetë Gjykatës, duke e kthyer këtë të fundit në zgjatim të sistemit gjyqësor ose thënë ndryshe në gjykatë të shkallës së katërt që dikton ecurinë ligjore të procesit gjyqësor të zakonshëm.

9. *Së dyti*, vlerësoj se edhe nga pikëpamja substanciale nuk qëndrojnë argumentet e paraqitura nga shumica për kontrollin kushtetues të vendimit të Gjykatës së Lartë që ka kthyer çështjen për rigjykim. Në këtë drejtim, shumica, në mënyrë të përmbledhur, ka evidentuar dy argumente, që përligjin kontrollin kushtetues, ndonëse çështja gjyqësore nuk kishte përfunduar në gjykatat e zakonshme: (i) Gjykata e Lartë nuk ka respektuar parimin e gjykatës së caktuar me ligj; (ii) vendimi i Gjykatës së Lartë për kthimin e çështjes për rigjykim sjell pasoja në të drejtën e pronës së kërkueses, pasi ajo duhet të kthejë shumën e parave nga ekzekutimi i vendimit.

10. Lidhur me parimin e gjykatës së caktuar me ligj, Gjykata e Lartë në vendimin e saj ka analizuar rrethanat faktike të përcaktuara nga gjykatat e faktit, duke vënë në dukje se me vendimin gjyqësor të rivendosjes në afat, i cili nuk është ankimuar nga asnjë prej palëve, është vërtetuar pavlefshmëria e njoftimeve në gjykimin në shkallë të parë. Në këtë kontekst faktik, Gjykata e Lartë ka referuar në vendimin e saj nenin 467 të KPC-së, sipas të cilit gjykata e apelit prish vendimin e gjykatës së shkallës së parë dhe e dërgon çështjen për rigjykim kur çështja është gjykuar në mungesë të pjesëmarrësve në proces, pa pasur dijeni për gjykimin (shkronja ç"). Me fjalë të tjera, Gjykata e Lartë ka evidentuar se në kushtet kur gjykimi në shkallë të parë ishte i pavlefshëm, nuk mund të zhvillohej gjykim themeli në shkallë të dytë, por duhej zhvilluar gjykimi nga e para. Në këtë mënyrë, në ndryshim nga shumica, vlerësoj se Gjykata e Lartë ka vepruar si gjykatë ligji dhe nuk ka tejkaluar kompetencat e saj ligjore, ndaj ky argument i shumicës nuk përligj krijimin e një precedenti të ri për rastet përjashtimore të kontrollit kushtetues të vendimeve gjyqësore që kthejnë çështjen për rigjykim.

11. Lidhur me pasojën e pretenduar nga kërkuesja për të drejtën e pronës, e cila, sipas shumicës, justifikon shqyrtimin e çështjes në nivel kushtetues,

jam e mendimit se nuk përbën argument të përshtatshëm kushtetues në rastin konkret. E drejta e pronës është pikërisht objekti i mosmarrëveshjes gjyqësore midis dy shoqërive tregtare që po gjykohet nga gjykatat e zakonshme, ndaj se kujt i përket kjo e drejtë midis dy personave juridikë privatë mbetet për t'u përcaktuar gjyqësisht nga gjykatat e zakonshme. Pikërisht për këtë arsye, Gjykata në jurisprudencën e saj ka pohuar se cenimi i të drejtave themelore mund të pretendohet në këtë Gjykatë vetëm pasi të shterohen të gjitha mundësitë e ofruara nga sistemi i apelimeve dhe kjo vlen edhe në rastet kur procedurat gjyqësore paraprake çojnë në një rëndim të mëtejshëm ose në tejzgjatjen e cenimit të kësaj të drejte (*shih vendimet nr. 29, datë 16.04.2024; nr. 25, datë 13.10.2022; nr. 14, datë 11.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Në konkluzion, vlerësoj se vendimi gjyqësor objekt ankimi kushtetues nuk është përfundimtar dhe as rast përjashtimor sipas jurisprudencës së Gjykatës që të mund të justifikojë shqyrtimin e tij në nivel kushtetues. Për më tepër, ai nuk duket se ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë në të drejtën substanciale të pronës, të pretenduar nga shumica se justifikon shqyrtimin kushtetues të atij vendimi. Për rrjedhojë, shqyrtimi i ankimit kushtetues individual nuk duhet të tejkalonte kriteret paraprake për shqyrtimin e çështjes në seancë plenare, në drejtim të kriterit të shterimit të mjeteve juridike efektive, prandaj kërkesa duhet të rrëzohej.

Anëtare: Marsida Xhaferllari

Vendim nr. 39, datë 17.06.2025
(V-39/25)

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Holta Zaçaj, Kryetare, Marsida Xhaferllari, Fiona Papajorgji, Sonila Bejtja, Sandër Beci, Ilir Toska, Genti Ibrahimi, Marjana Semini, anëtarë, me sekretare Belma Lleshi, në datën 17.06.2025 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 30 (E) 2024 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: **ESAT ÇOJI**, përfaqësuar nga avokat Endri Kotherja, me prokurë të posaçme.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E SHËRBIMEVE TË TRANSPORTIT RRUGOR, përfaqësuar nga drejtori i Përgjithshëm, Ilir Mëngra.

DREJTORIA RAJONALE E SHËRBIMEVE TË TRANSPORTIT RRUGOR ELBASAN, përfaqësuar nga drejtori, Irland Sina.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2024-3472 (209), datë 13.05.2024 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**
Dërgimi i çështjes për shqyrtim në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: **Nenet 4, 17, pika 2, 18, pika 1, 33, pika 1, 41, pikat 1 dhe 2, 42, 131, pika 1, shkronja "f", 134, pika 1, shkronja "i" dhe 142, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 6 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe neni 1 i Protokollit nr. 1 të saj *(KEDNJ)*; neni 27 i**

ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

GJYKATA KUSHTETUESE

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Marjana Semini, mori në shqyrtim parashtrimet me shkrim të Esat Çoji (*kërkuesi*), i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjekteve të interesuara, Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor *(DPSHTRR)* dhe Drejtorisë Rajonale të Shërbimeve të Transportit Rrugor *(DRSHTRR)* Elbasan, të cilat kanë kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I
Rrethanat e çështjes

1. Me urdhrin e datës 31.07.2006 të drejtorit të përgjithshëm të DPSHTRR-së, kërkuesi është emëruar inspektor në Sektorin e Kontrollit të Transportit Rrugor pranë DRSHTRR-së, Elbasan, akt i formalizuar me kontratën e punës të datës 18.11.2009 me kohëzgjatje të pacaktuar. Me vendimin nr. 188, datë 02.12.2013 të DPSHTRR-së *(vendimi nr. 188/2013)* është vendosur ndërprerja e marrëdhënieve të punës së kërkuesit, për shkak të riorganizimit të drejtorisë, me qëllim rritjen e performancës së institucionit, duke iu njohur e drejta e përfitimit të shpërblimit për vjetërsi në punë dhe e drejta e përfitimit të pagave për lejet vjetore të pakryera. Pas vendimit nr. 188/2013, atij i është dhënë leja vjetore takuese, si dhe i është paguar edhe shpërblimi për vjetërsi në punë.

2. Kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës me kërkesëpadi kundrejt DPSHTRR-së dhe DRSHTRR-së, Elbasan, duke kërkuar kthimin në vendin e mëparshëm të punës, si dhe pagimin e pagës për kohën e qëndrimit pa punë padrejtësisht deri në ekzekutimin e vendimit të gjykatës. Me vendimin nr. 690, datë 22.05.2014, kjo gjykatë ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë, si të pabazuar në ligj dhe prova. Kundër këtij vendimi kërkuesi ka paraqitur ankim.

3. Gjykata Administrative e Apelit, në dhomën e këshillimit, me

vendimin nr. 676, datë 25.03.2016, ka ndryshuar vendimin e gjykatës së shkallës së parë dhe ka pranuar pjesërisht padinë, duke vendosur detyrimin e DPSHTRR-së të dëmshpërblejë kërkuesin me 12 paga mujore, sipas nenit 155, pika 3, të Kodit të Punës, për zgjidhje të menjëhershme dhe të pajustifikuar të kontratës së punës, si dhe me pagesën që i korrespondon periudhës së pushimeve vjetore të kryera brenda periudhës 02.12.2013 - 03.03.2014, ndërsa ka rrëzuar padinë për kërkimet e tjera. Kundër këtij vendimi, për pjesën e pranuar të padisë, të padituri në proces kanë ushtruar rekurs të përbashkët.

4. Me vendimin nr. 00-2022-2649, datë 03.11.2022, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, ka vendosur prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë.

5. Në datën 23.02.2023 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me kërkesë për shfuqizimin e vendimit të Gjykatës së Lartë dhe dërgimin e çështjes për shqyrtim po në atë gjykatë. Me vendimin nr. 55, datë 07.11.2023 *(vendimi nr. 55/2023)*, Gjykata ka vendosur pranimin e kërkesës, shfuqizimin e vendimit të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë, duke vlerësuar se zgjerimi i kufijve të shqyrtimit të çështjes dhe të juridiksionit nga Gjykata e Lartë, i shoqëruar me mungesën e arsyetimit në këtë drejtim, si dhe mosdhënia mundësi kërkuesit për të parashtruar mendimin e tij për një çështje ligjore që ka rezultuar thelbësore për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, i ka cenuar atij të drejtën për proces të rregullt ligjor në drejtim të së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, së drejtës për t'u mbrojtur dhe dëgjuar, si dhe standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, në kushtet e mosparashtrimit të arsyeve për këto aspekte ligjore të procesit të zhvilluar nga ajo dhe mungesës së koherencës së vendimit.

6. Në rigjykim, me vendimin nr. 00-2024-3472 (209), datë 13.05.2024, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur sërish prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë.

7. Në datën 15.11.2024 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual, sipas objektit, duke kërkuar shfuqizimin si antikushtetues të vendimit të Gjykatës së Lartë të marrë në rigjykimin e çështjes, pas kthimit të saj me vendimin nr. 55/2023. Në datën 22.01.2025 Kolegji i Gjykatës ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve, ndërsa kjo e fundit në datën 04.02.2025 ka

vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II
Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

8. ***Kërkuesi***, në mënyrë të përmbledhur, ka parashtruar se i janë cenuar:

8.1. *E drejta për proces të rregullt ligjor*, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të:

8.1.1. *Së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj*, pasi në kundërshtim me nenet 58, shkronja "a" dhe 63, shkronjat "a" dhe "dh", të ligjit nr. 49/2012, datë 03.05.2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", të ndryshuar *(ligji nr. 49/2012)* dhe nenin 473/a të Kodit të Procedurës Civile *(KPC)*, Gjykata e Lartë e ka shqyrtuar çështjen tej shkaqeve të rekursit. Në rekurs të paditurit kanë paraqitur pretendime vetëm për zbatimin e ligjit material (Kodit të Punës) dhe nuk kanë ngritur pretendime për moszbatim të ligjit procedural, çka ka bërë që këto kërkime të bien në dekadencë. Po kështu, ata nuk kanë paraqitur pretendime për ligjin nr. 152/2013, datë 30.05.2013 "Për nëpunësin civil", por kanë kërkuar zgjidhjen e çështjes sipas Kodit të Punës, i cili edhe është zbatuar nga gjykatat e faktit. Rekursi nuk kalonte testin e pranueshmërisë për trajtim, sipas nenit 58, shkronja "a", të ligjit nr. 49/2012, pasi në të nuk ishin paraqitur argumente bindëse ndaj vendimit të gjykatës së apelit lidhur me shkakun e ristrukturimit.

8.1.2. *Së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme*, pasi, në tejkalim të shkaqeve të rekursit, Gjykata e Lartë ka zgjidhur çështjen në favor të palës së paditur.

8.1.3. *Parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit*, pasi Gjykata e Lartë nuk ka vlerësuar pretendimet e parashtruara nga të paditurit për zbatimin e dispozitave të Kodit të Punës e pasojat e zgjidhjes së marrëdhënies së punës.

8.1.4. *Parimit të sigurisë juridike,* pasi Gjykata e Lartë nuk ka respektuar vendimin nr. 55/2023 të Gjykatës, i cili kishte efekt detyrues dhe krijonte pritshmëri të ligjshme për kërkuesin. Po kështu, ajo nuk ka zbatuar jurisprudencën e Kolegjeve të

Bashkuara të saj, të cilat u kanë atribuar gjykatave të faktit përcaktimin e legjislacionit të zbatueshëm dhe zgjidhjen e çështjes referuar këtij legjislacioni, e KPC-në, duke dhënë një vendim në kundërshtim me to.

8.1.5. *Standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor*, pasi edhe pse i ka pasqyruar në vendim, Gjykata e Lartë nuk ka analizuar pretendimet e paraqitura në rekurs nga të padituri. Shkaqet e rekursit janë përsëritje e pretendimeve të paraqitura në gjykatat e faktit. Vendimi është kontradiktor dhe i mungojnë analiza juridiko-ligjore e arsyetimi. Në dispozitiv nuk është përcaktuar shkronja konkrete e shkelur e nenit 58 të ligjit nr. 49/2012 që mundësonte pranimin për shqyrtim të rekursit të të paditurve.

8.2. *Parimi i barazisë përpara ligjit*, pasi është vënë në kushte pabarazie me palën e paditur, e cila, edhe pse në mungesë, është mbrojtur në interesat e saj nga Gjykata e Lartë gjatë debatit gjyqësor, përmes zgjerimit të hetimit gjyqësor tej kufijve të rekursit, duke hetuar lidhur me zbatimin e ligjit procedural kur pretendimet e ngritura në rekurs nga të paditurit kishin të bënin vetëm me ligjin material.

8.3. *Standardi i zbatimit të detyrueshëm të vendimeve të Gjykatës,* i garantuar nga neni 132 i Kushtetutës, pasi Gjykata e Lartë nuk ka reflektuar shkeljet e konstatuara në vendimin nr. 55/2023 të Gjykatës. Ajo e ka gjykuar çështjen në të njëjtën linjë arsyetimi me vendimin e saj të mëparshëm të shfuqizuar nga Gjykata, duke zgjeruar sërish hetimin gjyqësor tej kufijve të rekursit, pa përcaktuar dispozitën procedurale që parashikon këtë të drejtë.

8.4. *E drejta e pronës*, pasi Gjykata e Lartë i ka mohuar vlerat financiare të pagës që duhej të përfitonte si rrjedhojë e largimit të padrejtë nga puna.

8.5. *E drejta për të fituar mjetet e jetesës me punë të ligjshme*, e garantuar nga neni 49 i Kushtetutës dhe *e drejta për sigurime shoqërore*, e garantuar nga neni 52 i Kushtetutës, si rrjedhojë e vendimmarrjeve të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës dhe Gjykatës së Lartë.

9. ***Subjektet e interesuara, DPSHTRR-ja dhe DRSHTRR-ja, Elbasan,*** kanë prapësuar:

9.1. Pretendimet për cenimin e *parimit të sigurisë juridike*, si rrjedhojë e shqyrtimit nga Gjykata e Lartë të një vendimi që është ekzekutuar,

janë të pabazuara, pasi neni 58 i ligjit nr. 49/2012 nuk kufizon marrjen në shqyrtim të rekursit me ekzekutimin ose jo të vendimit. Kjo është sjellë në vëmendje të kërkuesit edhe në vendimin nr. 55/2023 të Gjykatës, në drejtim të dallimit që ekziston mes një vendimi të formës së prerë, në kuptim të fuqisë së tij ekzekutive, dhe një vendimi përfundimtar me fuqinë e gjësë së gjykuar, që zgjidh në themel çështjen.

9.2. Pretendimet për cenimin e *standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor* nuk qëndrojnë, pasi vendimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë përmban analizë të plotë juridiko-ligjore dhe është logjik e i qartë në përmbajtje. Ai përmban të dhënat e kërkuesit, vendimmarrjet e gjykatave të ulëta, shkaqet e ngritura në ankim e rekurs, ligjin e zbatueshëm, pjesën arsyetuese ku mbështet qëndrimin e shprehur në dizpozitiv dhe nuk lë hapësira për keqinterpretime ose paqartësi, duke përmbushur kështu standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor.

9.3. Edhe pretendimet e kërkuesit për cenimin e *parimit të barazisë përpara ligjit* dhe *paanësisë së gjykatës*, si rrjedhojë e shqyrtimit të rekursit tej shkaqeve të përcaktuara në të, janë të pabazuara.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkuesit

10. Çështja e legjitimimit (*locus standi*) si një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

11. Kërkuesi, si individ, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të shkronjës "f" të pikës 1 të nenit 131 dhe shkronjës "i" të pikës 1 të nenit

134 të Kushtetutës, pasi është palë në çështjen objekt ankimi kushtetues individual, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të këtij gjykimi.

12. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës, Gjykata evidenton se pretendimi i kërkuesit për cenimin e së drejtës për sigurime shoqërore është parashtruar për herë të parë në ankimin kushtetues individual. Në kushtet kur ky pretendim nuk i është nënshtruar më parë vlerësimit nga gjykatat e zakonshme, Gjykata çmon se në lidhje me të kërkuesi nuk ka shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion përpara se t'i drejtohet Gjykatës. Ndërsa për sa u përket pretendimeve të tjera, të parashtruara në formë dhe substancë përpara gjykatave të zakonshme, vlerëson se ai nuk ka mjete të tjera juridike në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të tij kushtetuese përveç ankimit kushtetues individual.

13. Kërkuesi legjitimohet edhe *ratione temporis*, në kuptim të përmbajtjes së nenit 71/a, pika 1, shkronja "b", të ligjit nr. 8577/2000, pasi vendimi i kundërshtuar, ai i Gjykatës së Lartë, i cili mban datën 13.05.2024, sipas informacionit të kësaj gjykate të vënë në dispozicion të kërkuesit, është publikuar në faqen e saj zyrtare më 13.09.2024, ndërsa kërkesa është dërguar në Gjykatë në datën 15.11.2024, pra brenda afatit 4-mujor.

14. Në lidhje me legjitimimin *ratione materiae* kërkuesi ka pretenduar cenimin e *parimit të barazisë përpara ligjit*, *së drejtës së pronës*, *së drejtës për proces të rregullt në disa aspekte (e drejta për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme dhe e caktuar me ligj, parimi i barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit, parimi i sigurisë juridike, standardi i arsyetimit të vendimit gjyqësor*), *së drejtës për të fituar mjetet e jetesës me punë të ligjshme* dhe *standardit të zbatimit të detyrueshëm të vendimeve të Gjykatës*, të garantuara nga nenet 18, 41, 42, 49 dhe 132 të Kushtetutës. Nisur nga thelbi i argumenteve të kërkuesit, të cilat parashtrohen në kuadër të shqyrtimit të rekursit të palëve të paditura tej shkaqeve të tij, si dhe duke pasur parasysh faktin se, bazuar në vendimin nr. 55/2023, çështja është shqyrtuar për herë të dytë nga Gjykata e Lartë, Gjykata çmon që pretendimet e kërkuesit t'i analizojë në vijim në drejtim të së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj të lidhur me standardin e zbatimit të detyrueshëm të vendimeve të Gjykatës dhe standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj të lidhur me standardin e zbatimit të detyrueshëm të vendimeve të Gjykatës dhe standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor

15. Kërkuesi ka pretenduar se Gjykata e Lartë nuk ka respektuar vendimin nr. 55/2023 të Gjykatës, duke gjykuar sërish çështjen jashtë shkaqeve të rekursit, me të njëjtën linjë arsyetimi si në vendimin e mëparshëm të saj, të shfuqizuar nga Gjykata. Sipas tij, në rekurs të paditurit kanë ngritur pretendime për zbatimin e ligjit material (Kodit të Punës), pa paraqitur asnjë shkak për moszbatimin e ligjit procedural. Ata nuk kanë paraqitur pretendime për ligjin nr. 152/2013, por kanë kërkuar zgjidhjen e çështjes sipas Kodit të Punës. Shkaqet e rekursit janë përsëritje e pretendimeve të paraqitura në gjykatat e faktit dhe argumentet për shkakun e ristrukturimit nuk janë bindëse. Edhe pse i ka pasqyruar në vendim, Gjykata e Lartë nuk ka analizuar pretendimet e paraqitura në rekurs nga të paditurit. Në dispozitivin e vendimit të saj nuk është përcaktuar shkronja konkrete e shkelur e nenit 58 të ligjit nr. 49/2012.

16. Subjektet e interesuara, DPSHTRR-ja dhe DRSHTRR-ja, Elbasan, kanë prapësuar se, në kundërshtim nga sa kërkuesi pretendon, shqyrtimi i rekursit të tyre është bërë nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë brenda shkaqeve të tij.

17. E drejta për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, si element i procesit të rregullt ligjor, sipas nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së, në sensin material karakterizohet nga funksioni i saj gjyqësor, që ka të bëjë me zgjidhjen e çështjeve nga organe të ngarkuara me ligj për të dhënë drejtësi. Përveç këtij kushti, këto organe duhet të shqyrtojnë dhe të vendosin për çështje që janë në kompetencë të tyre gjatë një procesi të zhvilluar për një procedurë ligjërisht të përcaktuar dhe në pajtim me rendin juridik. E drejta e çdo pale për t'u dëgjuar në seancë përpara një gjykate kompetente dhe të caktuar me ligj nënkupton që gjykata të ketë juridiksion për të gjykuar çështjen dhe që kompetenca për të vendosur për të t'i jetë njohur nëpërmjet ligjit (*shih vendimet nr. 55, datë 07.11.2023; nr. 7, datë 23.02.2021; nr. 27, datë 24.06.2013 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata ka pohuar se interpretimi i dispozitave që lidhen me procedurën e shqyrtimit të rekurseve është detyrë funksionale e Gjykatës së Lartë, megjithatë ky interpretim i nënshtrohet kontrollit kushtetuese kur vihet në diskutim parimi i gjykatës së caktuar me ligj, në kuptimin që Gjykata analizon nëse Gjykata e Lartë u është përmbajtur kompetencave të saj të

dhëna nga ligji. Sipas saj, pavarësisht sistemit me tre nivele të ushtrimit të pushtetit gjyqësor, ligji procedural civil ka përcaktuar kufijtë e juridiksionit, pra të kompetencës për secilin nivel juridiksioni, ku për sa i përket Gjykatës së Lartë, Kushtetuta dhe ligji, në vijim, kanë përcaktuar një juridiksion të kufizuar, ngushtësisht ligjor, duke pasur ajo kompetencë të korrigjojë vendimet e gjykatave më të ulëta për aspekte të ligjit, por jo të faktit *(shih vendimin nr. 14, datë 25.03.2025 të Gjykatës Kushtetuese)*.

18. Po kështu, nenet 124 dhe 132 të Kushtetutës shprehen qartësisht në lidhje me forcën detyruese që vendimet e Gjykatës kanë mbi të gjitha organet kushtetuese, autoritetet publike, duke përfshirë edhe gjykatat. Gjykata ka theksuar se zbatimi i vendimeve të saj është detyrim kushtetues. Ato kanë fuqi detyruese të përgjithshme dhe janë përfundimtare. Si të tilla, përbëjnë jurisprudencë kushtetuese, për rrjedhojë kanë efektet e forcës së ligjit. Ky efekt detyrues ka të bëjë si me pjesën urdhëruese, ashtu edhe me pjesën arsyetuese të vendimit. Efekti detyrues shtrihet tek argumentet thelbësore të vendimit, që përbëjnë edhe *ratio decidendi,* eliminimi i të cilave do ta bënte vendimin, në tërësinë e tij, të pakuptimtë *(shih vendimet nr. 30, datë 18.04.2024; nr. 66, datë 06.12.2023; nr. 49, datë 03.07.2017 të Gjykatës Kushtetuese)*.

19. Në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se respektimi i të drejtave kushtetuese është funksion edhe i gjykatave të zakonshme, për më tepër i Gjykatës së Lartë, e cila i ka të gjitha mjetet dhe kompetencat për të kryer një rol që shkon përtej ligjit dhe synon të drejtën (*shih vendimet nr. 10, datë 04.03.2021; nr. 3, datë 23.02.2016 të Gjykatës Kushtetuese)*, ndërsa detyra e Gjykatës është të shqyrtojë dhe të vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës *(shih vendimet nr. 25, datë 23.04.2025; nr. 50, datë 20.06.2024 të Gjykatës Kushtetuese)*.

20. Nën dritën e standardeve të mësipërme, për qëllime të vlerësimit të pretendimeve të parashtruara nga kërkuesi, Gjykata do të analizojë në vijim nëse në rigjykimin e çështjes, pas kthimit të saj nga kjo Gjykatë, Gjykata e Lartë ka korrigjuar shkeljet e konstatuara në vendimin nr. 55/2023.

21. Në çështjen në shqyrtim, Gjykata evidenton se në rekurs të paditurit kanë parashtruar zbatimin e gabuar të ligjit material nga gjykata e apelit, me argumentin se në zgjidhjen e marrëdhënies së punës janë respektuar dispozitat e Kodit të Punës lidhur me afatet e njoftimit dhe procedurën

dhe se ndërprerja e saj nuk është bërë në mënyrë të menjëhershme dhe të pajustifikuar, por në përfundim të afatit të njoftimit.

22. Me vendimin nr. 00-2022-2649, datë 03.11.2022, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka prishur vendimin e gjykatës së apelit, duke lënë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë, me të cilin padia e kërkuesit është rrëzuar në tërësi, duke vlerësuar se rekursi përmbante shkaqe nga ato të parashikuara nga neni 58 i ligjit nr. 49/2012, të cilat, nga njëra anë, bënin të cenueshëm vendimin e gjykatës së apelit dhe, nga ana tjetër, çonin në lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, por me arsyetimin e duhur. Kolegji Administrativ e ka gjetur të drejtë e të bazuar në ligj përfundimin e gjykatës së shkallës së parë se marrëdhënia e punësimit mes palëve nuk ishte marrëdhënie administrative e Shërbimit Civil dhe se paditësi nuk gëzonte statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013, por vetëm mbi këtë premisë vlerësimi nuk mund të rrëzohej padia e tij. Edhe pse gjykata e apelit ka mbajtur të njëjtin qëndrim, ajo ka vijuar gjykimin dhe e ka zgjidhur mosmarrëveshjen bazuar në një shkak tjetër ligjor, të papretenduar nga paditësi (kërkuesi), duke vepruar *ultra petita partium*, ndërsa është shprehur tej kërkimeve në padi dhe në objektin e ankimit, ndërkohë që referimi i bërë nga gjykata e apelit në vendimin nr. 190/2014 të Gjykatës së Lartë dhe vendimin unifikues nr. 7/2011, nuk është një zbatim i duhur i këtyre vendimeve.

23. Në vendimin e saj nr. 55/2023 Gjykata i ka vlerësuar të bazuara pretendimet e kërkuesit për cenimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj dhe së drejtës për t'u mbrojtur e dëgjuar të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor, me arsyetimin se Gjykata e Lartë: (i) nuk e ka shqyrtuar çështjen brenda shkaqeve të parashtruara në rekursin e palës së paditur, sikurse përcakton neni 473/a, paragrafi i parë, i KPC-së, i zbatueshëm edhe në çështje administrative, pa arsyetuar se përse ishte përpara rastit përjashtimor që lejon zgjerimin e shqyrtimit të çështjes përtej shkaqeve të rekursit; (ii) nuk i ka kërkuar kërkuesit të shprehej paraprakisht për çështjen e vënë në diskutim kryesisht prej saj dhe për të cilën ka zgjeruar shqyrtimin e çështjes përtej kufijve të rekursit, pikërisht për atë nëse ai përmes padisë së tij ka kërkuar edhe zgjidhjen e atyre pasojave, nga ndërprerja e marrëdhënieve të punës, për të cilat gjykata e apelit ka disponuar në favor të tij, pa arsyetuar se përse marrja e mendimit të kërkuesit nuk ka qenë e detyrueshme, pra se nuk gjente zbatim neni 473/a, paragrafi i dytë, i KPC-së; (iii) vendimi nuk përmbushte mjaftueshëm standardet e arsyetimit të vendimit gjyqësor, pasi: *a)* nuk ishte konsistent dhe i mungonte

koherenca në drejtim të respektimit të parimit *ultra petita partium* kur, nga njëra anë, Gjykata e Lartë shprehej për detyrimin e gjykatës së apelit për të mos u shprehur tej kërkimeve në padi e në objektin e ankimit të palës/palëve, ndërsa, nga ana tjetër, ka zgjidhur mosmarrëveshjen mes palëve për pretendime që nuk ishin ngritur në rekursin e palës së paditur, si dhe në drejtim të mospërputhjes së argumenteve të parashtruara në pjesën arsyetuese me disponimin përfundimtar në rrethanat, ku, nga njëra anë, ka pohuar se arsyetimi i vendimit të gjykatës së shkallës së parë nuk ishte ai i duhuri e argumenti i përdorur prej saj nuk ishte i mjaftueshëm për rrëzimin e padisë së kërkuesit, ndërsa, nga ana tjetër, ka vendosur lënien në fuqi të atij vendimi, duke marrë përsipër të plotësojë arsyetimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë, por se argumenti shtesë i përdorur është i natyrës procedurale dhe nuk kishte të bënte kurrsesi me bazueshmërinë në themel të padisë; *(b)* kishte mungesë arsyetimi për sa shprehej se referimi i bërë nga gjykata e apelit në vendimin nr. 190/2014 të Gjykatës së Lartë dhe në vendimin unifikues nr. 7/2011 nuk është një zbatim i duhur i këtyre vendimeve, duke anashkaluar të tregonte arsyet se përse gjykata e apelit kishte gabuar në përfundimin e arritur mbi bazën e kësaj praktike gjyqësore.

24. Në zbatim të vendimit të Gjykatës, çështja është rigjykuar nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë në seancë gjyqësore, në prani të palëve. Edhe pse nga aktet gjyqësore për shqyrtimin e çështjes nga Gjykata e Lartë nuk rezulton që kërkuesit t'i jetë kërkuar paraprakisht dhe specifikisht të shprehet për ndonjë çështje të ligjit të vënë në diskutim kryesisht prej saj, Gjykata vëren se gjatë shqyrtimit të çështjes në seancë gjyqësore publike, atij i është dhënë mundësia të paraqesë qëndrimin e vet edhe për atë çështje, të cilën Gjykata e Lartë në vijim e ka trajtuar kryesisht si çështje ligjore. Në këtë kuptim, në përputhje me përcaktimet e nenit 473/a, paragrafi i dytë, të KPC-së, kërkuesit i është siguruar e drejta për të dhënë sqarime nëse përmes padisë ka kërkuar ose jo dëmshpërblim për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës. Ndaj, në këtë këndvështrim, Gjykata çmon se shkelja e konstatuar sipas vendimit nr. 55/2023 të saj, për mosdhënien mundësi kërkuesit për t'u shprehur për çështjet ligjore dhe mosmarrjen paraprakisht të mendimit të palëve, në zbatim të nenit 473/a, paragrafi i dytë, të KPC-së (i), duket se është korrigjuar në rigjykimin e çështjes nga Gjykata e Lartë.

25. Për sa i përket zgjidhjes në themel të çështjes, Gjykata e Lartë edhe në rigjykimin e saj ka vendosur sërish prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë. Edhe në

këtë rast, njëlloj si edhe në vendimin e shfuqizuar të saj, Gjykata e Lartë ka arsyetuar se Gjykata Administrative e Apelit ka zgjidhur mosmarrëveshjen, bazuar në një shkak tjetër ligjor (sipas Kodit të Punës), që rezultonte i pa(kërkuar)/pretenduar nga paditësi (kërkuesi). Sipas saj, në kushtet kur në gjykimin në shkallë të parë kërkuesi nuk kishte kërkuar ndryshimin e shkakut ligjor e objektit të padisë dhe në ankim nuk kishte parashtruar pretendime që lidheshin me moszbatimin nga gjykata e shkallës së parë të dispozitave të Kodit të Punës (neneve 141, 143, 144, 145 dhe 155), një kërkim i tillë prezumohej se kishte rënë në dekadencë, sipas nenit 459 të KPC-së, edhe në rast se pranohej se ishte ngritur prej tij në formën e shpjegimeve gjatë gjykimit në shkallë të parë dhe jo përmes mjetit të duhur procedural të parashikuar nga neni 185 i KPC-së. Po sipas Gjykatës së Lartë, me qëllim garantimin e parimit të disponibilitetit, gjykata e apelit duhej të kishte mbajtur parasysh se pretendimet e kërkuesit në ankim parashtroheshin në kuadër të zbatimit të ligjit nr. 152/2013 dhe se nisur nga natyra e dëmshpërblimeve, sipas Kodit të Punës, ato nuk mund të njiheshin tej kërkimeve të kërkuesit. Ndërsa kishte arsyetuar se kërkuesi nuk gëzonte statusin e nëpunësit civil dhe marrëdhënia e punës rregullohej nga Kodi i Punës, gjykata e apelit kishte vendosur zbatimin e neneve 143, 144, 153 dhe 155 të këtij kodi pa qenë ngritur në ankim pretendime për moszbatimin nga gjykata e shkallës së parë të dispozitave të tij. Në këto kushte, vendimi i saj, që i njihte kërkuesit shpërblime sipas Kodit të Punës, ishte në linjë të gabuar arsyetimi dhe nuk përputhej me parashikimet e ligjit material dhe procedural, ndërsa vendimi i gjykatës së shkallës së parë që kishte vendosur për rrëzimin e kërkesëpadisë, pasi kërkimet nuk ishin sipas këtij kodi, ishte në përcaktim të drejtë të marrëdhënies juridike në konflikt *(shih faqet 10-13 dhe 16 të vendimit nr. 00-2024-3472 (209), datë 13.05.2024 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë)*.

26. Nisur nga sa më lart, Gjykata vëren se Gjykata e Lartë sërish ka zgjeruar kufijtë e shqyrtimit të çështjes, ndërsa nuk e ka shqyrtuar atë brenda shkaqeve të rekursit të palës së paditur. Për këtë ajo gjykatë ka arsyetuar se në Republikën e Shqipërisë sistemi i kontrollit gjyqësor garantohet në formën e kontrollit trishkallësh, ku secila hallkë e pushtetit gjyqësor gëzon juridiksionin gjyqësor brenda kufizimeve të parashikuara me ligj. Gjykata e Lartë, vijon ajo, ka kompetenca rishikuese dhe sipas nenit 141 të Kushtetutës ajo shqyrton çështje lidhur me kuptimin dhe zbatimin e ligjit, për të siguruar njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore sipas ligjit. Po sipas saj, neni 63 i ligjit nr. 49/2012, i cili sanksionon parimin e

taksativitetit të vendimmarrjes së Gjykatës së Lartë, ka parashikuar llojet e vendimmarrjeve të Kolegjit Administrativ, duke gëzuar ai autoritetin për ndryshimin e vendimeve të gjykatave administrative më të ulëta dhe zgjidhjen e çështjes në themel kur zbatimi i ligjit procedural ose material nuk diktohet nga nevoja për rivlerësimin e fakteve apo të provave të çështjes. Edhe jurisprudenca kushtetuese, sipas saj, është shprehur për juridiksionin ekskluzivisht ligjor të Gjykatës së Lartë, e cila, si gjykatë e ligjit, mund të vendosë për themelin e çështjes vetëm nëse mosmarrëveshja mund të zgjidhet në bazë të të njëjtave fakte dhe prova, të vlerësuara nga gjyqtari i faktit dhe që përbëjnë bazën e vendimit në të cilin është bërë një interpretim i gabuar i ligjit dhe se procesi nuk konsiderohet i parregullt, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës, kur Gjykata e Lartë, mbi të njëjtat prova e fakte të vlerësuara në gjykimet e mëparshme, vendos të prishë vendimet dhe të zgjidhë vetë çështjen, për shkak të zbatimit të gabuar të ligjit.

27. Për rrjedhojë, ka arsyetuar Gjykata e Lartë, i vetmi test që duhet të kalojë Kolegji Administrativ për të gëzuar autoritetin e ndryshimit të vendimmarrjeve të gjykatave më të ulëta dhe zgjidhjes në themel të çështjes, është konstatimi i zbatimit të gabuar të ligjit procedural ose material, i cili nuk ngre nevojën e rivlerësimit të faktit apo provës së administruar në gjykimin e çështjes nga gjykatat më të ulëta. Në këtë kuptim, vijon ajo, pa i hyrë analizës së provave, krahas shkaqeve të ngritura në rekurs, Kolegji Administrativ duhet të evidentojë nëse nga gjykatat e faktit janë lejuar ose jo shkelje të normave procedurale dhe nëse ligji për faktet e pranuara si të provuara prej tyre është respektuar drejt ose jo. Në rastin konkret, sipas Gjykatës së Lartë, pavarësisht shkaqeve të ngritura në rekurs, çështja paraqet problematika që lidhen drejtpërdrejt me mënyrën e zbatimit të ligjit procedural e material nga ana e Gjykatës Administrative të Apelit.

28. Në analizë të vendimit të kundërshtuar, Gjykata vëren se Gjykata e Lartë është përpjekur të arsyetojë respektimin e parimit të gjykatës së caktuar me ligj, duke argumentuar se ajo është gjykatë ligji dhe ka kompetencë të korrigjojë vendimet e gjykatave më të ulëta për zbatim të gabuar të tij. Gjykata thekson se në vendimin e saj nr. 55/2023 nuk është vënë në dyshim juridiksioni ekskluzivisht ligjor i Gjykatës së Lartë, por masa e kompetencës së Gjykatës së Lartë, e cila ishte ushtruar *ultra petitia partum*, pra përtej shkaqeve të ngritura në rekurs. Në këtë këndvështrim, Gjykata thekson se parimi i gjykatës së caktuar me ligj do të thotë se ligji procedural e ka kufizuar kompetencën e Gjykatës së Lartë për të shqyrtuar çështjen brenda shkaqeve të ngritura në rekurs dhe këta kufij mund të

tejkalohen vetëm në rastet përjashtimore të parashikuara shprehimisht nga ligji. Në këtë drejtim, neni 473, paragrafi 1, i KPC-së përcakton qartë se Gjykata e Lartë shqyrton rekursin brenda kufijve të tij, përveç kur ligji parashikon ndryshe. Gjykata e Lartë ka dështuar të tregojë se përse fakti se ajo është gjykatë ligji dhe se ka kompetencë të korrigjojë vendimet e gjykatave më të ulëta për zbatim të gabuar të tij klasifikohen si një "parashikim i ndryshëm i ligjit" në kuptim të kësaj dispozite dhe, për më tepër, se pikërisht ato e bëjnë rastin konkret një rast përjashtimor në të cilin ajo lejohet të zgjerojë kufijtë e shqyrtimit të çështjes përtej shkaqeve të rekursit. Gjykata e Lartë në çdo rast vepron si gjykatë ligji, por nëse kjo kufizon në përgjithësi juridiksionin rishikues gjyqësor të saj, një gjë e tillë nuk nënkupton *a priori* se juridiksioni i saj në këtë drejtim është i pakufizuar, pra se ajo në çdo rast kontrollon kuptimin dhe zbatimin e ligjit nga gjykatat më të ulëta edhe përtej shkaqeve të ngritura në mjetin me të cilin ajo është vënë në lëvizje. Një mënyrë e tillë të kuptuari rrezikon të zhvlerësojë dhe të bëjë të pakuptimtë rregullat procedurale në lidhje me mjetin ankimues (rekursin) dhe shqyrtimin e tij nga Gjykata e Lartë, të cilat janë elemente esenciale të një procesi gjyqësor dhe përcaktuese në pikëpamje të rregullshmërisë së tij.

29. Për sa më lart, Gjykata konstaton se edhe pse formalisht e ka zbatuar vendimin nr. 55/2023, në rigjykim Gjykata e Lartë sërish ka zgjidhur mosmarrëveshjen mes palëve pa marrë në analizë dhe pa shqyrtuar shkaqet e parashtruara në rekurs nga të padituri dhe përtej shkaqeve të parashtruara në të, në kundërshtim nga sa parashikon neni 473/a, paragrafi i parë, i KPC-së, dispozitë kjo e zbatueshme edhe për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative dhe që mishëron parimin e së drejtës procedurale *non ultra petita partium*, duke mos parashtruar ajo ndonjë argument të qenësishëm për zgjerimin e kufijve të shqyrtimit të çështjes dhe, në këtë kuptim, të kufijve të juridiksionit rishikues të saj në rastin konkret. Për rrjedhojë, Gjykata vëren se Gjykata e Lartë nuk e ka korrigjuar shkeljen e konstatuar më parë, duke mos e zbatuar në këtë mënyrë vendimin e saj.

30. Po kështu, Gjykata vëren se në vendimin e saj nr. 55/2023 ka konstatuar edhe mosrespektimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor nga Gjykata e Lartë në drejtim të mospërputhjes së argumenteve të parashtruara në pjesën arsyetuese me disponimin përfundimtar për sa i përket përdorimit të një argumenti të natyrës procedurale për vlerësimin e bazueshmërisë në themel të padisë. Një shkelje e tillë konstatohet sërish edhe në vendimin e kundërshtuar. Përsëri vijon të jetë e paqartë

sesi shkelja e papretenduar e së drejtës procedurale të palës së paditur për mbrojtje efektive, për shkak të kapërcimit të supozuar të objektit të padisë nga gjykata e apelit, është e korrigjueshme përmes rrëzimit të padisë së kërkuesit, i cili, nga ana tjetër, ndërsa gëzon të drejtën e disponimit të padisë, nuk ka pretendime për atë mënyrë të vepruari nga gjykata e apelit.

31. Gjithashtu, po në lidhje me mosrespektimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, Gjykata në vendimin e saj nr. 55/2023 ka konstatuar edhe mungesë arsyetimi nga Gjykata e Lartë për sa shprehej se referimi i bërë nga gjykata e apelit në vendimin nr. 190/2014 të Gjykatës së Lartë dhe në vendimin unifikues nr. 7/2011 nuk është një zbatim i duhur i këtyre vendimeve, duke anashkaluar të tregojë arsyet se përse gjykata e apelit kishte gabuar në përfundimin e arritur mbi bazën e kësaj praktike gjyqësore. Edhe në vendimin e kundërshtuar, pavarësisht qëndrimit të parashtruar nga kërkuesi përpara Gjykatës së Lartë, konstatohet sërish mungesë arsyetimi në këtë drejtim.

32. Në këndvështrim të sa më sipër, Gjykata evidenton se në rigjykim Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë nuk e ka zbatuar plotësisht vendimin e saj nr. 55/2023, duke mos korrigjuar shkeljet e konstatuara, pasi e ka shqyrtuar çështjen pa marrë në konsideratë kuadrin kushtetues e ligjor lidhur me kufijtë e shqyrtimit të rekursit dhe pa arsyetuar qëndrimin e saj në raport me standardin e zbatimit të detyrueshëm të vendimeve të Gjykatës. Në vlerësimin e Gjykatës, mënyra sesi Gjykata e Lartë ka arsyetuar zgjerimin e kufijve të shqyrtimit të çështjes përtej shkaqeve të ngritura në rekurs përbën një interpretim të paarsyeshëm të nenit 473/a, paragrafi i parë, të KPC-së, në cenim të së drejtës së kërkuesit për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj.

33. Për sa më lart, në kushtet kur Gjykata e Lartë nuk rezulton të ketë marrë në shqyrtim shkaqet e parashtruara në rekurs nga pala e paditur dhe nuk ka korrigjuar shkeljet e konstatuara në vendimin e saj nr. 55/2023, për të cilat çështja është kthyer për rishqyrtim në atë gjykatë, Gjykata çmon se pretendimi i kërkuesit për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj të lidhur me standardin e zbatimit të detyrueshëm të vendimeve të saj dhe standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor është i bazuar.

34. Në përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkuesit janë të bazuara, sipas arsyetimit të mësipërm të këtij vendimi, ndaj kërkesa pranohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, si dhe neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, njëzëri,

V E N D O S I:

1. Pranimin e kërkesës.

2. Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2024-3472 (209), datë 13.05.2024 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

3. Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 17.06.2025
Shpallur më 22.07.2025

Vendim nr. 40, datë 17.06.2025
(V-40/25)

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Holta Zaçaj, Kryetare, Marsida Xhaferllari, Sonila Bejtja, Sandër Beci, Genti Ibrahimi, Ilir Toska, Marjana Semini, Fiona Papajorgji, anëtarë, me sekretare Belma Lleshi, në datën 17.06.2025 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve kërkesën nr. 23 (M) 2024 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUESE: **MIMOZA MARGJEKA,** përfaqësuar nga avokate Margarita Kola, me prokurë të përgjithshme.

SUBJEKT I INTERESUAR:
PROKURORIA E POSAÇME KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR, përfaqësuar nga prokuror Sotir Kllapi, me autorizim.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimeve nr. 457, datë 27.10.2022 të Gjykatës e Posaçme e Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar; nr. 171, datë 09.11.2022 të Gjykatës e Posaçme e Apelit kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar; nr. 00-2024-1625 (195), datë 24.07.2024 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

BAZA LIGJORE: **Nenet 17, 27, 28, pika 3 dhe 42, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 5, 6 dhe 7 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut *(KEDNJ)*; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të**

Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Fiona Papajorgji, mori në shqyrtim parashtrimet me shkrim të kërkueses, Mimoza Margjeka (*kërkuesja*), e cila ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet e subjektit të interesuar, Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar *(Prokuroria e Posaçme)*, që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I
Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesja është proceduar nga Prokuroria e Posaçme në kuadër të procedimit penal nr. 186, datë 09.07.2020 *(procedimin penal nr. 186/2020)* për veprën penale "Korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë", të parashikuar nga nenet 319/ç dhe 25 të Kodit Penal *(KP)*.

2. Mbi bazën e kërkesës së Prokurorisë së Posaçme, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar *(GJKKO-ja e Shkallës së Parë)*, me vendimin nr. 92, datë 05.09.2020, ka vendosur caktimin e masës së sigurimit personal "Arresti në shtëpi", të parashikuar nga neni 237 i Kodit të Procedurës Penale *(KPP)*. Masa është zbatuar në datën 09.09.2020. Po ajo gjykatë, me vendimin nr. 94, datë 12.09.2020, ka vendosur vazhdimin e zbatimit të masës. Kundër këtyre vendimeve ka ushtruar ankim kërkuesja.

3. Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar *(GJKKO-ja e Apelit)*, me vendimin nr. 29, datë 01.10.2020, ka vendosur miratimin e vendimeve nr. 92, datë 05.09.2020 dhe nr. 94, datë 12.09.2020 të GJKKO-së së Shkallës së Parë. Ndërsa rekursi i ushtruar nga kërkuesja kundër këtij vendimi nuk është pranuar nga Gjykata e Lartë me vendimin nr. 00-2020-486, datë 24.12.2020.

4. Në vijim, GJKKO-ja e Shkallës së Parë, pasi është njohur me informacionin e prokurorit për hetimet e kryera për procedimin penal nr. 186/2020, në zbatim të nenit 246, pika 6, të KPP-së, me vendimin nr.

403, datë 24.11.2020, ka vendosur zëvendësimin e masës së sigurimit për kërkuesen në "Detyrim për t'u paraqitur në Policinë Gjyqësore". Mbi bazën e ankimit të prokurorit, GJKKO-ja e Apelit, me vendimin nr. 221, datë 17.12.2020, ka ndryshuar masën e arrestit "Detyrim për t'u paraqitur në Policinë Gjyqësore" dhe kërkuesja ka vazhduar nën masën e sigurimit personal "Arresti në shtëpi".

5. Në datën 26.02.2021 Prokuroria e Posaçme ka dërguar kërkesën për kalimin e çështjes në gjyq. Kërkesa është pranuar nga GJKKO-ja e Shkallës së Parë me vendimin nr. 37, datë 07.05.2021.

6. Gjatë kohës që çështja ka qenë në proces gjykimi, kërkuesja, në datën 19.10.2022, mbështetur në nenin 263, pika 2, shkronja "b", të KPP-së, ka kërkuar shuarjen e masës së sigurimit personal të arrestit në shtëpi, me argumentin se ishte tejkaluar afati ligjor 9-mujor i zbatimit të saj. Kërkesa është rrëzuar nga GJKKO-ja e Shkallës së Parë me vendimin nr. 457, datë 27.10.2022, me arsyetimin se masa e sigurimit personal "Arresti në shtëpi" ishte e ndryshme nga ajo "Arresti në burg" dhe në zbatim të nenit 263, pika 2, shkronja "b", të lidhur me nenin 267, pika 1, të KPP-së për atë masë zbatohej dyfishi i afateve të parashikuara nga neni 263 i KPP-së. Në rastin konkret, sipas gjykatës, afati ishte 18 muaj, i cili ende nuk ishte përmbushur, ndaj masa nuk e kishte humbur fuqinë e saj.

7. Mbi bazën e ankimit të kërkueses, GJKKO-ja e Apelit, me vendimin nr. 171, datë 09.11.2022, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, me të njëjtën linjë arsyetimi. Kundër këtij vendimi ka ushtruar rekurs kërkuesja, i cili është regjistruar në Gjykatën e Lartë në datën 13.12.2022.

8. Gjatë kohës që rekursi ishte në pritje për shqyrtim, GJKKO-ja e Shkallës së Parë, me vendimin nr. 69, datë 15.12.2022, ka vendosur deklarimin fajtore të kërkueses sipas akuzës dhe dënimin e saj me 4 vjet e 6 muaj burgim dhe *pezullimin e ekzekutimit të vendimit të dënimit me burgim për pjesën e mbetur pa vuajtur të tij, duke e vënë kërkuesen në provë për një periudhë kohe prej 3 vjetësh.* Në pikën 14 të dispozitivit, GJKKO-ja e Shkallës së Parë, në zbatim të nenit 261, pika 1, shkronja "b", të KPP-së, ka disponuar shuarjen e masës së sigurimit personal "Arresti në shtëpi". Ky vendim është lënë në fuqi nga GJKKO-ja e Apelit me vendimin nr. 52, datë 12.12.2023. Ndaj vendimit të apelit ka ushtruar rekurs kërkuesja dhe aktualisht çështja me nr. 59412-00319-00-2024, datë 21.05.2024 është në pritje për t'u gjykuar.

9. Ndërkohë, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, pasi ka marrë në shqyrtim rekursin për shuarjen e masës së sigurimit personal, me vendimin nr. 00-2023-8, datë 12.01.2023, ka vendosur mospranimin e tij, me arsyetimin se çështja ka mbetur pa objekt, pasi masa e sigurimit personal nuk është më në fuqi, për shkak se ndaj kërkueses është disponuar me vendim penal të formës së prerë për dënimin e saj. Ky vendim i Gjykatës së Lartë është ankimuar nga kërkuesja në Gjykatën Kushtetuese *(Gjykata)*.

10. Gjykata, me vendimin e saj nr. 17 të datës 13.03.2024, ka vendosur pranimin e kërkesës, shfuqizimin e vendimit nr. 00-2023-8, datë 12.01.2023 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë dhe dërgimin e çështjes për shqyrtim pranë atij Kolegji. Gjykata ka vlerësuar se është cenuar e drejta e aksesit, pasi Gjykata e Lartë nuk u ka dhënë përgjigje pretendimeve të kërkueses, duke i lënë të pazgjidhura, në thelb, pasojat që kishin të bënin me një të drejtë themelore kushtetuese sikurse është kufizimi i lirisë personale. Gjykata ka arsyetuar se ndonëse Gjykata e Lartë ka zgjidhur formalisht çështjen, duke vendosur mospranimin e rekursit, ajo nuk ka bërë vlerësim në substancë të shkaqeve të tij, duke u mjaftuar me faktin se masa për të cilën kishte nisur procesi ishte shuar tashmë nga vendimi gjyqësor i dënimit. Pra, Gjykata e Lartë nuk ka bërë vlerësim nëse gjykatat më të ulëta për shkak të interpretimit të ligjit procedural penal i kanë cenuar ose jo lirinë personale kërkueses për periudhën që ajo pretendon se ka qëndruar në kufizim të lirisë përtej afatit të parashikuar nga ligji. Sipas Gjykatës, Gjykata e Lartë, duke mos kontrolluar ligjshmërinë e vendimmarrjes së gjykatave të faktit, ndonëse është ndodhur para pretendimeve për interpretim të gabuar të ligjit prej tyre, ka cenuar të drejtën e kërkueses për proces të rregullt ligjor.

11. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka marrë në rishqyrtim në seancë publike me praninë e palëve çështjen dhe me vendimin nr. 00-2024-1625 (195), datë 24.07.2024 ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të GJKKO-së së Apelit nr. 171, datë 09.11.2022. Çështja e shtruar për diskutim nga ai kolegj lidhet me llogaritjen e kohëzgjatjes maksimale të masës së sigurimit "Arresti në shtëpi" dhe nëse duhet konsideruar kjo masë sigurimi e njëjtë me masën e paraburgimit ose e ndryshme me të. Në këtë kuptim, kolegji ka arsyetuar se afatet e parashikuara në nenin 263 të KPP-së lidhen me rastin e paraburgimit, pra të masës së sigurimit "Arresti në burg", që nënkupton ndalimin dhe vendosjen në regjimin tradicional të burgjeve. Për të gjitha masat e tjera të sigurimit personal me karakter shtrëngues, përfshirë edhe masën e sigurimit "Arresti në shtëpi" vlen afati i kohëzgjatjes së tyre sipas parashikimit të nenit 267, pika 1, të KPP-së, pra që kohëzgjatja

maksimale e saj është sa dyfishi i afateve të paraburgimit. Vendosja në masën e sigurimit "Arresti në shtëpi", sipas atij kolegji, përbën privim të lirisë, por nuk përbën as paraburgim në pritje të vendimit, por një regjim më pak të ashpër se sistemi tradicional i burgjeve. Nën këtë optikë, përcaktimet e nenit 237, pika 4, të KPP-së, që parashikon se rregullat e caktuara për paraburgimin vlejnë edhe për kohëzgjatjen e arrestit në shtëpi, lidhen me përshtatshmërinë e rregullave të caktuara për paraburgimin gjatë kohëzgjatjes së masës së sigurimit, pra që duhet të arsyetohet se pse është e nevojshme dhe proporcionale vendosja ose vijimi i kësaj mase. Ai kolegj më tej arsyeton se ndaj kërkueses duhet të mbahen në konsideratë përcaktimet eksplicite të nenit 267 të KPP-së që lidhen me masat e tjera të sigurimit, përveç arrestit në burg, pra jo afati prej 9 muajsh i parashikuar nga neni 263 i KPP-së për veprën penale për të cilën akuzohet kërkuesja, por afati prej 18 muajsh (dyfishi) i parashikuar nga neni 267 i KPP-së. Gjithashtu, për të arritur në këtë përfundim në vendim elaborohen edhe përcaktimet e ligjit nr. 7942, datë 31.05.1995 "Për hyrjen në fuqi të ligjit nr. 7895, datë 27.01.1995 "Për Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë"" *(ligji nr. 7942/1995),* si dhe të ligjit nr. 81/2020 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve" (*ligji nr. 81/2020*), i cili termat "i paraburgosur" dhe "institucione të paraburgimit" i lidh me masën e sigurimit "Arresti në burg". Në këtë mënyrë, Gjykata e Lartë ka arsyetuar se afatet e masave të sigurimit llogariten të ndara për çdo masë, prandaj ajo gjykatë ka konkluduar se gjykatat e faktit e kanë interpretuar drejt ligjin lidhur me afatet e shuarjes së masave të sigurimit.

12. Në datën 18.11.2024 kërkuesja ka paraqitur ankim kushtetues individual në Gjykatë, sipas objektit të tij. Kolegji i Gjykatës në datën 24.01.2025 ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve, e cila në datën 04.02.2025 ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II
Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

13. ***Kërkuesja*****,** në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar *liria personale*, e garantuar nga nenet 27 dhe 17 të Kushtetutës, si dhe KEDNJ-ja, pasi në zbatim të gabuar të ligjit procedural penal asaj i është kufizuar liria tej afateve ligjore, duke u mbajtur në burg pa ligj. Sipas saj, afati i masës së sigurimit personal është 9 muaj, pasi vepra penale për të cilën

ajo është akuzuar parashikon dënimin me burgim deri në 10 vjet. Ndërkohë që nga data 26.02.2021, kur Prokuroria e Posaçme ka dërguar kërkesën për kalimin e çështjes në gjyq e deri në datën 19.10.2022, ditën e paraqitjes së kërkesës së saj për shuarjen e masës së sigurimit personal, kanë kaluar 386 ditë, duke mos llogaritur në këtë periudhë afatet e pezulluara të paraburgimit. Gjykata e Lartë nuk ka konstatuar paligjshmëritë në vendimet e gjykatave më të ulëta, duke e interpretuar në mënyrë të gabuar ligjin procedural penal. Kohëzgjatja e masës "Arresti në shtëpi" është e barabartë me kohëzgjatjen e afateve të paraburgimit, pra barazohet me paraburgimin dhe në këto kushte edhe përllogaritja e kohëzgjatjes së këtyre afateve referon në nenin 263 të KPP-së dhe pezullimi i afateve të paraburgimit referon te neni 265 i KPP-së. Sipas saj, Gjykata e Lartë nuk ka zbatuar rregullat e neneve 237, pika 4, ku përcaktohet se *"për kohëzgjatjen e arrestit në shtëpi vlejnë rregullat e caktuara për paraburgimin"* dhe 263 të KPP-së. Gjithashtu, Gjykata e Lartë duhej të kishte dalë me një vendim njësues për shkak të qëndrimeve të ndryshme të Kolegjit Penal lidhur me çështjen.

14. ***Subjekti i interesuar, Prokuroria e Posaçme,*** në mënyrë të përmbledhur, ka parashtruar si vijon:

14.1. *Së pari,* kërkesa ka mbetur pa objekt sipas nenit 71/a, pika 1, shkronja "ç", të ligjit nr. 8577/2000, pasi masa është shuar prej dy vjetësh dhe në një eventualitet të pranimit të kërkesës dhe prishjes së vendimeve të gjykatave të zakonshme, këto të fundit në rishqyrtim do të konstatonin mungesën e objektit.

14.2. *Së dyti,* kërkuesja nuk i ka argumentuar në nivel kushtetues pretendimet e saj. Pretendimi i kërkueses për interpretimin që gjykatat e zakonshme u kanë bërë dispozitave procedurale nuk qëndron nga pikëpamja kushtetuese, pasi interpretimi i ligjit është detyrë e gjykatave të zakonshme.

14.3. *Së treti,* kohëzgjatja dhe zëvendësimi i masës nuk përfshihen në sferën e kontrollit kushtetues. Kjo për arsye se jo çdo modalitet i zbatimit të masave mund të analizohet në zbatim të nenit 5 të KEDNJ-së.

14.4. *Së katërti,* vendimi nr. 58 i vitit 2014 i Gjykatës së Lartë, që citohet nga kërkuesja, i përket një regjimi të ndryshëm juridik dhe praktika gjyqësore ka ndryshuar, siç është edhe rasti i vendimit nr.111, datë 07.04.2022 të Gjykatës së Lartë, i cituar edhe nga vetë ajo, që i konsideron këto masa sigurimi të ndryshme dhe me regjim juridik të ndryshëm.

14.5. *Së pesti,* diferencat e parashikuara nga KPP-ja tregojnë se arresti në burg dhe ai në shtëpi janë dy masa krejt të ndryshme nga njëratjetra, për të cilat zbatohen afate të ndryshme. Këto dallime kanë të bëjnë me termin "paraburgim" që përdoret vetëm për arrestin në burg, fillimin e efekteve të masës, ku ato të arrestit në burg fillojnë nga çasti i ndalimit, ndërkohë për arrestin në shtëpi nga momenti i njoftimit të vendimit. Të ndryshme këto masa dalin edhe në nenin 236 të KPP-së, për sa i takon garancisë pasurore dhe atë 248 të KPP-së, që lidhet me pyetjen e personit të arrestuar. Po ashtu, ka dallim të qartë edhe në disa ligje si ai nr. 79, datë 25.06.2020 "Për ekzekutimin e vendimeve penale" (*ligji nr. 79/2020*) dhe nr. 81/2020. Për sa i takon kohëzgjatjes, në nenin 263 të KPP-së legjislatori ka përdorur termin "paraburgim" duke iu referuar qartësisht vetëm masës së arrestit në burg. Edhe për sa u takon kushteve dhe kritereve të aplikimit, dy masat rezultojnë të kundërta referuar nenit 230 të KPP-së, ndërkohë edhe neni 57 i KP-së "Llogaritja e paraburgimit" i referohet vetëm arrestit në burg.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkueses

15. Çështja e legjitimimit *(locus standi)* është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, shterimin e mjeteve juridike efektive, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

16. Lidhur me legjitimimin *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, individi për të vënë në lëvizje Gjykatën duhet të provojë interesin e tij si

në aspektin procedural, ashtu edhe në atë substancial. Kjo do të thotë se individi mund të bëjë kërkesë në Gjykatë vetëm për çështje që lidhen me interesat e tij, si dhe të provojë se në çfarë mënyre ai është cenuar në të drejtat e tij kushtetuese, pra se është viktimë e një shkeljeje dhe pasojat nga akti i kundërshtuar janë të drejtpërdrejta dhe reale për të (*shih vendimet nr. 65, datë 30.11.2023; nr. 44, datë 26.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Posaçme, në këtë drejtim ka prapësuar se kërkesa ka mbetur pa objekt sipas nenit 71/a, pika 1, shkronja "ç", të ligjit nr. 8577/2000, pasi masa është shuar prej dy vjetësh dhe në një eventualitet të pranimit të kërkesës dhe prishjes së vendimeve të gjykatave të zakonshme, këto të fundit në rishqyrtim do të konstatonin mungesën e objektit.

18. Në kontekst të rrethanave të rastit në shqyrtim, Gjykata sjell në vëmendje qëndrimin e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*GJEDNJ*) në vendimin Hysa kundër Shqipërisë, datë 21.02.2023, sipas të cilit "*ndonëse në datën kur Gjykata Kushtetuese mori vendimin e saj, kërkuesja kishte vuajtur tashmë kufizimin e lirisë së saj, ajo mund të përfitonte në mënyrë legjitime nga një shqyrtim kushtetues post facto dhe se një shqyrtim i plotë nga Gjykata Kushtetuese mund të kishte çuar në konstatimin se kërkuesja ishte mbajtur në burgim në shkelje të së drejtës së saj për liri" (shih Hysa kundër Shqipërisë, datë 21.02.2023, § 83)*. Në këtë drejtim, Gjykata thekson rëndësinë e veçantë që merr liria personale si një e drejtë themelore kushtetuese dhe substanciale, e cila nuk mund të cenohet pa një proces të rregullt ligjor *(shih vendimet nr. 12, datë 24.05.2022; nr. 40, datë 18.07.2012 të Gjykatës Kushtetuese)*, si dhe mundësinë që ka kushdo për të gëzuar të drejtën për kompensim për burgim të padrejtë edhe në rastin e vuajtjes së arrestit në shtëpi tej afateve të përcaktuara nga ligji. Lidhur me këtë të drejtë GJEDNJ-ja, në rastin e shqyrtimit të pretendimeve për parregullsi të procesit gjyqësor që ka sjellë kufizim të padrejtë të lirisë, është shprehur se "*përveç interesit moral në marrjen e rezultatit, një zgjidhje e tillë deklarative mund të hapte rrugën edhe për një kërkesë për kompensim mbi arsyet për burgim të paligjshëm sipas nenit 5 § 5 të Konventës (shih Hysa kundër Shqipërisë, datë 21.02.2023, § 83)*.

19. Gjithashtu, Gjykata konstaton se edhe në gjykimin kushtetues pararendës të zhvilluar prej saj (*vendimi nr. 17/2024*), pavarësisht faktit se edhe në atë rast Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë e kishte konsideruar pa objekt rekursin për shkak të shuarjes së masës së sigurimit, Gjykata e mori

në shqyrtim ankimin e kërkueses sipas jurisprudencës së sipërpërmendur të GJEDNJ-së. Prandaj, në ndryshim nga sa parashtron subjekti i interesuar, Gjykata vlerëson se kërkuesja legjitimohet *ratione personae* edhe në rastin objekt shqyrtimi.

20. Për sa i takon kriterit për *shterimin e mjeteve juridike efektive*, individi mund t'i drejtohet Gjykatës me ankim individual kushtetues, vetëm pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese që ai pretendon se i janë cenuar. Detyrimin për përmbushjen e këtij kriteri Gjykata e ka vlerësuar si në rastet e vendimeve përfundimtare, që kanë përmbyllur në themel procesin gjyqësor, ashtu edhe në rastin e vendimeve të ndërmjetme, karakteri i të cilave është konsideruar përfundimtar për qëllimet e nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës. Për sa u takon këtyre të fundit, Gjykata ka pranuar se vendimet gjyqësore për caktimin e masës të sigurimit personal me karakter shtrëngues që lidhet me heqjen e lirisë së individit, si përjashtim, i bëjnë ato vendim përfundimtar në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës *(shih vendimet nr. 19, datë 04.04.2023; nr. 14, datë 11.03.2021; nr. 28, datë 23.06.2011 të Gjykatës Kushtetuese)*. Si të tilla Gjykata në jurisprudencën e saj ka konsideruar si masat e sigurimit personal "Arresti në burg" (*shih vendimet nr. 17, datë 13.03.2024; nr. 14, datë 11.03.2021; nr. 28, datë 23.06.2011 të Gjykatës Kushtetuese*), ashtu edhe ato të masës së sigurimit "Arresti në shtëpi" (*shih vendimet nr. 13, datë 13.03.2024; nr. 75, datë 22.12.2015 të Gjykatës Kushtetuese).*

21. Në rastin konkret, Gjykata evidenton se pretendimet e kërkueses kanë të bëjnë me procesin gjyqësor të zhvilluar në Gjykatën e Lartë për shuarjen e masës së sigurimit personal "Arresti në shtëpi", për të cilën ajo nuk ka mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të saj kushtetuese përveç ankimit kushtetues individual. Prandaj Gjykata vlerëson se kërkuesja e ka përmbushur këtë kriter.

22. Në lidhje me legjitimimin *ratione temporis*, sipas nenit 71/a, pika 1, shkronja "b", të ligjit nr. 8577/2000, ankimi kushtetues individual shqyrtohet nga Gjykata kur kërkesa është paraqitur brenda afatit ligjor 4-mujor nga konstatimi i cenimit. Në rastin konkret, Gjykata vëren se procesi gjyqësor i kundërshtuar nga kërkuesja ka përfunduar me vendimin e datës 24.07.2024 të Gjykatës së Lartë, ndërkohë që ankimi kushtetues individual është paraqitur në Gjykatë në datën 18.11.2024, pra brenda afatit ligjor 4-mujor.

23. Për sa i takon legjitimimit *ratione materiae*, kërkuesja në thelb ka pretenduar cenimin e lirisë personale të parashikuar nga neni 27 i Kushtetutës për shkak të interpretimit që gjykatat e zakonshme u kanë bërë dispozitave procedurale penale në lidhje me kohëzgjatjen maksimale të afateve të masës së sigurimit "Arresti në shtëpi".

24. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Posaçme, ka prapësuar se kërkuesja nuk i ka argumentuar në nivel kushtetues pretendimet e saj dhe se pretendimi i kërkueses për interpretimin që gjykatat e zakonshme u kanë bërë dispozitave procedurale nuk qëndron nga pikëpamja kushtetuese, pasi interpretimi i ligjit është detyrë e gjykatave të zakonshme.

25. Gjykata thekson se në parim interpretimi i ligjit është kompetencë e gjykatave të zakonshme, vendimet e të cilave nuk vihen në dyshim, përveç rasteve kur gjetjet e tyre mund të konsiderohen si haptazi të paarsyeshme (*shih vendimet nr. 67, datë 06.12.2023; nr. 59, datë 14.11.2023; nr. 30, datë 29.05.2023 të Gjykatës Kushtetuese).* Megjithatë, duke qenë se kushtet, kriteret dhe procedurat për caktimin, zbatimin, rivlerësimin, zëvendësimin dhe kontrollin gjyqësor për masat e sigurimit janë drejtpërdrejt të lidhura me respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe konkretisht me lirinë personale (*shih vendimet nr. 51, datë 18.10.2023; nr. 19, datë 04.04.2023; nr. 40, datë 18.07.2012 të Gjykatës Kushtetuese*), në kushtet kur interpretimi i ligjit nga Gjykata e Lartë është vënë në dyshim nga kërkuesja, si shkak për të cilin asaj i është cenuar liria personale e garantuar nga neni 27 i Kushtetutës, Gjykata çmon se prapësimi i subjektit të interesuar se interpretimi i ligjit është jashtë juridiksionit kushtetues nuk qëndron.

26. Mbi bazën e këtyre standardeve Gjykata në vijim do të shqyrtojë bazueshmërinë në themel të pretendimit të kërkueses për cenimin e lirisë personale, duke iu referuar edhe arsyetimit të gjykatave të zakonshme, pasi sikurse ka pohuar në jurisprudencën e saj (*shih vendimet nr. 1, datë 17.01.2025; nr. 19, datë 21.03.2024 të Gjykatës Kushtetuese*), për të vlerësuar nëse ka pasur ose jo cenim të të drejtave substanciale, Gjykata bazohet në arsyetimin e vendimeve të gjykatave të zakonshme, për sa kohë që në bazë të parimit të subsidiaritetit u takon gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, që përveç zbatimit të ligjit material dhe procedural penal, të mbajnë parasysh edhe jurisprudencën e Gjykatës dhe të GJEDNJ-së, duke qenë kjo Gjykatë mjeti i fundit për mbrojtjen e këtyre të drejtave.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e lirisë personale

27. Kërkuesja ka pretenduar cenimin e lirisë personale, të garantuar nga nenet 27 dhe 17 të Kushtetutës dhe KEDNJ-ja, pasi në zbatim të gabuar të ligjit procedural penal i është kufizuar liria tej afateve ligjore, duke u mbajtur në burg pa ligj. Sipas kërkueses, afati i masës së sigurimit personal është 9 muaj, pasi vepra penale për të cilën ajo është akuzuar parashikon dënimin me burgim deri në 10 vjet. Ndërkohë që afati i llogaritur prej saj nga data 26.02.2021, kur Prokuroria e Posaçme ka dërguar kërkesën për kalimin e çështjes në gjyq e deri në datën 19.10.2022, ditën e paraqitjes së kërkesës së saj për shuarjen e masës së sigurimit personal, është 386 ditë, duke mos llogaritur në këtë periudhë afatet e pezulluara të paraburgimit. Gjithashtu, Gjykata e Lartë nuk ka konstatuar paligjshmëritë në vendimet e gjykatave më të ulëta, duke e interpretuar në mënyrë të gabuar ligjin procedural penal. Kohëzgjatja e masës së arrestit në shtëpi është e barabartë me kohëzgjatjen e afateve të paraburgimit, pra barazohet me paraburgimin dhe në këto kushte edhe përllogaritja e kohëzgjatjes së këtyre afateve referon në nenin 263 të KPP-së dhe pezullimi i afateve të paraburgimit referon te neni 265 i KPP-së. Sipas saj, Gjykata e Lartë nuk ka zbatuar rregullat e neneve 237, pika 4, ku përcaktohet se "*për kohëzgjatjen e arrestit në shtëpi vlejnë rregullat e caktuara për paraburgimin*" dhe 263 të KPP-së. Gjithashtu, Gjykata e Lartë duhej të kishte dalë me një vendim njësues për shkak të qëndrimeve të ndryshme të Kolegjit Penal lidhur me çështjen.

28. Subjekti i interesuar ka prapësuar se kohëzgjatja dhe zëvendësimi i masës nuk përfshihen në sferën e kontrollit kushtetues. Kjo për arsye se jo çdo modalitet i zbatimit të masave mund të analizohet në zbatim të nenit 5 të KEDNJ-së. Gjithashtu, sipas tij, vendimi nr. 58 i vitit 2014 i Gjykatës së Lartë, që citohet nga kërkuesja, i përket një regjimi të ndryshëm juridik dhe praktika gjyqësore ka ndryshuar siç është edhe rasti i vendimit nr. 111, datë 07.04.2022, i cituar edhe nga vetë ajo, që i konsideron këto masa sigurimi të ndryshme dhe me regjim juridik të ndryshëm. Po kështu, diferencat e parashikuara nga KPP-ja tregojnë se arresti në burg dhe ai në shtëpi janë dy masa krejt të ndryshme nga njëra-tjetra, për të cilat zbatohen afate të ndryshme. Këto dallime kanë të bëjnë me termin "paraburgim" që përdoret vetëm për arrestin në burg, fillimin e efekteve të masës, ku ato të arrestit në burg fillojnë nga çasti i ndalimit, ndërkohë për arrestin në shtëpi nga momenti i njoftimit të vendimit. Të ndryshme këto masa dalin edhe në nenin 236 të KPP-së, për sa i takon garancisë pasurore dhe atë 248 të KPP-së, që lidhet me pyetjen e personit të arrestuar. Po ashtu, ka dallim

të qartë edhe në disa ligje si ai nr. 79/2020 dhe ligji nr. 81/2020. Për sa i takon kohëzgjatjes, në nenin 263 të KPP-së legjislatori ka përdorur termin "paraburgim", duke iu referuar qartësisht vetëm masës së arrestit në burg. Edhe për sa u takon kushteve dhe kritereve të aplikimit, dy masat rezultojnë të kundërta referuar nenit 230 të KPP-së, ndërkohë edhe neni 57 i KP-së "Llogaritja e paraburgimit" i referohet vetëm arrestit në burg.

29. Kushtetuta në nenin 27 parashikon se liria nuk mund t'i hiqet askujt, përveçse në rastet dhe sipas procedurave të parashikuara me ligj *(pika 1)* dhe se kufizimi i saj mund të bëhet vetëm kur ka dyshime të arsyeshme se individi ka kryer një vepër penale ose për të parandaluar kryerjen prej tij të veprës penale ose largimin e tij pas kryerjes së saj *(pika 2, shkronja "c", po aty)*. Ndërsa neni 42 i saj sanksionon se liria nuk mund të cenohet pa një proces të rregullt ligjor *(pika 1)* dhe se kushdo, për mbrojtjen e saj, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë *(pika 2)*.

30. Gjykata rithekson se qëllimi kryesor i nenit 27 të Kushtetutës është të parandalojë heqjen arbitrare ose të pajustifikuar të lirisë, pasi e drejta për lirinë personale është e një rëndësie jetike për një shoqëri demokratike. Në rastet që kanë të bëjnë me heqjen e lirisë, është thelbësore që kushtet për heqjen e lirisë të jenë qartësisht të përcaktuara sipas ligjit dhe që vetë ligji të jetë i parashikueshëm në zbatimin e tij, në mënyrë që ai të përmbushë standardin e "*ligjshmërisë*" të përcaktuar nga Kushtetuta *(shih vendimet nr. 24, datë 27.04.2023; nr. 39, datë 15.02.2022 të Gjykatës Kushtetuese)*.

31. Edhe GJEDNJ-ja është shprehur në jurisprudencën e saj se askujt nuk mund t'i hiqet liria, përveç rasteve të parashikuara në nenin 5 të KEDNJ-së dhe vetëm bazuar në ligj *(shih Saadi kundër Mbretërisë së Bashkuar [DhM], datë 28 janar 2008, § 67).* Konventa në thelb i referohet legjislacionit të brendshëm dhe deklaron detyrimin për t'iu përshtatur rregullave materiale dhe procedurale, por, gjithashtu, çdo heqje lirie duhet të jetë në përputhje me qëllimin e nenit 5, pra të mbrojë individët nga *arbitrariteti (shih Bozano kundër Francës, datë 18.12.1986, § 54; Lukanov kundër Bullgarisë, datë 20.03.1997, § 41).*

32. Bazuar në sa më lart dhe në kontekstin e çështjes konkrete, Gjykata thekson se në rastin e masave të sigurimit që kufizojnë lirinë e individit, për mbrojtjen e individit nga arbitrariteti veprojnë disa garanci të nivelit ligjor, sipas të cilave ligji duhet të parashikojë llojin e masës së sigurimit dhe kohëzgjatjen e saj, ligji duhet të jetë i parashikueshëm në zbatimin e tij dhe masa e sigurimit, si dhe kohëzgjatja e saj duhet të jenë objekt i

kontrollit gjyqësor. Në këtë kuptim, Gjykata vëren se në zbatim të delegimit të nenit 27 të Kushtetutës, kushtet, kriteret dhe procedurat e kufizimit të lirisë personale për shkak të veprave penale janë parashikuar në KPP.

33. Lidhur me kufizimin e lirisë personale si pasojë e zbatimit të masës së sigurimit "Arresti në shtëpi", GJEDNJ-ja në praktikën e saj gjyqësore është shprehur se kjo masë konsiderohet, për nga shkalla dhe intensiteti i saj, si privim i lirisë në kuptim të nenit 5 të KEDNJ-së *(shih Nikolova kundër Bullgarisë (nr. 2), datë 30.09.2004, § 60; Ninescu kundër Republikës së Moldavisë, datë 15.07.2014, § 53; Delijorgji kundër Shqipërisë, datë 28.04.2015, § 75)*. Sipas GJEDNJ-së, është e vërtetë se në shumicën e rasteve arresti në shtëpi nënkupton më pak kufizime dhe një shkallë më të vogël vuajtjeje ose shqetësimi për të pandehurin sesa paraburgimi i zakonshëm në burg. Pavarësisht nga vendi, ndaj kërkuesit zbatohen të njëjtat kritere për të gjithë periudhën e kufizimit të lirisë. Po sipas saj, nocionet "shkallë" dhe "intensitet" në praktikën gjyqësore, si kritere për zbatueshmërinë e nenit 5 të KEDNJ-së, i referohen vetëm shkallës së kufizimeve të lirisë së lëvizjes, jo dallimeve në rehati ose në regjimin e brendshëm të paraburgimit *(shih Buzadji kundër Republikës së Moldavisë, datë 05.07.2016, § 103, §§ 112 – 114)*.

34. GJENDJ-ja gjithashtu ka theksuar se për sa i takon përcaktimit të kohëzgjatjes së paraburgimit sipas nenit 5, paragrafi 3, të Konventës, periudha që duhet të merret në konsideratë fillon në ditën kur i akuzuari merret në paraburgim dhe përfundon në ditën kur përcaktohet akuza, edhe nëse vetëm nga një gjykatë e shkallës së parë, ose, ndoshta, kur aplikanti lirohet nga paraburgimi në pritje të procedurave penale kundër tij *(shih Idalov kundër Rusisë, datë 22 maj 2012, § 112; Kovyazin dhe të tjerë kundër Rusisë, 17 shtator 2015, § 75)*. Në këtë drejtim, GJEDNJ-ja nuk ka gjetur asnjë arsye për të miratuar një qasje të ndryshme në lidhje me arrestin në shtëpi *(shih Razvozzhayev dhe Udaltsov kundër Rusisë, datë 19 shkurt 2020 § 213)*.

35. Nën dritën e standardeve të mësipërme dhe bazuar në thelbin e pretendimeve të kërkueses, Gjykata do të analizojë nëse në rastin në shqyrtim interpretimi i ligjit nga Gjykata e Lartë për kohëzgjatjen e masës së sigurimit "Arresti në shtëpi" ka cenuar garancitë procedurale të lirisë personale të kërkueses, në kuptimin nëse interpretimi i ligjit ka qenë haptazi i paarsyeshëm, pra në atë masë sa rezultati në tërësi i kontrollit gjyqësor që gjykatat e zakonshme i kanë bërë kohëzgjatjes së masës së sigurimit është i padrejtë.

36. Në parantezë të analizës së këtij argumenti, Gjykata rithekson se interpretimi i ligjit është detyrë e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, në veçanti e Gjykatës së Lartë, për qëllime të procesit gjyqësor që ato zhvillojnë, ndërsa detyra e kësaj Gjykate është të shqyrtojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese (*shih vendimet nr. 33, datë 14.11.2022; nr. 3, datë 23.02.2016; nr. 42, datë 07.07.2014 të Gjykatës Kushtetuese*). Megjithatë, kur interpretimi i ligjit nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm ka cenuar parimet, standardet ose të drejtat kushtetuese, atëherë çështja i nënshtrohet kontrollit kushtetues (*shih vendimet nr. 63, datë 20.11.2023; nr. 19, datë 04.04.2023; nr. 19, datë 07.07.2022 të Gjykatës Kushtetuese*). Për këtë arsye, sikurse u theksua më sipër (*shih paragrafin 25 të vendimit*), në kushtet kur kërkuesja pretendon se interpretimi i ligjit nga Gjykata e Lartë i ka cenuar lirinë personale, Gjykata në vijim do të analizojë nëse interpretimi i ligjit nga Gjykata e Lartë, në kuptimin e garancive procedurale të lirisë personale në lidhje me masën e sigurimit "Arresti në shtëpi", është haptazi i paarsyeshëm.

37. Në këtë këndvështrim Gjykata vëren se krahas masës së sigurimit "Arresti në burg" (neni 238), KPP-ja si masë sigurimi që kufizon lirinë personale të individit parashikon edhe atë "Arresti në shtëpi", sipas së cilës individi urdhërohet të izolohet në shtëpi (neni 237). Nisur nga standardet e jurisprudencës së GJEDNJ-së, Gjykata thekson paraprakisht se të dyja masat e sigurimit të arrestit, ajo në burg dhe ajo në shtëpi, konsistojnë në privim të lirisë personale të individit, pasi pavarësisht nga vendi ku zbatohet masa e sigurimit të arrestit, në burg ose në shtëpi, ato passjellin izolim të tij. Gjithashtu, duke qenë kufizimi i lirisë personale të individit *ultima ratio*, pra vetëm kur masat e tjera nuk mund të arrijnë të njëjtin qëllim, KPP-ja krahas garancive të shumta procedurale, që kanë të bëjnë me procesin e rregullt ligjor, me të cilën vendosen këto masa, për të mbrojtur individin nga arbitrariteti në heqjen e lirisë ka parashikuar edhe kohëzgjatjen maksimale të masave të sigurimit dhe të drejtën e individit që të kërkojë nga gjykata e zakonshme shuarjen e masës, pra lirimin në rast se procedimi penal vijon për një kohë të gjatë. Arsyeja e kësaj garancie procedurale lidhet me nevojën për të mbrojtur individin nga arbitrariteti në rastin e kufizimit të lirisë personale, në kuptimin që të detyrojë organin procedues – prokurorinë dhe gjykatën, që në rastin e akuzave penale ndaj individit me heqje lirie të kryejnë veprimet sa më shpejt të jetë e mundur, ashtu siç parashikon neni 28, pika 3, i Kushtetutës dhe neni 5, paragrafi 3, i KEDNJ-së. Këto dispozita vënë theksin në

mënyrë të posaçme në të drejtën e të arrestuarit për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm.

38. Konkretisht, referuar kohëzgjatjes së afateve të masave të sigurimit, pika 2 e nenit 263 të KPP-së "Afatet e kohëzgjatjes së paraburgimit" parashikon se paraburgimi e humbet fuqinë në qoftë se nga dita e dorëzimit të akteve në gjykatë kanë kaluar afatet e përcaktuara në shkronjat "a", "b" dhe "c" (në varësi të veprës penale për të cilën bëhet procedimi) pa u dhënë vendimi i dënimit në shkallë të parë. Ndërkohë që pika 1 e nenit 267 të KPP-së "Afatet e kohëzgjatjes maksimale të masave të tjera të sigurimit" përcakton se masat shtrënguese, të ndryshme nga paraburgimi, e humbasin fuqinë kur nga fillimi i zbatimit të tyre ka kaluar një kohë e barabartë me dyfishin e afateve të parashikuara nga neni 263 i KPP-së.

39. Në rastin në shqyrtim, kërkuesja pas kalimit të 9 muajve nga vendosja e masës së arrestit në shtëpi, duke qenë se vendimi në shkallë të parë ende nuk ishte dhënë, bazuar në nenin 263, pika 2, shkronja "b", të KPP-së (për shkak të veprës penale për të cilën po procedohej), ka paraqitur kërkesë për shuarjen e masës së arrestit në shtëpi. Referuar në tërësi përmbajtjes së vendimeve të gjykatave të faktit dhe në veçanti atij të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, Gjykata vëren se nga interpretimi i dispozitave procedurale që lidhen me kohëzgjatjen maksimale të afateve të masave të sigurimit, ato kanë arritur në përfundimin se masa e sigurimit "Arresti në shtëpi" nuk mund të barazohet me masën e sigurimit "Arresti në burg". Konkretisht, Gjykata konstaton se gjykatat e faktit në thelb kanë arsyetuar se masa e sigurimit personal "Arresti në shtëpi" është e ndryshme nga ajo "Arresti në burg" dhe se në zbatim të nenit 263, pika 2, shkronja "b", që lidhet me veprën penale për të cilën procedohet kërkuesja, e interpretuar në lidhje me nenin 267, pika 1, të KPP-së, për atë masë do të zbatohet dyfishi i afateve të parashikuara nga neni 263 i KPP-së. Sipas atyre gjykatave, afati në rastin konkret ishte 18 muaj, afat ky që ende nuk ishte përmbushur, ndaj për rrjedhojë masa nuk e kishte humbur fuqinë e saj.

40. Ky qëndrim është mbajtur edhe nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, i cili ka arsyetuar se ndaj kërkueses rezulton të jetë caktuar masa e sigurimit "Arresti në shtëpi" dhe jo "Arresti në burg", sikurse parashikon neni 263 i KPP-së. Ai kolegj ka vlerësuar se do të duhet të mbahen në konsideratë përcaktimet eksplicite të nenit 267 të KPP-së, se masat shtrënguese, të ndryshme nga paraburgimi, e humbasin fuqinë kur nga fillimi i zbatimit të tyre ka kaluar një kohë e barabartë me dyfishin e afateve të parashikuara nga neni 263 i KPP-së. Në arsyetimin e saj ajo gjykatë argumenton se

pavarësisht parashikimit të pikës 4 të nenit 237 të KPP-së, ku thuhet se *"për kohëzgjatjen e arrestit në shtëpi vlejnë rregullat e caktuara për paraburgimin"*, e cila ngjan sikur ka kundërthënie me parashikimet e nenit 267, pika 1, të KPP-së, në qëllim parashikimet e këtyre dispozitave janë në harmoni dhe nuk dublojnë ose kundërshtojnë aspak njëra-tjetrën. Në rastin konkret, sipas interpretimit të bërë nga Gjykata e Lartë, përcaktimet e nenit 237, pika 4, të KPP-së lidhen me përshtatshmërinë e rregullave të caktuara për paraburgimin gjatë kohëzgjatjes së masës së sigurimit.

41. Gjithashtu, në arritjen e këtij konkluzioni, Gjykata e Lartë mbështetet te metodat e interpretimit të dispozitave dhe ligjit, si dhe në prezumimin se kohëzgjatja e zbatimit të masave të sigurimit përcaktohet në proporcion me shkallën e rëndësisë dhe të kufizimit të lirisë së individëve. Sipas saj, referuar metodës së interpretimit qëllimor (teleologjik) dhe atij literal (gjuhësor) nxirret konkluzioni se ligjvënësi ka synuar të diferencojë rëndësinë dhe peshën e masës së sigurimit shtrëngues "Arresti në burg" në raport me masat e tjera shtrënguese, duke përcaktuar shprehimisht kohëzgjatjen maksimale në një dispozitë të posaçme (nenin 263 të KPP-së). Qëllimi i kësaj dispozite, sipas Gjykatës së Lartë, del qartësisht si në titullin e saj, ashtu edhe në përmbajtje, ku përmendet vetëm fjala "paraburgim". Me interpretim "*a contrario*", nëse ligjvënësi do të kishte synuar që në këto afate të kishte përfshirë edhe masën "Arresti në shtëpi", neni 263 i KPP-së do të duhej ta citonte atë në tekstin e kësaj norme. Gjithashtu, në arsyetim elaborohet edhe koncepti i kuptimit të termit "paraburgim", duke u interpretuar sipas nenit 7 të ligjit nr. 7942/1995. Si argument tjetër plotësues për termin "paraburgim", ajo gjykatë përdor edhe përcaktimet e neneve 3 dhe 21 të ligjit nr. 81/2020.

42. Në përfundim, ajo gjykatë ka vlerësuar se qëllimi i ligjvënësit në lidhje me afatet e kohëzgjatjes së çdo mase tjetër të ndryshme nga paraburgimi (arrest në burg) del që në titullin e dispozitës të nenit 267 të KPP-së "Afatet e kohëzgjatjes maksimale të masave të tjera të sigurimit". Referuar kësaj analize, arsyeton ajo, arrihet në konkluzionin se neni 267 i KPP-së është i posaçëm për sa i përket kohëzgjatjes maksimale të masave të sigurimit të ndryshme nga paraburgimi, në raport me nenin 237 të KPP-së, që parashikon në tërësi modalitetet përmbajtësore dhe procedurale të caktimit të masës "Arresti në shtëpi", duke përfshirë edhe mënyrën e ekzekutimit dhe mbikëqyrjes së saj. Duke e konsideruar korpusin ligjor si një tërësi normash logjike e të ndërlidhura racionalisht dhe logjikisht me njëra-tjetrën, Gjykata e Lartë evidenton se nëse do të pranohej që afatet

maksimale të "Arrestit në burg" (paraburgimi) do të ishin të njëjta me ato "Arresti në shtëpi", do të rezultonte se rëndësia dhe shkalla e kufizimit të lirisë në një institucion paraburgimi dhe në shtëpi për personat nën hetim do të ishin të njëjta. Kjo hipotezë, arsyeton ajo në vijim, do të reflektonte paqartësi për nevojën për të parashikuar dy masa të ndryshme në ligj, por me të njëjtën rëndësi dhe shkallë kufizimi të lirisë. Gjykata e Lartë thekson se masa e sigurimit "Arresti në burg" nuk konsiderohet e njëjtë me "Arresti në shtëpi", duke analizuar dhe interpretuar frymën e pikës 1 të nenit 266 të KPP-së, përderisa kjo dispozitë parashikon mundësinë e caktimit të masave të tjera të sigurimit, pa asnjë përjashtim, kur kanë mbaruar afatet e paraburgimit, që nënkupton se masat e sigurimit janë të ndryshme ndërmjet njëra-tjetrës dhe nuk mund të përjashtojnë njëra-tjetrën për shkak të kalimit të afatit maksimal në zbatimin e tyre.

43. Gjykata vëren se Gjykata e Lartë ndonëse e gjendur përpara një rregulli ligjor, i cili literalisht parashikon se "*për kohëzgjatjen e arrestit në shtëpi vlejnë rregullat e caktuara për paraburgimin"* (neni 237, pika 4, i KPP-së), pra me përmbajtje të qartë, duke përdorur disa metoda interpretimi ligjor, duket se ka krijuar në fakt normë të re procedurale (penale), sipas së cilës kohëzgjatja e masës së sigurimit "Arresti në shtëpi" është sa dyfishi i masës së sigurimit "Arresti në burg". Duke vepruar në këtë mënyrë, Gjykata e Lartë ka zhvendosur qëllimin e garancisë ligjore nga ajo për mbrojtjen e individit nga arbitrariteti në kufizimin e lirisë personale në rastet kur procedimi penal zgjat në mënyrë të paarsyeshme, në atë për t'i dhënë dyfishin e kohës organeve publike (në këtë rast prokurorisë dhe gjykatave) për të zhvilluar hetimet dhe gjykimin, duke tejkaluar qëllimin e ligjit. Në këtë pikë, Gjykata nuk vë në dyshim se masa e sigurimit "Arresti në shtëpi" është e një shkalle më të vogël vuajtjeje sesa "Arresti në burg", arsye për të cilën ligji procedural parashikon afate të ndryshme të konvertimit të tyre dhe konkretisht për arrestin në burg si masë sigurimi 1 ditë paraburgim konvertohet në 1.5 ditë burg (neni 57 i KP-së) dhe për arrestin në shtëpi 1 ditë arrest në shtëpi barazohet në 1 ditë burg (neni 7 i ligjit nr. 7942/1995). Gjithsesi, pavarësisht vendit ku zbatohet masa e sigurimit të arrestit, Gjykata, në të njëjtën linjë me jurisprudencën e GJEDNJ-së, vlerëson se ndaj individit duhet të zbatohen të njëjtat kritere për të gjithë periudhën e kufizimit të lirisë, përfshirë afatin e llogaritjes së kohëzgjatjes maksimale të tyre. Prandaj nuk ka arsye për të pasur një qasje të ndryshme edhe në lidhje me llogaritjen e këtyre afateve për arrestin në shtëpi në raport me arrestin në burg.

44. Edhe sipas Gjykatës së Kasacionit italian afatet maksimale të kohëzgjatjes të përcaktuara nga neni 303 i KPP-së, që ka të bëjë me kohëzgjatjen maksimale të masave të sigurisë personale me heqje lirie, i referohen paraburgimit paraprak në përgjithësi, domethënë një kategorie më të gjerë sesa paraburgimi paraprak në burg. Ky i fundit në lidhje me paraburgimin në përgjithësi qëndron në një raport të rregullit të posaçëm me atë të përgjithshëm. Si pasojë, kushtet e parashikuara nga dispozita e lartpërmendur zbatohen edhe për arrestin në shtëpi dhe nuk zbatohen ato të përmendura në nenin pasues 308 të KPP-së, që ka të bëjë me kohëzgjatjen maksimale të masave të tjera të ndryshme nga ato të sigurisë personale me heqje lirie, duke pasur parasysh se paragrafi i pestë i nenit 284 të KPP-së që parashikon arrestin në shtëpi e barazon atë me paraburgimin paraprak (*shih vendimin nr. 1536/1993*).

45. Parë në këtë këndvështrim, Gjykata vlerëson se mënyra e interpretimit nga ana e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm të neneve 263 dhe 267 të KPP-së në lidhje me pikën 4 të nenit 237 të tij, duke përcaktuar se për afatet e kohëzgjatjes maksimale të masave të sigurimit, afatet për arrestin në shtëpi nuk mund të barazohen me afatet për masën e sigurimit "Arresti në burg", jo vetëm nuk u përshtatet standardeve kushtetuese e konventore, por edhe nuk ka garantuar në mënyrë efektive lirinë personale. Ashtu sikurse ka pohuar Gjykata, dispozitat e KPP-së nuk mund të interpretohen nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë në mënyrë të ngushtë, pasi të drejtat individuale duhet të interpretohen gjithmonë në atë mënyrë që të jenë efektive (*shih vendimet 17, datë 13.03.2024; nr. 13, datë 07.03.2024 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këto kushte, duke qenë se kriteret dhe procedurat për caktimin dhe kontrollin gjyqësor të masave të sigurimit, përfshirë afatet e kohëzgjatjes së tyre, janë drejtpërdrejt të lidhura me respektimin e lirisë personale, Gjykata vlerëson se interpretimi i dispozitave procedurale penale nga ana e gjykatave të faktit dhe Gjykatës së Lartë nuk duket të jetë i arsyeshëm, duke i cenuar në këtë mënyrë kërkueses lirinë personale.

46. Në përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkueses për cenimin e lirisë personale për shkak të interpretimit të dispozitave procedurale janë të bazuara sipas arsyetimit të mësipërm, ndaj vendimet e të tria gjykatave të zakonshme duhet të shfuqizohen dhe kërkesa të pranohet. Megjithatë, në këtë rast, për shkak se masa e sigurimit "Arresti në shtëpi" tashmë është shuar, Gjykata vlerëson të shprehet vetëm për konstatimin e cenimit të lirisë personale, në kushtet kur pavarësisht konstatimit të shkeljes

së kësaj lirie dërgimi i çështjes për rishqyrtim në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm nuk do të sillte ndonjë rezultat konkret për kërkuesen.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, si dhe neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, njëzëri,

V E N D O S I:

1. Pranimin e kërkesës.

2. Shfuqizimin e vendimeve nr. 457, datë 27.10.2022 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar; nr. 171, datë 09.11.2022 të Gjykatës së Posaçme të Apelit kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar; nr. 00-2024-1625 (195), datë 24.07.2024 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

3. Konstatimin e cenimit të lirisë personale.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 17.06.2025
Shpallur më 16.07.2025

Vendim nr. 41, datë 24.06.2025
(V-41/25)

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Holta Zaçaj, Kryetare, Marsida Xhaferllari, Fiona Papajorgji, Sonila Bejtja, Sandër Beci, Ilir Toska, Genti Ibrahimi, Marjana Semini, anëtarë, me sekretare Belma Lleshi, në datat 04.06.2025 dhe 24.06.2025 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve kërkesën nr. 19 (F) 2024 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: **FATOS GJINI,** përfaqësuar nga avokat Arseni Mema, me prokurë.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:
DREJTORIA E POLICISË E QARKUT VLORË,
KOMISARIATI I POLICISË DELVINË,
të përfaqësuar me autorizim nga juriste Ergita Shanaj.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2022-3138 (393), datë 22.11.2022 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

BAZA LIGJORE: **Nenet 42, 49, 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut *(KEDNJ);* nenet 71 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).**

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Holta Zaçaj, mori në shqyrtim parashtrimet me shkrim të kërkuesit Fatos Gjini (*kërkuesi*), i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjekteve të interesuara, Drejtorisë së Policisë të Qarkut Vlorë (*DPQ)* dhe Komisariatit të Policisë Delvinë *(Komisariati i Delvinës)*, që kanë kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I
Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi ka qenë në marrëdhënie pune në DPQ-në, Vlorë, me detyrë "ndihmësspecialist" në Komisariatin e Delvinës sipas urdhrit nr. 7/4, datë 05.01.2009 të DPQ-së, Vlorë. Me urdhrin nr. 57/20, datë 23.04.2014 të DPQ-së, Vlorë, kërkuesi është liruar nga detyra me motivacionin se është pranuar në radhët e policisë në kundërshtim me kriteret ligjore, pasi ka qenë edhe më parë i përjashtuar, sipas nenit 57, pika 1, të ligjit nr. 9749, datë 04.06.2007 "Për Policinë e Shtetit" (*ligji nr. 9749/2007*), neneve 46 dhe 62, pika 5, shkronja "ç", të "Rregullores së Personelit të Policisë së Shtetit", "Procedurat Standarde për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore", të miratuar me urdhrin nr. 1277, datë 11.11.2009 të drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

2. Duke mos qenë dakord me këtë akt, në datën 05.05.2014 kërkuesi i është drejtuar me padi Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër, kundërdrejtuar DPQ-së, Vlorë dhe Komisariatit të Delvinës, me objekt: (i) shfuqizimin e urdhrit nr. 57/20, datë 23.04.2014 të DPQ-së, Vlorë; (ii) rikthimin në detyrë; (iii) detyrimin e palës së paditur t`i paguajë pagën.

3. Me vendimin nr. 421, datë 19.06.2014, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastër ka pranuar pjesërisht padinë, duke detyruar DPQ-në, Vlorë t'i paguajë kërkuesit 12 paga mujore dëmshpërblim për lirimin nga detyra. Për kërkimin për shfuqizimin e urdhrit të lirimit dhe rikthimin në detyrë të kërkuesit, ajo gjykatë ka vendosur rrëzimin e padisë, pasi ligji specifik nuk parashikon kthimin në detyrë.

4. Për ankimin e palës së paditur, DPQ-së, Vlorë, Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 1122, datë 21.05.2015, ka vendosur ndryshimin

e vendimit të gjykatës së shkallës së parë vetëm për kërkimin e parë të padisë, duke shfuqizuar urdhrin nr. 57/20, datë 23.04.2014 të DPQ-së, Vlorë, me arsyetimin se shkaku i ndërprerjes së marrëdhënies së punës është i pambështetur në ligj. Sipas saj, gjykata e shkallës së parë duhet të kishte vendosur shfuqizimin e urdhrit të lirimit dhe zgjidhjen e pasojave. Kundër këtij vendimi, në datën 15.06.2015, ka paraqitur rekurs pala e paditur në procesin gjyqësor, DPQ-ja, Vlorë.

5. Pas vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit, me urdhrin nr.603/1, datë 04.04.2022 "Për rikthimin në Policinë e Shtetit dhe emërimin në detyrë të z. Fatos Gjini", të drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit dhe urdhrin nr.750, datë 06.04.2022 "Për rikthimin në Policinë e Shtetit dhe emërimin në detyrë të z. Fatos Gjini" të drejtorit të Drejtorisë Vendore të Policisë Vlorë, është bërë rikthimi i kërkuesit në Policinë e Shtetit dhe emërimi në detyrë si oficer i Patrullës së Përgjithshme Shqiponja/Motorist në Seksionin e Rendit Publik, në Komisariatin e Policisë Sarandë në Drejtorinë Vendore të Policisë Vlorë.

6. Ndërkohë, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2022-3138 (393), datë 22.11.2022, ka vendosur ndryshimin e vendimeve të gjykatave të faktit dhe rrëzimin e padisë, me arsyetimin se bazuar në ligjin nr. 9749/2007 dhe VKM-në nr. 804, datë 21.11.2007 "Rregullorja e personelit të Policisë së Shtetit", dalë në zbatim të këtij ligji, personat e përjashtuar nga policia nuk kanë të drejtë rikthimi në strukturat e policisë, përveç rastit kur akti i përjashtimit është: i) revokuar ose shfuqizuar nga vetë organi publik; ii) shfuqizuar ose deklaruar absolutisht i pavlefshëm me vendim gjyqësor të formës së prerë. Sipas Gjykatës së Lartë, gjykatat e faktit kanë interpretuar në mënyrë të gabuar ligjin material të zbatueshëm për zgjidhjen e mosmarrëveshjes.

7. Në vijim, me urdhrin nr. 5695, datë 17.10.2024 të drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit, kërkuesi është liruar nga detyra.

8. Në datën 11.11.2024 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij. Në datën 21.01.2025 Kolegji i Gjykatës ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve. Në seancën plenare mbi bazë të dokumenteve të datës 04.06.2025, Gjykata ka vendosur shtyrjen e saj me qëllim kërkimin e informacionit dhe të materialeve shtesë nga kërkuesi, si dhe nga subjektet e interesuara.

9. Në vijim, Gjykata ka bërë njoftimin e palëve, për caktimin e seancës plenare mbi bazë të dokumenteve në datën 24.06.2025.

II
Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

10. ***Kërkuesi,*** në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se vendimi i kundërshtuar i ka cenuar:

10.1. *Të drejtën për një proces të rregullt ligjor*, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së, në drejtim të:

10.1.1. *Parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit,* pasi Gjykata e Lartë i ka mohuar të drejtën për të paraqitur kundërrekurs dhe parashtrime përpara seancës gjyqësore, për shkak të moskomunikimit të rekursit të palës së paditur, ndonëse në vendimin e saj ajo gjykatë shprehet, ndër të tjera, se rekursi i është komunikuar rregullisht palës paditëse (kërkuesit) dhe se ai nuk ka paraqitur kundërrekurs për mbrojtjen e tij.

10.1.2. *Së drejtës së aksesit substancial të lidhur me të drejtën për t'u njoftuar, për t'u mbrojtur e për t'u dëgjuar,* pasi Gjykata e Lartë me mosnjoftimin e rekursit i ka hequr të drejtën të ndjekë vijueshmërinë e çështjes së tij, ndërsa kërkuesi është njohur me vendimin e saj vetëm pas urdhrit të lirimit të tij nga detyra.

10.2. *Të drejtën për punë dhe për të fituar mjetet e jetesës,* të parashikuar nga neni 49 i Kushtetutës, pasi Gjykata e Lartë ka lënë në fuqi aktet që e hiqnin kërkuesin nga puna.

11. ***Subjektet e interesuara,*** DPQ-ja, Vlorë dhe Komisariati i Delvinës, në mënyrë të përmbledhur, kanë parashtruar se rekursi i paraqitur prej tyre nuk paraqet të meta, ndërkohë që detyrimin për të njoftuar palët ndërgjyqëse e ka Gjykata e Lartë. Në vijim të vendimmarrjes së Kolegjit Administrativ, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit është venë menjëherë në lëvizje për ndjekjen e procedurave ligjore për ekzekutimin e vendimit.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkuesit

12. Çështja e legjitimimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1,

shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

13. Në këtë këndvështrim, kërkuesi, si individ, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të shkronjës "f" të pikës 1 të nenit 131 dhe shkronjës "i" të pikës 1 të nenit 134 të Kushtetutës, pasi është palë në çështjen objekt të ankimit kushtetues individual, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të këtij gjykimi.

14. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës, Gjykata vëren se kërkuesi i është drejtuar asaj me ankim kushtetues individual, duke ngritur pretendime për procesin gjyqësor të zhvilluar në Gjykatën e Lartë, për të cilin nuk ka mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të tij kushtetuese përveç ankimit kushtetues individual.

15. Për sa i përket legjitimimit *ratione temporis*, bazuar në nenin 71/a, pika 1, shkronja "b", të ligjit nr. 8577/2000, afati për paraqitjen e ankimit kushtetues individual është 4 muaj nga konstatimi i cenimit të së drejtës. Gjykata, duke mbajtur në konsideratë se pretendimi kryesor i kërkuesit lidhet me faktin që nuk ka marrë dijeni për rekursin e subjektit të interesuar dhe rrjedhimisht as për procesin dhe vendimmarrjen e Gjykatës së Lartë, si dhe faktin që në dosjen gjyqësore nuk ka ndonjë akt që të provojë njoftimin e tij, çmon të konsiderojë si momentin nga i cili ka filluar të ecë afati ligjor 4-mujor për paraqitjen e ankimit kushtetues datën 17.10.2024, kur kërkuesi parashtron se i është komunikuar urdhri i lirimit nga detyra në ekzekutim të vendimit të Gjykatës së Lartë. Për rrjedhojë, kërkuesi legjitimohet edhe *ratione temporis.*

16. Për sa i takon legjitimimit *ratione materiae*, Gjykata vëren se kërkuesi ka ngritur disa pretendime për procesin e zhvilluar nga Gjykata e Lartë në drejtim të parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit, së drejtës së aksesit substancial të lidhur me të drejtën për t'u njoftuar, për t'u mbrojtur e për t'u dëgjuar, për shkak se nuk është njoftuar për rekursin

e palës kundërshtare në proces, duke i hequr mundësinë për të paraqitur kundërrekurs dhe parashtrime përpara seancës gjyqësore, si dhe të ndjekë vijueshmërinë e çështjes së tij. Sipas tij, kjo i ka cenuar të drejtën për të fituar mjetet e jetesës së tij me punë të ligjshme. Nisur nga thelbi i pretendimeve, Gjykata çmon t'i analizojë ato në drejtim të së drejtës së aksesit substancial lidhur me të drejtën për t'u njoftuar dhe për t'u mbrojtur.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e së drejtës së aksesit substancial të lidhur me të drejtën për t'u njoftuar dhe për t'u mbrojtur

17. Kërkuesi ka pretenduar se Gjykata e Lartë i ka mohuar të drejtën për të paraqitur kundërrekurs dhe parashtrime përpara seancës gjyqësore, për shkak të moskomunikimit të rekursit të palës së paditur, ndonëse në vendimin e saj ajo gjykatë shprehet, ndër të tjera, se rekursi i është komunikuar rregullisht palës paditëse (kërkuesit) dhe se ai nuk ka paraqitur kundërrekurs për mbrojtjen e tij. Po kështu, sipas kërkuesit, Gjykata e Lartë me mosnjoftimin e rekursit i ka hequr të drejtën të ndjekë vijueshmërinë e çështjes së tij, pasi është njohur me vendimin e Gjykatës së Lartë vetëm pas lëshimit të urdhrit të lirimit nga detyra. Gjykata e Lartë ka lënë në fuqi aktet që e hiqnin atë nga puna.

18. Subjektet e interesuara kanë pretenduar se rekursi i paraqitur prej tyre nuk paraqet të meta, ndërkohë që detyrimin për të njoftuar palët ndërgjyqëse e ka Gjykata e Lartë, si dhe në vijim të vendimmarrjes së Kolegjit Administrativ, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit është vënë menjëherë në lëvizje për ndjekjen e procedurave ligjore për ekzekutimin e vendimit.

19. Neni 42, pika 2, i Kushtetutës sanksionon të drejtën për gjykim, ku e drejta e aksesit, që është e drejta për të vënë në lëvizje Gjykatën, përbën një aspekt të saj. E drejta e aksesit u garanton subjekteve të cenuara të drejtën t'i drejtohen një gjykate, e cila do t'i dëgjojë pretendimet e tyre dhe do të shpallë një vendim pas një gjykimi të drejtë dhe publik. Kjo e drejtë e individit nuk përfshin vetëm të drejtën për të vënë në lëvizje Gjykatën, por edhe të drejtën për të pasur prej saj një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pasi aksesi në gjykatë duhet të jetë substancial dhe jo thjesht formal (*shih vendimet nr. 31, datë 03.11.2022; nr. 22, datë 29.04.2021; nr. 3, datë 23.02.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Gjykata në jurisprudencën e saj ka përcaktuar disa standarde kushtetuese, të cilat janë të lidhura nga pikëpamja organike dhe funksionale

me njëra-tjetrën në mënyrë të tillë që cenimi i njërit standard ndikon në mënyrë të pashmangshme në cenimin e të tjerave. Konkretisht, e drejta për t'u njoftuar për një gjykim dhe pjesëmarrja në të është e lidhur me vendimmarrjen e gjykatës, e cila ndikon drejtpërsëdrejti në të drejtat subjektive ose interesat e ligjshëm të individit. E drejta për t'u njoftuar për të marrë pjesë në gjykim u paraprin të drejtave të tjera, pasi nëse pala ndërgjyqëse nuk njoftohet për datën dhe orën e seancës, ajo detyrimisht do të gjendet në pamundësi objektive për të ushtruar të drejtat që i garantohen nga neni 42 i Kushtetutës, në kuadrin e një procesi të rregullt ligjor. Nga ana tjetër, e drejta për të marrë pjesë në gjykim krijon të njëjtat mundësi për të paraqitur prova dhe argumente në mbrojtje të interesave vetjakë në raport me palën kundërshtare *(shih vendimet nr. 8, datë 23.02.2021; nr. 37, datë 30.06.2016 të Gjykatës Kushtetuese)*.

21. E drejta e palës për t'u njoftuar për argumentet e faktet e parashtruara në ankimin e palës tjetër është pjesë e së drejtës së individit për një proces të rregullt, nëpërmjet së cilës atij i krijohet mundësia të përgatisë mbrojtjen e vet e të parashtrojë argumentet ndaj pretendimeve të palës tjetër (*shih vendimet nr. 18, datë 04.04.2023; nr. 5, datë 26.01.2007; nr.15, datë 13.07.2005 të Gjykatës Kushtetuese).*

22. Për sa i takon procesit në Gjykatën e Lartë, kjo e fundit, pavarësisht nëse i shqyrton çështjet në seancë të hapur publike ose mbi bazë të dokumenteve, ka detyrimin të verifikojë nëse palët në proces kanë marrë dijeni efektivisht për rekursin dhe procesin, me qëllim garantimin e së drejtës së mbrojtjes dhe të parimit të barazisë së armëve në gjykim. Vetëm njoftimi me shpallje nuk nënkupton përmbushjen e detyrimit të sekretarisë së Gjykatës së Lartë për njoftimin e rregullt të palëve, në mënyrë që ato të mund të marrin pjesë në gjykim, si dhe të dëgjohen e të mbrohen me anë të paraqitjes së komenteve ose prapësimeve. (*shih vendimet nr. 14, datë 21.03.2023; nr. 28, datë 01.11.2022; nr. 21, datë 04.04.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

23. Gjykata vëren se referuar akteve të dosjes gjyqësore të administruar për efekt të këtij shqyrtimi, konstatohet se pas përfundimit të gjykimit në gjykatën e apelit, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastër, me dëftesën e komunikimit nr. 329 akti, datë 19.06.2015, i ka dërguar kërkuesit një kopje të rekursit të palës së paditur në adresën e vendbanimit të tij në Metoq, Sarandë (marrë nga të dhënat e kërkuesit në kërkesëpadi). Dëftesa e komunikimit është nënshkruar për efekt të marrjes dijeni nga shtetasja E.B. në datën 02.07.2015. Në vijim, pas më shumë se 7 vjetëve

nga paraqitja e rekursit, në datën 04.11.2022 gjyqtari relator në Gjykatën e Lartë ka caktuar datën 22.11.2022 për shqyrtimin e çështjes në dhomën e këshillimit, duke urdhëruar sekretarinë e gjykatës të bëjë njoftimin e palëve. Në datën 04.11.2022 Gjykata e Lartë ka shpallur listën e çështjeve administrative për shqyrtim në dhomën e këshillimit në datën 22.11.2022, përfshirë edhe çështjen e kërkuesit. Gjithashtu, njoftimi për shqyrtimin e çështjes së kërkuesit rezulton të jetë shpallur edhe në faqen elektronike të Gjykatës së Lartë në rubrikën *"Lista e çështjeve administrative për shqyrtim"* në dhomën e këshillimit, datë 22.11.2022. Në procesverbalin e shqyrtimit të çështjes në Gjykatën e Lartë, që mban datën 22.11.2022, ora 10:50, është shënuar se palët janë njoftuar rregullisht.

24. Gjykata vëren se më herët Gjykata Administrative e Apelit i ka dërguar kërkuesit kopje të vendimit të saj me njoftim vendimi nr. 7193/2635 akti, datë 02.06.2015, i cili rezulton i nënshkruar për marrje dijeni nga shtetasja E.Ç. në datën 02.06.2015 me shënimin "*Vendimi është tërhequr në sekretari*". Ndërkohë dëftesat e komunikimit nr. 376 akti, datë 23.06.2014 dhe nr. 376 akti, datë 21.07.2014 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër rezultojnë të nënshkruara për marrje dijeni nën emrin e kërkuesit në datën 09.07.2014 dhe në datën 23.07.2014.

25. Në analizë të fakteve të mësipërme, Gjykata konstaton se për sa i takon njoftimit të akteve gjyqësore, nenet 130 dhe 131 të Kodit të Procedurës Civile, sipas përmbajtjes së tyre në kohën e depozitimit të rekursit (datë 19.06.2015), si rregull, parashikonin njoftimin me shkresë, që konsistonte në dorëzimin e kopjes së aktit të njoftimit personit që përcaktohej si marrës, kudo ku ai gjendej dhe, në pamundësi, njoftimi bëhej në vendbanimin ose vendqëndrimin e marrësit ose në zyrën, ose vendin ku ushtron veprimtarinë tregtare, industriale ose të artizanatit, duke ia dorëzuar aktin personalisht marrësit, një personi të familjes që ka mbushur moshën gjashtëmbëdhjetë vjeç, fqinjëve që pranojnë t'ia dorëzojnë atë marrësit, zyrës ose qendrës së punës së tij ose portierit të ndërtesës së banimit, të zyrës, ose të qendrës së punës. Në rastin konkret, kërkuesit i është dërguar vendimi i gjykatës së apelit dhe rekursi në adresën e caktuar nga ai në kërkesëpadi, nëpërmjet dëftesave të komunikimeve përkatëse, të cilat te rubrika e marrjes dijeni janë nënshkruar nga dy persona të ndryshëm, për të cilët nuk ka informacion të lidhjes së tyre me kërkuesin. Me shkresën e datës 11.06.2025, përfaqësuesi ligjor i kërkuesit, në përgjigje të informacionit të kërkuar, ka informuar Gjykatën se as kërkuesi e as ndonjë pjesëtar ose i afërm i tij nuk ka marrë dijeni dhe as ka firmosur

dëftesën e komunikimit nr.329 akti, datë 19.06.2025, si dhe shtetasja E.B., e cila ka firmosur këtë dëftesë komunikimi, nuk njihet nga kërkuesi ose nga ndonjë pjesëtar, apo i afërm i tij. Ky pretendim nuk është kundërshtuar nga subjektet e interesuara.

26. Gjykata vëren se bazuar në aktet e dosjes gjyqësore, kërkuesi nuk është njoftuar për rekursin e palës së paditur, DPQ-së Vlorë, duke u vënë kështu në pamundësi objektive jo vetëm për të marrë dijeni për vënien në lëvizje të procesit gjyqësor në Gjykatën e Lartë, por edhe për të ushtruar të drejtat e tij që i garantohen nga neni 42 i Kushtetutës, pra për të paraqitur, përmes kundërrekursit ose parashtrimeve në proces, pretendime në mbrojtje të interesave të tij ligjorë e kushtetues. Edhe pse Gjykata e Lartë ka detyrimin të verifikojë, në këndvështrim të garantimit të së drejtës së mbrojtjes dhe parimit të barazisë së armëve, nëse administrata gjyqësore ka marrë masat për të kryer njoftimin e rekursit palëve ndërgjyqëse, ajo nuk është ndalur në kryerjen e këtij vlerësimi.

27. Në kuptim të sa më sipër, pra të pasojave që i kanë ardhur kërkuesit nga mosnjoftimi i rekursit, Gjykata vlerëson se njoftimi i akteve me të cilat vihet në lëvizje një proces gjyqësor ka rëndësi në drejtim të pjesëmarrjes së individit në gjykim dhe të realizimit të të drejtave të tij kushtetuese. Po kështu, njoftimi në kohën e duhur i akteve gjyqësore përbën një garanci të domosdoshme si për të vënë në dijeni individin për procesin gjyqësor ku ai është palë, ashtu edhe për të garantuar pjesëmarrjen e tij në proces dhe ushtrimin e së drejtës së mbrojtjes dhe përdorimin e mjeteve procedurale në funksion të mbrojtjes së tij, siç është kundërrekursi ose prapësimet ndaj pretendimeve të palës tjetër në proces.

28. Gjykata thekson se pavarësisht se në procesin gjyqësor të zhvilluar në Gjykatën e Lartë kjo e fundit, përmes administratës gjyqësore, ka kryer njoftimin e datës së zhvillimit të seancës gjyqësore në përputhje me parashikimet procedurale të zbatueshme në atë gjykim, kjo nuk është e mjaftueshme për të korrigjuar dhe për të riparuar të metat e evidentuara në drejtim të njoftimit të rekursit, të cilat kanë sjellë si pasojë humbjen nga ana e kërkuesit të së drejtës për të paraqitur kundërrekurs dhe argumente ligjore në kundërshtim të pretendimeve të palës kundërshtare, si dhe për të parashtruar qëndrimin dhe pretendimet e saj për zgjidhjen e çështjes. Mënyra sesi kanë vepruar gjykatat, në rastin konkret, e kanë vënë kërkuesin në pamundësi të ushtrojë të drejtën e tij të mbrojtjes ndaj shkaqeve të rekursit dhe në këtë mënyrë procesi nuk ka garantuar respektimin e parimit të barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit.

29. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se mangësitë në njoftimin e rekursit dhe pasojat që kanë sjellje ato përbejnë shkelje thelbësore që e bëjnë procesin të parregullt në kuptimin kushtetues, për sa kohë kanë pasur ndikim në të drejtën e aksesit të kërkuesit, pra në të drejtën për t`iu drejtuar Gjykatës së Lartë dhe për të marrë një përgjigje përfundimtare për pretendimet e tij, për rrjedhojë edhe në të drejtën për t'u dëgjuar në atë gjykatë në respektim të parimit të barazisë së armëve. Për sa më lart, Gjykata çmon se shkeljet e konstatuara kanë pasur ndikim të drejtpërdrejtë në procesin e zhvilluar në Gjykatën e Lartë, duke e bërë atë proces të parregullt në kuptimin kushtetues, ndaj pretendimi i kërkuesit është i bazuar.

30. Në përfundim Gjykata çmon se pretendimet e kërkuesit janë të bazuara, sipas arsyetimit të mësipërm, ndaj kërkesa pranohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, si dhe neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, njëzëri,

V E N D O S I:

1. Pranimin e kërkesës.

2. Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2022-3138 (393), datë 22.11.2022 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

3. Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 24.06.2025
Shpallur më 28.07.2025

Vendim nr. 42, datë 01.07.2025
(V-42/25)

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Holta Zaçaj, Kryetare, Marsida Xhaferllari, Fiona Papajorgji, Sonila Bejtja, Sandër Beci, Genti Ibrahimi, Marjana Semini, Ilir Toska, anëtarë, me sekretare Belma Lleshi, në datat 25.02.2025 dhe 23.06.2025 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 10 (S) 2024 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUESE: **SHOQËRIA "STUDIO PUSTINA" SH.P.K.**, përfaqësuar nga avokat Klodjan Skënderaj, me prokurë.

SUBJEKT I INTERESUAR:
PROKURORIA E POSAÇME KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR, përfaqësuar nga prokurorja Enkeleda Millonai.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimeve datë 28.04.2023 të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar; nr. 206, datë 01.06.2023 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 128, datë 15.09.2023 të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 00-2024-741 (26), datë 08.02.2024 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

BAZA LIGJORE: **Nenet 17, 37 dhe 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 6 dhe 8 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për**

organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Ilir Toska, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të shoqërisë "Studio Pustina" sh.p.k. (*kërkuesja*), e cila ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar, Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (*Prokuroria e Posaçme*), që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I
Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesja është person juridik i regjistruar në regjistrin tregtar në formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, me seli në Tiranë dhe ushtron veprimtarinë e saj në fushën e konsulencës dhe shërbimeve financiare, ekonomike prej vitit 2011, me ortake të vetme dhe administratore shtetasen A.P.

2. Në muajin dhjetor 2020 Prokuroria e Posaçme ka regjistruar procedimin penal nr. 287/2020 për veprën penale "Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale", të parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal (*KP*). Objekti i hetimit kishte të bënte me procesin e kthimit të pronës në favor të pesë familjeve ish-pronare, me procesin e privatizimit të pronës shtetërore (të objekteve të ish-klubit sportiv "Partizani"), si dhe me procesin e ndryshimit të destinacionit dhe më pas edhe të zhvillimit të pronës, nën dyshimin se për këto procese janë dhënë dhe marrë përfitime monetare, paligjshmëria në origjinën e të cilave është fshehur nëpërmjet veprimeve financiare, transaksioneve të copëzuara ose në *cash*, duke u favorizuar në mënyrë të paligjshme shtetasit J.M., Xh.B. dhe F.B., të cilët, sikundër edhe shoqëria "H." sh.p.k. e lidhur me ta, kanë realizuar në atë pronë ndërtimin e një blloku pallatesh.

3. Gjatë hetimeve paraprake ka rezultuar se zhvillimi i pronës është bërë nga shoqëria "H." sh.p.k., e krijuar në vitin 2008, me ortak të vetëm dhe administrator shtetasin F.B. (përfitues i një prej familjeve ish-pronare),

referuar dokumentacionit të saj, të sekuestruar në datën 24.01.2023, pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit *(QKB)*. Po sipas këtij dokumentacioni, shtetasit Xh.B. dhe J.M. (përfitues të një familjeje tjetër ish-pronare) janë bërë formalisht ortakë të shoqërisë në vitin 2018, me regjistrimin e kontratave për blerje kuotash, ndonëse ato datojnë në vitin 2014, ndërkohë që përgjatë kësaj periudhe shtetasi F.B. ka vijuar të sillet si ortak i vetëm dhe administrator i saj. Këtij të fundit, në datën 28.04.2023, ora 12:12, i janë marrë deklarime nga ka dalë e dhëna se dokumentacioni financiar i shoqërisë në lidhje me aktivitetin e ndërtimit në pronën objekt hetimi është mbajtur nga kërkuesja. Mbi dyshimin se në zyrën e saj mund të gjendeshin prova për gjendjen reale të ortakëve të shoqërisë "H." sh.p.k., investimet e tyre dhe ndarjen e fitimit në vite, të kamufluar në funksion të pastrimit të produkteve të veprës penale, me vendimin e së njëjtës datë, mbështetur në nenet 208 e vijues të Kodit të Procedurës Penale (*KPP*), prokurorët e çështjes kanë urdhëruar sekuestrimin në zyrën e kërkueses: i) të të gjitha dokumenteve që kishin lidhje me shoqërinë "H." sh.p.k.; ii) të kompjuterit në të cilin mbaheshin të dhënat e kësaj shoqërie; iii) të çdo gjëje tjetër që vlerësohej me rëndësi për hetimin dhe që ofronte të dhëna për faktin objekt hetimi (*vendimi i sekuestrimit*). Për kryerjen e sekuestrimit janë ngarkuar tre oficerë të policisë gjyqësore (*OPGJ*), hetues financiarë të Byrosë Kombëtare të Hetimit*,* të cilët janë urdhëruar të njihnin personat e interesuar me vendimin, për të cilin lejohej ankim sipas ligjit.

4. Po në datën 28.04.2023 OPGJ-të janë paraqitur në zyrën e kërkueses dhe kanë zbatuar vendimin e sekuestrimit në prani të përfaqësueses së saj, administratores A.P. Në procesverbalin e sekuestrimit, krahas orës së përpilimit, 15:30, OPGJ-të kanë evidentuar se ai mbahej në bazë të neneve 300 dhe 301 të KPP-së, në zbatim të vendimit të prokurorëve dhe në vijim kanë përshkruar "*Sendet/dokumentet e gjetura (apo të dorëzuara) nga shtetasja A.P., pronare e vetme e subjektit tregtar "Studio Pustina*" dhe konkretisht 4 pajisje kompjuterike (2 laptopë dhe 2 njësi qendrore) me të dhënat përkatëse të identifikimit, 407 dokumente shkresore (fatura tatimore, kontrata, akt-marrëveshje, raporte, mandatarkëtime, pasqyra financiare etj.) që lidhen me shoqërinë "H." sh.p.k. dhe 4 dokumente shkresore të tjera (pasqyra financiare) që në dukje u përkisnin subjekteve të tjera juridike. Procesverbali është nënshkruar rregullisht pa vërejtje edhe nga përfaqësuesja e kërkueses dhe asaj i është dhënë një kopje e tij.

5. Në datën 02.05.2023 përfaqësuesja A.P. e kërkueses është pyetur nga OPGJ-të në cilësinë e personit që ka dijeni për veprën penale, ndërsa ajo

ka dhënë deklarime për lidhjen e saj dhe të "Studio Pustina" me shoqërinë "H." sh.p.k., administratorin dhe ortakët e saj, si dhe për veprimet financiare të kryera për ata.

6. Ndërkohë, në datën 03.05.2023 kërkuesja ka paraqitur ankim në gjykatë kundër vendimit të sekuestrimit, duke kërkuar deklarimin e tij si të marrë në kundërshtim me nenin 208/a të KPP-së dhe kthimin e sistemeve kompjuterike të sekuestruara, si dhe konstatimin e veprimeve të OPGJ-ve si të kryera në shkelje të dispozitave të KPP-së për kontrollin e vendeve, për rrjedhojë në kundërshtim me nenin 37 të Kushtetutës dhe nenin 8 të KEDNJ-së.

7. Në datën 19.05.2023 Prokuroria e Posaçme, me arsyetimin se mbajtja e sekuestros nuk ishte e nevojshme, i ka kthyer kërkueses 1 nga pajisjet kompjuterike (laptop) të sekuestruara, duke vijuar mbajtjen nën sekuestro të 3 pajisjeve të tjera.

8. Për kërkesën ankimore të kërkueses, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (*GJKKO-ja e Shkallës së Parë*), me vendimin nr. 206, datë 01.06.2023, ka vendosur rrëzimin e saj. Sipas asaj gjykate, referuar procesverbalit të sekuestrimit, OPGJ-të kanë vepruar në bazë të neneve 300 dhe 301 të KPP-së dhe kërkueses i janë sekuestruar dokumentet që kishin lidhje me shoqërinë "H." sh.p.k., si dhe kompjuteri në të cilin mbaheshin të dhënat e kësaj shoqërie, duke vlerësuar se sekuestrimi është kryer në përputhje me nenin 208 të KPP-së. Po sipas saj, ndërsa çështja ndodhej në fazën e hetimeve, është detyrim i prokurorit të kryejë një hetim të plotë dhe shterues dhe sendet e sekuestruara duhet të vazhdojnë të qëndrojnë në këtë gjendje deri në përfundimin e hetimeve. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim kërkuesja.

9. Në vijim, në datën 07.06.2023 Prokuroria e Posaçme, me të njëjtin arsyetim për panevojshmërinë e mbajtjes së sekuestros, i ka kthyer kërkueses edhe 2 nga pajisjet e tjera kompjuterike (njësitë qendrore) të sekuestruara, duke vijuar mbajtjen nën sekuestro tashmë vetëm të njërës prej tyre.

10. Në lidhje me ankimin e kërkueses, Gjykata e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (*GJKKO-ja e Apelit*), me vendimin nr. 128 (87-2023-196), datë 15.09.2023, ka vendosur miratimin e vendimit të GJKKO-së së Shkallës së Parë. Sipas asaj gjykate, masa e sekuestrimit provues e zbatuar në rastin konkret rregullohet nga neni 208 i KPP-së, i cili i jep të drejtë edhe prokurorit për të vendosur për sekuestrimin ose kufizimin e disponimit të lirë të sendeve dhe provave materiale kur kjo është e

domosdoshme për vërtetimin e fakteve të caktuara të procedimit penal. Për nga qëllimi dhe "urgjenca" që paraqet, ky lloj sekuestrimi është kryesisht mjet i prokurorit, pasi ai drejton hetimet paraprake dhe njeh nevojat e procedimit penal. Pajisjet e sekuestruara, ndërsa janë të pandërlidhura në një rrjet/sistem kompjuterik, në referim të nenit 1 të Konventës "Për krimin në fushën e kibernetikës" (*Konventa e Budapestit*), nuk janë sisteme kompjuterike në kuptim të nenit 208/a të KPP-së, por veçse mekanizma të automatizuar ose sende në kuptim të nenit 187 të KPP-së, të cilat me të dhënat apo gjurmët që mund të përmbajnë, shërbejnë si prova materiale. Për rrjedhojë, disponimi i prokurorëve për sekuestrimin e sendeve dhe dokumenteve është në përputhje me nenin 208, pika 1, të kombinuar me nenet 187 dhe 191 të KPP-së, pasi ato lidhen dhe ofrojnë të dhëna për faktet objekt hetimi. Në lidhje me veprimet e OPGJ-ve, GJKKO-ja e Apelit ka vlerësuar se procesverbali i sekuestrimit dokumenton korrektësisht veprimet e kryera nga OPGJ-të, nga del qartazi se ato nuk janë veprime kontrolli sipas nenit 202 të KPP-së, ndaj, për rrjedhojë, ata kanë vepruar brenda hapësirës së veprimit të deleguar nga prokurorët, në përputhje me nenet 30, pikat 2 e 3 dhe 208, pika 2, të KPP-së. Kundër vendimit të GJKKO-së së Apelit kërkuesja ka paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë.

11. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-741(26), datë 08.02.2024, pasi ka shqyrtuar çështjen në seancë gjyqësore dhe ka dëgjuar palët, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të asaj gjykate, duke vlerësuar se në rekurs nuk ngrihen shkaqe për cenimin e vendimit të GJKKO-së së Apelit dhe se kjo e fundit ka arsyetuar në mënyrë shteruese në lidhje me pretendimet e ankueses (kërkueses). Sipas Gjykatës së Lartë, disponimi i prokurorëve për sekuestrimin e sendeve/dokumenteve është në përputhje me nenin 208 të KPP-së dhe me konkluzionet e vendimit njësues nr. 147/2021, ndërkohë që në këtë rast nuk është i zbatueshëm neni 208/a i KPP-së, pasi ai u referohet veprave penale që kanë të bëjnë me krime që lidhen me teknologjinë e informacionit. Ndërsa gjatë hetimeve paraprake është organi i prokurorisë ai që vlerëson se cilat sende/dokumente janë të nevojshme për hetimin dhe duhen sekuestruar, në rastin konkret ky organ, pasi ka identifikuar faktin se ankuesja ka pasur në administrim akte ose të dhëna në lidhje me shoqërinë "H." sh.p.k. dhe ka kryer veprime ekonomike ligjore për të, ka disponuar me vendimin e sekuestrimit të kundërshtuar nga ankuesja. Megjithatë, kjo e fundit nuk argumenton faktin se në pajisjet e sekuestruara nuk ndodhet asnjë e dhënë e kësaj shoqërie apo për personat nën hetim, ndërkohë që asaj, pas ekzaminimit, i janë kthyer disa prej tyre.

Po sipas Gjykatës së Lartë, në zbatim të vendimit të sekuestrimit, OPGJ-të, në vlerësim dhe për aq sa është e mundur të sendeve që kanë pasur të dhëna për shoqërinë në fjalë, i kanë sekuestruar ato sipas procesverbalit të sekuestrimit, me të cilin është njohur edhe përfaqësuesja e ankueses, ndërsa kjo e fundit nuk ka referuar në procesverbal asnjë problematikë për përmbajtjen dhe përkatësinë e sendeve dhe dokumenteve. Nga analiza e vendimit të sekuestrimit dhe e veprimeve të kryera nga OPGJ-të nuk konstatohet të jemi përpara një kontrolli, por ka një pasqyrim të qartë të qëllimit të sekuestrimit të sendeve/dokumenteve ku mund të ndodhen të dhëna të dobishme për hetimin. Për rrjedhojë, sipas asaj gjykate, nuk ndodhemi para veprimeve të cilat nuk kanë respektuar parashikimet e nenit 37 të Kushtetutës ose të nenit 8 të KEDNJ-së.

12. Në vijim të hetimeve paraprake, Prokuroria e Posaçme ka ngritur akuzë ndaj kërkueses, "Studio Pustina" sh.p.k. dhe ndaj administratores së saj, shtetases A.P., për kryerjen e veprës penale "Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale", të parashikuar nga neni 287, paragrafi i dytë, i KP-së, në formën e parashikuar nga shkronjat "b", "ç" dhe "dh" të tij, të kryer në bashkëpunim. Në datën 10.10.2024 Prokuroria e Posaçme ka paraqitur në GJKKO-në e Shkallës së Parë kërkesë për dërgimin për gjykim të çështjes penale edhe në ngarkim të kërkueses dhe administratores së saj, krahas disa subjekteve të tjerë, ndërsa këta të fundit janë akuzuar për veprat penale "Korrupsioni aktiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë", "Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë", në bashkëpunim apo edhe "Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale", të parashikuara nga nenet 245, 260 e 25 dhe 287 të KP-së.

13. Më herët, në datën 20.06.2024, kërkuesja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankimin kushtetues individual në shqyrtim, sipas objektit të tij. Kolegji i Gjykatës, me vendimin e datës 23.09.2024, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve dhe kjo e fundit, me vendimin e datës 22.10.2024, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

14. Ankimi kushtetues i kërkueses është shqyrtuar në seancën plenare mbi bazë të dokumenteve të datës 25.02.2025. Pas përfundimit të seancës trupa është tërhequr në dhomën e këshillimit për vendimmarrje dhe diskutimet kanë vijuar deri në datën 11.04.2025, kur Gjykata, bazuar në parashikimet e nenit 44, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000, ka vendosur riçeljen e seancës plenare mbi bazë të dokumenteve, duke vlerësuar të nevojshëm

sqarimin e rrethanave plotësuese me rëndësi për çështjen. Palët janë njoftuar për këtë vendim dhe u është kërkuar paraqitja e argumenteve me shkrim, përfshirë edhe të çdo prove relevante, në drejtim të disa aspekteve konkrete të gjykimit kushtetues. Në vijim, seanca plenare mbi bazë të dokumenteve është zhvilluar në datën 23.06.2025 dhe palët janë njoftuar rregullisht.

II
Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

15. ***Kërkuesja***, në mënyrë të përmbledhur, në ankimin kushtetues individual dhe në parashtrimet e saj, ka pretenduar se janë cenuar:

15.1. *E drejta për proces të rregullt në drejtim të:*

15.1.1. *Së drejtës për t`u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj,* pasi gjyqtarja I.Gj., që ka dhënë vendimin në shkallë të parë, ka qenë në kushtet e mbarimit të mandatit të magjistratit, në kuptim të nenit 6/1 të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" (*ligji nr. 96/2016*), pasi nuk ka deklaruar në formularin përkatës, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" (*ligji nr. 138/2015*), dënimin penal nga gjykata e shtetit grek. Ky vendim dënimi është siguruar nga një subjekt tjetër në datën 02.05.2025 dhe ai i është vënë në dispozicion kërkueses pas datës 05.05.2025, të përcaktuar nga Gjykata për paraqitjen e argumenteve dhe provave shtesë. Ndërkohë, në deklaratën publike të datës 04.03.2024, Këshilli i Lartë Gjyqësor i ka konsideruar këto "sulme" ndaj gjyqtares, çka ka penguar zbulimin e provave për faktin e dënimit të saj.

15.1.2. *Së drejtës së aksesit dhe standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor,* pasi gjykatat më të larta nuk u kanë dhënë përgjigje të argumentuara pretendimeve të kërkueses, siç është ai se OPGJ-të për të zbatuar vendimin e sekuestrimit kanë kryer kontroll të hollësishëm të zyrës pa vendim gjyqësor, në shkelje të nenit 37 të Kushtetutës dhe nenit 8 të KEDNJ-së. Gjykata e shkallës së parë ka theksuar se OPGJ-të kanë vepruar në kushtet e ngutshmërisë, sipas neneve 300 dhe 301 të KPP-së, çka nuk është rasti konkret, kurse gjykatat

më të larta e kanë injoruar këtë pretendim. Gjykata e apelit ka përshkruar përkufizimin e sistemeve kompjuterike sipas Konventës së Budapestit, por nuk ka argumentuar se përse pajisjet e sekuestruara kërkueses nuk janë të tilla. Edhe vendimi i Gjykatës së Lartë është jologjik dhe në të nuk u jepen përgjigje pretendimeve të mbrojtjes se përse kontrolli pa vendim gjyqësor është i ligjshëm dhe përse nuk duhet vendim gjyqësor për sekuestrimin e të dhënave dhe të sistemeve kompjuterike dhe, për më tepër, nuk argumentohet se ku ndryshon ky rast nga ai në vendimin e saj njësues nr. 147/2021. Gjykatat nuk kanë arsyetuar për domosdoshmërinë e kontrollit të zyrës dhe sekuestrimin e të dhënave ose sistemeve kompjuterike, kur të paktën në 3 nga pajisjet nuk ka të dhëna që kanë lidhje me hetimin.

15.1.3. *Parimit t*ë *sigurisë juridike,* për shkak të mosrespektimit të vendimit njësues nr. 147/2021 të Gjykatës së Lartë dhe zbatimit arbitrar të neneve 202 e 208 të KPP-së. Siç është theksuar në vendimin njësues, në përputhje me parashikimet e nenit 208 të KPP-së, prokurori duhet të kishte përcaktuar specifikisht sendet dhe dokumentet që kërkonte të sekuestronte, çka do të kishte shmangur kontrollin e paautorizuar të zyrës së kërkueses.

15.2. *E drejta e jetës private,* sipas neneve 22, 23, 36 dhe 37 të Kushtetutës dhe nenit 8 të KEDNJ-së, pasi:

15.2.1. OPGJ-të kanë kryer kontroll të zyrës pa vendim gjyqësor, në kundërshtim me nenin 202 të KPP-së, gjatë të cilit kanë sekuestruar sisteme kompjuterike pa disponim gjyqësor, në kundërshtim me nenin 208/a të KPP-së dhe vendimin njësues nr. 147/2021. Për zbatimin e vendimit të sekuestrimit OPGJ-të kanë hyrë në zyrën e kërkueses dhe kanë kontrolluar të gjithë kompjuterët, dollapët dhe sirtarët bazuar në bindjen e tyre. Ata kanë sekuestruar jo vetëm kompjuterin ku mbaheshin të dhënat e shoqërisë "H." sh.p.k., por edhe 3 kompjuterë të tjerë, që nuk kanë qenë objekt i vendimit të sekuestrimit dhe nuk kanë lidhje me hetimin. Po ashtu, kanë sekuestruar edhe dokumente, disa nga të cilat nuk kanë lidhje me objektin e hetimit.

15.2.2. Fakti që është kryer kontroll përpara sekuestrimit shpjegohet në mënyrë të besueshme nga përfaqësuesja e kërkueses,

shtetasja A.P., përveçse ai rezulton qartësisht edhe nga vendimi dhe procesverbali i sekuestrimit. Kontrolli nga OPGJ-të është diktuar *de facto* nga përmbajtja e vendimit të sekuestrimit, përndryshe ai ishte i paekzekutueshëm. Në atë vendim, në shkelje të nenit 208 të KPP-së, prokurorët nuk kanë specifikuar sendet dhe dokumentet objekt sekuestrimi, për të shmangur kontrollin e paautorizuar të zyrës. Ata janë shprehur për sekuestrimin edhe për "*të çdo gjëje tjetër që vlerësohet me rëndësi mbi faktin objekt hetimi*", duke mos nënkuptuar kështu një dorëzim vullnetar nga kërkuesja. Edhe nga procesverbali i sekuestrimit kuptohet qartë se është kryer kontroll dhe se shumë sende e dokumente janë marrë kundër vullnetit të kërkueses, pasi në të shënohet "*sendet/ dokumentet e gjetura apo të dorëzuara*". Kontrolli i zyrës, për më tepër, është kryer pa u thirrur një person i besuar, siç mund të ishin avokatët që kanë njohuri të posaçme, sipas nenit 205 të KPP-së.

15.2.3. Nëse nuk do të kishte kontroll, por vetëm dorëzim vullnetar, përfaqësuesja A.P. e kërkueses nuk do të kishte dorëzuar edhe një kompjuter që nuk është në pronësi të saj dhe në të cilin mbahet kontabiliteti i një prej operatorëve më të mëdhenj në vend. Për më tepër, për të ka qenë e pamundur të vlerësonte se cilat ishin "dokumentet e tjera që kishin rëndësi mbi faktin objekt hetimi", në mënyrë që t'i dorëzonte vullnetarisht, pa u kryer kontroll nga OPGJ-të. Fakti që ajo nuk ka bërë vërejtje në procesverbal, nuk do të thotë se nuk ka shkelje. Kërkuesja ka paraqitur ankim, ndërkohë që KPP-ja nuk parashikon që për të drejtën e shkelur duhet të bëhen shënime në procesverbal.

15.2.4. Nuk qëndron pretendimi se sekuestrimi është urdhëruar në kushte urgjence, pas marrjes së deklarimit të shtetasit F.B., pasi këtij shtetasi i janë marrë disa herë deklarime. Për më tepër, dinamika e hetimit, ndërsa procedimi penal është regjistruar në datën 01.12.2020, pra më shumë se 2 vjet përpara, tregon se nuk ka pasur asnjë urgjencë, ndaj është e pakuptimtë përse nuk mund të merrej paraprakisht nga gjykata një vendim kontrolli. Edhe në rast të ekzistencës së kushteve të urgjencës, dispozitat procedurale kërkojnë verifikimin gjyqësor të tyre.

15.2.5. Sekuestrimi i të dhënave dhe i sistemeve kompjuterike kryhet vetëm me vendim gjyqësor dhe ai mund të bëhet vetëm nëse është i domosdoshëm dhe vetëm për aq kohë sa është i nevojshëm për marrjen e të dhënave ose bërjen e kopjeve. Nëse ka disa sisteme ose pajisje kompjuterike duhet të përzgjidhen ato që cenojnë më pak personin, duke mbajtur në konsideratë bërjen e kopjeve, për të shmangur sa më shumë sekuestrimin. Në rastin konkret nuk është arsyetuar se përse sekuestrimi i të dhënave ose i sistemeve kompjuterike është i domosdoshëm për çështjen penale, kur të paktën në 3 prej tyre nuk ka të dhëna për shoqërinë "H." sh.p.k.; nuk është përcaktuar se cilat janë të dhënat ose sistemet kompjuterike që do t`i nënshtrohen sekuestrimit dhe se çfarë synohet të provohet përmes kësaj mase; nuk janë përcaktuar modalitetet e sekuestrimit në mënyrë që të sekuestrohen vetëm të dhënat ose sistemet kompjuterike të përcaktuara shprehimisht; nuk është përcaktuar koha kur sistemet kompjuterike duhet të jenë në dispozicion të organit të akuzës. Sekuestrimi i sendeve të gjetura gjatë kontrollit as nuk është vleftësuar nga prokurori.

15.2.6. Në pajisjet e sekuestruara ndodhen informacione edhe për shumë klientë të tjerë të zyrës, informacione konfidenciale me kredenciale për akses në *e-Albania, self-care, e-filing* (faqja e tatimeve), *Profisc* (program për lëshimin e faturave *online*), llogari bankare, fjalëkalime për aksese në llogari bankare, posta elektronike të klientëve, si dhe programe kontabiliteti të domosdoshme për punën e kërkueses, të cilat ruhen nga sekreti profesional ose tregtar. Për më tepër, në dy nga pajisjet nuk ka asnjë informacion për shoqërinë "H." sh.p.k.

15.2.7. Ndërhyrja nuk respekton kriteret e nenit 17 të Kushtetutës dhe standardet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*GJEDNJ*), e cila ka theksuar se shtetet palë mund të kenë konsideruar të nevojshme t'u drejtohen masave të tilla si kontrollet dhe sekuestrimet për të marrë prova fizike për vepra penale dhe në raste të tilla shqyrtimi i masave do të synojë rëndësinë dhe përshtatshmërinë e arsyeve të dhëna për t'i justifikuar ato, si dhe pajtueshmërinë me parimin e proporcionalitetit të tyre me qëllimin e ndjekur. Serioziteti i veprës penale që shkaktoi kontrollin dhe sekuestrimin,

rrethanat në të cilat u dha urdhri, në veçanti nëse kishte ndonjë provë të mëtejshme në atë kohë, përmbajtja dhe qëllimi i urdhrit, duke pasur parasysh veçanërisht natyrën e objektit të kontrolluar dhe masat mbrojtëse të zbatuara për të kufizuar ndikimin e masës në kufij të arsyeshëm, mënyra në të cilën është kryer kontrolli dhe shkalla e pasojave të mundshme në respektimin e jetës private të personit në fjalë, janë të gjitha kritere të rëndësishme që duhen marrë parasysh në balancimin e interesave të ndryshëm konkurrues. GJEDNJ-ja, gjithashtu, kërkon që ligji vendas të ofrojë garanci të përshtatshme dhe të mjaftueshme kundër arbitraritetit, të cilat përfshijnë edhe "shqyrtimin efektiv" të masave që cenojnë nenin 8 të Konventës.

15.3. *E drejta e pronës private*, e cila gëzon mbrojtje edhe kur zhveshja e titullarit të sendit nga disponimi i ligjshëm bëhet për një kohë relativisht të shkurtër. Masa e sekuestros është e vlefshme dhe e ekzekutueshme menjëherë dhe qëndron në fuqi, si rregull, deri në përfundim të çështjes me vendim përfundimtar. Sekuestrimi i dokumenteve dhe i sendeve në rastin konkret është kryer në kundërshtim me ligjin, pa vendim gjyqësor, pa argumentuar domosdoshmërinë e sekuestrimit dhe janë sekuestruar dokumente që haptazi nuk i shërbejnë hetimit. Sekuestrimi jo vetëm i kompjuterit ku mbaheshin të dhënat e shoqërisë "H." sh.p.k. nuk ka qenë i domosdoshëm dhe proporcional, duke i sjellë dëme kërkueses, pasi në ato pajisje, sipas kërkesave ligjore, kryhen regjistrimet kontabël për mbylljen e pasqyrave financiare të klientëve.

16. ***Subjekti i interesuar, Prokuroria e Posaçme,*** në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar si vijon:

16.1. Pretendimi për cenimin e së drejtës për proces të rregullt është i pabazuar, pasi gjykatat u kanë dhënë përgjigje pretendimeve të kërkueses dhe arsyetimi i tyre është i qartë dhe i mjaftueshëm për të kuptuar arsyet e vendimmarrjes dhe qëndrimin ndaj pretendimeve të ngritura. Vendimet gjyqësore janë logjike, nuk kanë kundërthënie dhe përmbajnë referenca në ligjin e zbatueshëm.

16.2. Edhe pretendimi për cenimin e parimit të sigurisë juridike është i pabazuar. Referuar praktikës së Kolegjit Penal nuk konstatohet që neni 208/a i KPP-së të zbatohet në të gjitha rastet kur sekuestrohen pajisje elektronike. Evokimi i kësaj dispozite për sekuestrimin

e çdo pajisjeje elektronike, siç janë kompjuterët ose aparatet telefonike, është abuziv për sa kohë ligjvënësi nuk e ka parashikuar një gjë të tillë, ndërkohë që kjo dispozitë zbatohet vetëm për krime në fushën e teknologjisë së informacionit. Për sa kohë pajisjet elektronike nuk ndërveprojnë dhe nuk transmetojnë tek të tretët informacion nëpërmjet rrugëve elektronike të komunikimit, nuk kemi të bëjmë me sisteme kompjuterike, por me sende.

16.3. Pretendimet për cenimin e së drejtës për jetë private dhe asaj të pronës private janë të pabazuara. Sekuestrimi është kryer në përputhje me ligjin, bazuar në nenet 208 e vijues të KPP-së. Ai është urdhëruar në kuadër të një procedimi penal, të regjistruar për veprën penale të parashikuar nga neni 287 i KP-së, ndërsa ekzistonte dyshimi i arsyeshëm se shoqëria "H." sh.p.k. po shërbente si strukturë, hallkë e pastrimit të parave. Sekuestrimi është urdhëruar për një qëllim të ligjshëm. Ai synonte zbulimin e të dhënave për ligjshmërinë e aktivitetit të shoqërisë dhe ortakëve të saj, duke qenë i domosdoshëm pikërisht për vërtetimin e momentit se kur realisht shtetasit J.M. dhe Xh.B. janë bërë ortakë të shoqërisë dhe cila ka qenë arsyeja e depozitimit të vendimit të shitjes së kuotave 4 vjet më vonë në QKB, si dhe hallkat që kanë vijuar për pastrimin e parave, ku një nga format e konsumimit të kësaj vepre penale është edhe mbulimi i natyrës së produktit të veprës penale, fshehja e origjinës, duke u kamufluar në formën e një dividenti, sikurse është krijuar dyshimi edhe në rastin konkret. Megjithatë, në vendimin e sekuestrimit nuk mund të evidentohej ajo se çfarë do të provohej nga sendet dhe dokumentet objekt sekuestrimi, për sa kohë të dhënat e hetimit paraprak mbulohen nga sekreti hetimor. Një gjë e tillë mund të evidentohet vetëm pas marrjes dhe shqyrtimit të tyre, në ndërthurje edhe me prova të tjera.

16.4. Sekuestrimi është drejtuar ndaj kërkueses, pasi ajo ka mbajtur kontabilitetin e shoqërisë për ndërtimet e kryera në pronën objekt hetimi. Asaj i janë sekuestruar vetëm ato pajisje kompjuterike dhe dokumente që kanë pasur lidhje me shoqërinë "H." sh.p.k. dhe në të vërtetë në ato pajisje janë gjetur dokumente që kanë të bëjnë me këtë shoqëri. Edhe sekuestrimi i bilanceve të shoqërive që nuk kanë lidhje me shoqërinë "H." sh.p.k. nuk i ka cenuar kërkueses asnjë të drejtë, ndërsa shoqëritë tregtare kanë detyrimin për depozitimin

e bilanceve pranë QKB-së. Nisur nga rëndësia e veprës penale, sekuestrimi në këtë rast ka ruajtur proporcionalitetin mes interesit publik dhe interesit të kërkueses.

16.5. Pretendimi se në rastin konkret është ushtruar kontroll për shkak të përmbajtjes së vendimit të sekuestrimit është i pabazuar. Nisur nga fakti se dokumentacioni i shoqërive tregtare mund të mbahet në format letër ose elektronik, prokurorët kanë disponuar për sekuestrimin e të gjitha dokumenteve që kanë lidhje me shoqërinë "H." sh.p.k. dhe të kompjuterit ku mbahen të dhënat e saj, si dhe të çdo gjëje tjetër që vlerësohej me rëndësi për hetimin dhe që ofronte të dhëna për fakte objekt hetimi. Një mënyrë e tillë disponimi është e qartë dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi, pasi në këtë rast ka qenë e pamundur bërja e një liste të dokumenteve. Ato mund të ishin bilance, kontrata, vendime ortakësh etj. dhe sidoqoftë lista do të përfundonte me fjalën "e të tjera", për shkak të pafundësisë së llojeve të akteve që mund të dispononte kërkuesja, si dhe për sa kohë që hetimi shtrihej në ngjarje ndër vite, në episode ku ishin implikuar shumë persona, roli dhe përgjegjësia e të cilëve ishte ende për t`u përcaktuar. Prokurorët janë shprehur edhe për sekuestrimin e çdo sendi tjetër që vlerësohet me rëndësi për hetimin dhe që ofron të dhëna për faktin objektin hetimi, duke mos abuzuar me të drejtën për vlerësimin e domosdoshmërisë, por duke ia deleguar OPGJ-ve sekuestrimin e tyre, në respektim të nenit 208 të KPP-së.

16.6. Sekuestrimi është urdhëruar në kushte urgjence, pas deklarimeve të shtetasit F.B., duke qenë se ekzistonte rreziku që ky shtetas, pasi të dilte nga ambientet e prokurorisë, të kontaktonte me bashkëpunëtorët e tij dhe kërkuesen dhe dokumentacioni që ajo kishte për shoqërinë "H." sh.p.k. mund të manipulohej ose zhdukej. Për zbatimin e vendimit, sikurse parashtrohet edhe në informacionin me shkrim të datës 28.04.2023, OPGJ-të janë paraqitur menjëherë pranë zyrës së kërkueses ku kanë marrë kontakt me recepsionisten që ka kërkuar të mos kryhet asnjë veprim deri në ardhjen e përfaqësueses A.P. të kërkueses, e cila është paraqitur disa minuta më pas. Asaj i është vënë në dispozicion vendimi i sekuestrimit dhe i është kërkuar vënia në dispozicion e materialit. Ajo është treguar bashkëpunuese, duke krijuar kushtet dhe lehtësitë e nevojshme për realizimin e veprimeve hetimore,

përfshirë vënien në dispozicion dhe të një kompjuteri për mbajtjen e procesverbalit nga OPGJ-të. Vetë ajo ka vënë në dispozicion të tyre dokumentet, kurse për pajisjet kompjuterike, duke qenë zyrë kontabiliteti, ka shprehur shqetësimin se sekuestrimi i tyre ndikonte në punën e përditshme, shqetësim që është marrë parasysh dhe ajo është sqaruar se nuk do të sekuestrohen pajisjet që nuk lidhen me shoqërinë "H." sh.p.k. Në vijim, OPGJ-të kanë marrë vetëm ato pajisje që nga vetë shtetasja A.P. janë identifikuar se përmbanin dokumente që lidheshin me këtë shoqëri. Në procesverbalin e sekuestrimit janë përshkruar hollësisht të gjitha dokumentet dhe pajisjet e sekuestruara dhe një kopje e tij i është dhënë A.P., e cila nuk ka pasur pretendime dhe nuk ka bërë ndonjë shënim. Ajo nuk ka ngritur pretendime për veprimet e OPGJ-ve as kur është pyetur në datën 02.05.2023 në ambientet e prokurorisë.

16.7. Nëse do të ishte ushtruar kontroll, do të ishin sekuestruar edhe një tërësi sendesh të tjera që u gjetën dhe u sekuestruan vetëm gjatë kontrollit të muajit tetor 2023. Pretendimi se në procesverbal është shënuar "sendet/dokumentet e gjetura apo të dorëzuara" nuk vërteton se është ushtruar kontroll, pasi përveçse fjalët janë vendosur si alternativë, gjetja dhe dorëzimi i tyre është bërë nga përfaqësuesja A.P. e kërkueses dhe OPGJ-të i kanë marrë në dorëzim prej saj. Procedura e ndjekur është kontrolluar nga gjykatat, të cilat, gjithashtu, kanë vlerësuar se nuk ndodheshin përpara një kontrolli të zyrës së kërkueses.

16.8. Në vijim të hetimeve pajisjet e sekuestruara i janë nënshtruar ekspertimit teknik-kompjuterik nga sektori i ekspertizës pranë Prokurorisë së Posaçme. Të gjitha dokumentet e ruajtura dhe të rikuperuara nga memoriet e tyre i janë vënë në dispozicion organit procedues në format të lexueshëm dhe kopje bruto. Imazhet dhe kopjet e raporteve të të dhënave të nxjerra ruhen në pajisje ruajtëse që nuk janë të lidhura në internet dhe në to kanë akses vetëm ekspertët përkatës. Ekspertimi bazohet në përcaktime të qarta ligjore për kompetencën e ekspertëve dhe në standarde të larta teknike ndërkombëtarisht të njohura për programet e përdorura. Po ashtu, është kryer edhe këqyrja e të dhënave, duke u bërë kërkimi me fjalë kyçe, vetëm për të dhënat që lidhen me procedimin penal dhe kjo është dokumentuar në procesverbal. Për materialet në format "pdf" ose të skanuara, mundësia e vetme për verifikimin e të dhënave

është kontrolli manual, por duke dokumentuar në procesverbalin e këqyrjes vetëm ato të dhëna që kanë lidhje me faktet objekt hetimi dhe që i shërbejnë sqarimit të rrethanave objekt hetimi.

16.9. Duke qenë se kërkuesja ka pasur pretendime se pajisjet e sekuestruara mbanin edhe dokumente të klientëve të tjerë, me qëllim mospengimin e punës së saj, me urdhrat e datave 18.05.2023 dhe 07.06.2023, pra brenda një periudhe relativisht të shkurtër pas sekuestrimit, është vendosur kthimi i 3 pajisjeve, pasi janë administruar të dhënat që lidhen me hetimin. Ato janë mbajtur për një kohë të shkurtër, aq sa ka qenë e nevojshme për ekspertimin dhe këqyrjen e tyre. Pajisja tjetër është mbajtur për nevoja të hetimit dhe në vijim është dërguar si provë materiale në gjykatë, e cila do të vendosë në lidhje me të.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkueses

17. Çështja e legjitimimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

18. Për sa i takon legjitimimit *ratione personae,* Gjykata ka pohuar se në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, individi mund të bëjë ankim kushtetues individual vetëm për çështje që lidhen me të drejtat themelore të tij, duke treguar se është viktimë e një shkeljeje dhe pasojat nga akti i kundërshtuar janë të drejtpërdrejta dhe reale për të (*shih vendimet nr. 21, datë 22.04.2025; nr. 17, datë 13.03.2024; nr. 44, datë 26.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*). Në kuptim të nenit 16 të Kushtetutës, të drejtat dhe liritë themelore të

parashikuara në Kushtetutë vlejnë edhe për personat juridikë, për aq sa përputhen me qëllimet e përgjithshme të tyre dhe me thelbin e këtyre të drejtave e lirive.

19. Në çështjen në shqyrtim, kërkuesja, në cilësinë e personit juridik, ka kundërshtuar vendimin e sekuestrimit për qëllime provuese të prokurorëve dhe mënyrën e zbatimit të tij nga OPGJ-të, sikundër edhe vendimet gjyqësore që kanë rrëzuar ankimin e saj, me pretendimin se ato akte dhe veprime kanë ndërhyrë drejtpërdrejt në të drejtat e saj themelore. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se kërkuesja justifikon interesin në çështjen e parashtruar, ndaj legjitimohet *ratione personae*.

20. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, Gjykata ka pohuar se mbrojtja kushtetuese ka funksion përfundimtar dhe, si e tillë, mund të aplikohet për ato vendime për të cilat kanë përfunduar procedurat gjyqësore. Cenimi i të drejtave themelore mund të pretendohet në këtë Gjykatë vetëm pasi të shterohen të gjitha mundësitë e ofruara nga sistemi i apelimeve dhe kjo vlen edhe në rastet kur procedurat gjyqësore paraprake çojnë në një rëndim të mëtejshëm ose në tejzgjatjen e cenimit të të drejtave. Ky rregull, në thelb, synon t'u japë organeve publike dhe në veçanti gjykatave të zakonshme mundësinë e parandalimit ose korrigjimit në substancë të shkeljeve të të drejtave kushtetuese të individit (*shih vendimet nr. 21, datë 22.04.2025; nr. 18, datë 19.03.2024; nr. 25, datë 13.10.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Në rastin konkret, Gjykata konstaton se vendimet e kundërshtuara gjyqësore dhe të prokurorisë, që janë shprehur për kontrollin dhe sekuestrimin, nuk kanë vendosur për themelin e akuzave, por janë vendime të ndërmjetme të procedimit penal në funksion të mbledhjes së provave për faktin penal. Në jurisprudencën kushtetuese vendimet e ndërmjetme të sekuestros, të dhëna gjatë hetimeve paraprake, i janë nënshtruar kontrollit kushtetues, edhe pse gjykimi i themelit të fajësisë ende nuk kishte përfunduar, duke u konsideruar si vendime përfundimtare, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës. Për këto lloj vendimesh, Gjykata është shprehur se ndonëse me karakter të përkohshëm dhe nuk vendosin për themelin e çështjes, ato ndërhyjnë në të drejtat kushtetuese individuale, ndaj konsiderohen me natyrë përfundimtare për qëllime të kontrollit kushtetues (*shih vendimet nr. 21, datë 22.04.2025; nr. 29, datë 16.04.2024; nr. 18, datë 19.03.2024 të Gjykatës Kushtetuese*). Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se vendimet objekt kërkese e përmbushin këtë kriter.

22. Në lidhje me këtë kriter të legjitimimit, për sa u përket pretendimeve

të kërkueses për cenimin e paprekshmërisë së banesës për shkak të kontrollit të pretenduar të zyrës, Gjykata mban në konsideratë edhe qëndrimin e saj për kontrollin kushtetues të pretendimeve për cenimin e të drejtave substanciale për shkak të kontrollit personal ose të vendeve. Sipas këtij qëndrimi, referuar parashikimeve aktuale ligjore, kur gjatë kontrollit sekuestrohen prova materiale, atëherë pretendimet kushtetuese për procedurën e kontrollit parashtrohen nga individi në aktin e ankimit ndaj vendimit të sekuestrimit drejtuar një gjykate më të lartë dhe pas shterimit të atyre mjeteve juridike ai mund të paraqesë ankim kushtetues individual. Po kështu, për sa kohë që kriteri i shterimit të mjeteve juridike kërkon edhe që të gjitha pretendimet që ngrihen në këtë Gjykatë të jenë paraqitur më parë në gjykatat e zakonshme, të paktën në substancë (*shih vendimet nr. 14, datë 21.06.2022; nr. 12, datë 09.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese*), Gjykata ndalet edhe në verifikimin e pretendimeve të kërkueses në këtë aspekt.

23. Gjykata vëren se kërkuesja, në aspektin formal, i është drejtuar asaj me ankim kushtetues pasi ka shteruar mjetet e zakonshme të ankimit përpara gjykatave të zakonshme të të tria shkallëve të gjykimit. Për sa i përket aspektit substancial të këtij kriteri, kërkuesja ka pretenduar cenimin e së drejtës për jetë private në këndvështrim të neneve 22, 23, 36 dhe 37 të Kushtetutës dhe nenit 8 të KEDNJ-së. Në lidhje me nenin 22 të Kushtetutës, që garanton lirinë e shprehjes, nuk rezulton që kërkuesja të ketë ngritur më parë pretendime në ankimet drejtuar gjykatave të zakonshme, në formë ose në përmbajtje, duke mos parashtruar, në asnjë rast, argumente dhe as ka bërë ndonjë referim specifik në këtë dispozitë kushtetuese. Ajo i ka mbështetur pretendimet e saj përpara gjykatave të zakonshme në nenin 8 të KEDNJ-së, por duke mos pretenduar dhe argumentuar se kjo dispozitë mbron edhe lirinë e shprehjes. Për rrjedhojë, për pretendimin për cenimin e lirisë së shprehjes kërkuesja nuk ka shteruar mjetet e zakonshme të ankimit.

24. Edhe në lidhje me nenin 23 të Kushtetutës, që garanton të drejtën e informimit, Gjykata vëren se kërkuesja nuk rezulton të ketë ngritur më parë pretendime në ankimet drejtuar gjykatave të zakonshme. Megjithatë, ndërsa pretendon se OPGJ-të kanë ushtruar kontroll të zyrës pa praninë e një personi të besuar, siç mund të ishin avokatët që kanë njohuri të posaçme, duket se kërkuesja, në thelb, pretendon mungesën e informimit nga ana e OPGJ-ve për të drejtat e saj në procedurën që ata po ndiqnin. Për rrjedhojë, argumentet e kërkueses kanë të bëjnë me pretendimin për paprekshmërinë e banesës, ndaj do të trajtohen në kuadër të këtij pretendimi.

25. Në ankimin kushtetues individual është pretenduar edhe cenimi i nenit

36 të Kushtetutës, në lidhje me lirinë dhe fshehtësinë e korrespondencës dhe të mjeteve të komunikimit. Në ankimet përpara gjykatave të zakonshme, ndonëse nuk ka një referim specifik në këtë dispozitë kushtetuese, kërkuesja ka ngritur pretendime në lidhje me masën e sekuestros edhe për sa u përket të dhënave dhe informacioneve konfidenciale të klientëve të tjerë të saj (të ndryshëm nga shoqëria "H." sh.p.k.), ashtu edhe të dhënave që, sipas saj, përbëjnë sekret profesional ose tregtar. Për rrjedhojë, vlerësohet se kërkuesja i ka shteruar mjetet juridike të zakonshme për pretendimin për cenimin e lirisë së korrespondencës dhe të mjeteve të komunikimit.

26. Gjykata vëren, gjithashtu, se në ankimin kushtetues individual kërkuesja ka pretenduar edhe cenimin e nenit 41 të Kushtetutës, për të drejtën e pronës private. Në ankimet përpara gjykatave të zakonshme ajo ka një referim specifik në këtë dispozitë kushtetuese dhe ka ngritur pretendime në lidhje me masën e sekuestros dhe në veçanti ndaj pajisjeve kompjuterike, duke parashtruar edhe disa argumente në këtë drejtim. Për rrjedhojë, vlerësohet se kërkuesja i ka shteruar mjetet juridike të zakonshme për këtë pretendim.

27. Kërkuesja legjitimohet edhe *ratione temporis*, në kuptim të përmbajtjes së nenit 71/a, pika 1, shkronja "b", të ligjit nr. 8577/2000, pasi vendimi më i fundit në kohë i kundërshtuar, ai i Gjykatës së Lartë, mban datën 08.02.2024, i cili, bazuar në informacionin e dërguar nga ajo gjykatë për nevoja të këtij shqyrtimi, është publikuar në faqen e saj zyrtare në datën 23.04.2024, ndërsa ankimi kushtetues individual është paraqitur në Gjykatë në datën 20.06.2024, pra brenda afatit 4-mujor.

28. Për sa i takon legjitimimit *ratione materiae*, kërkuesja ka pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt në drejtim të parimit të gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj, të së drejtës së aksesit, të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor dhe të parimit të sigurisë juridike, sipas nenit 42 të Kushtetutës, cenimin e lirisë dhe fshehtësisë së korrespondencës dhe së drejtës për paprekshmërinë e banesës, sipas neneve 36 dhe 37 të Kushtetutës dhe nenit 8 të KEDNJ-së, si dhe të së drejtës së pronës private, sipas nenit 41 të Kushtetutës, pretendime këto që janë me natyrë kushtetuese.

29. Gjykata vëren se kërkuesja ka pretenduar cenimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, me argumentin se gjyqtarja I.Gj., që ka dhënë vendimin në shkallë të parë, ka qenë në kushtet e mbarimit të mandatit të magjistratit, në kuptim të nenit 6/1 të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 96/2016, pasi nuk kishte deklaruar në formularin përkatës, në përputhje

me kërkesat e ligjit nr. 138/2015, dënimin e saj me vendim penal të huaj (të shtetit grek). Sipas kërkueses, edhe pse këto të dhëna janë bërë publike në vitin 2024, ajo ka siguruar kopje të vendimit të shtetit grek vetëm në muajin maj të vitit 2025, pas riçeljes së seancës plenare nga Gjykata.

30. Gjykata konstaton se një pretendim i tillë nuk është ngritur nga kërkuesja në ankimin kushtetues, por vetëm në parashtrimet e datës 12.05.2025, pasi çështja kishte kaluar për shqyrtim në seancë plenare dhe, për më tepër, pas riçeljes së saj për arsye të tjera të gjykimit kushtetues. Në këto kushte, për këtë pretendim, lind pyetja nëse ai është ngritur brenda afatit ligjor. Megjithatë, Gjykata nuk do të ndalet në këtë çështje, pasi konsideron se ky pretendim është gjithsesi haptazi i pabazuar *ratione materiae.* Konkretisht, çështja që ngrihet nga kërkuesja ka të bëjë me faktin se gjyqtarja I.Gj. ka qenë në kushtet e ndalimit të ushtrimit të funksionit për shkak të ligjit, ndaj ushtrimi i tij në rastin konkret ka cenuar parimin e gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj. Megjithatë, sikurse pranohet edhe nga vetë kërkuesja, nuk ka ndonjë akt të organit publik të ngarkuar nga ligji që të ketë vendosur për ndalimin e ushtrimit të funksionit nga ajo gjyqtare për shkakun e pretenduar nga kërkuesja ose për ndonjë shkak tjetër ligjor. Në këtë kuptim, gjyqtarja në fjalë, ndërsa ka qenë në detyrë, ka vepruar në kushte legjitimiteti në ushtrimin e funksioneve në rastin konkret dhe, për pasojë, pretendimi i kërkueses është qartazi pa bazë ligjore.

31. Për sa i takon pretendimit për cenimin e lirisë dhe fshehtësisë së korrespondencës dhe mjeteve të komunikimit, sipas nenit 36 të Kushtetutës dhe nenit 8 të KEDNJ-së, edhe në ankimin kushtetues individual kërkuesja e ka argumentuar me natyrën personale, konfidenciale dhe sekretin profesional ose tregtar të të dhënave që ndodheshin në pajisjet kompjuterike të sekuestruara. Në lidhje me këtë pretendim, kërkuesja ka kundërshtuar pranë gjykatave të zakonshme masën e sekuestrimit, duke argumentuar se është shkelur neni 208/a i KPP-së, pasi ndonëse bëhej fjalë për të dhëna ose sisteme kompjuterike, sekuestrimi nuk është vendosur me vendim gjyqësor. Gjykata vëren se kërkuesja ka dijeni të plotë për informacionin që pajisjet e sekuestruara përmbajnë dhe po ashtu, është njohur mjaftueshëm për veprimet e kryera nga organi i ndjekjes penale. Megjithatë, ajo nuk ka parashtruar ndonjë argument faktik ose ligjor se cila konkretisht është korrespondenca apo e dhëna profesionale në pajisjet e sekuestruara dhe se cili është veprimi konkret i prokurorit ose policisë gjyqësore që ka prekur të dhënat e ruajtura nga sekreti profesional. Në këtë kuptim, pretendimi i saj ka mbetur vetëm një deklaratë me natyrë të përgjithshme, sipas së cilës

sekuestrimi i katër kompjuterëve përbën ndërhyrje në korrespondencën, të dhënat personale dhe sekretet tregtare të saj. Në këto rrethana, Gjykata çmon se fakti i sekuestrimit të 4 kompjuterëve, të cilët për nga natyra nuk janë domosdoshmërisht mjete komunikimi, nuk mjafton për të prezumuar se ka pasur ndërhyrje në lirinë e korrespondencës së kërkueses, sipas neneve 36 të Kushtetutës dhe nenit 8 të KEDNJ-së, në kushtet kur ajo nuk ka argumentuar dhe as ka arritur të provojë se në ato pajisje ruheshin komunikime që përfshihen në konceptin e korrespondencës, fshehtësia e të cilave të jetë prekur. Për rrjedhojë, vetëm ngritja e pretendimit për cenimin e së drejtës substanciale, pa e arsyetuar dhe argumentuar në terma konkretë dhe ligjorë, e bëjnë atë haptazi të pabazuar.

32. Për sa i përket së drejtës së pronës private, Gjykata vëren se kërkuesja i ka ngritur pretendimet, në thelb, në drejtim të të dhënave, dokumenteve dhe programeve që pajisjet kompjuterike të sekuestruara përmbajnë, të cilat i shërbejnë për ushtrimin e veprimtarisë e saj. Vetë kërkuesja, qoftë përpara gjykatave të zakonshme, ashtu dhe në ankimin kushtetues, ka parashtruar se për këtë shkak mund të ishte evituar sekuestrimi i pajisjeve kompjuterike, duke u disponuar vetëm kopjimi i të dhënave të nevojshme, ndërsa nga sekuestrimi i pajisjeve ajo është dëmtuar në veprimtarinë e saj. Për rrjedhojë, Gjykata, bazuar në parimin *iura novit curia,* duke pasur parasysh natyrën dhe thelbin e këtij pretendimi, vlerëson ta shqyrtojë atë në themel në këndvështrim të lirisë së veprimtarisë ekonomike, e cila përmban në vetvete edhe të drejtën e pronës si aftësi e individëve për të grumbulluar, poseduar dhe disponuar sende (*shih vendimet nr. 29, datë 02.07.2021; nr. 33, datë 08.06.2016; nr. 14, datë 21.03.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

33. Për sa u përket pretendimeve të tjera të kërkueses, Gjykata vëren se ato kanë të bëjnë me kushtetutshmërinë e ndërhyrjes në ambientet ku kërkuesja, person juridik, ushtron veprimtarinë e saj në fushën e konsulencës dhe shërbimeve financiare, ekonomike. Për rrjedhojë, Gjykata duhet të vlerësojë fillimisht nëse kërkuesja mund të pretendojë cenimin e së drejtës së paprekshmërisë së banesës në kuptim të nenit 37 të Kushtetutës dhe të nenit 8 të KEDNJ-së, pra nëse zyra e saj përfshihet në nocionin e banesës ose mjedisit të njësuar me të, ndaj të cilave shtrihet mbrojta e ofruar nga dispozitat kushtetuese dhe konventore.

34. Në lidhje me të drejtën për jetë private, Gjykata ka vlerësuar se ajo nuk mbrohet nga një dispozitë e vetme e Kushtetutës, por nga disa prej tyre, ku përfshihet edhe neni 37, që bën fjalë për paprekshmërinë e banesës (*shih vendimet nr. 38, datë 02.12.2021; nr. 52, datë 01.12.2011; nr. 16, datë*

11.11.2004 të Gjykatës Kushtetuese). Sipas kësaj dispozite, paprekshmëria e banesës është e garantuar (pika 1) dhe kontrollet e banesës, si dhe të mjediseve që njësohen me të, mund të bëhen vetëm në rastet dhe mënyrat e parashikuara me ligj (pika 2). Ndërsa sipas nenit 8 të KEDNJ-së çdokush ka edhe të drejtën e respektimit të banesës dhe autoriteti publik nuk mund të ndërhyjë në ushtrimin e kësaj të drejte, përveçse në shkallën e parashikuar nga ligji, kur është e nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit publik, shëndetit ose moralit apo për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të të tjerëve.

35. Neni 37 i Kushtetutës përfshin në fushën e mbrojtjes së tij jo vetëm banesën e individit, por edhe çdo mjedis tjetër që është i tillë që të njësohet me të. Për sa i përket nocionit "banesë" sipas GJEDNJ-së, ai është një koncept autonom që nuk varet nga klasifikimi sipas ligjit të brendshëm dhe ky përcaktim varet nga rrethanat faktike, përkatësisht nga ekzistenca e lidhjeve të mjaftueshme dhe të vazhdueshme me një vend specifik (*shih Winterstein dhe të tjerë kundër Francës, datë 17.10.2013, § 141; Prokopovich kundër Rusisë, datë 08.01.2004, § 36; McKay-Kopecka kundër Polonisë, datë 19.09.2006*). Ky përkufizim nuk kufizohet vetëm në banesat tradicionale (*shih Chapman kundër Mbretërisë së Bashkuar, datë 19.01.2001, §§ 71-74*), por mbulon dhe mund të shtrihet edhe në ambiente biznesi, siç është edhe zyra ku ushtron profesionin personi *(shih Niemietz kundër Gjermanisë, datë 16.12.1992, § 30),* duke përfshirë selinë e regjistruar të një shoqërie të drejtuar nga një individ privat (*shih Buck kundër Gjermanisë, datë 28.04.2005, § 31*), ashtu edhe atë të një personi juridik, degëve të tij dhe ambienteve të tjera të biznesit *(shih Société Colas Est dhe të tjerë kundër Francës, datë 16.04.2002, § 41; Sallinen dhe të tjerë kundër Finlandës, datë 27.09.2005, § 70; Bernh Larsen Holding AS dhe të tjerë kundër Norvegjisë, datë 14.03.2013, § 104).*

36. Për sa më lart, Gjykata çmon se selia/zyra e kërkueses, person juridik, ku ajo ushtron veprimtarinë e saj profesionale, përbën mjedis të njësuar me banesën në kuptim të nenit 37 të Kushtetutës dhe nenit 8 të KEDNJ-së, ndaj paprekshmëria e saj është e garantuar.

37. Për sa u përket pretendimeve të kërkueses në drejtim të së drejtës për proces të rregullt, Gjykata ka theksuar se në rastin përjashtimor të kontrollit të vendimeve që vendosin masa me karakter të ndërmjetëm, ajo i trajton pretendimet e parashtruara në ankimin kushtetues individual në

drejtim të të drejtave substanciale, ndërsa pretendimet që kanë të bëjnë me të drejtën për proces të rregullt ligjor trajtohen si aspekte procedurale të së drejtës substanciale të pretenduar të cenuar, ndaj, në këtë kuptim, ajo ndalet në aspekte të veçanta të së drejtës për proces të rregullt ligjor, për sa ato mund të ndikojnë drejtpërdrejt në të drejtën substanciale në vetvete (*shih vendimet nr. 79, datë 12.11.2024; nr. 29, datë 16.04.2024; nr. 18, datë 19.03.2024 të Gjykatës Kushtetuese*). Po sipas Gjykatës, për të vlerësuar nëse ka pasur ose jo cenim të të drejtave substanciale, ajo niset nga arsyetimi i vendimeve të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, për sa kohë që në bazë të parimit të subsidiaritetit u takon atyre gjykatave që përveç zbatimit të ligjit material dhe procedural penal, të mbajnë parasysh edhe jurisprudencën e Gjykatës dhe të GJEDNJ-së në lidhje me parimin e proporcionalitetit, duke qenë kjo Gjykatë mjeti i fundit për mbrojtjen e këtyre të drejtave (*shih vendimet nr. 79, datë 12.11.2024; nr. 29, datë 16.04.2024 të Gjykatës Kushtetuese*).

38. Për rrjedhojë, për sa kohë që pretendimet në drejtim të së drejtës së aksesit dhe standardit të arsyetimit të vendimit, në thelb, kanë të bëjnë me përcaktimin e fakteve dhe me mënyrën e interpretimit dhe të zbatimit të dispozitave që përcaktojnë rregullat për kontrollin e vendit apo të banesës, me qëllim sekuestrimin e provave materiale, çka sipas kërkueses, vë në dyshim ligjshmërinë, domosdoshmërinë dhe proporcionalitetin e veprimeve dhe masave të marra nga autoritetet e ndjekjes penale dhe vlerësimin e gjykatave të zakonshme në këtë drejtim, ato do të shqyrtohen në këndvështrim të respektimit të kritereve kushtetuese të ndërhyrjes në të drejtën substanciale të paprekshmërisë së banesës. Gjykata, referuar natyrës dhe thelbit të këtyre pretendimeve të kërkueses, për sa kohë që ato kanë të bëjnë me njërin nga aspektet e së drejtës për jetë private, atë për paprekshmërinë e banesës, vlerëson t`i trajtojë në vijim, në themel, në këndvështrim të së drejtës së garantuar nga neni 37 i Kushtetutës dhe neni 8 i KEDNJ-së.

39. Thënë sa më sipër, Gjykata do të ndalet në vijim në shqyrtimin në themel të pretendimeve të kërkueses për të drejtën për paprekshmërinë e banesës, në këndvështrim të nenit 37 të Kushtetutës dhe nenit 8 të KEDNJ-së dhe për cenimin e lirisë së veprimtarisë ekonomike, në këndvështrim të nenit 11 të Kushtetutës.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për të drejtën e paprekshmërisë së banesës

40. Sipas kërkueses, zyra e saj është kontrolluar nga OPGJ-të dhe janë

sekuestruar një sasi dokumentesh dhe disa pajisje kompjuterike. Sipas saj, OPGJ-të sapo kanë hyrë në zyrë kanë urdhëruar që asnjë punonjës të mos lëvizte nga vendi i punës, kanë kontrolluar të gjithë kompjuterët e zyrës, dollapët dhe sirtarët bazuar në bindjen e tyre, duke sekuestruar pajisjet kompjuterike dhe dokumentet e përshkruara në procesverbalin e sekuestrimit. Vendimi i sekuestrimit, vijon ajo, ishte i paqartë, pasi nuk kishte të specifikuara sendet që duhet të sekuestroheshin, ndaj OPGJ-të praktikisht kanë kryer kontroll të hollësishëm të zyrës pa vendim gjyqësor, siç përcaktohet në nenin 202 të KPP-së, duke cenuar nenin 37 të Kushtetutës dhe nenin 8 të KEDNJ-së. Bazuar në nenin 208 të KPP-së, në vendimin e sekuestrimit duhet të specifikohen sendet dhe dokumentet që duhet të sekuestrohen, për të shmangur kontrollin e paautorizuar, ndërkohë që në rastin konkret ato nuk janë specifikuar dhe prokurorët shprehen edhe për "*çdo gjë tjetër që vlerësohet me rëndësi mbi faktin objekt hetimi*". Në këtë kuptim, sipas kërkueses, prokurorët nuk kanë nënkuptuar një dorëzim vullnetar. Kështu, për përfaqësuesen A.P. të kërkueses ka qenë e pamundur të vlerësonte se cilat ishin "dokumentet e tjera që kishin rëndësi mbi faktin objekt hetimi", në mënyrë që t'i dorëzonte ato vullnetarisht, pa u kryer kontroll. Po sipas kërkueses, edhe sipas procesverbalit të sekuestrimit kuptohet qartësisht se është kryer kontroll dhe shumë sende e dokumente janë marrë kundër vullnetit të A.P., për sa kohë në të shënohet "*sendet/ dokumentet e gjetura apo të dorëzuara ...*", duke pranuar vetë OPGJ-të se një pjesë e tyre janë të gjetura, pra jo të dorëzuara. Edhe fakti i sekuestrimit jo vetëm të një kompjuteri, sipas vendimit të sekuestrimit, por katër të tillëve, tregon se ka pasur kontroll të zyrës. Po ashtu, nëse nuk do të ishte kryer kontroll, nuk do të kishte pasur dorëzim vullnetar edhe të kompjuterit ku mbahej kontabiliteti i një prej operatorëve më të mëdhenj në vend, pajisje kjo që për më tepër nuk ishte as në pronësi të saj. Fakti që nuk ka pasur vërejtje në procesverbalin e sekuestrimit, nuk do të thotë se nuk ka shkelje në kontrollin e zyrës, ndërkohë që ajo ka paraqitur ankim ndaj kësaj procedure.

41. Po sipas kërkueses, ndërhyrja në të drejtën e paprekshmërisë së banesës nuk respekton kriteret e nenit 17 të Kushtetutës dhe ato të jurisprudencës së GJEDNJ-së. Ndërhyrja përmes kontrollit dhe sekuestrimit në vijim nuk ka qenë as e ligjshme, as e domosdoshme dhe proporcionale. Kontrolli është kryer pa vendim të gjykatës, në shkelje të nenit 202 të KPP-së. Nuk qëndron pretendimi për kryerjen në kushte urgjence, pasi shtetasit F.B. i janë marrë disa herë deklarime. Për më tepër, dinamika e hetimit

nuk tregon se ka pasur ndonjë urgjencë që bënte të pamundur marrjen e një vendimi kontrolli nga gjykata, sepse procedimi penal është regjistruar në datën 01.12.2020, pra më shumë se 2 vjet përpara. Sipas kërkueses, edhe në rastet e urgjencës, dispozitat procedurale kërkojnë verifikimin gjyqësor të kushteve të saj, çka nuk ka ndodhur në rastin konkret, ndërsa kontrolli nga gjykatat i procedurës së ndjekur nuk ka qenë efektiv, për sa kohë ato nuk kanë shqyrtuar dhe nuk u kanë dhënë përgjigje pretendimeve për ligjshmërinë, domosdoshmërinë dhe proporcionalitetin e masës. Gjatë kontrollit janë sekuestruar edhe 3 pajisje kompjuterike që nuk kanë qenë objekt i vendimit të sekuestrimit dhe nuk kanë lidhje me hetimin, si dhe disa dokumente që nuk kanë lidhje me objektin e tij. Po ashtu, sipas kërkueses, kontrolli është kryer pa u thirrur një person i besuar, siç mund të ishin avokatët që kanë njohuri të posaçme, sipas nenit 205 të KPP-së.

42. Sipas subjektit të interesuar, Prokurorisë së Posaçme, pretendimi se në rastin konkret është ushtruar kontroll është i pabazuar dhe ai ka marrë përgjigje të arsyetuar nga gjykatat e zakonshme, sipas të cilave nuk ka pasur kontroll të zyrës së kërkueses. Në vendimin e sekuestrimit nuk mund të evidentohej se çfarë do të provohej nga sendet dhe dokumentet objekt sekuestrimi, për sa kohë të dhënat e hetimit paraprak mbulohen nga sekreti hetimor. Po ashtu, fakti se nuk është bërë një listë e dokumenteve që duhet të sekuestroheshin, nuk tregon se OPGJ-ve u është kërkuar të ushtrojnë kontroll dhe as se ata kanë kryer një të tillë, pasi lista në çdo rast do të përfundonte me fjalën "e të tjera", për shkak të pafundësisë së llojeve të akteve që kërkuesja mund të dispononte dhe për sa kohë që hetimi shtrihej në ngjarje ndër vite, ku implikoheshin shumë persona. Ky subjekt ka prapësuar se prokurorët janë shprehur për sekuestrimin edhe të çdo sendi që vlerësohej me rëndësi për hetimin dhe që ofronte të dhëna për faktin objekt hetimi, duke mos abuzuar aspak me të drejtën për vlerësimin e domosdoshmërisë, por duke ia deleguar OPGJ-ve sekuestrimin e këtyre sendeve, në respektim të nenit 208 të KPP-së. Sipas këtij subjekti, sekuestrimi është urdhëruar në kushte urgjence, pas marrjes së deklarimit të shtetasit F.B. se të gjitha dokumentet e shoqërisë "H." sh.p.k. gjendeshin në zyrën e kërkueses dhe pasi është vlerësuar se në rast vonese ai mund të lajmëronte bashkëpunëtorët e tij për të manipuluar ose zhdukur provat që do të hidhnin dritë mbi ngjarjen dhe autorët. Në zbatim të vendimit të sekuestrimit, OPGJ-të janë paraqitur menjëherë pranë zyrës së kërkueses, ku kanë kontaktuar recepsionisten që ka kërkuar të mos kryhej asnjë veprim derisa të vinte përfaqësuesja A.P. dhe pas ardhjes së saj, pasi i është vënë

në dispozicion vendimi i sekuestrimit, ajo është treguar bashkëpunuese, jo vetëm duke krijuar lehtësitë e nevojshme përmes vënies në dispozicion të sendeve/dokumenteve të kërkuara, madje edhe të një kompjuteri për mbajtjen e procesverbalit të sekuestrimit, por edhe duke vënë në dispozicion dokumentet e kërkuara, ndërsa për pajisjet kompjuterike ka shprehur shqetësimin se sekuestrimi do të ndikonte në punën e përditshme, shqetësim që është marrë parasysh, duke u marrë vetëm ato pajisje të identifikuara nga vetë A.P. si pajisje ku ndodheshin dokumente që lidheshin me shoqërinë "H." sh.p.k. Sipas subjektit të interesuar, në procesverbalin e sekuestrimit janë përshkruar hollësisht të gjitha sendet/dokumentet e sekuestruara dhe një kopje e tij i është dhënë përfaqësues A.P. të kërkueses, e cila nuk ka pasur pretendime dhe nuk ka bërë ndonjë shënim. Edhe kur është pyetur në datën 02.05.2023, përfaqësuesja A.P. e kërkueses nuk ka ngritur pretendime për veprimet e kryera gjatë sekuestrimit. Nëse do të ishte ushtruar kontroll, vijon subjekti i interesuar, atëherë do të ishin sekuestruar edhe një tërësi sendesh të tjera, të cilat u gjetën dhe u sekuestruan vetëm gjatë kontrollit të muajit tetor 2023. Shënimi në procesverbalin e sekuestrimit "*sendet/dokumentet e gjetura apo të dorëzuara*" nuk vërteton se është ushtruar kontroll, pasi përveçse fjalët janë vendosur si alternativë, gjetja dhe dorëzimi i tyre është bërë nga vetë përfaqësuesja A.P. e kërkueses.

43. Po sipas subjektit të interesuar, në rastin konkret janë zbatuar në mënyrë të drejtë dispozitat ligjore procedurale penale, pasi sekuestrimi është urdhëruar në kuadrin e një procedimi penal, të regjistruar për veprën penale të parashikuar nga neni 287 i KP-së, ndërsa ka ekzistuar një dyshimi i arsyeshëm për kryerjen e kësaj vepre penale, ka ekzistuar situata e urgjencës dhe rëndësisë që paraqisnin provat për të cilat është proceduar me sekuestrimin. Po ashtu, sekuestrimi është bërë për një qëllim të ligjshëm dhe është garantuar proporcionaliteti mes rëndësisë së veprës, interesit publik dhe interesit të kërkueses. Sipas subjektit të interesuar, në pajisjet e sekuestruara, ndryshe nga sa kërkuesja pretendon, kanë rezultuar dokumente që kanë të bëjnë me shoqërinë "H." sh.p.k., por se çfarë konkretisht provohet, evidentohet vetëm pas marrjes së provës dhe shqyrtimit të saj, ekspertimit dhe këqyrjes të të dhënave, në ndërthurje edhe me prova të tjera.

44. Gjykata vëren se sipas nenit 37 të Kushtetutës, paprekshmëria e banesës është e garantuar (pika 1) dhe kontrollet e banesës, si dhe të mjediseve që njësohen me të, mund të bëhen vetëm në rastet dhe në mënyrat e parashikuara me ligj (pika 2). Gjykata vëren, po ashtu, se sipas GJEDNJ-

së, objekti i nenit 8 të KEDNJ-së është në thelb mbrojtja e individit nga ndërhyrjet arbitrare nga autoritetet publike *(shih Lozovyye kundër Rusisë, datë 24.04.2018, § 36*). E drejta për respektimin e banesës kuptohet jo vetëm si e drejtë për hapësirën aktuale fizike, por edhe për gëzimin e qetë të kësaj hapësire (*shih Giacomelli kundër Italisë, datë 02.11.2006, § 76; Halabi kundër Francës, datë 16.05.2019, § 54)*.

45. Gjykata vlerëson se garancia kushtetuese e paprekshmërisë së banesës, sipas nenit 37, pika 1, të Kushtetutës, i garanton individit një hapësirë themelore jetese në lidhje me dinjitetin e tij njerëzor dhe në interes të zhvillimit të lirë të personalitetit të tij, duke pasur të drejtën të lihet i qetë në hapësirën e tij të jetesës. Kontrollet e banesës dhe të mjediseve që njësohen me të, që bën fjalë pika 2 e kësaj dispozite, përbëjnë një ndërhyrje serioze në këtë sferë personale thelbësisht të mbrojtur. Megjithatë, ndryshe nga sa ka përcaktuar për kontrollin vetjak (personal) në pikën 3 të dispozitës, kushtetutëbërësi për kontrollet e banesës dhe të mjediseve që njësohen me të nuk ka përcaktuar garancitë minimale, kriteret për kufizimin e kësaj të drejte (rastet, autoritetin publik kompetent, proporcionalitetin). Gjithsesi, kjo nuk duhet kuptuar se pesha dhe rëndësia kushtetuese e mbrojtjes së hapësirës private të individit është më e pakët, pasi vetë norma kushtetuese, për garantimin e kësaj të drejte kushtetuese dhe për të siguruar sundimin e së drejtës dhe mënjanimin e arbitraritetit, kërkon që kontrollet të bëhen vetëm në rastet dhe në mënyrat e parashikuara me ligj. Arsyet që kanë çuar kushtetutëbërësin në delegimin për ligjvënësin e zakonshëm të rregullimit të kontrolleve të banesës dhe të mjediseve duket se kanë të bëjnë me faktin se në praktikë fushat e ndërhyrjes së shtetit në këtë të drejtë përmes kontrolleve të autoriteteve publike mund të jenë disa, në varësi të objektit të mbrojtjes dhe qëllimit të kontrollit, ndërkohë që ligjvënësi i zakonshëm ka mundësi të gjera njohjeje dhe vlerësimi, përveç edhe fleksibilitetin e nevojshëm, për të përcaktuar, modifikuar dhe përshtatur në vijimësi me praktikat më të mirat ndërkombëtare dhe, në veçanti, me jurisprudencën e GJEDNJ-së, rregullat konkrete procedurale në çdo fushë, për të garantuar në çdo rast një ekuilibër të drejtë mes kësaj të drejte kushtetuese dhe interesit publik.

46. Në kuptim të sa më sipër dhe duke mbajtur parasysh qëndrimet diametralisht të kundërta të palëve për mënyrën sesi u sekuestruan sendet në zyrën e kërkueses (me kontroll apo dorëzim vullnetar), Gjykata, duke mbajtur në konsideratë edhe jurisprudencën e GJEDNJ-së, do të shqyrtojë fillimisht nëse ka pasur ndërhyrje në të drejtën e saj për paprekshmërinë

e zyrës në formën e kontrollit dhe nëse po, në vijim do të shqyrtojë nëse ndërhyrja ka qenë e justifikuar, pra nëse ajo ka qenë në përputhje me ligjin, nëse ka ndjekur një qëllim të ligjshëm dhe nëse ka qenë proporcionale, domethënë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë.

a) Nëse ka pasur ndërhyrje

47. Gjykata vëren se kërkuesja pretendon se ka pasur kontroll të zyrës së saj nga OPGJ-të dhe sekuestrim nga ata në vijim të disa dokumenteve dhe pajisjeve kompjuterike në zbatim të vendimit të sekuestrimit të prokurorëve, në kuadër të një hetimi penal që po zhvillohej. Nga ana tjetër, subjekti i interesuar pranon se në zbatim të një mase sekuestrimi (provues) të ndërmarrë në kuadër të hetimit penal që zhvillohej, OPGJ-të janë futur në zyrën e kërkueses, me lejen e saj, por mohon që ata të kenë ushtruar kontroll të zyrës. Ai pranon se OPGJ-të kanë kryer sekuestrim të dokumenteve dhe pajisjeve kompjuterike sipas urdhrit të sekuestrimit të prokurorëve, por kërkimi, gjetja dhe dorëzimi i tyre është bërë nga vetë kërkuesja, përfaqësuesja e saj A.P., e cila nuk ka paraqitur asnjë vërejtje ose kundërshtim në procesverbalin ku janë dokumentuar veprimet e OPGJ-ve.

48. Gjykata vëren se sipas GJEDNJ-së si shembuj të "ndërhyrjes" së mundshme në të drejtën për respektimin e banesës janë: hyrja e policisë në shtëpinë e një personi (*shih Gutsanovi kundër Bullgarisë, datë 15.10.2013, § 217; Sabani kundër Belgjikës, datë 08.03.2022, § 41*) dhe kontrolli (*shih Murray kundër Mbretërisë së Bashkuar, datë 18.01.1994, § 86*), edhe kur aplikanti ka bashkëpunuar deri në atë masë sa i ka hapur derën policisë, e cila nuk kishte njoftuar paraprakisht, sepse heqja dorë nga e drejta themelore për mbrojtjen e banesës mund të bëhet vetëm pa detyrim dhe në bazë të pëlqimit të qartë dhe të informuar (*shih Sabani kundër Belgjikës, datë 08.03.2022, § 46*); kontrollet dhe sekuestrimet (*shih Chappell kundër Mbretërisë së Bashkuar, datë 30.03.1989, §§ 50-51; Funke kundër Francës, datë 25.02.1993, § 48*), edhe kur aplikanti ka bashkëpunuar me policinë (*shih Saint-Paul Luxembourg S.A. kundër Luksemburgut, datë 18.04.2013, § 38*) dhe kur vepra penale që ka çuar në kontroll është kryer nga një palë e tretë *(shih Buck kundër Gjermanisë, datë 28.04.2005)* dhe, në përgjithësi, çdo masë, nëse nuk është e ndryshme në mënyrën e ekzekutimit dhe efektet e saj praktike nga një kontroll, pavarësisht nga karakterizimi i tij sipas ligjit të brendshëm *(shih Belousov kundër Ukrainës, datë 07.11.2013, § 103; Kruglov dhe të tjerë kundër Rusisë, datë 04.02.2020, § 123);* vizitat në shtëpitë e zyrtarëve publikë pa leje, edhe kur nuk kryhet asnjë kontroll

dhe as nuk sekuestrohen dokumente ose sende të tjera (*shih Halabi kundër Francës, datë 16.05.2019, §§ 54-56*). Po sipas GJEDNJ-së, shpërndarja e barrës së provës dhe niveli i bindjes së nevojshme për të arritur në një përfundim të caktuar janë të lidhura në mënyrë të pandashme me specifikën e fakteve, natyrën e pretendimit dhe të drejtën konventore në fjalë. Ndaj, në rastet kur qëndrimet e palëve për ngjarjet janë të ndryshme, Gjykata përcakton nëse kërkuesi ka paraqitur prova *prima facie* në mbështetje të versionit të tij dhe nëse është kështu, barra e provës duhet t'i kalojë qeverisë (*shih Fadeyeva kundër Rusisë, datë 09.06.2005, § 79; N.D. dhe N.T. kundër Spanjës, datë 13.02.2020, § 85; Sabani kundër Belgjikës, datë 08.03.2022, § 43*).

49. Në rastin konkret, Gjykata vëren se në procesin gjyqësor të zhvilluar mbi ankimin e kërkueses, në lidhje me pretendimin për ushtrim kontrolli të zyrës nga OPGJ-të, gjykatat e zakonshme kanë mbështetur qëndrimin e subjektit të interesuar, duke arritur në përfundimin se nuk ka pasur kontroll të zyrës së kërkueses dhe se OPGJ-të kanë kryer vetëm sekuestrim të dokumenteve dhe pajisjeve kompjuterike në zbatim të urdhrit të sekuestrimit të prokurorëve. Gjykatat, sikundër edhe kërkuesja dhe subjekti i interesuar, në lidhje me veprimet e kryera nga OPGJ-të, qëndrimet e tyre i kanë mbështetur në përmbajtjen e vendimit të sekuestrimit dhe të procesverbalit të sekuestrimit. Edhe gjatë gjykimit kushtetues, pavarësisht ftesës së Gjykatës, palët nuk paraqitën prova të tjera.

50. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka pohuar se është detyrë e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm të vlerësojnë faktet dhe provat e administruara, si dhe të interpretojnë ligjin për qëllim të procesit gjyqësor që ato zhvillojnë, ndërsa detyra e saj është të vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës. Gjykata nuk vepron si shkallë e katërt gjykimi, por ajo ndërhyn atëherë kur gabimi ligjor ose faktik nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është aq i dukshëm, sa një gjykatë e arsyeshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose është i tillë që gjykimin e bën të padrejtë (*shih vendimet nr. 64, datë 01.10.2024; nr. 59, datë 14.11.2023; nr. 33, datë 14.11.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

51. Megjithatë, duke marrë shkas nga specifikat e rastit konkret, pretendimet e kërkueses dhe rëndësinë e së drejtës së pretenduar të shkelur, duke mbajtur në konsideratë edhe elaborimin nga GJEDNJ-ja të parimit të

barrës së provës, Gjykata çmon se është i pashmangshëm vlerësimi nga ajo i respektimit nga gjykatat e zakonshme të këtij parimi në rastin konkret, për sa kohë përcaktimet e faktit determinojnë përfundimet mbi ekzistencën e ndërhyrjes në të drejtën kushtetuese të paprekshmërisë së banesës të pretenduar si të shkelur nga kërkuesja.

52. Gjykata vëren se ndërhyrja e pretenduar nga kërkuesja ka ndodhur në kuadër të një procedimi penal të regjistruar në dhjetor të vitit 2020. Ky procedim, në kohën e ndodhjes së fakteve, në datën 28.04.2023, ka qenë i regjistruar për veprën penale "Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale", të parashikuar nga neni 287 i KP-së. Si të dyshuar për këtë vepër penale, megjithëse ende të paregjistruar në regjistrin e njoftimit të veprave penale, kanë qenë shoqëria e ndërtimit "H." sh.p.k. dhe ortakët e saj, për të cilët kërkuesja, prej disa vitesh, ka ofruar shërbime konsulence financiare përfshirë, në veçanti, edhe në lidhje me aktivitetin e shoqërisë në ndërtimet e zhvilluara në pronën që ishte objekt hetimi penal. Megjithatë, në atë kohë, as kërkuesja, as administratorja dhe as ndonjë punonjës tjetër i saj, nuk kanë qenë të dyshuar për kryerjen e veprës penale të regjistruar ose të ndonjë vepre tjetër penale.

53. Gjatë hetimit të procedimit penal, mesditën e datës 28.04.2023, prokurorët kanë marrë në pyetje një nga ortakët dhe njëherazi administratorin e shoqërisë "H." sh.p.k., shtetasin F.B. Në deklarimet e tij, ndër të tjera, në lidhje me dokumentet e shoqërisë për aktivitetin e ndërtimit në pronën që ishte objekt hetimi, ai ka pohuar se ato gjendeshin në zyrën e kërkueses, kurse për disa pyetje specifike të prokurorëve në lidhje me ortakërinë, investimet dhe ndarjen e dividentit, ai ka kërkuar dhënien e një kohe të nevojshme për t'u konsultuar me ato dokumente. Pas përfundimit të pyetjes së këtij shtetasi, prokurorët kanë përpiluar vendimin e sekuestrimit të sendeve/dokumenteve. Në këtë vendim përshkruhet se në kuadër të veprimeve hetimore për procedimin penal në fjalë, lind e nevojshme të sekuestrohen pranë zyrës së A.P. të gjitha dokumentet që kanë lidhje me shoqërinë "H." sh.p.k., kompjuteri në të cilin mbaheshin të dhënat e kësaj shoqërie, si dhe çdo gjë tjetër që vlerësohet me rëndësi për hetimin dhe që ofron të dhëna mbi faktin objekt hetimi. Mbi këtë bazë, mbështetur në nenet 208 e vijues të KPP-së, prokurorët kanë urdhëruar sekuestrimin e sendeve/dokumenteve si më lart, duke ngarkuar për zbatimin e vendimit tre OPGJ të cilët, përveç dokumentimit me procesverbal të sekuestrimit, janë urdhëruar të njihnin personat e interesuar me atë vendim, ndaj të cilit lejohej ankim sipas ligjit. Megjithatë, në vendim, përveç të dhënës identifikuese "*që*

kanë lidhje me shoqërinë "H." sh.p.k", nuk tregohet që përfaqësueses së kërkueses i është dhënë ndonjë informacion për faktet objekt hetimi apo për të dhënat që kishin rëndësi për hetimin, në mënyrë që ajo të kishte mundësi të identifikonte sendet dhe dokumentet që përmbanin ato të dhëna dhe për të cilat urdhërohej sekuestrimi, por edhe për t'i dorëzuar ato vullnetarisht.

54. Megjithëse në vendimin e sekuestrimit nuk tregohet koha kur kjo masë duhej të zbatohej, referuar procesverbalit të sekuestrimit del se ajo është zbatuar menjëherë. Sipas procesverbalit të hartuar në 15 faqe, në fillim të tij pasqyrohet momenti i përpilimit, pikërisht në datën 28.04.2023, ora 15:30. Në vijim, përshkruhet se ai mbahet në bazë të "*neneve 300 dhe 301 të KPP-së*", për sekuestrimin e dokumenteve "*të gjetura*" në zbatim të vendimit të prokurorëve të datës 28.04.2023, në funksion të hetimeve që zhvillohen në kuadër të procedimit penal nr. 287/2020 dhe, më pas, përshkruhen "*sendet/dokumentet e gjetura (apo të dorëzuara) nga shtetasja A.P., pronare e vetme e subjektit tregtar "Studio Pustina" sh.p.k....*". Në procesverbal, në mënyrë të detajuar, janë evidentuar 4 pajisje kompjuterike, 407 dokumente shkresore që lidhen me shoqërinë "H." sh.p.k. dhe 4 dokumente shkresore të tjera (pasqyra financiare) që u përkasin subjekteve juridike të tjera, duke u evidentuar gjithashtu se 2 grupe dokumentesh shkresore (të përcaktuara konkretisht) gjendeshin në 2 dosje, ku në pjesën anësore të njërës shënohej "P. Parkimi 2010-2011", ndërsa në atë të tjetrës "H. Kontrata 2011".

55. Gjykata vëren, megjithatë, se në procesverbalin e sekuestrimit nuk ka ndonjë sqarim se përse OPGJ-të janë mbështetur në nenin 300 të KPP-së, që bën fjalë për veprimet me iniciativë të policisë gjyqësore në rastet e verifikimeve të ngutshme në vend, kur ka rrezik që gjurmët dhe sendet të ndryshojnë ose të humbasin dhe prokurori nuk mund të ndërhyjë. Po kështu, nuk tregohet që përfaqësueses A.P. të kërkueses t'i jetë dhënë ndonjë informacion, qoftë edhe në atë masë që nuk shkelte sekretin hetimor, në lidhje me faktet objekt hetimi ose për të dhënat që kishin rëndësi për hetimin, referuar të cilit ajo të mund të identifikonte dhe të dorëzonte ato dokumente, pajisje kompjuterike ose çdo gjë tjetër që përmbante të dhëna për shoqërinë "H.", me rëndësi për hetimin dhe mbi faktet objekt të tij. Nuk ka as ndonjë sqarim të mëtejshëm për sa përshkruhet për sendet/dokumentet "e gjetura (apo të dorëzuara)". Gjithashtu, nuk tregohet nëse në zyrën e kërkueses janë sekuestruar të gjitha dokumentet dhe pajisjet kompjuterike apo vetëm një pjesë e tyre, sikurse kjo e fundit deklarohet nga subjekti i interesuar, ndërsa kërkuesja nuk parashtron asgjë konkrete në këtë drejtim.

Së fundi, në procesverbal nuk tregohet as se kur sekuestrimi ka përfunduar, pra sa ka zgjatur në kohë zbatimi i masës. Gjithsesi, procesverbali është nënshkruar edhe nga përfaqësuesja A.P. e kërkueses, pa ndonjë vërejtje apo shënim tjetër.

56. Në datën 02.05.2023 përfaqësuesja A.P. e kërkueses është pyetur nga OPGJ-të në cilësinë e personit që ka dijeni për veprën penale dhe ajo ka dhënë deklarime për lidhjen e saj dhe të "Studio Pustina" me shoqërinë "H." sh.p.k., administratorin dhe ortakët e saj, si dhe për veprimet financiare të kryera për ata. Ajo nuk është pyetur dhe as ka bërë ndonjë deklarim në lidhje me veprimet e kryera në zyrën e kërkueses në datën 28.04.2023. Ndërkohë, në datën 08.05.2023, përmes shërbimit postar, kërkuesja ka paraqitur ankim në gjykatë kundër vendimit të sekuestrimit të prokurorëve të datës 28.04.2023, të zbatuar po në këtë datë nga OPGJ-të, duke ngritur pretendime për vendimin e sekuestrimit dhe për mënyrën e ekzekutimit të tij nga OPGJ-të, duke pretenduar, ndër të tjera, se për realizimin e sekuestrimit është ushtruar prej tyre kontroll i paautorizuar i zyrës.

57. Gjykata konstaton, gjithashtu, se në vijim të hetimeve paraprake, me kërkesë të prokurorëve, GJKKO-ja e Shkallës së Parë, me vendimin nr. 420, datë 21.10.2023, ka autorizuar kontrollin edhe të zyrës së kërkueses, duke disponuar dhe për sekuestrimin e sendeve të gjetura gjatë kontrollit dhe që përbënin provë materiale. Në zbatim të këtij vendimi, në datën 22.10.2023 OPGJ-të, pas kontrollit të zyrës së kërkueses, bazuar në nenin 300, pika 2, të KPP-së, kanë sekuestruar disa dokumente dhe sende të gjetura (ose dorëzuara) nga përfaqësuesja A.P. e saj, përfshirë, ndër të tjera, edhe 2 njësi qendrore, 2 laptopë dhe 2 hard disc. Duket se në zyrën e kërkueses ka pasur edhe dokumente dhe pajisje kompjuterike që në vlerësim të organit të prokurorisë kanë pasur interes për hetimin, çka mbështet deklarimin e subjektit të interesuar se në datën 28.04.2023 OPGJ-të kanë sekuestruar vetëm sende dhe dokumente të dorëzuara nga vetë kërkuesja. Megjithatë, ndërsa kontrolli dhe sekuestrimi në këtë rast ka ndodhur rreth 6 muaj më pas, është e paqartë nëse dokumentet dhe pajisjet e sekuestruara kanë qenë në zyrën e kërkueses edhe në datën 28.04.2023.

58. Gjykata vëren se versionet e palëve për mënyrën sesi OPGJ-të kanë vepruar për zbatimin e vendimit të sekuestrimit duken të mundshme. Megjithatë, ka edhe një version tjetër, i cili, në kontekst të rrethanave, duket më i besueshëm në rastit konkret. Sipas këtij versioni, një pjesë e paidentifikuar e sendeve dhe dokumenteve të sekuestruara është dorëzuar

nga vetë kërkuesja, administratorja e saj A.P., kurse një pjesë tjetër e tyre, po ashtu të paidentifikuara, janë gjetur nga OPGJ-të. Një gjë e tillë nënkupton një lloj kërkimi nga këta të fundit, qoftë edhe sipërfaqësor dhe të kufizuar të zyrës së kërkueses. Në këtë pikë mbahet parasysh fakti i pranuar nga palët se kanë qenë tre OPGJ të cilët kanë qenë brenda zyrës së kërkueses dhe kanë qëndruar aty për një periudhë jo të shkurtër, referuar për këtë kohës së nevojshme për pasqyrimin në procesverbal të asaj sasie të madhe të sendeve dhe dokumenteve të sekuestruara, përveçse edhe përshkrimit të detajuar të tyre. Gjykata vlerëson se kërkuesja ka përmbushur *prima facie* barrën e saj të provës, ndërkohë që subjekti i interesuar nuk ka arritur të hedhë poshtë faktin se ka pasur një ndërhyrje në të drejtën e kërkueses për paprekshmërinë e zyrës.

59. Në vlerësim të Gjykatës do të ishte joproporcionale që barra e provës t'i ngarkohej vetëm individit, sikurse gjykatat e zakonshme kanë konsideruar praktikisht në rastin konkret, ndërsa është në detyrimin e autoritetit publik, subjektit të interesuar në këtë rast, të dokumentojë dhe provojë qartësisht masat dhe veprimet e ndërmarra, në veçanti kur ato prekin ose mund të prekin të drejta dhe liri kushtetuese. Ndërhyrja në të drejtën e kërkueses në rastin konkret ka konsistuar në zbatimin praktikisht të një mase kërkimi në zyrën e saj, e shoqëruar me sekuestrim, e cila për nga mënyra e zbatimit dhe efektet e saj praktike në thelb përbën një kontroll banese për efekte të zbatimit të nenit 37 të Kushtetutës dhe nenit 8 të KEDNJ-së.

60. Nga ana tjetër, në lidhje me faktin se përfaqësuesja e kërkueses ka nënshkruar procesverbalin e sekuestrimit pa vërejtje, Gjykata vlerëson të shqyrtojë, së pari, nëse kjo do të konsiderohet, në çdo rast, se përbën heqje dorë nga e drejta kushtetuese, pra nëse në parim do të përbënte lejim të një mase kontrolli. Sipas GJEDNJ-së, heqja dorë nga një e drejtë themelore duhet të përcaktohet në mënyrë të qartë, duke u bërë me njohuri të plotë të fakteve, pra në bazë të pëlqimit të informuar (*shih* Pfeifer dhe Plankl kundër Austrisë, datë 25.02.1992, §§ 37-38) të qartë dhe pa detyrim (*shih Sabani kundër Belgjikës, datë 08.03.2022, § 46*). Përveç kësaj, heqja dorë duhet të shoqërohet me garanci minimale në përpjesëtim me rëndësinë e saj (*shih Dvorski kundër Kroacisë, datë 20.10.2015, § 100; Bože kundër Letonisë, datë 18.05.2017, § 69*) dhe, pasi të përdoret, jo vetëm që duhet të jetë vullnetare, por duhet të përbëjë edhe një heqje dorë të vetëdijshme dhe inteligjente nga një e drejtë (*shih Pishchalnikov kundër Rusisë, datë 24.09.2009, § 77*).

61. Thënë sa më lart, në rastin konkret nuk rezulton ndonjë e dhënë

mbi të cilën Gjykata të vërejë mënyrën sesi është proceduar në respekt të këtij parimi, pra nëse përfaqësuesja A.P. e kërkueses është informuar për ushtrimin e të drejtave të saj, përfshirë atë për të refuzuar kërkimin nga OPGJ-të në ambientet e saj, qoftë edhe në mënyrë sipërfaqësore ose të kufizuar, të sendeve dhe dokumenteve apo për pasojat e dhënies së pëlqimit për këtë qëllim, si dhe nëse kjo heqje dorë nga kjo e drejtë ka qenë e vetëdijshme, në kuptimin e shprehjes së vullnetit pa vese, pasi të jetë kuptuar rëndësia e veprimit dhe e pasojave. Referimi nga subjekti i interesuar, Prokuroria e Posaçme, në nënshkrimin e procesverbalit pa vërejtje, nuk përbën bazë të mjaftueshme për të arritur në përfundimin se kjo përbën në thelb miratim kontrolli nga ana e kërkueses.

62. Po ashtu, fakti se përfaqësuesja A.P. e kërkueses i ka lejuar OPGJ-të të futen në zyrë apo se ajo ka bashkëpunuar me ta, duke iu ofruar edhe një post pune dhe kompjuter për përpilimin e procesverbalit të sekuestrimit, rrethana këto që nuk kundërshtohen nga kërkuesja, nuk mund të interpretohet si dhënie pëlqimi edhe për lejimin e tyre për të kërkuar në zyrën e saj, të sendeve, dokumenteve apo çdo gjëje tjetër me interes për hetimin penal që zhvillohej. Edhe për këtë aspekt vlen parimi i evidentuar më lart se heqja dorë nga një e drejtë themelore duhet të përcaktohet në mënyrë të qartë, duke u bërë me njohuri të plotë të fakteve, pra në bazë të pëlqimit të informuar dhe pa detyrim.

63. Së fundi, fakti se disa muaj më vonë ka pasur një procedurë kontrolli dhe sekuestrimi edhe të dokumenteve/sendeve të tjera në zyrën e kërkueses, ndryshe nga sa subjekti i interesuar pretendon, nuk përjashton pasjen e një kontrolli edhe në rastin në shqyrtim. Një rrethanë e tillë mund të tregojë vetëm se kontrolli dhe sekuestrimi në rastin konkret mund të mos ketë qenë i plotë apo i kujdesshëm, mbase edhe për arsye objektive që lidheshin me faktet e identifikuara si pjesë e objektit të hetimit, i cili duket se ka qenë dinamik.

64. Për sa më lart, Gjykata arrin në përfundimin se ka pasur ndërhyrje në të drejtën e kërkueses për paprekshmërinë e banesës.

b) Nëse ndërhyrja ka qenë e justifikuar

65. Gjykata, në vijim, do të ndalet në analizën nëse ndërhyrja në të drejtën e kërkueses për paprekshmërinë e banesës është e justifikuar, pra respekton kriteret kushtetuese të kufizimit, në kuptim të nenit 17 të Kushtetutës dhe ato të përcaktuara në jurisprudencën e GJEDNJ-së.

i) Nëse ndërhyrja ka qenë në përputhje me ligjin

66. Gjykata vëren se kërkuesja ka pretenduar se kontrolli i zyrës së saj është bërë në kundërshtim me ligjin, nenin 202 të KPP-së, pasi është bërë pa vendim gjyqësor. Përkundër kësaj, subjekti i interesuar, pavarësisht se ka mohuar që zyra e kërkueses të jetë kontrolluar nga OPGJ-të, ka prapësuar se masa e sekuestros (provuese) ndaj kërkueses është zbatuar në kushte urgjence, pasi sendet dhe dokumentet objekt sekuestrimi mund të zhdukeshin ose të humbitnin. Ndërkohë, për zbatimin e masës së sekuestrimit provues, OPGJ-të janë bazuar në nenin 300 të KPP-së.

67. Sikurse dhe më lart u parashtrua, neni 37 i Kushtetutës, rregullimin e rasteve dhe të mënyrës së kontrolleve të banesës dhe të mjediseve që njësohen me të, ia ka deleguar ligjvënësit të zakonshëm. Në lidhje me kontrollin në fushën penale, ai rregullohet nga KPP-ja. Sipas kësaj të fundit, kontrolli dhe sekuestrimi (provues) janë dy mjete të ndryshme të kërkimit të provës që rregullohen nga dispozita të veçanta të KPP-së. Sekuestrimi paraqitet si një masë hetimore procedurale autonome, por megjithatë në praktikë ai shpesh shoqëron ose pason një masë kontrolli ose këqyrjeje, sepse pikërisht përmes këtyre të fundit mund të gjenden sendet, dokumentet ose diçka tjetër që duhet sekuestruar. Nenet 202-207 të KPP-së rregullojnë kushtet dhe mënyrën e kryerjes së kontrolleve, përfshirë edhe të vendit apo të banesës, duke pasur si synim gjetjen e provave materiale të veprës penale ose të sendeve që i përkasin asaj, në rastet kur ekzistojnë arsye të bazuara për të menduar se ato gjenden në një vend të caktuar. Në veçanti, pikat 1 dhe 2 të nenit 202 të KPP-së parashikojnë se kontrolli edhe i vendit apo i banesës, si rregull, lejohet të kryhet vetëm me vendim të gjykatës dhe, përjashtimisht, në rast flagrance ose në rast ndjekjeje të personit që është duke ikur, që nuk lejon nxjerrjen e një vendimi kontrolli nga gjykata, OPGJ-të kryejnë edhe kontrollin e vendit apo të banesës, duke zbatuar rregullat e caktuara në nenin 298 të kodit (pika 3). Ndërsa neni 207 i KPP-së rregullon sekuestrimin gjatë kontrollit, duke parashikuar se sendet e gjetura gjatë kontrollit sekuestrohen, me kusht që të jenë të përcaktuara në vendimin për lejimin e kontrollit (pika 1). Sendet që nuk përfshihen në vendimin përkatës të kontrollit, por që lidhen me të njëjtën vepër penale, mund të sekuestrohen (pika 2) dhe po ashtu sekuestrohen sendet që nuk kanë lidhje me veprën penale për të cilat është dhënë vendimi i kontrollit, por që lidhen me një vepër tjetër penale që ndiqet kryesisht (pika 3), duke u zbatuar në këto dy raste kriteret e nenit 301 të kodit (pika 4).

68. Nga ana tjetër, sekuestrimi provues rregullohet në nenet 208-220

të KPP-së, të cilat, mes të tjerash, parashikojnë se ai mund të vendoset nga gjyqtari ose prokurori, me vendim të arsyetuar, për sekuestrimin e provave materiale dhe të sendeve që lidhen me veprën penale kur ato janë të domosdoshme për vërtetimin e fakteve, dhe se ai kryhet nga vetë ai që ka nxjerrë vendimin ose OPGJ-të e deleguar me të njëjtin vendim (neni 208). Në rastin e procedimeve për krime që lidhen me teknologjinë e informacionit, neni 208/a parashikon sekuestrimin e të dhënave ose sistemeve kompjuterike, me kërkesë të prokurorit dhe me vendim të gjykatës, në të cilin përcaktohet e drejta për të hyrë, kërkuar dhe marrë të dhënat kompjuterike në sistemin kompjuterik, si dhe ndalimi për kryerjen e veprimeve të mëtejshme apo sigurimi i të dhënave ose i sistemit kompjuterik. Neni 212 i kodit parashikon të drejtën e ankimit në gjykatë edhe të personit tek i cili janë sekuestruar sendet dhe të atij që ka të drejtën e kërkimit të tyre.

69. Ndërkohë, KPP-ja, në nenet 293-303 të saj, rregullon posaçërisht veprimtarinë me iniciativë të policisë gjyqësore në kuadër të hetimeve paraprake. Kështu, neni 294 rregullon "sigurimin e burimeve të provave", duke parashikuar se edhe pas referimit të veprës penale policia gjyqësore vazhdon të kryejë funksionet e treguara në nenin 30, duke grumbulluar e fiksuar çdo element të vlefshëm për rindërtimin e faktit dhe për individualizimin e fajtorit, duke proceduar sidomos edhe për kërkimin dhe fiksimin e sendeve dhe të gjurmëve të veprës penale, si dhe për ruajtjen e tyre dhe të vendit të ngjarjes për aq kohë sa kjo gjë është e domosdoshme apo dhe për kryerjen e veprimeve të caktuara në nenet vijuese (pika 1). Pas ndërhyrjes së prokurorit, policia gjyqësore kryen çdo veprim të urdhëruar ose të deleguar posaçërisht nga prokurori, si dhe kryen me iniciativë çdo veprim hetimor të nevojshëm dhe siguron burime të reja të provës (pika 2). Neni 298 i KPP-së në vijim, i cili është i lidhur me nenin 202, pika 3, të tij rregullon "kontrollet". Sipas pikës 1 të këtij neni, në rast flagrance ose në rast ndjekjeje të personit që është duke ikur, OPGJ-të kryejnë kontroll edhe në një vend të caktuar kur kanë arsye të bazuara të mendojnë se në të ndodhen sende ose gjurmë të veprës penale që mund të zhduken a të humbasin. Veprimet e kryera i nënshtrohen kontrollit të prokurorit sipas nenit 301 të këtij kodi (pika 4). Kurse neni 300 i kodit rregullon "verifikimet e ngutshme në vend", duke përcaktuar se OPGJ-të dhe agjentët e policisë gjyqësore marrin masa që gjurmët dhe sendet që i përkasin veprës penale të fiksohen e të ruhen dhe që gjendja e vendngjarjes dhe e sendeve të mos ndryshojnë dhe kur ka rrezik që ato të ndryshojnë ose të humbasin

dhe prokurori nuk mund të ndërhyjë urgjentisht, OPGJ-të kryejnë veprimet hetimore të domosdoshme dhe, kur është rasti, sekuestrojnë provat materiale dhe sendet që lidhen me veprën penale. Neni 301 parashikon se sekuestrimi kontrollohet nga prokurori, i cili me vendim të motivuar e vleftëson atë në qoftë se ekzistojnë kushtet ose vendos kthimin e sendeve të sekuestruara, vendim ndaj të cilit mund të bëhet ankim në gjykatë brenda dhjetë ditëve edhe nga personi të cilit i janë sekuestruar sendet dhe ai që ka të drejtë t'i kthehen ato, ankim që nuk pezullon zbatimin e sekuestros. Ndërsa neni 303 i KPP-së përcakton detyrimin për dokumentim të veprimeve nga policia gjyqësore, ndër të tjera, edhe të kontrolleve dhe sekuestrimeve (shkronja "ç").

70. Nga sa më lart, Gjykata vëren se KPP-ja, për sa i përket kontrollit të vendit apo të banesës, me qëllim sekuestrimin e provave materiale dhe të sendeve që lidhen me veprën penale kur ato janë të domosdoshme për vërtetimin e fakteve, parashikon se ai, si rregull, kryhet me vendim të gjykatës. Megjithatë, kodi lejon kryerjen e një kontrolli të tillë edhe pa vendim të gjykatës, me iniciativë të OPGJ-ve, por vetëm në rast flagrance ose në rast ndjekjeje të personit që është duke ikur, që nuk lejon nxjerrjen e një vendimi kontrolli nga gjykata dhe kur kanë arsye të bazuara të mendojnë se në të ndodhen sende ose gjurmë të veprës penale që mund të zhduken a të humbasin.

71. Po ashtu, KPP-ja bën fjalë edhe për "verifikime të ngutshme në vend" nga ana e OPGJ-ve të cilët, në rastin kur gjendja e vendngjarjes dhe e sendeve ka rrezik që të ndryshojnë ose të humbasin dhe prokurori nuk mund të ndërhyjë urgjentisht, kanë përgjegjësinë të kryejnë të gjitha veprimet hetimore të domosdoshme, duke përfshirë edhe sekuestrimin e provave materiale dhe sendeve që lidhen me veprën penale.

72. Nisur nga sa më sipër Gjykata vëren se, duke parashikuar mundësinë e kontrollit të vendit apo të banesës me iniciativë të OPGJ-ve, pra pa vendim të gjykatës, KPP-ja u referohet kërkesave të efikasitetit.

73. Gjykata vëren, po ashtu, se KPP-ja nuk ka ndonjë rregullim specifik për nocionin "rast flagrance" të përdorur në nenet 202 dhe 298. Megjithatë, në kreun që rregullon "arrestimin në flagrancë", pikërisht në nenin 252 të saj, rregullohet nocioni "gjendje e flagrancës", duke përcaktuar se është në gjendje të tillë personi që është kapur në kryerje e sipër të veprës penale ose ai që menjëherë pas kryerjes së veprës ndiqet nga policia gjyqësore, nga personi viktimë ose nga persona të tjerë ose që është kapur me sende dhe prova e materiale, nga të cilat duket se ka kryer veprën penale. Kurse

në lidhje me "verifikimet e ngutshme në vend", që bën fjalë neni 300 i KPP-së, duket se ato janë të lidhura me "vendngjarjen", por edhe për këtë nocion nuk ka ndonjë rregullim specifik. Megjithatë, referuar neneve 198 e vijues, që rregullojnë "këqyrjet" si një nga mjetet e kërkimit të provës, duket se nocioni "vendngjarje" mund të ketë kuptimin e një hapësire fizike apo edhe virtuale dhe të përfshijë vendin ku është përgatitur vepra penale, vendin ku ajo është realizuar, vendin ku janë lënë pasojat materiale të saj apo dhe vendin ku gjenden prova materiale ose gjurmë të lidhura me të.

74. Së fundi, Gjykata vëren se KPP-ja nuk ka ndonjë parashikim për mundësinë e ankimimit të një mase kontrolli të vendit apo të banesës, qoftë të lejuar me vendim të gjykatës, ashtu edhe të kryer me iniciativë nga OPGJ-të. Megjithatë, në jurisprudencën e saj Gjykata është shprehur se referuar parashikimeve aktuale ligjore, kur gjatë kontrollit sekuestrohen prova materiale, atëherë pretendimet kushtetuese për procedurën e kontrollit parashtrohen nga individi në aktin e ankimit ndaj vendimit të sekuestrimit drejtuar një gjykate më të lartë dhe pas shterimit të atyre mjeteve juridike ai mund të paraqesë ankim kushtetues individual (*shih paragrafin 22 të vendimit*). Kurse kur nga kontrolli nuk gjenden sende për t'u sekuestruar në cilësinë e provës materiale dhe individit i janë cenuar të drejtat dhe liritë themelore, atëherë ai mund t'i paraqesë pretendimet kushtetuese për procedurën e kontrollit drejtpërdrejt në Gjykatë me anë të ankimit kushtetues individual (*shih vendimin nr. 21, datë 22.04.2025 të Gjykatës Kushtetuese*).

75. Duke iu kthyer rastit konkret, Gjykata vëren se sekuestrimi nga prokurorët është urdhëruar duke konsideruar ekzistencën e një rreziku të afërt për humbjen ose zhdukjen e sendeve dhe dokumenteve që përmbanin të dhëna me rëndësi për hetimin, ndërkohë që OPGJ-të, nga ana tjetër, për zbatimin e masës së sekuestrimit, kanë konsideruar kryerjen e veprimeve me iniciativë në kuadër të një verifikimi të ngutshëm në vend. Gjykata vëren se kontrolli i vendit apo i banesës me iniciativë nga OPGJ-të, pa vendim të gjykatës, është një masë e lejuar nga KPP-ja, por vetëm në kushte të përcaktuara rigozorisht prej saj. Megjithatë, nëse ato kushte kanë ekzistuar në rastin konkret, nuk ka një përgjigje nga gjykatat e zakonshme, të cilat ndërsa kanë konkluduar se nuk ka pasur kontroll të zyrës së kërkueses, nuk kanë vënë në diskutim interpretimin dhe zbatimin e ligjit procedural për këtë aspekt. Po ashtu, Gjykata vëren se nuk evidentohet as ndonjë praktikë gjyqësore e qëndrueshme dhe aq më tepër njësuese e Gjykatës së Lartë për sa i përket kontrollit të vendit apo të banesës, në veçanti, me iniciativë

të OPGJ-ve, që t'i përgjigjet rrethanave të ngjashme me ato të çështjes konkrete. Në këtë situatë, ndërsa çështja në thelb kërkon interpretimin e dispozitave ligjore, që në respektim të parimit të subsidiaritetit i përket funksionit të gjykatave të zakonshme dhe sidomos atij të Gjykatës së Lartë, Gjykata vlerëson të mos ndalet në mënyrë të veçantë në lidhje me respektimin në rastin konkret të dispozitave të KPP-së për sa i përket masës së kontrollit të zbatuar praktikisht nga OPGJ-të në kuadër të ekzekutimit të vendimit të sekuestrimit. Duke thënë këtë, mënyra e zbatimit të masës në këtë rast do të vlerësohet nga Gjykata në lidhje me proporcionalitetin e saj.

ii) Nëse ndërhyrja ka ndjekur një qëllim të ligjshëm

76. Për sa i përket qëllimit të ndërhyrjes, Gjykata vëren se kontrolli (i kufizuar) në rastin konkret ka synuar gjetjen e të dhënave dhe provave për kryerjen e veprës penale të pastrimit të produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale. Nisur nga kjo, ndërsa as kërkuesja nuk ka ndonjë kundërshtim në këtë drejtim, është e qartë se ai ka pasur për qëllim parandalimin dhe ndjekjen penale të veprës penale të pastrimit të produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale, domethënë ruajtjen e rendit dhe të sigurisë publike nga veprimtaria kriminale, çka përbën një qëllim të ligjshëm në aspekt të interesit publik, në kuptim të nenit 17 të Kushtetutës.

iii) Nëse ndërhyrja ka qenë proporcionale, në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë

77. Gjykata, për sa i përket kriterit të proporcionalitetit të ndërhyrjes, është shprehur se ai nënkupton që marrëdhënia midis ndërhyrjes (kufizimit) dhe qëllimit të ndjekur duhet të jetë e arsyeshme. Gjykata e ka analizuar këtë kriter në drejtim të nevojës, pra nëse masa e zbatuar është e aftë të realizojë pasojën që ajo synon, të përshtatshmërisë, pra nëse masa e zbatuar është e arsyeshme, duke balancuar qëllimin për të cilin është zbatuar me interesat e individit të përfshirë, si dhe ashpërsisë, në kuptimin që ajo nuk duhet të jetë përtej asaj që është e pashmangshme (*shih vendimet nr. 79, datë 12.11.2024; nr. 29, datë 16.04.2024, nr. 18, datë 19.03.2024 të Gjykatës Kushtetuese*).

78. Sipas GJEDNJ-së, për të përcaktuar nëse një shkelje e veçantë e nenit 8 të Konventës është "e nevojshme në një shoqëri demokratike", ajo balancon interesat e shtetit me të drejtën e individit *(shih Vavřička dhe të tjerë kundër Republikës Çeke, datë 08.04.2021, §§ 273-275*). "E

nevojshme" në kontekst të nenit 8 të Konventës, nuk ka fleksibilitetin e shprehjeve të tilla si "e dobishme", "e arsyeshme" ose "e dëshirueshme", por nënkupton ekzistencën e një "nevoje të ngutshme shoqërore" për ndërhyrjen në fjalë. U takon autoriteteve kombëtare të bëjnë vlerësimin fillestar të nevojës së ngutshme shoqërore në secilin rast dhe në përputhje me rrethanat atyre u lihet një hapësirë vlerësimi. Një kufizim i një të drejte të Konventës nuk mund të konsiderohet si "i domosdoshëm në një shoqëri demokratike", përveçse nëse, ndër të tjera, është në përpjesëtim me qëllimin legjitim të ndjekur (*shih Dudgeon kundër Mbretërisë së Bashkuar, datë 22.10.1981, §§ 51-53*). Shtetet palë gëzojnë një hapësirë të caktuar vlerësimi në drejtim të domosdoshmërisë së një ndërhyrjeje dhe përjashtimet e parashikuara në paragrafin 2 të nenit 8 të Konventës duhet të interpretohen ngushtësisht, ndërsa domosdoshmëria në një rast të caktuar duhet të përcaktohet bindshëm (*shih Miailhe kundër Francës, datë 25.02.1993, § 36; Ernst dhe të tjerë kundër Belgjikës, datë 15.07.2003, § 113*).

79. Po sipas GJEDNJ-së, shtetet palë mund të konsiderojnë të nevojshme të përdorin masa të tilla për të marrë prova fizike për vepra të caktuara penale, por është detyrë e gjykatës të vlerësojë nëse arsyet e paraqitura për të justifikuar masa të tilla ishin relevante dhe të mjaftueshme, dhe nëse është respektuar parimi i proporcionalitetit. Lidhur me pikën e fundit, gjykata duhet, së pari, të sigurojë që legjislacioni dhe praktika përkatëse t`u ofrojnë individëve mbrojtje të mjaftueshme dhe efektive kundër abuzimit. Së dyti, ajo duhet të marrë në konsideratë rrethanat specifike të secilit rast për të përcaktuar nëse në rastin e veçantë ndërhyrja në fjalë ishte proporcionale me qëllimin e ndjekur. Kriteret që gjykata ka marrë në konsideratë në përcaktimin e kësaj çështjeje të fundit janë, ndër të tjera: rrethanat në të cilat është lëshuar urdhri, në veçanti nëse ka pasur prova të mëtejshme në dispozicion në atë kohë; përmbajtja dhe fushëveprimi i urdhrit, duke pasur parasysh veçanërisht natyrën e mjediseve të kontrolluara dhe mënyrën sesi është kryer kontrolli, duke përfshirë nëse kanë qenë të pranishëm apo jo vëzhgues të pavarur; shkalla e pasojave të mundshme për reputacionin e personit të prekur nga kontrolli (*shih Smirnov kundër Rusisë, datë 07.06.2007, § 44; K.S. dhe M.S. kundër Gjermanisë, datë 06.10.2016, § 44; Modestou kundër Greqisë, datë 16.03.2017, § 42*). Në kontekstin e kontrolleve dhe sekuestrimeve, gjykata kërkon, gjithashtu, që ligji i brendshëm të ofrojë garanci të mjaftueshme dhe të përshtatshme kundër arbitraritetit (*shih Gutsanovi kundër Bullgarisë, datë 15.10.2013, § 220;*

Vinci Construction dhe GTM Génie Civil et Services kundër Francës, datë 02.04.2015, § 66), garanci këto që përfshijnë edhe ekzistencën e "shqyrtimit efektiv" të masave që cenojnë nenin 8 të Konventës (*shih Lambert kundër Francës, datë 24.08.1998, § 34; Modestou kundër Greqisë, datë 16.03.2017, § 43*).

80. Në lidhje me një urdhër për kërkimin e provave, GJEDNJ-ja është shprehur se ai duhet të shoqërohet me kufizime të caktuara, në mënyrë që ndërhyrja që ai autorizon të mos jetë potencialisht e pakufizuar dhe, për këtë arsye, joproporcionale. Formulimi i urdhrit duhet të specifikojë fushëveprimin e tij (në mënyrë që të sigurohet që kontrolli të përqendrohet vetëm në veprat penale nën hetim) dhe kriteret për zbatimin e tij (për të lehtësuar kontrollin e shtrirjes së veprimeve). Ai duhet të përmbajë një informacion minimal për të mundësuar mbikëqyrjen e oficerëve që e ekzekutuan atë për të siguruar që fushëveprimi i hetimit që ai ka përcaktuar është respektuar. Një urdhër i formuluar gjerësisht, që nuk përmban informacion për hetimin ose sendet që do të sekuestrohen, nuk plotëson ekuilibrin e drejtë midis të drejtave të palëve të përfshira për shkak të kompetencave të gjera që u jep hetuesve (*shih Van Rossem kundër Belgjikës, datë 09.12.2004, §§ 44-45; Bagiyeva kundër Ukrainës, datë 28.04.2016, § 52*). Fakti që hetuesit "në të vërtetë dinin se çfarë duhej të kërkonin" nuk është i mjaftueshëm. Faktori vendimtar është që personi/personat e synuar nga masa, ose një palë e tretë, të kenë informacion të mjaftueshëm në lidhje me procedurat që çuan në këtë operacion për t'u mundësuar atyre të zbulojnë, parandalojnë dhe raportojnë abuzimet (*shih Funke kundër Francës, datë 25.02.1993, § 56; Miailhe kundër Francës, datë 26.09.1996, § 37; Van Rossem kundër Belgjikës, datë 09.12.2004, §§ 47*). Po sipas GJEDNJ-së, mungesa e një urdhri gjyqësor paraprak kontrolli mund të balancohet nga disponueshmëria e një shqyrtimi gjyqësor *ex post factum* të ligjshmërisë dhe domosdoshmërisë së masës. Ky shqyrtim, megjithatë, duhet të jetë efektiv në rrethanat e veçanta të çështjes në fjalë (*shih Smirnov kundër Rusisë, datë 07.06.2007, § 45; Gutsanovi kundër Bullgarisë, datë 15.10.2013, § 222; Modestou kundër Greqisë, datë 16.03.2017, § 49).*

81. Duke iu kthyer rastit konkret, Gjykata vëren së pari se kontrolli (i kufizuar) i zyrës së kërkueses është kryer gjatë fazës së hetimit paraprak të një procedimi penal, ndaj një kontroll i tillë duhet të shoqërohet me mbrojtje të përshtatshme dhe të mjaftueshme. Në vijim, Gjykata, në kontekst të kundërshtimit të kërkueses se vendimi i sekuestrimit ka përbërë shkas për

kontrollin e zyrës së saj nga OPGJ-të, do të shqyrtojë formulimin e këtij vendimi me qëllim për të verifikuar nëse janë marrë masa paraprake të mjaftueshme për të siguruar që ai nuk ka tejkaluar qëllimin e parandalimit dhe ndjekjes penale të veprës penale për të cilën ajo masë është marrë. Një vendim i tillë duhet t`u nënshtrohet kufizimeve të caktuara, në mënyrë që ndërhyrja që ai mund të shkaktojë, veçanërisht në të drejtën për respektimin e banesës, të mos jetë potencialisht e pakufizuar dhe, si pasojë, joproporcionale. Ai duhet të përfshijë, po ashtu, një numër minimal treguesish, çka mund të bënte të mundur më pas verifikimin nëse OPGJ-të e ngarkuar për zbatimin e tij kanë përmbushur fushëveprimin e hetimit të autorizuar në këtë mënyrë. Përveç kësaj, individi i prekur, kërkuesja në rastin konkret, duhet të ketë një informacion të mjaftueshëm, pa shkelur kufijtë e sekretit hetimor, për procedimin penal që ka përbërë shkak për ndërmarrjen e masës, për t'i mundësuar të dallojë, parandalojë dhe ankohet për abuzim.

82. Gjykata vëren se urdhri i sekuestrimit duket se është hartuar në terma të gjerë. Prokurorët e çështjes kanë urdhëruar sekuestrimin me qëllim gjetjen e provave për të verifikuar kryerjen e veprës penale të pastrimit të produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale përmes shoqërisë "H." sh.p.k., ndërsa të dyshuar në atë moment kanë qenë persona të ndryshëm nga kërkuesja, administratorja apo punonjësit e saj. Ata, gjithashtu, kanë urdhëruar OPGJ-të të sekuestronin dokumente dhe kompjuterin që kishte lidhje me shoqërinë "H." sh.p.k., si dhe "çdo gjë tjetër që kishte rëndësi për hetimin dhe ofronte të dhëna mbi faktin objekt hetimi", mbështetur në vlerësimin e tyre. Duket se prokurorët nuk kanë përfshirë ndonjë informacion në lidhje me hetimin në fjalë dhe as ndonjë informacion specifik për të dhënat që duhet të përmbanin dokumentet dhe sendet që do të sekuestroheshin, përveç atij se ato duhet të kishin lidhje me shoqërinë "H." sh.p.k., duke u dhënë kështu kompetenca të gjera OPGJ-ve, pavarësisht se ata mund ta kenë pasur këtë informacion për shkak të përfshirjes së tyre në hetimin e procedimit penal. Vendimi nuk përmbante as ndonjë listë shteruese të sendeve dhe dokumenteve në raport me natyrën e veprës penale në hetim dhe me faktet me rëndësi për hetimin në atë moment. Përveç kësaj, në vendim nuk është përshkruar as lidhja e mundshme e kërkueses me çështjen në hetim.

83. Gjykata pranon se mund të ketë situata në të cilat është e pamundur që vendimet e sekuestrimit të hartohen me një shkallë të lartë saktësie, në veçanti si ai në rastin konkret, kur provat që synohej të mblidheshin lidhen

me dyshime për një aktivitet kriminal të shtrirë përgjatë disa viteve dhe ku ishin të përfshirë disa persona, ndaj do të ishte iluzore të kërkohej që urdhri të përmbante informacion të saktë, siç është edhe një listë shteruese e sendeve ose dokumenteve që do të sekuestrohen. Megjithatë, në raste të tilla, dhe veçanërisht për sa kohë ligji procedural penal nuk parashikon shqyrtim paraprak gjyqësor të ligjshmërisë dhe domosdoshmërisë së një mase hetimore, do të duhet të zbatohen masa të tjera mbrojtëse, veçanërisht në lidhje me ekzekutimin e vendimit të sekuestrimit, në mënyrë që të kompensohet mungesa e lëshimit paraprak nga gjykata të një vendimi kontrolli dhe kufizimet e përcaktuara përmes tij. Në rastin konkret, siç edhe u përmend, KPP-ja, megjithëse parashikon, si rregull, një shqyrtim paraprak gjyqësor, përjashtimisht, në raste urgjente, lejon të mos ketë një shqyrtim të tillë. Megjithatë, sikurse GJEDNJ-ja ka pranuar, por edhe në përputhje me nenin 42 të Kushtetutës, mungesa e një vendimi gjyqësor paraprak kontrolli të vendit apo të banesës, të zyrës së kërkueses në rastin konkret, mund të balancohet nga një shqyrtim gjyqësor efektiv *ex post factum* i ligjshmërisë dhe domosdoshmërisë së kësaj mase hetimore, përfshirë edhe të kushtit të urgjencës së saj.

84. Gjykata vëren, së pari, se kontrolli i kryer në rastin konkret është shoqëruar me disa masa mbrojtëse procedurale. Ai është ndërmarrë në zbatim të një urdhri sekuestrimi të nxjerrë nga prokurorët e çështjes, detyrë të cilën ata ia deleguan OPGJ-ve, ndërsa për zbatimin e saj kanë vepruar tre të tillë. Po ashtu, kontrolli është kryer në prani të përfaqësueses së kërkueses, së cilës në përfundim i është vënë në dispozicion edhe një kopje e procesverbalit të mbajtur nga OPGJ-të për masën hetimore të zbatuar nga ata. Gjykata vëren se pavarësisht pranisë së përfaqësueses së kërkueses, ajo nuk duket se është informuar mjaftueshëm për çështjen penale në hetim, për faktet që kishin interes për hetimin dhe as për specifikën e të dhënave që duhet të përmbanin sendet dhe dokumentet që kërkoheshin për t'u sekuestruar. Po ashtu, duket se ajo nuk është informuar as për të drejtën për të kërkuar praninë e një personi të besuar ose mbrojtësit të saj, sikurse përcakton neni 205, pika 1, i KPP-së.

85. Përveç mungesës së shqyrtimit paraprak gjyqësor, natyrës jo tërësisht të saktë të vendimit të sekuestrimit dhe faktit që kërkueses nuk i është garantuar e drejta për të qenë i pranishëm një person i besuar ose mbrojtësi i saj, në rastin konkret pavarësisht se gjykatat u vunë në lëvizje *ex post factum* mbi ankimin e kërkueses, shqyrtimi gjyqësor nuk ka qenë efektiv. Kontrolli i zyrës së kërkueses në këtë rast ka çuar në sekuestrimin

e 4 pajisjeve kompjuterike dhe të qindra dokumenteve, por, megjithatë, nuk është përcaktuar nëse të gjitha ato përmbanin të dhëna që lidheshin drejtpërdrejt me veprën penale në hetim. Duke pasur parasysh formulimin e vendimit të sekuestrimit, është e diskutueshme nëse kërkueses i është dhënë informacion i saktë në lidhje me fushëveprimin e zbatimit të tij, çka praktikisht ka rezultuar në një masë kontrolli (të kufizuar) të zyrës, gjë e cila do t'i kishte mundësuar asaj (kërkueses) të verifikonte nëse ky kontroll ishte i kufizuar vetëm në kërkimin e provave të veprës penale të përmendur në vendimin e sekuestrimit dhe të ankohej për çdo abuzim në këtë kontekst. Gjykatat e zakonshme, mbi ankimin e kërkueses, duke konsideruar se nuk ka pasur kontroll të zyrës së saj, nuk kanë vënë në diskutim ligjshmërinë dhe domosdoshmërinë e kësaj mase hetimore, përfshirë edhe të kushtit të urgjencës së saj. Në lidhje me këtë të fundit, ndonëse mund të ketë pasur premisa për të menduar se provat materiale që janë synuar të sekuestrohen mund të zhdukeshin ose humbnin, pra se ka pasur një rrezik të menjëhershëm ose të afërt në këtë drejtim, nuk ka ndonjë tregues nëse masa të tjera hetimore, siç mund të ishte, për shembull, sekuestrimi dhe vulosja e përkohshme e zyrës së kërkueses, nuk do të kishin qenë të afta për të shmangur një rrezik të tillë deri në kërkimin dhe marrjen paraprakisht nga gjykata të një vendimi kontrolli, procedurë për të cilin KPP-ja parashikon një afat shumë të shkurtër kohor, deri në 24 orë nga paraqitja e kërkesës së prokurorit (neni 202/a, pika 3).

86. Në këtë pikë, Gjykata çmon të theksojë se kompetenca që KPP-ja i ka dhënë gjyqtarit për të vendosur për kontrollin e vendit apo të banesës synon kontrollin parandalues të kësaj mase nga një organ i pavarur dhe neutral. Gjyqtarët, për shkak të pavarësisë së tyre personale dhe profesionale dhe nënshtrimit të tyre të rreptë ndaj Kushtetutës dhe ligjit (neni 145 i Kushtetutës), kanë aftësitë dhe besueshmërinë e nevojshme për të mbrojtur të drejtat e të prekurve në raste individuale. Në hetimet penale paraprake, të cilat prokurori publik i kryen me përgjegjësinë e vet, gjyqtari, në përputhje me ndarjen e autoritetit të ndjekjes penale dhe gjykatës në procedurat penale, është një palë e tretë e papërfshirë, që sa i përket masave hetimore vepron vetëm me kërkesën e prokurorit publik. Në rastin e masës së kontrollit, e cila, sipas nenit 202/a të KPP-së, merret në dhomën e këshillimit, pra pa dëgjimin paraprak të personit të prekur, përfshirja e gjyqtarit synon të sigurojë në veçanti që interesat e personit të prekur të merren parasysh siç duhet. Në këtë kuptim, organet e ndjekjes penale kanë detyrimin që rezerva ligjore e mbikëqyrjes paraprake

gjyqësore, si një masë mbrojtëse e të drejtave themelore të individit, të jetë efektive në praktikë.

87. Po ashtu, Gjykata vëren se gjykatat e zakonshme janë fokusuar kryesisht në drejtim të faktit se sekuestrimi gjatë hetimeve paraprake është një masë hetimore në dorë të prokurorit të çështjes, por pa arsyetuar në lidhje me mënyrën e zbatimit dhe shtrirjen e tij në rastin konkret. Në këtë mënyrë, subjekti i interesuar dhe gjykatat e zakonshme në vijim nuk kanë përmbushur detyrimin e tyre për të treguar arsye "relevante dhe të mjaftueshme" për të justifikuar zbatimin në rastin konkret të një mase kontrolli të zyrës së kërkueses.

88. Për sa më lart, Gjykata vlerëson se këta faktorë janë të mjaftueshëm për të arritur në përfundimin se ndërhyrja në zyrën e kërkueses nuk ka qenë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë, pra nuk ka qenë proporcionale, pasi nuk provohet të jetë gjetur një ekuilibër i drejtë midis interesave të ndryshëm të përfshirë në këtë rast, duke pasur parasysh interesin e një shoqërie demokratike për të siguruar respektimin e paprekshmërisë së banesës. Për rrjedhojë, pretendimi i kërkueses për cenimin e së drejtës së paprekshmërisë së banesës është i bazuar, ndaj kërkesa pranohet për këtë shkak.

B.2. Për lirinë e veprimtarisë ekonomike

89. Sipas kërkueses, kjo liri gëzon mbrojtje kushtetuese edhe kur zhveshja e titullarit të sendit nga disponimi i ligjshëm bëhet për një kohë relativisht të shkurtër. Sipas saj, masa është e vlefshme dhe e ekzekutueshme menjëherë dhe qëndron në fuqi, si rregull, deri në përfundim të çështjes me vendim përfundimtar dhe se sekuestrimi i dokumenteve dhe sendeve në zyrën e saj është kryer në kundërshtim me ligjin, pa vendim gjyqësor, pa argumentuar domosdoshmërinë e sekuestrimit dhe janë sekuestruar dokumente që haptazi nuk i shërbejnë hetimit.

90. Sipas subjektit të interesuar, Prokurorisë së Posaçme, pretendimi është i pabazuar, pasi në sendet e sekuestruara kanë rezultuar dokumente që kanë të bëjnë me shoqërinë "H." sh.p.k. dhe veprimtarinë e saj dhe sekuestrimi është urdhëruar në kuadrin e një procedimi penal, të regjistruar për veprën penale të parashikuar nga neni 287 i KP-së, pra për një qëllim të ligjshëm. Sipas tij, në vendimin e sekuestrimit kishte të dhëna të mjaftueshme për veprën penale dhe për dokumentet e sendet që kërkoheshin të sekuestroheshin dhe ai është bazuar në dyshimin e arsyeshëm se shoqëria "H." sh.p.k. po shërbente si strukturë, hallkë e

pastrimit të parave dhe ato çfarë do të sekuestroheshin do të përdoreshin për të vërtetuar nëse aktiviteti i kësaj shoqërie dhe ortakëve të saj ishte në përputhje me ligjin. Sipas këtij subjekti, në lidhje me atë se çfarë kanë brenda këto pajisje kompjuterike dhe rëndësia për hetimin e të dhënave që ato përmbajnë, kjo zgjidhet pasi përfundon ekspertimi dhe këqyrja e të dhënave që këto pajisje kanë.

91. Kushtetuta në nenin 4, pika 1, ka parashikuar se e drejta përbën bazën dhe kufijtë e veprimtarisë së shtetit kurse në nenin 11, pika 1, ka përkufizuar se sistemi ekonomik bazohet në pronën private e publike, si dhe në ekonominë e tregut dhe lirinë e veprimtarisë ekonomike. Gjykata ka vlerësuar se liria e veprimtarisë ekonomike përmban në vetvete shumë të drejta dhe liri, ndër ato edhe lirinë e biznesit, lirinë e punës dhe të drejtat e pronës, si aftësi e individëve edhe për të poseduar sende, të lirë nga ndërhyrja e shtetit *(shih vendimet nr. 21, datë 18.04.2023; nr. 56, datë 27.07.2016; nr. 24, datë 24.07.2009 të Gjykatës Kushtetuese).*

92. Gjykata vëren se në zbatim të vendimit të sekuestrimit të datës 28.04.2023, OPGJ-të kanë sekuestruar në ambientet e punës së kërkueses 4 pajisje kompjuterike, 407 dokumente shkresore që lidhen me shoqërinë "H." sh.p.k. dhe 4 dokumente shkresore të tjera (pasqyra financiare) që u përkasin subjekteve juridike të tjera, sipas procesverbalit të po kësaj date. Në vijim, pajisjet kompjuterike u janë nënshtruar ekzaminimeve përkatëse, pas të cilëve 3 nga ato (1 laptop dhe 2 njësi qendrore) i janë kthyer kërkueses në datat 19.05.2023 dhe 07.06.2023, me arsyetimin se mbajtja e sekuestros nuk ishte e nevojshme. Nga ana tjetër, 1 nga laptopët është mbajtur nën sekuestro dhe në vijim i është dërguar gjykatës si provë materiale në kuadër të procedimit penal të dërguar për gjykim. Nisur nga këto veprime të kryera nga autoritetet e ndjekjes penale, si dhe duke konsideruar se sendet/pajisjet kompjuterike përdoreshin nga kërkuesja për ushtrimin e veprimtarisë tregtare së saj në fushën e konsulencës dhe shërbimeve financiare, ekonomike, Gjykata vlerëson se ka pasur ndërhyrje në lirinë e veprimtarisë ekonomike.

93. Gjykata e vlerëson ndërhyrjen si në kuptim të pikës 3 të nenit 11 të Kushtetutës, që parashikon se kufizime të lirisë së veprimtarisë ekonomike mund të vendosen vetëm me ligj dhe vetëm për arsye të rëndësishme publike, ashtu edhe të nenit 17 të Kushtetutës, që përveç arsyes publike përmban detyrimin për të respektuar edhe kritere të tjera, si: kufizimi për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve dhe ekzistenca e raportit të drejtë midis

kufizimit dhe gjendjes që e dikton atë. Parimi i proporcionalitetit nënkupton që ndërhyrja të bëhet me mjete të përshtatshme që i përgjigjen drejt qëllimit që synohet të arrihet (*shih vendimet nr. 1, datë 25.01.2024; nr. 30, datë 05.07.2021; nr. 16, datë 01.03.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

94. Për sa i përket kriterit të kufizimit me ligj dhe arsyes së rëndësishme publike Gjykata, nisur nga rrethanat e rastit dhe për sa kohë as nga palët nuk pati pretendime në lidhje me këto aspekte të ndërhyrjes, çmoi të mos ndalet në analizën e tyre, duke vlerësuar se ato përmbushen. Për sa i përket kriterit të proporcionalitetit, Gjykata në rastin konkret do ta analizojë atë në drejtim të kohëzgjatjes së masës së sekuestrimit ndaj sendeve/pajisjeve të kërkueses, ashtu si ka pohuar në jurisprudencën e saj (shih vendimin *nr. 79, datë 12.11.2024 të Gjykatës Kushtetuese)*.

95. Sipas GJEDNJ-së, mbajtja e provave materiale mund të jetë e nevojshme në interes të administrimit të duhur të drejtësisë, që është një "qëllim legjitim" në "interesin e përgjithshëm" të komunitetit. Megjithatë, duhet të ketë gjithashtu një lidhje të arsyeshme proporcionaliteti midis mjeteve të përdorura dhe qëllimit që kërkohet të realizohet nga çdo masë e zbatuar nga shteti, duke përfshirë masat e synuara për të kontrolluar përdorimin e pasurisë së individit (*shih Smirnov kundër Rusisë, datë 07.06.2007, § 57; BENet Praha, spol. S.r.o. kundër Republikës Çeke, datë 24.02.2011, §§ 100-01*). Ajo gjykatë ka konstatuar se mbajtja e vazhdueshme e pajisjeve elektronike të ruajtjes së të dhënave të sekuestruara nuk kishte asnjë justifikim të dukshëm kur vetë pajisjet nuk ishin objekt, instrument ose produkt i ndonjë vepre penale dhe, në këtë mënyrë, përbënin një ndërhyrje joproporcionale në të drejtën për gëzimin paqësor të pasurisë, të mbrojtur nga neni 1 i Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së (*shih Smirnov kundër Rusisë, datë 07.06.2007, § 5-8*).

96. Nisur nga qëllimi i ligjshëm i ndërhyrjes, në kuptim të interesit publik, në raport me kohëzgjatjen e masës sekuestrimit, Gjykata e vlerësoi të pabazuar pretendimin e kërkueses në lidhje me 3 nga pajisjet kompjuterike të sekuestruara, të cilat i janë kthyer asaj pas 21 dhe 40 ditëve, pas përfundimit të ekzaminimit të tyre. Mbajtja e sekuestrimit në këtë hark kohor nuk duket e paarsyeshme në kontekst të rrethanave të rastit konkret, ndaj masa e zbatuar ka ruajtur një ekuilibër të drejtë mes interesit material të kërkueses dhe interesit publik për parandalimin dhe ndjekjen penale të veprës penale të pastrimit të produkteve të veprës penale apo veprimtarisë kriminale.

97. Po ashtu, Gjykata vlerësoi të pabazuar pretendimin e kërkueses edhe në lidhje me atë pajisje kompjuterike të sekuestruar që nuk i është kthyer ende asaj. Lidhur me këtë, fakti që ajo pajisje është mbajtur nën sekuestro dhe në vijim i është dërguar gjykatës si provë materiale në kuadër të procedimit penal të dërguar për gjykim është në përpjesëtim me qëllimin e ndërhyrjes. Kjo do të thotë se pajisja duket se i shërben organit hetimor, jo vetëm për gjetjen e të dhënave që provojnë kryerjen ose jo të veprës penale, por edhe për t'u paraqitur si provë dhe për t'u debatuar gjatë procesit gjyqësor, sikurse ka argumentuar subjekti i interesuar. Po ashtu, nuk rezulton që kërkueses, për shkak të kësaj mase, t'i jetë penguar veprimtaria ekonomike në atë masë sa t'ia ketë bërë të pamundur atë, nisur nga fakti që asaj i janë kthyer pajisjet e tjera të sekuestruara, por edhe kur ajo ka pasur edhe pajisje të tjera kompjuterike, të cilat nuk i janë sekuestruar[1].

98. Në përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkueses në drejtim të së drejtës së paprekshmërisë së banesës janë të bazuara, sipas arsyetimit të mësipërm të vendimit, ndaj kërkesa pranohet pjesërisht, duke u konstatuar cenimi i kësaj të drejte kushtetuese. Ky konstatim, në vlerësimin e Gjykatës, përmbush kërkesat e efektivitetit të mjeteve dhe bën të panevojshëm dërgimin e çështjes për rishqyrtim në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, si dhe neneve 72, 73, pika 4 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me shumicë votash,

[1] Gjyqtarët Holta Zaçaj, Sonila Bejtja dhe Genti Ibrahimi votuan për bazueshmërinë e pretendimit të kërkueses për këtë pjesë, duke mbajtur qëndrimin se kohëzgjatja e mbajtjes nën sekuestro të pajisjes kompjuterike të sekuestruar tejkalon kriterin e ashpërsisë, pasi përbën një barrë të tepruar për kërkuesen në kushtet që ajo arriti të provojë se sendi i sekuestruar është i nevojshëm për ushtrimin e veprimtarisë ekonomike prej saj, si dhe për sa kohë që subjekti i interesuar nuk arriti të provojë se nuk kishte asnjë mënyrë tjetër, përveç sekuestrimit të sendit si provë, që të mund të siguronte në të njëjtën mënyrë, marrjen dhe nxjerrjen e të dhënave të konsideruara si të nevojshme për qëllime të procedimit penal.

V E N D O S I:

1. Pranimin pjesërisht të kërkesës.

2. Konstatimin e cenimit të së drejtës së kërkueses për paprekshmërinë e banesës, sipas arsyetimit të këtij vendimi.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 01.07.2025
Shpallur më 25.09.2025

MENDIM PARALEL

1. Në gjykimin kushtetues të çështjes nr. 10 (S) 2024 të Regjistrit Themeltar që i përket kërkueses, "Studio Pustina", me objekt: "*Shfuqizimi i vendimeve datë 28.04.2023 të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar; nr. 206, datë 01.06.2023 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 128, datë 15.09.2023 të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 00-2024-741 (26), datë 08.02.2024 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë*", i bashkohemi shumicës për zgjidhjen e saj në lidhje me pretendimin për cenimin e së drejtës për paprekshmërinë e zyrës së kërkueses, që mbrohet nga neni 37 i Kushtetutës. Megjithatë, në lidhje me argumentet që kanë çuar në përfundimin se ky pretendim është i bazuar, ne kemi një qasje të ndryshme nga shumica në drejtim të vlerësimit të kritereve kushtetuese të ndërhyrjes në këtë të drejtë kushtetuese, për sa kohë jemi të qëndrimit se ndërhyrja në rastin konkret është bërë pa ligj, çka e bënte të panevojshme analizën e kritereve të tjera të ndërhyrjes në kuptim të nenit 17 të Kushtetutës.

2. Shumica ka vlerësuar se "*ndërhyrja në të drejtën e kërkueses në rastin konkret ka konsistuar në zbatimin praktikisht të një mase kërkimi në zyrën e saj, e shoqëruar me sekuestrim, e cila për nga mënyra e zbatimit dhe efektet e saj praktike në thelb përbën një kontroll banese për efekte të zbatimit të nenit 37 të Kushtetutës dhe nenit 8 të KEDNJ-së"* (*shih paragrafin 59 të vendimit*). Në vlerësimin tonë, një analizë e tillë, e fokusuar thelbësisht në mënyrën e zbatimit të vendimit të sekuestrimit, e zvogëlon mbrojtjen kushtetuese të banesës dhe ambienteve që njësohen me të, në drejtim të standardit të paprekshmërisë së saj dhe mbart rrezikun që të lihet në diskrecion të organeve publike (në këtë rast të prokurorisë) mënyra e vlerësimit dhe zbatimit rast pas rasti të këtij standardi kushtetues, ashtu edhe e vlerësimit të pasojave që sjell një ndërhyrje e tillë. Ne jemi të qëndrimit se kjo qasje është e tillë që lë shteg për ndërhyrje arbitrare dhe për legjitimimin e këtyre pasojave të paligjshme që një ndërhyrje e tillë sjell ndaj të drejtave kushtetuese të individit.

3. Referuar standardeve të elaboruara nga GJEDNJ-ja në drejtim të nenit 8 të KEDNJ-së, për të siguruar prova fizike për vepra të caktuara penale, autoritetet mund të konsiderojnë të nevojshme që të zbatojnë masa që përfshijnë hyrjen në një banesë private (*shih Dragan Petrović*

kundër Serbisë, datë 14.04.2020, § 74), por këto veprime duhet të jenë "të ligjshme" (*shih Bostan kundër Republikës së Moldavisë, datë 08.12.2020, §§ 21-30*) dhe në përpjesëtim me qëllimin e ndjekur (*shih McLeod kundër Mbretërisë së Bashkuar, datë 23.09.1998, §§ 53-57*). Në kontekstin e kontrolleve dhe sekuestrimeve ligji duhet t`i ofrojë individit mbrojtje kundër ndërhyrjes arbitrare në të drejtat e mbrojtura nga neni 8 i Konventës, ai duhet të jetë mjaftueshëm i qartë për t`u dhënë qytetarëve një tregues të përshtatshëm në lidhje me rrethanat dhe kushtet në të cilat autoritetet publike janë të autorizuara të përdorin masa të tilla. Për më tepër, kontrolli dhe sekuestrimi përfaqësojnë një ndërhyrje serioze në jetën private, banesën dhe korrespondencën dhe, në përputhje me rrethanat, duhet të bazohen në një "ligj" që është veçanërisht i saktë, ndaj është thelbësore që për këtë qëllim të ketë rregulla të qarta dhe të detajuara (*shih Petri Sallinen dhe të tjerë kundër Finlandës, datë 27.09.2005, §§ 82 - 90*). Një urdhër kontrolli duhet të shoqërohet me kufizime të caktuara, në mënyrë që ndërhyrja që ai autorizon të mos jetë potencialisht e pakufizuar dhe për këtë arsye joproporcionale. Formulimi i një urdhri të tillë duhet të specifikojë fushëveprimin e tij (në mënyrë që të sigurohet që kontrolli të përqendrohet vetëm në veprat penale nën hetim) dhe kriteret për zbatimin e tij (për të lehtësuar kontrollin e shtrirjes së veprimeve). Një urdhër i formuluar gjerësisht, që nuk përmban informacion për hetimin ose sendet që do të sekuestrohen, nuk plotëson ekuilibrin e drejtë midis të drejtave të palëve të përfshira, për shkak të kompetencave të gjera që u jep hetuesve (*shih Van Rossem kundër Belgjikës, datë 09.12.2004, §§ 44-50; Bagiyeva kundër Ukrainës, datë 28.04.2016, § 52*).

4. Referuar dispozitave përkatëse të KPP-së, kontrolli i vendeve (përfshirë edhe banesën) dhe sekuestrimi i sendeve/provave materiale janë dy mjete të ndryshme të kërkimit të provës që rregullohen nga dispozita të ndryshme të këtij kodi. Nenet 202-207 të KPP-së rregullojnë kushtet dhe mënyrën e kryerjes së kontrolleve, duke parashikuar se ato synojnë gjetjen e provave materiale të veprës penale ose të sendeve që i përkasin veprës penale. Si rregull, kontrollet lejohen të kryhen vetëm me vendim të gjykatës. Përjashtimisht, KPP-ja parashikon se kontrolli i vendeve mund të kryhet edhe nga OPGJ-të në rastet e mëposhtme: i) në rast flagrance ose në rast ndjekjeje të personit që është duke ikur[2]; ii) kur duhet të kryhet

[2] Duke zbatuar rregullat e caktuara në nenin 298, pika 1, të KPP-së kur kanë arsye të bazuara të mendojnë se mbi personin gjenden të fshehura sende ose gjurmë të veprës penale që mund të zhduken a të humbasin.

një ndalim, të ekzekutohet një vendim arresti ose një vendim dënimi me burgim[3].

5. Për sa i përket kontrollit, neni 202/a i KPP-së parashikon se vendimi duhet të tregojë llojin e kontrollit, vendin apo banesën objekt kontrolli, provat materiale apo sendet që kërkohen, përfshirë edhe të sistemeve informatike ose telematike, arsyet që lejojnë kontrollin, si edhe autoritetin që do të kryejë atë (pikat 1 dhe 2). Ndërkohë, neni 203 i KPP-së përcakton se kur kërkohet një send i caktuar, organi procedues mund të kërkojë dorëzimin e tij dhe në qoftë se sendi dorëzohet, kontrolli nuk bëhet, me përjashtim të rasteve kur pas dorëzimit të sendit ka arsye të bazuara për të besuar se nga kontrolli mund të zbulohen gjurmë apo sende të tjera që lidhen me veprën penale (pika 1). Më tej, neni 205 i KPP-së rregullon mënyrën e kontrollit të vendeve, ndërsa neni 207 i tij rregullon sekuestrimin gjatë kontrollit. Kjo dispozitë përcakton se sendet e gjetura gjatë kontrollit sekuestrohen, me kusht që të jenë të përcaktuara në vendimin për lejimin e kontrollit, ndërsa ato që nuk përfshihen në vendimin përkatës, por që lidhen me të njëjtën vepër penale, mund të sekuestrohen duke zbatuar kriteret e nenit 301 të kodit.

6. Në kuadër të procedimit penal nr. 287/2020, me vendimin e datës 28.04.2023, prokurorët e çështjes, mbështetur në nenet 208 e vijues të KPP-së, kanë urdhëruar sekuestrimin pranë zyrës së shtetases A.P. "*të të gjitha dokumenteve që kanë lidhje me shoqërinë "H." sh.p.k., si dhe të kompjuterit në të cilin mbahen të dhënat e kësaj të fundit, si dhe çdo gjë tjetër që vlerësohet me rëndësi për hetimin dhe që ofron të dhëna mbi faktin objekt hetimi*", duke ngarkuar për kryerjen e sekuestrimit tre OPGJ, hetues financiarë të BKH-së. Në datën 28.04.2023, ora 15:30, OPGJ-të janë paraqitur në zyrën ku kërkuesja ushtron veprimtarinë e saj për zbatimin e vendimit të sekuestrimit. Nuk ka asnjë kundërshtim nga palët në lidhje me faktin se vendimi i është komunikuar shtetases A.P. (ortake e vetme dhe administratore e kërkueses) dhe se ajo ka qenë e pranishme gjatë kryerjes së veprimeve nga OPGJ-të, duke nënshkruar në përfundim edhe procesverbalin e sekuestrimit të dokumenteve të mbajtur për këtë qëllim. Në këtë të fundit janë përshkruar "*sendet/dokumentet e gjetura (apo të dorëzuara) nga shtetasja A.P.*". Po sipas këtij procesverbali, ai është nënshkruar rregullisht dhe pa vërejtje nga OPGJ-të dhe shtetasja A.P. (administratore e kërkueses) dhe një kopje e tij i është dhënë kësaj të fundit.

[3] Duke zbatuar rregullat e caktuara në nenin 298, pika 2, të KPP-së.

7. Nga ana tjetër, nuk vihet në diskutim as ajo çka ka parashtruar subjekti i interesuar, Prokuroria e Posaçme, se në rastin konkret prokurorët e posaçëm kanë pasur bazë për të vlerësuar se kërkuesja duhet të kishte në dispozicion prova materiale apo sende që lidheshin me veprën penale dhe që ofronin të dhëna me rëndësi për hetimin dhe kanë nxjerrë vendimin e sekuestrimit duke u mbështetur në parashikimet e nenit 208, pika 1, të KPP-së.

8. Në analizë të përmbajtjes së vendimit të sekuestrimit vërehet se prokurorët kanë përcaktuar qartë: (i) llojet e provave apo sendeve për të cilat kërkohej sekuestrimi (dokumente dhe sende/kompjuter); (ii) kriterin identifikues të tyre (faktin që këto dokumente ose sende duhej të kishin lidhje dhe përmbanin të dhëna për shoqërinë "H." sh.p.k.). Po në analizë të përmbajtjes së vendimit të sekuestrimit vërehet se në vendim është përcaktuar si objekt sekuestrimi edhe "*çdo gjë tjetër që ka rëndësi për hetimin dhe ofron të dhëna mbi faktin objekt të tij"*. Nga ana tjetër, në analizë edhe të dinamikës së veprimeve të OPGJ-ve në zbatim të vendimit të sekuestrimit (referuar procesverbalit përkatës), rezulton të jenë sekuestruar "*sendet/dokumentet e gjetura (apo të dorëzuara) nga shtetasja A.P.*" dhe konkretisht: katër pajisje kompjuterike (dy laptopë dhe dy njësi qendrore); 407 dokumente shkresore (fatura tatimore, kontrata, aktmarrëveshje etj.) që lidheshin me shoqërinë "H." sh.p.k.; katër dokumente shkresore të tjera (pasqyra financiare) që u përkisnin subjekteve juridike të ndryshme nga kjo shoqëri.

9. Për sa më sipër, jemi të mendimit se, duke mbajtur në konsideratë veçoritë e këtyre dy mjeteve të kërkimit të provës (sekuestrimit dhe kontrollit), llojin e të drejtave kushtetuese mbi të cilat ato ndërhyjnë[4], si dhe shkallën e ndërhyrjes që ato passjellin mbi të drejtat kushtetuese të individëve të cilëve u drejtohen, sekuestrimi, si mjet i kërkimit të provës, duhet të bazohet në një vendim i cili përcakton në mënyrë të qartë dhe nominalisht çdo send që kërkohet të sekuestrohet. Në të kundërt, hartimi i një vendimi në mënyrë të përgjithshme çon, nga njëra anë, në pamundësinë e zbatimit të tij dhe, nga ana tjetër, krijon mundësitë për arbitraritet në zbatimin e tij nga ana e OPGJ-ve, duke lënë në diskrecionin e tyre identifikimin dhe përcaktimin e atyre provave materiale dhe sendeve që lidhen me veprën penale. Ne jemi të qëndrimit se pikërisht kjo e fundit ka ndodhur edhe në

[4] Ndërsa kontrollet tipikisht shkaktojnë ndërhyrje në të drejtën për paprekshmëri të banesës, sekuestrimet tipikisht shkaktojnë ndërhyrje në lirinë dhe fshehtësinë e korrespondencës dhe të drejtën për jetë private.

rastin konkret, ku OPGJ-të janë paraqitur në ambientet e kërkueses, i kanë vënë në dispozicion përfaqësueses së saj A.P. vendimin e sekuestrimit dhe më tej kanë hyrë në zyrën e kërkueses dhe kanë sekuestruar disa kompjuterë (katër të tillë) dhe një numër të konsiderueshëm dokumentesh, të cilat dukshëm nuk kanë lidhje me shoqërinë "H." sh.p.k. dhe për to as nuk tregohet se ofrojnë ndonjë të dhënë me rëndësi për hetimin.

10. Ne arrijmë në përfundimin e mësipërm referuar, së pari, mënyrës sesi është hartuar vendimi i sekuestrimit, i cili, dukshëm është nisur nga prezumimi i pasjes në dispozicion të kërkueses të dokumenteve, sendeve të tjera, që mund të ishin me rëndësi për hetimin dhe që mund të ofronin të dhëna për faktin objekt të tij, por pa qenë ato të përcaktuara apo të përcaktueshme në atë moment, duke nënkuptuar dhe pranuar mundësinë e hyrjes në zyrën e kërkueses dhe të kontrollit të saj, si e vetmja mënyrë që i lejonte OPGJ-të të përmbushnin detyrat e lëna nga prokurorët e posaçëm për gjetjen dhe sekuestrimin e këtyre sendeve/dokumenteve, pra për të ekzekutuar vendimin. Edhe në analizë të fakteve të ndodhura në datën 28.04.2023, siç janë përshkruar në vendimin e Gjykatës, kur OPGJ-të janë paraqitur në zyrën e kërkueses, është arritur në mënyrë të paekuivoke në përfundimin se në rastin konkret ka pasur de facto një kontroll dhe jo një ekzekutim të një vendimi sekuestrimi, i cili realizohet vetëm përmes dorëzimit vullnetar të sendeve/dokumenteve të identifikuara në mënyrë të qartë dhe të saktë në vendimin që kërkohet të ekzekutohet nga personi të cilit i komunikohet ai. Për më tepër kur, siç është arsyetuar edhe në vendimin e Gjykatës, fakti se përfaqësuesja A.P. e kërkueses i ka lejuar OPGJ-të të futen në zyrë apo se ajo ka bashkëpunuar me ta, duke iu ofruar edhe një post pune dhe kompjuter për përpilimin e procesverbalit të sekuestrimit, nuk mund të interpretohet si dhënie pëlqimi edhe për lejimin e tyre për të kërkuar, për sa kohë që heqja dorë nga një e drejtë themelore duhet të përcaktohet në mënyrë të qartë, duke u bërë me njohuri të plotë të fakteve, pra në bazë të pëlqimit të informuar, të qartë dhe të dhënë pa asnjë detyrim/shtrëngim (*shih paragrafët 60 dhe 62 të vendimit*).

11. Edhe pse nuk vihet në diskutim qëllimi që kanë në kuadër të procedimit penal të tilla masa, ato nuk mund të justifikojnë çdo ndërhyrje apo t`u japin autoriteteve kompetente një liri të pakufizuar në ushtrimin e kompetencave të tyre. Në këto kushte, mënyra sesi është hartuar në rastin konkret vendimi i sekuestrimit, duke konsideruar edhe faktin se administratorja e kërkueses (shtetasja A.P.) nuk ka hequr dorë nga e drejta kushtetuese për paprekshmërinë e zyrës, si ambient i njësuar me banesën,

pra nuk ka pranuar në mënyrë të shprehur ushtrimin e një kontrolli pa një vendim gjykate, kjo edhe në mungesë të njoftimit të saj mbi të gjitha të drejtat që i garantohen nga legjislacioni procedural penal dhe pasojat e heqjes dorë prej tyre, vendimi i sekuestrimit ka përbërë në thelb një vendim kontrolli, që, për efekte të zbatimit të nenit 37 të Kushtetutës dhe nenit 8 të KEDNJ-së, mund dhe duhej të ishte miratuar vetëm nga gjykata dhe jo nga prokurori, si në rastin konkret.

12. Nga ana tjetër, ne nuk ndajmë të njëjtin qëndrim me shumicën edhe në drejtim të përfundimit të saj se për sa i përket ekzistencës së rrezikut të afërt për humbjen ose zhdukjen e sendeve dhe dokumenteve që përmbanin të dhëna me rëndësi për hetimin, që do të legjitimonte kontrollin pa vendim gjykate, ajo nuk shprehet për sa kohë gjykatat e zakonshme nuk e kanë vënë në diskutim interpretimin dhe zbatimin e ligjit procedural për këtë aspekt (*shih paragrafin 75 të vendimit*). Në vlerësimin tonë shumica duket se ka dashur të shmangë vlerësimin e aspektit të kufizimit me ligj, duke e trajtuar atë nën aspektin e proporcionalitetit të ndërhyrjes, për sa kohë që është nisur të bëjë një vlerësim *in abstracto* të parashikimeve ligjore, duke nxjerr në pah kështu, formalisht, një bazë ligjore që lejon ndërhyrje në banesë edhe pa vendim gjyqësor, ndërkohë që jo vetëm asnjë nga palët në gjykimin kushtetues nuk i ka bazuar qëndrimet mbi një hipotezë të tillë, por as ajo vetë (shumica) në përfundim nuk e ka bazuar qëndrimin e saj në një analizë të tillë të ndërhyrjes. Nga ana tjetër, edhe pse Gjykata në vlerësimin e ankimeve kushtetuese individuale niset edhe nga vendimet e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, një mungesë arsyetimi nga këto të fundit nuk e shmang vetë Gjykatën nga përgjegjësia dhe kompetenca për të verifikuar nëse veprimet e autoriteteve publike janë kryer në përputhje me ligjin dhe nëse ato kanë sjellë kufizim antikushtetues të të drejtave themelore të individit.

13. Thelbi i kësaj çështjeje, për rrjedhojë edhe argumentet e palëve, ka qenë nëse është kryer *de facto* kontroll ose jo në ambientet e kërkueses dhe jo nëse kontrolli i pranuar i kryer ka pasur si justifikim urgjencën për të vepruar të autoriteteve publike. Edhe vetë subjekti i interesuar, Prokuroria e Posaçme, pavarësisht se i kaloi barra e provës në këtë gjykim, për sa kohë nuk ka pretenduar se OPGJ-të ishin ndodhur në kushtet e kontrollit me iniciativë, për shkak të urgjencës së rastit, përkundrazi e ka kundërshtuar këtë pretendim të kërkueses, ai nuk ka sjellë prova se veprimet e OPGJ-ve janë bazuar në dispozitat procedurale që lejojnë përjashtimisht kontrollin pa vendim gjykate. Si gjatë procesit gjyqësor, ashtu edhe në atë kushtetues, ky

subjekt ka pretenduar se nuk ka pasur kontroll, por vetëm ekzekutim të një vendimi sekuestrimi, miratimi i të cilit është në kompetencë të prokurorit, procedurë në të cilën, sipas këtij subjekti, përfaqësuesja e kërkueses ka qenë e pranishme dhe ka pranuar veprimet, duke bashkëpunuar me organin procedues. Në këto kushte, në vlerësimin tonë, ishte e panevojshme që Gjykata të ndalej në një vlerësim të tillë.

14. Për sa më sipër, ne jemi të qëndrimit se çdo veprim i kryer pas hartimit dhe miratimit të vendimit të sekuestrimit të prokurorëve të posaçëm përbën ndërhyrje në zyrën e kërkueses pa vendim gjyqësor, pra pa ligj në kuptim të përmbajtjes së neneve 17 dhe 37 të Kushtetutës, çka bie ndesh me garancitë e ofruara nga këto norma kushtetuese.

15. Në këto kushte ne jemi të qëndrimit se mosrespektimi i këtij kriteri e bënte të panevojshëm verifikimin e kritereve të tjera të ndërhyrjes në kuptim të nenit 17 të Kushtetutës dhe kërkesa duhej të ishte pranuar vetëm për këtë shkak.

Kryetare: Holta Zaçaj
Anëtarë: Sonila Bejtja, Genti Ibrahimi

Vendim nr. 43, datë 24.07.2025
(V-43/25)

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Holta Zaçaj, Kryetare, Marsida Xhaferllari, Fiona Papajorgji, Sonila Bejtja, Ilir Toska, Genti Ibrahimi, Marjana Semini, Sandër Beci, anëtarë, me sekretare Blerina Basha, në datat 12.06.2025 dhe 26.06.2025 mori në shqyrtim në seancë plenare çështjen nr. 16 (S) 2024 të Regjistrit Themeltar që u përket:

KËRKUESE: **SINDIKATA E BASHKUAR E ARSIMIT SHQIPTAR,** përfaqësuar nga presidente Alma Lama dhe avokate Margarita Kola, me prokurë të posaçme.

SUBJEKT I INTERESUAR:
KËSHILLI I MINISTRAVE, përfaqësuar nga Herald Jonuzaj, Vangjel Duni, Irma Qosja, avokate shteti, Enkela Dudushi dhe Voltisa Koçi, me autorizim.

OBJEKTI: **Shfuqizimi pjesërisht i vendimit nr. 425, datë 26.06.2024 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve mësimorë dhe të punonjësve të tjerë jomësimorë në institucionet arsimore dhe në institucionet plotësuese të sistemit arsimor parauniversitar", pikërisht pika 2.ii, vlera e shtesës së nivelit të kualifikimit për grupin vetëm nivelet 6 dhe 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve *(KSHK),* master profesional, dhe niveli 6 dhe të lidhjes nr. 4, si pjesë përbërëse e vendimit për pjesën e vlerës së shtesës së nivelit të kualifikimit për grupin e diplomës 2, KSHK 7 dhe grupi i diplomës 3, KSHK 6, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

BAZA LIGJORE: Nenet 17, 18, 49, 50, 131, pika 1, shkronja "c" dhe 134, pika 1, shkronja "h", si dhe 135 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë *(Kushtetuta);* ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sandër Beci, mori në shqyrtim pretendimet e kërkueses Sindikatës së Bashkuar të Arsimit Shqiptar *(kërkuesja)*, e cila ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet e subjektit të interesuara, Këshillit të Ministrave, që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I
Rrethanat e çështjes

1. Kuvendi në datën 21.06.2012 ka miratuar ligjin nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë" *(ligji nr. 69/2012),* i cili ka hyrë në fuqi në datën 09.08.2012. Objekti dhe qëllimi i këtij ligji janë përcaktimi i parimeve bazë për strukturën, veprimtarinë dhe qeverisjen e sistemit arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë, si dhe garantimi i së drejtës kushtetuese për arsim, sipas kuadrit ligjor përkatës për funksionimin e sistemit arsimor parauniversitar. Ligji ka pësuar disa ndryshime me ligjet nr. 56/2015, datë 28.05.2015, nr. 48/2018, datë 23.07.2018 *(ligji nr. 48/2018)* dhe nr. 44/2023, datë 15.06.2023.

2. Në zbatim të ligjit nr. 69/2012 u miratua vendimi nr. 175, datë 08.03.2017 i Këshillit të Ministrave "Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve mësimorë në arsimin parauniversitar" *(VKM-ja nr. 175/2017).* Në pikën 3 të tij përcaktohej struktura e pagës mujore, që përbëhej nga paga e grupit (niveli arsimor, që varionte nga 10 000 lekë deri në 14 000 lekë), shtesa për vjetërsi pune, shtesa e kualifikimit dhe shtesa e pozicionit.

3. VKM-ja nr. 175/2017 u ndryshua me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 351, datë 19.04.2017 "Për disa shtesa dhe ndryshime në

vendimin nr. 175, datë 08.03.2017 "Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve mësimorë në arsimin parauniversitar"" *(VKM-ja nr. 351/2017).* Sipas këtij vendimi, punonjësit aktualë mësimorë/edukatorë, të cilët zotërojnë diplomë të ciklit të parë të studimeve universitare "Bachelor" ose të barasvlershme me të, sipas legjislacionit të arsimit të lartë dhe deri përpara datës 1 mars 2017 kanë përfituar pagën e grupit në masën 14 000 (katërmbëdhjetë mijë) lekë, do të vazhdojnë të përfitojnë të njëjtën masë të pagës së grupit deri në momentin e ndryshimit të nivelit të diplomës, ose ndërprerjes së marrëdhënieve të punës me institucionin arsimor përkatës. Punonjësit mësimorë/edukatorë që fillojnë punë për herë të parë si punonjës mësimorë/edukatorë në arsimin parauniversitar pas datës 1 mars 2017, do të trajtohen me pagë grupi sipas përcaktimeve të lidhjes nr. 2 të vendimit, ku përcaktohen pagat për nivelin arsimor (diploma master-vlera 14 000 lekë; diploma bachelor-vlera 11 000 lekë dhe diploma e shkollës së mesme pedagogjike -vlera 10 000 lekë).

4. Me ligjin nr. 48/2018, mes të tjerave, u ndryshua edhe neni 57 i ligjit nr. 69/2012, duke parashikuar se mësuesi për arsimin parashkollor duhet të ketë fituar diplomën e ciklit të parë "Bachelor", që formon mësues të arsimit parashkollor. Mësuesi për arsimin fillor duhet të ketë fituar diplomën e ciklit të parë "Bachelor" dhe diplomën e ciklit të dytë "Master profesional", që formojnë mësues të arsimit fillor, ose diplomë për arsimin fillor të ish-instituteve të larta pedagogjike. Mësuesi për arsimin e mesëm të ulët (nga klasa e VI-IX) dhe për arsimin e mesëm të lartë (gjimnazi, arsimi i mesëm profesional dhe arsimi mesëm orientues) duhet të ketë fituar diplomën e ciklit të parë "Bachelor" në fushën/lëndët e arsimit të mesëm të ulët dhe të arsimit të mesëm të lartë dhe diplomën e ciklit të dytë "Master" me 120 ECTS në fushën e mësuesisë, që lidhet me programin e studimit të ciklit të parë.

5. Po me ligjin nr. 48/2018, në nenin 72 të ligjit nr. 69/2012 u shtua pika 6 me këtë parashikim: "Personelit mësimdhënës, që ka përfunduar studimet universitare në ish-institutet e larta pedagogjike, diploma e përfituar i njihet si arsim i lartë, tetë semestra, për efekt page.". Në referim të nenit 124 të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" *(ligji nr. 80/2015),* diplomat e programeve të studimit, të lëshuara në Republikën e Shqipërisë, që kanë zgjatur, së paku, 4 vite akademike (8 semestra), deri në përshtatjen e studimeve, sipas parimeve të procesit të Bolonjës, janë ekuivalente me diplomat "Master i shkencave".

6. Këshilli i Ministrave, në zbatim të ligjit nr. 69/2012 dhe të ligjit nr. 35/2023 "Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi", në datën 26.06.2024 ka miratuar vendimin nr. 425, datë 26.06.2024 "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve mësimorë dhe të punonjësve të tjerë jomësimorë në institucionet arsimore dhe në institucionet plotësuese të sistemit arsimor parauniversitar" *(VKM-ja nr. 425/2024)*. Ky vendim ka hyrë në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare nr. 112, datë 03.07.2024, duke shfuqizuar VKM-në nr. 175/2017 dhe i ka shtrirë efektet financiare nga data 01.07.2024.

7. Fusha e veprimit të VKM-së nr. 425/2024 shtrihet ndaj punonjësve mësimorë (mësues/edukatorë, instruktorë), punonjësve të shërbimit psikosocial, si dhe punonjësve të tjerë jomësimorë, që shërbejnë në institucionet arsimore të sistemit arsimor parauniversitar (arsimin parashkollor, arsimin fillor, arsimin e mesëm të ulët, arsimin e mesëm të lartë, institucionet arsimore për përkujdesjen për kategori të veçanta të nxënësve, qendrat kulturore të fëmijëve dhe konviktet e nxënësve).

8. Në pikën 2 të VKM-së nr. 425/2024 parashikohen pesë elementet përbërëse të pagës bruto mujore të punonjësve të sipërcituar, që përbëhet nga: i. paga për pozicion, që shpërblen vlerën relative të çdo pozicioni pune; ii. shtesa e nivelit të kualifikimit, që shpërblen nivelin arsimor të kërkuar për pozicionin përkatës të punës. Kjo vlerë përcaktohet në lidhjen nr. 4 bashkëlidhur vendimit dhe është pjesë përbërëse e tij; iii. shtesa për vjetërsi pune; iv. shtesa për kategoritë e kualifikimit, që shpërblen zhvillimin profesional të punonjësve mësimorë përgjatë karrierës së tyre, pas përfitimit të kategorisë së kualifikimit do të llogaritet në përqindje për çdo kategori, duke filluar nga 10% (mësues i kualifikuar), 20% (mësues special) dhe 30% (mësues mjeshtër); v. shtesa për natyrë të veçantë pune, e aplikueshme për disa pozicione në shkollat e arsimit të mesëm të lartë profesional.

9. Kërkuesja, me kërkesën e datës 01.11.2024, e cila është regjistruar në datën 12.11.2024, pas plotësimit të dokumenteve sipas nenit 27 të ligjit nr. 8577/2000, i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese *(Gjykata)* për shfuqizimin si të papajtueshme me Kushtetutën të pikës 2.ii të VKM-së, që parashikon se një ndër elementet përbërëse të pagës bruto mujore të punonjësve mësimorë, që shërbejnë në institucionet e arsimit të sistemit arsimor parauniversitar, është edhe shtesa e nivelit të kualifikimit, që shpërblen nivelin arsimor të kërkuar për pozicionin përkatës të punës, si

dhe të lidhjes nr. 4, si pjesë përbërëse të VKM-së, ku janë të përcaktuara vlerat e shtesës së nivelit të kualifikimit për çdo grup diplome. Kolegji i Gjykatës në datën 24.01.2025 ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve. Në seancën plenare mbi bazë të dokumenteve të datës 12.06.2025, për nevoja të përcaktimit të fakteve, Gjykata ka vendosur ndryshimin e formës së shqyrtimit të çështjes nga seancë plenare mbi bazë të dokumenteve në seancë plenare publike në datën 26.06.2025.

II
Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

10. ***Kërkuesja,*** në mënyrë të përmbledhur, ka parashtruar:

10.1. *Për juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese*

10.1.1. Gjykata ka juridiksion për shqyrtimin e VKM-së nr. 425/2024, pasi është një akt me karakter normativ, vendos norma të përgjithshme, që shtrijnë efektet e tyre mbi një kategori të pacaktuar subjektesh, që janë mësues dhe punonjës të arsimit të të gjitha niveleve të arsimit parauniversitar dhe ka karakter detyrues.

10.2. *Për themelin, VKM-ja nr. 425/2024 cenon*:

10.2.1. *Parimin e sigurisë juridike,* pasi punonjësit e arsimit që kishin përfituar pagën e grupit në masën 14 000 lekë duhet të vazhdonin të trajtoheshin nga VKM-ja nr. 425/2024 po me këtë masë page. Por ndryshimet që solli VKM-ja nr. 425/2024 bënë që kjo vlerë të mos përfitohej më, duke cenuar një të drejtë të fituar. Çdo ndryshim duhet të jetë në përputhje me ligjin dhe të jetë në interes të të dyja palëve. Punonjësit kanë të drejtë të mbrohen nga ndryshimet që mund të ndikojnë negativisht në kushtet e tyre të punës, në pagë ose në të drejtat e tjera të fituara. Nëse një punonjës dëshiron të bëjë ndryshime në kontratën e punës, është e rëndësishme që këto ndryshime të diskutohen dhe të miratohen nga ai. Në rast mosmarrëveshjeje, punonjësit kanë të drejtë të ndjekin rrugën ligjore për të mbrojtur të drejtat e tyre. Me nenin 20 të ligjit nr. 48/2018, në nenin 72 të ligjit nr. 69/2012 u shtua pika 6, sipas së cilës personeli mësimdhënës, që ka përfunduar studimet universitare në ish-institutet e larta pedagogjike,

diploma e përfituar i njihet si arsim i lartë, tetë semestra, për efekt page. Pra, personeli që ka diplomë "Bachelor", sipas asaj periudhe (pasi nuk kishte diploma "Master"), paguhej në vlerën 14 000 lekë, që i korrespondon diplomës "Master". Ndërsa me VKM-në nr. 425/2024 këta punonjës nuk vazhdojnë të paguhen me këtë shumë, pasi për nivelin e kualifikimit "Bachelor" parashikohet vlera në shumën 10 000 lekë. Për më tepër, gjatë zbatimit praktik të vendimit objekt kundërshtimi ka pasur paqartësi, pasi disa zyra vendore arsimore zbatojnë vlera të ndryshme pagese për të njëjtën kategori të kornizës së kualifikimit. Gjithashtu, një ndër kërkesat e parimit të sigurisë juridike është bërja sa më publike e akteve normative. Kjo do të thotë jo vetëm botimi në Fletoren Zyrtare, por edhe transparenca, diskutimi publik dhe pjesëmarrja e gjerë e ekspertëve të fushës, grupeve të interesit ose individëve të veçantë edhe në procesin e miratimit të tyre nga mekanizmat përkatës. Shuma e pagës e përfituar gjatë detyrës së mësuesit do të ndikojë edhe në masën e pensionit në të ardhmen.

10.3. *Parimin e hierarkisë së normave juridike, të garantuar në nenin 116 të Kushtetutës,* pasi VKM-ja nr. 425/2024 është në kundërshtim me ligjin nr. 48/2018, konkretisht me pikën 6 të nenit 72 të tij, pra ky vendim nuk është i bazuar në ligj.

10.4. *Parimin e barazisë përpara ligjit dhe të mosdiskriminimit,* pasi përpara miratimit të VKM-së nr. 425/2024 punonjësit mësimorë trajtoheshin në mënyrë të barabartë sipas ligjit nr. 69/2012. Pas miratimit të vendimit dhe sipas përcaktimeve të lidhjes nr. 4 të tij, kategoria e punonjësve të arsimit me diplomën "Bachelor" (niveli 6 i KSHK) do të marrë vlerën 10 000 lekë, ajo me diplomë "Master profesional" ose të barasvlershme (niveli 7 i KSHK-së) do të marrë vlerë 12 000 lekë dhe "Master shkencor" do të marrë vlerën 14 000 lekë, në një kohë kur të dyja kategoritë trajtoheshin me vlerën e shtuar 14 000 lekë.

11. ***Subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave***, ka prapësuar si vijon:

11.1. *Për juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese*

11.1.1. Gjykata nuk ka juridiksion për shqyrtimin e VKM-së nr. 425/2024, pasi ajo kontrollon kushtetutshmërinë e akteve e jo ligjshmërinë e tyre dhe pretendimet e kërkueses janë me

natyrë ligjore. VKM-ja, si akt nënligjor, nuk i është nënshtruar gjykimit në Gjykatën Administrative të Apelit dhe kjo e fundit të ketë rezultuar një mjet ankimi joefektiv. Gjithashtu, VKM-ja nr. 175/2017, e ndryshuar me VKM-në nr. 351/2017, është shfuqizuar nga vendimi objekt kundërshtimi. Norma e re ka një përmbajtje thellësisht të ndryshme nga norma e tjetër dhe pretendimet e kërkueses kanë të bëjnë me një normë që nuk është në fuqi, pra nuk prodhon efekte juridike.

11.2. *Për themelin për VKM-në nr. 425/2024:*

11.2.1. *Pretendimi për cenimin e parimit të sigurisë juridike nuk gjen mbështetje në parashikimet kushtetuese dhe në jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ)*, pasi paga mujore për mësuesit e arsimit fillor dhe të mesëm të ulët në shkollat 9-vjeçare ka pësuar rritje, duke sjellë efekte financiare pozitive për çdo mësues. Në interpretimin literal të dispozitave të ligjit nr. 69/2012, si dhe ligjit nr. 80/2015, diploma e nivelit "Bachelor" që i korrespondon nivelit 6 të kornizës shqiptare të kualifikimeve nuk është e barasvlershme me diplomat që i përkasin nivelit 7 të kornizës shqiptare të kualifikimeve "Master". Këshilli i Ministrave, nëpërmjet këtij akti, ka konkretizuar elementet përbërëse të pagës mujore bruto të punonjësve të institucioneve të sistemit arsimor parauniversitar. Ndryshimet në shtesat mbi pagë nuk janë të drejta të patjetërsueshme, por përfitime të përcaktuara në akte administrative, që mund të rishikohen sipas politikave sociale të qeverisë. Trajtimi i mëparshëm duke iu dhënë disa grupeve më të ulëta diplomën shtesë kualifikimi të njëjtë me atë të grupeve më të larta të diplomës, përbënte "diskriminim pozitiv", por nuk mund të konsiderohet e drejtë e fituar e pandryshueshme, pasi nuk mbështetet në arsye ose rrethana objektive. Për këtë qëllim, VKM-ja nr. 425/2024 e ka rikthyer situatën duke trajtuar financiarisht grupet e diplomave sipas niveleve të tyre, për rrjedhojë nuk cenon parimin e sigurisë juridike. Gjithashtu, VKM-ja nr. 425/2024 përjashtohet nga detyrimi i nënshtrimit të procesit të konsultimit publik, pasi bën pjesë në ato akte që nuk i nënshtrohen atij procesi bazuar në ligjin nr. 146/2014 "Për njoftimin dhe konsultimin publik".

11.2.2. *Për pretendimin për cenimin e parimit të hierarkisë së normave*

juridike kërkuesja nuk ka parashtruar argumente në nivel kushtetues. VKM-ja ka dalë në zbatim të ligjeve nr. 69/2012 dhe nr. 35/2023 dhe nuk trajton çështje në kundërshtim me rezervën ligjore. Ligji nr. 35/2023 ka parashikuar në mënyrë të përgjithshme kuadrin rregullator për caktimin e pagave, trajtimet e tjera financiare dhe përfitimet e të punësuarve në institucionet e administratës publike dhe ka autorizuar Këshillin e Ministrave për miratimin e elementeve përbërëse të pagës bruto mujore dhe të vlerës për çdo element të saj.

11.2.3. *Pretendimi për cenimin e parimit të barazisë përpara ligjit dhe të mosdiskriminimit* është i pabazuar. Në çdo rast, edhe nëse ka ndërhyrje, ajo ka ndjekur një qëllim legjitim dhe proporcional me gjendjen e diktuar. Niveli i kualifikimit arsimor, i diferencuar sipas ligjit nr. 10247, datë 04.03.2010 "Për kornizën shqiptare të kualifikimeve" *(ligji nr. 10247/2010)* do të sillte edhe diferencim në trajtimin financiar të punonjësve arsimorë, me qëllim garantimin e një shpërblimi të drejtë dhe dinjitoz për çdo punonjës mësimor dhe punonjësve të tjerë jomësimorë në institucionet arsimore, si dhe në institucionet plotësuese të sistemit arsimor parauniversitar, në përputhje me nivelin e kualifikimit të tyre. Elementet për realizimin e reformës së pagave të nëpunësve/punonjësve të administratës publike dhe rritjen e niveleve të tyre janë "shtesa për vjetërsi në punë" dhe "shtesa për nivelin e kualifikimit", që i referohen kornizës shqiptare të kualifikimit. Pra, janë harmonizuar dhe janë marrë në konsideratë të gjitha vlerat që mbartin nëpunësit e administratës publike, ku bëjnë pjesë edhe punonjësit mësimorë.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkueses

12. Çështja e legjitimimit *(locus standi)* është vlerësuar si një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Në gjykime të kontrollit të kushtetutshmërisë së normës, subjektet, që parashikohen në nenin 134, pika 2, të Kushtetutës, kanë detyrimin për të provuar interesin ndërmjet veprimtarisë ligjore që ato kryejnë dhe çështjes kushtetuese të

ngritur (*shih vendimet nr. 4, datë 15.02.2021; nr. 1, datë 16.01.2017; nr.14, datë 21.03.2014 të Gjykatës Kushtetuese).*

13. Për legjitimimin e organizatave, si subjekte që vënë në lëvizje Gjykatën, sipas nenit 134, pika 1, shkronja "h", të Kushtetutës, Gjykata ka tashmë një jurisprudencë të konsoliduar, sipas së cilës vlerësimi nëse një organizatë ka ose jo mjaftueshëm interes, bëhet rast pas rasti, në varësi të rrethanave të çdo çështjeje të veçantë. Organizata që vë në lëvizje Gjykatën duhet të provojë se në çfarë mënyre ajo mund të preket në një aspekt të veprimtarisë së saj, pra duhet të provojë lidhjen e drejtpërdrejtë dhe të individualizuar që ekziston midis veprimtarisë së saj dhe normës që kundërshton *(shih vendimet nr. 20, datë 20.04.2021; nr. 1, datë 16.01.2017; nr. 33, datë 08.06.2016 të Gjykatës Kushtetuese).* Gjithashtu, Gjykata ka vlerësuar se nuk është e nevojshme të provohet që subjektet me legjitimitet të kushtëzuar përfaqësojnë të gjithë profesionistët e asaj fushe, pasi, në kuptim të nenit 134 të Kushtetutës, një kërkesë e tillë nuk përbën kusht për legjitimimin e tyre *(shih vendimet nr. 11, datë 06.03.2014; nr. 11, datë 06.04.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Në rastin konkret, në lidhje me aspektin formal të legjitimimit të kërkueses në gjykimin kushtetues, vërehet se ajo është regjistruar si person juridik me vendimin nr. 3, datë 15.02.2024 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe bazuar në statutin e sindikatës, ajo është bashkim vullnetar sindikal, që përfaqëson punëmarrësit në arsimin parashkollor, parauniversitar, të lartë, profesional dhe punëmarrësit e tjerë në këto sektorë të punësuar në Republikën e Shqipërisë. Kërkesa e paraqitur në datën 01.11.2024 është nënshkruar nga Alma Lama, presidente e sindikatës, e cila, sipas nenit 21 të statutit, mes të tjerave, ka në kompetencën e saj përfaqësimin e interesave të punëmarrësve përpara institucioneve shtetërore. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se kërkuesja legjitimohet *ratione personae* për të paraqitur kërkesë, pasi ka justifikuar interesin e saj. Gjithashtu, për legjitimimin *ratione temporis,* VKM-ja nr. 425/2024 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 112, datë 03.07.2024, ka hyrë në fuqi pas botimit në këtë fletore dhe i ka shtrirë efektet financiare nga data 01.07.2024. Kërkesa është paraqitur në Gjykatë në datën 01.11.2024, pra brenda afatit ligjor 2-vjeçar të parashikuar në nenin 50, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000, ndaj kërkuesja legjitimohet edhe *ratione temporis* për vënien në lëvizje të këtij gjykimi kushtetues.

15. Në lidhje me legjitimimin *ratione materiae*, Gjykata konstaton se kërkuesja ka parashtruar pretendime për cenimin e parimeve të: i) hierarkisë

së normave juridike; ii) sigurisë juridike në drejtim të të drejtave të fituara; iii) barazisë përpara ligjit dhe të mosdiskriminimit.

16. Për pretendimin për cenimin e parimit të hierarkisë së normave juridike, Gjykata vëren se kërkuesja ka parashtruar se VKM-ja nr. 425/2024 është në kundërshtim me ligjin nr. 48/2018, konkretisht me pikën 6 të nenit 72 të tij, pra ky vendim nuk është i bazuar në ligj, duke mos respektuar parimin e hierarkisë së normave juridike. Ndërsa subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave, ka prapësuar se kërkuesja nuk ka parashtruar argumente në nivel kushtetues. VKM-ja ka dalë në zbatim të ligjeve nr. 69/2012 dhe nr. 35/2023 dhe nuk trajton çështje në kundërshtim me rezervën ligjore.

17. Gjykata ka theksuar se respektimi i hierarkisë së akteve normative është një detyrim që rrjedh nga parimi i shtetit të së drejtës dhe i koherencës në sistemin *ligjor (shih vendimin nr. 20, datë 20.04.2021 të Gjykatës Kushtetuese).* Piramida e akteve normative, e sanksionuar në nenin 116 të Kushtetutës, përcakton marrëdhëniet midis normave juridike, të cilat bazohen në raportin e mbi/nënvendosjes së tyre. Rendi juridik nuk është një radhitje e barasvlershme normash, por një sistem hierarkik, i cili përbëhet nga nivele të ndryshme vlefshmërie dhe në secilin prej këtyre niveleve qëndron një normë ose grup normash, duke përftuar kështu edhe fuqinë e caktuar juridike. Kjo piramidë aktesh normative ka në majë të saj Kushtetutën, e cila shërben si burim për aktet e tjera juridike (*shih vendimet nr.5, datë 05.02.2014; nr.3, datë 20.02.2006 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Në vijim të sa më lart, Gjykata vlerësoi se pretendimi për cenimin e parimit të hierarkisë së normave juridike përbën lëndë kushtetuese në kuptim të kompetencës së Gjykatës për t'i vlerësuar ato, megjithatë është natyra e argumenteve të ngritura nga kërkuesja që përcakton nëse është Gjykata në rastin konkret kompetente për vlerësimin e kushtetutshmërisë së sjelljeve/veprimeve që, sipas kërkueses, përbëjnë cenim të këtij parimi. Në këtë drejtim nuk u arrit numri i nevojshëm i votave për vendimmarrje sipas nenit 73, pika 4, të ligjit nr. 8577/2000 lidhur me natyrën e argumenteve të parashtruara nga kërkuesja dhe pretendimi u konsiderua i rrëzuar.

19. Sipas njërit qëndrim, u vlerësua se pretendimi i kërkueses në këtë drejtim është me natyrë ligjore, pasi ka të bëjë me përplasjen mes aktit nënligjor dhe ligjit, për rrjedhojë nuk ka natyrë kushtetuese[1]. Kështu, për shembull, pretendimet që lidhen me cenimin e rezervës kushtetuese (kur

[1] Gjyqtarët Holta Zaçaj, Ilir Toska, Genti Ibrahimi dhe Marjana Semini vlerësuan sipas këtij qëndrimi.

Kuvendi miraton një ligj që praktikisht ndryshon një dispozitë kushtetuese ose konventore) ose ligjore (kur aktet nënligjore dalin jashtë kufijve të rregullimeve dhe autorizimeve ligjore), tipikisht aktivizojnë juridiksionin e Gjykatës për të vlerësuar kushtetutshmërinë e akteve të kontestuara nën prizmin e hierarkisë së normave juridike të parashikuar nga neni 116 i Kushtetutës. Nga ana tjetër, pretendimet për shkelje materiale të përmbajtjes/urdhërimit të një akti ligjor nga përmbajtja/urdhërimi i një akti nënligjor tipikisht, aktivizojnë juridiksionin e gjykatave të zakonshme administrative.

20. Ndërsa sipas qëndrimit tjetër, kërkuesja e ka mbështetur pretendimin për cenimin e parimit të hierarkisë së normave juridike në argumentin se akti është në kundërshtim me pikën 6 të nenit 72 të ligjit nr. 48/2018, për rrjedhojë nuk është i bazuar në ligj, duke mos respektuar hierarkinë e normave juridike. Ky pretendim në thelb lidhet me rregullat që Këshilli i Ministrave zbaton në miratimin e akteve nënligjore, në kuptim të neneve 116 dhe 118 të Kushtetutës. Në lidhje me këtë, në jurisprudencën kushtetuese është pohuar se është e vërtetë se organet kushtetuese, me kompetenca në nxjerrjen e akteve normative ose individuale, kanë hapësirën e tyre të vlerësimit për rregullimin e çështjeve në kompetencë të tyre, por në zgjedhjen e instrumentit ligjor ato duhet të respektojnë shtetin e së drejtës, të garantojnë koherencën e rendit juridik dhe hierarkinë e normave të tij *(shih vendimin nr. 29, datë 02.07.2021 të Gjykatës Kushtetuese).* Për rrjedhojë, pretendimi ka natyrë kushtetuese dhe përfshihet në juridiksionin kushtetues[2].

21. Gjykata vlerëson se pretendimet/argumentet për cenimin e parimeve të sigurisë juridike në drejtim të të drejtave të fituara dhe barazisë përpara ligjit e mosdiskriminimit janë me natyrë kushtetuese dhe në vijim do t'i shqyrtojë së bashku, duke mbajtur në konsideratë se në thelb parashtrohen të njëjtat argumente.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e parimeve të sigurisë juridike dhe të barazisë përpara ligjit e të mosdiskriminimit

22. Kërkuesja, në mënyrë të përmbledhur, ka parashtruar se VKM-ja nr. 425/2024 ka përkeqësuar gjendjen e punonjësve të arsimit, pasi ka ndryshuar vlerën e shtesës së nivelit të kualifikimit për çdo grup diplome, si një ndër elementet përbërëse të pagës bruto mujore të punonjësve,

[2] Gjyqtarët Marsida Xhaferllari, Fiona Papajorgji, Sandër Beci dhe Sonila Bejtja vlerësuan sipas këtij qëndrimi.

duke parashikuar vlerë më të ulët se ajo që përfitonin më parë. Në këtë drejtim, subjekti i interesuar ka prapësuar se në çdo rast, edhe nëse ka pasur ndërhyrje, ajo ka ndjekur një qëllim legjitim dhe proporcional me gjendjen e diktuar. Niveli i kualifikimit arsimor i diferencuar sipas ligjit nr. 10247/2010 do të sillte edhe diferencim në trajtimin financiar të punonjësve arsimorë, me qëllim garantimin e një shpërblimi të drejtë dhe dinjitoz për çdo punonjës mësimor dhe punonjësve të tjerë jomësimorë në institucionet arsimore dhe në institucionet plotësuese të sistemit arsimor parauniversitar, në përputhje me nivelin e kualifikimit të tyre.

23. Subjekti i interesuar, në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar se pretendimet e kërkueses lidhen me parashikimet e ligjit nr. 48/2018, sipas të cilit personelit mësimdhënës që ka përfunduar studimet universitare në ish-institutet e larta pedagogjike, diploma e përfituar i njihet si arsim i lartë, tetë semestra, për efekt page. Në interpretimin literal dhe sistematik të normave, nga përcaktimet e pikës 6 të nenit 72 të ligjit nr. 69/2012, si dhe nga përcaktimet e pikës 2 të nenit 124 të ligjit nr. 80/2015, rezulton se diplomën e nivelit "Bachelor", që i korrespondon nivelit 6 të kornizës shqiptare të kualifikimeve, legjislacioni i arsimit të lartë në asnjë moment nuk e ka përcaktuar si të barasvlershme me një nga diplomat që i përkasin nivelit 7 të kornizës shqiptare të kualifikimeve. Nëpërmjet VKM-së nr. 425/2024 janë materializuar elementet përbërëse të pagës bruto të punonjësve, ndërsa vlera e elementit "shtesa e nivelit të kualifikimit" është e përcaktuar duke zbatuar një logjikë përshkallëzimi sipas diplomës.

24. Lidhur me parimin e sigurisë juridike, në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se ai, si një nga elementet e parimit të shtetit të së drejtës, të sanksionuar në nenin 4 të Kushtetutës, përfshin, mes të tjerash, besueshmërinë e qytetarëve te shteti dhe pandryshueshmërinë e ligjit për marrëdhëniet e rregulluara. Besueshmëria ka të bëjë me bindjen e individit se nuk duhet të shqetësohet vazhdimisht ose të jetojë me frikë për ndryshueshmërinë dhe pasojat negative të akteve juridike, të cilat mund të cenojnë jetën e tij private ose profesionale dhe të përkeqësojnë një gjendje të vendosur me akte të mëparshme. Rregullimet ligjore që kanë të bëjnë me të drejtat e shtetasve duhet të kenë qëndrueshmëri të mjaftueshme që siguron vijimësinë e tyre. Si rregull, nuk mund të mohohen interesa dhe pritshmëri të ligjshme të qytetarëve nga ndryshimet në legjislacion dhe shteti duhet të synojë të ndryshojë një situatë të rregulluar më parë vetëm nëse ndryshimi sjell pasoja pozitive (*shih vendimet nr. 1, datë 25.01.2024; nr. 16, datë 01.03.2017; nr. 43, datë 26.06.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

25. Parimi i sigurisë juridike shoqërohet me mbrojtjen e të drejtave të fituara, vazhdimësinë ligjore, ndalimin e ligjeve me fuqi prapavepruese, qartësinë dhe përcaktueshmërinë në normimin e marrëdhënieve juridike, respektimin e pritshmërive legjitime *(shih vendimet nr. 35, datë 22.11.2022; nr. 16 datë 01.03.2017; nr. 10, datë 29.02.2016 të Gjykatës Kushtetuese*). Në lidhje me elementin e qartësisë, një rregullim i pasaktë i normës ligjore, që i lë shteg zbatuesit t'i japë asaj kuptime të ndryshme dhe që sjell pasoja, nuk shkon në përputhje me qëllimin, stabilitetin, besueshmërinë dhe efektivitetin që synon vetë norma *(shih vendimet nr. 20, datë 20.04.2021; nr.10, datë 26.02.2015; nr. 36, datë 15.10.2007 të Gjykatës Kushtetuese)*.

26. Sipas jurisprudencës kushtetuese, parimi i barazisë synon që të gjithë të jenë të barabartë në ligj dhe përpara ligjit jo vetëm në të drejtat themelore të parashikuara në Kushtetutë, por edhe në të drejtat e tjera ligjore. Barazia në ligj dhe përpara ligjit nuk do të thotë që të ketë zgjidhje të njëjta për individë ose kategori personash që janë në kushte objektivisht të ndryshme. Barazia përpara ligjit dhe në ligj presupozon barazinë e individëve që janë në kushte të barabarta. Megjithatë, parimi i barazisë nuk e ndalon trajtimin e diferencuar, por trajtimi i ndryshëm i kategorive të caktuara që përfitojnë nga kjo e drejtë mund të përligjet vetëm në raste përjashtimore dhe për shkaqe të arsyeshme e objektive *(shih vendimet nr. 34, datë 10.04.2017; nr. 10, datë 29.02.2016; nr. 71, datë 27.11.2015 të Gjykatës Kushtetuese)*.

27. Në vijim të standardeve kushtetuese, Gjykata, në rastin konkret, duke mbajtur në konsideratë pretendimet dhe prapësimet e palëve në këtë gjykim kushtetues, vëren se objekti i këtij gjykimi kushtetues lidhet me elementin përbërës të pagës bruto mujore, shtesën e nivelit të kualifikimit, e cila, në kuptim të VKM-së nr. 425/2024, shpërblen nivelin arsimor të kërkuar për pozicionin përkatës të punës.

28. Duke vijuar me analizën e kuadrit ligjor dhe nënligjor që rregullon pagën e punonjësve mësimorë, Gjykata vëren se në nenin 8 të ligjit nr. 35/2023 parashikohet se Këshilli i Ministrave miraton elementet përbërëse të pagës bruto dhe vlerën për çdo element të pagës bruto mujore të të punësuarve në institucionet e administratës publike. Në vijim, paga dhe elementet e saj janë rregulluar sipas VKM-së nr. 175/2017, që doli në zbatim të ligjit nr. 69/2012 dhe të ligjit nr. 10405, datë 24.03.2011 "Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve". Sipas pikës 3 të VKM-së nr. 175/2017, struktura e pagës mujore për punonjësit mësimorë përbëhet nga katër elemente: a) paga e grupit që është paga e nivelit arsimor; b) shtesa për vjetërsi; c) shtesa për kualifikim; ç) shtesa

e pozicionit, e përcaktuar për çdo vend pune sipas emërtesës përkatëse të pozicionit të punës. Vlera e pagës së grupit/ e nivelit arsimor për diplomën e ciklit të dytë të studimeve universitare ose të barasvlershme me ato ka qenë 14 000 lekë; për diplomat e ciklit të parë të studimeve universitare "Bachelor" ose të barasvlershme me to vlera ka qenë 11 000 lekë dhe për diplomën e shkollës së mesme pedagogjike me titullin "Mësues i shkollës fillore" vlera ka qenë 10 000 lekë.

29. Me VKM-në nr. 351/2017 u shtua, në fund të pikës 3.a, pra pas pagës së grupit, paragrafi me këtë përmbajtje: "Punonjësit aktualë mësimorë/ edukatorë, të cilët zotërojnë diplomë të ciklit të parë të studimeve universitare "Bachelor" ose të barasvlershme me të, sipas legjislacionit të arsimit të lartë dhe deri përpara datës 1 mars 2017, kanë përfituar pagën e grupit në masën 14 000 (katërmbëdhjetë mijë) lekë, do të vazhdojnë të përfitojnë të njëjtën masë të pagës së grupit deri në momentin e ndryshimit të nivelit të diplomës, ose ndërprerjes së marrëdhënieve të punës me institucionin arsimor përkatës. Punonjësit mësimorë/edukatorë që fillojnë punë për herë të parë si punonjës mësimorë/edukatorë në arsimin parauniversitar pas datës 1 mars 2017, do të trajtohen me pagë grupi sipas përcaktimeve të lidhjes nr. 2 të vendimit".

30. Ndërsa me ligjin nr. 48/2018 u shtua në nenin 72 (dispozitat kalimtare) të ligjit nr. 69/2012 parashikimi se personelit mësimdhënës, që ka përfunduar studimet universitare në ish-institutet e larta pedagogjike, diploma e përfituar i njihet si arsim i lartë, tetë semestra, për efekt page. Në referim të nenit 124 të ligjit nr. 80/2015, diplomat e programeve të studimit, të lëshuara në Republikën e Shqipërisë, që kanë zgjatur, së paku, 4 vite akademike (8 semestra), deri në përshtatjen e studimeve, sipas parimeve të procesit të Bolonjës, janë ekuivalente me diplomat "Master i shkencave".

31. Ndërsa VKM-ja nr. 425/2024, objekt shqyrtimi, ka ndryshuar elementet përbërëse të pagës bruto për punonjësve mësimorë, duke përcaktuar se ajo përbëhet nga pesë elemente: i. paga për pozicion, që shpërblen vlerën relative të çdo pozicioni pune; ii. shtesa e nivelit të kualifikimit, që shpërblen nivelin arsimor të kërkuar për pozicionin përkatës të punës; iii. shtesa për vjetërsi pune; iv. shtesa për kategoritë e kualifikimit, që shpërblen zhvillimin profesional të punonjësve mësimorë përgjatë karrierës së tyre, pas përfitimit të kategorisë së kualifikimit do të llogaritet në përqindje për çdo kategori, duke filluar nga 10% (mësues i kualifikuar), 20% (mësues special) dhe 30% (mësues mjeshtër); v. shtesa

për natyrë të veçantë pune e aplikueshme për disa pozicione në shkollat e arsimit të mesëm të lartë profesional.

32. Në vijim, në analizë të argumenteve për cenimin e parimeve të sigurisë juridike dhe të barazisë përpara ligjit e mosdiskriminimit, në përfundim të diskutimeve, në zbatim të nenit 72, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000, Gjykata nuk arriti numrin e kërkuar të votave për vendimmarrje, sipas parashikimeve të nenit 133, pika 2, të Kushtetutës dhe nenit 72, pika 2, të ligjit nr. 8577/2000.

33. Sipas njërit qëndrim, kërkuesja ka pretenduar cenimin e parimeve të: (i) sigurisë juridike; (ii) barazisë përpara ligjit dhe të mosdiskriminimit. Për parimin e sigurisë juridike, duke marrë në konsideratë argumentet e parashtruara nga kërkuesja dhe analizën e VKM-së nr. 425/2024, u vlerësua se për të arritur në përfundimin nëse në rastin konkret është cenuar ky parim duhet të analizohet nëse elementi "shtesa e nivelit të kualifikimit", një nga pesë elementet që përbëjnë pagën në tërësi sipas përcaktimit të VKM-së nr. 425/2024, përbën të drejtë të fituar, që gëzon mbrojtje nga parimi kushtetues i sigurisë juridike. Nga parashtrimet e palëve dhe shpjegimet e tyre u vërtetua se paga në tërësi për punonjësit e arsimit parauniversitar ka pësuar rritje në krahasim me pagën e mëparshme, fakt i konfirmuar edhe nga kërkuesja gjatë seancës plenare. Kërkuesja nuk arriti të parashtronte argumente nëse ndryshimi në llogaritjen e elementit të shtesës së nivelit të kualifikimit kishte sjellë pasoja negative në llogaritjen e pagës në tërësi, pasi në fakt, e drejta ligjore e fituar është paga në tërësinë e saj e përbërë nga pesë elementet sipas VKM-së nr. 425/2024 dhe jo elementet e veçanta të saj. Gjithashtu, gjatë shqyrtimit të çështjes, nga kërkuesja nuk u parashtrua asnjë argument për të provuar sesi ndryshimi i këtij elementi do të sillte pasoja në të ardhmen në të drejta, si e drejta për pension, për të cilën, në fakt, merret për bazë vlera e pagës në tërësi dhe jo elementet e veçanta të saj. Për këtë gjitha këto arsye, u vlerësua se e drejta ligjore e fituar, paga, nuk është cenuar dhe pretendimi për cenimin e parimit të sigurisë juridike nuk është i bazuar. Në lidhje me pretendimet për cenimin e parimit të barazisë përpara ligjit dhe të mosdiskriminimit, evidentohet se njohja e diplomave për efekt page, për sa i përket personelit mësimdhënës, lidhet me zbatimin e nenit 72, pika 6, të ligjit nr. 48/2018, në të cilin parashikohet se personelit mësimdhënës, që ka përfunduar studimet universitare në ish-institutet e larta pedagogjike, diploma e përfituar i njihet si arsim i lartë, tetë semestra, për efekt page. Ky parashikim ka dy elemente: (i) formal, që lidhet me emërtimin e institucionit të studimeve universitare (institute

të larta pedagogjike/universitet); (ii) substancial, për njohjen e diplomave për efekte të përfitimit të pagës. Në lidhje me elementin substancial, për të cilin janë edhe pretendimet në rastin konkret, pavarësisht çdo emërtimi formal të institucionit, punonjësi i arsimit parauniversitar që ka përfunduar arsimin me tetë semetra, që në referim të nenit 124 të ligjit nr. 80/2015 është ekuivalent me diplomën "Master i shkencave", për çdo pretendim për interpretimin dhe zbatimin e parashikimit ligjor mund t'i drejtohet gjykatës së juridiksionit të zakonshëm. Ndërsa për të gjitha kategoritë e punonjësve, që përfitojnë llogaritjen e pagës sipas arsimit përkatës, pas përshtatjes së sistemit të Bolonjës, parashikimi i VKM-së nr. 425/2024 nuk ka cenuar parimin e barazisë përpara ligjit dhe të mosdiskriminimit[3].

34. Sipas qëndrimit tjetër, duke u nisur nga analiza e ligjit nr. 48/2018 vlerësohet se përbën të drejtë të fituar njohja dhe njësimi i diplomës për efekt page me atë të arsimit të lartë, të barasvlershme me tetë semestra, për: (i) personelin mësimdhënës që ka filluar dhe përfunduar studimet në ish-institutet pedagogjike deri në vitin 2007, gjë që u konfirmua edhe nga shpjegimet e subjektit të interesuar në seancën gjyqësore të gjykimit kushtetues; (ii) personelin mësimdhënës që ka filluar studimet në ish-institutet pedagogjike dhe i ka përfunduar në fakultetet përkatëse të mësuesisë; (iii) personelin mësimdhënës që ka filluar dhe mbaruar studimet në fakultetet e mësuesisë deri në momentin e hyrjes në fuqi të zbatimit të detyrimeve të Kartës së Bolonjës. Për rrjedhojë, Këshilli i Ministrave me nxjerrjen e VKM-së nr. 425/2024, me të cilën nuk e njeh në të njëjtën mënyrë ekuivalentimin e diplomës si një të drejtë të fituar për kategoritë e mësipërme të listuara në pikat (ii) dhe (iii), ka cenuar pritshmëritë e ligjshme të atyre kategorive, si dhe i ka diferencuar ato pa një arsye të përligjur dhe objektive, duke cenuar në këtë mënyrë parimet e sigurisë juridike dhe të barazisë përpara ligjit e të mosdiskriminimit. Rregullat e VKM-së nr. 425/2024 nuk mund të tejkalohen nëpërmjet interpretimit të ligjit nga gjykatat e zakonshme, ndaj riparimi i këtyre të drejtave të cenuara mund të arrihet vetëm nëpërmjet shfuqizimit të VKM-së për këtë pjesë. Kjo do të thotë se pretendimet e kërkueses për këto kategori të personelit mësimdhënës janë të bazuara. Ndërsa për personelin mësimdhënës që ka filluar punë pas hyrjes në fuqi të detyrimeve të Kartës së Bolonjës, marrin vlerë kriteret e lidhura me nivelin e kualifikimit sipas skemës së parashikuar nga VKM-ja nr. 425/2024, ku evidentohet domosdoshmëria e

[3] Gjyqtarët Holta Zaçaj, Sonila Bejtja, Ilir Toska dhe Genti Ibrahimi votuan sipas këtij qëndrimi.

marrjes së një diplome në programin "Master" për t'u përfituar paga bazë në vlerën 14 000 lekë, për rrjedhojë pretendimi për cenimin e parimeve të sigurisë juridike dhe të barazisë përpara ligjit e të mosdiskriminimit për atë kategori nuk është i bazuar[4].

35. Për shkak të qëndrimeve të mësipërme, Gjykata konstatoi se nuk ishte e mundur të formohej numri i kërkuar prej 5 gjyqtarësh për të vijuar më tej shqyrtimin dhe vendimmarrjen për themelin e pretendimeve që lidheshin me cenimin e parimeve të sigurisë juridike dhe të barazisë përpara ligjit e të mosdiskriminimit.

36. Për sa më lart, Gjykata vëren se në kushtet kur nuk u formua shumica prej 5 gjyqtarësh, në kuptim të nenit 73, pika 4, të ligjit nr. 8577/2000, kërkesa e kërkueses konsiderohet e rrëzuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja "c" dhe 134, pika 1, shkronja "h", të Kushtetutës, si dhe neneve 72, 73, pika 4 dhe vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar,

V E N D O S I:

1. Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 24.07.2025
Shpallur më 28.10.2025

[4] Gjyqtarët Marsida Xhaferllari, Fiona Papajorgji, Sandër Beci dhe Marjana Semini votuan sipas këtij qëndrimi.

Vendim nr. 44, datë 29.07.2025
(V-44/25)

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Holta Zaçaj, Kryetare, Marsida Xhaferllari, Fiona Papajorgji, Sonila Bejtja, Sandër Beci, Ilir Toska, Marjana Semini, anëtarë, me sekretare Enina Kotoni, në datat 12.06.2025, 09.07.2025 dhe 15.07.2025 mori në shqyrtim në seancë plenare publike, me dyer të mbyllura, çështjen nr. 5 (O) 2024 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUESE: **ONEJDA YMERAJ**, përfaqësuar fillimisht nga avokatët Eugen Beci dhe Elis Bilali, ndërsa në vijim të gjykimit nga avokatët Flonja Boriçi (Tashko) dhe Florian Hasko, me prokurë të posaçme.

SUBJEKT I INTERESUAR:
PROKURORIA E POSAÇME KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR, përfaqësuar nga prokurorët Altin Dumani dhe Bledar Maksuti.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimeve nr. 93 (87-2024-134), datë 17.05.2024 të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 00-2024-1272, datë 11.07.2024 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

BAZA LIGJORE: **Nenet 17, 35, 36, 42, 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë *(Kushtetuta)*; nenet 6 dhe 8 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut" *(KEDNJ)*; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar *(Ligji Organik i Gjykatës)*.**

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Marjana Semini, mori në shqyrtim pretendimet e kërkueses Onejda Ymeraj *(kërkuesja)*, e cila ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar, Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar *(Prokuroria e Posaçme)*, që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I
Rrethanat e çështjes

1. Prokuroria e Posaçme në vitin 2022 ka regjistruar një procedim penal, ka kryer dhe po heton, për disa procedura koncesionare të zhvilluara nga ana e një ministrie. Në kuadër të këtij procedimi penal, në regjistrin e njoftimit të veprave penale, përveç veprave penale, janë shënuar edhe emrat e personave të cilëve u atribuohen ato. Ndër ta janë regjistruar edhe shtetasit A dhe B, bashkëjetues, të cilët janë dyshuar për veprat penale "Refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave privatë të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim", "Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë" dhe "Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale", të parashikuara nga nenet 257/a, paragrafi i dytë, 260, 287, paragrafi i dytë, e 25 të Kodit Penal *(KP)*.

2. Në lidhje me faktet penale objekt hetimi është ngritur dyshimi se personi nën hetim A, gjatë kohës së ushtrimit të funksioneve të larta shtetërore, ka konsumuar tri vepra penale, konkretisht: "Korrupsioni pasiv i funksionarit të lartë shtetëror", në disa raste, përmes marrjes drejtpërdrejt ose tërthorazi të përfitimeve të parregullta, për vete ose për persona të tjerë; "Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale", përmes fshehjes ose mbulimit të origjinës së pasurisë së paligjshme, të përfituar si pasojë e korrupsionit ose nga burimeve të tjera të paligjshme; "Refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave privatë të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim". Po kështu, është dyshuar se këto vepra penale ai i ka kryer në bashkëpunim,

përfshirë edhe bashkëjetuesen e tij, personin nën hetim B. Kjo e fundit, në gusht 2021, ka krijuar shoqërinë tregtare X, e cila, ndonëse nuk ka pasur kapacitete teknike dhe burime njerëzore për ofrimin e shërbimeve përkatëse, ka përfituar pagesa për ofrim shërbimesh nga subjekte të ndryshme tregtare. Është dyshuar për një aktivitet fiktiv të shoqërisë, i kryer me qëllim justifikimin e ligjshmërisë së burimeve të krijimit të pasurive dhe të shpenzimeve të të dy personave nën hetim në fjalë. Ndër subjektet tregtare që kanë bërë pagesa shërbimesh për shoqërinë X është identifikuar edhe shoqëria Y, përfaqësuesi C i së cilës, i pyetur në datën 14.02.2024, ka deklaruar, ndër të tjera, se kontaktin me personin nën hetim B ia ka rekomanduar kërkuesja. Gjithashtu, gjatë hetimit janë marrë të dhëna se regjistrimi i shoqërisë X pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit është bërë nga një punonjëse e një subjekti privat, ku kërkuesja mban një pozicion të lartë drejtues.

3. Mbi bazën e këtyre të dhënave, në datën 26.02.2024, kërkuesja është pyetur nga Prokuroria e Posaçme në cilësinë e personit që ka dijeni për veprën penale. Në deklarimet e saj ajo ka pohuar njohjen me personin nën hetim B, rekomandimin e kësaj të fundit te shtetasi C dhe mundësimin e kontaktimit mes tyre. Pas vlerësimit edhe të këtyre deklarimeve, po atë ditë, mbështetur në nenet 188 dhe 198 e vijues të Kodit të Procedurës Penale *(KPP),* Prokuroria e Posaçme ka marrë vendim "Për këqyrjen e sendeve/dokumenteve", me të cilin është vendosur këqyrja e të dhënave të telefonit celular *"Iphone 15 Pro Max"* (telefon inteligjent) në përdorim të kërkueses, si dhe bisedave të zhvilluara nga ajo në kanale të ndryshme komunikimi që ishin me interes për hetimin e procedimit penal. Sipas këtij vendimi, këqyrja do të realizohej nëpërmjet administrimit të të dhënave me fotografi dhe përshkrimit të tyre, ndërsa për kryerjen e veprimit janë ngarkuar dy oficerë të Policisë Gjyqësore *(OPGJ)*.

4. Në zbatim të këtij vendimi, po në datën 26.02.2024, ora 15:50, OPGJ-të i kanë kërkuar kërkueses të realizonin këqyrjen e të dhënave në telefonin celular në përdorim të saj. Kërkuesja nuk ka kundërshtuar dhe në prani të saj, OPGJ-të, përmes ekranit të telefonit, kanë këqyrur disa nga komunikimet e ruajtura në të. Ky veprim është dokumentuar me procesverbalin "Për këqyrjen e telefonit celular në posedim të shtetases Onejda Ymeraj". Sipas këtij procesverbali, nga këqyrja e telefonit është konstatuar se kërkuesja ka pasur disa komunikime me interes për hetimin. Konkretisht, ajo ka komunikuar me një person që, bazuar në të dhënat e kontaktit dhe përmbajtjen e komunikimit, dyshohej të ishte

personi nën hetim B; me një person tjetër, i identifikuar nga të dhënat e kontaktit si shtetasi C, përfaqësuesi i shoqërisë Y, që kishte bërë pagesa për shoqërinë e personit nën hetim B; komunikime të tjera ku përmendej personi nën hetim A. Nisur nga këto komunikime, të cilat vijonin edhe gjatë vitit 2021, si dhe nga fakti se këqyrja e tyre për nxjerrjen e të gjitha dokumenteve, komunikimeve me interes për procedimin penal kërkonte kohë të gjatë, OPGJ-të kanë vendosur ndërprerjen e këqyrjes së telefonit dhe sekuestrimin e tij. Më pas, me procesverbalin e datës 26.02.2024, ora 17:08, OPGJ-të, bazuar në nenin 300 të KPP-së, kanë sekuestruar sendin "telefon celular" të kërkueses. Me vendimin e datës 27.02.2024 Prokuroria e Posaçme, duke u mbështetur në nenin 301 të KPP-së, ka vleftësuar të ligjshëm sekuestrimin e provës/sendit "telefon celular" të kërkueses, me arsyetimin se ai është i domosdoshëm për hetimin, pasi në të mund të gjenden të dhëna me rëndësi, duke pasur parasysh rrezikun e ndryshimit ose të humbjes së tyre.

5. Pas sekuestrimit të telefonit të kërkueses, me vendimin e datës 28.02.2024, Prokuroria e Posaçme, bazuar në nenet 178 e vijues dhe 314 të KPP-së, ka vendosur kryerjen e ekspertimit teknik-elektronik të telefonit, me arsyetimin se në të mund të gjenden të dhëna me vlerë për hetimin dhe se për këtë nevojiten njohuri të posaçme teknike në fushën kompjuterike dhe telefonike. Si çështje të ekspertimit janë përcaktuar evidentimi dhe ekstraktimi: i) i të dhënave të rubrikës së thirrjeve hyrëse dhe dalëse, mesazheve SMS dhe MMS, thirrjeve të humbura, numrave të kontaktit, fotove dhe regjistrimeve audio e video e të dhënave të tjera, të fshira ose jo, nëse ekzistojnë dhe mund të rikuperohen; ii) i logimeve dhe i navigimeve në faqe interneti, faqeve të klikuara, komunikimeve me palë të treta, komunikimeve në rrjete sociale *(Facebook, Twitter, Instagram, Skype etj.)*, përmes opsioneve të *chat-it online* dhe aplikacioneve të instaluara në objektin e ekspertimit *(Whatsapp, Viber, BBM etj.)* nëse telefoni objekt ekspertimi ka opsione përdorimi të internetit; iii) i çdo të dhëne tjetër me rëndësi për hetimin. Për kryerjen e ekspertimit janë ngarkuar tre ekspertë të sektorit të ekspertizës pranë Prokurorisë së Posaçme. Ky vendim, sipas urdhërimit të tij, i është njoftuar personave nën hetim, por jo kërkueses.

6. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Posaçme, pohoi në gjykim se ekspertët kanë realizuar ekspertimin teknik-elektronik të telefonit të kërkueses dhe kanë përgatitur aktin e datës 29.03.2024. Sipas tij, dokumenti, akti i ekspertimit, i është nënshtruar këqyrjeve, të cilat janë drejt

përfundimit dhe se nga ato janë marrë të dhëna dhe inidicie që kanë vlerën e provës në funksion të objektit të hetimit. Ai ka sqaruar se ekspertimi, si në të gjitha rastet e kësaj natyre, ka konsistuar në ekstraktimin dhe kopjimin e të dhënave të memorizuara në telefonin celular të kërkueses, kurse këqyrja e materialit në vijim konsiston në kërkimin me fjalë kyçe vetëm të atyre të dhënave që lidhen me hetimin, pra me faktin penal, veprën penale dhe personat e përfshirë në të, duke shmangur të dhënat që kanë të bëjnë me jetën private dhe familjare. Ndërkohë, në mbështetje të kërkesës paraprake (*shih paragrafin 15 më poshtë*), subjekti i interesuar paraqiti si provë një procesverbal të datës 04.07.2025, për këqyrjen e pjesshme të të dhënave të aktit të ekspertimit teknik-elektronik. Sipas këtij procesverbali, OPGJ-të, bazuar në vendimin e prokurorit për këqyrjen e të dhënave, kanë realizuar këqyrjen dhe printimin e të dhënave nga akti i ekspertimit, në të cilin janë ekstraktuar të dhëna si numrat e kontaktit, thirrjet hyrëse dhe dalëse, SMS-të hyrëse dhe dalëse, komunikimet në Whatsapp, Viber, Telegram, fotot dhe dokumentet e shkëmbyera etj., të përftuara nga ekspertimi i telefonit të kërkueses, të cilat janë hedhur në një *hard drive* të jashtëm (pajisje ruajtjeje). Në vijim, në procesverbal përshkruhen veprimet e kryera nga OPGJ-të për realizimin e këqyrjes. Kështu, *hard drive* është vendosur në një kompjuter dhe pasi kanë shkuar te një folder, që në brendësi ka një program që bën të mundur leximin e të dhënave, OPGJ-të kanë bërë kërkim në një rubrikë ku gjendeshin të gjitha komunikimet në formë të shkruar ose zanore, të zhvilluara në aplikacione të ndryshme si: Whatsapp, Instagram, Facebook, Signal etj. Sipas procesverbalit, gjatë kërkimit të rastësishëm të komunikimeve të kërkueses në këtë rubrikë janë gjetur biseda në Whatsapp, mes saj dhe bashkëshortit (në një datë të vitit 2018), si dhe me dy persona të tretë (në dy data të vitit 2019), ku përmbajtja e tyre lidhej me një gjyqtar kushtetues, për të cilin është kërkuar përjashtimi nga gjykimi i çështjes. Bashkëlidhur procesverbalit janë edhe ekstraktet e printuara të bisedave.

7. Në datën 29.02.2024 kërkuesja i është drejtuar Prokurorisë së Posaçme me kërkesë për kthimin e telefonit celular të sekuestruar. Me vendimin e datës 08.03.2024, prokurorët e çështjes kanë vendosur mospranimin e kërkesës.

8. Po kështu, në datën 06.03.2024, duke mos qenë dakord me masën e sekuestrimit të telefonit celular, kërkuesja ka paraqitur edhe ankim në gjykatë kundër procesverbalit të datës 26.02.2024 për sekuestrimin e sendit "telefon celular" nga OPGJ-të, si dhe kundër vendimit të datës 27.02.2024 të Prokurorisë së Posaçme për vleftësimin e ligjshëm të sekuestrimit, duke

kërkuar edhe kthimin e sendit të sekuestruar. Ajo ka pretenduar se: (i) nuk është lejuar të konsultohet me mbrojtësin përpara sekuestrimit të telefonit; (ii) sekuestrimi është vendosur në kundërshtim me legjislacionin procedural penal, pasi ajo nuk ishte person nën hetim, nuk kanë ekzistuar kushtet e urgjencës sipas nenit 300 të KPP-së që OPGJ-të të vepronin me iniciativë, pa urdhër të prokurorit, si dhe se telefoni i saj nuk ka lidhje me procedimin penal; (iii) sekuestrimi dhe ekspertimi në vijim i telefonit të saj i kanë cenuar të drejtën për jetë private dhe të drejtën e pronës, përveçse e kanë penguar të kryejë detyrat e punës në institucionin mjekësor privat ku punonte.

9. Me vendimin nr. 161, datë 11.03.2024, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar *(GJKKO-ja e Shkallës së Parë)* ka pranuar ankimin e kërkueses, duke vendosur shfuqizimin e vendimit të datës 27.02.2024 të Prokurorisë së Posaçme, që kishte vleftësuar të ligjshëm sekuestrimin e telefonit të saj celular nga OPGJ-të, si dhe ka urdhëruar kthimin e tij kërkueses. Në mënyrë të përmbledhur, ajo gjykatë ka vlerësuar se: (i) sekuestrimi i telefonit të kërkueses nuk është bërë me vendim gjykate, pra nëpërmjet kontrollit personal që përfaqëson mjetin juridik që bën të mundur shkuarjen te sekuestrimi, në kundërshtim me nenet 202, 208/a dhe 209 të KPP-së; (ii) sekuestrimi i telefonit të kërkueses nga OPGJ-të nuk është kryer në kushtet e flagrancës, në kundërshtim me nenet 202, pika 3 dhe 298 të KPP-së dhe vendimin njësues nr. 1, datë 30.06.2017 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë *(vendimi njësues nr. 1/2017);* (iii) vendimet e Prokurorisë së Posaçme për vleftësimin e sekuestros dhe për kryerjen e ekspertimit teknik-elektronik të telefonit të kërkueses nuk përcaktojnë të dhënat që do të përzgjidheshin, të domosdoshme për vërtetimin e faktit penal dhe pa të cilat nuk mund të arrihej në njoftimin mbi ekzistencën e faktit, si dhe nuk tregojnë se përse sekuestrimi i të gjitha të dhënave të ruajtura në telefonin e kërkueses ka qenë i domosdoshëm në aspektin e proporcionalitetit në planin sasior, cilësor dhe kohor, në kundërshtim me jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut *(GJEDNJ)* në lidhje me nenin 8, paragrafi 2, të KEDNJ-së; (iv) dorëzimi i telefonit nga kërkuesja, e cila nuk është lejuar të konsultohet paraprakisht me avokatin dhe nuk është informuar për të drejtën për të mos e dorëzuar atë për këqyrje dhe sekuestrim, nuk përbën heqje dorë nga e drejta për jetë private dhe korrespondencë në kuptim të jurisprudencës së GJEDNJ-së. Kundër këtij vendimi ka ushtruar ankim Prokuroria e Posaçme.

10. Me vendimin nr. 93 (87-2024-134), datë 17.05.2024, Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar *(GJKKO-ja e Apelit)* ka ndryshuar vendimin e GJKKO-së së Shkallës së Parë, duke rrëzuar kërkesën ankimore të kërkueses. Ajo ka vlerësuar se OPGJ-të kanë vepruar brenda kompetencave për veprimin me iniciativë. Sipas asaj gjykate, pas deklarimeve të kërkueses dhe këqyrjes të të dhënave në telefonin e saj, është krijuar menjëherë një situatë që kërkonte gjetjen e elementeve të vlefshme për rindërtimin e faktit penal dhe individualizimin e fajtorëve, deri në atë moment të supozuar. Në funksion të fiksimit dhe ruajtjes së gjurmëve, dhe sendeve që i përkasin veprës penale, për të shmangur ndryshimin ose humbjen e tyre, dhe duke qenë se prokurori nuk ishte i pranishëm për të ndërhyrë urgjentisht, OPGJ-të me të drejtë sekuestruan sendin "telefon celular" të kërkueses. Ky send, si mjet mbajtës i fakteve, përbën provë të llojit "dokument" në kuptim të nenit 191 të KPP-së. Për rrjedhojë, veprimtaria me iniciativë e OPGJ-ve është në përputhje me nenin 294 të KPP-së, që i njeh Policisë Gjyqësore të drejtën të kryejë të gjitha veprimet për sigurimin e burimeve të provës. Po kështu, kjo veprimtari është në përputhje edhe me nenin 300 të KPP-së, për veprimet me iniciativë të Policisë Gjyqësore në rastet e verifikimeve të ngutshme në vend, kur vonesa deri në mbërritjen e prokurorit mund të sjellë ndryshim, humbje ose zhdukje të gjurmëve/sendeve, me pasoja për rezultatin e hetimeve. Ajo gjykatë ka theksuar se veprimi hetimor i sekuestrimit provues, si në rastin konkret, përbën veprim me inciativë të Policisë Gjyqësore kur plotësohen kushtet e nenit 208 të KPP-së, pra kur provat materiale dhe sendet që lidhen me veprën penale janë të domosdoshme për vërtetimin e fakteve, pavarësisht natyrës së tyre (të luajtshme/të paluajtshme). Ky sekuestrim i nënshtrohet regjimit të ruajtjes, vulosjes dhe heqjes/vënies së vulave sipas neneve 214-216 të KPP-së, njësoj sikur të ishte ekzekutuar me urdhër të gjykatës ose të prokurorit. Kundër vendimit të GJKKO-së së Apelit kërkuesja ka ushtruar rekurs.

11. Me vendimin nr. 00-2024-1272, datë 11.07.2024, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkueses, me arsyetimin se në të nuk ngrihen shkaqet e parashikuara nga neni 432 i KPP-së dhe se GJKKO-ja e Apelit ka arsyetuar në mënyrë shteruese për pretendimet e saj. Sipas atij kolegji, sekuestrimi i telefonit të kërkueses nga OPGJ-të është kryer në kushtet e urgjencës, duke u vleftësuar në vijim nga prokurorët e çështjes, ndërsa sekuestrimi është kryer në përputhje me kërkesat e nenit 208 në lidhje me nenin 187 të KPP-së. Pas këqyrjes,

organi procedues me të drejtë dyshoi se veprimtaria kriminale e pretenduar pasqyrohej edhe në të dhënat e ruajtura në telefon, ndërkohë që disponimi i tij nga kërkuesja krijonte rrezik për zhdukjen e dhënave të dobishme për hetimin, duke bërë kështu të domosdoshëm sekuestrimin e tij. Po sipas atij kolegji, ndryshe nga sa është pranuar nga GJKKO-ja e Shkallës së Parë, në rastin konkret nuk jemi para një kontrolli të kërkueses, ndërsa ajo e vuri vetë telefonin në dispozicion të OPGJ-ve, pa ndonjë kundërshtim. Ai kolegj ka vlerësuar se këqyrja e telefonit nga OPGJ-të është në përputhje edhe me vendimin njësues nr. 147, datë 23.12.2021 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë *(vendimi njësues nr. 147/2021)*. Sipas tij, kërkuesja ka qenë e pranishme dhe asaj nuk rezulton t'i jetë cenuar e drejta për jetë private në kuptim të nenit 8 të KEDNJ-së, për sa kohë këqyrja është kufizuar tek të dhënat që lidheshin me faktet objekt hetimi. Edhe sekuestrimi i telefonit, edhe vendimi i ekspertimit teknik-elektronik të tij, vijon ai, nuk i kanë shkelur kërkueses të drejtën për jetë private, pasi ato janë kryer vetëm në funksion të hetimit dhe kërkuesja nuk ka evidentuar fakte konkrete cenimi dhe as se të dhënat në telefon nuk kishin lidhje me objektin e hetimit. Këto veprime janë proporcionale, vetëm për aq sa të dhënat në telefon mund të ndihmonin hetimin. Sekuestrimi, ka vlerësuar ai, është në përputhje me nenin 17 të Kushtetutës lidhur me kufizimin e së drejtës së pronës, pasi është bërë për një interes publik, siç është hetimi dhe goditja e veprave penale të korrupsionit dhe pastrimit të parave, ka qenë i domosdoshëm, në përputhje me gjendjen që e ka diktuar dhe në proporcion të drejtë me qëllimin dhe rrethanat konkrete. Kthimi i sendit kërkueses, është shprehur kolegji, mund të bëhet vetëm kur mbajtja e tij për qëllime prove të mos jetë më i nevojshëm, ndërkohë që në rastin konkret hetimet paraprake vijojnë dhe është urdhëruar ekspertimi teknik-elektronik i tij.

12. Në datën 08.11.2024 kërkuesja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese *(Gjykata)* me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij. Në datën 03.01.2025 Kolegji i Gjykatës ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve dhe kjo e fundit në datën 28.01.2025 ka vendosur kalimin e saj për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

13. Në datën 05.06.2025 një gjyqtar i Gjykatës ka paraqitur kërkesë për heqjen dorë nga shqyrtimi i çështjes. Për këtë kërkesë, Mbledhja e Gjyqtarëve,[1] me vendimin e datës 12.06.2025, ka vendosur rrëzimin e saj

[1] Votuan për pranimin e kërkesës për dorëheqje të gjyqtarit kushtetues gjyqtarët Holta Zaçaj, Sonila Bejtja dhe Sandër Beci.

me arsyetimin se afërsia e lidhjes fisnore mes gjyqtarit dhe bashkëshortit të kërkueses nuk është në shkallën e parashikuar nga ligji dhe, për pasojë, nuk përbën shkak ligjor për papajtueshmëri në ushtrimin e funksionit nga gjyqtari kushtetues. Në seancën plenare të kësaj date Gjykata ka vendosur ndryshimin e formës së gjykimit në seancë plenare publike, duke e vlerësuar këtë si të nevojshme për përcaktimin e fakteve të çështjes. Palët janë njoftuar më pas për këtë vendim.

14. Në datën 24.06.2025 Prokuroria e Posaçme i është drejtuar Gjykatës me kërkesë për shtyrjen e seancës plenare dhe, bazuar në nenet 5, pika 3 e 33, pika 3, të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, ka kërkuar edhe zhvillimin e saj me dyer të mbyllura me qëllim ruajtjen e sekretit hetimor, duke qenë se procedimi penal për çështjen është ende në fazën e hetimit paraprak. Po atë ditë, Mbledhja e Gjyqtarëve ka vendosur pranimin e kërkesës për shtyrjen e seancës plenare, ndërsa kërkesën për zhvillimin e seancës me dyer të mbyllura ka vendosur ta shqyrtojë në seancën publike të datës 09.07.2025, pasi të dëgjonte palët. Në seancën plenare publike të kësaj date, Gjykata, pasi dëgjoi palët, vendosi zhvillimin e seancës plenare me dyer të mbyllura, vetëm me praninë e palëve, duke vlerësuar se, për sa kohë çështja ndodhet ende në fazën e hetimit paraprak, publiciteti mund të sjellë përhapjen e të dhënave që duhet të mbahen sekret në interes të hetimit.

15. Gjatë vijimit të seancës plenare, në kuadër të kërkesave paraprake, Prokuroria e Posaçme kërkoi përjashtimin nga gjykimi të gjyqtarit kushtetues, dorëheqja e të cilit nuk ishte pranuar më herët. Ajo parashtroi si shkak marrëdhëniet miqësore të gjyqtarit kushtetues me kërkuesen, duke paraqitur si provë disa komunikime të kërkueses me bashkëshortin e saj (në një datë të vitit 2018), si dhe me dy persona të tretë (në dy data të vitit 2019), të nxjerra nga të dhënat e memorizuara nga platforma në Whatsapp në telefonin celular të sekuestruar kërkueses. Pas njohjes me shkaqet e kërkesës dhe nisur nga ndjeshmëria e subjektit të interesuar, gjyqtari kushtetues ka paraqitur sërish kërkesë për heqjen dorë nga shqyrtimi i çështjes, e cila është pranuar nga Gjykata me qëllim garantimin e paanësisë së saj edhe në dukje. Në këto rrethana, kërkesa e Prokurorisë së Posaçme për përjashtimin e gjyqtarit kushtetues u konsiderua se nuk është bërë, bazuar në nenin 20 të KPP-së, i zbatueshëm në rastin konkret në kuptim të nenit 1, pika 2, të Ligjit Organik të Gjykatës.

II
Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

16. ***Kërkuesja***, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i janë cenuar:

16.1. *E drejta për proces të rregullt ligjor*, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të *parimit të sigurisë juridike*, pasi vendimet gjyqësore të kundërshtuara bien ndesh me vendimet njësuese nr. 1/2017 dhe nr. 147/2021 të Gjykatës së Lartë, për shkak të mosrespektimit të parimeve të proporcionalitetit dhe të përshtatshmërisë.

16.2. *E drejta për jetë private* në aspektin e *të dhënave personale* dhe *korrespondencës,* të garantuara nga nenet 35 dhe 36 të Kushtetutës, për shkak të mosrespektimit të *parimit të proporcionalitetit*, pasi:

16.2.1. Në përmbajtje të telefonit celular ka komunikime të saj, përveç edhe foto, të dhëna kontakti, faqe interneti të klikuara dhe të dhëna të tjera personale. Për shkak të profesionit që ajo ushtron, një pjesë e mirë e të dhënave kishin të bënin me pacientë, duke përbërë ato të dhëna me natyrë sensitive, të mbrojtura nga ligji nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar *(ligji nr. 9887/2008)*, në fuqi në kohën e sekuestrimit, nga ligji aktual nr. 124/2024 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" *(ligji nr. 124/2024)*, si dhe nga neni 30 i ligjit nr. 10107, datë 30.03.2009 "Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë", që përcakton detyrimin e profesionistëve të shëndetit, përdoruesve të sistemeve të informacionit shëndetësor dhe autoriteteve për ruajtjen e të dhënave shëndetësore që përbëjnë informacion konfidencial.

16.2.2. Sekuestrimi i telefonit celular është bërë në kundërshtim me nenin 209 të KPP-së dhe me vendimin njësues nr. 147/2021 të Gjykatës së Lartë në lidhje me sekuestrimin e të dhënave kompjuterike, sipas nenit 208/a të KPP-së, pasi ka dallim thelbësor ndërmjet telefonit si objekt fizik, i cili mund të sekuestrohet sipas nenit 208 të KPP-së, dhe përmbajtjes së tij si të dhëna personale ose korrespondencë. Nisur nga kjo, edhe pse neni 209 i KPP-së i referohet korrespondencës tradicionale, interpretimi i tij duhet të bëhet nën dritën e zhvillimeve të reja teknologjike, të frymës së Kushtetutës

dhe të jurisprudencës së GJEDNJ-së, duke u zbatuar kjo dispozitë edhe në rastin e sekuestrimit të telefonit celular në lidhje me leximin dhe përpunimin e përmbajtjes së tij, që përbën korrespondencë elektronike. Në këtë kuptim, ndërhyrja në korrespondencën e kërkueses është bërë pa vendim të gjykatës, si organi i vetëm që mund të vlerësojë proporcionalitetin e saj.

16.2.3. Sekuestrimi i telefonit celular është bërë në kundërshtim edhe me nenin 300 të KPP-së, pasi nuk kanë ekzistuar kushtet e urgjencës dhe flagrancës për veprimin me iniciativë nga OPGJ-të. Ajo nuk është person nën hetim dhe telefonin e ka vënë në dispozicion të OPGJ-ve duke qenë dakord me këqyrjen e tij, ndërkohë që OPGJ-të, ndonëse mund të merrnin kohën e nevojshme, nuk kanë vazhduar këqyrjen dhe dokumentimin e komunikimeve të saj me dy personat që kishin lidhje me hetimin. Kërkesa e saj për praninë e avokatit gjatë sekuestrimit të telefonit nuk është pranuar nga OPGJ-të dhe pretendimi i kërkueses në këtë drejtim nuk është analizuar nga gjykatat në vendimet e kundërshtuara.

16.2.4. Sekuestrimi i telefonit celular nuk ka qenë i domosdoshëm dhe ka pasur masa të tjera më të lehta, më pak kufizuese për të drejtat e saj, për arritjen e qëllimit të ndjekur, pikërisht sigurimin e komunikimeve me dy personat që kishin lidhje me hetimin, të tilla, si: këqyrja ose kopjimi i atyre të dhënave, madje edhe sekuestrimi i telefonit, por vetëm për një periudhë të kufizuar kohore (deri në një muaj), për aq sa ka qenë e nevojshme për këqyrjen dhe kopjimin e të dhënave në fjalë. Ajo ka pranuar dhe nuk ka penguar këqyrjen e telefonit celular nga OPGJ-të.

16.2.5. Sekuestrimi i telefonit celular dhe ekspertimi i tij nuk kanë qenë masa proporcionale në kuptimin e ngushtë, përveçse bien në kundërshtim me vendimin njësues nr. 147/2021. Vendimi i ekspertimit të telefonit është i përgjithshëm, evaziv dhe shumë i gjerë, pa përcaktuar të dhënat elektronike që i shërbenin hetimit e që lidheshin me veprën penale ose masat specifike për mbrojtjen e të dhënave. Media ka informuar se të dhënat për dosjen hetimore në fjalë janë hakeruar, ndonëse sipas njoftimit të Prokurorisë së Posaçme ka pasur tentativë

për hakerimin e tyre. Duke sekuestruar dhe ekspertuar telefonin janë aksesuar të gjitha të dhënat e ruajtura në të, ndonëse vetëm një pjesë e kufizuar e tyre lidhej me hetimin, përveçse komunikimet që i adresoheshin kërkueses kanë natyrë periferike dhe pa rëndësi të veçantë për hetimin. Në këtë drejtim, edhe materiali i paraqitur në mbështetje të kërkesës për përjashtimin e gjyqtarit kushtetues tregon qartë se organi i ndjekjes penale ka aksesuar edhe të dhëna që nuk lidhen me hetimin. Po kështu, edhe pse ka kaluar më shumë se 1 vit e 4 muaj nga sekuestrimi, telefoni nuk i është kthyer ende.

16.3. *E drejta e pronës private*, e garantuar nga neni 41 i Kushtetutës, si rrjedhojë e sekuestrimit të telefonit celular të saj dhe mbajtjes së tij të sekuestruar, masë kjo që e ka vënë në vështirësi serioze për organizimin dhe vijimin e veprimtarisë së saj profesionale.

17. ***Subjekti i interesuar*, *Prokuroria e Posaçme,*** ka prapësuar se:

17.1. Pretendimi i kërkueses për cenimin e *së drejtës për proces të rregullt ligjor* është i pabazuar, pasi GJKKO-ja e Apelit dhe Gjykata e Lartë kanë vepruar në përputhje me legjislacionin në fuqi, duke arsyetuar për proporcionalitetin dhe përshtatshmërinë e ndërhyrjes.

17.2. Pretendimet e kërkueses për cenimin e *së drejtës së pronës private* dhe *së drejtës për jetë private* në aspektin e *të dhënave personale* dhe *të korrespondencës* janë të pabazuara. Këto të drejta nuk janë absolute dhe ndërhyrja në telefonin celular të kërkueses në rastin konkret respekton standardet dhe kriteret e përcaktuara nga jurisprudenca kushtetuese dhe ajo e GJEDNJ-së në lidhje me:

17.2.1. Ligjshmërinë e ndërhyrjes, pasi sekuestrimi i telefonit celular të kërkueses është kryer në përputhje me nenin 300 të KPP-së, që u jep OPGJ-ve të drejtën për të sekuestruar, me iniciativë, sende që lidhen me një vepër penale, në kushtet e urgjencës. Sekuestrimi është vleftësuar në vijim nga prokurori, në përputhje me nenin 301 të KPP-së. Ai është realizuar nga OPGJ-të për shkak se vazhdimi i këqyrjes të të dhënave në telefon kërkonte kohë të gjatë, ndërkohë që ndërhyrja e prokurorit ka qenë e pamundur, pasi kishte kaluar orari zyrtar. Në rast mosveprimi, ka ekzistuar rreziku i fshirjes të të dhënave në telefonin e kërkueses dhe i pamundësisë së

rikuperimit të tyre. Dispozitat e KPP-së nuk parashikojnë praninë e mbrojtësit gjatë marrjes në pyetje të shtetasit në cilësinë e personit që ka dijeni për rrethanat e hetimit ose gjatë veprimit të sekuestrimit. Edhe jurisprudenca e GJEDNJ-së e ka konsideruar të ligjshme masën e sekuestrimit të pajisjeve elektronike, kur ajo ndihmon për zbulimin e fakteve të rëndësishme për hetimin penal.

17.2.2. Qëllimin legjitim të ndërhyrjes, pasi sekuestrimi i telefonit celular të kërkueses është kryer për mbledhjen e provave në kuadër të një hetimi për vepra të rënda penale si korrupsioni dhe pastrimi i produkteve të veprës penale, krime këto me pasoja të rënda për interesin publik dhe rendin ligjor.

17.2.3. Domosdoshmërinë e ndërhyrjes, pasi sekuestrimi i telefonit celular të kërkueses është bërë për nevojat e hetimit, me qëllim ekzaminimin e tij të mëtejshëm në kushtet kur është verifikuar se në telefon gjendej një numër i konsiderueshëm të dhënash me rëndësi për hetimin dhe ka pasur prova dhe indicie të mjaftueshme për lidhjen e kërkueses me hetimin penal, ndërkohë që nuk ka pasur alternativa të tjera më të lehta për të siguruar të njëjtin rezultat hetimor. Duke pasur parasysh volumin e madh të të dhënave në telefonin celular të kërkueses, për OPGJ-të ka qenë krejt e pamundur të vijonin me këqyrjen në vend të të dhënave, siç pretendon kërkuesja, prandaj është proceduar me sekuestrimin e telefonit, në kushtet kur kemi të bëjmë me prova elektronike që mund të zhduken menjëherë, në çast. Kopjimi i përmbajtjes së telefonit është bërë përmes ekspertimit teknik-elektronik, veprim i cili, ashtu si dhe këqyrja e aktit të ekspertimit në vijim, kërkon kohë për shkak të volumit të madh të të dhënave.

17.2.4. Proporcionalitetin dhe përshtatshmërinë e ndërhyrjes, pasi ndërhyrja në telefonin celular të kërkueses është orientuar vetëm drejt të dhënave që lidhen me faktin penal dhe me personat e përfshirë, duke mos qenë ajo e paarsyeshme ose arbitrare. Për më tepër, kërkuesja e ka dorëzuar me dëshirë telefonin e saj, duke nënshkruar pa vërejtje procesverbalin e këqyrjes dhe të sekuestrimit të tij. Të dhënat në përmbajtje të telefonit të kërkueses nuk janë bërë publike dhe do të përdoren vetëm për qëllime hetimore. Pretendimet e parashtruara në

gjykimin kushtetues për gjyqtarin kushtetues kanë synuar të japin pasqyrim të marrëdhënies së tij me kërkuesen dhe kanë të bëjë me objektin e gjykimit të çështjes, duke mos tejkaluar asnjë normë. Sekuestrimi i telefonit të kërkueses dhe mbajtja e tij i sekuestruar si provë materiale, për aq kohë sa është e domosdoshme për të provuar faktin penal, është në përputhje edhe me vendimin njësues nr. 147/2021. Nëse telefoni do t'i kthehej kërkueses, ekziston rreziku i dëmtimit ose i zhdukjes së provës dhe në kushtet kur hetimet vazhdojnë, kthimi i tij është i pamundur, pasi mund të lindë nevoja për riekspertim.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkueses

18. Çështja e legjitimimit *(locus standi)* është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor, që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, si dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

19. Në lidhje me legjitimimin *ratione personae,* Gjykata ka theksuar se në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, individi mund të bëjë ankim kushtetues individual vetëm për çështje që lidhen me të drejtat themelore të tij, duke treguar se është viktimë e një shkeljeje dhe se pasojat nga akti i kundërshtuar janë të drejtpërdrejta dhe reale për të *(shih vendimet nr. 21, datë 22.04.2025; nr. 17, datë 13.03.2024; nr. 44, datë 26.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese)*. Në dritën e kësaj jurisprudence, Gjykata vëren se, në rastin konkret, kërkuesja ka kundërshtuar masën e sekuestrimit, për qëllime provuese, të telefonit celular të saj të zbatuar nga OPGJ-të dhe vendimin e prokurorëve për vleftësimin si të ligjshëm të sekuestrimit, si dhe veprimin hetimor të ekspertimit teknik-elektronik të telefonit të sekuestruar, përveç edhe

vendimet gjyqësore të GJKKO-së së Apelit e të Gjykatës së Lartë që kanë rrëzuar ankimin e saj, me pretendimin se masa dhe veprimi hetimor në fjalë, si dhe ligjërimi i tyre nga gjykatat e zakonshme kanë ndërhyrë drejtpërdrejt në të drejtat themelore të saj. Në këto kushte, Gjykata çmon se kërkuesja justifikon interesin në çështjen e parashtruar dhe, për rrjedhojë, legjitimohet *ratione personae*.

20. Për sa i takon kriterit të *shterimit të mjeteve juridike efektive*, duke pasur parasysh se vendimet e ndërmjetme të sekuestros provuese, të zbatuara gjatë hetimeve paraprake, i janë nënshtruar kontrollit kushtetues duke u konsideruar si vendime përfundimtare, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës, për sa kohë ndërhyjnë në të drejtat kushtetuese individuale *(shih vendimet nr. 42, datë 01.07.2025; nr. 21, datë 22.04.2025 të Gjykatës Kushtetuese)*, si dhe faktin se kërkuesja pretendimet e saj në ankimin kushtetues individual i ka paraqitur më parë, në formë dhe në substancë, përpara gjykatave të zakonshme, Gjykata vlerëson se ajo nuk ka mjete të tjera juridike në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese përveç ankimit kushtetues individual, ndaj edhe ky kriter plotësohet.

21. Kërkuesja legjitimohet edhe *ratione temporis,* në kuptim të nenit 71/a, pika 1, shkronja "b", të Ligjit Organik të Gjykatës, pasi vendimi më i fundit në kohë i kundërshtuar, ai i Gjykatës së Lartë, mban datën 11.07.2024, ndërsa ankimi kushtetues individual është paraqitur në datën 08.11.2024, pra brenda afatit ligjor 4-mujor.

22. Për sa i takon legjitimimit *ratione materiae*, Gjykata vëren se kërkuesja ka pretenduar cenimin e së *drejtës për proces të rregullt ligjor* në drejtim të *parimit të sigurisë juridike, së drejtës për jetë private* në aspektin e *mbrojtjes të të dhënave personale* dhe *të korrespondencës,* si dhe *së drejtës së pronës private,* të lidhura me *parimin e proporcionalitetit*, pretendime të cilat përfshihen në juridiksionin kushtetues.

23. Për sa i përket pretendimit për cenimin e *së drejtës së pronës private,* sipas nenit 41 të Kushtetutës, Gjykata evidenton se kërkuesja nuk ka paraqitur ndonjë argument kushtetues në mbështetje të tij. Argumenti i saj konsiston në krijimin e vështirësive serioze për organizimin dhe vijimin e veprimtarisë së saj profesionale, duke e lidhur këtë jo me sekuestrimin e telefonit në vetvete, por me përmbajtjen e tij. Edhe gjatë gjykimit kushtetues ajo u përqendrua vetëm tek e drejta për mbrojtjen e të dhënave personale dhe fshehtësinë e korrespondencës. Për këto arsye, Gjykata çmon se ky pretendim nuk mund të merret në shqyrtim.

24. Në lidhje me *të drejtën për proces të rregullt ligjor*, Gjykata ka

theksuar se, përjashtimisht, në rastin e kontrollit të vendimeve që vendosin masa me karakter të ndërmjetëm ajo i trajton pretendimet e parashtruara në ankimin kushtetues individual në drejtim të të drejtave substanciale, ndërsa pretendimet që kanë të bëjnë me të drejtën për proces të rregullt ligjor i konsideron si aspekte procedurale të së drejtës substanciale të pretenduar të cenuar, ndaj, në këtë kuptim, ajo ndalet në elemente të veçanta të së drejtës për proces të rregullt ligjor, për sa ato mund të ndikojnë drejtpërdrejt në të drejtën substanciale në vetvete (*shih vendimet nr. 79, datë 12.11.2024; nr. 29, datë 16.04.2024; nr. 18, datë 19.03.2024 të Gjykatës Kushtetuese*).

25. Në rastin konkret, Gjykata vëren se, në aspektin procedural, kërkuesja ka pretenduar cenimin e *parimit të sigurisë juridike,* për shkak të moszbatimit nga GJKKO-ja e Apelit dhe Gjykata e Lartë të qëndrimit njësues të kësaj të fundit. Gjykata vlerëson se ky pretendim, pavarësisht se është ngritur në këndvështrim të nenit 42 të Kushtetutës, në thelb, lidhet me proporcionalitetin e ndërhyrjes, ndaj do të analizohet në drejtim të aspektit substancial të të drejtave kushtetuese të pretenduara të cenuara, mbrojtja e të cilave garantohet nga nenet 36 dhe 35 të Kushtetutës. Nga ana tjetër, në këndvështrim të garancive që parashikon neni 36 i Kushtetutës, Gjykata vëren se pretendimet e kërkueses në çështjen në shqyrtim nuk lidhen me cenimin e lirisë së korrespondencës, por me fshehtësinë e saj. Në thelb, pretendimet e kërkueses drejtohen ndaj masës hetimore të sekuestrimit të sendit "telefon celular" dhe aksesimit të përmbajtjes së tij përmes veprimit hetimor të ekspertimit teknik-elektronik, ku sipas kërkueses ruhen të dhëna personale dhe komunikime elektronike të saj, si dhe me mënyrën sesi Prokuroria e Posaçme, fillimisht, dhe më pas edhe gjykatat e zakonshme kanë interpretuar dispozitat penale procedurale të zbatueshme në rastin konkret.

26. Për sa u takon neneve 35 dhe 36 të Kushtetutës, Gjykata në jurisprudencën e saj i ka trajtuar ato në këndvështrim të së drejtës për jetë private, duke theksuar se kjo e fundit nuk mbrohet nga një dispozitë e vetme e Kushtetutës, por nga disa prej tyre, ndër të cilat përfshihet edhe neni 35, që bën fjalë për mbrojtjen e të dhënave personale, si dhe neni 36 që bën fjalë për lirinë dhe fshehtësinë e korrespondencës (*shih vendimet nr. 38, datë 02.12.2021; nr. 52, datë 01.12.2011; nr. 16, datë 11.11.2004 të Gjykatës Kushtetuese*).

27. Nga ana tjetër, sipas nenit 8 të KEDNJ-së, çdokush ka edhe të drejtën e respektimit të jetës private dhe autoriteti publik nuk mund të ndërhyjë në ushtrimin e kësaj të drejte, përveçse në shkallën e parashikuar nga ligji, kur është e nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë

publike, për mbrojtjen e rendit publik, shëndetit ose moralit, apo për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të të tjerëve. Gjykata i referohet KEDNJ-së, për rrjedhojë edhe jurisprudencës së GJEDNJ-së, jo vetëm për shkak të pretendimeve dhe argumenteve të sjella në një rast konkret, por edhe për shkak të vendit të privilegjuar që marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara zënë në hierarkinë e akteve normative në Republikën e Shqipërisë sipas neneve 116 dhe 122 të Kushtetutës. Për më tepër, për çështje që lidhen me kufizimet e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, KEDNJ-ja, në kuptim të nenit 17 të Kushtetutës, barazohet në rang me vetë Kushtetutën *(shih vendimin nr. 2, datë 29.01.2024 të Gjykatës Kushtetuese)*. Në këtë kuptim, Gjykata merr parasysh edhe jurisprudencën e GJEDNJ-së, e cila i ka konkretizuar standardet e KEDNJ-së nëpërmjet zbatimit të tyre në çështje të veçanta *(shih vendimin nr. 9, datë 23.03.2010 të Gjykatës Kushtetuese)*.

28. Për sa më sipër, duke mbajtur parasysh natyrën dhe thelbin e pretendimeve të kërkueses, Gjykata vlerëson që t'i shqyrtojë ato në themel në këndvështrim të *së drejtës për mbrojtjen e të dhënave personale*, të garantuar nga neni 35 i Kushtetutës dhe *të fshehtësisë së korrespondencës*, të garantuar nga neni 36 i saj. Për të vlerësuar nëse ka pasur ose jo cenim të të drejtave substanciale, Gjykata ka pohuar se niset nga arsyetimi i vendimeve të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, pasi, në zbatim të parimit të subsidiaritetit, u takon atyre gjykatave që, krahas zbatimit të ligjit material dhe procedural penal, të marrin në konsideratë edhe jurisprudencën e Gjykatës edhe të GJEDNJ-së në lidhje me parimin e proporcionalitetit, duke qenë Gjykata mjeti i fundit për mbrojtjen e këtyre të drejtave *(shih vendimet nr. 33, datë 20.05.2025; nr. 79, datë 12.11.2024; nr. 29, datë 16.04.2024 të Gjykatës Kushtetuese)*.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e së drejtës për mbrojtjen e të dhënave personale dhe fshehtësinë e korrespondencës

29. Kërkuesja pretendon se sekuestrimi i telefonit celular dhe ekspertimi pasues i tij i kanë cenuar të drejtën për mbrojtjen e të dhënave personale dhe fshehtësinë e korrespondencës, pasi telefoni është sekuestruar pa vendim gjykate, në kundërshtim me nenet 209 dhe 208/a të KPP-së dhe vendimin njësues nr. 147/2021, si dhe pa qenë të pranishme kushtet e urgjencës e të flagrancës, në kundërshtim me nenin 300 të KPP-së. Po sipas saj, sekuestrimi është kryer megjithëse nuk ishte person nën hetim, përveçse iu mohua prania e avokatit. Ndërhyrja, vijon ajo, nuk ka qenë e domosdoshme

dhe kanë ekzistuar masa më pak kufizuese për arritjen e qëllimit të ndjekur, të tilla, si: vijimi i këqyrjes nga OPGJ-të, kopjimi i të dhënave me rëndësi për hetimin ose sekuestrimin, por vetëm për një kohë të kufizuar (deri në një muaj), për aq sa ka qenë e nevojshme për këqyrjen dhe kopjimin e të dhënave në fjalë. Po sipas saj, sekuestrimi i telefonit dhe ekspertimi pasues i tij kanë qenë një masë joproporcionale në kuptimin e ngushtë. Vendimi i ekspertimit, shprehet ajo, është i përgjithshëm, evaziv dhe shumë i gjerë, pa përcaktuar të dhënat elektronike që i shërbenin hetimit dhe as masat specifike për mbrojtjen e të dhënave, duke sjellë aksesim të të gjitha të dhënave edhe pse vetëm një pjesë e vogël lidhej me hetimin, çka, sipas saj, konfirmohet edhe nga materiali i paraqitur në mbështetje të kërkesës për përjashtimin e gjyqtarit kushtetues, ndërkohë që telefoni nuk i është kthyer ende edhe pas më shumë se 1 viti e 4 muaj nga sekuestrimi.

30. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Posaçme, ka prapësuar se ndërhyrja në telefonin celular të kërkueses është në përputhje me standardet e jurisprudencës kushtetuese dhe të GJEDNJ-së. Sipas tij, ajo përmbush kriterin e ligjshmërisë, pasi sekuestrimi është kryer nga OPGJ-të në kushtet e urgjencës sipas nenit 300 të KPP-së dhe më pas është vleftësuar nga prokurori sipas nenit 301 të KPP-së, duke qenë i nevojshëm për shkak të kohës së gjatë që kërkonte vijimi i këqyrjes në vend dhe i rrezikut të fshirjes të të dhënave në telefonin e kërkueses dhe i pamundësisë së rikuperimit të tyre. Ndërhyrja, vijon ai, ndjek një qëllim legjitim, pikërisht mbledhjen e provave në një hetim për vepra të rënda, si korrupsioni dhe pastrimi i produkteve të veprës penale. Ajo ka qenë e domosdoshme dhe pa alternativa më të lehta, të cilat siguronin të njëjtin rezultat hetimor, edhe për shkak të volumit të madh të të dhënave dhe natyrës së brishtë të provës elektronike, e cila mund të zhduket menjëherë, në çast. Po kështu, vijon ai, ndërhyrja ka qenë proporcionale, e orientuar vetëm drejt të dhënave që lidhen me faktin penal dhe me personat e përfshirë, të cilat nuk janë bërë publike dhe do të përdoren vetëm për qëllime hetimore, duke mos qenë ajo e paarsyeshme ose arbitrare. Për më tepër, kërkuesja e ka dorëzuar vullnetarisht telefonin, duke nënshkruar pa vërejtje procesverbalin e këqyrjes dhe të sekuestrimit të tij. Pretendimet për gjyqtarin kushtetues, shprehet ai, lidhen me objektin e gjykimit të çështjes, duke mos tejkaluar asnjë normë. Mbajtja e telefonit nën sekuestro, si provë materiale, për aq sa është e domosdoshme për provimin e faktit penal dhe për të shmangur rrezikun e dëmtimit/zhdukjes ose nevojën për riekspertim gjatë hetimeve në vijim, është në përputhje edhe me vendimin njësues nr. 147/2021.

1) Për të drejtën e mbrojtjes të të dhënave personale

31. Neni 35 i Kushtetutës parashikon se askush nuk mund të detyrohet, përveçse kur e kërkon ligji, të bëjë publike të dhëna që lidhen me personin e tij dhe se mbledhja, përdorimi dhe bërja publike e të dhënave rreth personit bëhet me pëlqimin e tij, me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se e drejta për mbrojtjen e të dhënave personale, e garantuar nga neni 35 i Kushtetutës, përshkohet nga fryma se përpunimi i këtyre të dhënave duhet të bëhet duke respektuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut. Qëllimi i kushtetutëbërësit në parashikimin e kësaj dispozite kushtetuese ka qenë garantimi i një hapësire të nevojshme, brenda së cilës individi mund të zhvillojë në mënyrë të pavarur personalitetin e tij. Në këtë kuadër, është e drejtë e individit të vendosë vetë për mënyrën dhe masën e paraqitjes të të dhënave të tij personale përpara të tjerëve dhe publikut në tërësi *(shih vendimet nr. 20, datë 20.04.2021; nr. 16, datë 11.11.2004 të Gjykatës Kushtetuese)*. Po kështu, Gjykata ka pohuar se sanksionimi në këtë dispozitë i parimit të mosdetyrimit për bërjen publike të të dhënave personale përbën garanci kushtetuese *(shih vendimin nr. 52, datë 01.12.2011 të Gjykatës Kushtetuese).*

32. Nga ana tjetër, GJEDNJ-ja është shprehur se mbrojtja e të dhënave personale garantohet në kuadër të së drejtës për respektimin e jetës private sipas nenit 8 të KEDNJ-së. Sipas saj, mbrojtja e të dhënave personale është me rëndësi themelore për gëzimin e së drejtës për respektimin e jetës private dhe familjare dhe se kjo dispozitë parashikon të drejtën për një formë të vetëvendosjes informative, duke u lejuar individëve të mbështeten në të drejtën e tyre për privatësi, përfshirë edhe për ato të dhëna, të cilat, megjithëse asnjanëse, mblidhen, përpunohen dhe shpërndahen në mënyrë kolektive, në një formë ose mënyrë të tillë që mund të aktivizojnë të drejtat e tyre sipas nenit 8 *(shih L.B. kundër Hungarisë, datë 09.03.2023, § 103; Satakunnan Markkinapörssi Oy dhe Satamedia Oy kundër Finlandës*, *datë 27.06.2017, § 137*). Po kështu, GJEDNJ-ja ka theksuar se edhe natyra profesionale e aktiviteteve, të cilave u referohen të dhënat, nuk përjashton ekzistencën e së drejtës për privatësi *(shih Amann kundër Zvicrës [DhM], datë 16.02.2000, § 65; Rotaru kundër Rumanisë [DhM], datë 04.05.2000, § 43).*

33. Në veçanti, në lidhje me nocionin e të dhënave personale, GJEDNJ-ja i është referuar përkufizimit të dhënë nga Konventa nr. 108 e Këshillit të Evropës "Për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave personale" (CETS No. 108), e datës 28 janar 1981 *(Konventa për Mbrojtjen e të Dhënave Personale)*, sipas së cilës të dhënat

personale janë *"çdo informacion që lidhet me një individ të identifikuar ose të identifikueshëm" (shih L.B. kundër Hungarisë, datë 09.03.2023, § 42; Bernh Larsen Holding AS dhe të tjerë kundër Norvegjisë, datë 14.03.2013, § 76; Amann kundër Zvicrës, [DhM], datë 16.02.2000, § 65).* Kjo Konventë, bashkë me Protokollin e saj shtesë nr. 181 (ETS No. 181), të datës 08.11.2001, janë ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me ligjin nr. 9288, datë 07.10.2004, i ndryshuar, dhe me ligjin nr. 9287, datë 07.10.2004.

34. Në datën 10.10.2018 është hapur për nënshkrim Protokolli nr. 223 (CETS No. 223), i cili gjithashtu është ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me ligjin nr. 49/2022, datë 12.05.2022. Protokolli nr. 223 integron në një dokument të vetëm Konventën nr. 108 dhe Protokollin Shtesë nr. 181, me qëllim modernizimin dhe forcimin e zbatimit të tyre, për t'iu përgjigjur sfidave të reja dhe nevojës për të ruajtur rolin e rëndësishëm të Konventës në mbrojtjen e individëve nga përpunimi i të dhënave personale dhe, më gjerë, në mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe të lirive themelore. Gjykata i mban në konsideratë këto zhvillime legjislative, të cilat, edhe pse ende nuk kanë hyrë në fuqi, diktojnë nevojën për interpretim më rigoroz të garancive mbrojtëse për të dhënat personale dhe përpunimin e tyre.

35. Sipas ligjit nr. 9887/2008 në fuqi në kohën e ndodhjes së fakteve në çështjen në shqyrtim, "*të dhëna personale*" është çdo informacion në lidhje me një person fizik, të identifikuar ose të identifikueshëm, direkt ose indirekt, në veçanti duke iu referuar një numri identifikimi ose një a më shumë faktorëve të veçantë për identitetin e tij fizik, fiziologjik, mendor, ekonomik, kulturor ose social (neni 3, pika 1). Edhe sipas ligjit të ri nr. 124/2024, i cili ka hyrë në fuqi pas sekuestrimit të telefonit celular të kërkueses, konkretisht më 01.02.2025, "e dhënë personale" është çdo informacion në lidhje me një subjekt të dhënash (neni 5, pika 3), ndërsa *"subjekt i të dhënave"* është çdo person fizik i identifikuar ose i identifikueshëm dhe se një person është i identifikueshëm nëse mund të arrihet në identifikimin e tij, duke iu referuar drejtpërdrejt ose tërthorazi një ose disa faktorëve identifikues të veçantë, si: emri, numri i identifikimit, të dhënat për vendndodhjen, një identifikues në internet, ose një apo më shumë faktorëve specifikë lidhur me identitetin e tij fizik, fiziologjik, identitetin gjenetik, mendor, ekonomik, kulturor ose shoqëror (neni 5, pika 23).

36. Nga sa më lart, Gjykata vëren se neni 35 i Kushtetutës, në thelb, garanton të drejtën e individit për të vendosur në mënyrë autonome për mbledhjen, përdorimin dhe bërjen publike të informacionit që lidhet me

personin e tij. *E drejta për të vendosur vetë për informacionin personal* ka të bëjë me mënyrën dhe masën e paraqitjes, përpara të tjerëve dhe publikut në tërësi, të atij informacioni, përfshirë të dhënat personale, që ekspozon aspekte të jetës private të individit, si formë e shpalosjes së lirë të personalitetit njerëzor, e sanksionuar si vlerë kushtetuese edhe në Preambulën e Kushtetutës. Thënë ndryshe, kjo dispozitë garanton mbrojtjen e individit nga përpunimi i të dhënave në mënyrë të pakufizuar, duke i siguruar atij mundësinë për të vendosur vetë mbi përdorimin e të dhënave personale. Një mbrojtje e tillë nuk kushtëzohet nga forma e regjistrimit/dokumentimit dhe e ruajtjes të të dhënave personale, mjafton që ato të jenë të regjistruara dhe të ruajtura në një formë të atillë që mundëson mbledhjen, përpunimin, përdorimin ose publikimin e tyre. Në këtë kuptim, ajo garanton mbrojtjen e fshehtësisë të të dhënave personale, përfshirë edhe të atyre të regjistruara në formë elektronike në një pajisje inteligjente si telefoni celular. Në këtë kontekst, Gjykata vlerëson se edhe të dhënat personale që përmban një telefon celular në përdorim të një individi përfshihen në fushën e mbrojtjes të garantuar nga neni 35 i Kushtetutës.

2) Për të drejtën e fshehtësisë së korrespondencës

37. Neni 36 i Kushtetutës parashikon se edhe fshehtësia e korrespondencës ose e çdo mjeti tjetër të komunikimit janë të garantuara. Në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se kjo dispozitë kushtetuese mbron hapësirën brenda së cilës individi zhvillon personalitetin e tij dhe marrëdhëniet me individët e tjerë. Gjykata është shprehur se pjesë e korrespondencës janë edhe komunikimet e individit në ambiente publike me individë të tjerë në distancë që ai i bën me mesazhe të shkruara, zanore ose vizuale, duke përdorur pajisje kompjuterike, komunikime, të cilat mund të regjistrohen, filmohen ose fotografohen rastësisht gjatë zbatimit të masave të veçanta, veçanërisht të mbikëqyrjes vizuale *(shih vendimet nr. 30, datë 05.07.2021; nr. 52, datë 01.12.2011 të Gjykatës Kushtetuese)*.

38. Sipas GJEDNJ-së, e drejta për respektimin e korrespondencës sipas nenit 8 të Konventës synon të mbrojë konfidencialitetin e komunikimeve të një rangu të gjerë, përfshirë padyshim letrat me natyrë private ose profesionale *(shih Niemetz kundër Gjermanisë, datë 16.12.1992, § 32; Mehmet Nuri Özen dhe të tjerë kundër Turqisë, datë 11.11.2011, § 41; Nuh Uzun dhe të tjerë kundër Turqisë, datë 29.03.2022, § 80)* ose dhe pakot *(shih X kundër Mbretërisë së Bashkuar, vendim i Komisionit, datë 12.10.1978)*. Po kështu, ajo mbulon edhe forma të tjera komunikimi, si bisedat telefonike midis anëtarëve të familjes *(shih Margareta dhe Roger*

Andersson kundër Suedisë, datë 20.01.1992, § 72), ose me të tjerë *(shih Lüdi kundër Zvicrës, datë 15.06.1992, §§ 38-39; Azer Ahmadov kundër Azerbajxhanit, datë 22.07.2021, § 62),* pavarësisht nëse kanë ndodhur vetëm në një rast ose gjatë një periudhe të caktuar kohore. Ajo mbulon gjithashtu edhe komunikimet elektronike në format më të vjetra si telekset *(shih Christie kundër Mbretërisë së Bashkuar, vendimi i Komisionit, datë 27.06.1994),* mesazhet me pager *(shih Taylor-Sabori kundër Mbretërisë së Bashkuar, datë 22.10.2002)* ose transmetimet private radiofonike *(shih X dhe Y kundër Belgjikës, vendimi i Komisionit, datë 13.05.1982),* ashtu edhe ato në format më të reja. Lidhur me këto të fundit, GJEDNJ-ja ka pranuar se edhe teknologjitë e reja hyjnë në fushëveprimin e nenit 8 të KEDNJ-së, në veçanti të dhënat nga një telefon inteligjent/laptop dhe/ose kopja e tij pasqyrë *(shih Särgava kundër Estonisë, datë 16.11.2021),* mesazhet elektronike (e-mail-et) *(shih Copland kundër Mbretërisë së Bashkuar, datë 03.04.2007, §§ 41, 44),* SMS-të *(shih Saber kundër Norvegjisë, datë 17.12.2020, § 48)* mesazhet e çastit të dërguara dhe të marra nëpërmjet internetit *(shih Bărbulescu kundër Rumanisë [DhM], datë 05.09.2017, § 74),* si dhe të dhënat e ruajtura në serverët e kompjuterëve *(shih Grande Oriente d'Italia kundër Italisë, datë 19.12.2024, § 89),* duke përfshirë disqet e forta *(shih Petri Sallinen dhe të tjerë kundër Finlandës, datë 27.09.2005, § 71)* dhe disketat *(shih Iliya Stefanov kundër Bullgarisë, datë 22.05.2008, § 42).*

39. Legjislacioni në fuqi në kohën e ndodhjes së fakteve në çështjen në shqyrtim ka rregulluar edhe nocionet e mjetit, të komunikimit dhe të dokumentit elektronik, duke iu përshtatur zhvillimeve të teknologjisë së informacionit. Sipas ligjit nr. 9947, datë 07.07.2008 "Për pronësinë industriale", të ndryshuar, "*mjet elektronik*" është çdo mjet, me anë të të cilit mundësohet dërgimi fillestar i informacionit e marrja e tij nga marrësi i përcaktuar me anë të pajisjeve elektronike për përpunimin (duke përfshirë ngjeshjen shifrore) dhe ruajtja e të dhënave, tërësisht të transmetuara, të përcjella ose të marra përmes kabllove, valëve radio, mjeteve optike ose mjeteve të tjera elektromagnetike, përfshirë edhe internetin (*neni 4, pika 18*). Ndërsa sipas ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 "Për komunikimet elektronike", të ndryshuar, "*komunikim*" (elektronik) është shkëmbimi ose transmetimi i informacionit ndërmjet një numri të kufizuar përdoruesish të shërbimeve të komunikimeve elektronike (*neni 3, pika 13*). Po sipas tij, *"postë elektronike"* është çdo mesazh në formën e tekstit, tingullit ose imazhit, të dërguar nëpërmjet rrjetit publik të komunikimeve, i cili mund

të ruhet në rrjet ose në pajisjen fundore të marrësit derisa marrësi ta marrë atë (*neni 3, pika 34*), kurse "*pajisje fundore*" është pajisja e lidhur në pikën fundore të rrjetit, e cila shërben për transmetimin, marrjen dhe përpunimin e komunikimeve (*neni 3, pika 26*), ndërsa *"rrjet i komunikimeve publike"* është rrjeti i komunikimeve elektronike, që përdoret, tërësisht ose pjesërisht, për ofrimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike, të disponueshme për publikun (*neni 3, pika 37*).

40. Në vijim, sipas ligjit nr. 10273, datë 29.04.2010 "Për dokumentin elektronik", të ndryshuar, "*dokument elektronik*" është çdo informacion i krijuar me "cilësi dokumentare", i dërguar, i marrë ose i ruajtur në formë elektronike nga një sistem kompjuterik ose nga një mekanizëm i ngjashëm dhe që plotëson kushtet për vlefshmërinë, ndërsa përmbajtja e tij përfshin të gjitha format e të dhënave, e pasqyruar me shkronja, numra, simbole, zë dhe imazh (*neni 3, pika 1*). Po sipas tij, "*sistem kompjuterik*" është ai sistem, i cili përbëhet prej pajisjeve, grupi pajisjesh ose pajisje të lidhura, ku njëra ose më shumë prej tyre janë vazhduese dhe që kryejnë një proces automatik të transmetimit të të dhënave (*neni 3, pika 4*), kurse *"formë numerike"* është paraqitja e dokumentit elektronik në gjuhën shifrore të sistemit kompjuterik (*neni 3, pika 5*). Neni 8 i ligjit përcakton se dokumenti elektronik ka formën e paraqitjes së tij të brendshme, që është forma numerike, e përftuar nga përpunimi, dërgimi, marrja dhe ruajtja e dokumentit elektronik me një sistem programesh dhe pajisjesh kompjuterike, si dhe formën e paraqitjes së jashtme, që është paraqitja vizuale dhe e kuptueshme e përmbajtjes së tij në ekranin e kompjuterit ose në pajisje të tjera të ngjashme ose në letër, apo në mjete të tjera të materializuara, prodhuar nga forma e brendshme e paraqitjes së tij, ndërkohë që çdo dokument elektronik është unik (*neni 9, pika 1*).

41. Nga sa më lart, Gjykata vëren se koncepti kushtetues "*korrespondencë*" në nenin 36 të Kushtetutës mbulon çdo komunikim të individit në distancë, përmes çdo mjeti dhe mënyre që mundëson shkëmbimin ose transmetimin konfidencial të informacionit midis një numri të caktuar personash. Në mënyrën sesi është formuluar kjo dispozitë, ky koncept paraqitet i gjerë dhe gjithëpërfshirës, në kuptimin që përfshin çdo formë komunikimi të mendimit njerëzor (ide, qëllime, ndjenja, të dhëna, lajme) midis dy ose më shumë personave të përcaktuar, që kryhet në mënyrë të ndryshme nga biseda e personave të pranishëm. Fshehtësia e korrespondencës, sipas kësaj dispozite, nuk kushtëzohet nga përmbajtja dhe forma e pasqyrimit të saj dhe as nga mënyra dhe mjetet me të cilat korrespondenca kryhet.

Ajo garanton mbrojtje gjithëpërfshirëse të çdo komunikimi njerëzor në distancë. Prandaj, si rregull, shkëmbimi i mesazheve elektronike, qoftë përmes postës elektronike (e-mail), ashtu edhe ato tekst (SMS, MMS) përmes rrjeteve telefonike të lëvizshme ose përmes aplikacioneve në internet (të tilla si Whatsapp dhe të tjera të ngjashme), të ashtuquajtura sisteme të mesazheve të çastit, është në vetvete një formë korrespondence dhe përfshihet në sferën e mbrojtjes së nenit 36 të Kushtetutës, për sa kohë ky shkëmbim synon komunikimin e mendimit njerëzor në mënyrë ekuivalente me korrespondencën tradicionale dhe telegrafike përmes letrave, zarfeve dhe pakove të vulosura ose telegrameve postare.

42. Gjykata çmon të theksojë se e drejta kushtetuese për fshehtësinë e korrespondencës përfshin mbrojtjen e interesit të individit që shteti ose një palë e tretë e paautorizuar të mos mësojë përmbajtjen e komunikimit dhe të çdo informacioni tjetër për të, sikundër edhe interesin e tij (individit) për të pasur kontroll dhe liri për të vendosur se kujt, në çfarë mase, në çfarë mënyre dhe në çfarë kushtesh do t'ia transmetojë një informacion të caktuar. Në këtë kuptim, mbrojtja e ofruar nga neni 36 i Kushtetutës ka në qendër komunikimin në distancë të individit dhe është e pavarur nga karakteristikat e mjeteve teknike të përdorura për transmetimin e mendimeve njerëzore. Garancia, sipas saj, shtrihet në çdo mjet që zhvillimet teknologjike e bëjnë të disponueshëm për qëllime komunikimi, përfshirë edhe ato mjete elektronike, të cilat kanë qenë të panjohura në kohën e miratimit të Kushtetutës.

43. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se edhe komunikimi ose korrespondenca elektronike përmes teknologjive të reja të informacionit, përfshirë edhe atë nëpërmjet një telefoni inteligjent (telefoni celular), bie plotësisht në fushën e mbrojtjes së nenit 36 të Kushtetutës, duke u shfaqur ajo tërësisht e krahasueshme me korrespondencën fizike përmes letrave ose shënimeve të vulosura.

44. Gjykata, pasi më lart vlerësoi se të dhënat personale të regjistruara në formë elektronike dhe komunikimi ose korrespondenca elektronike, përmes një pajisjeje inteligjente, si telefoni celular, përfshihen në fushën e mbrojtjes sipas neneve 35 dhe 36 të Kushtetutës, do ta analizojë çështjen në drejtim të së drejtës për të vendosur vetë për informacionin personal të lidhur me të dhënat personale dhe të fshehtësisë së korrespondencës, në këndvështrim të këtyre dispozitave të Kushtetutës dhe të nenit 8 të KEDNJ-së.

45. Për t'u dhënë përgjigje pretendimeve të kërkueses për cenimin e të drejtave kushtetuese të garantuara nga nenet 35 dhe 36 të Kushtetutës,

si dhe nga neni 8 i KEDNJ-së, Gjykata, duke mbajtur në konsideratë edhe jurisprudencën e GJEDNJ-së, do të shqyrtojë fillimisht nëse ka pasur ndërhyrje në të drejtën e kërkueses për të vendosur vetë për informacionin personal të lidhur me të dhënat personale dhe për fshehtësinë e korrespondencës, si dhe ku konsiston ajo. Në vijim, nëse konstaton se ka pasur ndërhyrje, ajo do të shqyrtojë nëse ndërhyrja në këndvështrim të nenit 17 të Kushtetutës, ka qenë e justifikuar, që do të thotë nëse ajo ka qenë në përputhje me ligjin, nëse ka ndjekur një qëllim të ligjshëm dhe nëse ka qenë proporcionale, domethënë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë.

a) Nëse ka pasur ndërhyrje

46. Gjykata vëren se kërkuesja pretendon se telefoni i saj celular është sekuestruar nga OPGJ-të dhe organi procedues, në vijim, përmes veprimit hetimor të ekspertimit teknik-elektronik, ka aksesuar përmbajtjen e tij. Sipas saj, në telefon gjenden komunikime, por edhe foto, të dhëna kontakti, informacion për faqe interneti të klikuara dhe të dhëna të tjera personale, përfshirë edhe të dhëna shëndetësore të pacientëve të trajtuar në institucionin mjekësor privat ku ajo punonte, të cilat, sipas legjislacionit në fuqi, përbëjnë të dhëna sensitive.

47. Nga ana tjetër, subjekti i interesuar pranon se OPGJ-të kanë ndërmarrë masën hetimore të sekuestrimit provues të sendit "telefon celular" të kërkueses dhe se, në vijim, është kryer edhe veprimi hetimor i ekspertimit teknik-elektronik të tij, përmes të cilit janë ekstraktuar dhe kopjuar në një pajisje të jashtme të dhënat e memorizuara në telefon. Materiali më tej po u nënshtrohet këqyrjeve vetëm për ato të dhëna që lidhen me objektin e hetimit penal dhe ato do të dokumentohen me procesverbal. Ai nuk kundërshton pretendimet e kërkueses për llojin dhe natyrën e të dhënave të memorizuara në telefonin e sekuestruar asaj.

48. Gjykata vëren se neni 35, pika 2, i Kushtetutës në lidhje me të dhënat personale ka identifikuar si ndërhyrje në të drejtën e individit për të vendosur vetë për informacionin personal lidhur me mbledhjen, përdorimin dhe bërjen publike të tyre. Ndërkohë, GJEDNJ-ja, në këtë drejtim, i është referuar Konventës për Mbrojtjen e të Dhënave Personale në lidhje me nocionin e "përpunimit automatik", që përfshin operacionet, e kryera plotësisht ose pjesërisht më anë të mjeteve automatike, për: ruajtjen e të dhënave, kryerjen e veprimeve logjike dhe/ose aritmetike mbi to, ndryshimin, fshirjen, marrjen ose shpërndarjen e tyre (neni 2, shkronja "c"). Sipas ligjit kuadër për mbrojtjen e të dhënave personale (ligjit nr.

9887/2008, në fuqi në kohën e ndodhjes së fakteve në çështjen në shqyrtim), "*përpunim i të dhënave personale*" është çdo veprim ose grup veprimesh, të cilat janë kryer mbi të dhënat personale, me mjete automatike ose jo, të tilla, si: mbledhja, regjistrimi, organizimi, ruajtja, përshtatja ose ndryshimi, rikthimi, konsultimi, shfrytëzimi, transmetimi, shpërndarja ose ndryshe duke vënë në dispozicion, shtrirja ose kombinimi, fotografimi, pasqyrimi, hedhja, plotësimi, seleksionimi, bllokimi, asgjësimi ose shkatërrimi, edhe në qoftë se nuk janë të regjistruara në një bankë të dhënash (neni 3, pika 12). Ndërsa sipas ligjit të ri për mbrojtjen e të dhënave personale (ligji nr. 124/2024) "*përpunim*" është çdo veprim ose një grup veprimesh që kryhet mbi të dhënat personale ose grupe të dhënash personale, pavarësisht nëse kryhen me mjete të automatizuara ose jo, të tilla, si: mbledhja, regjistrimi, organizimi, strukturimi, ruajtja, përshtatja ose ndryshimi, rikthimi, konsultimi, përdorimi, përhapja me anë të transmetimit, shpërndarjes ose vënies në dispozicion në ndonjë mënyrë tjetër, lidhja ose kombinimi, kufizimi, fshirja ose shkatërrimi (neni 5, pika 16).

49. Në lidhje me fshehtësinë e korrespondencës, sipas GJEDNJ-së, si shembuj të "ndërhyrjes" së mundshme janë edhe shqyrtimi i korrespondencës *(shih Campbell kundër Mbretërisë së Bashkuar, datë 25.03.1992, § 33),* bërja e kopjeve *(shih Foxley kundër Mbretërisë së Bashkuar, datë 20.06.2000, § 30),* sekuestrimi i një telefoni inteligjent dhe laptopit të aplikantit, kopjimi i përmbajtjes së plotë të tyre në një *hard disk* të jashtëm dhe kontrolli i kopjes së tij pasqyrë *(shih Saber kundër Norvegjisë, datë 17.12.2020, § 48; Särgava kundër Estonisë, datë 16.11.2021),* ruajtja e të dhënave në lidhje me përdorimin e telefonit, *e-mail*-it dhe internetit *(shih Copland kundër Mbretërisë së Bashkuar, datë 03.04.2007, § 44),* pa pasur rëndësi nëse të dhëna të tilla janë marrë në mënyrë të ligjshme ose nëse informacioni nuk u është zbuluar palëve të treta, ose nuk është përdorur në procedura të tjera kundër personit në fjalë *(shih po aty, § 43)*, kopjimi i skedarëve elektronikë, përfshirë edhe ato që u përkasin kompanive *(shih Bernh Larsen Holding AS dhe të tjerë kundër Norvegjisë, datë 14.03.2013, § 106),* si dhe sekuestrimi i dokumenteve në letër dhe digjitale, përfshirë edhe ato të një shoqate *(shih Grande Oriente d'Italia kundër Italisë, datë 19.12.2024, § 91).*

50. Nga sa më lart, Gjykata vëren se në rastin konkret, subjekti i interesuar, Prokuroria e Posaçme, në kuadër të hetimit të një procedimi penal, ka zbatuar një masë hetimore, sikurse është sekuestrimi i telefonit celular të kërkueses dhe, më pas, e ka aksesuar atë duke ekstraktuar (nxjerrë), kopjuar

dhe ruajtur të dhënat që ai përmbante, me qëllim kërkimin e mëvonshëm dhe marrjen e atyre të dhënave që paraqesin rëndësi për hetimin.

51. Në këtë pikë, Gjykata çmon të theksojë se masa e sekuestrimit të telefonit celular të kërkueses, e zbatuar me qëllim zbulimin dhe marrjen e të dhënave të memorizuara që paraqesin rëndësi për hetimin, pra për sigurimin e provave për vërtetimin e fakteve të hetimit penal, nuk është thjesht një sekuestrim i një objekti (sendi) në vetvete. Duke pasur parasysh se telefoni celular shërben edhe për ruajtjen, përpunimin dhe shpërndarjen e informacioneve në distancë, se përdorimi i gjerë i formave të reja të komunikimit ka ndryshuar mënyrën sesi individët i perceptojnë dhe ruajnë të dhënat e tyre personale dhe se telefonat inteligjentë praktikisht janë shndërruar në "një arkiv", ku individët ruajnë informacionin personal që u përket jo vetëm atyre, por edhe palëve të treta, sekuestrimi i telefonit në rastin konkret përbën, po ashtu, edhe sekuestrim të të dhënave të ruajtura në të, përfshirë të dhënat personale dhe korrespondencën e kërkueses.

52. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se ka pasur ndërhyrje në të drejtën e kërkueses për të vendosur vetë për informacionin personal të lidhur me të dhënat personale dhe në fshehtësinë e korrespondencës në kuptim të neneve 35 dhe 36 të Kushtetutës, si dhe të nenit 8 të KEDNJ-së. Kjo ndërhyrje ka konsistuar në sekuestrimin e telefonit të saj celular dhe të të dhënave (elektronike) personale dhe të korrespondencës, si dhe aksesimin e telefonit në vijim përmes kopjimit dhe ruajtjes të të dhënat që ai përmbante.

b) Nëse ndërhyrja ka qenë e justifikuar

53. Gjykata, në vijim të analizës së parashtruar në paragrafin 45 të këtij vendimi, do të ndalet në analizën nëse ndërhyrja në të drejtën e kërkueses për të vendosur vetë për informacionin personal të lidhur me të dhënat personale dhe fshehtësinë e korrespondencës është e justifikuar, pra respekton kriteret kushtetuese të kufizimit, në kuptim të nenit 17 të Kushtetutës dhe ato të përcaktuara në jurisprudencën e GJEDNJ-së.

i) Nëse ndërhyrja ka qenë në përputhje me ligjin

54. Gjykata vëren se kërkuesja pretendon se sekuestrimi i telefonit të saj celular është kryer pa vendim të gjykatës, në kundërshtim me ligjin, konkretisht me nenin 209 të lidhur me nenin 208/a të KPP-së, si dhe me vendimin njësues nr. 147/2021. Po kështu, vijon ajo, sekuestrimi i telefonit me iniciativë nga OPGJ-të është kryer pa ekzistuar kushtet e urgjencës dhe të flagrancës, në kundërshtim me nenin 300 të KPP-së. Po sipas saj, ky sekuestrim është kryer megjithëse ajo nuk ishte as person nën hetim.

55. Nga ana tjetër, subjekti i interesuar ka prapësuar se sekuestrimi i telefonit celular të kërkueses është kryer në përputhje me ligjin, në bazë të nenit 300 të KPP-së, që u jep OPGJ-ve të drejtën për të sekuestruar, me iniciativë, në kushtet e urgjencës, sende që lidhen me veprën penale. Ky sekuestrim, vijon ai, është vleftësuar më pas nga prokurori në përputhje me nenin 301 të KPP-së. Sipas subjektit të interesuar, sekuestrimi nga OPGJ-të është realizuar për shkak se vazhdimi i këqyrjes të të dhënave në telefon kërkonte kohë të gjatë, ndërkohë që ndërhyrja e prokurorit ka qenë e pamundur, sepse kishte kaluar orari zyrtar. Në rast mosveprimi nga OPGJ-të, shprehet subjekti i interesuar, ka ekzistuar rreziku i fshirjes të të dhënave në telefonin e kërkueses dhe i pamundësisë së rikuperimit të tyre. Për më tepër, kërkuesja ka dorëzuar me dëshirën e saj telefonin celular dhe në vijim ka nënshkruar pa vërejtje procesverbalin e sekuestrimit të tij. Edhe jurisprudenca e GJEDNJ-së e ka konsideruar të ligjshme masën e sekuestrimit të pajisjeve elektronike, kur ajo ndihmon për zbulimin e fakteve të rëndësishme për hetimin penal.

56. Gjykata vëren se neni 35 i Kushtetutës, që garanton mbrojtjen nga përpunimi i të dhënave personale, parashikon se ndërhyrja në këtë të drejtë kushtetuese bëhet me pëlqimin e individit, me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj. Ndërsa neni 36 i Kushtetutës, që garanton fshehtësinë e korrespondencës, nuk përmban rregullime procedurale në rastet e ndërhyrjeve në këtë të drejtë kushtetuese.

57. Çështja në shqyrtim, siç u parashtrua më lart, lidhet me masën hetimore të sekuestrimit të telefonit të celular të kërkueses, që ka synuar zbulimin dhe marrjen e të dhënave të memorizuara në të dhe me rëndësi për hetimin. Nisur nga kjo, masa ka të bëjë me mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave personale e të korrespondencës dhe mbrojtjen e privatësisë në fushën penale. Në këtë fushë, kërkimi dhe marrja e provave u nënshtrohen rregullimeve të KPP-së. Po kështu, për përpunimin e të dhënave personale edhe në kuadër të veprimtarive të parandalimit dhe ndjekjes penale, zbatohet edhe ligji kuadër për mbrojtjen e të dhënave personale, referuar për këtë nenit 4, pika 3/1, në lidhje me nenin 6, pika 2, të ligjit nr. 9887/2008, në fuqi në kohën e ndodhjes së fakteve në çështjen në shqyrtim apo Pjesës III, nenet 47-74, të ligjit nr. 124/2024, në fuqi aktualisht.

58. Përpara se të shqyrtojë nëse ndërhyrja në të drejtat e kërkueses ka qenë në përputhje me ligjin, Gjykata e sheh të nevojshme të ndalet fillimisht në prapësimin e subjektit të interesuar, sipas të cilit ajo ka dorëzuar vullnetarisht telefonin dhe ka nënshkruar pa vërejtje procesverbalin e

sekuestrimit. Këtë sjellje të kërkueses subjekti i interesuar duket se e paraqet për të treguar se ndërhyrja në të drejtat kushtetuese është kryer me pëlqimin e saj, duke qenë kështu përpara një ndërhyrjeje të lejueshme dhe në përputhje me Kushtetutën.

i.1) Nëse ndërhyrja është kryer me pëlqimin e kërkueses

59. Në lidhje me këtë, GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka arritur në përfundimin se dorëzimi i telefonit celular nga kërkuesja, e cila nuk është lejuar të konsultohet paraprakisht me avokatin dhe nuk është vënë në dijeni për të drejtën për të mos e dorëzuar telefonin për këqyrje dhe sekuestrim, referuar jurisprudencës së GJEDNJ-së, nuk përbën heqje dorë nga e drejta për jetë private dhe fshehtësia e korrespondencës. Ky përfundim është gjetur i gabuar nga Gjykata e Lartë, e cila ka arsyetuar se, në rastin konkret, nuk kemi të bëjmë me kontroll të kërkueses, por me vënien në dispozicion, nga vetë ajo, të telefonit celular, pa ndonjë kundërshtim. Megjithatë, të dyja gjykatat më të larta, në vendimet e kundërshtuara, nuk e kanë bazuar refuzimin e ankimit të kërkueses në arsyetimin se ndërhyrja në të drejtat e saj është kryer me pëlqimin e saj.

60. Lidhur me faktin se kërkuesja ka dorëzuar vullnetarisht telefonin celular dhe ka nënshkruar pa vërejtje procesverbalin e sekuestrimit, Gjykata vlerëson të shqyrtojë nëse ky veprim përbën heqje dorë nga të drejtat kushtetuese, pra nëse përbën dhënie pëlqimi për marrjen dhe përpunimin e të dhënave personale dhe të korrespondencës të memorizuara në telefon. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka pohuar se heqja dorë nga një e drejtë themelore mund të bëhet vetëm në bazë të pëlqimit të informuar, pra kur subjekti ka njohuri të plota për faktet relevante. Heqja dorë jo vetëm që duhet të jetë vullnetare, por edhe e vetëdijshme dhe inteligjente, përveçse duhet të shoqërohet dhe me garanci minimale në përpjesëtim me rëndësinë e së drejtës *(shih vendimin nr. 42, datë 01.07.2025 të Gjykatës Kushtetuese)*.

61. Në rastin konkret, referuar akteve, sikurse pranohet edhe nga palët, kërkuesja është pyetur si person që ka dijeni për veprën penale për fakte që lidheshin me persona të caktuar. Pas përfundimit të pyetjes, prokurorët kanë urdhëruar këqyrjen e telefonit të saj celular. Ky vendim i është njoftuar kërkueses dhe OPGJ-të në vijim kanë kryer këqyrjen e komunikimeve të memorizuara në telefon. Ndonëse nuk ekziston ndonjë akt i veçantë për dorëzimin e telefonit nga kërkuesja me qëllim këqyrjen e tij dhe as dokumentimi i dhënies nga ajo të pëlqimit për kryerjen e këtij veprimi, kërkuesja pranon se nuk e ka kundërshtuar këqyrjen e telefonit për komunikimet e saj me persona që lidheshin me hetimin dhe as ka

pretendime në lidhje me këtë. Ajo, po ashtu, ka nënshkruar pa vërejtje edhe procesverbalin e këqyrjes. Pas 1 ore e 18 minutash OPGJ-të kanë ndërprerë këqyrjen e telefonit dhe kanë vendosur sekuestrimin e tij, ndërkohë që pajisja në atë moment posedohej nga ata. Më pas, prokurorët kanë vendosur kryerjen e ekspertimit teknik-elektronik të telefonit dhe ekspertët e kanë realizuar atë. Megjithatë, kërkuesja është njohur me vendimin e ekspertimit vetëm gjatë procesit gjyqësor në gjykatat e zakonshme.

62. Në rrethanat si më lart, Gjykata vëren se nuk ka ndonjë të dhënë që të tregojë se në rastin konkret janë respektuar kushtet për një heqje dorë të vlefshme nga të drejtat kushtetuese. Nuk rezulton e dokumentuar që kërkuesja është informuar paraprakisht dhe plotësisht për të drejtën e saj për të refuzuar, qoftë edhe pjesërisht, marrjen dhe aksesimin, me qëllim përpunimin e mëtejshëm të të dhënave personale dhe të korrespondencës të memorizuara në telefon, dhe as për pasojat që do të sillte dhënia e një pëlqimi të tillë. Për më tepër, edhe pse kërkuesja ka kërkuar praninë e avokatit për t'u këshilluar për masat dhe veprimet hetimore që po ndërmerreshin ndaj saj, një kërkesë e tillë nuk është pranuar. Po kështu, nuk del qartë nëse ndonjë heqje dorë e mundshme nga e drejta për të vendosur vetë për informacionin personal të lidhur me të dhënat personale dhe nga fshehtësia e korrespondencës ka qenë e ndërgjegjshme dhe e arsyeshme, në drejtim të shprehjes së vullnetit të lirë, pas kuptimit të plotë të rëndësisë së veprimit dhe të pasojave të tij. Në këtë këndvështrim, prapësimi i subjektit të interesuar, Prokurorisë së Posaçme, se kërkuesja ka dorëzuar me dëshirë telefonin dhe ka nënshkruar pa vërejtje procesverbalin e sekuestrimit të tij, nuk mjafton për të arritur në përfundimin se kemi një shfaqje të qartë dhe të padyshimtë të vullnetit të saj për dhënien e pëlqimit për marrjen dhe aksesimin, me qëllim përpunimin e mëtejshëm të të dhënave personale dhe të korrespondencës, të memorizuara në telefonin e saj.

63. Në këtë drejtim, Gjykata çmon të analizojë nocionin "*pëlqim*" në nenin 35, pika 2, të Kushtetutës, që është detajuar në ligjin kuadër për mbrojtjen e të dhënave personale *(shih paragrafin 35 të vendimit)*. Kështu, ligji nr. 9887/2008, në fuqi në kohën e ndodhjes së fakteve në çështjen në shqyrtim, parashikonte se "pëlqim i subjekteve të të dhënave" është çdo deklaratë me shkrim, e dhënë shprehimisht me vullnet të plotë e të lirë dhe duke qenë në dijeni të plotë për arsyen pse të dhënat do të përpunohen, çka nënkupton që subjekti i të dhënave pranon që të përpunohen të dhënat e tij. Ndërsa sipas ligjit nr. 124/2024, aktualisht në fuqi, "pëlqim" përkufizohet si çdo element tregues i vullnetit të subjektit të të dhënave, i dhënë lirisht,

i informuar dhe i qartë, nëpërmjet të cilit ai, me anë të një deklarate ose me çdo lloj shfaqjeje tjetër të padyshimtë pohuese të vullnetit, shpreh dakordësinë për përpunimin e të dhënave personale që lidhen me të për një ose më shumë qëllime specifike. Ky ligj është përafruar plotësisht me rregulloren (BE) nr. 679/2016 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 27 prill 2016, për mbrojtjen e personave fizikë në lidhje me përpunimin e të dhënave personale dhe për lëvizjen e lirë të këtyre të dhënave dhe shfuqizimin e direktivës 95/46/EC, si dhe me direktivën nr. 680/2016 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 27 prill 2016 për mbrojtjen e personave fizikë në lidhje me përpunimin e të dhënave personale nga autoritetet kompetente, me qëllim parandalimin, hetimin, zbulimin, ndjekjen penale të veprave penale ose ekzekutimin e dënimeve penale dhe për lëvizjen e lirë të këtyre të dhënave dhe shfuqizimin e vendimit kornizë të Këshillit 2008/977/JHA.

64. Për sa më lart, Gjykata vlerëson se ndërhyrja në të drejtat e kërkueses në rastin konkret nuk mund të konsiderohet e kryer me pëlqimin e saj. Për këtë arsye, për të nxjerrë përfundimin nëse ndërhyrja është bërë në përputhje me ligjin, Gjykata çmon se duhet analizuar nëse ndërhyrja pa pëlqimin e individit autorizohet nga ligji.

i.2) Nëse ndërhyrja autorizohet nga ligji

65. Sikurse u theksua më lart, nenet 35 dhe 36 të Kushtetutës nuk përmbajnë rregullime procedurale për rastet dhe garancitë e ndërhyrjeve në të drejtat e mbrojtura nga ato. Në nenin 35 të Kushtetutës, ato i janë deleguar ligjvënësit të zakonshëm. Ndërkohë, neni 17 i Kushtetutës, parashikon mundësinë e kufizimit të të drejtave dhe lirive kushtetuese vetëm me ligj. Edhe GJEDNJ-ja në jurisprudencën e saj mbi nenin 8 të KEDNJ-së, që mbulon të drejtën për jetë private, përfshirë të dhënat personale dhe korrespondencën, ka vlerësuar se kjo e drejtë nuk është absolute, por mund të kufizohet në funksion të imperativave të tjera legjitime. Sipas saj, kjo dispozitë mbron, në thelb, individin nga ndërhyrjet arbitrare nga autoritetet publike dhe çdo ndërhyrje duhet të jetë në përputhje me ligjin *(shih Vavřička dhe të tjerë kundër Republikës Çeke [DhM], datë 08.04.2021, §§ 266-269).*

66. Nën dritën e sa më sipër, Gjykata vlerëson se të drejtat kushtetuese të mbrojtura nga nenet 35 dhe 36 të Kushtetutës nuk janë absolute, por duhet të merren në konsideratë në lidhje me funksionin e tyre në shoqëri dhe të balancohen kundrejt të drejtave të tjera themelore. Ato mund t'iu nënshtrohen kufizimeve në rastet e parashikuara me ligj, duke respektuar thelbin e këtyre të drejtave themelore dhe parimin e proporcionalitetit.

67. Në çështjen në shqyrtim, siç u parashtrua më lart, ndërhyrja në të drejtat kushtetuese të kërkueses ka konsistuar në zbatimin e masës hetimore të sekuestrimit të telefonit të celular, me synimin e zbulimit dhe marrjes të të dhënave të memorizuara me rëndësi për hetimin. Sipas procesverbalit të sekuestrimit, OPGJ-të, në zbatimin e kësaj mase, janë mbështetur në nenin 300 të KPP-së, që rregullon veprimet e ngutshme me iniciativë të Policisë Gjyqësore. Sekuestrimi në këtë rast është vleftësuar më pas si i ligjshëm nga prokurorët, mbështetur në nenin 301 të KPP-së. Subjekti i interesuar pranon se në rastin konkret është zbatuar masa e sekuestrimit provues, që rregullohet nga nenet 208-220 të KPP-së.

68. Gjithashtu, ndërhyrja ka konsistuar edhe në aksesimin e telefonit, përmes ekstraktimit, kopjimit dhe ruajtjes në një pajisje të jashtme të të dhënave që ai përmbante, me qëllim kërkimin e mëvonshëm dhe marrjen e atyre të dhënave që paraqesin rëndësi për hetimin. Kjo është realizuar nëpërmjet vendimit të prokurorëve për kryerjen e ekspertimit teknik-elektronik të telefonit dhe përmes vetë ekspertimit të realizuar, që ka konsistuar në ekstraktimin, kopjimin dhe ruajtjen e të dhënave që ai përmbante. Vendimi i ekspertimit është bazuar në nenet 178 e vijues dhe 314 të KPP-së.

69. Për t'u dhënë zgjidhje çështjeve të ngritura në gjykimin kushtetues, Gjykata vlerëson të analizojë fillimisht dispozitat ligjore dhe praktikën gjyqësore të lidhur me to.

70. Për sa i përket sekuestrimit provues, Gjykata ka theksuar më parë se ai rregullohet në nenet 208-220 të KPP-së dhe mund të vendoset nga gjyqtari ose prokurori, me vendim të arsyetuar, për sekuestrimin e provave materiale dhe të sendeve që lidhen me veprën penale kur ato janë të domosdoshme për vërtetimin e fakteve. Sekuestrimi provues është mjet për kërkimin e provës dhe paraqitet si një masë hetimore procedurale autonome, por në praktikë shpesh shoqëron ose pason një masë kontrolli ose këqyrjeje, pasi përmes këtyre të fundit mund të gjenden sende, dokumente ose diçka tjetër që duhen sekuestruar *(shih vendimin nr. 42, datë 01.07.2025 të Gjykatës Kushtetuese).*

71. Gjykata konstaton se KPP-ja parashikon në mënyrë të veçantë sekuestrimin e të dhënave kompjuterike, sekuestrimin e korrespondencës, sekuestrimin pranë bankave dhe sekuestrimin në zyrat e shërbimeve informative.

72. Në lidhje me masën e *sekuestrimit të të dhënave kompjuterike,* ajo është përfshirë në kuadër të transpozimit të Konventës së Këshillit

të Evropës për Krimet Kibernetike, ratifikuar me ligjin nr. 8888, datë 25.04.2002. Kështu, neni 208/a i KPP-së (shtuar në vitin 2008), në rastin e procedimeve për krime që lidhen me teknologjinë e informacionit, parashikon sekuestrimin e të dhënave ose sistemeve kompjuterike me vendim të gjykatës, ku përcaktohet e drejta për të hyrë, kërkuar dhe marrë të dhënat kompjuterike në sistemin kompjuterik, si dhe ndalimi për kryerjen e veprimeve të mëtejshme ose sigurimi i të dhënave apo i sistemit kompjuterik (*pika 1*). Kur ka shkaqe të arsyeshme për të menduar se të dhënat e kërkuara janë memorizuar në një sistem tjetër kompjuterik ose në një pjesë të tij dhe këto të dhëna janë në mënyrë të ligjshme të kapshme prej ose janë të disponueshme nga sistemi kompjuterik fillestar, që kontrollohet, gjykata, me kërkesë të prokurorit, urdhëron menjëherë kërkimin ose hyrjen edhe në këtë sistem kompjuterik (*pika 2*). Në zbatim të vendimit të gjykatës, prokuroria ose OPGJ-ja, i deleguar nga prokurori, merr masa për: a) ndalimin e veprimeve të mëtejshme ose sigurimin e sistemit kompjuterik, vetëm të një pjese të tij ose të një mjeti tjetër memorizimi të dhënash; b) nxjerrjen dhe marrjen e kopjeve të të dhënave kompjuterike; c) pengimin e hyrjes në të dhënat kompjuterike ose heqjen e tyre nga sistemet kompjuterike me të drejtë hyrjeje; ç) sigurimin e paprekshmërisë të të dhënave përkatëse, të memorizuara (*pika 3*). Për zbatimin e këtyre veprimeve, prokurori mund të thërrasë ekspert me njohuri për sistemet kompjuterike apo për masat mbrojtëse të të dhënave kompjuterike (*pika 4*).

73. Në lidhje me *sekuestrimin e korrespondencës*, Gjykata konstaton se neni 209 i KPP-së përcakton se, kur ka arsye të bazuara për të menduar se në zyrat postare ose telegrafike gjenden letra, letra me vlerë, zarfe, pako, telegrame dhe objekte të tjera të korrespondencës, të dërguara nga i pandehuri ose që i drejtohen atij, qoftë edhe me emër tjetër ose nëpërmjet një personi tjetër, gjykata vendos sekuestrimin e tyre (*pika 1*). Kur sekuestrimin e kryen OPGJ-ja, ai duhet t'i dorëzojë objektet e sekuestruara të korrespondencës organit gjyqësor, pa i hapur dhe pa u njohur me ndonjë mënyrë tjetër me përmbajtjen e tyre (*pika 2*). Kur objektet e sekuestruara nuk hyjnë në korrespondencën e sekuestrueshme, ato i kthehen personit që i përkasin dhe nuk mund të përdoren (*pika 3*).

74. Ndërsa neni 210 i KPP-së, për *sekuestrimin pranë bankave*, parashikon se gjykata mund të vendosë sekuestrimin, ndër të tjera, të dokumenteve, letrave me vlerë dhe çdo gjëje tjetër, përfshirë edhe ato në kaseta sigurie, kur ka arsye të bazuara për të menduar se lidhen me veprën penale, edhe nëse nuk i përkasin të pandehurit ose nuk janë në

emër të tij, ndërkohë që në raste të ngutshme ky vendim mund të merret nga prokurori.

75. Përsa i përket ekspertimit, Gjykata, po ashtu, konstaton se ai, si provë, rregullohet nga nenet 178 - 186 të KPP-së. Sipas nenit 178, ekspertimi lejohet kur është i nevojshëm zhvillimi i kërkimeve, marrja e të dhënave ose i vlerësimeve që kërkojnë njohuri të posaçme teknike, shkencore ose kulturore (*pika 1*). Eksperti caktohet me vendim të organit procedues, i cili i njoftohet të pandehurit ose mbrojtësit të tij (*neni 179, pika 2*). Vendimi i ekspertimit duhet të jetë i motivuar (*neni 182, pika 1*) dhe të përmbajë edhe kërkesat e ekspertimit (*neni 183, pika 1*). Eksperti mund të autorizohet të shohë aktet, dokumentet dhe gjithçka që përfshihet në fashikullin e prokurorit ose të gjykatës (*neni 184, pika 1*) dhe harton aktin e ekspertimit me shkrim, i cili përmban mendimin e tij (*neni 185, pika 1*). Ndërkohë neni 314 i KPP-së rregullon një nga veprimet e prokurorit, pikërisht caktimin e ekspertit, duke përcaktuar se prokurori, për veprime të cilat kërkojnë njohuri teknike, mund të caktojë ekspert sipas nenit 179 të kodit.

76. Për sa i përket veprimtarisë me iniciativë të Policisë Gjyqësore në fazën e hetimeve paraprake, Gjykata ka pasur rastin të evidentojë se ajo rregullohet nga nenet 293-303 të KPP-së. Neni 294 përcakton se policia gjyqësore vazhdon të kryejë funksionet e saj edhe pas referimit të veprës penale për sigurimin e burimeve të provave, duke grumbulluar e fiksuar çdo element të vlefshëm për rindërtimin e faktit dhe për individualizimin e fajtorit dhe duke proceduar sidomos për kërkimin dhe fiksimin e sendeve dhe të gjurmëve të veprës penale, si dhe për ruajtjen e tyre dhe të vendit të ngjarjes për aq kohë sa kjo gjë është e domosdoshme ose dhe për kryerjen e veprimeve të caktuara në nenet vijuese (*pika 1*). Edhe pas ndërhyrjes së prokurorit, krahas çdo veprimi të urdhëruar ose të deleguar posaçërisht nga prokurori, policia gjyqësore kryen me iniciativë edhe çdo veprim hetimor të nevojshëm dhe siguron burime të reja të provës (*pika 2*). Ndërkohë, neni 300 i KPP-së rregullon "*verifikimet e ngutshme në vend"*, duke parashikuar se OPGJ-të dhe agjentët e policisë gjyqësore marrin masa që gjurmët dhe sendet që i përkasin veprës penale të fiksohen e të ruhen dhe që gjendja e vendngjarjes dhe e sendeve të mos ndryshojnë dhe kur ka rrezik që ato të ndryshojnë ose të humbasin dhe prokurori nuk mund të ndërhyjë urgjentisht, OPGJ-të kryejnë veprimet hetimore të domosdoshme dhe, kur është rasti, sekuestrojnë provat materiale dhe sendet që lidhen me veprën penale, sekuestrim i cili kontrollohet nga prokurori, ndaj vendimit të të

cilit mund të bëhet ankim në gjykatë (*neni 301*) *(shih vendimin nr. 42, datë 01.07.2025 të Gjykatës Kushtetuese).*

77. Në kuadër të veprimeve me iniciativë të Policisë Gjyqësore, neni 299 i KPP-së rregullon marrjen e plikove dhe të korrespondencës. Ai parashikon se kur është e nevojshme për qëllimet e procedimit, OPGJ-ja merr plikot e vulosura ose të mbyllura me ndonjë mënyrë tjetër dhe ia dërgon prokurorit të paprekura për sekuestro eventuale (të mundshme) dhe nëse ka shkaqe të bazuara për të menduar se plikot përmbajnë të dhëna që mund të humbasin për shkak të vonesës, OPGJ-ja njofton menjëherë prokurorin, i cili mund të autorizojë hapjen e tyre *(pika 1)*. Për sa u takon letrave, zarfeve, pakove, vlerave monetare e pasurore, telegrameve ose mjeteve të tjera të korrespondencës, për të cilat lejohet sekuestroja, OPGJ-ja, në raste të ngutshme, urdhëron pezullimin e dërgimit dhe nëse prokurori nuk vendos sekuestron brenda dyzet e tetë orëve, objektet e korrespondencës dërgohen në destinacion *(pika 2)*.

78. Në kushtet kur çështja në shqyrtim lidhet me një telefon inteligjent dhe me të dhënat personale dhe korrespondencën e memorizuar në të, Gjykata konstaton se KPP-ja nuk përmban ndonjë rregullim nën termin "provë elektronike". Megjithatë, neni 191/a i KPP-së (shtuar po në vitin 2008), është përfshirë në seksionin e provave "dokument" dhe parashikon "*detyrimin për paraqitjen e të dhënave kompjuterike*". Sipas këtij neni, në procedimet për vepra penale në fushën e teknologjisë së informacionit, gjykata, me kërkesë të prokurorit ose viktimës akuzuese, urdhëron mbajtësin ose kontrolluesin të dorëzojnë të dhënat kompjuterike të memorizuara në një sistem kompjuterik ose në një mjet tjetër memorizimi (*pika 1*). Kur ka arsye të bazuara për të menduar se vonesa mund të sjellë dëm të rëndë për hetimet, prokurori, me akt të motivuar, vendos detyrimin për paraqitjen e të dhënave kompjuterike dhe njofton menjëherë gjykatën, e cila vlerëson vendimin e tij (*pika 3*).

79. Po kështu, Gjykata konstaton se në seksionin e kontrolleve, neni 202/a (i shtuar me ligjin nr. 35/2017), që rregullon vendimin për lejimin e kontrollit, parashikon se edhe kur ka arsye të bazuara se të dhënat, informacionet, programet informatike ose gjurmë të tyre, gjenden në një sistem informatik ose telematik, edhe kur ky është i mbrojtur me masa sigurie, gjykata merr vendim për kontrollin, duke urdhëruar masa teknike të përshtatshme që sigurojnë ruajtjen e të dhënave origjinale dhe nuk lejojnë ndryshimin e tyre, ndërkohë që vendimi duhet të përcaktojë llojin e informacionit që kërkohet dhe mënyrën e marrjes së tij (*pika 2*).

Në lidhje me kontrollet me iniciativë të OPGJ-së, neni 298 i KPP-së, parashikon se edhe në rastet e flagrancës ose ndjekjes së personit në ikje, ose kur duhet të kryhet një ndalim apo të ekzekutohet një vendim arresti, ose një vendim dënimi me burgim, policia gjyqësore merr të gjitha masat teknike për sigurimin dhe ruajtjen e të dhënave origjinale kompjuterike, mbrojtjen e tyre nga humbja, dëmtimi dhe tjetërsimi, si dhe kryen kontrolle të mëtejshme të të dhënave kompjuterike, kur ka shkaqe të arsyeshme se ato përmbajnë informacion, programe ose gjurmë të veprës penale (*pika 3*).

80. Gjithashtu, Gjykata konstaton se neni 299/a (shtuar në vitin 2008) parashikon që prokurori mund të urdhërojë ruajtjen e përshpejtuar të të dhënave kompjuterike të caktuara, përfshirë të dhënat e trafikut, kur ka shkaqe të mjaftueshme për të besuar se ato mund të humbasin, dëmtohen ose ndryshohen (*pika 1*). Kur të dhënat janë në zotërim/kontroll të një personi, prokurori mund ta urdhërojë atë t'i ruajë dhe mirëmbajë për një periudhë deri në 90 ditë, me qëllim zbulimin dhe nxjerrjen e tyre, afat ky që mund të zgjatet vetëm një herë për shkaqe të arsyeshme (*pika 2*). Personi i ngarkuar ka detyrim të mbajë sekret procedurat dhe veprimet e kryera deri në përfundim të hetimeve (*pika 3*). Kurse neni 299/b (shtuar edhe ai në vitin 2008) parashikon se personi i ngarkuar me ruajtjen e përshpejtuar të të dhënave të trafikut duhet të marrë masa për të garantuar që të dhënat e ruajtura janë të vlefshme, edhe kur në transmetim kanë qenë të përfshirë një ose më shumë dhënës shërbimesh, dhe se ai duhet t'i sigurojë prokurorisë ose OPGJ-së së autorizuar zbulim të pjesshëm të një sasie të mjaftueshme të të dhënave të trafikut, për të mundësuar identifikimin e dhënësit të shërbimit dhe shtegut të transmetimit të komunikimit.

81. Në lidhje me praktikën gjyqësore, duke iu referuar për këtë vendimeve unifikuese ose njësuese të Gjykatës së Lartë për interpretimin e dispozitave ligjore të zbatueshme edhe në këtë çështje, Gjykata çmon të evidentojë vendimet e referuara nga kërkuesja dhe nga gjykatat e zakonshme, konkretisht vendimin nr. 1/2017 dhe vendimin njësues nr. 147/2021.

82. Gjykata konstaton se vendimi nr. 1/2017, i dhënë më 30.06.2017 nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, nuk i plotëson kriteret për t'u konsideruar vendim njësues në kuptim të nenit 141 të Kushtetutës. Pas ndryshimeve kushtetuese me ligjin nr. 76/2016 (miratuar më 22.07.2016), Kolegjet e Bashkuara nuk kishin më kompetencë të unifikonin praktikën përmes krijimit të precedentëve fillestarë, por vetëm të ndryshonin praktikën gjyqësore, ndërsa funksioni i unifikimit (nomofilatisë ose të uniformitetit)

u kalonte kolegjeve përkatëse të Gjykatës së Lartë. Në vetë vendimin, ndonëse shprehen se ai nuk është unifikues, por njësues dhe shërben për trajtimin ligjor të çështjeve të argumentuara në pjesën arsyetuese (paragrafi 43), Kolegjet e Bashkuara pranojnë se, për shkak të ndryshimit të situatës ligjore, çështjet e ngritura për njësimin e praktikës nuk paraqisnin më nevojën për adresimin e tyre (paragrafi 3). Po kështu, vendimi nuk evidenton çështje për njësim, nuk jep një sentencë njësuese dhe as dispozitivi nuk e kualifikon si të tillë. Për më tepër, ai nuk është publikuar në Fletoren Zyrtare, siç kërkon neni 35, pika 4, i ligjit nr. 98/2016 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë". Pavarësisht kësaj, objekti kryesor i analizës në atë vendim lidhet kryesisht me nenet 202, pika 3 dhe 298 të KPP-së, për veprimet me iniciativë të OPGJ-ve në rastin e kontrollit të vendeve.

83. Lidhur me vendimin njësues penal nr. 147/2021 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, Gjykata konstaton se themeli i tij ka konsistuar në marrjen nga gjykata të masës së sekuestrimit të të dhënave kompjuterike. Në këtë vendim është shtruar për njësim, ndër të tjera, edhe se cilat janë kriteret që gjykata duhet të ndjekë për lejimin e sekuestrimit të të dhënave ose sistemeve kompjuterike sipas nenit 208/a të KPP-së. Për sa u takon kritereve, Gjykata e Lartë ka nxjerrë sentencën njësuese, sipas së cilës sekuestrimi i të dhënave ose **i** sistemeve kompjuterike lejohet vetëm kur plotësohen kushtet e përgjithshme të nenit 208 të KPP-së. Ajo sekuestro vendoset për prova materiale në kuptim të nenit 187 të KPP-së ose për sende që lidhen me veprën penale, duke argumentuar në çdo rast se ato janë të domosdoshme për vërtetimin e fakteve. Në vendimin e saj gjykata duhet të përcaktojë qartë veprën penale të dyshuar, të arsyetojë pse sekuestrimi është i nevojshëm për zgjidhjen e çështjes, të specifikojë të dhënat/sistemet kompjuterike që sekuestrohen, çfarë synohet të provohet dhe modalitetet e sekuestrimit, në mënyrë që të preken vetëm të dhënat/sistemet kompjuterike të specifikuara. Sekuestrimi duhet të respektojë proporcionalitetin dhe përshtatshmërinë**,** vetëm sa është e nevojshme, për aq sa është e nevojshme dhe për aq kohë sa është e nevojshme. Për nxjerrjen e të dhënave, pajisjet mund të sekuestrohen nëse kjo është e domosdoshme dhe për aq kohë sa është e nevojshme për marrjen e të dhënave aose krijimin e kopjeve *(shih paragrafin 77 të vendimit njësues).*

84. Gjykata e Lartë ka vënë në dukje edhe rolin e teknologjisë së informacionit në procesin penal, duke nënvizuar se të dhënat dokumentare (përfshirë ato fotografike e filmike) mund të jenë në format "*hard copy*"

ose "*format kompjuterik*". Jo rrallë provat e domosdoshme për vërtetimin e fakteve penale gjenden në formën e të dhënave kompjuterike. Për këtë arsye, në vitin 2008 në KPP është shtuar neni 208/a për sekuestrimin provues të të dhënave kompjuterike. Ky nen parashikon rregulla të posaçme për sekuestrimin e të dhënave kompjuterike, por rregullat e përgjithshme të nenit 208 të KPP-së mbeten të zbatueshme, përveç rasteve kur neni 208/a parashikon ndryshe. Për rrjedhojë, garancia e arsyetimit të domosdoshmërisë së sekuestrimit të të dhënave zbatohet edhe në rastin e sekuestrimit të të dhënave kompjuterike *(shih paragrafët 55-56 të vendimit njësues).*

85. Gjykata e Lartë ka vërejtur se sekuestrimi i të dhënave kompjuterike, në rastin e krimeve në fushën e teknologjisë së informacionit, sipas nenit 208/a të KPP-së, bëhet vetëm me vendim gjykate, që pasqyron vullnetin e ligjvënësit për të ofruar garanci të shtuar. Kjo lidhet me vështirësinë e individualizimit të të dhënave kompjuterike dhe me rrezikun që, bashkë me të dhënat relevante, të ekspozohen dhe të dhëna të tjera që nuk kanë lidhje me veprën penale, marrja e të cilave mund të cenojë liri dhe të drejta që gëzojnë mbrojtje kushtetuese dhe konventore, të tilla, si: liria dhe fshehtësia e korrespondencës ose e çdo mjeti tjetër të komunikimit sipas nenit 36 të Kushtetutës, e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare sipas nenit 8 të KEDNJ-së, liria e shprehjes sipas neni 22 të Kushtetutës, e drejta e informimit sipas nenit 23 të Kushtetutës, të mbrojtura gjithashtu dhe nga neni 10 i KEDNJ-së, kufizimi i të cilave mund të bëhet vetëm në përputhje me nenin 17 të Kushtetutës *(shih paragrafin 57 të vendimit njësues).* Po sipas Gjykatës së Lartë, nenet 208 dhe 208/a të KPP-së përbëjnë bazën ligjore për sekuestrimin provues të të dhënave kompjuterike, sekuestrim i cili bëhet me vendim gjykate, në vijim të kërkesës së prokurorit *(shih paragrafin 60 të vendimit njësues).*

86. Në vendimin njësues, Gjykata e Lartë ka sqaruar se edhe sekuestrimi provues është mjet tipik i kërkimit të provës në procesin penal, me të cilin ndalohet përkohësisht disponimi dhe/ose tjetërsimi i provës materiale ose i dokumentit, që lidhet drejtpërdrejt ose tërthorazi me veprën penale dhe është i domosdoshëm për vërtetimin e faktit. Ai nuk lidhet me raportin e pronësisë, por me nevojat e të provuarit, ndaj mund të vendoset mbi çdo send, pavarësisht se kujt i përket *(shih paragrafin 31 të vendimit njësues).* Sipas Gjykatës së Lartë, gjatë hetimeve paraprake sekuestrimi mund të vendoset nga: (a) prokurori; (b) gjykata me kërkesë të prokurorit; (c) Policia Gjyqësore në rastin e "verifikimeve të ngutshme" *(shih paragrafin 42 të vendimit njësues).*

87. Nga sa më lart, Gjykata vëren se KPP-ja, për sa i përket sekuestrimit të provave materiale dhe të sendeve që lidhen me veprën penale, kur kjo është e domosdoshme për vërtetimin e fakteve, parashikon mundësinë që sekuestrimi të vendoset me vendim të gjykatës ose të prokurorit, por edhe nga OPGJ-ja, në kushte të përcaktuara. Praktika gjyqësore (vendimi njësues nr. 147/2021) ka pranuar se neni 300 i KPP-së lejon sekuestrimin provues me iniciativë të OPGJ-së, në rastet e "verifikimeve të ngutshme në vend", kur ka rrezik që gjurmët dhe sendet që lidhen me veprën penale të ndryshojnë ose të humbasin dhe prokurori nuk mund të ndërhyjë urgjentisht. Në këtë pikë, sikurse edhe më parë, Gjykata vëren se nocioni "vendngjarje" në përmbajtje të kësaj dispozite duket se ka kuptimin e një hapësire fizike ose edhe virtuale ku është përgatitur vepra penale, ku është realizuar ajo, ku janë lënë pasojat materiale të saj, ose ku ndodhen provat materiale ose gjurmët e lidhura me të *(shih vendimin nr. 42, datë 01.07.2025 të Gjykatës Kushtetuese).*

88. Gjykata vëren më tej se ndonëse KPP-ja nuk përmban një përkufizim të përgjithshëm të nocionit "*provë elektronike*", përmbajtja e disa dispozitave të tij tregon se të dhënat kompjuterike mund të jenë objekt administrimi dhe përdorimi si provë në procesin penal. Në këtë drejtim, vendosja e rregullimit mbi detyrimin për dorëzimin/paraqitjen e të dhënave kompjuterike në seksionin e provave me dokument tregon se ligjvënësi i ka trajtuar këto të dhëna, në rrethana të caktuara, si provë dokumentare. Në këtë kuadër, duke mbajtur parasysh edhe nocionin ligjor të dokumentit elektronik, i cili paraqitet në formë të brendshme numerike dhe në formë të jashtme të kuptueshme (vizualisht ose të materializuar), mund të pranohet se nocioni i provave dokumentare, i parashikuar në KPP, përfshin edhe dokumentet elektronike, si një formë e të dhënave kompjuterike, të cilat, njësoj si dokumentet në letër, mund të pasqyrojnë dhe të përfaqësojnë fakte, persona ose sende me rëndësi për procesin penal.

89. Megjithatë, vlen të përmendet se nocioni i "*të dhënave kompjuterike*" duket se është më i gjerë se ai i "*dokumentit elektronik*", pasi përfshin edhe të dhëna të natyrës teknike e funksionale, të cilat krijohen, regjistrohen ose ruhen automatikisht nga sistemet informatike dhe pajisjet elektronike gjatë funksionimit të tyre, të cilat, edhe kur mund të nxirren dhe të paraqiten në një formë të lexueshme, nuk përbëjnë domosdoshmërisht "dokument elektronik" në kuptimin klasik, për sa kohë që ato, në vetvete, nuk artikulojnë një përmbajtje të individualizuar si dokument, por pasqyrojnë kryesisht rrethana, parametra teknikë dhe gjurmë funksionimi të sistemeve dhe proceseve digjitale.

90. Po kështu, vlen të përmendet se fakti që dokumentet elektronike, njësoj si dokumentet në letër, mund të përfaqësojnë fakte, persona ose sende, nuk nënkupton se përmbajtja e tyre është e një natyre asnjanëse nga këndvështrimi kushtetues, ose që ajo përjashtohet nga kategoritë e mbrojtura, si të dhënat personale dhe korrespondenca. Përkundrazi, në varësi të përmbajtjes konkrete, një dokument elektronik mund të përmbajë informacion për një person të identifikuar ose të identifikueshëm në lidhje me jetën private, marrëdhëniet, vendndodhjen, shprehitë dhe preferencat e tij, si dhe komunikime private të tij në kuptimin e korrespondencës. Për rrjedhojë, klasifikimi i një materiali si "*provë dokumentare*" nuk mjafton, në vetvete, për të përcaktuar regjimin e plotë të mbrojtjes së përmbajtjes së tij dhe garancitë procedurale që duhet të shoqërojnë marrjen, aksesimin, përpunimin dhe përdorimin e tij në procesin penal. Në çdo rast vendimtare mbeten natyra e informacionit që materiali përmban dhe konteksti në të cilin ai është krijuar dhe ruajtur.

91. Në këtë pikë, Gjykata çmon të evidentojë se, duke mbajtur në konsideratë jurisprudencën e GJEDNJ-së *(shih Copland kundër Mbretërisë së Bashkuar, datë 03.04.2007, § 44; Bărbulescu kundër Rumanisë, datë 05.09.2017, § 74)*, por edhe praktikën e gjykatave kushtetuese homologe *(shih vendimin nr. 170/2023 të Gjykatës Kushtetuese të Italisë),* në kuadër të mbrojtjes së fshehtësisë së korrespondencës, krahas komunikimeve elektronike *in itinere,* përfshihen edhe ato *statike*. Kjo për shkak se kufizimi vetëm në komunikimet në zhvillim dhe jo të përfunduara (*in itinere*) do të nënkuptonte që t'i jepej një interpretim kufizues konceptit të korrespondencës, duke u dhënë mundësi organeve të hetimit që t'i shmangen detyrimit kushtetues, të cilat, në vend që të marrin komunikimet në momentin që ndodhin, do të mjaftonte të prisnin përfundimin e tyre dhe sekuestrimin e sendit në të cilën ka gjurmë të përmbajtjes së tyre. Në këtë kuptim, përcaktimi i *"komunikimit*" si një "*dokument i thjeshtë*" kur ai nuk është më *in itinere* është një zgjidhje që çon deri në eliminimin e mbrojtjes kushtetuese për komunikimet e kryera nëpërmjet postës elektronike dhe sistemeve të tjera të mesazheve të çastit, në të cilat dërgimi kryhet menjëherë ose, në çdo rast, pa një ndërprerje të dukshme kohore (*pritjeje*). Për rrjedhojë, komunikimet elektronike *statike* të memorizuara në një pajisje elektronike vijojnë të ruajnë karakterin e korrespondencës edhe pas marrjes nga marrësi, deri atëherë kur interesi për konfidencialitetin e tyre humb çdo rëndësi, qoftë për shkak të kalimit të kohës, ashtu dhe për arsye të tjera, duke u shndërruar ato thjesht në një dokument "historik".

92. Gjykata vëren gjithashtu se praktika gjyqësore (vendimi njësues nr. 147/2021) ka pranuar se rregullat e përgjithshme të sekuestrimit provues zbatohen edhe për sekuestrimin e të dhënave ose të sistemeve kompjuterike. Po sipas praktikës gjyqësore, referuar KPP-së, sekuestrimi provues i të dhënave ose i sistemeve kompjuterike bëhet me vendim të gjykatës, por vetëm në procedimet për krime që lidhen me teknologjinë e informacionit. Në raste të tilla, ndërsa krime të kësaj natyre kryhen duke përdorur pajisje kompjuterike, këto të fundit mund të përkufizohen si corpus delicti, pra si mjeti përmes të cilit është kryer krimi.

93. Megjithatë, Gjykata vëren se KPP-ja nuk ndalon sekuestrimin provues të të dhënave ose sistemeve kompjuterike në procedime për krime të tjera, të ndryshme nga ato që lidhen me teknologjinë e informacionit, kur ato shërbejnë ose përmbajnë të dhëna të dobishme për përcaktimin e krimit. Në këtë kuptim, konsiderata se vetëm luftimi i krimeve që lidhen me teknologjinë e informacionit justifikon sekuestrimin dhe aksesin në të dhënat kompjuterike kufizon në mënyrë të papërligjur kompetencat hetimore të autoriteteve publike, duke rritur rrezikun e pandëshkueshmërisë, në veçanti për veprat e rënda penale, duke pasur parasysh rëndësinë që të dhëna të tilla mund të kenë për hetimet penale. Nën këtë qasje, në praktikë, sekuestrimi i pajisjeve elektronike dhe i sistemeve kompjuterike, me qëllim nxjerrjen e konsultimin e të dhënave që ato përmbajnë dhe marrjen e atyre që kanë rëndësi për hetimin, është një masë që zbatohet shpesh edhe në hetime për vepra të tjera penale, duke pasur parasysh përdorimin e gjerë të tyre në jetën e përditshme dhe rëndësinë e të dhënave që ato përmbajnë për drejtësinë penale. Megjithatë, ndonëse nuk ka një praktikë gjyqësore të njësuar për mënyrën e zbatimit të sekuestrimit të të dhënave ose të sistemeve kompjuterike edhe në raste të tilla, është e kuptueshme që edhe në këto raste janë të zbatueshme standardet kushtetuese dhe ato të KEDNJ-së, sikurse edhe kërkesat ligjore specifike.

94. Gjykata vëren gjithashtu se KPP-ja rregullon edhe ekspertimin si provë në procesin penal, duke parashikuar se ai lejohet kur është i nevojshëm zhvillimi i kërkimeve, marrja e të dhënave ose e vlerësimeve që kërkojnë njohuri të posaçme teknike. Vendimi për ekspertimin dhe caktimi i ekspertit merret nga organi procedues, i cili në fazën e hetimeve paraprake është, në parim, prokurori, ndërsa ligji kërkon që vendimi të jetë i motivuar dhe të përcaktojë qartë edhe çështjet që i parashtrohen ekspertit, duke pranuar mundësinë e lejimit të tij për t'u njohur me aktet e nevojshme të fashikullit *(shih paragrafin 75 më sipër)*. Ndërsa për sa u takon të dhënave

ose sistemeve kompjuterike, në kuadrin e masave të sigurimit të provës elektronike, KPP-ja parashikon mundësinë e prokurorit për të thirrur ekspert me njohuri për sistemet kompjuterike dhe masat mbrojtëse të të dhënave, me qëllim zbatimin e masës së ndalimit të veprimeve të mëtejshme ose sigurimit të sistemit kompjuterik, nxjerrjen dhe marrjen e kopjeve të të dhënave kompjuterike, pengimin e hyrjes në të dhënat kompjuterike, ose heqjes së këtyre të dhënave nga sistemet kompjuterike me të drejtë hyrjeje, si dhe sigurimin e paprekshmërisë të të dhënave përkatëse, të memorizuara. Në këtë kuptim, kur ekspertimi teknik konsiston në ekstraktimin, kopjimin dhe ruajtjen e të dhënave të memorizuara në një pajisje elektronike, me qëllim kërkimin e mëvonshëm dhe marrjen e atyre të dhënave që paraqesin rëndësi për hetimin, ai duket se shërben, përpara së gjithash, si veprim teknik për sigurimin e provës dhe ruajtjen e integritetit, vërtetësinë dhe pandryshueshmërinë e saj, duke shmangur manipulimin e mundshëm të bartësit të të dhënave. Për rrjedhojë, në aspektin funksional, ekstraktimi, kopjimi dhe ruajtja e të dhënave të memorizuara në një pajisje elektronike përmes ekspertimit mund të kuptohen si veprime teknike të lidhura me zbatimin e masës së sekuestrimit, në masën që ato synojnë ruajtjen e provës në gjendjen që është dhe krijojnë kushtet që, në një fazë të mëpasshme, të mundësohet identifikimi dhe përzgjedhja e atyre të dhënave që paraqesin rëndësi për hetimin.

95. Në këtë pikë, Gjykata çmon të evidentojë se sekuestrimi i pajisjes elektronike dhe i të dhënave në tërësi që ajo përmban është një masë që dallon nga kërkimi i mëvonshëm i atyre të dhënave që paraqesin rëndësi për hetimin. Kjo pranohet edhe nga subjekti i interesuar, Prokuroria e Posaçme, sipas të cilit, kërkimi i të dhënave kompjuterike me rëndësi për hetimin realizohet përmes masës së këqyrjes së dokumentit/kopjes pasqyrë të përfituar nga ekspertimi, sipas nenit 198 të KPP-së. Megjithatë, siç edhe më lart u konstatua, neni 202/a i KPP-së (pika 2), bën fjalë për kontroll të sistemeve informatike ose telematike, kurse neni 298 (pika 3) për kontroll të të dhënave kompjuterike *(shih paragrafin 79 më sipër)*. Vlen të përmendet se këto masa, pra këqyrja dhe kontrolli, pa marrë përsipër përcaktimin se ku ato konsistojnë, duket se janë të dallueshme mes tyre, nisur edhe vetëm nga fakti se rregullohen nga dispozita të ndryshme ligjore. Po kështu, KPP-ja, zbatimin e masës së sekuestrimit e parashikon shprehimisht vetëm për rastin e kontrollit. Gjithsesi, edhe në këtë drejtim nuk duket se ka një praktikë gjyqësore të qëndrueshme dhe aq më tepër njësuese të Gjykatës së Lartë.

96. Po kështu, Gjykata çmon të evidentojë se në hetimet penale tradicionale autoritetet zakonisht procedojnë me kontrollin dhe, nëse gjenden prova, kalojnë te sekuestrimi i tyre. Ndërsa në fushën digjitale duket se ndodh e kundërta. Fillimisht zbatohet masa e sekuestrimit të pajisjes elektronike, përfshirë krijimin e kopjes pasqyrë (forenzike) dhe më pas kalohet në kërkimin e të dhënave me rëndësi për hetimin. Duket se ky *modus operandi* lidhet me nevojën për ruajtjen e integritetit të të dhënave kompjuterike.

97. Për sa më lart, Gjykata, fillimisht, vëren se sekuestrimi i një pajisjeje elektronike, edhe kur shoqërohet me veprime teknike për sigurimin e provës, si: nxjerrja, kopjimi dhe ruajtja e të dhënave, me qëllim garantimin e integritetit dhe parandalimin e humbjes, dëmtimit ose ndryshimit, është veprim i dallueshëm dhe nuk barazohet me veprimtarinë hetimore që konsiston në kërkimin, analizën, përzgjedhjen dhe marrjen e të dhënave me rëndësi për hetimin. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se KPP-ja, në kuadrin e përgjithshëm të sekuestrimit provues, parashikon sekuestrimin e provave materiale dhe të sendeve që lidhen me veprën penale me vendim të gjyqtarit ose të prokurorit dhe në raste përjashtimore edhe nga OPGJ-ja. Ndërkohë, kur ndërhyrja shtrihet në veprime që paraqesin cenim më intensiv të privatësisë, të tilla, si: kërkimi, analiza, përzgjedhja dhe marrja e të dhënave në një sistem informatik/telematik ose përcaktimi i modaliteteve të marrjes së tyre, ligjvënësi ka parashikuar garanci të shtuara, përfshirë kontrollin gjyqësor paraprak dhe detyrimin që vendimi të përcaktojë objektin dhe mënyrën e zbatimit të masës. Megjithatë, në këtë drejtim, sërish nuk duket se ka një praktikë gjyqësore të qëndrueshme dhe, aq më tepër, njësuese të Gjykatës së Lartë, që të ketë përcaktuar qartë kufijtë midis veprimeve teknike për sigurimin e provës elektronike dhe veprimeve të aksesimit/kërkimit dhe përpunimit të të dhënave në përmbajtjen e pajisjes, të cilat përbëjnë ndërhyrje më intensive në sferën e privatësisë.

98. Duke pasur parasysh të drejtat kushtetuese që potencialisht cenohen nga aksesimi dhe përpunimi i të dhënave, veçanërisht ajo e jetës private në aspektet e të dhënave personale dhe të fshehtësisë së korrespondencës, si dhe standardet që ligji procedural penal përcakton për masat hetimore që ndërhyjnë në elemente të tjera të së drejtës për jetë private, Gjykata çmon se kërkimi i të dhënave kompjuterike që përfaqësojnë të dhëna personale ose korrespondencë private duhet, në parim, të autorizohet me vendim paraprak të gjykatës. Ky vendim duhet të jetë i arsyetuar mjaftueshëm, në mënyrë që ndërhyrja të kufizohet vetëm në atë që është rreptësisht e nevojshme

për hetimin, duke shmangur arbitraritetin. Vendimi duhet të përcaktojë, së paku, garancitë procedurale për minimizimin e ndërhyrjes, veçanërisht në drejtim të: (a) kufizimit të fushës së kërkimit, duke identifikuar pajisjen elektronike dhe, kur është rasti, sistemin ose sistemet e lidhura me të, si dhe duke përcaktuar objektin e kërkimit, llojin e të dhënave, fjalët kyçe ose kriteret e filtrimit dhe shtrirjen kohore, me synim shmangien e të dhënave të parëndësishme dhe, kur është rasti, të atyre që gëzojnë mbrojtje të posaçme nga ligji; (b) kufizimit të kohës së ruajtjes dhe të rrethit të ekspozimit të të dhënave, duke përcaktuar afate për ruajtjen dhe analizimin, si edhe personat e autorizuar për akses, në mënyrë që ndërhyrja të mos shndërrohet në një mbledhje të përgjithshme dhe të pakontrolluar të informacionit; (c) si dhe dokumentimit të detajuar të të gjitha veprimeve të kryera për kërkimin dhe analizimin e të dhënave, duke përfshirë mënyrën e aksesimit, kriteret e përdorura për kërkimin, të dhënat e përzgjedhura, si dhe masat e marra për garantimin e integritetit, me qëllim që të mundësohet një kontroll gjyqësor real dhe efektiv, në rast pretendimesh për arbitraritet, tejkalim të autorizimit ose shkelje të garancive procedurale.

99. Gjykata vëren se, në kontekstin e telefonave inteligjentë, aksesimi i të dhënave të memorizuara mund të shtrihet potencialisht në një spektër shumë të gjerë informacioni dhe të lejojë nxjerrjen e përfundimeve tejet të hollësishme mbi jetën private, profesionale dhe shoqërore të individit. Për këtë arsye, ndërhyrja shtetërore mbi të nuk mund të trajtohet si ndërhyrje mbi një send të zakonshëm provues, por si ndërhyrje në një hapësirë të zgjeruar të jetës private, me intensitet të lartë kushtetues. Për rrjedhojë, ndërhyrja në nenet 35 e 36 të Kushtetutës dhe në nenin 8 të KEDNJ-së duhet konsideruar në parim si "*e rëndë*" e në rrethana të caktuara edhe si "*veçanërisht e rëndë*", kur ajo prek të dhëna me natyrë sensitive. Në këto kushte, për të shmangur arbitraritetin, kërkimi, analiza, përzgjedhja e të dhënave duhet, si rregull, t'i nënshtrohet një verifikimi paraprak nga gjykata, i aftë të refuzojë ose të kufizojë masën kur ndërhyrja është joproporcionale.

100. Gjykata, po ashtu, vëren se në rastet e ngutshme/të urgjencës, si përjashtim, interesi publik mund të justifikojë sekuestrimin e pajisjes elektronike dhe përkohësisht edhe të të dhënave të memorizuara në të, në tërësi, me iniciativë të OPGJ-së, pa vendim paraprak të gjykatës, referuar nenit 300 të KPP-së. Megjithatë, në këto raste masa i nënshtrohet kontrollit automatik të prokurorit dhe kontrollit gjyqësor *ex post* mbi ankimin e individit, ku ligjshmëria vlerësohet: *së pari*, në *aspektin e urgjencës,* nëse

kanë ekzistuar arsye të bazuara për të menduar se pajisja ose të dhënat mund të humbnin, ndryshonin ose cenoheshin. Lidhur me këtë, Gjykata çmon të theksojë se urgjenca, në kuptimin kushtetues, duhet të jetë reale, konkrete dhe e argumentuar në rrethanat specifike të rastit. Rreziku i fshirjes të të dhënave digjitale nuk mund të prezumohet për çdo pajisje elektronike, pasi një qasje e tillë rrezikon të zhvendosë qendrën e kontrollit nga gjykata tek organi hetimor, në kundërshtim me parimin kushtetues të kontrollit gjyqësor; *së dyti, në aspektin e nevojës* për qëllimet e procedimit penal, pra nëse kanë ekzistuar arsye të bazuara për të menduar se pajisja përmban informacion, programe ose gjurmë të veprës penale, domethënë të dhëna me rëndësi për hetimin.

101. Në këtë pikë, Gjykata thekson se sekuestrimi në kushtet e urgjencës nuk nënkupton se OPGJ-të fitojnë edhe të drejtën për të kërkuar, analizuar, përzgjedhur dhe marrë të dhëna të memorizuara në përmbajtjen e pajisjes elektronike dhe që kanë rëndësi për hetimin. Për këtë ndërhyrje kërkohet vendim gjykate, i cili përcakton edhe modalitetet konkrete të kërkimit dhe të administrimit të të dhënave, në mënyrë që ndërhyrja të kufizohet vetëm në atë që është rreptësisht e nevojshme. Përjashtimi në rastet e urgjencës nuk duhet të kuptohet si zëvendësim i kontrollit gjyqësor *ex ante,* por vetëm si devijim i arsyetuar nga rregulli i autorizimit paraprak gjyqësor. Prandaj, në rastet e urgjencës, kërkohet që arsyeja e ngutshmërisë të jetë e motivuar në mënyrë të veçantë dhe kontrolli gjyqësor *ex post* të realizohet në një afat të shkurtër, në mënyrë që ndërhyrja të mos konsumohet faktikisht pa verifikim real të domosdoshmërisë dhe kufijve të saj.

102. Gjykata vëren gjithashtu se qoftë kur masa autorizohet paraprakisht nga gjykata, ashtu dhe kur autorizohet pas sekuestrimit në kushtet e urgjencës, mënyra e kërkimit dhe e përzgjedhjes të të dhënave i nënshtrohet sërish kontrollit gjyqësor me kërkesë të prokurorit dhe është gjykata ajo që vendos përfundimisht për sekuestrimin e të dhënave kompjuterike me rëndësi për hetimin dhe, kur është rasti, urdhëron asgjësimin e të dhënave të parëndësishme ose të atyre që gëzojnë mbrojtje të veçantë nga ligji. Në këtë pikë, Gjykata çmon të theksojë se efektiviteti i mjetit juridik dhe realiteti i kontrollit gjyqësor për ndërhyrje të kësaj natyre presupozon gjithashtu që personi i prekur të vihet në dijeni për bazën, arsyet thelbësore që kanë shërbyer për lejimin e aksesit në përmbajtjen e telefonit, sapo komunikimi i këtij informacioni të mos rrezikojë më detyrat e autoriteteve hetimore dhe interesat legjitimë të hetimit. Ky informim, i bërë në kohën e duhur,

shërben si garanci kundër arbitraritetit dhe si parakusht për ushtrimin real të së drejtës për ankim të individit.

103. Duke iu kthyer rastit konkret, Gjykata vëren se sekuestrimi i telefonit të kërkueses është kryer në kuadër të hetimit penal që zhvillohet ndaj disa personave, të dyshuar për kryerjen e disa veprave penale specifike. Ky sekuestrim është kryer me iniciativë nga OPGJ-të, ndërsa më herët, përmes këqyrjes së telefonit nëpërmjet ekranit, kanë konstatuar se ai përmbante komunikime të kërkueses me persona të lidhur me hetimin, jo vetëm me personat nën hetim A dhe B, por edhe me përfaqësuesin e një prej subjekteve tregtare që ka realizuar pagesa për shoqërinë e personit nën hetim B, për shërbime që dyshohen të jenë fiktive, të kryera vetëm me qëllim justifikimin e ligjshmërisë së burimeve të krijimit të pasurive dhe të shpenzimeve të të dy personave nën hetim në fjalë. Sekuestrimi i telefonit nga OPGJ-të është justifikuar me rrezikun e humbjes ose zhdukjes së tij dhe i të dhënave që ai përmbante, ndërsa ndërhyrja e prokurorit ka qenë e pamundur. Në vijim, prokurorët kanë urdhëruar ekspertimin e telefonit, i cili ka konsistuar në ekstraktimin, kopjimin dhe ruajtjen e të dhënave në përmbajtjen e tij.

104. GJKKO-ja e Shkallës së Parë, e vënë në lëvizje me ankimin e kërkueses, ka pranuar këtë ankim, duke arsyetuar se sekuestrimi i telefonit të kërkueses nga OPGJ-të nuk është kryer në kushtet e flagrancës, në kundërshtim me nenet 202, pika 3 dhe 298 të KPP-së dhe vendimin nr. 1/2017 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë (referuar prej saj si njësues). Ndryshe nga ajo, GJKKO-ja e Apelit dhe Gjykata e Lartë kanë pranuar se sekuestrimi i telefonit të kërkueses nga OPGJ-të është kryer me iniciativë në kushtet e urgjencës, në përputhje me nenin 300 të KPP-së, menjëherë pas marrjes së deklarimeve të kërkueses dhe pas këqyrjes përmes ekranit të telefonit të disa komunikimeve të ruajtura në të, me qëllim për të shmangur ndryshimin ose humbjen e tyre, ndërsa prokurori nuk mund të ndërhynte urgjentisht, ndërkohë që ekzistonin kushtet e përgjithshme sipas nenit 208 të KPP-së, pasi marrja e të dhënave ishte e domosdoshme për vërtetimin e fakteve të hetimit penal. Gjykata e Lartë ka theksuar se sekuestrimi nuk është kryer gjatë një kontrolli të kërkueses, siç kishte pranuar GJKKO-ja e Shkallës së Parë.

105. Gjykata vëren se sekuestrimi me iniciativë i telefonit të kërkueses nga OPGJ-të është një masë hetimore e marrë në fazën e hetimeve paraprake të një procedimi penal dhe është mbështetur në nenin 300 të KPP-së, si "*verifikim i ngutshëm në vend*", pra në kushte urgjence. Masa

është justifikuar me vlerësimin se ekzistonte rreziku i afërt i humbjes, zhdukjes ose tjetërsimit të sendit, për pasojë edhe i të dhënave kompjuterike të memorizuara në të, të cilat, nisur edhe nga rezultatet e këqyrjes paraprake të telefonit, sipas OPGJ-ve, konsideroheshin se përmbanin njoftime me rëndësi për hetimin. Gjykata vëren se KPP-ja, në kushte të përcaktuara rreptësisht, lejon që sekuestrimi provues i provave materiale ose i sendeve që lidhen me veprën penale të kryhet përjashtimisht nga OPGJ-të edhe pa vendim paraprak të gjykatës, përfshirë rastet kur sendi përmban të dhëna personale ose korrespondencë. Megjithatë, në këto raste, për të garantuar mbrojtjen nga arbitrariteti, masa i nënshtrohet kontrollit të prokurorit dhe, nëse ka ankim, edhe kontrollit gjyqësor *ex post.*

106. Në lidhje me ekzistencën e kushteve të urgjencës në rastin konkret, Gjykata vëren se subjekti i interesuar, si dhe gjykatat e zakonshme në vendimet e kundërshtuara nga kërkuesja, kanë parashtruar argumentet e tyre në këtë drejtim. Në thelb, është pranuar se telefoni celular u sekuestrua në momentin në të cilin u verifikua se në të gjendeshin të dhëna me rëndësi dhe të domosdoshme për hetimin, të cilat, për shkak të natyrës së tyre digjitale dhe mënyrës së ruajtjes/përpunimit përmes teknologjisë së informacionit, mund të ndryshonin, fshiheshin ose humbnin, pra se ekzistonte rreziku i vonesës (*periculum in mora).* Ky rrezik ka qenë real në kushtet kur pajisja/telefoni kishte akses në rrjet (internet), çka e rriste mundësinë e ndërhyrjeve që mund të ndikonin mbi gjendjen e të dhënave, përfshirë përmes mekanizmave të sinkronizimit ose fshirjes në distancë. Në këto rrethana, OPGJ-të, në pamundësi të ndërhyrjes së menjëhershme të prokurorit, sekuestruan telefonin, i cili më pas iu nënshtrua veprimeve të ekspertimit me qëllim ruajtjen e integritetit të të dhënave. Kërkuesja, në këtë drejtim, pretendon vetëm se sekuestrimi nuk është bërë në kushtet e flagrancës. Megjithatë, kjo është një situatë faktike dhe ligjore e ndryshme nga ajo në rastin konkret, që ka të bëjë me sekuestrimin në kushtet e urgjencës. Po kështu, ndonëse kërkuesja pretendon se nuk është person nën hetim, ajo nuk ka treguar ndonjë dispozitë ligjore që pengon sekuestrimin për një arsye të tillë, dhe as Gjykata nuk konstaton ekzistencën e një ndalimi të tillë ligjor.

107. Për sa më sipër, dhe në mungesë të ndonjë të dhëne konkrete që mund të vënë në dyshim arsyetimin e gjykatave të zakonshme në vendimet e kundërshtuara, Gjykata vlerëson se marrja, sekuestrimi i telefonit të kërkueses nga OPGJ-të, si dhe veprimet teknike të domosdoshme për sigurimin dhe ruajtjen e integritetit të të dhënave kompjuterike të memorizuara në të, përfshirë edhe krijimin e një kopjeje të të dhënave për

qëllime ruajtjeje, kanë bazë ligjore dhe, për pasojë, ato përmbushin kërkesën që ndërhyrja të jetë në përputhje me ligjin. Kjo masë iu nënshtrua kontrollit të prokurorit dhe, mbi ankimin e kërkueses, edhe kontrollit gjyqësor *ex post,* nga i cili u verifikua ligjshmëria e saj në kushtet e urgjencës. Megjithatë, ky përfundim nuk shtrihet automatikisht te faza pasuese e përpunimit të përmbajtjes të të dhënave**,** kërkimi dhe përzgjedhja e tyre, sidomos kur ato përbëjnë të dhëna personale ose korrespondencë, gjë e cila kërkon garanci të posaçme dhe vlerësim të veçantë.

108. Gjatë gjykimit kushtetues, kërkuesja ngriti pretendimin se organi procedues (prokuroria, Policia Gjyqësore dhe ekspertët) kishin kërkuar dhe marrë në kopjen e përmbajtjes së telefonit të saj celular komunikime elektronike që nuk kishin rëndësi për hetimin penal, të cilat i përdorën për të mbështetur kërkesën për përjashtimin e gjyqtarit kushtetues (*shih paragrafin 6 më sipër*). Sipas saj, kjo përbënte një ndërhyrje tjetër në të drejtat kushtetuese të fshehtësisë së korrespondencës dhe të jetës private, ndërhyrje e cila nuk ishte bërë në përputhje me ligjin, pra me vendim të gjykatës.

109. Lidhur me këtë pretendim, Gjykata vëren se ai nuk është ngritur në gjykatat e zakonshme dhe nuk lidhet drejtpërdrejt me veprimet fillestare të organit procedues, për të cilat janë dhënë vendimet gjyqësore, objekt i ankimit kushtetues individual. Për këtë arsye, në pamje të parë duket se pretendimi nuk duhet marrë në shqyrtim për të respektuar parimin e subsidiaritetit dhe natyrën përfundimtare të gjykimit kushtetues. Megjithatë, duke mbajtur në konsideratë faktin se pretendimi bazohet në aktet e paraqitura prej subjektit të interesuar në gjykimin kushtetues për të mbështetur kërkesat procedurale për efekte të vet gjykimit kushtetues, Gjykata çmon se, përjashtimisht, ky pretendim, në dukje i ri, duhet të merret në shqyrtim prej saj. Në vijim të këtij arsyetimi, por edhe për shkak të analizës së mësipërme të kuadrit kushtetues dhe ligjor, në raport me praktikën gjyqësore, me të cilën janë nxjerrë përfundime të reja dhe të rëndësishme për të përshtatur metodat hetimore në funksion të mbrojtjes të të drejtave themelore, Gjykata çmon ta shqyrtojë këtë pretendim në kuadër të parimit të proporcionalitetit (*shih paragrafët 120-128 më poshtë*).

ii) Nëse ndërhyrja ka ndjekur një qëllim të ligjshëm

110. Për sa i përket qëllimit të ndërhyrjes, Gjykata vëren se sekuestrimi i telefonit dhe i të dhënave kompjuterike të ruajtura në të ka synuar gjetjen e të dhënave për kryerjen e veprave penale të korrupsionit dhe pastrimit

të produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale. Nisur nga kjo, ndërsa as kërkuesja nuk ka ndonjë kundërshtim në këtë drejtim, është e qartë se masa e sekuestrimit ka pasur për qëllim parandalimin dhe ndjekjen penale të veprave penale në fjalë, domethënë ruajtjen e rendit dhe të sigurisë publike nga veprimtaria kriminale, çka përbën një qëllim të ligjshëm në aspekt të interesit publik, në kuptim të nenit 17 të Kushtetutës. Në këtë pikë, vlen të evidentohet se Kushtetuta, në nenet 135, pika 2 dhe 148/dh, i ka dhënë rëndësi të veçantë luftës kundër korrupsionit, duke parashikuar ngritjen e organeve të posaçme të drejtësisë.

iii) Nëse ndërhyrja ka qenë proporcionale, në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë

111. Gjykata vëren se kërkuesja pretendon se sekuestrimi i telefonit të saj celular nuk ka qenë i domosdoshëm, pasi qëllimi i ndjekur, konkretisht sigurimi i komunikimeve me dy persona të lidhur me hetimin, mund të arrihej me masa më të lehta dhe më pak kufizuese për të drejtat e saj. Masa të tilla, shprehet ajo, do të ishin vijimi i këqyrjes së telefonit nga OPGJ-të, kopjimi i atyre të dhënave me interes për hetimin, ose sekuestrimi i telefonit, por vetëm për një periudhë të kufizuar kohore (deri në një muaj), për aq sa ka qenë e nevojshme për këqyrjen dhe kopjimin e të dhënave në fjalë. Po sipas saj, sekuestrimi i telefonit dhe ekspertimi pasues nuk kanë qenë proporcionalë dhe bien ndesh me vendimin njësues nr. 147/2021. Vendimi i ekspertimit të telefonit, shprehet ajo, është i përgjithshëm, evaziv dhe shumë i gjerë, pa përcaktuar të dhënat elektronike që i shërbenin hetimit dhe pa parashikuar masa specifike për mbrojtjen e tyre. Sipas saj, sekuestrimi dhe ekspertimi kanë çuar në aksesimin e të gjitha të dhënave të ruajtura në telefon, ndonëse vetëm një pjesë e tyre lidhej me hetimin. Në këtë drejtim, vijon kërkuesja, edhe materiali i paraqitur në mbështetje të kërkesës për përjashtimin e gjyqtarit kushtetues tregon qartë se organi i ndjekjes penale ka aksesuar edhe të dhëna që nuk lidhen me hetimin. Për më tepër, shprehet kërkuesja, komunikimet e saj kanë natyrë periferike dhe pa rëndësi të veçantë për hetimin ku edhe pse ka kaluar më shumë se 1 vit e 4 muaj nga sekuestrimi, telefoni ende nuk i është kthyer.

112. Nga ana tjetër, subjekti i interesuar ka prapësuar se sekuestrimi i telefonit celular të kërkueses është kryer për nevojat e hetimit, me qëllim ekzaminimin e mëtejshëm, pasi është verifikuar se në të gjendej një numër i konsiderueshëm të dhënash me rëndësi për hetimin dhe se ekzistonin prova e indicie të mjaftueshme për lidhjen e kërkueses me hetimin penal. Sipas

tij, ndërhyrja ka qenë e domosdoshme dhe nuk kanë ekzistuar alternativa të tjera më të lehta, të cilat të siguronin të njëjtin rezultat hetimor. Nisur nga volumi i madh i të dhënave, shprehet ai, vijimi i këqyrjes në vend të telefonit nga OPGJ-të, sikundër edhe ekstraktimi dhe kopjimi i të dhënave, për shkak të kohës që nevojitet për realizimin e tyre, ka qenë objektivisht e pamundur, ndaj është proceduar me sekuestrimin e telefonit, çka ka qenë e domosdoshme edhe për shkak të natyrës së brishtë të provës elektronike, e cila mund të zhduket menjëherë, në çast. Po sipas tij, ndërhyrja ka qenë proporcionale, e orientuar vetëm drejt të dhënave që lidhen me faktin penal dhe me personat e përfshirë, të cilat nuk janë bërë publike dhe do të përdoren vetëm për qëllime hetimore, duke mos qenë ajo e paarsyeshme ose arbitrare. Pretendimet për gjyqtarin kushtetues, shprehet ai, kanë pasur për qëllim të pasqyrojnë marrëdhënien e tij me kërkuesen dhe lidhen me objektin e gjykimit të çështjes, duke mos tejkaluar asnjë normë. Sekuestrimi i telefonit dhe mbajtja e tij si provë materiale, vijon ai, për aq kohë sa është e domosdoshme për të provuar faktin penal, është në përputhje edhe me vendimin njësues nr. 147/2021. Nëse telefoni do të kthehej, ekziston rreziku i dëmtimit ose i zhdukjes së provës dhe në kushtet kur hetimet vazhdojnë, kthimi i tij është i pamundur edhe për shkak se mund të lindë nevoja për riekspertim.

113. Gjykata, për sa i përket kriterit të proporcionalitetit të ndërhyrjes, është shprehur se ai nënkupton që marrëdhënia midis ndërhyrjes (kufizimit) dhe qëllimit të ndjekur duhet të jetë e arsyeshme. Ajo e ka analizuar këtë kriter në drejtim: i) të nevojës, pra të aftësisë së masës për të arritur qëllimin e ndjekur; ii) të përshtatshmërisë, në kuptimin që masa të mos shkojë përtej asaj që është e pashmangshme; iii) si dhe të ashpërsisë, në kuptim të shtrirjes së masës, përfshirë edhe kohëzgjatjen e saj (*shih vendimet nr. 42, datë 01.07.2025; nr. 79, datë 12.11.2024; nr. 29, datë 16.04.2024 të Gjykatës Kushtetuese*).

114. Gjykata, mbështetur edhe në standardet e GJEDNJ-së, ka pohuar se, edhe pse autoritetet publike, në funksion të parandalimit dhe ndjekjes penale, mund të përdorin masa për sigurimin e provave, ajo kontrollon nëse arsyet përkatëse janë relevante dhe të mjaftueshme dhe nëse janë respektuar garancitë kundër abuzimit, duke kërkuar që ligji dhe praktika të ofrojnë mbrojtje të mjaftueshme dhe efektive, si dhe që proporcionaliteti të vlerësohet mbi bazën e rrethanave konkrete. Në këtë drejtim, për të përcaktuar nëse ndërhyrja është proporcionale me qëllimin e ndjekur, mbahen në konsideratë, ndër të tjera, rrethanat e lëshimit të urdhrit të

kërkimit, përmbajtja e fushëveprimi i tij, mënyra e zbatimit dhe pasojat e mundshme për personin e prekur. Në kontekstin e kontrolleve dhe të sekuestrimeve, Gjykata ka theksuar se ligji duhet të ofrojë garanci të mjaftueshme dhe të përshtatshme kundër arbitraritetit, përfshirë edhe mundësinë e një shqyrtimi efektiv të masave që cenojnë të drejtën për jetë private. Po kështu, në kontekstin e urdhrave për kërkim dhe sekuestrim, Gjykata ka theksuar se ato duhet të përmbajnë kufizime të qarta, në mënyrë që ndërhyrja të mos jetë potencialisht e pakufizuar dhe, për këtë arsye, joproporcionale. Urdhri duhet të specifikojë fushëveprimin dhe kriteret e zbatimit, si dhe një minimum informacioni që mundëson mbikëqyrjen e ekzekutimit dhe verifikimin e respektimit të kufijve. Urdhrat e formuluar gjerësisht, pa të dhëna të mjaftueshme mbi hetimin ose objektin e sekuestrimit, nuk garantojnë ekuilibrin e drejtë ndërmjet interesit publik dhe të drejtave të individit, duke iu dhënë organeve hetimore kompetenca tepër të gjera, ndërsa individit të prekur i kufizojnë mundësinë për të zbuluar, parandaluar dhe raportuar abuzimet. Mungesa e një urdhri gjyqësor paraprak mund të kompensohet vetëm nga një shqyrtim gjyqësor *ex post* për ligjshmërinë dhe domosdoshmërinë e masës, i cili duhet të jetë real dhe efektiv në rrethanat konkrete *(shih vendimet nr. 42, datë 01.07.2025; nr. 79, datë 12.11.2024; nr. 29, datë 16.04.2024 të Gjykatës Kushtetuese*).

115. Gjykata, duke mbajtur në konsideratë se sekuestrimi i telefonit celular përbën në vetvete edhe sekuestrim të të dhënave në përmbajtjen e tij *(shih paragrafin 51 më sipër),* thekson se, në këto raste, organi procedues duhet të garantojë mbrojtjen efektive të të drejtave themelore mbi të dhënat personale dhe fshehtësinë e korrespondencës, përmes disa standardeve bazë, të tilla, si: i) kufizimi objektiv dhe material i ndërhyrjes, që nënkupton ndalimin e çdo veprimi të paautorizuar nga gjykata në drejtim të hapjes/hyrjes në pajisje, kërkimit, nxjerrjes, përpunimit dhe përdorimit të të dhënave personale dhe/ose korrespondencës; ruajtjen e pajisjes së sekuestruar, kur ajo përmban të dhëna personale dhe/ose korrespondencë, në gjendje të mbyllur, të vulosur, veprim ky që, kur është e mundur, duhet të kryhet në prani të individit dhe/ose avokatit dhe të dokumentohet me procesverbal; si dhe ndalimin e bërjes së kopjeve të përmbajtjes së pajisjes pa autorizim gjyqësor, me përjashtim të rastit kur një kopje teknike e plotë kryhet vetëm si masë paraprake ruajtjeje në kushtet e urgjencës, për të parandaluar humbjen ose ndryshimin e provës, kur ekziston realisht mundësia e ndërhyrjes mbi gjendjen e të dhënave dhe fshirjen e tyre në distancë, duke garantuar integritetin e provës dhe zinxhirin e ruajtjes; ii)

ndarja e qartë ndërmjet të dhënave me rëndësi për hetimin dhe atyre të parëndësishme, si dhe atyre që gëzojnë mbrojtje të posaçme nga ligji; iii) ushtrimi i një kontrolli gjyqësor real dhe efektiv për çdo fazë të ndërhyrjes; iv) respektimi i parimit të minimizimit, në kuptimin që, edhe kur lejohet ruajtja paraprake e përmbajtjes së pajisjes në kushtet e urgjencës, çdo veprim i mëtejshëm i kërkimit, analizës, përzgjedhjes dhe marrjes të të dhënave me rëndësi për hetimin kërkon autorizim të posaçëm nga gjykata dhe duhet të kufizohet në minimumin e domosdoshëm.

116. Duke iu kthyer çështjes konkrete, Gjykata vëren se kërkuesja ka pretenduar edhe se qëllimi i ndjekur nga organi procedues mund të arrihej me masa më të lehta dhe më pak kufizuese për të drejtat e saj, të realizueshme përmes alternativave, të tilla, si: i) vijimi i këqyrjes në vend të telefonit nga OPGJ-të; ii) kopjimi vetëm i atyre të dhënave që paraqisnin interes për hetimin; iii) sekuestrimi i telefonit vetëm për një periudhë të kufizuar kohore, sa ishte e nevojshme për këqyrjen dhe kopjimin e të dhënave me interes për hetimin.

117. Në lidhje me alternativën e parë, *vijimin e këqyrjes së telefonit*, Gjykata vëren se këqyrja e telefonit përmes ekranit, në kushtet e një situate urgjence dhe përballë një vëllimi potencialisht të lartë të të dhënave, nuk duket se ofron domosdoshmërisht garanci të barasvlershme me ato që kërkohen për sigurimin e provës në formë të plotë, të verifikueshme dhe të qëndrueshme. Në veçanti, vijimi i këqyrjes në vend nuk siguron, në vetvete, ruajtjen e integritetit të të dhënave dhe gjurmueshmërinë e veprimeve për dokumentimin e plotë të asaj që është kërkuar, parë dhe përzgjedhur, elemente këto të cilat janë thelbësore, si për vlefshmërinë provuese të materialit, ashtu edhe për mundësinë e kontrollit gjyqësor efektiv për respektimin e kufijve të ndërhyrjes. Për më tepër, një këqyrje e tillë do të kërkonte një shfletim të gjerë të përmbajtjes së telefonit, çka do të rrezikonte të rriste shkallën e ndërhyrjes në sferën private pa garanci të mjaftueshme.

118. Për sa i takon alternativës së dytë, *kopjimin e të dhënave*, Gjykata çmon se kopjimi selektiv i të dhënave mund të përbëjë, në parim, një mjet më pak kufizues, por zbatueshmëria e tij varet nga ekzistenca e kritereve paraprake të qarta që kufizojnë fushëveprimin e kërkimit, të tilla, si: kontakte të caktuara, periudhë kohore specifike, aplikacione, fjalë kyçe ose kritere filtrimi të caktuara, në mënyrë që përzgjedhja të mos bëhet në mënyrë rastësore ose e pavërtetueshme në një kontroll *ex post.* Në mungesë të një autorizimi me kufij të përcaktuar, seleksionimi "në vend" i të dhënave

do të rrezikonte të ishte ose i paqëndrueshëm e potencialisht arbitrar ose të presupozonte një ekspozim të gjerë ndaj të dhënave të parëndësishme për hetimin. Nga ana tjetër, duket se vetëm pas sigurimit të burimit të provës, parimi i minimizimit të ndërhyrjes merr peshë të posaçme, pikërisht në fazën e kërkimit, analizës, përzgjedhjes dhe marrjes të të dhënave me rëndësi për hetimin, duke u orientuar vetëm drejt kategorive të lidhura me objektin e hetimit dhe duke përjashtuar ekspozimin e të dhënave të parëndësishme ose të atyre që gëzojnë mbrojtje të posaçme nga ligji.

119. Lidhur me alternativën e tretë, *sekuestrimin e telefonit brenda një periudhe të kufizuar kohore*, Gjykata vëren se kufizimi kohor i mbajtjes në sekuestro i pajisjes/telefonit nuk mund të përcaktohet në mënyrë të përgjithshme dhe abstrakte, sikurse kërkuesja pretendon "deri në një muaj", pasi një gjë e tillë varet nga rrethanat konkrete të hetimit dhe nga veprimet procedurale që duhen kryer për sigurimin dhe administrimin e provës. Megjithatë, Gjykata çmon të theksojë se vijimi i mbajtjes në sekuestro i pajisjes dhe/ose i të dhënave të nxjerra prej saj nuk mund të mbështetet vetëm në një referim të përgjithshëm të interesit të hetimit, por kërkon arsyetim të posaçëm dhe kontroll gjyqësor efektiv për domosdoshmërinë e vijimit, si në shtrirje, ashtu edhe në kohë, veçanërisht kur bëhet fjalë për një person që nuk është subjekt nën hetim.

120. Në vijim, Gjykata thekson se vlerësimi i këtyre alternativave në fazën fillestare të sigurimit të provës nuk legjitimon, në mënyrë automatike, kërkimin dhe përpunimin potencialisht të pakufizuar të të gjithë përmbajtjes së pajisjes. Për rrjedhojë, Gjykata do të shqyrtojë nëse mënyra e autorizimit dhe e zbatimit të ekspertimit teknik-elektronik të telefonit, si dhe ushtrimi i mbikëqyrjes gjyqësore *ex post,* përveç edhe kërkimi, edhe përpunimi i të dhënave në vijim, kanë ofruar garanci të mjaftueshme që ndërhyrja të kufizohej në minimumin e pashmangshëm dhe të mos shndërrohej në një aksesim dhe përpunim të pakufizuar të të dhënave.

121. Në këtë kuadër, për të vlerësuar nëse ndërhyrja është kufizuar në minimumin e pashmangshëm dhe është shoqëruar me garanci të mjaftueshme kundër arbitraritetit, Gjykata u kthehet rrethanave konkrete të rastit. Në veçanti, duke pasur parasysh se, sipas akteve të procedimit penal, interesi faktik i hetimit lidhej, në thelb, me komunikimet e kërkueses me persona të lidhur me hetimin, Gjykata do të shqyrtojë nëse vendimi i prokurorit për ekspertimin teknik-elektronik të telefonit, sikundër edhe ai për kërkimin dhe përzgjedhjen, në kopjen teknike të plotë, të të dhënave me rëndësi për hetimin, referuar nga subjekti i interesuar si këqyrje e aktit

të ekspertimit, kanë përmbajtur kufizime të mjaftueshme që ndërhyrja të orientohej vetëm drejt këtyre të dhënave dhe të mos shndërrohej në një aksesim të përgjithshëm të të gjithë përmbajtjes së telefonit.

122. Gjykata vëren se, në kushtet kur sekuestrimi i telefonit, ekspertimi pasues i tij dhe kërkimi e përzgjedhja e të dhënave janë kryer pa vendim paraprak të gjykatës, kërkohen garanci të shtuara që masa të mos shndërrohet në një përpunim potencialisht të pakufizuar të të dhënave personale dhe të korrespondencës. Për këtë arsye, Gjykata do të shqyrtojë nëse organi procedues ka përcaktuar garanci të mjaftueshme procedurale për të siguruar që ndërhyrja të mos tejkalonte objektivin e parandalimit dhe të ndjekjes penale të veprës, për të cilën është zbatuar. Një vendim që, në thelb, autorizon kërkim të dhënash, pa shkelur kufijtë e sekretit hetimor, duhet të përmbajë kufizime të qarta dhe tregues minimalë orientues në drejtim të objektit konkret të kërkimit, rrethit të personave/komunikimeve që kërkohen, shtrirjen kohore të kërkimit, aplikacionet relevante dhe, kur është e mundur, kritere filtrimi (kontakte, fjalë-kyçe etj.). Këto kufizime dhe tregues minimalë orientues duhet të jenë të përshtatshëm për të drejtuar si veprimtarinë e ekspertit, ashtu edhe të OPGJ-së, në mënyrë që ndërhyrja, veçanërisht në të drejtën për mbrojtjen e të dhënave personale dhe fshehtësinë e korrespondencës, të mos jetë potencialisht e pakufizuar dhe, si pasojë, joproporcionale. Po kështu, ato duhet t'i mundësojnë individit të prekur të dallojë, të parandalojë dhe të ankohet për abuzim, përveçse duhet të mundësojnë një kontroll të mëvonshëm efektiv nëse ekspertët ose OPGJ-të kanë përmbushur fushëveprimin e autorizuar të hetimit.

123. Në rastin konkret, Gjykata vëren se vendimi për kryerjen e ekspertimit teknik-elektronik të telefonit të kërkueses duket se është hartuar në terma të gjerë, duke mos kufizuar në mënyrë të arsyeshme fushëveprimin e masës. Ndonëse, sipas akteve të procedimit penal, interesi i parashtruar i hetimit lidhej me komunikime të kërkueses me persona të lidhur me hetimin, ekspertët janë autorizuar për evidentimin dhe ekstraktimin e një spektri të gjerë të kategorive të të dhënave, përfshirë thirrje, mesazhe, kontakte, materiale fotografike dhe filmike, regjistrime audio/video, të dhëna të logimeve dhe navigimeve, komunikime në rrjete sociale dhe në aplikacione të ndryshme, përfshirë edhe të dhëna të fshira ose të rikuperueshme, si dhe "çdo të dhënë tjetër" me rëndësi për hetimin. Në mungesë të lidhjes së qartë të kësaj shtrirjeje me objektin konkret të hetimit dhe në mungesë të kufizimeve të përcaktuara për objektin e kërkimit, për nga vetë formulimi i vendimit, prokurorët e çështjes praktikisht kanë disponuar për ekstraktimin e kopjimin

dhe, në këtë mënyrë, për sekuestrimin në bllok të përmbajtjes së telefonit, pavarësisht nëse të dhënat e memorizuara në të kishin ose jo rëndësi për hetimin. Në këto kushte, Gjykata do të vlerësojë në vijim nëse kjo mungesë kufizimesh është kompensuar nga garanci procedurale të mjaftueshme gjatë zbatimit dhe, veçanërisht, nga një mbikëqyrje gjyqësore *ex post* reale dhe efektive mbi fushëveprimin real të përpunimit të të dhënave.

124. Gjykata konstaton se, në rastin konkret, këqyrja e disa komunikimeve përmes ekranit dhe sekuestrimi i telefonit celular në vijim, janë kryer në prani të kërkueses. Megjithatë, ndërsa ekstraktimi i të dhënave në përmbajtjen e telefonit dhe kopjimi tyre u krye më pas, kërkuesja nuk u njoftua paraprakisht për një masë të tillë dhe as për mënyrën e zbatimit të saj, pra për përmbajtjen e kopjes. Gjykata, po ashtu, konstaton se ndonëse masa nuk është urdhëruar paraprakisht nga gjykata, kërkuesja ka pasur një mjet juridik për kundërshtimin e sekuestrimit të telefonit dhe të të dhënave kompjuterike në përmbajtjen e tij, të cilin ajo e ka shfrytëzuar. Në këto rrethana, u takonte gjykatave të zakonshme të vendosnin se për cilat të dhëna sekuestrimi do të duhet të mbahej. Gjykata ka vërejtur më lart se sekuestrimi i telefonit celular përbën në vetvete edhe sekuestrim të të dhënave në përmbajtjen e tij, si dhe se vendimi për ekspertimin e tij, ekstraktimin e të dhënave dhe krijimin e kopjes, është formuluar në terma të gjerë, duke mos kufizuar në mënyrë të arsyeshme fushëveprimin e tij vetëm drejt komunikimeve të kërkueses me persona të lidhur me hetimin, të cilat, sipas subjektit të interesuar, paraqisnin rëndësi për hetimin. Megjithatë, rezulton se të gjitha të dhënat kompjuterike në telefonin e kërkueses janë kopjuar dhe sekuestruar në tërësi.

125. Në këto rrethana, mënyra se si gjykatat e zakonshme kanë ushtruar funksionin e tyre mbikëqyrës ***ex post*** merr rëndësi të veçantë, duke qenë se ndërhyrja në rastin konkret, që buron nga aksesimi i të dhënave në telefonin celular të kërkueses, paraqet një intensitet shumë më të lartë kushtetues dhe një kontroll i tillë nuk duhet të reduktohet në verifikimin formal të sekuestrimit të pajisjes si send, por duhet të shtrihet në mënyrë të posaçme mbi fushëveprimin real të përpunimit të të dhënave, me mundësinë për ta kufizuar ose përjashtuar atë pjesë të ndërhyrjes që nuk justifikohet nga nevojat konkrete të hetimit.

126. Gjykata vëren se, ndonëse GJKKO-ja e Shkallës së Parë vuri në diskutim proporcionalitetin e masës së sekuestrimit të të gjitha të dhënave në përmbajtjen e telefonit të kërkueses dhe arriti në përfundimin se ky kriter ishte shkelur, gjykatat më të larta, në vendimet e kundërshtuara, u kufizuan

vetëm në kontrollin e masës së sekuestrimit të telefonit si send, pa shqyrtuar proporcionalitetin e sekuestrimit të të dhënave kompjuterike në përmbajtjen e tij. Veçanërisht, ato nuk trajtuan nëse do të ishte e mjaftueshme që kopjimi dhe sekuestrimi të mbahej vetëm për ato të dhëna që përmbanin komunikime të kërkueses me persona të lidhur me hetimin. Po kështu, ato nuk dhanë as ndonjë arsye specifike se përse kopjimi dhe sekuestrimi i të gjitha të dhënave në telefonin e kërkueses ka qenë i nevojshëm për hetimin. Për rrjedhojë, mënyra e ushtrimit të mbikëqyrjes *ex post* nga gjykatat e zakonshme më të larta nuk i mundëson Gjykatës të përcaktojë se kopjimi dhe sekuestrimi i të gjitha të dhënave elektronike në telefonin e kërkueses është proporcional në rrethanat e rastit.

127. Megjithatë, faktet e çështjes tregojnë se veprimtaria e dyshuar kriminale, për të cilën nevojitej ekstraktimi, kopjimi dhe sekuestrimi i të dhënave në përmbajtjen e telefonit të kërkueses, lidhet, në thelb, me komunikimet midis saj dhe personave të lidhur me hetimin. Nisur nga kjo, Gjykata vëren se duhet të ekzistojnë arsye të veçanta që të justifikojnë sekuestrimin e të gjitha të dhënave në përmbajtjen e telefonit. Megjithatë, në rastin konkret, arsye të tilla nuk janë paraqitur as në vendimin e sekuestrimit të telefonit, as në vendimin e ekspertimit, dhe as në ndonjë dokument tjetër. Në këto rrethana, Gjykata vlerëson se sekuestrimi i të gjitha të dhënave në përmbajtjen e telefonit, si dhe shqyrtimi edhe i të dhënave që nuk kanë rëndësi për hetimin, referuar për këtë materialit mbështetës të kërkesës për përjashtimin e gjyqtarit kushtetues, ka shkuar përtej asaj që ka qenë e nevojshme për arritjen e qëllimit legjitim.

128. Për sa më lart, Gjykata vlerëson se ekstraktimi, kopjimi dhe sekuestrimi i të gjitha të dhënave kompjuterike në përmbajtjen e telefonit celular të kërkueses, si dhe kërkimi e përpunimi i mëvonshëm i tyre, nuk duket se ka qenë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë dhe, rrjedhimisht, ndërhyrja nuk ka qenë proporcionale, pasi nuk provohet të jetë gjetur një ekuilibër i drejtë midis interesave të ndryshëm të përfshirë në këtë rast. Duke pasur parasysh interesin e një shoqërie demokratike për të siguruar respektimin e së drejtës për të vendosur vetë për informacionin personal të lidhur me të dhënat personale dhe fshehtësinë e korrespondencës së individit, pretendimi i kërkueses për cenimin e së drejtës për mbrojtjen e të dhënave personale dhe fshehtësinë e korrespondencës, të garantuara nga nenet 35 dhe 36 të Kushtetutës, është i bazuar, për aq kohë sa ndërhyrja është drejtuar përtej të dhënave me rëndësi për hetimin.

129. Gjykata vëren se, në rastin konkret, cenimi i së drejtës së ankueses

buron jo vetëm nga vendimmarrja e gjykatave të zakonshme, por nga vetë ndërhyrja vazhduese e shkaktuar nga ekstraktimi, kopjimi, ruajtja dhe kërkimi i të dhënave të nxjerra nga telefoni celular, në kushtet e mungesës së kufizimeve të qarta të fushëveprimit dhe të një mbikëqyrjeje gjyqësore *ex post* reale dhe efektive. Për rrjedhojë, duke mbajtur në konsideratë se kopja e të dhënave mbahet aktualisht vetëm nga organi i ndjekjes penale dhe nuk i është vënë në dispozicion as Gjykatës dhe as gjykatave të zakonshme në procesin objekt kontrolli kushtetues, Gjykata çmon se rikthimi i çështjes për rishqyrtim, edhe nëse do të shoqërohej me shfuqizimin e vendimeve të kundërshtuara të gjykatave të zakonshme, nuk do të garantonte në vetvete rivendosjen praktike të së drejtës së shkelur, pasi masa riparuese vendimtare duhet të konsistojë në ndarjen/filtrimin material të të dhënave me rëndësi dhe atyre pa rëndësi për hetimin, asgjësimin e menjëhershëm të këtyre të fundit dhe vendosjen e garancive procedurale e kontrollin gjyqësor për vijimin e mbajtjes në sekuestro të të dhënave me rëndësi për hetimin. Në këto rrethana, Gjykata vlerëson se konstatimi i cenimit të së drejtës për mbrojtjen e të dhënave personale dhe fshehtësinë e korrespondencës, i shoqëruar me urdhërime konkrete riparuese dhe me përcaktimin e organit përgjegjës, mënyrën dhe afatet e ekzekutimit, përmbush kërkesat e efektivitetit të ankimit kushtetues individual dhe e bën të panevojshëm dërgimin e çështjes për rishqyrtim në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm.

130. Gjykata, duke iu referuar përfundimeve të mësipërme, vëren se ndërhyrja e konstatuar në të drejtën për mbrojtjen e të dhënave personale dhe fshehtësinë e korrespondencës nuk lidhet vetëm me sekuestrimin e telefonit celular si send, por edhe me ekstraktimin, kopjimin, kërkimin dhe përpunimin në vijim të të dhënave të nxjerra nga ai. Për rrjedhojë, riparimi kushtetues nuk mund të mbetet vetëm deklarativ, por duhet të jetë i aftë të ndalojë vazhdimin e ndërhyrjes së pajustifikuar, të kufizojë ndërhyrjen e justifikueshme në minimumin e pashmangshëm, si dhe të vendosë garanci procedurale të mjaftueshme dhe efektive kundër arbitraritetit.

131. Gjykata rithekson se proporcionaliteti, në kuptimin e ngushtë, kërkon gjetjen e një ekuilibri të drejtë ndërmjet interesit publik për parandalimin dhe ndjekjen penale dhe interesit të individit për respektimin e së drejtës për të vendosur vetë për informacionin personal të lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale dhe fshehtësinë e korrespondencës. Ky ekuilibër nuk mund të konsiderohet i arritur kur masa hetimore është formuluar dhe zbatuar në terma potencialisht të pakufizuar, pa kufizime të

qarta të fushëveprimit dhe pa një kontroll real e të plotë të domosdoshmërisë dhe proporcionalitetit të saj.

132. Gjykata vëren se, në çështjet që lidhen me prova digjitale, identifikimi i të dhënave me rëndësi për hetimin dhe i atyre që duhet të asgjësohen presupozon jo vetëm vlerësimi teknik, por edhe njohjen konkrete të përmbajtjes së kopjes dhe të elementeve faktike të hetimit. Në rastin konkret, pamundësia e Gjykatës për të bërë një identifikim të tillë nuk buron vetëm nga volumi dhe natyra e të dhënave, por, mbi të gjitha, nga fakti se kopja e të dhënave të nxjerra nga telefoni nuk i është vënë në dispozicion Gjykatës dhe ajo nuk ka qenë objekt i një shqyrtimi real e të plotë as në gjykatat e zakonshme në procesin gjyqësor, që përbën objekt kontrolli kushtetues. Kopja e përmbajtjes së telefonit të kërkueses edhe aktualisht vijon të mbahet vetëm nga organi i ndjekjes penale, subjekti i interesuar. Megjithatë, kjo pamundësi faktike nuk e pengon Gjykatën të përcaktojë pasojat kushtetuese të cenimit dhe të urdhërojë një mekanizëm zbatimi që vendos kufij të qartë dhe mundëson verifikimin e respektimit të tyre. Në këto rrethana, Gjykata çmon se ekzekutimi i vendimit të saj duhet të konsiderohet si proces i detyruar në kuptimin se organi që disponon kopjen duhet të kryejë veprimet teknike të ndarjes/filtrimit dhe asgjësimit të të dhënave që nuk kanë lidhje me objektin e hetimit, ndërsa gjykata e zakonshme duhet të ushtrojë kontrollin gjyqësor efektiv për vijimin e mbajtjes në sekuestro të të dhënave me rëndësi për hetimin dhe për sa i përket respektimit të kufijve të ndërhyrjes, në mënyrë që të garantohet mbrojtje e mjaftueshme dhe efektive kundër arbitraritetit.

133. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se masat riparuese konsistojnë në ndarjen materiale të të dhënave në përmbajtjen e telefonit të kërkueses dhe, konkretisht: i) korrespondenca dhe të dhënat personale që nuk lidhen me objektin e hetimit penal e që duhet të asgjësohen; ii) korrespondenca dhe të dhënat personale që lidhen me objektin e hetimit penal, të cilat mund të mbahen përkohësisht, por vetëm nën kontroll gjyqësor, duke zbatuar garancitë procedurale të përcaktuara në arsyetimin e këtij vendimi, në mënyrë që ndërhyrja të mos mbetet potencialisht e pakufizuar.

134. Për sa më lart, Gjykata vëren se kërkesa nuk mund të pranohet në tërësinë e saj, pasi autoritetet publike, në funksion të parandalimit dhe ndjekjes penale, mund të përdorin masa për sigurimin e provave, për aq kohë sa ndërhyrja është e parashikuar nga ligji, ndjek një qëllim legjitim dhe është e domosdoshme në rrethanat konkrete, duke u shoqëruar me garanci kundër abuzimit. Megjithatë, Gjykata ka arritur në përfundimin se

kopjimi dhe sekuestrimi i të gjitha të dhënave kompjuterike në përmbajtjen e telefonit të kërkueses, si dhe kërkimi e përpunimi i tyre, pa kufizime të arsyeshme të fushëveprimit dhe pa arsye të veçanta që ta justifikojnë këtë shtrirje, ka shkuar përtej asaj që ka qenë e nevojshme për të arritur qëllimin legjitim. Për rrjedhojë, kërkesa pranohet vetëm në masën që lidhet me pjesën e ndërhyrjes joproporcionale dhe me pasojat e saj, si dhe me urdhërimin e masave riparuese që sigurojnë respektimin e së drejtës për mbrojtjen e të dhënave personale dhe fshehtësinë e korrespondencës në kuptim të neneve 35 dhe 36 të Kushtetutës ose të së drejtës për jetë private dhe të korrespondencës në kuptim të nenit 8 të KEDNJ-së. Në vlerësim të Gjykatës, pranimi i pjesshëm pasqyron ekuilibrin që duhet ruajtur ndërmjet interesit publik për mbarëvajtjen e hetimit penal dhe nevojës për mbrojtje efektive të të drejtave kushtetuese të kërkueses.

135. Gjykata vlerëson se, *së pari*, është rasti të konstatojë cenimin e të drejtave kushtetuese të kërkueses për mbrojtjen e të dhënave personale dhe fshehtësinë e korrespondencës për të dhënat kompjuterike që nuk lidhet me objektin e hetimit penal. Siç u parashtrua, nga faktet e çështjes, rezulton se interesi real i hetimit lidhet, në thelb, me komunikimet e kërkueses me persona të lidhur me hetimin, ndaj është e justifikueshme që ndërhyrja të mund të shtrihet vetëm në atë pjesë të korrespondencës dhe të dhënave personale që lidhen me objektin konkret të hetimit penal. Nga ana tjetër, për të legjitimuar kopjimin dhe sekuestrimin e të gjitha të dhënave të tjera në përmbajtjen e telefonit të kërkueses, si dhe për kërkimin e përpunimin në tërësi të tyre, kërkohen arsye të veçanta dhe të mjaftueshme, çka në rastin konkret nuk janë parashtruar as në vendimin e sekuestrimit, as në vendimin e ekspertimit teknik-elektronik të telefonit, dhe as në ndonjë dokument tjetër. Për pasojë, ekstraktimi, kopjimi, sekuestrimi dhe shqyrtimi i korrespondencës dhe i të dhënave personale që nuk lidhen me objektin e hetimit cenojnë fshehtësinë e korrespondencës dhe të drejtën për mbrojtjen e të dhënave personale të kërkueses. Për rrjedhojë, Gjykata konstaton cenimin e fshehtësisë së korrespondencës dhe së drejtës për mbrojtjen e të dhënave personale, për pjesën që nuk lidhet me objektin e hetimit penal, pasi nuk provohet të jetë gjetur ekuilibri i drejtë ndërmjet interesave të përfshirë.

136. *Së dyti*, Gjykata vlerëson se është rasti të urdhërojë asgjësimin e kopjes të të dhënave që nuk lidhen me objektin e hetimit. Ajo vëren se konstatimi i cenimit të të drejtave kushtetuese të kërkueses do të ishte i pamjaftueshëm, nëse nuk do të shoqërohej me masa riparuese konkrete.

Në këtë kuptim, për sa kohë që kopjet e korrespondencës dhe të dhënave personale që nuk lidhen me objektin e hetimit penal vazhdojnë të mbahen nga organi i ndjekjes penale, ndërhyrja në të drejtat e kërkueses vazhdon në kohë dhe rreziku i aksesimit ose përdorimit të mëtejshëm mbetet aktual. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se asgjësimi i kopjeve të korrespondencës dhe i të dhënave personale të nxjerra nga telefoni celular i kërkueses, për pjesën që nuk lidhet me objektin e hetimit penal, është një masë riparuese e domosdoshme për të ndaluar ndërhyrjen e pajustifikuar dhe për të rivendosur, sa të jetë e mundur, respektimin e të drejtave të saj. Kjo masë buron nga detyrimi i autoriteteve publike për të mos mbajtur nën kontroll të dhëna që nuk justifikohen nga qëllimi legjitim i hetimit. Në këtë drejtim, Gjykata mban parasysh se realizimi i këtij asgjësimi presupozon identifikimin teknik të të dhënave që duhet të zhduken. Në rrethanat kur kopja mbahet vetëm nga organi i ndjekjes penale, subjekti i interesuar, është ky organ që ka mundësi për të kryer identifikimin dhe asgjësimin material të të dhënave përkatëse. Megjithatë, duke qenë se cenimi i konstatuar lidhet pikërisht me shtrirjen e pakufizuar dhe mungesën e mbikëqyrjes reale, identifikimi dhe asgjësimi nuk mund të mbeten diskrecionale, por duhet të realizohen në mënyrë të verifikueshme, sipas garancive procedurale të përcaktuara në arsyetimin e këtij vendimi dhe nën mbikëqyrjen e gjykatës së zakonshme.

137. Nga ana tjetër, Gjykata, *së treti*, vlerëson se është rasti të shprehet për vijimin e mbajtjes në sekuestro të të dhënave kompjuterike që kanë lidhje me objektin e hetimit, por duke ia nënshtruar këtë kontrollit gjyqësor. Në masën që ekzistojnë të dhëna që lidhen me objektin e hetimit penal, Gjykata çmon se ruajtja e tyre mund të jetë e domosdoshme për sigurimin e provës dhe mbarëvajtjen e procedimit penal. Megjithatë, vijimi i mbajtjes së këtyre të dhënave nuk mund të konsiderohet i ligjshëm dhe proporcional vetëm mbi bazën e interesit të hetimit, pa u vendosur nën kufij të qartë dhe mbikëqyrje gjyqësore të efektshme, sidomos kur ndërhyrja fillestare është konstatuar si e shtrirë në mënyrë të pakufizuar dhe pa kontroll gjyqësor *ex post* real e të plotë. Mbikëqyrja gjyqësore në rastin konkret duhet të përfshijë verifikimin e lidhjes së kategorive të të dhënave me objektin e hetimit, domosdoshmërinë e ruajtjes së tyre, si dhe kufijtë në shtrirje dhe në kohë të kësaj mbajtjeje, në mënyrë që ruajtja të kufizohet vetëm në të dhënat që lidhen me objektin e hetimit penal dhe të mos tejkalojë masën e pashmangshme. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se, në parim, kontrolli gjyqësor duhet të bëhet me kontradiktoritet, me pjesëmarrjen e palëve. Megjithatë, në rrethanat kur hetimi në rastin konkret është ende në vijim dhe ekziston rrezik real që zbulimi i materialit të cenojë sekretin

hetimor, duke mbajtur parasysh edhe faktin se kërkuesja nuk është subjekt nën hetim, gjykata e zakonshme e shkallës së parë mund të kufizojë kontradiktoritetin vetëm për aq sa është e domosdoshme dhe në mënyrë proporcionale, duke kompensuar çdo kufizim me garanci procedurale që ruajnë karakterin real dhe efektiv të kontrollit, të tilla, si: shqyrtim të plotë, vendimmarrje të arsyetuar dhe dokumentim të kufijve të masës. Duke mbajtur në konsideratë që Gjykata nuk është në pozicionin e duhur për të vlerësuar rrezikun që mund t'i vijë integritetit të hetimit penal, ajo vëren se kufizimi i kontradiktoritetit mund të shtrihet tek e drejta e njohjes me aktet e çështjes nëse verifikohet rreziku i cenimit të integritetit të hetimit penal, por gjithsesi kjo mbetet çështje për t'u zbatuar nga prokuroria dhe gjykata e zakonshme, sipas standardeve të këtij vendimi. Në këtë kuptim, kontrolli gjyqësor nuk duhet të mbetet formal, por duhet të ushtrohet realisht mbi ndërhyrjen që prek nenet 35 dhe 36 të Kushtetutës dhe nenin 8 të KEDNJ-së, pra mbi përpunimin dhe ruajtjen e të dhënave.

138. Gjykata, po ashtu, *së katërti*, vlerëson se është rasti të urdhërojë zbatimin e garancive procedurale për vijimin e mbajtjes në sekuestro të telefonit celular të kërkueses, si send që mbart korrespondencë dhe të dhëna personale. Duke ritheksuar se telefoni celular është send që mbart të dhëna personale dhe të korrespondencë dhe, për rrjedhojë, mbajtja e tij në sekuestro dhe çdo veprim i mëtejshëm për përmbajtjen e tij përbëjnë ndërhyrje në nenet 35 dhe 36 të Kushtetutës dhe nenin 8 të KEDNJ-së, Gjykata çmon se vijimi i mbajtjes në sekuestro i telefonit duhet të shoqërohet me garancitë procedurale të evidentuara në arsyetimin e këtij vendimi, të afta për të parandaluar arbitraritetin dhe për të kufizuar ndërhyrjen brenda kuadrit të hetimit penal. Këto garanci synojnë që ndërhyrja të mos jetë potencialisht e pakufizuar, që çdo akses dhe kërkim të jetë i justifikuar dhe i kufizuar vetëm në të dhënat që lidhen me hetimin penal dhe të mos tejkalojë masën e pashmangshme, si dhe që të mundësohet kontroll gjyqësor efektiv për respektimin e kufijve të masës. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se, duke qenë se kërkuesja nuk është subjekt nën hetim, por person që ka dijeni për rrethana të tij, zbatimi rigoroz i garancive procedurale merr peshë të shtuar, pasi ndërhyrja mbi të drejtat e saj nuk mund të shtrihet përtej minimumit të domosdoshëm që justifikohet nga hetimi penal.

139. Gjykata gjithashtu, *së fundmi*, vlerëson se është rasti për të ngarkuar Prokurorinë e Posaçme për ekzekutimin e vendimit dhe përcaktimin e një afati deri në 3 muaj për ekzekutimin. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se ekzekutimi i vendimit të saj kërkon kryerjen e veprimeve konkrete mbi kopjen e të dhënave të nxjerra nga telefoni, kopje e cila, siç u përmend, mbahet

aktualisht nga Prokuroria e Posaçme. Për pasojë, vetëm ky organ ka mundësi faktike të kryejë ndarjen/filtrimin dhe asgjësimin material të të dhënave që nuk kanë lidhje me hetimin si dhe të administrojë në vijim atë pjesë të të dhënave kompjuterike që pretendohet se kanë lidhje me të. Megjithatë, Gjykata çmon se ngarkimi i Prokurorisë së Posaçme me ekzekutimin nuk nënkupton lënien e vlerësimit përfundimtar në diskrecionin e saj. Përkundrazi, ekzekutimi duhet të kuptohet si realizim teknik i detyrimeve që rrjedhin nga ky vendim dhe si detyrim për të vënë në lëvizje kontrollin gjyqësor për vijimin e mbajtjes në sekuestro të të dhënave kompjuterike që kanë lidhje me hetimin. Për këtë qëllim, Prokuroria e Posaçme duhet t'i paraqesë gjykatës së zakonshme të shkallës së parë kërkesën për miratimin e vijimit të sekuestrimit të të dhënave që pretendon se kanë lidhje me hetimin, duke arsyetuar në mënyrë konkrete këtë lidhje dhe domosdoshmërinë e ruajtjes të të dhënave, si dhe duke siguruar zbatimin e garancive procedurale të përcaktuara në arsyetimin e këtij vendimi. Gjykata çmon se afati 3-mujor është i domosdoshëm për të garantuar efektivitetin e vendimit dhe për të shmangur zgjatjen në kohë të një ndërhyrjeje të konstatuar si joproporcionale. Ky afat detyron subjektin e interesuar për të kryer, brenda një kohe të arsyeshme, veprimet e nevojshme për ndarjen/filtrimin dhe asgjësimin e atyre të dhënave kompjuterike që nuk kanë lidhje me hetimin, si dhe për të paraqitur kërkesën për kontroll gjyqësor për vijimin e mbajtjes në sekuestro të të dhënave të tjera (atyre që kanë lidhje me hetimin), duke respektuar garancitë procedurale të përcaktuara në arsyetimin e këtij vendimi.

140. Në përfundim, Gjykata, bazuar në rrethanat e çështjes dhe arsyetimin e mësipërm, vlerëson se urdhërimet si më lart në dispozitivin e vendimit janë të përshtatshme dhe të domosdoshme për të bërë efektive mbrojtjen kushtetuese të të drejtave të kërkueses, duke garantuar njëkohësisht interesin publik për mbarëvajtjen e hetimit penal dhe duke vendosur mekanizma të verifikueshëm që parandalojnë arbitraritetin, në përputhje me kërkesën për gjetjen e një ekuilibri të drejtë ndërmjet interesave të përfshirë.

141. Gjykata, duke ritheksuar detyrimin kushtetues që rrjedh nga neni 132 i Kushtetutës për zbatimin e vendimeve të saj, të cilat janë përfundimtare dhe të detyrueshme për organet publike, çmon se, duke pasur parasysh natyrën e çështjes, duhet të shprehet edhe për efektet e këtij vendimi, në kuptim të nenit 76, pika 3, të Ligjit Organik të saj. Në këtë kuadër, duke iu referuar dhe rregullimit ligjor për fuqinë prapavepruese të vendimeve të saj në rastet përjashtimore (pika 7), Gjykata thekson se ky vendim nuk ka efekte prapavepruese në çështje të ngjashme të sekuestrimit të të dhënave kompjuterike, në të cilat nuk është paraqitur ankim kushtetues

individual ose për të cilat është paraqitur ankim dhe kontrolli gjyqësor ka përfunduar. Ky vendim prodhon efektet e tij në kuadër të këtij rasti konkret dhe brenda kufijve të urdhërimeve të dispozitivit, por edhe në çdo rast tjetër në të ardhmen, duke orientuar organet përgjegjëse për zbatimin e masave hetimore të kësaj natyre, në përputhje me garancitë procedurale të përcaktuara në arsyetimin e tij.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, si dhe neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, njëzëri,

V E N D O S I:

1. Pranimin e pjesshëm të kërkesës.

2. Konstatimin e cenimit të fshehtësisë së korrespondencës, si dhe së drejtës për mbrojtjen e të dhënave personale, për pjesën që ato nuk lidhen me objektin e hetimit penal.

3. Asgjësimin e kopjeve të korrespondencës dhe të dhënave personale të nxjerra nga telefoni celular i kërkueses që nuk lidhen me objektin e hetimit penal.

4. Vijimin e mbajtjes në sekuestro të kopjeve të korrespondencës dhe të dhënave personale që lidhen me objektin e hetimit penal, duke ia nënshtruar kontrollit gjyqësor.

5. Urdhërimin e zbatimit të garancive procedurale të parashikuara në arsyetimin e këtij vendimi në vijimin e mbajtjes në sekuestro të telefonit celular, si send që mbart korrespondencë dhe të dhëna personale.

6. Ngarkimin e Prokurorisë së Posaçme për ekzekutimin e vendimit brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e tij, duke respektuar garancitë procedurale, sipas arsyetimit të këtij vendimi.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 29.07.2025
Shpallur më 13.01.2026

Vendim nr. 45, datë 31.07.2025
(V-45/25)

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Holta Zaçaj, Kryetare, Marsida Xhaferllari, Fiona Papajorgji, Sonila Bejtja, Ilir Toska, Genti Ibrahimi, Marjana Semini, Sandër Beci, anëtarë, me sekretare Belma Lleshi, në datat 23.06.2025, 01.07.2025 dhe 31.07.2025 mori në shqyrtim në seancë plenare publike kërkesën nr. 6 (Nj) 2024 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: **JO MË PAK SE NJË E PESTA E DEPUTETËVE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË,** përfaqësuar nga deputetja Ina Zhupa dhe avokatët Franci Nuri dhe Marash Logu, me autorizim.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, përfaqësuar nga sekretari i përgjithshëm Genci Gjonçaj.

KËSHILLI I MINISTRAVE, përfaqësuar nga Herald Jonuzaj, Edlira Kokona, Vangelt Duni, Sofjan Jaupaj dhe avokatja e shtetit Irma Qosja.

SHOQATA ORNITOLOGJIKE E SHQIPËRISË, përfaqësuar nga avokatët Irena Dule, Vladimir Meçi dhe Dorian Matlija.

QENDRA PËR RUAJTJEN E EKOSISTEMEVE NATYRORE NË SHQIPËRI, përfaqësuar nga avokatët Irena Dule, Vladimir Meçi dhe Dorian Matlija.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i ligjit nr. 21/2024 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 81/2017 "Për zonat e mbrojtura"", si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe marrëveshjet ndërkombëtare.**

Pezullimi i zbatimit të ligjit nr. 21/2024 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 81/2017 "Për zonat e mbrojtura"", derisa vendimi përfundimtar i Gjykatës Kushtetuese të hyjë në fuqi.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, pika 1, 5, 6, 7, 15, 18, 56, 59, pika 1, shkronja "d", 81, 82, 83, 122, 124, 131, pika 1, shkronjat "a" dhe "e", 132 dhe 134, pika 1, shkronja "c", të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sandër Beci, shqyrtoi pretendimet e kërkuesit, një grup deputetësh prej jo më pak se një e pesta e deputetëve të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë (*kërkuesi*), i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet e subjekteve të interesuara, Kuvendit të Republikës së Shqipërisë *(Kuvendi)* dhe Këshillit të Ministrave, të cilat kanë kërkuar rrëzimin e kërkesës, parashtrimet e subjekteve të interesuara, Shoqatës Ornitologjike të Shqipërisë (*AOS*) dhe Qendrës për Ruajtjen e Ekosistemeve Natyrore në Shqipëri (*Eco Albania*), të cilat kanë kërkuar pranimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I
Rrethanat e çështjes

1. Në datën 04.05.2017 Kuvendi ka miratuar ligjin nr. 81/2017 "Për zonat e mbrojtura" ("*ligji për zonat e mbrojtura*" ose "*ligji bazë"*), i cili është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 116, datë 23.05.2017. Ky ligj ka për objekt shpalljen, ruajtjen, administrimin, menaxhimin, përdorimin e qëndrueshëm të zonave të mbrojtura mjedisore dhe të burimeve të tyre natyrore e biologjike, në bazë të parimit të zhvillimit të qëndrueshëm, për të garantuar përmbushjen e funksioneve mjedisore, ekonomike, sociale

e kulturore në interes të të gjithë shoqërisë (*neni 1*). Qëllimi i tij është të sigurojë mbrojtje të veçantë të zonave të mbrojtura mjedisore dhe përbërësve të rëndësishëm të biodiversitetit dhe të natyrës në to nëpërmjet: (i) shpalljes së zonave të mbrojtura mjedisore, me rëndësi të veçantë për vlerat e tyre natyrore, ekonomike apo sociale, si pjesë e trashëgimisë natyrore dhe kulturore të mjedisit; (ii) zhvillimit dhe mbrojtjes së zonave të mbrojtura mjedisore, pasurive kombëtare me rëndësi të veçantë për vlerat e rralla e të pazëvendësueshme të ekuilibrave natyrorë, biodiversitetit, si detyrim në interes të brezave të sotëm dhe të ardhshëm; (iii) lehtësimit të kushteve për zhvillimin e qëndrueshëm dhe promovimin e vlerësimin e shërbimeve të ekosistemeve (mjedisore); (iv) informimin dhe edukimin e publikut për gjendjen dhe dobishmërinë e zonave të mbrojtura mjedisore (*neni 2*).

2. Në datën 20.11.2023 një grup prej 12 deputetësh të Kuvendit ka propozuar projektligjin "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 81/2017 "Për zonat e mbrojtura"", me qëllim rregullimin e disa problematikave që vijnë si pasojë e zbatimit i ligjit lidhur me bashkëpunimin me qeverisjen vendore, si dhe zgjidhjen e disa ngërçeve që burojnë nga fakti se ligji është një ligj strikt mbrojtës, që nuk merr parasysh faktin se zonat e mbrojtura përbëjnë 21.5% të të gjithë territorit të Republikës së Shqipërisë ose 1/5-ën e vendit.

3. Komisioni Parlamentar për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin (*komisioni përgjegjës*) e ka shqyrtuar këtë projektligj dhe në datën 19.02.2024 ka miratuar raportin përkatës. Nga përmbajtja e raportit rezulton se projektligji nuk përafron ndonjë akt të veçantë të legjislacionit të Bashkimit Evropian (*BE*), ndërsa për sa i përket procesit të konsultimit, për shkak edhe të ndjeshmërisë së lartë mjedisore që ai përcjell, rezulton se është zhvilluar një proces i gjerë dhe gjithëpërfshirës konsultimi. Sipas raportit të komisionit përgjegjës, ky proces ka nisur me publikimin e projektligjit në platformën "Konsultimi i projektligjeve" në faqen zyrtare të Kuvendit, nga data 7 deri në datën 21 dhjetor 2023. Në të njëjtën kohë me publikimin në platformë ka nisur edhe komunikimi për marrjen e mendimeve të grupeve të interesit nëpërmjet adresës elektronike të komisionit përgjegjës. Sipas raportit, komisioni përgjegjës ka kërkuar edhe mendimin e Këshillit të Ministrave në lidhje me këtë projektligj, bazuar në nenin 82, pika 2, të Kushtetutës dhe nenin 68, pika 3, të Rregullores së Kuvendit. Po sipas raportit, komisioni përgjegjës ka zhvilluar seanca dëgjimore me përfaqësues të grupeve të interesit, të shoqatave/organizatave

që veprojnë në fushën e mbrojtjes së mjedisit, me ekspertë të fushës dhe përfaqësues të organizatave mjedisore dhe staf akademik në periudhën 30 janar deri më 12 shkurt 2024. Lidhur me efektet financiare të aktit, ka rezultuar se projektligji i prezantuar si nismë e deputeteve nuk kishte efekte financiare shtesë në buxhetin e shtetit.

4. Gjatë procesit të shqyrtimit të projektligjit, komisioni përgjegjës është njohur edhe me mendimin e Këshillit të Ministrave për projektligjin, të dërguar nëpërmjet vendimit nr. 56, datë 07.02.2024 të Këshillit të Ministrave "Mendim për projektligjin joqeveritar "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 81/2017 "Për zonat e mbrojtura"" (*VKM-ja nr. 56/2024*) (*shih faqet 21-28 të raportit të komisionit përgjegjës*). Sipas Këshillit të Ministrave, edhe pse ndryshimet në ligjin për zonat e mbrojtura janë të nevojshme për zhvillimin e qëndrueshëm të komuniteteve të këtyre zonave, projektligji është vlerësuar i paplotë, për rrjedhojë, sipas tyre, lind nevoja për një rishikim tërësor në një pjesë të konsiderueshme të propozimeve konkrete të cilat cenojnë qëllimin e mbrojtjes/ruajtjes së vlerave të zonave të mbrojtura dhe biodiversitetit. Këshilli i Ministrave ka propozuar ndërhyrje konkrete nen për nen, duke përfshirë propozimin për krijimin e Zyrave të Administrimit të Parqeve Kombëtare (*ZAPK*).

5. Gjatë shqyrtimit të projektligjit komisioni përgjegjës është njohur edhe me raportet e Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut (*komisioni i ligjeve*) të datës 19.02.2024 dhe të Komisionit për Çështjet Evropiane, po të datës 19.02.2024, në cilësinë e komisioneve për dhënie mendimi. Në përfundim, komisioni përgjegjës ka miratuar variantin integral të projektligjit, në parim, nen për nen dhe në tërësi dhe është shprehur dakord për kalimin e tij për miratim në seancë plenare.

6. Nga përmbajtja e relacionit shoqërues rezulton se qëllimet e tij kanë qenë: (i) adresimi i problematikave të evidentuara gjatë zbatimit të ligjit në praktikë lidhur me bashkëpunimin e qeverisjes vendore, komuniteteve dhe administratës së zonave të mbrojtura, si dhe ato lidhur me faktin se ligji bazë ishte strikt/mbrojtës, nuk merrte parasysh faktorin e komunitetit që bashkekziston në këto zona dhe faktin se zonat e mbrojtura përbëjnë më shumë se 1/5-ën e vendit; këto pa kompromentuar parimet bazë të zonave të mbrojtura, të ruajtjes dhe mbrojtjes së tyre; (ii) evidentimi i parimeve dhe politikave të reja, të përparuara, në një linjë me organizmat ndërkombëtarë, rezultat i realiteteve të reja dhe i nevojës për një zhvillim të qëndrueshëm;

(iii) dhënia e mundësisë qeverisjes lokale dhe komuniteteve të jenë pjesë e kësaj vendimmarrjeje.

7. Në datën 22.02.2024, tri ditë pas miratimit në komisionin përgjegjës, Kuvendi ka miratuar ligjin nr. 21/2024 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 81/2017 "Për zonat e mbrojtura"" (*ligji ndryshues*), i cili është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 50, datë 20.03.2024 dhe ka hyrë në fuqi 15 ditë pas botimit.

8. Ligji ndryshues ka sjellë ndryshime në nenin 3 të ligjit bazë "*Përkufizime*", në nenin 4 "*Parimet*", në nenin 9 "*Objektivat e shpalljes së territoreve si zona të mbrojtura*", në nenin 10 "*Shpallja e zonave të mbrojtura*", në nenin 12 "*Procedurat për shpalljen e zonave të mbrojtura*", në nenin 16 "*Parku kombëtar (kategoria II)*", në drejtim të mundësisë së lejimit të infrastrukturës dhe veprimtarive të mikpritjes, me standardet më të larta arkitektonike dhe mjedisore, për mbështetjen e turizmit të ekselencës (me 5 yje) dhe infrastrukturës mbështetëse për to në këto zona, në nenin 17 "*Monument natyror (kategoria III)*", në nenet 19 *"Rezervat natyror i menaxhuar/park natyror (kategoria IV)*" dhe 22 "*Zona të mbrojtura detare*", në drejtim të lejimit të veprimtarive dhe infrastrukturës turistike dhe infrastrukturës mbështetëse për to, në nenin 20 "*Peizazh i mbrojtur (kategoria V)*", në drejtim të lejimit të ndërhyrjeve të lejuara urbane, të rekreacionit apo atyre ekonomike brenda zonës. Është shfuqizuar neni 13 "*Ndarja në nënzona i territorit të zonës së mbrojtur kombëtare*" dhe janë ndryshuar nenet 23 "*Kurora e gjelbër*" dhe 24 "*Parqet natyrore bashkiake*". Ligji ndryshues ka sjellë ndryshime edhe në nenin 33 "*Veprimtaritë e lejuara në zonat e mbrojtura*", duke përcaktuar se zonat e mbrojtura shpallen me vendim të Këshillit të Ministrave (*VKM*), në të cilën përcaktohen edhe veprimtaritë e lejuara në të, si dhe në nenin 36 "*Ndryshimi i sipërfaqes*". Janë shtuar nenet 36/1 "*Ndryshimi i elementeve tekniko-formale*" dhe 39/1 "*Zyra e Administrimit të Parqeve Kombëtare*", që parashikon krijimin e ZAPK-ve si institucion tekniko-administrativ në varësi të ministrisë përgjegjëse për zonat e mbrojtura, i organizuar në nivel qendror dhe rajonal, për ushtrimin e veprimtarive brenda territorit gjeografik të zonës së kategorisë "Park kombëtar". Po kështu, janë ndryshuar edhe nenet 40, 47 - 50*,* 57, 66, 67, 69 dhe 74.

9. Në datën 01.11.2024 një grup prej 37 deputetësh të Kuvendit, në cilësinë e subjektit kushtetues jo më pak se një e pesta e deputetëve, i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me kërkesë për shfuqizimin e ligjit ndryshues, si të papajtueshëm me Kushtetutën dhe marrëveshjet

ndërkombëtare të ratifikuara, duke kërkuar edhe pezullimin e zbatimit të tij deri në hyrjen në fuqi të vendimit të Gjykatës. Kolegji i Gjykatës në datën 08.01.2025 ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare publike.

10. Në datën 27.01.2025 Mbledhja e Gjyqtarëve, pasi ka marrë në shqyrtim pretendimin e kërkuesit për pezullimin e zbatimit të ligjit ndryshues, në kuptim të parashikimeve të nenit 45 të ligjit nr. 8577/2000, me shumicë votash[1], ka vendosur rrëzimin e tij si të pabazuar, pasi ka vlerësuar se argumentet në mbështetje të atij pretendimi kanë natyrë të përgjithshme, duke mos arritur të provojë pasojat e rënda, të pariparueshme dhe reale nga zbatimi i ligjit objekt kërkese.

11. Në datën 05.03.2025 Mbledhja e Gjyqtarëve, pasi ka marrë në shqyrtim kërkesën e paraqitur nga organizatat jofitimprurëse AOS dhe Eco Albania për të marrë pjesë në këtë gjykim në cilësinë e subjekteve të interesuara, si dhe kërkesën e kërkuesit për pranimin e kësaj kërkese dhe thirrjen e tyre si subjekte të interesuara, në përputhje me parashikimet e nenit 39 të ligjit nr. 8577/20000, ka vendosur thirrjen në këtë gjykim, në cilësinë e subjekteve të interesuara, të organizatave AOS dhe Eco Albania.

II
Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

12. ***Kërkuesi***, në mënyrë të përmbledhur, ka parashtruar:

12.1. *Për pezullimin e zbatimit të ligjit ndryshues*:

12.1.1. Zbatimi i ligjit ndryshues do të sillte dëme ndaj interesave të ligjshëm të shtetit, të cilat rrezikojnë që të jenë të pariparueshme ose kthimin në gjendjen e mëparshme, shumë të vështirë. Nëse një subjekt tregtar nis punën në një nga zonat e mbrojtura dhe më pas Gjykata e shfuqizon ligjin si jokushtetues, dëmet e shkaktuara në mjedis, në përgjithësi, dhe në zonat e mbrojtura, në veçanti, do të jenë të mëdha dhe ndoshta të pakthyeshme, duke rrezikuar që ato zona të humbasin karakteristikat për të cilat janë shpallur si të tilla. Ndërkohë edhe subjektit tregtar të pajisur me lejet

[1] Gjyqtarja Marsida Xhaferllari votoi për pranimin e kërkesës, ndërsa gjyqtari Ilir Toska votoi për shqyrtimin e kërkesës për pezullim në seancë plenare.

përkatëse të zhvillimit/ndërtimit do t'i cenohen interesat dhe pritshmëritë e ligjshme.

12.2. *Për themelin:*

12.2.1. Procedura e nismës për projektligjin në rastin në shqyrtim mbart *shkelje të Rregullores së Kuvendit* lidhur me procedurat parlamentare për hartimin, paraqitjen, shqyrtimin dhe miratimin e projektligjeve. Projektligji ka ardhur në Kuvend në mënyrë jotransparente, pasi deputetët propozues pretendojnë se kërkesa ka ardhur nga disa kryetarë bashkish, por kjo kërkesë e tyre nuk i është vënë në dispozicion askujt për efekt transparence.

12.2.2. *Është cenuar e drejta e publikut për t'u informuar për gjendjen e mjedisit,* e parashikuar nga neni 56 i Kushtetutës, Konventa e Aarhusit dhe jurisprudenca e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*GJEDNJ*), të cilat kërkojnë që për parashikime ligjore që prekin mjedisin dhe zonat e mbrojtura, të kryhen konsultime publike gjatë gjithë hallkave të realizimit të procesit ligjvënës. Edhe në jurisprudencën kushtetuese është folur për "pjesëmarrje dhe konsultim efektiv", që nënkupton mundësinë për palët e përfshira në një procedurë legjislative për të kërkuar shpjegime dhe ofruar komentet e tyre për atë që është drafti më i mundshëm për t'u miratuar. Konventa e Aarhusit përcakton detyrimin e shteteve për marrjen e masave në garantimin e së drejtës së publikut për të pasur informacion për mjedisin, për të marrë pjesë në marrjen e vendimeve mjedisore dhe për t'iu drejtuar gjykatës në lidhje me këto çështje, ndërkohë që GJEDNJ-ja ka përcaktuar detyrimin e shteteve që përpara realizimit të projekteve që mund të sjellin pasoja në mjedis, të vënë në dispozicion të publikut informacione të vërteta, të besueshme, të sakta dhe të mjaftueshme, si dhe t`i japin mundësinë popullsisë së prekur për të kundërshtuar procedurat e dhënies së lejeve. Në rastin konkret, projektligji ka ardhur në Kuvend në mënyrë jotransparente, pasi kërkesa ka ardhur nga disa kryetarë bashkish, por ajo nuk është vënë në dispozicion të deputetëve dhe për projektligjin nuk janë kryer konsultimet e nevojshme me publikun. Komisioni përgjegjës parlamentar ka kryer konsultime vetëm për draftin fillestar të projektligjit,

ndërsa draftin final, pas ndryshimeve të bëra nga Këshilli i Ministrave, nuk ia ka nënshtruar konsultimit me grupet e interesit dhe publikun, edhe pse ai kishte pësuar ndryshime drastike, për më tepër teknike. Me këto ndryshime kanë kërkuar të konsultohen organizatat mjedisore, çka nuk është pranuar nga komisioni përgjegjës.

12.2.3. *Nuk është respektuar neni 82, pika 1, i Kushtetutës,* pasi edhe pse projektligji në versionin final krijonte efekte financiare shtesë në buxhetin e shtetit, ai nuk është shoqëruar me raportin përkatës që përligj shpenzimet financiare. Qëllimet e kushtetutëbërësit në këtë drejtim kanë qenë informimi i qytetarëve dhe deputetëve për kostot që sjell miratimi i një ligji të ri, si dhe mbrojtja e financave publike. Edhe Rregullorja e Kuvendit në nenin 68, pika 2, të saj përcakton një detyrim të tillë. Vetë raporti i komisionit të ligjeve të datës 09.02.2024 shprehet se projektligji ka efekte financiare, megjithatë më pas e ka injoruar plotësisht faktin se versioni final i projektligjit nuk është në përputhje me detyrimet kushtetuese. Kështu, krijimi i Zyrës së Administrimit të Parkut Kombëtar "Lumi i Vjosës" (*ZAPK Vjosa*) ka sjellë shtim të shpenzimeve në buxhetin e shtetit për periudhën 2025-2027, në masën 82 milionë lekë.

12.2.4. *Janë cenuar funksionet e Kuvendit dhe sistemi normativ*, pasi Kuvendi i është drejtuar Këshillit të Ministrave për marrje mendimi, duke u bazuar në nenin 82, pika 2, të Kushtetutës, pavarësisht se ajo nuk ishte dispozita e zbatueshme, pasi varianti fillestar i projektligjit nuk kishte efekte financiare shtesë në buxhetin e shtetit. Për më tepër, versioni i rishikuar i projektligjit sipas mendimit të Këshillit të Ministrave ka ndryshuar tërësisht nismën ligjore të deputetëve propozues, duke shtuar nene që krijojnë efekte financiare. Për rrjedhojë, janë anashkaluar procedurat e rregullta parlamentare, duke shtuar këtu edhe mungesën e tabelës së përputhshmërisë së ligjit me *acquis communautaire*.

12.2.5. *Ligji ndryshues cenon parimin e solidaritetit midis brezave*, të deklaruar në Preambulën e Kushtetutës, pasi dispozitat e tij heqin ndalimet ligjore me qëllim lejimin e turizmit të ekselencës (me 5 yje) dhe infrastrukturës mbështetëse në të

gjitha zonat e mbrojtura, përfshirë nënzonat qendrore të tyre, duke bërë që ligji ndryshues të sjellë pasoja të pakthyeshme për këto zona dhe duke cenuar edhe të drejtat dhe interesat e brezave të ardhshëm për të trashëguar një mjedis të pacenuar dhe relativisht të pandryshuar. Edhe Parimet e Maastricht-it për të Drejtat e Njeriut të Brezave të Ardhshëm, të miratuara nga Kombet e Bashkuara në vitin 2023, përcaktojnë se çdo brez ka detyrën të mbrojë dhe të mbështesë trashëgiminë kulturore dhe natyrore të tokës për brezat e ardhshëm (*parimi 8.b*). Solidariteti midis brezave përbën një qëllim themelor edhe të BE-së, ku Shqipëria synon të integrohet.

12.2.6. *Cenohen parimet e shtetit të së drejtës, barazisë përpara ligjit dhe hierarkisë së normave,* të parashikuara nga nenet 4 dhe 18 të Kushtetutës, pasi edhe pse kërkesa për ndryshimin e ligjit ka ardhur formalisht nga disa kryetarë bashkish drejtuar deputetëve, duket qartë se ligji ndryshues është i destinuar për përfitimin e vetëm një grupi individësh, investitorët e resorteve dhe të hoteleve me 5 yje. Ligji ndryshues nuk synon mbrojtjen e interesit të përgjithshëm dhe as vënien e rregullave të përgjithshme me qëllim ruajtjen e zonave të mbrojtura, por synon heqjen e çdo ndalese dhe hapjen e rrugës për ndërtimin në këto zona.

12.2.7. *Ligji ndryshues cenon nenin 59 të Kushtetutës lidhur me të drejtën për një mjedis të shëndetshëm dhe ekologjikisht të përshtatshëm për brezat e sotëm dhe të ardhshëm (shkronja "d"), shfrytëzimin racional të pyjeve, kullotave dhe burimeve të tjera natyrore (shkronja "dh") dhe mbrojtjen e trashëgimisë kombëtare, kulturore (shkronja "g"),* pasi dispozitat e tij që heqin ndalimet e ligjit bazë dhe bien në kundërshtim me qëllimin parësor të atij ligji, që është sigurimi i mbrojtjes së veçantë për zonat e mbrojtura, duke i bërë ato të cenueshme nga veprimet arbitrare, të cilat mund t'i tkurrin këto zona dhe të dëmtojnë biodiversitetin e tyre. Dispozitat e ligjit ndryshues kanë hequr termat "moslejim", "përjashtim", "eliminim", duke i zëvendësuar me "kufizim", si dhe sjellin elemente të reja, siç janë termat "zonë natyrore pak e shqetësuar", "turizëm i ekselencës (me 5 yje)", "veprimtaritë e lejuara në zonat e mbrojtura". Këto të fundit sipas ligjit

ndryshues, do të përcaktohen me VKM-në e shpalljes së zonës së mbrojtur dhe do të zbatohen sipas kritereve të miratuara me rregullore të posaçme të Këshillit Kombëtar të Territorit (*KKT*), pa vendosur kufizime ose kritere se cilat do të konsiderohen veprimtari të lejuara. Heqja e zonës buferike nga "monumentet e natyrës" (si Rana e Hedhun, Pisha Flamur etj.) dhe "rezervat strikte natyrore" do të jetë shkatërruese për to, pasi kjo do të thotë se aktivitetet dhe ndërtimet mund të kryhen në kufirin e monumentit ose rezervës. Ky ndryshim pasjell dëmtim të peizazhit, veçorive, habitateve dhe specieve të rëndësishme, për të cilat ato janë shpallur si të tilla. Po kështu, eliminohet kriteri normativ i vlerësimit të ndikimit në mjedis (*VNM*) për zonat e mbrojtura, duke e zëvendësuar me kriterin e përgjithshëm "raport efektiv në mjedis, duke përfshirë proceset dhe veprimtaritë e lejuara"; shfuqizohen kriteret themelore të zonës së mbrojtur dhe nënzonat, përfshirë zonën bufere; ndryshohen veprimtaritë e ndaluara në nënzonat qendrore, ku zbatohej shkalla e parë e mbrojtjes; hiqet përkufizimi i përdorimit tradicional të nënzonës qendrore; reduktohet mbrojtja dhe ruajtja e "monumenteve natyrore", duke u hequr atyre shkallën e mbrojtjes "rezervë strikte" dhe duke eliminuar zonën buferike për to; lejohen ndërhyrje urbane, veprimtari rekreative dhe ekonomike brenda zonës "peizazhi i mbrojtur"; hiqet ndalimi për ndërtime të përhershme në to, etj.

12.2.8. *Ligji ndryshues nuk respekton detyrimet që lindin nga marrëveshjet dhe konventat ndërkombëtare* të ratifikuara nga Shqipëria që, në kuptim të neneve 5, 116 dhe 122 të Kushtetutës, janë të detyrueshme për zbatim. Konventa për Ligatinat me Rëndësi Kombëtare, veçanërisht Habitati i Shpendëve Ujorë (*Konventa e Ramsarit*), në nenet 3 dhe 4 të saj ndalon ndërhyrjet që cenojnë në mënyrë të pakthyeshme karakterin ekologjik të këtyre zonave, ndërkohë që ligji ndryshues sjell rreziqe serioze për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin prej saj, pasi lejon zhvillimin e turizmit masiv nëpërmjet strukturave turistike elitare dhe infrastrukturës mbështetëse, për të cilat nuk ekziston më asnjë lloj kufizimi se ku mund të shtrihen. Konventa për Ruajtjen e Jetës së Egër

dhe Habitateve Natyrore të Evropës (*Konventa e Bernës*), në nenin 4, paragrafët 1 dhe 2, sanksionon detyrimin e shtetit për të marrë masa legjislative dhe administrative për ruajtjen e habitateve dhe specieve dhe në politikat e tyre të shmangin ose minimizojnë përkeqësimin e këtyre zonave. Përmes lejimit të ndërtimit ekziston rreziku i dëmit të specieve dhe habitateve të tyre dhe qartazi kemi të bëjmë me politika që përkeqësojnë gjendjen e zonave të mbrojtura. Konventa për biodiversitetin (*Konventa e Rios*), në nenin 8 kërkon nga shtetet që të marrin masa për krijimin dhe menaxhimin e zonave të mbrojtura për ruajtjen *in-situ* të specieve dhe habitateteve të tyre dhe rregullimin e ndikimeve negative nga aktiviteti i njeriut, ndërkohë që ligji ndryshues ul mbrojtjen ekzistuese, heq ndalimin e zhvillimit brenda zonave dhe përfshin kategori të reja menaxhimi. Ndryshimet ligjore vijnë në kundërshtim edhe me objektivat e Unionit Ndërkombëtar për Konservimin e Natyrës (*IUCN*), siç janë përshtatshmëria dhe fleksibiliteti.

12.2.9. *Ligji ndryshues bie ndesh edhe me Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit (MSA)*, nenin 108 të saj, që i referohet degradimit mjedisor. Sipas nenit 70 të MSA-së, Shqipëria është e detyruar të përafrojë legjislacionin e saj me atë të BE-së, ndaj ligji ndryshues bie ndesh edhe me *acquis communautaire,* konkretisht Direktivën e Këshillit 92/43/KEE, datë 21.05.1992 "Për ruajtjen e habitateve natyrore dhe të florës e faunës së egër", të ndryshuar (*Direktiva e Habitateve*), me të cilën është përafruar pjesërisht ligji bazë, dhe Direktivën 2009/147/EC, datë 30.11.2009 "Për ruajtjen e shpendëve të egër" (*Direktiva e Shpendëve*), të cilat përcaktojnë një regjim ruajtjeje që nuk përputhet me lejimin e zhvillimeve të tilla turistike dhe infrastrukturës mbështetëse (rrugë, pista avionësh, rrjete elektrike të shpërndarjes etj.).

12.2.10. Parimet e ligjit ndryshues bien ndesh me frymën e ligjit bazë dhe me ligje të tjera, duke u hequr kompetencat institucioneve të sotme menaxhuese të zonave të mbrojtura dhe duke ia ngarkuar KKT-së, së cilës i janë dhënë kompetenca të shqyrtojë kërkesa për leje zhvillimi/ndërtimi me rregullat dhe kriteret teknike të veprimtarive të lejuara në monumentet

natyrore të kategorisë “peizazh i mbrojtur” dhe “zonë e mbrojtur e burimeve të menaxhuara”, të cilat do të miratohen me rregullore të posaçme.

13. ***Subjektet e interesuara, AOS dhe Eco Albania*****,** në mënyrë të përmbledhur, kanë parashtruar si vijon:

13.1. Për pretendimin se procedurat parlamentare për miratimin e ligjit ndryshues shkelin *nenin 56 të Kushtetutës dhe nenin 8 të Konventës së Aarhusit,* këto subjekte kanë parashtruar, në thelb, të njëjtat argumente si kërkuesi. Për më tepër, sipas tyre, pas njohjes në mënyrë joformale me opinionin e Këshillit të Ministrave, i janë drejtuar këtij të fundit dhe Kuvendit, duke kërkuar mendimin e tyre, kërkesë e mbetur pa përgjigje. Konventa e Aarhus-it e shtrin të drejtën e pjesëmarrjes së publikut edhe gjatë përgatitjes së rregulloreve ekzekutive dhe instrumenteve të përgjithshme ligjore e normative. Sipas udhëzuesit për zbatimin e kësaj konvente, neni 8 mbulon edhe draftet ligjore që përgatiten nga organet ekzekutive, që më pas i kalohen legjislativit për miratim. Kuvendi nuk ka ofruar mundësi reale për komente mbi versionin e ri të projektligjit dhe as nuk ka dokumentuar sesi janë reflektuar në draftin përfundimtar komentet e Këshillit të Ministrave dhe të palëve të tjera. Pavarësisht se sipas Kuvendit janë pranuar vetëm 15 nga 28 propozimet e Këshillit të Ministrave, nuk sqarohet se ç’peshë juridike kishin dispozitat që u refuzuan dhe pse. Procesi i propozimit, shqyrtimit e miratimit të ligjit ndryshues në tërësi nuk ka qenë transparent, ai ka qenë minimal dhe joefektiv.

13.2. Ligji ndryshues cenon *identitetin dhe trashëgiminë kombëtare* që përfshin jo vetëm trashëgiminë kulturore, por edhe atë natyrore. Në nenin 59 të Kushtetutës theksohet synimi për një mjedis të shëndetshëm dhe shfrytëzim të qëndrueshëm të burimeve natyrore. Trashëgimia kombëtare dhe kulturore sipas shkronjës “g” të pikës 1 të këtij neni përbën një nga objektivat socialë, të cilin shteti, brenda kompetencave dhe mjeteve kushtetuese që disponon, synon të mbrojë. Këto parime formojnë bazën e interesit publik madhor për ruajtjen e pasurive natyrore unike të vendit. Edhe gjuha e përdorur nga Konventa e Parisit për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore dhe Natyrore Botërore, konfirmon se identiteti dhe trashëgimia kombëtare përfshijnë si një element integral edhe pasuritë natyrore. Në këtë kuptim, habitatet e mbrojtura, speciet

e rralla dhe peizazhet unike - pasuri të kombit - rrezikojnë të dëmtohen në mënyrë të pakthyeshme nga lejimi i zhvillimeve intensive turistike dhe nga dobësimi i masave mbrojtëse. Shteti, në rolin e kujdestarit të interesit publik, nuk mund të lejojë që pjesë të trashëgimisë kombëtare të vihen në rrezik për interesa afatshkurtër ekonomikë, pasi kjo bie ndesh edhe me *parimin e proporcionalitetit* në kufizimin e interesit publik.

13.3. Ligji ndryshues cenon *parimin e sigurisë juridike*:

13.3.1. Në kontekstin e *përafrimit me acquis communautaire*. Për këtë pretendim, këto subjekte të interesuara, në thelb, kanë parashtruar të njëjtat argumente si kërkuesi. Sipas tyre, sipas Gjykatës Evropiane të Drejtësisë, fuqia e shteteve për të zvogëluar sipërfaqen e një zone të mbrojtur speciale mund të justifikohet vetëm për shkaqe krejtësisht të jashtëzakonshme, ndërsa shkaqet ekonomike ose rekreative nuk mund të merren parasysh si justifikim për zvogëlimin apo degradimin e një zonë të tillë, pasi interesi ekologjik i ruajtjes së specieve ka përparësi ndaj tyre (*çështja Komisioni kundër Gjermanisë, C- 57/89*).

13.3.2. Në kontekstin e *pritshmërive legjitime të komuniteteve në zonat e mbrojtura*, pasi ligji bazë ka ndërtuar një kuadër të qëndrueshëm ligjor për menaxhimin dhe mbrojtjen e zonave të mbrojtura, të harmonizuar me standardet evropiane dhe konventat ndërkombëtare. Komunitetet vendore, duke iu përshtatur këtij kuadri ligjor ekzistues, kanë investuar dhe janë përgatitur për aktivitete tradicionale si bujqësia, blegtoria ose ekoturizmi, me besimin se karakteri natyror dhe kulturor i mjedisit të tyre do të mbrohej dhe do të shërbente si bazë për mirëqenien e tyre afatgjatë. Kësisoj, është krijuar pritshmëria se modeli i zhvillimit do të mbetej tradicional dhe i qëndrueshëm, pa ndërhyrje të papritura masive. Pasojat e këtij ndryshimi regresiv janë shumëplanëshe, në aspektin mjedisor, në aspektin social e ekonomik dhe në aspektin e ndikimeve kulturore, pasi komunitete me tradita të lashta rrezikojnë të zhbëhen nga një valë e papritur zhvillimi komercial, që nuk përputhet me identitetin e tyre lokal. Këto ndryshime nuk ishin parashikuar në politikat publike ose strategjitë e zhvillimit, por erdhën si një nismë ligjore e

papritur dhe pa konsultim të mirëfilltë me komunitetet lokale të prekura.

13.3.3. Lidhur me *objektivat e IUCN-së,* këto subjekte të interesuara, në thelb, kanë parashtruar të njëjtat argumente si kërkuesi.

13.3.4. Në kontekstin *e lirisë së kërkimit shkencor,* të garantuar nga neni 58 i Kushtetutës*,* pasi organizatat mjedisore, universitetet publike dhe institucionet shkencore i trajtojnë parqet kombëtare, lagunat dhe lumenjtë si laboratorë natyrorë. Me lejimet e ligjit ndryshues, integriteti shkencor i këtyre zonave të mbrojtura rrezikon të prishet, pasi një habitat i fragmentuar, i ndriçuar dhe i zhurmshëm shndërrohet në një eksperiment të dështuar. Në këtë mënyrë, studiuesve u hiqet objekti i studimit dhe siguria se mund t'i përdorin rezultatet për dobi publike.

13.4. Ligji ndryshues bie ndesh me dispozitat e *konventave ndërkombëtare të ratifikuara,* të cilat, sipas nenit 122 të Kushtetutës*,* janë pjesë e rendit juridik të brendshëm dhe kanë përparësi ndaj ligjeve të brendshme në rast mospërputhjeje, konkretisht: (i) *Konventën e Ramsarit*, në nenet 2, 3, 4 dhe 5, për shkak se dispozitat që lejojnë turizmin me 5 yje dhe infrastrukturën mbështetëse brenda lagunës, krijojnë rreziqe serioze për mospërmbushjen e detyrimeve sipas konventës, në masën që u lejon zonave të mbrojtura, përfshirë ato me status Ramsar, zhvillime intensive turistike dhe infrastrukturore, të cilat rrezikojnë të prekin strukturën dhe funksionet e ekosistemeve të ligatinave; (ii) *Konventën e Bernës,* në nenet 1, 2, 3, 4, 5, 6, 8, 9, 10, 11 dhe 12, pasi ndryshimet ligjore që lehtësojnë ndërtimet në zona të mbrojtura bien ndesh me detyrimet e kësaj konvente, e cila kërkon ruajtje rigoroze të habitateve të specieve të mbrojtura dhe që çdo zhvillim ekonomik të planifikohet duke mos i dëmtuar ato habitate. *Parimi i mosregresit* në të drejtën mjedisore ndërkombëtare nënkupton që kur është arritur një nivel mbrojtjeje, shtetet nuk duhet ta ulin atë nëse nuk ka arsye madhore dhe ligji ndryshues përfaqëson pikërisht një regres të tillë; (iii) *Konventën e Rios,* në nenet 6, 7, 8, 10 dhe 11, pasi ndryshimet e miratuara me ligjin ndryshues, që sanksionojnë ulje të mbrojtjes ekzistuese, shfuqizimin e ndalimit të zhvillimit brenda zonave të mbrojtura ose përfshirjen e kategorive të reja të menaxhimit, pa qartësi mbi

objektivat e ruajtjes, paraqesin shkelje të detyrimeve të Shqipërisë sipas kësaj konvente, e cila synon mbrojtjen e biodiversitetit, promovimin e përdorimit të tij të qëndrueshëm dhe ndarjen e drejtë të përfitimeve që rrjedhin nga burimet gjenetike, si dhe bien ndesh me frymën e saj; (iv) *Konventën për Ruajtjen e Specieve Shtegtuese të Kafshëve të Egra (Konventa e Bonit)*.

14. ***Subjekti i interesuar, Kuvendi,*** në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar si vijon:

14.1. Pretendimi për *mosrespektim të Rregullores së Kuvendit* nuk mund të përbëjë çështje për Gjykatën, e cila, në respektim të parimit të vetërregullimit të Kuvendit, ka vlerësuar se në parim rregullorja e tij nuk i nënshtrohet kontrollit kushtetues, duke mos u ngritur ky pretendim në nivel kushtetues.

14.2. Pretendimi për cenimin e së *drejtës për t'u informuar për gjendjen e mjedisit e mbrojtjen e tij* nuk është ngritur në nivel kushtetues, pasi neni 56 i Kushtetutës dhe Konventa e Aarhusit i referohen kontekstit të vendimmarrjeve për raste dhe çështje konkrete që kanë të bëjnë me mjedisin dhe nuk lidhen me akte rregullatore me fuqi juridike të përgjithshme. Megjithatë, procedura e shqyrtimit dhe miratimit të ligjit kanë qenë në përputhje me këto parashikime, pasi komisioni përgjegjës ka zhvilluar një proces të gjerë dhe gjithëpërfshirëse konsultimi, në respektim të parimit të transparencës dhe të gjithëpërfshirjes mbi të cilat zhvillohet veprimtaria parlamentare; projektligji është publikuar në platformën "Konsultimi i projektligjeve" në faqen zyrtare të Kuvendit; grupet e interesit, organizatat/shoqatat mjedisore dhe ekspertët individualë ose stafi akademik, me të cilët komisioni përgjegjës ka zhvilluar 4 seanca dëgjimore në periudhën 30 janar deri më 12 shkurt 2024 kanë dhënë opinionet e tyre; komisioni përgjegjës ka administruar, shqyrtuar dhe trajtuar komentet dhe sugjerimet e përfaqësuesve të grupeve të interesit, ka adresuar komentet dhe vërejtjet e tyre, duke bërë riformulime të disa neneve, ka administruar mendimin e Këshillit të Ministrave dhe rekomandimet e komisioneve parlamentare; janë thirrur në seancë dëgjimore edhe organizatat e shoqërisë civile, duke pasur mundësi për t'u shprehur në mënyrë shteruese në lidhje me shqetësimet e tyre Pas njohjes me opinionin e Këshillit të Ministrave, organizatat kishin lirinë të sillnin opinionet e tyre me shkrim.

14.3. Pretendimi për *detyrimin për shoqërimin e projektligjit me raportin që përligj shpenzimet financiare* është i pabazuar, pasi projektligji nismë e deputetëve nuk ka pasur efekte financiare, ndërsa krijimi i ZAPK-ve ka ardhur si propozim i Këshillit të Ministrave. Krijimi i këtyre zyrave, struktura dhe organika e tyre miratohen me VKM, ndaj efektet financiare do të vijnë në një fazë të mëvonshme, atë të ngritjes së zyrës për zonën e mbrojtur specifike me VKM. Kurse mendimi i Këshillit të Ministrave nuk barazohet me nismën ligjore, ndaj nuk kishte detyrim të shoqërohej me raportin përkatës për shpenzimet financiare.

14.4. Pretendimi për cenimin e *funksioneve të Kuvendit dhe sistemit normativ* është i pabazuar. Komisioni i Ligjeve e ka vlerësuar projektligjin në përputhje me Kushtetutën, legjislacionin në fuqi dhe Rregulloren e Kuvendit, si dhe i ka rekomanduar komisionit përgjegjës që të adresojë shqetësimet e ardhura nga grupet e interesit dhe mendimin e Këshillit të Ministrave, me qëllim hartimin e një varianti të përmirësuar. Për më tepër, Kuvendi ka një praktikë të konsoliduar për nismat e deputetëve që i dërgohen për mendim Këshillit të Ministrave, jo vetëm kur nisma ka efekte financiare, por edhe në kuadër të rolit që ka ai organ në përcaktimin e politikave shtetërore.

14.5. Pretendimi për cenimin e *parimit të solidaritetit midis brezave* është i pabazuar. Ndryshimet ligjore kanë për qëllim përmirësimin e kuadrit ligjor për mbrojtjen e zonave të mbrojtura, duke vendosur rregulla të qarta të menaxhimit të tyre, si dhe duke ruajtur ekuilibrin midis zhvillimit ekonomik dhe ruajtjes së pasurisë natyrore. Ndryshimet ligjore nuk i cenojnë, por i mbrojnë interesat e brezave të ardhshëm, duke respektuar parimet e Maastricht-it për të Drejtat e Njeriut të Brezave të Ardhshëm.

14.6. Për sa i përket pretendimit për cenimin e *parimeve të shtetit të së drejtës, barazisë përpara ligjit dhe të hierarkisë së akteve*, ai është i paargumentuar, pasi ligji ndryshues është një akt me karakter normativ, që plotëson kuadrin ligjor ekzistues. Ndryshimet ligjore parashikojnë sistemin e zonave të mbrojtura me interes kombëtar, modeli i të cilave është mbështetur në kriteret e IUCN-së.

14.7. Pretendimet për *cenimin e nenit 59 të Kushtetutës të lidhur me shkronjat "d", "dh" dhe "g"* nuk janë të natyrës kushtetuese. Ato përbëjnë vlerësim subjektiv dhe të paargumentuar të kërkuesit

për efekte të mundshme të ligjit, për më tepër që janë të natyrës teknike dhe nuk janë ngritur në nivel kushtetues. Ndryshimet sjellin risi në shkallën e mbrojtjes së zonës së mbrojtur dhe garantojnë siguri juridike, pasi miratohen me VKM. Ushtrimi i veprimtarive lejohet vetëm pasi të jetë marrë leja e mjedisit ose miratimi me shkrim i organit të mbrojtjes së zonës. Në këtë mënyrë prezantohet një regjim i ekuilibruar, që lejon zhvillimin e veprimtarive të ndryshme në zonat e mbrojtura, por vetëm nëse ato janë në përputhje me qëllimin e mbrojtjes së këtyre zonave dhe janë të kushtëzuara nga një kontroll i rreptë nga organet kompetente. Shtimi i përkufizimeve dhe parimeve ka si qëllim qartësimin dhe detajimin e klasifikimit të zonave të mbrojtura, duke e bërë ligjin më specifik dhe efektiv në zbatim. Përfshirja e KKT-së përbën një mekanizëm të domosdoshëm për të garantuar koherencën midis politikave kombëtare dhe atyre vendore në fushën e mjedisit. Ndryshimet që rregullojnë zonimin dhe nënzonimin reflektojnë zhvillimet e doktrinës ndërkombëtare dhe janë bërë me qëllim saktësimin e kategorive të zonave të mbrojtura ku zbatohet zonimi dhe nënzonimi, sipas shkallës respektive të mbrojtjes dhe fokusohen në kategoritë II dhe IV, në funksion të rritjes së efektshmërisë së menaxhimit dhe mbrojtjes të territorit të zonës së mbrojtur për ato kategori. Ndërsa, krijimi i ZAPK-ve është në përputhje me parimet e IUCN-së dhe rekomandim nga ekspertët e saj për një menaxhim eficient të atyre sipërfaqeve që kanë shkallën më të lartë të mbrojtjes dhe janë shumë të shtrira.

14.8. Pretendimi për cenimin e *parimeve të shtetit të së drejtës, barazisë përpara ligjit dhe të hierarkisë së akteve juridike* është i pambështetur në parashikime kushtetuese, madje dhe ligjore ose faktike. Ligji respekton parimet e barazisë dhe të interesit publik dhe garanton një balancim midis mbrojtjes së zonave natyrore dhe zhvillimit të qëndrueshëm. Ai parashikon një sërë rregullash për ndërtimet në zonat e mbrojtura, ku në çdo rast prioritet ka ruajtja e vlerave dhe elementeve të boidiversitetit, për të cilat zona e mbrojtur është shpallur si e tillë. Ligji nuk heq kufizimet mjedisore ekzistuese, por përcakton kritere të qarta për çdo veprimtari të tillë. Parashikimet ligjore për mundësinë e ndërtimit të turizmit të ekselencës nuk shkelin detyrimin për të garantuar ruajtjen e veçantë të zonave të mbrojtura.

14.9. Për pretendimin se ligji ndryshues është në kundërshtim me *acquis communautaire* ose *konventat e ratifikuara*, kërkuesi nuk ka argumentuar se cilat dispozita të ligjit bien ndesh me to. Ndërsa ligji bazë synonte përafrimin e pjesshëm me Direktivën e Habitateve, ligji ndryshues nuk synonte përafrimin, për më tepër nuk ndryshon asnjë nga këto nene. Nenet 13, 18, 19 dhe 20 mbajnë në konsideratë parashikimet e pikës 1 të nenit 6 të Direktivës së Habitateve, në të cilën i jepet e drejta shtetit anëtar për të vendosur masa në përputhje me planet e menaxhimit të këtyre zonave. Rekomandimet e organizatave mjedisore janë diskutuar nga komisioni përgjegjës dhe në përfundim të shqyrtimit është miratuar riformulimi i neneve 7, 8 dhe 10 të projektligjit, duke adresuar ato.

14.10. Pretendimi se ndryshimet e *ligjit të kundërshtuar bien në kundërshtim me objektivat e IUCN-së* është i pabazuar, pasi ligji në përgjithësi mban në konsideratë parimet dhe rekomandimet e IUCN-së. Mundësia e ndërtimeve të resorteve me 5 yje është në referim të parashikimeve të IUCN-së për ndërtimin e strukturave akomoduese miqësore me biodiversitetin. Ndryshimet ligjore parashikojnë sistemin e zonave të mbrojtura me interes kombëtar, modeli i të cilave është mbështetur në kriteret e IUCN-së. Ndërsa krijimi i ZAPK-ve ka qenë një rekomandim nga ekspertët e IUCN-së në raste të tjera, për një menaxhim eficient të atyre sipërfaqeve që kanë shkallën më të lartë të mbrojtjes dhe shumë të shtrirë.

14.11. Pretendimi se ka *përplasje mes normave ligjore* në fuqi, referuar kompetencave të KKT-së, nuk prek probleme të kushtetutshmërisë, por të raportit që duhet të kenë në zbatim normat me fuqi të njëjtë juridike, të cilat mund të zgjidhen nga ligjzbatuesi, organet administrative dhe në fund nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, pra nuk janë në juridiksionin e Gjykatës.

15. ***Subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave***, në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar si vijon:

15.1. Për pretendimin për *mosrespektim të Rregullores së Kuvendit,* subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave, ka prapësuar se mosrespektimi i saj e bën veprimtarinë parlamentare jokushtetuese vetëm nëse janë prekur dispozita të nivelit kushtetues që gjejnë pasqyrim në të, ndërsa për çështje të tjera rregullorja nuk mund të jetë objekt i kontrollit kushtetues.

15.2. Këshilli i Ministrave ka parashtruar, në thelb, të njëjtat prapësime si Kuvendi për sa i përket pretendimit të kërkuesit për cenimin e *së drejtës për t'u informuar për gjendjen e mjedisit e mbrojtjen e tij,* për të cilin ka prapësuar se nuk është ngritur në nivel kushtetues. Zbatimi i ligjit ndryshues kërkon nxjerrjen e akteve nënligjore, gjatë të cilave do të parashikohen procedura të reja për konsultimin publik dhe informimin e palëve të interesuara. Pavarësisht kësaj, pretendimi nuk qëndron, pasi Kuvendi ka zhvilluar një konsultim publik të gjerë. Edhe mendimi i Këshilli të Ministrave është bazuar në mendimin e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, e cila ka zhvilluar konsultime në mënyrë elektronike në përputhje me parimin e transparencës dhe përfshirjes efektive të publikut në procesin legjislativ.

15.3. Pretendimi për *detyrimin për shoqërimin e projektligjit me raportin që përligj shpenzimet financiare* është i pabazuar, pasi ndikimet financiare do të jenë të zbatueshme vetëm në fazën e implementimit, ku Këshilli i Ministrave do të luajë rolin e tij përmes akteve nënligjore. Po kështu, qëllimi i kushtetutëbërësit ka qenë që në situatën e miratimit të një ligji që sjell efekte financiare të bëhen edhe ndryshimet përkatëse në ligjin e buxhetit. Por nëse efektet financiare që mund të ketë një ligj përfshihen në buxhetin aktual të miratuar të ministrisë, siç ishte në këtë rast ZAPK Vjosa, atëherë efektet financiare nuk konsiderohen të jenë "shtesë", pasi janë të përthithura brenda buxhetit të vitit ekzistues dhe, në këtë kuptim, situata është në përputhje të plotë dhe me atë që parashikon vetë relacioni i Kuvendit sipas të cilit projektligji që nuk ka efekte financiare shtesë.

15.4. Pretendimi për cenimin e *funksioneve të Kuvendit dhe sistemit normativ* nuk është i bazuar, pasi projektligji prekte çështje nën përgjegjësi të Këshillit të Ministrave dhe që lidheshin me veprimtarinë e organeve në varësi të tij. Në këtë kuadër, marrja e mendimit të Këshillit të Ministrave ishte më se e arsyeshme dhe e justifikuar, si dhe nuk ka asnjë papajtueshmëri në faktin e të kërkuarit të mendimit të këtij organi në këto kushte. Projektligji ka qenë nismë e një grupi deputetësh dhe është shqyrtuar nga komisioni përgjegjës dhe komisionet për dhënie mendimi, duke ezauruar të gjitha hapat dhe procedurat e parashikuara në Rregulloren e Kuvendit për shqyrtimin dhe miratimin e projektligjit.

15.5. Për pretendimin se ligji cenon *parimin e solidaritetit midis brezave,* subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave, ka prapësuar se është i pabazuar, pasi ndryshimet ligjore janë në përputhje me parimet e traktatit të Maastricht-it dhe synojnë të përmirësojnë kuadrin e ri ligjor për mbrojtjen e zonave të mbrojtura, duke rritur standardet për mbrojtjen e tyre përmes vendosjes së rregullave të qarta dhe të forta për menaxhimin, si dhe duke përcaktuar kushte për zhvillimin e aktiviteteve të qëndrueshme. Ligji ruan një ekuilibër midis zhvillimit ekonomik dhe ruajtjes së pasurive natyrore, duke mbrojtur interesat e brezave të ardhshëm dhe përmban kritere për përdorimin dhe zhvillimin që minimizojnë rreziqet për mjedisin dhe promovojnë ruajtjen afatgjatë. Ligji përmban disa kritere-kufij që nuk mund të kapërcehen, siç mund të jenë mundësitë për investime të rënda infrastrukturore ose industriale brenda territoreve të zonave të mbrojtura. Pjesëmarrja e autoriteteve lokale siguron që menaxhimi të jetë i përshtatshëm për nevojat dhe interesat e komuniteteve lokale dhe brezave të ardhshëm.

15.6. Për sa i përket pretendimit të kërkuesit për cenimin e *parimeve të barazisë përpara ligjit dhe të hierarkisë së normave,* Këshilli i Ministrave ka prapësuar se ai është i pambështetur në parashikime kushtetuese dhe nuk vë në diskutim asnjë vlerë kushtetuese në rastin konkret. Ndryshimet sjellin koncepte të reja të kategorizimit të biodiversitetit në vend sipas rëndësisë, por edhe mundësinë e përditësimit të tij në mënyrë më të shpeshtë, si dhe i jep mundësi qeverisjes lokale dhe komuniteteve të jenë pjesë e kësaj vendimmarrjeje.

15.7. Për pretendimin për cenimin e *nenit 59 të Kushtetutës, shkronjat "d", "dh" dhe "g",* subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave, ka prapësuar se argumentet në mbështetje të tij nuk ngrenë ndonjë problematikë të natyrës kushtetuese, për sa kohë që kërkuesi nuk evidenton shkeljen e normave dhe parimeve të Kushtetutës. Neni 59 parashikon objektivat socialë të shtetit, të cilët nuk përfshihen në rrethin e çështjeve që i përkasin juridiksionit kushtetues. Ndryshimet kanë synuar përmirësimin e menaxhimit të zonave të mbrojtura; zgjidhjen e disa problematikave konkrete në terren; harmonizimin midis ligjeve; garantimin e të drejtave që banorët e këtyre zonave duhet të gëzojnë për plotësimin e nevojave dhe aksesimin e shërbimeve; vendosjen e rregullave të qarta dhe

të përshtatshme për të siguruar mbarëvajtjen e monitoruar të paketave turistike në këto zona, duke krijuar edhe hapësira për vende pune dhe perspektivë rajonale; vendosjen e një ekuilibri midis zonave të mbrojtura dhe nevojës që ka komuniteti dhe pushteti vendor për zhvillimin e agroturizmit, për zhvillimin e aktiviteteve të lejuara në zonat e mbrojtura. Futja e terminologjisë së re shërben për të qartësuar dhe detajuar klasifikimin e zonave të mbrojtura, duke e bërë ligjin më specifik dhe efektiv në zbatim. Dispozitat që u hapin mundësinë ndërtimeve të resorteve me 5 yje ose hoteleve "brand name" nuk shkelin detyrimin për të garantuar ruajtje të veçantë të zonave të mbrojtura dhe nuk i cenojnë ato, por synojnë t'u hapin rrugë infrastrukturës dhe veprimtarive të mikpritjes miqësore me biodiversitetin, me standardet më të larta arkitektonike dhe mjedisore, referuar edhe parashikimeve të IUCN-së mbi ndërtimin e strukturave akomoduese miqësore me biodiversitetin. Ligji parashikon një sërë rregullash për ndërtimet në zonat e mbrojtura, ku në çdo rast kanë prioritet ruajtja e vlerave dhe elementeve të boidiversitetit për të cilat zona e mbrojtur është shpallur e tillë.

15.8. Për sa i përket pretendimit se ligji ndryshues është në *kundërshtim me acquis communautaire ose konventat e ratifikuara,* kërkuesi nuk ka paraqitur fakte dhe argumente të nivelit kushtetues. Ligji bazë ka synuar vetëm përafrim të pjesshëm me Direktivën e Habitateve dhe vetëm një numër i kufizuar dispozitash të tij janë të përafruara me të. Këto dispozita nuk janë ndryshuar nga ligji ndryshues. Niveli i përafrimit të legjislacionit është një çështje që ka të bëjë me ecurinë e procesit të integrimit, por nuk përbën mosmarrëveshje kushtetuese.

15.9. Lidhur me *objektivat e IUCN-së,* subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave, ka prapësuar se infrastruktura dhe veprimtaritë e mikpritjes miqësore me biodiversitetin, me standardet më të larta arkitektonike dhe mjedisore, si dhe sistemi i zonave të mbrojtura me interes kombëtar janë në përputhje me parashikimet ose modelet e IUCN-së.

15.10. Ndërsa lidhur me pretendimin e *përplasjes mes normave ligjore* në fuqi referuar kompetencave të KKT-së, subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave, ka prapësuar se konfliktet që mund të ekzistojnë mes hierarkisë së akteve, ligjit të zbatueshëm ose edhe konflikti mes

normave me të njëjtën fuqi juridike, nuk janë lëndë për këtë Gjykatë, por mund të zgjidhen nga ligjzbatuesi, organet administrative dhe në fund nga gjykatat e juridiksionit të përgjithshëm.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkuesit

16. Çështja e legjitimimit *(locus standi)* është vlerësuar si një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Për sa i takon legjitimimit të kërkuesit për vënien në lëvizje të Gjykatës për kontrollin abstrakt të normës ligjore, në jurisprudencën kushtetuese në mënyrë të vazhdueshme është vlerësuar se ky subjekt, i parashikuar në nenin 134, pika 1, shkronja "c", të Kushtetutës dhe nenin 49, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000, ka të drejtë të paraqesë kërkesë për arsye të një interesi publik, pa u kushtëzuar me një interes subjektiv konkret. Interesi i këtyre funksionarëve publikë për të mbrojtur sistemin normativ dhe parimet shtetformuese, si konstitucionalizmi, shteti i së drejtës, demokracia, dinjiteti njerëzor, barazia sociale etj., të shpalosura në Kushtetutë, nuk është i kushtëzuar (*shih vendimet nr. 18, datë 07.07.2022; nr. 55, datë 27.07.2015 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, për legjitimimin *ratione personae*, Gjykata vëren se ajo është vënë në lëvizje nga një grup prej 37 deputetësh të Kuvendit, që përbën subjektin kushtetues jo më pak se një e pesta e deputetëve të Kuvendit, për rrjedhojë kërkuesi legjitimohet si në aspektin formal, ashtu edhe substancial për vënien në lëvizje të këtij gjykimi kushtetues.

17. Kërkuesi legjitimohet edhe *ratione temporis*, bazuar në përmbajtjen e nenit 50, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000, pasi ligji ndryshues është publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 50, datë 20.03.2024 dhe ka hyrë në fuqi 15 ditë pas botimit në këtë fletore, ndërsa kërkesa është regjistruar në Gjykatë në datën 01.11.2024, pra brenda afatit 2-vjeçar.

18. Për sa i takon legjitimimit *ratione materiae*, Gjykata vëren se kërkuesi ka parashtruar argumentet e tij në dy drejtime: (i) për procedurën e miratimit të ligjit lidhur me *(a) detyrimin për raportin shoqërues të projektligjit,* sipas nenit 82, pika 1, të Kushtetutës dhe *(b) të drejtën për t'u informuar për gjendjen e mjedisit*, të parashikuar nga neni 56 i Kushtetutës; (ii) për përmbajtjen e tij lidhur me *(a) parimin e solidaritetit midis brezave*, të deklaruar në Preambulën e Kushtetutës, *(b) nenin 59 të Kushtetutës*

në lidhje me të drejtën për një mjedis të shëndetshëm dhe ekologjikisht të përshtatshëm për brezat e sotëm dhe të ardhshëm (shkronja "d"), shfrytëzimin racional të burimeve natyrore mbi bazën e parimit të zhvillimit të qëndrueshëm (shkronja "dh") dhe mbrojtjen e trashëgimisë kombëtare kulturore (shkronja "g"); *(c) parimet e shtetit të së drejtës, barazisë përpara ligjit dhe hierarkisë së normave*, të garantuara nga nenet 3, 4, 18 dhe 116 të Kushtetutës; *(ç) funksionet e Kuvendit* dhe të *sistemit normativ; (d) MSA-në* në drejtim të *acquis communautaire dhe marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara,* sipas nenit 122 të Kushtetutës.

19. Po në këtë drejtim, subjektet e interesuara, AOS dhe Eco Albania, kanë mbështetur pretendimet e kërkuesit dhe kanë parashtruar edhe disa pretendime shtesë, që kanë të bëjnë me cenimin e *parimit të sigurisë juridike* në drejtim të *pritshmërive të ligjshme të komuniteteve në zonat e mbrojtura*, *lirisë së kërkimit shkencor dhe sigurisë juridike të lidhur me të*, të garantuar nga neni 4 i Kushtetutës, si dhe *mospërputhjen e ligjit ndryshues me Konventën e Bonit*. Gjykata, duke pasur parasysh se subjektet e interesuara thirren në gjykim në mënyrë që të kontribuojnë në shqyrtimin e çështjes që po gjykohet, në rastin konkret në lidhje me kërkesën e kërkuesit për shfuqizimin e ligjit ndryshues si të papajtueshëm me Kushtetutën dhe marrëveshjet ndërkombëtare, si dhe në situatën kur këto subjekte të interesuara nuk i janë drejtuar në formë dhe në përmbajtje Gjykatës për kundërshtimin e ligjit me kërkesë, kërkimet në tejkalim të kërkesës së kërkuesit të paraqitura nga këto subjekte, çmon se nuk mund t'i marrë në konsideratë.

20. Gjykata vëren se kërkuesi ka pretenduar cenimin e *funksioneve të Kuvendit dhe të sistemit normativ* të lidhur me parashikimet e pikës 2 të nenit 82 të Kushtetutës, pasi: *së pari*, Kuvendi i është drejtuar Këshillit të Ministrave për mendim në kapërcim të parashikimeve kushtetuese dhe në anashkalim të procedurave të rregullta parlamentare, edhe pse nuk kanë qenë kushtet për një gjë të tillë, duke qenë se varianti fillestar i projektligjit nuk kishte efekte financiare shtesë në buxhetin e shtetit; *së dyti*, sepse mendimi i Këshillit të Ministrave jo vetëm që nuk ka të bëjë me efektet financiare të projektligjit, por e ka ndryshuar tërësisht nismën ligjore të deputetëve propozues, duke shtuar madje nene që krijojnë efekte financiare, si p.sh. krijimi i ZAPK-ve.

21. Subjektet e interesuara, Kuvendi dhe Këshilli i Ministrave, kanë prapësuar se ky pretendim nuk gjen mbështetje në parashikimet kushtetuese, pasi projektligji prekte çështje për të cilat, trajtimi në nivel ekzekutiv është

përgjegjësi e Këshillit të Ministrave, pasi lidhen me veprimtarinë e organeve në varësi të tij. Sipas këtyre subjekteve, marrja e mendimit të Këshillit të Ministrave ishte më se e arsyeshme dhe e justifikuar nga pikëpamja ligjore e kushtetuese, si dhe nuk ka asnjë papajtueshmëri në faktin e të kërkuarit të mendimit të këtij organi në këto kushte. Në rastin konkret, sipas tyre, projektligji ka qenë nismë e një grupi deputetësh dhe është depozituar në Kuvend në datën 20.11.2023, e ndërmarrë në përgjigje të një letre drejtuar Kuvendit nga kryetarët e disa bashkive. Ai është shqyrtuar nga komisioni përgjegjës, Komisioni për Çështjet Evropiane, dhe komisioni i ligjeve, duke ezauruar të gjithë hapat dhe procedurat e parashikuara në Rregulloren e Kuvendit për shqyrtimin dhe miratimin e projektligjit. Për më tepër, ato kanë sqaruar se është tashmë praktikë e konsoliduar e Kuvendit që të marrë mendimin e Këshillit të Ministrave për nismat ligjvënëse të deputetëve për të konsideruar impaktin që ato nisma mund të kenë, pavarësisht nëse ato kanë efekte financiare ose jo.

22. Për këtë pretendim Gjykata vlerëson se kërkuesi nuk ka arritur ta argumentojë në këndvështrim kushtetues, pasi ai nuk shpjegon sesi norma kushtetuese e përdorur si referencë e ndalon marrjen e mendimit nga Këshilli i Ministrave për projektligje joqeveritare që nuk i rrisin shpenzimet në buxhetin e shtetit dhe as pakësojnë të ardhurat. Për rrjedhojë, ky pretendim nuk mund të merret në shqyrtim.

23. Po kështu, Gjykata vëren se kërkuesi ka pretenduar cenimin e *parimeve të shtetit të së drejtës*, *të barazisë përpara ligjit dhe hierarkisë së normave*, duke argumentuar se ligji ndryshues duhet të jetë i përgjithshëm dhe në funksion të interesit të shoqërisë dhe jo të një individi apo një grupi individësh të paracaktuar ose të përcaktueshëm lehtësisht. Sipas kërkuesit, marrja shkas nga disa shqetësime në nivel lokal për të zhbërë tërësisht ligjin për zonat e mbrojtura bëhet vetëm në funksion të një grupi personash, pasi nga analiza e kombinuar e neneve të tij duket qartë se ligji ndryshues është i destinuar për përfitimin e investitorëve të resorteve dhe hoteleve me 5 yje. Sipas tij, ligji ndryshues nuk synon mbrojtjen e interesit të përgjithshëm dhe as vënien e rregullave të përgjithshme, me qëllim ruajtjen e zonave të mbrojtura, por përkundrazi synon heqjen e çdo ndalese dhe hapjen rrugë të ndërtimit në to në shkelje të nenit 18 të Kushtetutës. Për më tepër, sipas kërkuesit, pas ndryshimit ka përplasje të neneve me njëri-tjetrin. Subjektet e interesuara, Kuvendi dhe Këshilli i Ministrave, kanë prapësuar se ky pretendim është i pambështetur në parashikime kushtetuese, pasi nuk është vënë në diskutim asnjë vlerë kushtetuese në rastin konkret.

24. Lidhur me këtë pretendim, Gjykata vlerëson se kërkuesi, në thelb, e ka lidhur atë me lejimin e ndërtimeve të resorteve dhe hoteleve me 5 yje në territorin e zonave të mbrojtura, por ai nuk ka parashtruar asnjë argument kushtetues në mbështetje të këtyre pretendimeve, duke paraqitur vetëm argumente me natyrë të përgjithshme. Për sa kohë që kërkuesi nuk ka arritur të argumentojë sesi lejimi i ndërtimeve të resorteve dhe hoteleve me 5 yje në territorin e zonave të mbrojtura cenon parimin e shtetit të së drejtës, Gjykata çmon se ky pretendim i tij nuk mund të merret në shqyrtim[2].

25. Për sa i përket pretendimit të kërkuesit për papajtueshmërinë e ligjit ndryshues me MSA-në në drejtim të përputhshmërisë me të drejtën e BE-së, veçanërisht në lidhje me Direktivën e Habitateve, me të cilën është përafruar pjesërisht ligji bazë (nenet 3, pikat 8, 9, 10, 11, 18, 23, 24, 25, 27, 31 dhe 32, 28, 29, 30, 31, 32 dhe 62) dhe me Direktivën e Shpendëve, me të cilën nuk rezulton që ligji bazë të jetë përafruar, në përfundim të diskutimeve vlerësimet e gjyqtarëve u ndanë në dy qëndrime dhe Gjykata nuk arriti numrin e kërkuar të votave për vendimmarrje, sipas parashikimeve të nenit 133, pika 2, të Kushtetutës, të detajuar edhe në nenin 72, pika 2, të ligjit nr. 8577/2000.

26. Konkretisht, sipas njërit qëndrim, vihet në dukje se, siç ka theksuar Gjykata, MSA-ja është një marrëveshje kuadër për marrëdhëniet ndërmjet Republikës së Shqipërisë, nga njëra anë, e BE-së dhe shteteve anëtare të saj, nga ana tjetër. Kjo marrëveshje është ratifikuar me ligjin nr. 9590, datë 27.07.2006 dhe ka hyrë në fuqi në datën 01.04.2009, pas ratifikimit të saj nga të gjitha vendet anëtare të BE-së. Ajo synon mbështetjen e Shqipërisë për forcimin e demokracisë dhe shtetit të së drejtës, dhënien e kontributit për stabilitetin politik, ekonomik dhe social në Shqipëri dhe në rajon, përafrimin e legjislacionit shqiptar me të drejtën komunitare dhe mbështetjen e Shqipërisë për të përfunduar tranzicionin drejt një ekonomie tregu funksionale. Në këtë mënyrë, MSA-ja është një marrëveshje që ka krijuar një proces asociimi të palëve në funksion të stabilizimit dhe përgatitjes së Republikës së Shqipërisë për anëtarësimin eventual në BE (*shih vendimet nr. 21, datë 18.04.2023; nr. 30, datë 02.11.2022; nr. 14, datë 21.03.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

[2] Gjyqtarja Marjana Semini votoi për shqyrtimin në themel të pretendimit për cenimin e parimit të barazisë përpara ligjit, me argumentin se përdorimi i fjalëve "*ekselencë*" dhe/ose "*me 5 yje*" në të gjithë tekstin e ligjit bie ndesh me këtë parim, pasi zhvillimi i zonave të mbrojtura nuk duhet të krijojë favorizime të lidhura me llojin ose natyrën e subjektit që e kryen këtë zhvillim.-

27. Për sa më sipër, sipas këtij qëndrimi, MSA-ja është një marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar me ligj, që synon një proces për t'u ndërmarrë nga shteti shqiptar. Si e tillë, ajo është pjesë e sistemit të brendshëm juridik dhe ka epërsi mbi aktet normative të brendshme që nuk pajtohen me të, në përputhje me parashikimet e neneve 116 dhe 122 të Kushtetutës. Për rrjedhojë, Gjykata ka shqyrtuar edhe më parë në praktikën e saj pajtueshmërinë e akteve të tjera normative me MSA-në, siç është rasti i parashikime të saj për rregullat e konkurrencës (*shih vendimet nr. 8, datë 21.02.2025; nr. 21, datë 18.04.2023; nr. 30, datë 02.11.2022 të Gjykatës Kushtetuese*). Nën këtë optikë, edhe detyrimet e përgjithshme që burojnë nga neni 108 i MSA-së për mosdegradimin mjedisor janë të zbatueshme nga shteti shqiptar dhe, në këtë kuptim, përbëjnë edhe parametër të kontrollit kushtetues që kryhet nga Gjykata, e cila, në kuadër të pretendimeve të kërkuesit, do të vlerësojë, në vijim, edhe atë për pajtueshmërinë me këtë dispozitë. Megjithatë, pretendimi konkret ka të bëjë me pajtueshmërinë me direktivat e BE-së dhe jo me detyrimet që burojnë nga MSA-ja në vetvete, e cila i përcakton direktivat si bazë dhe referencë për përafrimin e legjislacionit, por pa i bërë ato instrumente me forcë detyruese dhe pjesë të së drejtës së brendshme në kuptimin kushtetues. Edhe pse në disa raste Gjykata në vendimmarrjen e saj i është referuar së drejtës komunitare (*shih vendimet nr. 30, datë 02.11.2022; nr. 56, datë 27.07.2016; nr. 48, datë 15.11.2013 të Gjykatës Kushtetuese*), ajo nuk ka vendosur për pajtueshmërinë e akteve normative të rendit juridik të brendshëm me një akt të BE-së, por ky referim i ka shërbyer analizës kushtetuese krahasimore në drejtim të zhvillimit të koncepteve kushtetuese nën dritën e standardeve ndërkombëtare. Në rastin konkret, vërehet se, për shkak të angazhimit të Shqipërisë në procesin e integrimit evropian, ligji bazë është përafruar pjesërisht me Direktivën e Habitateve, megjithatë kjo direktivë mbetet pjesë e së drejtës së BE-së dhe në kushtet kur Republika e Shqipërisë nuk është ende shtet anëtar i saj, ky akt nuk është pjesë e rendit juridik të brendshëm, por i tillë është vetëm ligji që ka përafruar pjesërisht direktivën në fjalë. Në një interpretim *a contrario,* nëse Gjykata do të vendoste për pajtueshmërinë e akteve normative të brendshme me aktet e BE-së, do të dukej sikur ajo ka përthithur një funksion të pushtetit legjislativ, duke i bërë kështu ato pjesë të së drejtës së brendshme, për rrjedhojë duke u dhënë forcë të detyrueshme në rendin e brendshëm juridik, çka do të përbënte cenim të parimit të ndarjes së

pushteteve. Për rrjedhojë, ky pretendim i kërkuesit nuk mund të merret në shqyrtim nga Gjykata.[3]

28. Ndërsa, sipas qëndrimit tjetër, është e vërtetë që e drejta komunitare nuk është pjesë e rendit juridik të brendshëm, megjithatë çështja në shqyrtim lidhet me karakterin detyrues të MSA-së. Kjo e fundit ka krijuar një proces asociimi të palëve në funksion të stabilizimit dhe përgatitjes së Republikës së Shqipërisë për anëtarësimin eventual në BE (*shih vendimet nr. 21, datë 18.04.2023; nr. 30, datë 02.11.2022; nr. 14, datë 21.03.2014 të Gjykatës Kushtetuese*), por nuk mund të mohohet se MSA-ja përbën marrëveshje ndërkombëtare të ratifikuar me ligj, e cila përmban të drejta dhe detyrime të ndërsjella për palët e saj, që në rastin e Republikës së Shqipërisë kanë të bëjnë, ndër të tjera, me përafrimin e legjislacionit vendas me të drejtën komunitare. Si e tillë, MSA-ja, bazuar në nenin 122, pika 1 dhe 2 të Kushtetutës, është pjesë e sistemit të brendshëm juridik, që ka epërsi mbi ligjet e vendit që nuk pajtohen me të dhe zbatimi i saj kërkon, ndër të tjera, nxjerrjen e ligjeve në përputhje me *acquis communautaire*. Në zbatim të këtij detyrimi ndërkombëtar, Kuvendi ka miratuar ligjin nr. 81/2017 "Për zonat e mbrojtura", i cili, siç pasqyrohet në atributet e tij, është përafruar pjesërisht me Direktivën e Këshillit 92/43/KEE, datë 21 maj 1992 "Për ruajtjen e habitateve natyrore dhe të florës dhe faunës së egër", të ndryshuar" (*Numri celex 31992L0043, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, Seria L, nr. 206, datë 22.7.1992, faqe 7- 50*). Në këtë situatë duket se kur ndërmerren nisma për të ndryshuar ligjin "Për zonat e mbrojtura", Kuvendi duhet të analizojë sa dhe si nisma në fjalë ndërhyn te procesi i përafrimit për të garantuar që ai proces, edhe pse gradual, të mos kthehet pas në masën që të bjerë ndesh me detyrimet e Shqipërisë në kuadër të MSA-së.

29. Për sa më lart, sipas këtij qëndrimi, pretendimi i kërkuesit se ligji i kundërshtuar bie ndesh me nenin 108 të MSA-së nuk mund të përjashtohet nga juridiksioni kushtetues, për sa kohë neni 131, pika 1, shkronja "a", i Kushtetutës përcakton se Gjykata ka kompentecë të shqyrtojë pajtueshmërinë e ligjit me marrëveshjet ndërkombëtare, siç parashikohet në nenin 122 të saj. Në vijim të këtij arsyetimi, është e qartë se detyrimet që përcakton neni 108 i MSA-së për të promovuar qëndrueshmërinë mjedisore nuk mund të vlerësohen nga pikëpamja kushtetuese pa referencat specifike në të drejtën e BE-së, veçanërisht në lidhje me Direktivën e Habitateve,

[3] Votuan sipas këtij qëndrimi gjyqtarët Holta Zaçaj, Sonila Bejtja, Sandër Beci dhe Genti Ibrahimi.

pasi ndryshe neni 108 do të mbetej pa substancë. Për rrjedhojë, pretendimi i kërkuesit hyn në juridiksionin kushtetues dhe duhet shqyrtuar themeli i tij.[4]

30. Për shkak të qëndrimeve të mësipërme, Gjykata konstatoi se nuk ishte e mundur të formohej numri i kërkuar prej 5 gjyqtarësh për të vijuar me shqyrtimin dhe vendimmarrjen për themelin e pretendimit të lidhur me papajtueshmërinë e ligjit ndryshues me MSA-në në drejtim të përputhshmërisë me të drejtën e BE-së.

31. Gjykata vëren, gjithashtu, se kërkuesi dhe subjektet e interesuara, AOS dhe Eco Albania, kanë pretenduar se dispozitat e ligjit objekt gjykimi cenojnë *parimin e solidaritetit midis brezave*, të deklaruar në Preambulën e Kushtetutës, *identitetin dhe trashëgiminë kulturore*, të garantuar në nenin 3 të Kushtetutës dhe *nenin 59, pika 1,* në lidhje *me të drejtën për një mjedis të shëndetshëm dhe ekologjikisht të përshtatshëm për brezat e sotëm dhe të ardhshëm (shkronja "d"), shfrytëzimin racional të burimeve natyrore mbi bazën e parimit të zhvillimit të qëndrueshëm (shkronja "dh") dhe mbrojtjen e trashëgimisë kombëtare kulturore (shkronja "g")*. Në këtë kuptim, Gjykata vëren se Kushtetuta në nenin 3 të saj ka përcaktuar se identiteti dhe trashëgimia kombëtare përbëjnë vlera themelore, që shteti ka detyrë t'i respektojë dhe mbrojë. Mbrojtja e trashëgimisë kombëtare, kulturore përbën gjithashtu objektiv social sipas pikës 1 të nenit 59 të Kushtetutës (shkronja "g"). Edhe parimi i solidaritetit midis brezave, krahas deklarimit në Preambulën e Kushtetutës, është parashikuar nga neni 59 i lidhur me të drejtën për një mjedis të shëndetshëm dhe ekologjikisht të përshtatshëm, si detyrim për brezat e sotëm dhe të ardhshëm (shkronja "d"). Megjithatë, ndonëse identiteti kombëtar në drejtim të trashëgimisë kombëtare, e drejta për një mjedis të shëndetshëm dhe ekologjikisht të përshtatshëm si një detyrim për brezat e sotëm dhe të ardhshëm, si dhe shfrytëzimi racional i burimeve natyrore, janë parashikuar në Kushtetutë, ato kanë të bëjnë me objektivat socialë të parashikuar nga neni 59 i Kushtetutës, të cilat, shteti, brenda kompetencave kushtetuese dhe mjeteve që disponon, synon t'i plotësojë. Ashtu sikurse parashikon vetë pika 2 e këtij neni, përmbushja e objektivave socialë nuk mund të kërkohet drejtpërdrejt në gjykatë. Në vijim të këtij arsyetimi, duke marrë në konsideratë edhe faktin se palët nuk kanë ngritur argumente të mirëfillta kushtetuese në mbështetje të tyre, Gjykata do t'i vlerësojë pretendimet në lidhje me to në këndvështrim të së drejtës ndërkombëtare të ratifikuar dhe detyrimeve që rrjedhin ndaj shtetit shqiptar

[4] Votuan sipas këtij qëndrimi gjyqtarët Marsida Xhaferllari, Fiona Papajorgji, Ilir Toska dhe Marjana Semini.

në lidhje me identitetin kombëtar dhe trashëgiminë natyrore, sipas nenit 122 të Kushtetutës. Siç ka thekuar edhe më parë Gjykata, edhe në trajtimin konventor, Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*) nuk i ka parashikuar ato si të drejta më vete, por janë trajtuar në jurisprudencën e GJEDNJ-së të ndërlidhura me të drejta të tjera të parashikuara në të (*shih vendimin nr. 3, datë 30.01.2024 të Gjykatës Kushtetuese*).

32. Në mbështetje të këtyre pretendimeve kërkuesi dhe subjektet e interesuara, AOS dhe Eco Albania, në mënyrë të përmbledhur, kanë parashtruar se për shkak të heqjes së "ndalimeve" dhe zëvendësimit të tyre me "kufizime", ligji ndryshues mund të sjellë pasoja të pakthyeshme te pasuritë natyrore të vendit, si një element përbërës i identitetit dhe trashëgimisë kombëtare, pasi dobëson mbrojtjen e tyre si një detyrim për brezat e sotëm dhe të ardhshëm. Ky pretendim është i lidhur veçanërisht me nenin 14 të ligjit ndryshues, që ndryshon nenin 33 të ligjit bazë "Veprimtaritë e lejuara në zonat e mbrojtura". Nëpërmjet lejimit të turizmit elitar dhe infrastrukturës mbështetëse të tij, ligji ndryshues, sipas tyre, e zhvendos balancën nga ruajtja e pasurisë natyrore drejt lehtësimit të aktiviteteve zhvillimore, ndaj është i papajtueshëm me nenin 108 të MSA-së. Po kështu, sipas tyre, ekzistojnë rreziqe serioze për mospërmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara, specifikisht: (i) Konventa e Ramsarit, në nenet 2, 3, 4 dhe 5; (ii) Konventa e Bernës, në nenin 4, paragrafët 1 dhe 2, si dhe nenet 1, 2, 3, 5, 8, 9, 10, 11 dhe 12; (iii) Konventa e Rios, në nenet 6, 8, 10 dhe 11; (iv) Konventa e Parisit.

33. Subjekti i interesuar, Kuvendi, ka prapësuar se këto janë vlerësime subjektive dhe të paargumentuara, për efekte të mundshme të ligjit, për më tepër që mbeten të natyrës teknike dhe nuk kanë mundur të ngrihen në nivel kushtetues. Sipas këtij subjekti të interesuar, pretendimi se ligji mund të hapë rrugë për ndryshime arbitrare nuk qëndron, pasi çdo ndryshim ose veprim në zonat e mbrojtura do të bazohet në akte nënligjore dhe procedura të mirëpërcaktuara. Ndryshimet ligjore, sipas këtij subjekti, passjellin risi në shkallën e mbrojtjes së zonës së mbrojtur, por edhe garantojnë siguri juridike, pasi miratohen me VKM dhe ushtrimi i veprimtarive lejohet vetëm pasi të jetë marrë leja e mjedisit ose miratimi me shkrim i organit të mbrojtjes së zonës. Në këtë mënyrë, prezantohet një regjim i ekuilibruar, që lejon zhvillimin e veprimtarive të ndryshme në zonat e mbrojtura, por vetëm nëse ato janë në përputhje me qëllimin e mbrojtjes së këtyre zonave dhe janë të kushtëzuara nga një kontroll i rreptë nga

organet kompetente. Ndërsa subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave, ka prapësuar se argumentet në mbështetje të pretendimit se ligji cenon nenin 59 të Kushtetutës nuk ngrenë ndonjë problematikë të natyrës kushtetuese, por janë pretendime me natyrë ligjore, çka bën që shqyrtimi i tyre të jetë jashtë juridiksionit të kësaj Gjykate.

34. Gjykata ka theksuar se trashëgimia kombëtare përbën një nga bazat e shtetit, respektimi dhe mbrojtja e saj përbëjnë vlerë kushtetuese, ndaj është detyrë e shtetit të miratojë dhe përcaktojë mënyrat e format për garantimin dhe mbrojtjen e saj, si dhe të sigurojë ruajtjen për brezat e ardhshëm. Ajo është pjesë e trashëgimisë së popullit, përbën kujtesën e prekshme dhe të paprekshme të asaj që njeriu ka krijuar (dhe vazhdon të krijojë) për pasardhësit e tij, si dhe një formë të veçantë të shprehjes së kulturës së popullit dhe përfshin çdo gjë që konsiderohet vendimtare për identitetin e një shoqërie ose vendi. Për këtë arsye, identiteti kombëtar dhe trashëgimia kombëtare parashikohen në nenin 3 të Kushtetutës, që përcakton se shteti ka për detyrë të mbrojë dhe të respektojë bazat e përcaktuara në të, të cilat nuk janë gjë tjetër veçse vlera themelore, pra që qëndrojnë në themel të organizimit shtetëror (*shih vendimin nr. 29, datë 02.07.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

35. Po sipas Gjykatës, në bazë të nenit 122 të Kushtetutës çdo marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar përbën pjesë të sistemit të brendshëm juridik pasi botohet në Fletoren Zyrtare dhe ajo zbatohet në mënyrë të drejtpërdrejtë, përveç rasteve kur nuk është e vetëzbatueshme dhe zbatimi kërkon nxjerrjen e një ligji. Një marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar me ligj ka epërsi mbi ligjet e vendit kur nuk pajtohen me të. Nën dritën e parashikimeve të neneve 5, 116 dhe 122 të Kushtetutës, Gjykata ka theksuar se Republika e Shqipërisë zbaton të drejtën ndërkombëtare të detyrueshme për të, duke i radhitur marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara, të cilat janë pjesë e sistemit të brendshëm juridik, në hierarkinë e akteve normative që kanë fuqi përpara ligjeve (*shih vendimet nr. 3 datë 30.01.2024; nr. 30, datë 02.11.2022; nr. 14, datë 21.03.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

36. Referuar edhe sa më sipër, Gjykata ka evidentuar se MSA-ja është një marrëveshje kuadër për marrëdhëniet ndërmjet Republikës së Shqipërisë, nga njëra anë, dhe BE-së dhe shteteve anëtare të saj, nga ana tjetër. Kjo marrëveshje në nenin 108 të saj "Degradimi mjedisor" parashikon se "palët do të zhvillojnë dhe forcojnë bashkëpunimin në detyrën shumë të rëndësishme të luftës kundër degradimit mjedisor, me synim promovimin

e qëndrueshmërisë mjedisore". Po kështu, Gjykata evidenton se nëpërmjet Konventës së Parisit shtetet palë kanë marrë përsipër jo vetëm të ruajnë sitet e pasurisë botërore që ndodhen në territorin e tyre, por edhe që të mbrojnë pasurinë kombëtare. Konventa e Ramsarit parashikon se shtetet palë formulojnë dhe zbatojnë plane për promovimin dhe mbrojtjen e ligatinave të përfshira në listë, si dhe për përdorimin sa më racional të ligatinave në territorin e tyre. Objekti i Konventës së Bernës është të sigurojë ruajtjen e florës, të faunës së egër, vendbanimet e tyre natyrale, veçanërisht speciet dhe vendstrehimet për të cilat ruajtja kërkon kooperimin e shumë shteteve, si dhe të nxisë këtë bashkëpunim. Ndërsa objekti i Konventës së Rios është ruajtja e diversitetit biologjik, përdorimi i qëndrueshëm i përbërësve të tij dhe ndarja e drejtë dhe e barabartë e përfitimeve që rrjedhin nga shfrytëzimi i burimeve gjenetike.

37. Në rastin në shqyrtim, me ligjin ndryshues janë bërë disa ndryshime, shtesa dhe shfuqizime në ligjin bazë, si: shtimi i disa përkufizimeve (neni 1) dhe parimeve (neni 2); lejimi i infrastrukturës dhe veprimtarive të mikpritjes për mbështetjen e turizmit të ekselencës (me 5 yje) dhe infrastrukturës mbështetëse në zonën e llojit "Park kombëtar" (neni 7); lejimi i veprimtarive dhe infrastrukturës turistike dhe infrastrukturës mbështetëse për zonat "Rezervat natyror i menaxhuar/park natyror" (neni 9) dhe "Zonë e mbrojtur detare" (neni 11); lejimi i ndërhyrjeve të lejuara urbane, të rekreacionit apo atyre ekonomike brenda zonës "Peizazh i mbrojtur" (neni 10); përcaktimi i veprimtarive të lejuara në zonat e mbrojtura (neni 14); prezantimi i mundësisë së ndryshimit të sipërfaqes së zonës (neni 16); parashikimi i krijimit të ZAPK-ve si institucion teknik-administrativ në varësi të ministrisë përgjegjëse për zonat e mbrojtura, i organizuar në nivel qendror dhe rajonal, i cili do të ushtrojë veprimtari brenda territorit gjeografik të zonës së kategorisë "Park kombëtar" (neni 17); mundësia e lidhjes së kontratave tripalëshe me bashkinë dhe subjektet e interesuara për dhënien për përdorim të përkohshëm të territoreve kullota, pjesë e zonave të mbrojtura (neni 18).

38. Për sa më sipër, Gjykata vëren se ligji për zonat e mbrojtura është një ligj kuadër dhe, si i tillë, ky ligj nuk është i vetëzbatueshëm, pra nuk sjell pasoja në vetvete. Duke qenë se pretendimet e kërkuesit dhe subjekteve të interesuara, AOS dhe Eco Albania, në këtë drejtim janë specifike dhe lidhen kryesisht me mundësinë hipotetike të ndërtimit të resorteve dhe hoteleve me 5 yje në zona të mbrojtura me karakteristika të caktuara, Gjykata çmon se është e pamundur për të verifikuar në këtë

moment sesi pretendimi specifik i kërkuesit dhe këtyre subjekteve të interesuara mund të dëmtojë karakteristikat e një zone me specifika të caktuara, tek e cila mund të mos ndërtohet asnjëherë. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se ligji i kundërshtuar, duke qenë ligj kuadër, edhe pse shton disa elemente të reja të administrimit të zonave të mbrojtura, nuk duket të sjellë pasoja konkrete të drejtpërdrejta në këtë drejtim. Në këtë kuptim, Gjykata, duke pasur parasysh se për zbatimin e ligjit do të nxirren VKM-të specifike për shpalljen e zonave të mbrojtura, të cilat do të bëjnë përcaktimet e detajuara përkatëse për secilën zonë sipas nenit 33 të ligjit bazë, evidenton se vetëm atëherë do të jetë e mundur të verifikohet përputhja ose jo e këtyre VKM-ve me detyrimet e përgjithshme që burojnë nga neni 108 i MSA-së për mosdegradim mjedisor, në varësi të specifikave të zonës së mbrojtur konkrete të shpallur në VKM-në për të cilën ka dalë akti, i cili në çdo rast mund t'i nënshtrohet kontrollit të ligjshmërisë ose kushtetutshmërisë së tij. E njëjta analizë si për MSA-në vlen edhe për përputhshmërinë e ligjit ndryshues me konventat ndërkombëtare të Parisit, Ramsarit, Bernës dhe Rios, për shkak të mungesës së efekteve dhe pasojave konkrete të ligjit kuadër objekt shqyrtimi. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimi për papajtueshmërinë e ligjit me marrëveshjet ndërkombëtare në lidhje me identitetin kombëtar dhe trashëgiminë natyrore është haptazi i pabazuar[5].

39. Gjykata vëren se kërkuesi ka pretenduar se procedura e propozimit të projektligjit në rastin në shqyrtim mbart *shkelje të Rregullores së Kuvendit* lidhur me procedurat parlamentare për hartimin, paraqitjen, shqyrtimin dhe miratimin e projektligjeve. Sipas tij, projektligji ka ardhur në Kuvend në mënyrë jotransparente, pasi deputetët propozues pretendojnë se kërkesa ka ardhur nga disa kryetarë bashkish, por kjo kërkesë e tyre nuk i është vënë në dispozicion askujt për efekt transparence.

40. Subjektet e interesuara, Kuvendi dhe Këshilli i Ministrave, kanë prapësuar se mosrespektimi i Rregullores së Kuvendit e bën veprimtarinë parlamentare jokushtetuese vetëm nëse janë prekur dispozita të nivelit

[5] Gjyqtarja Marjana Semini votoi për shqyrtimin në themel të pretendimit për papajtueshmërinë e ligjit me marrëveshjet ndërkombëtare në lidhje me identitetin kombëtar dhe trashëgiminë kulturore në drejtim të solidaritetit midis brezave sipas neneve 3 dhe 122 të Kushtetutës, që lidhet me *parimin e fleksibilitetit të menaxhimit*, të parashikuar në shkronjën "e" të nenit 2 të ligjit ndryshues, pasi çdo formë menaxhimi e zonave të mbrojtura duhet të ketë prioritet *parimin e zhvillimit të qëndrueshëm,* që do të thotë se duhet t'i referohet vetëm një menaxhimi të kujdesshëm në mbrojtje të pasurive natyrore në drejtim të nevojave të brezave të tashëm dhe të ardhshëm.

kushtetues, që gjejnë pasqyrim në të, ndërsa për çështje të tjera, rregullorja nuk mund të jetë objekt kontrolli kushtetues.

41. Në rastet kur ka shqyrtuar pretendime në lidhje me pajtueshmërinë e procedurës së miratimit të akteve ligjore me rregulloren, Gjykata është shprehur se në respektim të parimit të vetërregullimit të Kuvendit, ky akt, në parim, nuk i nënshtrohet kontrollit kushtetues. Kuvendi është organi që me rregullore interpreton jo vetëm normat kushtetuese, por edhe normat e tjera të këtij akti në praktikën e rasteve konkrete (*shih vendimet nr. 1, datë 16.02.2022; nr. 44, datë 07.10.2011; nr. 29, datë 21.10.2009 të Gjykatës Kushtetuese*). Kompetenca e saj për kontrollin e rregullores është e kufizuar vetëm në pretendime që kanë të bëjnë me cenimin e normave kushtetuese, për rrjedhojë edhe kontrolli kushtetues shtrihet vetëm ndaj atyre dispozitave të rregullores që prekin normat kushtetuese (*shih vendimin nr. 48, datë 30.05.2024 të Gjykatës Kushtetuese*).

42. Në rastin në shqyrtim Gjykata vëren se kërkuesi, në thelb, ka pretenduar mungesën e transparencës lidhur me origjinën e projektligjit të propozuar, duke argumentuar se letra e kryetarëve të bashkive drejtuar deputetëve nuk është bërë publike. Gjykata vëren se sipas nenit 81 të Kushtetutës të drejtën për të propozuar ligje e ka Këshilli i Ministrave, çdo deputet, si dhe 20 mijë zgjedhës dhe se ajo nuk përmban rregulla të përcaktuara për procedurën përgatitëse/përpara propozimit të projektligjeve. Në këtë kuptim, Gjykata vlerëson se ky pretendim i kërkuesit nuk është ngritur në nivel kushtetues, pasi për shkeljen e pretenduar nuk është referuar dispozita ose standardi kushtetues i cenuar, për rrjedhojë ky pretendim i kërkuesit nuk mund të merret në shqyrtim nga Gjykata.

43. Lidhur me pretendimin tjetër të kërkuesit se ligji ndryshues është në kundërshtim me frymën e ligjit ekzistues dhe se ka *përplasje mes normave ligjore* në fuqi referuar kompetencave të KKT-së, Gjykata vë në dukje se në juridiksionin kushtetues hyjnë papajtueshmëria e ligjeve ose kodeve me Kushtetutën, kurse mënyra e të kuptuarit, e të zbatuarit të ligjit dhe harmonizimit ndërmjet dispozitave të tij me ligje të tjera nuk janë çështje që i përkasin kontrollit kushtetues, ndaj nuk janë objekt shqyrtimi nga Gjykata (*shih vendimet nr. 5, datë 05.02.2015; nr. 1, datë 06.02.2013; nr. 2, datë 03.02.2010; të Gjykatës Kushtetuese*). Për rrjedhojë, kjo çështje nuk mund të përfshihet në juridiksionin kushtetues, ndaj ky pretendim i kërkuesit nuk mund të merret në shqyrtim prej saj.

44. Pjesën e mbetur të pretendimeve Gjykata vlerëson t'i shqyrtojë në vijim, në themel, në drejtim të konsultimit publik të lidhur me të *drejtën për*

t'u informuar për gjendjen e mjedisit dhe për mbrojtjen e tij dhe *detyrimit për shoqërimin e projektligjit me raportin që përligj shpenzimet financiare,* respektivisht sipas neneve 56 dhe 82 të Kushtetutës.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për detyrimin për shoqërimin e projektligjit me raportin që përligj shpenzimet financiare, sipas nenit 82, pika 1, të Kushtetutës

45. Kërkuesi ka pretenduar se nuk është respektuar neni 82, pika 1, i Kushtetutës, pasi edhe pse projektligji në versionin final krijonte efekte financiare shtesë në buxhetin e shtetit, ai nuk u shoqërua me raportin përkatës që përligj shpenzimet financiare. Qëllimet e kushtetutëbërësit në këtë drejtim kanë qenë informimi i qytetarëve dhe deputetëve për kostot që sjell miratimi i një ligji të ri, si dhe mbrojtja e financave publike. Edhe Rregullorja e Kuvendit në nenin 68, pika 2, të saj, përcakton një detyrim të tillë. Vetë raporti i Komisionit të Ligjeve, i datës 09.02.2024, shprehet se projektligji ka efekte financiare, megjithatë më pas e ka injoruar plotësisht faktin se versioni final i projektligjit nuk është në përputhje me detyrimet kushtetuese. Kështu, krijimi i ZAPK-së Vjosa ka sjellë shtim të shpenzimeve në buxhetin e shtetit për periudhën 2025-2027 në masën 82 milionë lekë.

46. Subjekti i interesuar, Kuvendi, ka prapësuar se ky pretendim është i pabazuar, pasi projektligji nismë e deputetëve nuk ka pasur efekte financiare, ndërsa krijimi i ZAPK-ve ka ardhur si propozim i Këshillit të Ministrave. Krijimi i këtij institucioni, struktura dhe organika e tij miratohet me VKM, ndaj efektet financiare do të jenë të zbatueshme vetëm në fazën e ngritjes së këtij institucioni. Kurse mendimi i Këshillit të Ministrave nuk bazohet me nismën ligjore, ndaj nuk kishte detyrim të shoqërohej me raportin përkatës për shpenzimet financiare.

47. Subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave, ka prapësuar se ky pretendim është i pabazuar, pasi efektet financiare do të jenë zbatueshme vetëm në fazën e implementimit, ku Këshilli i Ministrave do të luajë rolin e tij përmes akteve nënligjore. Po kështu, qëllimi i kushtetutëbërësit ka qenë që në situatën e miratimit të një ligji që sjell efekte financiare, të bëhen edhe ndryshimet përkatëse në ligjin e buxhetit. Por nëse efektet financiare që mund të ketë një ligj përfshihen në buxhetin aktual të miratuar të ministrisë, siç ishte në këtë rast ZAPK-ja Vjosa, atëherë efektet financiare nuk konsiderohen të jenë "shtesë", pasi janë të përthithura brenda buxhetit të vitit ekzistues dhe, në këtë kuptim, situata është në përputhje të plotë edhe

me atë që parashikon vetë relacioni i Kuvendit që pohon se projektligji nuk ka efekte financiare shtesë.

48. Kushtetuta në nenin 82 parashikon se propozimi i ligjit, kur është rasti, duhet të shoqërohet me raportin që përligj shpenzimet financiare për zbatimin e tij (pika 1). Asnjë projektligj joqeveritar që bën të nevojshme rritjen e shpenzimeve të buxhetit të shtetit ose që pakëson të ardhurat nuk mund të miratohet pa marrë mendimin e Këshillit të Ministrave, i cili duhet të shprehet brenda 30 ditëve nga marrja e projektligjit (pika 2). Neni 82 i Kushtetutës, në thelb, përcakton detyrimin për paraqitjen e raportit që përligj shpenzimet financiare në rastet kur projektligji ndërhyn në financat publike, pra ndikon në buxhetin e shtetit, duke sjellë rritje shpenzimesh ose pakësim të të ardhurave të tij (*shih vendimin nr. 32, datë 27.10.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

49. Për sa më lart, pas shqyrtimit të pretendimit për cenimin e nenit 82 të Kushtetutës në lidhje me raportin shoqërues të projektligjit që përligj shpenzimet financiare për zbatimin e tij, në përfundim të diskutimeve vlerësimet e gjyqtarëve u ndanë në dy qëndrime dhe Gjykata nuk arriti numrin e kërkuar të votave për vendimmarrje, sipas parashikimeve të nenit 133, pika 2, të Kushtetutës dhe nenit 72, pika 2, të ligjit nr. 8577/2000.

50. Sipas njërit qëndrim, nga interpretimi literal i normës kushtetuese të pretenduar të cenuar, synimi i kushtetutëbërësit në këtë rast është i lidhur me përligjjen e shpenzimeve financiare për zbatimin e projektligjeve që rrisin shpenzimet e buxhetit të shtetit ose pakësojnë të ardhurat dhe nuk ka të bëjë me verifikimin e masës së tyre, pra me përllogaritjen. Neni 17 i ligjit ndryshues, që parashikon krijimin e këtyre strukturave të reja për zonat e mbrojtura "Park kombëtar", parashikon se ZAPK-të brenda territorit të veprimtarisë së tyre ushtrojnë çdo funksion administrimi, menaxhimi që ligji parashikon për administratën rajonale të zonave të mbrojtura, pra, me fjalë të tjera, funksionet e tyre, në thelb, mbeten të njëjta me ato të strukturave ekzistuese dhe, për rrjedhojë, nuk duket se ka pasur nevojë për një përligjje të mëtejshme të këtyre shpenzimeve.

51. Pavarësisht sa më sipër, gjyqtarët që mbajnë këtë qëndrim vërejnë se ligji ndryshues me nenin 17 të tij ka shtuar në ligjin bazë nenin 39/1 të titulluar "Zyra e Administrimit të Parqeve Kombëtare". Në pikën 8 të këtij neni parashikohet se krijimi i Zyrës së Administrimit të Parkut Kombëtar, struktura dhe organika e saj miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për zonat e mbrojtura. Në këtë kuptim, sipas tyre, nga mënyra sesi është formuluar neni 17 i ligjit ndryshues, në veçanti pika 8 e tij në lidhje me krijimin e ZAPK-ve, duket

se ai nuk passjell shpenzime financiare, pasi nuk është i vetëzbatueshëm. Ashtu siç prapësojnë edhe subjektet e interesuara, Kuvendi dhe Këshilli i Ministrave, përllogaritja e efekteve financiare që do të vinin si pasojë e krijimit të ZAPK-ve, është e mundshme vetëm në fazën e ngritjes së zyrës përkatëse nga Këshilli i Ministrave nëpërmjet akteve nënligjore dhe jo në momentin e miratimit të ligjit të kundërshtuar, për shkak se këto shpenzime do të ishin të pamatshme në atë moment. Për më tepër, subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave, gjatë seancës plenare ka prapësuar se në rastin e strukturës së re të krijuar me VKM, ZAPK-ja Vjosa, efektet financiare që e shoqërojnë atë janë të përthithura brenda buxhetit të vitit ekzistues të ministrisë përgjegjëse për zonat e mbrojtura dhe, në këtë kuptim, nuk ka një efekt të shtuar financiar në buxhetin e shtetit. Kjo situatë, sipas këtij subjekti të interesuar, është në përputhje të plotë edhe me atë që parashikon vetë relacioni i komisioni përgjegjës, që pohon se projektligji nuk ka efekte financiare shtesë. Për rrjedhojë, pretendimi për cenimin e nenit 82, pika 1, të Kushtetutës, është i pabazuar.[6]

52. Sipas qëndrimit tjetër, neni 82, pika 1, i Kushtetutës vendos detyrimin që projektligji të shoqërohet kurdoherë kur është rasti me raportin që përligj shpenzimet financiare për zbatimin e tij. Përligjja e shpenzimeve nënkupton detyrimin për llogaritjen e shpenzimeve financiare dhe identifikimin e burimit ligjor për mbulimin e tyre, që nuk është gjë tjetër përveçse parashikimi i atij burimi në buxhetin e shtetit. Ky detyrim është në funksion të mbrojtjes dhe të menaxhimit të përshtatshëm të financave publike, të cilat Kushtetuta i rregullon në mënyrë të detajuar në pjesën e trembëdhjetë të saj (nenet 155-161). Nga analiza e këtyre dispozitave konstatohet lehtësisht se financat publike mbrohen në nivel kushtetues dhe menaxhimi i tyre bazohet në parimin e transparencës dhe të llogaridhënies. Për këtë arsye, organet e pushtetit qendror dhe atij vendor janë të detyruara t'i bëjnë publike të ardhurat dhe shpenzimet (neni 157, pika 4); hartimi, miratimi dhe zbatimi i buxhetit u nënshtrohen procedurave specifike kushtetuese, të ndryshme nga ajo e procesit ligjvënës (neni 158), ku një prej ndryshimeve thelbësore lidhet me karakteristikën e përvitshmërisë së ligjit për buxhetin; zbatimi i buxhetit të shtetit kontrollohet nga një organ kushtetues i specializuar – Kontrolli i Lartë i Shtetit (nenet 158, pika 5 dhe 162-165). Ndonëse Kushtetuta lejon ndryshime në buxhet gjatë vitit financiar (neni 160, pika 1), ajo parashikon ndalim të shprehur për uljen e

[6] Votuan sipas këtij qëndrimi gjyqtarët Holta Zaçaj, Sandër Beci, Genti Ibrahimi dhe Marjana Semini.

shpenzimeve të parashikuara me ligje të tjera, për sa kohë këto ligje janë në fuqi (neni 160, pika 2).

53. Sipas këtij qëndrimi, duke zbatuar këtë kuadër normativ në çështjen konkrete, vihet re se ligji i kundërshtuar parashikon ngritjen e ZAPK-ve, si strukturë e re shtetërore, e cila është e pajisur me funksione të reja që kanë të bëjnë me planet e menaxhimit për veprimtaritë ekonomike, turistike dhe infrastrukturën mbështetëse për to. Nuk ka dyshim që ngritja e kësaj strukture mbart efekte financiare, që e bëjnë të nevojshëm hartimin e raportit që i përligj ato. Efektet financiare rezultojnë jo vetëm nga përmbajtja e ligjit që parashikon krijimin e këtyre zyrave, por konfirmohen edhe nga raporti i Komisionit të Ligjeve që ka pohuar se projektligji sjell efekte financiare. Gjithashtu, këto efekte dukshëm janë pranuar edhe në përgjigjet e pyetjeve të drejtuara nga Gjykata, nga subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave, i cili, ndonëse i lidhi ato me aktin nënligjor, informoi se ngritja e ZAPK-së Vjosa paraqiste efekte financiare për strukturën e re me 19 punonjës në varësi të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, arsye për të cilën u çel produkti i ri buxhetor "Parku Vjosë i mirëmenaxhuar". Sipas këtij subjekti të interesuar, fondet buxhetore u detajuan për aparatin e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit deri në momentin e krijimit të institucionit, duke u *rialokuar* shpenzimet korrente të buxhetit për vitet 2025-2027 (26 milionë lekë për vitin 2025, 28 milionë lekë për vitin 2026 dhe 28 milionë lekë për vitin 2027) nga aparati i ministrisë për njësinë e re shpenzuese.

54. Në këtë kuptim, sipas këtij qëndrimi, raporti që përligjte shpenzimet financiare duhet të përmbante shumën e përgjithshme të shpenzimeve vjetore për ngritjen dhe funksionimin e Zyrës; parashikimet e hollësishme për çdo zë të buxhetit, të nevojshme për ngritjen dhe funksionimin e saj; kohën e fillimit të efekteve financiare në raport me parashikimin e hyrjes në fuqi të ligjit; shpenzimet e detajuara për strukturat që ngarkohen me ngritjen e Zyrës; burimet e sigurta dhe të pritshme të financimit; analizën e rritjes ose të pakësimit të shpenzimeve buxhetore të paktën për tre vjetët e para të zbatimit të ligjit; vlerën e detyrimeve fiskale të pritshme ose të përjashtuara, nëse kishte të tilla. Mungesa e një raporti të tillë nuk është një mangësi formale dhe nuk mund të riparohet për përllogaritjen e tyre në kohën e nxjerrjes së akteve nënligjore, sepse një veprim i tillë, në thelb, deformon menaxhimin e financave publike, duke lejuar ndryshime në buxhetin e shtetit jo me ligj, por me akte nënligjore të pakontrolluara nga Kuvendi. Për rrjedhojë, në kushtet kur detyrimi për hartimin e raportit të shpenzimeve

financiare nuk është përmbushur, neni 17 i ligjit të kundërshtuar dhe dispozitat e tjera që lidhen me të duhen shfuqizuar.[7]

55. Për shkak të qëndrimeve të mësipërme, Gjykata vëren se në kushtet kur nuk u formua shumica prej 5 gjyqtarësh, në kuptim të nenit 73, pika 4, të ligjit nr. 8577/2000, pretendimi për cenimin e nenit 82, pika 1, të Kushtetutës konsiderohet i rrëzuar.

B.2. Për cenimin e së drejtës për t'u informuar për gjendjen e mjedisit dhe mbrojtjen e tij

56. Kërkuesi ka pretenduar se është cenuar e drejta e publikut për t'u informuar për gjendjen e mjedisit, e parashikuar nga neni 56 i Kushtetutës, Konventa e Aarhus-it dhe jurisprudenca e GJEDNJ-së, të cilat kërkojnë që për parashikimet ligjore që prekin mjedisin dhe zonat e mbrojtura të kryhen konsultime publike gjatë gjithë hallkave të realizimit të procesit ligjvënës. Edhe në jurisprudencën kushtetuese është folur për "pjesëmarrje dhe konsultim efektiv", që nënkupton mundësinë për palët e përfshira në një procedurë legjislative për të kërkuar shpjegime dhe të ofruar komentet e tyre mbi atë që është drafti më i mundshëm për t'u miratuar. Konventa e Aarhus-it përcakton detyrimin e shteteve për marrjen e masave në garantimin e së drejtës së publikut për të pasur informacion për mjedisin, për të marrë pjesë në marrjen e vendimeve mjedisore dhe për t'iu drejtuar gjykatës për këto çështje, ndërkohë që GJEDNJ-ja ka përcaktuar detyrimin e shteteve që, përpara realizimit të projekteve që mund të sjellin pasoja në mjedis, të vënë në dispozicion të publikut informacione të vërteta, të besueshme, të sakta dhe të mjaftueshme, si dhe t`i japin mundësinë popullsisë së prekur për të kundërshtuar lidhur me procedurat e dhënies së lejeve. Në rastin konkret, projektligji ka ardhur në Kuvend në mënyrë jotransparente, pasi kërkesa ka ardhur nga disa kryetarë bashkish, por ajo nuk është vënë në dispozicion të deputetëve dhe për projektligjin nuk janë kryer konsultimet e nevojshme me publikun. Komisioni përgjegjës parlamentar ka kryer konsultime vetëm për draftin fillestar të projektligjit, ndërsa draftin final, pas ndryshimeve të bëra nga Këshilli i Ministrave, nuk ia ka nënshtruar konsultimit me grupet e interesit dhe publikun, edhe pse ai kishte pësuar ndryshime drastike, për më tepër teknike. Me këto ndryshime kanë kërkuar të konsultohen organizatat mjedisore, çka nuk është pranuar nga komisioni përgjegjës.

57. Subjektet e interesuara, AOS dhe Eco Albania, kanë parashtruar në

[7] Votuan sipas këtij qëndrimi gjyqtarët Marsida Xhaferllari, Fiona Papajorgji, Sonila Bejtja dhe Ilir Toska.

thelb të njëjtat argumente si kërkuesi. Për më tepër, sipas tyre, pas njohjes në mënyrë joformale me opinionin e Këshillit të Ministrave, i janë drejtuar këtij të fundit dhe Kuvendit, duke kërkuar mendimin e tyre, kërkesë e mbetur pa përgjigje. Konventa e Aarhus-it e shtrin të drejtën e pjesëmarrjes së publikut edhe gjatë përgatitjes së rregulloreve ekzekutive dhe instrumenteve të përgjithshme ligjore e normative. Sipas udhëzuesit për zbatimin e kësaj konvente, neni 8 mbulon edhe draftet ligjore që përgatiten nga organet ekzekutive, që më pas i kalohen legjislativit për miratim. Kuvendi nuk ka ofruar mundësi reale për komente për versionin e ri të projektligjit dhe as nuk është dokumentuar sesi janë reflektuar në draftin përfundimtar komentet e Këshillit të Ministrave dhe të të tjerëve. Pavarësisht se sipas Kuvendit janë pranuar vetëm 15 nga 28 propozimet e Këshillit të Ministrave, nuk sqarohet se ç'peshë juridike kishin dispozitat që u refuzuan dhe pse. Procesi i propozimit, shqyrtimit e miratimit të ligjit ndryshues në tërësi nuk ka qenë transparent, ai ka qenë minimal dhe joefektiv.

58. Subjektet e interesuara, Kuvendi dhe Këshilli i Ministrave, kanë prapësuar se ky pretendim nuk është ngritur në nivel kushtetues, pasi neni 56 i Kushtetutës dhe Konventa e Aarhusit i referohen kontekstit të vendimmarrjeve për raste dhe çështje konkrete që kanë të bëjnë me mjedisin dhe nuk lidhen me akte rregullatore me fuqi juridike të përgjithshme. Megjithatë, procedura e shqyrtimit dhe miratimit të ligjit ka qenë në përputhje me këto parashikime, pasi: komisioni përgjegjës ka zhvilluar një proces të gjerë dhe gjithëpërfshirës konsultimi, në respektim të parimit të transparencës dhe të gjithëpërfshirjes mbi të cilat zhvillohet veprimtaria parlamentare; projektligji është publikuar në platformën "Konsultimi i projektligjeve" në faqen zyrtare të Kuvendit; grupet e interesit, organizatat/ shoqatat mjedisore dhe ekspertët individualë ose stafi akademik, me të cilët komisioni përgjegjës ka zhvilluar 4 seanca dëgjimore në periudhën 30 janar deri më 12 shkurt 2024, kanë dhënë opinione; komisioni përgjegjës ka administruar, shqyrtuar dhe trajtuar komentet dhe sugjerimet e përfaqësuesve të grupeve të interesit, ka adresuar komentet dhe vërejtjet e tyre duke bërë riformulime të disa neneve, ka administruar mendimin e Këshillit të Ministrave dhe rekomandimet e komisioneve parlamentare; në seancë dëgjimore janë thirrur edhe organizatat e shoqërisë civile, duke pasur mundësi për t'u shprehur në mënyrë shteruese në lidhje me shqetësimet e tyre Pas njohjes me opinionin e Këshillit të Ministrave, organizatat mund të sillnin opinionet e tyre me shkrim.

59. Kushtetuta në nenin 56 të saj parashikon se kushdo ka të drejtë të

informohet për gjendjen e mjedisit dhe për mbrojtjen e tij. Siç është shprehur edhe Gjykata në jurisprudencën e saj, krahas së drejtës për t'u informuar për gjendjen e mjedisit, kjo dispozitë kushtetuese përfshin edhe të drejtën për t'u informuar për mbrojtjen e tij, në drejtim të masave të ndërmarra ose që duhet të ndërmerren për këtë qëllim. Në garantimin e kësaj të drejte kushtetuese, një rol të veçantë luan edhe transparenca e autoriteteve shtetërore përmes garantimit të aksesit të publikut në informacion dhe përfshirjes së tij në proceset e veprimtaritë që sjellin ndikim në mjedis (*shih vendimin nr. 3, datë 30.01.2024 të Gjykatës Kushtetuese).*

60. Gjykata ka pohuar se ndonëse e drejta për një mjedis të shëndetshëm dhe për t'u informuar për gjendjen e tij nuk parashikohet drejtpërsëdrejti nga KEDNJ-ja, në jurisprudencën e saj në këtë drejtim GJEDNJ-ja ka theksuar se krahas detyrimit për të miratuar legjislacionin e nevojshëm për mbrojtjen e mjedisit, në aspektin procedural shtetet kanë detyrimin që përpara realizimit të projekteve që mund të sjellin pasoja në mjedis, të vënë në dispozicion të publikut informacionin e nevojshëm në lidhje me to. Ky informacion duhet të jetë i vërtetë, i besueshëm, i saktë dhe i mjaftueshëm. Po kështu, shtetet duhet t'i japin mundësinë popullsisë së prekur për të marrë pjesë në procedurat e dhënies së lejeve, si dhe për të paraqitur kundërshtime (*shih vendimin nr. 3 datë 30.01.2024 të Gjykatës Kushtetuese)*.

61. Po kështu, sipas Gjykatës, në bazë të nenit 122 të Kushtetutës çdo marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar përbën pjesë të sistemit të brendshëm juridik pasi botohet në Fletoren Zyrtare dhe ajo zbatohet në mënyrë të drejtpërdrejtë, përveç rasteve kur nuk është e vetëzbatueshme dhe zbatimi kërkon nxjerrjen e një ligji. Një marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar me ligj ka epërsi mbi ligjet e vendit kur nuk pajtohen me të. Nën dritën e parashikimeve të neneve 5, 116 dhe 122 të Kushtetutës, Gjykata ka theksuar se Republika e Shqipërisë zbaton të drejtën ndërkombëtare të detyrueshme për të, duke i radhitur marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara, të cilat janë pjesë e sistemit të brendshëm juridik, në hierarkinë e akteve normative që kanë fuqi përpara ligjeve (*shih vendimet nr. 3 datë 30.01.2024; nr. 30, datë 02.11.2022; nr. 14, datë 21.03.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

62. Në vështrim të standardeve të mësipërme, Gjykata vë në dukje se me ligjin nr. 8672, datë 26.10.2000 Republika e Shqipërisë ka ratifikuar Konventën e Aarhus-it, e cila, me qëllim që të kontribuohet në mbrojtjen e së drejtës së çdo individi e të brezave të sotëm e të ardhshëm për të jetuar në një mjedis të përshtatshëm për shëndetin dhe mirëqenien e tij, përcakton detyrimin e shteteve për marrjen e masave në garantimin e së drejtës së publikut për të

pasur informacion për mjedisin, për të marrë pjesë në marrjen e vendimeve mjedisore dhe për t'iu drejtuar gjykatës në lidhje me çështje të mjedisit.

63. Sipas nenit 8 të Konventës së Aarhus-it, shtetet anëtare kanë detyrimin të garantojnë, në një periudhë të përshtatshme dhe ndërsa alternativat për ndërhyrjet me ndikim në mjedis janë ende të hapura, pjesëmarrjen efektive të publikut gjatë përgatitjes prej autoriteteve publike të rregulloreve ekzekutive dhe rregullave të tjera ligjore të përgjithshme e detyruese, të cilat mund të kenë një efekt të rëndësishëm në mjedis. Për këtë qëllim, ajo kërkon që pjesëmarrja e publikut të realizohet që në fazat e para të përgatitjes së këtyre rregulloreve dhe/ose instrumenteve të përgjithshme ligjore e normative, përmes ndërmarrjes së disa hapave si: përcaktimi i afateve kohore të mjaftueshme për pjesëmarrje efektive; publikimi ose bërja të disponueshme për publikun e projekteve dhe rregullave ligjore; dhënia e mundësisë publikut për të komentuar drejtpërdrejt ose nëpërmjet organeve përfaqësuese këshillimore; marrja parasysh e rezultateve të pjesëmarrjes publike, për aq sa të jetë e mundur.

64. Sipas nenit 6 të Konventës së Aarhus-it, publiku i interesuar ka të drejtë të informohet me lajmërim publik ose individualisht që në procedurën e hershme të marrjes së një vendimi për mjedisin dhe në mënyrë të përshtatshme, efektive dhe në kohë, midis të tjerash, për: (a) veprimtarinë e propozuar dhe aplikimin mbi të cilin do të merret vendim; (b) natyrën e vendimeve të mundshme ose draftin e vendimit; (c) autoritetin publik përgjegjës për marrjen e vendimit; (ç) procedurën e parashikuar, mënyrën dhe kohën kur ky informacion mund të jepet, përfshirë: (i) fillimin e procedurave; (ii) mundësitë e publikut për të marrë pjesë; (iii) kohën dhe vendin e çdo mbledhjeje publike të parashikuar; (iv) adresimin tek autoriteti publik, prej të cilit mund të merret informacioni përkatës dhe ku ky informacion depozitohet për shqyrtim nga publiku; (v) adresimin tek autoriteti publik ose çdo organ tjetër zyrtar, të cilit mund t'i drejtohen komente ose pyetje, si edhe informimi për kohën ose afatet kohore të paraqitjes së këtyre pyetjeve ose komenteve; (vi) informimin për informacionin e disponueshëm mjedisor në lidhje me veprimtarinë e propozuar; (d) faktin që veprimtaria i nënshtrohet një procedure kombëtare ose ndërkufitare të vlerësimit të ndikimit në mjedis (*pika 2*). Informacioni që i jepet publikut të interesuar përfshin përshkrim të vendit dhe karakteristikave fizike e teknike të veprimtarisë së propozuar, të efekteve të rëndësishme të veprimtarisë së propozuar në mjedis; përshkrim të masave të parashikuara për të parandaluar dhe/ose pakësuar efektet.

65. Ashtu siç ka theksuar Gjykata, shteti shqiptar duhet të ofrojë mundësi

të përshtatshme për pjesëmarrjen e publikut në procesin vendimmarrës, si dhe të miratojë një kuadër të qartë, transparent dhe të qëndrueshëm ligjor për zbatimin e dispozitave të konventës (*shih vendimin nr. 3 datë 30.01.2024 të Gjykatës Kushtetuese*). Po sipas kësaj jurisprudence, aktet e hartuara nga shtetet në zbatim të Konventës së Aarhus-it duhet të garantojnë njoftimin në kohë, adekuat dhe efektiv të publikut të interesuar, dhënien e mundësisë efektive për pjesëmarrje të tij që në fazat e hershme, si dhe marrjen parasysh të rezultatit të pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrje, çka do të ndihmonte në shmangien e paqartësive në të ardhmen (*shih vendimin nr. 3 datë 30.01.2024 të Gjykatës Kushtetuese*).

66. Në kuadër të legjislacionit të brendshëm, ligji nr. 10431, datë 09.06.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit" përcakton si një ndër parimet e mbrojtjes së mjedisit edhe parimin e së drejtës për informim dhe të pjesëmarrjes së publikut (*neni 13*) në çështje që kanë të bëjnë me mjedisin, ndërsa ligji nr. 146/2014 "Për njoftimin dhe konsultimin publik" (*ligji nr. 146/2014*) rregullon procesin e njoftimit dhe të konsultimit publik të projektligjeve, projektdokumenteve strategjike kombëtare dhe vendore, si dhe politikave me interes të lartë publik përmes përcaktimit të rregullave procedurale që duhen zbatuar për të garantuar transparencën dhe pjesëmarrjen e publikut në proceset politikëbërëse dhe vendimmarrëse nga organet publike, me qëllim nxitjen e transparencës, të përgjegjshmërisë dhe integritetit të autoriteteve publike. Ligji nr. 146/2014 përcakton, ndër të tjera, detyrimin e organeve publike për marrjen e masave të nevojshme për krijimin e mundësive për pjesëmarrjen e publikut dhe të të gjitha palëve të interesuara në procesin e njoftimit të konsultimit publik dhe organizimin e konsultimeve të drejtpërdrejta ose të takimeve publike me palët e interesuara, të cilat dokumentohen me procesverbal (*neni 6*). Ai parashikon gjithashtu rregullat e procesit të njoftimit dhe konsultimit publik, zhvillimin e takimeve publike në rastet e projektakteve që paraqesin interes të lartë publik (*neni 17*), si dhe të drejtën e ankimit të palëve të interesuara pranë titullarit të organit publik përgjegjës për procesin e njoftimit dhe konsultimit publik, kur projektakti nuk është miratuar ende ose pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (*neni 21*).

67. Për sa kohë që ligji objekt gjykimi ka ndikim në mjedis, lind detyrimi për respektimin e nenit 56 të Kushtetutës dhe Konventës së Aarhus-it. Për rrjedhojë, Gjykata do të vlerësojë nëse në kuptim të nenit 8 të Konventës së Aarhus-it detyrimet për organet shtetërore shtrihen edhe në veprimtarinë parlamentare, për të verifikuar më pas nëse Kuvendi e ka përmbushur një detyrim të tillë.

68. Për sa i përket detyrimit sipas nenit 56 të Kushtetutës, Gjykata vëren se e drejta e konsultimit publik përfshin jo vetëm informimin për gjendjen e mjedisit, por edhe atë për mbrojtjen e tij. Ky parashikim është i përgjithshëm dhe e shtrin detyrimin e shtetit për të garantuar këtë të drejtë të publikut kundrejt të gjithë publikut, pa e kategorizuar atë. Duke qenë se e drejta për t'u informuar për gjendjen e mjedisit dhe mbrojtjen e tij është një e drejtë kushtetuese, ajo shtrihet ndaj të gjitha organeve shtetërore, përfshirë Kuvendin.

69. Gjykata, referuar rrethanave të çështjes konkrete, vëren se Kuvendi ka realizuar një proces konsultimi publik të gjerë dhe gjithëpërfshirës, i cili ka nisur me publikimin e projektligjit në platformën "Konsultimi i projektligjeve" në faqen zyrtare të Kuvendit, ka vijuar me komunikimin për marrjen e mendimeve të grupeve të interesit, të shoqatave/organizatave që veprojnë në fushën e mbrojtjes së mjedisit, ekspertëve të fushës dhe përfaqësuesve të stafit akademik, si dhe me marrjen e mendimit të Këshillit të Ministrave. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se konsultimi publik i bërë nga Kuvendi në lidhje me projektligjin për disa ndryshime në ligjin për zonat e mbrojtura, nismë e 12 deputetëve të Kuvendit, përmbush detyrimin e përcaktuar nga neni 56 i Kushtetutës.

70. Për sa i përket detyrimit sipas nenit 8 të konventës, Gjykata evidenton se duke qenë se konventa u drejtohet kryesisht autoriteteve publike ekzekutive, ajo synon të garantojë pjesëmarrjen e publikut në procesin e hartimit të legjislacionit përmes veprimtarisë së këtyre autoriteteve. Edhe sipas Udhëzuesit të Konventës së Aarhus-it, neni 8 i saj trajton rolin e degës ekzekutive në hartimin e ligjeve dhe përcakton konkretisht që publiku duhet të jetë i përfshirë. Ky nen gjithashtu përfshin pjesëmarrjen e autoriteteve publike në procesin legjislativ, deri në momentin kur draftet e përgatitura nga dega ekzekutive i kalojnë legjislativit. Neni 8, sipas udhëzuesit, përcakton pjesëmarrjen e publikut në përgatitjen e rregullave të tilla, si një qëllim i Konventës dhe vendos kërkesa të caktuara që palët duhet të përmbushin për arritjen e saj. Secila palë, sipas udhëzuesit, do të përpiqet të nxisë pjesëmarrjen efektive të publikut në një fazë të përshtatshme dhe ndërsa opsionet janë ende të hapura, gjatë përgatitjes nga autoritetet publike të akteve ekzekutive dhe rregullave të tjera të zbatueshme, ligjërisht të detyrueshme, që mund të kenë një efekt të rëndësishëm në mjedis. Meqenëse Konventa u drejtohet kryesisht autoriteteve publike, ajo synon të zbatojë pjesëmarrjen e publikut në ligjbërje përmes këtyre aktorëve. Pasi projektligji të mos jetë më në duart e autoriteteve publike dhe i ka kaluar për miratim organit legjislativ, ai nuk konsiderohet më

në fazë "përgatitjeje" nga një autoritet publik dhe neni 8 i konventës nuk është më i zbatueshëm. Për më tepër, referuar udhëzuesit, kur një autoritet publik miraton një ligj të hartuar nga një organ legjislativ që vepron në një kapacitet legjislativ (për shembull, kur Presidenti dekreton një ligj të miratuar nga Kuvendi), neni 8 nuk gjen zbatim, pasi kjo veprimtari nuk përbën "përgatitje" në kuptim të konventës. Me fjalë të tjera, çështja e zbatueshmërisë së nenit 8 të Konventës së Aarhus-it, që së bashku me nenin 56 të Kushtetutës përcaktojnë detyrimin pozitiv për konsultim publik, lidhet vetëm me aktet qeveritare dhe procedurat e ndërmarra nga autoritetet publike ekzekutive dhe jo ndaj atyre legjislative. Në këtë kuptim, në rastin në shqyrtim, nisma për ndryshimin e ligjit për zonat e mbrojtura është një nismë e deputetëve dhe pavarësisht faktit se ajo nismë ka pësuar ndryshime, ndër të tjera, bazuar në sugjerimet e Këshillit të Ministrave, ajo mbetet një nismë origjinale e deputetëve. Sasia e propozimeve të pranuara në këtë nismë dhe prejardhja e tyre nuk e ndryshojnë origjinën e nismës. Për këtë shkak, Gjykata çmon se neni 8 i Konventës së Aarhus-it, për sa më sipër, nuk gjen zbatim për ligjet e propozuara nga deputetët. Po kështu, neni 8 i Konventës nuk gjen zbatim as për opinionin e Këshillit të Ministrave për projektligjin, për sa kohë kjo nuk është një nismë ligjore qeveritare.

71. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se pretendimi për cenimin e së drejtës për t'u informuar për gjendjen e mjedisit dhe mbrojtjen e tij është i pabazuar.

72. Në përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkuesit janë të pabazuara, sipas arsyetimit të mësipërm, ndaj kërkesa rrëzohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja "a" dhe 134, pika 1, shkronja "c", të Kushtetutës, si dhe neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me shumicë votash,

V E N D O S I:

1. Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 31.07.2025
Shpallur më 31.10.2025

MENDIM PAKICE

1. Në gjykimin kushtetues të vënë në lëvizje nga një grup prej 37 deputetësh të Kuvendit (jo më pak se një e pesta), me objekt shfuqizimin e ligjit nr. 21/2024 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 81/2017 "Për zonat e mbrojtura"", si të papajtueshëm me Kushtetutën dhe marrëveshjet ndërkombëtare, si dhe pezullimin e zbatimit të tij deri në vendimin përfundimtar të Gjykatës, ne, gjyqtarët në pakicë, jemi kundër qëndrimit të shumicës që ka vendosur rrëzimin e kërkesës. Në mbështetje të nenit 132, pika 3, të Kushtetutës dhe nenit 72, pika 8, të ligjit nr. 8577/2000, që parashikojnë publikimin e mendimit të pakicës së bashku me vendimin përfundimtar të Gjykatës, parashtrojmë në vijim argumentet që mbështesin qëndrimin tonë kundër.

2. *Së pari*, ndajmë mendim të ndryshëm nga shumica, e cila ka vlerësuar se pretendimi për *pajtueshmërinë e ligjit me marrëveshjet ndërkombëtare në lidhje me identitetin kombëtar dhe trashëgiminë kulturore,* sipas nenit 122 të Kushtetutës, është haptazi i pabazuar, pasi ligji për zonat e mbrojtura është një ligj kuadër dhe si i tillë nuk është i vetëzbatueshëm, por se për zbatimin e ligjit do të nxirren VKM-të specifike për shpalljen e zonave të mbrojtura, të cilat në çdo rast mund t'i nënshtrohen kontrollit të ligjshmërisë ose kushtetutshmërisë së tyre.

3. Në thelb, pretendimet e kërkuesit dhe subjekteve të interesuara, AOS dhe Eco Albania, kanë të bëjnë me faktin se për shkak të heqjes së "ndalimeve" dhe zëvendësimit të tyre me "kufizime", ligji ndryshues mund të sjellë pasoja të pakthyeshme te pasuritë natyrore të vendit, si një element përbërës i identitetit dhe trashëgimisë kombëtare, pasi dobëson mbrojtjen e tyre si një detyrim për brezat e sotëm dhe të ardhshëm. Ky pretendim është i lidhur veçanërisht me nenin 14 të ligjit ndryshues, që ndryshon nenin 33 të ligjit bazë "Veprimtaritë e lejuara në zonat e mbrojtura". Nëpërmjet lejimit të turizmit elitar dhe infrastrukturës mbështetëse të tij, ligji ndryshues, sipas tyre, e zhvendos balancën nga ruajtja e pasurisë natyrore drejt lehtësimit të aktiviteteve zhvillimore, ndaj është i papajtueshëm me nenin 108 të MSA-së. Po kështu, sipas tyre, ekzistojnë rreziqe serioze për mospërmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara, specifikisht: (i) Konventa e Ramsarit, në nenet 2, 3, 4 dhe 5; (ii) Konventa e Bernës, në nenet 1, 2,

3, 4, paragrafët 1 dhe 2, 5, 8, 9, 10, 11 dhe 12; (iii) Konventa e Rios, në nenet 6, 8, 10 dhe 11; (iv) Konventa e Parisit.

4. Sikurse konstaton edhe shumica (*shih paragrafin 37 të vendimit*) me ligjin ndryshues janë bërë disa ndryshime, shtesa dhe shfuqizime në ligjin bazë, si: shtimi i disa përkufizimeve (*neni 1*) dhe parimeve (*neni 2*); lejimi i infrastrukturës dhe veprimtarive të mikpritjes për mbështetjen e turizmit të ekselencës (me 5 yje) dhe infrastrukturës mbështetëse në zonat e llojit "Park kombëtar" (*neni 7*), "Rezervat natyror i menaxhuar/park natyror" (*neni 9*), "Zonë e mbrojtur detare" (*neni 11*); lejimi i ndërhyrjeve të lejuara urbane, rekreacioni apo ekonomike brenda zonës "Peizazh i mbrojtur" (*neni 10*); përcaktimi i veprimtarive të lejuara në zonat e mbrojtura (*neni 14*); prezantimi i mundësisë së ndryshimit të sipërfaqes së zonës (*neni 16*); parashikimi i krijimit të Zyrës së Administrimit të Parqeve Kombëtare si një institucion tekniko-administrativ në varësi të ministrisë përgjegjëse për zonat e mbrojtura, i organizuar në nivel qendror dhe rajonal, i cili do të ushtrojë veprimtari brenda territorit gjeografik të zonës së kategorisë "Park kombëtar" (*neni 17*); mundësia e lidhjes së kontratave tripalëshe me bashkinë dhe subjektet e interesuara për dhënien për përdorim të përkohshëm të territoreve "kullota", pjesë e zonave të mbrojtura (*neni 18*).

5. Shumica, edhe pse ka konstatuar se ligji i kundërshtuar shton disa elemente të reja të administrimit të zonave të mbrojtura, ka vlerësuar se ai duke qenë ligj kuadër nuk duket të sjellë pasoja konkrete të drejtpërdrejta në këtë drejtim. Kështu, shumica ka evidentuar se duke pasur parasysh se për zbatimin e ligjit do të nxirren VKM-të specifike për shpalljen e zonave të mbrojtura, të cilat do të bëjnë përcaktimet e detajuara përkatëse për secilën zonë sipas nenit 33 të ligjit bazë, vetëm atëherë do të jetë e mundur të verifikohet përputhja ose jo e tyre me detyrimet e përgjithshme që burojnë nga neni 108 i MSA-së për mosdegradim mjedisor. Kjo, sipas shumicës, në varësi të specifikave të zonës së mbrojtur konkrete të shpallur në VKM-në për të cilën ka dalë akti, i cili në çdo rast mund t'i nënshtrohet kontrollit të ligjshmërisë ose kushtetutshmërisë së tij. E njëjta analizë si për MSA-në, në vlerësimin e shumicës, vlen edhe për përputhshmërinë e ligjit ndryshues me konventat ndërkombëtare të Parisit, Ramsarit, Bernës dhe Rios, për shkak të mungesës së efekteve dhe pasojave konkrete të ligjit kuadër objekt shqyrtimi (*shih paragrafin 38 të vendimit*).

6. Neni 33 i ligjit bazë përcakton se veprimtaritë e lejuara në zonat e mbrojtura mjedisore janë ato veprimtari të përcaktuar në VKM-të e shpalljes së zonës së mbrojtur (*pika 1 e nenit 33*); veprimtaritë e zhvilluara

në struktura akomoduese të ekselencës, 5 yje apo më shumë, në fushën e turizmit dhe çdo veprimtari/infrastrukturë tjetër mbështetëse ose në funksion të tyre, *pavarësisht* nëse kjo përcaktohet në VKM-në e shpalljes së zonës së mbrojtur (*pika 2 e nenit 33*); veprimtaritë e zhvilluara në struktura akomoduese të agroturizmit dhe çdo veprimtari/infrastrukturë tjetër mbështetëse ose në funksion të tyre, *pavarësisht* nëse kjo përcaktohet në vendimin e shpalljes së zonës së mbrojtur (*pika 3 e nenit 33*).

7. Në ndryshim nga shumica vlerësojmë se elementet e reja në administrimin e zonave të mbrojtura janë pasojë e drejtpërdrejtë e ndryshimeve në ligjin e kundërshtuar. Kjo do të thotë se nuk janë VKM-të konkrete, që do të dalin në zbatim të këtij ligji, ato që sjellin pasoja të pakthyeshme te pasuritë natyrore të vendit dhe dobësojnë mbrojtjen e tyre. Shprehimisht, neni 33, pikat 2 dhe 3, i ligjit bazë parashikon se veprimtaritë lejohen *pavarësisht* nëse ato përcaktohen në vendimin e shpalljes së zonës së mbrojtur. Edhe neni 16, pika 3, i ligjit bazë, në lidhje me zonën e mbrojtur "Park Kombëtar", parashikon se në këtë zonë mund të ushtrohen veprimtari të lejuara të përcaktuara në VKM-në e shpalljes së zonës së mbrojtur, si dhe ato të parashikuara në nenin 33 të këtij ligji. Me fjalë të tjera, VKM-ja e shpalljes së zonës së mbrojtur mund të shtojë veprimtari të tjera, përveç atyre të parashikuara në nenin 33 të ligjit, në bazë të karakteristikave dhe kategorisë së zonës së mbrojtur. I njëjti parashikim gjendet edhe në nenin 20, pika 4, të ligjit bazë në lidhje me zonën e mbrojtur "*Rezervat natyror i menaxhuar/park natyror*", si dhe në nenin 20, pika 2, nënpika 2/1, në lidhje me zonën e mbrojtur "*Zona të mbrojtura detare*".

8. Ndërkohë, vërejmë se për sa i takon *ratio legis* në lidhje me veprimtaritë e lejuara, në relacionin e projektligjit që ndryshon ligjin bazë rezulton se qëllimi i nismës është adresimi i problematikave të përfaqësuesve të qeverisjes vendore, kryesisht të lidhura me faktin se ligji bazë është strikt mbrojtës dhe nuk merr parasysh faktorin e komunitetit në të dhe se këto zona përbëjnë më shumë se 1/5-ën e territorit të vendit. Sipas atij relacioni, ndryshimet vijnë për të siguruar që vendi të ofrojë një paketë turistike të larmishme, por edhe të qëndrueshme dhe që komuniteteve lokale t'u ofrohet një mundësi zhvillimi, duke krijuar vende pune, rritje ekonomike dhe një perspektivë rajonale (*shih faqet 1 dhe 2 të relacionit të projektligjit*). Referuar raportit të komisionit përgjegjës për miratimin e variantit integral të projektligjit, lidhur me fjalën e deputetëve në prezantimin e nismës së tyre, vërehet se ndryshimet e propozuara synojnë të vendosin një ekuilibër midis zonave të mbrojtura dhe nevojës që ka komuniteti e pushteti vendor

për zhvillimin e agroturizimit dhe për zhvillimin e aktiviteteve të lejuara në zonat e mbrojtura (*shih faqen 20 të raportit të komisionit përgjegjës*). Nisur nga këto konsiderata, si dhe duke mbajtur në vëmendje, nga njëra anë, se identiteti kombëtar dhe trashëgimia kombëtare parashikohen si vlera themelore në nenin 3 të Kushtetutës, që përcakton se shteti ka për detyrë t'i mbrojë dhe t'i respektojë ato (*shih vendimin nr. 29, datë 02.07.2021 të Gjykatës Kushtetuese*) dhe se pasuritë natyrore, sipas nenit 1 të Konventës së Parisit, konsiderohen si trashëgimi kulturore, dhe nga ana tjetër, se standardet globale të IUCN-së përcaktojnë zgjidhje të mbështetura te natyra për hartimin, verifikimin dhe zbatimin e projekteve, ne, gjyqtarët në pakicë, jemi të mendimit se ndryshimet në ligj që lejojnë ushtrimin e veprimtarive/infrastrukturave në zonat e mbrojtura bien ndesh me marrëveshjet ndërkombëtare në lidhje me identitetin kombëtar dhe trashëgiminë kulturore.

9. *Së dyti*, ndajmë mendim të ndryshëm nga shumica lidhur me pretendimin për *cenimin e së drejtës për t'u informuar për gjendjen e mjedisit dhe mbrojtjen e tij*. Shumica e ka vlerësuar të pabazuar këtë pretendim, duke argumentuar ndarazi përmbajtjen e nenit 56 të Kushtetutës me atë të nenit 8 të Konventës së Aarhusit.

10. Konkretisht, shumica është shprehur se e drejta e konsultimit publik, e garantuar nga neni 56 i Kushtetutës, përfshin edhe informimin për gjendjen e mjedisit, që i përkon detyrimit të të gjitha organeve shtetërore, përfshirë Kuvendin, ta garantojnë këtë të drejtë kundrejt të gjithë publikut. Sipas shumicës, Kuvendi ka realizuar një proces konsultimi publik të gjerë dhe gjithëpërfshirës, i cili ka nisur me publikimin e projektligjit në platformën "Konsultimi i projektligjeve" në faqen zyrtare të tij, ka vijuar me komunikimin për marrjen e mendimeve të grupeve të interesit, të shoqatave/organizatave që veprojnë në fushën e mbrojtjes së mjedisit, ekspertëve të fushës dhe përfaqësuesve të stafit akademik, si dhe me marrjen e mendimit të Këshillit të Ministrave. Për rrjedhojë, konsultimi publik i bërë nga Kuvendi në lidhje me projektligjin për disa ndryshime në ligjin për zonat e mbrojtura, nismë e 12 deputetëve të Kuvendit, përmbush detyrimin e përcaktuar nga neni 56 i Kushtetutës (*shih paragrafët 64-65 të vendimit*). Ndërsa neni 8 i Konventës së Aarhusit, që flet për të drejtën e konsultimit të publikut, u drejtohet autoriteteve publike ekzekutive, pra jo organit legjislativ, që do të thotë, sipas shumicës, se kur një projektligj kalon për miratim në organin legjislativ, ky i fundit nuk ka detyrimin për konsultim. Në këtë kuptim, shprehet shumica, pavarësisht se ligji i

kundërshtuar ka pësuar disa ndryshime bazuar në sugjerimet e Këshillit të Ministrave, sasia e të cilave nuk është e rëndësishme, ligji është nismë origjinale e deputetëve të Kuvendit, ndaj neni 8 i Konventës së Aarhusit nuk gjen zbatim (*shih paragrafin 66 të vendimit*).

11. Nuk pajtohemi me këto argumente të shumicës, duke vënë në dukje fillimisht se ligji i kundërshtuar ka në objektin e tij rregulla që lidhen me masat mbrojtëse ndaj mjedisit. Ky ligj u iniciua me nismën e 12 deputetëve të Kuvendit, bazuar në një letër të disa kryebashkiakëve për pengesat që ata hasnin në menaxhimin e territorit. Në këtë pikëpamje, me qëllim adresimin e pengesave, është e qartë që nisma ka synuar të zvogëlojë disa masa ligjore mbrojtëse të mjedisit drejt lehtësimit të aktiviteteve zhvillimore, duke u përfshirë në këtë mënyrë në konceptin e masave që kanë të bëjnë me mbrojtjen e mjedisit, të parashikuar nga neni 56 i Kushtetutës. Kjo dispozitë, e cila tregon edhe natyrën bashkëkohore të Kushtetutës, kur garanton të drejtën e kujtdo për t'u informuar për gjendjen dhe mbrojtjen e mjedisit, krijon njëkohësisht edhe detyrimin pozitiv të të gjitha organeve shtetërore që të ofrojnë mekanizmat e duhur të informimit, pa pasur ndarje midis pushtetit ekzekutiv dhe atij legjislativ. Nën këtë optikë, shpërfillja e kërkesave konstante të shoqatave të shoqërisë civile për t'u përfshirë në konsultim përgjatë të gjithë procesit legjislativ të miratimit të nismës në fjalë, me argumentin se ato ishin thirrur dhe dëgjuar në seanca parlamentare për versionin fillestar të projektligjit, nuk përbën gjë tjetër përveçse konsultim formal. Mirëpo, siç është pohuar në jurisprudencën kushtetuese, informimi, konsultimi, pjesëmarrja e publikut dhe negocimi kanë rëndësi thelbësore në garantimin e së drejtës për të marrë informacion për gjendjen e mjedisit dhe mbrojtjen e tij. Ushtrimi efektiv i kësaj të drejte do të mund të realizohet atëherë kur organet shtetërore garantojnë përfshirjen e publikut të interesuar në çdo etapë të procesit, si një premisë për të garantuar një proces të drejtë e transparent vendimmarrës nga ana e autoriteteve publike, bazuar në një kuadër të plotë informativ mbi efektet e projektit, çka sjell garantimin e së drejtës për një mjedis të shëndetshëm për brezat e sotëm dhe të ardhshëm (*shih vendimin nr. 3, datë 30.01.2024 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Në vijim të këtij argumenti, duhet evidentuar se për shkak të sugjerimeve të paraqitura nga Këshilli i Ministrave, gjatë procesit të konsultimit, nisma fillestare e deputetëve ka pësuar ndryshime të konsiderueshme (për ilustrim, duke iu referuar përgjigjeve të Kuvendit rezulton se janë hequr 8 nga 22 nene, janë riformuluar 11 prej tyre, si dhe

janë shtuar 8 të tjera) dhe rrënjësore, në kuptimin që kanë prekur thelbin e normave (zonimin, aktivitetet e lejuara dhe institucionet vendimmarrëse). Sugjerimet u paraqitën të formalizuara me vendimin nr. 56, datë 07.02.2024 të Këshillit të Ministrave, në një kohë kur seancat dëgjimore parlamentare me organizatat e interesuara të mjedisit kishin përfunduar. Sugjerimet u reflektuan nga Kuvendi dhe nisma e deputetëve u ndryshua rrënjësisht në përmbajtjen e saj, duke marrë tiparet e një teksti të ri të hartuar nga Këshilli i Ministrave. Ashtu siç vuri në dukje kërkuesi, por edhe subjektet e interesuara, AOS dhe Eco Albania, paraqitja e këtyre sugjerimeve përbën ndërhyrje të drejtpërdrejtë të Këshillit të Ministrave, pa marrë ky i fundit përgjegjësi formale të nismës legjislative dhe për të shmangur në këtë mënyrë detyrimin për konsultim sipas nenit 8 të Konventës së Aarhusit.

13. Në analizë të sa më sipër, vlerësojmë se procedura e ndjekur në miratimin e ligjit të kundërshtuar bie ndesh me nenin 56 të Kushtetutës dhe nenin 8 të Konventës së Aarhusit, ndaj si rrjedhojë ligji i kundërshtuar duhej shfuqizuar.

14. Për të gjitha argumentet e mësipërme, ne, gjyqtarët në pakicë, bazuar në nenet 3, 56, 59, 81-85, 116, 122 dhe 131, shkronja "a", të Kushtetutës, vlerësojmë se ligji objekt kundërshtimi është i papajtueshëm me Kushtetutën dhe marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara. Për rrjedhojë, Gjykata duhej të kishte pranuar kërkesën pjesërisht dhe të vendoste shfuqizimin e ligjit objekt kërkese.

Anëtarë: Marsida Xhaferllari, Fiona Papajorgji, Ilir Toska

Vendim nr. 46, datë 18.09.2025
(V-46/25)

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Holta Zaçaj, Kryetare, Marsida Xhaferllari, Fiona Papajorgji, Sonila Bejtja, Sandër Beci, Ilir Toska, Marjana Semini, Genti Ibrahimi, anëtarë, me sekretare Belma Lleshi, në datat 04.03.2025, 01.07.2025 dhe 18.09.2025, mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve kërkesën nr. 14 (D) 2024 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: **DRITA PULLEJA, GANI QATIPI, LULJETA QATIPI, GAZMIR QATIPI, DORINA QATIPI, FLORIAN QATIPI**

SUBJEKTE TË INTERESUARA:
AFËRDITA SHKRELI, MEHMET SHKRELI, REFAT SHKRELI, GËZIM XHEMRISHI, YLLI XHEMRISHI, MIMOZA XHEMRISHI, ADRIAN XHEMRISHI, LULJETA HYSA, PETRIT HYSA, AVDI HYSA, SOKOL HYSA, KRESHNIK HYSA, ORNELA QATIPI, HAJREDIN QATIPI,
DREJTORIA E ADMINISTRIMIT DHE MBROJTJES SË TOKËS, KËSHILLI I QARKUT TIRANË, në mungesë.
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS, DREJTORIA VENDORE TIRANA RURALE 2, përfaqësuar nga juristi Arjan Halilaj, me autorizim.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2024-698, datë 17.01.2024 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

BAZA LIGJORE: Nenet 4, 17, 18, 33, 41, pikat 1 dhe 2, 42, 131, pika 1, shkronja "f", 134, pika 1, shkronja "i" dhe 142, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Genti Ibrahimi, mori në shqyrtim parashtrimet me shkrim të kërkuesve, *(kërkuesit),* të cilët kanë kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjekteve të interesuara, Afërdita Shkreli, Mehmet Shkreli, Refat Shkreli dhe Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (*ASHK*), Drejtoria Vendore Tirana Rurale 2, që kanë kërkuar rrëzimin e kërkesës, konstatoi mungesën e prapësimeve me shkrim të subjektit të interesuar, Drejtorisë së Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës, Këshilli i Qarkut Tiranë, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I
Rrethanat e çështjes

1. Komisioni i Ndarjes së Tokës (*KNT*) i fshatit Mëzez, Tiranë, bazuar në ligjin nr. 7501, datë 19.07.1991 "Për tokën" (*ligji nr.7501/1991*), me aktin nr. 75, datë 15.10.1993, i ka dhënë në përdorim shtetasit Nj.Sh, në cilësinë e punonjësit të Ndërmarrjes Bujqësore, 5.000 m², vresht, në ngastrën kadastrale nr. 8, me kufizimet përkatëse. Po ky komision, me Aktin e Marrjes së Tokës në Pronësi (*AMTP*) nr. s'ka, datë 15.10.1993, të njëjtën sipërfaqe toke ia ka dhënë në pronësi po këtij shtetasi, i cili e ka regjistruar më pas në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (*ZRPP*), Tiranë, në datën 08.09.1998. Në vijim, me shkresën nr. 488/1 të datës 04.05.1995, Seksioni i Kadastrës ka njoftuar shtetasin Nj.Sh. se AMTP-të e datës 15.10.1993 janë të pavlefshme, pasi ai nuk ka rezultuar banor i fshatit Mëzez, por i qytetit të Tiranës. Ky njoftim nuk rezulton të jetë kundërshtuar në Komisionin Qeveritar të Tokës (*KQT*), si organi më i lartë administrativ, ose në rrugë gjyqësore.

2. Kërkuesit (pala e paditur në procesin gjyqësor të përmbyllur me vendimin e kundërshtuar) janë trashëgimtarë ligjorë të shtetasit Y.A., të cilit, në bazë të ligjit nr. 7698, datë 15.04.1993 "Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve" (*ligji nr.7698/1993*), me vendimin nr. 220, datë 22.06.1995 (*vendimi nr. 220/1995*) të ish-Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Tiranë (ish-*KKKP-ja, Tiranë*), i është njohur dhe kthyer sipërfaqja 9.000 m^2 truall në fshatin Mëzez, komuna Kashar, Tiranë, me kufizimet përkatëse, pasuri që është regjistruar më pas në ZRPP-në, Tiranë.

3. Në vijim, me vendimin nr. 5, datë 13.07.1999, Komisioni i Tokës i Këshillit të Rrethit Tiranë ka anuluar aktin e marrjes së tokës në pronësi, lëshuar në emër të shtetasit Nj.Sh. (trashëgimlënësi i paditësve të kundërpaditur) nga KNT-ja, Mëzez, për sipërfaqen 5.000 m^2, si të dhënë në kundërshtim me ligjin nr. 7501/1991. Në vijim, ZRPP-ja, Tiranë ka deklaruar të pavlefshëm regjistrimin e bërë nga shtetasi Nj.Sh. dhe certifikatën e pronësisë të datës 08.09.1998 të lëshuar në emër të tij, si dhe ka bërë regjistrimin e tokës në emër të kërkuesve. Ndërsa me shkresën e datës 13.07.2000 kryetari i komunës Mëzez, në cilësinë edhe të kryetarit të KNT-së, ka vlerësuar se sipas VKM-së nr. 230, datë 22.07.1991 "Për krijimin e komisioneve të tokave", Komisioni i Tokës së Këshillit të Rrethit Tiranë nuk ka të drejtë të shfuqizojë dokumentacionin e tokës.

4. Në datën 06.06.1996 shtetasi Nj.Sh. ka paditur në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë kërkuesit (trashëgimtarë të shtetasit Y.A.) dhe ish-Agjencinë e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, Tiranë (*ish-AKKP-ja*), me objekt kundërshtimin pjesërisht të vendimit nr. 220/1995 të KKKP-së, Tiranë, për sipërfaqen 5.000 m^2, me pretendimin se ajo mbivendoset me sipërfaqen e tokës së fituar prej tij sipas ligjit nr. 7501/1991, duke kërkuar edhe çregjistrimin e kësaj sipërfaqeje nga pronësia e kërkuesve dhe regjistrimin në emrin e tij. Kërkuesit kanë paraqitur kundërpadi, duke kërkuar lirimin dhe dorëzimin e sipërfaqes 5.000 m^2, me pretendimin se e kanë fituar pronësinë në bazë të ligjit nr. 7698/1993 dhe se kjo pronë mbahet në mënyrë të paligjshme nga ana e paditësit.

5. Me vendimin nr. 8281, datë 11.10.1996, Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë ka vendosur pranimin e padisë dhe rrëzimin e kundërpadisë, duke anuluar pjesërisht vendimin nr. 220/1995 të KKKP-së, Tiranë, si të pabazuar në ligj dhe në prova. Për ankimin e kërkuesve, Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 13, datë 08.01.1997, ka vendosur mospranimin e tij. Mbi bazën e rekursit të kërkuesve, me vendimin nr. 1615, datë 13.11.1997, Gjykata

e Kasacionit ka vendosur prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe dërgimin e çështjes për rigjykim po në atë gjykatë. Në rigjykim, Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 1283, datë 23.09.1998, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 8281, datë 11.10.1996 të gjykatës së shkallës së parë. Ndërsa Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 966, datë 21.10.1999, ka vendosur prishjen e vendimeve të gjykatave të faktit dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në shkallë të parë, duke lënë si detyra për këtë gjykatë (i) vlerësimin e ligjshmërisë ose paligjshmërisë së AMTP-ve, si dhe (ii) thirrjen në gjykim si persona të interesuar të komisioneve përkatëse të ndarjes së tokës, me qëllim zgjidhjen e mosmarrëveshjes sipas ligjit.

6. Në rigjykimin e çështjes, me vendimin nr. 5311/1068, datë 01.02.2000, Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë ka vendosur pushimin e gjykimit të çështjes. Ky vendim është prishur me vendimin nr. 811, datë 12.09.2000 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe çështja është dërguar për rigjykim në gjykatën e shkallës së parë. Kjo e fundit, në rigjykim, me vendimin nr. 3124, datë 12.07.2002, ka vendosur pranimin e padisë, anulimin pjesërisht të vendimit nr. 220/1995 të KKKP-së, Tiranë, urdhërimin e fshirjes së regjistrimit në emër të kërkuesve dhe regjistrimin në emër të trashëgimtarëve të shtetasit Nj.Sh., si dhe rrëzimin e kundërpadisë. Gjatë gjykimit gjykata ka proceduar me zëvendësimin procedural të paditësit Nj.Sh. me trashëgimlënësit e tij, si dhe ka thirrur si persona të tretë ish-ZRPP-në, Tiranë dhe KNT-në, Kashar. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr. 503, datë 17.04.2003. Mbi bazën e rekursit të kërkuesve, me vendimin nr. 1118, datë 01.06.2004, Gjykata e Lartë ka vendosur prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe dërgimin e çështjes për rigjykim po në atë gjykatë, me tjetër trup gjykues. Sipas Gjykatës së Lartë, gjykatat më të ulëta nuk kanë vlerësuar ligjshmërinë e akteve të komisionit të tokës, të cilat paraqesin kontradikta në përmbajtjen e tyre, si dhe vendimin e KKKP-së, Tiranë nuk kanë zbatuar detyrat e lëna prej saj me vendimin nr. 966, datë 21.10.1999, të detyrueshme për gjykatën që rigjykon çështjen, bazuar në nenin 486 të Kodit të Procedurës Civile (*KPC*). Po kështu, ajo ka vlerësuar se vendimi i gjykatës së apelit ka mungesë të analizës së provave dhe të bazës ligjore mbi të cilën bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes.

7. Në zbatim të detyrave të lëna nga Gjykata e Lartë, Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 32, datë 22.01.2007, ka vendosur ndryshimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë, rrëzimin e padisë dhe pranimin e kundërpadisë të paraqitur nga të padituri (kërkuesit), duke detyruar paditësit t'u lirojnë e dorëzojnë të paditurve kundërpaditës sipërfaqen 5.000 m^2. Ky

vendim është prishur me vendimin nr. 406, datë 19.06.2014 të Gjykatës së Lartë, e cila e ka dërguar çështjen për rigjykim në Gjykatën e Apelit Tiranë, me tjetër trup gjykues. Sipas Gjykatës së Lartë, në rishqyrtimin e çështjes gjykata e apelit duhet të kryente një hetim të plotë e të gjithanshëm.

8. Pas rigjykimit të çështjes, përfundimisht, me vendimin nr. 2315, datë 18.11.2015, Gjykata e Apelit Tiranë ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 3124, datë 12.07.2002 të gjykatës së shkallës së parë, por me ndryshimin që kërkuesit të kompensohen për sipërfaqen prej 5.000 m² në një nga mënyrat e parashikuara nga ligji. Kundër vendimit të gjykatës së apelit kanë ushtruar rekurs kërkuesit dhe Agjencia e Trajtimit të Pronës, të cilët kanë kërkuar rrëzimin e vendimit dhe pranimin e kundërpadisë, duke parashtruar, ndër të tjera, si shkaqe kryesore: pavlefshmërinë absolute të AMTP-së, datë 15.10.1993, nxjerrë nga KNT-ja e komunës Mëzez, në kapërcim të kompetencave që i njihte ligji; paditësi Nj.Sh. është vërtetuar që ishte banor i qytetit të Tiranës dhe njëkohësisht anëtar i Ndërmarrjes Bujqësore, pra duke mos përmbushur kriteret e përcaktuara në nenin 6 të ligjit nr.7501/1991 për të marrë AMTP-në; AMTP-ja në emër të shtetasit Nj.Sh. është shfuqizuar nga KNT-ja e Këshillit të Rrethit Tiranë me vendimin nr. 5, datë 13.7.1999, i cili nuk rezulton të jetë kundërshtuar nga pala paditëse; nga akti i ekspertimit nuk rezulton mbivendosje pronash, fakt i konfirmuar nga ekspertja në seancë gjyqësore; sipërfaqja 5.000 m² ka qenë e lirë në kuptim të ligjit.

9. Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 00-2024-698, datë 17.01.2024, ka vendosur mospranimin e rekursit, pasi është bërë për shkaqe të ndryshme nga ato që parashikohen në nenin 472 të KPC-së. Sipas asaj gjykate, janë respektuar normat procedurale dhe janë zbatuar drejt dispozitat e ligjit material, duke bërë një cilësim të drejtë të fakteve dhe rrethanave që lidhen me mosmarrëveshjen. Po kështu, shkaqet e parashtruara në rekurs ngrenë kryesisht çështje të vlerësimit të provave dhe të fakteve, të cilat dalin jashtë juridiksionit rishikues dhe ligjor të saj.

10. Në datën 22.07.2024 kërkuesit i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij. Në datën 28.10.2024 Kolegji i Gjykatës ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve. Pas konstatimit të mungesës së njoftimit për disa nga subjektet e interesuara, konkretisht të shtetasve Rahmije Xhemrishi, Arife Hysa, Ornela Qatipi dhe Hajredin Qatipi, Gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës, me qëllim njoftimin e tyre. Po kështu, nga aktet shkresore të administruara, Gjykata konstatoi se kërkuesi

Izeir Qatipi dhe subjektet e interesuara Rahmije Xhemrishi, Arife Hysa dhe Nanie Shkreli kanë ndërruar jetë. Në këto kushte, Gjykata e ka vlerësuar të nevojshëm kërkimin e dokumentacionit ligjor për trashëgimtarët e tyre. Në vijim, me vendimin e datës 10.06.2025, për kalimin procedural të palëve në proces, Mbledhja e Gjyqtarëve ka vendosur thirrjen në cilësinë e kërkuesve të shtetasve Luljeta Qatipi, Gazmir Qatipi dhe Dorina Qatipi, si dhe në cilësinë e subjekteve të interesuara të shtetaseve Gëzim Xhemrishi, Ylli Xhemrishi, Mimoza Xhemrishi, Adrian Xhemrishi, Luljeta Hysa, Petrit Hysa, Avdi Hysa, Sokol Hysa dhe Kreshnik Hysa. Në seancën e datës 01.07.2025 Gjykata, pasi konstatoi se subjektet e interesuara në këtë çështje Refat Shkreli, Mehmet Shkreli, Luljeta Hysa, Avdi Hysa, Petrit Hysa, Kreshnik Hysa Sokol Hysa, Adrian Xhemrishi, Gëzim Xhemrishi, Ylli Xhemrishi, Mimoza Xhemrishi, Hajredin Qatipi nuk kishin marrë dijeni për gjykimin kushtetues të çështjes, ka vendosur shtyrjen e seancës plenare me qëllim njoftimin e tyre me shpallje dhe caktimin e seancës plenare të radhës në datën 18.09.2025.

II
Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

11. ***Kërkuesit,*** në mënyrë të përmbledhur, kanë pretenduar se vendimi i kundërshtuar u ka cenuar *të drejtën për proces të rregullt ligjor,* të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës*,* në drejtim të:

11.1. *Parimit të sigurisë juridike dhe të pritshmërive të ligjshme,* pasi në kuptim të jurisprudencës kushtetuese dhe asaj të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*GJEDNJ*), vendimi i KKKP-së, Tiranë, mbi bazën e të cilit ka fituar pasurinë trashëgimlënësi i kërkuesve, krijon të njëjtën pritshmëri si një vendim gjyqësor që njeh pronësinë mbi sendin. Për sa kohë që pasuria në pronësi të tyre është fituar me vendim të ish-KKKP-së, ai barazohet me vendim gjyqësor dhe ka krijuar pritshmëri të ligjshme tek ata që do të vihen në posedim të pronës ose do të dëmshpërblehen për të.

11.2. *Parimit të barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit,* pasi Gjykata e Lartë duhet ta shqyrtonte çështjen në seancë gjyqësore dhe në prani të palëve ndërgjyqëse, të cilat duhet t'i kishte njoftuar për orën dhe datën e gjykimit, ndërkohë që gjykimi i saj në dhomën e këshillimit u ka mohuar të drejtën për të marrë pjesë në gjykim dhe për të paraqitur prova e argumente në mbrojtje të interesave

të tyre. Po kështu, Gjykata e Lartë nuk ka kryer zëvendësimin procedural të palëve që kishin ndërruar jetë, duke u cenuar edhe të drejtën për *shqyrtim efektiv e në mënyrë të pavarur të rekursit*.

12. ***Subjektet e interesuara,*** Afërdita Shkreli, Mehmet Shkreli, Refat Shkreli, në mënyrë të përmbledhur, kanë parashtruar si vijon:

12.1. Pretendimi për cenimin e *parimit të sigurisë juridike dhe të pritshmërive të ligjshme* është i pabazuar, pasi ata e kanë fituar të parët titullin e pronësisë dhe janë ata që janë cenuar në të drejtën e pronës, për të cilën ligji duhet t`u ofronte siguri, qartësi dhe vazhdimësi të kësaj të drejte. Pritshmëritë e kërkuesve për kthimin dhe kompensimin e pronës nuk janë mohuar, pasi gjykatat kanë vendosur kompensim për sipërfaqen e pronës së mbivendosur, duke dhënë arsyet për vlerësimet e tyre.

12.2. Pretendimet për cenimin e *parimit të barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit*, si dhe *së drejtës për shqyrtim efektiv të rekursit,* në mënyrë të pavarur, janë të pabazuara, pasi gjykimi i çështjes në dhomën e këshillimit nga Gjykata e Lartë është bërë në përputhje me parashikimet e nenit 480 të KPC-së. Pavarësisht kohës së regjistrimit të rekursit, për sa i takon formimit të trupit gjykues, procedurës së gjykimit dhe mënyrës sesi disponon, Gjykata e Lartë u referohet dispozitave ligjore në fuqi. Lidhur me zëvendësimin procedural të palëve që kanë ndërruar jetë, nuk është arritur të provohet cenimi në të drejtat kushtetuese të kërkuesve, pasi me këtë pretendim synohet mbrojtja e të drejtave të personave të tjerë në procesin gjyqësor. Po kështu, gjykata e apelit ka respektuar ligjin procedural dhe palët kanë pasur mundësi të realizojnë të drejtën e mbrojtjes, të paraqesin prova, të njihen me provat e palës kundërshtare, të debatojnë e të shprehin qëndrimet e tyre, duke respektuar parimet bazë të procesit të rregullt ligjor.

13. ***Subjekti i interesuar, ASHK-ja, Drejtoria Vendore Tirana Rurale 2,*** në mënyrë të përmbledhur, ka parashtruar të njëjtat pretendime me subjektet e interesuara Afërdita Shkreli, Mehmet Shkreli dhe Refat Shkreli, duke shtuar se në datën 07.04.2016, pas regjistrimit të vendimit nr. 2315, datë 18.11.2015 të Gjykatës së Apelit Tiranë, ZRPP-ja (sot ASHK-ja) ka kryer certifikimin e pronës me sipërfaqe 5.000 m^2, lloji i pasurisë "arë", duke pajisur trashëgimtarët e shtetasit Nj.Sh. me certifikatën e pronësisë.

14. ***Subjekti i interesuar, Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së***

Tokës, Këshilli i Qarkut Tiranë, nuk ka paraqitur prapësime me shkrim, edhe pse është njoftuar rregullisht**.**

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkuesve

15. Çështja e legjitimimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

16. Lidhur me legjitimimin *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, individi duhet të provojë interesin e tij si në aspektin procedural, ashtu edhe në atë substancial *(shih vendimet nr. 65, datë 30.11.2023; nr. 44, datë 26.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese)*. Për sa i përket aspektit substancial, Gjykata ka theksuar se individi, si subjekt i kushtëzuar, mund të bëjë ankim kushtetues individual vetëm për çështje që lidhen me interesat e tij të drejtpërdrejtë, si dhe të tregojë se në çfarë mënyre ai është cenuar në të drejtat e tij kushtetuese, pra se është viktimë e një shkeljeje dhe se pasojat nga akti i kundërshtuar janë të drejtpërdrejta dhe reale për të (*shih vendimet nr. 29, datë 16.04.2024; nr. 44, datë 26.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Në çështjen në shqyrtim, Gjykata vëren se në ankimin kushtetues individual kërkuesit kanë pretenduar se Gjykata e Lartë nuk ka kryer zëvendësimin procedural të palëve të paditura në procesin gjyqësor objekt ankimi që kishin ndërruar jetë. Ndërsa subjektet e interesuara kanë prapësuar se kërkuesit nuk kanë arritur të provojnë cenimin në të drejtat e tyre kushtetuese si rrjedhojë e moskryerjes së zëvendësimit procedural të palëve që kishin ndërruar jetë, pasi me këtë pretendim synohet mbrojtja e të drejtave të personave të tjerë në procesin gjyqësor. Për sa i takon këtij

pretendimi, duke mbajtur parasysh edhe faktin se vendimi i kontestuar i Gjykatës së Lartë është vendim mospranimi, i marrë në ushtrim e sipër të veprimtarisë seleksionuese të kësaj të fundit, pa vlerësuar në themel pretendimet e kërkuesve, Gjykata çmon se kërkuesit, si subjekte të kushtëzuara, nuk legjitimohen *ratione personae* në aspektin substancial, pasi nuk kanë arritur të provojnë cenimin e të drejtave të tyre kushtetuese për këtë shkak. Ndërsa për sa u përket pretendimeve të tjera, Gjykata çmon se kërkuesit legjitimohen *ratione personae,* bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, pasi janë palë ndërgjyqëse në procesin gjyqësor të kundërshtuar, ndaj kanë interes të drejtpërdrejtë në çështjen e paraqitur.

18. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës, Gjykata vëren se kërkuesit i janë drejtuar asaj me ankim kushtetues individual, duke ngritur pretendime për procesin gjyqësor të zhvilluar në Gjykatën e Lartë, për të cilin nuk kanë mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të tyre kushtetuese përveç ankimit kushtetues individual.

19. Kërkuesit legjitimohen edhe *ratione temporis*, pasi vendimi i Gjykatës së Lartë mban datën 17.01.2024 dhe sipas informacionit të kësaj gjykate, të vënë në dispozicion të Gjykatës nga përfaqësuesit ligjorë të tyre, ai është publikuar në faqen zyrtare të saj në datën 20.03.2024, kurse ankimi kushtetues individual është paraqitur në datën 22.07.2024 (dita e fundit e afatit ka qenë ditë pushimi, e shtunë), pra brenda afatit ligjor 4-mujor të parashikuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja "b", i Ligjit Organik të Gjykatës.

20. Për sa i përket legjitimimit *ratione materiae*, në ankimin kushtetues individual kërkuesit kanë pretenduar cenimin e *së drejtës për proces të rregullt ligjor* në drejtim të *parimit të barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit* në aspekt të së drejtës për shqyrtim efektiv e në mënyrë të pavarur të rekursit, si dhe *parimit të sigurisë juridike* në aspekt të *pritshmërive të ligjshme*, pretendime të cilat bëjnë pjesë në juridiksionin kushtetues.

21. Për sa u takon pretendimeve për cenimin e *parimit të barazisë së armëve në procesin gjyqësor dhe të kontradiktoritetit* në drejtim të *së drejtës për shqyrtim efektiv e në mënyrë të pavarur të rekursit,* kërkuesit kanë parashtruar si argument se çështja është gjykuar nga Gjykata e Lartë në dhomën e këshillimit pa dijeninë e tyre dhe pa i njoftuar për datën e orën e zhvillimit të seancës, në cenim të së drejtës së tyre për të marrë

pjesë në gjykim, për të paraqitur prova dhe argumente në mbrojtje të interesave vetjakë.

22. Subjektet e interesuara kanë prapësuar se çështja është gjykuar nga Gjykata e Lartë në dhomën e këshillimit, në përputhje me parashikimet e nenit 480 të KPC-së. Sipas tyre, pavarësisht kohës së regjistrimit të rekursit, për sa i takon formimit të trupit gjykues, procedurës së gjykimit dhe mënyrës se si disponon, Gjykata e Lartë u referohet dispozitave ligjore në fuqi. Po kështu, gjykata e apelit ka respektuar ligjin procedural dhe palët kanë pasur mundësi të realizojnë të drejtën e mbrojtjes, të paraqesin prova, të njihen me provat e palës kundërshtare, të debatojnë e të shprehin qëndrimet e tyre duke respektuar parimet bazë të procesit të rregullt ligjor.

23. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se veprimtaria seleksionuese e dhomës së këshillimit në Gjykatën e Lartë është një veprimtari e domosdoshme në funksion të aksesit në gjykatë vetëm të atyre çështjeve që i parashikon ligji, duke lënë jashtë përzgjedhjes kërkesat e paarsyeshme dhe haptazi të pambështetura në ligj. Sipas këtyre standardeve, kur kërkesat e ligjit për kalimin në seancë nuk janë plotësuar, vendoset për mospranimin e kërkesës dhe ky lloj shqyrtimi paraprak vlerësues është kompetencë vetëm e trupës së gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë në dhomën e këshillimit *(shih vendimet nr. 16, datë 16.03.2021; nr. 26, datë 27.03.2017 të Gjykatës Kushtetuese).* Më tej, në rastin kur rekursi plotëson kushtet e pranueshmërisë, çështja shqyrtohet në seancë gjyqësore, si rregull, në dhomën e këshillimit mbi bazë dokumentesh (*neni 482 i KPC-së*) ose në prani të palëve (*neni 482/a i KPC-së*), shqyrtim për të cilin palët njoftohen për ditën, orën dhe përbërjen e trupit gjykues, të paktën 15 ditë përpara datës së shqyrtimit, përmes shpalljes në ambientet e Gjykatës së Lartë, si dhe në faqen e saj të internetit dhe me njoftim individual kur palët ose përfaqësuesit e tyre kanë lënë të dhënat e tyre elektronike të kontaktit në shkallët e tjera të gjykimit (*neni 482/a, pika 2, i KPC-së*).

24. Gjithashtu, Gjykata ka pohuar se e drejta për t'u njoftuar për një gjykim dhe pjesëmarrja në të është e lidhur me vendimmarrjen e gjykatës, e cila ndikon drejtpërsëdrejti mbi të drejtat subjektive ose interesat e ligjshme të individit. Nga ana tjetër, e drejta për të marrë pjesë në gjykim krijon të njëjtat mundësi, për të paraqitur prova dhe argumente në mbrojtje të interesave vetjake, në raport me palën kundërshtare Ajo u paraprin të drejtave të tjera, pasi nëse pala ndërgjyqëse nuk njoftohet për datën dhe orën e seancës, ajo detyrimisht do të gjendet në pamundësi objektive për të ushtruar të drejtat që i garantohen nga neni 42 i Kushtetutës në kuadrin

e një procesi të rregullt ligjor *(shih vendimet nr. 6, datë 27.01.2017; nr. 34, datë 25.07.2011; nr. 34, datë 03.10.2007 të Gjykatës Kushtetuese)*.

25. Në rastin në shqyrtim, Gjykata vëren se Gjykata e Lartë është vënë në lëvizje me rekursin e kërkuesve. Nga aktet bashkëlidhur ankimit kushtetues, në rekurs nuk rezulton që kërkuesit apo përfaqësuesi i tyre ligjor të kenë lënë të dhënat e tyre elektronike të kontaktit, me qëllim njoftimin e tyre për datën dhe orën e gjykimit, sipas parashikimeve të nenit 482, pika 3, të KPC-së dhe urdhrit nr. 131, datë 02.07.2021 "Për publikimin e datave të gjykimeve dhe njoftimin e palëve". Ndërsa, nga faqja zyrtare e Gjykatës së Lartë, rezulton se në datën 27.12.2023, në rubrikën "*Çështje të shpallura për gjykim*", kategoria "*Çështje civile*", nënrubrika "*Për shqyrtim në dhomë këshillimi*", është shpallur lista e çështjeve për shqyrtim në datën 17.01.2024, ora e seancës, si dhe përbërja e trupit gjykues për çdo çështje, listë në të cilën pasqyrohet edhe çështja e kërkuesve.

26. Për sa më sipër, nisur nga fakti se rekursi në Gjykatën e Lartë është paraqitur nga vetë kërkuesit, të cilët kanë detyrimin të ndjekin fatin e çështjes së tyre dhe se ligji procedural i kohës parashikon, si rregull, shqyrtimin e çështjes në dhomën e këshillimit dhe njoftimin e palëve me shpallje, që, sipas kësaj mënyre, rezulton të jetë bërë, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuesve për mungesën e njoftimit të shqyrtimit të çështjes në dhomën e këshillimit në Gjykatën e Lartë është haptazi i pabazuar për sa i takon pretendimit për cenimin e *parimit të barazisë së armëve në procesin gjyqësor dhe të kontradiktoritetit* në drejtim të *së drejtës për shqyrtim efektiv e në mënyrë të pavarur të rekursit*.

27. Gjithashtu, kërkuesit kanë pretenduar se vendimi i kundërshtuar u ka cenuar *parimin e sigurisë juridike* në drejtim *të pritshmërive të ligjshme*. Gjykata, duke mbajtur në konsideratë se argumentet e kërkuesve për këtë pretendim lidhen me procesin gjyqësor të kundërshtuar, i cili sipas tyre ka cenuar *parimin e sigurisë juridike* në drejtim *të pritshmërive të ligjshme* për shkak të mosmbajtjes parasysh nga gjykatat të natyrës *quasi gjyqësore* të vendimeve të KKKP-së, Tiranë dhe moszbatimit të udhëzimeve të Gjykatës së Lartë për verifikimin e ligjshmërisë së AMTP-ve dhe të akteve të Komisionit të Tokës të Këshillit të Rrethit, Tiranë, çmon ta shqyrtojë atë në këndvështrim të nenit 42 të Kushtetutës, sipas të cilit prona nuk mund të cenohet pa një proces të rregullt ligjor dhe se kushdo, për mbrojtjen e së drejtës kushtetuese të pronës, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë. Në këtë kontekst, duke mbajtur në konsideratë argumentet e lartpërmendura

të kërkuesve, ajo vlerëson të analizojë në vijim bazueshmërinë e tyre në themel në drejtim *të aksesit substancial të lidhur me të drejtën e pronës*.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e së drejtës së aksesit substancial të lidhur me të drejtën e pronës

28. Kërkuesit kanë pretenduar se, në kuptim të jurisprudencës kushtetuese dhe asaj të GJEDNJ-së, vendimi i KKKP-së, Tiranë, mbi bazën e të cilit ka fituar pasurinë trashëgimlënësi i tyre ka krijuar për ta të njëjtën pritshmëri që krijon një vendim gjyqësor i cili njeh pronësinë për sendin. Për rrjedhojë, për sa kohë pasuria në pronësi të kërkuesve është fituar me vendim të ish-KKKP-së, ai ka krijuar pritshmëri të ligjshme te ata se do të vihen në posedim të pronës ose do të dëmshpërblehen në lidhje me të.

29. Sipas subjekteve të interesuara, ata kanë fituar të parët titullin e pronësisë dhe është kjo palë që është cenuar në të drejtën që ligji t`i ofrojë siguri, qartësi dhe vazhdimësi të së drejtës së pronës. Sipas tyre, pritshmëritë e kërkuesve për kthimin dhe kompensimin e pronës nuk janë mohuar pasi gjykatat kanë vendosur kompensim për sipërfaqen e pronës së mbivendosur. Gjykata ka dhënë arsyet për vlerësimin e saj.

30. Neni 42, pika 1, i Kushtetutës parashikon se liria, prona dhe të drejtat e njohura me Kushtetutë dhe me ligj nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor. Kjo dispozitë sanksionon të drejtën për gjykim, ku e drejta e aksesit, që është e drejta për të vënë në lëvizje gjykatën, përbën një aspekt të saj. E drejta e aksesit u garanton subjekteve të cenuara të drejtën t'i drejtohen një gjykate, e cila do t'i dëgjojë pretendimet e tyre dhe do të shpallë një vendim pas një gjykimi të drejtë dhe publik. Ajo nuk përfshin vetëm të drejtën për të vënë në lëvizje gjykatën, por edhe për të pasur një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pasi aksesi në gjykatë duhet të jetë substancial dhe jo thjesht formal (*shih vendimet nr. 22, datë 29.04.2021; nr. 3, datë 23.02.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

31. Për sa i përket rolit të gjyqësorit të zakonshëm në garantimin e standardeve kushtetuese të sipërcituara, Gjykata ka theksuar se kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese për proces të rregullt ligjor është funksion edhe i gjykatave të zakonshme, aq më tepër i Gjykatës së Lartë. Roli i kësaj gjykate, si gjykatë e ligjit, është i një natyre të pazëvendësueshme. Ajo i ka të gjitha mjetet dhe kompetencat për ta bërë vetë këtë rol aktiv, që shkon përtej ligjit dhe synon të drejtën, duke ndikuar efektivisht edhe në vendimmarrjen e gjykatave të shkallëve më të ulëta (shih vendimet nr. 10,

datë 04.03.2021; nr. 3, datë 23.02.2016 të Gjykatës Kushtetuese). Gjykata e Lartë e ushtron këtë rol qoftë përmes standardizimit të praktikës gjyqësore, qoftë përmes dhënies së udhëzimeve zbatimi i të cilave është i detyrueshëm për gjykatën që rishqyrton çështjen. Gjykata në këto vendime pranon që Gjykata e Lartë ka një rol aktiv dhe "ligjor" kur u cakton detyra gjykatave të shkallëve të ulëta. Ky rol përfshin interpretimin e ligjit, kontrollin e bazueshmërisë së vendimeve të gjykatave më të ulëta dhe një obligim arsyetimi për vendimet që ajo merr, veçanërisht kur ato lidhen me çështje me natyrë kushtetuese.

32. Bazuar në standardet e mësipërme kushtetuese, në rastin konkret Gjykata do të vlerësojë nëse kërkuesit kanë marrë një zgjidhje përfundimtare nga gjykatat për të drejtën e pronës së njohur me vendim të ish-KKKP-së, Tiranë, si dhe nëse Gjykata e Lartë ka verifikuar zbatimin nga gjykatat më të ulëta të detyrave të lëna prej saj me vendime të mëparshme për sa i takon ligjshmërisë së akteve të Komisioneve të Tokave të cilat paraqesin kontradikta në përmbajtjen e tyre.

33. Në rastin në shqyrtim, Gjykata vëren se me vendimin nr. 220/1995, të ish-KKKP-së Tiranë, kërkuesve u është kthyer 9.000 m^2 truall, i cili është regjistruar prej tyre në ish-ZRPP-në, Tiranë. Ky vendim është bërë objekt kundërshtimi në gjykatë. Pas rishqyrtimit dy herë të çështjes nga gjykata e apelit, Gjykata e Lartë me vendimin nr. 966, datë 21.10.1999 ka vendosur prishjen e vendimeve të gjykatave të faktit dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në shkallë të parë, duke lënë si detyra (i) vlerësimin e ligjshmërisë ose paligjshmërisë së AMTP-ve dhe (ii) thirrjen në gjykim, si persona të interesuar, të komisioneve përkatëse të ndarjes së tokës, me qëllim zgjidhjen e mosmarrëveshjes sipas ligjit. Në rigjykim, me vendimin nr. 3124, datë 12.07.2002, gjykata e shkallës së parë ka vendosur pranimin e padisë, duke anuluar pjesërisht vendimin nr. 220/1995 të KKKP-së, Tiranë, si dhe urdhërimin e fshirjes së regjistrimit të pronës në emër të kërkuesve dhe regjistrimin e saj në emër të trashëgimtarëve të shtetasit Nj.Sh., vendim ky i lënë në fuqi nga gjykata e apelit. Mbi rekursin e kërkuesve, me vendimin nr. 1118, datë 01.06.2004, Gjykata e Lartë ka vendosur prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në po atë gjykatë, me tjetër trup gjykues, me arsyetimin se: i) gjykatat më të ulëta nuk kanë vlerësuar ligjshmërinë e aktit të marrjes së tokës në pronësi dhe të vendimit që e ka anuluar atë, që paraqisnin kontradikta në përmbajtjen e tyre, si dhe të vendimit të ish-KKKP-së, Tiranë; ii) gjykatat më të ulëta nuk kanë zbatuar detyrat e lëna prej saj me vendimin nr. 966, datë 21.10.1999, të

detyrueshme për gjykatën që rigjykon çështjen, bazuar në nenin 486 të KPC-së; iii) vendimi i gjykatës së apelit ka mungesë të analizës së provave dhe të bazës ligjore mbi të cilën bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes. Në rigjykim, Gjykata e Apelit Tiranë, në zbatim të detyrave të lëna nga Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 32, datë 22.01.2007, ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. 3124, datë 12.07.2002, të gjykatës së shkallës së parë, rrëzimin e padisë dhe pranimin e kundërpadisë të paraqitur nga të padituri (kërkuesit), duke detyruar paditësit që të lirojnë e dorëzojnë të paditurve kundërpaditës sipërfaqen prej 5.000 m^2. Ajo gjykatë, në zbatim të detyrave të lëna nga gjykata e Lartë, pasi ka gjykuar mbi ligjshmërinë e AMTP-ve në emër të shtetasit Nj.Sh., ka vlerësuar se ato janë të parregullta dhe se prona është kthyer në truall ndërtimi me vendime të Këshillit të Rregullimit të Territorit të datave 24.05.1994, 26.12.1994 dhe 12.04.1995, pra përpara se të hynte në fuqi ligji nr. 8053, datë 21.12.1995 "Për kalimin në pronësi pa shpërblim të tokës bujqësore", i cili përjashtonte dhënien në pronësi të tokës bujqësore dhe i kualifikonte të pavlefshme AMTP-të në këto raste, si dhe regjistrimet e tyre. Ky vendim është prishur sërish me vendim të Gjykatës së Lartë, e cila e ka dërguar çështjen për rigjykim në Gjykatën e Apelit Tiranë, me arsyetimin se, vendimi i gjykatës së apelit ka mungesë të analizës së provave dhe të bazës ligjore mbi të cilën bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes.

34. Pas rigjykimit të çështjes, gjykata e apelit ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 3124, datë 12.07.2002 të gjykatës së shkallës së parë, që ka anuluar pjesërisht vendimin e ish-KKKP-së, duke u njohur kërkuesve të drejtën e kompensimit për sipërfaqen prej 5.000 m^2, në një nga mënyrat e parashikuara nga ligji. Gjykata e apelit ka vlerësuar se, në kushtet kur është vërtetuar se sipas ligjit nr.7501/1991 paditësit janë pronarë të ligjshëm të një parcele toke që sipas aktit të ekspertimit teknik kishte zërin kadastral "arë", ish-KKKP-ja, Tiranë nuk duhet të kishte vendosur kthimin e saj si të lirë, por të kompensonte trashëgimtarët e ish-pronarit në një nga format e parashikuara me ligj. Po kështu, pavlefshmëria e akteve administrative nuk mund të konstatohej kryesisht pa kërkim dhe, referuar provave në gjykim, AMTP-ja e palës paditëse është e vlefshme e me fuqi ligjore, ndaj bazuar në nenin 296 të Kodit Civil, kërkuesit nuk mund të ngrinin padinë e rivendikimit ndaj pronarit posedues të kësaj pasurie. Ndërsa për sa i përket kundërpadisë, kërkimi i së cilës kishte për objekt vetëm lirimin e dorëzimin e pronës nga ana e palës paditëse, vendimmarrja e gjykatës së shkallës së parë ishte e drejtë, pasi kërkuesit nuk kishin kundërshtuar titullin e

pronësisë së palës paditëse në mënyrën dhe formën e duhur ligjore, por vetëm në kuadër të prapësimeve.

35. Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 00-2024-698, datë 17.01.2024, ka vendosur mospranimin e rekursit, pasi ishte bërë për shkaqe të ndryshme nga ato që parashikoheshin në nenin 472 të KPC-së, me arsyetimin se (i) gjykata e apelit ka respektuar normat procedurale, (ii) palëve në procesin gjyqësor u është dhënë mundësia të realizojnë të drejtën e mbrojtjes, të paraqesin prova, të njihen me provat e palës kundërshtare e të debatojnë për to, si dhe të shprehin qëndrimin e tyre për zgjidhjen e mosmarrëveshjes, (iii) janë respektuar dhe zbatuar drejt dispozitat e ligjit material, pasi në zbatim të detyrave të dhëna nga Gjykata e Lartë, gjykata e apelit, duke mbajtur në konsideratë kufijtë e shqyrtimit gjyqësor të saj dhe në aplikim të drejtë të nenit 36 të KPC-së, ka vepruar drejt duke mos mbajtur në konsideratë vendimin e marrë nga Komisioni i Tokës të Këshillit të Rrethit Tiranë për pavlefshmëri të AMTP-së të paditësit, për sa kohë që ky organ ka vepruar në kundërshtim me kompetencat e tij, (iv) gjykata e apelit ka hetuar dhe ka arritur në përfundimin se sipërfaqja e disponuar me AMTP-në në favor të paditësit në momentin e dhënies në përdorim ose në pronësi, ka qenë tokë e llojit "arë", gjë që e bënte atë objekt të disponimit në favor të subjekteve përfituese në zbatim të ligjit nr.7501/1991, (v) me të drejtë gjykata e apelit nuk ka marrë në konsideratë pretendimet e ngritura nga kërkuesit për pavlefshmërinë e AMTP-së lidhur me faktin se pala paditëse, punëtor i Ndërmarrjes Bujqësore, ishte me banim në qytet, me argumentimin se sipas vendimit unifikues nr.5/2012 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, pavlefshmëria e aktit administrativ nuk mund të konstatohet kryesisht nga gjykata ose mbi bazën e një prapësimi të palëve sikurse ndodh në rastet e pavlefshmërisë së veprimeve juridike. Sipas Gjykatës së Lartë, ky dallim bëhet për shkak se aktet administrative janë shprehje e vullnetit të organeve të sipërpërmendura në funksion të ushtrimit të kompetencave të tyre në bazë të ligjit dhe sjellin pasoja juridike si akte të organeve të pushtetit, pra i përkasin fushës të së drejtës publike. Në përfundim, Gjykata e Lartë ka vlerësuar se vendimi i dhënë nga Gjykata e Apelit Tiranë nuk vjen në kundërshtim me praktikën e Kolegjit Civil ose të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë dhe se shkaqet e parashtruara në rekurs, kanë ngritur kryesisht çështje të vlerësimit të provave dhe të fakteve, të cilat dalin jashtë juridiksionit rishikues dhe ligjor të saj.

36. Në analizë të sa më sipër, Gjykata konstaton se Gjykata e Lartë me vendimin nr. 966, datë 21.10.1999, ka dhënë orientime të detyrueshme për gjykatat e faktit lidhur me vlerësimin e ligjshmërisë së AMTP-ve dhe të

akteve të Komisionit të Tokës së Këshillit të Rrethit Tiranë, për shkak të kontradiktave në përmbajtjen e tyre. Këto orientime janë përsëritur edhe në vendimin e Gjykatës së Lartë nr. 1118, datë 01.06.2004. Në rigjykimin e fundit, gjykata e apelit, edhe pse ka njohur të drejtën e pronësisë së kërkuesve, ka vlerësuar se: (i) në kushtet kur paditësit janë pronarë të ligjshëm të pronës, sipas ligjit nr.7501/1991, KKKP-ja Tiranë nuk duhet të vendoste kthimin e saj si të lirë, por duhet të vendoste kompensimin e trashëgimtarëve të ish pronarit në një nga format e parashikuara me ligj, dhe se (ii) kërkuesit nuk mund të ngrinin një padi të thjeshtë rivendikimi pa kërkuar më parë pavlefshmërinë e aktit administrativ (AMTP-së) . Në analizë të vendimit të gjykatës së apelit, Gjykata vëren se ajo gjykatë nuk rezulton të jetë shprehur për problematikat e ngritura nga kërkuesit dhe të evidentuara nga Gjykata e Lartë në vendimin e vitit 1999, për ligjshmërinë e AMTP-ve dhe akteve të Komisionit të Tokës së Këshillit të Rrethit Tiranë, që kanë qenë edhe themeli i mosmarrëveshjes objekt kundërshtimi. Ndërkohë, Gjykata e Lartë, duke u ndodhur përpara situatës ligjore ku gjykatat e faktit (dhe vetë Kolegjet e Gjykatës së Lartë) kanë dhënë vendime të kundërta, si dhe nuk janë shprehur, edhe pse kishin detyrimin ligjor, për zbatimin e detyrave të lëna nga Gjykata e Lartë lidhur me ligjshmërinë e akteve të marrjes së tokës në përdorim dhe në pronësi, si dhe të akteve të KT-së së Këshillit të Rrethit Tiranë, nuk rezulton t'u ketë dhënë përgjigje përfundimtare pretendimeve të ngritura nga kërkuesit (pala e paditur/ kundërpaditëse).

37. Duke mbajtur në konsideratë për sa më sipër, Gjykata vlerëson se, në kuadër të së drejtës për proces të rregullt ligjor dhe në zbatim të parimit të susbsidiaritetit, Gjykata e Lartë, si gjykatë ligji, duhej t'u jepte përgjigje përfundimtare, në aspektin substancial, pretendimeve të kërkuesve për mosmarrëveshjen objekt gjykimi. Për rrjedhojë, mungesa e një qëndrimi të Gjykatës së Lartë për problematikat në thelb të mosmarrëveshjes, u ka cenuar atyre të drejtën për akses substancial në atë gjykatë për pretendimet për cenimin e së drejtës së pronësisë.

38. Në përfundim, Gjykata çmon se pretendimet e kërkuesve janë të bazuara, sipas arsyetimit të mësipërm, ndaj kërkesa duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, si dhe neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin

e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me shumicë votash,

V E N D O S I:

1. Pranimin e kërkesës.

2. Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2024-698, datë 17.01.2024 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

3. Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 18.09.2025
Shpallur më 30.12.2025

MENDIM PAKICE

1. Në gjykimin kushtetues të çështjes që u përket kërkueseve Drita Pulleja dhe të tjerë, me objekt shfuqizimin e vendimit nr. 00-2024-698, datë 17.01.2024 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën, jam kundër qëndrimit të shumicës për pranimin e kërkesës, pasi vlerësoj se pretendimet janë të pabazuara, ndaj kërkesa duhej rrëzuar. Në mbështetje të nenit 132, pika 3, të Kushtetutës dhe nenit 72, pika 8, të Ligjit Organik të Gjykatës, që parashikojnë publikimin e mendimit të pakicës së bashku me vendimin përfundimtar të Gjykatës, parashtroj në vijim argumentet që mbështesin qëndrimin tim kundër.

2. Çështja konkrete ka në themelin e saj mosmarrëveshjen civile midis palëve për një truall prej 5000 m^2, të ndodhur në fshatin Mëzez, komuna Kashar, Tiranë. KKKP-ja, Tiranë, me vendimin nr. 220/1995, ka njohur pronësinë dhe ua ka kthyer kërkuesve sipas ligjit për kthimin e pronave, ndonëse në vitin 1993 ky truall i ishte dhënë fillimisht në përdorim dhe më pas në pronësi subjekteve të interesuara, trashëgimtarëve të shtetasit Nj.Sh., sipas ligjit për tokën. Subjektet e interesuara, të cilat e kishin në përdorim truallin, kanë ngritur padi, me objekt kundërshtimin e vendimit nr. 220/1995 të KKKP-së, Tiranë për pjesën që u kthente kërkuesve truallin prej 5000 m^2, ndërsa kërkuesit, brenda të njëjtit proces, kanë ngritur kundërpadi, me objekt kthimin e truallit. Procesi gjyqësor ka filluar më 06.06.1996 dhe çështja është gjykuar tre herë në shkallë të parë (në vitet 1996, 2000 dhe 2002), gjashtë herë në shkallë të dytë (në vitet 1997, 1998, 2000, 2003, 2007 dhe 2015) dhe pesë herë në Gjykatën e Lartë (në vitet 1997, 1999, 2004, 2014 dhe 2024). Në përfundim të procesit, gjykatat e zakonshme kanë vendosur anulimin e pjesshëm të vendimit nr. 220/1995 të KKKP-së, Tiranë, për pjesën që u kthente kërkuesve truallin prej 5000 m^2 (vendimi i vitit 2002 i gjykatës së shkallës së parë), duke u njohur atyre (kërkuesve) të drejtën e kompensimit në një nga mënyrat e parashikuara nga ligji (vendimi i gjykatës së apelit i vitit 2015). Gjykata e Lartë, me vendimin e datës 17.01.2024, ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuesve.

3. Në këto rrethana, kërkuesit kanë paraqitur ankim kushtetues individual, me pretendimet se vendimi i Gjykatës së Lartë për mospranimin e rekursit u ka cenuar atyre të drejtën për proces të rregullt ligjor, të garantuar nga

neni 42 i Kushtetutës, në aspektet e parimeve të barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit, si dhe të sigurisë juridike.

4. Shumica ka vlerësuar se pretendimi për cenimin e parimit të barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit është haptazi i pabazuar (*shih paragrafët 21-26 të vendimit*), ndërsa pretendimin për cenimin e parimit të sigurisë juridike e ka analizuar në këndvështrim të së drejtës së aksesit substancial të lidhur me të drejtën e pronës (*shih paragrafin 27 të vendimit*). Lidhur me këtë të fundit, shumica ka arritur në përfundimin se Gjykata e Lartë, me vendime të mëparshme, ka caktuar detyra të detyrueshme për gjykatat e faktit lidhur me vlerësimin e ligjshmërisë së AMTP-ve dhe të akteve të Komisionit të Tokës së Këshillit të Rrethit Tiranë, për shkak të kontradiktave në përmbajtjen e tyre. Sipas shumicës, gjykata e apelit nuk rezulton të jetë shprehur për këtë detyrë që ka qenë edhe themeli i mosmarrëveshjes objekt kundërshtimi. Gjykata e Lartë, duke u ndodhur përpara situatës ligjore, ku kolegjet e saj kishin dhënë vendime të kundërta, si dhe gjykatat e faktit nuk janë shprehur për zbatimin e detyrës të lënë nga Gjykata e Lartë në vitin 1999 për ligjshmërinë e akteve të marrjes së tokës në përdorim dhe në pronësi, nuk rezulton t'u ketë dhënë përgjigje përfundimtare pretendimeve të ngritura nga kërkuesit. Për këtë arsye, sipas shumicës, mungesa e një qëndrimi të Gjykatës së Lartë për problematikat në thelb të mosmarrëveshjes, u ka cenuar kërkuesve të drejtën për akses substancial në atë gjykatë për pretendimet për cenimin e së drejtës së pronësisë (*shih paragrafët 36-37 të vendimit*).

5. Nuk pajtohem me këtë qëndrim të shumicës për tri arsye themelore. *Së pari,* kufijtë e shqyrtimit të çështjes nga Gjykata, në vlerësimin tim, janë tejkaluar nga shumica. Në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se sipas nenit 48 të Ligjit Organik të Gjykatës kufijtë e shqyrtimit të çështjes janë brenda objektit të kërkesës dhe shkaqeve të parashtruara në të, ndërkohë që objekti dhe shkaqet e kërkesës, me të cilat ngrihet çështja e kushtetutshmërisë, përbëjnë thelbin (*thema decidendum*) e gjykimit kushtetues (*shih vendimet nr. 22, datë 23.04.2025; nr. 81, datë 21.11.2024; nr. 20, datë 04.04.2014 të Gjykatës Kushtetuese)*. Mbi bazën e këtij standardi, duhet evidentuar se "*mungesa e qëndrimit të Gjykatës së Lartë ndaj mospërmbushjes së detyrave të lëna më parë prej saj në rigjykimin e çështjes nga gjykatat e faktit*" nuk rezulton të jetë ngritur nga kërkuesit si shkak në aktin e ankimit kushtetues individual. Për rrjedhojë, jam e mendimit se shumica ka tejkaluar kufijtë e shqyrtimit të çështjes, duke

hetuar ajo vetë rrethana dhe fakte që nuk janë parashtruar nga kërkuesit, pra duke marrë një rol aktiv të palejuar.

6. *Së dyti* nuk rezulton që kërkuesit në aktin e rekursit të kenë ngritur pretendimin që gjykata e apelit në rigjykimin e çështjes nuk ka zbatuar udhëzimet e Gjykatës së Lartë të vitit 1999, përkundrazi kanë parashtruar se udhëzimi i Gjykatës së Lartë në vendimin e vitit 2014 nuk ishte i drejtë. Duke mos e ngritur këtë shkak në rekurs, madje duke pasur një vlerësim të kundërt me atë që shprehet shumica, jam e mendimit se arsyetimi i shumicës nuk i përgjigjet as fakteve të çështjes dhe as ligjit të zbatueshëm. Në këtë pikë, evidentoj se një prej parimeve themelore të gjykimit civil është ai i disponibilitetit, i cili detyron gjykatën e zakonshme të shprehet mbi gjithçka që kërkohet dhe vetëm për atë që kërkohet (*neni 6 i KPC-së*) dhe Gjykatën e Lartë ta shqyrtojë rekursin brenda kufijve të tij (*neni 473/a i KPC-së*). Për rrjedhojë, është e pakuptueshme sesi Gjykata e Lartë duhet të mbante qëndrim të shprehur për një shkak që nuk ishte ngritur në rekurs.

7. *Së treti,* jam e mendimit se në substancë nuk qëndron konkluzioni i shumicës, sipas të cilit gjykatat e faktit në rigjykimin e çështjes, në kundërshtim me nenin 486 të KPC-së, nuk kanë zbatuar udhëzimet dhe konkluzionet e Gjykatës së Lartë. Për këtë konkluzion, shumica i referohet vendimit të vitit 1999 të Gjykatës së Lartë, me të cilin ajo ka prishur vendimet e gjykatave të faktit dhe ka urdhëruar rigjykimin e çështjes në shkallë të parë, duke lënë si detyrë verifikimin e të gjitha aspekteve të vendimit të komisionit të tokës për të konkluduar për ligjshmërinë ose kundërligjshmërinë e tij. Për këtë qëllim, sipas Gjykatës së Lartë, në rigjykim duhet të thirreshin të gjithë personat që kishin interes në çështje, konkretisht të gjitha komisionet e ndarjes së tokës dhe t'i jepej përgjigje kundërpadisë që mund të ngrihej në rigjykim.

8. Në vitin 2004 Gjykata e Lartë ka prishur vendimin e gjykatës së apelit dhe ka urdhëruar rigjykimin e çështjes, me arsyetimin se gjykatat e faktit nuk kishin zbatuar detyrat e lëna nga Gjykata e Lartë në vitin 1999, pasi nuk kishin vlerësuar ligjshmërinë e akteve të komisioneve të tokës, me të cilat ishin anuluar aktet e marrjes së tokës në pronësi dhe përdorim nga subjektet e interesuara. Pas dhënies së këtij vendimi, Gjykata e Apelit Tiranë në vitin 2007 ka shqyrtuar në themel mosmarrëveshjen dhe ka vendosur, ndër të tjera, detyrimin e subjekteve të interesuara t'u dorëzojnë truallin kërkuesve. Gjykata e Lartë është vënë sërish në lëvizje, përmes rekursit të subjekteve të interesuara dhe në vitin 2014 ka vendosur prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe rigjykimin e çështjes në shkallë të dytë. Ajo ka arsyetuar

se gjykata e apelit duhet ta hetonte plotësisht çështjen dhe të mbante në konsideratë nenin 36 të KPC-së, sipas të cilit organet administrative nuk mund të pranojnë për shqyrtim mosmarrëveshjen që është duke u shqyrtuar nga gjykata, ndaj, sipas saj, vendimet e komisionit të tokës për anulimin e akteve të ndarjes së tokës nuk duhet t'i nënshtroheshin shqyrtimit gjyqësor, si akte të nxjerra pas fillimit të procesit gjyqësor. Në vijim, Gjykata e Apelit Tiranë në vitin 2015 ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, me të cilin trualli u mbetej subjekteve të interesuara, por duke plotësuar vendimin me të drejtën e kërkuesve për t'u kompensuar për pronën, sipas mënyrave të parashikuara nga ligji.

9. Gjykata e Lartë në vitin 2024, e vënë në lëvizje nga kërkuesit, vendosi mospranimin e rekursit të tyre, duke arsyetuar, ndër të tjera, se gjykata e apelit me të drejtë nuk ka marrë në konsideratë pretendimet që kërkuesit kishin për titullin e pronësisë të subjekteve të interesuara. Sipas Gjykatës së Lartë, bazuar në vendimin unifikues nr. 5/2012, pavlefshmëria e aktit administrativ nuk mund të konstatohet kryesisht nga gjykata vetëm bazuar në prapësimin e palës.

10. Duke iu referuar këtij konteksti faktesh, rezulton se detyra e lënë nga Gjykata e Lartë në vitin 1999 për verifikimin e ligjshmërisë së titullit të pronësisë mbi truallin i referohej një ngjarjeje të ardhshme – kundërpadisë që mund të ngrihej nga kërkuesit në gjykim. Për sa i takon kësaj të fundit, kërkuesit kanë zgjedhur të ngrenë kundërpadinë e rivendikimit, duke kërkuar kthimin e truallit, që sipas tyre mbahej pa të drejtë nga subjektet e interesuara. Kjo do të thotë se kërkuesit nuk kanë ngritur padi për të kundërshtuar aktet administrative të lëshuara nga komisionet e tokës, por janë mjaftuar me prapësime në seancë gjyqësore për kundërligjshmërinë e tyre. Në këto rrethana, siç me të drejtë ka vënë në dukje Gjykata e Lartë në vitin 2024, ligjshmëria e titullit të pronësisë, që ishte akt administrativ, nuk mund të verifikohej me nismën e vet gjykatës, pasi një verifikim i tillë do të binte ndesh me vendimin unifikues të Gjykatës së Lartë. Për rrjedhojë, ndaj qëndrimin se në thelb nuk rezulton që gjykata e apelit në vitin 2015 të mos ketë respektuar detyrat e Gjykatës së Lartë dhe as që kjo e fundit të mos ketë mbajtur qëndrim në këtë drejtim.

11. Për sa më lart, jam e mendimit se në rastin e mosmarrëveshjeve midis palëve private për të drejtën e pronës, ekziston gjithnjë mundësia që njëra prej palëve të humbasë në përfundim të gjykimit të drejtën e pronës, ndaj rezultati i gjykimit nuk mund të përbëjë *apriori* rrethanë vendimtare për të vlerësuar nga pikëpamja kushtetuese cenimin e së drejtës së pronës.

Në këtë drejtim, duhet theksuar se, siç është pohuar në mënyrë konstante në jurisprudencën kushtetuese, vlerësimi i fakteve dhe i rrethanave të çështjes, si dhe interpretimi i ligjit janë kompetenca të gjykatave të sistemit gjyqësor të zakonshëm dhe, si të tilla, nuk mund të jenë objekt i gjykimit kushtetues *(shih vendimet nr. 5, datë 09.02.2023; nr. 3, datë 17.02.2022; nr. 2, datë 17.02.2022 të Gjykatës Kushtetuese)*. Ndaj, vlerësimi kushtetues i Gjykatës nuk mund të zëvendësojë rolin dhe funksionin e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, duke e shndërruar atë në një shkallë të katërt gjykimi.

12. Në përfundim, çmoj se pretendimet e kërkuesve janë të pabazuara, për pasojë Gjykata duhet të vendoste rrëzimin e kërkesës.

Anëtare: Marsida Xhaferllari

Vendim nr. 47, datë 18.09.2025
(V-47/25)

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Holta Zaçaj, Kryetare, Fiona Papajorgji, Sonila Bejtja, Sandër Beci, Ilir Toska, Genti Ibrahimi, Marjana Semini, Marsida Xhaferllari, anëtarë, me sekretare Anjeza Puka, në datën 18.09.2025 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 3 (T) 2025 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: **TOM DEDAJ**, përfaqësuar nga avokat Bexhet Lata, me prokurë.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË, përfaqësuar nga Danja Hobdari dhe Albion Salaj, me autorizim.

PROKURORIA E PËRGJITHSHME, në mungesë.

PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM DIBËR, në mungesë.

KËSHILLI I MINISTRAVE, përfaqësuar nga Herald Jonuzaj, me autorizim.

AVOKATURA E SHTETIT, përfaqësuar nga avokatet e shtetit Valbona Legisi dhe Irma Qosja.

OBJEKTI: **Ndreqje gabimi në vendimin nr. 4, datë 21.01.2025 të Gjykatës Kushtetuese, për sa i takon miratimit të shpenzimeve gjyqësore.**

BAZA LIGJORE: **Neni 310 i Kodit të Procedurës Civile (*KPC*); nenet 28 dhe 80 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).**

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Marsida Xhaferllari, mori në shqyrtim prapësimet me shkrim të kërkuesit Tom Dedaj *(kërkuesi)*, që ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar, Këshillit të Lartë të Prokurorisë (*KLP*), që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar, Këshillit të Ministrave, që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar, Avokaturës së Shtetit, që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, konstatoi mungesën e prapësimeve me shkrim të subjekteve të tjera të interesuara, Prokurorisë së Përgjithshme dhe Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër (*Prokuroria e Dibrës*), si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I
Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi në datën 09.07.2024 i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual me objekt konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm të gjykimit të çështjes së tij nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë dhe shfuqizimin e vendimit të gjykatës së apelit që e kishte rrëzuar atë. Pas kontrollit paraprak, çështja ka kaluar për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

2. Në vijim, kërkuesi përmes avokatit të tij ka paraqitur parashtrimet shtesë, ku, ndër të tjera, ka kërkuar edhe caktimin e shpenzimeve gjyqësore në ngarkim të KLP-së, Prokurorisë së Përgjithshme dhe Prokurorisë së Dibrës, në vlerën gjithsej 201 200 lekë.

3. Në përfundim, Gjykata, me vendimin nr. 4, datë 21.01.2025 (*vendimi nr. 4/2025*), ka vendosur pranimin e kërkesës, shfuqizimin e vendimit objekt kundërshtimi, konstatimin e cenimit të së drejtës për një gjykim brenda afatit të arsyeshëm dhe detyrimin e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë të shqyrtojë çështjen e kërkuesit me përparësi. Ndërkohë, Gjykata nuk është shprehur për kërkimin që lidhej me shpenzimet gjyqësore. Vendimi është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 40, datë 26.02.2025.

4. Në datën 03.04.2025 kërkuesi i është drejtuar sërish Gjykatës me kërkesë sipas objektit. Kolegji i Gjykatës, në datën 05.06.2025 ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve,

ndërsa kjo e fundit, në datën 24.06.2025, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II
Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

5. ***Kërkuesi***, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se bazuar në nenet 28 dhe 80 të ligjit nr. 8577/2000, Gjykata duhet të shprehet për shpenzimet gjyqësore në vlerën gjithsej 201 200 lekë në ngarkim të palës së paditur solidarisht, KLP-së, Prokurorisë së Përgjithshme dhe Prokurorisë së Dibrës, të cilat janë dokumentuar prej tij me fatura shpenzimesh.

6. ***Subjekti i interesuar, KLP-ja,*** në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar se shpenzimet nuk mund t'i ngarkohen atij, në kushtet kur nuk është bërë shkak i shkeljes kushtetuese. Për më tepër, edhe në gjykimin që po zhvillohet pranë gjykatave të zakonshme, gjykata e shkallës së parë i ka rrëzuar pretendimet e kërkuesit ndaj KLP-së për mungesë të legjitimimit pasiv, duke ia ngarkuar shpenzimet gjyqësore Prokurorisë së Përgjithshme dhe Prokurorisë së Dibrës.

7. ***Subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave,*** në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar se neni 80 i ligjit nr. 8577/2000 nuk është i aplikueshëm, pasi trajton vetëm rastet e gabimeve materiale në tekstin e vendimit. Neni 28, pika 2, i ligji nr. 8577/2000 trajton vetëm shpenzimet e përfaqësimit, ndaj shpenzimet e tjera për kancelarinë dhe ditët e punës nuk mund të njihen. Shpenzimet e përfaqësimit duhet t'i ngarkohen subjektit të interesuar në gjykim, i cili është palë në procesin gjyqësor të zakonshëm. Këshilli i Ministrave dhe Ministria e Financave nuk zotërojnë buxhet për llogari të subjekteve të tjera.

8. ***Subjekti i interesuar, Avokatura e Shtetit,*** në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar se masa e shpenzimeve të përfaqësimit nuk duhet caktuar në mënyrë arbitrare, por duhet të përfshijë ato që janë reale, të nevojshme dhe të dokumentuara, duke mbajtur në konsideratë edhe kompleksitetin e çështjes. Shpenzimet duhet t'i ngarkohen subjektit të interesuar në gjykim, por duke mbajtur në konsideratë edhe gjendjen ekonomike të tij. Në rastet kur subjekt i interesuar është institucion publik, shpenzimet e përfaqësimit nuk mund t'i ngarkohen Ministrisë së Financave ose gjykatës në mënyrë abstrakte dhe as Këshillit të Ministrave, i cili nuk zotëron buxhet për llogari të subjekteve të tjera. Në rastin konkret, shpenzimet e përfaqësimit duhet t'u

ngarkohen subjekteve të interesuara që kanë qenë palë në gjykim, KLP-së, Prokurorisë së Përgjithshme dhe Prokurorisë së Dibrës. Po kështu, Gjykata ka diskrecionin që në vendimin përfundimtar të caktojë edhe mënyrën e ekzekutimit.

9. ***Subjektet e interesuara, Prokuroria e Përgjithshme dhe Prokuroria e Dibrës,*** nuk kanë paraqitur prapësime me shkrim edhe pse janë njoftuar rregullisht nga Gjykata.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

10. Në rastet kur Gjykata vihet në lëvizje për plotësimin e vendimit të saj, legjitimimi i kërkuesit dhe procedura parashikohen në nenin 80 të ligjit nr. 8577/2000. Sipas kësaj dispozite, Gjykata ka të drejtë, me kërkesë, të ndreqë gabimet në shkrim, në llogari ose ndonjë pasaktësi të dukshme të lejuar në vendim, pa ndryshuar thelbin e vendimmarrjes, brenda 2 muajve nga shpallja e vendimit. Vendimi i Gjykatës në këto raste publikohet në Fletoren Zyrtare. I njëjti rregull parashikohet edhe në nenin 43 të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese (*Rregullorja*), sipas të cilit kur kërkesa ka të bëjë me një vendim përfundimtar, kompetente për shqyrtimin e saj është Gjykata.

11. Në kuptim të këtyre dispozitave, Gjykata çmon se kërkuesi legjitimohet në paraqitjen e kërkesës sipas objektit, pasi ka qenë palë pjesëmarrëse në gjykimin për të cilin është dhënë vendimi nr. 4/2025 i Gjykatës dhe i është drejtuar asaj brenda 2 muajve nga shpallja e vendimit. Po kështu, kërkimi për të plotësuar vendimin edhe me disponimin për shpenzimet gjyqësore, sipas nenit 28 të ligjit nr. 8577/2000, hyn në kompetencën lëndore të Gjykatës të përcaktuar nga neni 80 i të njëjtit ligj, i cili emërtohet "*Saktësimi dhe plotësimi i vendimit*", pasi është kërkim i paraqitur në parashtrimet shtesë të ankimit individual të parë dhe nuk ndryshon thelbin e vendimmarrjes, ndaj në vijim Gjykata do ta analizojë atë në themel.

12. Gjykata vëren se në nenin 28 të ligjit nr. 8577/2000, i cili është përfshirë për herë të parë në vitin 2016, me ndryshimet e miratuara që reformuan, ndër të tjera, ankimin kushtetues individual, janë parashikuar rregulla për sa u takon shpenzimeve gjyqësore, sipas të cilave, shpenzimet e procesit gjyqësor para saj u nënshtrohen rregullave të parashikuara në ligjin për tarifat gjyqësore (*pika 1*); kur ajo vendos pranimin e ankimit individual

kushtetues, ajo mund të shprehet edhe për shpenzimet e përfaqësimit pjesërisht ose tërësisht, nëse kërkohet nga kërkuesi (*pika 2*). Kjo dispozitë është konkretizuar edhe në nenin 14 të Rregullores, sipas së cilës kur Gjykata vendos pranimin e ankimit kushtetues individual, ajo shprehet në dispozitiv edhe për shpenzimet e përfaqësimit dhe masën e tyre, nëse kjo kërkohet nga kërkuesi (*pika 4*).

13. Në kontekst të këtyre parashikimeve, të cilat nuk janë zbatuar deri më tani në praktikën e saj, Gjykata çmon të analizojë paraprakisht disa çështje juridike, që kanë të bëjnë me: (i) afatin e paraqitjes së kërkesës për shpenzimet gjyqësore në procesin kushtetues, pra nëse një kërkesë e tillë mund të paraqitet së bashku me ankimin kushtetues individual, gjatë gjykimit deri në shpalljen e vendimit apo në çdo kohë, por gjithsesi jo më vonë se 2 muaj nga shpallja e vendimit; (ii) kriteret dhe dokumentet mbi bazën e të cilave caktohet masa e shpenzimeve të përfaqësimit; (iii) subjektin që i ngarkohen shpenzimet e përfaqësimit, në rast pranimi të kërkesës: (a) subjekti i interesuar që është palë e procesit gjyqësor të zhvilluar në gjykatat e zakonshme; (b) subjekti i interesuar që ka nxjerrë vendimin gjyqësor ose aktin e pushtetit publik, që shfuqizohet nga gjykata; (c) Ministria e Financave, në kushtet kur ligji ngarkon Këshillin e Ministrave që me anën e organeve përkatëse të administratës shtetërore të sigurojë ekzekutimin e vendimeve të Gjykatës; (iv) mënyrën, afatet dhe procedurën e ekzekutimit të shpenzimeve të përfaqësimit.

14. Lidhur me këto çështje kërkuesi ka parashtruar se shpenzimet e përfaqësimit janë pjesë integrale e çdo procesi gjyqësor dhe ato kërkohen në bazë të faturave përkatëse tatimore, përfshirë edhe ato që lidhen me ditët e humbura për pjesëmarrjen në gjykim të palëve, dëshmitarët, ekspertët, udhëtimin, ushqimin, akomodimin dhe gjithçka të shpenzuar. Sipas tij, faturat e shpenzimeve duhet të paraqiten gjatë shqyrtimit gjyqësor, për shkak të dinamikës së procedurave dhe Gjykata duhet të shprehet për mënyrën dhe afatin e ekzekutimit sipas shembullit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Ndërsa, subjektet e interesuara, Këshilli i Ministrave dhe Avokatura e Shtetit, kanë prapësuar se në kuptim të nenit 28 të ligjit nr. 8577/2000, kërkesa për shpenzimet gjyqësore duhet të paraqitet së bashku me ankimin kushtetues individual, me qëllim që t'u jepet mundësia subjekteve të interesuara për t'u shprehur lidhur me to. Gjykata duhet të shprehet vetëm për shpenzimet e përfaqësimit të dokumentuara sipas përcaktimeve ligjore në fuqi dhe krahas kontratës së shërbimit me avokatin duket të jetë edhe fatura tatimore përkatëse, ndërsa asnjë nga shpenzimet

e tjera, si ato që lidhen me kancelarinë dhe ditët e punës, nuk mund të jenë objekt vendimmarrjeje nga Gjykata dhe asnjë dokument i lidhur me këto kosto nuk ka vlerë për gjykimin kushtetues. Shpenzimet gjyqësore duhet t'i ngarkohen palës ndërgjyqëse në disfavor të së cilës është shprehur gjykata e faktit, duke mbajtur në konsideratë edhe gjendjen ekonomike ose, sipas rastit, atij organi apo institucioni që është përgjegjës për zbatimin e vendimit të Gjykatës. Ato nuk mund t'i ngarkohen gjykatës ose Ministrisë së Financave në mënyrë abstrakte. Po sipas tyre, Këshilli i Ministrave dhe Ministria e Financave nuk zotërojnë buxhet për llogari të subjekteve të tjera. Për sa i përket mënyrës së ekzekutimit, përcaktimi mbetet në atribut të vetë Gjykatës. Ndërsa, sipas subjektit tjetër të interesuar, KLP-së, shpenzimet nuk mund t'i ngarkohen atij në kushtet kur nuk është bërë shkak i shkeljes kushtetuese.

15. Gjykata thekson se në parim çështja e shpenzimeve të përfaqësimit në gjykimin kushtetues të ankimit individual është pjesë e procesit të rregullt ligjor dhe refuzimi për mbulimin e tyre rrezikon të kufizojë në mënyrë të pajustifikuar të drejtën e individit për akses në gjykatë, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës.

16. Nën këtë optikë, Gjykata vëren se ligji nr. 8577/2000 nuk ka parashikuar në mënyrë të shprehur afatin konkret brenda të cilit kërkuesi mund të paraqesë kërkesë për shpenzimet e përfaqësimit, por është mjaftuar me shprehjen "*nëse kërkohet nga kërkuesi*". Në vlerësimin e Gjykatës kjo do të thotë se, *së pari*, disponimi për shpenzimet vihet në lëvizje vetëm me kërkesë formale nga ankuesi dhe, *së dyti*, një kërkesë e tillë mund të paraqitet së bashku me ankimin kushtetues individual deri kur deklarohet mbyllja e seancës plenare nga Gjykata.

17. Po kështu, Gjykata vë në dukje se individi ka të drejtën e mbulimit të shpenzimeve vetëm nëse vërteton se ato janë kryer, kanë qenë të nevojshme dhe në masë të arsyeshme. Për këtë arsye, kërkesa duhet të shoqërohet me akte që dokumentojnë në mënyrë reale dhe të nevojshme masën e shpenzimeve të kryera për qëllim të procesit kushtetues, të cilat në çdo rast duhet të jenë të arsyeshme dhe të shoqëruara me fatura tatimore të lëshuara sipas legjislacionit në fuqi. Sipas udhëzimit të përbashkët nr. 18, datë 05.08.2020 të ministrit të Drejtësisë dhe ministrit të Financave "Për miratimin e kritereve të përfitimit të pagesave dhe tarifat e shpërblimit të avokatëve që ofrojnë ndihmë juridike dytësore", shpenzimet për ofrimin e mbrojtjes juridike për përfaqësimin në Gjykatë përcaktohen në vlerat 50 000 lekë dhe 60 000 lekë, ndërsa për shërbime

jashtëgjyqësore përcaktohen në vlerat 25 000 lekë (përgatitje kërkese) dhe 500 deri në 1500 lekë ora (ofrimi i ndihmës juridike në formën e këshillimit - shih rubrikat I dhe II të shtojcës 1 "*Tarifat e shërbimeve juridike të avokatëve të ndihmës juridike*"). Nga ana tjetër, kriteret bazë për llogaritjen e masës lidhen me: kompleksitetin e çështjes, nivelin e formimit dhe përvojën juridike të kërkuesit për të kuptuar çështjen, moshën dhe gjendjen financiare të kërkuesit, si dhe elemente të tjera që ndikojnë në vlerën e kërkuar.

18. Për sa i takon subjektit që ngarkohet për mbulimin e shpenzimeve të përfaqësimit, Gjykata vë në dukje se natyra dhe objekti i gjykimit kushtetues ndryshojnë nga gjykimi i zakonshëm, ku në këtë të fundit shpenzimet gjyqësore i ngarkohen palëve ndërgjyqëse sipas disponimit të gjykatës së zakonshme. Përkundër kësaj, në gjykimin kushtetues individi kërkon të mbrojë të drejtat themelore të shkelura si pasojë e veprimtarisë së autoriteteve publike, ku përfshihet edhe ajo e gjykatave të zakonshme, që i kanë pasjellë atij cenimin e të drejtave themelore, ndaj përgjegjësia në këtë gjykim i takon vetë shtetit. Në këtë këndvështrim, një logjikë analoge ndiqet nga rregullimet ligjore për kompensimin për arrestin në shtëpi, paraburgim dhe burgim të padrejtë, ku shpenzimet përballohen nga buxheti i shtetit (*neni 9 i ligjit nr. 9381, datë 28.04.2005 "Për kompensimin e burgimit të padrejtë"*) ose ato për kompensimin e shkeljes të së drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm, ku në gjykimin e zakonshëm thirren të paditur Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Financave (*neni 399/4, pika 2, i KPC-së*).

19. Mbi bazën e këtyre standardeve, në rastin konkret Gjykata vëren se kërkimi i kërkuesit për shpenzimet gjyqësore është paraqitur brenda afatit, pasi ai është depozituar përpara marrjes së vendimit për pranimin e ankimit kushtetues individual. Kërkuesi e ka paraqitur personalisht vetë ankimin kushtetues individual dhe në atë fazë nuk ka qenë i përfaqësuar me avokat. Pas njoftimit nga Gjykata se çështja e tij ka kaluar për shqyrtim në seancë plenare, kërkuesi në datën 08.10.2024 ka lidhur një marrëveshje për shpërblimin e avokatit (në format të thjeshtë dhe të panoterizuar) përmes së cilës ka emëruar si përfaqësues ligjor të tij një avokat. Sipas marrëveshjes, kërkuesi bie dakord që avokati ta përfaqësojë në të gjitha fazat dhe shkallët e gjykimit deri në ekzekutimin e plotë të vendimeve kundrejt shpërblimit në vlerën 140 000 lekë. Pas rreth 16 ditëve, në datën 24.10.2024 është lëshuar fatura tatimore në vlerën 140 000 lekë, me përshkrimin "*Përfaqësim për çështje administrative*

pranë Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë". Një ditë më pas, në datën 25.10.2024, përpara noterit është nënshkruar prokura e përgjithshme për emërimin e avokatit në cilësinë e përfaqësuesit ligjor të kërkuesit, të cilit i jepej tagri i përfaqësimit në çdo gjykatë dhe për çdo çështje civile ose familjare, administrative dhe penale, si dhe në procedurat jashtëgjyqësore në të cilat ai është palë. Në të njëjtën datë është lëshuar edhe fatura tatimore në vlerën 6 200 lekë, me përshkrimin "*Faturë shitjeje e gjeneruar për listë shërbimesh*". Sipas përshkrimeve në aktet e paraqitura, "Marrëveshja për shpërblimin e avokatit" dhe "Prokura e përgjithshme", konstatohet se përfaqësimi i kërkuesit nga avokati nuk i referohet vetëm shqyrtimit të çështjes përpara Gjykatës, por të gjitha çështjeve pavarësisht natyrës dhe shkallës së gjykimit në të cilat ai është palë. Ndërsa shpenzimet për ditët e punës dhe kancelarinë në vlerën 55 000 lekë pasqyrohen në nivel deklarativ e të pashoqëruara me akte provuese.

20. Për sa më lart, duke marrë në konsideratë se ankimi kushtetues është paraqitur nga vetë kërkuesi, i cili ka formimin e përvojën e mjaftueshme për të kuptuar çështjen dhe se gjykimi kushtetues i përfunduar me vendimin nr. 4/2025 nuk ka qenë kompleks, Gjykata i vlerëson shpenzimet e përfaqësimit në vlerën 50 000 lekë. Detyrimi për pagimin e kësaj vlere i ngarkohet Ministrisë së Financave. Në këtë pikë, Gjykata vë në dukje se afati për përmbushjen e detyrimit për mbulimin e shpenzimeve të përfaqësimit duhet të jetë i arsyeshëm deri në masën që mos të humbasë qëllimin e tij legjitim.

21. Në përfundim, Gjykata çmon se kërkesa për shpenzimet e përfaqësimit është e drejtë dhe duhet pranuar pjesërisht.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, bazuar në nenin 80 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, njëzëri,

V E N D O S I:

1. Pranimin e pjesshëm të kërkesës.

2. Plotësimin e vendimit nr. 4, datë 21.01.2025 të Gjykatës Kushtetuese në dispozitivin e tij, si më poshtë:

"*Shpenzimet e përfaqësimit të kërkuesit në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë i ngarkohen Ministrisë së Financave*".

3. Një kopje e këtij vendimi i bashkohet vendimit përfundimtar nr. 4, datë 21.01.2025 të Gjykatës Kushtetuese.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 18.09.2025
Shpallur më 10.10.2025

Vendim nr. 48, datë 22.09.2025
(V-48/25)

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Holta Zaçaj, Kryetare, Marsida Xhaferllari, Fiona Papajorgji, Sonila Bejtja, Sandër Beci, Genti Ibrahimi, Marjana Semini, Ilir Toska, anëtarë, me sekretare Belma Lleshi, në datën 16.09.2025 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve kërkesën nr. 48 (A) 2024 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: **ASTRIT MELI**

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

NIKOLIN KODHIMA, BUKURIE AGAJ, MELEQE BINAJ, GRAMOZ HAXHIRAJ, në mungesë.

BARJAM MEMINAJ, përfaqësuar nga avokate Majlinda Shehu, me prokurë.

SHOQËRIA "ÇIKA" SH.P.K., përfaqësuar nga avokat Fredi Xhoshi, me prokurë.

SHOQËRIA "SEVAST" SH.P.K., në mungesë.

AGJENCIA E TRAJTIMIT TË PRONAVE, në mungesë.

KËSHILLI I RREGULLIMIT TË TERRITORIT, BASHKIA VLORË, në mungesë.

ZYRA VENDORE E REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, VLORË, në mungesë.

OBJEKTI: **Rihapja e procesit përpara Gjykatës Kushtetuese.**
Shfuqizimi i vendimit nr. 12, datë 09.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese.
Shfuqizimi i vendimeve nr. 580, datë 16.03.2010 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë; nr. 390, datë 23.04.2012 të Gjykatës së Apelit Vlorë; nr.

00-2017-899 (72), datë 13.06.2017 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 71/c i ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Ilir Toska, mori në shqyrtim pretendimet e kërkuesit Astrit Melit, (*kërkuesi*), i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet e subjektit të interesuar, Barjam Meminaj, i cili ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, prapësimet e subjektit të interesuar, shoqërisë "Çika" sh.p.k., e cila ka kërkuar pranimin e kërkesës, konstatoi mungesën e prapësimeve me shkrim nga subjektet e interesuara, Nikolin Kodhima, Bukurie Agaj, Meleqe Binaj, Gramoz Haxhiraj, shoqëria "Sevast" sh.p.k., Agjencia e Trajtimit të Pronave *(ATP)*, Këshilli i Rregullimit të Territorit, Bashkia Vlorë *(KRRT-ja, Vlorë)* dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë *(ZVRPP-ja, Vlorë)*, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I
Rrethanat e çështjes

1. Çështja në shqyrtim lidhet me një mosmarrëveshje pronësie për një sipërfaqe toke të ndodhur në qytetin e Vlorës, e cila, në bazë të ligjit për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve (ligji nr. 7698, datë 15.04.1993), u është njohur dhe kthyer ish-pronarëve Kodhima, sikundër po ashtu ajo i është dhënë në pronësi, si kompensim fizik, edhe trashëgimtares së ish-pronarit J.B., subjektit të interesuar Meleqe Binaj (Haxhiraj), ndërsa në vijim prona është tjetërsuar në favor të subjekteve të interesuara Bukurije Agaj dhe Gramoz Haxhiraj (djali i shtetases Meleqe

Binaj (Haxhiraj)) dhe, më tej akoma, për atë pronë është dhënë leje sheshi dhe ndërtimi për dy objekte 8 dhe 10 kate.

2. Për pronën si më lart, në vijim, kanë ngritur pretendime pronësie edhe shtetasi Xh.M., babai dhe njëherazi trashëgimlënësi i kërkuesit, sikundër edhe trashëgimtarët e M.M., një nga të cilët subjekti i interesuar Barjam Meminaj. Këta të fundit, pra babai i kërkuesit dhe subjekti i interesuar Barjam Meminaj, i janë drejtuar organit publik të ngarkuar nga ligji nr. 9235, datë 29.07.2004 me kërkesa për njohjen e së drejtës së pronësisë dhe kthimin e pronës, por kërkesat e tyre nuk janë pranuar dhe ata në vijim kanë paraqitur padi në gjykatë. Gjatë procesit gjyqësor, kur çështja ndodhej për shqyrtim në Gjykatën e Lartë, babai i kërkuesit ka ndërruar jetë, duke u zëvendësuar në proces nga kërkuesi si trashëgimtar i tij, ndërsa është kërkuesi ai që ka ndjekur në vazhdim procedurat përkatëse deri më sot. Nisur nga kjo, në vijim të arsyetimit të këtij vendimi, me qëllim shmangien e përsëritjeve të panevojshme dhe në funksion të qartësisë së tij, edhe veprimet/mosveprimet e babait të kërkuesit dhe vendimet e dhëna për kërkesat e tij do të referohen si veprime/mosveprime të kërkuesit ose si vendime të dhëna për kërkesat e tij.

3. Më konkretisht, Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave pranë Bashkisë së Vlorës *(KKKP-ja e Bashkisë së Vlorës),* me vendimin nr. 106, datë 19.06.1996 *(vendimi nr. 106/1996),* u ka njohur ish-pronarëve Kodhima, konkretisht shtetasve Xh.K., E.K., S.K. dhe Xh.K., të drejtën e pronësisë për truallin me sipërfaqe 21.392 m^2, të ndodhur në Vlorë, në lagjen "24 Maji", me kufij të përcaktuar dhe u ka kthyer në natyrë sipërfaqen 5.600 m^2. Nga ana tjetër, Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave pranë Këshillit të Rrethit Vlorë *(KKKP-ja e Këshillit të Rrethit Vlorë),* me vendimin nr. 352, datë 14.02.1997 *(vendimi nr. 352/1997),* i ka njohur ish-pronarit J.B. të drejtën e pronësisë për një sipërfaqe toke bujqësore në fshatin Sevaster, Vlorë dhe e ka kompensuar fizikisht trashëgimtaren e tij, subjektin e interesuar Meleqe Binaj (Haxhiraj), me sipërfaqen 4.800 m^2, të ndodhur në qytetin e Vlorës, në lagjen "Çole", me kufij të përcaktuar.

4. Ndërsa gjatë procesit të regjistrimit në regjistrat e pasurive të paluajtshme ka rezultuar se pronat e disponuara përmes këtyre vendimeve krijonin mbivendosje, subjekti i interesuar Meleqe Binaj (Haxhiraj), me deklaratën noteriale nr. 633/266, datë 01.03.2006, ka hequr dorë nga regjistrimi i pronës

në favor të pronarëve Kodhima, duke mbetur vetëm formalisht në fuqi vendimi nr. 352/1997 i KKKP-së së Këshillit të Rrethit Vlorë.

5. Në vijim, pronarët Kodhima, shtetasit Xh.K., E.K., S.K. dhe Xh.K., të përfaqësuar me prokurë nga subjekti i interesuar Nikolin Kodhima, me kontratën noteriale të shitblerjes nr. 2556/889, datë 31.07.2006, u kanë shitur subjekteve të interesuara Bukurije Agaj dhe Gramoz Haxhiraj një pjesë të pronës së njohur dhe kthyer me vendimin nr. 106/1996 të KKKP-së së Bashkisë së Vlorës, konkretisht sipërfaqen 2.949 m^2, e cila krijonte mbivendosje me pronën e trajtuar me vendimin nr. 352/1997 të KKKP-së së Këshillit të Rrethit Vlorë. Po në të njëjtën datë, me kontratën noteriale të shitblerjes nr. 2559/891, ata i kanë shitur subjektit të interesuar Bukurie Agaj edhe një pjesë tjetër të pronës, sipërfaqen 2.371 m^2. Në datën 24.11.2008 për këtë truall është dhënë leja e sheshit të ndërtimit dhe në vijim, në datën 23.02.2009, edhe lejet e ndërtimit për dy objekte 8 dhe 10 kate për shoqëritë subjekte të interesuara.

6. Nga ana tjetër, kërkuesi, me pretendimin se ka qenë pronar i një sipërfaqeje toke prej 7 vretenësh në vendin e quajtur "Çole", me kufij të përcaktuar, e cila i është shpronësuar në vitin 1948, i është drejtuar Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave *(AKKP)* (sot ATP-ja), Zyrës Rajonale Vlorë për njohjen e së drejtës së pronësisë dhe kthimin e saj sipas ligjit për kthimin dhe kompensimin e pronave (ligji nr. 9235, datë 29.07.2004). Po ashtu, kësaj zyre i është drejtuar edhe subjekti i interesuar Barjam Meminaj, me pretendimin se trashëgimlënësi i tij M.M. ka qenë pronar i një sipërfaqeje toke prej 4 vretenësh në lagjen "Çole", në vendin e quajtur "Kume", me kufij të përcaktuar, e cila i është shpronësuar pas vitit 1948. Këto kërkesa nuk janë pranuar nga Zyra Rajonale Vlorë me shkakun se prona e pretenduar ishte trajtuar më herët nga ish-KKKP-ja e Bashkisë Vlorë. Ankimet e paraqitura nga ata në vijim në Zyrën Qendrore të AKKP-së nuk janë shqyrtuar në afatin e parashikuar nga ligji.

7. Në këtë situatë, në datën 29.07.2008, me pretendimin se është pronar i tokës, kërkuesi i është drejtuar gjykatës me padi, duke kërkuar njohjen e tij pronar, anulimin e vendimeve të KKKP-ve respektive dhe pavlefshmërinë e të gjitha transaksioneve të bëra me pronën, krahas edhe anulimit të vendimeve për miratimin e sheshit dhe të lejes së ndërtimit për atë pronë. Për të vërtetuar të drejtën e pronësisë ai ka paraqitur si provë një dokument arkivor të vitit 1946, që përcakton madhësinë e sipërfaqes prej 7 vretenësh, në vendin e quajtur "Çole", me kufij të përcaktuar të kohës. Sipas këtij dokumenti arkivor, mbi këtë sipërfaqe toke ndodhej edhe një ndërtesë me

konstruksion çimento e gurë e me çati me tjegulla dhe kjo pronë i është shpronësuar në vitin 1948. Sipas kërkuesit, mbi themelet e ndërtesës së vjetër, pas viteve ’90, ai ka ndërtuar një ndërtesë tjetër, të cilën e përdor si punishte dhe që është në proces legalizimi. Në lidhje me ish-pronarët Kodhima, shtetasit Xh.K., E.K., S.K. dhe Xh.K., ai ka pretenduar se ata nuk ekzistojnë dhe ka qenë subjekti i interesuar Nikolin Kodhima dhe babai i tij (P.K.), ata që kanë falsifikuar dokumentet për të përfituar pronën në emër të tyre dhe për ta tjetërsuar atë më pas.

8. Gjatë gjykimit, në datën 21.05.2009, subjekti i interesuar Barjam Meminaj ka paraqitur kërkesë për ndërhyrje kryesore dhe në vijim një padi, duke kërkuar edhe ai njohjen pronarë të trashëgimtarëve të shtetasit M.M., babait të tij, krahas anulimit të vendimeve të KKKP-ve respektive dhe pavlefshmërisë së kontratave të shitblerjes, përveç edhe anulimin e vendimeve për leje sheshi dhe ndërtimi. Padia e ndërhyrësit kryesor është pranuar për shqyrtim në një gjykim të vetëm me padinë e kërkuesit.

9. Në përfundim të gjykimit, me vendimin nr. 580, datë 16.03.2010, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë ka vendosur: (a) rrëzimin e padisë së kërkuesit si të pabazuar në prova; (b) pranimin e padisë së ndërhyrësit kryesor Barjam Meminaj, duke: (i) detyruar kërkuesin dhe të paditurit Bukurie Agaj, Gramoz Haxhiraj dhe Meleqe Binaj (Haxhiraj) të njohin trashëgimtarët e M.M. pronarë të truallit me sipërfaqe 4 vreten ose 4.800 m^2, të ndodhur në Vlorë, me kufij të përcaktuar; (ii) shfuqizuar tërësisht vendimin nr. 106/1996 të KKKP-së së Bashkisë së Vlorës, si të dhënë në kundërshtim me ligjin; (iii) anuluar vendimin nr. 352/1997 të KKKP-së së Këshillit të Rrethit Vlorë; (iv) konstatuar si të pavlefshme kontratat e shitblerjes nr. 2556/889 dhe nr. 2559/891, datë 31.07.2006 dhe urdhëruar kthimin e palëve në gjendjen e mëparshme; (v) detyruar ZVRPP-në, Vlorë të çregjistrojë pasurinë në emër të të paditurve; (vi) anuluar vendimin për miratimin e sheshit të ndërtimit për truallin objekt konflikti dhe lejet e ndërtimit për të dyja objektet 8 dhe10 kate.

10. Mbi ankimin edhe të kërkuesit, Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. 390, datë 23.04.2012, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, me të njëjtën linjë arsyetimi si ajo. Kundër vendimit të gjykatës së apelit kanë paraqitur rekurs disa nga palët, përfshirë edhe kërkuesi, ndërkohë që ndërhyrësi kryesor ka paraqitur kundërrekurs.

11. Në përfundim të shqyrtimit të çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve, me vendimin nr. 00-2017-899 (72), datë 13.06.2017, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur lënien në fuqi të vendimit

të gjykatës së apelit, me arsyetimin se ai është rrjedhojë e respektimit të ligjit material dhe procedural, ndërsa në rekurset e paraqitura nuk ngrihen shkaqe për cenimin e tij.

12. Vendimet e dhëna në këtë proces gjyqësor janë kundërshtuar me ankim kushtetues individual nga kërkuesi dhe nga subjekti i interesuar Nikolin Kodhima. Për ankimin e këtij të fundit, Kolegji i Gjykatës Kushtetuese *(Gjykata),* me vendimin nr. 289, datë 20.12.2017, ka vendosur moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.

13. Ndërkohë, ankimi individual i kërkuesit është shqyrtuar nga Gjykata në seancë plenare mbi bazë dokumentesh dhe në përfundim, me vendimin nr. 12, datë 09.03.2021 (*vendimi nr. 12/2021*), është vendosur rrëzimi i kërkesës së tij.

14. Referuar arsyetimit të vendimit, Gjykata nuk e ka legjitimuar kërkuesin në lidhje me pretendimin për cenimin e *së drejtës së mbrojtjes dhe parimit të kontradiktoritetit* për argumentin e mosformimit të drejtë të ndërgjyqësisë, me arsyetimin se nuk ka provuar të drejtën e cenuar dhe interesin e tij të ligjshëm vetjak për mbrojtjen e saj. Po ashtu, Gjykata ka vlerësuar se për pretendimin e cenimit të *parimit të paanshmërisë në gjykim* kërkuesi nuk ka shteruar mjetet juridike në dispozicion, ndërsa për pretendimin e cenimit të *së drejtës së mbrojtjes dhe parimit të kontradiktoritetit,* vetëm në lidhje me argumentin se gjykata e apelit ka shtyrë shpalljen e vendimit, Gjykata ka vlerësuar se kërkuesi nuk ka arritur ta ngrejë atë në nivel kushtetues, duke mos arritur të provojë pasojat e ardhura dhe cenimin e së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor.

15. Nga ana tjetër, Gjykata ka vlerësuar se kërkuesi legjitimohet për pretendimet e tjera, duke i shqyrtuar në themel ato. Kështu, për pretendimet e kërkuesit për cenimin e *së drejtës së aksesit në gjykim, të së drejtës së mbrojtjes dhe parimit të kontradiktoritetit në gjykim* (për argumentet e tjera), si dhe të *parimit të gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj,* Gjykata ka arritur në përfundimin se ato janë të pabazuara. Kurse për sa u përket pretendimeve të kërkuesit për cenimin e *parimit të barazisë së armëve* dhe të *standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor* nuk është arritur shumica e nevojshme e votave prej 5 gjyqtarësh për bazueshmërinë ose jo në themel të tyre dhe Gjykata ka vlerësuar se kërkesa për këto pretendime konsiderohet e rrëzuar referuar nenit 73, pika 4, të ligjit nr. 8577/2000.

16. Në datën 30.07.2021 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*GJEDNJ*) (*aplikimi nr. 41373/21 Astrit Meli kundër Shqipërisë)* për shkelje të nenit 6, paragrafi 1, të Konventës Evropiane

për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*), duke pretenduar mohimin e aksesit në Gjykatë, mosdhënien e vendimit të arsyetuar nga ajo gjykatë për shkak të rrëzimit të ankimit kushtetues, sepse nuk u arrit shumica e ligjshme prej pesë gjyqtarësh, për mungesën e arsyetimit të vendimeve të gjykatave më të ulëta, barazinë e armëve dhe kohëzgjatjen e procesit gjyqësor përpara Gjykatës *(shih paragrafin 1 të vendimit të GJEDNJ-së).* Me vendimin e datës 16.07.2024, në dispozitivin e tij, GJEDNJ-ja ka shpallur të papranueshëm ankimin e kërkuesit për kohëzgjatjen e procesit gjyqësor përpara Gjykatës Kushtetuese, si dhe ka vendosur se: i) nuk ka shkelje të nenit 6, paragrafi 1, të Konventës për mungesën e pretenduar të aksesit në Gjykatën Kushtetuese; ii) ka shkelje të nenit 6, paragrafi 1, të Konventës për të drejtën e kërkuesit për vendim të arsyetuar nga Gjykata; iii) nuk ka nevojë të shqyrtojë ankimet e tjera sipas paragrafit 1 të nenit 6 të Konventës.

17. Referuar arsyetimit të vendimit, GJEDNJ-ja ka gjetur shkelje për të drejtën e kërkuesit për vendim të arsyetuar nga Gjykata, pasi kjo e fundit, për shkeljet e pretenduara të barazisë së armëve dhe për një vendim gjyqësor të arsyetuar, në vendimin e saj është kufizuar me vënien në dukje të rezultatit të votimit dhe rezultatit përfundimtar, përfshirë një të dhënë të shkurtër në shënimin fundor për mënyrën e votimit nga secili gjyqtar, por duke mos dhënë arsye për themelin e çështjes dhe për mendimet e shumicës efektive (pra, gjyqtarët që votuan për të refuzuar ankimet) ose ato të pakicës efektive (gjyqtarët që votuan në favor të pranimit të ankimeve), pra duke mos dhënë arsyet dhe shkaqet thelbësore mbi të cilat ajo gjykatë kishte dalë në ato konkluzione (*shih paragrafët 12-13 dhe 68-76 të vendimit të GJEDNJ-së).*

18. Në lidhje me korrigjimin e shkeljes së konstatuar, GJEDNJ-ja ka arsyetuar se nisur nga natyra e ankimit të kërkuesit dhe e shkeljes së gjetur, forma më e përshtatshme e dëmshpërblimit për atë shkelje do të ishte rihapja e procesit gjyqësor të brendshëm, duke evidentuar në këtë drejtim parashikimin e nenit 71(c) të ligjit për Gjykatën *(shih paragrafin 83 të vendimit të GJEDNJ-së).* Nga ana tjetër, GJEDNJ-ja ka vlerësuar se nuk ishte e nevojshme të shqyrtonte në atë moment pretendimet e kërkuesit për arsyetimin e vendimit nga gjykatat e zakonshme dhe për shkeljen e pretenduar të barazisë së armëve, duke pasur parasysh gjetjen e saj në lidhje me shkeljen e së drejtës së kërkuesit për një vendim të arsyetuar nga Gjykata Kushtetuese, pasi kërkuesi tani ka mundësi të kërkojë rihapjen e procesit përpara Gjykatës Kushtetuese, e cila aktualisht ka trupë gjyqësore të plotë me nëntë gjyqtarë dhe në parim kjo mundëson shqyrtimin e kësaj

pjese të ankimit të kërkuesit përmes një vendimi të arsyetuar si duhet të kësaj gjykate, duke qenë e hapur në vijim për të mundësia për të depozituar kërkesë të re përpara saj, sipas rastit, pas vendimmarrjes më të fundit për ankimin e tij kushtetues në nivel kombëtar *(shih paragrafët 77-78 të vendimit të GJEDNJ-së).*

19. Vendimi i GJEDNJ-së, pasi është bërë përfundimtar, është publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 191, datë 12.11.2024.

20. Në datën 16.12.2024, bazuar në nenin 71/c, pikat 3 dhe 4, të ligjit nr. 8577/2000, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me kërkesë për rihapjen e procesit të përfunduar me vendimin nr. 12/2021 të Gjykatës, duke kërkuar shfuqizimin e këtij vendimi dhe të vendimeve gjyqësore sipas objektit të saj. Kolegji i Gjykatës në datën 12.02.2025 ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve dhe thirrjen si subjekte të interesuara të palëve në procesin gjyqësor të kundërshtuar, të cilat në vijim janë njoftuar rregullisht, duke u ftuar për të paraqitur parashtrimet e tyre në lidhje me kërkesën e kërkuesit.

21. Në këtë kuadër, subjekti i interesuar, shoqëria "Çika" sh.p.k., në parashtrimet e dërguara përmes shërbimit postar në datën 31.03.2025, ka kundërshtuar procesin gjyqësor objekt i ankimit kushtetues, duke ngritur pretendime për cenimin asaj, por edhe të personave të tjerë jo palë në gjykim, të së drejtës për proces të rregullt ligjor. Gjykata, duke pasur parasysh se subjektet e interesuara thirren në gjykim në mënyrë që të kontribuojnë në shqyrtimin e çështjes që po gjykohet, në rastin konkret në lidhje me ankimin kushtetues individual të kërkuesit, si dhe në situatën kur ky subjekt i interesuar edhe pse ka qenë palë në procesin gjyqësor objekt i këtij gjykimi, nuk i është drejtuar në formë dhe në përmbajtje Gjykatës për kundërshtimin e tij me ankim kushtetues individual për sa procesi gjyqësor dhe rezultati i tij mund të kenë prekur interesat e tij, pretendimet dhe kërkimet ngushtësisht personale të paraqitura nga ky subjekt, për aq sa ato nuk lidhen dhe as kontribuojnë për çështjen në këtë gjykim, nuk u morën në konsideratë.

22. Po ashtu, ndonëse afati i caktuar nga Gjykata ka qenë deri në datën 31.03.2025, subjekti i interesuar Nikolin Kodhima, përfaqësuesi me prokurë i tij, parashtrimet me shkrim i ka depozituar në datën 16.09.2025, ditën e seancës plenare mbi bazë të dokumenteve, ndërsa seanca për më tepër kishte përfunduar. Për këtë shkak, në zbatim të nenit 38, pika 6, të ligjit nr. 8577/2000, parashtrimet e subjektit të interesuar në fjalë nuk u bënë pjesë e shqyrtimit nga Gjykata dhe ato iu kthyen atij pa veprim.

II
Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

23. ***Kërkuesi,*** në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar:

a) Për kërkesën për rihapjen e procesit:

23.1. Kërkesa plotëson kriteret e përcaktuara nga neni 71/c, pika 4, i ligjit nr. 8577/2000, pasi është paraqitur brenda afatit 4-mujor nga hyrja në fuqi e vendimit të GJEDNJ-së, referuar datës së botimit të tij në Fletoren Zyrtare, ajo përmban një përmbledhje të vendimit të GJEDNJ-së me çështjet kryesore të trajtuara dhe kërkuesi ka kërkuar shprehimisht rihapjen e procesit në Gjykatë, sikurse GJEDNJ-ja ka përcaktuar në vendimin e saj, ndërkohë që nuk mund të zbatohen parashikimet e pikës 5 të kësaj dispozite të ligjit, sepse është vetë GJEDNJ-ja që ka deleguar, sipas parimit të subsidiaritetit, shqyrtimin në themel nga Gjykata të pretendimeve substanciale të kërkuesit për gjykatat e zakonshme, thelbi i të cilave lidhet me cenimin e së drejtës së pronës private për shkak të shkeljeve të kryera nga gjykatat e zakonshme në gjykimin e çështjes së tij. Duke pasur parasysh se GJEDNJ-ja jo vetëm ka gjetur shkelje në procesin e zhvilluar nga Gjykata, por është shprehur se i takon kësaj të fundit të shqyrtojë pretendimet e kërkuesit për vendimet gjyqësore objekt kërkese, kërkohet që çështja të shqyrtohet sërish për pretendimet e ngritura në kërkesën e gjykuar me vendimin nr. 12/2021, që është gjetur nga GJEDNJ-ja si i papajtueshëm me KEDNJ-në.

b) Për themelin e çështjes:

23.2. Duke pasur parasysh se GJEDNJ-ja jo vetëm ka gjetur shkelje në procesin e zhvilluar nga Gjykata, por është shprehur se i takon kësaj të fundit të shqyrtojë pretendimet e kërkuesit për vendimet gjyqësore objekt kërkese, duke iu përmbajtur të njëjtave pretendime dhe shkaqe të parashtruara në kërkesën e parë për cenimin *e së drejtës për proces të rregullt ligjor* në drejtim të:

23.2.1. *Së drejtës së aksesit në gjykatë,* pasi gjykatat e faktit, pa e hetuar, kanë rrëzuar padinë e kërkuesit, me arsyetimin se i mungon legjitimimi aktiv dhe se dokumenti arkivor i paraqitur nga ai nuk përbën provë për ta legjitimuar atë. Ky qëndrim është i gabuar, pasi legjitimimi aktiv nuk ka

lidhje me bazueshmërinë në prova të padisë, e cila lidhet me shqyrtimin në themel të saj, gjë e cila nuk ka ndodhur.

23.2.2. *Parimit të gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj,* pasi në zbatim të urdhërimit të nenit 181 të Kodit të Procedurës Civile *(KPC)*, gjykimi në shkallë të parë nuk mund të vazhdonte aty ku ishte lënë në momentin e ndërrimit të dy gjyqtarëve, por duhej të niste nga fillimi.

23.2.3. *Parimit të paanshmërisë në gjykim,* pasi gjyqtari H.S., i cili ka marrë pjesë në shqyrtimin e çështjes në shkallë të parë, ka marrë pjesë më parë edhe në dhënien e një vendimi për vërtetimin e faktit juridik të pronësisë të një personi tjetër, ku është pranuar se prona e kërkuesit gjendet në vendin e pretenduar në padinë në shqyrtim, por megjithatë në rastin konkret ai gjyqtar është shprehur se paditësi nuk provoi ku gjendej prona e tij.

23.2.4. *Së drejtës së mbrojtjes dhe parimit të kontradiktoritetit në gjykim,* pasi ndërgjyqësia nuk është ndërtuar drejt dhe në gjykim nuk janë thirrur si palë personat që kanë të drejta mbi pasurinë objekt konflikti. Po ashtu, gjykata e shkallës së parë ka marrë vendim për vazhdimin e gjykimit në mungesë dhe nuk ka vijuar me njoftimin e palëve që nuk kanë qenë të pranishme kur janë shtyrë seancat gjyqësore. Për shkak të mosrespektimit të rregullave të njoftimit gjykata e apelit duhej të vendoste kthimin e çështjes për rigjykim, në kuptim të nenit 467 të KPC-së.

23.2.5. *Parimit të barazisë së armëve*, pasi gjykata ka ngatërruar rolin e saj me atë të ekspertit, duke disponuar me vendim vetëm atë çka ka konstatuar eksperti, pa marrë dhe administruar në cilësinë e provave shkresore akte që vërtetojnë ose rrëzojnë këto konstatime, ndërkohë që nuk është në misionin e ekspertit të vlerësojë provat ku palët mbështesin pretendimet e tyre. Kërkuesi është vënë në situatë të disfavorshme në krahasim me palën tjetër, pasi gjykatat jo vetëm që nuk kanë pranuar kërkesat e tij për paraqitjen e provave, por i kanë mohuar të drejtën që nëpërmjet gjykatës të sigurojë provat e nevojshme shkresore ose me dëshmitarë për të vërtetuar pretendimet e tij, për më tepër kur ekspertimi, i cili ka qenë prova e vetme dhe vendimtare ku gjykatat janë mbështetur

për dhënien e vendimeve, ka qenë i paplotë dhe i pasaktë. Gjykatat, qoftë edhe kryesisht, përballë pretendimeve të palëve dhe kontradiktave të dokumenteve shkresore, në zbatim të nenit 224 të KPC-së, duhet të kishin kërkuar nga organet shtetërore të dhëna për akte e dokumente që ishin të nevojshme për gjykimin. Gjykatat nuk kanë marrë parasysh pretendimet e paraqitura nga palët, ku në vlerësim të provave të paraqitura dhe në përgjigje të kërkesave të tyre, ato duhej të thërrisnin një grup ekspertësh për të saktësuar pronësinë e vjetër të paditësit, vendndodhjen e saj, por edhe të palëve të tjera në gjykim, e më pas të konkludonin. Vetëm nëse do të pranonin kërkesën për riekspertim, gjykatat do t'u krijonin mundësi kërkuesit, ashtu dhe subjekteve të interesuara për të pasur mjetet provuese të nevojshme për pretendimet e tyre. Duke mos administruar në gjykim një provë thelbësore, e cila mund të sigurohej vetëm prej tyre, si dhe duke mos i dhënë përgjigje kërkuesit lidhur me këto prova, gjykatat nuk kanë respektuar parimin e barazisë së armëve.

23.2.6. *Së drejtës për t`u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm,* pasi gjykata e apelit ka shkelur rregullat e përcaktuara në KPC, sepse ajo është tërhequr në dhomën e këshillimit për marrjen e vendimit në datën 16.03.2012, por e ka vonuar shpalljen e tij pa shkaqe të përligjura.

23.2.7. *Standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor,* pasi arsyetimi i vendimeve nga gjykatat e faktit është i mangët, përveçse alogjik dhe ato nuk u kanë dhënë përgjigje të arsyetuar pretendimeve të kërkuesit. Gjykatat i kanë mbështetur konkluzionet e tyre vetëm në përfundimet e ekspertit, i cili nuk ka arritur të përcaktojë vendndodhjen e pronës së kërkuesit, në një kohë kur eksperti, nga ana tjetër, ka arritur të përcaktojë me saktësi vendndodhjen e pronës së ndërhyrësit kryesor, megjithëse prona e këtij të fundit, sipas dokumenteve të vjetra, ka kufij tokësorë dhe kufitarë të përcaktuar, por jo moçal dhe kënetë, sikurse kufizohej pjesërisht prona e kërkuesit sipas dokumenteve të vjetra. Për sa kohë eksperti i thirrur në gjykim nuk ka mundur të përcaktojë vendndodhjen e pronës së kërkuesit, gjykatat duhet të kërkonin mendimin e një eksperti tjetër. Kjo vendndodhje do të përcaktohej lehtësisht

nga ekspertë me njohuri të posaçme, pasi pas shtetëzimit në vitin 1948, kërkuesit (babait të tij) i është lënë në pronësi sipërfaqja prej 1 vretenësh, ku aty ka ekzistuar edhe shtëpia e banimit, lehtësisht e verifikueshme në planshetat ndër vite, shtëpi kjo e transkriptuar më pas familjes P. dhe e regjistruar në regjistrin hipotekar nr. 275 të vitit 1942, fakt ky që është anashkaluar nga gjykatat, pa hetuar për gjendjen juridike të shtëpisë, kufijtë e saj të kohës dhe kufitarët përkatës, ku një pjesë e tyre ndodhen në kufijtë e kësaj prone. Gjykatat janë shprehur se kërkuesit i mungon legjitimimi aktiv, me arsyetimin se dokumenti arkivor i paraqitur nuk përbën provë për ta legjitimuar atë, ndërkohë që dokumentin arkivor për pronën e ndërhyrësit kryesor e konsideron si provë për legjitimimin e tij. Ato kanë anashkaluar dhe nuk i kanë dhënë përgjigje të arsyetuar as faktit se i padituri Nikolin Kodhima është dënuar me vendim të formës së prerë për falsifikimin e vendimit objekt padie që lidhet me kthimin e pronës. Po ashtu, ndonëse kanë konstatuar pavlefshmërinë e kontratave të shitblerjes dhe kanë anuluar aktet administrative objekt gjykimi, gjykatat nuk kanë zgjidhur pasojat e pavlefshmërisë, pra mosmarrëveshjen në gjykim, duke krijuar kështu një konflikt të ri, ndërsa mbi truallin objekt gjykimi ka dy pallate shumëkatëshe. Pavarësisht shkeljeve të lejuara gjatë procesit gjyqësor, Gjykata e Lartë i ka legjitimuar ato, duke lënë në fuqi vendimet e gjykatave të faktit. Në shtesë të këtyre, në kërkesën për rihapjen e procesit, parashtrohet edhe se gjykatat kanë legjitimuar ndërhyrësin kryesor edhe me arsyetimin se pretendimi i tij mbështetet edhe në dokumentet e kufitarëve, megjithëse ato dokumente flasin për prona që ndodhen në vende të tjera, të ndryshme nga ajo objekt gjykimi. Gjykatat, po ashtu, nuk kanë arsyetuar edhe për faktin se ndërhyrësi kryesor përpara komisionit të pronave ka pretenduar se është kufitar me Gj.E. dhe S.K., për të cilët prokuroria ka verifikuar se nuk ekzistojnë.

24. ***Subjekti i interesuar, Barjam Meminaj****,* në mënyrë të përmbledhur, ka paraqitur prapësime vetëm për themelin e çështjes, duke parashtruar si vijon:

24.1. Pretendimi për cenimin e së drejtës së aksesit nuk qëndron, pasi

kërkuesi ka ushtruar të drejtën e padisë dhe gjykatat janë shprehur me vendim përfundimtar në lidhje me të, sikundër u kanë dhënë përgjigje të gjitha pretendimeve të tij, pavarësisht se ato nuk janë parashtruar nëpërmjet mjeteve procedurale në formën e kërkuar dhe sipas afateve ligjore. Në ankimin përpara gjykatës së apelit kërkuesi ka ngritur pretendime edhe për ekspertin e caktuar nga gjykata e shkallës së parë dhe pavarësisht se ai nuk kishte ngritur pretendime të tilla dhe as kishte kërkuar përjashtimin e tij në gjykimin e çështjes në shkallë të parë, gjykata e apelit i ka shqyrtuar dhe u ka dhënë përgjigje këtyre pretendimeve, duke arsyetuar se fakti se eksperti ka arritur në përfundimin se dokumenti arkivor i kërkuesit nuk shoqërohet me hartë (skicë) dhe nuk ka të përcaktueshëm kufijtë e pronës, nuk dëshmon për pamjaftueshmëri të njohurive të posaçme ose për paaftësi profesionale të ekspertit. Po ashtu, pavarësisht pretendimeve për ekspertimin, kërkuesi nuk ka paraqitur ndonjë provë të re ose raport alternativ në mbështetje të tyre dhe të kërkesës për një ekspertim të ri, fakt që është evidentuar edhe nga GJEDNJ-ja në paragrafin 9 të vendimit të saj.

24.2. Nuk qëndron as pretendimi i kërkuesit në lidhje me parimin e gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj. Kërkuesi keqinterpreton ligjin dhe aktet e dosjes gjyqësore, sikundër me të drejtë ka arsyetuar edhe Gjykata e Lartë, si gjykatë ligji, kur edhe pse janë ndryshuar dy anëtarë të trupit gjykues, zëvendësimi i tyre është bërë në kohë të ndryshme e jo në të njëjtën seancë gjyqësore, përveçse nga ana e gjyqtarëve është deklaruar vazhdimi i gjykimit pas njohjes së tyre me përmbajtjen e procesit gjyqësor.

24.3. Kërkuesi nuk ka shteruar mjetet juridike në dispozicion në lidhje me pretendimin për cenimin e parimit të paanshmërisë për sa i përket pjesëmarrjes së gjyqtarit H.S. në gjykimin e çështjes në shkallë të parë, për sa kohë një pretendim të tillë ai nuk e ka ngritur më parë në instancat e zakonshme, ndaj ky pretendim nuk mund të merret në shqyrtim nga Gjykata.

24.4. Pretendimi i kërkuesit në lidhje me parimin e barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit në gjykim është i pabazuar. Ai ka ngritur pretendime edhe për mosformimin e drejtë të ndërgjyqësisë dhe për mosrespektimin e rregullave të njoftimit për palët në mungesë, për të cilat jo vetëm ka marrë përgjigje nga gjykatat e zakonshme,

por ai nuk legjitimohet në ngritjen e tyre për sa kohë ato nuk lidhen me të drejtat e tij, por të personave të tretë. Lidhur me pretendimet e kërkuesit për ekspertimin, sikurse u parashtrua, ato janë marrë në shqyrtim dhe gjykata e apelit u ka kthyer përgjigje. Eksperti ka pasur njohuri të posaçme dhe në përmbushje të detyrës ka dhënë mendimin e tij, ndërkohë që kërkuesi nuk ka dhënë asnjë arsye bindëse përpara gjykatës së apelit se përse duhej të bëhej një ekspertim i ri referuar nenit 229 të KPC-së, duke marrë përgjigje për kërkesën për riekspertim. Nga ana tjetër, kërkuesi nuk parashtron fakte konkrete për kërkesat që pretendon të ketë paraqitur dhe që nuk janë pranuar nga gjykatat, qoftë për marrje të provave shkresore, ashtu edhe ato me dëshmitarë. Po ashtu, ai nuk ka treguar ndonjë akt shkresor, të cilin gjykatat duhet ta kishin kërkuar, qoftë edhe kryesisht. Pra, është i pabazuar pretendimi i tij për mungesë hetimi gjyqësor të plotë e të gjithanshëm.

24.5. Nuk qëndron as pretendimi i kërkuesit në lidhje me të drejtën për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm. Ky pretendim, përveçse kontradiktor, nuk është ngritur në nivel kushtetues, duke mos provuar kërkuesi ndonjë pasojë të ardhur në të drejtën e pretenduar si të cenuar. Ndryshe nga sa ai pretendon, çështja jo vetëm ishte komplekse, por gjykata e apelit, nisur nga pretendimet e palëve, ka përsëritur shqyrtimin gjyqësor, duke ia nënshtruar debatit provat e paraqitura nga të padituri.

24.6. Edhe pretendimi i kërkuesit në lidhje me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor nuk qëndron dhe për këtë vlejnë argumentet e parashtruara edhe për pretendimin tjetër të tij për të drejtën e aksesit. Për sa i përket faktit të dënimit penal të të padituri, subjektit të interesuar Nikolin Kodhima, gjykatat kanë hetuar dhe kanë arsyetuar për paligjshmërinë e vendimit të komisionit të pronave të dhënë në favor të ish-pronarëve Kodhima dhe të veprimeve juridike të kryera më pas. Për më tepër që kërkuesi nuk ka ngritur pretendime në këtë drejtim as në ankimin përpara gjykatës së apelit, as në rekursin në Gjykatën e Lartë. Ai, po ashtu, nuk ka paraqitur asnjë provë shtesë për vendndodhjen e pronës në vendin e pretenduar, çka evidentohet dukshëm edhe në kërkesën drejtuar Gjykatës, ku nuk tregohet asnjë provë konkrete, e cila duhet të ishte dhe nuk është administruar nga gjykatat. Është i pabazuar pretendimi në lidhje me zgjidhjen e pasojave të

pavlefshmërisë së kontratave të shitblerjes dhe anulimin e akteve administrative, pasi gjykatat i kanë zgjidhur ato në përputhje me ligjin, për më tepër që kërkimet në këtë drejtim kanë qenë edhe të tijat (ndërhyrësit kryesor) dhe për sa kërkuesi pretendon ato nuk lidhen me cenimin atij të së drejtës për proces të rregullt ligjor.

24.7. Pretendimet e parashtruara nga subjekti i interesuar, shoqëria "Çika" sh.p.k, janë të pabazuara dhe kontradiktore, pasi, nga njëra anë, mbështesin kërkuesin që proceduralisht konsiderohet palë kundërshtare në procesin gjyqësor, ndërsa, nga ana tjetër, parashtrojnë argumente në mbështetje të lejes së ndërtimit (sipas kontratës së sipërmarrjes për ndërtim të lidhur me familjen Kodhima) dhënë në favor të kësaj shoqërie, mbi një pasuri, e cila, sipas hetimit dhe shqyrtimit gjyqësor në të tria shkallët e gjykimit, ka rezultuar se ishte përfituar nga persona inekzistentë dhe mbi dokumente të falsifikuara, ndërsa vendimi i KKKP-së është shfuqizuar. Shoqëria në fjalë nuk ka paraqitur asnjë argument për shkeljen asaj të të drejtave kushtetuese, për më tepër kur ajo nuk ka paraqitur më parë as ankim kushtetues individual.

25. ***Subjekti i interesuar, shoqëria "Çika" sh.p.k.,*** në mënyrë të përmbledhur, ka paraqitur prapësime vetëm për themelin e çështjes, duke parashtruar si vijon:

25.1. Pretendimi i kërkuesit për cenimin e së drejtës së aksesit qëndron, pasi gjykatat, pa hetuar, kanë rrëzuar padinë e tij, me arsyetimin se i mungon legjitimiteti aktiv në ngritjen e saj, pra pa e shqyrtuar atë në themel. Po ashtu, gjykatat nuk kanë shqyrtuar në themel as pretendimet e saj (shoqërisë "Çika" sh.p.k.) për cenimin e të drejtave nga shfuqizimi i akteve administrative, lejes së ndërtimit. Marrja e masës së sigurimit nga gjykata, në shkelje të ligjit dhe në mungesë të shoqërisë, përbën shkelje të rëndë të rregullave për formimin e ndërgjyqësisë. Të tria shkallët e gjykimit nuk e kanë gjykuar në themel çështjen, sepse nuk janë bazuar në dokumentet arkivore që disponoheshin nga palët dhe vendndodhja e pronës, sipas dokumenteve arkivore, është zhvendosur, pra prona e ndërhyrësit kryesor nuk është aty ku pretendohet dhe për këtë nuk ka pasur një hetim gjyqësor të plotë e të gjithanshëm. Harta topografike e paraqitur në gjykim nuk paraqet realitetin, sepse është ndryshuar në mënyrë të padrejtë.

25.2. Edhe pretendimi i kërkuesit për cenimin e parimit të gjykimit

nga një gjykatë e caktuar me ligj qëndron, pasi gjatë gjykimit në shkallë të parë është bërë zëvendësimi i dy gjyqtarëve të trupit gjykues, duke u lejuar kështu shkelje e rëndë procedurale në lidhje me vazhdimin e procesit aty ku ishte lënë para zëvendësimit të gjyqtarëve njëri pas tjetrit, ndërkohë që gjykimi i çështjes duhet të fillonte nga fillimi sipas parashikimit të nenit 181 të KPC-së. Kjo shkelje nuk u mor parasysh as nga gjykata e apelit, as nga Gjykata e Lartë.

25.3. Pretendimi i kërkuesit për cenimin e parimit të paanshmërisë në gjykim është i bazuar, pasi Gjykata e Lartë, si një gjykatë ligji, kishte detyrimin që në bazë të fakteve të çështjes të përcaktonte se cilat ishin normat ligjore të zbatuara gabim. Megjithatë, kjo nuk ka ndodhur dhe ajo gjykatë ka legjitimuar shkeljet e kryera nga gjykatat e faktit. Edhe pse pretendimi për cenimin e parimit të paanshmërisë është ngritur në seancë gjyqësore nga kërkuesi dhe shoqëria "Çika" sh.p.k., ai nuk u mor parasysh nga Gjykata e Lartë dhe ajo nuk u shpreh në lidhje me të.

25.4. Edhe pretendimi i kërkuesit për cenimin e parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit në gjykim qëndron, pasi gjykatat e të tria shkallëve kanë lejuar shkelje procedurale në lidhje me formimin e drejtë të ndërgjyqësisë, sepse në gjykim nuk janë thirrur palë që tërheqin të drejta mbi truallin objekt konflikti. Po ashtu, gjykatat nuk kanë administruar provat përkatëse që mund të silleshin nga palët, duke mos u dhënë përgjigje pretendimeve për provat, qoftë të kërkuesit, ashtu edhe të shoqërisë "Çika" sh.p.k.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për kërkesën për rihapjen e procesit

26. Gjykata vëren se referuar nenit 71/c, pikat 3 dhe 4, të ligjit nr. 8577/2000, nëse ajo ka vendosur më parë për një çështje, e cila është gjykuar nga një gjykatë ndërkombëtare dhe kjo e fundit ka konstatuar se janë cenuar të drejtat dhe liritë themelore të individit, si rrjedhojë e vendimit të Gjykatës, subjekti i cenuar, në favor të të cilit ka vendosur gjykata ndërkombëtare, ka të drejtë të paraqesë kërkesë për rihapjen e procesit gjyqësor, e cila paraqitet brenda 4 muajve nga hyrja në fuqi e vendimit të gjykatës ndërkombëtare. Kërkesa duhet të përmbajë një përmbledhje të

vendimit të gjykatës ndërkombëtare me çështjet kryesore që ka konstatuar ajo gjykatë, kërkimet konkrete dhe kërkuesi duhet të kërkojë shprehimisht rihapjen e procesit, si dhe shfuqizimin e aktit.

27. Gjykata thekson se çështja e legjitimimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me inicimin e një procesi kushtetues, duke mos përjashtuar edhe rastin e rihapjes së procesit sipas nenit 71/c të ligjit nr. 8577/2000. Kriteret për pranueshmërinë e kërkesës për rihapje të procesit në këtë Gjykatë, sikurse të ankimit kushtetues individual, janë të natyrës kumulative, pra ato duhet të plotësohen njëkohësisht. Prandaj, në vijim, Gjykata do të analizojë nëse kriteret ligjore të lartpërmendura plotësohen në rastin në shqyrtim.

28. Gjykata vlerëson se kërkuesi legjitimohet *ratione personae* për paraqitjen e kërkesës për rihapjen e procesit, pasi ka qenë palë në procesin kushtetues, vendimin nr. 12/2021 të të cilit e ka ankimuar përpara GJEDNJ-së. Kjo e fundit, me vendimin e datës 16.07.2024, pasi ka konstatuar shkeljen e nenit 6, paragrafi 1, të KEDNJ-së të lidhur me të drejtën për vendim të arsyetuar nga Gjykata, për sa u përket dy prej pretendimeve të tij, atyre për cenimin e parimit të barazisë së armëve dhe të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, ka vlerësuar se forma më e përshtatshme për korrigjimin e shkeljes do të ishte rihapja e procesit përpara Gjykatës, ndërsa trupa e saj tashmë është plotësuar dhe është i mundur shqyrtimi i atyre pretendimeve të kërkuesit përmes një vendimi të arsyetuar siç duhet.

29. Për sa i përket legjitimimit *ratione temporis,* në rastin e kërkesave për rihapjen e procesit, Gjykata ka pohuar se llogaritja e afatit ligjor 4-mujor fillon nga hyrja në fuqi i vendimit të gjykatës ndërkombëtare, pra nga botimi në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë, sipas nenit 71/c, pika 4, të ligjit nr. 8577/2000 *(shih vendimin nr. 67, datë 03.10.2024 të Gjykatës Kushtetuese).* Në rastin konkret, vendimi i GJEDNJ-së për çështjen Meli kundër Shqipërisë është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 191, datë 12.11.2024 dhe kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me kërkesë për rihapjen e procesit në datën 16.12.2024, pra brenda afatit ligjor 4-mujor. Për rrjedhojë, kërkuesi e përmbush edhe kriterin *ratione temporis.*

30. Lidhur me legjitimimin *ratione materiae,* Gjykata evidenton se në rastet e rihapjes së procesit, kufijtë e shqyrtimit të çështjes përcaktohen nga shkaku i rihapjes. Kjo do të thotë që kur shkaku i rihapjes së procesit ka të bëjë me një shkelje, e cila prek vetëm një pjesë të vendimit të dhënë, atëherë procesi rihapet vetëm për atë pjesë. Nga ana tjetër, në rastet e rihapjes së procesit, kërkuesi nuk mund të zgjerojë shkaqet e ankimit

kushtetues fillestar dhe as të shtojë argumente të tjera në lidhje me to. Në këtë kuptim, Gjykata vëren se kërkuesi në kërkesën për rihapjen e procesit përpara saj, ashtu si dhe në ankimin fillestar drejtuar asaj ka pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në disa aspekte të tij, përfshirë edhe për sa i përket parimit të barazisë së armëve dhe të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, për të cilat Gjykata, në vendimin e saj nr. 12/2021, ka pranuar se bëjnë pjesë në juridiksionin kushtetues dhe se ankuesi plotëson kriteret paraprake të legjitimimit.

31. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se kërkesa e kërkuesit për rihapjen e procesit është e bazuar dhe duhet të pranohet, duke shfuqizuar vendimin e saj nr. 12/2021 vetëm për atë pjesë të tij, për të cilën GJEDNJ-ja ka konstatuar shkelje nga ana e saj (Gjykatës), pra vetëm për sa Gjykata ka disponuar për rrëzimin e kërkesës (ankimit kushtetues fillestar) në lidhje me pretendimet për cenimin e parimit të barazisë së armëve dhe të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor. Për pretendimet e tjera të kërkuesit, për të cilat GJEDNJ-ja nuk ka konstatuar shkelje nga ana e Gjykatës, ato nuk mund të rimerren në shqyrtim për sa kohë Gjykata është shprehur me vendim në lidhje me to, vendim i cili për këtë pjesë ka natyrë përfundimtare *(res judicata),* ndaj këto pretendime nuk mund t'i nënshtrohen sërish kontrollit kushtetues. Në këtë pikë, Gjykata çmon të theksojë se nisur nga fuqia detyruese e vendimeve të GJEDNJ-së, e përcaktuar në nenin 46 të KEDNJ-së, detyrimi që lind në kuadër të zbatimit të vendimit të asaj gjykate në rastin konkret, konsiston vetëm në shqyrtimin e këtyre dy pretendimeve të kërkuesit, shqyrtim i cili përmbush detyrimet që rrjedhin nga Konventa për korrigjimin e shkeljes së konstatuar nga GJEDNJ-ja.

32. Për sa më lart, Gjykata në vijim do të analizojë bazueshmërinë në themel të pretendimeve të kërkuesit për cenimin e parimit të barazisë së armëve dhe të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, të parashtruara në kërkesën fillestare dhe të përsëritura edhe në kërkesën për rihapjen e procesit drejtuar asaj. Në këtë pikë, Gjykata çmon të evidentojë se disa nga argumentet e kërkuesit në lidhje me standardin e arsyetimit kanë të bëjnë, në thelb, me parimin e barazisë së armëve, ndaj do të trajtohen në këtë aspekt. Po ashtu, Gjykata çmon të evidentojë se në kërkesën për rihapjen e procesit gjyqësor, në lidhje me pretendimin e cenimit të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, në shtesë të argumenteve në ankimin kushtetues fillestar, kërkuesi ka parashtruar edhe se gjykatat e zakonshme kanë legjitimuar ndërhyrësin kryesor edhe me arsyetimin se

pretendimi i tij mbështetet edhe në dokumentet e kufitarëve, megjithëse ato dokumente flasin për prona që ndodhen në vende të tjera, të ndryshme nga ai objekt gjykimi, përveçse po ashtu ato nuk kanë arsyetuar edhe për faktin se ndërhyrësi kryesor përpara komisionit të pronave ka pretenduar se është kufitar me Gj.E. dhe S.K., për të cilët prokuroria ka verifikuar se nuk ekzistojnë. Në lidhje me këto argumente, Gjykata vëren se ato nuk ka qenë pjesë e ankimit kushtetues fillestar, prandaj pretendimi i kërkuesit për këto argumente nuk mund të merret në shqyrtim.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e parimit të barazisë së armëve

33. Kërkuesi ka pretenduar se gjykatat e faktit kanë ngatërruar rolin e tyre me të ekspertit, për sa kohë vendimet e tyre i kanë mbështetur në konstatimet e ekspertit, pa administruar në cilësinë e provave shkresore akte që vërtetojnë ose rrëzojnë këto konstatime, ndërkohë që nuk është në misionin e ekspertit të vlerësojë provat ku palët mbështesin pretendimet e tyre. Sipas tij, ai është vënë në situatë të disfavorshme në krahasim me palën tjetër, pasi gjykatat jo vetëm që nuk kanë pranuar kërkesat e kërkuesit për paraqitjen e provave, por i kanë mohuar të drejtën që nëpërmjet gjykatës të sigurojë provat e nevojshme shkresore ose me dëshmitarë për të vërtetuar pretendimet e tij, për më tepër kur ekspertimi, i cili ka qenë prova e vetme dhe vendimtare ku gjykatat janë mbështetur për dhënien e vendimeve, është i paplotë dhe i pasaktë. Gjykatat, vijon kërkuesi, qoftë edhe kryesisht, përballë pretendimeve të palëve dhe kontradiktave të dokumenteve shkresore, në zbatim të nenit 224 të KPC-së, duhet të kishin kërkuar nga organet shtetërore të dhëna për akte e dokumente që ishin të nevojshme për gjykimin. Gjykatat nuk kanë marrë parasysh pretendimet e paraqitura nga palët, ku në vlerësim të provave të paraqitura dhe në përgjigje të kërkesave të tyre, ato duhej të thërrisnin një grup ekspertësh për të saktësuar pronësinë e vjetër të kërkuesit (babait të tij), vendndodhjen e saj, por edhe të palëve të tjera në gjykim, e më pas të konkludonte. Sipas kërkuesit, për sa kohë eksperti i thirrur në gjykim nuk ka mundur të përcaktojë vendndodhjen e pronës së tij, gjykatat duhej të kërkonin mendimin e ekspertëve të tjerë me njohuri të posaçme dhe vendndodhja e pronës do të përcaktohej lehtësisht nisur nga fakti se pas shtetëzimit në vitin 1948, babait të tij i është lënë në pronësi sipërfaqja prej 1 vretenësh, ku aty ka ekzistuar edhe shtëpia e banimit, lehtësisht e verifikueshme në planshetat ndër vite, shtëpi kjo e transkriptuar më pas familjes P. dhe e regjistruar në regjistrin hipotekar nr.

275 të vitit 1942, çka është anashkaluar nga gjykatat, pa hetuar për gjendjen juridike të shtëpisë, kufijtë e saj të kohës dhe kufitarët përkatës, ku një pjesë e tyre ndodhen në kufijtë e kësaj prone. Vetëm nëse do të pranonin kërkesën për riekspertim, sipas nenit 229 të KPC-së, gjykatat do t'i krijonin mundësi kërkuesit për të pasur mjetet provuese të nevojshme për pretendimet e tij. Duke mos administruar në gjykim një provë thelbësore, e cila mund të sigurohej vetëm nga ato, si dhe duke mos i dhënë përgjigje kërkuesit lidhur me këto prova, gjykatat nuk kanë respektuar parimin e barazisë së armëve.

34. Subjekti i interesuar, Barjam Meminaj, ka prapësuar se pretendimet e kërkuesit për ekspertimin, pavarësisht se ai nuk i ka ngritur ato në gjykimin në shkallë të parë dhe as ka kërkuar përjashtimin e ekspertit, janë marrë në shqyrtim dhe gjykata e apelit u ka kthyer përgjigje, duke arsyetuar se fakti se eksperti ka arritur në përfundimin se dokumenti arkivor i paditësit nuk shoqërohet me hartë (skicë) dhe nuk ka të përcaktueshëm kufijtë e pronës, nuk dëshmon për pamjaftueshmëri të njohurive të posaçme ose për paaftësi profesionale të ekspertit. Po ashtu, vijon subjekti i interesuar, pavarësisht pretendimeve për ekspertimin, kërkuesi nuk ka paraqitur ndonjë provë të re ose raport alternativ në mbështetje të tyre dhe të kërkesës për një ekspertim të ri, fakt që është evidentuar edhe nga GJEDNJ-ja në paragrafin 9 të vendimit të saj. Edhe në ankimin e tij kushtetues kërkuesi nuk ka paraqitur ndonjë provë shtesë për vendndodhjen e pronës së pretenduar, e cila duhet të ishte dhe nuk është administruar nga gjykatat. Po sipas subjektit të interesuar, kërkuesi nuk parashtron fakte konkrete për kërkesat që pretendon të ketë paraqitur dhe që nuk janë pranuar nga gjykatat, qoftë për marrje të provave shkresore, ashtu edhe ato me dëshmitarë. Po ashtu, ai nuk ka treguar ndonjë akt shkresor, të cilin gjykatat duhet ta kishin kërkuar, qoftë edhe kryesisht, duke qenë i pabazuar pretendimi i tij për mungesë hetimi gjyqësor të plotë e të gjithanshëm.

35. Subjekti i interesuar, shoqëria "Çika" sh.p.k., duke mbështetur pretendimin e kërkuesit, ka parashtruar se gjykatat nuk kanë administruar provat përkatëse që mund të silleshin nga palët dhe nuk u ka dhënë përgjigje pretendimeve të kërkuesit në lidhje me provat.

36. Për sa i takon parimit të barazisë së armëve, Gjykata është shprehur se ai nënkupton se çdokush që është palë në proces duhet të ketë mundësi të barabarta që të paraqesë çështjen e tij dhe se asnjë palë nuk duhet të gëzojë avantazh të konsiderueshëm ndaj palës tjetër, por duhet të përcaktohet një ekuilibër i drejtë mes tyre. Nëse nuk do të ekzistonte barazia e armëve, atëherë argumentet e njërës palë do të prevalonin mbi argumentet e palës

së cenuar dhe, për rrjedhojë, e drejta për të marrë pjesë në gjykim do të zhvishej nga funksioni i saj kushtetues për të garantuar një proces të rregullt ligjor. Bazuar në këto parime, Gjykatës i dalin një sërë detyrash, mes të cilave rëndësi të veçantë merr krijimi i mundësive të barabarta për pjesëmarrjen e palëve ose përfaqësuesve të tyre në proces, si dhe mundësia e deklarimit të tyre për faktet, provat dhe vlerësimet ligjore që janë të lidhura ngushtë me çështjen që shqyrtohet në gjykatë *(shih vendimet nr. 19, datë 01.04.2021; nr. 21, datë 20.03.2017 të Gjykatës Kushtetuese).*

37. Mbi bazën e këtyre standardeve dhe nisur nga pretendimet e kërkuesit, Gjykata do të verifikojë nëse atij i janë krijuar mundësi të barabarta për paraqitjen e provave, si dhe për të parashtruar deklarimet e tij për faktet, provat dhe vlerësimet ligjore për çështjen.

38. Referuar akteve të dosjes gjyqësore të administruar për qëllime të gjykimit kushtetues, Gjykata konstaton fillimisht se kërkuesi është përfaqësuar me avokatë në të gjitha shkallët e gjykimit. Në gjykimin e çështjes në shkallë të parë ai ka parashtruar kërkesa për marrjen e provave shkresore, të cilat janë pranuar nga gjykata dhe ajo ia ka nënshtruar shqyrtimit gjyqësor të gjitha provat e paraqitura nga ai. Nuk konstatohet që ajo gjykatë të ketë refuzuar ndonjë kërkesë të tij për marrje të provës, me përjashtim të asaj që konsistonte në marrjen nga gjykata të akteve të dosjes penale në ngarkim të të padituri, subjektit të interesuar Nikolin Kodhima dhe të akteve të dosjes së AKKP-së që i përkiste ndërhyrësit kryesor Barjam Meminaj. Për këtë kërkesë, ajo gjykatë, me vendim të ndërmjetëm të datës 25.11.2009, është shprehur se kërkuesi duhej t'u drejtohej më parë atyre organeve dhe nëse ato nuk ia vinin në dispozicion aktet e kërkuara, mund t'i kërkonte gjykatës marrjen e tyre. Pas kësaj kërkuesi nuk i ka parashtruar gjykatës ndonjë kërkesë tjetër në këtë drejtim.

39. Në lidhje me provën e ekspertimit topografik, Gjykata konstaton se ajo është marrë nga gjykata e shkallës së parë mbi kërkesën e ndërhyrësit kryesor, subjektit të interesuar Barjam Meminaj. Për ekspertin e caktuar nga gjykata, asnjë nga palët fillimisht nuk ka ngritur pretendime, ndërkohë që kërkuesi është shprehur kundër edhe një kërkese të bërë në vijim të gjykimit nga një prej të padituve, për përjashtimin e ekspertit dhe që motivohej mbi pretendime rreth përmbushjes së detyrës nga ai. Për sa u përket detyrave të ekspertimit, kërkuesi ka kërkuar që eksperti të aplikonte (përcaktonte) në terren vetëm pronën e palës kundërshtare (ndërhyrësit kryesor), sipas dokumentit arkivor të saj. Megjithatë, duke mbajtur në konsideratë edhe kërkesat e palëve të tjera, gjykata i ka caktuar ekspertit

edhe një tërësi detyrash të tjera që konsistonin në aplikimin në terren të pronës për të gjitha palët ndërgjyqëse, sipas dokumentacionit të paraqitur nga ato. Përpara përgatitjes së aktit të ekspertimit, eksperti ka parashtruar në gjykim se nuk mund të aplikonte në terren pronat e palëve ndërgjyqëse bazuar vetëm në ato dokumente që ato kishin depozituar deri në atë kohë, ndaj nevojiteshin dokumente të tjera shtesë. Kërkuesi ka kërkuar kohë për paraqitjen e provave të tjera, megjithatë ai në vijim nuk ka paraqitur të tilla dhe eksperti ka përgatitur aktin e ekspertimit të datës 21.10.2009. Pas kësaj, kërkuesi ka paraqitur disa prova shkresore, të cilat, sipas tij, bënin fjalë për pronën e kufitarit. Ato prova janë pranuar nga gjykata, e cila ka urdhëruar ekspertin të plotësojë aktin e ekspertimit dhe ai në vijim ka përgatitur aktin e ekspertimit shtesë të datës 17.11.2009.

40. Gjatë debatit gjyqësor për aktin e ekspertimit topografik, në seancën gjyqësore të datës 25.11.2009 kërkuesi ka shprehur kundërshtime për përfundimet e ekspertimit vetëm në lidhje me aplikimin në terren të pronës së palës kundërshtare, të ndërhyrësit kryesor Meminaj dhe të pronës së familjes Kodhima, ndërkohë që nuk ka pasur pyetje për ekspertin. Nga ana tjetër, eksperti u ka dhënë përgjigje me shkrim pyetjeve të palëve të tjera. Pas kësaj, kërkuesi nuk ka parashtruar ndonjë koment ose kërkesë në lidhje me ekspertimin, ndërsa në seancën gjyqësore të datës 04.03.2010 ka kërkuar dhënien fund të shqyrtimit gjyqësor. Edhe në pretendimet përfundimtare me shkrim ai nuk ka parashtruar ndonjë vërejtje ose objeksion, qoftë në lidhje me procesin gjyqësor dhe respektimin e të drejtave të tij procedurale, ashtu edhe për përfundimet e ekspertimit topografik, të cilave as nuk iu është referuar. Duke konsideruar të provuar pronësinë e tij mbi pronën objekt gjykimi, në bazë të dokumentit arkivor të vitit 1946, sikundër edhe në padinë fillestare dhe në parashtrimet e bëra gjatë procesit, kërkuesi është përqendruar kryesisht në paligjshmërinë e akteve të dhëna në favor të të paditurve dhe të veprimeve juridike mes tyre.

41. Në vijim, Gjykata konstaton se në ankimin e paraqitur fillimisht kundër vendimit të gjykatës së shkallës së parë kërkuesi ka ngritur pretendime vetëm për vlerësim të gabuar të provave dhe interpretim të keq të ligjit, duke përsëritur në fakt ato çka kishte parashtruar në pretendimet përfundimtare përpara gjykatës së shkallës së parë. Në vijim, ai ka paraqitur një shtesë ankimi, duke ngritur pretendime për shkelje procedurale të lejuara nga gjykata e shkallës së parë në drejtim të mungesës së juridiksionit gjyqësor për padinë e ndërhyrësit kryesor ose për mungesën e një kërkimi në padinë e këtij të fundit për kundërshtimin e vendimit të AKKP-së që

kishte rrëzuar kërkesën e tij për njohjen e pronësisë, si dhe për mungesën e njoftimit për Avokaturën e Shtetit. Po ashtu, ai ka pretenduar edhe pabazueshmërinë në ligj dhe në prova të vendimit të gjykatës së shkallës së parë për pranimin e padisë së ndërhyrësit kryesor, duke pretenduar falsitetin e dokumenteve të paraqitura nga ky i fundit, shkak për të cilin ka kërkuar edhe përsëritjen e hetimit gjyqësor, rimarrjen nga gjykata e apelit të provave të administruara në gjykimin në shkallë të parë, por edhe të provave të reja, por pa treguar ndonjë të tillë. Në veçanti, kërkuesi ka kërkuar rivlerësimin e aktit të ekspertimit topografik dhe urdhërimin e një ekspertimi të ri, duke ngritur pretendime për përcaktimin, vendosjen në terren të pronës së ndërhyrësit kryesor, duke u shprehur po ashtu se për këtë arsye eksperti duhej të ripyetej.

42. Në gjykimin e çështjes në apel, në seancën e parë gjyqësore të zhvilluar (të datës 28.10.2011), në kërkesat paraprake, vetëm një nga të paditurit ka kërkuar përsëritjen pjesërisht të hetimit gjyqësor, duke kërkuar administrimin si prova të disa akteve shkresore, ndërsa seanca është shtyrë me kërkesë të kërkuesit për t'u njohur me ato prova. Në seancën e zhvilluar të radhës (të datës 16.03.2012), asnjë nga palët nuk ka paraqitur kërkesa të tjera për prova dhe gjykata i ka ftuar ato për parashtrimet përfundimtare. Nga ana e tij, kërkuesi ka kërkuar prishjen e vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe dërgimin e çështjes për rigjykim, duke pretenduar, ndër të tjera, edhe se hetimi gjyqësor nga gjykata e shkallës së parë nuk ka qenë i plotë. Pas parashtrimit nga palët të pretendimeve përfundimtare, gjykata e apelit është tërhequr për vendim dhe në vijim e ka shpallur atë, duke lënë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë.

43. Gjykata konstaton po ashtu se kërkuesi ka paraqitur rekurs, duke kërkuar prishjen e vendimeve të gjykatave më të ulëta dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në gjykatën e shkallës së parë, ndër të tjera, edhe me pretendimet se gjykatat kanë vlerësuar keq provat veçanërisht ekspertimin topografik dhe se ato nuk kanë kryer një hetim të plotë e të gjithanshëm, me të njëjtat argumente, si në parashtrimet përfundimtare përpara gjykatës së apelit. Gjykata e Lartë e ka gjykuar çështjen në seancë publike në prani të palëve dhe në përfundim ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së apelit, me arsyetimin se gjykatat më të ulëta kanë hetuar në mënyrë të plotë dhe të gjithanshme për provat dhe pretendimet e palëve ndërgjyqëse, duke arritur në përfundime bazuar në provat e administruara në gjykim, të cilat janë analizuar në tërësinë e tyre. Ajo gjykatë, ndërsa ka marrë në analizë në mënyrë të veçantë pretendimet për juridiksionin gjyqësor

dhe formimin e trupit gjykues, për pretendimet e tjera të parashtruara në rekurset e palëve ndërgjyqëse, përfshirë edhe në atë të kërkuesit, ka vlerësuar se ato lidhen kryesisht me vlerësimin e provave, të cilat i janë nënshtruar hetimit gjyqësor në të dyja shkallët e gjykimit, ndaj si të tilla ato pretendime dilnin jashtë natyrës së gjykimit nga ana e saj.

44. Nga sa më sipër, Gjykata vëren se gjykata e shkallës së parë, ndryshe nga sa kërkuesi pretendon, ka pranuar çdo kërkesë të tij për prova, duke administruar në gjykim të gjitha provat shkresore të paraqitura nga ai. Ndërkohë, nuk ka nga ai ndonjë kërkesë për marrjen e provës me dëshmitarë. Për kërkesën e tij për marrjen nga gjykata pranë organeve shtetërore të disa provave shkresore që kishin lidhje me të paditurit dhe ndërhyrësin kryesor, gjykata ka arsyetuar se kërkuesi duhej t'i drejtohej më parë atyre organeve dhe nëse ato nuk ia vinin në dispozicion aktet, mund t'i kërkonte asaj marrjen e tyre, ndërkohë që në vijim ai nuk i ka parashtruar gjykatës ndonjë kërkesë tjetër në këtë drejtim. Në lidhje me ekspertimin topografik nuk rezulton që kërkuesi të këtë kërkuar marrjen e një prove të tillë dhe as të ketë kërkuar riekspertim në gjykimin në shkallë të parë. Një kërkesë e tillë është paraqitur nga ai në ankimin (shtesë) në gjykatën e apelit, me argumentet se eksperti kishte gabuar në përcaktimin, vendosjen në terren të pronës së ndërhyrësit kryesor, arsye për të cilën ai duhej të ripyetej. Megjithatë, në gjykimin në apel kërkuesi nuk ka kërkuar nga gjykata përsëritjen e hetimit gjyqësor dhe rimarrjen e provës së ekspertimit topografik dhe as pyetjen e ekspertit që kishte përgatitur aktin e ekspertimit në gjykimin në shkallë të parë. Ai është mjaftuar vetëm me paraqitjen e vërejtjeve të tij për ekspertimin në parashtrimet përfundimtare, në funksion të kërkesës për prishjen e vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe dërgimin asaj të çështjes për rigjykim.

45. Në lidhje me argumentin e kërkuesit se gjykatat e faktit, qoftë edhe kryesisht, duhet të kishin kërkuar nga organet shtetërore të dhëna dhe akte që ishin të nevojshme për gjykimin, referuar nenit 224 të KPC-së, Gjykata vëren se ky argument i kërkuesit dhe përmbajtja e asaj dispozite ligjore nuk duket se kanë të bëjnë me ndonjë të drejtë procedurale të palëve, e cila, nga ana tjetër, të jetë cenuar për shkak të qëndrimit joaktiv të mbajtur nga gjykatat për të kërkuar dhe administruar në gjykim prova që mbështesnin ose jo pretendimet e palëve. Për më tepër, ndërsa nuk është në rolin e gjykatës të veprojë në mënyrë aktive në këtë drejtim, por iu takon palëve barra e provës për të provuar pretendimet e tyre, kërkuesi nuk tregon ndonjë kontradiktë në provat dokumentare të palëve, për sheshimin e të

cilave gjykatat e faktit duhet të kishin ndërhyrë në kuptim të dispozitës ligjore të referuar nga ai (kërkuesi).

46. Gjykata vëren po ashtu se edhe argumenti i kërkuesit se gjykatat e faktit duhej që kryesisht të thërrisnin një grup ekspertësh për të saktësuar vendndodhjen e pronës së tij, por edhe të palëve të tjera në gjykim, nuk duket se ka të bëjë me ndonjë të drejtë procedurale të tij, e cila të jetë cenuar nga ato gjykata për shkak se nuk kanë vlerësuar nevojën për përsëritjen e ekspertimit topografik. Për më tepër, përsëritja e ekspertimit, referuar nenit 229 të KPC-së, mund të urdhërohet nga gjykata në hipotezat kur ai është i metë ose i paqartë apo kur ka ndryshim mendimesh midis ekspertëve. Ndërsa hipoteza e dytë as nuk shtrohet për diskutim, për hipotezën e parë kërkuesi nuk del të ketë parashtruar arsye të qenësishme për të meta ose paqartësi të ekspertimit të realizuar në gjykimin në shkallë të parë, qoftë në gjykimin në këtë shkallë, ashtu edhe përpara gjykatës së apelit. Sikurse ka prapësuar edhe subjekti i interesuar Barjam Meminaj, por edhe GJEDNJ-ja ka evidentuar në vendimin e saj *(shih paragrafin 9 të vendimit të GJEDNJ-së),* kërkuesi nuk ka paraqitur ndonjë provë të re ose ekspertim alternativ, qoftë në gjykatën e shkallës së parë, ashtu edhe në gjykatën e apelit, për të mbështetur kundërshtimet e tij për ekspertimin e realizuar në shkallë të parë, por edhe kërkesë për kryerjen e një ekspertimi të ri. Për më tepër, në gjykimin në shkallë të parë, kërkuesi as nuk ka kundërshtuar ekspertimin në lidhje me konkluzionet e arritura për pronën e pretenduar nga ai dhe as ka pretenduar nevojën për një ekspertim të ri. Argumenti i kërkuesit se gjykatat duhej të kërkonin mendimin e një eksperti tjetër për sa kohë eksperti i caktuar nuk ka mundur të përcaktojë vendndodhjen e pronës së tij, nuk duket i arsyeshëm në kontekst të rrethanave të çështjes. Sikurse gjykatat kanë pranuar, eksperti nuk ka mundur të përcaktojë vendndodhjen e pronës së kërkuesit jo për mungesë të njohurive të posaçme, por për shkak të mungesës të të dhënave konkrete dhe të mjaftueshme për kufijtë e pronës në aktin (dokumentin arkivor të vitit 1946) ku ai ka bazuar pretendimin për të drejtën e pronësisë, por edhe në aktet e tjera dokumentare të paraqitura nga ai.

47. Gjykata po ashtu vëren se në parashtrimet përfundimtare përpara gjykatës së apelit, kërkuesi ka pretenduar edhe se prona e tij ka qenë lehtësisht e përcaktueshme, pasi aty ka ekzistuar edhe shtëpia e banimit e regjistruar në regjistrat hipotekarë të vitit 1942 dhe që është transkriptuar më vonë në emër të familjes P., duke qenë ajo e verifikueshme në planshetat ndër vite. Megjithatë, gjatë gjithë gjykimit në vijimësi ai ka pretenduar se referuar

dokumentit arkivor të vitit 1946, pas shpronësimit në vitin 1948, i është lënë në pronësi një sipërfaqe toke prej 1 vretenësh, ku ndodhej edhe një ndërtesë me konstruksion çimento e gurë e me çati me tjegulla, mbi themelet e së cilës, pas viteve `90, ka ndërtuar një ndërtesë tjetër që është në proces legalizimi. Gjithsesi, dokumenti për regjistrimin hipotekar në fjalë është administruar si provë në gjykimin e çështjes në shkallë të parë dhe ai flet për pronësinë e dy vëllezërve Meli (shtetasve T. dhe B.) për një shtëpi në lagjen "Varosh", në vendin e quajtur "Kume", me kufij: veri - kanali; lindje - i zoti; jugu - udha; perëndimi - prona e shtetasit T.K. Kjo provë nuk përmendet dhe analizohet në mënyrë specifike në aktin e ekspertimit topografik, megjithatë nuk konstatohet që kërkuesi të ketë ngritur pretendime në këtë drejtim dhe as të ketë debatuar për të dhënat që ajo provë sillte në raport me të drejtën e pronësisë për pronën objekt kërkimi në padinë e tij. Ai i është referuar kësaj prove vetëm në parashtrimet përfundimtare përpara gjykatës së apelit, ndërsa kishte përfunduar hetimi gjyqësor edhe në atë shkallë gjykimi. Gjithsesi duket se edhe kjo provë i është nënshtruar vlerësimit nga gjykatat e faktit, të cilat duke pranuar se e vetmja provë dokumentare e kërkuesit që sjell të dhëna për të drejtën e tij të pronësisë është dokumenti arkivor i vitit 1946, kanë vlerësuar se çdo provë tjetër dokumentare e tij nuk sjell të dhëna të tilla për pronën objekt kërkimi në padinë e tij. Në këtë kuptim, argumenti në fjalë i kërkuesit, në thelb, duket se ka të bëjë me mënyrën e vlerësimit nga gjykatat e zakonshme të kësaj prove. Për rrjedhojë, për sa kohë që prova në fjalë është administruar në gjykim, vetëm fakti se gjykatat e zakonshme kanë vlerësuar se të dhënat që ajo sjell nuk provojnë të drejtën e pronësisë së kërkuesit për pronën objekt kërkimi në padinë e tij, nuk mund të mbështesë pretendimin e tij për cenimin e parimit të barazisë së armëve.

48. Gjykata vëren, gjithashtu, se edhe argumenti i kërkuesit se gjykata ka ngatërruar rolin e saj me atë të ekspertit, duke disponuar me vendim vetëm për atë çka eksperti ka konstatuar, nuk mund të shërbejë për të vënë në dyshim respektimin e parimit të barazisë së armëve, për më tepër që edhe në thelb ky argument është i pabazuar. Ekspertimi është provë në procesin civil dhe është gjykata që e vlerëson atë të lidhur dhe në harmoni edhe me provat e tjera. Ndaj vetëm fakti që gjykatat e zakonshme kanë pranuar konstatimet e aspektit teknik të ekspertit, pra pamundësinë teknike për përcaktimin e vendndodhjes së pronës së kërkuesit për ato prova të paraqitura prej tij, nuk nënkupton se ato kanë ngatërruar rolin e tyre me atë të ekspertit, por se gjykatat e faktit nuk kanë pasur ndonjë arsye të qenësishme për të mbajtur një qëndrim të kundërt me të.

49. Nën dritën e rrethanave të mësipërme, Gjykata vlerëson se kërkuesit i janë krijuar mundësi të barabarta për të paraqitur prova dhe për të parashtruar deklarimet e tij për faktet, provat dhe vlerësimet ligjore për çështjen. Për rrjedhojë, pretendimi i tij për cenimin e parimit të barazisë së armëve është i pabazuar[1].

B.2. Për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor

50. Kërkuesi ka pretenduar se arsyetimi i vendimeve nga gjykatat e faktit është i mangët, përveçse alogjik dhe ato nuk u kanë dhënë përgjigje të arsyetuara pretendimeve të tij. Gjykatat, shprehet ai, i kanë mbështetur konkluzionet e tyre vetëm në përfundimet e ekspertit, i cili, nga njëra anë, nuk ka arritur të përcaktojë vendndodhjen e pronës së tij, në një kohë kur eksperti, nga ana tjetër, ka arritur të përcaktojë me saktësi vendndodhjen e pronës së ndërhyrësit kryesor, megjithëse prona e këtij të fundit, sipas dokumenteve të vjetra, ka kufij tokësorë dhe kufitarë të përcaktuar, por jo moçal dhe kënetë, sikurse kufizohej pjesërisht prona e tij sipas dokumenteve të vjetra. Po sipas kërkuesit, gjykatat, nga njëra anë, janë shprehur se dokumenti arkivor nuk përbën provë për legjitimimin e tij në ngritjen e padisë, ndërkohë që, nga ana tjetër, kanë konsideruar se dokumenti arkivor i ndërhyrësit kryesor përbën provë për legjitimimin e tij. Gjykatat, vijon kërkuesi, kanë anashkaluar dhe nuk i kanë dhënë përgjigje të arsyetuar as faktit se i padituri Nikolin Kodhima është dënuar me vendim të formës së prerë për falsifikimin e vendimit objekt padie që lidhet me kthimin e pronës. Gjithashtu, sipas kërkuesit, ndonëse gjykatat kanë konstatuar pavlefshmërinë e kontratave të shitblerjes dhe kanë anuluar aktet administrative objekt gjykimi, ato nuk kanë zgjidhur pasojat e pavlefshmërisë, pra mosmarrëveshjen në gjykim, duke krijuar kështu një konflikt të ri, ndërsa mbi truallin objekt gjykimi ka dy pallate shumëkatëshe. Pavarësisht shkeljeve të lejuara gjatë procesit gjyqësor, shprehet kërkuesi, Gjykata e Lartë i ka legjitimuar ato, duke lënë në fuqi vendimet e gjykatave të faktit.

[1] Gjyqtarja Sonila Bejtja votoi për pranimin e këtij pretendimi, me arsyetimin se kërkuesit nuk iu krijuan mundësitë e barabarta për të paraqitur prova në drejtim të aktit të ekspertimit. Kjo gjë e ka vendosur atë në pozita jo të barabarta me palët ndërgjyqëse lidhur me fuqinë provuese të provave në përcaktimin e fakteve të mosmarrëveshjes, si dhe ka bërë të mundur që vendimet gjyqësore të lënë në thelb paqartësinë dhe pamundësinë e paraqitjes së një akti ekspertimi nga ana e tij, gjë që do të bënte të mundur zgjidhjen e një rasti të pazgjidhshëm, ndryshe nga sa duhet të garantojë një gjykim i drejtë në respektim të parimit të barazisë së armëve.

51. Subjekti i interesuar, Barjam Meminaj, ka prapësuar se gjykatat e faktit i kanë dhënë përgjigje të arsyetuar pretendimeve të kërkuesit. Gjykatat kanë arsyetuar edhe në lidhje me provën e ekspertimit. Edhe për faktin e dënimit penal të të padituri Nikolin Kodhima, gjykatat kanë hetuar dhe kanë arsyetuar për paligjshmërinë e vendimit të komisionit të pronave në favor të ish-pronarëve Kodhima dhe të veprimeve juridike të kryera më pas, gjë për të cilën, për më tepër, kërkuesi nuk ka ngritur pretendime as në ankimin përpara gjykatës së apelit, as në rekursin në Gjykatën e Lartë. Po sipas këtij subjekti, është i pabazuar edhe pretendimi i kërkuesit në lidhje me zgjidhjen e pasojave të pavlefshmërisë së kontratave të shitblerjes dhe anulimin e akteve administrative, ndërsa gjykatat i kanë zgjidhur ato në përputhje me ligjin, për më tepër që kërkimet në këtë drejtim kanë qenë edhe të tijat (subjektit të interesuar) dhe për sa kërkuesi pretendon ato nuk lidhen me cenimin atij të së drejtës për proces të rregullt ligjor.

52. Gjykata ka theksuar se e drejta për proces të rregullt ligjor, që i garantohet individit nga neni 42 i Kushtetutës, përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, i cili përkon edhe me detyrimin e gjykatave për të arsyetuar vendimet, sipas nenit 142, pika 1, të Kushtetutës. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i drejtësisë së vendimeve (*shih vendimet nr. 16, datë 16.03.2021; nr. 45, datë 03.07.2017 të Gjykatës Kushtetuese).* Në këtë drejtim, Gjykata ka pohuar se funksioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve se ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Vendimi gjyqësor në çdo rast duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje dhe në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre dhe të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie ose kontradiktë të hapur ose të fshehtë. Arsyetimi duhet domosdoshmërisht të plotësojë kriteret minimale ligjore të përcaktuara dhe të mos ketë të meta të tilla serioze që cenojnë standardin e vendimit gjyqësor të arsyetuar. Zbatimi i këtij parimi është vlerësuar nga Gjykata rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsyetimin e vendimeve të tyre *(shih vendimet nr. 16, datë 16.03.2021; nr. 45, datë 03.07.2017; nr. 12, datë 19.03.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

53. Nga ana tjetër, Gjykata ka pohuar se është detyrë e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm të vlerësojnë faktet dhe provat e administruara, si dhe të interpretojnë ligjin për qëllim të procesit gjyqësor që ato zhvillojnë,

ndërsa detyra e saj është të vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese. Gjykata nuk vepron si shkallë e katërt gjykimi, por ajo ndërhyn atëherë kur gabimi ligjor ose faktik nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është aq i dukshëm, sa një gjykatë e arsyeshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë (*shih vendimet nr. 64, datë 01.10.2024; nr. 59, datë 14.11.2023; nr. 33, datë 14.11.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

54. Mbi bazën e standardeve të mësipërme dhe nisur nga pretendimet e kërkuesit, Gjykata do të verifikojë nëse vendimet e gjykatave të zakonshme plotësojnë standardet kushtetuese të arsyetimit në drejtim të përcaktimit të fakteve të çështjes dhe zbatimit të ligjit dhe nëse ky përcaktim nga ato i fakteve dhe zbatimit të ligjit në vijim është dukshëm i gabuar, sa një gjykatë e arsyeshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë.

55. Gjykata vëren se gjykata e shkallës së parë ka vendosur rrëzimin e padisë së kërkuesit për njohjen pronar dhe kërkimet e tjera të ndërvarura, me arsyetimin se ai nuk arriti të provojë legjitimimin aktiv, interesin e ligjshëm në ngritjen e padisë, për sa kohë nuk provoi që vendndodhja e pronës së tij ishte pikërisht në vendin e pronës objekt kërkimi në padi. Sipas gjykatës, prova e vetme e paraqitur nga ai për të provuar të drejtën e pronës ishte dokumenti arkivor i vitit 1946, që bënte fjalë për një pronë prej 7 vretenësh, në vendin e quajtur "Çole", i cili specifikonte kufijtë e saj dhe konkretisht: veriu - rrugë këmbësorësh; lindje - baçe e shtetasit Sh.S.; jugu - moçal dhe kënetë; perëndimi - kënetë, nga e cila 1 vreten i ishte lënë të zotit, por ky dokument nuk shoqërohej me hartë (skicë). Po sipas gjykatës, për të përcaktuar vendndodhjen e pronës së kërkuesit në gjykim u thirr edhe një ekspert, por ai nuk arriti ta përcaktonte atë në mungesë të hartës (skicës) së pronës për të cilën bënte fjalë dokumenti arkivor dhe në mungesë të ndonjë dokumenti grafik të pronës së kufitarit (shtetasit Sh.S.), ndërkohë që për kufijtë moçal dhe kënetë të pronës, eksperti sqaroi se zona e Çoles ka qenë e gjitha e tillë (moçal dhe kënetë) sipas hartës së vitit 1937 dhe në këtë hartë nuk përcaktohej qartë kufiri midis moçalit dhe tokës. Po sipas ekspertit, edhe sipërfaqja prej 1 vretenësh e lënë pronarit nuk ishte e përcaktuar, për ta vlerësuar në raport me pjesën tjetër të pronës.

56. Nga ana tjetër, gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar se ndërhyrësi kryesor, subjekti i interesuar Barjam Meminaj, arriti të provojë legjitimimin aktiv, interesin e ligjshëm në ngritjen e padisë. Sipas gjykatës, për të provuar të drejtën e pronës ai paraqiti një dokument arkivor të vitit 1948 që bënte fjalë për një pronë prej 4 vretenësh, në lagjen "Çole", në vendin e quajtur "Kume", i cili specifikonte kufijtë e saj dhe konkretisht: veriu -

çairet e shtetasve M.Gj. dhe H.K.; lindja - udhë; jugu - prona e shtetasit Sh.V. dhe çaire belik; perëndimi - çairet e shtetasit S.I. dhe moçal. Ky dokument, sipas gjykatës, nuk shoqërohej me hartë (skicë) të pronës, por ndërhyrësi kryesor paraqiti si prova shkresore dokumente të kufitarëve të pronës, bazuar në të cilat eksperti arriti në përfundimin se prona e tij ndodhej pikërisht në vendin ku familjeve Kodhima dhe Binaj u ishte kthyer prona me vendimet përkatëse të komisioneve të pronave, pronë kjo që pas transaksioneve të kryera zotërohej nga të paditurit, subjektet e interesuara Bukurije Agaj dhe Gramoz Haxhiraj dhe ku aktualisht shoqëritë e paditura po kryenin punime për ndërtimin e pallateve 8 dhe 10 kate. Mbi këtë bazë, ajo gjykatë ka arritur në përfundimin se ndërhyrësi kryesor ka provuar të drejtën e pronësisë për pronën objekt gjykimi. Nisur nga kjo, por edhe se vendimi i KKKP-së së Bashkisë Vlorë për njohjen dhe kthimin e pronës në favor të familjes Kodhima është nxjerrë mbi kërkesë të personave inekzistentë dhe, në veçanti, duke u mbështetur në dokumente të falsifikuara, ky vendim është absolutisht i pavlefshëm dhe për këtë arsye janë absolutisht të pavlefshme edhe transaksionet për shitjen e pronës më pas, por edhe aktet administrative për dhënien e lejes së sheshit dhe asaj të ndërtimit. Po sipas gjykatës, edhe vendimi i KKKP-së së Këshillit të Rrethit Vlorë, përveç faktit që mund të mos jetë lëshuar nga ai komision, pasi nuk gjendet në arkivën e tij, është nxjerrë në kundërshtim të hapur me ligjin, sipas të cilit procesi i kompensimit fizik do të kryhej vetëm pas përfundimit të procesit të kthimit në natyrë të pronës për të gjithë ish-pronarët.

57. Çështja në vijim është shqyrtuar nga gjykata e apelit edhe mbi ankimin e kërkuesit, ndërsa ajo ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, me të njëjtën linjë arsyetimi si ajo. Për përfundimin e mungesës së legjitimimit aktiv të kërkuesit, gjykata e apelit ka arsyetuar se gjatë procedimit administrativ nga Zyra Rajonale e AKKP-së në lidhje me kërkesën e tij, ka rezultuar se sipërfaqja e pretenduar mbivendosej plotësisht me pronën e njohur me vendimin nr. 4, datë 23.03.2007 të Zyrës Rajonale Vlorë, dhënë në favor të subjektit të shpronësuar M.Sh. dhe se kërkuesi, në një proces gjyqësor paralel, ka kërkuar vërtetimin gjyqësor të faktit të vendndodhjes së pronës, por ajo çështje është pushuar me vendimin nr. 2684, datë 05.12.2009 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

58. Po ashtu, çështja i është nënshtruar kontrollit edhe nga Gjykata e Lartë, e cila ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së apelit, duke vlerësuar

se ai është rrjedhojë e respektimit të ligjit material dhe procedural, ndërsa në rekurset e paraqitura edhe nga kërkuesi nuk ngrihen shkaqe për cenimin e tij. Në veçanti, ai kolegj ka vlerësuar të drejtë konkluzionin e arritur nga gjykata e faktit se kërkuesi nuk ka arritur të provojë legjitimitetin aktiv në ngritjen e padisë në situatën kur nuk ka paraqitur prova të tjera sikurse do të ishte dokumenti i pronësisë së kufitarit të tij ose ndonjë dokument tjetër, për të bërë të mundur përcaktimin e vendndodhjes së pronës së tij.

59. Nga sa më sipër, Kolegji vëren se vendimet e gjykatave të zakonshme nuk duket të kenë mangësi, mungesë ose pamjaftueshmëri arsyetimi apo alogjizëm. Po ashtu, ndërsa gjykatat nuk janë të detyruara të japin përgjigje të detajuara për çdo pretendim, nga përmbajtja e vendimeve të tyre del qartë se ato kanë trajtuar çështjet thelbësore të faktit dhe të ligjit të rëndësishme për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së parashtruar përpara tyre. Kështu, gjykatat kanë arsyetuar në veçanti në lidhje me pretendimin kryesor në padinë e kërkuesit, atë për të drejtën e pronësisë, duke arritur në përfundimin se ai nuk e provon këtë të drejtë për pronën objekt kërkimi në padi. Mbi këtë bazë, gjykatat kanë gjetur të pabazuara edhe pretendimet e tjera të tij, për sa kohë ato ndërvareshin pikërisht nga bazueshmëria e pretendimit kryesor për të drejtën e pronësisë. Për përfundimin se kërkuesi nuk ka provuar të drejtën e pronësisë për pronën objekt kërkimi në padinë e tij, gjykatat e faktit kanë analizuar dhe tërhequr konkluzione nga provat e paraqitura nga ai, përfshirë edhe konstatimet teknike të ekspertit. Në vendimet e tyre ato kanë dalluar provat e kërkuesit në raport me ato të ndërhyrësit kryesor, ku në analizë të provave të këtij të fundit, përfshirë edhe konkluzionet e ekspertit, kanë arritur në përfundimin se ai ka arritur të provojë të drejtën e pronësisë mbi pronën objekt gjykimi. Fakti që si kërkuesi, ashtu edhe ndërhyrësi kryesor pretendimin për të drejtën e pronësisë e kanë mbështetur në dokumente të të njëjtit lloj (dokumente arkivore) dhe që ofronin të dhëna të së njëjtës natyrë (sipërfaqen dhe kufijtë e pronës), nuk i bën kontradiktore arsyetimet e gjykatave të faktit, për sa kohë që për arritjen e përfundimeve në lidhje me pretendimet e ndërhyrësit kryesor ato kanë evidentuar se janë mbështetur edhe në prova të tjera.

60. Nga ana tjetër, në lidhje me sa kërkuesi pretendon për mungesë arsyetimi nga gjykatat e zakonshme për sa i përket faktit të dënimit penal të të padituri Nikolin Kodhima për falsifikimin e vendimit objekt padie të KKKP-së së Bashkisë Vlorë ose për moszgjidhjen nga ato të pasojave të pavlefshmërisë së kontratave të shitblerjes dhe të akteve administrative

objekt gjykimi, Gjykata vëren se këto aspekte të çështjes janë bërë pjesë e shqyrtimit gjyqësor në kuadër të padisë së ndërhyrësit kryesor dhe, në këtë kuptim, kërkuesi nuk argumenton se përse përmbushja ose jo e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor në këtë drejtim ka ndonjë pasojë ose ndikim në të drejtën e tij për proces të rregullt ligjor.

61. Nën dritën e rrethanave të mësipërme, Gjykata vlerëson se vendimet e gjykatave të zakonshme përmbajnë mjaftueshëm arsyetim në lidhje me përcaktimin e fakteve të çështjes dhe zbatimin e ligjit dhe ky përcaktim nga ato i fakteve dhe i zbatimit të ligjit në vijim nuk duket se është dukshëm i gabuar, sa një gjykatë e arsyeshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë. Për rrjedhojë, pretendimi i kërkuesit për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor është i pabazuar[2].

62. Në përfundim, Gjykata çmon se pretendimet e kërkuesit për cenimin e parimit të barazisë së armëve dhe të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor janë të pabazuara sipas arsyetimit të mësipërm, ndaj kërkesa duhet rrëzuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, si dhe neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me shumicë votash,

V E N D O S I:

1. Pranimin e kërkesës për rihapjen e procesit.

2. Shfuqizimin e vendimit nr. 12, datë 09.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese vetëm për sa është disponuar në lidhje me pretendimet e kërkuesit për cenimin e parimit të barazisë së armëve dhe standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor.

[2] Gjyqtarja Fiona Papajorgji mbajti qëndrimin se pretendimi i kërkuesit për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit nga ana e Gjykatës së Lartë është i bazuar. Kjo e fundit, bazuar në parimin e subsidiaritetit, pavarësisht se ka si funksion kontrollin e respektimit të standardeve kushtetuese për proces të rregullt ligjor, në rastin në shqyrtim duket se ka bërë një vlerësim formal të vendimmarrjes së gjykatës së apelit. Gjykata e Lartë edhe pse e ka shqyrtuar çështjen e kërkuesit në seancë gjyqësore, duket se nuk u ka dhënë përgjigje në substancë pretendimeve të tij për vendndodhjen e pronës objekt mosmarrëveshjeje, e për rrjedhojë në lidhje me legjitimimin aktiv të tij në ngritjen e kërkesëpadisë.

3. Rrëzimin e ankimit kushtetues individual të kërkuesit për pretendimet e cenimit të parimit të barazisë së armëve dhe standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 22.09.2025
Shpallur më 05.11.2025

MENDIM PJESËRISHT KUNDËR

1. Në gjykimin kushtetues të vënë në lëvizje nga kërkuesi Astrit Meli, pas shqyrtimit të çështjes së tij nga GJEDNJ-ja, jemi pjesërisht kundër vendimit të shumicës, pasi vlerësojmë se ankimi kushtetues individual i tij për pretendimet e cenimit të parimit të barazisë së armëve dhe standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor është i bazuar, ndaj, si i tillë duhej pranuar në tërësi. Në mbështetje të nenit 132, pika 3, të Kushtetutës dhe nenit 72, pika 8, të ligjit nr. 8577/2000, që parashikojnë publikimin e mendimit të pakicës së bashku me vendimin përfundimtar të Gjykatës, parashtrojmë në vijim argumentet tona.

2. Sikurse ka rezultuar nga rrethanat e çështjes, trashëgimlënësi (i ati) i kërkuesit ka ngritur pretendime pronësie për një pasuri të shpronësuar në vitin 1948, për të cilën KKKP-ja, në vitet 1996 dhe 1997, ka disponuar njohjen, kthimin dhe kompensimin e saj fizik personave të tjerë, të cilët kanë kryer transaksione me të. Kërkesat për njohjen e së drejtës së pronësisë dhe kthimin e pasurisë janë refuzuar administrativisht nga organet e ngarkuara me ligj, ndaj në këtë situatë ai ka paraqitur padi në gjykatë. Gjykata e shkallës së parë ka vendosur, ndër të tjera, rrëzimin e padisë të trashëgimlënësit të kërkuesit si të pabazuar në prova, me arsyetimin se ai nuk ka arritur të provojë legjitimitetin aktiv, pra cenimin e ndonjë interesi të ligjshëm që të mund të zgjidhej ndonjë konflikt nga gjykata, ndaj në këtë situatë ajo (gjykata) nuk i ka hyrë shqyrtimit në themel të padisë së tij. Vendimi në fjalë është lënë i pacenuar nga gjykata e apelit dhe Gjykata e Lartë, duke e vlerësuar atë të bazuar në ligj dhe në prova.

3. Në këto rrethana, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual, fillimisht në datën 13.10.2017, me pretendimin se gjykatat e zakonshme i kanë cenuar të drejtën për proces të rregullt ligjor në aspekte të aksesit, mbrojtjes dhe kontradiktoritetit, barazisë së armëve, gjykimit brenda një afati të arsyeshëm dhe nga një gjykatë e caktuar me ligj, paanshmërisë, si dhe standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor. Pas shqyrtimit në seancë plenare, Gjykata, me vendimin nr. 12/2021, ka vendosur rrëzimin e kërkesës, pasi kërkuesi lidhur me pretendimet: për cenimin e së drejtës së mbrojtjes dhe parimit të kontradiktoritetit (me argumentin e mosformimit të drejtë të ndërgjyqësisë) nuk legjitimohet; për cenimin e parimit të paanshmërisë në gjykim, nuk ka shteruar mjetet

juridike në dispozicion; për cenimin e së drejtës së mbrojtjes dhe parimit të kontradiktoritetit (për argumentin se gjykata e apelit ka shtyrë shpalljen e vendimit) nuk ka arritur ta ngrejë atë në nivel kushtetues; për cenimin e së drejtës së aksesit, së drejtës së mbrojtjes dhe parimit të kontradiktoritetit në gjykim (për argumentet e tjera), si dhe të parimit të gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj, i ka të pabazuara, ndërsa për cenimin e parimit të barazisë së armëve dhe të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, nuk u arrit shumica e nevojshme e votave të gjyqtarëve, ndaj ato u konsideruan të rrëzuara, në kuptim të nenit 73, pika 4, të ligjit nr. 8577/2000. Në vijim, kërkuesi i është drejtuar GJEDNJ-së, e cila, me vendimin e datës 16.07.2024, ka gjetur shkelje të nenit 6, paragrafit 1, të KEDNJ-së për të drejtën për vendim të arsyetuar sa i takon dy pretendimeve të rrëzuara.

4. Pas kësaj, në datën 16.12.2024 kërkuesi i është drejtuar sërish Gjykatës me ankim kushtetues sipas objektit. Pas rihapjes së gjykimit kushtetues dhe shfuqizimit të vendimit nr. 12/2021 vetëm për atë pjesë të tij, për të cilën GJEDNJ-ja ka gjetur shkelje, pra lidhur me arsyetimin për sa i takon rrëzimit të dy pretendimeve - parimit të barazisë së armëve dhe të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, shumica në përfundim ka disponuar me rrëzimin e kësaj pjese të kërkesës, duke i vlerësuar ato të pabazuara.

5. Ndonëse jemi dakord me shumicën për sa i takon rihapjes së procesit kushtetues dhe rigjykimit të çështjes së kërkuesit vetëm për sa i takon arsyetimit për dy pretendimet për të cilat GJEDNJ-ja ka vlerësuar se cenohej neni 6 i KEDNJ-së, nuk ndajmë të njëjtin vlerësim lidhur me faktin se ato dy pretendime janë të pabazuara në themel, pasi për shkak të rrethanave dhe fakteve të trajtuara si nga gjykatat e zakonshme, ashtu edhe gjatë gjykimit kushtetues, çështja e kërkuesit kishte nevojë të rishqyrtohej sërish, në kushtet kur arsyetimi i gjykatave përmbante gabime të dukshme faktike që lidheshin edhe me parimin e barazisë së armëve në gjykim.

6. Konkretisht, kërkuesi ka pretenduar se gjykata ka ngatërruar rolin e saj me të ekspertit, duke disponuar me vendim vetëm atë çka ka konstatuar eksperti dhe se ai është vënë në situatë të disfavorshme në krahasim me palën tjetër, pasi gjykatat jo vetëm që nuk kanë pranuar kërkesat e tij për paraqitjen e provave, por i kanë mohuar të drejtën që, nëpërmjet gjykatës, të sigurojë provat e nevojshme shkresore ose me dëshmitarë për të vërtetuar pretendimet e tij. Sipas kërkuesit, gjykatat nuk kanë marrë parasysh pretendimet e paraqitura nga palët dhe ato duhej të thërrisnin një grup ekspertësh për të saktësuar pronësinë në fjalë. Gjykatat, shprehet

kërkuesi, i kanë mbështetur konkluzionet e tyre vetëm në përfundimet e ekspertit, sipas të cilit është e vështirë të pasqyrohet vendndodhja e pasurisë, ndërkohë që ajo do të përcaktohej lehtësisht nëse do të thërrisnin ekspertë me njohuri të posaçme. Për më tepër, aty ka ekzistuar edhe shtëpia e banimit dhe prona ka qenë e regjistruar edhe në regjistrin hipotekar të vitit 1942. Pavarësisht shkeljeve të konstatuara në këtë proces gjyqësor, Gjykata e Lartë i legjitimoi ato, duke lënë në fuqi vendimet e gjykatave të faktit.

7. Shumica, duke i trajtuar veçmas këto pretendime i ka vlerësuar ato të pabazuara, pasi ka çmuar se kërkuesit i janë krijuar mundësi të barabarta për të paraqitur prova dhe për të parashtruar deklarimet e tij për faktet, provat dhe vlerësimet ligjore për çështjen (*shih paragrafin 49 të vendimit*) dhe se vendimet e gjykatave të zakonshme përmbajnë mjaftueshëm arsyetim në lidhje me përcaktimin e fakteve të çështjes dhe zbatimin e ligjit dhe ky përcaktim nga ato nuk duket se është dukshëm i gabuar, sa një gjykatë e arsyeshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë (*shih paragrafin 61 të vendimit*).

8. Nuk jemi dakord me këtë konkluzion të shumicës, pasi nga argumentet që ka përdorur gjykata e shkallës së parë për të rrëzuar padinë e kërkuesit, ka referuar se ai ka paraqitur si provë për të provuar pronësinë e tij një dokument arkivor të dalë nga Arkivi i Shtetit, në të cilin jepen specifikime konkrete, por ky dokument nuk është i shoqëruar me skicë. Për të përcaktuar faktin se ku ndodhet prona e kërkuesit dhe nëse midis saj dhe pronës së palëve të tjera ndërgjyqëse ka ose jo mbivendosje, gjykata ka proceduar me thirrjen e një eksperti. Nga eksperti u arrit në përfundimin se për kufitarët e kësaj prone nuk ka asnjë dokument grafik dhe për faktin se dokumenti nuk ka hartë (skicë) ose nuk ka të përcaktueshëm kufijtë e pronës, ai nuk mund të përcaktojë se ku ndodhet kjo pronë, pra nuk mund të përcaktohet nëse ndodhet pikërisht aty ku palët ndërgjyqëse kanë pronën e tyre ose në ndonjë vend tjetër. Nga kërkuesi, shprehet gjykata, nuk u sollën prova të tjera, sikurse do të ishte dokumenti i pronësisë së kufitarit të tij ose ndonjë dokument tjetër për të bërë të mundur të përcaktohej se ku pikërisht është vendosur prona e tij. Pra, kërkuesi, ka konkluduar gjykata e shkallës së parë nuk arriti të provojë legjitimitetin aktiv në padinë e tij, sepse nuk arriti të provojë cenimin e ndonjë interesi të tij të ligjshëm që të vinte në lëvizje gjykatën në zgjidhjen e ndonjë konflikti me palët ndërgjyqëse, ndaj për mungesë të legjitimitetit aktiv, gjykata, pa i hyrë themelit të padisë së kërkuesit, e ka rrëzuar atë si të pabazuar në prova. Ndonëse çështja u shqyrtua nga gjykata e apelit, ajo e ka lënë në fuqi vendimin e ankimuar

me të njëjtën linjë arsyetimi, duke u shprehur edhe se i ati i kërkuesit, në një proces gjyqësor paralel, ka kërkuar vërtetimin gjyqësor të faktit të vendndodhjes së pronës, por ajo çështje është pushuar me vendim gjyqësor në vitin 2009. Gjykata e Lartë ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së apelit, duke vlerësuar se ai është rrjedhojë e respektimit të ligjit material dhe procedural, ndërsa në rekursin e kërkuesit nuk ngrihen shkaqe për cenimin e tij. Sipas saj, gjykatat e faktit kanë konkluduar drejt se kërkuesi nuk ka arritur të provojë legjitimitetin aktiv në ngritjen e padisë në situatën kur nuk ka paraqitur prova të tjera, sikurse do të ishte dokumenti i pronësisë së kufitarit të tij ose ndonjë dokument tjetër, për të përcaktuar vendndodhjen e pronës së tij.

9. Në kuadër të analizës së argumenteve të mësipërme të gjykatave të zakonshme, paraprakisht sjellim në vëmendje standardet kushtetuese sipas të cilave e drejta për të marrë pjesë në gjykim nuk duhet konsideruar si një e drejtë formale, ku palëve t'u garantohet thjesht prania fizike gjatë procesit civil, por duhet që legjislacioni procedural, në radhë të parë, dhe, më pas, gjyqtari gjatë gjykimit, t'u japin mundësi të barabarta palëve për të paraqitur argumente dhe prova në mbrojtje të interesave të tyre dhe se gjykatës i dalin një sërë detyrash, mes të cilave rëndësi të veçantë merr krijimi i mundësive të barabarta për pjesëmarrjen e palëve ose përfaqësuesve të tyre në proces, si dhe mundësia e deklarimit të tyre për faktet, provat dhe vlerësimet ligjore që janë të lidhura ngushtë me çështjen që shqyrtohet në gjykatë *(shih vendimet 13, datë 21.03.2023; nr. 41, datë 22.12.2022 të Gjykatës Kushtetuese)*.

10. Mbi bazën e këtyre standardeve, gjykatat e faktit kishin detyrimin që në situatën e paqartësisë dhe mungesës së një përgjigjeje konkrete nga eksperti i thirrur për të përcaktuar saktësisht pronën objekt mosmarrëveshjeje, të mund të thërrisnin një grup ekspertësh të specializuar për të zgjidhur çështjen e vendndodhjes së pasurisë në fjalë. Përkundër kësaj, ato janë mjaftuar me faktin se kërkuesi nuk ka sjellë prova të tjera, sikurse do të ishte dokumenti i pronësisë së kufitarit të tij ose ndonjë dokument tjetër, për të përcaktuar se ku pikërisht ishte vendosur prona e tij, duke i ngarkuar atij në mënyrë të shpërpjesëtuar një barrë, e cila mund të adresohej nga vetë gjykata. Ndërkohë që gjykata ka pranuar provat e palëve të tjera ndërgjyqëse pa dhënë një argumentim të plotë se përse ato zgjidhnin qartësisht dhe plotësisht një situatë që në vlerësimin e një eksperti kompetent nuk ishte e tillë. Kjo situatë nuk u rregulla as nga gjykata e apelit, megjithëse gjendej përpara një raporti të një eksperti, i

cili nuk ishte në gjendje të përcaktonte saktësisht pronësinë dhe kufijtë e saj, që në thelb ishin dhe objekti i mosmarrëveshjes që duhet të zgjidhej prej gjykatave. Nga ana tjetër, edhe Gjykata e Lartë, e cila bazuar në parimin e subsidiaritetit, ka funksion kontrollin e respektimit të standardeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor (*shih vendimet nr. 19, datë 07.07.2022; nr. 6, datë 16.02.2021 të Gjykatës Kushtetuese*) ka bërë një vlerësim formalist të vendimmarrjes së gjykatës së apelit, duke e lënë, në thelb, të pazgjidhshëm paqartësinë dhe pamundësinë e një eksperti për të konkluduar mbi rastin.

11. Nga sa më lart, çmojmë se gjykatat e zakonshme e kanë vendosur kërkuesin në pozita të pabarabarta me palët ndërgjyqëse lidhur me fuqinë provuese të provave në përcaktimin e fakteve të mosmarrëveshjes, duke bërë që vendimet gjyqësore objekt kundërshtimi të shfaqin gabime të dukshme faktike në atë masë sa një gjykatë e arsyeshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose të tillë që gjykimin e bën të padrejtë (*shih vendimet nr. 64, datë 01.10.2024; nr. 59, datë 14.11.2023; nr. 33, datë 14.11.2022 të Gjykatës Kushtetuese*). Për rrjedhojë, Gjykata duhet të kishte vendosur pranimin e ankimit kushtetues individual të kërkuesit, shfuqizimin e vendimit të Gjykatës së Lartë dhe dërgimin e çështjes për shqyrtim pranë asaj gjykate, duke marrë në konsideratë arsyetimin e mësipërm.

Anëtare: Marsida Xhaferllari, Marjana Semini

Vendim nr. 49, datë 24.09.2025
(V-49/25)

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Holta Zaçaj, Kryetare, Marsida Xhaferllari, Fiona Papajorgji, Sandër Beci, Ilir Toska, Genti Ibrahimi, Marjana Semini, Sonila Bejtja, anëtarë, me sekretare Belma Lleshi, në datën 23.09.2025 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 9 (Gj) 2024 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUESE: **GJYKATA E SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM KORÇË,** përfaqësuar nga gjyqtarja Valjona Haxhiraj.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:
KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, në mungesë.
KËSHILLI I MINISTRAVE, përfaqësuar nga Herald Jonuzaj.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i nenit 123, pika 2, shkronja "ë", të ligjit nr. 8378, datë 22.07.1998 "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

BAZA LIGJORE: **Nenet 134, pika 1, shkronja "dh" dhe 145, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 112 i Kodit të Procedurës Penale (*KPP*); ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).**

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Sonila Bejtja, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë (*gjykata referuese*), e cila ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar, Këshillit të Ministrave, i cili ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, konstatoi mungesën e prapësimeve me shkrim të subjektit të interesuar, Kuvendit të Republikës së Shqipërisë (*Kuvendi*), si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I
Rrethanat e çështjes

1. Në datën 18.07.2024, ora 12:30, në qytetin e Korçës, shtetasi T.B., gjatë drejtimit të motomjetit, është përplasur me një automjet të drejtuar nga shtetasja O.M. Nga verifikimi i kryer ka rezultuar se mjeti i drejtuar nga shtetasi T.B. bënte pjesë në kategorinë A1 të motomjeteve, ndërkohë që drejtuesi i tij (shtetasi T.B.) ka qenë i pajisur me lejedrejtimi të kategorisë B, e cila, sipas shkronjës "ë" të pikës 2 të nenit 123 të Kodit Rrugor *"është e vlefshme në territorin kombëtar për të drejtuar mjete rrugore me tri rrota, me fuqi më të madhe se 15 kW, si dhe motomjetet e kategorisë A1, me kusht që mbajtësi i lejedrejtimit të jetë, të paktën, 21 vjeç*". Për shkak se nga verifikimi i drejtuesit të mjetit shtetasi T.B. ka rezultuar se ishte i moshës 20 vjeç, për rrjedhojë nuk ka pasur lejen përkatëse të drejtimit, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë (*Prokuroria Korçës*) ka regjistruar ndaj tij procedimin penal nr. 900/2024 për kryerjen e veprës penale "Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt", të parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal (*KP*), i cili parashikon se "*drejtimi i automjeteve apo mjeteve të tjera të motorizuara [...] pa dëshminë përkatëse të aftësisë dënohet me burgim nga dhjetë ditë deri në tre vjet*". Në vijim, në datën 21.10.2024, Prokuroria Korçës ka paraqitur në gjykatën referuese kërkesë për dërgimin e kësaj çështjeje në gjyq.

2. Në seancën paraprake të datës 05.12.2024, të zhvilluar në Gjykatën e Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, shtetasi T.B. ka parashtruar përpara gjykatës referuese se edhe pse është i pajisur me lejedrejtimi të kategorisë B, ai di të drejtojë motomjetin e tij të kategorisë A1, me të cilin ka rreth dy vjet që punon (transporton pica). Po sipas shtetasit T.B., ai ka kërkuar

të regjistrohej në kursin e lejedrejtimit të kategorisë A1, por kanë qenë drejtuesit e autoshkollave që i kanë thënë se nuk ishte e nevojshme, për shkak se ishte i pajisur me lejedrejtimi të kategorisë B. Po gjatë seancës paraprake, mbrojtësi i shtetasit T.B. i ka kërkuar gjykatës referuese të pezullojë gjykimin dhe t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) për t'u shprehur për kushtetutshmërinë e kësaj dispozite, nisur nga fakti që neni 291 i KP-së, i cili parashikon veprën penale për të cilën akuzohet i përfaqësuari prej tij, referon te shkronja "ë" e pikës 2 të nenit 123 të Kodit Rrugor. Gjykata referuese, pasi është tërhequr në dhomën e këshillimit, me vendimin e datës 05.12.2024, ka vendosur të pezullojë gjykimin e çështjes në shqyrtim përpara saj dhe t'i drejtohet Gjykatës me kërkesë për shfuqizimin e shkronjës "ë" të pikës 2 të nenit 123 të Kodit Rrugor.

3. Në datën 20.12.2024 në Gjykatë është regjistruar vendimi i gjykatës referuese, sipas objektit të mësipërm, dhe Kolegji i Gjykatës në datën 13.02.2025 ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II
Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

4. ***Gjykata referuese***, në mënyrë të përmbledhur, ka parashtruar:

i) *Për legjitimimin*

4.1. Ajo legjitimohet në kërkesën e saj drejtuar Gjykatës, pasi bën pjesë në kategorinë e subjekteve që mund ta vënë në lëvizje atë, bazuar në nenet 134, 145, pika 2, të Kushtetutës dhe nenin 49, pika 3, shkronja "dh", të ligjit nr. 8577/2000. Sipas gjykatës referuese, neni 291 i KP-së, që zbatohet në rastin e paraqitur për shqyrtim përpara saj, referon drejtpërdrejt në dispozitën e kundërshtuar dhe ka lidhje të drejtpërdrejtë me të, e cila po ashtu është e vetmja dispozitë që zbatohet në atë gjykim. Po kështu, gjykata referuese ka argumentuar se nuk ka asnjë mundësi që të bëhet interpretimi pajtues i dispozitës së kundërshtuar dhe se për çështjen e paraqitur për gjykim përpara saj nuk ka dispozita të tjera ligjore, mbi bazën e të cilave të zgjidhet ajo. Për këto arsye, sipas gjykatës referuese, çështja e paraqitur për shqyrtim përpara saj nuk mund të përfundojë në mënyrë të pavarur nga çështja konkrete e paraqitur për shqyrtim në Gjykatë.

ii) *Për themelin*

4.2. Dispozita e kundërshtuar cenon *lirinë e lëvizjes dhe të drejtën për punë,* të parashikuara nga nenet 38 dhe 49 të Kushtetutës dhe ky kufizim nuk respekton *parimin e proporcionalitetit,* sipas nenit 17 të Kushtetutës, për shkak se kushti i vendosur në shkronjën "ë" të pikës 2 të nenit 123 të Kodit Rrugor nuk i përgjigjet zhvillimit social, kulturor, ekonomik dhe moral të shoqërisë, duke mos respektuar thelbin e të drejtave dhe lirive të njeriut. Nga relacionet që kanë shoqëruar ndryshimet në Kodin Rrugor nuk jepet asnjë shpjegim se përse është vendosur ky kufizim për shkak të moshës. Ligjvënësi ka ndërmarrë një masë kufizuese për të mbrojtur të drejtat e njeriut, sigurinë e qarkullimit rrugor, jetën, shëndetin dhe pronën nga rreziku eventual dhe potencial që mund të ketë drejtimi i mjeteve rrugore nga persona që nuk janë të aftë t'i drejtojnë ato. Megjithatë, rreziku eventual dhe potencial është i njëjtë si për personat e aftë që njohin rregullat e qarkullimit rrugor e që drejtojnë mjetet me lejen përkatëse, ashtu edhe për ata që nuk kanë lejen përkatëse të drejtimit, por një leje tjetër, të cilët po ashtu janë njësoj të aftë fizikisht e mendërisht t'i drejtojnë ato mjete njësoj si personat që kanë lejen përkatëse.

4.3. *Është cenuar parimi i barazisë dhe i mosdiskriminimit,* sipas nenit 18 të Kushtetutës, për shkak të vendosjes së kufizimit për efekt të moshës, çka përbën një diskriminim të paarsyeshëm. Dispozita e kundërshtuar e Kodit Rrugor trajton në mënyrë të pabarabartë drejtuesit e motomjeteve me drejtuesit e mjeteve të tjera dhe nuk është në përputhje me legjislacionin evropian. Për trajtimin jo të barabartë përpara ligjit që u bëhet drejtuesve të motomjeteve nuk ekziston një përligjje e arsyeshme dhe objektive për kufizimin e drejtimit të motomjeteve me moshën 21 vjeç, në kushtet kur drejtuesit e motomjeteve i nënshtrohen të njëjtit testim për marrjen e lejes së drejtimit të kategorisë B, e përfundojnë atë me sukses, njohin mirë rregullat e qarkullimit rrugor dhe dëshmojnë se kanë aftësi shumë të mira drejtuese edhe për drejtimin e motomjeteve të kategorisë A1. Nuk ka asnjë studim ose statistikë për vendosjen e kufizimit të moshës 21 vjeç për drejtimin e motomjeteve dhe nuk ka një përligjje të arsyeshme dhe objektive për vendosjen e tij. Në këtë mënyrë, personat që janë në kushte të njëjta trajtohen ndryshe nga ligji.

4.4. Dispozita objekt kërkese bie në kundërshtim edhe me *parimin e shtetit të së drejtës edhe me të drejtën për t'u mos u dënuar pa*

ligj, sipas neneve 4 dhe 29 të Kushtetutës dhe nenit 7 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*), pasi ligjvënësi nuk ka bërë një zgjedhje dhe zgjidhje proporcionale me nevojën dhe gjendjen që e ka diktuar atë, si dhe nuk ka trajtuar në mënyrë të barabartë në ligjin penal dhe në përgjegjësinë penale që mbajnë personat që kanë rrezikshmëri të njëjtë shoqërore në veprimet që kryejnë. Në rastin konkret mungon arsyeja e kriminalizimit të një sjelljeje njerëzore, konkretisht rrezikshmëria shoqërore penale, pasi fakti që drejtuesi nuk është të paktën 21 vjeç, nuk përmbush asnjë nga tre kriteret për të pasur vepër penale (rrezikshmëria shoqërore e veprës, kundërligjshmëria e saj dhe faji). Drejtimi i mjetit nga individi pa lejen përkatëse, në kushtet kur ai ka aftësi ta drejtojë atë, pasi ka leje drejtimi të një kategorie tjetër, e cila përfshin lejen që i duhej atij për të drejtuar atë mjet, përbën vetëm shkelje administrative dhe nuk mund të përbëjë edhe përgjegjësi penale. Për pasojë, i gjithë procesi gjyqësor do të jetë i paragjykuar dhe jokushtetues.

4.5. Dispozita objekt kërkese cenon *parimin e prezumimit të pafajësisë,* të parashikuar nga neni 30 i Kushtetutës, dhe bie në kundërshtim me nenet 33 dhe 42 të saj (Kushtetutës) dhe nenin 6 të KEDNJ-së, pasi në rastin konkret ligji e parashikon si krim kushtin e mospasjes së moshës të paktën 21 vjeç për të drejtuar motomjete të kategorisë A1. Po kështu, në rastin konkret, të pandehurit nuk i jepet mundësia të provojë mungesën e çdo rrezikshmërie të mundshme penale në veprimet e tij dhe për pasojë edhe faktin që nuk ka vepër penale. Në këtë rast, ligji jo vetëm që shkel të drejtën e të pandehurit për t'u prezumuar i pafajshëm, por këmbëngul në fajësinë e tij dhe në përgjegjësinë penale të padiskutueshme vetëm nga fakti se provohet se ai nuk është të paktën 21 vjeç.

4.6. Dispozita objekt kërkese cenon edhe *parimin e ndarjes dhe të balancimit të pushteteve,* të parashikuar në nenet 7 dhe 135, pika 1, të Kushtetutës*,* pasi duke vendosur një kriter thjesht formal, siç është mosha mbi 21 vjeç për penalizimin e një sjelljeje njerëzore si krim, ligjvënësi u ka hequr mundësinë gjykatave që në ushtrimin e funksionit të tyre për dhënien e drejtësisë të vlerësojnë nëse ka ose jo vepër penale, referuar rrethanave konkrete të ngjarjes të sjellë si fakt penal nga organi i akuzës. Për rrjedhojë, gjykatat janë të detyruara të shpallin fajtor të pandehurin vetëm me vërtetimin e mosplotësimit

të kushtit të moshës 21 vjeç, pa provuar (mos) aftësinë e tij në drejtimin e motomjetit. Kështu mund të konsiderohet krim drejtimi i mjetit pa pasur lejen e drejtimit, por jo përmbushja e kriterit të moshës dhe pasja e një lejeje drejtimi të një kategorie tjetër dhe kur është e provuar që personi ka aftësitë për të drejtuar mjetin për të cilin nuk disponon lejen përkatëse të drejtimit.

5. ***Subjekti i interesuar, Kuvendi***, nuk ka paraqitur prapësime, edhe pse është njoftuar rregullisht.

6. ***Subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave***, në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar si vijon:

i) *Për legjitimimin e gjykatës referuese*

6.1. Gjykata referuese nuk legjitimohet për shkak se nuk ka parashtruar arsye të mjaftueshme, bindëse dhe serioze për antikushtetutshmërinë e normës ligjore të kundërshtuar, por e ka paragjykuar atë, duke mos i dhënë kuptimin e duhur. Ajo gjykatë nuk ka bërë të gjitha përpjekjet për të interpretuar normën në përputhje me Kushtetutën dhe nuk ka analizuar se përse procesi gjyqësor përpara saj nuk mund të përfundojë në mënyrë të pavarur nga gjykimi kushtetues. Në këtë rast, gjykata referuese ka kërkuar interpretimin e normës ligjore nga Gjykata.

ii) *Për themelin*

6.2. Dispozita e kundërshtuar respekton *kriteret e nenit 17 të Kushtetutës,* pasi kufizimi është bërë me ligj, për sa kohë ndërhyrja është bërë në Kodin Rrugor, i cili referon te neni 291 i KP-së. Ky parashikim ligjor ka si qëllim sigurinë rrugore që është një interes publik, i cili, në rastin konkret, përfshin mbrojtjen e jetës dhe të shëndetit të individëve, duke kufizuar aksesin në drejtimin e mjeteve të fuqishme nga persona që nuk kanë arritur moshën dhe pjekurinë e duhur. Parashikimi ligjor synon parandalimin e aksidenteve me pasoja fatale, të cilat në realitet ndodhin shpesh për shkak të mungesës së përvojës në drejtimin e motoçikletave të kategorisë A1. Duke e trajtuar shkeljen si vepër penale dhe jo vetëm si kundërvajtje administrative, rritet ndërgjegjësimi dhe përgjegjësia e drejtuesve të mjeteve. Drejtimi i motomjeteve nga persona që nuk plotësojnë kriterin e moshës dhe të përvojës përbën rrezik të drejtpërdrejtë për jetën dhe shëndetin e individëve të tjerë. Gjykata referuese nuk ka arritur të evidentojë të drejtën ose lirinë kushtetuese, e cila është kufizuar në rastin konkret.

6.3. Dispozita e kundërshtuar nuk cenon *parimin e barazisë përpara ligjit, sipas nenit 18 të Kushtetutës,* pasi nuk ndodhemi përpara individëve në kushte të njëjta, siç e paraqet gjykata referuese, për sa kohë që personat nën moshën 21 vjeç ndodhen në kushte objektivisht të ndryshme nga ata mbi moshën 21 vjeç, për shkak të njohurive dhe të përvojës në drejtimin e mjeteve motorike. Barazia përpara ligjit nuk nënkupton trajtim të barabartë për raste të ndryshme. Kodi Rrugor parashikon ndarje të drejtuesve të mjeteve sipas kategorive të ndryshme, në varësi të rrezikut dhe të aftësive të ndryshme dhe mosha 21 vjeç është vendosur për të mbrojtur sigurinë publike dhe jo për të diskriminuar drejtuesit e motomjeteve. Motomjetet përfaqësojnë vetëm 6% të numrit të përgjithshëm të mjeteve të regjistruara në vendin tonë, por shkalla e aksidenteve me viktima ose dëmtime serioze për këto mjete është shumë më e lartë se në kategoritë e tjera të mjeteve rrugore.

6.4. Dispozita e kundërshtuar është në përputhje dhe me *parimet e shtetit të së drejtës dhe me të drejtën për të mos u dënuar pa ligj,* sipas neneve 4 dhe 29 të Kushtetutës, pasi bazuar në përmbajtjen e saj rezulton se KP-ja ka parashikuar për gjyqtarin mundësinë e individualizimit të dënimit për veprën penale të kryer. Në rastin konkret, dispozita është e qartë, e parashikueshme dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare për sigurinë rrugore dhe nuk ka një kriminalizim të paqartë ose të padrejtë, por një rregull të qartë për kriteret për drejtimin e mjeteve motorike dhe pasojat për mosrespektimin e tyre.

6.5. Dispozita e kundërshtuar është në përputhje edhe me *parimin e prezumimit të pafajësisë,* sipas neneve 30 e vijues të Kushtetutës, për shkak se ajo nuk përjashton shqyrtimin gjyqësor, por përcakton një kriter objektiv, siç është mosha. Është gjykata ajo që do të shqyrtojë rrethanat e çështjes dhe që do të vendosë për (pa) fajësinë e individit. Fakti që një individ nuk plotëson kriteret për drejtimin e mjetit përkatës nuk do të thotë se dënohet automatikisht, por ai nuk mund ta ushtrojë këtë të drejtë pa përmbushur kushtet e nevojshme, siç është plotësimi i moshës së kërkuar nga ligji. Mosplotësimi i moshës, i ndërthurur me elementet e anës objektive të figurës së veprës penale, nuk passjell dënimin e individit, por ai është subjekt i ndjekjes penale në bazë të ligjit.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e gjykatës referuese

7. Çështja e legjitimimit të subjekteve që mund t'i drejtohen Gjykatës është vlerësuar si një ndër aspektet kryesore që mundëson fillimin e procesit kushtetues. Kërkesa për kontroll incidental parashikohet në nenin 145, pika 2, të Kushtetutës, i cili u njeh të drejtën gjyqtarëve që në çdo fazë të gjykimit, kur çmojnë se ligjet bien në kundërshtim me Kushtetutën, të mos i zbatojnë ato, të vendosin pezullimin e gjykimit të çështjes dhe dërgimin e saj Gjykatës për t'u shprehur për kushtetutshmërinë e normës. Kjo dispozitë, e konkretizuar edhe në nenin 68 të ligjit nr. 8577/2000, lidhet me kontrollin kushtetues të ligjeve nga Gjykata, kur ky kontroll kërkohet nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm.

8. Gjykata referuese ka parashtruar se plotëson kriteret e legjitimimit për nisjen e kontrollit incidental të pajtueshmërisë së normës ligjore me Kushtetutën, pasi neni 291 i KP-së, që zbatohet në çështjen penale në shqyrtim përpara saj, referon drejtpërdrejt në shkronjën "ë" të pikës 2 të nenit 123 të Kodit Rrugor dhe ka lidhje të drejtpërdrejtë me të, e cila po ashtu është e vetmja dispozitë që zbatohet në atë gjykim. Po kështu, gjykata referuese ka parashtruar se nuk ka asnjë mundësi që të bëhet interpretimi pajtues i dispozitës së kundërshtuar dhe se çështja e paraqitur për shqyrtim përpara saj nuk mund të përfundojë në mënyrë të pavarur nga çështja konkrete e paraqitur për shqyrtim në Gjykatë.

9. Subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave, ka pretenduar se gjykata referuese nuk legjitimohet t'i drejtohet Gjykatës, pasi nuk ka parashtruar arsye të mjaftueshme bindëse dhe serioze për antikushtetutshmërinë e normës ligjore të kundërshtuar, por e ka paragjykuar atë, duke mos i dhënë kuptimin e duhur. Sipas këtij subjekti, gjykata referuese nuk i ka bërë të gjitha përpjekjet për ta interpretuar normën ligjore në përputhje me Kushtetutën dhe nuk ka analizuar se përse procesi i paraqitur përpara saj nuk mund të përfundojë në mënyrë të pavarur nga gjykimi kushtetues, por, në thelb, ka kërkuar interpretimin e normës ligjore nga Gjykata.

10. Për sa i takon legjitimimit të gjykatës referuese që vë në lëvizje kontrollin incidental të kushtetutshmërisë së normës ligjore, bazuar në nenin 145 të Kushtetutës, të konkretizuar në nenin 68 të ligjit nr. 8577/2000, Gjykata ka zhvilluar disa kritere kumulative, sipas të cilave gjykata referuese duhet që gjatë gjykimit që zhvillohet pranë saj: (i) të ketë identifikuar ligjin që do të zbatohet për zgjidhjen e tij dhe të ketë krijuar

bindjen se gjykimi i saj nuk mund të përfundojë në mënyrë të pavarur nga çështja në Gjykatë, pra lidhjen e drejtpërdrejtë midis ligjit dhe çështjes kushtetuese; (ii) të ketë parashtruar arsye bindëse për antikushtetutshmërinë e ligjit, duke referuar në normat ose parimet konkrete të Kushtetutës; (iii) të ketë bërë të gjitha përpjekjet për ta interpretuar atë në përputhje me Kushtetutën (*shih vendimet nr. 20, datë 03.04.2024; nr. 32 datë 30.05.2023; nr. 8, datë 07.02.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Lidhur me këto kritere legjitimimi, në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se gjykata referuese duhet të arsyetojë efektin e drejtpërdrejtë që ka dispozita e kundërshtuar për gjykimin pranë saj, duke individualizuar se pikërisht ajo dispozitë zbatohet dhe zgjidh mosmarrëveshjen konkrete pranë saj. Dispozita e kundërshtuar duhet të ketë lidhje me gjykimin në gjykatën referuese në atë masë që ai nuk mund të përfundojë në mënyrë të pavarur pa u shqyrtuar nga Gjykata kushtetutshmëria e dispozitës ligjore (*shih vendimet nr. 20, datë 03.04.2024; nr. 30, datë 02.11.2022; nr. 30, datë 25.05.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Po kështu, Gjykata ka theksuar se përpara marrjes së vendimit të pezullimit të çështjes, gjykata referuese duhet të konkludojë se gjykimi që ka nisur nuk mund të përfundojë pa i dhënë përgjigje çështjes së kushtetutshmërisë së ligjit nga ana e Gjykatës. Për këtë arsye, kërkohet një raport i domosdoshëm midis vendimit të Gjykatës (zgjidhjes së çështjes të kushtetutshmërisë) dhe zgjidhjes së çështjes konkrete nga gjykata referuese (*shih vendimet nr. 20, datë 03.04.2024; nr. 73, datë 17.11.2017; nr. 4, datë 23.02.2016 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, gjykata referuese duhet të evidentojë jo vetëm objektin, por edhe standardin kushtetues të cenuar në funksion të vënies në lëvizje të gjykimit kushtetues, pra jo vetëm normën ligjore, por edhe parimet ose standardet kushtetuese që ajo cenon në rast se zbatohet për zgjidhjen e çështjes (*shih vendimet nr. 20, datë 03.04.2024; nr. 8, datë 07.02.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Për sa i përket kriterit të përpjekjeve për interpretimin e dispozitës në përputhje me Kushtetutën, Gjykata ka theksuar se është detyrim i gjykatës referuese të zgjidhë dyshimet interpretative, duke i dhënë normës së zbatueshme një interpretim që përputhet me parimet kushtetuese (*shih vendimet nr. 20, datë 03.04.2024; nr. 5, datë 16.02.2012; nr. 29, datë 31.05.2010 të Gjykatës Kushtetuese*). Vetëm në rast se gjykata referuese vlerëson se çdo interpretim i mundshëm bie në kundërshtim me Kushtetutën, atëherë duhet t'i drejtohet Gjykatës, duke kërkuar kontrollin e kushtetutshmërisë së normës të individualizuar si të zbatueshme në rastin

konkret (*shih vendimet nr. 20, datë 03.04.2024; nr. 69, datë 27.12.2023; nr. 4, datë 23.02.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Në çështjen konkrete, Gjykata konstaton se gjykata referuese është vënë në lëvizje për shqyrtimin e kërkesës së Prokurorisë së Korçës për dërgimin në gjyq të çështjes penale nr. 900/2024, me të pandehur shtetasin T.B., të akuzuar për kryerjen e veprës penale "Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt", të parashikuar nga neni 291 i KP-së. Ai shtetas, i moshës 20 vjeç, nën drejtimin e motomjetit të tij, me të cilin punonte, është përplasur me një mjet tjetër. Mjeti i cili drejtohej nga shtetasi T.B., sipas dokumentacionit të administruar në dosje, bën pjesë në kategorinë A1 të motomjeteve, ndërkohë që ai (shtetasi T.B.) në momentin e shkaktimit të aksidentit ka qenë i pajisur me lejedrejtimi të kategorisë B. Sipas shkronjës "ë" të pikës 2 të nenit 123 të Kodit Rrugor "*Lejedrejtimi e kategorisë B është e vlefshme në territorin kombëtar për të drejtuar mjete rrugore me tri rrota, me fuqi më të madhe se 15 kW, si dhe motomjetet e kategorisë A1, me kusht që mbajtësi i lejedrejtimit të jetë, të paktën, 21 vjeç"*. Nga verifikimi i akteve ka rezultuar se shtetasi T.B. në momentin e aksidentit ishte 20 vjeç, për rrjedhojë në atë kohë nuk ka pasur lejen përkatëse të drejtimit për mjetin të cilin drejtonte.

15. Gjykata, referuar rrethanave të çështjes në shqyrtim dhe arsyetimit të vendimit të gjykatës referuese për pezullimin e gjykimit përpara saj dhe referimin e çështjes së kushtetutshmërisë, konstaton se dispozita penale e zbatueshme në rastin konkret është neni 291 i KP-së, paragrafi i parë i të cilit "*drejtimi i automjeteve apo mjeteve të tjera të motorizuara [...] pa dëshminë përkatëse të aftësisë dënohet me burgim nga dhjetë ditë deri në tre vjet",* referon te shkronja "ë" e pikës 2 të nenit 123 të Kodit Rrugor, objekti i kërkesës në shqyrtim. Në këtë rast, duke mbajtur parasysh se shkaqet e kërkesës lidhen me antikushtetutshmërinë e dispozitës së Kodit Rrugor, e identifikuar nga gjykata referuese si e zbatueshme për zgjidhjen e çështjes konkrete, për shkak të referimit që bën në të norma penale që parashikon veprën penale për të cilën është akuzuar i pandehuri, si dhe analizën e kësaj të fundit për pamundësinë e interpretimit të normës në përputhje me Kushtetutën, Gjykata vlerëson se, në rastin konkret, janë plotësuar kriteret e legjitimimit në drejtim të identifikimit të ligjit të zbatueshëm dhe lidhjes që ka me çështjen e paraqitur për shqyrtim përpara gjykatës referuese, në kuptim të nenit 145, pika 2, të Kushtetutës dhe nenit 68 të ligjit nr. 8577/2000, ndaj prapësimi i subjektit të interesuar, Këshillit të Ministrave, në këtë drejtim është i pabazuar.

16. Për sa i përket kriterit të parashtrimit të arsyeve serioze për antikushtetutshmërinë e dispozitës së kundërshtuar, Gjykata konstaton se gjykata referuese, ndër të tjera, ka pretenduar cenimin e *parimit të prezumimit të pafajësisë*, duke argumentuar se, në rastin konkret, ligji e parashikon si krim kushtin e mospasjes së moshës të paktën 21 vjeç, për të drejtuar motomjete të kategorisë A1 dhe të pandehurit nuk i jepet mundësia të provojë mungesën e çdo rrezikshmërie të mundshme penale në veprimet e tij dhe për pasojë edhe faktin që nuk ka vepër penale.

17. Në rastin konkret, për këtë pretendim të gjykatës referuese, referuar argumenteve të saj në këtë drejtim, Gjykata vëren se ajo nuk ka arritur të provojë sesi dispozita objekt kërkese e ka cenuar këtë parim. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se gjykata referuese nuk ka paraqitur argumente kushtetuese në mbështetje të këtij pretendimi të saj.

18. Po kështu, gjykata referuese ka pretenduar se dispozita objekt kërkese ka cenuar edhe *parimin e ndarjes dhe të balancimit të pushteteve*, pasi, sipas saj, ligjvënësi u ka hequr mundësinë gjykatave të vlerësojnë nëse ka ose jo vepër penale referuar rrethanave konkrete të ngjarjes të sjellë si fakt penal nga organi i akuzës dhe ato (gjykatat) janë të detyruara që të shpallin fajtor të pandehurin vetëm me vërtetimin e mosplotësimit të kushtit të moshës 21 vjeç, pa provuar (mos) aftësinë e tij në drejtimin e motomjetit.

19. Sipas Gjykatës, parimi i ndarjes dhe i balancimit të pushteteve, i parashikuar në nenin 7 të Kushtetutës, sanksionon se ligjvënësi, ekzekutivi dhe gjyqësori janë të ndarë, efektivisht të pavarur dhe midis tyre duhet të ketë një balancë. Në përputhje me detyrat që u ka ngarkuar Kushtetuta, secili prej tyre është i pajisur me pushtet të mjaftueshëm, gjë që i jep mundësinë të marrë vendime në mënyrë të lirë e të pavarur dhe asnjë organ ose institucion tjetër, në përbërje ose jo të njërit prej tre pushteteve, nuk mund të ndërhyjë në trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve, që, sipas rastit, do të përbënin objektin qendror të veprimtarisë së organeve ose të institucioneve të tjera kushtetuese *(shih vendimet nr. 36, datë 01.06.2015; nr. 16, datë 10.04.2015 të Gjykatës Kushtetuese).*

20. Gjykata në jurisprudencën e saj ka vlerësuar se dënimi penal është rezultat i vlerësimit të rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale, nga njëra anë, dhe shkallës së fajit të autorit të saj, nga ana tjetër. Në këtë drejtim, përcaktimi i veprave penale dhe i llojeve të dënimeve janë në diskrecion të ligjvënësit, ndërsa individualizimi i tyre, rast pas rasti, është në diskrecion të gjykatës, e cila, duke shqyrtuar të gjitha elementet juridike të veprës

penale, shkallën e fajit dhe pasojat e ardhura nga vepra penale, cakton llojin dhe masën e dënimit për autorët e veprave penale (*shih vendimin nr. 47, datë 27.06.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Gjykata, bazuar në parimin e ndarjes dhe të balancimit të pushteteve, të parashikuar nga neni 7 i Kushtetutës, si dhe në përmbajtjen e nenit 29 të saj, vlerëson se në procesin penal caktimi i veprave penale dhe i dënimeve të tyre është në diskrecion të pushtetit ligjvënës, ndërsa gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, në kontekstin e funksionit kushtetues të ushtrimit të pushtetit gjyqësor në procesin penal, kanë detyrën të identifikojnë veprën penale të kryer, si dhe të individualizojnë dënimin brenda kufijve minimalë dhe maksimalë të përcaktuar nga ligjvënësi për veprën konkrete penale.

22. Gjykata vëren se KP-ja, në nenin 47 të saj, ka përcaktuar se individualizimi i dënimit është përcaktimi ndërmjet një minimumi dhe një maksimumi të ofruar nga ky kod dhe zbatimi i kësaj mase brenda kufijve të parashikuar në ligj dhe në përshtatje me karakterin e shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale dhe të autorit të saj, si dhe shkallën e fajësisë, duke pasur parasysh rrethanat rënduese dhe lehtësuese, të cilat, në mënyrë më efikase, do të ndikonin në riedukimin e autorit të veprës penale, çka do të thotë përshtatja e dënimit të veprës penale dhe kryerësit të saj. Në këtë kuptim, neni 291 i KP-së ka parashikuar se drejtimi i automjeteve ose i mjeteve të tjera të motorizuara pa dëshminë përkatëse dënohet me burgim nga dhjetë ditë deri në tre vjet dhe gjykata mund të vendosë zëvendësimin e dënimit me burgim me pagimin e një shume të hollash në favor të shtetit.

23. Për sa më lart, Gjykata vëren se, ndryshe nga sa pretendon gjykata referuese, ligjvënësi u ka dhënë mundësinë gjykatave që duke u referuar te dispozitat përkatëse të Kodit Rrugor të vlerësojnë nëse personi i cili drejton një mjet pa dëshminë përkatëse, ka kryer një vepër penale dhe të shpallet fajtor ose jo për kryerjen e saj, si dhe të individualizojnë dënimin për veprën penale të kryer. Për këtë arsye, Gjykata çmon se dispozita objekt kërkese nuk cenon thelbin e së drejtës të gjykatave në vlerësimin nëse ka ose jo vepër penale dhe në individualizimin e dënimit për veprën konkrete penale të kryer. Për rrjedhojë, në drejtim të detyrimit për parashtrimin e arsyeve serioze për antikushtetutshmërinë e dispozitës së kundërshtuar, argumentet e gjykatës referuese në drejtim të cenimit të parimit të ndarjes dhe të balancimit të pushteteve janë haptazi të pabazuara.

24. Për sa u përket pretendimeve të tjera të gjykatës referuese, Gjykata vëren se ajo ka arritur të evidentojë standardet/parimet kushtetuese të

pretenduara të cenuara prej normës së kundërshtuar, duke sjellë argumente konkrete në këtë drejtim, të cilat janë të mjaftueshme në kontekstin e vlerësimit *prima facie* të legjitimimit. Në këtë drejtim, Gjykata konstaton se sipas gjykatës referuese dispozita objekt kërkese bie në kundërshtim me Kushtetutën, pasi ajo cenon lirinë e lëvizjes, të drejtën për punë, parimin e proporcionalitetit, parimin e barazisë përpara ligjit dhe të mosdikriminimit, parimin e shtetit të së drejtës dhe të drejtën për t'u mos u dënuar pa ligj. Gjykata, duke mbajtur parasysh natyrën dhe përmbajtjen e argumenteve të parashtruara në mbështetje të këtyre pretendimeve, vlerëson se ato, në thelb, kanë të bëjnë me parimin e barazisë përpara ligjit dhe të mosdiskriminimit, të parashikuar nga neni 18 i Kushtetutës, ndaj, në vijim, do të shqyrtojë çështjen në themel në këtë drejtim.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e parimit të barazisë përpara ligjit dhe mosdiskriminimit

25. Gjykata referuese ka pretenduar se dispozita, objekt i këtij gjykimi kushtetues, trajton në mënyrë të pabarabartë drejtuesit e motomjeteve me drejtuesit e mjeteve të tjera dhe nuk ka përputhshmëri me legjislacionin evropian. Sipas saj, ky parashikim ligjor përbën një diskriminim të paarsyeshëm dhe nuk ekziston një përligjje e arsyeshme dhe objektive për kufizimin e drejtimit të motomjeteve me moshën 21 vjeç, në kushtet kur drejtuesit e motomjeteve i nënshtrohen të njëjtit testim për marrjen e lejes së drejtimit të kategorisë B, njohin mirë rregullat e qarkullimit rrugor dhe dëshmojnë se kanë aftësi shumë të mira drejtuese edhe për drejtimin e motomjeteve të kategorisë A1. Sipas gjykatës referuese, në këtë rast, personat që janë në kushte të njëjta trajtohen ndryshe nga ligji. Nga relacionet që kanë shoqëruar ndryshimet në Kodin Rrugor nuk jepet asnjë shpjegim se përse është vendosur ky kufizim moshe, edhe pse rreziku eventual dhe potencial është i njëjtë si për personat e aftë që njohin rregullat e qarkullimit rrugor dhe që drejtojnë mjetet me lejen përkatëse, ashtu edhe për ata që nuk kanë lejen përkatëse të drejtimit, por një leje tjetër, të cilët po ashtu janë njësoj të aftë fizikisht e mendërisht t`i drejtojnë ato mjete njësoj si personat që kanë lejen përkatëse. Gjykata referuese ka pretenduar se ligjvënësi nuk ka trajtuar në mënyrë të barabartë në ligjin penal dhe në përgjegjësinë penale që mbajnë personat që kanë rrezikshmëri të njëjtë shoqërore në veprimet që kryejnë.

26. Subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave, ka prapësuar se dispozita e kundërshtuar është në përputhje edhe me nenin 18 të Kushtetutës dhe se

në rastin konkret ndodhemi përpara individëve në kushte të ndryshme e jo përpara individëve në kushte të njëjta, siç paraqitet nga gjykata referuese. Sipas Këshillit të Ministrave, personat nën moshën 21 vjeç ndodhen në kushte objektivisht të ndryshme nga ata mbi moshën 21 vjeç, për shkak të njohurive dhe të përvojës në drejtimin e mjeteve motorike. Në vlerësimin e këtij subjekti, Kodi Rrugor parashikon ndarje të drejtuesve të mjeteve sipas kategorive të ndryshme, në varësi të rrezikut dhe të aftësive të ndryshme dhe mosha 21 vjeç është vendosur për të mbrojtur sigurinë publike dhe jo për diskriminim. Po kështu, Këshilli i Ministrave ka argumentuar se motomjetet përfaqësojnë vetëm 6% të numrit të përgjithshëm të mjeteve të regjistruara në vendin tonë, por shkalla e aksidenteve me viktima ose dëmtime serioze për këto mjete është shumë më e lartë se në kategoritë e tjera të mjeteve rrugore. Po sipas Këshillit të Ministrave, parashikimi ligjor ka si qëllim sigurinë rrugore dhe synon parandalimin e aksidenteve me pasoja fatale, të cilat në realitet ndodhin shpesh për shkak të mungesës së përvojës në drejtimin e motoçikletave të kategorisë A1, pasi drejtimi i motomjeteve nga persona që nuk plotësojnë kriterin e moshës dhe të përvojës përbën rrezik të drejtpërdrejtë për jetën dhe shëndetin e tyre, si dhe të individëve të tjerë.

27. Kushtetuta në nenin 18 të saj parashikon se të gjithë duhet të jenë të barabartë përpara ligjit. Kjo dispozitë, në paragrafin e dytë, sanksionon ndalimin e diskriminimit, ndërsa paragrafi i tretë mishëron në vetvete kufizimin e kësaj të drejte, por vetëm nëse ekziston një përligjje e arsyeshme dhe objektive. Parimi i barazisë synon që të gjithë të jenë të barabartë përpara ligjit, jo vetëm në të drejtat themelore të parashikuara në Kushtetutë, por edhe në të drejtat e tjera ligjore. Barazia në ligj dhe përpara ligjit nuk do të thotë që të ketë zgjidhje të njëjta për individë ose kategori personash që janë në kushte objektivisht të ndryshme. Ky parim presupozon barazinë e individëve që janë në kushte të barabarta dhe vetëm në raste përjashtimore dhe për shkaqe të arsyeshme e objektive mund të përligjet trajtimi i ndryshëm i kategorive të caktuara që përfitojnë nga kjo e drejtë (*shih vendimet nr. 35, datë 15.06.2023; nr. 27, datë 29.06.2021; nr. 10, datë 29.02.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

28. Për të vlerësuar nëse një akt normativ është diskriminues, Gjykata shqyrton nëse ai parashikon trajtim të diferencuar të subjekteve dhe në rast se e konstaton këtë fakt, ajo vlerëson nëse diferencimi ka qenë i përligjur dhe për një arsye objektive. Kjo përligjje vlerësohet e lidhur me qëllimet dhe efektet e masave të marra. Gjithashtu, nuk mjafton vetëm diferencimi i përligjur, por duhet edhe që mjeti i përzgjedhur për arritjen e qëllimit

të ligjvënësit të jetë i arsyeshëm dhe i përshtatshëm. Veçanërisht për sa u takon mjeteve të përdorura, ato duhet të jenë efektive, pra të zgjedhura në mënyrë të tillë që të jenë të përshtatshme për realizimin e synimeve që ndiqen. Respektimi i këtyre kushteve kërkon një analizë të kujdesshme në çdo rast konkret, duke ballafaquar interesin publik që dikton diferencimin e përligjur dhe arsyen objektive (*shih vendimet nr. 35, datë 15.06.2023; nr. 34, datë 10.04.2017; nr. 33, datë 08.06.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

29. Në kuptim të këtyre standardeve, Gjykata edhe në rastin konkret do të verifikojë nëse ligjvënësi ka parashikuar një trajtim të diferencuar mes subjekteve që ndodhen në kushte të njëjta, siç pretendohet nga gjykata referuese, dhe nëse një trajtim i tillë nuk respekton kriteret kushtetuese që e lejojnë atë.

30. Gjykata vëren se sipas nenit 114 të Kodit Rrugor, cilido që drejton mjete rrugore, krahas plotësimit të kërkesave fizike e psikike dhe testit psikofizik, duhet të mbushë edhe moshën e caktuar, që përcaktohet në varësi të mjetit që kërkohet të drejtohet. Për sa u përket mjeteve me motor të kategorive A1, A2, B1 dhe B, dispozita parashikon se kushdo që kërkon të drejtojë një mjet të tillë duhet të ketë mbushur moshën 18 vjeç (*pika 1, shkronja "c"*). Në këtë kuptim, Gjykata konstaton se sipas kësaj dispozite mosha minimale për t'u pajisur me lejen e drejtimit të kategorisë B dhe kategorisë A1 është 18 vjeç. Mjetet e kategorisë B dhe kategorisë A1 janë përcaktuar në nenin 115, pika 3, të Kodit Rrugor që parashikon ndarjen e lejedrejtimit sipas kategorive dhe aftësive në drejtimin e mjeteve, ku specifikisht kategoria A1 përfshin motomjetet me cilindratë jo më shumë se 125 centimetër kub dhe me fuqi jo më shumë se 11 kW dhe me raportin fuqi/peshë jo më shumë se 0,1 kW/kg, si dhe triciklat me një fuqi jo më të madhe se 15 kW, ndërsa, kategoria B përfshin mjetet motorike me masë maksimale të autorizuar jo më të madhe se 3 500 kg dhe me jo më shumë se 8 ndenjëse, përjashtuar ndenjësen e drejtuesit të mjetit. Mjetet e kësaj kategorie (B) mund të tërheqin një rimorkio të lehtë ose një gjysmërimorkio që nuk e kalon masën maksimale të autorizuar 750 kg, duke u siguruar që masa maksimale e autorizuar e këtij kombinimi të mos kalojë 4 250 kg. Në rast se kombinimi i kalon 3 500 kg, drejtuesi duhet t'i nënshtrohet një trajnimi dhe provimi të posaçëm.

31. Neni 123 i Kodit Rrugor që përcakton periudhat dhe njëvlershmëritë midis kategorive të lejedrejtimit, në pikën 2, shkronja "ë", ka parashikuar se lejedrejtimi i kategorisë B është i vlefshëm në territorin kombëtar për të drejtuar mjete rrugore me tri rrota, me fuqi më të madhe se 15 kW, si

dhe motomjetet e kategorisë A1, me kusht që mbajtësi i lejedrejtimit të jetë të paktën i moshës 21 vjeç. Referuar kësaj dispozite, objekt i gjykimit kushtetues, Gjykata vëren se mjetet rrugore me tri rrota, me fuqi më të madhe se 15 kW, si dhe motomjetet e kategorisë A1 mund të drejtohen vetëm nga personat e pajisur me lejen e drejtimit të kategorisë B dhe vetëm nëse kanë mbushur moshën 21 vjeç. Në këtë kuptim, Gjykata konstaton se, si rregull të përgjithshëm, Kodi Rrugor parashikon moshën minimale 18 vjeç për pajisjen me leje drejtimi për kategorinë B, ndërkohë që brenda kësaj kategorie ka kushtëzuar drejtimin e disa lloj mjetesh (motomjetet e kategorisë A1) edhe me mbushjen e moshës 21 vjeç. Për rrjedhojë, personat të cilët pajisen me leje drejtimi të kategorisë B pas mbushjes së moshës 18 vjeç kanë të drejtën që të drejtojnë mjetet e tjera që përfshihen në kategorinë përkatëse pa pasur ndonjë kufizim tjetër, siç është mosha në këtë rast. Në këtë mënyrë, Gjykata konstaton se dispozita e kundërshtuar ka bërë një trajtim të diferencuar ndërmjet personave të pajisur me të njëjtën leje drejtimi, ajo e kategorisë B, duke parashikuar për disa lloje motomjetesh një kriter të shtuar për drejtimin e tyre, që është mosha 21 vjeç. Për rrjedhojë, Gjykata, në vijim, do të vlerësojë nëse në rastin konkret ka një përligjje të arsyeshme dhe objektive që justifikon këtë trajtim të diferencuar brenda së njëjtës kategori të individëve.

32. Gjykata vëren se kategoritë e mjeteve rrugore janë përcaktuar në nenin 115 të Kodit Rrugor, i cili i ka ndarë ato sipas tipologjisë, kategorisë, shpejtësisë, madhësisë, fuqisë ose peshës, të kombinuara këto elemente me njëri-tjetrin. Gjithashtu, Gjykata konstaton se përveç kufizimit të lidhur me moshën të vendosur në dispozitën e kundërshtuar, ky kod parashikon edhe kufizime të tjera për dhënien e lejeve të drejtimit për disa kategori të caktuar personash, bazuar në gjendjen fizike, shëndetësore, mendore, ose moshës, apo eksperiencës, duke i lidhur këto me tipologjinë, kategorinë, shpejtësinë, madhësinë, fuqinë ose peshën e mjeteve.

33. Kështu, sipas Kodit Rrugor, cilido që drejton mjete me motor nuk duhet të ketë kaluar moshën 70 vjeç për të drejtuar autobusë, kamionë, kamionë me rimorkio, gjysmërimorkiatorë, artikularë të tjerë, të caktuar për transport personash dhe mjete me motor për transport malli (*neni 114, pika 2*). Në dispozitat vijuese, Kodi Rrugor ka përcaktuar edhe dhënien e lejeve të drejtimit për personat me aftësi të kufizuara, si dhe certifikatat e aftësisë profesionale për drejtimin e motomjeteve dhe të automjeteve për to, duke e kufizuar dhënien e tyre vetëm për disa kategori të caktuara mjetesh (*neni 115/1*), si dhe ka ndaluar pajisjen me leje drejtimi dhe/ose autorizim për t'u

ushtruar në drejtim mjeti për personat e prekur nga sëmundje fizike apo çrregullime të shëndetit mendor, ose për ata që kanë paaftësi anatomike ose funksionale, të tilla që e pengojnë të drejtojë në mënyrë të sigurt një mjet me motor (*neni 117, pika 1*). Po kështu, Gjykata vëren se Kodi Rrugor ka përcaktuar edhe kufizime të tjera në varësi të përvojës së individëve në drejtimin e mjeteve, duke parashikuar se disa kategori mjetesh mund të drejtohen nga zotëruesit e një lejeje drejtimi të caktuar, vetëm pasi kanë kaluar një, dy ose tre vjet nga marrja e saj (*nenet 117/1, pikat 1 dhe 1/1, dhe 123, pika 1, shkronjat "c", "ç" dhe "d"*).

34. Sipas Kodit Rrugor, zotëruesve të lejedrejtimeve vendase të grupit "A" për tre vjetët e para pas marrjes së lejedrejtimit nuk u lejohet drejtimi i motomjeteve me fuqi prej 25 kW specifike referuar ngarkesës, ose 0,16 kW/kg (*neni 117/1, pika 1*). Ndërsa mbajtësve të lejeve të drejtimit të kategorisë B, në dy vjetët e para të lëshimit, nuk u lejohet të drejtojnë mjete motorike me fuqi specifike, referuar masës bosh të mjetit, më të madhe se 55 kW/tonë. Për makinat hibride elektrike ose plug-in, kufiri specifik i fuqisë është 65 kW/tonë, duke përfshirë peshën e baterisë (*neni 117/1, pika 1/1*). Një tjetër kufizim që parashikon Kodi Rrugor për pajisjen me lejedrejtimi është edhe ai i përcaktuar në nenin 123, pika 1, shkronja "ç", paragrafët e dytë dhe të tretë, sipas të cilëve mosha minimale për t'u pajisur me lejedrejtimi D1 dhe lejedrejtimi D1E është 21 vjeç, ndërsa për pajisjen me lejedrejtimi të kategorisë D është 24 vjeç, lejedrejtimi për të cilat mund të aftësohen vetëm personat e pajisur me leje drejtimi të kategorisë B, të marrë përkatësisht prej 3 vjetësh ose 12 muajve. Nga ana tjetër, referuar edhe parashikimeve të akteve të zbatueshme për përgatitjen dhe pajisjen me lejedrejtimi, rezulton se programi dhe prova e praktikës për pajisjen me lejedrejtimi të kategorisë A1 dhe të kategorisë B janë të ndryshme.

35. Gjykata vëren se neni 123 i Kodit Rrugor në kohën e miratimit të tij nuk parashikonte ndonjë kusht të posaçëm për drejtimin e motomjeteve brenda së njëjtës kategori. Me ligjin nr. 175/2014, datë 18.12.2014 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8378, datë 22.07.1998 "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar"", ligjvënësi ka ndryshuar edhe përmbajtjen e nenit 123 të Kodit Rrugor, duke shtuar edhe shkronjën "ë" në pikën 2 të këtij neni, sipas formulimit aktual. Edhe pse ky kod ka pësuar ndryshime të tjera gjatë viteve, kjo dispozitë ka mbetur e njëjtë në formulim. Gjykata konstaton se sipas subjektit të interesuar,

Këshillit të Ministrave, vendosja e këtij kriteri moshe (mbushja e moshës 21 vjeç), ka qenë një kusht i parashikuar nga legjislacioni i Bashkimit Evropian.

36. Gjykata, referuar direktivës 2006/126/EC "Për lejet e drejtimit" të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, vëren se sipas saj triciklat me një fuqi më të madhe se 15 kW mund të drejtohen nga personat të cilët janë të pajisur me leje drejtimi të kategorisë B, me kusht që mbajtësi i lejedrejtimit të jetë të paktën i moshës 21 vjeç. Ndërsa për mjetet e kategorisë A1 direktiva parashikon se ato mund të drejtohen nga mbajtësit e lejedrejtimit të kategorisë B (*neni 6, pika 3, i direktivës*).

37. Më tej, nga një vështrim i përgjithshëm krahasimor i legjislacionit të brendshëm të disa shteteve evropiane, Gjykata vëren se Kodi Rrugor italian nuk ka parashikuar asnjë kusht shtesë nga ato të parashikuara nga direktiva. Ndryshe ka vepruar Spanja, e cila në legjislacionin e saj ka parashikuar kushte shtesë vetëm për drejtimin e mjeteve të kategorisë A1, duke përcaktuar mbajtjen e lejes së drejtimit të kategorisë B për të paktën 3 vjet. Edhe Austria edhe Gjermania kanë transpozuar variantin e direktivës me kushte shtesë për drejtimin e mjeteve të kategorisë A1, duke parashikuar se ato mund të drejtohen nga mbajtësit e lejeve të drejtimit të kategorisë B, pas kalimit të një periudhe prej pesë vjetësh (pa ndërprerje në rastin e Austrisë) nga mbajtja e leje drejtimit të kategorisë B. Në këtë rast, Gjermania ka vendosur edhe kushtin e mbushjes së moshës 25 vjeç dhe realizimit të trajnimit të detyrueshëm, ndërsa Austria ka vendosur kushtin e mosqenies në periudhë prove dhe përfundimit të trajnimit praktik në drejtimin e këtyre mjeteve. Franca lejon drejtuesin e pajisur me lejedrejtimi të kategorisë B të drejtojë edhe mjete rrugore me tre rrota me fuqi më të madhe se 15 kW, por përveç mbushjes së moshës minimale 21 vjeç që parashikon direktiva, ka vendosur edhe dy kushte të tjera shtesë që janë përvoja të paktën dyvjeçare me lejen e drejtimit të kategorisë B dhe detyrimi për trajnim praktik, duke vendosur një standard më të rreptë në nivel kombëtar. Ndërsa shtete si Holanda dhe Greqia kanë mbajtur ndarje të plotë midis lejeve të drejtimit të kategorisë B dhe kategorisë A1, ku drejtimi i mjeteve me tre rrota mbi 15 kW ose i motomjeteve të kategorisë A1 kërkon pajisje të veçantë me kategori të re lejedrejtimi.

38. Në kuptim të sa më sipër, Gjykata vëren se direktiva e BE-së, ashtu edhe legjislacioni i disa shteteve evropiane, si më sipër, sjellin qasje të ndryshme, ku në disa prej tyre nuk janë parashikuar kushte shtesë përveç

atyre që parashikon direktiva, kurse në legjislacionet e tjera gjenden të parashikuara kushte shtesë për drejtimin e mjeteve të kategorisë A1, të cilat kanë të bëjnë me arritjen e një moshe të caktuar ose me përvojën në drejtimin e një kategorie të caktuar mjeti, në të njëjtën mënyrë siç ka vepruar ligjvënësi shqiptar.

39. Në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se përkufizimi i një rregullimi juridik, nëse është ose jo *objektivisht* i arsyetuar, nuk është vetëm një çështje e thjeshtë juridike, por kërkon edhe një vlerësim real. Diferencimet, si dhe arsyet që çojnë tek to ose kundër tyre duhen ballafaquar për t'ia lënë në dorë përfundimisht vendimin organit kompetent, sipas kritereve të tij. Mënyra e zgjidhjes është një e drejtë e organit përkatës, sepse çdo çështje ka specifikat e saj. Ndodhemi përpara diskriminimit kur subjekte juridike që ndodhen në të njëjtën gjendje trajtohen në mënyra të ndryshme pa justifikim ligjor të arsyeshëm dhe objektiv. Natyrisht që përkufizimi i çdo kriteri për ta cilësuar arsyetimin *objektiv* varet në një masë të madhe nga çmuarja e vlerave dhe nuk mund të jetë i përcaktuar në mënyrë precize *(shih vendimet nr. 20, datë 20.04.2021; nr. 48, datë 15.11.2013; nr. 4, datë 12.02.2010 të Gjykatës Kushtetuese)*.

40. Gjykata vëren se, bazuar në argumentet e subjektit të interesuar, Këshillit të Ministrave, rezulton se kushti i moshës 21 vjeç në dispozitën objekt gjykimi është vendosur për shkak të numrit të lartë të aksidenteve me viktima ose dëmtimeve serioze nga këto mjete, në krahasim me ato të shkaktuara nga mjetet rrugore të kategorive të tjera, pra për një interes publik, i cili është i lidhur drejtpërdrejt me sigurinë rrugore dhe në këtë rast përfshin jo vetëm mbrojtjen e jetës, por dhe shëndetin dhe sigurinë fizike të individëve. Nga ana tjetër, Gjykata konstaton se ky interes publik lidhet edhe me mbrojtjen e të rinjve, pasi përmes këtij parashikimi ligjor synohet të parandalohen pasojat e përdorimit të këtyre mjeteve me rrezikshmëri të lartë nga personat që konsiderohen se nuk kanë moshën dhe pjekurinë e duhur për drejtimin e tyre. Gjykata vlerëson të theksojë se edhe sipas nenit 54 të Kushtetutës të rinjtë kanë të drejtën e një mbrojtjeje të veçantë nga shteti, që reflektohet edhe në marrjen e masave me natyrë pozitive për t`i mbrojtur ata edhe nga veprime që mund të sjellin pasoja për jetën dhe të ardhmen e tyre në mënyrë të drejtpërdrejtë. Po kështu, edhe KP-ja ka ofruar në vazhdimësi një mbrojtje të veçantë për të rinjtë e moshës deri në 21 vjeç, duke i përfshirë ata në subjektet që përfitojnë nga alternativat e dënimit me burgim (*neni 59/a, paragrafi i parë, shkronja "d"*).

41. Nisur nga sa më lart, Gjykata, duke pasur parasysh vlerat dhe interesat që vihen në diskutim, në rastin konkret, çmon se parashikimi ligjor i shkronjës "ë" të pikës 2 të nenit 123 të Kodit Rrugor edhe pse përbën një trajtim të diferencuar mes subjekteve që përfshihen brenda së njëjtës kategori, pra që kanë lejedrejtimi të kategorisë B, ka një justifikim ligjor të arsyeshëm, objektiv dhe të justifikuar. Pavarësisht se dispozita ligjore e kundërshtuar përmes këtij gjykimi incidental diferencon në trajtim personat që janë të pajisur me lejedrejtimi të kategorisë B, në varësi të natyrës, karakteristikave dhe sigurisë që ofron mjeti rrugor që drejtohet prej tyre, duke ndaluar përdorimin e motomjeteve të kategorisë A1, në rast se nuk kanë mbushur moshën 21 vjeç, ndonëse e kanë mbushur atë për pajisjen me lejedrejtimi, qëllimi që synohet të arrihet është jo vetëm siguria rrugore në drejtimin e mjeteve rrugore, por edhe mbrojtja e jetës dhe e shëndetit të qytetarëve, sidomos e vet të rinjve që mund të përdorin këto mjete. Gjykata konstaton se ligjvënësi, duke parashikuar një kufi moshe minimale për drejtimin e mjeteve të kategorisë A1, që është tre vjet më i lartë se kufiri minimal për drejtimin e mjeteve të kategorisë B, ka synuar të rrisë jo vetëm nivelin e maturisë në vlerësimin dhe shmangien e rrezikut të mundshëm në qarkullim, por edhe eksperiencën 1-3 vjeçare për ata që e kanë marrë lejen e drejtimit të kategorisë A1 në kufirin e moshës minimale ose afër tij (18-21 vjeç). Për rrjedhojë, Gjykata arrin në përfundimin se në rastin konkret kjo ndërhyrje e ligjvënësit ka pasur një përligjje të arsyeshme, të përshtatshme dhe objektive, ndaj pretendimi i gjykatës referuese është i pabazuar.

42. Në përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimi i gjykatës referuese për cenimin e parimit të barazisë përpara ligjit dhe të mosdiskriminimit, nga përmbajtja e nenit 123, pika 2, shkronja "ë", të Kodit Rrugor, nuk është i bazuar, sipas arsyetimit të mësipërm të këtij vendimi, ndaj kërkesa rrëzohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja "a" dhe 134, pika 1, shkronja "dh", të Kushtetutës, si dhe neneve 68, 70, 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me shumicë votash,

V E N D O S I:

1. Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 24.09.2025
Shpallur më 27.10.2025

MENDIM PAKICE

1. Në gjykimin kushtetues të çështjes që i përket kërkueses, Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, me objekt: "*Shfuqizimin e nenit 123, pika 2, shkronja "ë", të ligjit nr. 8378, datë 22.07.1998 "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë*", jam kundër qëndrimit të shumicës për rrëzimin e kërkesës dhe vlerësoj se ajo duhej të ishte pranuar, për shkak se dispozita e kundërshtuar cenon parimin e barazisë përpara ligjit dhe të mosdiskriminimit, të parashikuar nga neni 18 i Kushtetutës. Për këtë arsye, në mbështetje të nenit 132, pika 3, të Kushtetutës dhe nenit 72, pika 8, të ligjit nr. 8577/2000, që parashikojnë publikimin e mendimit të pakicës së bashku me vendimin përfundimtar të Gjykatës, në vijim do të parashtroj argumentet që mbështesin qëndrimin tim kundër.

2. Sipas rrethanave të rastit konkret, të parashtruara edhe nga shumica, ka rezultuar se shtetasi T.B., gjatë drejtimit të motomjetit të tij është përplasur me një automjet, duke shkaktuar aksident. Nga verifikimi i kryer ka rezultuar se mjeti i drejtuar nga shtetasi T.B. bënte pjesë në kategorinë A1 të motomjeteve, ndërkohë që ai ka qenë i pajisur me lejedrejtimi të kategorisë B, e cila, sipas shkronjës "ë" të pikës 2 të nenit 123 të Kodit Rrugor *"është e vlefshme në territorin kombëtar për të drejtuar mjete rrugore me tri rrota, me fuqi më të madhe se 15 kW, si dhe motomjetet e kategorisë A1, me kusht që mbajtësi i lejedrejtimit të jetë, të paktën, 21 vjeç*". Nga verifikimi i drejtuesit të mjetit, shtetasi T.B., ka rezultuar se ishte i moshës 20 vjeç, për rrjedhojë nuk ka pasur lejen përkatëse të drejtimit, Prokuroria e Korçës ka regjistruar ndaj tij procedimin penal për kryerjen e veprës penale "Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt", të parashikuar nga neni 291 i KP-së, i cili parashikon se "*drejtimi i automjeteve apo mjeteve të tjera të motorizuara [...] pa dëshminë përkatëse të aftësisë dënohet me burgim nga dhjetë ditë deri në tre vjet*". Në vijim, Prokuroria e Korçës ka paraqitur në gjykatën referuese kërkesë për dërgimin e kësaj çështjeje në gjyq. Nga ana e saj, gjykata referuese, pas kërkesës së palëve, ka vendosur të pezullojë gjykimin e çështjes në shqyrtim përpara saj dhe t'i drejtohet Gjykatës me kërkesë për shfuqizimin e shkronjës "ë" të pikës 2 të nenit 123 të Kodit Rrugor.

3. Në vlerësimin e kërkueses, gjykatës referuese, ky përcaktim i dispozitës së kundërshtuar bie në kundërshtim me parimin e barazisë përpara ligjit dhe të mosdiskriminimit, pasi përbën një diskriminim të paarsyeshëm dhe nuk ekziston një përligjje e arsyeshme dhe objektive për kufizimin e drejtimit të motomjeteve me moshën 21 vjeç, në kushtet kur drejtuesit e motomjeteve i nënshtrohen të njëjtit testim për marrjen e lejes së drejtimit të kategorisë B, njohin mirë rregullat e qarkullimit rrugor dhe dëshmojnë se kanë aftësi shumë të mira drejtuese edhe për drejtimin e motomjeteve të kategorisë A1. Sipas gjykatës referuese, në këtë rast, personat që janë në kushte të njëjta trajtohen ndryshe nga ligji.

4. Ndërkohë ky pretendim i gjykatës referuese është kundërshtuar nga subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave, sipas të cilit dispozita e kundërshtuar është në përputhje edhe me nenin 18 të Kushtetutës dhe, se në rastin konkret ndodhemi përpara individëve në kushte të ndryshme e jo përpara individëve në kushte të njëjta. Sipas Këshillit të Ministrave, personat nën moshën 21 vjeç ndodhen në kushte objektivisht të ndryshme nga ata mbi moshën 21 vjeç, për shkak të njohurive dhe përvojës në drejtimin e mjeteve motorike.

5. Në shqyrtimin e pretendimeve dhe të prapësimeve të mësipërme, shumica ka vlerësuar se, bazuar në argumentet e subjektit të interesuar, Këshillit të Ministrave, rezulton se kushti i moshës 21 vjeç në dispozitën objekt gjykimi është vendosur për shkak të numrit të lartë të aksidenteve me viktima ose dëmtimeve serioze nga këto mjete, në krahasim me ato të shkaktuara nga mjetet rrugore të kategorive të tjera, pra për një interes publik, i cili është i lidhur drejtpërdrejt me sigurinë rrugore dhe në këtë rast përfshin jo vetëm mbrojtjen e jetës, por edhe shëndetin edhe sigurinë fizike të individëve. Nga ana tjetër, shumica ka konstatuar se ky interes publik lidhet edhe me mbrojtjen e të rinjve, pasi përmes këtij parashikimi ligjor synohet të parandalohen pasojat e përdorimit të këtyre mjeteve me rrezikshmëri të lartë nga personat që konsiderohen se nuk kanë moshën dhe pjekurinë e duhur për drejtimin e tyre, duke referuar në nenin 54 të Kushtetutës *(shih paragrafin 40 të vendimit*). Po sipas shumicës, edhe pse parashikimi ligjor i shkronjës "ë" të pikës 2 të nenit 123 të Kodit Rrugor përbën një trajtim të diferencuar mes subjekteve që përfshihen brenda së njëjtës kategori, pra që kanë lejedrejtimi të kategorisë B, ka një justifikim ligjor të arsyeshëm, objektiv dhe të justifikuar. Po kështu, shumica ka vlerësuar se pavarësisht se dispozita ligjore e kundërshtuar përmes këtij gjykimi incidental diferencon në trajtim personat që janë të pajisur me

lejedrejtimi të kategorisë B në varësi të natyrës së mjetit rrugor që drejtohet nga ata, duke ndaluar përdorimin e motomjeteve të kategorisë A1, në rast se nuk kanë mbushur moshën 21 vjeç, ndonëse kanë mbushur atë për pajisjen me lejedrejtimi, qëllimi që synohet të arrihet, është jo vetëm siguria rrugore në drejtimin e mjeteve rrugore, por edhe mbrojtja e jetës dhe e shëndetit të qytetarëve, sidomos të vet të rinjve që mund të përdorin këto mjete (*shih paragrafin 41 të vendimit*).

6. Ndërkohë, në rastin konkret, është konstatuar se nga subjekti i interesuar, Kuvendi, si organi i cili ka miratuar Kodin Rrugor, pra dispozitën e kundërshtuar nga gjykata referuese, nuk u paraqit asnjë argument për nevojën e miratimit të saj ose referenca konkrete për bazueshmërinë e kësaj dispozite ligjore dhe as arsye se përse kjo dispozitë parashikon një kusht shtesë, mbushjen e moshës 21 vjeç për drejtimin e mjeteve të kategorisë A1, kur për t'u pajisur me këtë kategori lejedrejtimi qytetarët mjafton të kenë mbushur moshën 18 vjeç. Po kështu, as nga subjekti tjetër i interesuar, Këshilli i Ministrave, nuk u paraqitën argumente bazuar në të dhëna statistikore se përse vendosja e këtij kushti shtesë për personat e pajisur me lejedretimi të kategorisë B mbron interesin publik, duke rritur sigurinë rrugore dhe duke mbrojtur në këtë mënyrë edhe interesin publik. Në këtë gjykim kushtetues, nga subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave, nuk u paraqit asnjë argument se përse personat e pajisur me lejedrejtimi të kategorisë B, të cilët nuk kanë mbushur moshën 21 vjeç, nuk janë të aftë të drejtojnë mjetet e kategorisë A1, si dhe nuk u arrit të provohej nëse ky diferencim sillte mbrojtje më të madhe për sigurinë rrugore, shëndetin dhe jetën e qytetarëve, duke mbrojtur interesin publik.

7. Për këto arsye, ndryshe nga shumica, çmoj se ky parashikim ligjor, duke sjellë një diferencim ndërmjet personave të pajisur me lejedrejtimi të kategorisë B, për drejtimin e mjeteve të kategorisë A1, nuk ka një përligjje të arsyeshme dhe objektive, në drejtim të garantimit të sigurisë në drejtimin e mjeteve rrugore dhe as në drejtim të mbrojtjes së jetës dhe të shëndetit të qytetarëve. Në vlerësimin tim, edhe pse legjislacioni i disa shteteve evropiane ka parashikuar kushte shtesë për drejtimin e mjeteve të kategorisë A1, përveç atyre të përcaktuara nga direktiva 2006/126/EC "Për lejet e drejtimit" të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, sipas së cilës mjetet e kategorisë A1 mund të drejtohen nga mbajtësit e lejedrejtimit të kategorisë B (*neni 6, pika 3, i direktivës*), pa parashikuar asnjë kusht tjetër shtesë, nuk përbën arsye të përligjur për të diferencuar subjektet që përfshihen brenda së njëjtës kategori.

8. Për rrjedhojë, jam e mendimit se pretendimi i gjykatës referuese se dispozita objekt kërkese cenon parimin e barazisë përpara ligjit dhe të mosdiskriminimit është i bazuar dhe duhej pranuar nga Gjykata.

Anëtare: Sonila Bejtja

Vendim nr. 50, datë 25.09.2025
(V-50/25)

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Holta Zaçaj, Kryetare, Marsida Xhaferllari, Fiona Papajorgji, Sonila Bejtja, Sandër Beci, Ilir Toska, Marjana Semini, Genti Ibrahimi, anëtarë, me sekretare Anjeza Puka, në datën 25.09.2025 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 24 (K) 2024 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: **KOSTANDIN XHOLLI,** i përfaqësuar nga avokat Altin Ibro, me prokurë.

SUBJEKT I INTERESUAR:
AGJENCIA E TRAJTIMIT TË PRONAVE, TIRANË, në mungesë.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimeve nr. 10-2015-1185(523), datë 19.05.2015 të Gjykatës së Apelit Durrës; nr. 00-2024-1183, datë 19.03.2024 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Dërgimi i çështjes për rigjykim në gjykatën kompetente të apelit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 42 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 71 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*); neni 460 i Kodit të Procedurës Civile (*KPC*).**

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Genti Ibrahimi, mori në shqyrtim parashtrimet me shkrim të kërkuesit Kostandin Xholli (*kërkuesi*), që ka

kërkuar pranimin e kërkesës, konstatoi mungesën e prapësimeve me shkrim të subjektit të interesuar, Agjencisë së Trajtimit të Pronave (*ATP*), Tiranë, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I
Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi është një nga trashëgimtarët ligjorë të shtetasit J.Xh. (i biri), për të cilin Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me vendimin nr. 2682, datë 22.10.1996, ka vendosur vërtetimin e faktit juridik të pronësisë përpara reformës agrare për një sipërfaqe toke prej 39.2 dynymsh, të ndodhur në fshatin Gjinar, Elbasan, sipas parcelave dhe kufizimeve përkatëse, por pa përcaktuar vendndodhjen e këtyre pronave në hartat treguese të pasurive. Po kështu, me vendimin nr. 1720, datë 22.11.2002, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan ka vendosur vërtetimin e faktit juridik të pronësisë të ish-pronarit J.Xh. edhe për disa pasuri të paluajtshme të ndodhura në fshatin Gjinar, Elbasan, duke përcaktuar vendndodhjen e tyre, e pasqyruar kjo në hartat e përgatitura nga eksperti i thirrur në gjykim.

2. Kërkuesi, në cilësinë e trashëgimtarit ligjor, në datën 27.09.1996, në bazë të ligjit nr. 7698/1993 "Për kthimin dhe kompensimin e pronave" *(ligji nr. 7698/1993)* i është drejtuar Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave të Rrethit Elbasan me kërkesë për njohjen dhe kthimin e kompensimin e pronave të ish-pronarit J.Xh. Duke qenë se kërkuesi nuk ka paraqitur hartat për përcaktimin e vendndodhjes së pronave, kërkesa nuk është marrë në shqyrtim.

3. Me shkresën nr. 710, datë 06.06.2008 të Zyrës Rajonale të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (*ZRKKP*), qarku Elbasan, është bërë shpallja publike për njoftimin e të gjitha subjekteve që kishin paraqitur kërkesa në ish-KKKP të cilat nuk ishin shqyrtuar ende, duhet të paraqisnin dokumentacionin sipas kërkesave të ligjit nr. 9235/2004 dhe akteve të dala në zbatim të tij. Duke qenë se kërkuesi nuk ka paraqitur dokumente të tjera veç atyre të paraqitura deri në daljen e shpalljes, me vendimin nr. 526, datë 04.09.2008, ZRKKP-ja, Elbasan ka vendosur mosnjohjen e së drejtës së pronësisë të subjektit kërkues, përfaqësues i subjektit të shpronësuar J.Xh.

4. Kundër këtij vendimi kërkuesi ka paraqitur ankim në Agjencinë e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave *(sot ATP),* Tiranë. Kjo e fundit,

me vendimin nr. 1168, datë 20.11.2008, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të ZRKKP-së, Elbasan, me arsyetimin se kërkuesi nuk ka arritur të provojë me dokumentacionin e duhur ligjor të drejtën e pronësisë të ish-pronarit mbi pasuritë e pretenduara. Duke mos qenë dakord me këto vendime administrative, kërkuesi i është drejtuar gjykatës me padi me objekt kundërshtimin e vendimeve të ZRKKP-së, Elbasan dhe të ish-AKKP-së, Tiranë.

5. Me vendimin nr. 1004, datë 27.04.2010, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan ka vendosur të pranojë padinë e kërkuesit, duke anuluar vendimet e ZRKKP-së, Elbasan dhe të ish-AKKP-së, Tiranë dhe ka njohur të drejtën e pronësisë të ish-pronarit J.Xh. (trashëgimtarëve të tij) mbi një sipërfaqe toke bujqësore pyll, kullotë e livadh prej 89220 m^2, të ndodhur në fshatin Gjinar, Elbasan, në parcelat me sipërfaqet dhe kufizimet sipas vendimit, nga e cila ka vendosur kthimin fizik për sipërfaqen 72097 m^2 dhe kompensimin, në një nga format e parashikuara nga ligji, për sipërfaqen 17123 m^2. Ky vendim është prishur me vendimin nr. 10-2012-1114 (548), datë 09.07.2012 të Gjykatës së Apelit Durrës, dhe çështja është kthyer për rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

6. Në rigjykim, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me vendimin nr. 2324 (13-2013-6587), datë 21.11.2013, ka vendosur rrëzimin e padisë si të pabazuar në ligj e në prova, duke vlerësuar se dokumentet e paraqitura nga paditësi (kërkuesi) nuk janë të asnjë prej llojeve të dokumenteve që parashikohen nga ligji si akte për vërtetimin e pronësisë. Sipas gjykatës, me dokumentacionin e paraqitur, nuk provohet pronësia e shtetasit J.Xh. për pronat e pretenduara, ndaj vendimet e ZRKKP-së, Elbasan dhe ish-AKKP-së, Tiranë, që kanë rrëzuar kërkesën, janë të bazuara në ligj e në prova dhe nuk ka vend për cenimin e tyre. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim kërkuesi.

7. Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. 10-2015-1185 (523), datë 19.05.2015, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, duke vlerësuar se ai është marrë në zbatim korrekt të ligjit dhe është i bazuar në provat shkresore të nënshtruara shqyrtimit gjyqësor, ndërsa pretendimet e ngritura në ankim janë të pabazuara. Kundër këtij vendimi ka paraqitur rekurs kërkuesi.

8. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, me vendimin nr. 00-2024-1183, datë 19.03.2024, ka vendosur mospranimin e rekursit, pasi nuk përmban shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 472 të KPC-së. Sipas Kolegjit Civil, shkaqet e parashtruara në rekurs ngrenë

çështje të vlerësimit të provave dhe fakteve, të cilat dalin jashtë juridiksionit rishikues dhe ligjor të Gjykatës së Lartë.

9. Në datën 25.11.2024 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*), me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij, i cili, pasi është plotësuar sipas kërkesave të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 06.12.2024. Kolegji i Gjykatës në datën 05.03.2025 ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në Mbledhjen e Gjyqtarëve, e cila në datën 06.03.2025 ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II
Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

10. ***Kërkuesi*****,** në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar e drejta për proces të rregullt ligjor, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të:

10.1. *Së drejtës për t'u njoftuar dhe parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit në gjykim,* sepse kërkuesi nuk ka marrë dijeni për datën dhe orën e gjykimit të çështjes në gjykatën e apelit, për shkak se nuk është njoftuar rregullisht dhe njoftimi nuk është realizuar sipas parashikimeve të KPC-së. Gjykata e apelit nuk e ka shqyrtuar çështjen në seancën e datës 05.05.2015, pasi njëri nga anëtarët e trupit gjykues ka pasur pengesa, ndaj ka urdhëruar njoftimin e palëve me shpallje për seancën e radhës. Shpallja për seancën gjyqësore të datës 19.05.2015 nuk është afishuar pranë gjykatës së shkallës së parë, në kundërshtim me nenin 460 të KPC-së, çka provohet nga aktet bashkëlidhur kërkesës (shkresa e kancelarit të Gjykatës të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan), sipas së cilës, nga verifikimi dhe kontrolli pranë zyrës së arkivës, nuk rezulton të jetë protokolluar shkresa për periudhën maj 2015 e dërguar nga gjykata e apelit.

10.2. Gjykata e Lartë, në lajthim, shprehet në vendimin e Kolegjit Civil se gjykimi në gjykatën e apelit është bërë në prani të palëve edhe pse kjo verifikohet nga përmbajtja e vendimit të gjykatës së apelit, sipas të cilit çështja është gjykuar në mungesë të palëve ndërgjyqëse. Kërkuesi mundi të paraqesë parashtrime në Gjykatën e Lartë vetëm në datën 15.03.2024, përmes shërbimit postar, dhe në sekretari ditën e hënë, datë 18.03.2024, pra brenda afatit

5-ditor nga njoftimi me shpallje i asaj gjykate i datës 04.03.2024. Nëse verifikohet relacioni i këshilltarit ligjor, ai është simetrik me vendimin dhe mban datën 15.03.2024, ditë e shpallur pushim me VKM-në nr. 156, datë 13.03.2024. Pra, ai daton përpara parashtrimeve të kërkuesit dhe qartazi nuk i ka marrë në konsideratë ato. Për pasojë, nuk është respektuar instrumenti ligjor i kërkuesit "për t'u dëgjuar shkresërisht" për të pasur akses në atë gjykatë dhe për të ngritur çështje që mund të merren parasysh edhe kryesisht nga Gjykata e Lartë.

10.3. Po ashtu, Gjykata e Lartë ka referuar në mënyrë të gabuar si subjekt suksedues të AKKP-së Agjencinë Shtetërore të Kadastrës dhe jo Agjencinë e Trajtimit të Pronave, sipas ligjit. Në prizmin e seriozitetit të shqyrtimit të çështjes dhe gabimeve të tjera të konstatuara, edhe ky element cenon të drejtën për proces të rregullt.

11. ***Subjekti i interesuar, Agjencia e Trajtimit të Pronave,*** nuk ka paraqitur prapësime me shkrim, edhe pse është njoftuar rregullisht.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkuesit

12. Çështja e legjitimimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

13. Gjykata vlerëson se kërkuesi legjitimohet *ratione personae,* në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, sepse ka qenë palë në procesin gjyqësor të kundërshtuar dhe ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

14. Lidhur me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, Gjykata vëren se kërkuesi i është drejtuar asaj me ankim kushtetues individual pas përfundimit të procesit gjyqësor në të tria shkallët e gjyqësorit të zakonshëm dhe pasi ka shteruar në formë e substancë mjetet e zakonshme të ankimit ndaj vendimeve të gjykatave më të ulëta. Për rrjedhojë, ai nuk ka mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të tij kushtetuese përveç paraqitjes së ankimit kushtetues individual.

15. Kërkuesi legjitimohet edhe *ratione temporis*, në kuptim të përmbajtjes së nenit 71/a, pika 1, shkronja "b", të ligjit nr. 8577/2000, pasi vendimi më i fundit në kohë i kundërshtuar, ai i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, mban datën 19.03.2024, i cili i është njoftuar avokatit të kërkuesit përmes postës elektronike në datën 23.07.2024, ndërsa kërkesa është paraqitur në këtë Gjykatë në datën 25.11.2024, dita e parë e punës pas festës zyrtare që përkon me datën 22.11.2024 (dita e premte). Sipas nenit 15, pika 3, të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, kur afati mbaron në ditë pushimi ose feste, ai shtyhet deri në ditën pasardhëse të punës ose jofestive. Për rrjedhojë, kërkesa është paraqitur brenda afatit ligjor.

16. Për sa i takon legjitimimit *ratione materiae*, kërkuesi ka pretenduar, ndër të tjera, se relacioni i këshilltarit ligjor jo vetëm që është simetrik me vendimin e Kolegjit Civil, çka provon qartazi se pretendimet e tij nuk janë marrë në konsideratë, por edhe mban datën 15.03.2024, ditë e shpallur pushim me VKM-në nr. 156, datë 13.03.3024.

17. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se veprimtaria që ushtron këshilltari ligjor ka karakter këshillues dhe ndihmës, në ndryshim nga ajo e gjyqtarit, që ka karakter vendimmarrës. Rregullat procedurale që normojnë veprimtarinë e Gjykatës së Lartë kanë përcaktuar në mënyrë të qartë rolin dhe pozicionin, si dhe kompetencat e këshilltarit ligjor gjatë procesit të vendimmarrjes *(shih vendimet nr. 49, datë 05.10.2023; nr. 42, datë 19.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese)*. Po sipas Gjykatës, kur pretendimet e ngritura kanë të bëjnë me mospërputhje në linjë dhe në arsyetim ndaj akteve të brendshme me natyrë përgatitore dhe ndihmuese dhe vendimeve përfundimtare, kontrolli kushtetues ushtrohet vetëm ndaj këtyre të fundit *(shih vendimin nr. 4, datë 31.01.2024 të Gjykatës Kushtetuese)*. Për rrjedhojë, ky pretendim i kërkuesit është haptazi i pabazuar, pasi jo vetëm që nuk është argumentuar nga pikëpamja kushtetuese cenimi i ardhur

në të drejtat e tij për këtë shkak, por, nga ana tjetër, VKM-ja e referuar është e detyrueshme për zbatim ndaj administratës shtetërore dhe nuk është e detyrueshme për zbatim ndaj çdo institucioni tjetër që u përket pushteteve të tjera, në rastin konkret atij gjyqësor.

18. Kërkuesi ka pretenduar edhe cenimin e *së drejtës për t`u njoftuar dhe të parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit në gjykim*, për shkak të mosmarrjes dijeni për datën dhe orën e gjykimit të çështjes në gjykatën e apelit, pasi nuk është njoftuar nga gjykata rregullisht sipas parashikimeve të KPC-së, me pasojë zhvillimin e gjykimit në mungesë të kërkuesit. Sipas kërkuesit, ky pretendim është ngritur edhe në Gjykatën e Lartë, e cila jo vetëm që nuk e ka marrë në shqyrtim atë, por madje, në lajthim, është shprehur se gjykimi në gjykatën e apelit është bërë në prani të palëve. Gjykata, duke pasur parasysh natyrën dhe thelbin e pretendimeve të kërkuesit dhe argumentet e parashtruara në mbështetje të tyre, si dhe në kuptim të parimit të subsidiaritetit të kontrollit kushtetues vlerëson t`i shqyrtojë ato, në vijim, në drejtim të respektimit të së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor në procesin gjyqësor të zhvilluar në Gjykatën e Lartë.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit

19. Kërkuesi ka pretenduar se ai nuk ka marrë dijeni për datën dhe orën e gjykimit të çështjes në gjykatën e apelit, pasi nuk është njoftuar rregullisht dhe njoftimi nuk është realizuar sipas parashikimeve të KPC-së. Sipas tij, shpallja për seancën gjyqësore të datës 19.05.2015 nuk është afishuar në gjykatën e shkallës së parë, në kundërshtim me nenin 460 të KPC-së, çka provohet nga shkresa e kancelarit të Gjykatës të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, sipas së cilës, nga verifikimi dhe kontrolli pranë zyrës së arkivës, nuk rezulton të jetë protokolluar shkresa për periudhën maj 2015 e dërguar nga gjykata e apelit. Sipas kërkuesit, pretendimi për mosshpalljen e datës së seancës në gjykatën e shkallës së parë, që ka sjellë mosmarrjen dijeni prej tij për gjykimin në gjykatën e apelit, është ngritur edhe në Gjykatën e Lartë, por kjo e fundit, në lajthim, ka konsideruar në vendim se gjykimi është bërë në prani të palëve, edhe pse nga përmbajtja e vendimit të gjykatës së apelit konstatohet se çështja është gjykuar në mungesë. Kërkuesi ka pretenduar se ai ka mundur të paraqesë parashtrime në Gjykatën e Lartë vetëm në datën 15.03.2024,

përmes shërbimit postar, dhe në sekretari ditën e hënë, datë 18.03.2024, pra brenda afatit 5-ditor nga njoftimi me shpallje i asaj gjykate i datës 04.03.2024.

20. Në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës, e drejta e aksesit u garanton subjekteve të cenuara të drejtën t'i drejtohen një gjykate, e cila do t'i dëgjojë pretendimet e tyre dhe do të shpallë një vendim pas një gjykimi të drejtë dhe publik. Kjo e drejtë e individit nuk përfshin vetëm të drejtën për të vënë në lëvizje gjykatën, por edhe të drejtën për të pasur prej saj një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pasi aksesi në gjykatë duhet të jetë substancial dhe jo thjesht formal. Në rast se mohohet kjo e drejtë procesi konsiderohet i parregullt, sepse aksesi në gjykatë është, para së gjithash, një kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tjera të individit *(shih vendimet nr. 22, datë 29.04.2021; nr. 3, datë 23.02.2016 të Gjykatës Kushtetuese)*.

21. Nga ana tjetër, e drejta për proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit edhe nga neni 142, pika 1, i Kushtetutës. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë dhe funksioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve se ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë (*shih vendimet nr. 19, datë 21.03.2024; nr. 21, datë 26.09.2022; nr. 67, datë 10.11.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Detyrimi për garantimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor nuk nënkupton se kërkohet përgjigje e detajuar për çdo pretendim të palëve ndërgjyqëse, por ai varet nga natyra e vendimit në fjalë. Po kështu, Gjykata ka theksuar se mospasqyrimi në pjesën hyrëse të vendimit të Gjykatës së Lartë i shkaqeve të parashtruara nga kërkuesi në shtesën e rekursit, përbën cenim të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor *(shih vendimin nr. 19, datë 07.07.2022 të Gjykatës Kushtetuese)*.

22. Në kuptim të standardeve të mësipërme dhe referuar fakteve me natyrë kushtetuese të rezultuara gjatë këtij gjykimi, Gjykata do të verifikojë në vijim nëse në rastin konkret kërkuesi ka parashtruar përpara Gjykatës së Lartë pretendime me natyrë kushtetuese për procesin gjyqësor objekt rekursi dhe nëse ajo gjykatë ka ushtruar rolin e saj subsidiar në trajtimin e këtyre pretendimeve.

23. Gjykata, bazuar në aktet e dosjes gjyqësore të administruar për nevoja të këtij gjykimi, konstaton se kërkuesi në datën 05.12.2013 ka paraqitur ankim në Gjykatën e Apelit Durrës për kundërshtimin e vendimit nr. 2324 (13-2013-6587), datë 21.11.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor

Elbasan. Seanca e parë gjyqësore në atë gjykatë është zhvilluar në datën 05.05.2015 dhe referuar procesverbalit të asaj seance rezulton se asnjë nga palët ndërgjyqëse nuk është paraqitur në gjykim. Sipas gjykatës së apelit paditësi (kërkuesi) nuk është paraqitur, edhe pse ka marrë dijeni me shpalljen e datës 10.04.2015. Po nga aktet e dosjes gjyqësore rezulton se me kërkesën e datës 05.05.2015 një nga anëtarët e trupit gjykues ka kërkuar të heqë dorë nga gjykimi i kësaj çështjeje, pasi kishte pengesa ligjore për të marrë pjesë në gjykim, kërkesë kjo që është pranuar, për rrjedhojë është vendosur shtyrja e seancës gjyqësore në datën 19.05.2015, duke u urdhëruar sekretaria për njoftimin e palëve me shpallje. Në dosjen gjyqësore është administruar lista e shpalljes së seancës gjyqësore, si dhe shkresa "Shpallje" e datës 06.05.2015 për njoftimin e seancës së radhës të datës 19.05.2015.

24. Në seancën gjyqësore të datës 19.05.2015, referuar procesverbalit të saj, konstatohet se sërish asnjë nga palët ndërgjyqëse nuk ka qenë e pranishme në gjykim dhe gjykata e apelit ka vendosur zhvillimin e gjykimit "*në mungesë të palëve ndërgjyqëse, të cilat nuk u paraqitën edhe pse kishin dijeni me listë shpalljeje*". Në përfundim të kësaj seance Gjykata e Apelit Durrës ka shpallur vendimin, duke lënë në fuqi vendimin e ankimuar të gjykatës së shkallës së parë, pasi ka vlerësuar se pretendimet e ngritura nga paditësi (kërkuesi) në ankim janë po ato të ngritura gjatë shqyrtimit gjyqësor në shkallën e parë, për të cilat ajo gjykatë ka arsyetuar se përse nuk duhen pranuar, duke iu referuar dispozitave konkrete të ligjit material e procedural, përfundime që gjykata e apelit i ka gjetur të drejta.

25. Në datën 15.06.2015 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës së Lartë me rekurs për kundërshtimin e vendimit të gjykatës së apelit, duke ngritur, në thelb, të njëjtat pretendime që ka ngritur edhe përpara gjykatave të faktit, duke kundërshtuar në tërësi atë proces. Referuar të dhënave të publikuara në faqen zyrtare të asaj gjykate, Gjykata konstaton se në datën 04.03.2024 është publikuar lista e çështjeve civile për shqyrtim në dhomën e këshillimit në datën 19.03.2024, ku përfshihej edhe çështja e kërkuesit. Nga aktet e dosjes gjyqësore rezulton edhe se pas publikimit të kësaj date kërkuesi i është drejtuar Gjykatës së Lartë me aktin "Pretendime" të nënshkruar nga avokati i tij, i cili mban datën 15.03.2024 dhe është regjistruar në Gjykatën e Lartë në datën 18.03.2024, një ditë përpara datës së shpallur për shqyrtimin e rekursit në dhomën e këshillimit, ku ka ngritur në mënyrë të shprehur pretendimin për mosmarrjen dijeni për datën dhe orën e zhvillimit të seancës gjyqësore në gjykatën e apelit.

26. Me vendimin nr. 00-2024-1183, datë 19.03.2024, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, ka vendosur mospranimin e rekursit, pasi nuk kishte shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 472 të KPC-së. Sipas atij kolegji, gjykata e apelit ka interpretuar dhe zbatuar drejt ligjin (material dhe atë procedural) që ka shërbyer për zgjidhjen e mosmarrëveshjes, ka arsyetuar në mënyrë ezauruese shkakun e vendimmarrjes, nuk janë shkelur dispozitat për juridiksionin dhe kompetencën lëndore, funksionale dhe as tokësore ekskluzive, përbërja e trupës gjykuese ka qenë në rregull dhe nuk ka pasur shkaqe papajtueshmërie, çështja është shqyrtuar në prani të palëve ndërgjyqëse dhe nuk konstatohen shkelje lidhur me procesin e njoftimit të tyre *(shih paragrafin 36 të vendimit të Kolegjit Civil)*.

27. Gjykata vëren se kërkuesi, në mbështetje të pretendimit të tij për mosrespektimin e dispozitave të KPC-së për shpalljen e datës së seancës të datës 19.05.2015 në gjykatën e shkallës së parë, ka paraqitur bashkëlidhur ankimit kushtetues edhe shkresën "Kthim përgjigje" nr. 1761 prot., datë 16.10.2024 të kancelarit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, sipas së cilës, në përgjigje të kërkesës së kërkuesit për informacion pranë kësaj gjykate nëse ishte protokolluar dhe afishuar shpallja nr. 1239 sistemi, datë 06.05.2015 e Gjykatës së Apelit Durrës për periudhën maj 2015, e ka informuar se "*nga verifikimi dhe kontrolli i ushtruar pranë Zyrës së Arkivës nuk rezulton të jetë e protokolluar kjo shkresë për periudhën maj 2015 të dërguar nga Gjykata e Apelit Durrës*".

28. Gjykata, bazuar në sa më sipër, në situatën që kërkuesi rezulton se nuk ka qenë i pranishëm në seancat gjyqësore të zhvilluara në gjykatën e apelit dhe në situatën që ai e ka ngritur një pretendim të tillë përpara Gjykatës së Lartë, i takonte kësaj të fundit që të verifikonte bazueshmërinë në themel të këtij pretendimi me natyrë kushtetuese, për sa kohë që prania fizike në procesin gjyqësor lidhet drejtpërdrejt me garantimin e të drejtave të tjera procedurale të palëve në këndvështrim të së drejtës për proces të rregullt.

29. Gjykata ka theksuar se raporti ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme udhëhiqet nga parimi i *subsidiaritetit*. Respektimi i të drejtave kushtetuese është funksion edhe i gjykatave të zakonshme, për më tepër i Gjykatës së Lartë. Roli i kësaj gjykate, si gjykatë e ligjit, është i një natyre të pazëvendësueshme. Ajo i ka të gjitha mjetet dhe kompetencat për ta bërë vetë këtë rol aktiv, që shkon përtej ligjit dhe synon të drejtën, duke ndikuar efektivisht edhe në

vendimmarrjen e gjykatave të shkallëve më të ulëta (*shih vendimet nr. 10, datë 04.03.2021; nr. 3, datë 23.02.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

30. Në këtë kuptim, Gjykata vlerëson se, referuar natyrës kushtetuese të pretendimeve të parashtruara në Gjykatën e Lartë për cenimin e së drejtë për t'u njoftuar dhe dëgjuar në procesin gjyqësor në gjykatën e apelit, ajo gjykatë, në ushtrim të funksionit të saj, duhej të kishte mbajtur një qëndrim të shprehur në këtë drejtim. Mungesa e pasqyrimit në vendim të shkaqeve të paraqitura nga kërkuesi në aktin "Pretendime", të depozituar pas publikimit të datës së seancës gjyqësore në Gjykatën e Lartë, si dhe mosdhënia atyre përgjigje të arsyetuar, edhe pse këto shkaqe janë dukshëm me natyrë kushtetuese, passjell cenim të së drejtës së aksesit. Për rrjedhojë mospranimi i rekursit duke u mjaftuar vetëm me shqyrtimin *de plano* të çështjes dhe me arsyetimin e kufizuar se shkaqet e rekursit nuk janë nga ato të parashikuara nga ligji, pa i dhënë përgjigje të arsyetuar pretendimit me natyrë kushtetuese, vë në dyshim respektimin e së drejtës së aksesit në atë gjykatë, e cila përfshin edhe të drejtën për të marrë përgjigje për të gjitha pretendimet e tij.

31. Gjykata vëren, gjithashtu, se Gjykata e Lartë në vendimin e saj është shprehur se "*çështja është shqyrtuar në prani të palëve ndërgjyqëse...*", ndërkohë që, siç konstatohet lehtësisht nga aktet e administruara në gjykim dhe nga vetë përmbajtja e vendimit të gjykatës së apelit, gjykimi në atë gjykatë është bërë në mungesë të të dyja palëve ndërgjyqëse. Kjo e dhënë e gabuar në vendimin e Gjykatës së Lartë është e tillë që vë në dyshim respektimin e së drejtës për proces të rregullt edhe në drejtim të standardit të arsyetimit të vendimit. Për më tepër, po në drejtim të këtij standardi, Gjykata konstaton se në vendimin e Gjykatës së Lartë ka edhe një gabim material që ka të bëjë me të dhënat e palëve ndërgjyqëse, ku si palë e paditur është shënuar si subjekt suksedues i AKKP-së, Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe jo Agjencia e Trajtimit të Pronave.

32. Në përfundim, Gjykata çmon se pretendimet e kërkuesit për cenimin e së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsyetimit në Gjykatën e Lartë janë të bazuara, sipas arsyetimit të mësipërm të këtij vendimi, ndaj kërkesa pranohet pjesërisht.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, si dhe nenit 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës

Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me shumicë votash,

V E N D O S I:

1. Pranimin pjesërisht të kërkesës.

2. Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2024-1183, datë 19.03.2024 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

3. Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 25.09.2025
Shpallur më 10.11.2025

MENDIM PAKICE

1. Në gjykimin kushtetues të çështjes që i përket kërkuesit Kostandin Xholli, me objekt shfuqizimin e vendimeve nr. 10-2015-1185(523), datë 19.05.2015 të Gjykatës së Apelit Durrës dhe nr. 00-2024-1183, datë 19.03.2024 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, jemi kundër qëndrimit të shumicës, pasi vlerësojmë se kërkesa duhej të ishte rrëzuar për shkak të pabazueshmërisë në themel të pretendimit për cenimin e së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor.

2. Kërkuesi e ka mbështetur këtë pretendim në faktin se në vendimin e Gjykatës së Lartë nuk gjejnë pasqyrim shkaqet e parashtruara prej tij në shtesën e rekursit, të cilat, për këtë shkak, as nuk janë marrë në shqyrtim prej asaj gjykate. Shumica, pasi ka marrë në shqyrtim këtë pretendim, ka arritur në përfundimin se mungesa e pasqyrimit në vendim të shkaqeve të paraqitura nga kërkuesi në aktin "Pretendime", të depozituar pas publikimit të datës së shqyrtimit të rekursit në seancë gjyqësore në Gjykatën e Lartë, si dhe mosdhënia atyre përgjigje të arsyetuar, edhe pse këto shkaqe janë dukshëm me natyrë kushtetuese, passjell cenim të së drejtës së aksesit. Për rrjedhojë, sipas shumicës, mospranimi i rekursit duke u mjaftuar vetëm me shqyrtimin *de plano* të çështjes dhe me arsyetimin e kufizuar se shkaqet e rekursit nuk janë nga ato të parashikuara nga ligji, pa i dhënë përgjigje të arsyetuar pretendimit me natyrë kushtetuese që ka të bëjë me cenimin e së drejtës për t'u njoftuar dhe dëgjuar në procesin gjyqësor në gjykatën e apelit, vë në dyshim respektimin e së drejtës së aksesit në atë gjykatë, e cila përfshin edhe të drejtën për të marrë përgjigje për të gjitha pretendimet e tij. Po sipas shumicës, Gjykata e Lartë, në ushtrim të funksionit të saj, referuar natyrës kushtetuese të këtyre pretendimeve të parashtruara nga kërkuesi në aktin "Pretendime", duhej të kishte mbajtur qëndrim të shprehur në këtë drejtim *(shih paragrafët 30-31 të vendimit)*.

3. Ne, gjyqtarët në pakicë, nuk pajtohemi me këtë vlerësim të shumicës. Për këtë mbajmë në konsideratë faktet në lidhje me parashtrimet, shtesën e rekursit, sikurse ato janë pasqyruar kronologjikisht dhe në mënyrë të përmbledhur edhe nga shumica *(shih paragrafin 25 të vendimit),* në referim të të cilave mund të analizohet se vendimi i Gjykatës së Apelit Durrës mban datën 19.05.2015 dhe kërkuesi në datën 15.06.2015 ka ushtruar të drejtën

e rekursit për kundërshtimin e atij vendimi. Në vijim, pas publikimit të listës së çështjeve civile për shqyrtim në dhomën e këshillimit në datën 19.03.2024, ku përfshihej edhe çështja e kërkuesit, pra pas rreth 9 vjetësh nga paraqitja e rekursit, ai i është drejtuar Gjykatës së Lartë me aktin "Pretendime" të nënshkruar nga avokati i tij, i cili mban datën 15.03.2024 dhe është regjistruar në Gjykatën e Lartë në datën 18.03.2024, që do të thotë vetëm një ditë përpara datës së planifikuar dhe të shpallur për shqyrtimin e rekursit në dhomën e këshillimit. Në këtë akt kërkuesi ka ngritur shkaqe të reja për të mbështetur kërkimin e tij për shfuqizimin e vendimit objekt ankimi, siç është ai për mosmarrjen dijeni për datën dhe orën e zhvillimit të seancës gjyqësore në gjykatën e apelit.

4. Për rrjedhojë, akti "Pretendime", që përbën shtesë të shkaqeve të rekursit, daton shumë vjet pas paraqitjes së rekursit në Gjykatën e Lartë, pra pas kalimit të afatit ligjor për ushtrimin e së drejtës së rekursit. Dispozitat procedurale civile që parashikojnë mjetet dhe afatet e ankimit në Gjykatën e Lartë (neni 442 i KPC-së), sipas përmbajtjes së tyre në kohën e ushtrimit të rekursit, kanë parashikuar afatin 30-ditor për paraqitjen e këtij mjeti ankimi (neni 443 i KPC-së), afat ky që fillonte nga dita e nesërme e shpalljes së vendimit përfundimtar (neni 444 i KPC-së). Po kështu, sipas dispozitave procedurale civile, shkaqet e rekursit janë përcaktuese për kufijtë e shqyrtimit të çështjes nga ajo gjykatë (neni 473/a i KPC-së). Referuar këtyre rregullimeve ligjore, kohëzgjatja e procesit gjyqësor në Gjykatën e Lartë, pra periudha kohore nga paraqitja/regjistrimi i rekursit/çështjes dhe deri në shqyrtimin e tij nga kolegji në dhomën e këshillimit/seancë gjyqësore, nuk nënkupton dhe as mund të shërbejë si shkak për t'i dhënë palës rekursuese të drejtën për të paraqitur vazhdimisht dhe në çdo kohë pretendime ose shkaqe të reja për kundërshtimin e procesit gjyqësor në gjykatat e faktit, përtej atyre të parashtruara në rekurs dhe as për të zgjeruar kufijtë e shqyrtimit të çështjes nga Gjykata e Lartë.

5. Në jurisprudencën e saj Gjykata është shprehur se e drejta e aksesit mund të kufizohet kur bëhet fjalë për kushtet e pranueshmërisë së një ankimi, siç janë afatet e përcaktuara në Kushtetutë dhe ligje, të cilat janë në funksion të parimit të sigurisë juridike *(shih vendimet nr. 40, datë 22.12.2022; nr. 18, datë 31.03.2014; nr. 17, datë 19.06.2009 të Gjykatës Kushtetuese)*. Po ashtu, Gjykata ka mbajtur qëndrimin se nuk është arbitrar interpretimi i ligjit procedural nga Gjykata e Lartë për papranueshmërinë e shtesës së rekursit, interpretim sipas të cilit, bazuar në nenin 473/a të KPC-së, ajo e shqyrton çështjen brenda kufijve të rekursit, përveç rasteve

kur ligji i jep të drejtën të investohet kryesisht, ndërkohë që në kushtet kur shqyrtimi gjyqësor kufizohet vetëm brenda shkaqeve të parashtruara në rekurs, shkaqet e reja të parashtruara në shtesën e rekursit nuk mund të merren në vlerësim, pasi për shkak të ligjit janë të papranueshme *(shih vendimin nr. 30, datë 18.04.2024 të Gjykatës Kushtetuese).*

6. Për rrjedhojë, çdo shkak i paraqitur gjatë kohës që çështja është në pritje të shqyrtimit të saj në Gjykatën e Lartë, në rastin konkret dukshëm jashtë afatit ligjor për atë mjet ankimi, nuk mund të merret në shqyrtim nga ajo gjykatë, pra të marrë përgjigje përfundimtare lidhur me (pa) bazueshmërinë në ligj.

7. Po sipas shumicës, Gjykata e Lartë në vendimin e saj është shprehur se "*çështja është shqyrtuar në prani të palëve ndërgjyqëse...*", ndërkohë që, nga aktet e administruara në gjykim dhe nga vetë përmbajtja e vendimit të gjykatës së apelit, gjykimi në atë gjykatë është bërë në mungesë të të dyja palëve ndërgjyqëse. Sipas shumicës, kjo e dhënë e gabuar në vendimin e Gjykatës së Lartë është e tillë që vë në dyshim respektimin e së drejtës për proces të rregullt edhe në drejtim të standardit të arsyetimit të vendimit. Për më tepër, po në drejtim të këtij standardi, shumica ka vlerësuar se në vendimin e Gjykatës së Lartë ka edhe një gabim material që ka të bëjë me të dhënat e palëve ndërgjyqëse, ku si palë e paditur është shënuar si subjekt suksedues i AKKP-së, Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe jo Agjencia e Trajtimit të Pronave (*shih paragrafin 31 të vendimit*).

8. Për ne, gjyqtarët në pakicë, edhe pse dukshëm në vendimin e Gjykatës së Lartë ka një pasaktësi në lidhje me praninë e palëve në gjykimin në gjykatën e apelit, i cili, siç rezulton nga aktet e dosjes gjyqësore, është zhvilluar në mungesë të të dyja palëve ndërgjyqëse, kjo pasaktësi nuk është e tillë që të vërë në dyshim atë vendimmarrje. Po ashtu, edhe gabimi material që ka të bëjë me të dhënat e palëve ndërgjyqëse, ku si palë e paditur është shënuar si subjekt suksedues i AKKP-së, Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe jo Agjencia e Trajtimit të Pronave, nuk është argumentuar se përse e bën të cenueshëm vendimin në situatën që kërkuesi në lidhje me këtë aspekt nuk ka argumentuar nga pikëpamja kushtetuese pasojat në të drejtën e tij për proces të rregullt, apo se një pasaktësi e tillë në vendimin e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë e bën vendimin alogjik ose arbitrar. Në këtë drejtim vlen të përmendet se në jurisprudencën e saj Gjykata ka pohuar se ndikim të drejtpërdrejtë në një proces ligjor kanë ato shkelje thelbësore, vërtetimi i të cilave do të cenonte të drejtat dhe liritë themelore të individit. Gjatë shqyrtimit të pretendimeve për të drejtën për proces të rregullt nuk

mjafton vetëm konstatimi i shkeljes procedurale, por duhet të analizohet karakteri i saj, pasojat që kanë ardhur për kërkuesin dhe për interesat që ai përfaqëson *(shih vendimet nr. 30 datë 18.04.2024; nr. 9, datë 26.02.2015; nr. 21, datë 01.10.2008 të Gjykatës Kushtetuese)*.

9. Për sa më lart, ne jemi të qëndrimit se pretendimet e kërkuesit janë të pabazuara, ndaj kërkesa duhej të rrëzohej për shkaqet si më sipër.

Anëtarë: Sandër Beci, Ilir Toska, Genti Ibrahimi

Vendim nr. 51, datë 25.09.2025
(V-51/25)

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Holta Zaçaj, Kryetare, Marsida Xhaferllari, Fiona Papajorgji, Sonila Bejtja, Sandër Beci, Ilir Toska, Marjana Semini, Genti Ibrahimi, anëtarë, me sekretare Anjeza Puka, në datën 25.09.2025 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 16 (B) 2024, që u përket:

KËRKUES: **BARDHYL IBRA**

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

MINISTRIA E DREJTËSISË, përfaqësuar nga Xhelal Kasaj, Erjon Ndreca dhe Albjona Toçi, me autorizim.

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR, përfaqësuar nga Ilir Rusi.

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E GJENDJES CIVILE, PRANË MINISTRISË SË BRENDËSHME, në mungesë.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i e vendimit nr. 00-2024-3271, datë 23.07.2024 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**
Zhvillimi i gjykimit nga një gjykatë jokompetente për shkak të konflikteve të herëpashershme me gjyqtaren A.A. të Gjykatës së Lartë, duke qenë relatore e çështjes.
Konstatimi i cenimit të së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor si rezultat i mosgjykimit të çështjes brenda një afati të arsyeshëm, të parashikuar në pikën 2 të nenit 399/7 të Kodit të Procedurës Civile, të kërkesës nr. regjistrimi 31138-04501-86-2017, datë 11.09.2017 pranë sekretarisë së Gjykatës

Administrative të Apelit dhe përshpejtimin e shqyrtimit të çështjes, pasi ende nuk është gjykuar.

BAZA LIGJORE: Nenet 15, 16,18, 42, pika 2, 43 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 6, pika 1 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*); nenet 399/1-399/12, 474 dhe 475 të KPC-së.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Genti Ibrahimi, mori në shqyrtim parashtrimet me shkrim të kërkuesit Bardhyl Ibra (*kërkuesi*), që ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjekteve të interesuara, Ministrisë së Drejtësisë dhe Këshillit të Lartë Gjyqësor (*KLGJ*), të cilat kanë kërkuar rrëzimin e kërkesës, konstatoi mungesën e prapësimeve me shkrim të subjektit tjetër të interesuar, Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I
Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi ka paraqitur në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë një ankesë kundër ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë (sot Këshilli i Lartë Gjyqësor), ministrit të Drejtësisë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile, me objekt dhënien e informacionit të kërkuar prej tij në lidhje me identitetin e një gjyqtari.

2. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 2469, datë 05.06.2017, bazuar në nenin 39 të ligjit nr. 49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", të ndryshuar (*ligji nr. 49/2012*) dhe vendimin unifikues nr. 3, datë 29.03.2012

të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, ka vendosur mospranimin e ankimit të paraqitur nga kërkuesi, me arsyetimin se kërkesa nuk plotëson kushtet formale të paraqitjes së saj. Kundër këtij vendimi ka bërë ankim të veçantë kërkuesi dhe çështja është regjistruar në Gjykatën Administrative të Apelit në datën 11.09.2017, me numër 16041(31138-04501-86-2017) akti. Në kushtet kur çështja nuk po shqyrtohej nga gjykata e apelit, në datën 27.06.2024, bazuar në nenet 399/4, 399/5 dhe 399/6, pika 1, shkronja "b", të KPC-së, kërkuesi ka depozituar në Gjykatën e Lartë kërkesë për konstatimin e cenimit të së drejtës për proces të rregullt ligjor si rezultat i mosgjykimit të çështjes brenda afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e gjykimit nga Gjykata Administrative e Apelit.

3. Në datën 03.07.2024 gjyqtarja relatore e çështjes i është drejtuar kërkuesit me vendim për plotësimin e të metave të kërkesës duke konstatuar si të metë parashikimin e nenit 56/a shkronja "d", të ligjit nr. 49/2012 dhe të nenit 474 KPC-së, konkretisht, nënshkrimin e avokatit, duke vendosur t'i caktojë atij një afat pesë ditor për plotësimin e të metave, siç përcaktohet në pjesën arsyetuese të këtij vendimi.

4. Në datën 09.07.2024 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës së Lartë me aktin "plotësim të metash", ku përveç pretendimeve në lidhje me vendimin e plotësimit të të metave ka kërkuar edhe zëvendësimin e trupit gjykues, pasi ky trup ka rrëzuar kërkesa të mëparshme të paraqitura prej tij dhe, po ashtu, ky trup ka për gjykim edhe kërkesa të tjera të kërkuesit për të cilat nuk ka ende një vendimmarrje prej tij.

5. Me vendimin e datës 22.07.2024, gjyqtari i vetëm i Kolegjit Penal ka rrëzuar kërkesën e kërkuesit për përjashtimin e trupit gjykues, me arsyetimin se kërkesa e tij nuk është shoqëruar me asnjë dokument provues në drejtim të shkakut të pretenduar. Pavarësisht faktit se ky trup gjykues ka gjykuar ose ka në gjykim edhe kërkesa të tjera të kërkuesit, ato nuk lidhen me çështjen objekt gjykimi, si dhe nuk rezultojnë që të jenë kërkesa për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm, gjykim në të cilin trupi gjykues nuk shqyrton themelin e çështjes, por vlerëson respektimin e afatit të arsyeshëm nga gjykata që ka çështjen në gjykim.

6. Në vijim, Gjykata e Lartë i ka kërkuar informacion gjykatës së apelit lidhur me kërkesën për shkeljen e afatit të arsyeshëm nga gjyqtarja relatore e çështjes (gjyqtarja E.SH.), e cila në mendimin me shkrim të datës 24.05.2024 ka parashtruar se është objektivisht i pamundur shqyrtimi në kohë i kësaj çështjeje dhe kjo vonesë nuk mund të përbëjë shkak për shkelje të afatit të arsyeshëm nga gjykata e apelit. Po sipas gjyqtares relatore, për

shqyrtimin e çështjeve ajo zbaton rendin kronologjik, duke iu referuar datës së regjistrimit, ku aktualisht po gjykon çështjet e regjistruara në vitin 2017 dhe nuk rezulton se nga kërkuesi të jetë kërkuar përshpejtimi i gjykimit për shkaqe të arsyeshme.

7. Me vendimin nr. 00-2024-3271, datë 23.07.2024, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, ka vendosur rrëzimin e kërkesës së kërkuesit për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm të gjykimit të çështjes së tij nga Gjykata Administrative e Apelit. Sipas atij kolegji, mosveprimi i Gjykatës Administrative të Apelit nuk ka ndodhur për shkaqe subjektive që lidhen me vlerësime dhe qëndrime abuzive të gjyqtares relatore të çështjes, e cila ka marrë të gjitha masat e nevojshme organizative, duke përcaktuar kritere transparente dhe objektive për marrjen në gjykim të çështjeve që i janë ngarkuar në cilësinë e gjyqtarit relator, sipas radhës së vjetërsisë. Po sipas saj, për shkak të problematikës së përgjithshme të shkaktuar nga reforma në drejtësi, Gjykata Administrative e Apelit ndodhet në pamundësi objektive për marrjen e masave për shqyrtimin e kësaj çështjeje me përshpejtim.

8. Në datën 20.12.2024 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij. Kolegji i Gjykatës në datën 12.03.2025, bazuar në nenin 21, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II
Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

9. ***Kërkuesi*****,** në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të:

9.1. *Së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm*, për shkak se Gjykata e Lartë nuk ka marrë parasysh faktin se nga momenti i regjistrimit të çështjes në Gjykatën Administrative të Apelit deri në paraqitjen e kërkesës për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm kanë kaluar rreth shtatë vjet, dhe megjithëse çështja nuk paraqitet komplekse, ajo nuk është shqyrtuar ende. Edhe pse mosgjykimi i çështjes ka ardhur si pasojë e mosplotësimit të numrit të gjyqtarëve në Gjykatën Administrative të Apelit nga organet përkatëse, justifikimi i Gjykatës së Lartë se vonesat në

gjykim janë rrjedhojë e numrit të lartë të çështjeve është vlerësuar i pabazuar nga jurisprudenca kushtetuese. Ai nuk është bërë shkak për zvarritjen e procesit dhe mosha e tij është 73 vjeçare.

9.2. *Parimit të barazisë para ligjit,* pasi Gjykata e Lartë nuk ndjek të njëjtën praktikë për kërkesat për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e gjykimit të çështjes, ku njëri trup gjykues i Kolegjit Administrativ të saj i ka dhënë të drejtë kërkuesit, por pavarësisht kësaj Gjykata e Lartë nuk e ka kaluar çështjen për njësim të praktikës gjyqësore.

9.3. *Së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme,* pasi në kolegjin që ka shqyrtuar çështjen e tij në Gjykatën e Lartë ka marrë pjesë edhe gjyqtarja A.A., me të cilën ai ka mosmarrëveshje në kuptim të nenit 72 të KPC-së.

10. ***Subjekti i interesuar, Ministria e Drejtësisë,*** në mënyrë të përmbledhur, ka parashtruar se kërkuesi nuk ka paraqitur argumente kushtetuese në mbështetje të pretendimeve të ngritura. Kërkuesi nuk ka provuar se ka interes të vazhdueshëm për gjykimin sa më të shpejtë të çështjes së themelit nga Gjykata Administrative e Apelit, pasi nuk ka shfrytëzuar mjetet procedurale që garanton legjislacioni në fuqi për përshpejtimin e çështjes. Sjellja e kërkuesit në këtë rast vërteton se të drejtat e tij nuk kanë qenë të rrezikuara në nivele të konsiderueshme nga mosgjykimi i çështjes brenda afateve ligjore. Ai nuk ka paraqitur argumente konkrete që faktojnë rrezikun që ka sjellë ose që eventualisht mund të sjellë tejzgjatja e procedurave gjyqësore nga Gjykata Administrative e Apelit dhe Gjykata e Lartë. Për më tepër, nisur nga natyra e çështjes, ajo nuk është e tillë që të ketë përparësi në radhën e gjykimit të çështjeve nga gjyqtarja relatore, për sa kohë që në këtë proces gjyqësor që kërkuesi pretendon gjykimin brenda afatit të arsyeshëm atij kërkesa i është kthyer vetëm për të meta në aspektin formal, aspekte që ia bëjnë të pamundur gjykatës gjykimin në themel të pretendimeve të kërkuesit.

11. ***Subjekti i interesuar, KLGJ-ja,*** në mënyrë të përmbledhur, ka parashtruar se kërkuesi nuk ka shfrytëzuar mjetin ligjor të parashikuar nga dispozitat procedurale për të kërkuar përshpejtimin e gjykimit të çështjes së tij nga Gjykata Administrative e Apelit. Në rastin e kërkuesit nuk duket që tejzgjatja e procedurave të paraqesë një shkallë rreziku të konsiderueshme për interesin e kërkuesit. Mosveprimi i gjykatës në rastin e kërkuesit nuk ka ndodhur për shkaqe subjektive që lidhen me vlerësime dhe qëndrime abuzive të gjyqtarit. Në asnjë rast cilësia e procesit të rregullt

ligjor dhe e vendimmarrjes së gjykatës nuk duhet të sakrifikohet për sasinë e afatit të arsyeshëm ose dhe ekonominë gjyqësore në tërësi. Për sa i takon pretendimit të kërkuesit për cenimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme, pavarësisht faktit se gjyqtarja A.A ka qenë pjesë e trupit gjykues që ka gjykuar ose ka në gjykim kërkesa të tjera të kërkuesit, ka rezultuar e provuar edhe nga Gjykata e Lartë se objekti i kërkesave të tij konsistonte në konstatimin e afatit të arsyeshëm, ku trupi gjykues në këto raste nuk shqyrton themelin e çështjes, por vlerëson respektimin e afatit të arsyeshëm nga gjykata që ka çështjen në shqyrtim. Në asnjë moment nuk është provuar nga kërkuesi se gjyqtarja ka shfaqur mendime lidhur me çështjen konkrete në mënyrë që të krijohet perceptimi për njëanshmëri.

12. ***Subjekti tjetër i interesuar, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile,*** nuk ka paraqitur prapësime me shkrim, edhe pse është njoftuar rregullisht.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkuesit

13. Çështja e legjitimimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

14. Në lidhje me legjitimimin *ratione personae*, sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, individi është subjekt i cili mund të paraqesë ankim kushtetues individual vetëm për çështje që lidhen me interesat e tij të drejtpërdrejta, duke provuar se është cenuar në të drejtat e tij kushtetuese, pra se është viktimë e një shkeljeje dhe se pasojat nga akti i kundërshtuar janë të drejtpërdrejta dhe reale për të. Kjo do të thotë se kërkuesi duhet të provojë legjitimimin e tij si në

aspektin procedural, ashtu edhe në atë substancial (*shih vendimet nr. 65, datë 30.11.2023; nr. 44, datë 26.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Në rastin konkret, Gjykata vëren se në themelin e mosmarrëveshjes gjyqësore është kërkesa për dhënie informacioni të kërkuar prej kërkuesit në lidhje me identitetin e një gjyqtari, për të cilën Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka vendosur mospranimin si të pabazuar, me arsyetimin se kërkesa nuk plotëson kushtet formale të paraqitjes së saj. Sipas asaj gjykate, duke qenë se kërkohet detyrimi i palës së paditur që të kryejë një veprim konkret, atëherë e drejta subjektive e ankuesit nuk mund të realizohet nëpërmjet kësaj ankese, por nëpërmjet kërkesëpadisë, pasi vetëm nëpërmjet këtij mjeti procedural gjykata mund të marrë një vendim detyrues. Kundër këtij vendimi ka ushtruar ankim në gjykatën e apelit kërkuesi, i cili është regjistruar në datën 11.09.2017. Duke qenë se çështja ende nuk ishte gjykuar nga gjykata e apelit, kërkuesi në datën 27.06.2024 i është drejtuar Gjykatës së Lartë me kërkesë për konstatimin e cenimit të afatit të arsyeshëm, për të cilën Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin e datës 23.07.2024, ka vendosur rrëzimin, duke vlerësuar se standardi i gjykimit brenda një afati të arsyeshëm nuk cenohet kur gjykata është në pamundësi objektive, që nuk varen nga vullneti i saj, për gjykimin e çështjes brenda një afati të arsyeshëm. Kundër këtij vendimi kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me ankim individual.

16. Gjykata vëren se për sa i përket themelit të çështjes së kërkuesit, pas shqyrtimit të ankimit të tij, Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 2238(86-2024-2481), datë 19.12.2024 ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 2469, datë 05.06.2017 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, duke marrë kështu kërkuesi përgjigje për thelbin e pretendimeve të tij nga gjykata e pretenduar se ka qenë në vonesë. Në rastin e kërkuesit rezulton se ai i ka përdorur mjetet juridike në dispozicion, sipas neneve 399/1 e vijues të KPC-së, me qëllimin për të siguruar përshpejtimin e gjykimit të ankimit të tij nga Gjykata Administrative e Apelit dhe për të pasur një vendim të arsyetuar për shkaqet e ankimit të tij. Në këto kushte, për sa kohë që shqyrtimi i çështjes së kërkuesit nga ajo gjykatë ka përfunduar, çka do të thotë se është realizuar qëllimi që ka synuar të arrijë kërkuesi përmes këtyre mjeteve juridike, Gjykata çmon se kërkuesi nuk ka më interes në këtë gjykim kushtetues. Për rrjedhojë, në këto kushte, kriteri i interesit të kërkuesit për të vënë në lëvizje gjykimin kushtetues nuk konsiderohet i plotësuar, pasi për sa kohë që ai ka marrë përgjigje përfundimtare nga

gjykata e apelit, konsiderohet se është rivendosur e drejta e pretenduar që synonte të mbronte nëpërmjet këtij procesi.

17. Për sa më sipër, në situatën që çështja e kërkuesit në gjykatën e apelit ka përfunduar tashmë, Gjykata vlerëson se kërkuesi nuk legjitimohet *ratione personae* në ankimin kushtetues individual, pasi nuk ka arritur të provojë interesin e tij të drejtpërdrejtë dhe individual për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues.

18. Në përfundim, Gjykata çmon se kërkesa e kërkuesit duhet të rrëzohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, si dhe neneve 71/a dhe 72, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, njëzëri,

V E N D O S I:

1. Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 25.09.2025
Shpallur më 12.11.2025

Vendim nr. 52, datë 07.10.2025
(V-52/25)

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Holta Zaçaj, Kryetare, Marsida Xhaferllari, Fiona Papajorgji, Sandër Beci, Ilir Toska, Genti Ibrahimi, Marjana Semini, Sonila Bejtja, anëtarë, me sekretare Anjeza Puka, në datën 07.10.2025 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 4 (Z) 2024 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUESE: **"ZYRA E PËRMBARIMIT PRIVAT ARB" SH.P.K.**, përfaqësuar nga administratori, Alban Ruli.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:
BANKA E TIRANËS, përfaqësuar nga avokate Evelina Qirjako, me prokurë.
KORPORATA ELEKTROENERGJETIKE SHQIPTARE, në mungesë.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2024-2474, datë 21.05.2024 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**
Shfuqizimi i vendimeve nr. 8890, datë 16.11.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr. 701, datë 23.03.2017 të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr. 00-2024-3825, datë 11.09.2024 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.
Konstatimi i shkeljes së aksesit në një gjykatë të krijuar me ligj. Konstatimi i shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimi i procedurës së gjykimit nga kolegji tjetër i Gjykatës së Lartë për sa i përket çështjes nr. 11243-02837-00-2017, datë 14.09.2017 në lidhje me vendimin nr. 8890, datë 16.11.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor

Tiranë, lënë në fuqi me vendimin nr. 701, datë 23.03.2017 të Gjykatës së Apelit Tiranë.
Konstatimi i mungesës së një mjeti efektiv për konstatimin, dëmshpërblimin dhe përshpejtimin e procedurave të sipërpërmendura.
Konstatimi i statusit të "viktimës" përgjatë procesit gjyqësor, si pasojë dhe rrjedhojë direkt e shkeljes së aksesit në një gjykatë të krijuar me ligj dhe afatit të arsyeshëm, në përputhje me vendimin Scordino kundër Italisë.
Rehabilitimi dhe zhdëmtimi në përputhje me ligjin, pasi dëmi/dëmtimi është shkaktuar/ka ardhur për shkak të aktit të paligjshëm konkretizuar me shkresën nr. 3103/1/2020 të kancelarit të Gjykatës së Lartë dhe urdhrit "Për konstatimin e të metave të kërkesës", datë 30.04.2024 të Gjykatës së Lartë, si dhe të shkeljes së afatit të arsyeshëm në gjykim.

BAZA LIGJORE: **Nenet 18, 41, 42, 44, 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë *(Kushtetuta)*; nenet 6, paragrafi 1, dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*); nenet 399/1 – 399/12 të Kodit të Procedurës Civile (*KPC*); ligji nr. 8510, datë 15.07.1999 "Për përgjegjësinë jashtëkontraktore të organeve të administratës shtetërore", i ndryshuar; vendimet e Gjykatës Kushtetuese; vendimet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*GJEDNJ*).**

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Sonila Bejtja, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të shoqërisë "Zyra e Përmbarimit Privat ARB" sh.p.k. (*kërkuesja*), e cila ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me

shkrim të subjektit të interesuar, Bankës së Tiranës, që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, konstatoi mungesën e parashtrimeve me shkrim të subjektit të interesuar, Korporatës Elektroenergjitike Shqiptare (*KESH*), si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I
Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesja ka lidhur kontratë shërbimi me KESH-in për kryerjen e shërbimit përmbarimor për ekzekutimin e vendimit nr. 9031 akti, datë 13.09.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit për faturat tatimore të shitjes (*urdhri i ekzekutimit nr. 9031/2012*). Pas kalimit të afatit për ekzekutimin vullnetar, kërkuesja ka vijuar procedurat e ekzekutimit të detyrueshëm të urdhrit të ekzekutimit, duke urdhëruar bllokimin e llogarive të shoqërisë debitore "CEZ Shpërndarje" sh.a., në të gjitha bankat e nivelit të dytë, duke përfshirë edhe ato te Banka e Tiranës.

2. Me pretendimin se Banka e Tiranës ka fshehur e tjetërsuar mjetet monetare dhe likuiditetet e CEZ-it me qëllim pengimin e ekzekutimit të urdhrit të ekzekutimit, për sa kohë që edhe pas bllokimeve të konfirmuara prej saj nuk ka ndërmarrë veprime për të bërë të mundur transferimin e shumave të bllokuara, kërkuesja ka paraqitur kallëzim penal në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila, me vendimin e datës 11.03.2013, ka vendosur mosfillimin e procedimit penal. Ky vendim është kundërshtuar në gjykatë nga kërkuesja, për të cilin Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur rrëzimin e kërkesës, vendim që është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë.

3. Në datën 27.05.2014 kërkuesja i është drejtuar gjykatës me padi me objekt detyrimin e palës së paditur, Bankës së Tiranës, që ta shpërblejë për dëmin pasuror dhe jopasuror të shkaktuar nga veprimet me faj në masën 10,000,000 lekë, fitimin e munguar dhe kamatat ligjore sipas normës tribor njëditor të vendosur nga Banka e Shqipërisë deri në datën e ekzekutimit të këtij vendimi.

4. Me vendimin nr. 8890, datë 16.11.2015, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur rrëzimin e padisë. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim kërkuesja.

5. Me vendimin nr. 701, datë 23.03.2017, Gjykata e Apelit Tiranë ka

vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë. Kundër këtij vendimi kërkuesja ka ushtruar rekurs dhe në Gjykatën e Lartë është regjistruar çështja nr. 11243-02837-00-2017, datë 14.09.2017.

6. Në datën 14.12.2020 kërkuesja ka paraqitur në Gjykatën e Lartë kërkesë për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave të gjykimit të çështjes pranë kësaj gjykate, bazuar në nenet 399/1-399/12 të KPC-së. Me shkresën nr. 3103/1 prot., datë 21.12.2020 "*Kthim kërkese për konstatim shkelje afati të arsyeshëm*", kancelari i Gjykatës së Lartë ka njoftuar kërkuesen se kërkesa për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave nuk është nënshkruar nga një avokat i pajisur me akt përfaqësimi, kriter i parashikuar në nenin 474 të KPC-së dhe, në këto kushte, e ka kthyer atë pa veprime për të bërë plotësimet përkatëse. Në vijim, në datën 30.12.2020 kërkuesja ka paraqitur në Gjykatën e Lartë kërkesë për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave, të nënshkruar si nga ajo, ashtu edhe nga një avokat, e cila është regjistruar me nr. 6 regjistri.

7. Me shkresën nr. 1009/1 prot., datë 01.04.2021 të kancelarit të Gjykatës së Lartë, në vijim të kërkesës së kërkueses për informacion, ajo është njoftuar se të dyja çështjet e saj, si rekursi, ashtu edhe kërkesa për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm, janë në fazën e studimit dhe në pritje për t'u shqyrtuar në dhomën e këshillimit.

8. Në datën 21.04.2021 kërkuesja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata)* me kërkesë, me objekt konstatimin e: shkeljes së aksesit në një gjykatë të caktuar me ligj; shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave në gjykimin e çështjes civile nr. 11243-02837-00-2017 akti, datë regjistrimi 14.09.2017 dhe çështjes nr. 6 regjistri, datë 30.12.2020; mungesës së një mjeti efektiv për konstatimin, dëmshpërblimin dhe përshpejtimin e procedurave të sipërpërmendura.

9. Me vendimin nr. 33, datë 01.11.2021, Gjykata, pasi ka shqyrtuar në themel pretendimin për kohëzgjatjen e paarsyeshme të procesit në Gjykatën e Lartë, ka vendosur rrëzimin e kërkesës si të pabazuar. Edhe pse ka konstatuar se deri diku ka një tejzgjatje të procesit, ku faktorë shtesë kanë qenë edhe veprimet administrative të kancelarit të Gjykatës së Lartë dhe se sjellja e kërkueses nuk ka penguar ecurinë e tij, Gjykata, bazuar në rrethanat e çështjes, kompleksitetin e saj, rrezikun në një shkallë jo të konsiderueshme për interesin e kërkueses, si dhe në numrin e lartë të çështjeve në Gjykatën e Lartë në pritje për t'u gjykuar, ka vlerësuar se nuk ka cenim të së drejtës për proces të rregullt ligjor si pasojë e mosshqyrtimit të çështjes brenda një afati të arsyeshëm.

10. Pas publikimit të vendimit të Gjykatës, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 6, datë 16.12.2021, ka vendosur rrëzimin e kërkesës së kërkueses për konstatimin e cenimit të afatit të arsyeshëm.

11. Në datën 07.03.2022 kërkuesja i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual për shfuqizimin e vendimit nr. 6, datë 16.12.2021 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë. Mbledhja e Gjyqtarëve, me vendimin nr. 56, datë 20.05.2022, ka vendosur moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare. Sipas Mbledhjes së Gjyqtarëve, vendimi i kundërshtuar nga kërkuesja, ndonëse përbën rrethanë të re, duke qenë se është dhënë pas vendimit të kësaj Gjykate, në vetvete nuk përbën shkak që ankimi kushtetues i ri të kalojë për shqyrtim në seancë plenare. Për sa i përket pretendimit kryesor të kërkueses për gjykimin e çështjes së saj brenda afatit të arsyeshëm, Mbledhja e Gjyqtarëve ka vlerësuar se kërkuesja nuk ka paraqitur ndonjë argument që të tregojë ndryshimin e situatës dhe të interesit të saj nga koha e dhënies së vendimit nr. 33, datë 01.11.2021 nga kjo Gjykatë, për rrjedhojë në rastin konkret nuk ekziston ndonjë fakt ose rrethanë e re që të ketë rëndësi të mjaftueshme për të ndryshuar arsyet që kanë qëndruar në themel të vendimmarrjes së mëparshme të saj.

12. Në datën 24.02.2023 kërkuesja ka paraqitur në Gjykatën e Lartë parashtrime shtesë në lidhje me rekursin e saj dhe në datën 25.04.2024 ka paraqitur, po përpara asaj gjykate, kërkesë me objekt konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e gjykimit të çështjes, konstatimin e statusit të viktimës përgjatë procesit gjyqësor, si dhe shpërblimin e dëmit si pasojë e shkeljes së afatit të arsyeshëm. Kjo kërkesë është regjistruar në Gjykatën e Lartë në datën 29.04.2024.

13. Në datën 30.04.2024 gjyqtarja relatore ka urdhëruar njoftimin e kërkueses për të metat e kërkesës, konkretisht mungesën e nënshkrimit nga avokati përfaqësues dhe të aktit të përfaqësimit, duke i caktuar një afat 5-ditor për plotësimin e tyre. Me shkresën e datës 07.05.2024, kërkuesja ka paraqitur në Gjykatën e Lartë kërkesën e nënshkruar nga avokati dhe aktin e përfaqësimit.

14. Me vendimin nr. 00-2024-2474, datë 21.05.2024, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, pasi ka marrë në shqyrtim kërkesën dhe pasi ka konstatuar se Kolegji Civil që ka në shqyrtim çështjen e kërkueses ka caktuar datën 11.09.2024 për shqyrtimin e rekursit në dhomën e këshillimit, përtej radhës së pritjes për gjykim, bazuar në nenin 399/7, pika 3, të KPC-së ka vendosur pushimin e shqyrtimit të kërkesës për konstatimin e cenimit dhe përshpejtimin e gjykimit.

15. Për sa i përket rekursit të kërkueses, me vendimin nr. 00-2024-3825,

datë 11.09.2024, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, duke vlerësuar se nuk përmbante shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 472 të KPC-së, ka vendosur mospranimin e tij.

16. Në datën 24.12.2024 kërkuesja i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual, për kundërshtimin e vendimit të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë që ka pushuar shqyrtimin e kërkesës për konstatimin e cenimit, duke kërkuar edhe konstatimin e mungesës së një mjeti efektiv, konstatimin e statutit të viktimës, si dhe zhdëmtimin në përputhje me ligjin. Kjo çështje është regjistruar me nr. 4 (Z) 2024 të Regjistrit Themeltar. Kolegji i Gjykatës, me vendimin e datës 05.03.2025, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

17. Në datën 25.02.2025 kërkuesja i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual për kundërshtimin edhe të vendimit të Kolegjit Civil që ka vendosur mospranimin e rekursit të saj. Kjo çështje është regjistruar me nr. 2 (Z) 2025 të Regjistrit Themeltar. Kolegji i Gjykatës, me vendimin e datës 20.05.2025, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

18. Në seancën plenare të datës 07.10.2025, Gjykata, pasi konstatoi se këto dy kërkesa të paraqitura nga kërkuesja kishin lidhje me njëra-tjetrën, pasi bëhej fjalë për të njëjtin proces gjyqësor, në mbështetje të nenit 19 të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, vendosi bashkimin e çështjeve nr. 4 (Z) 2024 të Regjistrit Themeltar dhe nr. 2 (Z) 2025 të Regjistrit Themeltar, me qëllim shqyrtimin e përbashkët të tyre. Po në bazë të kësaj dispozite, vendimi i Gjykatës mori numrin e çështjes së regjistruar më parë në Gjykatë, konkretisht 4 (Z) 2024 të Regjistrit Themeltar, datë 24.12.2024.

II
Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

19. ***Kërkuesja***, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar:

i) Për kërkimin për konstatimin e cenimit të së drejtës për kohëzgjatje të arsyeshme të procesit:

19.1. *Është cenuar e drejta e aksesit në një gjykatë të caktuar me ligj*, si pasojë e kthimit për plotësim, me urdhër të gjyqtarit relator, të kërkesës për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm në kundërshtim me jurisprudencën e Gjykatës që ka pohuar se në

këto raste nuk nevojitet nënshkrimi i kërkesës nga avokati. Edhe termi "nëse" në nenin 399/5 të KPC-së tregon se prokura kërkohet vetëm nëse kërkesa bëhet nga avokati.

19.2. *Është cenuar e drejta për të pasur një mjet efektiv për përshpejtimin e procedurave,* sipas nenit 13 të KEDNJ-së së bashku me nenin 6, pika 1, të saj, për shkak se rekursi është regjistruar në Gjykatën e Lartë më 14.09.2017 dhe deri në datën 11.09.2024 nuk ishte marrë asnjë masë për shqyrtimin e tij, edhe pse kishin kaluar shtatë vjet. Kërkesa është shqyrtuar nga Kolegji Administrativ në kundërshtim me nenin 399/6 të KPC-së, sipas të cilit kompetent për shqyrtimin e çështjes ishte Kolegji Civil. Kërkesa në Gjykatën e Lartë nuk përbën më mjet efektiv për zgjidhjen e pretendimeve për vonesa të procedurave të gjykimit.

19.3. *Është cenuar afati i arsyeshëm i gjykimit,* pasi afati 2-vjeçar sipas nenit 399/2 të KPC-së për shqyrtimin e çështjes në Gjykatën e Lartë është tejkaluar me pesë vjet. Në lidhje me sjelljen e kërkueses, qëndrimi i saj ka qenë në favor të përshpejtimit, duke qenë aktive, si dhe nuk ka ndikuar asnjë nga rrethanat e parashikuara nga neni 399/2 i KPC-së. Reforma në drejtësi ose procesi i rivlerësimit kalimtar nuk përbën shkak justifikues për tejkalimin e afateve. Gjykata e Lartë ka dështuar të japë drejtësi dhe nuk ka parashtruar asnjë fakt, provë ose precedent për vonesën në shqyrtimin e rekursit dhe për zbatimin e nenit 399/4 të KPC-së për shpërblimin e drejtë. Kohëzgjatja e procedurave rrezikon interesat e kërkueses, pasi ortaku i vetëm dhe administratori i saj Alban Ruli ishte nën masën e sigurimit "Arresti në shtëpi", si i dyshuar për kryerjen e veprave penale të parashikuara nga nenet 248 dhe 320 të Kodit Penal. Me urdhër të ministrit të Drejtësisë atij iu pezullua përkohësisht edhe certifikata e ushtrimit të veprimtarisë përmbarimore, masë që aktualisht është hequr. Me vendimin e datës 29.02.2024 të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, ai është deklaruar i pafajshëm për veprat penale për të cilat akuzohej, ndaj ka rrethana të reja që duhet të merren parasysh. Administratori Alban Ruli është kryefamiljar, me një fëmijë të mitur, me nënën në moshë të thyer që kërkon përkujdesje, ndërkohë që kur ai ka qenë nën masën e sigurimit e ka pasur të pamundur t`u përgjigjet kërkesave jetësore dhe bazike të familjes dhe biznesit dhe kërkuesja po shkon drejt

falimentimit. Për të riparuar sadopak pasojat negative të ardhura duhet të konstatohet shkelja e afatit të arsyeshëm dhe statusi i viktimës ende të parehabilituar. Vendimmarrja e Gjykatës së Lartë ka përkeqësuar pozitën e kërkueses dhe pasojat kanë të bëjnë si me aspektin e veprimtarisë ekonomike të saj, ashtu edhe atë personale/vetjake të ortakut të vetëm.

19.4. Në çështjen "ARB sh.p.k. e të tjerë kundër Shqipërisë", GJEDNJ-ja, me vendimin e datës 27.05.2025, ka gjetur shkelje të afatit të arsyeshëm, ndaj Gjykata është e detyruar ta marrë atë vendim në konsideratë në tërësi dhe paragrafët 109-111, 115, 118 e 124 të tij në veçanti dhe pas shfuqizimit të vendimit të Gjykatës së Lartë duhet të rehabilitojë statusin e kërkueses si "viktimë" e t'i akordojë asaj dëmshpërblimin e arsyeshëm.

ii) Për kërkimin për themelin e çështjes:

19.5. *Është cenuar e drejta për proces të rregullt në drejtim të:*

19.5.1. *Së drejtës së aksesit dhe standardit të arsyetimit të vendimit,* pasi Gjykata e Lartë ka refuzuar të pranojë rekursin dhe shtesat e tij, duke u mbështetur vetëm në shkaqe procedurale dhe duke shmangur shqyrtimin material të pretendimeve të kërkueses, për rrjedhojë nuk u ka dhënë përgjigje të arsyetuara pretendimeve me natyrë kushtetuese. Edhe pse është provuar lidhja shkakësore, e drejtpërdrejtë dhe e menjëhershme midis sjelljes së kundërligjshme të palës së paditur në proces dhe dëmit të shkaktuar, ajo gjykatë nuk ka zbatuar dispozitat e Kodit Civil (*KC*). Ajo nuk ka marrë në shqyrtim procesin penal të kallëzuar, provat në dosje, përfshirë raportet e ekspertëve që tregojnë humbjet financiare, dëm ky i shkaktuar nga pala e paditur. Për shkak se kërkuesja dështoi të ekzekutojë në kohë urdhrin e ekzekutimit nr. 9031/2012, gjendje/situatë e shkaktuar kjo nga Banka e Tiranës, KESH-i nuk lidhi kontrata të tjera shërbimi me të. Sipas aktit të ekspertimit të datës 16.07.2015 fitimi i munguar nga mosqarkullimi i shumës është në vlerën 32,370,550 lekë. Arsyetimi i Gjykatës së Lartë se subjekti që do të pësonte dëm nga veprimet ose mosveprimet e Bankës së Tiranës do të ishte KESH-i, bie në kundërshtim me pikën 1 të aneksit të kontratës së shërbimit, ndërkohë që qëndrimi i asaj gjykate se kërkuesja, si shërbim përmbarimor gjyqësor privat, ka një

funksion të pavarur publik, bie ndesh me shkaqet e rekursit për sa i takon markës së regjistruar "ARB" në Drejtorinë e Përgjithshme të Patentave dhe Markave. Vendimit të Gjykatës së Lartë i mungon analiza juridiko-ligjore, pasi nga veprimet dhe mosveprimet e kundërligjshme të palës së paditur në proces nuk është likuiduar tarifa përmbarimore.

19.5.2. *Parimit të barazisë së armëve,* pasi Gjykata e Lartë, duke rrëzuar argumentet e kërkueses ka favorizuar palën e paditur, Bankën e Tiranës, edhe pse në shkelje të legjislacionit në fuqi dhe detyrues për zbatim. Kjo, sipas kërkueses, përbën cenim edhe të *parimit të barazisë përpara ligjit.*

19.5.3. *Parimit të sigurisë juridike,* pasi Gjykata e Lartë ka vendosur në mënyra të ndryshme në situata të ngjashme, duke mbajtur standarde dhe qëndrim të dyfishtë në drejtim të arsyetimit të vendimit, në krahasim me vendime të tjera të saj, siç është ai nr. 00-2024-5438 (191), datë 18.04.2024.

19.6. *Është cenuar e drejta e pronës private*, pasi Gjykata e Lartë ka dështuar të trajtojë pretendimet për humbjen ekonomike të shkaktuar nga veprimet e Bankës së Tiranës. Pavarësisht fakteve, provave dhe argumenteve që tregojnë dëmet monetare, pretendimet e kërkueses janë rrëzuar pa u dhënë një justifikim i mjaftueshëm ligjor.

20. ***Subjekti i interesuar, Banka e Tiranës****,* ka prapësuar si vijon:

i) Për kërkimin për konstatimin e cenimit të së drejtës për kohëzgjatje të arsyeshme të procesit:

20.1. Pretendimet e kërkueses jo vetëm që nuk janë ngritur në nivel kushtetues, por janë edhe të pabazuara. Me vendim përfundimtar të formës së prerë është konfirmuar pabazueshmëria në ligj e në prova e së drejtës së pretenduar gjyqësisht, ndërkohë që për të ngritur këtë pretendim dhe për të kërkuar dëmshpërblim për këtë shkak, duhet të ketë ardhur një pasojë në të drejtat kushtetuese për shkak të procesit "të parregullt" gjyqësor. Jo vetëm që nuk është zhvilluar një proces i parregullt, pasi vonesat në gjykim kanë si shkak rrethana objektive, por kërkueses nuk i ka ardhur ndonjë pasojë, për sa kohë që e drejta e pretenduar gjyqësisht është konsideruar e pabazuar në themel Për sa kohë që kërkuesja nuk ka gëzuar asnjëherë një të drejtë/interes të ligjshëm në procesin gjyqësor të themelit, ajo nuk ka pasur dhe as nuk mund të kishte ndonjë pritshmëri të ligjshme

dhe/ose të ekzekutueshme nga mosrealizimi i së cilës do të mund t'i lindte ndonjë e drejtë për zhdëmtim. I vetmi subjekt që mund të ketë ndonjë pretendim në këtë drejtim është Banka e Tiranës, e cila i është nënshtruar një kalvari gjyqësor bazuar në një padi që është konstatuar e pabazuar nga gjykatat.

ii) Për kërkimin për themelin e çështjes:

20.2. Pretendimi për cenimin e *së drejtës së aksesit* dhe *standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor* është i pabazuar, pasi kërkuesja nuk ka arritur të provojë "të drejtën" mbi të cilën bazohej kërkimi gjyqësor dhe legjitimimin aktiv në proces, në mënyrë që të vijohej me përcaktimin e vlerës së dëmit sipas ekspertizës së kryer. Pretendimet e kërkueses se Gjykata e Lartë nuk ka konsideruar ekspertizën dhe se ka shmangur shqyrtimin material të pretendimeve janë të pabazuara. Kërkuesja ngatërron legjitimitetin aktiv në kuptimin substancial/material me atë formal/procedural. Pretendimet e kërkueses janë rrëzuar edhe gjatë procesit penal të nisur pas kallëzimit të saj kundër Bankës së Tiranës, për të cilin është pushuar çështja penale. Emri dhe marka tregtare e kërkueses nuk janë kundërshtuar dhe as nuk janë vënë në diskutim gjatë procesit gjyqësor. Të drejtat që rrjedhin nga pronësia intelektuale/industriale nuk kanë qenë objekt gjykimi dhe subjekti i interesuar nuk ka kryer asnjë veprim që mund të cenojë të drejtën industriale të kërkueses. Vendimi i Gjykatës së Lartë i plotëson të gjitha standardet e arsyetimit të vendimit gjyqësor të vendosura nga Gjykata.

20.3. Pretendimi për cenimin e *parimit të barazisë së armëve* dhe *barazisë përpara ligjit* është i pabazuar, pasi kërkuesja ka pasur në dispozicion dhe i ka ushtruar të gjitha mjetet procedurale, duke gëzuar të njëjtat armë ligjore si pala tjetër në proces. Asaj nuk i është mohuar e drejta për të qenë e pranishme në proces, për të depozituar prova dhe për t'u njohur me aktet e palës tjetër.

20.4. Pretendimi për cenimin e *parimit të sigurisë juridike* jo vetëm është i pabazuar, por edhe konfuz, pasi vendimi i të njëjtit kolegj të Gjykatës së Lartë dhe jurisprudenca evropiane janë shtrembëruar tërësisht. Në çështjen konkrete nuk ekziston asnjë vendim unifikues që të përcaktojë linjën e zbatueshme ligjore të zgjidhjes së çështjes, sikundër as vendime të gjykatave evropiane, të cilat nuk janë të detyrueshme për t'u zbatuar nga Gjykata e Lartë, për sa u takon pretendimeve të përmbaruesve

për shpërblim dëmi, si pasojë e veprimeve të konsideruara penguese të bankave.

20.5. I pabazuar është edhe pretendimi për cenimin e *së drejtës së pronës*, pasi vlera e kuantifikuar e dëmit të kërkuar gjyqësisht nga kërkuesja nuk përfshihet në nocionin "pronë" në përputhje me kriteret jurisprudenciale. Kërkimet në kërkesëpadi dhe provat e depozituara lidhen me procesin e ekzekutimit të urdhrit të ekzekutimit nr. 9031/2012, praktika e të cilit u është drejtuar 16 bankave të nivelit të dytë dhe jo vetëm Bankës së Tiranës, e cila ka pasur një aktivitet të kufizuar me KESH-in.

21. ***Subjekti i interesuar, KESH-i***, nuk ka paraqitur parashtrime me shkrim edhe pse është njoftuar rregullisht.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkueses

22. Çështja e legjitimimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, si dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

23. Gjykata vlerëson se kërkuesja legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, pasi është palë ndërgjyqëse në proceset gjyqësore objekt të ankimit kushtetues, ndaj justifikon interesin në çështjen e parashtruar. Për rrjedhojë, prapësimi i subjektit të interesuar, Bankës së Tiranës, se kërkuesja nuk legjitimohet, pasi nuk ka arritur të provojë gjatë procesit gjyqësor të themelit "të drejtën" mbi të cilën bazohej kërkimi gjyqësor dhe legjitimimin aktiv në proces, është i pabazuar.

24. Po kështu, kërkuesja ka *shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion*, sepse i është drejtuar Gjykatës pasi ka shteruar më parë, në

formë dhe përmbajtje, mjetet e zakonshme të ankimit, si për sa i përket kërkimit për kohëzgjatjen e paarsyeshme të procesit gjyqësor, ashtu edhe atij për themelin e çështjes, për rrjedhojë nuk ka mjete të tjera në dispozicion përveç ankimit kushtetues individual.

25. Kërkuesja legjitimohet edhe *ratione temporis* për të dyja kërkimet e ngritura në ankimin kushtetues individual. Lidhur me kërkimin e parë, për konstatimin e cenimit të afatit të arsyeshëm, jo vetëm që shkelja është vazhduese, por ankimi kushtetues individual është paraqitur në datën 24.12.2024, kurse vendimi i datës 21.05.2024 i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, sipas shkresës të datës 16.09.2024 të asaj gjykate, është bërë i disponueshëm në datën 04.09.2024 kur është publikuar në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë. Lidhur me kërkimin e dytë, për procesin e themelit të çështjes, ankimi kushtetues individual është paraqitur në datën 25.02.2025, kurse vendimi i Kolegjit Civil që ka vendosur mospranimin e rekursit, i cili mban datën 11.09.2024, sipas shkresës nr. 6423/1, datë 27.01.2025 të Gjykatës së Lartë, është bërë i disponueshëm në datën 30.10.2024. Për rrjedhojë, ankimi kushtetues i kërkueses është paraqitur brenda afatit 4-mujor të parashikuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja "b", i ligjit nr. 8577/2000.

26. Në këndvështrim të legjitimimit *ratione materiae*, për sa i përket procesit gjyqësor që ka shqyrtuar kërkesën për kohëzgjatjen e paarsyeshme të procesit në Gjykatën e Lartë, Gjykata vëren se kërkuesja ka vënë edhe më parë në lëvizje juridiksionin kushtetues për këtë qëllim (*shih paragrafët 8-11 të vendimit*) dhe në vijim i është drejtuar GJEDNJ-së, duke pretenduar cenimin e neneve 6, pika 1 dhe 13 të KEDNJ-së për shkak të kohëzgjatjes së paarsyeshme të proceseve gjyqësore ku ajo është palë (kërkesat nr. 39860/19 dhe nr. 38996/20, ku kjo e fundit i përket procesit gjyqësor në shqyrtim). Këto dy kërkesa janë bashkuar edhe me dy kërkesa të tjera kundër shtetit shqiptar dhe në përfundim GJEDNJ-ja, me vendimin e datës 27.05.2025, ka vendosur se ka pasur shkelje të nenit 6, pika 1 dhe nenit 13 të KEDNJ-së. Po kështu GJEDNJ-ja, në zbatim të nenit 41 të KEDNJ-së, i ka njohur kërkueses, në lidhje me kërkesën nr. 38996/20, dëmin jopasuror në vlerën 2,400 euro dhe kostot e shpenzimet në vlerën 1,500 euro, ndërkohë që për dëmin pasuror të pretenduar ka vlerësuar se nuk ka gjetur ndonjë lidhje midis tij dhe shkeljeve të konstatuara.

27. Sipas nenit 71/a, pika 1, shkronja "ç", të ligjit nr. 8577/2000, ankimi kushtetues shqyrtohet nga Gjykata kur shqyrtimi i çështjes prej saj do të mund të rivendoste në vend të drejtën e shkelur të individit. Gjykata

vëren se vendimi i GJEDNJ-së në çështjen e kërkueses është dhënë në datën 27.05.2025, pra pasi ankimi kushtetues i kërkueses ishte shqyrtuar nga Kolegji i Gjykatës dhe ky i fundit, me vendimin e datës 05.03.2025, kishte vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare. Gjykata vëren, gjithashtu, se e drejta themelore që është kërkuar të rivendoset me ankimin kushtetues individual, është rivendosur tashmë nga GJEDNJ-ja, e cila jo vetëm që ka konstatuar shkeljen e së drejtës së kërkueses për proces të rregullt në drejtim të kohëzgjatjes së paarsyeshme të procesit në Gjykatën e Lartë, por i ka njohur asaj edhe shpërblimin e drejtë për dëmin e shkaktuar nga kjo vonesë. Duke pasur parasysh qëllimin e mjeteve juridike që ofron legjislacioni në fuqi, që janë përshpejtimi i gjykimit dhe shpërblimi i dëmit në rastet e konstatimit të tejzgjatjes së procesit gjyqësor, Gjykata vëren se përmes ankimit kushtetues individual të paraqitur pas përfundimit të shqyrtimit të rekursit në Gjykatën e Lartë kërkuesja ka synuar pikërisht konstatimin e cenimit të së drejtës për një gjykim brenda një afati të arsyeshëm, me qëllim njohjen e shpërblimit të drejtë sipas dispozitave përkatëse të KPC-së. Për rrjedhojë, në kuptim të nenit 71/a, pika 1, shkronja "ç", të ligjit nr. 8577/2000, kërkimi i parë i kërkueses si më sipër nuk mund të merret në shqyrtim.

28. Për sa i përket kërkimit të dytë të ankimit kushtetues individual, për procesin e themelit të çështjes, Gjykata vëren se edhe pse në objektin e ankimit kushtetues janë kundërshtuar vendimet gjyqësore të të tria shkallëve të gjykimit, në përmbajtjen e tij janë ngritur pretendime vetëm për procesin gjyqësor të zhvilluar në Gjykatën e Lartë, në përfundim të të cilit është vendosur mospranimi i rekursit të paraqitur nga kërkuesja.

29. Sipas kërkueses, janë cenuar *e drejta e aksesit* dhe lidhur me të *standardi i arsyetimit të vendimit gjyqësor*, *parimi i barazisë së armëve* dhe ai *i barazisë përpara ligjit*, *parimi i sigurisë juridike*, si dhe *e drejta e pronës private*. Për sa u përket argumenteve mbi të cilat janë mbështetur këto pretendime, Gjykata vëren se në drejtim të *parimit të barazisë së armëve në proces* dhe atij *të barazisë përpara ligjit* kërkuesja ka pretenduar se Gjykata e Lartë duke rrëzuar argumentet e kërkueses ka favorizuar veprimet procedurale të palës së paditur në proces, Bankës së Tiranës. Po kështu, në drejtim të *së drejtës së pronës private*, kërkuesja ka pretenduar se Gjykata e Lartë ka dështuar të trajtojë pretendimet për humbjen ekonomike të shkaktuar nga veprimet e Bankës së Tiranës, pavarësisht provave të paraqitura, pa marrë në konsideratë argumentet e kërkueses. Për rrjedhojë, këto pretendime, për nga natyra e tyre, kanë të bëjnë, në thelb, me mënyrën

sesi Gjykata e Lartë ka shqyrtuar dhe arsyetuar pretendimet e kërkueses, ndaj do të shqyrtohen në vijim në këndvështrim të *së drejtës së aksesit* të lidhur me *standardin e arsyetimi të vendimit.*

30. Kërkuesja ka pretenduar edhe cenimin e *parimit të sigurisë juridike,* për shkak se Gjykata e Lartë ka dëmtuar me pasoja të tashme dhe të ardhme qëndrueshmërinë ligjore, si dhe për shkak se ka zbatuar standarde të ndryshme, duke vendosur në mënyra të ndryshme në situata të ngjashme. Gjykata në jurisprudencën e saj, kur janë ngritur pretendime për mënyrën sesi gjykatat kanë vendosur në raste të ngjashme, ka theksuar se vlerësimi kushtetues i mënyrës së zgjidhjes së çështjeve të ngjashme nga gjykatat e zakonshme bëhet rast pas rasti, duke iu referuar edhe rastit konkret. Fakti që gjykatat e zakonshme kanë vendosur ndryshe në një rast të ngjashëm, në vetvete nuk mund të justifikojë *apriori* pretendimet e individit, pasi mënyra e zgjidhjes së çështjes dhe e zbatimit të ligjit është e drejtë e çdo gjykate, për sa kohë çdo çështje konkrete është specifike dhe ka individualitetin e saj, harmonizuar edhe me rrethana, faktorë, motive ose prova gjyqësore, të cilat nuk mund të jenë të njëjta (*shih vendimet nr. 19, datë 21.03.2024; nr. 17, datë 23.03.2023 të Gjykatës Kushtetuese*). Megjithatë, Gjykata vëren se kërkuesja, në mbështetje të këtij pretendimi, i referohet një vendimi njësues të praktikës gjyqësore të Kolegjit Civil (vendimi nr. 00-2024-5438 (191), datë 18.04.2024), në të cilin janë shtruar për zgjidhje disa çështje ligjore që kanë të bëjnë me interpretimin e ligjit nr. 9072, datë 22.05.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike" dhe ligjit nr. 43/2015 që e ka shfuqizuar atë, lidhur me kuptimin e institutit të dëmit ekonomik të llogaritur nga furnizuesi i energjisë elektrike në faturën tatimore të konsumit të energjisë elektrike dhe të cilësisë së tij si titull ekzekutiv, si pjesë e faturës së energjisë elektrike. Për rrjedhojë, jo vetëm që vendimi i referuar prej kërkueses nuk ka lidhje me çështjen e saj, por as nuk ndodhemi përpara rastit të njëjtë apo rrethanave të njëjta me ato të çështjes së kërkueses. Në këto kushte, ky pretendim është haptazi i pabazuar.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit

31. *Kërkuesja* ka pretenduar se Gjykata e Lartë nuk u ka dhënë përgjigje të arsyetuar pretendimeve me natyrë kushtetuese duke u mjaftuar me arsyetimin "*de plano*", edhe pse është provuar lidhja shkakësore midis sjelljes së kundërligjshme të palës së paditur dhe dëmit të shkaktuar, referuar akteve dhe

provave të cilat nuk janë marrë në shqyrtim. Sipas kërkueses, pretendimet e saj janë rrëzuar pa një justifikim të mjaftueshëm ligjor, ndërkohë që është provuar se për shkak se nuk është ekzekutuar në kohë urdhri i ekzekutimit nr. 9031/2012, e shkaktuar kjo drejtpërdrejt nga Banka e Tiranës, kreditori nuk ka lidhur kontrata të tjera shërbimi me të, çka, sipas ekspertit, ka sjellë fitim të munguar në vlerën 32,370,550 lekë. Po sipas kërkueses, arsyetimi i Gjykatës së Lartë se subjekti që do të pësonte dëm në këtë rast do të ishte KESH-i, bie në kundërshtim me pikën 1 të aneksit të kontratës së shërbimit, ndërkohë që qëndrimi i asaj gjykate se kërkuesja, si shërbim përmbarimor gjyqësor privat, ka një funksion të pavarur publik, bie ndesh me rekursin dhe parashtrimet shtesë për sa i takon markës së regjistruar "ARB". Kërkuesja ka pretenduar se vendimit të Gjykatës së Lartë i mungon analiza juridiko-ligjore, pasi nga veprimet dhe mosveprimet e kundërligjshme të palës së paditur nuk është likuiduar tarifa përmbarimore dhe se duke rrëzuar argumentet e kërkueses ajo gjykatë ka favorizuar palën e paditur në proces.

32. *Subjekti i interesuar, Banka e Tiranës,* ka prapësuar se pretendimet e kërkueses janë të pabazuara, pasi gjatë gjykimit nuk është provuar "e drejta" mbi të cilën bazohej kërkimi gjyqësor dhe legjitimimi aktiv i saj. Sipas tij, pretendimet e kërkueses janë rrëzuar edhe në procesin penal për kallëzimin e saj kundër Bankës së Tiranës, ku është vendosur pushimi i çështjes penale, ndërkohë që emri dhe marka tregtare e kërkueses nuk kanë qenë objekt shqyrtimi dhe nuk janë vënë në diskutim gjatë procesit gjyqësor dhe as të drejtat që rrjedhin nga pronësia intelektuale/industriale. Sipas subjektit të interesuar, vendimi i Gjykatës së Lartë plotëson standardin e arsyetimit. Po sipas tij, kërkuesja ka pasur në dispozicion dhe i ka ushtruar të gjitha mjetet procedurale, duke gëzuar të njëjtat armë ligjore si pala tjetër në proces dhe se vlera e kuantifikuar e dëmit të kërkuar gjyqësisht nuk përfshihet në nocionin "pronë".

33. Në kuptim të nenit 42, pika 1, të Kushtetutës, e drejta e aksesit i garanton individit të drejtën t'i drejtohet një gjykate, e cila do t'i dëgjojë pretendimet e tij dhe do të shpallë një vendim që u jep përgjigje atyre (pretendimeve), përfshirë edhe pretendimet që mund të ngrihen nga pala tjetër, e ndryshme nga kërkuesi, në kuadër të ankimeve që mund të bëhen gjatë zhvillimit të procesit gjyqësor, pas një gjykimi të drejtë dhe publik. Ajo nuk përfshin vetëm të drejtën për të filluar një proces, por edhe të drejtën për të pasur, nga ana e gjykatës, një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi *(shih vendimet nr. 73, datë 17.10.2024; nr. 5, datë 09.02.2023; nr. 29, datë 01.11.2022 të Gjykatës Kushtetuese)*.

34. Nga ana tjetër, e drejta për proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë dhe funksioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve se ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë (*shih vendimet nr. 19, datë 21.03.2024; nr. 21, datë 26.09.2022; nr. 67, datë 10.11.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie, kontradiksion të hapur ose të fshehtë dhe duhet të jenë, gjithashtu, të mjaftueshme për të mbështetur dhe pranuar pjesën urdhëruese (*shih vendimet nr. 19, datë 21.03.2024; nr. 79, datë 14.12.2017; nr. 3, datë 26.01.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

35. Gjithsesi, zbatimi i këtij parimi është vlerësuar nga Gjykata rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes dhe natyrës së vendimit, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsyetimin e tyre (*shih vendimet nr. 19, datë 21.03.2024; nr. 21, datë 26.09.2022; nr. 6, datë 16.02.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Për sa u përket vendimeve të Gjykatës së Lartë për mospranimin e rekursit, Gjykata ka theksuar se ato mund të arsyetohen në mënyrë të kufizuar, me kusht që në pjesën hyrëse të listohen shkaqet e rekursit. Ky arsyetim i kufizuar nuk cenon standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor, përderisa, në thelb, shpreh shkaqet e mospranimit të rekursit nga ana e kolegjeve të saj gjatë shqyrtimit paraprak të tij në dhomën e këshillimit (*shih vendimet nr. 10, datë 07.03.2023; nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 21, datë 16.04.2015 të Gjykatës Kushtetuese*). Po kështu, Gjykata ka theksuar se ajo nuk vepron si gjykatë e shkallës së katërt dhe për këtë arsye vendimet e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm nuk vihen në dyshim, përveç rasteve kur gjetjet e tyre mund të konsiderohen si arbitrare ose haptazi të paarsyeshme (*shih vendimet nr. 19, datë 21.03.2024; nr. 4, datë 31.01.2024; nr. 30, datë 29.05.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

36. Bazuar në standardet e mësipërme kushtetuese, Gjykata do të analizojë në vijim nëse në rastin konkret Gjykata e Lartë, në përputhje me funksionin e saj, ka marrë në shqyrtim pretendimet e parashtruara nga kërkuesja dhe nëse ka argumentuar mjaftueshëm qëndrimin e saj për mospranimin e rekursit.

37. Gjykata vëren se kërkuesja i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me padi kundër subjektit të interesuar, Bankës së Tiranës,

duke kërkuar detyrimin e palës së paditur për shpërblimin e dëmit pasuror e jopasuror të shkaktuar nga veprimet e saj me faj, në masën 10,000,000 lekë, fitimin e munguar, si dhe kamatat ligjore, sipas normës tribor njëditor të Bankës së Shqipërisë, deri në ekzekutimin e vendimit. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur rrëzimin e padisë, duke arsyetuar se paditësja (kërkuesja) nuk ka mundur të provojë dëmin, si dhe sjelljet e paligjshme të të paditurës, Bankës së Tiranës, ndaj nuk legjitimohet në kërkimet e saj. Mbi ankimin e kërkueses, Gjykata e Apelit Tiranë ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, duke e vlerësuar qëndrimin e saj të bazuar në ligj e në prova. Sipas gjykatës së apelit, e paditura, Banka e Tiranës, ka respektuar urdhërimet e KPC-së dhe nuk ka kryer asnjë veprim të paligjshëm. Po sipas gjykatës së apelit, kërkuesja ka përfituar shpërblimin përkatës për efekt të kryerjes së çdo veprimi përmbarimor, ndërkohë që në një rast hipotetik subjekti që do të pësonte nga veprimet e bankës do të ishte KESH-i.

38. Kundër vendimit të gjykatës së apelit kërkuesja ka paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë dhe në datën 24.02.2023 ajo ka paraqitur edhe parashtrime shtesë për rekursin. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, me vendimin nr. 00-2024-3825, datë 11.09.2024, ka vendosur mospranimin e rekursit, duke vlerësuar se nuk ekzistojnë shkaqet ligjore të parashikuara në nenin 472 të KPC-së, të cilat ta bëjnë të cenueshëm vendimin objekt rekursi. Sipas asaj gjykate: i) gjykatat e faktit kanë respektuar normat procedurale të cilat mund të çojnë në pavlefshmërinë e vendimit gjyqësor ose të procedurës së gjykimit dhe nuk rezultojnë shkaqe të rënda procedurale që të kenë ndikuar dukshëm në dhënien e vendimeve; ii) palëve u është dhënë mundësia të realizojnë të drejtën e mbrojtjes, të paraqesin prova, të njihen me provat e palës kundërshtare, të debatojnë në lidhje me to, të shprehin qëndrimin për zgjidhjen e mosmarrëveshjes, duke u respektuar parimet e procesit të rregullt; iii) gjykatat e faktit kanë respektuar dhe zbatuar drejt dispozitat e ligjit material për zgjidhjen e çështjes, kanë bërë një cilësim të drejtë të fakteve dhe rrethanave që lidhen me mosmarrëveshjen, kanë kryer një analizë juridike të plotë të provave dhe e kanë zgjidhur mosmarrëveshjen në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi; iv) vendimet e gjykatave të faktit nuk vijnë në kundërshtim me praktikën e Kolegjit Civil ose të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë; v) shkaqet e parashtruara në rekurs ngrenë kryesisht çështje të vlerësimit të provave dhe fakteve, të cilat dalin jashtë juridiksionit rishikues dhe ligjor të Gjykatës së Lartë si gjykatë ligji. Sipas Gjykatës së Lartë,

përmbaruesi gjyqësor ushtron detyrën me qëllim ekzekutimin e titullit ekzekutiv dhe jo për përmbushjen e interesave të tij personale. Ajo gjykatë ka vlerësuar se këtij subjekti ligji i ka njohur mjetet ligjore përmes të cilave ai vepron për të shmangur pengesat nga debitori ose nga personat e tretë për të përmbushur detyrën për ekzekutimin e titullit ekzekutiv dhe veprimet e tyre penguese ndëshkohen me gjobë, por nuk mund të përbëjnë bazë për lindjen e së drejtës së dëmshpërblim për përmbaruesin sipas neneve 608 e vijues të KC-së. Po sipas Gjykatës së Lartë, përmbaruesi gjyqësor nuk mund të bëjë të vlefshme në emrin e tij të drejta që i përkasin subjektit në favor të të cilit bëhet ekzekutimi dhe as mund të kërkojë të përfitojë si dëm interesat e vonesës së pagimit të shumës objekt ekzekutimi në llogari të tij, pasi ai nuk ka asnjë të drejtë të përfitojë interesa e as të sillet si pronar mbi një pasuri që i përket kreditorit (*shih paragrafët 15, 16 dhe 18-18.2 të vendimit të Gjykatës së Lartë*).

39. Gjykata vëren se, ndryshe nga sa pretendon kërkuesja, Gjykata e Lartë, pasi ka marrë në shqyrtim shkaqet e parashtruara në rekurs dhe parashtrimet shtesë të rekursit, të cilat gjejnë pasqyrim në vendimin e saj, ka vlerësuar se nuk janë të tilla që të cenojnë vendimmarrjen e gjykatës së apelit, duke dhënë argumentet mbi bazën e të cilave ka arritur në mënyrën e zgjidhjes së çështjes. Vendimi i Kolegjit Civil përmbush elementet e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese. Në aspektin formal vendimi ka pasqyruar të dhënat e palëve në procesin gjyqësor, shkaqet e parashtruara në ankim dhe rekurs, disponimet e gjykatave më të ulëta, ligjin e zbatueshëm dhe në pjesën arsyetuese janë pasqyruar shkaqet që kanë çuar në qëndrimin e shprehur në dispozitiv. Për sa i përket arsyetimit të atij vendimi, në drejtim të argumenteve mbi të cilat është mbështetur qëndrimi i Gjykatës së Lartë, Gjykata vlerëson se ato nuk rezulton të jenë arbitrare, alogjike apo kontradiktore ose që vendimi të jetë i paqartë në përmbajtjen dhe vlerësimin e shkaqeve të parashtruara përpara asaj gjykate nga kërkuesja. Për rrjedhojë, vendimi i Kolegjit Civil nuk vë në dyshim respektimin e së drejtës për proces të rregullt në drejtim të aksesit dhe standardit të arsyetimit dhe vetëm fakti se është vendosur mospranimi i rekursit të kërkueses nuk është i mjaftueshëm në këndvështrimin kushtetues për të vënë në dyshim procesin gjyqësor të zhvilluar në Gjykatën e Lartë.

40. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkueses për cenimin e së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor është i pabazuar.

41. Në përfundim, Gjykata çmon se kërkesa është e pabazuar, sipas arsyetimit të mësipërm të vendimit, ndaj ajo rrëzohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, si dhe neneve 71 e 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, njëzëri,

V E N D O S I:

1. Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 07.10.2025
Shpallur më 12.11.2025

Vendim nr. 53, datë 09.10.2025
(V-53/25)

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Holta Zaçaj, Kryetare, Marsida Xhaferllari, Fiona Papajorgji, Sonila Bejtja, Sandër Beci, Ilir Toska, Marjana Semini, Genti Ibrahimi, anëtarë, me sekretare Anjeza Puka, në datën 07.10.2025 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 3 (Z) 2024 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUESE: **SHOQËRIA "ZYRA E PËRMBARIMIT PRIVAT ARB" SH.P.K.**, përfaqësuar nga administratori Alban Ruli.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:
"RAIFFEISEN BANK" SH.A., në mungesë.
KORPORATA ELEKTROENERGJETIKE SHQIPTARE SH.A., në mungesë.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2024-2946, datë 09.07.2024, i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**
Konstatimi i cenimit të aksesit në një gjykatë të krijuar me ligj.
Konstatimi i shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimi i procedurës së gjykimit nga kolegji tjetër i Gjykatës së Lartë, për sa i përket çështjes nr. 11118-00653-00-2019 akti, datë regjistrimi 13.03.2019, në lidhje me vendimin nr. 4868, datë 06.06.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, lënë në fuqi me vendimin nr. 42, datë 21.01.2019 të Gjykatës së Apelit Tiranë.
Konstatimi i mungesës së një mjeti efektiv për konstatimin, dëmshpërblimin dhe përshpejtimin e procedurave të sipërpërmendura.

Konstatimi i statusit të viktimës përgjatë procesit gjyqësor, si rrjedhojë e cenimit të aksesit në një gjykatë të krijuar me ligj dhe afatit të arsyeshëm, në përputhje me vendimin *Scordino kundër Italisë*.
Rehabilitimi dhe zhdëmtimi në përputhje me ligjin, pasi dëmi/dëmtimi është shkaktuar/ka ardhur për shkak të vendimit "Për plotësimin e të metave të kërkesës", datë 30.04.2024 të Gjykatës së Lartë dhe shkeljes së afatit të arsyeshëm në gjykim.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 44, 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 6, paragrafi 1 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut *(KEDNJ)*; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar *(ligji nr. 8577/2000).*

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Genti Ibrahimi, mori në shqyrtim pretendimet e kërkueses, shoqërisë "Zyra e Përmbarimit Privat ARB" sh.p.k. *(kërkuesja*), e cila ka kërkuar pranimin e kërkesës, konstatoi mungesën e prapësimeve të subjekteve të interesuara, "Raiffeisen Bank" sh.a. (*banka*) dhe Korporatës Elektroenergjetike Shqiptare (*KESH*), si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I
Rrethanat e çështjes

1. Në ushtrim të funksionit të saj, kërkuesja ka lidhur kontratë shërbimi me KESH-in, me objekt kryerjen e shërbimit përmbarimor për ekzekutimin e urdhrit të ekzekutimit nr. 9031 akti, datë 13.09.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Pas lajmërimit për ekzekutimin vullnetar të

urdhrit të ekzekutimit, kërkuesja ka lëshuar urdhrin për vënien e sekuestros konservative drejtuar bankave të nivelit të dytë.

2. Kërkuesja ka pretenduar se banka në atë kohë ka kryer veprime të tilla që të krijojnë bindje të arsyeshme se ajo ka fshehur likuiditetet e debitorit, shoqërisë "CEZ Shpërndarje" sh.a. (*CEZ*) dhe se banka, organet dhe përfaqësuesit e saj, ka pasur fitime të drejtpërdrejta nga këto veprime të kundërligjshme. Për më tepër, banka nuk i ka dhënë kërkueses informacionin e kërkuar.

3. Në këto kushte, kërkuesja ka vlerësuar se mosekzekutimi i urdhrit të ekzekutimit i ka dëmtuar asaj reputacionin e konsoliduar në treg, për rrjedhojë edhe fitimet, dhe në datën 28.05.2014 ajo i është drejtuar gjykatës me kërkesëpadi kundër bankës, me palë të tretë KESH-in, duke kërkuar detyrimin e shoqërisë së paditur t'i dëmshpërblejë dëmin pasuror dhe jopasuror të shkaktuar me faj, fitimin e munguar, si dhe kamatat ligjore përkatëse sipas normës Tribor njëditore të vendosur nga Banka e Shqipërisë deri në datën e ekzekutimit të vendimit të gjykatës.

4. Në përfundim të gjykimit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 4868, datë 06.06.2016, ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë, pasi nuk u vërtetua ekzistenca e ndonjë dëmi pasuror që t'i ketë ardhur paditëses (kërkueses) nga veprimet e të padituri. Ajo gjykatë ka evidentuar se sipas kërkueses dëmi konsiston në fitimin e munguar që do të kishte realizuar shoqëria nga kontratat e shërbimit që shpresonte të lidhte në të ardhmen me KESH-in. Në rastin konkret fitimi i munguar i pretenduar prej kërkueses është cilësuar nga gjykata si imagjinar, pasi nuk është provuar fakti se të gjithë titujt ekzekutivë me kreditor KESH-in do të viheshin në ekzekutim nga kërkuesja. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 42, datë 21.01.2019, me të njëjtën linjë arsyetimi.

5. Në datën 13.02.2019 kërkuesja ka ushtruar rekurs. Çështja është regjistruar në Gjykatën e Lartë me nr. 11118-00653-00-2019 akti, datë 13.03.2019 regjistrimi, por nuk është gjykuar ende.

6. Gjatë kohës që rekursi ishte në pritje për shqyrtim, në datën 26.03.2021 kërkuesja i është drejtuar Gjykatës së Lartë me kërkesë për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave në gjykimin e çështjes civile në fjalë, bazuar në nenet 399/1-399/12 të Kodit të Procedurës Civile *(KPC)*.

7. Duke pretenduar se Gjykata e Lartë ishte në vonesë si për shqyrtimin e çështjes civile, ashtu edhe për shqyrtimin e kërkesës së saj për konstatimin e

shkeljes së afatit të arsyeshëm, kërkuesja në datën 10.06.2021 ka paraqitur ankim kushtetues individual në Gjykatën Kushtetuese (*Gjykata*), duke kërkuar: (i) konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave në gjykimin e çështjes civile dhe shqyrtimin e kërkesës për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm; (ii) konstatimin e mungesës së një mjeti efektiv për konstatimin, dëmshpërblimin dhe përshpejtimin e procedurave të sipërpërmendura (*kërkesa nr. 1*).

8. Gjykata, me vendimin nr. 39, datë 09.12.2021, ka vendosur rrëzimin e kërkesës, pasi ka vlerësuar se edhe pse duket se deri diku ka një tejzgjatje të procesit, duke konsideruar rrethanat e çështjes, kompleksitetin e saj, rrezikun në një shkallë jo të konsiderueshme për interesin e kërkueses, si dhe numrin e lartë të çështjeve në Gjykatën e Lartë në pritje për t'u gjykuar nga një numër i reduktuar gjyqtarësh, nuk ka cenim të së drejtës për proces të rregullt ligjor si pasojë e mosshqyrtimit të çështjes brenda një afati të arsyeshëm.

9. Pas publikimit të vendimit të Gjykatës në Fletoren Zyrtare, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 9, datë 11.04.2022, ka vendosur rrëzimin e kërkesës për përshpejtimin e procedurave të paraqitur nga kërkuesja në datën 26.03.2021. Gjykata e Lartë ka arsyetuar, ndër të tjera, se procedura e shqyrtimit të rekursit të kërkueses ka kaluar afatin ligjor, megjithatë tejkalimi i këtij afati është rrjedhojë e disa rrethanave që përbëjnë pamundësi objektive.

10. Në datën 18.07.2022 kërkuesja i është drejtuar sërish Gjykatës me ankim kushtetues individual për shfuqizimin e vendimit nr. 9, datë 11.04.2022 të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën dhe detyrimin e Gjykatës së Lartë për rishqyrtimin e kërkesës (*kërkesa nr. 2*).

11. Mbledhja e Gjyqtarëve, me vendimin nr. 155, datë 16.11.2022, ka vendosur moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare, pasi ka vlerësuar se në rastin konkret nuk ekzistonte ndonjë fakt ose rrethanë e ndodhur pas dhënies së vendimit të mëparshëm të Gjykatës, që të kishte rëndësi të mjaftueshme për të ndryshuar arsyet që kanë qëndruar në themel të vendimmarrjes së mëparshme të saj. Sipas Mbledhjes së Gjyqtarëve, periudha kohore e kaluar nga publikimi në Fletoren Zyrtare të vendimit të mëparshëm të Gjykatës nuk ndryshonte substancialisht situatën e kërkueses në mënyrë të tillë që kërkesa e saj të konsiderohet si çështje e re për efekt të gjykimit kushtetues (*vendimi nr. 155/2022*).

12. Më pas, në datën 25.04.2024 kërkuesja ka paraqitur në Gjykatën e Lartë një kërkesë të re për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave në gjykimin e çështjes civile në fjalë.

Kërkesa është regjistruar në Gjykatën e Lartë me nr. 77205-00024-00-2024 të regjistrit themeltar, datë regjistrimi 29.04.2024 dhe me vendimin e datës 30.04.2024 të gjyqtarit relator kërkueses i është kërkuar plotësimi i të metave për shkak se mungonte nënshkrimi i avokatit. Në këto kushte, kërkuesja ka paraqitur sërish në Gjykatën e Lartë kërkesën e nënshkruar nga avokati dhe autorizimin përkatës.

13. Në vijim, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-2946, datë 09.07.2024, ka vendosur rrëzimin e kërkesës për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm të paraqitur nga kërkuesja, me argumentin se tejkalimi i afatit ligjor për shqyrtimin e rekursit të saj nuk ka ardhur as për faj të palës, por as për faj të gjykatës, por është rrjedhojë e disa rrethanave që përbëjnë pamundësi objektive. Për më tepër, sipas atij kolegji, kërkesa është mbështetur vetëm në argumentin e tejkalimit të afatit 2-vjeçar dhe se kategoria e mosmarrëveshjes në fjalë nuk përfshihet në rrethin e asaj kategorie mosmarrëveshjesh për të cilat parashikohet shqyrtimi me procedura të përshpejtuara. Shqyrtimi me përparësi i çështjes vetëm për shkak të paraqitjes së kërkesës nga kërkuesja, do të cenonte parimin kushtetues të barazisë para ligjit, sipas tij, i cili gjen zbatim edhe në rregullat e vendosura për radhën e gjykimit të çështjeve në Gjykatën e Lartë, ku çështja e regjistruar më parë në këtë shkallë gjykimi, sidomos me të njëjtën natyrë, ka përparësi ndaj çështjes së mbërritur më vonë, me përjashtim të rasteve kur veçantia e natyrës së çështjes dhe e rrethanave subjektive justifikojnë përjashtimin e radhës së gjykimit. Natyra e çështjes në rastin konkret është vlerësuar nga ai kolegj se nuk gëzon cilësi të veçanta të prioritetit të gjykimit.

14. Në datën 24.12.2024 kërkuesja i është drejtuar sërish Gjykatës duke paraqitur ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij (*kërkesa nr. 3*). Kolegji në datën 12.03.2025 ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II
Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

15. ***Kërkuesja***, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar *e drejta për proces të rregullt ligjor*, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të:

15.1. *Së drejtës së aksesit në një gjykatë të caktuar me ligj*, të garantuar në nenin 42 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së, si pasojë

e shkresës nr. 77205-00024-00-2024 të regjistrit themeltar, datë 30.04.2024 "Vendim për plotësimin e të metave të kërkesës" të Gjykatës së Lartë, përmes së cilës kërkohej plotësimi i kërkesës së datës 25.04.2024 së kërkueses për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave. Në këtë mënyrë ajo gjykatë nuk zbaton as vendimet e detyrueshme të Gjykatës, e cila ka një praktikë të konsoliduar të lidhur me veprimin administrativ të kthimit të kërkesës për përshpejtim nga kancelari i Gjykatës së Lartë. Për më tepër që në interpretim të nenit 399/5, pika 2, shkronja "ç", të KPC-së, kjo lloj kërkese mund të bëhet nga kërkuesja dhe, vetëm në rast se bëhet nga avokati, nevojitet pajisja me prokurë.

15.2. *Së drejtës për një gjykatë të caktuar me ligj*, pasi kërkesa e kërkueses drejtuar Gjykatës së Lartë për konstatimin e cenimit të afatit, në kundërshtim me nenin 399/6, shkronja "c" të KPC-së, është shqyrtuar nga Kolegji Administrativ i asaj gjykate dhe jo nga një trupë tjetër civile (Kolegji Civil), edhe pse sipas të dhënave të faqes zyrtare të Gjykatës së Lartë, Kolegji Civil i saj përbëhet nga tre trupa të përhershme.

15.3. *Së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë të paanshme*, pasi Gjykata e Lartë e ka paragjykuar ose paracaktuar fatin e çështjes së themelit të kërkesës, duke ushtruar ndikim mbi Kolegjin Civil që do ta shqyrtojë atë, pasi në vendimin objekt kundërshtimi është shprehur se nuk ka një të drejtë e cila të jetë njohur dhe që duhet të ekzekutohet brenda afateve të arsyeshme.

15.4. *Standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor,* pasi Gjykata e Lartë nuk e ka arsyetuar vonesën në shqyrtimin e kërkesave të përsëritura të kërkueses. Kjo pasi ajo gjykatë nuk ka referuar në asnjë fakt, provë, ligj, doktrinë ose precedent të vendosur nga gjykatat vendase dhe/ose të huaja kur ka nxjerrë përfundimin se vonesa e shkaktuar është rrjedhojë e një problematike të përgjithshme që tejkalon rastin konkret dhe as nuk ka përcaktuar ndonjë metodologji për përcaktueshmërinë e "pamundësisë objektive". Ndërsa kur shprehet se kërkuesja nuk ka paraqitur shkaqe veçanërisht të rënda që të justifikojnë përshpejtimin e çështjes në raport me çështjet pararendëse, ajo gjykatë nuk referon në asnjë vendimmarrje të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*GJEDNJ*) në të cilën e bazon këtë konkluzion.

15.5. Së *drejtës për një mjet efektiv për konstatimin e cenimit, dëmshpërblimin dhe përshpejtimin e procedurave*, të garantuar në nenin 13 të KEDNJ-së të lidhur me nenin 6, paragrafi 1, të KEDNJ-së dhe nenin 42 të Kushtetutës, pasi rekursi është regjistruar në Gjykatën e Lartë në datën 09.03.2019 dhe që prej asaj kohe, prej më shumë se 5 vjetësh, nuk është ndërmarrë asnjë hap procedural në drejtim të gjykimit të çështjes, përveç veprimtarisë administrative të shortimit dhe rishortimit të gjyqtarit relator. Për më tepër, ajo gjykatë në vendimin e saj nr. 00-2024-2946, datë 09.07.2024 shprehet se aktualisht Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë po përfundon shqyrtimin e çështjeve të themelit të regjistruara në vitin 2015 dhe se aktualisht janë në trajtim 298 çështje civile të vitit 2015 dhe rreth 2000 çështje të vitit 2016, të cilat kanë prioritet në trajtim. Gjykata e Lartë, me një *modus operandi* me rrezikshmëri të lartë për të drejtat individuale, "pamundësinë objektive" e gjeti të tillë me qëllim për të mos konstatuar statusin e viktimës së kërkueses dhe për të mos e dëmshpërblyer atë sipas parashikimeve të nenit 399/3 të KPC-së. Në këto kushte, Gjykata e Lartë nuk përbën më mjet efektiv për zgjidhjen e pretendimeve për vonesë të procedurave të gjykimit.

15.6. *Së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm,* në veçanti në Gjykatën e Lartë, pasi:

15.6.1. KPC-ja ka parashikuar afate të prera për gjykimin e çështjeve gjyqësore brenda një afati të arsyeshëm dhe mjete për t'u ankuar nëse këto afate nuk zbatohen, ndërsa në rastin konkret afati 2- vjeçar i parashikuar me nenin 399/2, shkronja "b", të KPC-së është tejkaluar me më shumë se 3 vjet të tjerë. Vetë kërkuesja nuk ka ndikuar në asnjë prej rrethanave të parashikuara nga neni 399/2 i KPC-së për tejzgjatjen e afatit të gjykimit, ndërsa pasojat e ardhura nga zbatimi i reformës në drejtësi nuk përbëjnë shkak justifikues për tejkalimin e këtij afati.

15.6.2. Gjykata e Lartë, lidhur me kërkesën e kërkueses për konstatimin e cenimit të afatit, e ka marrë vendimin pas 75 ditësh dhe duke mos parashtruar asnjë argument për këtë, në kundërshtim me nenin 399/7, pika 2, të KPC-së, i cili përcakton afatin ligjor 45-ditor për shqyrtimin e këtyre lloj kërkesave.

15.6.3. Përkeqësimi i "statusit të viktimës", referuar nenit 34 të KEDNJ-së, si rrjedhojë e rrëzimit të kërkesës për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e gjykimit nga Gjykata e Lartë me vendimin nr. 00-2024-2946, datë 09.07.2024, në rrethanat që i kanë ndodhur pas datës 11.01.2023 e në vijim ortakut të vetëm të kërkueses.

15.6.4. Interesi ekonomik i kërkueses dhe personal-vetjak, si dhe psikosocial e shëndetësor i ortakut të vetëm të saj rrezikohen në një shkallë të konsiderueshme nga tejzgjatja e procedurave gjyqësore, duke qenë se masa e sigurimit personal të arrestit në shtëpi e vendosur ndaj ortakut të vetëm, tashmë në liri, po e çon kërkuesen drejt falimentimit. Në kushtet kur edhe certifikata për ushtrimin e veprimtarisë është pezulluar nga Ministria e Drejtësisë, është bërë e pamundur për ortakun e shoqërisë që t'u përgjigjet kërkesave jetësore dhe bazike të familjes dhe biznesit, duke konsideruar që ai është prind i një fëmije të mitur dhe kujdeset për nënën e sëmurë.

15.7. *Së drejtës së rehabilitimit dhe/ose zhdëmtimit*, të garantuar nga neni 44 i Kushtetutës, kryesisht për shkak të cenimit të së drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm, veçanërisht në Gjykatën e Lartë, si dhe për shkak të cenimeve të të drejtave të tjera të pretenduara nga kërkuesja.

16. ***Subjektet e interesuara, banka dhe KESH-i,*** nuk kanë paraqitur prapësime me shkrim, edhe pse janë njoftuar rregullisht.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkueses

17. Çështja e legjitimimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Referuar neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve

juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

18. Në verifikim të kritereve si më sipër, Gjykata vlerëson se kërkuesja, si bartëse e të drejtave dhe lirive themelore të parashikuara nga Kushtetuta, legjitimohet *ratione personae,* bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, pasi është palë ndërgjyqëse në procesin gjyqësor në Gjykatën e Lartë, për të cilin ka ngritur pretendime, ndaj justifikon interesin në çështjen e parashtruar.

19. Një kriter tjetër është *shterimi i mjeteve juridike efektive*, i parashikuar nga neni 131, pika 1, shkronja "f", i Kushtetutës dhe neni 71/a, pika 1, shkronja "a", i ligjit nr. 8577/2000, që kërkon shfrytëzimin në rrugë normale të mjeteve juridike efektive, të cilat janë të përshtatshme, të disponueshme dhe të frytshme për një çështje konkrete. Për sa u përket kërkesave për konstatimin e cenimit të së drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm, Gjykata ka mbajtur qëndrimin se legjislacioni i brendshëm parashikon mjete juridike efektive që mund t'i ofrojnë individit rezultate konkrete për rivendosjen e kësaj të drejte kushtetuese. Në këtë kuptim, individi duhet t'u drejtohet gjykatave të zakonshme, në përputhje me parashikimet e neneve 399/2 e vijues të KPC-së dhe vetëm pasi të ketë shteruar garancitë e mbrojtjes që i ofrohen nga juridiksioni i zakonshëm gjyqësor, ai mund të vërë në lëvizje gjykimin kushtetues. Gjykata e ka konsideruar të shteruar këtë kriter si në rastet kur Gjykata e Lartë është shprehur me vendim, ashtu edhe në rastet e mungesës së një vendimi (*shih vendimet nr. 46, datë 03.10.2023; nr. 44, datë 26.09.2023; nr. 2, datë 17.02.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Në rastin në shqyrtim, kërkuesja i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual pasi ka paraqitur më parë kërkesë në Gjykatën e Lartë për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e shqyrtimit të çështjes së saj të regjistruar me nr. 11118-00653-00-2019, datë 13.03.2019, për të cilën Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 00-2024-2946, datë 09.07.2024, ka vendosur rrëzimin e kërkesës. Për rrjedhojë, i vetmi mjet në dispozicion të kërkueses për rivendosjen e së drejtës së pretenduar të cenuar është ankimi kushtetues individual.

21. Në lidhje me afatin e paraqitjes së ankimit kushtetues individual, kërkuesja i është drejtuar Gjykatës në datën 24.12.2024, ndërsa vendimi i Gjykatës së Lartë për rrëzimin e kërkesës për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm mban datën 09.07.2024 dhe i është komunikuar

asaj nëpërmjet adresës së *e-mail*-it në datën 07.10.2024. Në këto rrethana, Gjykata vlerëson se kërkuesja legjitimohet edhe *ratione temporis*, sepse jo vetëm që shkelja është vazhduese, por edhe ankimi kushtetues individual është paraqitur brenda afatit ligjor 4-mujor të parashikuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja "b", i ligjit nr. 8577/2000.

22. Në drejtim të legjitimimit *ratione materiae*, kërkuesja ka pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor, të parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të së drejtës së aksesit, asaj për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme dhe e caktuar me ligj, standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor dhe së drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm, konstatimin e mungesës së një mjeti efektiv për konstatimin, dëmshpërblimin dhe përshpejtimin e procedurave, si dhe të drejtën për rehabilitim dhe dëmshpërblim në përputhje me ligjin.

23. Për pretendimin e kërkueses për t'u *rehabilituar dhe dëmshpërblyer* në përputhje me ligjin për shkak të tejzgjatjes së procedurave gjyqësore, Gjykata ka theksuar edhe në vendimmarrje të saj të mëparshme ndaj kërkueses (*shih vendimet nr. 80, datë 21.11.2024; nr. 34, datë 01.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese*), bazuar në nenin 131 të Kushtetutës dhe praktikën e GJEDNJ-së në raste të ngjashme, se ky pretendim i kërkueses nuk bën pjesë në juridiksionin e saj, ndaj nuk mund të merret në shqyrtim.

24. Kërkuesja ka pretenduar edhe cenimin e së *drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj*, me argumentin se kërkesa e saj drejtuar Gjykatës së Lartë për konstatimin e cenimit të afatit të arsyeshëm, në kundërshtim me nenin 399/6, shkronja "c", të KPC-së, është shqyrtuar nga Kolegji Administrativ i asaj gjykate dhe jo nga një trupë tjetër civile, edhe pse sipas të dhënave të faqes zyrtare të Gjykatës së Lartë, Kolegji Civil i saj përbëhet nga tre trupa të përhershme. Lidhur me këtë pretendim, Gjykata vë në dukje se neni 399/6, shkronja "c", i KPC-së parashikon se në rastet kur çështja në të cilën pretendohet të ketë shkelje është duke u gjykuar në Gjykatën e Lartë, kërkesa për konstatimin e shkeljes dhe përshpejtimin e procedurave shqyrtohet nga një kolegj tjetër i Gjykatës së Lartë, pa përcaktuar kolegjin që do ta marrë në shqyrtim. Për këtë pretendim Gjykata vlerëson se kërkuesja nuk ka arritur të parashtrojë argumente në nivel kushtetues për të provuar cenimin e së drejtës së saj si pasojë e shqyrtimit të kërkesës për përshpejtim nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë dhe jo nga Kolegji Civil, që të mund të justifikojë shqyrtimin e këtij pretendimi në nivel kushtetues.

25. Për pretendimin për cenimin e së *drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme,* kërkuesja ka argumentuar se Gjykata e Lartë e ka paragjykuar ose paracaktuar fatin e çështjes së themelit të kërkesës, duke ushtruar ndikim mbi Kolegjin Civil që do ta shqyrtojë atë, pasi në vendimin objekt kundërshtimi është shprehur se nuk ka një të drejtë e cila të jetë njohur dhe që duhet të ekzekutohet brenda afateve të arsyeshme. Për këtë pretendim Gjykata evidenton se Gjykata e Lartë, duke analizuar kriteret e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese, veçanërisht "rëndësinë e asaj çfarë rrezikon kërkuesi" dhe në referencë edhe të vendimeve të gjykatave më të ulëta, ka konstatuar se nuk ka një të drejtë e cila të jetë njohur dhe që duhet të ekzekutohet brenda afateve të arsyeshme. Ky argument i vetëm nuk është i mjaftueshëm nga pikëpamja kushtetuese për të vënë në dyshim cenimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme, ndaj edhe ky pretendim i kërkueses nuk mund të merret në shqyrtim.

26. Po në drejtim të legjitimimit *ratione materiae*, Gjykata vëren se kërkuesja ka ngritur pretendime për cenimin e së *drejtës për proces të rregullt ligjor* në drejtim të *kohëzgjatjes së paarsyeshme* të procesit në Gjykatën e Lartë, duke kërkuar edhe konstatimin e mungesës së një mjeti efektiv për konstatimin e cenimit dhe përshpejtimin e procedurave, si dhe në drejtim të së *drejtës së aksesit* dhe *standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor*, të cilat edhe pse janë ngritur si pretendime të mëvetshme, në thelb kanë të bëjnë me të *drejtën për gjykim brenda një afati të arsyeshëm*, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës. Për rrjedhojë, bazuar në natyrën dhe thelbin e këtyre pretendimeve, ato do të trajtohen në vijim në këndvështrim të së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm

27. Kërkuesja ka pretenduar se Gjykata e Lartë ka tejkaluar ndjeshëm afatin e arsyeshëm në gjykimin e çështjes civile të iniciuar prej saj, e cila është regjistruar në atë gjykatë në datën 09.03.2019 dhe ende nuk është gjykuar. Ajo gjykatë nuk rezulton të ketë pezulluar çështjen për shkaqe ligjore ose që ajo të jetë shtyrë për shkak të kërkesave të palës kërkuese. Prej asaj gjykate nuk është ndërmarrë asnjë hap procedural në drejtim të gjykimit të çështjes, përveç shortimit dhe rishortimit të herëpashershëm të gjyqtarit relator. Nga ana tjetër, ajo gjykatë nuk ka referuar në asnjë fakt, provë, ligj, doktrinë ose precedent të vendosur nga gjykatat vendase dhe/ose të huaja kur ka nxjerrë

përfundimin se vonesa e shkaktuar është rrjedhojë e një problematike të përgjithshme që tejkalon rastin konkret dhe as nuk ka përcaktuar ndonjë metodologji për përcaktueshmërinë e "pamundësisë objektive". Ndërsa nuk referon në asnjë vendimmarrje të GJEDNJ-së kur shprehet për mungesën e shkaqeve veçanërisht të rënda që të justifikojnë përshpejtimin e çështjes në raport me çështjet pararendëse. Prej kësaj tejzgjatjeje interesi ekonomik i kërkueses dhe personal-vetjak, si dhe psikosocial e shëndetësor i ortakut të vetëm të saj rrezikohen në një shkallë të konsiderueshme, duke qenë se masa e sigurimit personal të arrestit në shtëpi e vendosur ndaj ortakut të saj, tashmë në liri, po e çon kërkuesen drejt falimentimit.

28. Neni 42 i Kushtetutës parashikon, ndër të tjera, se kushdo, për mbrojtjen e të drejtave ligjore, ka të drejtën e një gjykimi brenda një afati të arsyeshëm. Në jurisprudencën kushtetuese është pohuar se kohëzgjatja e gjykimit, normalisht, llogaritet nga momenti i fillimit të procesit gjyqësor deri në dhënien e vendimit dhe se në kohëzgjatjen e përgjithshme të gjykimit nuk përjashtohen vonesat e shkaktuara nga zbatimi i reformës në drejtësi, pasi barra e këtyre vonesave nuk duhet të zhvendoset te palët ndërgjyqëse *(shih vendimet nr. 15, datë 03.04.2025; nr. 57, datë 17.09.2024; nr. 2, datë 17.02.2022 të Gjykatës Kushtetuese).*

29. Në rastin konkret, Gjykata vëren se kërkuesja i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë në datën 28.05.2014, duke kërkuar nga banka, palë e paditur, shpërblim për dëmin pasuror e jopasuror të pretenduar, fitimin e munguar, si dhe kamatat ligjore përkatëse. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur rrëzimin e padisë së kërkueses si të pambështetur në ligj. Kërkuesja ka paraqitur ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë, e cila ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë. Kundër vendimit të gjykatës së apelit, në datën 13.02.2019 kërkuesja ka paraqitur rekurs, i cili është regjistruar në Gjykatën e Lartë me nr. 11118-00653-00-2019 akti, datë 13.03.2019 regjistrimi. Nga momenti i paraqitjes së kërkesëpadisë (28.05.2014) deri në shqyrtimin e saj në Gjykatë kanë kaluar rreth 11 vjet, ndërsa nga regjistrimi i çështjes në Gjykatën e Lartë (13.03.2019) kanë kaluar rreth 6 vjet dhe ende nuk ka një vendimmarrje për të.

30. Lidhur me afatet e gjykimit të mosmarrëveshjes civile, KPC-ja, në grupin e rregullave për mjetet e ankimit për konstatimin e shkeljeve të gjykimit brenda afatit të arsyeshëm, ka përcaktuar afatin 2-vjeçar për përfundimin e gjykimit në Gjykatën e Lartë (neni 399/2, pika 1, shkronja "b", i KPC-së). Kjo nënkupton se formalisht gjykimi i çështjes në Gjykatën e Lartë ka tejkaluar afatin e përcaktuar ligjor.

31. Në vështrim të standardeve të mësipërme, për të vlerësuar nëse në rastin në shqyrtim ka pasur tejzgjatje të paarsyeshme të afatit, pra nëse kërkueses i është cenuar e drejta kushtetuese për proces të rregullt në këtë aspekt, do të analizohen rrethanat e veçanta të çështjes konkrete dhe kriteret e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese që lidhen me: (i) sjelljen e kërkuesit; (ii) kompleksitetin e çështjes; (iii) sjelljen e autoriteteve; (iv) rëndësinë e asaj çfarë rrezikon kërkuesi *(shih vendimet nr. 68, datë 07.12.2023; nr. 6, datë 16.02.2023; nr. 13, datë 26.05.2022 të Gjykatës Kushtetuese)*.

32. Në lidhje me *sjelljen e kërkueses,* Gjykata vëren se, sikurse ka pranuar edhe Gjykata e Lartë (*shih paragrafin 27 të vendimit të Gjykatës së Lartë),* nuk konstatohet ndonjë sjellje e kërkueses në veçanti ose e palëve në përgjithësi që të ketë ndikuar në kohëzgjatjen e procesit, për sa kohë që nga regjistrimi i çështjes në Gjykatën e Lartë e deri në shqyrtimin e saj në këtë Gjykatë nuk është kryer ndonjë veprim procedural. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se kërkuesja ose palët në proces nuk rezulton të jenë bërë shkak ose të kenë shkaktuar vonesa në gjykimin e çështjes.

33. Për sa i takon *kompleksitetit të çështjes,* Gjykata konstaton se mosmarrëveshja objekt gjykimi është e natyrës civile dhe rregullohet nga Kodi Civil. Si palë në këtë proces janë kërkuesja, banka, në cilësinë e palës së paditur dhe KESH-i si person i tretë. Në objektin e padisë kërkohet shpërblimi i dëmit pasuror e jopasuror që kërkuesja pretendon se i është shkaktuar nga banka për shkak të mosdebitimit të llogarisë së debitorit (CEZ-it) në favor të kreditorit (KESH-it), i cili është klient i kërkueses. Në vijim, Gjykata konstaton se procedurat përpara gjykatës së shkallës së parë kanë zgjatur përafërsisht 2 vjet dhe në përfundim ajo gjykatë ka vendosur rrëzimin e padisë së kërkueses. Po kështu, procedurat përpara Gjykatës së Apelit Tiranë kanë zgjatur rreth 2 vjet e gjysmë dhe në përfundim ajo gjykatë ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë.

34. Gjykata ka theksuar se kompleksiteti i çështjes nuk mbartet në të njëjtën mënyrë në çdo shkallë të gjykimit, por varet nga faza në të cilën ndodhet shqyrtimi i saj dhe shkalla e gjykimit në të cilën kërkohet konstatimi i kohëzgjatjes së paarsyeshme. Me fjalë të tjera, edhe pse çështja mund të mbartë kompleksitet gjatë gjykimit të saj në gjykatat e faktit, gjykimi në gjykatën e ligjit nuk mund të thuhet se paraqet të njëjtat elemente kompleksiteti (*shih vendimin nr. 80, datë 21.11.2024 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata evidenton se kompleksiteti i çështjes

konkrete është marrë në analizë më parë prej saj (*shih vendimin nr. 39, datë 09.12.2021 të Gjykatës Kushtetuese*), duke arritur në përfundimin se çështja paraqet elemente kompleksiteti. Megjithatë, në referim të standardit të mësipërm kushtetues dhe nisur nga natyra e gjykimit në Gjykatën e Lartë, Gjykata vlerëson se edhe pse në dukje çështja mund të ketë elemente kompleksiteti, kjo nuk ka ndikuar në kohëzgjatjen e procesit në atë gjykatë.

35. Për sa i përket *sjelljes së autoriteteve,* Gjykata vëren se çështja e kërkueses është në pritje për shqyrtim në Gjykatën e Lartë prej përreth 6 vjetësh, ndërsa kohëzgjatja totale e procedurave nga momenti i paraqitjes së padisë në gjykatën e shkallës së parë është përreth 11 vjet.

36. Nga përmbajtja e vendimit të Gjykatës së Lartë që ka rrëzuar kërkesën e kërkueses për konstatimin e cenimit dhe përshpejtimin e procedurave, Gjykata vë në dukje se Kolegji Civil po përfundon shqyrtimin e çështjeve të regjistruara në vitin 2015 dhe se deri në datën e atij vendimi kanë qenë në trajtim 298 çështje civile të vitit 2015 dhe rreth 2000 çështje të vitit 2016, të cilat kanë prioritet në trajtim. Gjykata e Lartë ka çmuar se mosgjykimi i kësaj çështjeje nuk rezulton që të jetë rrjedhojë e veprimeve penguese të palëve ndërgjyqëse ose gjykatës, por rrjedhojë e shkaqeve të pavarura nga vullneti i tyre, të cilësuara si "pamundësi objektive për procedim" për shkak të mospasjes së përkohshme të kapaciteteve njerëzore të nevojshme për përballimin brenda limiteve të arsyeshme të stokut të çështjeve të mbetura pa gjykuar për një kohë të gjatë. Për më tepër, ajo gjykatë ka arsyetuar se në kushtet ku kategoria e mosmarrëveshjes për të cilën është kërkuar përshpejtimi i gjykimit nuk përfshihet në rrethin e mosmarrëveshjeve për të cilat parashikohet shqyrtimi me procedura të përshpejtuara, si dhe nisur nga fakti se kërkuesja nuk ka parashtruar shkaqe veçanërisht të rënda, që justifikojnë përshpejtimin e çështjes në raport me çështjet pararendëse, përshpejtimi çështjes vetëm për shkak të paraqitjes së kërkesës nga kërkuesja do të cenonte parimin e barazisë para ligjit, të garantuar nga neni 18 i Kushtetutës.

37. Nga të dhënat e faqes zyrtare të Gjykatës së Lartë, Gjykata konstaton se për çështjen është zgjedhur gjyqtari relator A.K., por nuk rezulton të jetë planifikuar një datë për shqyrtimin e rekursit të kërkueses. Ndërkohë, nga informacioni i përcjellë nga Gjykata e Lartë me *e-mail*-in e datës 29.09.2025, çështja civile nr. 11118-0065300-2019 rezulton se është në fazë studimi.

38. Bazuar në treguesit e mësipërm, Gjykata vlerëson se kohëzgjatja e gjykimit të çështjes së kërkueses lidhet me ngarkesën në Gjykatën e Lartë shkaktuar nga zbatimi i reformës në drejtësi. Në këtë drejtim, Gjykata ka theksuar në mënyrë të përsëritur se pavarësisht rëndësisë dhe përfitimeve që sjellin reformat në sektorin e drejtësisë, ligjvënësi ka për detyrë të marrë masat dhe të gjejë mjetet e duhura për ndryshimin e gjendjes faktike, me qëllim që ligjet të zbatohen dhe gjykatat e të gjitha niveleve të funksionojnë normalisht. Gjithsesi, kjo gjendje është duke u zgjatur prej disa vitesh, prandaj edhe metodat e identifikuara nga vetë gjykatat dhe KLGJ-ja tregojnë se mekanizmat e parashikuar nga nenet 399/1-399/12 të KPC-së i shërbejnë një kohe normale të veprimtarisë gjyqësore, pra jo situatës së jashtëzakonshme, në pikëpamje të volumit, që ndodhet tashmë sistemi i drejtësisë *(shih vendimet nr. 80, datë 21.11.2024, nr. 2, datë 17.02.2022; nr. 37, datë 05.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

39. Po në këtë drejtim, Gjykata vëren se kërkuesja ka paraqitur kërkesë në Gjykatën e Lartë për konstatimin e cenimit të afatit të arsyeshëm të gjykimit dhe përshpejtimin e shqyrtimit të rekursit të saj, e cila i është kthyer për plotësimin e të metave, me arsyetimin se duhej nënshkruar nga një avokat dhe se duhej paraqitur akti i përfaqësimit, ndonëse kërkesa ishte nënshkruar nga kërkuesja. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se kthimi pa veprim i kërkesave drejtuar Gjykatës së Larë për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e gjykimit bazuar në dispozitat që përcaktojnë nënshkrimin nga avokati të rekursit, përbën formalizëm të tepruar dhe kthen një rregull garantues procedural në një pengesë të aksesit në Gjykatën e Lartë. Kjo e fundit ka detyrimin të sillet në atë mënyrë që kërkesa për përshpejtim të mos humbasë qëllimin e vet dhe individit të mos i cenohet në thelb e drejta për mjet juridik efektiv *(shih vendimet nr. 80, datë 21.11.2024; nr. 58, datë 17.09.2024; nr. 37, datë 05.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese)*. Mbi bazën e këtij standardi, Gjykata vlerëson se në rastin konkret, edhe pse kërkuesja ka shfrytëzuar mjetin juridik në dispozicion të saj, duke e paraqitur kërkesën për përshpejtim në Gjykatën e Lartë, kjo e fundit nuk e ka shqyrtuar themelin e kërkesës, duke mbajtur një qasje formaliste dhe duke e shndërruar kërkesën në fjalë në mjet ankimi joefektiv.

40. Për sa i takon *rëndësisë së asaj çfarë rrezikon kërkuesja*, sipas kërkueses, ajo lidhet me interesin ekonomik të saj dhe atë personal-vetjak, si dhe psikosocial e shëndetësor të ortakut të vetëm të saj, që rrezikohen në një shkallë të konsiderueshme nga tejzgjatja e procedurave gjyqësore,

për shkak se masa e arrestit në shtëpi e vendosur ndaj ortakut të vetëm, e cila nuk është më në fuqi, po e çon kërkuesen drejt falimentimit dhe nuk i jep mundësi ortakut të shoqërisë që t'u përgjigjet kërkesave jetësore dhe bazike të familjes dhe biznesit.

41. Gjykata ka vlerësuar se disa kategori çështjesh, për shkak të natyrës së tyre, kërkojnë përshpejtim të posaçëm të gjykimit, nisur nga interesi veçanërisht i lartë i kërkuesit. Disa çështje që lidhen me interesa "vetjakë e jetësorë " nevojitet të trajtohen me shpejtësi e përparësi. Të tilla janë çështjet që kërkojnë "kujdes të veçantë" ose "kujdes të jashtëzakonshëm", si ato që lidhen me statusin civil, kujdestarinë e fëmijëve, marrëdhëniet e punësimit, sëmundjet e pashërueshme dhe pensionin. Lista e këtyre çështjeve nuk mund të jetë shteruese dhe kriteri i interesit të kërkuesit në proces verifikohet nga Gjykata rast pas rasti *(shih vendimet nr. 43, datë 04.06.2024; nr. 21, datë 04.04.2024; nr. 6, datë 16.02.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

42. Ndërsa GJEDNJ-ja ka pohuar se palët e një mosmarrëveshje civile që nuk ka nevojë për ndonjë prioritet të veçantë, sidoqoftë kanë të drejtë, sipas nenit 6, paragrafi 1, i KEDNJ-së, të dëgjohen brenda një afati të arsyeshëm. Në lidhje me këtë, atyre nuk iu kërkohet që të provojnë se për shkak të vonesave procedurale iu është shkaktuar ndonjë dëm i veçantë ose shtesë. GJEDNJ-ja ka pranuar – në një linjë me këtë Gjykatë – se në përpjekje për të trajtuar numrin e madh të çështjeve të prapambetura dhe për të garantuar trajtim të drejtë për të gjitha këto çështje, gjykatat vendase mund të kenë hapësira të kufizuara për të përdorur mjetet përshpejtuese të ofruara nga juridiksioni vendas për çështjet joprioritare, sidoqoftë, sipas saj, shtetit ende i kërkohet që të ofrojë një mjet kompensues efektiv në rrethana të tilla. Duke mbajtur në konsideratë vonesën prej tetë vjetësh dhe gjashtë muajsh pranë Gjykatës së Lartë në një rast, ajo gjykatë ka arritur në përfundimin se është shkelur kërkesa për një "afat të arsyeshëm" sipas nenit 6, paragrafi 1 të KEDNJ-së (*shih ARB sh.p.k. dhe të tjerë kundër Shqipërisë, kërkesat nr. 39860/19 dhe 3 të tjera, datë 27.05.2025, §§§ 118, 122, 124*).

43. Për sa i përket kriterit të interesit për kërkuesen dhe rrezikut që passjell tejzgjatja e procedurave për të, Gjykata evidenton se, sikurse kanë arsyetuar gjykata e shkallës së parë dhe gjykata e apelit, nuk ka rezultuar që kërkuesja të ketë pësuar dëm pasuror nga veprimet e palës së paditur, për të cilat pretendon se kanë shkaktuar moslidhjen në vijimësi të kontratave

të mëtejshme të shërbimit me shoqëritë KESH dhe OST, duke qenë se në rastin konkret fitimi i munguar i pretenduar prej kërkueses është cilësuar prej gjykatës si imagjinar, pasi nuk është provuar fakti se të gjithë titujt ekzekutivë me kreditor KESH-in do të viheshin në ekzekutim nga kërkuesja. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se çështja konkrete është e një natyre të tillë që interesi i kërkueses nuk rrezikohet në shkallë të konsiderueshme nga kohëzgjatja e tepruar e procedurave gjyqësore, duke mbajtur në konsideratë edhe listën e çështjeve që duhet të gjykohen me përparësi, si dhe objektin e padisë që lidhet me detyrimin e bankës, për shpërblimin e dëmit pasuror e jopasuror të shkaktuar nga veprimet me faj dhe fitimin e munguar, si dhe për kamatat ligjore sipas normës Tribor njëditore të vendosur nga Banka e Shqipërisë deri në datën e ekzekutimit të vendimit të gjykatës. Megjithatë, mungesa e shqyrtimit të saj nga Gjykata e Lartë pas 6 vjetësh ka cenuar të drejtën e kërkueses për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm.

44. Në përfundim, Gjykata, në konsideratë edhe të jurisprudencës së GJEDNJ-së lidhur me disa çështje kundër Shqipërisë, çmon se edhe vetëm kohëzgjatja në tërësi e gjykimit në rastin konkret përbën shkak të mjaftueshëm për të konstatuar tejzgjatje të procedurave, për rrjedhojë kërkueses i është cenuar e drejta kushtetuese për gjykim brenda një afati të arsyeshëm, ndaj kërkesa e saj duhet të pranohet.

45. Gjithashtu, Gjykata, duke marrë në konsideratë dhe mundësitë aktuale të Gjykatës së Lartë, çmon se, bazuar në nenin 81, pika 3, të ligjit nr. 8577/2000, duhet urdhëruar detyrimi i kësaj gjykate ta shqyrtojë çështjen me përparësi.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, si dhe nenit 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, njëzëri,

V E N D O S I:

1. Pranimin pjesërisht të kërkesës.

2. Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2024-2946, datë 09.07.2024 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën.

3. Konstatimin e cenimit të së drejtës për një gjykim brenda afatit të arsyeshëm.

4. Detyrimin e Gjykatës së Lartë ta shqyrtojë çështjen me përparësi.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 09.10.2025
Shpallur më 20.11.2025

Vendim nr. 54, datë 09.10.2025
(V-54/25)

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Holta Zaçaj, Kryetare, Marsida Xhaferllari, Fiona Papajorgji, Sonila Bejtja, Sandër Beci, Ilir Toska, Genti Ibrahimi, Marjana Semini, anëtarë, me sekretare Anjeza Puka, në datën 09.10.2025 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 4 (B) 2025 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUESE: **BAHRIJE LLUKA**, përfaqësuar nga avokat Erdi Prifti, me prokurë.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:
MINISTRIA E SHËNDETËSISË, në mungesë.
DREJTORIA E SHËRBIMIT SPITALOR PUKË, në mungesë.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2024-4408, datë 06.11.2024 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**
Konstatimi i cenimit të së drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm të çështjes administrative nr. 31003-01713-00-2019 regjistri, datë 06.09.2019, në shqyrtim pranë Gjykatës së Lartë.
Detyrimi i Gjykatës së Lartë të gjykojë çështjen e kërkueses brenda gjashtë muajve.
Detyrimi i subjekteve të interesuara të paguajnë shpenzimet gjyqësore sipas faturës nr. 2/2025, datë 16.01.2025 të përgatitjes së ankimit kushtetues individual nga përfaqësuesi.

BAZA LIGJORE: **Nenet 41, 42, 43, 124, 131, pika 1, shkronja "f" dhe 142, pika 1, të Kushtetutës së Republikës**

së Shqipërisë *(Kushtetuta)*; nenet 6, pika 1, dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut *(KEDNJ)*; nenet 28, 49, 71 dhe 71/a të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar *(ligji nr. 8577/2000*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Holta Zaçaj, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkueses Bahrije Lluka (*kërkuesja*), e cila ka kërkuar pranimin e kërkesës, konstatoi mungesën e parashtrimeve me shkrim të subjekteve të interesuara, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Drejtorisë së Shërbimit Spitalor Pukë, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I
Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesja ka qenë në marrëdhënie pune pranë Drejtorisë së Shërbimit Spitalor Pukë, në pozicionin e infermieres në Spitalin e Pukës, për periudhën 01.01.2009 deri më 15.03.2016. Me shkresën nr. 4987/1, datë 30.10.2015, Ministria e Shëndetësisë i ka dërguar Drejtorisë së Shërbimit Spitalor Pukë "Strukturën analitike të Shërbimit Spitalor Pukë", sipas së cilës kishte ndryshuar numri i punonjësve. Mbi këtë bazë, me shkresën nr. 206 prot., datë 14.11.2015, kërkuesja është njoftuar për fillimin e bisedimeve për zgjidhjen e kontratës së punës, në mbështetje të neneve 141-145 të Kodit të Punës (*KP*). Me shkresën nr. 287 prot., datë 27.11.2015 të drejtorit të Shërbimit Spitalor Pukë është zgjidhur kontrata e punës me kërkuesen, duke iu ndërprerë marrëdhëniet financiare në datën 13.03.2016, bazuar në nenin 143, pika 1, të KP-së, për shkak të afatit të njoftimit referuar vjetërsisë së saj në punë. Sipas këtij urdhri, kërkuesja do të përfitonte pushimet vjetore të pakryera deri në momentin e ndërprerjes së marrëdhënies së punës dhe bazuar në nenin 145 të KP-së, edhe shpërblim për vjetërsi në punë në masën 3,5 paga.

2. Duke mos qenë dakord me sa më sipër, kërkuesja i është drejtuar gjykatës me padi kundër Ministrisë së Shëndetësisë dhe Drejtorisë së

Shërbimit Spitalor Pukë, me objekt deklarimin e pavlefshmërisë së veprimeve administrative, shkresave nr. 4987, datë 30.10.2015 dhe nr. 4987/1, datë 30.10.2015 të Ministrisë së Shëndetësisë për miratimin dhe dërgimin e strukturës analitike të Shërbimit Spitalor Pukë, si dhe nr. 287 prot., datë 27.11.2015 të Drejtorisë së Shërbimit Spitalor Pukë, për shkak të zgjidhjes së kontratës së punës pa shkaqe të arsyeshme e të pajustifikuara; konstatimin e shkeljes së të drejtave, lirive e interesave kushtetues e ligjorë; rikthimin e paditëses (kërkueses) në vendin e mëparshëm të punës; detyrimin e palëve të paditura ta dëmshpërblejnë me 3 paga mujore për mosrespektim të afatit të njoftimit për zgjidhjen e kontratës së punës, 2 paga mujore për mosrespektim të procedurës së zgjidhjes së kontratës së punës, 12 paga mujore për shkak të zgjidhjes së menjëhershme pa shkaqe të justifikuara të kontratës së punës, 12 paga mujore për shkak të zgjidhjes së menjëhershme pa shkaqe të arsyeshme të kontratës së punës dhe 20 paga mujore shpërblim për vjetërsinë në punë prej 40 vitesh, duke iu referuar pagës bruto në momentin e ndërprerjes së marrëdhënies së punës.

3. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 2481, datë 19.05.2016, ka shpallur moskompetencën tokësore dhe i ka dërguar aktet Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, e cila, me vendimin nr. 631 (550), datë 03.10.2016, ka vendosur pranimin e pjesshëm të padisë, duke detyruar palën e paditur të shpërblejë paditësen (kërkuesen) me 2 paga mujore për mosrespektim të procedurës së njoftimit, sipas nenit 114, pika 5, të KP-së dhe rrëzimin e pjesës tjetër të padisë. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim kërkuesja.

4. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr.1625, datë 28.05.2019, ka vendosur ndryshimin pjesërisht të vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, duke detyruar palën e paditur që t'i paguajë paditëses (kërkueses) 11.5 paga mujore si shpërblim për vjetërsi në punë dhe lënien në fuqi të vendimit për pjesën tjetër. Kundër vendimit kërkuesja ka paraqitur ankim në Gjykatën e Lartë, ku është regjistruar çështja nr. 31003-01713-00-2019, datë 06.09.2019.

5. Në datën 24.04.2023, në pritje të shqyrtimit të çështjes së saj, kërkuesja i është drejtuar Gjykatës së Lartë me kërkesë për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e gjykimit. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2023-1993, datë 24.05.2023, ka vendosur rrëzimin e kërkesës, duke vlerësuar se edhe pse çështja e ka kaluar afatin e shqyrtimit sipas nenit 399/2, pika 1, shkronja "b", të Kodit

të Procedurës Civile (*KPC*), kjo vonesë është rrjedhojë e një problematike të përgjithshme që tejkalon rastin konkret. Sipas atij kolegji, mosveprimi i gjykatës nuk ka ndodhur për shkaqe subjektive që lidhen me vlerësime dhe qëndrime abuzive të gjyqtarit relator, i cili ka marrë të gjitha masat e nevojshme, duke përcaktuar edhe kritere transparente për marrjen në shqyrtim sipas radhës së vjetërsisë të çështjeve që i janë caktuar, për rrjedhojë nuk vërehet ndonjë zvarritje e qëllimshme prej tij.

6. Në datën 22.10.2024 kërkuesja i është drejtuar sërish Gjykatës së Lartë me kërkesë për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e gjykimit të çështjes së saj. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, pasi është njohur edhe me informacionin e paraqitur nga gjyqtari relator, me vendimin nr. 00-2024-4408, datë 06.11.2024, ka vendosur rrëzimin e kërkesës, mbi të njëjtat argumente si më sipër. Edhe sipas atij kolegji, vonesa e gjatë në shqyrtimin e mosmarrëveshjes konkrete është rrjedhojë e një problematike të përgjithshme, që ka krijuar kosto për qytetarët në tejzgjatjen e afateve për gjykimin e çështjeve gjyqësore, vështirësi këto që janë proporcionale në raport me të mirën e përgjithshme që krijon procesi i reformës në drejtësi. Kolegji Civil ka vlerësuar se referuar numrit të përgjithshëm të çështjeve të regjistruara në atë gjykatë dhe atyre me natyrë administrative, si dhe faktit të mungesave të gjyqtarëve, aktualisht Kolegji Administrativ po përfundon shqyrtimin e çështjeve të themelit të regjistruara në vitin 2017. Po sipas atij kolegji, mosveprimi i gjykatës nuk ka ndodhur për shkaqe subjektive që lidhen me vlerësime dhe qëndrime abuzive të gjyqtarit relator, i cili ka marrë të gjitha masat e nevojshme, duke përcaktuar edhe kritere transparente për marrjen në shqyrtim sipas radhës së vjetërsisë të çështjeve që i janë caktuar.

7. Në datën 20.01.2025 kërkuesja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata)* me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij dhe Kolegji i Gjykatës, me vendimin e datës 28.03.2025, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II
Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

8. ***Kërkuesja***, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar e drejta për proces të rregullt ligjor, e parashikuar në nenin 42 të Kushtetutës, në drejtim të:

8.1. *Standardit të gjykimit brenda një afati të arsyeshëm,* për shkak se çështja e kërkueses edhe pse është regjistruar në Gjykatën e Lartë në datën 06.09.2019 nuk është gjykuar ende, në kundërshtim me afatin për gjykimin e çështjeve në atë gjykatë, që është 1 vit sipas nenit 399 të KPC-së dhe 90 ditë sipas ligjit nr. 49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", i ndryshuar (*ligji nr. 49/2012*). Kërkuesja ka paraqitur prova të plota përpara gjykatës dhe nuk ka kërkuar kryerjen e ndonjë akti ekspertimi, si dhe nuk ka paraqitur ndonjë kërkesë për shtyrje të gjykimit, pra nuk është bërë shkak për vonesat. Kjo situatë, duke pasur parasysh edhe moshën e kërkueses (pensioniste), i ka krijuar një gjendje të rënduar psikologjike, pa pasur parasysh edhe vështirësitë e saj ekonomike. Çështja në pritje të gjykimit ka për objekt të padisë marrëdhënien e punësimit të kërkueses dhe shpërblimin e dëmit që rrjedh prej saj, e cila, për shkak të pasojave me natyrë sociale dhe financiare, përbën interes vetjak dhe jetësor për kërkuesen që është pensioniste, ndaj duhet të trajtohet me përparësi.

8.2. *Së drejtës për t`u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj dhe e paanshme,* pasi Kolegji Civil ka vepruar pa shqyrtuar çështjen, përderisa në vendim shprehet se këto lloj mosmarrëveshjesh duhet të gjykohen me prioritet, ndërsa në fund ka vendosur rrëzimin e kërkesës.

8.3. *Standardit të arsyetimit,* pasi vendimi i Kolegjit Civil është i paarsyetuar dhe bie ndesh edhe me vetë shpjegimet e tij.

8.4. *Parimit të sigurisë juridike,* pasi Kolegji Civil ka disponuar jo në bazë të përcaktimeve të ligjit procedural civil dhe atij administrativ.

9. ***Subjektet e interesuara, Ministria e Shëndetësisë dhe Drejtoria e Shërbimit Spitalor Pukë***, nuk kanë paraqitur parashtrime me shkrim edhe pse janë njoftuar rregullisht.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkueses

10. Çështja e legjitimimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1,

shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, si dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

11. Në kuptim të sa më sipër, Gjykata vlerëson se kërkuesja legjitimohet *ratione personae*, pasi është palë ndërgjyqëse në procesin gjyqësor, për të cilin ka pretenduar se i është cenuar e drejta për gjykim brenda afatit të arsyeshëm, ndaj justifikon interesin në çështjen e parashtruar.

12. Për sa i përket kriterit të *shterimit të mjeteve juridike efektive*, të parashikuar nga neni 131, pika 1, shkronja "f", i Kushtetutës dhe neni 71/a, pika 1, shkronja "a", i ligjit nr. 8577/2000, kërkuesja ka paraqitur ankim kushtetues individual, pasi i është drejtuar më parë Gjykatës së Lartë me kërkesë për konstatimin e kohëzgjatjes së paarsyeshme dhe përshpejtimin e gjykimit, në zbatim të nenit 399/6, pika 1, shkronja "c", të KPC-së, për të cilën ajo gjykatë ka vendosur rrëzimin. Për rrjedhojë, konsiderohet se është përmbushur kriteri i shterimit të mjeteve juridike në dispozicion.

13. Kërkuesja legjitimohet edhe *ratione temporis,* në kuptim të përmbajtjes së nenit 71/a, pika 1, shkronja "b", të ligjit nr. 8577/2000, pasi jo vetëm që shkelja është vazhduese, por edhe se vendimi i Gjykatës së Lartë objekt ankimi mban datën 06.11.2024, kurse ankimi kushtetues individual është paraqitur në datën 20.01.2025, brenda afatit 4-mujor.

14. Në drejtim të legjitimimit *ratione materiae*, kërkuesja ka ngritur pretendime për cenimin *e së drejtës për proces të rregullt ligjor*, të parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të *kohëzgjatjes së paarsyeshme* të procesit gjyqësor në Gjykatën e Lartë, si edhe në drejtim të *së drejtës për t`u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj dhe e paanshme, standardit të arsyetimit* dhe *parimit të sigurisë juridike,* të cilat, edhe pse janë ngritur si pretendime të mëvetshme, në thelb kanë të bëjnë me mënyrën sesi Kolegji Civil ka arsyetuar dhe argumentuar vendimin e tij për rrëzimin e kërkesës së kërkueses për kohëzgjatjen e gjykimit dhe përshpejtimin e procedurave. Për rrjedhojë, bazuar në natyrën dhe thelbin e këtyre pretendimeve, ato do të trajtohen në vijim në këndvështrim të së

drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm

15. Kërkuesja ka pretenduar se çështja e saj është regjistruar në Gjykatën e Lartë në datën 06.09.2019, por nuk është gjykuar ende, në kundërshtim me afatin për gjykimin e çështjeve në atë gjykatë, që është 1 vit sipas nenit 399 të KPC-së dhe 90 ditë sipas ligjit nr. 49/2012. Në lidhje me sjelljen e saj, kërkuesja ka parashtruar se nuk është bërë shkak për vonesat, se ka paraqitur prova të plota përpara gjykatës dhe nuk ka kërkuar kryerjen e ndonjë akti ekspertimi, si dhe nuk ka paraqitur ndonjë kërkesë për shtyrje të gjykimit. Sipas saj, objekti i gjykimit është marrëdhënia e punësimit dhe shpërblimi i dëmit, që, për shkak të pasojave me natyrë sociale dhe financiare, përbën interes vetjak dhe jetësor për kërkuesen që është pensioniste, ndaj duhet të trajtohet me përparësi. Kjo situatë, duke pasur parasysh edhe moshën e saj, i ka krijuar kërkueses një gjendje të rënduar psikologjike, pa pasur parasysh edhe vështirësitë e saj ekonomike. Kërkuesja ka pretenduar se Kolegji Civil, edhe pse shprehet se këto mosmarrëveshje duhet të gjykohen me prioritet, ka vendosur rrëzimin e kërkesës, vendim që është i paarsyetuar pasi ajo gjykatë nuk ka disponuar në bazë të përcaktimeve të ligjit procedural civil dhe atij administrativ.

16. Neni 42, pika 2, i Kushtetutës parashikon se kushdo, për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese dhe ligjore, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe brenda një afati të arsyeshëm. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka vlerësuar se kohëzgjatja e gjykimit, normalisht, llogaritet nga momenti i fillimit të procesit gjyqësor deri në momentin kur jepet vendimi *(shih vendimet nr. 27, datë 11.04.2024; nr. 46, datë 03.10.2023; nr. 6, datë 16.02.2023 të Gjykatës Kushtetuese)*.

17. Gjykata vëren se çështja e kërkueses është regjistruar në Gjykatën e Lartë në datën 06.09.2019, me numër 31003-01713-00-2019 dhe ndonëse aktualisht kanë kaluar 6 vjet që prej datës së regjistrimit, referuar të dhënave të faqes zyrtare të Gjykatës së Lartë, rezulton se ende nuk ka një datë të planifikuar për shqyrtimin e saj nga Kolegji Administrativ i asaj gjykate. Po kështu, sipas informacionit të datës 06.10.2025 të dërguar prej Gjykatës së Lartë përmes postës elektronike, rezulton se çështja e kërkueses "*ndodhet ende në fazë studimi dhe aktualisht nuk ka një datë të planifikuar në sistemin ICMIS*". Për rrjedhojë, kohëzgjatja e shqyrtimit të

çështjes së kërkueses ka tejkaluar afatin 2-vjeçar, që sipas nenit 399/2, pika 1, shkronja "b", të KPC-së është parashikuar si i arsyeshëm për gjykimin civil në Gjykatën e Lartë dhe atë 90-ditor të parashikuar nga neni 60, pika 2, i ligjit nr. 49/2012 për gjykimin administrativ në po atë gjykatë. Gjykata vëren, gjithashtu, se kohëzgjatja tërësore e procesit gjyqësor deri në këtë fazë të tij është mbi 9 vjet, referuar datës së regjistrimit të padisë në gjykatën e shkallës së parë (datë 30.05.2016).

18. Gjykata ka theksuar se arsyeshmëria e kohëzgjatjes së procedurave, në kuptim të rrethanave të veçanta të çështjes konkrete, vlerësohet nën dritën e këtyre kritereve: (i) sjellja e kërkuesit; (ii) kompleksiteti i çështjes; (iii) sjellja e autoriteteve; (iv) rëndësia e asaj çfarë rrezikon kërkuesi. Për sa u përket kritereve që kanë të bëjnë me sjelljen e kërkueses, kompleksitetin e çështjes dhe sjelljen e autoriteteve, bazuar në qëndrimin e konsoliduar të saj për vlerësimin e tyre (*shih vendimet nr. 15, datë 03.04.2025; nr. 57, datë 17.09.2024; nr. 6, datë 16.02.2023 të Gjykatës Kushtetuese*), Gjykata thekson se në rastin konkret nuk konstatohet ndonjë shkak ose rrethanë e re, ose e ndryshme për të arritur ajo në një qëndrim të ndryshëm për sa i përket respektimit të tyre. Për rrjedhojë, për të vlerësuar arsyeshmërinë e kohëzgjatjes së procesit gjyqësor, Gjykata vlerëson të ndalet në vijim vetëm në analizën e kriterit të *asaj se çfarë rrezikon kërkuesja* në rastin konkret për shkak të vonesave në gjykimin e çështjes së saj.

19. Në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se disa çështje që lidhen me interesa "vetjakë e jetësorë" nevojitet të trajtohen me shpejtësi e përparësi, të tilla si ato që lidhen me statusin civil, kujdestarinë e fëmijëve, marrëdhëniet e punësimit, sëmundjet e pashërueshme, pensionin etj., edhe pse kjo listë nuk mund të jetë shteruese dhe interesi i kërkuesit verifikohet rast pas rasti *(shih vendimet nr. 43, datë 04.06.2024; nr. 21, datë 04.04.2024; nr. 6, datë 16.02.2023 të Gjykatës Kushtetuese*). Nga ana tjetër, Gjykata, referuar qëndrimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, vëren se një periudhë e gjatë mosveprimi nuk mund të konsiderohet si një kohë e arsyeshme dhe se palët në mosmarrëveshjet civile që nuk kërkojnë ndonjë trajtim të veçantë prioritar kanë megjithatë të drejtë, sipas nenit 6, pika 1, të KEDNJ-së, për një proces brenda një afati të arsyeshëm dhe ato nuk janë të detyruara të tregojnë, për këtë qëllim, se u është shkaktuar ndonjë dëm i veçantë ose shtesë nga vonesat procedurale. Sipas asaj gjykate, një periudhë e gjatë mosveprimi nuk mund të konsiderohet e arsyeshme kur argumenti i vetëm për vonesën është reforma në sistemin e drejtësisë dhe ngarkesa e gjyqtarëve e krijuar për këtë shkak dhe faktorë të tillë të një natyre të

përgjithshme mund të merren parasysh në një masë të përshtatshme në përcaktimin e çdo kohëzgjatjeje të procedurave në një çështje të veçantë, por nuk janë të afta, në vetvete, të justifikojnë vonesa të një mase të tillë (*shih ARB sh.p.k. e të tjerë kundër Shqipërisë, §§§ 111, 118, 122, datë 27 maj 2025*).

20. Në analizë të kritereve si më sipër, Gjykata vëren se në rastin konkret në shqyrtim thelbi i çështjes gjyqësore të vënë në lëvizje nga kërkuesja ka të bëjë me marrëdhëniet e punës dhe pasojat që rrjedhin prej kësaj mosmarrëveshjeje, për rrjedhojë kjo çështje, për nga natyra e saj, lidhet me interesa *vetjakë* dhe *jetësorë*, të tillë që duhet të shqyrtohen me prioritet nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm. Për më tepër, kërkuesja ka arritur të parashtrojë shkaqe objektive, specifike dhe të mjaftueshme për të provuar se çështja është e një natyre të tillë që interesi i saj rrezikohet në shkallë të konsiderueshme nga kohëzgjatja e procedurave gjyqësore, duke pasur parasysh këtu edhe se ajo është pensioniste dhe në një moshë të caktuar. Për rrjedhojë, Gjykata, në kontekst të rrethanave të çështjes konkrete, si dhe në drejtim të rëndësisë së asaj çfarë rrezikon kërkuesja nga vonesa në gjykim, çmon se është argumentuar dhe provuar rreziku për interesat e kërkueses, natyra dhe rëndësia e të cilave justifikojnë trajtimin me përparësi dhe shpejtësi të veçantë të çështjes së saj nga Gjykata e Lartë.

21. Në përfundim, Gjykata, duke pasur parasysh periudhën prej 6 vjetësh gjatë së cilës çështja është në pritje të shqyrtimit në Gjykatën e Lartë, arrin në përfundimin se ka pasur shkelje të së drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës.

22. Për sa më sipër, duke marrë në konsideratë veçoritë e çështjes së kërkueses, si dhe mundësitë aktuale të Gjykatës së Lartë, Gjykata çmon që, bazuar në nenin 81, pika 3, të ligjit nr. 8577/2000, të urdhërojë detyrimin e asaj gjykate për shqyrtimin e çështjes me përparësi.

C. Për shpenzimet e përfaqësimit në Gjykatën Kushtetuese

23. Në objektin e ankimit kushtetues individual kërkuesja ka kërkuar edhe detyrimin e subjekteve të interesuara që të paguajnë shpenzimet gjyqësore të përgatitjes së ankimit kushtetues individual nga përfaqësuesi i saj në këtë gjykim. Për këtë qëllim, ajo ka paraqitur faturën e datës 16.01.2025, të lëshuar nga përfaqësuesi i saj Erdi Prifti, në vlerën 25,000 lekë (pa TVSH), të përshkruar si pagesë për ofrimin e shërbimit të përgatitjes së ankimit kushtetues individual.

24. Gjykata vëren se në nenin 28 të ligjit nr. 8577/2000 janë parashikuar

rregullat për sa u takon shpenzimeve gjyqësore, sipas të cilave, shpenzimet e procesit gjyqësor përpara saj u nënshtrohen rregullave të parashikuara në ligjin për tarifat gjyqësore (*pika 1*); kur vendos pranimin e ankimit kushtetues individual, ajo mund të shprehet edhe për shpenzimet e përfaqësimit pjesërisht ose tërësisht, nëse kërkohet nga kërkuesi (*pika 2*). Kjo dispozitë është konkretizuar edhe në nenin 14 të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës, sipas së cilit me paraqitjen e kërkesës paraqitet edhe akti që provon shlyerjen e tarifave përkatëse (*pika 2*); kur vendoset pranimi i ankimit kushtetues individual, Gjykata shprehet në dispozitiv edhe për shpenzimet e përfaqësimit dhe masën e tyre, nëse kjo kërkohet nga kërkuesi (*pika 4*).

25. Gjykata ka theksuar se në parim çështja e shpenzimeve të përfaqësimit në gjykimin kushtetues të ankimit individual është pjesë e procesit të rregullt ligjor dhe refuzimi për mbulimin e tyre rrezikon të kufizojë në mënyrë të pajustifikuar të drejtën e individit për akses në gjykatë, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës. Po kështu, referuar përmbajtjes së dispozitave si më sipër, *së pari*, disponimi për shpenzimet vihet në lëvizje vetëm me kërkesë formale nga ankuesi dhe, *së dyti*, një kërkesë e tillë mund të paraqitet së bashku me ankimin kushtetues individual deri kur deklarohet mbyllja e seancës plenare nga Gjykata. Individi ka të drejtën e mbulimit të shpenzimeve vetëm nëse vërteton se ato janë kryer, kanë qenë të nevojshme dhe në masë të arsyeshme, ndaj ai duhet të paraqesë edhe aktet që dokumentojnë në mënyrë reale dhe të nevojshme masën e shpenzimeve të kryera për qëllim të procesit kushtetues, të cilat në çdo rast duhet të jenë të arsyeshme dhe të shoqëruara me fatura tatimore të lëshuara sipas legjislacionit në fuqi. Sipas udhëzimit të përbashkët nr. 18, datë 05.08.2020 të ministrit të Drejtësisë dhe ministrit të Financave "Për miratimin e kritereve të përfitimit të pagesave dhe tarifat e shpërblimit të avokatëve që ofrojnë ndihmë juridike dytësore" (*udhëzimi nr. 18/2020*), shpenzimet për ofrimin e mbrojtjes juridike për përfaqësimin në Gjykatë përcaktohen në vlerat 50,000 lekë dhe 60,000 lekë, ndërsa për shërbime juridike jashtëgjyqësore përcaktohen në vlerat 25,000 lekë (përgatitje kërkese) dhe 500 deri në 1,500 lekë ora (ofrimi i ndihmës juridike në formën e këshillimit - shih rubrikat I dhe II të shtojcës 1 "*Tarifat e shërbimeve juridike të avokatëve të ndihmës juridike*"). Nga ana tjetër, kriteret bazë për llogaritjen e masës lidhen me: kompleksitetin e çështjes, nivelin e formimit dhe përvojën juridike të kërkuesit për të kuptuar çështjen, moshën dhe gjendjen financiare të kërkuesit, si dhe

elemente të tjera që ndikojnë në vlerën e kërkuar (*shih vendimin nr. 47, datë 18.09.2025 të Gjykatës Kushtetuese*).

26. Për sa i takon subjektit që ngarkohet për mbulimin e shpenzimeve të përfaqësimit, Gjykata ka theksuar se natyra dhe objekti i gjykimit kushtetues ndryshojnë nga gjykimi i zakonshëm, për sa kohë që në gjykimin kushtetues individi kërkon të mbrojë të drejtat themelore të shkelura si pasojë e veprimtarisë së autoriteteve publike, ku përfshihet edhe ajo e gjykatave të zakonshme, që i kanë pasjellë atij cenimin e të drejtave themelore, ndaj përgjegjësia në këtë gjykim i takon vetë shtetit. Kjo logjikë ndiqet nga rregullimet ligjore për kompensimin e shkeljes të së drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm, ku në gjykimin e zakonshëm thirren të paditur Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Financave (*neni 399/4, pika 2, i KPC-së*) (*shih vendimin nr. 47, datë 18.09.2025 të Gjykatës Kushtetuese*).

27. Për sa më sipër, Gjykata vëren se kërkimi për shpenzimet gjyqësore (tarifa e përgatitjes së ankimit kushtetues individual) është paraqitur nga kërkuesja në ankimin kushtetues individual, duke bashkëlidhur edhe faturën tatimore të lëshuar nga avokati, në të cilën përshkruhet shërbimi i ofruar prej tij dhe vlera e këtij shërbimi në masën 25,000 lekë, vlerë kjo e përcaktuar edhe nga udhëzimi nr. 18/2020 për shërbimin juridik jashtëgjyqësor, përgatitje kërkese në Gjykatë. Këto shpenzime, duke pasur parasysh natyrën e çështjes konkrete, që ka të bëjë me konstatimin e cenimit të së drejtës për proces të rregullt për shkak të kohëzgjatjes së paarsyeshme të procesit gjyqësor, i ngarkohen Ministrisë së Financave. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se kërkesa për shpenzimet e përfaqësimit është e drejtë dhe pranohet.

28. Në përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkueses janë të bazuara sipas arsyetimit të mësipërm, ndaj kërkesa pranohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, si dhe neneve 28, 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, njëzëri,

V E N D O S I:

1. Pranimin e kërkesës.

2. Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2024-4408, datë 06.11.2024 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

3. Konstatimin e cenimit të së drejtës për një gjykim brenda afatit të arsyeshëm.

4. Detyrimin e Gjykatës së Lartë ta shqyrtojë çështjen me përparësi.

5. Shpenzimet e përfaqësimit të kërkueses në vlerën 25,000 lekë i ngarkohen Ministrisë së Financave.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 09.10.2025
Shpallur më 30.10.2025

Indeks i vendimeve të vitit 2025

INDEKSI ALFABETIK

A

- Administrimi
  - *i akteve në gjykim (Nuk ka vendime në Vol. II)*
  - *i drejtësisë (V-36/25 f. 853, Vol. II)*
- Afat
  - *i arsyeshëm ekzekutimi (V-29/25 f. 693, Vol. II)*
  - *i arsyeshëm gjykimi (V-37/25 f. 869, Vol. II); (V-53/25 f. 1264, Vol. II)*
  - *i ngritjes së padisë (Nuk ka vendime në Vol. II)*
  - *ligjor (V-37/25 f. 869, Vol. II); (V-40/25 f. 913, Vol. II); (V-53/25 f. 1264, Vol. II)*
  - *llogaritje afati (V-40/25 f. 913, Vol. II)*
  - *rivendosje në afat (V-38/25 f. 879, Vol. II)*
- Akademia e Shkencave të Shqipërisë *(Nuk ka vendime në Vol. II)*
- Akses substancial *(V-41/25 f. 932, Vol. II)*
- Aksident
  - *rrugor (V-30/25 f. 709, Vol. II)*
  - *në punë (Nuk ka vendime në Vol. II)*
- Akt
  - *administrativ (V-36/25 f. 853, Vol. II)*
  - *ekspertimi (V-27/25 f. 659, Vol. II); (V-48/25 f. 1158, Vol. II)*
  - *ekspertimi biologjik (Nuk ka vendime në Vol. II)*
  - *ekspertimi grafik (Nuk ka vendime në Vol. II)*
  - *ekspertimi teknik-elektronik (V-44/25 f. 1014, Vol. II)*
  - *fuqi provuese e aktit (Nuk ka vendime në Vol. II)*
  - *individual (Nuk ka vendime në Vol. II)*
  - *normativ (Nuk ka vendime në Vol. II)*
  - *pavlefshmëri absolute e aktit (V-36/25 f. 853, Vol. II)*
  - *pavlefshmëri relative e aktit (Nuk ka vendime në Vol. II)*
  - *përfaqësimi (Nuk ka vendime në Vol. II)*
- Aparat telefonik celular *(V-44/25 f. 1014, Vol. II)*
- Arbitrazh ndërkombëtar *(Nuk ka vendime në Vol. II)*
- Arsye antikushtetutshmërie *(Nuk ka vendime në Vol. II)*
- Arsyetim
  - *arbitrar (Nuk ka vendime në Vol. II)*
  - *de plano i vendimit (Nuk ka vendime në Vol. II)*
  - *formal (Nuk ka vendime në Vol. II)*
  - *i kufizuar (V-31/25 f. 726, Vol. II); (V-34/25 f. 807, Vol. II); (V-52/25 f. 1245, Vol. II)*
  - *i vendimit (V-27/25 f. 659, Vol. II); (V-30/25 f. 709, Vol. II); (V-31/25 f. 726, Vol. II); (V-32/25 f. 748, Vol. II); (V-36/25 f. 853, Vol. II); (V-39/25 f. 897, Vol. II); (V-48/25 f. 1158, Vol. II); (V-50/25 f. 1221, Vol. II); (V-52/25 f. 1245, Vol. II)*

- Asgjësim i të dhënave kompjuterike të sekuestruara *(Nuk ka vendime në Vol. II)*
- Autonomi parlamentare *(Nuk ka vendime në Vol. II)*
- Autorizim për heqjen e lirisë *(Nuk ka vendime në Vol. II)*

B
- Barazia e armëve *(V-48/25 f. 1158, Vol. II)*
- Barrë prove *(V-42/25 f. 942, Vol. II)*
- Bashkëpunim gjyqësor penal *(Nuk ka vendime në Vol. II)*
- Bindje e brendshme e gjyqtarit *(Nuk ka vendime në Vol. II)*
- Burim gjenerues energjie *(Nuk ka vendime në Vol. II)*

C
- Cilësim
  - *juridik i faktit penal (Nuk ka vendime në Vol. II)*
  - *juridik i veprës penale (Nuk ka vendime në Vol. II)*

D
- Decentralizim i qeverisjes vendore *(Nuk ka vendime në Vol. II)*
- Detyrim
  - *financiar (V-29/25 f. 693, Vol. II)*
  - *i Gjykatës Administrative të Apelit të shqyrtojë çështjen (V-37/25 f. 869, Vol. II)*
  - *ushqimor (Nuk ka vendime në Vol. II)*
- Dëm
  - *biologjik (V-31/25 f. 726, Vol. II)*
  - *jashtëkontraktor (V-36/25 f. 853, Vol. II)*
  - *jopasuror (V-31/25 f. 726, Vol. II)*
  - *pasuror (V-31/25 f. 726, Vol. II)*
  - *shkaktim dëmi (V-36/25 f. 853, Vol. II)*
  - *shpërblim dëmi (V-30/25 f. 709, Vol. II); (V-36/25 f. 853, Vol. II); (V-54/25 f. 1282, Vol. II)*
- Dënim
  - *me gjobë (Nuk ka vendime në Vol. II)*
  - *parashkrim i dënimit (Nuk ka vendime në Vol. II)*
  - *ulje e dënimit (Nuk ka vendime në Vol. II)*
- Dëshmitar *(Nuk ka vendime në Vol. II)*
- Direktiva BE 2024/1260, datë 24.04.2024 *(V-33/25 f. 766, Vol. II)*
- Direktiva 42/2014 BE, datë 24.04.2024 *(V-33/25 f. 766, Vol. II)*
- Direktiva 2006/126/EC "Për lejet e drejtimit" *(V-49/25 f. 1196, Vol. II)*
- Dispozitë kalimtare *(Nuk ka vendime në Vol. II)*
- Dyshim
  - *i arsyeshëm (V-27/25 f. 659, Vol. II); (V-33/25 f. 766, Vol. II)*
  - *i justifikuar (Nuk ka vendime në Vol. II)*

E
- E drejta
  - *analizë e së drejtës (Nuk ka vendime në Vol. II)*
  - *e informimit (V-45/25 f. 1077, Vol. II)*

  - *e jetës private (V-42/25 f. 942, Vol. II); (V-44/25 f. 1014, Vol. II)*
  - *e pronës (V-32/25 f. 748, Vol. II); (V-33/25 f. 766, Vol. II); (V-38/25 f. 879, Vol. II); (V-46/25 f. 1127, Vol. II)*
  - *e punës dhe profesionit (Nuk ka vendime në Vol. II)*
  - *e drejta për të qëndruar në heshtje (V-54/25 f. 1282, Vol. II)*
  - *për gjykim të drejtë (V-28/25 f. 676, Vol. II)*
  - *për pension (Nuk ka vendime në Vol. II)*
  - *për të mos u dëbuar (Nuk ka vendime në Vol. II)*
  - *për të marrë në pyetje dëshmitarë (Nuk ka vendime në Vol. II)*
  - *për t'u dëgjuar (Nuk ka vendime në Vol. II)*
  - *për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm (V-37/25 f. 869, Vol. II); (V-53/25 f. 1264, Vol. II); (V-54/25 f. 1282, Vol. II)*
  - *për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj (V-38/25 f. 879, Vol. II); (V-39/25 f. 897, Vol. II)*
  - *për t'u mbrojtur (V-41/25 f. 932, Vol. II)*
  - *për t'iu drejtuar gjykatës (aksesi) (V-27/25 f. 659, Vol. II)*; *(V-30/25 f. 709, Vol. II)*; *(V-31/25 f. 726, Vol. II)*; *(V-32/25 f. 748, Vol. II)*; *(V-36/25 f. 853, Vol. II)*; *(V-41/25 f. 932, Vol. II)*; *(V-46/25 f. 1127, Vol. II)*; *(V-50/25 f. 1221, Vol. II)*; *(V-52/25 f. 1245, Vol. II)*
  - *pozitive*
- Ekstradim *(Nuk ka vendime në Vol. II)*
- Ekzekutim
  - *i vendimit (V-29/25 f. 693, Vol. II)*
  - *i vendimit penal (Nuk ka vendime në Vol. II)*

F

- Fajësia *(V-27/25 f. 659, Vol. II)*
- Fakt
  - *analizë e fakteve (Nuk ka vendime në Vol. II)*
  - *penal (Nuk ka vendime në Vol. II)*
  - *prezumim fakti (Nuk ka vendime në Vol. II)*
  - *ripërcaktim i fakteve (Nuk ka vendime në Vol. II)*
  - *vlerësimi i fakteve (Nuk ka vendime në Vol. II)*
- Falsifikim i dokumenteve *(Nuk ka vendime në Vol. II)*
- Faturë financiare e projektligjit *(V-45/25 f. 1077, Vol. II)*
- Flora dhe fauna *(V-45/25 f. 1077, Vol. II)*
- Fshehje e kufomës *(Nuk ka vendime në Vol. II)*
- Funksionarët e lartë shtetërorë *(Nuk ka vendime në Vol. II)*
- Funksionet GJL *(V-38/25 f. 879, Vol. II)*; *(V-46/25 f. 1127, Vol. II)*
- Fuqia detyruese
  - *e vendimeve GJK (V-39/25 f. 897, Vol. II)*
- Fuqia prapavepruese e normës juridike *(V-34/25 f. 807, Vol. II)*; *(V-43/25 f. 997, Vol. II)*

GJ

- Gjobë *(Nuk ka vendime në Vol. II)*

- Gjykatë
  - *e posaçme (Nuk ka vendime në Vol. II)*
  - *ligji (V-39/25 f. 897, Vol. II)*
- Gjykim
  - *i drejtë (Nuk ka vendime në Vol. II)*
  - *i shkurtuar (Nuk ka vendime në Vol. II)*
  - *në mungesë (Nuk ka vendime në Vol. II)*

H
- Harmonizim i kuadrit ligjor *(Nuk ka vendime në Vol. II)*
- Hetim
  - *administrativ (Nuk ka vendime në Vol. II)*
  - *i të dhënave (Nuk ka vendime në Vol. II)*
- Hierarki e normave juridike *(Nuk ka vendime në Vol. II)*
- Humbja e jetës *(Nuk ka vendime në Vol. II)*

I
- Identitet kulturor *(Nuk ka vendime në Vol. II)*
- Imunitet i deputetit *(Nuk ka vendime në Vol. II)*
- Inspektorati Qendror Teknik *(Nuk ka vendime në Vol. II)*
- Instituti i Trashëgimisë Kulturore *(Nuk ka vendime në Vol. II)*
- Interes
  - *i drejtpërdrejtë (V-51/25 f. 1237, Vol. II)*
  - *i kërkuesit (V-29/25 f. 693, Vol. II); (V-54/25 f. 1282, Vol. II)*
  - *i ligjshëm (Nuk ka vendime në Vol. II)*
  - *jetësor (V-54/25 f. 1282, Vol. II)*
  - *pasuror (Nuk ka vendime në Vol. II)*
  - *publik (Nuk ka vendime në Vol. II)*
  - *vetjak (V-37/25 f. 869, Vol. II); (V-54/25 f. 1282, Vol. II)*
- Interpretim
  - *arbitrar i ligjit (Nuk ka vendime në Vol. II)*
  - *konstruktiv dhe funksional (Nuk ka vendime në Vol. II)*
  - *i ligjit (V-30/25 f. 709, Vol. II); (V-40/25 f. 913, Vol. II)*
- Investim strategjik *(Nuk ka vendime në Vol. II)*

J
- Juridiksion
  - *fillestar (V-28/25 f. 676, Vol. II)*
  - *rishikues (V-31/25 f. 726, Vol. II)*
  - *tejkalim juridiksioni (Nuk ka vendime në Vol. II)*
  - *kushtetues (Nuk ka vendime në Vol. II)*

K
- Karta e Bolonjës *(V-43/25 f. 997, Vol. II)*
- Karta Europiane e Autonomisë Vendore *(Nuk ka vendime në Vol. II)*
- Karriera e gjyqtarit *(Nuk ka vendime në Vol. II)*

- Kategoritë e motomjeteve *(V-49/25 f. 1196, Vol. II)*
- Kërkesë
  - *për heqje dorë nga gjykimi i çështjes (Nuk ka vendime në Vol. II)*
  - *për përjashtim të gjyqtarit (Nuk ka vendime në Vol. II)*
  - *për përshpejtim të gjykimit (V-35/25 f. 828, Vol. II); (V-37/25 f. 869, Vol. II); (V-52/25 f. 1245, Vol. II); (V-53/25 f. 1264, Vol. II)*
- Këshilli i Lartë Gjyqësor *(V-28/25 f. 676, Vol. II)*
- Komiteti i Kulteve dhe Fesë *(Nuk ka vendime në Vol. II)*
- Kompensim për burgim të padrejtë *(Nuk ka vendime në Vol. II)*
- Kompetencë
  - *lëndore (Nuk ka vendime në Vol. II)*
  - *tejkalim kompetence (V-38/25 f. 879, Vol. II)*
- Kompleksiteti i çështjes *(V-29/25 f. 693, Vol. II)*; *(V-37/25 f. 869, Vol. II)*; *(V-54/25 f. 1282, Vol. II)*
- Koncesion *(Nuk ka vendime në Vol. II)*
- Konfidencialitet i burimit të gazetarit *(Nuk ka vendime në Vol. II)*
- Konflikt interesi *(V-35/25 f. 828, Vol. II)*
- Kontratë
  - *sipërmarrjeje (V-36/25 f. 853, Vol. II)*
  - *shitblerjeje (Nuk ka vendime në Vol. II)*
- Kontroll
  - *abstrakt (V-35/25 f. 828, Vol. II); (V-45/25 f. 1077, Vol. II)*
  - *i banesës (V-42/25 f. 942, Vol. II)*
  - *incidental (V-49/25 f. 1196, Vol. II)*
  - *konkret (V-27/25 f. 659, Vol. II); (V-28/25 f. 676, Vol. II); (V-29/25 f. 693, Vol. II); (V-30/25 f. 709, Vol. II); (V-31/25 f. 726, Vol. II); (V-32/25 f. 748, Vol. II); (V-33/25 f. 766, Vol. II); (V-34/25 f. 807, Vol. II); (V-36/25 f. 853, Vol. II); (V-37/25 f. 869, Vol. II); (V-38/25 f. 879, Vol. II); (V-39/25 f. 897, Vol. II); (V-40/25 f. 913, Vol. II); (V-41/25 f. 932, Vol. II); (V-42/25 f. 942, Vol. II); (V-43/25 f. 997, Vol. II); (V-44/25 f. 1014, Vol. II); (V-46/25 f. 1127, Vol. II); (V-47/25 f. 1149, Vol. II); (V-48/25 f. 1158, Vol. II); (V-50/25 f. 1221, Vol. II); (V-51/25 f. 1237, Vol. II); (V-52/25 f. 1245, Vol. II); (V-53/25 f. 1264, Vol. II); (V-54/25 f. 1282, Vol. II)*
- Konventa e Aarhusit "Për të drejtën e publikut për informacion, pjesëmarrje në vendimmarrje dhe të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës, për çështje që lidhen me mjedisin" *(V-45/25 f. 1077, Vol. II)*
- Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut dhe Protokollet Shtesë *(V-27/25 f. 659, Vol. II)*; *(V-28/25 f. 676, Vol. II)*; *(V-29/25 f. 693, Vol. II)*; *(V-30/25 f. 709, Vol. II)*; *(V-36/25 f. 853, Vol. II)*; *(V-39/25 f. 897, Vol. II)*; *(V-40/25 f. 913, Vol. II)*; *(V-44/25 f. 1014, Vol. II)*; *(V-52/25 f. 1245, Vol. II)*; *(V-54/25 f. 1282, Vol. II)*
- Konventa Europiane për Ekstradimin *(Nuk ka vendime në Vol. II)*
- Konventa e Këshillit të Europës "Për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave personale" *(V-44/25 f. 1014, Vol. II)*
- Konventa ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Greqisë për ndihmën gjyqësore në çështjet civile dhe penale *(Nuk ka vendime në Vol. II)*
- Konventa e Parisit "Për mbrojtjen e pronësisë industriale" *(Nuk ka vendime në Vol. II)*
- Korrupsion pasiv i funksionarëve të lartë *(Nuk ka vendime në Vol. II)*

- Kryetar i bashkisë *(Nuk ka vendime në Vol. II)*
- Kthim shume *(Nuk ka vendime në Vol. II)*
- Kufijtë e shqyrtimit të çështjes *(V-39/25 f. 897, Vol. II)*
- Kufizim
  - *i lirisë individuale (V-40/25 f. 913, Vol. II)*
  - *i masës së përfitimit të pensionit (Nuk ka vendime në Vol. II)*
  - *i moshës (V-49/25 f. 1196, Vol. II)*
- Kushte të urgjencës dhe flagrancës *(V-44/25 f. 1014, Vol. II)*
- Kuorum vendimmarrjeje *(V-48/25 f. 1158, Vol. II)*

L
- Lajthim *(V-50/25 f. 1221, Vol. II)*
- Largim nga puna *(Nuk ka vendime në Vol. II)*
- Legalizim i ndërtimit pa leje *(Nuk ka vendime në Vol. II)*
- Legjitimim *(V-27/25 f. 659, Vol. II)*; *(V-28/25 f. 676, Vol. II)*; *(V-29/25 f. 693, Vol. II)*; *(V-30/25 f. 709, Vol. II)*; *(V-31/25 f. 726, Vol. II)*; *(V-32/25 f. 748, Vol. II)*; *(V-33/25 f. 766, Vol. II)*; *(V-34/25 f. 807, Vol. II)*; *(V-35/25 f. 828, Vol. II)*; *(V-36/25 f. 853, Vol. II)*; *(V-37/25 f. 869, Vol. II)*; *(V-38/25 f. 879, Vol. II)*; *(V-39/25 f. 897, Vol. II)*; *(V-40/25 f. 913, Vol. II)*; *(V-41/25 f. 932, Vol. II)*; *(V-42/25 f. 942, Vol. II)*; *(V-43/25 f. 997, Vol. II)*; *(V-44/25 f. 1014, Vol. II)*; *(V-45/25 f. 1077, Vol. II)*; *(V-46/25 f. 1127, Vol. II)*; *(V-47/25 f. 1149, Vol. II)*; *(V-48/25 f. 1158, Vol. II)*; *(V-49/25 f. 1196, Vol. II)*; *(V-50/25 f. 1221, Vol. II)*; *(V-52/25 f. 1245, Vol. II)*; *(V-53/25 f. 1264, Vol. II)*; *(V-54/25 f. 1282, Vol. II)*
- Leje drejtimi *(V-49/25 f. 1196, Vol. II)*
- Leje ndërtimi *(V-36/25 f. 853, Vol. II)*
- Letërporosi *(Nuk ka vendime në Vol. II)*
- Ligjshmëri
  - *e veprimit administrativ (Nuk ka vendime në Vol. II)*
  - *e ndërhyrjes (V-33/25 f. 766, Vol. II)*
- Liria e shprehjes *(Nuk ka vendime në Vol. II)*
- Lirim nga detyra *(V-41/25 f. 932, Vol. II)*
- Luajalitet kushtetues *(Nuk ka vendime në Vol. II)*
- Lufta kundër kriminalitetit *(Nuk ka vendime në Vol. II)*

M
- Mandat
  - *i anëtarit KQZ (Nuk ka vendime në Vol. II)*
  - *kohëzgjatje e mandatit të gjyqtarit kushtetues (Nuk ka vendime në Vol. II)*
  - *mbarimi dhe fillimi ideal i mandatit (Nuk ka vendime në Vol. II)*
  - *mbarimi i mandatit të anëtarit të Kuvendit (V-35/25 f. 828, Vol. II)*
  - *mbarimi i mandatit të gjyqtarit kushtetues (Nuk ka vendime në Vol. II)*
- Marrëdhënie
  - *jashtëkontraktore (Nuk ka vendime në Vol. II)*
  - *juridiksionale me autoritetet e huaja (Nuk ka vendime në Vol. II)*
  - *keqbesimi (Nuk ka vendime në Vol. II)*
  - *pune (V-39/25 f. 897, Vol. II); (V-54/25 f. 1282, Vol. II)*

- Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Europiane e shteteve të tyre anëtare *(Nuk ka vendime në Vol. II)*
- Marrje dijeni mbi gjykimin *(V-38/25 f. 879, Vol. II)*
- Markë e regjistruar *(Nuk ka vendime në Vol. II)*
- Masë
  - *arresti në burg (V-40/25 f. 913, Vol. II)*
  - *dënimi (Nuk ka vendime në Vol. II)*
  - *efektivitet i masës (V-33/25 f. 766, Vol. II)*
  - *proporcionalitet i masës (V-42/25 f. 942, Vol. II); (V- 44/25 f. 1014, Vol. II)*
  - *ligjshmëri e masës së sigurimit (Nuk ka vendime në Vol. II)*
  - *qëllimi i masës (Nuk ka vendime në Vol. II)*
  - *sekuestro e akteve shkresore (Nuk ka vendime në Vol. II)*
  - *sekuestro e aparateve telefonikë (Nuk ka vendime në Vol. II)*
  - *sekuestro provuese (V-42/25 f. 942, Vol. II); (V-44/25 f. 1014, Vol. II)*
  - *sekuestro preventive (V-33/25 f. 766, Vol. II); (V-53/25 f. 1264, Vol. II)*
  - *sigurimi personal (V-40/25 f. 913, Vol. II)*
  - *vleftësim i masës nga prokurori (V-42/25 f. 942, Vol. II)*
  - zëvendësim mase sigurimi *(Nuk ka vendime në Vol. II)*
- Mbrojtës
  - *kryesisht (Nuk ka vendime në Vol. II)*
- Mbrojtja e mjedisit *(V-45/25 f. 1077, Vol. II)*
- Mbrojtja e trashëgimisë kulturore *(V-45/25 f. 1077, Vol. II)*
- Mbledhja e Posaçme e Gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë *(Nuk ka vendime në Vol. II)*
- Mekanizimi i përtëritjes së pjesshme *(rotacionit) (Nuk ka vendime në Vol. II)*
- Mendim
  - *kundër (vendimi i GjK) (Nuk ka vendime në Vol. II)*
  - *paralel (vendimi i GjK) (V-42/25 f. 942, Vol. II)*
  - *pakice (vendimi i GjK) (V-27/25 f. 659, Vol. II); (V-29/25 f. 693, Vol. II); (V-33/25 f. 766, Vol. II); (V-35/25 f. 828, Vol. II); (V-38/25 f. 879, Vol. II); (V-45/25 f. 1077, Vol. II); (V-46/25 f. 1127, Vol. II); (V-49/25 f. 1196, Vol. II); (V-50/25 f. 1221, Vol. II)*
  - *pjesërisht kundër (vendimi i GjK) (V-48/25 f. 1158, Vol. II)*
- Metodologji e vlerësimit të dëmit *(V-31/25 f. 726, Vol. II)*
- Mjet
  - *i jashtëzakonshëm ankimi (Nuk ka vendime në Vol. II)*
  - *jetese (Nuk ka vendime në Vol. II)*
  - *i kërkimit të provës (Nuk ka vendime në Vol. II)*
- Mocion
  - *mosbesimi (V-35/25 f. 828, Vol. II)*
- Moslegjitim *(V-51/25 f. 1237, Vol. II)*
- Mosmarrëveshje
  - *administrative (Nuk ka vendime në Vol. II)*

N

- Ndarje e çështjes *(Nuk ka vendime në Vol. II)*
- Ndërgjyqësia *(V-42/25 f. 942, Vol. II)*
- Ndërhyrës kryesor *(V-48/25 f. 1158, Vol. II)*

- Ndërhyrje arbitrare e autoritetit publik *(V-42/25 f. 942, Vol. II)*
- Ndërtim pa leje *(Nuk ka vendime në Vol. II)*
- Ndihmë juridike falas *(V-47/25 f. 1149, Vol. II)*
- Ndihmë shtetërore *(Nuk ka vendime në Vol. II)*
- Ndjekje penale
  - *parashkrim i ndjekjes penale (Nuk ka vendime në Vol. II)*
- Nevoja dhe urgjenca *(Nuk ka vendime në Vol. II)*
- Nënshkrim i mbrojtësit *(Nuk ka vendime në Vol. II)*
- Nëpunës publik *(Nuk ka vendime në Vol. II)*
- Ndreqje gabimi *(V-47/25 f. 1149, Vol. II)*

NJ

- Njëzëri *(vendimi i GJK) (V-28/25 f. 676, Vol. II)*; *(V-32/25 f. 748, Vol. II)*; *(V-34/25 f. 807, Vol. II)*; *(V-36/25 f. 853, Vol. II)*; *(V-37/25 f. 869, Vol. II)*; *(V-39/25 f. 897, Vol. II)*; *(V-40/25 f. 913, Vol. II)*; *(V-41/25 f. 932, Vol. II)*; *(V-44/25 f. 1014, Vol. II)*; *(V-47/25 f. 1149, Vol. II)*; *(V-51/25 f. 1237, Vol. II)*; *(V-52/25 f. 1245, Vol. II)*; *(V-53/25 f. 1264, Vol. II)*; *(V- 54/25 f. 1282, Vol. II)*
- Njoftim
  - *i akuzës (Nuk ka vendime në Vol. II)*
  - *i aktit të vlerësimit (Nuk ka vendime në Vol. II)*
  - *i gjykimit (V-41/25 f. 932, Vol. II); (V-50/25 f. 1221, Vol. II)*
  - *individual i aktit administrativ (Nuk ka vendime në Vol. II)*
  - *i vendimit (Nuk ka vendime në Vol. II)*
  - *pavlefshmëri e njoftimit (V-38/25 f. 879, Vol. II)*
- Njohje e vendimit penal të huaj *(Nuk ka vendime në Vol. II)*

O

- Objekt shqyrtimi:
  - *Saktësim dhe plotësim i vendimit GJK (V-47/25 f. 1149, Vol. II)*
  - *Rihapje procesi gjyqësor nga GJEDNJ (V-48/25 f. 1158, Vol. II)*
  - *Interpretim i Kushtetutës (Nuk ka vendime në Vol. II)*
  - *Ligje dhe norma të tjera me fuqinë e ligjit (V-45/25 f. 1077, Vol. II); (V-49/25 f. 1196, Vol. II)*
  - *Vendime të Kuvendit (V-35/25 f. 828, Vol. II)*
  - *Vendime të Këshillit të Ministrave (Nuk ka vendime në Vol. II)*
  - *Vendime të gjykatave (V-27/25 f. 659, Vol. II); (V-28/25 f. 676, Vol. II); (V-30/25 f. 709, Vol. II); (V-31/25 f. 726, Vol. II); (V-32/25 f. 748, Vol. II); (V-33/25 f. 766, Vol. II); (V-34/25 f. 807, Vol. II); (V-36/25 f. 853, Vol. II); (V-37/25 f. 869, Vol. II); (V-38/25 f. 879, Vol. II); (V-39/25 f. 897, Vol. II); (V-40/25 f. 913, Vol. II); (V-41/25 f. 932, Vol. II); (V-42/25 f. 942, Vol. II); (V-44/25 f. 1014, Vol. II); (V-46/25 f. 1127, Vol. II); (V-50/25 f. 1221, Vol. II); (V-51/25 f. 1237, Vol. II); (V-52/25 f. 1245, Vol. II); (V-53/25 f. 1264, Vol. II); (V-54/25 f. 1282, Vol. II)*
  - *Konstatim i cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor (V-29/25 f. 693, Vol. II); (V-34/25 f. 807, Vol. II); (V-52/25 f. 1245, Vol. II); (V-53/25 f. 1264, Vol. II); (V-54/25 f. 1282, Vol. II)*
  - *Zgjidhje e mosmarrëveshjes së kompetencës (Nuk ka vendime në Vol. II)*

- Organ emërtese *(Nuk ka vendime në Vol. II)*
- Organe të pushtetit vendor *(Nuk ka vendime në Vol. II)*

P

- Padi
  - *afat i paraqitjes së padisë (V-36/25 f. 853, Vol. II)*
  - *parashkrimi i padisë (Nuk ka vendime në Vol. II)*
  - *rivendikimi (V-46/25 f. 1127, Vol. II)*
  - *sigurimi i padisë (Nuk ka vendime në Vol. II)*
  - *shkak ligjor i padisë (V-39/25 f. 897, Vol. II)*
  - *vlera e padisë (Nuk ka vendime në Vol. II)*
- Pagë
  - *e arsimtarit (V-43/25 f. 997, Vol. II)*
  - *elementët e pagës (V-43/25 f. 997, Vol. II)*
  - *ndërprerje e pagës (Nuk ka vendime në Vol. II)*
  - *referuese (Nuk ka vendime në Vol. II)*
- Pagesë kalimtare *(Nuk ka vendime në Vol. II)*
- Pakicë parlamentare *(V-35/25 f. 828, Vol. II)*
- Panele diellore *(Nuk ka vendime në Vol. II)*
- Parimi
  - *i barazisë para ligjit (V-43/25 f. 997, Vol. II)*
  - *i barazisë së armëve (V-48/25 f. 1158, Vol. II)*
  - *i disponibilitetit (Nuk ka vendime në Vol. II)*
  - *i gjësë së gjykuar (Nuk ka vendime në Vol. II)*
  - *i kontradiktoritetit (Nuk ka vendime në Vol. II)*
  - *i hierarkisë së akteve (Nuk ka vendime në Vol. II)*
  - *i ligjshmërisë (Nuk ka vendime në Vol. II)*
  - *i mosdënimit pa ligj (V-33/25 f. 766, Vol. II)*
  - *i mosgjykimit dy herë për të njëjtën vepër penale (ne bis in idem) (Nuk ka vendime në Vol. II)*
  - *i ndarjes dhe i balancimit të pushteteve (Nuk ka vendime në Vol. II)*
  - *i ndalimit të "reformatio in peius" (V-46/25 f. 1127, Vol. II)*
  - *i paanshmërisë (Nuk ka vendime në Vol. II)*
  - *i pavarësisë së gjyqësorit (Nuk ka vendime në Vol. II)*
  - *i prezumimit të pafajësisë (V-27/25 f. 659, Vol. II)*
  - *i proporcionalitetit (V-44/25 f. 1014, Vol. II)*
  - *i sigurisë juridike (V-34/25 f. 807, Vol. II)*
  - *i shtetit të së drejtës (Nuk ka vendime në Vol. II)*
- Pasuria
  - *barrë mbi pasurinë (Nuk ka vendime në Vol. II)*
  - *konfiskim i pasurisë (V-33/25 f. 766, Vol. II)*
  - *origjina e pasurisë (Nuk ka vendime në Vol. II)*
  - *pjesëtim i pasurisë bashkëshortore (Nuk ka vendime në Vol. II)*
  - *publike (V-35/25 f. 828, Vol. II)*
  - *regjistrim i pasurisë (Nuk ka vendime në Vol. II)*
- Papajtueshmëri me mandatin e deputetit *(V-35/25 f. 828, Vol. II)*

- Papajtueshmëri dhe pazgjedhshmëri e funksionit *(Nuk ka vendime në Vol. II)*
- Person i zhdukur *(Nuk ka vendime në Vol. II)*
- Person në dijeni për veprën penale *(V-42/25 f. 942, Vol. II)*
- Pension
  - *i parakohshëm (V-34/25 f. 807, Vol. II)*
  - *pleqërie (Nuk ka vendime në Vol. II)*
  - *suplementar (Nuk ka vendime në Vol. II)*
- Pezullim
  - *i gjykimit (Nuk ka vendime në Vol. II)*
  - *i pjesshëm i dekretit të Presidentit (Nuk ka vendime në Vol. II)*
  - *i vendimit të Këshillit të Ministrave (Nuk ka vendime në Vol. II)*
  - *i zbatimit të ligjit (V-45/25 f. 1077, Vol. II)*
  - *i zbatimit të vendimit gjyqësor (Nuk ka vendime në Vol. II)*
- Përgjegjësi ligjore *(Nuk ka vendime në Vol. II)*
- Përgjim ambiental *(Nuk ka vendime në Vol. II)*
- Përligjje e arsyeshme dhe objektive *(Nuk ka vendime në Vol. II)*
- Pritshmëritë e ligjshme *(Nuk ka vendime në Vol. II)*
- Privatizimi *(Nuk ka vendime në Vol. II)*
- Pjesëmarrje e publikut në vendimmarrje *(V-45/25 f. 1077, Vol. II)*
- Porti i Durrësit *(Nuk ka vendime në Vol. II)*
- Pranim kërkese *(vendim i GJK) (V-32/25 f. 748, Vol. II)*; *(V-37/25 f. 869, Vol. II)*; *(V-38/25 f. 879, Vol. II)*; *(V-39/25 f. 897, Vol. II)*; *(V-40/25 f. 913, Vol. II)*; *(V-41/25 f. 932, Vol. II)*; *(V-46/25 f. 1127, Vol. II)*; *(V-48/25 f. 1158, Vol. II)*; *(V-54/25 f. 1282, Vol. II)*
- Pranim kërkese pjesërisht *(vendim i GJK) (V-27/25 f. 659, Vol. II)*; *(V-28/25 f. 676, Vol. II)*; *(V-29/25 f. 693, Vol. II)*; *(V-30/25 f. 709, Vol. II)*; *(V-31/25 f. 726, Vol. II)*; *(V-34/25 f. 807, Vol. II)*; *(V-36/25 f. 853, Vol. II)*; *(V-42/25 f. 942, Vol. II)*; *(V-44/25 f. 1014, Vol. II)*; *(V-47/25 f. 1149, Vol. II)*; *(V-50/25 f. 1221, Vol. II)*; *(V-53/25 f. 1264, Vol. II)*
- Proces i rregullt ligjor *(V-27/25 f. 659, Vol. II)*; *(V-28/25 f. 676, Vol. II)*; *(V-29/25 f. 693, Vol. II)*; *(V-30/25 f. 709, Vol. II)*; *(V-31/25 f. 726, Vol. II)*; *(V-32/25 f. 748, Vol. II)*; *(V-33/25 f. 766, Vol. II)*; *(V-34/25 f. 807, Vol. II)*; *(V-36/25 f. 853, Vol. II)*; *(V-37/25 f. 869, Vol. II)*; *(V-38/25 f. 879, Vol. II)*; *(V-39/25 f. 897, Vol. II)*; *(V-40/25 f. 913, Vol. II)*; *(V-41/25 f. 932, Vol. II)*; *(V-42/25 f. 942, Vol. II)*; *(V-44/25 f. 1014, Vol. II)*; *(V-46/25 f. 1127, Vol. II)*; *(V-47/25 f. 1149, Vol. II)*; *(V-48/25 f. 1158, Vol. II)*; *(V- 50/25 f. 1221, Vol. II)*; *(V-51/25 f. 1237, Vol. II)*; *(V-52/25 f. 1245, Vol. II)*; *(V-53/25 f. 1264, Vol. II)*; *(V-54/25 f. 1282, Vol. II)*
- Proces i zgjedhjes së gjyqtarit kushtetues *(Nuk ka vendime në Vol. II)*
- Procesi zgjedhor *(Nuk ka vendime në Vol. II)*
- Procedim penal *(V-33/25 f. 766, Vol. II)*
- Produkte të veprës penale *(V-33/25 f. 766, Vol. II)*
- Prodhim pijesh energjike *(Nuk ka vendime në Vol. II)*
- Pronë
  - *kthim dhe kompensim i pronës (V-32/25 f. 748, Vol. II); (V-48/25 f. 1158, Vol. II); (V-50/25 f. 1221, Vol. II)*
  - *lirim dhe dorëzim prone (V-46/25 f. 1127, Vol. II)*
  - *mbivendosje prone (V-46/25 f. 1127, Vol. II)*

  - *publike (Nuk ka vendime në Vol. II)*
  - *shpronësim (V-29/25 f. 693, Vol. II)*
  - *vlera e pronës (Nuk ka vendime në Vol. II)*
- Pronësi intelektuale *(Nuk ka vendime në Vol. II)*
- Proporcionalitet i ndërhyrjes *(V-33/25 f. 766, Vol. II)*
- Protokolli i Marrëveshjes së Madridit "Për regjistrimin ndërkombëtar të markave" *(Nuk ka vendime në Vol. II)*
- Provë
  - *elektronike (V-44/25 f. 1014, Vol. II)*
  - *materiale (Nuk ka vendime në Vol. II)*
  - *mënyra e marrjes së provës (V-27/25 f. 659, Vol. II)*
  - *vlerësimi i provës (V-48/25 f. 1158, Vol. II)*
  - *ripërcaktim i provave (Nuk ka vendime në Vol. II)*
- Punonjës policie *(V-41/25 f. 932, Vol. II)*
- Punësimi në sistemin shëndetësor *(Nuk ka vendime në Vol. II)*
- Pushim *(vendim i GJK) (Nuk ka vendime në Vol. II)*

Q
- Qëllim
  - *i ligjshëm (V-42/25 f. 942, Vol. II)*
- Qëndrim arbitrar i gjykatës *(V-52/25 f. 1245, Vol. II)*
- Qëndrim formal i gjykatës *(Nuk ka vendime në Vol. II)*

R
- Raport i Komisionit të Venecias CDL-AD*(2014) (Nuk ka vendime në Vol. II)*
- Reciprocitet *(Nuk ka vendime në Vol. II)*
- Reforma në drejtësi *(Nuk ka vendime në Vol. II)*
- Regjim tranzitor *(Nuk ka vendime në Vol. II)*
- Rekursi
  - *afat i paraqitjes së rekursit (Nuk ka vendime në Vol. II)*
  - *individual (Nuk ka vendime në Vol. II)*
  - *pretendime në rekurs (V-30/25 f. 709, Vol. II)*
  - *shkaqe ligjore të rekursit (V-27/25 f. 659, Vol. II); (V- 50/25 f. 1221, Vol. II); (V-52/25 f. 1245, Vol. II)*
- Rezervë konventore *(Nuk ka vendime në Vol. II)*
- Rikthim në detyrë *(Nuk ka vendime në Vol. II)*
- Rishqyrtim
  - *në Gjykatën e Posaçme të Apelit kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (Nuk ka vendime në Vol. II)*
  - *në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm (Nuk ka vendime në Vol. II)*
  - *në Gjykatën e Lartë (V-27/25 f. 659, Vol. II); (V-28/25 f. 676, Vol. II); (V-30/25 f. 709, Vol. II); (V-31/25 f. 726, Vol. II); (V-32/25 f. 748, Vol. II); (V-34/25 f. 807, Vol. II); (V-36/25 f. 853, Vol. II); (V-38/25 f. 879, Vol. II); (V-39/25 f. 897, Vol. II); (V-41/25 f. 932, Vol. II); (V-46/25 f. 1127, Vol. II)*
- Rivendosje e së drejtës *(V-32/25 f. 748, Vol. II)*

RR
- Rregullore AMF *(V-30/25 f. 709, Vol. II)*
- Rregulla të qarkullimit rrugor *(V-31/25 f. 726, Vol. II)*; *(V-49/25 f. 1196, Vol. II)*
- Rrethi i subjekteve të interesuara në gjykimin kushtetues *(Nuk ka vendime në Vol. II)*
- Rrjedhje informacioni hetimor *(Nuk ka vendime në Vol. II)*
- Rënie në dekadencë *(Nuk ka vendime në Vol. II)*
- Rrëzim kërkese *(vendim i GJK) (V-33/25 f. 766, Vol. II)*; *(V-35/25 f. 828, Vol. II)*; *(V-43/25 f. 997, Vol. II)*; *(V-45/25 f. 1077, Vol. II)*; *(V-48/25 f. 1158, Vol. II)*; *(V-49/25 f. 1196, Vol. II)*; *(V-51/25 f. 1237, Vol. II)*; *(V-52/25 f. 1245, Vol. II)*

S
- Sekret hetimor *(V-42/25 f. 942, Vol. II)*
- Siguria
  - *në plazhe (Nuk ka vendime në Vol. II)*
  - *në punë (Nuk ka vendime në Vol. II)*
- Sigurim i detyrueshëm *(Nuk ka vendime në Vol. II)*
- Sigurim
  - *shoqëror suplementar (Nuk ka vendime në Vol. II)*
- *Sine qua non (Nuk ka vendime në Vol. II)*
- Sistemi arsimor parauniverstitar *(V-43/25 f. 997, Vol. II)*
- Sistem shëndetësor *(Nuk ka vendime në Vol. II)*
- Sjellja e
  - *kërkuesit (V-29/25 f. 693, Vol. II); (V-54/25 f. 1282, Vol. II)*
  - *autoriteteve (V-29/25 f. 693, Vol. II); (V-54/25 f. 1282, Vol. II)*
- Subjekte kërkues:
  - *Grup deputetësh (V-35/25 f. 828, Vol. II); (V-45/25 f. 1077, Vol. II)*
  - *Gjykatat (V-49/25 f. 1196, Vol. II)*
  - *Shoqata dhe organizata të tjera (V-43/25 f. 997, Vol. II)*
  - *Individët dhe shoqëritë (V-27/25 f. 659, Vol. II); (V-28/25 f. 676, Vol. II); (V-29/25 f. 693, Vol. II); (V-30/25 f. 709, Vol. II); (V-31/25 f. 726, Vol. II); (V-32/25 f. 748, Vol. II); (V-33/25 f. 766, Vol. II); (V-34/25 f. 807, Vol. II); (V-36/25 f. 853, Vol. II); (V-37/25 f. 869, Vol. II); (V-38/25 f. 879, Vol. II); (V-39/25 f. 897, Vol. II); (V-40/25 f. 913, Vol. II); (V-41/25 f. 932, Vol. II); (V-42/25 f. 942, Vol. II); (V-44/25 f. 1014, Vol. II); (V-46/25 f. 1127, Vol. II); (V-47/25 f. 1149, Vol. II); (V-48/25 f. 1158, Vol. II); (V-50/25 f. 1221, Vol. II); (V-51/25 f. 1237, Vol. II); (V-52/25 f. 1245, Vol. II); (V-53/25 f. 1264, Vol. II); (V-54/25 f. 1282, Vol. II)*
- Statusi i magjistratit *(Nuk ka vendime në Vol. II)*

SH
- Shkarkim nga detyra *(Nuk ka vendime në Vol. II)*
- Shfuqizim
  - *ligji (Nuk ka vendime në Vol. II)*
  - *vendim gjykate (V-27/25 f. 659, Vol. II)*; *(V-28/25 f. 676, Vol. II)*; *(V-30/25 f. 709, Vol. II)*; *(V-31/25 f. 726, Vol. II)*; *(V-32/25 f. 748, Vol. II)*; *(V-34/25 f. 807, Vol. II)*; *(V-36/25 f. 853, Vol. II)*; *(V-37/25 f. 869, Vol. II)*; *(V-38/25 f. 879, Vol. II)*; *(V-39/25 f. 897, Vol. II)*; *(V-40/25 f. 913, Vol. II)*; *(V-41/25 f. 932, Vol. II)*; *(V-46/25 f. 1127, Vol. II)*; *(V-53/25 f. 1264, Vol. II)*; *(V-54/25 f. 1282, Vol. II)*

- Shkelje disiplinore *(Nuk ka vendime në Vol. II)*
- Shoqëritë huamarrëse *(Nuk ka vendime në Vol. II)*
- Shoqëri sigurimi *(Nuk ka vendime në Vol. II)*
- Shpenzime gjyqësore *(V-47/25 f. 1149, Vol. II)*; *(V-54/25 f. 1282, Vol. II)*
- Shpenzime përfaqësimi *(V-47/25 f. 1149, Vol. II)*; *(V-54/25 f. 1282, Vol. II)*
- Shpërblim i drejtë *(Nuk ka vendime në Vol. II)*
- Shpërdorim detyre *(V-28/25 f. 676, Vol. II)*
- Shqyrtim i kufizuar *(Nuk ka vendime në Vol. II)*
- Shumicë
  - vendimi i GJK *(V-27/25 f. 659, Vol. II); (V-29/25 f. 693, Vol. II); (V-30/25 f. 709, Vol. II); (V-31/25 f. 726, Vol. II); (V-33/25 f. 766, Vol. II); (V-35/25 f. 828, Vol. II); (V-38/25 f. 879, Vol. II); (V-42/25 f. 942, Vol. II); (V-45/25 f. 1077, Vol. II); (V-46/25 f. 1127, Vol. II); (V-48/25 f. 1158, Vol. II); (V-49/25 f. 1196, Vol. II); (V-49/25 f. 1196, Vol. II); (V-50/25 f. 1221, Vol. II)*

T

- Tagër përfaqësimi *(V-38/25 f. 879, Vol. II)*
- Tarifë gjyqësore *(Nuk ka vendime në Vol. II)*
- Taksë e ndikimit në infrastrukturë *(V-36/25 f. 853, Vol. II)*
- Tejzgjatje gjykimi *(V-37/25 f. 869, Vol. II)*; *(V-53/25 f. 1264, Vol. II)*
- Të dhëna
  - *kompjuterike (V-44/25 f. 1014, Vol. II)*
  - *personale (V-44/25 f. 1014, Vol. II)*
- Titull ekzekutiv *(Nuk ka vendime në Vol. II)*
- Titull pronësie *(Nuk ka vendime në Vol. II)*
- Trashëgimia
  - *ligjore (V-32/25 f. 748, Vol. II)*
- Të drejtat e fituara *(V-43/25 f. 997, Vol. II)*
- Të dhëna sensitive *(Nuk ka vendime në Vol. II)*
- Të dhënat personale *(V-44/25 f. 1014, Vol. II)*

U

- Urdhër ekzekutimi *(V-52/25 f. 1245, Vol. II)*; *(V-53/25 f. 1264, Vol. II)*
- Ushtarak i FA *(V-34/25 f. 807, Vol. II)*

V

- Vendim
  - *i Gjykatës Europiane të Drejtësisë (Nuk ka vendime në Vol. II)*
  - *i Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut (V-29/25 f. 693, Vol. II); (V-33/25 f. 766, Vol. II); (V-40/25 f. 913, Vol. II); (V-42/25 f. 942, Vol. II); (V-44/25 f. 1014, Vol. II); (V-45/25 f. 1077, Vol. II); (V-46/25 f. 1127, Vol. II); (V-52/25 f. 1245, Vol. II); (V-53/25 f. 1264, Vol. II); (V-54/25 f. 1282, Vol. II)*
  - *i gjykatave kushtetuese të vendeve të tjera (Nuk ka vendime në Vol. II)*
  - *gjyqësor i formës së prerë (V-27/25 f. 659, Vol. II); (V-29/25 f. 693, Vol. II)*
  - *i mëparshëm i GJK (V-27/25 f. 659, Vol. II); (V-28/25 f. 676, Vol. II); (V-29/25 f. 693, Vol. II); (V-30/25 f. 709, Vol. II); (V-31/25 f. 726, Vol. II); (V-32/25 f. 748,*

Vol. II); (V-33/25 f. 766, Vol. II); (V-34/25 f. 807, Vol. II); (V-35/25 f. 828, Vol. II); (V-36/25 f. 853, Vol. II); (V-37/25 f. 869, Vol. II); (V-38/25 f. 879, Vol. II); (V-39/25 f. 897, Vol. II); (V-40/25 f. 913, Vol. II); (V-41/25 f. 932, Vol. II); (V-42/25 f. 942, Vol. II); (V-43/25 f. 997, Vol. II); (V-44/25 f. 1014, Vol. II); (V-48/25 f. 1158, Vol. II); (V-49/25 f. 1196, Vol. II); (V-50/25 f. 1221, Vol. II); (V-51/25 f. 1237, Vol. II) (V-53/25 f. 1264, Vol. II)
  - *i ndërmjetëm (Nuk ka vendime në Vol. II)*
  - *kontradiktor (Nuk ka vendime në Vol. II)*
  - *njësues i Gjykatës së Lartë (V-34/25 f. 807, Vol. II) (V-52/25 f. 1245, Vol. II)*
  - *përfundimtar (Nuk ka vendime në Vol. II)*
  - *unifikues KBGJL (V-31/25 f. 726, Vol. II)*
- Veprime hetimore të domosdoshme *(V-42/25 f. 942, Vol. II)*
- Veprim i normës juridike në kohë *(V-31/25 f. 726, Vol. II)*
- Veprim me iniciativë të oficerit të policisë gjyqësore *(V-42/25 f. 942, Vol. II)*
- Veprimtari parlamentare *(Nuk ka vendime në Vol. II)*
- Veprimtari fitimprurëse *(V-35/25 f. 828, Vol. II)*
- Vepër penale
  - *produkt i veprës penale (Nuk ka vendime në Vol. II)*
  - *person që ka dijeni për veprën penale (V-44/25 f. 1014, Vol. II)*
- Verifikim i funksionarëve në sistemin e drejtësisë *(Nuk ka vendime në Vol. II)*
- Vijimësi e shkeljes së pretenduar *(Nuk ka vendime në Vol. II)*
- Vjetërsi në shërbim *(V-34/25 f. 807, Vol. II)*
- Vrasje me paramendim *(Nuk ka vendime në Vol. II)*
- Vrasje për shkak të marrëdhënieve familjare *(Nuk ka vendime në Vol. II)*

Z

- Zbatimi
  - *arbitrar i ligjit (Nuk ka vendime në Vol. II)*
  - *i gabuar i ligjit (Nuk ka vendime në Vol. II)*
  - *i ligjit nga gjykatat më të ulëta (V-31/25 f. 726, Vol. II)*
- Zgjedhje vendore *(Nuk ka vendime në Vol. II)*
- Zonë arkeologjike *(Nuk ka vendime në Vol. II)*
- Zonë e mbrojtur *(V-45/25 f. 1077, Vol. II)*

INDEKSI SISTEMATIK

1. E DREJTA KUSHTETUESE

1.1. Juridiksioni kushtetues

1.1.1. Statusi i anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese

1.1.1.1. Mbarimi i mandatit të gjyqtarit kushtetues
(Nuk ka vendime në Vol. II)

1.2. Subjektet kërkuese

1.2.1. Presidenti i Republikës së Shqipërisë
(Nuk ka vendime në Vol. II)

1.2.2. Kuvendi i Republikës së Shqipërisë
Jo më pak se një e dhjeta e deputetëve të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë
Vendim nr. 35, datë 27.05.2025 ……..f. 828, Vol. II
Jo më pak se një e pesta e deputetëve të Kuvendit të Republikës të Shqipërisë
Vendim nr. 45, datë 31.07.2025 ……..f. 1077, Vol. II

1.2.3. Gjykatat
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë
Vendim nr. 49, datë 24.09.2025 ……..f. 1196, Vol. II

1.2.4. Shoqata dhe organizata të tjera
Sindikata e Bashkuar e Arsimit Shqiptar
Vendim nr. 43, datë 24.07.2025 ……..f. 997, Vol. II

1.2.5. Individët, shoqëritë
Edmond Mamushi
Vendim nr. 27, datë 29.04.2025 ……..f. 659, Vol. II
Tunxh Vatnikaj
Vendim nr. 28, datë 30.04.2025 ……..f. 676, Vol. II
Rafet Dokollari
Vendim nr. 29, datë 30.04.2025 ……..f. 693, Vol. II
Geg Ndoci, Age Ndoci
Vendim nr. 30, datë 02.05.2025 ……..f. 709, Vol. II

Festim Elezaj, Eglantina Elezaj, Fabiola Begaj (Elezaj)
Vendim nr. 31, datë 02.05.2025 ……..f. 726, Vol. II
Luan Mumajesi, Isuf Mumajesi, Majlinda Mumajesi, Enver Mumajesi,
Pullumb Mumajesi
Vendim nr. 32, datë 19.05.2025 ……..f. 748, Vol. II
Përllumb Gjoka, Shoqëria "IMPERIAL GROUP" sh.a., Kolë Gjoka
Vendim nr. 33, datë 20.05.2025 ……..f. 766, Vol. II
Hysni Mullalli
Vendim nr. 34, datë 27.05.2025 ……..f. 807, Vol. II
Shoqëria "Marlen" sh.p.k.
Vendim nr. 36, datë 04.06.2025 ……..f. 853, Vol. II
Kristofor Robo, Andonis Lina, Anastasia Lina
Vendim nr. 37, datë 04.06.2025 ……..f. 869, Vol. II
Shoqëria "ERDA" sh.p.k.
Vendim nr. 38, datë 10.06.2025 ……..f. 879, Vol. II
Esat Çoji
Vendim nr. 39, datë 17.06.2025 ……..f. 897, Vol. II
Mimoza Margjeka
Vendim nr. 40, datë 17.06.2025 ……..f. 913, Vol. II
Fatos Gjini
Vendim nr. 41, datë 24.06.2025 ……..f. 932, Vol. II
Shoqëria "Studio Pustina" sh.p.k.
Vendim nr. 42, datë 01.07.2025 ……..f. 942, Vol. II
Onejda Ymeraj
Vendim nr. 44, datë 29.07.2025 ……..f. 1014, Vol. II
Drita Pulleja, Gani Qatipi, Luljeta Qatipi, Gazmir Qatipi,
Dorina Qatipi, Florian Qatipi
Vendim nr. 46, datë 18.09.2025 ……..f. 1127, Vol. II
Tom Dedaj
Vendim nr. 47, datë 18.09.2025 ……..f. 1149, Vol. II
Astrit Meli
Vendim nr. 48, datë 22.09.2025 ……..f. 1158, Vol. II
Kostandin Xholli
Vendim nr. 50, datë 25.09.2025 ……..f. 1221, Vol. II
Bardhyl Ibra
Vendim nr. 51, datë 25.09.2025 ……..f. 1237, Vol. II
Shoqëria "Zyra e Përmbarimit Privat ARB" sh.p.k.
Vendim nr. 52, datë 07.10.2025 ……..f. 1245, Vol. II
Vendim nr. 53, datë 09.10.2025 ……..f. 1264, Vol. II
Bahrie Lluka
Vendim nr. 54, datë 09.10.2025 ……..f. 1282, Vol. II

1.3. Objekti i shqyrtimit

1.3.1. Interpretimi i Kushtetutës
(Nuk ka vendime në Vol. II)

1.3.2. Ligje dhe norma të tjera me fuqinë e ligjit
Vendim nr. 45, datë 31.07.2025 ..... f. 1077, Vol. II
Vendim nr. 49, datë 24.09.2025 ..... f. 1196, Vol. II

1.3.3. Vendime të Kuvendit
Vendim nr. 35, datë 27.05.2025 ..... f. 828, Vol. II

1.3.4. Vendime të Këshillit të Ministrave
Vendim nr. 43, datë 24.07.2025 ..... f. 997, Vol. II

1.3.5. Zgjidhje e mosmarrëveshjes së kompetencës
Vendim nr. 35, datë 27.05.2025 ..... f. 828, Vol. II

1.3.6. Vendime të gjykatave
Vendim nr. 27, datë 29.04.2025 ..... f. 659, Vol. II
Vendim nr. 28, datë 30.04.2025 ..... f. 676, Vol. II
Vendim nr. 30, datë 02.05.2025 ..... f. 709, Vol. II
Vendim nr. 31, datë 02.05.2025 ..... f. 726, Vol. II
Vendim nr. 32, datë 19.05.2025 ..... f. 748, Vol. II
Vendim nr. 33, datë 20.05.2025 ..... f. 766, Vol. II
Vendim nr. 34, datë 27.05.2025 ..... f. 807, Vol. II
Vendim nr. 36, datë 04.06.2025 ..... f. 853, Vol. II
Vendim nr. 37, datë 04.06.2025 ..... f. 869, Vol. II
Vendim nr. 38, datë 10.06.2025 ..... f. 879, Vol. II
Vendim nr. 39, datë 17.06.2025 ..... f. 897, Vol. II
Vendim nr. 40, datë 17.06.2025 ..... f. 913, Vol. II
Vendim nr. 41, datë 24.06.2025 ..... f. 932, Vol. II
Vendim nr. 42, datë 01.07.2025 ..... f. 942, Vol. II
Vendim nr. 44, datë 29.07.2025 ..... f. 1014, Vol. II
Vendim nr. 46, datë 18.09.2025 ..... f. 1127, Vol. II
Vendim nr. 50, datë 25.09.2025 ..... f. 1221, Vol. II
Vendim nr. 51, datë 25.09.2025 ..... f. 1237, Vol. II
Vendim nr. 52, datë 07.10.2025 ..... f. 1245, Vol. II
Vendim nr. 53, datë 09.10.2025 ..... f. 1264, Vol. II
Vendim nr. 54, datë 09.10.2025 ..... f. 1282, Vol. II

1.3.7. Konstatim i cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor
Vendim nr. 29, datë 30.04.2025 ..... f. 693, Vol. II
Vendim nr. 34, datë 27.05.2025 ..... f. 807, Vol. II
Vendim nr. 52, datë 07.10.2025 ..... f. 1245, Vol. II
Vendim nr. 53, datë 09.10.2025 ..... f. 1264, Vol. II
Vendim nr. 54, datë 09.10.2025 ..... f. 1282, Vol. II

1.3.8. Rihapje e procesit gjyqësor nga GJEDNJ
Vendim nr. 48, datë 22.09.2025 ..... f. 1158, Vol. II

1.3.9. Saktësim, plotësim i vendimit të GjK
Vendim nr. 47, datë 18.09.2025 ..... f. 1149, Vol. II

1.4. Vendimet e Gjykatës

1.4.1. Votimi i anëtarëve

1.4.1.1. Njëzëri
Vendim nr. 28, datë 30.04.2025 ..... f. 676, Vol. II
Vendim nr. 32, datë 19.05.2025 ..... f. 748, Vol. II
Vendim nr. 34, datë 27.05.2025 ..... f. 807, Vol. II
Vendim nr. 36, datë 04.06.2025 ..... f. 853, Vol. II
Vendim nr. 37, datë 04.06.2025 ..... f. 869, Vol. II
Vendim nr. 39, datë 17.06.2025 ..... f. 897, Vol. II
Vendim nr. 40, datë 17.06.2025 ..... f. 913, Vol. II
Vendim nr. 41, datë 24.06.2025 ..... f. 932, Vol. II
Vendim nr. 44, datë 29.07.2025 ..... f. 1014, Vol. II
Vendim nr. 47, datë 18.09.2025 ..... f. 1149, Vol. II
Vendim nr. 51, datë 25.09.2025 ..... f. 1237, Vol. II
Vendim nr. 52, datë 07.10.2025 ..... f. 1245, Vol. II
Vendim nr. 53, datë 09.10.2025 ..... f. 1264, Vol. II
Vendim nr. 54, datë 09.10.2025 ..... f. 1282, Vol. II

1.4.1.2. Shumicë
Vendim nr. 27, datë 29.04.2025 ..... f. 659, Vol. II
Vendim nr. 29, datë 30.04.2025 ..... f. 693, Vol. II
Vendim nr. 30, datë 02.05.2025 ..... f. 709, Vol. II
Vendim nr. 31, datë 02.05.2025 ..... f. 726, Vol. II
Vendim nr. 33, datë 20.05.2025 ..... f. 766, Vol. II
Vendim nr. 35, datë 27.05.2025 ..... f. 828, Vol. II
Vendim nr. 38, datë 10.06.2025 ..... f. 879, Vol. II
Vendim nr. 42, datë 01.07.2025 ..... f. 942, Vol. II
Vendim nr. 43, datë 24.07.2025 (nuk u formua shumica prej 5 gjyqtarësh) ... f. 997, Vol. II
Vendim nr. 45, datë 31.07.2025 ..... f. 1077, Vol. II
Vendim nr. 46, datë 18.09.2025 ..... f. 1127, Vol. II
Vendim nr. 48, datë 22.09.2025 ..... f. 1158, Vol. II
Vendim nr. 49, datë 24.09.2025 ..... f. 1196, Vol. II
Vendim nr. 50, datë 25.09.2025 ..... f. 1221, Vol. II

1.5. Arsyetimet individuale të anëtarëve

1.5.1. Mendim pakice
Vendim nr. 27, datë 29.04.2025 ..... f. 659, Vol. II
Vendim nr. 29, datë 30.04.2025 ..... f. 693, Vol. II
Vendim nr. 33, datë 20.05.2025 ..... f. 766, Vol. II
Vendim nr. 35, datë 27.05.2025 ..... f. 828, Vol. II
Vendim nr. 38, datë 10.06.2025 ..... f. 879, Vol. II

Vendim nr. 45, datë 31.07.2025 ..... f. 1077, Vol. II
Vendim nr. 46, datë 18.09.2025 ..... f. 1127, Vol. II
Vendim nr. 49, datë 24.09.2025 ..... f. 1196, Vol. II
Vendim nr. 50, datë 25.09.2025 ..... f. 1221, Vol. II

1.5.2. Mendim paralel
Vendim nr. 42, datë 01.07.2025 ..... f. 942, Vol. II

1.5.3. Mendim kundër
(Nuk ka vendime në Vol. II)

1.5.4. Mendim pjesërisht kundër
Vendim nr. 48, datë 22.09.2025 ..... f. 1158, Vol. II

1.6. Mënyra e përfundimit të çështjeve të gjykuara

1.6.1. Pranim
Vendim nr. 32, datë 19.05.2025 ..... f. 748, Vol. II
Vendim nr. 37, datë 04.06.2025 ..... f. 869, Vol. II
Vendim nr. 38, datë 10.06.2025 ..... f. 879, Vol. II
Vendim nr. 39, datë 17.06.2025 ..... f. 897, Vol. II
Vendim nr. 40, datë 17.06.2025 ..... f. 913, Vol. II
Vendim nr. 41, datë 24.06.2025 ..... f. 932, Vol. II
Vendim nr. 46, datë 18.09.2025 ..... f. 1127, Vol. II
Vendim nr. 54, datë 09.10.2025 ..... f. 1282, Vol. II

1.6.2. Pranim pjesërisht
Vendim nr. 27, datë 29.04.2025 ..... f. 659, Vol. II
Vendim nr. 28, datë 30.04.2025 ..... f. 676, Vol. II
Vendim nr. 29, datë 30.04.2025 ..... f. 693, Vol. II
Vendim nr. 30, datë 02.05.2025 ..... f. 709, Vol. II
Vendim nr. 31, datë 02.05.2025 ..... f. 726, Vol. II
Vendim nr. 34, datë 27.05.2025 ..... f. 807, Vol. II
Vendim nr. 36, datë 04.06.2025 ..... f. 853, Vol. II
Vendim nr. 42, datë 01.07.2025 ..... f. 942, Vol. II
Vendim nr. 44, datë 29.07.2025 ..... f. 1014, Vol. II
Vendim nr. 47, datë 18.09.2025 ..... f. 1149, Vol. II
Vendim nr. 50, datë 25.09.2025 ..... f. 1221, Vol. II
Vendim nr. 53, datë 09.10.2025 ..... f. 1264, Vol. II

1.6.3. Rrëzim
Vendim nr. 33, datë 20.05.2025 ..... f. 766, Vol. II
Vendim nr. 35, datë 27.05.2025 ..... f. 828, Vol. II
Vendim nr. 43, datë 24.07.2025 ..... f. 997, Vol. II
Vendim nr. 45, datë 31.07.2025 ..... f. 1077, Vol. II
Vendim nr. 49, datë 24.09.2025 ..... f. 1196, Vol. II

Vendim nr. 51, datë 25.09.2025 ..... f. 1237, Vol. II
Vendim nr. 52, datë 07.10.2025 ..... f. 1245, Vol. II

1.6.4. Pranim & Rrëzim
Vendim nr. 48, datë 22.09.2025 ..... f. 1158, Vol. II

1.6.5. Pushim
(Nuk ka vendime në Vol. II)

1.6.6. Deklarim i mbarimit të mandatit
(Nuk ka vendime në Vol. II)

1.7. Juridiksioni

1.7.1. Llojet e kontrollit

1.7.1.1. Kontroll abstrakt
Vendim nr. 35, datë 27.05.2025 ..... f. 828, Vol. II
Vendim nr. 45, datë 31.07.2025 ..... f. 1077, Vol. II

1.7.1.2. Kontroll incidental
Vendim nr. 49, datë 24.09.2025 ..... f. 1196, Vol. II

1.7.1.3. Kontroll konkret
Vendim nr. 27, datë 29.04.2025 ..... f. 659, Vol. II
Vendim nr. 28, datë 30.04.2025 ..... f. 676, Vol. II
Vendim nr. 29, datë 30.04.2025 ..... f. 693, Vol. II
Vendim nr. 30, datë 02.05.2025 ..... f. 709, Vol. II
Vendim nr. 31, datë 02.05.2025 ..... f. 726, Vol. II
Vendim nr. 32, datë 19.05.2025 ..... f. 748, Vol. II
Vendim nr. 33, datë 20.05.2025 ..... f. 766, Vol. II
Vendim nr. 34, datë 27.05.2025 ..... f. 807, Vol. II
Vendim nr. 36, datë 04.06.2025 ..... f. 853, Vol. II
Vendim nr. 37, datë 04.06.2025 ..... f. 869, Vol. II
Vendim nr. 38, datë 10.06.2025 ..... f. 879, Vol. II
Vendim nr. 39, datë 17.06.2025 ..... f. 897, Vol. II
Vendim nr. 40, datë 17.06.2025 ..... f. 913, Vol. II
Vendim nr. 41, datë 24.06.2025 ..... f. 932, Vol. II
Vendim nr. 42, datë 01.07.2025 ..... f. 942, Vol. II
Vendim nr. 43, datë 24.07.2025 ..... f. 997, Vol. II
Vendim nr. 44, datë 29.07.2025 ..... f. 1014, Vol. II
Vendim nr. 46, datë 18.09.2025 ..... f. 1127, Vol. II
Vendim nr. 47, datë 18.09.2025 ..... f. 1149, Vol. II
Vendim nr. 48, datë 22.09.2025 ..... f. 1158, Vol. II
Vendim nr. 50, datë 25.09.2025 ..... f. 1221, Vol. II
Vendim nr. 51, datë 25.09.2025 ..... f. 1237, Vol. II

Vendim nr. 52, datë 07.10.2025 ..... f. 1245, Vol. II
Vendim nr. 53, datë 09.10.2025 ..... f. 1264, Vol. II
Vendim nr. 54, datë 09.10.2025 ..... f. 1282, Vol. II

1.8. Procedura

1.8.1. Subjektet (legjitimimi)

Vendim nr. 27, datë 29.04.2025 ..... f. 659, Vol. II
Vendim nr. 28, datë 30.04.2025 ..... f. 676, Vol. II
Vendim nr. 29, datë 30.04.2025 ..... f. 693, Vol. II
Vendim nr. 30, datë 02.05.2025 ..... f. 709, Vol. II
Vendim nr. 31, datë 02.05.2025 ..... f. 726, Vol. II
Vendim nr. 32, datë 19.05.2025 ..... f. 748, Vol. II
Vendim nr. 33, datë 20.05.2025 ..... f. 766, Vol. II
Vendim nr. 34, datë 27.05.2025 ..... f. 807, Vol. II
Vendim nr. 35, datë 27.05.2025 ..... f. 828, Vol. II
Vendim nr. 36, datë 04.06.2025 ..... f. 853, Vol. II
Vendim nr. 37, datë 04.06.2025 ..... f. 869, Vol. II
Vendim nr. 38, datë 10.06.2025 ..... f. 879, Vol. II
Vendim nr. 39, datë 17.06.2025 ..... f. 897, Vol. II
Vendim nr. 40, datë 17.06.2025 ..... f. 913, Vol. II
Vendim nr. 41, datë 24.06.2025 ..... f. 932, Vol. II
Vendim nr. 42, datë 01.07.2025 ..... f. 942, Vol. II
Vendim nr. 43, datë 24.07.2025 ..... f. 997, Vol. II
Vendim nr. 44, datë 29.07.2025 ..... f. 1014, Vol. II
Vendim nr. 45, datë 31.07.2025 ..... f. 1077, Vol. II
Vendim nr. 46, datë 18.09.2025 ..... f. 1127, Vol. II
Vendim nr. 47, datë 18.09.2025 ..... f. 1149, Vol. II
Vendim nr. 48, datë 22.09.2025 ..... f. 1158, Vol. II
Vendim nr. 49, datë 24.09.2025 ..... f. 1196, Vol. II
Vendim nr. 50, datë 25.09.2025 ..... f. 1221, Vol. II
Vendim nr. 52, datë 07.10.2025 ..... f. 1245, Vol. II
Vendim nr. 53, datë 09.10.2025 ..... f. 1264, Vol. II
Vendim nr. 54, datë 09.10.2025 ..... f. 1282, Vol. II

1.8.2. Moslegjitimimi

1.8.2.1. *Ratione personae*

Vendim nr. 51, datë 25.09.2025 ..... f. 1237, Vol. II

1.8.2.2. *Shterimi i mjeteve*
(Nuk ka vendime në Vol. II)

1.8.2.3. *Ratione temporis*
(Nuk ka vendime në Vol. II)

1.8.3. Procedurat e ndërmjetme

1.8.3.1. Pezullimi
Vendim nr. 45, datë 31.07.2025 ..... f. 1077, Vol. II

1.8.3.2. Ndarja e çështjes
(Nuk ka vendime në Vol. II)

2. BURIMET E SË DREJTËS KUSHTETUESE

2.1. Rregullat e shkruara

2.1.1. Instrumentet ndërkombëtare

2.1.1.1. Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut dhe protokollet shtesë
Vendim nr. 27, datë 29.04.2025 ..... f. 659, Vol. II
Vendim nr. 28, datë 30.04.2025 ..... f. 676, Vol. II
Vendim nr. 29, datë 30.04.2025 ..... f. 693, Vol. II
Vendim nr. 30, datë 02.05.2025 ..... f. 709, Vol. II
Vendim nr. 36, datë 04.06.2025 ..... f. 853, Vol. II
Vendim nr. 39, datë 17.06.2025 ..... f. 897, Vol. II
Vendim nr. 40, datë 17.06.2025 ..... f. 913, Vol. II
Vendim nr. 44, datë 29.07.2025 ..... f. 1014, Vol. II
Vendim nr. 52, datë 07.10.2025 ..... f. 1245, Vol. II
Vendim nr. 54, datë 09.10.2025 ..... f. 1282, Vol. II

2.1.1.2. Konventa Europiane për Ekstradimin
(Nuk ka vendime në Vol. II)

2.1.1.3. Karta Europiane e Autonomisë Vendore
(Nuk ka vendime në Vol. II)

2.1.1.4. Konventa nr. 108 e Këshillit të Europës "Për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave personale"
Vendim nr. 44, datë 29.07.2025 ..... f. 1014, Vol. II

2.1.1.5. Deklarata e përbashkët e Ministrave Europianë të Arsimit, Bolonjë, 19 qershor 1999
Vendim nr. 43, datë 24.07.2025 ..... f. 997, Vol. II

2.1.1.6. Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Europiane e shteteve të tyre anëtare
(Nuk ka vendime në Vol. II)

2.1.1.7. Direktiva 42/2014 BE e Parlamentit Europian dhe e Këshillit, 3 prill 2014, "Për ngrirjen dhe konfiskimin e instrumenteve dhe të ardhurave nga krimi në Bashkimin Evropian"
Vendim nr. 33, datë 20.05.2025 ……f. 766, Vol. II

2.1.1.8. Direktiva BE 2024/1260, 24 prill 2024 "Për rikuperimin dhe konfiskimin e pasurive"
Vendim nr. 33, datë 20.05.2025 ……f. 766, vol. II

2.1.1.9. Direktiva 2006/126/KE e Parlamentit Europian dhe e Këshillit, 20 dhjetor 2006 "Për lejet e drejtimit"
Vendim nr. 49, datë 24.09.2025 ……f. 1196, Vol. II

2.1.1.10. Konventa ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Greqisë viti 1993 "Për ndihmën gjyqësore në çështjet civile dhe penale"
(Nuk ka vendime në Vol. II)

2.1.1.11. Konventa e Aarhusit (UNECE), 25 qershor 1998 "Për të drejtën e publikut për informacion, pjesëmarrje në vendimmarrje dhe të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës, për çështje mjedisore"
Vendim nr. 45, datë 31.07.2025 ……f. 1077, Vol. II

2.1.1.12. Konventa e Parisit "Për mbrojtjen e pronësisë industriale"
(Nuk ka vendime në Vol. II)

2.1.1.13. Protokolli i Marrëveshjes së Madridit "Për regjistrimin ndërkombëtar të markave"
(Nuk ka vendime në Vol. II)

2.1.1.14. Raporti i Komisionit të Venecias CDL-AD (2014)011 "Mbi mbi shtrirjen dhe heqjen e imuniteteve parlamentare"
(Nuk ka vendime në Vol. II)

2.1.2. Jurisprudenca

2.1.2.1. Jurisprudenca ndërkombëtare

2.1.2.1.1. Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut
Vendim nr. 29, datë 30.04.2025 ……f. 693, Vol. II
Vendim nr. 33, datë 20.05.2025 ……f. 766, Vol. II
Vendim nr. 40, datë 17.06.2025 ……f. 913, Vol. II
Vendim nr. 42, datë 01.07.2025 ……f. 942, Vol. II
Vendim nr. 44, datë 29.07.2025 ……f. 1014, Vol. II
Vendim nr. 45, datë 31.07.2025 ……f. 1077, Vol. II
Vendim nr. 46, datë 18.09.2025 ……f. 1127, Vol. II
Vendim nr. 52, datë 07.10.2025 ……f. 1245, Vol. II

Vendim nr. 53, datë 09.10.2025 ..... f. 1264, Vol. II
Vendim nr. 54, datë 09.10.2025 ..... f. 1282, Vol. II

2.1.2.1.2. Gjykata Europiane e Drejtësisë
(Nuk ka vendime në Vol. II)

2.1.2.1.3. Vendime të gjykatave kushtetuese të vendeve të tjera
(Nuk ka vendime në Vol. II)

2.1.2.2. Jurisprudenca kombëtare

2.1.2.2.1. Vendime të mëparshme të Gjykatës Kushtetuese
Vendim nr. 27, datë 29.04.2025 ..... f. 659, Vol. II
Vendim nr. 28, datë 30.04.2025 ..... f. 676, Vol. II
Vendim nr. 29, datë 30.04.2025 ..... f. 693, Vol. II
Vendim nr. 30, datë 02.05.2025 ..... f. 709, Vol. II
Vendim nr. 31, datë 02.05.2025 ..... f. 726, Vol. II
Vendim nr. 32, datë 19.05.2025 ..... f. 748, Vol. II
Vendim nr. 33, datë 20.05.2025 ..... f. 766, Vol. II
Vendim nr. 34, datë 27.05.2025 ..... f. 807, Vol. II
Vendim nr. 35, datë 27.05.2025 ..... f. 828, Vol. II
Vendim nr. 36, datë 04.06.2025 ..... f. 853, Vol. II
Vendim nr. 37, datë 04.06.2025 ..... f. 869, Vol. II
Vendim nr. 38, datë 10.06.2025 ..... f. 879, Vol. II
Vendim nr. 39, datë 17.06.2025 ..... f. 897, Vol. II
Vendim nr. 40, datë 17.06.2025 ..... f. 913, Vol. II
Vendim nr. 41, datë 24.06.2025 ..... f. 932, Vol. II
Vendim nr. 42, datë 01.07.2025 ..... f. 942, Vol. II
Vendim nr. 43, datë 24.07.2025 ..... f. 997, Vol. II
Vendim nr. 44, datë 29.07.2025 ..... f. 1014, Vol. II
Vendim nr. 48, datë 22.09.2025 ..... f. 1158, Vol. II
Vendim nr. 49, datë 24.09.2025 ..... f. 1196, Vol. II
Vendim nr. 50, datë 25.09.2025 ..... f. 1221, Vol. II
Vendim nr. 51, datë 25.09.2025 ..... f. 1237, Vol. II
Vendim nr. 53, datë 09.10.2025 ..... f. 1264, Vol. II

2.2. Hierarkia

2.2.1. Hierarkia ndërmjet akteve ndërkombëtare dhe akteve të brendshme
(Nuk ka vendime në Vol. II)

3. PARIME TË PËRGJITHSHME

3.1. Parimi i barazisë para ligjit
Vendim nr. 43, datë 24.07.2025 ..... f. 997, Vol. II

3.2. Parimi i hierarkisë së akteve
(Nuk ka vendime në Vol. II)

3.3. Parimi i shtetit të së drejtës
(Nuk ka vendime në Vol. II)

3.4. Parimi i sigurisë juridike
Vendim nr. 34, datë 27.05.2025 ……..f. 807, Vol. II

3.5. Të drejtat e fituara
Vendim nr. 43, datë 24.07.2025 ……..f. 997, Vol. II

3.6. Parimi i proporcionalitetit
Vendim nr. 44, datë 29.07.2025 ……..f. 1014, Vol. II

3.7. Parimi i ndarjes dhe i balancimit të pushteteve
(Nuk ka vendime në Vol. II)

3.8. Parimi i mosdënimit pa ligj (*nullum crimen nulla poena sine lege*)
Vendim nr. 33, datë 20.05.2025 ……..f. 766, Vol. II

3.9. Parimi i pavarësisë së gjyqësorit
(Nuk ka vendime në Vol. II)

4. INSTITUCIONET

4.1. Presidenti

4.1.1. Kompetencat

4.1.1.1. Marrëdhëniet me organet gjyqësore (Gjykatën Kushtetuese)
(Nuk ka vendime në Vol. II)

4.2. Legjislativi/ Kuvendi

4.2.1. Statusi i anëtarëve të Kuvendit (Imuniteti)
(Nuk ka vendime në Vol. II)

4.2.2. Përbërja

4.2.2.1. Mandati i anëtarit të Kuvendit

4.2.2.1.1. Mbarimi i mandatit
Vendim nr. 35, datë 27.05.2025 ……..f. 828, Vol. II

4.2.3. Organizimi

4.2.3.1. Zhvillimi i seancave plenare, mbledhjeve
(Nuk ka vendime në Vol. II)

4.2.4. Procedura ligjvënëse
Vendim nr. 45, datë 31.07.2025 ……..f. 1077, Vol. II

4.2.5. Marrëdhëniet me organet gjyqësore (Gjykatën Kushtetuese)
(Nuk ka vendime në Vol. II)

4.3. Pushteti gjyqësor

4.3.1. Gjykata e Lartë
(Nuk ka vendime në Vol. II)

4.4. Qeverisja vendore

4.4.1. Parimet themelore

4.4.1.1. Autonomia vendore
(Nuk ka vendime në Vol. II)

4.4.2. Ekzekutivi (Kryetari i Bashkisë)

4.4.2.1. Shkarkimi nga detyra i Kryetarit të Bashkisë
(Nuk ka vendime në Vol. II)

5. TË DREJTAT DHE LIRITË THEMELORE

5.1. Barazia (Mosdiskriminimi)

5.1.1. Qëllimi i zbatimit

5.1.1.1. Punësimi
Vendim nr. 43, datë 24.07.2025 ……f. 997, Vol. II

5.1.1.1.1. Punësimi në sektorin publik
(Nuk ka vendime në Vol. II)

5.1.1.1.2. Punësimi në sektorin privat
(Nuk ka vendime në Vol. II)

5.1.2. Kriteret e dallimit (diferencimit)

5.1.2.1. Mosha
Vendim nr. 49, datë 24.09.2025 ..... f. 1196, Vol. II

5.2. Të drejtat civile dhe politike

5.2.1. Liria individuale

5.2.1.1. Kufizimi i lirisë individuale

5.2.1.1.1. Masat e sigurimit
Vendim nr. 40, datë 17.06.2025 ..... f. 913, Vol. II

5.2.2. E drejta për të mos u dëbuar
(Nuk ka vendime në Vol. II)

5.2.3. Garancitë procedurale

5.2.3.1. Procesi i rregullt ligjor dhe fushat e zbatimit

5.2.3.1.1. Procedurë administrative
Vendim nr. 28, datë 30.04.2025 ..... f. 676, Vol. II
Vendim nr. 29, datë 30.04.2025 ..... f. 693, Vol. II
Vendim nr. 34, datë 27.05.2025 ..... f. 807, Vol. II
Vendim nr. 36, datë 04.06.2025 ..... f. 853, Vol. II
Vendim nr. 39, datë 17.06.2025 ..... f. 897, Vol. II
Vendim nr. 41, datë 24.06.2025 ..... f. 932, Vol. II
Vendim nr. 52, datë 07.10.2025 ..... f. 1245, Vol. II
Vendim nr. 53, datë 09.10.2025 ..... f. 1264, Vol. II

5.2.3.1.2. Procedurë civile
Vendim nr. 30, datë 02.05.2025 ..... f. 709, Vol. II
Vendim nr. 31, datë 02.05.2025 ..... f. 726, Vol. II
Vendim nr. 32, datë 19.05.2025 ..... f. 748, Vol. II
Vendim nr. 37, datë 04.06.2025 ..... f. 869, Vol. II
Vendim nr. 38, datë 10.06.2025 ..... f. 879, Vol. II
Vendim nr. 46, datë 18.09.2025 ..... f. 1127, Vol. II
Vendim nr. 48, datë 22.09.2025 ..... f. 1158, Vol. II
Vendim nr. 50, datë 25.09.2025 ..... f. 1221, Vol. II
Vendim nr. 54, datë 09.10.2025 ..... f. 1282, Vol. II

5.2.3.1.3. Procedurë penale
Vendim nr. 42, datë 01.07.2025 ..... f. 942, Vol. II
Vendim nr. 27, datë 29.04.2025 ..... f. 659, Vol. II
Vendim nr. 33, datë 20.05.2025 ..... f. 766, Vol. II
Vendim nr. 40, datë 17.06.2025 ..... f. 913, Vol. II
Vendim nr. 44, datë 29.07.2025 ..... f. 1014, Vol. II

5.2.3.1.4. E drejta për gjykim të drejtë
Vendim nr. 28, datë 30.04.2025 ..... f. 676, Vol. II
Vendim nr. 34, datë 27.05.2025 ..... f. 807, Vol. II

5.2.3.1.5. E drejta për t'iu drejtuar gjykatës (aksesi)
Vendim nr. 27, datë 29.04.2025 ..... f. 659, Vol. II
Vendim nr. 30, datë 02.05.2025 ..... f. 709, Vol. II
Vendim nr. 31, datë 02.05.2025 ..... f. 726, Vol. II
Vendim nr. 32, datë 19.05.2025 ..... f. 748, Vol. II
Vendim nr. 36, datë 04.06.2025 ..... f. 853, Vol. II
Vendim nr. 46, datë 18.09.2025 ..... f. 1127, Vol. II
Vendim nr. 50, datë 25.09.2025 ..... f. 1221, Vol. II
Vendim nr. 52, datë 07.10.2025 ..... f. 1245, Vol. II

5.2.3.1.5.1. E drejta për t'iu drejtuar gjykatës (aksesi substancial)
Vendim nr. 41, datë 24.06.2025 ..... f. 932, Vol. II

5.2.3.1.6. E drejta për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm
Vendim nr. 37, datë 04.06.2025 ..... f. 869, Vol. II
Vendim nr. 53, datë 09.10.2025 ..... f. 1264, Vol. II
Vendim nr. 54, datë 09.10.2025 ..... f. 1282, Vol. II

5.2.3.1.6.1. Ekzekutimi i vendimit
Vendim nr. 29, datë 30.04.2025 ..... f. 693, Vol. II

5.2.3.1.7. E drejta për t'u dëgjuar
(Nuk ka vendime në Vol. II)

5.2.3.1.8. E drejta për t'u mbrojtur
Vendim nr. 41, datë 24.06.2025 ..... f. 932, Vol. II

5.2.3.1.9. E drejta për të marrë në pyetje dëshmitarët (për të thirrur dëshmitarë)
(Nuk ka vendime në Vol. II)

5.2.3.1.10. Parimi i paanshmërisë
(Nuk ka vendime në Vol. II)

5.2.3.1.11. Barazia e armëve
Vendim nr. 48, datë 22.09.2025 ..... f. 1158, Vol. II

5.2.3.1.12. Parimi i kontradiktoritetit
(Nuk ka vendime në Vol. II)

5.2.3.1.13. Prezumimi i pafajësisë
Vendim nr. 27, datë 29.04.2025 ..... f. 659, Vol. II

5.2.3.1.14. E drejta për të qëndruar në heshtje

5.2.3.1.14.1. E drejta për të mos inkriminuar veten
(Nuk ka vendime në Vol. II)

5.2.3.1.15. Ligjshmëria e provave
(Nuk ka vendime në Vol. II)

5.2.3.1.16. E drejta për t'u gjykuar nga një "*gjykatë e caktuar me ligj*"
Vendim nr. 38, datë 10.06.2025 ..... f. 879, Vol. II
Vendim nr. 39, datë 17.06.2025 ..... f. 897, Vol. II

5.2.3.1.17. Parimi i gjësë së gjykuar *(res judicata)*
(Nuk ka vendime në Vol. II)

5.2.3.1.18. Arsyetimi i vendimit
Vendim nr. 27, datë 29.04.2025 ..... f. 659, Vol. II
Vendim nr. 30, datë 02.05.2025 ..... f. 709, Vol. II
Vendim nr. 31, datë 02.05.2025 ..... f. 726, Vol. II
Vendim nr. 32, datë 19.05.2025 ..... f. 748, Vol. II
Vendim nr. 36, datë 04.06.2025 ..... f. 853, Vol. II
Vendim nr. 39, datë 17.06.2025 ..... f. 897, Vol. II
Vendim nr. 48, datë 22.09.2025 ..... f. 1158, Vol. II
Vendim nr. 50, datë 25.09.2025 ..... f. 1221, Vol. II
Vendim nr. 52, datë 07.10.2025 ..... f. 1245, Vol. II

5.2.4. Parimi i mosgjykimit dy herë për të njëjtën vepër penale *(ne bis in idem)*
(Nuk ka vendime në Vol. II)

5.2.5. Liria e shprehjes
(Nuk ka vendime në Vol. II)

5.2.6. E drejta e jetës private

5.2.6.1. Mbrojtja e të dhënave personale
Vendim nr. 44, datë 29. 07. 2025 ..... f. 1014, Vol. II

5.2.7. Paprekshmëria e banesës
Vendim nr. 42, datë 01.07.2025 ..... f. 942, Vol. II

5.2.8. Paprekshmëria e komunikimit

5.2.8.1. Korrespondenca *(fshehtësia e korrespondencës)*
Vendim nr. 44, datë 29.07.2025 ..... f. 1014, Vol. II

5.2.9. E drejta e pronës

5.2.9.1. Shpronësimet
Vendim nr. 32, datë 19.05.2025 ……..f. 748, Vol. II
Vendim nr. 46, datë 18.09.2025 ……..f. 1127, Vol. II

5.2.9.2. Kufizime të tjera
Vendim nr. 33, datë 20.05.2025 ……..f. 766, Vol. II
Vendim nr. 38, datë 10.06.2025 ……..f. 879, Vol. II

5.2.10. E drejta e informimit
Vendim nr. 45, datë 31.07.2025 ……..f. 1077, Vol. II

5.3. Të drejtat ekonomike, shoqërore dhe kulturore

5.3.1. Liria për të patur një punë të paguar
(Nuk ka vendime në Vol. II)

5.3.2. Liria e veprimtarisë ekonomike dhe industriale
Vendim nr. 42, datë 01.07.2025 ……..f. 942, Vol. II
Vendim nr. 43, datë 24.07.2025 ……..f. 997, Vol. II

5.3.3. E drejta e punës dhe profesionit
(Nuk ka vendime në Vol. II)

5.3.4. E drejta për pension
(Nuk ka vendime në Vol. II)

Statistika mbi vendimmarrjen e Gjykatës Kushtetuese për vitin 2025

Vendime të dhëna gjithsej	429
Lloji i vendimit	
Vendime të seancës	85
Vendime moskalimi	344
Mënyra e përfundimit të çështjeve të gjykuara	
Pranim	24
Pranim pjesërisht	35
Konstatim + Rrëzim	1
Rrëzim	23
Pushim	1
Deklarim i mbarimit të mandatit	1
Efektet e vendimeve*	
Ex tunc (me efekt prapaveprues)	-
Ex nunc (me efekt nga dhënia e vendimit)	
Erga omnes (me efekt të përgjithshëm)	
Inter partes (me efekt mes palëve në gjykim)	
Të menjëhershëm	-
Shtyrje në kohë	-
Subjektet kërkuese	
Presidenti i Republikës	2
Kryeministri	-
1/5 e deputetëve	4
Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit	-
Gjykata	2
Avokati i Popullit	-
Organe të pushtetit vendor	-
Bashkësi fetare	-

* Në këto statistika janë përfshirë vetëm vendimet e marra mbi çështjet e shqyrtuara në seancë gjyqësore.

Partitë politike dhe organizatat të tjera	3
Individë, shoqëritë	74
Gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese	-
Objekt kontrolli	
Kushtetuta (Interpretim)	1
Saktësim, plotësim i vendimit të GJK	2
Ligje	6
Marrëveshje ndërkombëtare	-
Vendime të Kuvendit	1
Vendime të Këshillit të Ministrave	3
Vendime të gjykatave	68
Zgjidhje e mosmarrëveshjes së kompetencës	2
Mosekzekutim i vendimit gjyqësor të formës së prerë	-
Konstatim cenimi i procesit të rregullt ligjor	9
Rihapje e procesit gjyqësor nga GJEDNJ	3
Lloji i kërkesave	
Proces i rregullt ligjor	
Konflikt kompetence	2
Konflikt zgjedhor	1
Kushtetutshmëri e partive politike	-
Shkarkim i Presidentit të Republikës	-
Kushtetutshmëri e akteve normative organeve qendrore	3
Kushtetutshmëri e ligjit	6
Interpretim i Kushtetutës	1
Kushtetutshmëri e marrëveshjeve ndërkombëtare	-
Mbarim i mandatit të gjyqtarit të GjK	2
Llojet e kontrollit	
Kontroll konkret	79
Kontroll abstrakt	4
Kontroll incidental	2
Kontroll a priori	-
Kontroll a posteriori	85

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë
Shqipëri. Gjykata Kushtetuese
Vendime të Gjykatës Kushtetuese të
Republikës së Shqipërisë : 2025
/ Gjykata Kushtetuese.
- Tiranë : Onufri, 2026-
3 Vëllime ; 17x24.5 cm.
ISBN 9789928861580 (Set)
Vëllim 2, Vendime 27-54. - 2026. - 678 f.
ISBN 9789928861603 (v. 2)
1. Gjykata kushtetuese 2. Vendime gjyqësore
3. Shqipëri

342.565.2(496.5) “2025”